



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

V E N D I M

PËR MARRJEN E PERSONIT SI TË PANDEHUR DHE NJOFTIMIN E AKUZËS

Në Tiranë, më datë 11.09.2024, ne Arben KRAJA dhe Enkeleda MILLONAI, prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, në bazë të nenit 34 të K. Pr. Penale, me këtë akt i njoftojmë akuzën, personit që merr cilësinë e të pandehurit:

- **Sali Berisha**, i biri i Ramë dhe i Shiqere, datëlindja 15.10.1944, lindur në Tropojë, me nr. personal E40701031R, me masë sigurimi personal "*arrest në shtëpi*" parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale,

Ai akuzohet se, ka kryer veprën penale të "*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*", kryer në bashkëpunim me shtetasin Jamarbër Malltezi, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Në përfundim të hetimeve, në kuadër të procedimit penal, nr 287 të vitit 2020, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Shtetasi Jamarbër Malltezi, rezulton të jetë trashëgimtar i familjes Begeja, trashëgimi që rrjedh nga gjyshja e tij, Nimete Bekteshi sipas dëshmisë së trashëgimisë, të çelur me vendimin nr. 6368 datë 15.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 1/8 pjesë takuese.

Gjithashtu edhe shtetasi Xhimi Begeja rezulton të jetë trashëgimtar i familjes Begeja.

Familja Begeja pretenduese pronare mbi 28 dynym tokë, në sipërfaqet ku shtriheshin dy klubet Sportive Partizani, në Tiranë, i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe është njohur pronare në vitin 1996, duke iu kthyer, po gjatë këtij viti, një sipërfaqe prej 2 335 m², ndërkohë që i është njohur e drejta e parablerjes së objekteve sportive. Nga viti 1996 deri në vitin 2006, nuk konstatohet të ketë vendime për kthim prone nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), për këto territore.

Gjithashtu, pretenduese dhe të njohura pronare, mbi territoret ku shtriheshin dy Klubet Sportive Partizani, janë edhe katër familje të tjera, Llagami, Vaqarri, Alimehmeti dhe Saliaga. Edhe këtyre familjeve u janë njohur deri në vitin 1999, prona të ndodhura në këto territore si dhe u është kthyer një pjesë e tyre.

Shtetasi Fatmir Bektashi i cili është ortak i shoqërisë Kontakt sh.p.k., me objekt veprimtarie në fushën e ndërtimeve, rezulton gjithashtu të jetë trashëgimtar i familjes Vaqarri, konkretisht shtetases Fitnet Bektashi, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr 12672/9525 datë 10.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me VKM nr 312 dt 15.05.2003 "Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportesh "Partizani" nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" është vendosur që Klubi Shumësportesh Partizani të kalojë në varësinë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve kurse me VKM nr. 515 dt 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes" është vendosur miratimi i listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, ku ndërmjet të tjerave, identifikohen pronat me nr. 7 Orkestra frymore e ushtrisë dhe me nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani.

Të dy Klubet Sportive, rezulton të jenë inventarizuar si klasa të veçanta, në respektim të Udhëzimit nr 2 dt 30.04.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralimit, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave publike, gërma B, sipas të cilës inventarizohen si **klasa të veçanta**, duke përfshirë të renditur dhe komponentët përbërës:... b. Zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, rendit dhe të sigurisë publike.... Megjithatë, në kundërshtim me ligjin nr 8743 dt 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", nuk rezulton të jenë regjistruar në ZRPP dhe madje edhe kur janë privatizuar, nuk kanë qenë te regjistruara.

Në territoret e Klubit të Futbollit Partizani, në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes, që prej vitit 2000 ka ushtruar aktivitetin e saj shoqëria Partizani sh.a. e regjistruar sipas vendimit gjyqësor nr 24628 dt 07.11.2000, pas miratimit të marrë nga Federata Shqiptare e Futbollit. Sipas statutit dhe aktit të themelimit të kësaj shoqërie, përcaktohet se **përfaqësimi i Ministrisë së Mbrojtjes nën juridiksionin e të cilit ndodhej Klubi i Futbollit Partizani, do të bëhet në formën e zotërimit të një aksioni, i cili është kontribut i këtij institucioni dhe është i barazvlefshëm me emrin dhe stemën e Klubit. Ky kontribut nuk mund të shitet, dhurohet apo të ndryshojë pronësinë.** Megjithëse Ministri i Mbrojtjes i kohës, nuk ka qenë dakord me krijimin e shoqërisë Partizani sh.a. duke i dërguar madje edhe një shkresë më dt 19.12.2000, Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, për prishjen e regjistrimit të shoqërisë së mësipërme, nuk gjenden gjurmë të prishjes së kësaj shoqërie apo largimit nga ambjentet e Klubit të Futbollit Partizani.

Madje referuar raportit për vlerësimin e kapitalit të Klubit të Futbollit Partizani, dt 27.03.2012, ekspertet e caktuara në atë kohë, nga Ministria e Mbrojtjes, sipas urdhërit nr 408 dt 13.03.2012, kanë pasqyruar ndër të tjera se: " **...Klubi i Futbollit "Partizani" është krijuar në vitin 1947 dhe rezulton pjesëmarrës pa ndërprerje në veprimtaritë kombëtare të futbollit.** ...Referuar një shkresë të vitit 2011 të Ministrisë së Mbrojtjes, këto eksperte kanë theksuar se: **... Ministria e Mbrojtjes është personi juridik që ka zotëruar dhe zotëron të gjitha të drejtat mbi këtë emër...**

Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, ka regjistruar më dt 04.06.2012, shoqërinë "Klubi i Futbollit "PARTIZANI" sh.a, me Nipt L21804007A, me kapital me vlerë 3 500 000 lekë, ku kontributi në para është 2 000 000 lekë, kurse pjesa tjetër, ka derivuar nga vlerësimi dhe arritjet e klubit që nga viti 1947 (janë bërë pjesë e kapitalit, mbështetur në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr 7066 dt 01.10.2010 dhe të METE nr 8758/1 dt 25.10.2010 "Për zbatimin e VKM nr 1718 dt 24.12.2008" pika 3, ku parashikohet se, kapitali themeltar i shoqërive aksionere që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv, do të bazohet ndër të tjera, në vlerën e emrit të klubit dhe logos së tij, bazuar në vitin e krijimit dhe viteve të aktivitetit).

Kurse në lidhje me Klubin Shumësportesh Partizani, është konstatuar se, me urdhërin nr. 603 dt 20.11.2003 "Për miratimin e statutit të Klubit Shumësportesh Partizani" të Ministrisë së

Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, është miratuar **statuti i Klubit Shumësportesh Partizani**, ku ky i fundit identifikohet si *një organizatë sportive, person juridik publik në varësinë e Ministrisë së Kulturës*, duke u emëruar në detyrën e drejtorit Ekzekutiv të tij, shtetasi Isa Tare. Ky klub ka vijuar aktivitetin e tij sportiv, dokumentuar në një sërë dokumentash të administruara nga Ministria e Kulturës.

Privatizimi i Klubit të Futbollit Partizani, duket se ka gjetur diskutim dhe mbështetje, që në mesin e vitit 2005, kur evidentohet korrespondencë e Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetur edhe në kërkesat e shoqërisë Partizani sh.a., por kjo procedurë, ka mbetur në fazat fillestare.

Në vitin 2005, pasi shtetasi Sali Berisha zgjidhet Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, konstatohet se shtetasit Jamarbër dhe Argita Malltezi, të cilët rezultojnë të kenë qënë të punësuar pranë UNMIK, Kosovë, fillojnë të zhvillojnë pjesën më të madhe të aktivitetit të tyre në Shqipëri.

Shtetasi Jamarbër Malltezi, në muajin janar 2006 konstatohet se është përfshirë në një projekt të rëndësishëm, duke mbajtur edhe pozicionin e koordinatorit të projektit "*Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare*" me financim në shumën 950 000 \$ midis Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Ministrisë së Financave dhe duke u atashuar me zyra pranë Ministrisë së Punëve Publike.

Shtetësja Argita Malltezi, nga ana tjetër, ka vendosur të ushtrojë profesionin e avokates, siç edhe deklaroi shtetësja Flutura Kola, me të cilën nga viti 2005 kanë krijuar një shoqëri të thjeshtë të cilën kanë dashur ta regjistrojnë në Dhomën e Avokatisë.

Shtetasi Jamarbër Malltezi, dukshëm konstatohet se, paraqitet si një person që mbarte pushtet, për shkak të lidhjeve familjare të tij.

Nga hetimet e kryera, është konkluduar se shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Sali Berisha, kanë konsumuar veprën penale të "*Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*" në bashkëpunim me njëri tjetrin, parashikuar nga neni 260 e 25 i K.Penal kurse shtetasi Fatmir Bektashi, ka konsumuar veprën penale të "*Korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*" parashikuar nga neni 245 i K.Penal, përse më poshtë:

Veprat penale të sanksionuara për të mbrojtur rregullat e vendosura për funksionimin e shtetit, kanë në fokus të tyre, pikërisht funksionimin e organizmave shtetërore në mënyrën e duhur, transparente dhe të ndershme, në kërkim dhe mbrojtje të interesit publik, mbrojtjen e besimit të qytetarit tek shteti dhe funksionarët e tij.

Korrupsioni si aktiv ashtu edhe ai pasiv, janë dy anë të të njëjtit fenomen, ku njëri ofron, premtion dhe tjetri pranon/kërkon ofertën, premtimin ose dhuratën.

Korrupsioni në thelb të tij, ka qëllimin, i cili duhet të mbulojë të gjithë elementët thelbësorë të veprës penale dhe duhet të lidhet me një rezultat në të ardhmen, me një pritshmëri të pretenduar se nga ana e zyrtarit do të kryhet apo jo detyra, pavarësisht se në konkluzion, zyrtari vepron ose jo sipas qëllimit të mitës.

Subjekti që kryen korrupsionin aktiv mund të jetë kushdo, edhe çdo qytetar i thjeshtë apo një shoqëri tregtare.

Subjekti që kryen korrupsionin pasiv duhet të jetë zyrtar, pavarësisht se mita është për të apo ndonjë person të tretë.

Kjo vepër penale, konsumohet nëpërmjet premtimit, ofrimit ose kërkimit apo dhënies së një avantazhi të padrejtë, drejtëpërdrejtë ose edhe indirekt, për zyrtarin ose për një person tjetër.

Premtimi ka të bëjë me situatat, kur subjekti i korrupsionit aktiv, premtton për dhënien e një përfitimi të padrejtë në të ardhmen (*zakonisht pasi zyrtari ka kryer sjelljen që pritet prej tij*) ose kur ekziston një marrëveshje, ndërmjet subjektit të korrupsionit aktiv dhe subjektit të korrupsionit pasiv, që mita do të jepet në një fazë të mëvonshme. Nga tërësia e të dhënave të administruara deri në këtë moment, ashtu si paraqitet e shkruar nëpër akte, duke i lexuar ato në përputhje me njëra – tjetrën dhe ballafaquar me ngjarjet reale që kanë ndodhur, vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se, shtetasi Fatmir Bektashi, ka premtuar, dhënien e një pjesë të përfitimit, që do të realizohej nga shitjet e objekteve që do të ndërtoheshin në territoret e dy klubeve sportive Partizani. Dhënia e këtij premtimi, mbështetej në kërkesën e realizimit të *kthimit të plotë të territoreve, privatizimin e objekteve të ndodhura në të, ndryshimin e destinacionit të zonës sportive në zonë banimi*, që do të sillte një zhvillim ndërtimi të konsiderueshëm dhe në këtë mënyrë fitim të madh. I vetmi që kishte pushtetin e mjaftueshëm për të kontrolluar të gjithë sektorët ku mund të realizoheshin këto objektiva, ishte shtetasi Sali Berisha. Kontaktet për arritjen e këtij qëllimi, dokumentohen të jenë realizuar mes dhëndrrit të këtij të fundit, shtetasit Jamarbër Malltezi dhe shtetasit Fatmir Bektashi. Shtetasi Sali Berisha, nga leximi në tërësi i provave të administruara përgjatë gjykimit, rezulton të ketë marrë përsipër përmbushjen e kërkesave, duke pranuar shpërblimin/mitën që në vijim kalon në bashkësinë ligjore të familjes së vazjës së tij, shtetases Argita Malltezi, nëpërmjet shtetasit Jamarbër Malltezi.

Me shkresën e dt. 23.11.2022 drejtuar Studio Pustinës, shtetasi Xhimi Begeja i pakënaqur kur janë ndarë përfitimet, është shprehur: *“... Ju besova verbërisht sepse Gita dhe Abi më garantuan qysh nga dita e parë ku studio e juaj të jetë garantusja ligjore dhe financiare në marrveshjet e kontratat tona... Nuk kam qenë pengesë në anjë moment të firmosja vetëm “letër të bardhë” sepse e konsideroja veten turp nëqoftë se nuk do ju besoja... Kam përshtypjen se ajo Gocë e Familjes nuk ka pas dhe as ka dijeni për situatën e krijuar tani mes nesh. Unë nuk e kam shqetësuar dhe nuk do e shqetësoj kurrë për hallin e madh që ka zënë, por aq më tepër ne si familje i kemi borxh të madh Familjes Berisha për shqetësimet që i kemi sjellë ku shkaktare është prona jonë...”* (shtetasi Xhimi Begeja, në këtë letër fjalët *“Gocë e familjes”* dhe *“Familja Berisha”* i shkruan me shkronja të mëdha duke treguar konceptimin që ka ai për pushtetin e familjes Berisha).

Ndërkaq, me qëllim ruajtjen e imazhit të një politikani që nuk është pasuruar asnjëherë, shtetasi Sali Berisha, nuk do të rriste formalisht pasurinë e tij, dhe ky përfitim do të kalonte tek shtetasi Jamarbër Malltezi, i martuar dhe si më sipërcituar, në bashkësi ligjore, me shtetasen Argita Malltezi, vajzën e shtetasit Sali Berisha. Siç edhe rezulton nga hetimi, aksesit në pasuritë e shtetasve Malltezi, është i përhershëm nga familja Berisha dhe jo thjesht shfrytëzimi i pasurive të tyre për akomodim por edhe përdorimi i shumave monetare, në vlera që, pasur parasysh nivelin ekonomik të një politikani shqiptar, mbështetur vetëm në pagën e tij, nuk justifikohen.

Megjithatë, siç rezultoi nga hetimi, shtetasi Sali Berisha, ka përfituar avantazhe të drejtëpërdrejta, jo vetëm nëpërmjet shfrytëzimit të pasurive të familjes Malltezi, por ai ka përfituar financim nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në kuadrin e fushatës zgjedhore të vitit 2013,

nëpërmjet pagesave që janë kryer, për akomodimin dhe udhëtimin e një këngëtarit të ftuar prej tij.

Shtetasi Jamarbër Malltezi duke qëndruar në këtë aktivitet korrupsioni në anën pasive, në bashkëpunim me shtetasin Sali Berisha, në pranimin e premtimeve të bëra dhe në vijim siç rezulton nga hetimi, kërkimin e mitës dhe shtënies në dorë të saj, nëpërmjet një sërë transaksionesh, të fshehta dhe kamufluese, i ka treguar që në fillimet e veta shtetasit Fatmir Bektashi por edhe trashëgimtarëve të familjeve pronare, se që të arriheshin objektivat duhet të paguanin. Sjellim në vëmendje se fillimisht kanë qënë familjarët Begeja që kanë vendosur të bashkëpunonin për arritjen e këtyre objektiveve, duke vendosur në dispozicion 3 – 5% të pasurisë së tyre për arritjen e këtyre objektiveve, dhe kjo pasqyrohet më së miri në prokurat e lëshuara nga ata. Por në vijim, pasur parasysht madhësinë e sipërmarrjes së synuar, kontraktimin e shoqërisë Kontakt për zhvillimin e gjithë trojeve (*përveç një pjese ku rezulton shoqëria Eralb sh.p.k.*), ka qënë shtetasi Fatmir Bektashi, i interesuar për arritjen e të gjithë këtyre objektiveve, duke marrë përsipër, dhe duke e theksuar në thujtje te gjitha aktet që nënshkruan, kryerjen e shpenzimeve dhe siç rezulton nga hetimi edhe dhënien e përfitimeve/mitës.

Me tërësinë e familjeve të njohura pronare, përveç familjes Begeja, kontaktet mbahen nga shtetasit Fatmir Bektashi dhe personi garantues i shfaqur publikisht tek të tretët, në vend të shtetasit Jamarbër Malltezi, i arritjes së objektiveve të kërkuara, shtetasi Xhimi Begeja. Shtetasi Fatmir Bektashi do të jepte përfitimin e paligjshëm por që të realizonte këtë gjë, duhet të kishte pronat jo vetem te tijat, por të të pesë familjeve të njohura pronare. Për familjen Begeja, për vënien e tokës në dispozicion për zhvillimin e ndërtimit, garantues është shtetasi Jamarbër Malltezi, kurse me familjet e tjera pronare, Saliaga, Llagami, Vaqarri dhe Alimehmeti, kontaktet mbahen nga shtetasi Fatmir Bektashi, me përfaqësuesit e këtyre të fundit.

Interesat e shtetasit Jamarbër Malltezi, në realizimin e objektiveve të kërkuara nga ofruesi i mitës, konkordojnë në një pikë me ofruesin e mitës, për shkak se si trashëgimtar i familjes Begeja, cilësi që e fiton në nëntor 2006, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerës gjyshes së tij, Nimete Bekteshi, bëjnë që ai përveç mitës, përfiton drejtëpërdrejtë edhe si bashkëpronar trualli.

Ndryshimi i destinacionit të zonës sportive në zonë banimi

Kërkesat e shtetasit Fatmir Bektashi për objektivat që kërkon të arrijë nëpërmjet pushtetit të shtetasit Sali Berisha, e konkretisht ***ndryshimi i destinacionit të zonës sportive në zonë banimi***, përkundrejt përfitimit që ai do të japë si mitë, lexohen në aktet e lidhura me shtetasin Jamarbër Malltezi.

- Kontratë sipërmarrje nr 4938/831 rep/kol datë **22.05.2006** të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin: ***Sipas n 1, objekti i kontratës së sipërmarrjes është kthimi i destinacionit të tokës nga zonë sportive në zonë për ndërtim banesa, privatizimi i objekteve ekzistuese dhe bashkëpunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional me emër kompleksi Paschal.***
- Kontratë sipërmarrje nr. 8032/ 1303 rep/kol datë **20.07.2006** të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës

sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin:...*Ndërtimi i objektit shumëfunksional, ...Leja e ndërtimit do të merret 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje (ndërtimi sjellim në vëmendje se nuk kryhet pa u ndryshuar destinacioni);*

Kryerja e sjelljes së kërkuar nga ana zyrtarit:

- Vendimi nr. 4 dt **21.11.2006** "Për miratimin e ndryshimit në planin rregullues të Qytetit të Tiranës në lidhje me zonimin funksional për disa zona të qytetit" ku përfshihet dhe zona me sipërfaqe 0.7 ha në Rrugën "Frosina Plaku", e cila ndryshohet nga "zonë sportive" në "zonë banimi". Ky vendim është firmosur nga Kryetari i KRRT-së Z. Sali Berisha.

Kërkesat e shtetasit Fatmir Bektashi për objektivat që kërkon të arrijë nëpërmjet pushtetit të shtetasit Sali Berisha, e konkretisht ndryshimi i destinacionit të zonës sportive në zonë banimi, lexohen në aktet e lidhura me shtetasin Jamarbër Malltezi:

- Kontratë sipërmarrje nr 8346/1265 rep/kol datë **22.10.2007** të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin:...**Neni 4: Ndërrimi i destinacionit të zonës ku ndodhet trualli: ...** Pala sipërmarrëse dhe pala pronare marrin përsipër që të realizojë detyrimet sipas afateve të mëposhtme: **Ndërrimin e destinacionit të zonës sportive në zonë banimi 24 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje**
- Deklaratë nr. 759/99 kol dt **01.02.2008**, të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin, për vënie në dispozicion të sipërfaqeve të tjera për ndërtim (*sjellim në vëmendje se ndërtimi nuk mund të realizohet pa u ndryshuar destinacioni*)
- Akt marrëveshje për pjesmarrje në investim me nr 3000 rep datë **02.10.2008**, të Kompleksit Begeja 6000, për pronat e familjes Begeja dhe Shtojcë nr 3193/1891 rep/kol datë **15.10.2008** e akt marrëveshjes për ndërtimin e Kompleksit Begeja 6000, duke u shtruar edhe pronat e familjeve Vaqarri, Llagami, Saliaga dhe prona të familjes Begeja të cilat nuk mund të zhvilloheshin pa u ndryshuar destinacioni; (*Këtë objektiv shoqëria Kontakt sh.p.k. e përcjell tek trashëgimtarët Saliaga me kontratën e sipërmarrjes nr 8668/1309 rep/kol dt 02.11.2007, nr 2831 (2891)/486 rep/kol dt 29.09.2008 me familjen Llagami, kontratën nr 3735/630 kol dt 03.12.2008 me familjen Alimehmeti; kontratën nr 1466/421 rep/kol kol dt 03.05.2010 me familjen Vaqarri etj.*)

Kryerja e sjelljes së kërkuar nga ana e zyrtarit:

- Me vendimin nr. 1 datë **15.02.2013**, Këshilli Kombëtar i Territorit, me kryetar shtetasin Sali Berisha, ka vendosur:
1) *Miratimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Tiranë. ...*

Sa më lart, arritja e objektivave të kërkuara për dhënien e përfitimit, janë kryer drejtëpërdrejtë nga shtetasi Sali Berisha.

KRRT-së e Bashkisë, Tiranë në vitin 2006, kishte një shumicë të cilësuar nga përfaqësues të pushtetit qendror. Vetë Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr 29 dt **21.12.2006**, arsyeton se:

“...N 19 i ligjit nr. 8405, dt 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, që parashikon përbërjen e KRRT-së së Bashkisë, Tiranë me një shumicë të cilësuar nga përfaqësues të pushtetit qendror dhe me pakicën prej 1/3-ës të anëtarëve nga pushteti vendor.... shumica e cilësuar e anëtarëve të KRRT-së, nuk përfaqësojnë bashkinë. Ekzistenca e një rregullimi normues të tillë, që kërkon minimumin e 2/3-ve të anëtarëve për të konsideruar të vlefshme mbledhjen e KRRT-së, nuk i krijon mundësi autoritetit vendor të gëzojë instrumentet e nevojshme ligjore për ushtrimin normalisht të funksionit dhe të vendimmarrjes në fushën e planifikimit urban, duke e vendosur atë, në këtë mënyrë, nën vullnetin e pushtetit qendror...”. Në fakt, pushtetin e KRRTRSH-së, në vendimmarrjet e KRRT-së së Bashkisë Tiranë, kjo e fundit, e ka kundërshtuar pranë Gjykatës Kushtetuese. Subjektet e interesuara, e specifikisht KRRTRSH-ja, konstatohet se është përfaqësuar pikërisht nga shtetasi **Marin Biçoku**. Gjithashtu, edhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, konstatohet ndër të tjerë se është përfaqësuar nga shtetasi **Andi Toma dhe Marin Biçoku**. Shtetasi Andi Toma, rezulton të jetë bashkëshorti i shtetases Laura Pustina, noterja tek e cila vijon të bëhet pjesa dërrmuese e akteve noteriale që lidhen me familjen Berisha, Malltezi dhe ato me shoqërinë Homeplan. Shtetësja Laura Pustina është motra e shtetases Andia Pustina që në vijim mban kontabilitetin e shoqërisë Homeplan sh.p.k.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr 29 datë 21.12.2006, ka vendosur të deklarojë të papajtueshme me Kushtetutën e RSH dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, n. 10 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, që parashikonte se, **KRRTRSH-ja kryesisht ose me kërkesë të këshillave lokalë, prefekturave, në rastet kur vëren shkelje ligjore në marrjen e vendimeve nga KRRT-të e rretheve dhe të bashkive kur pengohet realizimi i programi të qeverisë, shqyrton dhe merr vendime, duke shfuqizuar vendimet e marra nga KRRT-të e rretheve dhe të bashkive. Prefekturat sipas kompetencave territoriale të tyre kanë të drejtë që të pezullojnë zbatimin e vendimeve të KRRT-ve deri në shqyrtimin e tyre në KRRTRSH**. Megjithatë, si edhe më sipër cituar, rezulton se vendimi i KRRTRSH-së, për rastin konkret, është marrë më dt 21.11.2006, një muaj para se Gjykata Kushtetuese të deklaronte këtë papajtueshmëri.

Kthimi i pronave

Kërkesat e shtetasi Fatmir Bektashi, për objektivat që kërkon të arrijë nëpërmjet pushtetit të shtetasi Sali Berisha, e konkretisht ***kthimi i pronës***, përkundrajt përfitimit që ai do të japë si mitë, lexohet nga tërësia e provave të administruara përgjatë hetimit, si marrja përsipër fillimisht nga shtetasi Jamarbër Malltezi të kthimit të pronave të familjes Begeja e më pas, mbledhja e trashëgimtarëve të të pesta familjeve të njohura pronare, duke u marrë përsipër realizimi i të gjithë objektiveve.

Kthimi përfundimtar i pronave për të gjitha familjet e njohura pronare, bëhet në të njëjtën kohë, gjë, që tregon kalimin edhe në drejtim të një hapi tjetër për realizimin e objektivit tjetër të kërkuar nga shtetasi Fatmir Bektashi, zhvillimin e ndërtimeve. Sjellim në vëmendje se zhvillimi në një sipërfaqe sa më të madhe të ndërtimit sillte, edhe rritjen e përfitimeve të premtuara si mitë.

Më dt 21.11.2023 shtetasi **Ervin Llagami**, ka deklaruar se, ... **Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja kishin marrë përsipër para nesh, anëtarëve të tjerë që do e mbaronin ata këtë punë, do interesoheshin ata për këtë punë si kthimin ashtu edhe privatizimin me qellim përfundimtar zhvillimin e pronës.** ...

Më dt 23.02.2024 shtetasi **Blendi Marika**, deklaruar se, ... ***I ka përfaqësuar familjarët e tjerë që i kanë dhënë prokurë, në takimet me familjarët e familjeve të tjera ish pronare. Takimet***

me familjet e tjera ish pronare në fillim para privatizimit i realizonin në kafe dhe pas privatizimit në zyrat tek Klubi i Futbollit Partizani. Kërkesa për kthimin e truallit mesa kujton është bërë në një kërkesë të vetme pasi ky ka qënë dhe qëllimi i mbledhjes së bashku të të gjitha familjeve ish pronare që të vepronin të gjithë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë.Shtetasi Xhimi Begeja e ka njohur për herë të parë në takimet që kanë organizuar familjet ish-pronare në lidhje me zhvillimin e pronës, ku ky shtetas ishte përfaqësues i familjes Begeja, i cili e përfaqësonte këtë familje i vetëm. Nga familja Vaqarri, kujton që përfaqësues ishte shtetasi Fatmir Bektashi dhe familjet e tjera kishin mesa kujton, më shumë se një përfaqësues.

Më datë 22.11.2022, shtetasi Iglit Vaqarri, i cili ka deklaruar se, shoqërinë Kontakt e ka pasur Fatmir Bektashi i cili është pronar toke tek pjesa e familjes Vaqari, është djalë halle i Iglit, i biri i Fitnetit, dhe Fatmiri kishte këtë shoqërinë që bënte ndërtime. Kështu, që duke e pasur njeriun e tyre, kishin biseduar që në pronën e tyre të përbashkët, të kryente ndërtime. ...Iglit ka biseduar vetëm me Fatmirin në lidhje me kërkesën për kthimin e pronës. Në lidhje me privatizimin deklaroi se, Fatmiri dhe gjithë pronarët e tjerë bënë dokumentat përkatëse në dikastere si tek kthimi i pronave, tek Ministria e Ekonomisë.

Më datë 24.05.2022 shtetasi Muharrem Lika, trashëgimtar i familjes Begeja, deklaroi se me shtetasin Jamarbër Malltezi janë takuar vetëm një herë, para se të niste ndërtimi i pallateve për të dakordësuar për firmën e ndërtimit dhe mesa kujton kanë qënë rreth 10 – 12 persona ku kanë qënë prezent Gëzim Begeja, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi. Takimi është realizuar në lokalitë e shtetasis Xhimi Begeja tek Ekspozita Shqipëria sot, në katin e 13-të dhe është diskutuar që ndërtimet do të kryheshin nga firma e Fatmir Bektashit. Me këto punë më së shumti është marrë shtetasi Xhimi Begeja.

Nervit Hoxha dhe Rajmonda Bekteshi, emërojnë si përfaqësues vëllain e tyre, Bashkim Bekteshi, ku ndër të tjera i japin tagre për t'u paraqitur pranë Agjencisë së Kthimit të Pronave (shih prokurën e posaçme nr. 9605 rep nr. 1550 kol datë 05.09.2006, nr 1108 rep nr. 124/2 kol datë 21.10.2006).

Fadil, Hamide Saliaga, Xhevrije Mullisi, Tire Deda (Luzi), Fatmir Luzi, emërojnë si përfaqësues të tyre av Silvana Bello (shih prokurën e posaçme nr. 6335 rep nr. 877 kol datë 04.11.2006)...

Për familjen Begeja, megjithëse ishin lëshuar një sërë prokurash duke u caktuar shtetasi Jamarbër Malltezi si përfaqësues i tyre, në të vërtetë në KKKP paraqitet shtetasi Bashkim Bektashi, mbi bazë të prokurave të vjetra që kishte (si përfaqësues me prokurën nr. 1007 rep nr 262 kol dt 13.03.2002) por duke u vendosur si adresë kontakti në kërkesë xhibeg1900@yahoo.com, adresa e emailit të shtetasis Xhimi Begeja, që pasqyrohej si mëkëmbësi i shtetait Jamarbër Malltezi.

Arritja e Objektivave, në këtë rast, evidentohet me shfrytëzimin e kompetencave, nëpërmjet presionit të ushtrimit të pushtetit qeverisës të shtetasis Sali Berisha. Pak pas ardhjes në pushtet të këtij të fundit, shtetasi Bashkim Bekteshi dorëzon në muajin tetor 2005 kërkesën për kthim prone dhe:

- Më datë 20.01.2006 KKKP ka vendosur: **Të kthejë pronën me një sip truall prej 11 740 m².**

Ndëshkimi i korrupsionit të politikanit, në kuadrin e veprës penale të korrupsionit, mbi të gjitha, ka synimin që, të mbrohet transparenca, drejtësia dhe paanësia në procesin vendimmarrës, nga manovrat korruptive të tyre.

Arritja e Objektivave, në këtë rast, evidentohet me përgatitjen e kushteve për konkludimin me sukses të kthimit të pronave, duke ushtruar pushtetin dhe rolin e tij në propozimin e projektligjeve, projekt vendimeve, në bashkëpunim me aleatët e vetë politik, e në vijim fitimin e pushtetit mbi Agjensinë e Kthimit të Pronave, emërimin e personave të besuar në pozicione kyçe, duke u shfrytëzuar kompetencat e këtyre të fundit, nëpërmjet presionit të ushtrimit të pushtetit të tij qeverisës.

Ndëshkimi i korrupsionit të politikanit, në kuadrin e veprës penale të korrupsionit, mbi të gjitha, ka synimin që, të mbrohet transparenca, drejtësia dhe paanësia në procesin vendimmarrës, nga manovrat korruptive të tyre.

Në rastin konkret, shtetasi Sali Berisha, në cilësinë e kryeministrit të R.Sh. me detyrën për t'i shërbyer qytetarëve, ka zgjedhur t'i japë ligjeve dhe akteve nënligjore, formën që i përshtatet interesave të familjes së tij.

Konkretisht:

- Këshilli i Ministrave, miraton VKM nr 723 datë 23.11.2005, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës"
- Në lidhje me paraqitjen e propozimeve për ndryshimin e ligjit, në proces verbalin dt 13.07.2006 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, shtetasi *Arian Madhi* është shprehur: "...Pas një procesi të gjatë bisedimesh me qeverinë, lidhur me disa përmirësime të ligjit dhe projekt ligjit të qeverisë, kemi përfunduar një marrëveshje me mirëkuptim të plotë. Materiali që keni si projekt, shpreh qëndrimin e përbashkët të qeverisë dhe PR, me përjashtim vetëm të një dispozite që ndajmë qëndrime të ndryshme të kthimit të pakufi për ne dhe qeveria deri në 100 ha tokë bujqësore....Jemi të bindur që agjencia e kthimit dhe kompensimit të pronave, që do të varet nga qeveria, do të jetë shumë më efektive, se përgjegjësitë janë të ekzekutivit lidhur me angazhimet që ai ka dhe të mos përsërisë historinë, që për hir të qëndrimit politik, pengojnë procesin me kosto politike.
- Më datë 17.07.2006, miratohet ligji nr 9583/2006 që sillte ndryshime në ligjin për kthimin e pronave.

Konkretisht ndryshoi n 6, në këtë mënyrë: .../c. Subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale - shkencore të instituteve kërkimore-shkencore dhe në çdo veprimtari tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore, por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre. ...

Janë shfuqizuar parashikimet e ligjit të mëparshëm për Kthimin dhe Kompensimin e pronave, që sanksiononte se nëse kishte ndërtime ose investime të kryera në përputhje me legjislacionin në fuqi, në varësi të vlerës së tyre, vendosej nëse do i ktheheshin subjekteve të shpronësuara apo pronësia do i mbetej shtetit, duke u përcaktuar tashmë me ndryshimet e reja se i kthehen pronarit, vetëm me kufizimin që të mos përdoren më për interes publik.

U miratua me këtë ligj n. 15 "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", dhe dispozita të tjera që sollën edhe një rritje të madhe të pushtetit të kryeministrit. Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e pronave, përbëhej nga anëtarë që emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Kuvendi. Tashmë

pas ndryshimeve të bëra, u krijua Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si person juridik publik, ku mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

- Më datë 23.08.2006 u miratua VKM nr. 566/2006 “Për organizimin dhe funksionimin e AKKP” me propozimin e Kryeministrit, sipas të cilës, rezulton se AKKP është në varësi të Ministrit të Drejtësisë por, organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të kryeministrit me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP, emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit (ndërsa 2 *z/drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë*), dhe përveç të tjerave:... *Raporton, informon dhe i relatton për veprimtarinë e agjencisë, ministrit të Drejtësisë, ... zbaton udhëzimet e tij... i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të RSH, ku ndërmjet të tjerave evidentohet se raportohen edhe: ... të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit. ...*

Në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, parashikohet më parë se, komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave përbëheshin nga anëtarë që emëroheshin nga Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e pronave ndërsa pas këtyre ndryshimeve, Drejtuesit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Drejtori i zyrës rajonale *u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Prefektit të Qarkut... të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të zyrës rajonale, duhet të vihet në dijeni drejtori i Përgjithshëm apo prefekti.*

Ndërmjet të tjerave, këto ndryshime sollën edhe zgjatjen e afatit të paraqitjes së kërkesave për kthimin e pronës.

- Pikërisht pasi Kryeministri Sali Berisha, ka marrë pushtet të mjaftueshëm në lidhje me AKKP, emëron në detyrë si Drejtoreshë të kësaj të fundit, shtetasen Justina Boriçi. Në deklarinë dt 26.09.2023 kjo shtetase deklaron: “..... Në muajin gusht të vitit 2006 më ka thirrur kryeministri Sali Berisha, i cili më ka bërë të ditur se isha emëruar si drejtoreshë e përgjithshme e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. ..”
- Shtetësja Justina Boriçi emëron, drejtoreshën e Zyrës Rajonale të AKKP, shtetasen Dhurata Hoxha (Çela), me urdhërin nr. 203 dt 09.10.2006 e cila qëndron në detyrë deri më dt 02.08.2007. Në deklarinë e dt 26.09.2023, shtetësja Justina Boriçi deklaron: “...Unë nuk e njihja Dhurata Hoxhën dhe emërimi i saj mesa më kujtohet ka ardhur me rekomandim por nuk më kujtohet se kush saktësisht e ka rekomanduar. Përgjithësisht rekomandimet vinin nga lart që mund të ishte zëvendës kryeministri por në rastin konkret nuk di të jap një përgjigje të saktë. ...”
- Me urdhërin nr. 248 dt 01.11.2006 “Për emërim në detyrë”, rezulton se është emëruar në detyrën përgjegjëse në sektorin juridik, pranë AKKP Tiranë, shtetësja Tetis

Lubonja. Sipas të dhënave të deklaruara prej vetë kësaj të fundit, më dt 15.06.2023, ajo ka miqësi të vjetër me shtetasin Jamarbër Malltezin të cilin e ka njohur prej vitit 1992 dhe ka pasur dijeni që ishte një nga trashëgimtarët e familjes Begeja. Gjithashtu ka njohur edhe shtetasen Rudina Llagami, e të cilën deklaroi se ka punuar në Kryeministri. Për më tepër, shtetësja Tetis Lubonja, ka deklaruar, se ka punuar pranë kësaj zyre vetëm 10 muaj dhe më pas është larguar me kërkesën e saj dhe është ripunësuar pranë Ministrisë së Integritimit Europian. Megjithatë nga të dhënat e hetimit, rezultoi se kjo shtetase, ka pasur marrëdhënie punësimi edhe me shoqërinë Kontakt sh.p.k. që zhvillon ndërtimet në këto prona që kthehen. Ajo shfaqet në listë pagesat e kësaj shoqërie, përgjatë periudhës tatimore 2009, pa përshkrim në lidhje me pozicionin që mban ose si punëtoare.

- Grupi i punës që është ngarkuar me shqyrtimin e kësaj dosje, është shtetasi Altin Ceni (jurist), Petrit Kullolli (topograf) dhe Tetis Lubonja (përgjegjëse e sektorit juridik). Shtetasi *Petrit Kullolli* i pyetur më datë 26.05.2022 ka deklaruar se, *shtetasin Jamarbër Malltezi nuk e njeh dhe nuk e ka takuar asnjëherë, e njeh vetëm nga mediat*. Por siç rezultoi në vijim, *ky shtetas ka përpiluar plane rilevimi për pasuritë familjare të shtetasit Jamarbër Malltezi të ndodhura në Priskë*.
- Nisja me shqyrtimin me prioritet të dosjeve të pesë familjeve të njohura pronare. E pyetur më dt 15.06.2023, shtetësja *Tetis Lubonja*, ka deklaruar: *"... Kur ka nisur të nxjerri vendime (AKKP) këto kanë qenë nga dosjet e para që na janë dhënë për t'u shqyrtuar dhe vazhduam shqyrtimin..."*. E pyetur nëse kanë pasur ndonjë ndikim nga eprorët ose persona të tretë për të përshpejtuar procedurën, është përgjigjur: *"Na është thënë nga Drejtori i Zyrës, e cila ka qenë shtetësja Dhurata Hoxha se këto do të ishin dosjet e para që do të shqyrtoheshin dhe ne kemi zbatuar urdhërin e saj"*.

Realizimi i Objektivave:

- Me vendimin Nr. 6 dt **21.03.2007**, të AKKP-së, është vendosur: **t'i kthehet** subjektit të shpronësuar **Mahmut dhe Xhemal Begeja**, nga sipërfaqja e e pronës së njohur, prej 14 360 m2 **një sipërfaqe prej 12,596 m2. ...**
- Me vendimin Nr. 7 dt **21.03.2007** të AKKP-së, është vendosur **t'i kthehet** subjektit të shpronësuar **Qamil Saliaga**, nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 8, 780 m2 **një sipërfaqe trualli prej 4779 m2.**
- Me vendimin Nr.09 dt **26.03.2007** të AKKP-së, është vendosur **të kthehet** nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 11,070 m2, një sipërfaqe trualli prej **10,975 m2** subjektit të shpronësuar **Dylbere Vaqarrit**.
- Me vendimin Nr.08 dt **23.03.2007** të AKKP-së, është vendosur **të kthehet** nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 10,860 m2 një sipërfaqe trualli prej **7, 930 m2** (subjektit të shpronësuar **Rexhep Alimehmeti** .
- Me vendimin Nr. 64, dt **18.05.2007** të AKKP-së ka vendosur **të kthejë** nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 5650 m2, sipërfaqen e lirë prej **3910 m2** subjektit të shpronësuar **Sabrije Llagami**.

Në këto vendimmarrje, kanë ndodhur një sërë shkeljesh ligjore të shoqëruara edhe me pasoja, të analizuar më gjatë në aktin e vendimit për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës.

Konkluzione në lidhje me kthimin e pronave:

AKP, ka shqyrtuar me shpejtësi të pajustificuar, kërkesat e pesë familjeve të njohura pronare, në krahasim me kërkesat e qytetarëve të tjerë, pasur parasysh ngarkesën dhe volumin e dosjeve që kishte. Kërkesa e familjes Begeja është paraqitur në mesin e muajit dhjetor 2006. Menjëherë pas përfundimit të pushimeve dimërore, më datë 08 dhe 09 janar 2007 grupi i punës është aktivizuar për të nisur nga puna me këto dosje.

Kërkesat e gjendura në dosje, specifikisht ato që i përkasin familjeve Alimehmeti, Saliaga dhe Begeja janë thuajse të njëjta me njëra – tjetrën, duke vërtetuar faktin se janë përgatitur nga e njëjta dorë, mbështetur edhe në deklaratimet e dhëna nga shtetas të ndryshëm gjatë hetimit, që këto kërkesa janë kryer pas mbledhjeve të anëtarëve të familjeve. Për familjen Begeja, kërkesa është paraqitur nga shtetasi Bashkim Bekteshi, daja i shtetasit Jamarbër Malltezi. Paraqitja e kësaj kërkesë konstatohet se është bërë nën udhëzimet e shtetasve Fatmir Bektashi, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi, siç edhe rezultojnë nga dëshmitë e ndryshme në lidhje me takimet e zhvilluara ndërmjet trashëgimtarëve në lokalitetin Begeja por edhe siç pasqyrohet në deklaratën e nënshkruar nga shtetasi Bashkim Bekteshi, gjendet adresa e emailit të shtetasit Xhimi Begeja dhe adresa e lokalitit të tij Begeja.

Grupi i punës, ka pasqyruar, sikur janë kryer verifikime në terren, për familjet, ndërkohë që nuk rezultojnë të kenë qenë të pranishëm subjektet kërkuese, duke vërtetuar fiktivitetin e këtyre verifikimeve. Kjo gjë mbështetet edhe nga fakti se ka qenë realisht e pamundur, kryerja e verifikimeve, matjeve të sipërfaqeve të tokave, brenda një dite, pasur parasysh madhësinë e tyre, apo pasur parasysh deklaratimet kontradiktore të dy punonjësve të AKP-së që, prezumohet se kanë qenë në terren (*shtetasi Petrit Kullolli deklaroi se nuk ka konstatuar aktivitete sportive në të kundërt nga shtetasi Altin Ceni*). Verifikimet në terren nuk kanë pasur mundësi të kryeshin pa prezencën e subjekteve dhe përcaktimin e sipërfaqes së saktë, të pretenduar për t'u kthyer si dhe përshkrimin e objekteve të ndodhura në to. Moskryerja e verifikimit mbështetet ndër të tjera edhe në faktin se përgjatë regjistrimit të pasurive të këtyre familjeve, nga matjet, disa sipërfaqe kanë rezultuar më të vogla në terren. Për më tepër, në rast se do të ishin kryer verifikimet në terren do të ishin konstatuar objekte të shtetit apo të subjekteve të treta ose ndërtime të paligjshme, ku sipërfaqja e truallit e ndodhur nën to, nuk mund të kthehej.

Janë administruar shkresa pa protokoll dhe pa pasur ekstremitetet e dokumentave (fotokopje). Rezultojnë se i është nisur kërkesë Ministrisë së Mbrojtjes, duke u mbështetur në një dokument të dorëzuar fotokopje nga shtetasi Bashkim Bekteshi, (*pa noterizuar apo njehsuar me origjinalin*). Për më tepër, ky dokument kishte të bënte pikërisht me nisjen e procesit të privatizimit, duke treguar se familjet pronare, kishin mundësi të aksesonin dokumenta zyrtarë pa u dokumentuar formalisht nga ka ardhur ky aksesim.

Me shkresën nr. 121/3 prot dt 14.02.2007, Bashkia e Tiranës (*shih dosjen e familjes Begeja*), bën me dije se, nga informacioni i dhënë nga Njësia e Planit Rregullues, zona për të cilën interesohet KKKP është **pjesërisht zonë sportive dhe zonë banimi dhe sipas planit të përgjithshëm rregullues** (*për të cilën nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar*) dhe pjesërisht përfshihet në studimin urbanistik pjesor të miratuar me vendim të KRRT Tiranë nr. 76 datë 18.03.2005. N. 8/1 i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës, pas ndryshimeve të pësuara më dt 17.07.2006, parashikonte në lidhje me truallin e zënë me ndërtime në pronësi të shtetit se, **kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik**, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Referuar n 3 të ligjit nr 8743 datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të*

shtetit", i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike, zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike. Janë gjithashtu prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe aktivitet e ngurtësuar (ose të trupëzuara) që shërbejnë për krverjen e shërbimeve publike si... ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti, për arsimin, shkencën, kulturën dhe sportet..., për institucionet qendrore dhe vendore. Sipas n. 4 Ndryshimi i statusit të një prone të paluajtshme të shtetit nga publike në jopublike bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Në n. 31 pika 1, të ligjit nr 9376 të vitit 2005, para ndryshimeve të mëtejshme, parashikohet se ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qendror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".

Pra nga sa më sipër, qartësisht konstatohet se territoret e sipërcituara, për të cilat vendoset kthimi, janë prona të shtetit që paraqesin një interes publik dhe si të tilla nuk mund të ktheheshin, përse kohë, shërbenin për kryerjen e shërbimeve publike, siç ishin ato në fushën sportive.

Nga grupi i punës, janë përpiluar relacione fiktive referuar kohës së kryerjes, pra data e vendosur në këto relacione, nuk përputhet me përmbajtjen, pasi janë cituar shkresa që janë administruar më vonë. Kjo nënkupton se datat fiktive, janë vendosur vetëm për të treguar një radhë pune që duket se nuk është ndjekur dhe përpilimi e plotësimi i akteve është kryer formalisht, në mënyrë që të konkludohej sa më parë me vendimmarrje.

Janë marrë vendime, pa u administruar përgjigjet nga institucionet.

Nuk është mbledhur informacioni i duhur nga institucionet, pasi këtyre të fundit, nuk i është kërkuar informacioni i saktë vetëm zonën e pretenduar për kthim.

Konstatohet se mënyra se si janë trajtuar këto dosje, është e njëjtë dhe duke u shfrytëzuar dokumentat e njëres apo tjetres dosje, pa u mbajtur akte dokumentimi të marrjes së akteve nga njëra dosje tek tjetra. Kështu sjellim në vëmendje konkretisht shkresat e Ministrisë së Mbrojtjes.

Janë kthyer prona në kundërshtim me n. 41 dhe 42 të Kushtetutën e Republikës, që garanton mbrojtjen e pronës. KKKP dhe AKKP ka vepruar në kundërshtim me n 7 gërma "b" të ligjit nr. 9235 dt 08.06.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" në të cilin sanksionohet se nuk kthehen pronat që janë të zëna sipas akteve ligjore të paraqitura në shtojcën 1 të këtij ligji. Në shtojcën 1 pika 2 të këtij ligji, parashikohen pronat e zëna nga ligji nr. 7512 datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit" duke sjellë në këtë mënyrë, konflikte me vëllezërit Kapollari dhe shoqërinë G Kam.

Janë kthyer prona në kundërshtim me ligjin nr.9235, dt 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", pasi rezulton se është kthyer një pjesë prone që ka qenë në planin e përhapjes, konkretisht Orkestra frymore në KS Partizani ka qenë pjesë e planit të përhapjes (shih delaratën dt 12.07.2007 të familjes Saliaga, drejtar ZVRPP se *përse i përket mbulesës tjetër të pasurisë së tyre të paluajtshme Reparti Ushtarak nr. 6612, bashkëpronarët nuk heqin dorë nga e drejta e tyre si bashkëpronar, por këtë problem e lenë përkohësisht menjëherë për ta zgjidhur në rrugë gjyqësore....*).

Gjithashtu, rezulton se kthimi i pronave si më sipër, ka sjellë problematika, pasi ka krijuar mbivendosje edhe me institutin Hidrometeorologjik. Kthimi i pronave pikërisht familjes Begeja, ka sjellë mbivendosje me ambientet e këtij instituti, truell ku ndodheshin objekte që i përkasin Observatorit të Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit. Observatori i IHM sipas listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore (për inventarizimin e pronave të veçanta) ka të përcaktuar se prona Godina e Observatorit Tiranë, ndodhur në rrugën Frosina Plaku, ka sipërfaqe totale të pronës 3700 m² nga e cila ndërtesë 667.4 m² dhe sipërfaqe të brendshme 1335 m².

Në kundërshtim me kreu III të VKM nr. 747 dt 09.11.2006 "*Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës*" nuk janë administruar të dhëna nga ALUIZNI mbi ndërtimet e kryera, nëse janë apo jo në proces legalizimi. Sipas ligjit Nr.9583, dt 17.7.2006 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar*" është shtuar n. 28/1 "*Dispozita kalimtare*" parashikohet se: *Për pasuri të paluajtshme, mbi të cilat janë ngritur nga të tretë objekte pa leje në kundërshtim me ligjin "Për urbanistikën", kthimi fizik nuk zbatohet pa përfunduar afatet ligjore të parashikuara për legalizimin e objekteve në zona informale dhe objekte të tjera informale me vendndodhje brenda territoreve formale.*Nga aktet e administruara pranë AKKP-së nuk rezultoi të jetë administruar asnjë dokument që të verifikonte faktin nëse kishte objekte pa leje të ndërtuara dhe nëse ishin në proces legalizimi. Në territoret sportive, ishin vendosur shumë familje të cilat edhe kishin paraqitur praktikat pranë ALUIZNI-t për legalizim apo familje apo të cilat ishin futur në objektet sportive të klubeve, si të pastrehë. Këta shtetas, në vijim quhen si "*uzurpatorë*" nga shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, dhe ku këta të fundit, me qëllim largimin e tyre, detyrohet edhe t'i paguajnë në vlera monetare ose me dhënie njësie banimi.

Nuk janë administruar të dhëna nga Enti Kombëtar i Banesave, në kundërshtim me parashikimin e n 9 të ligjit nr 9235 dt 29.07.2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*" dhe parashikimet e VKM nr 747 dt 09.11.2006, megjithëse nga hetimi ka rezultuar se në objektet e Klubeve Sportive, janë strehuar një kategori qytetarësh. Konkretisht sipas urdhërit nr. 81 regj dt 14.02.1996 (*Ministria e Mbrojtjes*) dhe nr. 210 regj (*Ministria e Punës...*) "*Për kalimin kapital ndërtese dhe ambientesh*" pasqyrohet se, mbështetur në VKM nr. 153 dt 03.04.1993 "*Për kalimin kapital të objekteve dhe mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore*" dhe nisur nga kërkesat e organeve të ish të përndjekurve politikë, që Ushtria të ndihmojë për strehimin e kësaj kategorie qytetarësh me objekte të liruara prej saj, urdhërohet: *Ndërtesa 2 katëshe e lojërave me dorë dhe ambientet e ndërtesës 2 katëshe ish e atletikës të Klubit Sportiv Olimpik Partizani Tiranë, të cilat që nga viti 1992 kur kanë mbetur të lira nga reduktimi i aktiviteteve të Klubit janë përdorur për të strehuar familje ish të përndjekura politike, i bëhen kalim kapitali Ministrisë së Punës...për t'i përdorur për banesa për familje ish të përndjekura. Dorëzimi të bëhet brenda datës 10.03.1996 nga KSO Partizani.*

Sa më lart, tregon qartazi për një urgjencë në kryerjen e veprimeve, që vërteton se, punonjësit e AKKP-së kishin marrë udhëzime për kryerjen e kthimit të kësaj prone, sa më shpejt të ishte e mundur. Pasur parasysh që shtetasit Altin Ceni dhe Tetis Lubonja ishin emëruar në muajin nëntor 2006, ndërkohë që shtetësja Dhurata Hoxha është emëruar në tetor 2006, konstatohet se puna e tyre ka nisur pikërisht me këto kërkesa të reja.

I. Privatizimi i objekteve dhe terrreneve sportive

Kërkesat e shtetasit Fatmir Bektashi, për objektivat që kërkon të arrijë nëpërmjet pushtetit të shtetasit Sali Berisha, e konkretisht privatizimi i objekteve, përkundrejt përfitimit që ai do të japë si mitë, lexohet nga një sërë aktesh.

Siç edhe më lart u citua, shtetasit Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja, kanë organizuar të pesta familjet pronare në takime, ku kanë marrë përsipër para tyre, arritjen e të gjithë objektivave. Normalisht nuk mund të mohohet, besimi i krijuar tek familjet pronare mbi arritjen e këtyre objektivave, pasur parasysh dijeninë e tyre se edhe shtetasi Jamarbër Malltezi, ishte trashëgimtar i familjes Begeja. Përkundrejt premtimit të shtetasve Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja ata kanë lëshuar një sërë prokurash për përfaqësuesit e tyre duke cituar...*të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për privatizimin e ndërtesave... (nr. 6335/877 rep/kol dt. 04.11.2006;*

- Kontratë sipërmarrje nr 4938/831 rep/kol datë **22.05.2006** të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin: *Sipas n 1, objekti i kontratës së sipërmarrjes është kthimi i destinacionit të tokës nga zonë sportive në zonë për ndërtim banesa, privatizimi i objekteve ekzistuese dhe bashkëpunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional me emër kompleksi Paschal.*
- Kontratë sipërmarrje nr. 8032/ 1303 rep/kol datë **20.07.2006** të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin: *...Ndërtimi i objektit shumëfunksional, ...Leja e ndërtimit do të merret 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje. (ndërtimi sjellim në vëmendje se nuk kryhet pa u privatizuar objektet);*
- Kontratë shtesë e kontratës së sipërmarrjes (nr 4938/831 rep/kol dt. 22.05.2006) me nr 8166/1249 rep/kol dt. **11.10.2007**, e lidhur ndërmjet shtetasit Jamarbër Malltezi si përfaqësues i familjes Begeja dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k., ku ndër të tjera, rritet sipërfaqja e ndërtimit të vënë në dispozicion, *(ndërtimi sjellim në vëmendje se nuk kryhet pa u privatizuar objektet);*
- Kontratë sipërmarrje nr 8346/1265 rep/kol dt. **22.10.2007** ndërmjet shtetasit Jamarbër Malltezi si përfaqësues i familjes Begeja dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. si sipërmarrës, ku vihen në dispozicion sipërfaqe trualli, me qëllim ndërrim destinacioni të zonës dhe ndërtimi i banesave në të *(ndërtimi sjellim në vëmendje se nuk kryhet pa u privatizuar objektet);*
- Deklaratën noteriale nr. 10084/1541 rep/kol dt **31.12.2007**, mes shoqërisë së ndërtimit Kontakt sh.p.k. dhe shtetasit Jamarbër Malltezi si trashëgimtar i familjeve Begeja për shtyrjen e afatit të për nxjerrjen e lejes së ndërtimit *(ndërtimi nuk mund të realizohet pa u privatizuar objektet);*
- Deklaratë nr. 759/99 kol dt **01.02.2008**, të lidhur mes shtetasit Jamarbër Malltezi në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja si palë pronare dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. me ortak shtetasin Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse që do të zhvillonte ndërtimin, për vënie në dispozicion të sipërfaqeve të tjera për ndërtim *(ndërtimi nuk mund të realizohet pa u privatizuar objektet);*
- Akt marrëveshje të datës **18.02.2008** për pjesmarrje në investime të lidhura ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, për zhvillimin e ndërtimeve në pronat e familjes Begeja, që ende nuk ishin privatizuar dhe që pavarësisht këtyre akt marrëveshje nuk rezulton që shtetasit Jamarbër Malltezi dhe

Xhimi Begeja të kenë investuar;

- Akt marrëveshje për pjesmarrje në investim me nr 3000 rep datë **02.10.2008**, të Kompleksit Begeja 6000, për pronat e familjes Begeja,
 - Shtojcë nr 3193/1891 rep/kol datë **15.10.2008** e akt marrëveshje për ndërtimin e Kompleksit Begeja 6000, duke u shtruar edhe pronat e familjeve Vaqarri, Llagami, Saliaga dhe prona të familjes Begeja;
 - Kontratë sipërmarrje ndërtimi nr 3329/1967 kol dt. **28.10.2008** ndërmjet shoqërisë Homeplan sh.p.k. dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. ku pasqyrohet sikur shoqëria Homeplan do të investojë në ndërtimin e Kompleksit Homeplan etj.;
- (Këtë objektiv shoqëria Kontakt sh.p.k. e përcjell tek trashëgimtarët Vaqarri me kontratën nr 574/177 rep/kol dt. 16.04.2007; Saliaga me kontratën e sipërmarrjes nr 8668/1309 rep/kol dt 02.11.2007, nr 2831 (2891)/486 rep/kol dt 29.09.2008 me familjen Llagami, kontratën nr 3735/630 kol dt 03.12.2008 me familjen Alimehmeti; kontratën nr 1466/421 rep/kol kol dt 03.05.2010 me familjen Vaqarri; Deklaratë noteriale e familjes Vaqarri ku shtetasi Fatmir Bektashi është vetë trashëgimtar nr 911/203 rep/kol dt. 28.04.2008 etj.)

Arritja e Objektivave, në këtë rast, nga ana e shtetasit Sali Berisha, evidentohet me përgatitjen e kushteve për konkludimin me sukses të privatizimit, duke ushtruar pushtetin dhe rolin e tij në propozimin e projektligjeve apo marrjen e vendimeve të qeverisë, në bashkëpunim me aleatët e vetë politik, duke shfrytëzuar kompetencat e vartësve të tij, nëpërmjet presionit të ushtrimit të pushtetit të tij qeverisës.

Në rastin konkret, shtetasi Sali Berisha, në cilësinë e kryeministrit të R.Sh. me detyrën për t'i shërbyer qytetarëve, ka zgjedhur t'i japë ligjeve dhe akteve nënligjore, formën që i përshtatet interesave të familjes së tij.

- Më dt **18.06.2008** miratohet VKM nr. 906/2008 për propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9376 dt 21.05.2005 "*Për Sportin*", që lejon privatizimin e objekteve sportive;
- Më dt **17.12.2008** miratohet VKM nr. 1638/2008 "*Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes*", ku përcaktohet se blerja e objekteve që privatizohen, mund të bëhet me **bono privatizimi**, propozuar me shkresën Nr. 10807 Prot. dt **16.12.2008**, të Ministrit Genc Ruli, METE, me të cilën përcillet projekt vendimi;

Shtetasi Sali Berisha, gjithashtu ka shfrytëzuar funksionin e vet, me qëllim detyrimin e Komandantit të Komandës Mbështetëse për të marrë në dorëzim pronën nr 11, Klubi i Futbollit Partizani dhe lidhjen e kontratës së shitjes.

- Më dt **16.04.2009**, Kryeministri Sali Berisha, nxjerr urdhërin Nr. 1289 Prot "*Mbi kontrollin tematik në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës Nr.11, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes*". Drejtori Oerd Bylykbashi, mbështetur në konceptimin e bërë nga shtetasi Ilir Kadiu, ka përgatitur programin e kontrollit me nr. 1289 prot dt 16.04.2009, i cili në vijim rezulton të jetë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm Gjergj Lezhja. Më dt **24.04.2009** shtetasi Gjergj Lezhja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, i ka kërkuar shtetasit Vladimir Qiriazi, të verë në dispozicion të grupit të kontrollit, praktikën në lidhje me pronën, në kuadër të kontrollit. Inspektorët e Departamentit Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, shtetasit **Ilir Kadiu** dhe Saimir Struga, mbajnë aktin e kontrollit dt **04.05.2009**. ...

gjejnë përgjegjës shtetasin Vladimir Qiriazhi ... çka ngarkon me përgjegjësi Vladimir Qiriazhin. .. Komanda Mbështetëse ... duhej të kishte dorëzuar objektin brenda afateve ligjore... Më dt. 19.05.2009 Këshilli i Ministrave e konkretisht Sekretari i Përgjithshëm Gjergj Lezhja (konc nga Ilir Kadiu dhe nënshkruar nga drejtori Oerd Bylykbashi), ka dërguar raportin e kontrollit pranë Ministrit të Mbrojtjes, Gazmend Oketa dhe Komandantit Vladimir Qiriazhi, rekomandojnë: Komanda Mbështetëse ... të përfundojë procedurat e dorëzimit të pronës nr. 11 brenda 5 ditëve. Ministri i Mbrojtjes të fillojë menjëherë procedurat disiplinore për z. Vladimir Qiriazhi...për zbatimin e rekomandimeve ... të njoftohet zyrtarisht Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave brenda 10 ditëve. (tërheq vëmendjen në këtë shkresë përmendja e fjalëve "uzurpatorë" për personat që kanë shfrytëzuar ambjentet e klubit të futbollit Partizani, që është i njëjti term i përdorur nga shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi në aktet që mban studio Pustina)

Veprimet e kryera nga vartësit e tij:

- Me shkresën nr. 9549/3 prot dt 14.11.2005, Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, i parashtron Ministrit të Ekonomisë, Genc Ruli, se: Klubi i Futbollit Partizani..... propozojnë miratimin e privatizimit ...duke mirëpritur sugjerimet e METE në lidhje me forma të tjera.
- Mosfutja në planin e përhapjes e Klubit të Futbollit Partizani. Megjithëse në shkresën nr 6932 prot dt 09.08.2006, të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, është vlerësuar që Klubi i Futbollit Partizani, duhet të ishte pjesë e Planit të Përhapjes, kjo pronë është lënë jashtë këtij plani përhapje dërguar nga Ministri i Mbrojtjes dhe miratuar në vijim, nga Presidenti i Republikës më dt 29.08.2007.
- METE, shtetasi Genc Ruli, me shkresën Nr. 9508 Prot. dt 18.12.2007 ka ngritur komisionin e vlerësimit për Klubin e Futbollit Partizani, të përbërë nga *Mynyre Pajana, Stefan Tane*; Ekspert Vlerësues Znj.*Elvira Aliaj* dhe Ekspert Kontabël i autorizuar *Sali Preçi (anëtar)*, ndërkohë që më dt 21.11.2007, kishin hyrë në fuqi ndryshimet e ligjit për sportin dhe nuk lejohej më privatizimi i objekteve sportive
- Ministri Ylli Pango, në kundërshtim me n. 31 të ligjit për sportin, i ndryshuar mbi bazë të vetë propozimeve të tij, me shkresën dt 04.01.2008 shprehet dakort për privatizimin e Klubit Shumësportësh "Partizani".
- Ministri i METE shtetasi Genc Ruli, më dt.22.01.2008, miraton privatizimin e Klubit Shumësportësh "Partizani", ndërkohë që më dt 21.11.2007, kishin hyrë në fuqi ndryshimet e ligjit për sportin dhe nuk lejohej më privatizimi i objekteve sportive
- Ngrihet Komisioni i Vlerësimit për vlerësimin e Klubit Shumësportësh Partizani, sipas shkresës dt 04.02.2008 të Ministrit Genc Ruli, me përbërje: *Irfan Hoxha, Afrim Tola*; Ekspert Vlerësues i Licensuar i pasurive të paluajtshme *Elvira Aliaj*; Ekspert Kontabël i autorizuar *Sali Preçi*, ndërkohë që më dt 21.11.2007, kishin hyrë në fuqi ndryshimet e ligjit për sportin dhe nuk lejohej më privatizimi i objekteve sportive
- Në datë dt 02.06.2008, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i është adresuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Brendshme duke i dërguar për mendim projekt vendimin për ndryshime sërish në ligjin për sportin, të cilat tashmë tashmë konsistonin në zhbërjen e ndryshimeve të mëparshme, pra që pengonin privatizimin e objekteve sportive.
- Me vendimin Nr. 7, dt 01.09.2008 të regjistruarit të ZVRPP, është vendosur: *Fshirja e regjistrimit të kryernë emër të Esat Pira dhe Marita Osmani dhenë emër të Novruz Nurka si regjistrime të kryera në kundërshtim me ligjin, lënë në fuqi, persona*

- që rezultonin të kishin në pronësi pjesë toke në pishinën Laprakë, që i nënshtrohej privatizimit bashkë me Klubin e Shumësportëshit Partizani, Me vendimin Nr.39 Prot. dt 12.09.2008 kryeregjistruesi Arben Qirjako, le në fuqi këtë vendim.
- Më dt 27.11.2008, nënshkruhet programi i punës “Për auditim të plotë në Komandën Mbështetëse”, miratuar nga Ministri i Mbrojtjes Gazmend Oketa. Periudha e auditimit është nga auditimi i fundit deri më 30.10.2008, si formë presioni ndaj Komandës Mbështetëse që nuk merrte në dorëzim pronën Klubi i Futbollit Partizani dhe më dt 12.02.2009 të drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Mbrojtjes, shtyhet koha për të cilën Komanda Mbështetëse i nënshtrohet auditimit, deri më datë 31.01.2009
 - Me urdhërin nr. 334 dt 13.03.2009 Ministri i Mbrojtjes Gazmend Oketa, urdhëron Komandën Mbështetëse të përfaqësojë Ministrinë e Mbrojtjes nëpërmjet dorëzimit dhe nënshkrimit të kontratës së shitjes së pronës nr. 11 me emërtim “Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani” Tiranë.
 - Më dt 26.03.2009 shtetasi Vladimir Qiriazhi me telefon i është kërkuar zbatimi me urgjencë i urdhërit nr. 334 dt 13.03.2009 “Për dorëzim prone e lidhje kontrate” për pronën nr. 11. ... Ndjejhet i shqetësuar për mënyrën se si i kërkohet kjo firmosje ndaj dhe kërkon mendimin e tij. (shih shkresën me të cilën shtetasi Vladimir Qiriazhi ka informuar Shefit e Shtabit të Përgjithshëm)
 - Më dt 31.03.2009 Drejtori i DMIBM shtetasi Ardian Shashaj i dërgon dy shkresa Komandës Mbështetëse duke bërë me dije edhe Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa, Sekretarin e Përgjithshëm Fiqiri Kupe dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm Maksim Malaj. Në këto shkresa i tërhiqet vëmendje Komandës Mbështetëse për sjelljen e saj ..
 - Më dt 31 mars 2009 shtetasi Vladimir Qiriazhi është thirrur në takim nga Ministri i Mbrojtjes z. Gazmend Oketa. ... Në takim i cili zgjati një orë e gjysëm, Ministri i Mbrojtjes i ka kërkuar të firmosja kontratën e privatizimit. ... Në takim ka ardhur edhe Sekretari i Përgjithshëm z Fiqiri Kupe. ... (shih shkresën me të cilën shtetasi Vladimir Qiriazhi ka njoftuar shefin e Shtabit të Përgjithshëm dt. 02.04.2009)
 - Në dt 01.04.2009, Sekretari i Përgjithshëm Fiqiri Kupe, e ka thirrur në takim me Ministrin e Mbrojtjes, shtetasin Vladimir Qiriazhi, ku të pranishëm kanë qenë personeli i DMIBM... Ardian Shashaj, Roland Llazari dhe Erinda Ndroqi, sekretari i Përgjithshëm Z. Fiqiri Kupe dhe Drejtori i Kabinetit të Ministrisë së Mbrojtjes z. Besnik Dervishi. Në këtë takim, shtetasi Vladimir Qiriazhi tregon për presionin e bërë për marrjen në dorëzim të pronës. Ministri i Mbrojtjes largoi ekipin e DMIBM-së dhe qëndruan aty sekretari e drejtori. ... Pas insistimit të Drejtorit të Kabinetit se duhej që të firmoste shtetasi Vladimir Qiriazhi, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes dhe i ka thënë, z. Ministër unë mendoj se drejtori juaj i kabinetit është shumë më afër përfaqësimit tuaj në këtë problem se sa jam unë, ndaj autorizoni atë për ta firmosur. Debatimi u nxe dhe pastaj Ministri i Mbrojtjes, nxori jashtë ata dhe qëndruan bashkë. Ministri i kërkoi se Vladimiri duhej të firmoste pasi kjo gjë i kërkohet edhe atij. ... I ka thënë se kjo punë mund të shkojë deri në masë..”. (shih shkresën me të cilën shtetasi Vladimir Qiriazhi ka njoftuar shefin e Shtabit të Përgjithshëm dt. 02.04.2009)
 - Më datë 03.04.2009 Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, shtetasi Gjergj Lezhja, dhe miratuar nga shtetasi Oerd Bylykbashi, i drejtohet Komandantit të Forcës Mbështetëse dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes mbështetur në një shkresë të hyrë në Kryeministri fotokopje, si denoncim i disa prej trashëgimtarëve të familjeve të njohura pronare, duke kërkuar marrjen e masave të menjëherëshme për përfundimin e procedurave ligjore. ... brenda 10 ditësh pas vënies në dijeni me këtë shkresë, duhet të njoftohet DKBAA për zbatimin e masave konkrete.

- Më dt. 16.04.2009 me tre shkresa të së njëjtës datë, Drejtori i DMIBM, shtetasi Ardian Shashaj, i është drejtuar Komandës Mbështetëse dhe për dijeni Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa dhe Sekretarit të Përgjithshëm Fiqiri Kupe, me të cilat *...kërkojnë që të informohen lidhur me vazhdimin e procedurave të përcaktuara në titullin administrativ pasi afati që kanë vënë në shkresën e vetë është tejkaluartë vazhdohen procedurat në përputhje me urdhërin...*
- Më dt. 17.04.2009 Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm shtetasi Maliq Xhebra, informon Ministrin Gazmend Oketa se: *"Gjatë misionit të auditimit të plotë të ushtruar në Komandën Mbështetëse, sipas programit të punës ... dhe sipas porosisë suaj, ... Opinionit i auditit, është se Komanda Mbështetëse pavarësisht mungesës së dokumentacionit kontabël dhe pikës së kontaktit me ish administruesit, bazuar në ligjin nr. 9642 dt 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" duhet të merrte në dorëzim, me komision, duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën, sipas gjendjes në fakt, veprim i cili nuk është kryer edhe aktualisht. ..."*
- Më dt 20.05.2009 shtetasi Vladimir Qiriaz, raporton se, në bisedë telefonike nga ana e ministrit është tërhequr vëmendja për arsyen se pse nga ana e komandës, komisioni për marrjen në administrim dhe hartim të dokumentacionit teknik, ka kontaktuar me personat e sha Partizani që aktualisht ndodhen dhe ushtrojnë aktivitet në këtë pronë
- Me dt 21.07.2009 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm i paraqet Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, raportin e auditimit ku citon: *"... Marrja në dorëzim dhe regjistrimi i Klubit të Futbollit Partizani. Opioni i auditit, është se Komanda Mbështetëse pavarësisht mungesës së dokumentacionit kontabël dhe pikës së kontaktit me ish administruesit, ... duhet të merrte në dorëzim, pronën sipas gjendjes në fakt, me komision, duke mbajtur proces verbalin përkatës, veprim i cili nuk është kryer edhe aktualisht."* Në përfundim të raportit, në masat organizative, në pikën 19 kanë përcaktuar: *"...19. Komanda Mbështetëse, ... të marrë në dorëzim me komision duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën Klubi i Futbollit Partizani, sipas gjendjes në fakt.*
- Me urdhërin dt 21.07.2009 Ministri Gazmend Oketa ka vendosur *"Për dhënie masash dhe zbatim detyrash në përfundim të auditimit të plotë të ushtruar në komandën mbështetëse (Reparti Ushtarak nr. 4001.) Tiranë"*, ku në pikën 20 ka udhëruar: *"...20. Komanda Mbështetëse, ... të marrë në dorëzim me komision duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën Klubi i Futbollit Partizani, sipas gjendjes në fakt.*
- Me shkresën nr. 5576 datë 20.08.2009 *"Për përfaqësim në ankand, dorëzim objekti dhe nënshkrim kontrate"* është dhënë autorizim nga Ministri.
- Me dekretin nr. 6231 datë 02.09.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, shtetasit Bamir Topi, gjeneral brigade Vladimir Qirjazi, Komandant i Komandës Mbështetëse, shkarkohet nga detyra si komandant i Komandës Mbështetëse.
- Më datë 14.09.2009 me dekret të Presidentit, shtetasi Arben Imami emërohet Ministër i Mbrojtjes duke u larguar në këtë mënyrë edhe ministri Gazmend Oketa.
- Me dekretin e Presidentit të Republikës Bamir Topi, nr. 6291 datë 07.10.2009 gjeneral Brigade Xhemal Gjunksi, emërohet Komandant i Komandës Mbështetëse. Ky i fundit, ka qëndruar në këtë detyrë deri më datë 01.03.2010.
- Me memon dt 16.10.2009 drejtuar Gjeneral Brigade Xhemal Gjunksi, nëpërmjet kolonel Adem Halilaj nga n/kol Naim Rama, shefi i sek. Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës, është parashtruar se *...u bë kontabilizimi në llogarinë e Repartit Ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) të Klubit të Futbollit.*

- Me Autorizimin Nr. 6927 dt **15.10.2009** "*Për dorëzimin prone dhe lidhje kontrate*" **Ministri i Mbrojtjes**, ka Autorizuar Komandantin e Komandës Mbështetëse Gjeneral Brigade Z. **Xhemal Gjunkshi** të përfaqësojë Ministrinë e Mbrojtjes për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës Nr. 11 **Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit "Partizani", Tiranë.**
- Me urdhërin nr. 6094/3 dt **16.10.2009** "*Për marrjen në administrim dhe dorëzimin e pronës nr 11 Klubi i Futbollit Partizani*" komandanti i Komandës Mbështetëse, Xhemal Gjunkshi, Komanda Mbështetëse, ka urdhëruar të ngrihet në Repartin ushtarak 4001, **grupi i punës për marrjen në dorëzim të pronës nr. 11. Prona nr. 11 me t'u marrë në dorëzim, do të administrohet nga Reparti Ushtarak 4001 sipas vlerës kontabël....** Grupi i punës me të marrë në dorëzim pronën të hartojë proces verbalin e marrjes në dorëzim sipas dokumentacionit teknik të hartuar nga IGJU dhe pastaj të hartojë proces verbalin e dorëzimit të pronës Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.
- Me proces verbalin dt **16.10.2009** nr. 6094/3 prot është pasqyruar nga grupi i punës marrja në dorëzim e klubit të futbollit me vlerë kontabël të ngelur 8 876 416 lekë, sip **sipas faktit 31 002, 5.**
- Më dt **16.10.2009** është bërë dorëzimi i pronës, ku Ministria e Mbrojtjes është përfaqësuar nga Gjeneral Brigade Z. Xhemal Gjunkshi, përfaqësues i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Nuri Sopaj, ku marrësit për trashëgimtarët Begeja evidentohet të jenë shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Bashkim Bekteshi.**

Arritje e objektivave:

- Më dt **04.11.2008**, është lidhur kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme Nr. 3298/562 rep/kol në lidhje me blerjen e objekteve dhe truallit të **Klubit Shumësportesh Partizani.**
- Më dt **21.10.2009** është lidhur kontrata e shitjes nr. 3553 rep nr. 661 kol për blerjen e objekteve dhe një pjese të truallit të **Klubit të Futbollit Partizani.**

Konkluzione në lidhje me privatizimin:

Shprehja për privatizimin në lidhje me dy Klubet Sportive, është bërë në kundërshtim edhe me VKM nr. 195 dt 20.03.1998 "*Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen*" pasi kjo VKM sanksionon privatizimin e ndërmarrjeve që kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, ndërkohë që Klubi Shumësportesh Partizani vijonte normalisht veprimtarinë dhe Klubi i Futbollit Partizani në vijim transformohet nga Ministri i Mbrojtjes Arben Imami.

Kanë vepruar në kundërshtim edhe me VKM nr 819 dt 29.11.2007 "*Për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore*" që shfuqizoi VKM nr.195, datë 20.3.1998, që parashikonte privatizimin e ndërmarrjeve që kishin ndërprerë aktivitetin, ndërkohë që siç theksuam të dy këto klube vijonin aktivitetin. Edhe për Klubin e Futbollit Partizani, sjellim në vëmendje se vetë Ministri i Mbrojtjes Arben Imami ka pretenduar kur e ka regjistruar, se ky klub nuk e ka ndërprerë aktivitetin.

Privatizimi i mësipërm, ka ndodhur në kundërshtim edhe me n. 19 të ligjit nr 9376/2005 "*Për sportin*" i cili parashikonte:...2. *Transformimi i klubeve sportive në shoqëri anonime miratohet nga Ministria e Ekonomisë, me kërkesë të organit të pushtetit qendror ose vendor.*

në varësi të të cilit është klubi sportiv. Ky transformim bëhet brenda një afati prej dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji. ... ndryshuar me ligjin nr 9816 datë 22.10.2007 (hyrë në fuqi më datë 21.11.2007) si vijon: "2. Procedurat e transformimit të tyre realizohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozim të përbashkët të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës."

Këshilli i Ministrave i kryesuar nga shtetasi Sali Berisha, vetëm pasi ka përfunduar procedura e privatizimit, ka miratuar VKM nr 1718 dt 24.12.2008 "Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar" (FZ 214 datë 31.12.2008).

Por megjithatë, siç konstatohet, për klubet sportive Partizani, qëllimi nuk ka qenë asnjëherë për ndonjë transformim të tyre, pasi procedurat e privatizimit kanë vijuar në shkelje të kuadrit ligjor për sportet:

n. 27, sipas të cilit *1. Objektet sportive janë publike ose private, 2. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen, rikonstrukcionin dhe për ndërtimin e objekteve të reja, 4. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive. Objektet sportive në pronësi publike përdoren për të ofruar shërbime të nevojshme për sportin për të gjithë...*

n. 28... *1. Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike, të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës, 2. Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive...*

n. 29 parashikonte: *Organet shtetërore ose organizatat sportive, që i kanë në pronësi a përdorim këto objekte, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.* Në n. 29, me ndryshimet me ligjin nr 9816 datë 22.10.2007 të propozuara nga ministri Ylli Pango, pas paragrafit të parë u shtua paragrafi me këtë përmbajtje: *"Në rastet kur vërehet se kushtet dhe kriteret nuk janë plotësuar sipas standardeve të miratuara nga organizatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse, merren masa për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive sportive, deri në përbushjen e tyre."* Etj.

Pra megjithë këto ndryshime në ligjin për sportin, që nxorrën më së miri në pah qoftë interesin publik, qoftë qëllimin e transformimit të klubeve sportive, qoftë përgjegjësinë e institucioneve që i administrojnë, sërish procedurat e privatizimit, vijuan.

Detyrimi i Komandës Mbështetëse për të marrë në dorëzim objektin dhe lidhjen e kontratës pas privatizimit: Detyrimi i Komandës Mbështetëse për të marrë në dorëzim objektin dhe për të lidhur kontratën, vjen në kundërshtim me procedurën e ndjekur deri më tani e konkretisht VKM nr 794/2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" pasi nuk dokumentohet që Shtabi i Përgjithshëm të kishte dhënë mendim për privatizim, që Komanda Mbështetëse ta kishte marrë ndonjëherë në dorëzim, ta kishte regjistruar apo që ndonjë përfaqësues i tyre të kishte qenë pjesë e komisionit të Vlerësimit përgjatë privatizimit. Përkundrazi, Shtabi i Përgjithshëm pronën me nr 11 e kishte përfshirë në listën e Pronave të Planit të Përhapjes.

Në kreun I "Vlerësimi i elementëve të pasurisë dhe kompetencat" të VKM nr 794/2007, sanksionohet se: *...2. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi, ngrihet nga titullari i institucionit, që ka të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet.*

3. Ky komision kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën përkatëse, ku ndodhet objekti, dhe në përbërje ka:

....b) drejtorin e ndërmarrjes apo institucionit, në administrim të të cilit ndodhet aset. ...

Në lidhje me miratimin e VKM për blerjen me bono privatizimi: Më dt **04.11.2008**, rezulton se është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme Nr. 3298/562 rep/kol në lidhje me blerjen e objekteve dhe truallit të **Klubit Shumësportesh Partizani**, pasi ishte arritur privatizimi i tij. Nga aktet rezulton se **8 700 000 lekë** për këtë privatizim janë paguar nga shtetasi **Gjon Gjonaj (bashkëpunëtor në biznese me shtetasin Xhimi Begeja)**, **828 000 lekë** nga familja **Llagami** dhe **60 187 145 lekë janë paguar nga shoqëria Kontakt sh.p.k**. Këto pagesa kanë përfunduar së kryeri deri më datë 29.10.2008.

Më datë **16.10.2008**, shtetasi Nuri Sopaj, përgjegjës i sektorit të shitjeve, i është drejtuar drejtorit Urim Muja, duke i parashtruar se i paraqet për miratim proces verbalin dt 15.10.2008 **për dhënien e të drejtës së parablerjes për objektin "Terrenet sportive dhe objekte të klubit të futbollit Partizani"**, ku ky privatizim duhet të bëhet kundrejt pagesës prej 10,109,000 lekë për objektet dhe 22 956 459 lekë, për tokën truall, pra gjithsej **33 065 459 lekë**. Shoqëria **Kontakt sh.p.k.** deri më datë 04.09.2008 kishte paguar për këtë privatizim, garancinë në vlerën **2 021 800 lekë**.

Procedura për privatizimin e Klubit të Futbollit Partizani, e ndjekur deri në këtë moment me hapa të përshpejtuar, duket se është bllokuar, deri në hyrjen në fuqi të VKM-së si më poshtë. Konkretisht miratohet VKM nr. 1638 dt **17.12.2008** "**Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes**" e cila hyn në fuqi më dt **31.12.2008**, ku përcaktohet se blerja e objekteve që privatizohen, mund të bëhet me **bono privatizimi**. Pas këtij momenti, duket se zhbllokohet edhe ecuria e procedurës së privatizimit, kur nënshkruhet shkresa nr. 812 prot dt **26.01.2009** e sektorit të shitjes, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së pronave publike, me lëndë "**Autorizim për kalim pronësie**" nga drejtori Urim Muja.

Nga aktet rezulton se, për privatizimin e Klubit të Futbollit Partizani, më dt **13.02.2009** dorëzohen **bonot e privatizimit nga shtetasi Xhimi Begeja, për shumën 8 200 000 lekë** kurse vlera e truallit shtet, në vlerën **22 956 459 lekë** nuk paguhet.

Përsa më sipër, vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ndryshimi i VKM-së së mësipërme, është bërë pikërisht në kohën kur duhet të bëhet pagesa për Klubin e Futbollit Partizani. Vërtetohet se shpenzimet për privatizimin ishin marrë përsipër nga shoqëria Kontakt sh.p.k. por kjo e fundit duket se gjendet në vështirësi përsa kohë kishte bërë ndërkohë pagesat për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani, ku jashtë parashikimit kishin blerë edhe pjesën e kësaj të fundit të identifikuar si Pishina me vendodhje Laprakë. Vetë fakti i ndërprerjes pa asnjë arsye i konkludimit të procedurave të shitjes së objekteve dhe terreneve të Klubit të Futbollit Partizani dhe rinisja e tyre vetëm pas hyrjes në fuqi në këtyre procedurave, mbështet më tepër vërtetësinë e sa më lart.

Për më tepër, vetëm **7 muaj më vonë**, me VKM nr. 738 dt **01.07.2009**, të miratuar po në kohën që shtetasi Sali Berisha ka qënë kryeministër, **pika 26 e kapitullit III ka ndryshuar përsëri, duke u përcaktuar se pagesa bëhet vetëm në lekë**.

Auditimi i Ministrisë së Mbrojtjes. Risjellim në vëmendje se Këshilli i Ministrave, në kohën që kryeministër ka qënë shtetasi Sali Berisha, ka miratuar VKM nr 1718 dt 24.12.2008 "**Për**

procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar" (FZ 214 datë 31.12.2008). Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, në tentativa për të transformuar Klubin e Futbollit Partizani sipas VKM-së së mësipërme i është dashur të iniciojë një procedurë fillimisht gjyqësore, sipas padisë dt 25.11.2010 për të kërkuar të drejtën e përdorimit të stemës e më pas të procedojë me regjistrimin e shoqërisë tregtare. Pas vendimit gjyqësor nr. 8824 dt 07.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur rrëzimin e padisë, ka vendosur ushtrimin e auditimit në ish Komandën Mbështetëse (ish Reparti Ushtarak nr. 4001) Tiranë, me nr 12071 dt 23.12.2011 me objekt "Vlerësimin e veprimtarisë ekonomike financiare në ish Komandën Mbështetëse (ish Reparti Ushtarak nr. 4001), Tiranë".

Sipas raportit final, përcjellë me shkresën nr 7557 prot dt 28.06.2012, është pasqyruar në pikën 5 të tij se: ...Referuar formularit nr. 6 të bilancit "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qendrueshme" (vlera bruto) 2009, gjendja e llogarisë 212, në mbyllje të ushtrimit ...shtesa ... e paargumentuar ... shuma 8 096 296 lekë (e paraqitur si në shtesë ashtu edhe pakësim të llogarisë 212 të formatit nr. 6) përfaqëson vlerën e pronës nr. 11 "Klubi i Futbollit Partizani". ... Nga grupi i punës është përpiluar proces verbali ...dt 16.10.2009 dhe miratuar nga ish komandanti i KM, për marrjen në administrim të pronës nr. 11 Klubi i futbollit Partizani, ku shprehet se komisioni shkoi në vend dhe mori gjendjen në fakt sipas gjendjes kontabël, ...këto dy shprehje nuk kanë të njëjtin kuptim dhe nuk shprehin të njëjtën gjë....Si vlerë, është paraqitur vetëm vlera e objektit të marrë, sipas pasqyrimin në kontabilitet në bilancin e vitit 2000 (të dërguar nga Drejtoria e PPB në MM) por pa pasur parasysh e marrë në konsideratë rikonstruksionet që mund të jenë kryer gjatë kësaj periudhe në komponentët e kësaj prone, ndërsa amortizimi është llogaritur i plotë për gjithë periudhën.

Nga auditimi i kryer për regjistrimin e vlerës së pronës nr. 11 8 096 296 lekë, në librin e llogarisë së pronave të repartit, u konstatua se, për këtë objekt nuk është prerë dokument hyrje për marrjen në administrim, nuk është hapur kartelë për pronën, objektin dhe komponentët e saj, për pasojë nuk është pasqyruar në librat e llogarisë si hyrje, shtesë e AOT si dhe sipërfaqja e marrë në dorëzim nuk kuadron me sipërfaqen e përcaktuar në VKM nr. 515/2003...me një diferencë prej 3002.5 m² (31 002.5 – 28 000).

Vlera e këtij objekti nuk është kontabilizuar, duke mos zbatuar rregullat e administrimit dhe standartet e kontabilitetit si dhe pikën 2 të urdhërit të brendshëm të Komandantit të KM ...dt 16.10.2009 "Për marrjen në administrim dhe dorëzimin e pronës nr. 11..." edhe pse nga grupi i punës ... është raportuar se janë kryer veprimet e kontabilizimit të pronës nr. 11 në llogarinë e Rep. Ushtarak nr. 4001 (KM)

Nga auditimi u kërkuan sqarime në grupit të punës në lidhje me informimin e gabuar për kontabilizimin e kësaj prone, të cilët nuk pranuan të japin shpjegimet e nevojshme duke u shprehur se, e dinim të regjistruar në llogari këtë pronë.

... objekti i kontratës, është kalimi në pronësi private i objektit "Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit Partizani" me vendndodhje,... me sip totale 26 524 m²...nga 28 000 m² në bazë të VKM nr. 515/2003, të inventarizuar si prona me nr. 11, ose me një diferencë më pak në sasinë 1 476 m², duke mos dhënë asnjë sqarim për këtë diferencë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, Nga grupi i punës është përpiluar proces verbali ... dt 16.10.2009 dhe miratuar nga ish komandanti i KM për marrjen në administrim të pronës nr. 11 ...duke rezultuar diferenca e patrajtuar më sipër.

Opinionimi i auditit është se: Për marrjen në administrimin dhe dorëzimin e pronës nr. 11...nga grupi i punës si dhe shefi i financës, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të përcaktuara në kreun III Dokumentimi i veprimeve ekonomike financiare, n 7 i ligjit nr. 9642/1984..., n 6 pika 1 dhe

2 të ligjit nr. 9228/2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, kapitulli I, pika 2 gërma c, dokumentat kontabël të VKM nr. 783/2006... duke mos përcaktuar saktë pronën nr. 11 sipas komponentëve përkatës, përcaktuar në VKM nr. 515/2003 për miratimin e listës..., nuk është prerë dokument hyrje për administrimin e saj, njëkohësisht nuk është prerë dokument dalje apo akt dorëzimi për dorëzimin e saj, nuk janë kryer regjistrimet në librin e llogarisë së AQT, për shtesën dhe pakësimin e tyre, për pasojë rezultojnë diferencat si më poshtë:

Kontrata e shitjes është bërë për sip totale 26 524 m²... nga 28 000 m² në bazë të VKM nr. 515 të vitit 2003, inventarizuar si prona me nr. 11, ose me një diferencë më pak në sasinë 1476 m², ndërsa krahasuar me proces verbalin e marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, referuar matjeve të IGJU-s, kjo sip është 31 002.5 m² dhe kjo diferencë arrin në sasinë prej 4 478 m². ...

Përbërja e Komisioneve të vlerësimit. Për vlerësimin e objekteve të dy klubeve Partizani, ekspertët e fushës, janë zgjedhur të njëjtë. Konkretisht ata kanë qenë shtetasit Elvira Aliaj (Lame) dhe Sali Preçi.

Shtetësja Elvira Aliaj, është njohje e shtetasit Jamarbër Malltezi dhe rezulton se edhe ka pasur në vijim marrëdhënie kontraktore me shoqërinë Homeplan sh.p.k. Konkretisht, nga aktet ka rezultuar se, shtetësja Elvira Aliaj (Lame) më datë 03.12.2011 është dokumentuar të ketë përgatitur çertifikatën e vlerësimit (*raport vlerësimi*) datë 03.12.2011, bazuar në kërkesën e shtetasit Jamarbër Malltezi për pasurinë tokë arë, me sip 3000 m² vol 8 faqa 219 ZK 3051, nr pas 370/18 regj. në bashkëpronësi të Jamarbër dhe Argita Malltezi, pasuri e ndodhur në fshatin Priskë, për të cilën edhe shtetasi Petrit Kullolli ka përgatitur plan rilevimin.

Nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit të hard drive-it të sekuestruar pranë Studio Pustina, rezulton një dokument në formatin Word, email i emërtuar si "Email dt. 22.06.2011" dokument i krijuar më dt 20.06.2011 dhe i ruajtur e i printuar më dt 23.06.2011, ku ky email i cili i drejtohet një shtetasi të identifikuar si Bledi parashton disa pyetje. Nga këto pyetje evidentohet: "Pershendetje Bledi, Doja te te pyesja: ...Me date 26.05.2011 keni paguar per fature zj.Elvira Lame, per cilen fature behet fjale, sepse une nuk e kam nje te tille? ...PERGJIGJET E BLEEDIT: **Pergjigjen e kesaj pyetje t'a ka dhene Suzana me mail.** "

Nga të dhënat e esktraktuara, nëpërmjet aktit të ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se është gjendur një dokumenti i emërtuar si "07 Libër blerje korrik 2012 Homeplan ok", ku evidentohet: - nr 42, nr 86565999 datë 23.07.2012 shitësi Elvira Lame, shuma 120 000 lekë.

Gjithashtu nga aktet e administruara përgjatë hetimit rezulton se për shtetasen Elvira Aliaj (Lame) shoqëria Homeplan sh.p.k. ka lëshuar faturën nr. 42 dt 23.07.2012 me përshkrimin shërbime "Akt ekspertimi" në vlerën 120 000 lekë.

Kurse shtetasi Sali Preçi, rezulton të ketë qenë administrator i shoqërisë "KLS Auditing" së bashku me shtetasin Lulash Pjetërnikaj dhe të dy këta shtetas, janë caktuar si ekspertë kontabël në vitin 2006, të shoqërisë "ASG Poëer Albania" sh.a. me NIPT K71416002M, me drejtorë të përgjithshëm Paolo Rossi (shtetas zvicerian) dhe Agim Gjinali (shtetas i Serbisë dhe Malit të Zi), ku anëtarë të Këshillit Mbikqyrës ka qenë Diego Lissi, Marko Luli dhe shtetasi Florenc Kola. (i biri i Pjetrit). Shtetasi Florenc Kola, rezulton të jetë mik i familjes Malltezi (madje me prokurën e posaçme nr regj 266274524 dt 21.07.2020, të bërë nga shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi, në Konsullatën Shqiptare në Mynih, Gjermani, i janë dhënë tagre shtetasit Florenc Kola, dt. 20.09.1967, për të nënshkruar dhe firmosur për llogarinë e tyre dokumentat në emrin e tyre pranë institucioneve shtetërore dhe private). Nga aktet e depozituara në QKB konstatohet se, përkthyesja e akteve të shoqërisë ASG Poëer Albania, është shtetësja Lealba

Pelinku, që ka qenë e punësuar pranë subjektit të shtetases Argita Malltezi (ka kryer edhe veprime bankare për llogari të shtetases Liri Berisha me kërkesë të shtetases Argita Malltezi) dhe me noterizimet apo regjistrimet në QKB është ngarkuar shtetësja Joana Qeleshi, e njëjta kjo e fundit që është ngarkuar edhe me regjistrimin e shoqërisë Homeplan sh.p.k.. Më dt 07.05.2008, si administrator i kësaj shoqërie është caktuar shtetasi Fatmir Bektashi.

Vlerësimi i pronave gjatë privatizimit. Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr 794/2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" në kapitullin I "Vlerësimi i elementëve të pasurisë dhe kompetencat", pika 4 dhe Udhëzimin nr 1 dt 27.12.2007 për zbatimin e kësaj VKM, pika 5. Vlerësimi i pasurisë shtetërore në zbatim të këtij vendimi bëhet për çdo element të pasurisë nga komisioni i vlerësimit, duke përcaktuar vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Sipas raportit të vlerësimit të mbajtur nga ekspertët Elvira Aliaj dhe Sali Preçi e konfirmuar edhe nga Komisioni i vlerësimit në procedurën e privatizimit të **Klubit Shumësportesh Partizani**, vlera e ndërtesave është **43 254 740 lekë**, ndërkohë sipas aktit të ekspertimit të kryer nga ekspertët e caktuar nga prokuroria, vlera shumë e ndërtimeve është **388 713 429 lekë, pra 345 458 689 lekë më shumë.**

Sipas raportit të vlerësimit të ekspertëve Elvira Aliaj dhe Sali Preçi në lidhje me vlerësimin e **Klubit të Futbollit Partizani**, ka rezultuar se vlera e ndërtesave është **10 108 780 lekë** e konfirmuar edhe nga grupi i vlerësimit, kurse nga ekspertët gjatë hetimit, është vlerësuar **101 094 535 lekë, ose 90 985 755 lekë më shumë.**

Pra shtetit nga këto privatizime, i ka ardhur një dëm në vlerën 436 444 444 lekë.

Gjithashtu ka rezultuar se më dt **21.10.2009** është lidhur kontrata e shitjes nr. 3553 rep nr. 661 kol për blerjen e objekteve dhe një pjese të truallit të Klubit të Futbollit Partizani, ku ndërmjet të tjerave, sipas nenit 2, të kësaj kontrate, objekt është kalimi në pronësi private i objektit "*Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani*", me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku, Tiranë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë, me sip totale **26 524 m²**, nga e cila **775 m² nën objekt**, sipas vendimeve të KKKP-ish Pronarëve. Në nenin 3 parashikohet çmimi i shitjes së objektit është **10,109,000 (dhjetë milionë e njëqind e nëntë mijë) lekë.**

Në nenin 6, pika 6.4 është përcaktuar se **blerësi është i detyruar të bëjë pagesën e pjesës së truallit që do të mbetet shtet, pas konfirmimit të dhënë nga ZRKK Pronave Tiranë, brenda afatit 30 ditor nga data e njoftimit që do t'u bëhet për këtë qëllim.**

Me procesverbalin datë **15.10.2008** i mbajtur në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Sektori i Shitjes së Pronave nga komisioni i përbërë nga Nuri Sopaj, Sotiraq Veizi, Kliton Rusi dhe Liza Lleshi, pasi u shqyrtuar dokumentacioni për vlerësimin për privatizim të objektit Klubi i Futbollit Partizani ... konstatoi se **Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani, bien mbi 70 % në pronën e ish pronarëve të subjekteve të shpronësuar Xhemal e Mahmut Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqarri, Sabrije Llagami, Rexhep Alimehmeti.** Nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë dhe krahasimit të hartave të pronës së ish pronarëve me gen planin e objektit që privatizohet dhe HTR të lëshuara nga ZRPP rezulton se për objektin "*Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit Partizani*" me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku Tiranë, **një pjesë e truallit prej 857 m² nuk përfshihet në pronën e njohur ish pronarëve të truallit të sipërpërmendur.**

Siç mund të konstatohet, nga ana e këtij komisioni, është konkluduar se sipërfaqja e truallit

shtesë, që nuk përfshihet në pronën e njohur ish pronarëve të truallit është 857 m². **Pasur parasysh vlerën prej 26 787 m² X 857 m², sipas përlogaritjeve të këtij komisioni, familjet që po krvenin privatizimin, duhet të paguanin edhe shumën prej 22 956 459 lekë.**

Ndërkohë nga interpretimi i kontratës së mësipërme, është shitur e gjithë prona, përfshirë edhe sipërfaqen prej 857 m² me kushtin që ta bëjnë brenda 30 ditëve pas konfirmimit nga ZRPP. Kjo pagesë prej 22 956 459 lekë nuk është bërë asnjëherë, duke sjellë kështu dëm në interesat e shtetasit.

Përfitimet

Faza e fundit e konsumimit të veprës penale, në rastin konkret ka të bëjmë me ofrimin dhe dhënien e mitës së premtuar.

Ofrimi kupton situatën kur subjekti aktiv i korrupsionit, tregon gatishmërinë, për të dhënë mitën në çdo moment dhe përfundimisht dhënia ka të bëjë me situatën kur subjekti aktiv i korrupsionit transferon mitën. Dhënia dhe transferimi i kësaj mite, nuk është e nevojshme për t'u quajtur e konsumuar, kur i jepet zyrtarit, por edhe në ato raste kur i jepet një pale të tretë, si një të afërmi, një organizate ku zyrtari ka interesa, apo partisë ku ai është anëtar etj. E rëndësishme është që zyrtari ta dijë se kjo dhënie ka ndodhur. Transaksionet mund të kryhen edhe me dhënien personave të tjerë.

Në këtë çështje konstatohet se vjelja e përfitimt të padrejtë/mitës, është kryer si rezultat i një procesi të gjatë, në varësi të zhvillimit të ndërtimeve dhe vjeljes së përfitimeve nga këto ndërtime. Konkretisht, në muajin maj 2008, krijohet shoqëria Homeplan sh.p.k., ku qëllimi i vetëm i krijimit të saj, është dokumentimi i të ardhurave dhe shpenzimeve që kryhen për privatizimin, që kryhen për ndërtimet, me qëllim për t' u pasur nën kontroll nga shtetasi Jamarbër Malltezi, për rezultatin final, marrjen e mitës së premtuar. Pjesë e këtyre përfitimeve, bëhet edhe shtetasi Xhimi Begeja, i cili ka vepruar në terren si përfaqësues i familjes Begeja, megjithëse sjellim në vëmendje se tagrat si përfaqësues nga trashëgimtarët Begeja, i ishin dhënë shtetasit Jamarbër Malltezi.

Kjo gje lexohet edhe nga fakti se pas shperndarjes se fitimeve (dhenies perfundimtare te mitës), shoqeria Homeplan, nga ortaket vendoset te kaloje ne likujdim, duke treguar edhe nje here se ekzistenca e saj ka qene vetem per dhenin e mitës.

Kontabiliteti mbahet nga shtetësja Andia Pustina dhe studio Pustina. Shtetësja Andia Pustina rezulton mikeshë e familjes Berisha dhe Malltezi, dhe madje edhe përpilon deklaratat e tyre DIVA dhe deklaratat e pasurisë për dorëzimin në ILDKPKI.

Motra e saj, Laura Pustina, e cila është personi që edhe përgatit kontrata të ndryshme apo akte në funksion të aktivitetit të zhvillimit të ndërtimeve por edhe të shoqërisë Homeplan sh.p.k., rezulton të jetë e martuar me shtetasin Andi Toma, ku edhe ky i fundit, evidentohet gjatë pushtetit të shtetasit Sali Berisha të ketë mbajtur pozicione drejtuese si Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rugor Shqiptar. Emri i këtij shtetasi shfaqet dhe në planin e veprimit për reformimin e kapaciteteve institucionale dhe shëndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve në Ent Publik të miratuar me VKM nr 341 dt 27.02.2008, ku shtetasi Andi Toma evidentohet si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Ligjore Mbështetëse dhe i cituar si zyrtar i konsultuar.

Audituese vendoset shtetësja Shpresa Breçani, mbesa e shtetasit Sali Berisha.

Si subjekt të ruajtjes të ambjenteve ku zhvillohen ndërtimet, kontraktohet subjekti "*Breçani R.O.S.P*" me Nipt K52116005E, me administrator shtetasin Fatbardh Breçani. Kjo shoqëri konstatohet se më datë 30.06.2009 ka caktuar si eksperte kontabël shtetasen **Shpresa Breçani. Shtetasi Fatbardh Breçani, rezulton të jetë vëllai i shtetasit Erzen Breçani.**

Emri i shtetasit Erzen Breçani, përmendet dhe rezulton ndër dokumenta, në lidhje me ndërhyrjet që ka bërë policia e shtetit, gjatë kohës së lindjes së konflikteve ndërmjet shoqërisë ndërtuese Kontakt sh.p.k., Homeplan sh.p.k. me qytetarë të ndryshëm.

Ndër të punësuarit e shoqërisë Homeplan sh.p.k. janë Fatmir Ymaj dhe Sokol Barçi, që shfaqen me lidhje të ngushta me shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi (*atyre u jepen prokura, akte përfaqësimi, automjete në përdorim pa kundërshpërblim etj*).

Konstatohet se edhe arkitekti që është kontraktuar për projektet e ndërtesave të kryera në territoret e klubeve Sportive Partizani, shtetasi Daniel Liebeskind, fiton pikërisht shtetasin Flamur Kuçi, në kohën që ky i fundit ka qenë këshilltar për Çështjet e territorit pranë Kryeministrit Sali Berisha dhe shtetasin Fatmir Bektashi për një vizitë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Udhëtimi kryhet në vitin 2012 dhe paratë e biletës për shtetasin Flamur Kuçi, në shumën 911 euro, paguhet nga shoqëria Homeplan sh.p.k.

Shoqëria Homeplan sh.p.k. megjithëse paraqitet si investitore në zhvillimin e ndërtimeve, në fakt rezulton se financohet fillimisht nga shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe shtetasi Fatmir Bektashi e më pas vetëfinancohet nga shitjet. Shpenzimet e privatizimit janë marrë përsipër nga shoq Kontakt sh.p.k. (*shih deklarata, kontrata sipërmarrje etj*) por fiktivisht janë kaluar paratë në shoqërinë Homeplan sh.p.k. nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe shoqëria Kontakt.

Sipas aktit të ekspertimit kontabël, por edhe si rezulton nga tërësia e akteve, në vitet e para të aktivitetit, shoqëria Homeplan sh.p.k. është financuar nga shtetasi Fatmir Bektashi, ku në vitin 2008 ka depozituar 255 450 euro dhe nga shoqëria Kontakt sh.p.k. e cila në vitin 2008 ka financuar 230 000 euro. Në vitin 2010 është financuar nga shtetasi Fatmir Bektashi që ka depozituar 378 050 euro dhe 3 471 000 lekë dhe nga klientë për blerje pronash 3 534 991 euro dhe 7 580 000 lekë.

Vetem në vitin 2012, shoqëria Homeplan sh.p.k. është financuar nga Jamarbër Malltezi në shumën 45 129 euro dhe ky është financimi i vetëm që ky shtetas ka bërë.

Nga eksperti kontabël që ka kryer aktin e ekspertimit përgjate hetimeve, është evidentuar sikur shoqëria Homeplan sh.p.k. është financuar në vitin 2016 nga shtetasi Xhimi Begeja, në shumën 73 820 euro, por edhe kjo shumë, nga hetimet ka rezultuar se i është dhënë shtetasit Xhimi Begeja si hua nga shoqëria Homeplan, hua të cilën ai e përdor për të shlyer vlera objektesh të blera po nga kjo shoqëri.

Është financuar me kredi bankare në shumën 1 000 000 euro në vitin 2013 dhe 300 000 euro në vitin 2014.

Për periudhat e tjera, është financuar kryesisht nga arkëtimet e klientëve për derdhjet e bëra për shitblerjen e pronave.

Dokumentohet te pakten qe nga viti 2011 qe shtetasi Jamarber Malltezi ka nisur te marre pjese te mitës, te dhene cash e ne vijim ne forma te ndryshme si me fatura, banke etj.

Me qëllim vjeljen e këtyre të ardhurave, të cilat sa vinin e ishin në rritje, kanë filluar përpjekjet që pjesmarrja e shtetasit Jamarbër Malltezi dhe shtetasit Xhimi Begeja, të formalizohej me hyrjen në shoqëri si bashkëortak. Për këtë është përgatitur një kontratë shitblerjesh aksionesh, për vitin 2014, sikur janë shitur kuotat pikërisht në atë periudhë. Por nga të dhënat e hetimit, ka rezultuar se ne hard drive-in e jashtëm të gjendur në studion Pustina, rezulton i ruajtur dokumenti "Praktika e shitjes së pjesmarrjes" ku gjendet vendimi i ortakut dhe kontrata e shitjes. Ky dokument rezulton të jetë krijuar më datë 21.09.2018 me autor Laura dhe të jetë printuar po më datë 21.09.2018. Gjithashtu po nga ky ekspertim është gjendur i ruajtur dokumenti në Word me emërtimin "Homeplan-shitje kuotash" ku gjendet i përpiluar draft vendimi i ortakut (pa datë) për shitjen e kuotave me datë krijimi 05.10.2017, datë e ruajtjes 06.10.2017 dhe datë e printimit 24.05.2017. Po nga ky ekspertim, është gjendur i ruajtur dokumenti me datë krijimi 05.10.2017, datë printimi 06.10.2017 dhe datë ruajtje për herë të fundit 23.10.2017 me autor dhe ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi "Laura" dokumenti me emërtimin "Kontratë shitje Homeplan". Në këtë dokument në formatin Word, gjendet kontratë shitje e datës 20.02.2015 mes shitësit Fatmir Bektashi dhe blerësve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Ne shënimet e gjendura në një bllok me ngjyrë të zezë, sekuestruar tek studio Pustina me mbishkrimin "2018" në faqen 20 janar 2018: "250 K Xh.B." dhe paraqitja e një skeme me tre rrathë. Në të njëjtin bllok konstatohet ndër të tjera shënimi i bërë më datë 02 mars 2018 si vijon: "Homeplan i ri. Të sistemohet bordi i A prej 250 000 lekë. Të shihet mundësia e largimit të Xh. Pas blerjes së kuotave nga A dhe të futet në ... (palexueshëm) A + F, 50 + 50".

Pra në ndërthurje të gjithë situatës së sipërcituar, rezulton si edhe janë pasqyruar nëpër dokumenta të ndryshme, se janë bërë përpjekje ndër vite për të justifikuar shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja në vjeljen e përfitimeve nga shoqëria Homeplan sh.p.k., por deri në fund të vitit 2018 nuk ishte gjetur forma si do të bëhej ky prezantim.

Perpilimi i kontrates se shitjes me date te vitit 2014, behej per te justifikuar te ardhurat qe shtetasi Jamarber Malltezi ka marre me banke qe nga viti 2017, në formën e dividendit.

Gjithashtu, shtetasit Jamarber Malltezi i jane derdhur parate, edhe me pershkrime si "Kalim fondi" dhe "divident" në llogari bankare, në shuma të copëzuara.

Referuar ligjit nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", neni 4 "Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur" është sanksionuar se subjektet (siç janë bankat) duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në rastet e mëposhtme:

...b) kur klienti, në raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë:

...ii) një transaksion me një shumë të barabartë me jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëri-tjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimt, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm....

Pra, copëzimi i pagesave të mësipërme, është bërë me qëllim shmangien e këtij raportimi.

Si përfundim, shtetasi Jamarbër Malltezi rezulton të ketë marrë nga shoqëria Homeplan sh.p.k.: Në total për vitin 2011 shumën 90,000 euro; për vitin 2012, shumën 1,776,4 euro; për

vitin 2015 shumën **50,000 euro**; për vitin 2016 shumën **190,817 euro**.

Në total, nga viti 2011 deri në çuarjen në likuidim të shoqërisë Homeplan sh.p.k., shtetasi Jamarbër Malltezi, ka përfituar nga shoqëria Homeplan shpk **4,657,755 euro**, të cilat janë përfitime CASH, përfitime nëpërmjet faturave, përfitimet nga dividendi dhe **1,250,815 euro** përfitim nga njësi shërbimi të marra me tepër sipërfaqet takuese tek ARA 11-kateshi. **Total 5,908,570 euro**

Kurse shtetasi Xhimi Begeja, ka përfituar gjithsej nga shoqëria Homeplan shpk **3,354,140 euro**, të cilat janë përfitime CASH, përfitime nëpërmjet faturave dhe pagesa dividendi. Gjithashtu, shtetasi Xhimi Begeja ka përfituar edhe shumën prej **500,000 euro**, nga shjitja e kuotave në shoqërinë Homeplan shpk, sipas kontratës së Shitjes së Kuotave me nr. 1387 rep nr 455/2 kol dt 19/05/2023.

Përfitime të tjera:

Bileta avioni

Në vitin 2010, rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. i ka paguar shtetasit Jamarbër Malltezi, biletë avioni në shumën 822 euro.

Më dt 30.10.2010 shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi, fluturojnë me linjën e fluturimit Austrian Airlines OS 849/850 Viena për t' u kthyer më dt 04.11.2010 me të njëjtën linjë fluturimi. Biletat e avionit, në shumën 1644 euro për udhëtim TIA-VIE -JFK-VIE-TIA, janë blerë me faturën faturën nr 19 dt 18.10.2010 të lëshuar nga Premier Travel për shoqërinë Homeplan sh.p.k. me përshkrimin "Bileta avioni 1644 euro..." për shtetasin Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi, për udhëtim, në periudhën 30 tetor – 03 nëntor, Tia-Vie-JFK-VIE-TIA, pagesë e kryer me Intesa San Paolo Bank (gjendur në hard drive fatura). Sipas dokumentit të ekstraktuar nga Hard disku i jashtëm, sekuestruar pranë studio Pustina, dokument i emërtuar si "10 Format bilanc Homeplan" në formatin excel, në faqen "details 2010" evidentohet ndër të tjera se, dokument për marketing, ka pasqyruar, debi:... Bileta avioni 1644 euro ose 233.004.12 leke

Përfitimet e familjes Berisha

Përgjatë viteve konstatohet se edhe familja Berisha ka pasur përfitimet e saj, nga të ardhurat e familjes Malltezi.

Viti 2014: Gjithsej 24 000 euro (shuma 6,000 euro shpenzimet shëndetësore për shtetasen Liri Berisha deklaruar në ILDKPKI nga vetë shtetasi Sali Berisha se këto para janë dhënë nga dhëndrri i tij shtetasi Jamarbër Malltezi dhe 18 000 euro deklaruar nga shtetasi Shkëlzen Berisha se i janë dhënë hua, pa interes, nga shtetasi Jamarbër Malltezi, shumë e cila deri më sot nuk dokumentohet të jetë shlyer).

Viti 2017: 27 439.98 USD dhe 7,403.75 euro (shuma 7 403.75 euro shpenzimet mjekësore për shtetasin Sali Berisha, vetëdeklarim i shtetases Argita Malltezi në ILDKPKI dhe 27 439.98 USD paguar avokati i shtetasit Shkëlzen Berisha, av. Jason Zolads, në USA, shumë kjo e pretenduar e dhënë pa interes, sipas vetëdeklarimit të këtij të fundit).

Viti 2018: 3,000 euro (pushime të paguara nga Jamarbër Malltezi për shtetasit Sali dhe Liri Berisha, sipas vetëdeklarimit të tyre në ILDKPKI).

Viti 2021: Gjithsej 19 933.35 euro (13,288.9 euro pasqyruar si detyrim ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi për shpenzimet e konsulencës, avokatisë për zyrën ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken për shtetasit Sali dhe Liri Berisha sipas vetëdeklarimit të tyre në ILDKPKI dhe 6 644.45 euro, pasqyruar si detyrim ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi për të njëjtin qëllim nga shtetasi Shkëlzen Berisha sipas vetëdeklarimit në ILDKPKI).

Viti 2022: 72,004.87 dollarë (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga vajza Argita Malltezi, sipas vetëdeklarimit të shtetasit Sali Berisha në ILDKPKI. Pagesa është kryer nga shtetasja Argita Malltezi sipas konfirmimeve bankare për ZAIËALLA And Co Limited).

Viti 2023: 201,675.6 euro dhe 54,382.76 usd (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga shtetasja Argita Malltezi për babain Sali Berisha. Ka gjithashtu disa pagesa nga Jamarbër Malltezi por ato i kreditohen në llogari këtij shtetasi nga Argita Malltezi).

Viti 2024: 213,590.27 euro (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga shtetasja Argita Malltezi për babain Sali Berisha).

Pagesa te shoqërisë Homeplan sh.p.k. për këngëtarin Ricardo Cocciantë

Përgjatë vitit 2013, në kohën e fushatës zgjedhore, rezultoi se mbështetur në kërkesën dhe kujdesin e veçantë shtetasit Kryeministrit Sali Berisha, Ministri i Kulturës, ka ftuar këngëtarin Riccardo Cocciantë, të vijë në Shqipëri. Ky i fundit ka ardhur i shoqëruar me bashkëshorten e tij, këngëtaren Elhaida Dani dhe një gazetar italian. Në vetë dokumentat e Ministrisë së Kulturës paraqitet si mbështetës shtetasi Fatmir Bektashi, por nga aktet ka rezultuar se pagesat për akomodim dhe udhëtim të këtyre shtetasve janë kryer nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në një vlerë në total prej **676 250 lekësh**.

Akomodimi në Hotel Sheraton nga data 07.06.2013 deri më datë 09.06.2013 janë kryer nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në vlerën **800 euro**. Nga sistemi tatimor rezultoi se shoqëria Mak Albania ka deklaruar shitje në shumën **120 822 lekë** për shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Me Faturën tatimore të shitjes nr. 312 datë **11.06.2013**, e lëshuar nga Albania experience për shoqërinë Homeplan sh.p.k. dokumentohet gjithashtu të jenë paguar biletat e udhëtimit "*Bileta udhëtimi sipas faturës bashkangjitur*" në vlerën **3171.72 euro** dhe automjetet me qera sipas faturës bashkangjitur në vlerën **770 euro**, gjithsej 3941.72 euro ose në shumën totale **446 927 lekë**. Bashkalidhur janë të dhënat e faturës nr 312 datë 11.06 lëshuar nga Albania Experience për Homeplan sh.p.k. në një vlerë të përgjithshme prej **446 927 lekë, për shtetasit: Elhaida Dani, Riccardo Cocciantë, C. Cocciantë, G.Papi, Nausika Spahia** për pagim biletash udhëtimi. Nga kqyrjet e zhvilluara pranë subjektit Landëays International sh.p.k. rezultoi se kjo shoqëri konfirmon faturat si më sipër dhe në kartelën e klientit, të kësaj shoqërie parashtrihet në lidhje me faturën e mësipërme, datë 11.06.2013 të dhëna në lidhje me blerje dhe automjete, në vlerën **555 428 lekë**.

Pagesa për të tretë

Shoqëria Homeplan sh.p.k. i ka paguar shtetasit Flamur Kuçi, në kohën që ky i fundit ka qenë këshilltar për Çështjet e territorit pranë Kryeministrit Sali Berisha në vitin 2012 paratë e biletës,

në shumën 911 euro.

Pagesa për Fondacionin nga shtetasit Malltezi

Gjithashtu konstatohet se nje pjese parash nga te ardhurat e familjes Malltezi kane shkuar ne drejtim te Fondacionit Domenic Scaglione me president shtetasen Liri Berisha. Konkretisht në periudhën 2010 – 2022 shtetasit Argita Malltezi dhe Jamarbër Malltezi, kanë sponsorizuar Fondacionin Fëmijët Shqiptarë, Domenick Scaglione, me president shtetasen Liri Berisha, në një shumë prej 8 599 647.6 leke, 24 171 euro euro, 8 225.89 USD

Pagesa për Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione nga shoqëritë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k.

Viti 2016 – Shoqeria Homeplan sh.p.k. ne vitin 2016 ka transferuar prane Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione Shumen prej 18 534 euro.

Viti 2021: Shoqeria Homeplan sh.p.k. ne vitin 2021 ka transferuar prane Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione Shumen prej 1970 euro.

Viti 2022: Shoqeria Kontakt sh.p.k. ne vitin 2022 ka transferuar prane Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione Shumen prej 30,000 euro.

Ne perfundim, konkludohet se rezulton plotësisht e provuar se shtetasi Sali Berisha, ka konsumuar vepren penale të “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, kryer në bashkëpunim me shtetasin Jamarbër Malltezi, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Me poshte parashtrojme hetimet e kryera dhe rezultatet e tyre:

Procedimi penal nr. 287 i vitit 2020, është regjistruar mbi bazë të kallzimit të shtetasit Taulant Balla, i cili ka ngritur pretendime lidhje me pronesine e familjes te njohura pronare ne territoret e Klubeve Sportive Partizani, duke pretenduar se *Toka në të cilën ishte i vendosur kompleksi Partizani dhe fushat sportive, rezulton se gjatë viteve '39 – 40 të ketë qenë aeroport i përdorur nga ushtria italiane pushtuese...Pas verifikimeve, ka dyshime, bazuar në dokumenta arkivore, se pronarët janë dëmshpërblyer me franga ari, nga qeveria e saj kohe në vitin 1940. Rrjedhimisht pretendon se jane kryer shkelje edhe nga Agjensia e Trajtimit te Pronave dhe Ish Komisioni i Kthimit te Pronave. Gjithashtu ka parashtruar se ka ardhur ne dijeni se ka pasur subjekte qe kane privatizuar pjese kufitare me Kompleksin Partizani dhe dyshohet se jane kryer veprime abuzive nga pronarët dhe hipoteka, sipas pretendimeve te njerit prej subjekteve te parashtruar ne nje padi, duke u bashkuar prona kufitare me ate te kompleksit Partizani dhe ne vijim kthimi si një pronë e tërë familjeve Begeja, Malltezi, Bektashi etj. Ka ngritur pretendime ne lidhje me periudhen e shpejte te kthimit te pronave, gje qe i ka nxitur dyshimet per kryerje abuzimesh. Dyshimet e tij janë se, nën ndikimin e shtetasit Jamarbër Malltezi, për shkak të lidhjeve të tija me struktura të larta shtetërore, provohet se në një kohë rekord, ka përfunduar procedura e njohjes, e kthimit fizik, e vlerësimit financiar të objektit që i nënshtrohet parablerjes, e dorëzimit nga ana e organeve të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe shpallja për privatizim nga Ministria e Ekonomisë dhe regjistrimi në ZVRPP si pronë e tyre. Në kallzimin e tij, thekson se është shprehur se, vetë i dyshuari Jamarbër Malltezi, është trashëgimtar që rrjedh nga familja Begeja, në masën 1/64 të pjesës takuese, që e përkthyer në sipërfaqe rezulton të jetë 144 m2 truall si dhe po ashtu, ai, në fund të kësaj sipërmarrje, dyshimet e tij është se zotëron 60 % të pronës së objekteve të ndërtuara.*

Gjithashtu, vlerëson se, element shumë i rëndësishëm për hetimin dhe provimin e pretendimeve të tija, është fakti që, trashëgimtarët e familjeve pronare, i kanë ofruar shtetasit Jamarbër Malltezi, si tarifë suksesi, të kthimit dhe kompensimit të pronës, 5% të vlerës së kthyer dhe nga njohuritë e tij të kësaj dosje, rezultojnë që kjo është e provuar në kontratat noteriale me secilin prej përfituesve. Një element tjetër në vlerësimin e tij, që duhet pasur në vëmendje gjatë hetimit, shtetasi Jamarbër Malltezi, për shkak të ligjit nr. 9049 të vitit 2003 për deklarimin dhe kontrollin e pasurive..., duke qenë se është lidhje e ekspozuar politikisht me ish kryeministrin e asaj kohe, është subjekt i posaçëm dhe ka pasur detyrimin që t'i deklaronte në deklaratat e pasurisë të bashkëshortes dhe të subjektit, marrëdhëniet kontraktore të këtij lloji. Në vlerësimin e tij gjatë kësaj kohe, me aq sa njohur me deklaratimet e kësaj kohe, nuk rezultojnë të jenë deklaruar. Pra ajo që është objekt i këtij kallzimi nga ana e tij, i rezultojnë që elementë të marrëdhënieve kontraktuale nuk janë deklaruar, megjithëse ligji e parashikon si domosdoshmëri. Një element tjetër thelbësor, është vlerësimi financiar i objekteve mbi truall. Vlerëson se metoda e përdorur nga grupi i eksperteve, është në kundërshtim të hapur me VKM nr. 794 datë 21.11.2007 dhe udhëzimit nr. 6364 datë 03.07.2008 e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes". Në këto akte përcaktohet se, vlera duhet t'i përafrohet tregut të lirë. Në pronat mbi truall, shteti shqiptar, gjatë viteve 1994 – 1995, kishte investuar për rikonstruksionin e tyre në një vlerë mbi 300 000 dollarë. E ngre këtë fakt si shqetësim, sepse konstaton se, është shqetësues fakti që, ekspertët kanë vlerësuar në masën 10 190 000 lekë, vlerën totale të objekteve mbi truall për parablerje për privatizim, vlerë kjo tepër e ulët në krahasim me sipërfaqen ndërtimore të saj apo edhe faktin se kjo zonë është e miratuar për zhvillim ndërtimi. Kjo është një provë tjetër favorizimi të personave të përfshirë në këtë privatizim.

Njohja e pronësisë së familjeve ish pronare:

1. Hetimet në kuadrin e këtij procedimi penal, janë shtrirë në lidhje me territoret e dy ish Klubeve sportive, konkretisht Klubi i Futbollit Partizani dhe Klubi Shumësportesh Partizani si dhe zhvillimi i këtyre territoreve.

Përgjatë hetimit, janë konstatuar përmendja e disa emrave identifikuese në lidhje me klubet sportive, duke u cituar si Klubi Sportiv Olimpik Partizani, Klubi Shumësportesh Partizani, Klubi Sportiv Partizani etj.

1.1. Nga aktet e administruara, është evidentuar se sipas organikës së Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 386 datë 06.11.1976, **Klubi Sportiv "Partizani" fillimisht ka qenë strukturë e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore**. Ky klub, ka vijuar të ngelet pjesë e kësaj ministrie, për një periudhë të gjatë kohe. Kjo gjë evidentohet nga disa akte¹.

Përgjatë viteve, evidentohet se ka ndodhur një ndryshim në konceptimin e Klubit Sportiv Partizani, duke u evidentuar Klubi Sportiv Olimpik dhe Klubi i Futbollit Partizani. Konkretisht rezultojnë se, më dt 09.10.1992 ish Klubi Sportiv Partizani, është suprimuar dhe prej tij, janë

¹ Shih Urdhërin Nr. 54, dt 16.03.1984 "Për përmirësimin e punës në Klubin Sportiv Partizani", firmosur nga Ministri i Mbrojtjes Popullore; relacioni "Për vendosjen e një funksioni të vetëm të drejtim të klubit Sportiv "Partizani", Nr.13/12 prot. dt 13.12.1990, nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Organizimit dhe Mobilizimit dhe Drejtori i Drejtorisë së Kulturës dhe Propagandës; shkresa Nr. Regj 630, dt 19.02.1994 me lëndë "Miratimi dhënie ambjentesh me qira", nënshkruar nga zv. Ministri ing. Bashkim Shehu, drejtuar Degës së Agjencisë së Privatizimit Tiranë, Klubit Sportiv Olimpik dhe për njoftim Entit Social Kulturor të Ushtrisë; shkresa Nr. 4563/1 regj, dt 17.12.1994, nënshkruar nga zv. Ministri për Probleme Ekonomike, për anulimin e autorizimit të dhënies me qera të ish mencës së klubit etj

krijuar **Klubi i Futbollit Partizani dhe Klubi Olimpik Partizani**, që të dy me struktura dhe administratë më vete. Pavarësisht nga kjo, të paktën deri në vitin 1993, sipas akteve të administruara në institucione, veprimtaria ekonomike – financiare e të dy klubeve, ka vazhduar të jetë e përbashkët. Të dy këto klube, deri në vitin 1995 kanë qenë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Përmendja e dy emërtimeve të klubeve të mësipërme, rezulton edhe në VKM Nr. 50 dt 30.01.1995 "*Për ndryshimin e vartësisë së Klubit Sportiv Olimpik Partizani dhe Klubi i Futbollit Partizani*". Këto komplekse sportive, kanë pësuar ndryshime herë pas here, në lidhje me institucionin përgjegjës/administrues të tyre, sipas VKM-ve përkatëse.

Me VKM nr. 50 dt 30.01.1995, është vendosur kalimi i Klubit Sportiv Olimpik Partizani, Ministrisë së Kulturës.

1.1.1. Klubi i Futbollit Partizani, rezulton të jetë krijuar si një ndërmarrje e përbashkët, sipas vendimit nr. 7820 të vitit 1992 të Gjykatës së Rrethit Tiranë me emërtimin "*Sport Klub Partizani*".

Më dt 01.08.1994, ai regjistrohet me vendimin vendimit nr. 5763 dt 01.08.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, si shoqëria "*K.S.Partizani*" sh.p.k. (*Sport Klub Partizani*), me NIPT J91505019B, seli në Rruga *Frosina Plaku 31*. Administrator i saj ka qenë shtetasi Bujar Labinoti. Ortakë të kësaj shoqërie, kanë qenë Klubi i Futbollit Partizani (*ortak shtetëror*) dhe shoqëria *Abaco s.r.l.* ortak i huaj. Ortaku shqiptar do vinte në dispozicion të shoqërisë, kapitalin në natyrë, që ishte 2.8 ha tokë, godina dhe pajisje të vlerësuara në shumën 31 277 dollarë amerikanë, respektivisht 20 % të kapitalit themeltar, ndërsa ortaku i huaj, do të vinte në dispozicion të shoqërisë, kontributin në natyrë, në vlerën 91 277 dollarë amerikanë, respektivisht 80% të kapitalit themeltar.

2. Nga aktet rezulton se, në privatizimin e objekteve sportive, të ish Klubit të Futbollit dhe ish Klubit Shumësportesh Partizani, janë përfshirë gjithsej 5 (pesë) familje, e konkretisht trashëgimtarët e ish pronarëve Begeja, Alimehmeti, Vaqarri, Saliaga dhe Llagami.

Trashëgimtarëve të familjes Begeja, u derivon pronësia nga të ndjerit Mahmut dhe Xhemal Begeja.

Të pesta këto familje, fillimisht kanë paraqitur kërkesa për njohjen e pronësisë, në territoret e këtyre dy klubeve dhe siç pasqyrohet në vijim, megjithëse u është njohur pronësia, kthimi i pronës është bërë në sipërfaqe të kufizuar, për shkak të gjendjes mbi to, të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore.

3. Pronësia, këtyre familjeve, u është njohur nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave/Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, mbështetur në dokumenta të vjetra pronësie, vendime gjykate etj.

Në lidhje me hetimet zhvilluara mbi pretendimet për shpronësim gjatë mbretërimit Italian dhe dokumentat e pronësisë:

4. Familja Begeja, e ka mbështetur pretendimin e saj për pronat e ndodhura në sinurin Shëngjin, në një transkriptim që i referohet vitit 1935. Konkretisht, referuar rradorit të pronësisë, administruar pranë ASHK-së, evidentohet se, me nr 299, gjendet e pasqyruar notë transkriptimi, sipas të cilës, *...në favor të zz Mahmut e Xhemal Begeja, bijt e të ndjerit Murat, lindur e banues në Tiranë, tregtarë, kundra Ramazan Deliu, i të ndjerit Mehmet, lindur e*

banues në Tiranë, i cili në bazë të aktit publik me nr 10517/15952 datë 26.03.1935 të marrë prej meje M.Kokalari, noterit publik, banues në Tiranë u shiti zz. Mahmut e Xhemal Begeja që pranuan dhe blenë një tokë të vete prej 14 dylmë, në sinurin Shingjin të Tiranës, kufi L: Rruga e Krojit, P.Mahmud Begeja e Vllazën, V. Ramazan Deliu, J.Hendeku Beqiraga, të zotnueme, në bazë të akt njoftimit gjyqit të paqit Tiranë nr 35 datë 11.04.935, shitja u ba me çmimin fr ari njëqind çdo dynym, për të gjithë tokën e shitun fr ari 11300 të pagueme në dorë. Ky shënim, rezulton se mban nënshkrimin e noterit M.Kokalari dhe është bërë më datë 29.03.1935, megjithëse në pjesën përshkruese referohet data "njëmbëdhjetë prill një mijë e nëntëqind e tridhjet e pesë". Dokumentacioni mbi bazë të të cilit është bërë kjo notë transkriptimi, nuk gjendet në ASHK.

Pra, megjithëse konstatohet si i bërë në datë 29.03.1935, evidentohet se në përmbajtje të tij përmendet një akt i prillit 1935.

Sipas vërtetimit të pronësisë, të lëshuar nga Ipoteka datë 23.02.1995, ku gjendet edhe një shënim me shkrim dore "Blerë nga R.Deliu, 7.IX.95. Vërtetimi i pronësisë është i rregull", janë pasqyruar të dhënat e radhorit të pronësisë si më sipër cituar.

Në krah, është bërë shënimi se, është transferuar në nr 713 datë 12.02.1997 si dhe transkriptimi nr. 266 dt. 24.03.1943, në lidhje me një kërkesë padi. Shënimi mbi transferimin, referuar nr 713 datë 12.02.1997 ka të bëjë me regjistrimet e vendimeve të KKKP të vitit 1996. Kurse shënimi në lidhje me vitin 1943, nga kqyrja në ASHK, konstatohet se është një notë transkriptimi për Xhemal Begeja kundra Mahmud Begeja dhe zonjës Qamile, e shoqe e Rustem Petrelës, për pjesëtimin e pasurisë e konkretisht objekte të ndodhur lagjen Abdulla Bej, në tregun e Tiranës, tokë Sake, tokë Sallmona, dy shtëpi në katundin Selitë, tokë Qarrishtë, tokë Yzberisht, Babrue, tokë 15 dylm Gjinalë, në lagjen e re dhe 9 dynym në Selitë. Ullinj në katundin sheshe, Kus, katundin Yzberish, katundin e Myzes, Gronaj, Armath, Selitë, Mjell, Bathore, Pecalle, Vish, Petrelë, Durisht, Shinkoll, Lanabregas, Linz, Shtish – Tufinë, Cerme, Mihajes, Yb, Makal, Qehaja, Shytë, Berbes, Daijas, Pullumbas, Priska e Madhe, Priske e vogël, Dobresh, Bërzhitë, Farkë, Surrel.

Po në lidhje me këtë shënim të vitit 1943, sipas një çertifikate të lëshuar nga Zyra e Ipotekave më datë 05.09.1956, pasqyrohet se randohet me padi pjestimi për pronat e renditura më sipër kësaj çertifikate, (pronat e përmendura janë: një shtëpi e kopshti në lagjen Abdulla Bej; dyqane, një copë truall me sip 312 m² në lagjen Abdulla Bej, dy copë troje në lagjen Ismail Efendi njëri me sip 343.23 m² dhe tjetri me sip 2747.60 m²). Po në këtë çertifikatë përmenden se kanë kaluar në favor të shtetit, tre dyqane nga ato të përmendura, trualli i ndërimit, një ndërtesë në lagjen Abdulla Bej, një ndërtesë me anekse e truall po në këtë lagje, një ndërtesë me gjithë truall ndodhur po në atë lagje si dhe një ndërtesë me gjithë truall...).

5. Sidoqoftë, familjarët Begeja, konkretisht shtetasit Haki dhe Ednant Begeja kanë, depozituar më dt 30.10.1995, një kërkesë padi me të paditur Bashkia Tiranë, me objekt **Njohje pronësie, tej përmbajtjes së vërtetimit hipotekor** në bazë të nenit 86 shkronja "c" të K.Pr.Civile dhe n 22 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve". Në përmbajtje të kësaj kërkesë padije, pretendohet se pavarësisht se sipas vërtetimit nr 299 dt 11.04.1935, në pronësi të trashëgimlënësve Mahmut dhe Xhemal Begeja, figuron në pronësi të tyre, një tokë prej 14 dynym, e ndodhur në sinorin Shëngjin Tiranë, në fakt prona, nuk është 14 dynym por 32 dynym dhe gabimisht është transkriptuar në regjistrat e ipotekës për 14 dynym.

5.1. Për të vërtetuar pretendimet e palës, konstatohet se në dosje, ndër të tjera janë administruar

akte, që tregojnë, zgjerimin e fushës së aviacionit, në kohën e mbretërimit italian.

Kështu, është administruar një dokument "Relievi i Tiranës, shk. 1:2000. Viti 1940 e parcelës nr. 3, 4, 5, zona tek fusha e aviacionit deri tek kroi i Shëngjinit" me vulë të Arkivit Qendror Teknik i Ndërtimit Tiranë, viti 1995. Në këtë dokument, shihet e shënuar me shkrim dore, që për shtetasin Mahmut Bega është bërë shënimi: **28 200**.

Në një fletë formati A4, gjenden shënime me shkrim dore, të disa koordinatave dhe ky shënim: "Koordinatat e pikave të parcelës N. 5 me pronar z. Mahmut Begeja (Bega) me sipërfaqe 28 200 (njëzetë e tetë mijë e dyqint) metra katror të transformuara nga sistemi italian në sistemin shtetëror". Poshtë këtij shënimi është emri Ing. Nexhat Turkeshi dhe data 20.07.1995....

Një fragment harte, e sistemit italian të kohës, planimetri e fushës së Aviacionit, kopjuar nga origjinali, i cili ndodhet në arshivën e Ministrisë së Ndërtimit. Në këtë hartë, me shkrim dore, është shkruar në vijim: "Këtu paraqitet plani i zgjerimit të fushës dhe shpronësimet e pronarëve të tokës. Ky shpronësim nuk është realizuar sipas dëshmitarëve. E vë këtë planimetri në dispozicion të Kadastrës së Tiranës për të ndihmuar në gjetjen e pronave dhe kufijve të tyre. N/kryetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës Selman Zala nënshkrimi Tiranë 10/7/93". Kjo hartë është e parceluar me nr nga 1; 2; 3; 4; 5 marrë nga zona tek fusha e aviacionit deri tek Kroi i Shëngjinit, hartë identike me atë të gjetur gjatë hetimeve në arkivë, ku me numrin 5 të rrethuar tregohet sipërfaqja e tokës që i perket Mahmut Bega-s prej **28 200 m²**.

5.2. Për t'u provuar pretendimet e palëve në lidhje me pasjen e një sipërfaqe më të madhe se 14 dynym, janë administruar edhe dokumenta pronësi të familjeve të tjera, siç është vërtetimi i pronësisë i lëshuar nga Ipoteka, Ministria e Drejtësisë më dt 05.04.1993, nga nëpunësja Ruko Sako, për pronësinë e Sabrije Llagamit, ku evidentohet se prona e saj, një copë tokë e ndodhur në lagjen e Re të Tiranës, në sinorin Shëngjin, kufizohet nga jugu me tokën e vëllezërve Begeja si dhe vërtetesa e Zyrës së Hipotekave Tiranë me nr 957 të vitit 1942, për zonjat Haxhire e Adlije, gocat e Ali Elezit, ku toka e tyre prej 18 dylym në sinurin Shëngjin, kufizohet me tokat e çunave të Mirat Begës.

5.3. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8398 datë 14.12.1995, ka vendosur, **njohjen e pronësisë** së Mahmut e Xhemal Begeja, mbi një truall të ndodhur në **sinorin Shëngjin të Tiranës me sipërfaqe 14 dynym** dhe të kufizuar, nga veriu me Ismail Haxhi Pëllumbi e Adije e Haxhi Haxhire Elezi, jugu e perëndimi me hendekun e Beqir Agës dhe në lindje me vete pronarët e Mahmut dhe Xhemal Begeja.

6. Në lidhje me pronësinë prej 28 000 m², e të ndjerëve Mahmut dhe Xhemal Begeja, nga kallzuesi, u ngritën pretendime se këta shtetas ishin shpronësuar gjatë sundimit të Mbretërisë Italiane në Shqipëri. Për këtë arsye, u bënë hetime në këtë drejtim, u administruan akte si nga Arkiva e Shtetit, Biblioteka Kombëtare, nga dosje të ndryshme gjyqësore dhe gjithashtu edhe nëpërmjet letër porosisë nga shteti Italian.

Pronat e paluajtshme të shtetasve Begeja, kanë qenë objekt shpronësimesh për dobi publike nga Qeverija e Mbretit Zog, fakt ky që vërtetohet nga materialet e administruara nga AQSH në dosjet nr.22/1933; nr. 17/1935; nr. 45/1936; nr. 203/1934; nr. 180/1937; etj. sipas të cilave vërtetohet se, **objekt shpronësimi ka qenë një cope toke e perbame prej 44 607,60 m², toke kjo e ndodhur pranë Kazermave të Reja Ushtarake në Tiranë**.

Gjithashtu, me dekretin Luegotenenziale nr 215 datë 04.06.1943 - XXI është dekretuar, *shpronësimi i një copë toke, me një sipërfaqe mq. 8527.85, që ndodhet te Kazerma Shkumbini, pronë e zz. Mahmut dhe Xhemal Begeja, e cila kufizohet nga veri me tokën shtetnore të Kazermës Shkumbini, nga jugu me rrugën komunale, nga perëndimi me pronën e z. Panteqi, nga lindja me rrugën Tiranë - Durrës. ...Ky shpronësim ka ndodhur për ndërtimin e palazzinave për banimin e zyrtarëve, në Tiranë.*

Por pavarësisht këtij shpronësimi, me vendimin me nr 4469 dt 26.08.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ndër të tjera, trashëgimtarëve të Mahmut dhe Xhemal Begeja, i është njohur pronësia deri në vitin 1946, mbi një sipërfaqe toke prej 9 dynym në vendin e quajtur Kazermat e Shkumbinit në Tiranë.

7. Në lidhje me shpronësimet, në territoret e dy ish klubeve Partizani, janë kqyrur aktet e kohës, qoftë ato ligjore, qoftë ato që kishin të bënin me evidentimin e pronave përkatëse që u ishin nënshtruar shpronësimeve. Nga këto akte ka rezultuar se me dekretin e Mëkëmbësit datë **02 Shtator 1939-XVII nr. 77**, dekretohet se për interesa botërore mund të urdhërohet me pagesë të një shpërblimi të arsyeshëm dhe me mënyra të caktuara nga ky dekret, **rekuizimi** i pasurive të paluajtshme e të sendeve të luajtshme.

Kurse me **Dekretin e Pergjithshem Nr. 178, dt 11 Dhjetor 1939-XVIII** që permban normat për shpronësime për dobi publike, pasqyrohet se për ekzekutimin e punëve të një interesi botëror, **mund të bëhet shpronësimi i pasurive të paluajtshme ose i të drejtave që i përkasin këtyre pasurive.** Pas shpalljes së dekretit të Mëkëmbësit, në fletoren zyrtare, **ministri kompetent urdhëron ekzekutimin e planit** për pjesën që i përket çdo bashkije ose komune në të cilat do të bëhet shpronësimi. **Dekreti Ministror** i ekzekutimit të planit, u njoftohet pronarëve të pasurive të paluajtshme që do të shpronësohen, duke u treguar edhe shpërblimin e ofruar me të drejtën e ankimit 15 ditë. Kundërshtimi që i bëhet shumës së ofruar gjykohet nga kolegji arbitror. Kryetari i trupit të kolegjit arbitror brenda 5 ditëve thërret palët për pajtim dhe në rast se nuk arrihet pajtimi disponon që brenda 10 ditëve palët të emërojnë përfaqëuesit e tyre për fomimin e trupit të kolegjit arbitror. Në bazë të çertifikatës së lëshuar nga sekretaria e trupit kolegjal arbitror me të cilin vërtetohet se nuk është paraqitur në afat kundërshtim, ose në bazë të deklaratës së pranimit të shpërblimit të ofruar, ose të marrëveshjes së arritur, ose në bazë të vendimit arbitror, **Ministri kompetent mbi kërkesën e shpronësuesit, dekreton depozitimin e shumës së shpërblimit të ofruar.** Pasi të provohet me dokument depozitimi i bërë ose pagimi i shpërblimit, **Ministri deklaron shpronësimin dhe autorizon okupimin e pasurive** dhe dekreti ministror duhet të transkribohet në zyrën e ipotekave brenda 15 ditëve. Shkurtimi i vendimit duhet të botohet në fletoren zyrtare të mbretërisë. Pas kalimit të afatit 30 ditor nga ky botim, ministri autorizon pagimin e shumës së depozituar pronarit.

Në rast urgjence të madhe, Ministri kompetent për punët ushtarake, Ministri i Punëve Botërore, mbi kërkimin e Komandës së Lartë ushtarake, **mundet të disponojë okupimin e menjëhershëm** të paurve që do të shpronësohen, pasi më parë të përcaktohet me saktësi gjendja e këtyre, në prani të pronarëve. Për pjesën tjetër zbatohen dispozitat e caktuara në këtë dekret.

Kur veprat ushtarake, interesojnë mbrojtjen tokësore të vendit, zaptimi i menjëhershëm mundet të urdhërohet prej Komandantit të Lartë të Trupave ose Komandantit të Divizionit në juridiksionin e të cilit duhet të kryhen veprat (shtuar më 22.02.1940).

8. Nga Mbretëria Italiane, është evidentuar se është dekretuar zmadhimi i aeroportit të Tiranë, duke u specifikuar me akte të veçanta, tre zmadhime. Për të tre fazat janë nxjerrë aktet ligjore përkatëse.

8.1. *Zmadhimi i parë*: Me dekretin Ministërial “Shpronësime për zmadhimin e parë t’ aeroportit në Tiranë” datë 30.04.1940 zv. Ministri i Punëve Botore, Sh.Vërlaci, ka dekretuar shpronësimin e tokave t’okupime për zmadhimin e parë të sheshit t’ Aeroplanëve në Tiranë, pasi u pa se shumt e përkatëshme për t’iu paguar të interesuarëve janë depozituar rregullisht pranë Arkës së Përgjithshme të Ministrisë së Financave dhe pasi janë parë deklaratat që vërtetojnë pranimin nga ana e të interesuarëve, të idemnitetit të ofruar, d.m.th. *Halil Karapici, Delber Karapici, Nadire Jella, Zyhdi Juma, Besim Karapici, Petrit Karapici, Vediha Karapici, Tiftire Karapici* shumë fr. Shq. 51 815.50; *Mustafa Farka për gjysëm dhe Selim Farka dhe Shaban Farka* për gjysmën tjetër shumë fr. Shq. 22 665.80.

8.2. *Zmadhimi i dytë*: Konkretisht, me dekretin e Mëkambësit nr 32 datë 25 kallnuer 1940, botuar në Fletoren Zyrtare nr 18 datë 6 fruer 1940 – XVIII, në faqen 5, evidentohet se dekretohet zmadhimi i dytë i aeroportit të Tiranës. Mbi hartë janë treguar planet e parcelave dhe emrat e pronarëve të tokave që janë subjekt shpronësimi. Ministri propozues (*Ministri i Punëve Botore*), është i ngarkuar për ekzekutimin e këtij dekreti e përsa tjetër të kompetencës së tij simbas dekretit datë 11 dhetuer 1939-XVIII nr 178.

Me dekretin e Mëkambësit nr 384 dt 26 gusht 1940 – XVIII është dekretuar shpronësimi i tokës dhe i godinës pronë e *Bajram Xhepës*, të nevojshme për zmadhimin e aeroportit të Tiranës ...Në të njëjtën hartë shënohet plani pjetues i pasurisë së paluajtshme që do të shpronësohet dhe emnat e sejcilit pronar. Ministri propozues është i ngarkuar për zbatimin e këtij dekreti...

Me dekretin Ministror “Shpronësime për sheshin e aeroplanëve në Tiranë” zv. Ministri i Punëve Botore Sh.Verlaci ka dekretuar shpronësimin e tokave të: *Ismail Nurishmi, Mahmut Abdyl Kurdari; Kisha Katolike e Tiranës; Ismail Xhepa,...* Që nevojiten për zmadhimin e sheshit të aeroplanëve në Tiranë, pasi ka parë dekretin Ministerial datë 01 korrik 1940 – XVIII mbi depozitimin e shumave të përkatëshme. ...

Me dekretin Ministror datë 21 korrik 1941 – XIX “Shpronësime toke për smadhimin e aeroportit të Tiranës” zv. Ministri i P.Botore Kryeministri Sh.Verlaci, ka dekretuar shpronësimin e pronës së firmës *Bajram Xhepa*, për nevojat e zmadhimit të aeroportit të Tiranës e përbërë prej ndërtesës kryesore dhe vjegasat e saja si dhe m² – 903, ...pasi pa dekretin ministerial datë 21 korrik 1941-XIX që urdhëron depozitimin e shumë s të caktuar për indenitetin e pronës në fjalë.

Me dekretin e mëkambësit nr 318 datë 20.11.1942 – XXI, është dekretuar, mbi kërkesën e komandës aeronautike në Shqipëri, revokimi i dekretit Mëkambësuer datë 25 kallnduer 1940 – XVIII, nr 32, mbi shpronësimin e disa tokave për smadhimin e dytë të aeroportit në Tiranë...

8.3. *Zmadhimi i tretë*: Ka qenë pikërisht ky zmadhim, që duket se ka cënuar pronat e shtetasve Begeja.

Me Urdher të Komandës së Aeronautikes Shqiptare, i datës **8 Mars 1940**, bazuar në N. 12 të Dekretit Ligj nr. 178 datë 11 Dhjetor 1939 XVIII^o dhe në N. 12 të projekt Dekretit të hartuar në bazë të Dekret Ligjit nr. 59 datë 22.02.1940 XVIII^o, i cili urdhëron **okupimin e menjëhershëm**, të terreneve, me sipërfaqe totale 419 840 m², ku sipas listës, evidentohet me numrin 5^o) se është shënuar sipërfaqja **28 200 m²** e zotit **Mahmut Bega**, urdhërohet që të fillojë menjëherë procedura e shpronësimi, pas përpilimit dhe shqyrtimit të gjendjes përkatëse të tokës që do të zabtohet. Me shkresën nr 9233 date **9 Mars 1940**, Komanda e

Aeronautikës, i drejtohet Ministrisë së Punëve Botore, me tematiken: "*Occupazione Immobili per il 3° ampliamento dell'Aeroporto*" / "*Okupimi i pronës për zgjerimin e 3-të të Aeroportit*": E gjithë praktika, është shoqëruar edhe me hartën përkatëse të Ministrisë së Punëve Botore, ku sipërfaqja e pasurisë së paluajtshme të shtetasit *Mahmut Bega (28 200 m²)*, është shënuar me numrin 5- dhe kufizohet nga ana e Krojit të Shengjinit me: 4- pronat e *Ali Mehmet*; 3- pronat e *Zan Deliu*; 2-pronën e *Mal Pellumbi*; 1- E shoqja e *Ali Bim Elezit*; ndërsa nga ana e Rrugës së Kavajës me 6- pronën e të shoqes së *Qazim Nekiut*; 7- pronën e familjes së *Qyrit të Him Zanes*; 8- pronën e djemve të *Him Rrelit*; 9- pronën e *Ramazan Koçit* dhe 10- me pronat e *Xhavit Bej Lushna*.

Me dekretin e Mëkëmbësit, nr. 91, datë 11.03.1940 "*Zmadhimi i tretë i sheshit t'Aeroplanëve në Tiranë*", XVIII, Fletore Zyrtare datë 29.03.1940 – XVIII, në nenin e vetëm të këtij dekreti, përshkruhet "*Asht deklarue i interesës publike okupimi i tokave për zmadhimin e tretë të sheshit të Aeroplanëve në Tiranë që shënohen në hartën koreografike përkatëse që mbasi të jetë pa në Urdhënin tonë prej Ministrit propozues do t'i bashkangjitet këtij dekreti. Po n'atë hartë tregohet plani përpjestues i zonës që do të shpronësohet me emrat e pronarëve përkatës. Ministri propozues është i ngarkuem për zbatimin e këtij dekreti.*" Ndërmjet tyre evidentohet: ...*Mahmut e Xhemal Begeja fu Murati* – particella 5.

Me dokumentin "*Stato di consistenza*" nr. 5, datë 13 mars 1940 pasqyrohet gjendja e pronës së paluajtshme të vëllezërve z. *Mahmut e Xhemal Begeja fu Murat*, për t'u pushtuar për zgjerimin e tretë të Aeroportit të Tiranës. Kjo pronë është pasqyruar në këtë mënyrë: *Veri – perëndim = Mehmet e Ramazan Deliu – Mal Pëllumbi – Trashëgimtarët Elezi; Jug – e njëjta pronë, Lindje – Stërmasi, Konci, Relli, Zane e Nekiut*, Nr. I kadastrës 5; emërtimi i fondit Shingjin. Gjendja dhe cilësia efektive e pjesës që pushtohet – pascolita. Sipërfaqja në Ha që pushtohet 2.82 ha. Më datë 13.03.1940, është mbajtur proces verbali i pushtimit, me vëllezërit *Begeja*, duke u cilësuar particella nr. 5.

Në fletoren zyrtare nr. 47, të datës 29 Mars 1940, është botuar Dekreti i Mëkëmbësit Nr. 91 i datës 11 Mars 1940, ku dekretohet zmadhimi i tretë i sheshit t'Aeroplanave në Tiranë. Me shkresën Nr. 178/6 Prot. datë 15.03.1940 Kryesia e Këshillit Ministrues, i përcjell Ministrisë së P. Botore, kopjen e Dekretit të Mëkëmbësit të Përgjithshëm të Madhnis së Tij, Mbretit Perandor, mbi smadhimin e tretë të sheshit të Aeroplanëve në Tiranë. Me anë të këtij dekreti, dekretuar me propozimin e Ministrit të Punëve Botore është deklaruar me interes publik *okupimi i tokave për zmadhimin e tretë të sheshit të Aeroplanëve Tiranë që shënohen në hartën korografike përkatëse, e cila pasi të shikohet dhe nga Ministri propozues, do t'i bashkëlidhet këtij dekreti. Në atë hartë, tregohet plani përpjestues i zonës që do të shpronësohet, së bashku me emrat e pronarëve përkatës. Për zbatimin e këtij dekreti ngarkohet Ministri propozues. Urdhërohet gjithashtu botimi në fletoren zyrtare i dekretit.* Më 18.03.1940 Ministria e Punëve Botore, i dërgon kopjen e dekretit, Drejtorisë së Përgjithshme të Shtypit, propagandës dhe Turizmit, duke i kërkuar botimin e tij në të parin numër të fletores zyrtare.

Më dt 03.04.1940, Ministria e Punëve Botore, i dërgon Komandës Aeronautike të Shqipërisë Dekretin Ministerjal për ekzekutimin e planit bashkanjitë Dekretit dt 11 Mars 1940-XVIII, botue në Fletoren Zyrtare Nr.47, datë 29 Mars 1940, e që i përket zmadhimit të tretë të sheshit të Aeroplanëve Tiranë. Shkresë kjo e nënshkruar nga Kryeministri Shefqet Vërlaci.

Me Dekretin e Mëkëmbësit nr. 130 datë 09.04.1940 – XVIII "*Sistemimi i shërbimeve të Aeroportit në Tiranë*" është deklaruar i interesit publik, sistemimi i shërbimeve të aeroportit në Tiranë, në vendin e caktuar në hartën koreografike përkatëse që pasi të jetë parë me urdhërin

tonë prej ministrit propozues do t'i bashkangjitet këtij dekreti. Po në atë hartë tregohet plani përpjestues i zonës që do të shpronësohet me emrat e pronarëve përkatës... ..

Është kryer një akt ekspertimi më datë 02.07.1940, për shperblimin, për zgjerimin e tretë të aeroportit: - shih foto 240, ku me nr. 7 për parcelen 5 Mahmut e Xhemal Begeja është pasqyruar 28 200 m², Zona B....Mahmud e Xhemal Begeja fu Murati partic. 5, sip 28200 m². Në total, administrata Aeronautike, duhet të paguajë një shumë në tërësi prej 2 482 233 lira italiane. Në riepilogun "Për kompensimin e shpronësimit që i korrespondon firmave të shpronësuarra për zgjerimin e Aeroportit të Tiranës" me nr rendor 7 është vendosur Mahmut e Xhemal Begeja; nr. Rendor 8 Ethem, Rexhep e Selim Mehmet, nr rendor 9 Ramazan Deliu. Shuma komplekse në vlerën 2 990 699.07 lira italiane. Në vijim akti i ekspertimit përshkruan: "Kriteret e përgjithshme për kompensimin për pushtimin e përkohshëm". Terrenet janë pushtuar më datë 13.03.1940 dhe ndërtesat më 01.07.1940. Është vlerësuar kompensimi, me 5% e vlerës kapitale të pasurisë së paluajtshme. Mahmut e Xhemal Begeja, janë renditur me nr. 7 në vlerën 28200X0.05 = 1410.

Me një letër që mban vulën me datën 21.07.1940, Kreu i Divizionit Demanio, i është drejtuar Divizionit administrativ, për shpronësimin e tretë për zgjerimin e aeroportit, ku i përshkruan se dërgohet një fashikull i Gazetës Zyrtare Shqiptare, që përmban dekretin e përdorimit publik të veprës në fjalë dhe planin e parcelizuar, në dy kopje, të pronave të shpronësuarra.

Komanda e Xhenios FF.AA Shqipëri, me fletën n. 15292 të 08.08.1940, - XVIII- ka aprovuar ekspertimin me të cilin kompensohen, pronat e shpronësuarra nga Administrata Ushtarake.

Është gjendur ndërkohë një Deklaratë e datës 13.08.1940 e shtetasit Xhemal Begeja, i cili, me anë të kësaj deklarate, ka llogaritur vlerën e pjesës së tij, në pasuritë që ka në bashkëpronësi me vëllain e tij Mahmud Begeja. Ndërmjet këtyre pasurive, identifikon Në shënjinet toka gjashtëdhjetë e pesë denym që pjesa e jeme tridhjetë e dy e gjymës. (ka shënim në gjuhën italiane "Terreno vicino aeroporto") me vlerë prej 17 250 franga ari.

Me shkresën Nr. 18066 datë reference 25.10.1940, Komanda Aeronautike e Shqipërisë i drejtohet Ministrisë së Punëve Botore që të nxjerri dekrete për depozitim dhe shpronësime për smadhimin e tretë të sheshit të Aeroplanëve në Tiranë.

Në vijim të shkresës është një listë përshkruese e pronave të shpronësuarra për zgjerimin e tretë të sheshit të Aeroplanëve në Tiranë me emërtimin "Elenco descrittivo degli immobili espropriati per il 3 ampliamento dell'aeroporto di Tirana", ku janë përshkruar pronat si më vijon: Nr.10, Lutfije Elezi Stermasi, sipërfaqja e shpronësuar 48,944 m², në shumën 450,000 lira=72,000 FrA; Nr. 9 Ramazan e Ozman Konci fu Ibrahim, sipërfaqja e shpronësuar 10,820 m², në shumën 127,500 lira ose 20,400 FrA; Nr.8 Eredi Him Rreli, sipërfaqja e shpronësuar 9,200 m², në shumën 243,750 lira ose 39,000 FrA; Nr.7 Besim e Fiqeret Zana fu Abdurraman e Kume Zana fu Hasan, sipërfaqja e shpronësuar 14,400 m², në shumën 198,187 lira ose 31,710 FrA. Të gjitha pronat e mësipërme, në kufirin verior, kufizohen me Villazen Begeja. Kjo listë është nënshkruar nga Komandanti Gjenerali i Skuadres Ajrore Ferruccio Ranza. Më datë 26 Tetuer 1940 ka dalë Dekreti i Ministrit Sekretar Shteti për Punë Botore, i nënshkruar nga Kryeministri Shefqet Verlaci, me anë të së cilit është dekretuar depozitimi i shumës 163,110 franga shqiptare për subjektet e shpronësuarra të përshkruara më sipër. Me dekretin ministror datë 26.10.1940 – XVIII zv. Ministri i Punëve Botore, Sh. Verlaci, ka dekretuar shpronësimin e tokave të shtetasve të mësipërm, që nevojiten

për zmadhimin e sheshit të aeroplanëve në Tiranë, pasi ka parë dekretin Ministerial datë 24 tetor 1940 – XVIII mbi depozitimin e shumave të përkatëshme. ...

Gjithashtu po më datë **26.10.1940** ka dalë Dekreti i Ministrisë Sekretar Shteti për Punë Botore, i nënshkruar nga Kryeministri Shefqet Verlaci, me atë të së cilit shpronësohen tokat pronë të **shoqërisë Stamles** okupue për nevojat e **zmadhimit të tretë** t' aerodromit në Tiranë. Sipërfaqja e shpronësuar është 24,180 m² dhe çmimi i paguar është 443,437.50 lira ose 70,950 franga shqiptare. **Kjo pronë në kufirin verior kufizohet me Vëllezërit Begeja.**

Me një dokument të datës **23.11.1940**, (shih foton 296), është rënë dakord me firmat e mëparshme, që për pjesën e brendshme, e njohur si **Zona B** (që është pjesa e familjeve objekt *hetimi*), që të ofrohen Lit. 5 = FA. 0.80 për m². **Ne legjenden – foto 220** shfaqet skica grafike – harta e shpronësimeve ku me nr 5 shfaqen Mahmut dhe Xhemal Begeja, me nr 5 me sip 28 200, në skicë identifikohet si zona B. Mban datën **28.11.1940**.

Dosja Nr. 20 për periudhën 1940-1942 – Kolegji Arbitror, në faqen 7 të së cilës ndodhet një listë në gjuhën italiane me emrat e pronarëve të shpronësuar për zgjerimin e 3-të të Aeroportit, konkretisht me emërtimin “*Tirana Elenco delle ditte espropriate per il 3 apliamento dell'Aeroporto*”, ku **me numrin 1. janë shënuar emrat Mehmet e Xhemal Begeja**. Në dosjen me Nr.22 (shih kqyrjen pranë Arkivës së Shtetit) me emërtimin “*Ankesa, Korrespondenca e vendime lidhur me një konflikt të ngritur mes disa shtetasve shqiptarë dhe komandës së pushtimit italian për shpronësimin që kërkon të bëj për qëllime ushtarake dhe rezistenca e këtyre shtetasve*” dosja përfshin akte të periudhës 22.12.1940-10.08.1943.

Në brendësi të kësaj dosjes gjendet dosja Nr.121, viti 1941 “*Kërkesa kundërshtimore Mahmut dhe Xhemal Begeja, Shpronësimi i Xhenjos Ushtarake*”. Me shkresën nr. 8/1368 datë **24.01.1941**, Aeronautika e Shqipërisë, Direzione Demanio, i është drejtuar Sekretariatit të Kolegjit Arbitrar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me objekt “*Pasuritë e paluajtshme për zgjerimin e tretë, Kërkohet çertifikatë për kundërshtim të munguar*”. Në këtë shkresë parashtrohet se, në vijim të njoftimit të kryer nga Prokuroria e Shtetit të Tiranës, mbi kërkesën e avancuar të Komandës Aeronautike, me fletën nr. 8/21399 datë 29.12.1940 dhe në përputhje me sa kërkon neni 8 i Dekretit Luogotenziale nr. 178 datë 11.12.1939, luten që të nxirret për firmat e paraqitura në listë, çertifikata e mungesës së kundërshtimit, kundër shpërblimit të shpronësimit të ofruar nga Administrata Aeronautike për pasuritë e paluajtshme të shpronësuar. Praktika ka një karakter të veçantë urgjence. Shkresa Nr. 89 datë **27 kallnduer 1941** e Kolegjit Arbitruer të Shpronësimeve për Dobi Publike drejtuar Kryesisë së Gj. Shk. Së Parë Tiranë, me anë të së cilës, është përcjellë bashkëlidhur kërkesa kundërshtimore e **Z. Mahmut dhe Xhemal Begeja, kundër çmimit të ofruem për tokën e shpronësuar nga ana e Komandës Aeronautike**, me kërkesën që të thirren të përmendurit për të paguar taksën përkatëse dhe mandej me i sjell kolegjit për veprimet e tjera respektive.

Në brendësi të dosjes, gjendet një njoftim i Direzione Genio, Intendenza Superiore, i adresuar shtetasve Mahmut dhe Xhemal Begeja, me lëndë “*Ofertë për kompensim për shpronësim*”, ku me shkrim dore në fund është pasqyruar se është bërë njoftimi më datë **28.01.1941**. Kjo shkresë ka këtë përmbajtje: “*Ju komunikoj që Komanda e Xhenios FF.AA Shqipëri, me fletën n. 15292 të 08.08.1940, - XVIII- ka aprovuar ekspertimin me të cilin është fiksuar çmimi i terrenit në pronësinë tuaj, i shpronësuar nga Administrata Ushtarake, në 8 826 fr. A. Në rast se pranoni këtë çmim, duhet të dorëzoni në këtë zyrë, deklaratën ku paraqisni aprovimin tuaj dhe do të paraqiteni para një noteri që e zgjidhni vetë për lidhjen e kontratës të shitblerjes. Në rast të mos pranimit të kompensimit të ofruar, brenda 15 ditëve nga marrja e këtij njoftimi mund të*

paraqisni kundërshtim të çmimit pranë Kolegjit Arbitrar për Shpronësimin për Interes Publik pranë Gjykatës së Kasacionit të Tiranës në kuptim të neneve 4 të D.L. 11.12.1939 n. 178, publikuar në Gazetën Zyrtare të Shqipërisë nr. 132 datë 21.12.1939 - XVIII. Njoftohen që nëse skadojnë 15 ditë të afatit të ankimit, pa u paraqitur ankimi, shuma e kompensimit do të vlerësohet si e pranuar dhe do të vijohet me depozitimin e saj në kuptim të nenit 8 të dekretit të cituar (shënim i autorit: dekreti i cituar është 178 datë 11.12.1939). Gjendet një fletë ku janë bërë shënime me shkrim dore që referojnë se njoftimi për shtetasit e mësipërm është kryer më datë 28.01.1941 pasi janë kryer bashkë me dosjen e Hysenj Kazazit ndërkohë që është pretenduar se njoftimi është kryer më 28.02.1941 e nga ana e ftuesit.

Shkresa nr. 92 datë 31 kallduer 1941 e Kolegjit Arbitror të Shpronësimeve, drejtuar Komandës Aeronautike të Shqipërisë (Direzione Demanio), ku i bën me dije se, në përgjigje të shkresës nr. 8/1368 datë 24.01.1941 – XIX, njoftojnë se personat e shënuar prej kësaj komande në listën e posaçme kanë paraqitur kërkesat kundërshtimore relative, me përjashtim të Kryqit të Kuq Shqiptar. Megjithatë që të munden të konstatojnë nëse kërkesat kundërshtimore janë dhënë në afatin ligjor, u nevojiten dëftesë komunikimet e të përmendurëve. Prandaj janë në pritje të këtyre dëftesave për të lëshuar çertifikatën e kërkuar të moskundërshtimit për Kryqin e Kuq Shqiptar, eventualisht edhe për të tjerë në rast se të përmendurit nuk e kanë dhënë kërkesën e tyre në afatin ligjor. Bashkalidhur është lista me emrat e disa shtetasve ku ndërmjet tyre evidentohen edhe Mehmet e Xhemal Begeja.

Mahmut dhe Xhemal Begeja, më datë 06.03.1941, kanë paraqitur kërkesë kundërshtimore përpara Kolegjit Arbitruer të Çpronësimeve të Pronave për Dobi Publike pranë Gjyqit të Diktimit me anë të së cilës kanë kundërshtuar shumën për të cilën janë shpronësuar tokat e tyre për nevoja ushtarake prej 8,826 franga shqiptare. Kanë kërkuar rishqyrtimin e çështjes dhe vlerësimi të kryhet me anë të një ekspertimi. Konkretisht në këtë kërkesë ata parashtrojnë: *“...Më datë 28 Fruer 1941 – XIX na u komunikua nga ana e ftuesit, shkresa e Komandës Ushtarake pa numër e pa datë e cilla ju bashkëparaqitet, dhe nga e cila rezulton se autoriteti ushtarak i Komandës së Xhenjos që u sipërtregua, ka çponësue tokat t'ona për nevojat ushtarake, për shumën 8826 franga shqiptare siç tregohet hollësisht në përmbajtjen e shkresës së sipërtreguar. Mbasi ky çmim i caktuar për tokat tona është shumë i pakët dhe nuk i përshtatet realitetit brenda afatit ligjor po e kundërshtojmë për këto arsye justifikuese...Prandaj për këto arsye kërkojmë rishqyrtimin e çështjes nga të gjitha pikëpamjet ligjore dhe procedurale dhe më së fundi të vepriohet me anë të një eksperimenti siç dispoznojnë ligjet në fuqi, dhe prandaj të më paguhet vlera reale e pronave(tokavet) të shpronësuese për nevoja ushtarake. ..”* Në këtë dosje gjendet një akt i shkruar me shkrim dore, ku deklarohet i papranueshëm ankimi i mësipërm, për shkak të paarqitjes së kërkesës ankimore jashtë afatit. Në kapakun e kësaj dosje është shënuar me shkrim dore **“jashtë afatit”**.

Dosja Nr.4 ka në brendësi shkresën Nr. 121 dt 28.03.1941 të Kolegjit Arbitruer të Shpronësimeve për Dobi Publike drejtuar Intendenza Superiore Albania/ Direzione Superiore Genio Tirane, me anë të së cilës i ka kërkuar dëftesë-komunikimet relativisht me komunikimin e ofertës së çmimit të shpronësimit të Z. Mahmut dhe Xhemal Begeja dhe Hysen Kazazi. Kjo shkresë është nënshkruar nga Kryetari i Kolegjit Arbitruer Dr. Rr. Kolaj. Konkretisht ka këtë përmbajtje: *“Jeni te lutun me na derguesa ma pare diftese komunikimet relativisht me komunikimin e ofertes se çmimit te shpronësimit te z. Mahmut e Xhemal Begeja dhe Hysen Kazazi”*.

Me shkresën Nr. 89, datë 05.05.1941 Kolegji Arbitruer i Shpronësimeve për Dobi Publike i drejtohet Komandës Aeronautike të Shqipërisë ku i komunikon që më datë 08.05.1941 kanë

ftuar shtetasit Gafur Dibra, Myslym Beka, **Mahmut dhe Xhemal Begeja**, për të proceduar me tentativën e paqimit sikur disponon ligja përkatëse e shpronësimit. Në këtë shkresë i është kërkuar komandës aeronautike të dërgoj përfaqësuesin e saj në këtë mbledhje. Në vijim, nuk rezulton të gjenden të dhëna se çfarë ka ndodhur me këtë procedurë gjvqësore.

Me dekretin ministror datë 29.03.1941 – XIX zv. Ministri i Punëve Botore Sh.Verlaci ka dekretuar shpronësimin e tokës pronë e Kryqit të Kuq Shqiptar me një sipërfaqe prej mk 33 136 e kufizuar në veri me pjesën tjetër të shpronësimeve, në lindje me pronën e trashëgimtarëve të Hoxhë Farkës, në jug me rrugën e Durrësit, që nevojitet për ngrehjen e ndërtesave për nevoja ajronautike në Tiranë.

Me dekretin ministror datë 05.05.1941 – XIX zv. Ministri i Punëve Botore Sh.Verlaci ka dekretuar shpronësimin e pronës së Kryqit të Kuq Shqiptar okupue për nevojat e zmadhimit të tretë t' aerodromit në Tiranë, shënue nën nr 11 në planin përpjestues përkatës.

9. Megjithatë, konstatohet se, megjithëse nuk gjendet ndonjë dekret për shfuqizimin e dekretit për shpronësim të tokave për zmadhimin e tretë, evidentohen në vijim dekrete mbi *rekuizimin* e pronave. Konkretisht me dekretin Mëkambësuar nr 90 datë 29.04.1942 – XX “*Rekuizim pronash në Tiranë për zmadhimin e aeroportit*” është urdhëruar rekuizimi dhe për pasojë okupimi për një periudhë prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e këtij dekreti e pasurive të paluajtshme që përbëjnë të dytin e të tretin zmadhim të aeroportit të Tiranës, treguar në hartën korografike që i bashkangjitet këtij dekreti, së bashku me listën e pronarëve dhe vistuar me urdhër nga Kryetari i Këshillit të Ministrave propozues. Ky dekret do t’u njoftohet në vështrim të nenit 5 të D.M. datë 02 shtator 1939 - XVII nr 77, (dekret që ka të bëjë me pushtimet) pronarëve dhe mbajtësve të pasurive të paluajtshme të rekuizuara. Në listën e pronarëve renditen me nr **7 Begeja Mahmud e Xhemal i të ndjerit Murat**.

Me dekretin Mëkambësuar nr 129 datë 05.02.1943 – XX “*Zgjatje rekuizimi pasunirash në Tiranë për zmadhim t' Aeroportit*” është dekretuar rekuizimi dhe për pasojë okupimi i pasurive të paluajtshme ndodhur në Tiranë që përbëjnë të dytin dhe të tretin zmadhim të aeroportit të Tiranës, urdhëruar me dekretin datë 29 prill 1942 – XX nr 90, zgjatet për një periudhë tjetër prej gjashtë muajsh.

Me dekretin Mëkambësuar nr 204 datë 04 qershuer 1943 është dekretuar rekuizimi e për pasojë okupimi i pasurive të patundshme që gjenden në Tiranë e që përbëjnë zgjanimin e dytë e të tretë të aeroportit të Tiranës, urdhëruar me dekretin nr 90 datë 29.04.1942, shtyhet rishtas për një kohë prej gjashtë muajsh, duke filluar prej 29 prillit 1943...

Nuk ka të dhëna në lidhje me vendndodhjen dhe sip e pronës, për këto rekuizime.

10. Nga hetimi, ka rezultuar gjithashtu, se babai i shtetasit Jamarbër, shtetasi Luan Malltezi, ka ushtruar funksionin e drejtorit pranë Drejtorisë së Arkivit të Shtetit, siç dokumentohet ndër të tjera edhe nga një dokument me nr 1586/1 prot datë 12.05.1994 që ia ka dërguar Komisionit të Kthimit të Pronave, ku i ka bërë me dije e në këtë arkiv ndodhen dokumenta për shpronësimet e bëra gjatë viteve 1940 dhe 1941 për zgjerimin e aeroportit të Tiranës, kategori dokumentash kjo, që sipas tij, është klasifikuar si rezervate. Ky dokument megjithatë, nuk përmban ndonjë të dhënë në lidhje me pronat e familjes Begeja.

11. Përgjatë hetimit ka pasur edhe persona të tjerë që kanë pretenduar ekzistencën e shpronësimit nga mbretëria Italiane. Këhstu shtetasi *Isa Tare*, i pyetur më datë 21.12.2022, i cili ka qenë drejtor i Klubit Shumësportesh Partizani, nga vitit 1995 deri në 2005, deklaroi se

në dijeninë e tij, ish pronarëve të cilëve iu ishte dhënë kjo tokë, janë shpërblyer nga italianët shumë vite më parë dhe dokumentat janë në Firenze.

11.1. Më datë 20.09.2022, është pyetur shtetasi **Fejzi (Fejzo) Haxhia**, i cili ka deklaruar se, në vitin 2013, pasi ishte larguar rreth vitit 2006 nga Ministria e Mbrojtjes, ka filluar punë sërish pranë kësaj ministrie, si pjesë e strukturave të inspektimit. Mesa i kujtohet është larguar në fund të vitit 2014 nga puna kurse marrëdhëniet financiare i janë ndërprerë në muajin mars 2015...Ai pohon kryerjen e këtij inspektimi dhe sipas tij, sipas dokumentacionit që ka marrë në arkivin e shtetit, Klubi i Futbollit Partizani i rezultoi se ishte pronë shtetërore nga '39 – 40 dhe se familjet që ishin pronare në pjesën e ish fushës së aviacionit, përfshirë edhe klubin e futbollit Partizani, janë kompensuar nga qeveria italiane nëpërmjet bankës italiane. Ka gjetur mandate të katër pagesave për të gjitha familjet, me perjashtim të familjes Begeja.

11.1.1. I ripyetur më datë 08.01.2024, shtetasi **Fejzo (Fejzi) Haxhiaj**, ka deklaruar se, disponon një pjesë fotokopje të dokumentave të administruara në kuadër të këtij inspektimi si dhe disponon CD të përcjellë nga arkiva e shtetit me dokumenta të vëna në dispozicion nga kjo arkivë, bashkë me shkresën përkatëse përcjellëse. Gjithashtu disponon edhe një hartë të cilën e kanë përgatitur në bazë të hartave të lëshuara nga arkivi i shtetit. Këto dokumenta i ve në dispozicion dhe jep sqarime se ku janë dorëzuar zyrtarisht.

11.2. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga shtetasi Fejzo (Fejzi) Haxhia, për një inspektim të kryer në lidhje me privatizimin e objekteve të Klubit të Futbollit Partizani, ku sipas tij kishin rezultuar të dhëna në lidhje me një shpronësim në kohën e mbretërimit italian, të familjeve që pretendonin pronësinë, u bënë kërkime pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Rezultoi se, me shkresën nr. 2620 prot datë 30.06.2014 drejtuar Ministrit të Mbrojtjes Mimi Kodheli nëpërmjet drejtorit të kabinetit Gjergj Teneqexhi, nga sekretari i përgjithshëm Arian Kraja, përgatitur nga drejtori i inspektimit të përgjithshëm dhe antikorrupsionit Kolonel Neshet Shena me lëndë "*Miratim i planit të verifikimit për kontrollin e procedurave të dorëzimit dhe shitjes së pronës nr 11 K.F.Partizani*" datë 27.06.2014, i është parashtruar ministres se, në zbatim të detyrës së vënë nga ana e saj, për verifikimin e procedurave për dorëzimin dhe shitjen e pronës nr 11 Klubi i Futbollit Partizani, kanë përgatitur planin e verifikimit dhe projekt urdhërin për këtë qëllim. Me urdhërin nr 900 datë 02.07.2014 "*Për verifikimin e procedurave të dorëzimit dhe shitjes së pronës nr 11 "Klubi i Futbollit Partizani"*" të Ministrit të Mbrojtjes Mimi Kodheli, është urdhëruar që brenda datës 10.07.2014 të kryhet kontrolli tematik në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe Brigadën Logjistike mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe administative për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës nr 11 "*Klubi i Futbollit Partizani...*". Me shkresën nr 2620/1 prot datë 03.07.2014, të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes Mimi Kodheli, është hartuar plani i verifikimit për procedurat e dorëzimit dhe shitjes së pronës nr 11 Klubi i Futbollit Partizani. Struktura e grupit të kontrollit përbëhet nga: Kolonel **Fejzo Haxhiaj**; N/kolonel **Sofokli Kondakçiu**; N/Kol **Ndue Mamli** pranë Drejtorisë J/4 në SHPFA; Kolonel **Bashkim Bunavia** specialist auditit në drejtorinë e auditit në MM; **Migena Shema**; Major **Ramiz Haxhia** specialist pranë IGJU; **Agim Zeneli** specialist auditit në Drejtorinë e auditit në MM; Shkëlqim Xhoxhaj specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve. Plani i verifikimit është nënshkruar nga kolonel Neshet Shena.

Por, me shkresën nr 23/1 prot datë 09.01.2024 të Ministrisë së Mbrojtjes, konfirmohet se në arkivat e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk ndodhet asnjë shkresë e cila të përmbajë konkluzionet e plan verifikimit, për këtë çështje. Në mënyrë verbale, kanë marrë informacion nga punonjësit, se konkluzionet, i janë dërguar nëpërmjet postës elektornike tek Ministri i Mbrojtjes nga drejtori i inspektimit të saj kohe i ndjeri kolonel Neshet Shena.

Me qëllim që të arrinim të gjenim materialin e sipërcituar, janë pyetur disa punonëjs të Ministrisë së Mbrojtjes. Kështu, është pyetur më datë 10.10.2023 shtetësja **Luljeta Tafani**, e cila ka qenë specialiste në sektorin e kërkesë ankesave, drejtorja e inspektimit të përgjithshëm; më datë 10.10.2023 shtetësja **Natasha Gjoka**, e cila ka punuar tek sekretari arkiva dhe si protokolliste në sekretari arkivë; më datë 02.11.2023 është pyetur shtetasi **Arian Kraja**, i cili ka ushtruar funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes në periudhën 16.09.2013 deri më datë 10.10.2017.

11.3. Është pyetur më datë 18.01.2023, shtetasi **Bashkim Punavija**, i cili deklaron se, *nuk është njohur ndonjëherë me urdhërin e mësipërm (atë me nr 900 datë 02.07.2014), megjithëse ka qenë shef sektori nga viti 2013 deri në vitin 2018 tek auditi. Deklaron se ish Klubin Partizani, nuk e kanë audituar pasi në dijeninë e tij ka qenë shoqëri aksionare që varej nga Ministria e Ekonomisë. Nga aktet rezulton se shtetasi Bashkim Punavija, është xhaxhai i shtetasit **Enton Punavija** (anëtar i Këshillit Teknik të Tiranës në vitin 2008 kur janë dhënë lejet e ndërtimit për subjektin Kontakt në territoret e Klubeve Partizani dhe bashkëpunëtor i ngushtë në vijim me shtetasin Fatmir Bektashi).*

Është pyetur më datë 19.01.2023, shtetasi **Ramiz Haxhija**, i cili deklaron se nuk është vënë në dijeni me këtë urdhër dhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë në grupin e kontrollit. Është pyetur më datë 18.01.2023, shtetasi **Ndue Mamli**, i cili nuk mban të ketë firmosur asnjë procedurë apo letër që bëhet fjalë për këtë objekt dhe se gjatë kësaj periudhe ka qenë shef i furnizimit dhe i trajtimit të materialeve të tepërta. Fizikisht për këtë objekt nuk ka qenë kurrë.

11.3.1. Është pyetur më datë 18.01.2023 shtetasi **Sofokli Kondakçiu**, i cili deklaron se, *nuk i kujtohet saktësisht se si është proceduar, por detyra e tyre ka qenë që të mbledhnin dokumentacion në interes të zbatimit të urdhërit. Në përbërje të komisionit, kanë qenë pjestarë nga struktura të ndryshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, por puna nuk ishte e përbashkët pasi secili kryente detyrat e veta sipas përgjegjësisë. Detyra e deklaruesit ka qenë mbledhja e dokumentave nëpër institucione. Nuk i kujtohet nëse është hartuar një akt lidhur me përfundimet e verifikimeve të procedurave të dorëzimit dhe shitjes së pronës nr 11 "Klubi i Futbollit Partizani".*

11.3.2. Është pyetur shtetësja **Mimi Kodheli**, më datë 18.07.2024, e cila ka deklaruar se, *në lidhje me rezultatet e auditimit të brendshëm, për rastin e Klubit të Futbollit Partizani, nuk i kujtohet nëse ka parë konkretisht raportin e kontrollit megjithëse pranon kryerjen e këtij inspektimi.*

11.3.3. Më datë 02.11.2023 është pyetur shtetasi **Arjan Kraja**, i cili ka sqaruar se, *ka filluar punë pranë Ministrisë së Mbrojtjes më datë 16.09.2013 në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe e ka mbajtur këtë detyrë deri më datë 10.10.2017. Jep shpjegimet e veta se si mund të ketë lëvizur materiali.*

12. Ka qenë vetë shtetasi Fejzi Haxhia që na ka vënë në dispozicion një kopje të akteve të kontrollit/auditit të ushtruar dhe kopje të dokumentacionit të administruar nga grupi i auditit. Nga informacioni që është përgatitur dhe nënshkruar nga kolonel Fejzo Haxhij dhe n/kolonel Sofokli Kondakçiu si dhe aktet bashkalidhur, atyre iu është krijuar bindja se prona në fjalë ishte shpronësuar.

13. Megjithatë, pas shqyrtimit të hollësishëm të gjithë dokumentacionit, vlerësohet se, u arritën të gjendeshin të dhëna në lidhje me shpronësime të vëllezërve Mahmut dhe Xhemal Begeja, që nga koha e Mbretërisë Shqiptare, por nuk u arrit të vërtetohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ishte konkluduar procedura e shpronësimit në lidhje me territoret ku u shtrinë më vonë dy ish Klubet Partizani, ashtu si nuk u gjendën në fakt, as shpronësime/shtetëzime nga shteti shqiptar pas Çlirimit, duke e lënë sërish situatën e pronësisë të paqartë.

Konkretisht, nuk u gjend asnjë dokument që t'i përkiste periudhës së regjimit monist ku të pasqyrohej se ishte shtetëzuar trualli i pretenduar dhe asnjë dokument ku të pasqyrohej se familja Begeja e ka zotëruar këtë truall, deri në kohën e shtetëzimit, nga shteti monist, në rast se ka ndodhur ky shtetëzim. Kështu, referuar Vërtetimit të pronësisë datë **01.09.1992** të lëshuar nga nëpunësi i hipotekës **Ruko Sako**, me përmbajtje si vijon; *"Në regjistrin ipotekor Nr. 266, datë 24.03.1943 në favor të zotit Xhemal Begeja kundër Mahmut Begës dhe Qamile Petrelës është ngritur një kërkesë padi në datën 17.03.1943 në të cilën kërkohet pjestimi pasurisë si vijon: Një shtëpi, tre troje, një kopësht e shtëpi e re e një magazinë, që ndodhet në lagjen Abdulla Bej të Tiranës, 10 dyqane në treg të Tiranës, tokë në Sauk prej 100 dylmës, tokë Sallmone prej 70 dylm brenda të cilës ndodhen dy shtëpi në katundin Selitë të Tiranës, tokë gjashtëdhjetë dylm, qerishte tetëdhjetë dylm, tokë prej tetë dylmësh në katundin Yzberisht të Tiranës, tokë dyqind e shtatëdhjetë dylmësh e një shtëpi në Katundin Babru, tokë pesëmbëdhjetë dylm Gjinalë në Lagjen e Re, tokë nëntë dylm në katundin Selitë. Në vijm janë të pasyruar rrënjët e ullinjve dhe katundin në të cilat gjenden.*

Këto prona u gjetën të regjistruara; Një dyqan Nr.572 viti 1919, Nr.577 deri 581 viti 1925 e Nr.56 deri në 59 viti 1926, pesë dyqane, toka lagje Nr.299 viti 1935, tokë 30 dylm në katundin yzberisht Nr.197 viti 1935 toka 318600 metër katror në katundin Babrru me Nr.273, viti 1939, truall 70m2 në Lagje Abdulla Bej me Nr.288 viti 1928, truall 1312 m2 Lagje Abdulla Bej me Nr.287 viti 1928, shtëpi në lagjen Abdulla Bej me Nr.8 korrik 1913, tokë në lagjen e re Selitë e Yzberisht me Nr.10,11,12354,361,358 dyqane me Nr.3 e 4 në tetor 1314 dhe të gjitha pronat e tjera në fshatra janë të regjistruara me Nr. 397, 405, 528,663 e 664 datë korrik 1313 allaturka.

Ky vërtetim pronësie është nënshkruar nga punonjësi i hipotekës Ruko Sako.

Në këtë vërtetim është shënimi: "Nga kontrolli që ju bë regjistrave mbas transkriptimit të kërkesës dhe në pronën bazë si para transkriptimit të kërkesë padisë dhe mbas transkriptimit të saj , nuk del që gjyqi të jetë zhvilluar, sepse nuk ka asnjë transkriptim të ri të këtyre pronave."

Është gjendur një shkresë me Nr. 462, datë 23.03.1943, me anë të së cilës Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, i drejtohet zyrës së Ipotekave, duke i dërguar një kopje të kërkesë padisë të paditësit Xhemal Murat Begeja tregtar dhe banues në Tiranë, ngritur kundra të paditurve Mahmut Begeja e Qamile Begeja, e shoqja e Rustem Petrelës për pjestim pasunije. Kërkesë padia, është paraqitur nga paditësi Xhemal Begeja (i përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga avokat Spiro Stringa) drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me palë të paditur shtetasit Mahmut Begeja dhe Qamile e shoqja e Rustem Petrelës, banuesa në Tiranë. Në këtë kërkesë padi, janë listuar pasuritë në të cilat palët e sipërcitura janë bashkëpronar për të cilat kërkohet pjestimi i pasurisë dhe në rast të ndonjë pamundësie për t'u pjestuar, pasuria të shitet në ankand dhe shuma të ndahet ndërmjet bashkëpronarëve. Në përmbajtje të kërkesë padisë në pikën 22 është përshkruar pasuria *"Një copë tokë, me emën "Gjinalë" e ndodhur në lagjen e Re të Tiranës, e përbame aproksimativisht prej 15 dynym, e kufizuese me prruen e Lanës, Rexhep Rada, Mehmet Pinari dhe Shab Xhafa".*

Me proces verbalin Nr.2, datë 13.11.1946 të Komitetit të Fshatrave për zbatimin e Reformës Agrare, evidentohet se, gjatë mbledhjes së komitetit janë marrë vendime në lidhje me klasifikimin e pronave dhe pronarëve për zona të ndryshme. Konkretisht: Selta: a) **Mehmet Mahmut Begeja- Mbasi ka marrë toka në Yzberisht, toka e Selitës të shpronësohet (banon veç Xhemal Begës).... C) Xhemal Begeja – Kategoria 3, Neni 2 i Reformës Agrare. Babrru, pika (i) Mehmet Begeja- shtetëzue.**

Nuk evidentohet pronë, në sinurin Shëngjin.

Vendimet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, periudha 1995 – 1999

14. Në vitet e para, pas vendosjes së pluralizmit, Shqipëria u përfshi nga një tërësi reformash, miratimesh ligjesh dhe aktesh nënligjore, që synonin ndër të tjera edhe kthimin e pronës, ish pronarëve. Konkretisht, rezultoi që të jetë miratuar ligji nr 7698 datë 15.04.1993 “*Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve*”, ku sipas nenit 1, ky ligj u njeht ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës, të dala pas datës 29 nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin apo kompensimin e tyre.

15. Pikërisht në këtë kohë, konstatohen edhe veprime nga familjet që pretendonin pronësinë mbi territoret ku shtriheshin dy klubet sportive Partizani. Nga aktet që parashtrihen në vijim, familja Begeja, në lidhje me pronësinë mbi këto territore, pas daljes së vendimit të KKKP në vitin 1996, nuk rezultoi të ketë pasur vendimmarrje të tjera në lidhje me këto prona, deri në vitin 2006.

Familja Begeja:

16. Mbështetur në një pjesë të dokumentave sa më lart, rezultoi se, familja **Begeja** ka investuar Komisionin e Kthimit të Pronave, për njohjen dhe kthimin e pronave në vendin e quajtur Sinuri Shëngjin. Por në këtë kohë, në këto territore, qëndronin objekte të dy ish Klubeve Partizani. Kështu rezultoi se me *vendimin Nr.532, datë 25.04.1996 të KKKP ish pronarëve Mahmud e Xhemal Begeja: U është njohur 28 dynym pronë me dy parcela; U është kthyer 1900 m2 dhe është vendosur të kompensohen për truallin me sip 26 100 m2.*

Në arsyetimin e vendimit parashtrihet se **sip prej 28 dynym** përbëhet nga: **Një tokë prej 14 dynym** e ndodhur në sinurin Shëngjin të Tiranës që kufizohet nga lindja rruga e Kroit, Perëndim Mahmut Begeja dhe vëllezër, veriu Ramazan Deliu, Jugu Hendeku i Beqir Agës, të zotëruar në bazë të aktit të njoftunisë së gjyqit të Paqit të Tiranës me nr. 35 dt 11.04.1935. Kjo pronë figuron e regjistruar në regj ipotekor me nr. 299 datë 11.04.1935; dhe Një truall me sip 14 dynym e ndodhur në sinurin Shëngjin të Tiranës dhe e kufizuar nga veriu me Ismail Haxhi Pëllumbi e Adije Haxhire Elezi, Jugu e perëndimi me hendekun e Beqir Agës dhe lindje me vetë pronarët Mahmut dhe Xhemal Begeja. Kjo pronë vërtetohet nga vendimi i Gjykatës së Rrethit nr. 8398 dt 14.12.1995.

Specialistët bënë verifikimin dhe hartuan p-v përkatës nga i cili rezultoi se: Trualli ka sip të përgjithshme 28 000 m2 dhe paraqitet si më poshtë:

- **Truall i lirë** ka sip të përgjithshme S1=1900 m2 (S1 në genplanin bashkangjitur)
- **Truall i zënë nga ndërtime shtetërore** ka sip të përgjithshme 19 527 m2 dhe përbëhet nga ambiente dhe ndërtesa të klubit sportiv Partizani dhe objekte të tjera si më poshtë:

- Truall i zënë nga fusha e futbollit me sip 2 500 m²;
- Truall i zënë nga tre fushat e lojërave me dorë me sip 3331 m²;
- Truall i zënë nga territori i Stacionit Metereologjik me sip 1044 m²
- Truall i zënë nga ndërmarrja Albabeton me sip 4000 m²
- Truall i zënë nga fusha sportive me sip 8460 m²
- Truall i zënë nga ndërtime 1 kt të klubit Partizani me një sip 192 m²
- **Truall i zënë me ndërtime të përhershme ka një sip të përgjithshme 6573 m² dhe përbëhet nga:**
- Truall i zënë nga pallate 5 kt me sip 372 m²
- Truall i zënë nga rrugë e sheshe me sip 5056 m²
- Truall i zënë nga shtëpi 1 kt me sip 1145 m²

Komisioni ka vendosur:

- 1) **Të njohë** Mahmut dhe Xhemal Begejë ish pronarë të pronës së tyre të përbërë nga 28 dynym në dy parcela nga 14 dynym ...

Trualli kthehet dhe kompensohet si më poshtë:

- a) – **t'i njohë** ... pronësinë dhe t'i kthejë truallin e lirë me sip $S1=1900$ m²...
- **Të kompensojë** ... për truallin e zënë me ndërtime të përhershme dhe shtetërore (pallate 5 kt, rrugë e sheshe, shtëpi 1 kat, objektet e klubit sportiv partizani si fusha e futbollit, tri fushat e lojërave me dorë, dy ndërtesa 1 kt, territori i stacionit metereologjik, ndërmarrja Albabeton) me sip 26 100 m². (Truall i zënë nga fusha sportive me sip 8460 m² nuk është përmendur por në sip totale është vendosur për kompensim)
- b/1) – **t'i njohë** ... të drejtën e parablerjes së objekteve shtetërore si: fusha e futbollit (2500 m²); fushat e lojërave me dorë (3331 m²); dy ndërtime 1 kt të klubit sportiv Partizani (192 m²); territori i stacionit metereologjik (1044m²); ndërmarrja Albabeton (4000m²)...(Pra në lidhje me truallin me sip 8460 m² nuk është shprehur as këtu)

Prona në përgjithësi, kufizohet Lindje shtëpi private (ish rruga e kroit), perëndim ndërmarrja qilim punuese (ish hendeku i Beqir Agës), veri vazhdimi i ndërmarrjes Albabeton, klubi sportiv Partizani (ish Ramazan Deliu, Ismail Haxhi Pëllumbi, Adlije dhe Haxhire Elezi), jugu pall 5 kt, vazhdim i fushave të lojërave me dorë, stacioni metereologjik, ndërtime 1 kt dhe 2 kt (ish hendeku i Beqir Agës genplani bashkëngjitur).

16.1. Në vijim, familjes Begeja i është kthyer edhe një sipërfaqe tjetër. Kështu rezulton se me vendimin nr. 656 dt 08.08.1996 të KKKP ish pronarëve është pasqyruar se, pasi është marrë në shqyrtim shkresa me nr. 9072 dt 31.05.1996 e Drejtorisë së Urbanistikës për miratimin e sheshit të ndërtimit të pallatit 6 kt në pronën e familjes Begeja (terreni sportiv i klubit sportiv Partizani) vendosi që: **Truallin me sip 435 m², ta konsiderojë të lirë dhe t'ia kthejë** ish pronarëve Mahmut dhe Xhemal Begeja. Shuma e kompensimit të njohur me vendimin nr. 532 datë 24.04.1996 bëhet 25 665 m².

16.2. Me nr ind 713 dt 12.02.1997, është regjistruar Vendimi i KKP nr 132 dt 25.04.1996 dhe nr 656 dt 08.08.1996 e konkretisht: *Një truall i lirë me sip 1900 m² dhe një truall i lirë me sip 435 m²*. Konstatohet se, si origjinë përmendet prona me nr 299 dt 11.04.1935. Pra, i referohet pronës me sip 14 dynym dhe **nuk gjendet origjina e pronës tjetër me sip 14 dynym e njohur në vijim.**

Në vijim rezulton se, me nr 901 dt 22.05.2008 kjo pronë është inskriptuar në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k. dhe është transferuar me nr 54 datë 27.01.2012. Në nr ind 54 datë 27.01.2012 rezulton të vijojë të regjistrohet sip prej 1900 m² në bazë të dëshmimeve të trashëgimisë. Kjo

pronë tashmë merr nr 3/115. Me nr ind 122 dt 24.02.2012 vijon të regjistrohet prona me sip 435 m2, në bazë të dëshmimeve të trashëgimisë.

16.3. Pra, si më sipër konstatohet, familjes Begeja i kthehen vetëm 2 335 m2 dhe pas vitit 1996, nuk evidentohet vendime të Komisionit të Kthimit të Pronave, për kthim prone në lidhje me këto territore.

Familja Saliaga

17. Për subjektin e shpronësuar **Qamil Saliaga**, rezulton se me **vendimin nr. 7 datë 15.04.1995 të KKKP ish Pronarëve**, është vendosur të njihet pronësia shtetasit Qamil Saliaga, për një copë tokë të përbërë nga sip 8 780 m2 dhe një rryp tokë me sip 270 m2 që ndodhet në lagjen e re të Tiranës dhe që kufizohet Lindje me tokën e Sabrije Llagamit, perëndim me Iljaz Çizmen e pjestarë, Jugu me Shaqit Petroschin dhe veriu me hendekun e Beqiragës. Prona kthehet dhe kompensohet si vijon:

A. **Një truall i lirë me sip të përgjithshme 3967 m2**, i përbërë nga katër parcela S10 – 1750 m2, SL9 – 328 m2 (në të cilën gjendet themele me xokolaturë me sip 72 m2), S 20- 1369 m2 dhe S21 – 490 m2...duke ruajtur për çdo rast rrugë kalimi sipas normativave të miratuara nga Urbanistika dhe në bazë të n.19 të ligjit nr. 7698 dt 15.04.1994 i njihet dhe u kthehet pronarit **Qamil Saliaga**. ...

B. **Një truall i zënë me ndërtime shtetërore me sip të përgj 3237.80 m2** (palestra e basketbollit, S1 – 1396, ndërtesë 1 kt me kollona ..., S 3 – 40 m2, dhomë e zhveshjes 1 kt, S4 – 44 m2, lavanteria S6 – 140 m2, godina 1 kt mbrapa palestrës së mundësave S 8 – 78 m2, klubi dhe palestra e mundësave S 9 - 638 m2, një pjesë e hotelit të klubit Partizani S 10 – 50 m2, magazina 1 kt e klubit Partizani, S 11 – 122 m2, magazinë 1 kt e klubit S 12 – 91.80 m2, një pjesë e parkut të oficinës të 21 dhjetorit, 2 kt, S 13 – 34 m2 dushet e klubit partizani, S 14 – 130 m2, ndërtesa e bandës së ushtrisë S 15 – 474 m2 si dhe një truall i zënë me ndërtime të përhershme, rrugë kalimi, kabinë elektrike me sip të përgjithshme 1575.20 m2)...**kompensohet**...

C. ...i lind e drejta e parablerjes së objekteve: **Palestra e basketbollit ..., ndërtesa e bandës së ushtrisë** etj... kur ato të privatizohen (për objektet e cituara më sipër).

17.1. Familja Saliaga, ka hyrë në konflikt pronësie me familjen Llagami dhe nga aktet rezulton se, vendimi i mësipërm i kthimit të pronave, është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë nga familja Llagami. Gjykata me vendimin nr. 10016/484 akti dt 12.06.1997, të formës së prerë, ka vendosur miratimin e zgjidhjes së çështjes me pajtim sipas marrëveshjes midis palëve. Konkretisht është disponuar në këtë mënyrë: *Miratimin e zgjidhjes së çështjes me pajtim midis palëve sipas kushteve të përcaktuara në akt marrëveshje; Trashëgimtarët e Qamil Saliagës të mbeten pronarë të sip prej 8780 m2 të kthyer nga KKKP me vendimin nr. 7 datë 15.04.1995; t'i njihet dhe të kthehet nga KKP trashëgimtarëve të Sabrije Llagamit parcela nr. 8 me sip prej 8780 m2 e hipotekuar me nr. 28/34 datë 26.01.1946 në emër të Qamil Saliagës (e cila është e patrajtuar nga KKKP) dhe ka për kufi Sabrije Llagamin Lindje, Veriu me kanalën e Beqir Agës, Jugu Shaqir Katroschi, perëndimi Iljaz Çizmja (Kjo pronë i kthehet në vend të pronës së mësipërme që i është kthyer gabimisht trashëgimtarëve të Qamil Saliagës nga KKKP...". Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 16.06.1997.*

17.2. Në ZVRPP, nga kqyrja ka rezultuar se, me nr ind. 3797 dt 04.09.1995 është regjistruar vendimi i mësipërm i komisionit të kthimit të pronave. Në vijim, rezulton se në librat e vjetër të pronësisë, është bërë shënimi se, është transferuar me nr 923 dt 29.09.2010 në ZK 8220.

Në rradhorët e pronësisë, rezulton se është bërë me nr ind. 923 dt 29.09.2010 regjistrimi i vendimit të gjykatës nr 5412 datë 30.06.2010 dhe V.P. + HTR vol 112, faqa 200, 201, 202, ref 041754 i truallit të lirë me sip të përgj 3967 m². Nga bashkëpronësia është përjashtuar Caje Saliaga. Mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa nr 2/411/ND vol 40 faqa 213 dhe nr 2/412/ND, vol 40 faqa 214 (L.Leg. Ref 12646).

17.3. Në vijim, pasur parasysh sa më lart, referuar konfliktit të dy familjeve, Llagami dhe Saliaga, me Vendimin Nr. 98, dt 17.12.1999 të KKP Ish- Pronarëve është vendosur t'i njihet pronarit **Qamil Saliaga** (trashgimtarëve të tij) pronësinë mbi pronën e tij, të përbërë prej një copë toke me sipërfaqe 8510 m².

Prona që kthehet dhe kompensohet është si vijon: një truall i përbërë nga 4 (katër) parcela, me sipërfaqe 3967 m² i **kthehet** pronarit Qamil Saliaga (trashgimtarëve të tij) (S18 = 1790 m² + S19=328m² + S20=1369m² + S21=480m²).

Trualli i zënë nga: *palestra e basketbollit S1=1396 m², nga ndërtesa 1 kt me kollona me kapriata të zbuluara S3=40 m, dhoma e zhveshjes 1 kt me S4= 44m², Lavanteria S6=140 m², Godinë 1 kt mbrapa palestrës së mundësave S8=78 m², Klubi dhe palestra e mundësave S9=638 m², Një pjesë e lokalit të klubit Partizani S10=50 m², Magazina 1 kt e klubit Partizani S11=122m², Magazina 1 kt e klubit S12=91 m², Një pjesë e parkut të oficinës 1 Dhjetori 2 KT S13=34 m², Dushet e klubit Partizani S14 = 130 m², Ndërtesa e bandës së ushtrisë S15=474 m², Truall i zënë me ndërtime të përhershme, rrugë kalimi, kabina elektrike S22=1576 m², Sip e përgjithshme 4813 m² i kompensohet pronarit Qamil Saliaga*

Për objektet: *palestra e basketbollit S1=1396 m², ndërtesa 1 kt me kollona me kapriata të zbuluara S3=40 m, dhoma e zhveshjes 1 kt me S4= 44m², Lavanteria S6=140 m², Godinë 1 kt mbrapa palestrës së mundësave S8=78 m², Klubi dhe palestra e mundësave S9=638 m², Një pjesë e lokalit të klubit Partizani S10=50 m², Magazina 1 kt e klubit Partizani S11=122m², Magazina 1 kt e klubit S12=91 m², Një pjesë e parkut të oficinës 1 Dhjetori 2 KT S13=34 m², Dushet e klubit Partizani S14 = 130 m², Ndërtesa e bandës së ushtrisë S15=474 m², I njihet e drejta e parablerjes.*

Prona kufizohet: Veri: me ballë 41.25 m me rrugë (ish rruga e kroit të Shëngjinit), Lindja me ballë 167 m me kaponet e klubit Sportiv Partizani (ish Sabrije Llagami), Jugu me ballë 76.25 m² me fushën e klubit sportiv Partizani (ish familja Begeja), Perëndimi me ballë 154 m me kaponet e parkut 21 dhjetori (ish Ismail Pëllumbi).

Familja Llagami

18. Në lidhje me subjektin e shpronësuar Sabrije Llagami, rezulton se me vendimin Nr. 667, datë 16.08.1996 të KKKP ish pronarëve, Rajoni 2 vendosi të njohë Sabrije Llagamin, ish pronare të pronës së saj, e përbërë nga një truall me sipërfaqe 9500 m².

Sipas përmbajtjes së vendimit, ky truall përbëhet nga: *Truall i zënë nga ndërtime të përhershme (pallate, rrugë, sheshe) ka sip 5900 m²; Truall i zënë nga Parku Automobilistik i Tregtisë me sip 360 m² nga cila objektet zënë 2540 m² kurse sheshe funksionale të tyre zënë 1060 m². Të kompensojë trashgimtarët ligjorë të ish pronares Sabrije Llagami për truallin e zënë me ndërtime të përhershme me sip. 9500 m² dhe t'ju njohë trashgimtarëve ligjorë të drejtën e parablerjes së Parkut Automobilistik të Tregtisë kur ato të privatizohen.*

18.1. Me vendimin Nr. 668, dt 16.08.1996 të KKKP ish pronarëve, Rajoni 2 vendosi të njohë Sabrije Llagamin ish pronare të pronës së saj e përbërë nga një truall me sipërfaqe 5650 m².

Trualli i lirë me sipërfaqe **1740 m²** t'i kthehet dhe për truallin e zënë me ndërtime të përhershme nga Klubi sportiv Partizani prej 3910 m² të kompensohet dhe i lind e drejta e parablerjes në rast privatizimi.

Në arsyetimin e këtij vendimi parashtrrohet se Sip e përgjithshme e truallit është 14 120 m²:

- **Trualli i zënë nga oborri i bandës me sip 360 m²**
- **Trualli i zënë nga objekte sportive dhe terrene sportive të Klubit Sportiv Partizani me sip 3550 m² i cili përbëhet:** Godina 2 kt në pjesën e palestrës me sip 140 m², Godina 4 kt e klubit Partizani me sip 200 m², Godinë 2 kt me sip 250 m², Trualli i zënë nga terrene sportive me sip 2960 m², Trualli i zënë nga terrene sportive me sip 2960 m², Trualli i zënë nga ndërtime pa leje të vërtetuara në bazë të shkresës së njësishme administrative nr. 7 datë 306 dt. 23.10.1995 me sip të përgjithshme 1740 m² e përbërë nga: Shtëpi 2 kt S1=25 m²; S2=110 m², S3= 70 m², S4 = 30 m², Rrugë e sheshe para shtëpive me sip 1505 m².

Një pjese trualli prej 8470 m² Komisioni i ka njohur të drejtën e pronësisë familjes Saliaga me vendimin nr. 310 datë 09.04.1995 dhe problemi i pronësisë do të zgjidhet në rrugë gjyqësore.

18.2. Me vendimin Nr. 97, datë 17.12.1999 KKKP ish pronarëve, vendosi t'i njohë Sabrije Llagamit, pronësinë mbi pronën, nga një copë toke me sipërfaqe 6354 m². Truall i lirë me sipërfaqe **5286 m²** i kthehet pronares Sabrije Llagami (trashëgimtarëve të saj) dhe trualli i zënë me sipërfaqe 1068 m² (pallati dhe rruga) kompensohet në një nga format që përcakton N 16 ligjit 7698, dt 15.04.1993.

Vendimi nr. 7 datë 15.04.1995 dhënë në emër të Qamil Saliagës (trashëgimtarëve të tij) anulohet duke u mbështetur në vendimet e gjykatës nr. 110016/484 dt. 12.06.1997 dhe akt marrëveshjes. Në këtë vendim parashtrrohet se, në bazë të marrëveshjes midis palëve trashëgimtare të Sabrije Llagamit dhe të Qamil Saliagës, të miratuar me vendimin gjyqësor me nr. 10016/484 Akti dhe 12.06.1997 në të cilën trashëgimtarëve të Qamil Saliaga të mbeten pronarë të sip së pronës së kthyer nga KKKP me vendimin nr. 7 datë 15.04.1995 në emër të ish pronares Sabrije Llagami dhe të pajtohet nga KKKP trashëgimtarëve të Sabrije Llagami parcela nr. 8 e hipotekuar me nr. 28/34 datë 21.01.1946 në emër të Qamil Saliaga (e cila është e patrajtuar nga KKK). **Prona figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 329 datë 03.12.1945.** Kjo vendndodhje e pronës është vendosur gabim, sepse kjo pronë i përket pronares Sabrije Llagami. Objekt i këtij komisioni është ndryshimi i planvendosjeve të pronave midis Qamil Saliaga dhe Sabrije Llagami.

Pra, siç mund të konstatohet për këtë familje përmenden të dhëna që datojnë në vitin 1945 në lidhje me pronat e tyre, ndryshe nga familja Begeja që humb gjurmët në vitin 1935.

Familja Vaqarri

19. Në lidhje me subjektin e shpronësuar Dylbere Vaqari, rezulton se me vendimin Nr. 681, datë 27.08.1996 të KKKP ish pronarëve, është vendosur njohja e shtetases Dylbere Vaqari si ish pronare e pronës me sipërfaqe **14,120 m²** nga të cilat **3050 m²** truall i pazënë (në të cilin përfshihen edhe ndërtimet pa leje) i kthehet dhe për sipërfaqen e zënë truall me sip **42.5 m²** nga ndërtesa 1 kt e Klubit Sportiv "Partizani" dhe terrene sportive prej **11,027.5 m²**, të kompensohet ndërkohë që për objektet i lind e drejta e parablerjes kur të privatizohen.

19.1. Në rradorët e pronësisë gjendet notë transkriptimi me të dhënat e pronësisë së Dylbere Vaqarrit (e bija e të ndjerit Ramzan Deliu), Zoje Alimehmeti (e bija e Ramzan Deliu), Sabrije Llagami (e bija e Ramazan Deliu) etj. ndryshe nga prona e pretenduar dhe më pas njohur familjarëve Begeja, që humbet gjurmët në vitin 1935.

Familja Alimehmeti

20. Në lidhje me subjektin e shpronësuar **Rexhep Alimehmeti**, rezulton se **me vendimin nr. 722 datë 10.10.1996 të KKKP ish pronarëve**, është vendosur të njohë Rexhep Alimehmetin (trashëgimtarët e tij) ish pronarë, të një parcele me sip **10680 m²**.

Në përfundim ka vendosur përveç njohjes edhe kthimin dhe kompensimin si vijon:

A. Trualli i zënë me ndërtime shtetërore (terrene të K.S. Partizani, Parku i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Stacioni i pompave, shtëpi të vjetra private) me sip **9780 m² kompensohet...**

B. ...kanë të drejtën e parablerjes të objekteve terrene sportive të K.S. Partizani me sip **7440 m²**, parkun e Ministrisë së Punëve të Brendshme me sip 1650 m², stacionin e pompave me sip 220 m² dhe shtëpitë e vjetra private me sip 470 m² kur ato të privatizohen...

C. ...personat fizikë e juridikë që kanë në pronësi ndërtesa...sip 900 m², detyrohen të paguajnë pronarit të truallit qera ose ta riblejnë truallin sipas kontratës së lidhur midis palëve. Mosmarrëveshjet zgjidhen me rrugë gjyqësore.

20.1. Me **vendimin nr. 48 datë 04.06.1997 të KKKP ish pronarëve** Alimehmeti, është vendosur të kompensohet Rexhep Alimehmeti... për truallin e zënë me ndërtime shtetërore me sipërfaqe 400 m², me dy sipërfaqe trualli prej 300 dhe 100 m² pronë shtetërore ngjitur dhe afër ish pronës së tij dhe mbas kompensimit, i mbeten për t'u kompensuar sip **9380 m²**.

Ushtrimi i aktivitetit në klubet sportive

21. Pavarësisht njohjes dhe kthimit të një pjese të pronës, familjeve si më sipër cituar, aktiviteti i klubeve sportive ka vijuar, përse kohë kanë mbetur të pacënuara objektet sportive.

22. Me VKM nr. 115 datë 16.02.1998 "Për ndryshimin e vartësisë së Klubit Sportiv Olimpik Partizani dhe të klubit të Futbollit Partizani" është vendosur që këto dy klube, të kalojnë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Mjetet kryesore dhe objektet e Klubit Olimpik Partizani, i kalojnë kalim kapitali pa pagesë Ministrisë së Mbrojtjes. Plani i shpenzimeve për vitin 1998 dhe numri i punonjësve të miratuar për Klubin Sportiv Olimpik Partizani dhe atë të futbollit Partizani, i pakësohen Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes.

Më dt 21.09.2022, është pyetur shtetasi **Fatmir Mediu**, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Mbrojtjes nga shtatori i vitit 2005 deri në mars 2008. Në deklarin e tij ai shpreh se nuk ka dijeni nese Klubi Shumësportesh dhe Klubi Sportiv janë e njëjta gje. Në fakt, kjo padijeni që shpreh, bie në kundërshtim me memon e dt 13.01.2006 përgatitur nga Këshilltari i Jashtëm Genci Çelo, ku ky i fundit i ka bërë një pasqyrim të të dhënave në lidhje me këto dy klube, pas një kërkesë të paraqitur më datë 09.01.2006 nga Bashkësia Kroj i Shëngjinit.

Më datë 21.09.2022 është pyetur shtetasi **Gazmend Oketa**, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Mbrojtjes që nga marsi i vitit 2008 deri në shtator 2009. Në deklarin e tij, ky shtetas pohon se, nuk është në dijeni nëse Klubi Sportiv Olimpik Partizani, Klubi Shumësportesh Partizani dhe Klubi Sportiv Partizani, janë objekte të ndryshme.

Klubi Shumësportesh Partizani, ka vijuar të ushtrojë normalisht aktivitetin e tij, siç edhe rezulton nga një urdhër me nr. 856 datë 17.11.1999 për dërgim jashtë shtetit të ekipit të volejbollit femra të Klubit Shumësportesh Partizani, urdhër ky i Ministrit të Mbrojtjes Luan Hajdaraga.

Gjithashtu, edhe **Klubi i Futbollit Partizani**, siç rezulton nga shkresa me nr 2351 prot datë 21.04.2000 e Drejtorisë së Plan Financës, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me të cilën i ka përcjellë një informacion Ministrit të Mbrojtjes, mbi kontrollin e ushtruar më datë 19.04.2000 në Klubin e Futbollit Partizani, konstatohet se ka vijuar aktivitetin e tij.

23. Më datë 21.12.2022, është pyetur shtetasi *Isa Tare*, i cili ka deklaruar se, *ka qenë drejtori i Klubit Shumësportesh Partizani nga viti 1995 – 2005, rreth muajve prill, maj dhe jep sqaimë në lidhje me aktivitetin e këtij klubi, varësinë e tij etj.*

24. Më datë **20.01.1996** është marrë vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë "*Sport Klub Partizani*" sh.p.k. me ortakë **Klubi i Futbollit Partizani**, përfaqësuar nga shtetasi **Bujar Labinoti** dhe shoqëria **Abaco** me administrator **Vincenzo Mignoli**. Sipas përshkrimit në këtë vendim, pasqyrohet se shoqëria **Abaco s.r.l.** me qendër në Terni, Itali, me vendim të asamblesë së ortakëve datë 04.01.1996 ka vendosur të shesë **kuotat e kapitalit që zotëron në shoqërinë Sport Klub Partizani sh.p.k.** të cilat janë **80 % e kapitalit themelues me vlerë 91 277 USD**. Në këto kushte, ortaku italian ia ka afruar së pari ortakut shqiptar, Klubit të Futbollit Partizani, me çmim 80 000 USD por ortaku shqiptar ka refuzuar të drejtën e parablerjes, duke i bërë këto kuota lirish të transferueshme. Prandaj u vendos të pranohet **transferimi i tyre në shoqërinë Abaco sh.p.k.** me qendër në Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 4791 datë 08.06.1994 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me administrator Antonio De Simone, me të njëjtat kushte që ju ofruan ortakut të shoqërisë, pra me çmimin 80 000 USD dhe pa ndryshuar vlerën nominale të tyre. Mbas transferimit të kuotave, ortaku i shoqërisë Sport Klub Partizani do të jetë shoqëria **Abaco sh.p.k.**, që do të ketë **80 % të kuotave të kapitalit**. Në pikën tjetër të rendit të ditës asambleja pranoi dorëheqjen e administratorit Vincenzo Mignoli dhe zgjodhi administratorin e ri Antonio De Simone. Me vendimin datë **07.03.1996** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur pranimi i kërkesës për depozitim të vendimit të asamblesë si më sipër cituar.

25. Me vendimin nr. 2204 dt **09.07.1999** akti të Gjykatës së Rrethit Tiranë (*paditës ka qenë shtetasi Neptun Bajko, përfaqësues i ortakut shtetëror të shoqatës së përbashkët "Sport Klub Partizani" sh.p.k. dhe e paditur shoqëria "Sport Klub Partizani" sh.p.k.*), është vendosur konstatimi i pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik të kontratës së themelimit të shoqërisë "*Sport Klub Partizani*" sh.p.k. që ishte krijuar me ortakët Ministria e Mbrojtjes dhe shoqëria italiane **Abaco s.r.l.**, duke u caktuar edhe likuidatori. Gjykata arsyeton se, kjo pavlefshmëri, është rrjedhojë ndër të tjera e faktit se, kontrata e themelimit të shoqërisë, nuk është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë, konform ligjit për shoqëritë tregtare dhe përfaqësuesi i palës shqiptare, përgjegjësi i klubit sportiv Partizani, nuk ka pasur prokurë apo autorizim të veçantë nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1018 dt 16.08.1999 dhe nga Gjykata e Lartë.

26. Me proces verbalin dt **20.09.2000** të Asamblesë së jashtëzakonshme, të Klubit të **Futbollit Partizani**, me kryetar Fatmir Lela, sekretar Ilir Lame, anëtar Saimir (*mblidhja e pallexueshëm*) pasqyrohet se komisionit i votimit të asamblesë së jashtëzakonshme të Klubit të Futbollit Partizani, i krijuar për procesin votues, **për shndërrimin e Klubit të Futbollit Partizani në**

shoqëri aksionare, pasi bëri numërimin e votave, deklaroi se votimi u krye në rregull. Në votim morën pjesë 68 votues. Rezultatet e votimit janë: *Për kthimin e klubit Partizani në shoqëri aksionere 62 vota ose 90 % dhe Për mbetjen e klubit Partizani si shoqatë 6 vota ose 10%*. Nisur dhe nga rezultati shpallet shndërrimi i Klubit Futbollit Partizani në shoqëri aksionare. Me vendimin e Mbledhjes së asamblesë së jashtëzakonshme të Klubit të Futbollit Partizani, është vendosur shndërrimi i klubit të futbollit Partizani, në shoqëri tregtare në formën e shoqërisë aksionere.

Në pikën 5 është përcaktuar: *Ruajtjen e emrit të Klubit dhe stemës së tij. Ato do të përfaqësohen në shoqërinë aksionere nga një përfaqësues, që do të caktohet nga Ministri i Mbrojtjes. Ky do të jetë aksioner i përhershëm i shoqërisë. Kontributi i tij përbëhet nga emri dhe stema e Klubit. Ky kontribut nuk mund të shitet, dhurohet apo të ndryshojë.*

Ky vendim është nënshkruar nga sekretari i klubit Neptun Bajko dhe presidenti i klubit Albert Xhani.

26.1. Me shkresën nr. extra/2310 prot dt **23.10.2000**, Klubi i Futbollit Partizani, përfaqësuar nga Presidenti i Klubit të Futbollit Partizani, i është adresuar Federatës Shqiptare të Futbollit me lëndë *"Mbi miratimin e statutit të shoqërisë aksionare "Partizani" sh.a.* Në këtë shkresë pasqyrohet se *Asambleja e jashtëzakonshme e Klubit të Futbollit Partizani, me vendimin e saj të dt 20.09.2000 ka vendosur shndërrimin e Klubit të Futbollit Partizani në shoqëri tregtare, në formën e një shoqërie aksionare. Duke iu përmbajtur kërkesave të ligjit nr. 8650 dt 28.07.2000 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8114 datë 28.03.1996 "Për sportin" si dhe udhëzimit nr. 9 dt 12.09.2000 të Ministrisë së Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, konform një procedure të rregullt ligjore e transparente, ia nënshtroi këtë proces transformimi një periudhe kohore prej 30 ditësh. Brenda kësaj periudhe kohore, në llogarinë e hapur për këtë qëllim, në emër të klubit të Futbollit Partizani, nuk tregoi interes asnjë person fizik apo juridik, që të ishte bashkëaksioner në këtë sipërmarrje tepër të rëndësishme, për një klub futbollit. Brenda afatit 30 ditor në këtë llogari u derdh vetëm shuma e kapitalit fillestar që nevojitet për krijimin e një shoqërie aksionere pa ofertë publike shuma prej 2 000 000 lekë nga ana e presidentit të klubit të futbollit Partizani, z. Albert Xhani. Nga ana e presidentit të klubit përveç këtij kontributi, është derdhur dhe një kontribut i konsiderueshëm në të holla e investime në pronën e Klubit të futbollit Partizani të cilat janë në vazhdim dhe që do të llogariten sipas rregullave të përcaktuara nga ligji për shoqëritë tregtare për këtë qëllim. Përsa më sipër kërkojnë që brenda një afati kohor të nevojshëm të shqyrtojnë dhe të japin mendim lidhur me dokumentacionin bashkalidhur.*

Me shkresën nr. 46 prot dt **02.11.2000 Federata Shqiptare e Futbollit**, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Sulejman Starova, i është adresuar Albert Xhanit, President i klubit të futbollit Partizani, duke u shprehur se, ka mendimin se, dokumentat në konceptin e funksionimit, përveçse si shoqëri me karakter ekonomik, janë plotësisht konform dhe me statutin e Federatës Shqiptare të Futbollit. **Federata jep pëlqimin për krijimin e kësaj shoqërie.**

26.1.1. Sipas statutit të shoqërisë anonime "Partizani" sh.a., nënshkruar nga noteri me nr. 7652 rep nr. 1908 kol datë 06.11.2000, neni 3, është përcaktuar se *shoqëria do të ruajë me fanatizëm emrin dhe stemën e Klubit të Futbollit Partizani dhe asnjëherë nuk do ta ndryshojë atë. Ky emër do të mbetet i tillë edhe në raste të transferimit të titullit të aksioneve të kësaj shoqërie në persona të tretë.*

Emri dhe stema e shoqërisë në asnjë rast nuk nxirren në likujdim, në rast të falimentimit apo të shpërbërjes së shoqërisë. Në një rast të tillë ato kthehen në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes e cila ka detyrimin të ruajë traditën e këtyre simboleve. Përfaqësimi i emrit dhe

stemës së Klubit të Futbollit Partizani (në shoqërinë aksionare) do të bëhet nëpërmjet një përfaqësuesi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përfaqësimi i Ministrisë së Mbrojtjes nën juridiksionin e të cilit ndodhej Klubi i Futbollit Partizani, do të bëhet në formën e zotërimit të një aksioni, i cili është kontribut i këtij institucioni dhe është i barazvlefshëm me emrin dhe stemën e Klubit. Ky kontribut nuk mund të shitet, dhurohet apo të ndryshojë pronësinë.

...Përfaqësimi që do të realizohet nga përfaqësuesi i Ministri i Mbrojtjes do të jetë një përfaqësim vetëm sipas përcaktimit të bërë më sipër dhe jo një përfaqësim që lind detyrime për aksionarin themelues të shoqërisë konform ligjit "Për shoqëritë tregtare". Ky është një kontribut që nuk merr pjesë në realizimin e aktivitetit ekonomik të shoqërisë dhe për më tepër në ndarjen e fitimeve.

Në n 5 është përcaktuar se *Ministria e Mbrojtjes do të përfaqësohet në këtë shoqëri si aksionare jo nëpërmjet kontributit në të holla, por nëpërmjet kontributit nga posedimi i emrit dhe stemës së Klubit të Futbollit.*

26.1.2. Sipas akt themelimit, nënshkruar para noterit, me nr. 7650 rep nr. 1907 kol datë 06.11.2000 është vendosur të themelohet shoqëria tregtare Partizani sh.a. në formën e një shoqërie anonime pa ofertë publike. Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është funksionimi i Klubit të Futbollit Partizani si shoqëri tregtare duke pasur si qëllim fitimin nëpërmjet realizimit të veprimtarisë ekonomike dhe kryesisht asaj me karakter sportiv...

Me vendimin nr. 24628 datë 07.11.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur të regjistrohet si person juridik privat shoqëria tregtare "Partizani" sh.a. me seli në qytetin e Tiranës, me adresë rruga "Frosina Plaku" nr. 40 me aksioner themelues z. Albert Xhani me 100% të aksioneve në kapitalin themeltar, me drejtor z. Albert Xhani, me anëtarë të Këshillit Mbikqyrës Robert Çeku, Artan Hajdari dhe Dashnor Frashëri dhe me kapital themeltar 2 000 000 (dy milionë) lekë, me kohëzgjatje dhe me afat kohor të pakufizuar dhe me objekt: *Veprimtari në fushën e zhvillimit të aktivitetit të futbollit në Klubin e Futbollit Partizani duke përfshirë këtu jo vetëm ekipin e parë por edhe ekipet e moshave të tjera...*

26.2. Ndërkohë, rezulton se me shkresën nr. 8859 regj datë 19.12.2000, Drejtoria Juridike pranë Ministrisë së Mbrojtjes, shkresë kjo e nënshkruar nga Ministri Ismail Lleshi, drejtuar shtetasit Albert Xhani, pasqyrohet se, *pasi janë njohur me praktikën e dërguar nga shtetasi Albert Xhani, mbi procesin e shndërrimit të Klubit të Futbollit Partizani në shoqëri aksionere, deklaroi se nuk e njohin procesin e shndërrimit të Klubit Sportiv Partizani në shoqëri aksionere i shndërruar si i tillë, vetëm duke pasur parasysh interesat private të këtij shtetasi. Është shmangur Ministria e Mbrojtjes si pronar i vetëm dhe i pakontestueshëm i Klubit të Futbollit Partizani. Shndërrimi në shoqëri aksionere, është bërë, pa qenë i regjistruar së pari Klubi i Futbollit Partizani si shoqatë sportive në gjykatë, ndërkohë që janë mbyllur mundësitë e pjesëmarrjes në shoqërinë aksionere dhe të aksionerëve të tjerë. Përsa më lart, nuk do të njohin këtë shoqëri aksionere, nuk do të japin pasurinë e patundshme as me qera, as me enfiteozë, as me koncension, do të kërkojnë në gjykatë pavlefshmërinë e veprimit juridik, të ndërpriten të gjitha investimet që vazhdojnë të bëhen nga ana e këtij shtetasi dhe godinat e detyruar si Ministri e Mbrojtjes për t'i larguar nga këto ambiente. Megjithatë ofron një zgjidhje tjetër, që është pranimi nga ana e shtetasit Albert Xhani i prishjes së shoqërisë Partizani sh.a. dhe fillimi i përpilimit të procedurave bashkarisht siç e ka ligji.*

Me shkresën nr. 9859 regj datë 19.12.2000, Ministri i Mbrojtjes Ismail Lleshi i drejtohet Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë duke kërkuar prishjen e regjistrimit të mësipërm.

Me shkresën nr. 8766/1 prot datë 21.12.2000 të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, ministri Mustafa Muçi, i kthen përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, duke pasqyruar se, në lidhje me tuajën me nr. 8743 prot datë 11.12.2000, shprehemi dakord me qëndrimin tuaj dhe do të sugjerohet kryerjen e veprimeve në gjykatë sa më shpejt.

Nuk gjenden gjurmë të çeljes së ndonjë procesi gjyqësor, përsa u përket pretendimeve të ngritura prej tyre, në lidhje me regjistrimin e shoqërisë Partizani sh.a.

27. Më dt 20.09.2022, është pyetur shtetasi **Albert Khani**, i cili ka deklaruar se: *Klubi Partizani, mesa i kujtohet, nga vitet 92 – 94, ka pasur një president italian dhe ka qenë sh.p.k.. Këtë sh.p.k. e hodhi në gjyq më vonë Ministria e Mbrojtjes dhe mesa di ai, gjyqitues ka dalë Ministria e Mbrojtjes. Klubi, i cili u ndodh në mes të rrugës për moszhvillimin e aktivitetit, po kërkonte donatorë dhe sponsorizues për zhvillimin e aktivitetit të klubit. Sipas ligjit të '93 – 94 shoqatës së klubit dhe vetë klubit, i lindte e drejta të transformohej, nga shoqatë në shoqëri aksionere. Për këtë u morën masa, erdhi një përfaqësues i Ministrisë, i duket se quhej Bashkim, mbulonte sportin dhe kulturën në Ministrinë e Mbrojtjes. Në këtë shoqatë, bënë pjesë veteranët e klubit Partizani dhe disa figura të ndritura të klubit Partizani. U bë dy herë mbledhja e asamblesë me votim të fshehtë për të marrë vendim për transformimin. Mbledhja u bë në godinën e ish Shqip-it, në prani të kamerave dhe mediave, në prani të përfaqësuesit të ministrisë së mbrojtjes, për transformimin nga shoqatë në shoqëri Aksionere. Kështu themeluan sh.a. Partizani, e cila i kishte të gjitha të drejtat si shoqëri aksionere. Por kjo shoqëri, nuk kishte asnjë lidhje me terrenet dhe klubin. U regjistruan në gjykatë. Kjo shoqëri pas themelimit të saj, nuk ka marrë asnjë lloj financimi nga asnjë institucion shtetëror, qoftë edhe një mijë lekë të vjetra. U vendos, siç është paraqitur në dokumentacion, që do të vijonin aktivitetin, në ambientet e klubit të futbollit të Partizanit, siç ka qenë.*

28. Më dt 22.09.2023, është pyetur shtetasi **Bujar Labinoti**, i cili ka deklaruar se *ka qenë drejtor i Klubit Partizani në tërësi, pasi është emëruar nga Ministria e Mbrojtjes në vitin 1992. Jep sqarime në lidhje me krijimin e klubit, varësinë nga Ministria e Mbrojtjes, objektet e të dy klubeve sportive.*

29. Më dt 21.09.2022, është pyetur shtetasi **Fatmir Mediu**, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Mbrojtjes që nga shtatori i vitit 2005 deri në mars 2008. Ky shtetas deklaroi se, *nuk ka dijeni se si ka qenë i organizuar Klubi Sportiv Partizani apo të ketë patur ndonjë diskutim për mënyrën e organizimit apo funksionimit të këtij klubi. Nuk ka qenë as në detyrat dhe as në interesin e tij si Ministër i Mbrojtjes, se çfarë bëhej me ekipin e futbollit Partizani.*

30. Më dt 21.09.2022 është pyetur shtetasi **Gazmend Oketa**, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Mbrojtjes që nga marsi i vitit 2008 deri në shtator 2009. Ky shtetas në deklarin e tij, pretendon se, *ka qenë në dijeni që terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani shfrytëzoheshin nga Klubi i Futbollit Partizani, por nuk e di se në çfarë mënyre ishte vendosur kjo marrëdhënie me terrenet dhe objektet që ishin në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes. Ai nuk di të thotë se çfarë marrëdhëniesh ka pasur Albert Khani me pronën në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.*

31. Më dt 27.09.2022, është pyetur shtetasi **Genc Ruli**, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës në vitin 2005. Ky shtetas ndër të tjera, ka deklaruar se,

në dijeninë e tij, Klubi i Futbollit Partizani, rreth viteve 1997 – 1998 është regjistruar si shoqëri e përbashkët e Ministrisë së Mbrojtjes me subjekt privat, me emrin Paro Laço. Në vijim është ndjekur një rrugë gjyqësore, ndoshta mbështetur në ndonjë ankesë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në vitin 1999 kjo shoqëri është prishur, pasi përfundoi procesi deri në Gjykatën e Lartë. Më pas ka qenë një gjendje edhe më konfuze për shkak se administrimin e kësaj prone e bën një shoqëri aksionere private e quajtur Futboll Klub Partizani sh.a. me drejtues shtetasin Albert Xhani. Edhe kjo shoqëri nuk ishte e regjistruar si shoqate sportive, por bënte administrim real të pronave të klubit dhe të aktivitetit. Duhet të ketë një korrespondencë të Ministrisë së Mbrojtjes, me Ministrinë e Ekonomisë së asaj kohe që sqaronin statusin e kësaj shoqërie, për shkak se kapitali ishte shtetëror ndërkohë që e administronin subjekt privat.

32. Shoqëria Partizani sh.a. ka vijuar aktivitetin e saj, në ambjentet e Klubit të Futbollit Partizani, për shumë vite, deri në privatizimin e objekteve mbi territore.

Referuar ligjit nr 8650 dt 28.07.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 8114 dt 28.03.1996 "Për sportin", n 19, parashikon se Klubi Sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqatë ose si shoqëri tregtare. Klubi Sportiv ndërtohet dhe funksionon si shoqëri tregtare në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare në RSH. Klubi Sportiv mund të transformohet nga shoqatë sportive në shoqëri tregtare vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të tij, në përputhje me aktet nënligjore të Ministrisë Përgjegjëse për Sporti. Vetëm klubet sportive që funksionojnë si shoqëri tregtare kanë të drejtë të kenë si qëllim fitimin në veprimtarinë e tyre sportive.

Mesa u konstatua më sipër, shoqëria Partizani sh.a. ka vijuar ushtrimin e aktivitetit, pas miratimit të marrë edhe nga Federata.

33. Megjithëse si më sipër u theksua, të dy territoret e klubeve sportive vijonin të ishin në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, nuk evidentohet të jetë lidhur ndonjë kontratë apo të jetë nxjerrë ndonjë akt që të legjitimonte ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë Partizani sh.a. në ambjentet e Klubit të Futbollit Partizani dhe Ministria e Mbrojtjes ka vijuar të mbetet aksionere e kësaj shoqërie, me një aksion.

Sipas pikës 4 të n 4, të ligjit nr 8743 dt 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" pronat e paluajtshme publike, tjetërsohen ose jepen në përdorim sipas mënyrave dhe kufijve të përcaktuar me ligje të veçanta. (Me shkresën nr. 13768/1 prot dt 15.07.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Publike, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, na bën me dije se nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e arshivuar pranë këtij institucioni, nuk rezulton të ketë të dhëna dhe informacion që prona me emërtimin "Terrenet sportive dhe objektet e klubit të Futbollit Partizani" Tiranë, të jetë dhënë në përdorim me kontratë qeraje, e për rrjedhojë nuk ka as të dhëna dhe informacion për investime, projekte zbatimi, leje ndërtimi apo pagesa qeraje të kryera nga shoqëria Partizani sh.a.)

Sipas nenit 12 të këtij ligji, Administrimi i pronës së paluajtshme siguron këto kushte:

a) ruajtjen dhe garantimin e interesit publik; b) ruajtjen e karakteristikave dhe të vlerave unike të pronës; c) ruajtjen dhe rritjen e vlerës ekonomike të pronës; ç) ruajtjen e treguesve ekologjikë të njësisë së pronës së paluajtshme, sipas parimit të dobishmërisë më të madhe publike.

Sipas n. 13, Këshilli i Ministrave, cakton organin shtetëror përgjegjës për administrimin e çdo njësie të pronës së paluajtshme, duke bërë shënimin përkatës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

Sipas n. 14, Këshilli i Ministrave, ngarkon me përgjegjësi për administrimin e çdo njësie të pronës së paluajtshme, atë organ shtetëror ose ent publik që ushtron shkallën më të lartë të kontrollit mbi pronën. Në qoftë se asnjë organ nuk plotëson kushtin e mësipërm, Këshilli i Ministrave ngarkon me administrimin e pronës atë organ shtetëror ose ent publik, fusha e veprimtarisë e të cilit është më afër me karakteristikat e pronës.

34. Gjithashtu, nuk konstatohet të jenë regjistruar si pasuri të shtetit territoret ku shtrihej aktiviteti i Klubeve Sportive dhe ku ndodheshin objektet sportive.

Sipas n. 6 të ligjit nr 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të gjitha pronat e paluajtshme të shtetit, **regjistrohen** në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme në përputhje me ligjin nr. 7843, dt 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme". Regjistrimi i pronave të paluajtshme bëhet përkatësisht:

a) nga Këshilli i Ministrave për pronat në varësi të pushtetit qendror, të cilat regjistrohen me pronar Republikën e Shqipërisë;

b) nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore për pronat e paluajtshme në pronësi të saj, të cilat regjistrohen me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore.

35. Pikërisht në këto vite, filluan të miratoheshin aktë ligjore dhe nënligjore, që rregullonin administrimin dhe regjistrimin e pronave të shtetit. Kështu me ligjin nr. 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" u synua rregullimi i procesit të transferimit të pronave të paluajtshme publike të shtetit dhe titujt e pronësisë së shtetit, mbi kapitalin e shoqërive tregtare dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore.

Sipas n 3, u transferohen njësitë të qeverisjes vendore, pronat që përdoren për realizimin e funksioneve dhe/ose shërbimeve për bashkësinë të njohura me ligj, të tilla si: ... d) Pronat që përdoren për kryerjen e veprimtarive social-kulturale e sportive. ...

Sipas n 4, Në ato raste kur pronat e transferuara njësitë të qeverisjes vendore janë në formën e aksioneve në një shoqëri tregtare dhe/ose ndërmarrje shtetërore, pushteti qendror mund të transferojë një pjesë ose të tërë titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin që ka në këto shoqëri.

35.1. Sipas VKM nr. 500 dt 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" u vendos krijimi i Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike (AITPP), e cila do të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit të Pushtetit Lokal, për kryerjen e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore dhe për hartimin e procedurave për transferimin e pronave, në njësitë e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij vendim. Sipas pikës 25 të kësaj VKM-je, derisa Këshilli i Ministrave të miratojë listën e pronave që do t'u transferohen njësitë të qeverisjes vendore dhe listat e pronave që i mbeten në pronësi pushtetit qendror, me përgjegjësit e caktuar administrativ, **institucionet e pushtetit qendror, të cilat kanë qenë deri në këto çaste, përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e pronës publike e ruajnë këtë përgjegjësi.**

Sipas pikës 26, Institucionet e pushtetit qendror janë përgjegjës për: - mbajtjen e listave të inventarizimit, me përgjegjësi të përcaktuar menaxhimi, derisa të bëhet verifikimi i pronësisë publike të këtyre pronave dhe regjistrimi i tyre; - azhurnimin e listave të inventarizimit pas regjistrimit, kur prona të reja jepen në përgjegjësi administrative ose disa prona të tjera hiqen.

35.2. Me urdhërin nr 391 dt 15.11.2001 të Ministrit të Mbrojtjes "Për krijimin e strukturës së përkohshme për inventarizimin dhe transferimin e pronave publike", në pikën 9 është parashikuar se derisa Këshilli i Ministrave të miratojë listën e pronave që do t'u transferohen njësisive të qeverisjes vendore dhe listat e pronave që i mbeten në pronësi MM, me përgjegjësitë e caktuara administrative, MM që ka qenë deri në këtë moment përgjegjës për mirëmbajtjen dhe riparimin e pronës publike, e ruan këtë përgjegjësi. Sipas pikës 14, pas regjistrimit në pronësi të ndërtesave administrative dhe të mjediseve përkatëse, komandat e reparteve dhe komandat e forcave janë të detyruara të vendosin çdo aset në librin e llogarive, sipas rregullave kontabël.

35.2.1. Me anë të udhëzimit nr 116 dt 21.03.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme dhe transferimin e pronave në FA" të Ministrit të Mbrojtjes, pika 12 parashikohet se, pas miratimit të listës së pronave të transferuara dhe regjistrimit të këtyre pronave në emër të çdo strukture ushtarake, këto të fundit janë të detyruara të vendosin çdo aset në librin e llogarisë dhe të reflektojnë çdo pronë si aset në bilancet e veta në përputhje sipas ligjit për kontabilitetin. Drejtoria e Planit financiar në MM do të udhëzojë për rregullimet kontabël për pronat që do të mbeten në pronësi të MM duke zbatuar për këtë qëllim kriteret dhe rregullsitë e VKM. ...Nëse mbajtës i mëparshëm i pronës është i ndryshëm nga pronari i ri, duhet që njëkohësisht të heq këtë aset nga librat e tij kontabël. Ky transferim kontabël i asetit, do të dokumentohet në aktin e veçantë të transferimit kontabël të nënshkruar nga të dyja palët...

Sipas pikës 13, me miratimin e pronave që do t'i mbeten në pronësi Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Ekonomisë dhe Privatizimit nëpërmjet zyrës së inventarizimit dhe transferimit të pronave në MM, mbi bazën e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore të KM, u dërgon strukturave ushtarake përgjegjësitë administrative që kanë vetë Ministria e Mbrojtjes ashtu dhe strukturat ushtarake, pronat që mbeten në pronësi të MM do të regjistrohen në emër të R.Sh. ...

Sipas Udhëzimit nr 2 dt 30.04.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralimit, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave publike, është parashikuar edhe inventarizimi në kategori të pronave të paluajtshme të shtetit për efekt të inventarizimit. Sipas pikës II, ndarja në kategori të pronave të paluajtshme të shtetit për efekt inventarizimi në gjermën A parashikon se **inventarizohen si prona të veçanta**: a. Parqet, lulishtet, sheshet publike në qytete dhe të tjera qendra të banuara, troje të veçanta, ndërtesat së bashku me oborret (sheshe funksionale) që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për ...sportet, ...për institucionet qendrore dhe vendore...

Sipas gjermës B, inventarizohen si **klasa të veçanta**, duke përfshirë të renditur dhe komponentët përbërës: b. Zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, rendit dhe të sigurisë publike...

Konstatohet se, me shkresën nr. 5774 dt 02.06.2003 "Dërgohen formularët standart të inventarizimit të pronave të paluajtshme të Forcave të Armatosura", Ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko, i ka përcjellë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit Pronave të Paluajtshme, formularët standart të inventarizimit të Pronave të Paluajtshme të FA-së dhe listën e pronave të inventarizuara sipas Njësisive të Pushtetit Vendor. Në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore, për inventarizimin e pronave si **klasa të veçanta**, bashkalidhur kësaj shkrese, rezulton në listë:

Shumësportesh "Partizani", me funksion "Veprimtari sportive", me ent përgjegjësi administrative Klubi Shumësportesh Partizani dhe gjithashtu edhe si ent përdorues, ka një të dhënë në rubrikën e shënimeve të veçanta "proces kalimi kapital MKRS-së". Në inventar janë përcaktuar 22 objekte, përfshirë këtu edhe një truall prej 8920 m² të zënë forcërisht. Kurse Klubi i Futbollit Partizani është pasqyruar si vijon: Klubi i Futbollit Partizani – Rruga "Frosina Plaku", me objekt veprimtari sportive, me ent përgjegjës MM; Klubi Shumësportesh Partizani, Tiranë, dhe ent përdorues Klubi Shumësportesh Partizani Tiranë me 9 objekte përfshirë edhe terrenin sportiv dhe truallin, të gjitha me shënimin "i zënë".

Me urdhërin nr 282 dt 17.06.2003 "Për krijimin e grupit të punës për përcaktimin e listës së pronave të paluajtshme që do të mbeten në përgjegjësi administrimi të FA" të Ministrit të Mbrojtjes, është urdhëruar që për shqyrtimin dhe vlerësimin e listës së pronave të paluajtshme të inventarizuara, krijohet grupi i punës, i cili mbështetur në Objektivat dhe strategjinë e FA, në Planin e Përhapjes së Forcave, 20 ditë nga dalja e daljes së këtij urdhëri, përcakton listën e pronave të paluajtshme që do të mbeten nën përgjegjësinë administrative të FA-së.

Bashkalidhur këtij urdhëri, evidentohet Lista me prona në përdorim dhe që propozohen të mbeten në administrim të Njësisë dhe reparteve të vartësisë. Me nr rendor 68 konstatohet se sipas të dhënave të dërguara nga Sektori i Administrimit dhe Privatizimit të pronës, është renditur Klubi i Futbollit Partizani, rruga Frosina Plaku me sip 28 000 m².

Me një listë të veçantë, nga Ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko, është miratuar lista e pronave të paluajtshme të inventarizuara të cilat nuk do të mbeten nën përgjegjësinë administrative të FA-së. Konkretisht janë evidentuar prona në proces të propozuara për privatizim, të cilat propozohen për transferim Pushtetit Vendor. Në këtë listë, në faqen 151 evidentohet se Komanda e Doktrinës dhe stërvitjes ka dërguar propozimet me shkresat nr 1491 dt 02.07.2003, nr 1656 dt 15.07.2003, nr 2035/1 dt 22.09.2003, nr 2218/1 dt 09.10.2003, ku evidentohet me nr 553, Klubi Shumësportesh Partizani, ndodhur në rrugën Frosina Plaku Tiranë me sip 27 200 m², me shënim "Kalim kapitali Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës me VKM nr 312 dt 15.05.2003" dhe shënimin për t'i kaluar në administrim Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Tiranë.

Me nr 554 evidentohet Pishina e notit Klubit shumësportesh Partizani, Laprakë, Tiranë, me sip 1 200 m², me shënimin që t'i kalojë në administrim Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës. Në fund gjenden e emrat e grupit të punës e konkretisht Luan Hoxha, Arben Dervishi, Kostaq Karoli, Perlat Sula, Astrit Jaupi, Kudret Çela, Kudusi Lame, Viktor Berdaj, Kadri Sula.

36. Megjithëse nuk gjenden gjurmë të regjistrimit në ZVRPP të dy klubeve të mësipërme, konstatohet se në lidhje me to, merren vendime nga Këshilli i Ministrave. Kështu Klubi Shumësportesh Partizani, konstatohet se vijon të ndryshojë varësinë ndër vite. Me VKM nr. 312 datë 15.05.2003 "Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportesh "Partizani" nga Ministria e Mbrojtjes tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" është vendosur:

1. Ndryshimin e varësisë së klubit sportiv shumësportësh "Partizani" nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
2. Objektet e këtij klubi, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, së bashku me mjetet përkatëse, i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t'i shtohet fondi prej 21 500 000 (njëzet e një milionë e pesëqind mijë) lekësh për përballimin e shpenzimeve të klubit sportiv shumësportësh "Partizani" fond, i cili t'i pakësohet buxhetit të

vitet 2003, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

4. Numrit të punonjësve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve t'i shtohen edhe 50 (pesëdhjetë) punonjës të klubit sportiv shumësportësh "Partizani".

5. Vendimi nr.115, datë 16.2.1998 i Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e varësisë së klubit sportiv olimpiq "Partizani", shfuqizohet.

6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Lista e kompleksit të objekteve të Klubit Sportiv Shumësportësh Partizani, 19 të tilla.

36.1. Me VKM nr. 515 dt 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes" është vendosur që të miratohet lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të pronave me numër rendor 9 dhe 10 (Klubi shumësportësh "Partizani"), 549 (Shtëpia e Ushtarakëve, Korçë) dhe 653 (Shtëpia e Ushtarakëve, Përmet), që me vendim të Këshillit të Ministrave, u kanë kaluar në administrim institucioneve të tjera. Lista përfshin 1117 (një mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) prona dhe përbëhet nga 765 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

Bashkalidhur është lista përmbledhëse ku pasqyrohet me:

- Nr. 7 Orkestra frymore rruga "Frosina Plaku", Tiranë me sip 1230 m²;
- nr. 9 Klubi Shumësportësh Partizani i ndodhur në rrugën Frosina Plaku, Tiranë, me sip 27 200 m²
- nr. 10 Pishina e notit Klubit shumësportësh Partizani, ndodhur në Laprakë, Tiranë, me sip 1200 m²;
- nr 11 Klubi i Futbollit Partizani, ndodhur në Rruga Frosina Plaku, Tiranë, me sip 28 000 m².

Bashkalidhur VKM nr. 515 datë 18.07.2003 është formulari nr. 3 për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore (për inventarizimin e pronave si **klasa të veçanta**) ku pasqyrohet se me nr rendor 7 është Orkestra frymore e Ushtrisë me sip 1230 m², e ndodhur në rruga Frosina Plaku me 9 objekte ku përfshihet edhe trualli me sip 766 m².

36.1.1. Me urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes Pandeli Majko, nr. 483 datë 13.10.2003 "Për ngritjen e grupit të punës për realizimin e dorëzimit të objekteve të klubit sportiv shumësportësh Partizani" është ngritur grupi i punës për realizimin e dorëzimit të objekteve të klubit Sportiv Partizani, në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

Sipas shkresës nr. 7198 prot dt 30.10.2003 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Sportit, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Sportit etj dhe për dijeni zëvendës ministrit, është pasqyruar se më dt 29.10.2003 grupi i punës, në mungesë të sekretarit të Klubit Shumësportësh Isa Tare, bëri takim me shefen e financës e cila duke iu referuar listës së objekteve të këtij klubi, informoi se, nga shoqëria Partizani sh.a. janë zënë godina dy katëshe e atletikës, garazhi, palestra e atletikës (hangari), fusha e tenisit dhe volejbollit në hyrje të klubit djathtas, dy fusha volejbollit të reja pranë godinës dy katëshe të lojërave. Gjithashtu kanë përshkruar edhe godina të zëna nga familjarë. Në këtë mënyrë parashtrajnë se nuk po bëhet i mundur zbatimi i urdhërit të ministrit nr. 398 dt 16.09.2003 për inventarizimin e ambjenteve dhe është vlerësuar se kërkohet ndërhyrja e instancave më të larta pranë Ministrisë së Mbrojtjes

për të bërë të mundur dorëzimin e objekteve. Të lira shfaqen Palestra e madhe (basketboll, volejball), palestra e gjimnastikës, godinë dy katëshe e sporteve të rënda dhe zyrat (salla e mundjes, ngritjes së peshave, menca), magazina e materialeve sportive, depo e qymyrit, fisha e basketbollit dhe hendbollit (5 të tilla në hyrje të klubit majtas), kabina elektrike, sheshi para godinës dykatëshe (përdoret për parkim makinash).

Me urdhërin nr. 520 dt 03.11.2003 "Për heqjen e shërbimit të ruajtjes me polici ushtarake në objektet e klubit shumësportesh Partizani..." nga Ministri i Mbrojtjes Pandeli Majko, është urdhëruar Batalioni i Policisë Ushtarake të heqë shërbimin e ruajtjes me polici ushtarake në objektet e Klubit Shumësportesh Partizani dhe Qendrën e Rekrutim Mobilizimit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga dalja e këtij urdhëri.

Në një listë përmbledhëse rezultojnë lista e pronave të paluajtshme të inventarizuara nga FA e rezultojnë: Klubi Shumësportesh Partizani me sipërfaqe 27 200 m²; Pishina e notit, Klubi Shumësportesh Partizani – Laprakë me sipërfaqe 1200 m² dhe Klubi i Futbollit Partizani me sipërfaqe 28 000 m². Përcaktohet se grupi do të bëjë dorëzimin e objekteve të këtij klubi sipas listës bashkëngjitur VKM nr. 312 datë 15.05.2003 së bashku me mjetet përkatëse.

37. Pra nga sa më sipër cituar, pavarësisht pretendimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, rezultojnë provuar se shoqëria Partizani sh.a. ka vijuar të jetë e regjistruar dhe të ushtronte aktivitetin pikërisht në ambjentet e Klubit të Futbollit Partizani, ndërkohë që ky objekt ka qenë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe kjo shoqëri madje ka marrë edhe miratimin e Federatës.

Sipas raportit për vlerësimin e kapitalit të Klubit të Futbollit Partizani, dt 27.03.2012, ekspertet e caktuara në atë kohë nga Ministria e Mbrojtjes, konkretisht shtetaset Encida Rahmani dhe Margarita Kalemasi, sipas urdhërit nr 408 datë 13.03.2012, kanë pasqyruar ndër të tjera se: "...Klubi i Futbollit "Partizani" është krijuar në vitin 1947 dhe rezultojnë pjesmarrës pa ndërprerje në veprimtaritë kombëtare të futbollit, kjo e vërtetuar sipas shkresës nr prot 322 datë 02.03.2012 të Federatës Shqiptare të Futbollit. Me VKM nr 115 datë 16.02.1998 "Për ndryshimin e varësisë së Klubit Sportiv Olimpik Partizani dhe të Klubit të Futbollit Partizani, ky i fundit (pra Klubi i Futbollit Partizani) kalon në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në shkresën nr 7696 prot datë 08.08.2011 të Ministrisë së Mbrojtjes, me lëndë "Për regjistrimin e KF Partizani" në veprimtaritë kombëtare të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) theksohet se: "Ministria e Mbrojtjes është personi juridik që ka zotëruar dhe zotëron të gjitha të drejtat mbi këtë emër". Me shkresën nr prot 1514 datë 05.09.2011 të FSHF-së drejtuar z. Arben Imami, në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 7696 prot datë 08.08.2011 "Për regjistrimin e KF Partizani" në veprimtaritë kombëtare të FSHF theksohet se: "Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit me vendimin e tij nr 48 datë 04.09.2011 pranon kërkesën tuaj për njohjen e Ministrisë së Mbrojtjes si subjekti i vetëm që zotëron të drejtën e përdorimit të emrit të Klubit të Futbollit Partizani".

Ndërkohë, Klubi Shumësportesh Partizani, ka vijuar të qëndrojë në varësinë e Ministrisë së Kulturës.

Shoqëria Kontakt sh.p.k.

38. Shtetasi Fatmir Bektashi, i cili mbart një rol të posaçëm përgjatë fakteve të ndodhura gjatë këtij hetimi, rezultojnë të evidentohet në vitin 2000 si personi që ble kuotat e kapitalit themelues të shoqërisë Kontakt sh.p.k., me NIPT J92108006V. Kjo shoqëri fillimisht është themeluar në

bazë të vendimit nr 2.1456 dt 07.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në bazë të një kontrate shitje kuotash nr 6518 rep nr 452 kol dt 16.10.2000, ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, i ka shitur shtetasit Fatmir Bektashi, të gjitha kuotat duke u bërë ky i fundit ortaku dhe administratori i vetëm i kësaj shoqërie. Sipas aktit të themelimit, dt **21.10.2000**, objekt i veprimtarisë së shoqërisë është *projektim, ndërtim, supervizion të objekteve publike etj.* Qendra dhe selia e shoqërisë është në rruga "*Muhamet Gjollështa*" pall. 69 shkalla 1, ap. 4 me kapital themeltar 100 000 lekë. Sipas statutit të kësaj shoqërie të datës 21.12.2000, administrator i saj do të jetë ortaku i vetëm shtetasi Fatmir Bektashi.

39. Kjo shoqëri, ka përqëndruar aktivitetin e vet në fushën e ndërtimit. Konkretisht, rezulton se Familja Vaqarri, që në vitin **2002**, angazhohet me qëllim zhvillimin e pronës, angazhim ky i synuar me shoqërinë **Kontakt sh.p.k.** Kështu, rezulton se me prokurën e posaçme nr. 524 rep nr. 102 kol datë **25.04.2002**, para noteres Gentiana Shkodra, shtetasit *Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari (përfaqësuar nga Petrit Bektashi), Milva Arapi, Liliana Arapi, Luan Arapi (përfaqësuar nga Bardhyl Qatipi), Arben Arapi (përfaqësuar nga Liljana Arapi), Fiqirete Vaqari, Eva Vaqari (përfaqësuar nga Fiqirete Vaqari)*, parashatrojnë se, duke qenë bashkëpronarë sipas vërtetimit të pronësisë nr. 6294 datë 05.09.1996 të një trualli të lirë prej **3050 m2 të ndodhur në Tiranë**, emërojnë si përfaqësues të tyre të posaçëm shtetasin **Igli Vaqari**, i cili ka të drejtë që, në emër dhe për llogarinë e tyre t'i përfaqësojë në bisedimet me shoqërinë e ndërtimit "**Kontakt**" dhe të verë në dispozicion të shoqërisë dokumentacionin përkatës tekniko – juridik, me qëllim që shoqëria të kryejë studimin urbanistik mbi truallin e lartpërmendur. Kjo prokurë është e vlefshme, vetëm për fazën studimore.

39.1. Gjithashtu konstatohet se shoqëria Kontakt zhvillon ndërtime edhe në territorin e familjes Agushi. Me kontratën e sipërmarrjes nr 2289 rep nr 154 kol dt **18.07.2003**, rezulton të jetë lidhur një kontratë ndërmjet palës Pronare familja Agushi dhe palëve investitore shoq Kontakt sh.p.k. dhe Aleksandër Josifi për ndërtimin e një godine me lartësi të thyer, deri në 13 kate mbi truallin me sip 1 100 m2. **Prona ndodhet tek rruga Dëshmorët e 4 shkurtit.**

Nga aktet rezulton se, me vendimin e KRRT Bashkia Tiranë nr 32 dt 11.02.2005 (nr 2026 prot dt 11.03.2005), është miratuar sheshi i ndërtimit prej 1 100 m2 ndodhur në rrugën **Dëshmorët e 4 shkurtit** Tiranë, ZK 8270, për shoqërinë Kontakt sh.p.k. dhe shtetasin Aleksandër Josifi. Leja e ndërtimit, është miratuar me vendimin nr 73 dt 18.03.2005, të KRRT Bashkia Tiranë, protokolluar me shkresën nr 2677 prot datë 06.04.2005, subjektit ndërtues Kontakt.

Akti i piketimit është nënshkruar nga drejtoresha e urbanistikës ligjore **Kozeta Gëdeshi**. Kjo shtetase ka nënshkruar edhe aktet e kontrollit të mbajtura gjatë fazave të ndërtimit, ku nuk janë gjetur shkelje. Konstatohet që në dokumentat e kqyrura pranë ASHK-së në lidhje me ndërtimin e mësipërm gjendet edhe licencë me nr Z 4272 datë regi 05.04.2005 e ing të ndërtimit **Ruben Alite**. Akti i kolaudimit është bërë në vitin 2007.

39.1.1. Shtetësja **Kozeta Gëdeshi**, rezulton të jetë një person që shfaqet si punonjëse e Bashkisë Tiranë, drejtoreshë e Urbanistikës Ligjore, pjesmarrëse në ndryshimin e destinacionit të ndodhur në vitin 2006, në territorin e Klubit të Futbollit Partizani, ku fillon të zhvillohet ndërtimi nga shoqëritë Kontakt sh.p.k. Gjithashtu, kjo shtetase, ka qenë pjesë e KRRT-së në vitin 2008, kur është miratuar leja e ndërtimit me faza, nga ku kanë marrë jetë në vijim edhe zhvillimi i pronës së kthyer familjeve të sipërcituara, në territoret e Klubeve Sportive Partizani.

39.1.2. Gjithashtu, shtetasi **Ruben Alite**, është bashkëshorti i shtetases Anila Alite. Shtetasi Ruben Alite evidentohet se, ka vazhdimisht bashkëpunim me shoqëritë Kontakt sh.p.k. dhe

Homeplan sh.p.k. Ai është bashkëortak në subjektin LEAL – CSE sh.p.k me NIPT K31529014H, me shtetasin Frederik Lena. Kjo shoqëri në periudhën 2012 – 2016, ka aktivitet tregtar në një masë shitjesh prej 40 629 055 lekë ndaj shoqërisë Homeplan sh.p.k. ndërkohë që rezulton se shitjet në të njëjtën periudhë në drejtim të subjekteve të tjera janë shumë herë më të vogla, psh në një rënie drastike me subjektin në vijim, prej 14 445 936 lekë.

39.1.2.1. Shtetësja **Anila Alite**, e pyetur më datë 15.01.2024, ka deklaruar se, *ka qenë e zgjedhur si anëtare e KRRT-së, së bashku dhe me disa anëtare të tjerë, nga të cilët kujton Arben Biçokun, Artan Shkrelin, Adrian Myderizi, Marin Biçoku etj. Mesa kujton, në atë kohë bëhej një zgjedhje e anëtarëve e KRRT-së, të cilët propozoheshin nga institucione të ndryshme si Bashkia Tiranë, Presidenca, Ministria dhe forcat politike. Shtetësja Anila, mund të jetë propozuar nga LSI-ja, nuk e kujton me siguri. Të gjithë anëtarët e KRRT-së, ishin me profesion arkitekt ose inxhinier dhe njiheshin me njëri tjetrin psh. Marin Bicokun e ka patur student, Artan Shkrelin e ka patur student, ndërsa Arben Biçokun e ka patur shok klase. Mesa mban mend, mbledhja e KRRT-së, në këtë formë, pra me anëtarë të zgjedhur, mund të ketë zgjatur 2 vite. Pra nuk punonin në Bashkinë Tiranë, por mbledheshin sa herë që KRRT-ja duhet të merrte ndonjë vendim. Kryetari i KRRT-së ishte kryetari i Bashkisë, në atë kohë ka qenë Edi Rama. Kjo shtetase deklaroi se shtetasin Fatmir Bektashi e njeh në rrethana personale, por jo në raporte pune. Ajo, nuk ka punuar në kompaninë e Fatmirit asnjëherë. Në pallatin ku jeton, mban mend që Fatmiri ka bërë konstruksionin e pallatit.*

Shtetasi **Ruben Alite**, i pyetur më dt 15.01.2024, ka deklaruar se, *në kompleksin e realizuar nga Fatmir Bektashi tek ish Klubi Partizani kanë filluar me objektin Eagle in Flight. Si shoqëri kanë bërë projektet e zbatimit për ndërtimin e objekteve të kompleksit të Fatmir Bektashit tek ish Klubi Partizani, nuk është në dijeni se në emër të kujt janë lëshuar faturat, e njohin për Kontakt, më saktë ka pasur marrëdhënie vetëm me Fatmirin. Nuk arrin të ndajë dot subjektet Homeplan apo Kontakt.*

Nisja e procesit të privatizimit

40. Ligji nr. 9376 datë 21.04.2005 “Për sportin” në nenin 31, parashikonte: **1. Ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qëndror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”.**

2. Objektet sportive jepen me koncesion apo privatizohen, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.

Në n 20 të këtij ligji, parashikohej: *Në shoqëritë tregtare, me objekt ushtrimin e veprimtarisë sportive në një sport të caktuar, pjesa e kapitalit shtetëror ose paketa e aksioneve të zotëruara nga shteti mund të privatizohen nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar.*

41. Me kërkesën nr. 4533 prot dt **18.07.2005** (hyrje në Ministrinë e Ekonomisë), shtetasi Albert Xhani si president i shoqërisë Partizani sh.a. i është drejtuar Ministrit të Ekonomisë, Anastas Angjeli, duke kërkuar privatizimin e terreneve sportive pranë KF Partizani dhe objektit të ngritur në të.

41.1. Me shkresën nr. 4533/1 prot dt **18.07.2005** Ministri i Ekonomisë, Anastas Angjeli, i është drejtuar Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duke i parashtruar se, në bazë e zbatim të ligjit nr. 9376 dt 21.04.2005 "*Për sportin*" si dhe kërkesave të vazhdueshme nga stafi i shoqërisë "*Partizani*" sh.a., për privatizimin e pasurive të paluajtshme dhe të inventarit ekonomik të Klubit të Futbollit Partizani, *lutemi qëndrimin tuaj për fillimin e procedurave të privatizimit sa më sipër.* Me shkresën nr. 2732/1 prot dt **22.07.2005** Ministri i Kulturës Blendi Klosi, i ka kthyer përgjigje se, në kuptim të n 20 të ligjit nr. 9376 dt 21.04.2005, e gjen të bazuar këtë kërkesë dhe në mbështetje të politikave të shprehura deri më tani, për shumë hapësira në sport. Përsa i përket **kapitaleve të këtij klubi, me statusin e një shoqërie tregtare, duhet të shprehet Ministria e Mbrojtjes si organ i varësisë administrative nga e cila varet kjo shoqëri.**

Gjithashtu, me shkresën nr. 4533/2 prot dt **21.07.2005** ministri i Ekonomisë Anastas Angjeli, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes Pandeli Majko, duke i parashtruar se në bazë e zbatim të ligjit nr. 9376 dt 21.04.2005 "*Për sportin*", n 31/2 si dhe kërkesave të vazhdueshme të shoqërisë aksionere Partizani sh.a. për privatizimin e pasurive të paluajtshme dhe asetëve të Klubit të Futbollit Partizani, sa më sipër, *lutemi prononcimin tuaj për fillimin e procedurave të privatizimit të pasurive të paluajtshme dhe asetëve të Klubit të Futbollit Partizani.*

42. Pas ardhjes në pushtet të shtetasit Sali Berisha dhe emërimit si Ministër Mbrojtje më datë 07.09.2005 të shtetasit Fatmir Mediu, shoqëria Partizani, ka përsëritur kërkesën e saj për privatizim. Konkretisht me shkresën nr. 478/05 prot dt **26.09.2005**, shoqëria Partizani sh.a. i ka paraqitur Ministrisë së Mbrojtjes, kërkesë për privatizimin e klubit të futbollit Partizani, duke parashtruar se, *privatizimi i ambjentëve të Klubit të Futbollit Partizani, ka qenë objekt i kërkesave të vazhdueshme, të bëra që nga krijimi i shoqërisë aksionere Partizani e në vazhdim. Nga struktura e Ministrisë së Mbrojtjes, ky klub është hequr që nga viti 2000 dhe objektet dhe terrenet e tij, janë në përdorim të shoqërisë aksionere Partizani, e cila nuk ka marrë asnjë fond apo subvencion nga dikasteri përkatës për këtë qëllim, ashtu si ka ndodhur me klubet e tjera, përkundrazi, nga ana e shoqërisë, janë bërë investime të cilat i kanë ndryshuar pamjen klubit duke e transformuar atë në një klub bashkëkohor. Ministria e Mbrojtjes i ka dhënë konfirmimin e saj, për privatizimin e objekteve të terreneve sportive, Ministrisë së Ekonomisë, por procedurat kanë mbetur pezull, duke penguar dhe dëmtuar aktivitetin e lirë privat dhe për rrjedhojë edhe zhvillimin e këtij sporti në vendin tonë. Në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005, është përcaktuar "*e drejta e shoqërive me status sportiv për privatizimin e terreneve sportive*". Nisur nga sa më sipër, kërkojnë rifillimin e procedurave ligjore për privatizimin e objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit Partizani, bazuar në aktet ligjore që rregullojnë këtë proces.*

43. Me shkresën nr. 9549/1 prot dt **12.10.2005**, Ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu i është drejtuar METE-s, ministrit Genc Rulit, duke i bërë me dije se, *Ministria e Mbrojtjes krahas pronësive të tjera të përcaktuara në VKM nr. 515 datë 18.07.2003 ka në administrim edhe terrenet sportive ku është vendosur Klubi i Futbollit Partizani. Nga studimi i bërë në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në strategjinë e zhvillimit të FA dhe në kuadër të ristrukturimit të tyre, është konkluduar se këto terrene të mos përfshihen në planet e përhapjes së FA-ve. Në këto kushte gjykojnë të nevojshme që të merren hapa të mëtejshme, përsa i përket mënyrës dhe përgjegjësisë së administrimit të kësaj pronësie. Përsa më sipër, kërkojnë mendimin e METE për veprime të mëtejshme në lidhje me administrimin e kësaj prone.*

I pyetur më datë 21.09.2002 shtetasi Fatmir Mediu, i cili ka ushtruar funksionin e Ministrit të Mbrojtjes, nga shtatori 2005 deri në mars 2008, deklaroi se: "... ..Ne njohjen e tij, pronarë të pronave që administroheshin nga institucione të ndryshme, ka qenë Ministria e Ekonomisë,

ky ka qenë pronari shtet. Si Ministri Mbrojtje administronin pronat e Ministrisë së Mbrojtjes..... Në përgjigje të kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë, dhe bazuar në kërkesën që ka ligji nr. 195 datë 30.03.1998 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen", ky ligj flet për privatizimin, si Ministri e Mbrojtjes kanë thënë që mund të privatizohet ose janë të hapur për çdo propozim përse i përket... .., këto akte, janë një proces vazhdues i lidhur me VKM nr. 515 datë 18.07.2003 apo duke vlerësuar shkresat me z. Ruli, të një korrespondence të qeverisë paraardhëse, përpara se ai vetë të emërohej ministër, korrespondencë kjo ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrive të tjera.

43.1. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Drejtorja e Privatizimit, Genc Ruli i parashtron Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr 280/1 prot dt **31.10.2005** sa vijon: "Në përgjigje të shkresës suaj me nr 9549/1 dt 12.10.2005 në lidhje me terrenet sportive të Klubit të Futbollit Partizani, shprehemi: Përse trajtoni në shkresë nga ana juaj, **nuk është ushtruar kompetenca me cilësinë e organit të vartësisë administrative si ministri e linjës, ku sipas VKM nr 195 datë 20.03.1998 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen" pika 2, dërgon propozimet përkatëse për privatizim në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Sa më sipër, në vijim të shkresës sonë me nr 4533/2 dt 21.07.2005 ripërsërisim kërkesën tonë duke kërkuar të saktësoni qëndroni tuaj në lidhje me terrenet sporte të Klubit të Futbollit Partizani".**

Sipas deklaramit të shtetasit *Fatmir Mediu*, kjo kërkesë e *METE* vjen në mbështetje dhe ripërsëritje të kërkesës së bërë nga kjo ministri në korrik të vitit 2005, nga qeveria e mëparshme. *Duket që ka pasur një korrespondencë të qeverisë së mëparshme...*

I pyetur më datë 27.09.2022 shtetasi *Genc Ruli*, i emëruar si ministër i Ekonomisë në vitin 2005, ka deklaruar: "...Në vitin 2005, në përputhje me atë që ishte **programi i qeverisë, përshpejtimi i procesit të privatizimit të pronave shtetërore dhe përshpejtimi i procesit të kthimit të pronave ish pronarëve, ministria jonë i është drejtuar gjithë ministrive të linjave që të dorëzonin pranë nesh inventarët e pronave shtetërore ende të paprivatizuara. Këtu fillon një shkëmbim korrepondencë me Ministrinë e Mbrojtjes, e cila na pyet se çfarë të bëjë me Klubin e Futbollit Partizani. Janë dy procese privatizimi që është klubi i Futbollit Partizani dhe klubi shumësportesh Partizani. Në të parin autoriteti administrues ishte Ministria e Mbrojtjes dhe të dytin e kishte Ministria e Kulturës. Ndofta nga korriku i vitit 2005 pasi kishin mbaruar edhe zgjedhjet, ka një shkëmbim midis Ministrisë së Ekonomisë Anastas Angjeli dhe Ministrisë së Mbrojtjes Pandeli Majko dhe Ministrisë së Turizmit dhe Sporteve Blendi Klosi, ku ministri Angjeli i kërkon të prononcohen se çfarë do bëhet me klubin Partizani, nëse do e miratojnë privatizimin, pasi ka interesim nga shoqëria anonime që operonte ndërkohë në ato ambiente. Nga ana ime, ne nentor te vitit 2005, iu drejtova gjithë ministrive me letër dhe z. Mediu më drejton një letër në lidhje konkretisht me këtë klub meqenëse katër muaj më parë ishte bërë një kërkesë për privatizim nga qeveria e mëparshme dhe më kërkon se çfarë mendonim ne si *METE* në lidhje me administrimin e kesaj prone, pasi Ministria e Mbrojtjes nuk ka më në objektin të administrojë prona jo ushtarake, që nuk i shërbejnë më ushtrisë. Ministria e Mbrojtjes në atë kohë ka pasur shumë lloje pronash, klub sportiv, shtëpitë e oficerëve, toka bujqësore, uzina, fabrika etj. Mediu m'u drejtua mua që të merrte mendim dhe unë i ktheva përgjigje që ishin ata që duhet të merrnin vendim për këtë pronë, se çfarë fati do të ketë, do privatizohet, do jepet me qera. Nga z. Mediu vjen një prononcim i dytë që nuk do ta perfshinin në planin e shpërndarjes ku këtë të fundit e miratonte presidenti. Z. Mediu u shpreh se nuk do ta përfshijë në planin e përhapjes pasi nuk përfshihet në objektivat tona. Kjo shkresë mund të jetë rreth nëntorit 2005..."**

43.2. Me shkresën nr. 9549/3 prot dt 14.11.2005, Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, i parashtron Ministrin të Ekonomisë, Genc Ruli, në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit me nr. 280/1 datë 31.10.2005 në lidhje me prononcimin e Ministrisë së Mbrojtjes ndaj objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit Partizani. Konkretisht shprehet se: *Klubi i Futbollit "Partizani" në bazë të VKM nr. 515 datë 18.07.2003 ... është inventarizuar si prona me nr. 11. Në bazë të VKM nr. 195 datë 30.03.1998 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen" propozojnë miratimin e privatizimit të objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit "Partizani" duke mirëpritur sugjerimet e METE në lidhje me forma të tjera.* Bashkalidhur është lista e inventarit të pronës nr. 11. Klubi i Futbollit Partizani.

44. Gjithashtu, në këtë kohë, kanë filluar edhe përpjekjet për të futur në proces privatizimi **Klubin Shumësportesh Partizani**. Aktiviteti i Klubit Shumësportesh Partizani, vijonte nën varësinë e Ministrisë së Kulturës. Me urdhërin nr. 603 datë 20.11.2003 "Për miratimin e statutit të Klubit Shumësportesh Partizani" të Ministrin të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Arta Dade, është miratuar **statuti i Klubit Shumësportesh Partizani**. Klubi Shumësportesh Partizani, është një organizatë sportive sipas këtij statuti, *person juridik publik në varësinë e Ministrisë së Kulturës*. KS Partizani është institucion buxhetor që nuk ndjek qëllime ekonomike, me seli në Tiranë. Me urdhërin nr. 638 datë 11.12.2003 të Ministrin të Kulturës Arta Dade, në detyrën e drejtorit Ekzekutiv të Klubit Shumësportesh Partizani, është emëruar Isa Tare.

Konstatohet se, me nr. 468 prot dt 14.10.2005 (hyrje) është depozituar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Kulturës, një kërkesë e trashëgimtarëve të njohur të truallit të Sport Klub Partizanit, drejtuar Ministrin Bujar Leskaj dhe nënshkruar nga shtetasit *Fadil Saliaga, Bashkim Bekteshi, Rudina Llagami, Fitnete Vaqarri*. Me këtë kërkesë, si përfaqësues të familjeve të njohura pronare, parashtrojnë se **me formimin e qeverisë së re, parashtrojnë kërkesën për privatizimin** e këtij objekti, duke kërkuar të bëhet e mundur fillimi i procedurave të privatizimit dhe vlerësimit të kësaj prone.

Vini re, vendosjen e theksit, tek formimi i qeverisë së re.

Me shkresën nr. 2284 prot datë 28.03.2006 të zëvendës ministrin të Ministrisë së Turizmit, shtetasit Neritan Alibali, rezulton se i është kthyer një përgjigje Bashkësisë së Kroit të Shëngjinit, duke i bërë me dije se **kjo Ministri, nuk ka një platformë për privatizimin e këtyre pronave.**

Gjithashtu, është evidentuar edhe një kërkesë nr. 1526 prot dt 24.11.2005 e kërkuarit Luan Saliaga, drejtuar Ministrisë së Kulturës, duke i parashtruar se ka bërë një kërkesë edhe më dt 08.07.2005 ku ka kërkuar të informohet për disa nga objektet e Klubit Partizani, por doli se Ministria e Kulturës nuk i ka në inventar. Kërkon të dijë nëse janë në inventar fizik këto objekte. Me anë të një informacioni të nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Sporteve Mehmet Spahiu, pranë Ministrisë së Turizmit, me nr. 101 prot dt 23.01.2006, drejtuar zv/Ministrin Neritan Alibali, pasqyrohet se **70 % e pronave të Klubit ose nga 27 200 m² që ka në inventar Klubi, 19 011 m² kanë qenë të zënë forcërisht nga familjarë ose tregtarë, ku përshkruan se nga 19 objekte, 11 kanë qenë të zëna e për këtë arsye pronat e Klubit Partizani, nuk janë pasqyruar në inventarin e pronave të Ministrisë së Turizmit, pasi nuk janë marrë asnjëherë në dorëzim nga kjo e fundit. Përsa më sipër, mendon t'i kthejnë përgjigje z. Luan Saliaga në të cilën t'i përcaktohet se asnjë nga pronat e Klubit Shumësportesh nuk është privatizuar apo kthyer në fond banese nga Ministria e Turizmit.** Me shkresën nr. 1526/1 prot dt 30.01.2006 zëvendës Ministri Neritan Alibali i kthen përgjigje shtetasit Luan Saliaga, duke i parashtruar se, **pronat për të cilat është i interesuar, nuk janë privatizuar apo kthyer në fond banese nga kjo Ministri.**

45. Fakti që Klubi Shumësportesh Partizani, ka vijuar të ushtrojë aktivitetin e tij sportiv, evidentohet nga një sërë shkresash të administruar nga Ministria e Kulturës, ku ndër të tjera për shembull rezulton struktura organike e Klubit Shumësportesh Partizani, e cila për vitin 2005 shfaqet me 24 punonjës.

Me shkresën nr. 159 prot dt **06.02.2006** të Drejtorisë së Sportit pranë Ministrisë së Turizmit, drejtori Mehmet Spahiu i dërgon informacion Ministrit të Turizmit Bujar Leskaj, duke qenë i mendimit dhe sugjeruar ndryshime në strukturën dhe drejtuesit e Klubit Shumësportesh Partizani në kuadrin e përmirësimit të cilësisë sportive etj.

Gjithashtu rezulton se Ministri Bujar Leskaj me nr. 3155 prot dt **25.04.2006** ka miratuar edhe një program auditimi për Klubin Shumësportesh Partizani, ku projekt raporti është përgatitur më dt 18.05.2006. Periudha që është audituar i përket 01.07.2004 deri më 31.03.2006. Për periudhën që auditohet konstatohet se ka pasur fonde në dispozicion në shumën 22 616 mijë lekë për 6 mujorin e dytë të vitit 2004; në shumën 12 700 mijë lekë për vitin 2005 dhe në shumën 2 417 mijë lekë për 3 mujorin e vitit 2006.

Me kërkesën për çelje fondesh në investime nr 50 prot dt **22.05.2006** të drejtorit ekzekutiv të Klubit Shumësportesh Partizani Afrim Tola, me të cilën, ky i fundit i është drejtuar Sekretares së Përgjithshme pranë Ministrisë së Turizmit, duke pasqyruar se për vitin 2006 Klubit shumësportesh Partizani nuk i është akorduar fond investimesh. Prandaj paraqet kërkesë për çelje investimesh për investime si rikonstruksion dhe pajisje. Në bazë të preventivave, fondi i investimeve prej 10 milionë lekësh, është planifikuar për rikonstruksionin e palestrave të basketbollit, volejbollit, mundjes, peshëngritjes, dhomave të zhveshjes së tyre, tualeteve, muzeumit etj. Fondi prej 800 mijë lekësh është planifikuar për pajisje zyresh, (kompjutera, fotokopje, makinë shkrimi, makina llogaritëse, kasaforta etj) , pajisje sportive (shtanga, tapete, dyshekë gjimnastike, pajisje mjekësore etj).

Me shkresën nr. 4555/1 prot dt **30.05.2006** të Drejtorit Dr. Mehmet Spahiu, pranë Drejtorisë së Sportit, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Sportit në Ministrinë e Turizmit, shtetasit Flamur Shehu, dhe për dijeni Shefes së Sektorit Ekonomik, shtetases Kozeta Mesiti, është kërkuar të çelet një fond investimesh për rikonstruksionine ambjenteve të Klubit Shumësportesh si dhe për blerje bazë materialesh për plotësimin dhe realizimin e nevojave të Klubit. Në këtë shkresë përmendet se një nga detyrimet e kësaj Ministrie, mbështetur në ligjin nr. 9376 datë 21.05.2005 "*Për sportin*" është zhvillimi i sportit.

Kthimi i dytë i pronave

46. Parlamenti, ka miratuar ligjin nr 9235 datë 29.07.2004 "*Për kthimin dhe Kompensimin e pronës*".

Neni 6 "*Njohja e së drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës*" parashikonte:

1. *Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompensohet deri në 60 ha dhe kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.*

....3. *Subjektet e shpronësuara dhe të kompensuara sipas ligjeve në fuqi kanë të drejtën e përfitimit nga ky ligj vetëm për pjesën e pronës së pakthyer ose të pakompensuar.*

Neni 7 "*Pronat që nuk kthehen*" sanksiononte:

1. *Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe që:*

a) *shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë;*

b) kanë investime ose përdoren për realizimin e projekteve me shtrirje territoriale ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji ose në investime të tjera në interes publik, të përcaktuara sipas ligjit "Për shpronësimet për interes publik";

c) shërbejnë për ruajtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës, arsimit publik ose edukimit parashkollor; ç) shërbejnë për mbrojtjen kombëtare dhe që nuk tjetërsohen;

d) janë pasuri e veçantë kulturore ose historike, e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi;

dh) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në Shtojcën 1 të këtij ligji, përveç rasteve kur sipas këtyre ligjeve shteti është pronar dhe prona e paluajtshme nuk i shërben një interesi publik.

2. Në rast se pronat e paluajtshme, që përfshihen në pikën 1 të këtij neni, propozohet të tjetërsohen, ato i kalojnë subjekteve të shpronësuara.

3. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kompensohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

Sipas nenit 19, subjektet e shpronësuara, për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e reja brenda 2 viteve (pas ndryshimeve të majit 2005) nga hyrja në fuqi e këtij ligji. (Ky ligj është botuar në FZ nr. 61 datë 31.08.2004).

Sipas nenit 24, procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave të paluajtshme përfundon deri në datën 31.12.2007 (pas ndryshime të majit 2005), me përjashtim të kryerjes së pagesës së kompensimit, e cila duhet të përfundojë në afatin e parashikuar në nenin 23 të këtij ligji.

47. Në vitin 2005, pasi shtetasi Sali Berisha zgjidhet Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, konstatohet se shtetasi Jamarbër dhe Argita Malltezi, të cilët rezultojnë të kenë qënë të punësuar pranë Unmik, Kosovë, fillojnë të zhvillojnë pjesën më të madhe të aktivitetit të tyre në Shqipëri.

Shtetasi Jamarbër Malltezi, bashkë me motrën e tij, Orindën, rezultojnë të jenë trashëgimtarë të shtetases Nimete Bekteshi, e bija e të ndjerit Xhemal Begeja. Kjo e fundit ka qënë e martuar me shtetasin Maliq Bekteshi dhe kanë pasur katër fëmijë: Bashkim, Nervit, Rajmonda dhe Merxhane. E ndjera Merxhane, ka ndërruar jetë më datë 26.03.1987 dhe ka qënë e martuar me të ndjerin Luan Malltezi. Nga kjo fëmijë ata kanë dy fëmijë, konkretisht shtetasit Jamarbër dhe Orinda.

Shtetasi Fatmir Bektashi është trashëgimtar i familjes Vaqarri dhe gjithashtu është kushëri me anëtarë të familjes Llagami. Si edhe më lart u theksua, ky shtetas rezulton të kishte në këtë kohë të zhvillimit të ngjarjeve shoqërinë Kontakt sh.p.k. si ortak i vetëm, shoqëri e cila merrej me ndërtime.

Shtetasi Xhimi Begeja, është trashëgimtar i familjes Begeja, ashtu si edhe shtetasi Jamarbër Malltezi.

Të tre këta persona, vërtetohet nga aktet e administruara në dosje se kanë pasur rol të posaçëm në procesin e kthimit të pronës që shtrihej në territoret e dy ish klubeve Partizani, të privatizimit dhe në vijim të zhvillimit të saj me ndërtime. Ndërkohë që shtetasi Jamarbër Malltezi ka qëndruar në hije, ata që shfaqen me veprime të drejtëpërdrejta në institucione janë shtetasit Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja.

Shtetasi Jamarbër Malltezi shfaqet formalisht vetëm në vitin 2018, kur bëhet pjesë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. së bashku me shtetasin Xhimi Begeja dhe shtetasin Fatmir Bektashi që kishte krijuar këtë shoqëri në vitin 2008.

48. Pikërisht në këtë periudhë, konstatohet se merren masa nga trashëgimtarët Begeja, pjesë e të cilëve rezultojnë të jetë edhe shtetasi Jamarbër Malltezi, për të vijuar me procesin e kthimit të pronave.

49. Shtetasi **Bashkim Bektashi** (*daja i shtetasit Jamarbër Malltezi*), me nr 102 prot datë 12.10.2005 (në regjistrin e përgjithshëm të kërkesave dhe njoftimeve të marra 2005 – 2006 rezultojnë e paraqitur kjo kërkesë me nr 101 prot) dhe paguar mandat pagesa me nr 23 datë 15.10.2005 paraqet në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kërkesën për plotësim dosje, për kthim prone. Kjo kërkesë siç mund të konstatohet është përgatitur në të njëjtën ditë që Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, i është drejtuar METE-s, për të marrë hapa të mëtejshëm në lidhje me pronën e ndodhur tek Klubi i Futbollit Partizani, pasi është vendosur që këto terrene të mos përfshihen në planin e përhapjes së FA-së.

Pikërisht në këtë periudhë konstatohet se shfaqen edhe udhëtime të përbashkëta mes shtetasit Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi, ku të dy këta shtetas, më datë 27.11.2005 dalin nga Pika e Kalimit Kufitar Qafë Thanë, respektivisht Fatmir Bektashi në orën 20.09 me automjetin me targë TR8199I dhe Jamarbër Malltezi me targë UN P8064 në orën 20.10.

Disa ditë më vonë, shfaqet një udhëtim i përbashkët i shtetasit Sali Berisha me shtetasin Bari Hodaj. Konkretisht në datë 01.12.2005, këta dy shtetas, kanë qenë pasagjerë të linjës ajrore të udhëtimit AUSTRIAN AIRLINES – OS 847/848 Viena. Regjistrimi i tyre në Hyrje është bërë në PKK Rinas, përkatësisht shtetasi Sali Berisha në orën 00:11 dhe shtetasi Bari Hodaj në orën 00:07. Rreth një muaj e gjysëm më vonë, Komisioni i Kthimit të Pronave, merr vendimin nr 135 datë 20.01.2006 që i kthen edhe një pjesë tjetër prone, familjes Begeja.

Pa u mbushur muaji nga ky udhëtim, konstatohet se në lidhje me familjen e **Mahmut dhe Xhemal Begeja** rezultojnë se me vendimin nr. 135 datë 20.01.2006 KVKKP ka vendosur: **Të kthejë pronën me një sipërfaqe prej 11 740 m².**

Nga përmbajtja e këtij vendimi rezultojnë se trashëgimtarët ligjorë të subjektit të shpronësuar Mahmut dhe Xhemal Begeja, janë të përfaqësuar me prokurën me nr. 1007 rep nr. 262 kol datë 13.03.2002 nga shtetasi Bashkim Bektashi.

Sipas këtij vendimi të dhënë nga anëtarët *Emil Konomi, Lindita Tako, Ermira Stavre, Bari Hodaj dhe Besnik Hoxhaj*, ka vendosur që të kthejë pronën prej një sipërfaqe trulli prej **11740 m²** (shënuar në hartë $SL1=3120\text{ m}^2$, $SL2=6780\text{ m}^2$, $SL3=1840\text{ m}^2$) subjektit të shpronësuar Mahmut dhe Xhemal Begeja...Sipërfaqe që mbetet për t'u kompensuar me një nga format e përcaktuara në këtë ligj subjektit të shpronësuar...të ndodhur në Tiranë, sinori Shëngjin, është **13 925 m².**

Konstatohet se, procesi verbal për dorëzimin e pronës, është mbajtur më datë 20.02.2006 nga KVKKP i përfaqësuar nga Bari Hodaj dhe Arben Lasku dhe subjekti Xhimi Begeja. Gjithashtu në librin Regjistër protokollin e vendimeve të marra nga Komisioni 2005 – 2006, konstatohet se aty ku janë bërë shënimet në lidhje me këtë vendim gjendet shënimi “*ju dorëzuar më 20.02.2006 Xhimi Begeja*” ku gjendet edhe nënshkrimi i shtetasit Xhimi Begeja.

I pyetur më dt 30.05.2022, shtetasi **Bari Hodaj** ka pretenduar se, *dosja e familjes Begeja i ka kaluar në bazë të shortit.*

Pikërisht për sipërfaqen prej 3120 m², pjese e kësaj sipërfaqe të kthyer në vitin 2006, ka lindur një konflikt me shtetasit Kapollari, i cili gjendet i pasqyruar në mënyrë të detajuar më poshtë.

Nga aktet rezulton se, sipas kartelës së pasurisë, më datë **28.02.2006**, është regjistruar pasuria me nr. 3/138 ZK 8220 vol 15 faqa 55 me sip trualli 3 120 m². Si bashkëpronarë janë: *Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nusret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri me 525/4200 secili pjesë; Sanije Velo (Begeja), Myzejen Ago (Begeja), Lirije Lika (Begeja), Ajete Sulstarova që kanë secili nga 84/4200 pjesë; Gëzim Begeja me 504/4200 pjesë; Haxhire dhe Elona Begeja me 105/4200 pjesë; Syzi Begeja, Ednand Begeja me 210/4200 pjesë; Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Teuta Malka, Xhelan Kadiu, Mariban Kadiu, Nerime Piro, Bashkim Kadiu, që kanë secili nga 60/4200 pjesë; Graciela Begeja, Vera Graboëski dhe Margaret Irëin që kanë sejcila nga 70/4200 pjesë.*

50. Gjithashtu, familjet e njohura pronare, nisin të përgatisin dokumentat përkatëse edhe për privatizim. Pra, ende pa u kthyer përgjigja përfundimtare nga Ministria e Mbrojtjes, por pasi kishte nisur tashmë kjo korrespondencë, fillojnë të përpilohen prokura nga pronarët e njohur, me qëllim marrjen pjesë në procedurën e privatizimit.

Kështu, rezulton se, **familja Llagami** emëron si përfaqësues të saj shtetasin Ervin Llagami (*prokura e posaçme nr 4053 rep nr 789 kol datë 14.10.2005, lëshuar nga shtetasit Behixhe Tafaj, Myhyrije Vezivolli, Nexhat Llagami, Aleksandra Llagami, Ervin Llagami, Artur Llagami, prokura e përgjithshme nr. 5997 rep nr. 669 kol datë 30.12.2005, lëshuar nga Artur Llagami dhe Aleksandra Llagami...*).

Familja Alimehmeti, emëron si përfaqësues të saj, shtetasin Blendi Marika (*prokurë e përgjithshme nr 5451 rep nr 592 kol datë 12.11.2005, lëshuar nga shtetasit Alma Sulo (Mullici); Fatbardha Marika (Alimehmeti), Genci Mullici, Fiqiri Alimehmeti, Fehmi Alimehmeti, Xhafer Alimehmeti*).

Familja Vaqarri emëron si përfaqësues të saj shtetasin Igli Vaqarri (*prokurë e përgjithshme nr 5995 rep nr 668 kol datë 29.12.2005 lëshuar nga shtetësja Eva Vaqarri; prokurë nr 166 rep nr 35 kol datë 25.01.2006.*).

Nga përmbajtja e këtyre prokurave konstatohet se këto familje, tashmë kanë fituar siguri se procesi i privatizimit do të ndodhte. Kështu, në prokurën me nr 5995 rep nr 668 kol datë 29.12.2005 ndër tagret që i janë dhënë shtetasit Igli Vaqarri janë: *...për të gjitha procedurat pranë AKKP për privatizimin në lidhje me pasurinë e saj të paluajtshme, që gjendet tek Kroj i Shëngjinit.* Me prokurën e përgjithshme nr. 5997 rep nr. 669 kol datë **30.12.2005**, shtetasit Ervin Llagami i janë dhënë tagre që të kryejë të gjitha **procedurat e privatizimit** pranë Agjensisë Kombëtare të Privatizimit. Me prokurën e përgjithshme nr. 5451 rep nr. 592 kol datë **12.11.2005**, shtetasit Blendi Marika, i janë dhënë tagre si vijon: *...Duke patur ne të drejtën e parablerjes së objekteve terrene sportive të KS Partizani me sip 7440 m²,**këto objekte do të privatizohen** me çmimet e përcaktuara nga dispozitat ligjore ndërsa personat juridikë apo fizikë të cilët kanë në pronësi ndërtesa (ndërtimi nr. 1, 2, 3, bashkë me truallin me sip të përgjithshme 900 (nëntëqind) m² detyrohen t'i paguajnë pronarëve të truallit qeranë ose të riblejnë truallin sipas kontratës që do të lidhet midis palëve...Përfaqësuesit i jepen tagre të kryejë ndër të tjera çdo veprim të nevojshëm që ka të bëjë me privatizimin e objekteve të*

sipërpërshkruar të cilat ndodhen mbi truallin e tyre. ...Përfaqësuesi ka të drejtë të krijojë shoqëri aksionare për Klubin Sportiv Partizani...

Me prokurën nr 166 rep nr 35 kol datë 25.01.2006, Fiqerete Vaqari lëshon prokurë duke caktuar si përfaqësues djalin e saj Igli Vaqari. Ndër tagret që evidentohen, **janë ato të dhëna për të kryer procedurat pranë Agjensisë Kombëtare të Privatizimit ose organeve të tjera kompetente në lidhje me privatizimin etj, por duke përjashtuar të drejtën e tjetërsimit.**

50.1. Nga hetimi, ka rezultuar se, kanë qenë shtetasit Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja që kanë marrë takime të drejtëpërdrejta me pesë familjet e njohura pronare, **duke u premtuar se do e mbaronin ata punën si për kthimin e pronës ashtu edhe për privatizimin, me qëllim përfundimtar zhvillimin e pronës.**

50.1.1. Më datë 21.11.2023 është pyetur shtetasi **Ervin Llagami**, i cili ka deklaruar se, në fillim deri rreth vitit 2004 – 2005, me procedurat për njohjen e kthimin e pronës qoftë në Komisionin e Kthimit të pronave ashtu edhe nëpër gjykata, është marrë Nexhat Llagami. Në nëntor 2005 deri kur është bërë privatizimi i Klubit të Futbollit Partizani, është marrë Ervini dhe vajza e xhaxhait të tij Rudina Llagami, që janë marrë me procedurat përkatëse në lidhje me pronën. Deri nga viti 2002 ka qene një ligj që çdo familje i kthehej vetëm 5000 (pesë mijë) m2, më pas ligji ndryshoi. **U mbloodhën të gjithë përfaqësuesit e familjeve, konkretisht kanë qenë Bledar Alimehmeti nga familja Alimehmeti dhe xhaxhai i tij emri i të cilit nuk i kujtohet, Xhim Begeja, Silva Bello (Saliaga) dhe motra e vet, por nuk i kujtohet emri për familjen Saliaga si dhe Fatmir Bektashi për familjen Vaqarri, dhe për familjen Llagami ishte Ervini dhe Rudina Llagami. Zakonisht mblihdeshin tek lokal Begeja 1900 pranë Gjykatës së Tiranës, në katin e fundit, përballë ish Ekspozitës. Pasi kanë diskutuar të gjithë në lidhje me mundësinë e kthimit të pronës, vendosën të paraqisnin kërkesa në Agjensinë e Kthimit të Pronave. I kujtohet që çdo dokumentacion noterial, deri në privatizim është përgatitur tek notere Gentiana Shkodra, notere e cila ishte zgjedhur nga Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja. Nuk më kujtohet kush i përgatiti kërkesat për në Agjensinë e Kthimit të Pronave në periudhën 2006. Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja kishin marrë përsipër para nesh, anëtarëve të tjerë që do e mbaronin ata këtë punë, do interesoheshin ata për këtë punë si kthimin ashtu edhe privatizimin me qellim përfundimtar zhvillimin e pronës. Dokumentat në Agjensinë e Kthimit të Pronave bashkë me kërkesën për kthimin e pronave, në vitin 2006 i ka çuar vetë Ervini. Anëtarët e tjerë të familjes Llagami, i kanë dhënë prokurë që të merrte Ervini kontakte me Fatmir Bektashin, Xhimi Begejen dhe bashkëpronarët e tjerë të klubit dhe të paraqitej para zyrave të kthim kompensimit të pronave, tek hipoteka etj. ... Ervini me shtetasin Fatmir Bektashi është kushëri i dytë, pra Fatmiri me babain e tij, jane djem tezesh.....Fillimisht takimet janë bërë tek lokali Begeja, deri në kohën e privatizimit dhe më pas, pas privatizimit Fatmir Bektashi filloi t'i takonte të gjithë familjarët sipas trashëgimive pra familjen Llagami, Saliaga etj më vete si familje. ... E di se kush ishte Jamarber Malltezi por nuk e njeh personalisht. Persa është në dijeni Ervini, Jamarber Malltezi nuk ka zhvilluar ndonje bisede me anëtarët e familjes Llagami, në lidhje me çështjet e kthimit të pronës apo privatizimit. Di që firma Kontakt është perzgjedhur si ndertuese pergjate takimeve që si familje kanë bere bashkarisht që në fillim tek lokali Begeja 1900.**

50.1.2. Më datë 23.02.2024 është pyetur shtetasi **Blendi Marika**, i cili ka deklaruar se, në vitin 2005 ka qenë përfaqësuesi me prokurë i nënës së tij dhe i disa trashëgimtarëve të tjerë të familjes Alimehmeti. I ka përfaqësuar familjarët e tjerë që i kanë dhënë prokurë, **në takimet me familjarët e familjeve të tjera ish pronare. Takimet me familjet e tjera ish pronare në fillim para privatizimit i realizonin në kafe dhe pas privatizimit në zyrat tek Klubi i Futbollit**

Partizani. Kërkesa për kthimin e truallit mesa kujton është bërë në një kërkesë të vetme pasi ky ka qënë dhe qëllimi i mbledhjes së bashku të të gjitha familjeve ish pronare që të vepronin të gjithë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë. Në lidhje me firmën e ndërtimit nuk e kujton shumë mirë kush e ka zgjedhur, por mesa mban mend çdo familje ka propozuar nga një firmë ndërtimi, por në fund është zgjedhur firma Kontakt shpk me administrator shtetasin Fatmir Bektashi, kjo pasi ai ishte vetë një nga trashëgimtarët e familjes Vaqarri dhe kishte një historik në ndërtim dhe të gjitha familjet bashkarisht ranë dakort që ndërtimin ta kryente Firma Kontakt. ...Në dijeninë e tij, trashëgimtarët e familjes Alimehmeti në vitet 90' pasi ka dalë vendimi i Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronës Ish-Pronarëve, kanë paraqitur kërkesa edhe me herët për nxjerrjen në privatizim të objekteve që ndodheshin në kufi të Klubit të Futbollit Partizani dhe ishin pronë e familjes Alimehmeti dhe një nga këto objekte ka qënë ish-Autooficina në inventarin e Ministrisë së Mbrojtjes, pronë e cila nuk ka dalë ende në privatizim. Më vonë të gjitha familjet ish pronare në Klubin e Futbollit Partizani kanë paraqitur kërkesë bashkarisht për privatizimin e objekteve në Klubin e Futbollit Partizani pasi kjo pronë po shfrytëzohej nga privatë dhe pas kësaj kërkesë ka vijuar procesi për privatizimin e këtyre objekteve. Pra Klubi i Futbollit Partizani ishte e vetmja pronë që i bashkonte me familjet e tjera ish pronare dhe për pronat e tjera të cilat ishin dhe në kufi me Klubin e Futbollit Partizani janë marrë të gjithë në mënyrë individuale. ...Shtetasin Xhimi Begeja e ka njohur për herë të parë në takimet që kanë organizuar familjet ish-pronare në lidhje me zhvillimin e pronës, ku ky shtetas ishte përfaqësues i familjes Begeja, i cili e përfaqësonte këtë familje i vetëm. Nga familja Vaqarri, kujton që përfaqësues ishte shtetasi Fatmir Bektashi dhe familjet e tjera kishin mesa kujton, më shumë se një përfaqësues.Shtetasin Jamarbër Malltezi e ka njohur në kohën kur kompleksi Magnet është bërë i banueshëm, e ka përshëndetur disa herë në kafën "Magnet" e cila ndodhet poshtë palestës dhe zyrave të Magnet IMO të shtetasit Vladimir Xheka. Kontakte të mëparshme nuk ka patur dhe nuk kujton të ketë marrë pjesë në takimet që janë kryer me familjet ish pronare.

50.1.3. Më datë 22.11.2022, është pyetur shtetasi **Igli Vaqarri**, i cili ka deklaruar se, shoqërinë Kontakt e ka pasur Fatmir Bektashi i cili është pronar toke tek pjesa e familjes Vaqari, është djalë halle i Iglit, i biri i Fitnetit, dhe Fatmiri kishte këtë shoqërinë që bënte ndërtime. Kështu, që duke e pasur njeriun e tyre, kishin biseduar që në pronën e tyre të përbashkët, të kryente ndërtime. ...Igli ka biseduar vetëm me Fatmirin në lidhje me kërkesën për kthimin e pronës. Në lidhje me privatizimin deklaroi se, Fatmiri dhe gjithë pronarët e tjerë bënë dokumentat përkatëse në dikastere si tek kthimi i pronave, tek Ministria e Ekonomisë.

51. Siç edhe më sipër konstatohet, evidentohet se si në procesin e kthimit të pronave por edhe në atë të privatizimit, një angazhim të madh ka pasur edhe shtetasi Xhimi Begeja, gjithashtu një nga trashëgimtarët Begeja. Ky shtetas, megjithëse është shfaqur si përfaqësues i familjes Begeja, në fakt nuk konstatohet të jenë lëshuar prokura përfaqësimi për të (përveç rrethit të ngushtë familjar), por familja Begeja, ka caktuar si përfaqësues pikërisht shtetasin Jamarbër Malltezi. E megjithatë, sërish tek të tretët, shfaqet shtetasi Xhimi Begeja.

52. Megjithëse duket se familjet, ndërkohë kishin ardhur në dijeni se do të procedohej me privatizimin e objekteve, lexuar nga vetë aktet e përfaqësimit të lëshuara prej tyre, duket se marrin edhe masa, për ta zyrtarizuar dijeninë e tyre nëpërmjet shkresave.

Konkretisht, nëpërmjet një shkresë me nr. 0670/1 prot datë 06.01.2006 (hyrë në Ministrinë e Mbrojtjes me nr. 48 datë 09.01.2006), pesë familje, të vetëemërtuara si "Bashkësia Kroi i Shëngjinit", shkresë e nënshkruar nga **Xhimi Begeja, Igli Vaqari, Blendi Alimehmeti, Hamide Saliaga, Nexhat Llagami**, i drejtohen Ministrit të Mbrojtjes Fatmir Mediu, duke pretenduar se,

pasi kanë marrë shkas nga një shkrim i Gazetës Shqiptare të datës 04.01.2006, kërkojnë zyrtarisht që të njoftohen për çdo procedurë që sjell si pasojë ndryshimin e statusit të Sport Klub Partizanit ose transferimin tek të tretët, të të drejtave reale mbi sport klubin, truallin apo objekteve ku subjekti (i referohen shoqërisë Partizani sh.a.) po zhvillon aktivitetin sportiv. Përmendin se bashkësia e bashkëpronarëve, disponon asetet e mjaftueshme të cilat do të vihen në shërbim të mirëadministrimit të Sport Klub Partizanit, objekteve ku ai zhvillon aktivitetin si dhe truallit përkatës. Për familjen Begeja konstatohet se ka nënshkruar shtetasi Xhimi Begeja. Si adresë është vendosur: "Bulevardi Gjergj Fishta, nr. 8.3.10, AL-00004 Tiranë", tel 00355692070306, fax 003554347691 dhe adresë emaili www.kroi-shengjinit.com.al

Pra, nga leximi i shkresës së mësipërme, konstatohet se situata nuk paraqet realitetin, lidhur me dijeninë mbi privatizimin, pasi që në vitin 2005, ishin lëshuar, si më lart u theksua, akte përfaqësimi që i jepnin tagra përfaqësuesve në lidhje me privatizimin mbi pronën objekt i kësaj shkrese.

52.1. Këshilltari i Jashtëm Genci Çelo, i adresohet me një memo të datës 13.01.2006 Ministrisë të Mbrojtjes Fatmir Mediu, ku e sqaron në lidhje me ndarjen e Sport Klub Partizanit në dy pjesë dhe se cili institucion i ka në varësi, duke ofruar të dhëna edhe në lidhje me shoqërinë Partizani sh.a. dhe se Ministria e Mbrojtjes i ka kërkuar METE-s miratimin e privatizimit të objekteve të Klubit Sportiv Partizani.

Si edhe më lart u theksua, padijenja dhe shkëputja që shtetasi Fatmir Mediu, kërkon të bëjë, në anë subjektive, se nuk ka pasur dijeni në lidhje me klubet sportive Partizani, se ekzistonin dy të tilla etj, duke u shprehur krejtësisht i pa interesuar, duket se nuk mbështetet nga provat e administruara.

52.2. Me shkresën nr. 48/1 prot dt 16.01.2006 Ministria e Mbrojtjes (Kabineti), shkresë e nënshkruar nga Shefi i Kabinetit, Prof. Ass. Dr. Elmaz Leci, i është drejtuar bashkësisë "Kroi i Shëngjinit" ku në lidhje me problematikën që ata kanë parashtruar në shkresën e datës 06.01.2006, i sqaron se: *Ministria e Mbrojtjes është organi që administron pronën e Klubit Sportiv Partizani, prandaj si administrator nuk lidhet me pronësinë. Klubi Sportiv Partizani nuk përfshihet në planin e përhapjes së FA dhe për këtë arsye MM i ka kërkuar METE miratimin e privatizimit të objekteve të këtij klubi. Procedurat e privatizimit që duhet të ndjekë MM në rolin e administratorit të pronës, lidhen me vlerësimin e objekteve që do të privatizohen. Problemet e pronësisë mbi truallin janë të përcaktuara në VKM nr. 159 datë 13.03.2003 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet si dhe procedurat e shitjes".*

Shtetasi Elmaz Leci, ka ushtruar detyrën e drejtorit të Kabinetit të Ministrisë sipas urdhërit nr. 92226 datë 15.09.2005 të Ministrisë të Mbrojtjes Fatmir Mediu, derisa me urdhërin nr. 579 datë 27.04.2007 të ministrisë të mbrojtjes Fatmir Mediu është liruar nga kjo detyrë.

53. Shtetasi Jamarbër Malltezi, në këtë kohë, nuk rezultonte ende si trashëgimtar i drejtëpërdrejtë, për shkak se shtetësja Nimete Bektoshi nga e cila ai përfiton trashëgiminë, ka qenë ende gjallë. Por ai duket se angazhohet për t' u marrë me një sërë procedurash që lidhen me kthimin e pronës dhe me zhvillimin e mundshëm të ndërtimeve në to. Si edhe më lart u theksua, pasi familjet e njohura pronare kanë zhvilluar takime kryesisht në lokalitetin e shtetasis Xhimi Begeja, të ndodhur pranë ish Ekspozitës Shqipëria Sot, janë angazhuar bashkarisht për kthimin e pronës, privatizimin dhe zhvillimin e saj.

Shtetasi **Jamarbër Malltezi**, ndërkohë në muajin janar 2006 konstatohet se është përfshirë në një projekt të rëndësishëm, duke mbajtur edhe pozicionin e koordinatorit të projektit "Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare" me financim në shumën 950 000 \$ midis Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Ministrisë së Financave dhe duke u atashuar me zyra pranë Ministrisë së Punëve Publike.

Shtetësja **Argita Malltezi**, nga ana tjetër, është kthyer nga Kosova duke vendosur të ushtrojë profesionin e avokates, siç edhe deklaroi shtetësja Flutura Kola, me të cilën nga viti 2005 kanë krijuar një shoqëri të thjeshtë të cilën kanë dashur ta regjistrojnë në Dhomën e Avokatisë.

Shtetasi Jamarbër Malltezi, dukshëm konstatohet se paraqitet si një person që mbarte pushtet, për shkak se përveç kthimit të pronës, në të njëjtën prokurë, i jepen tagre edhe për ndërtimet që do të kryheshin në të, megjithëse nuk kishte ende ndonjë siguri se prona do të kthehej, se objektet do të privatizoheshin, se do të mund të pajiseshin me leje ndërtimi etj.

Kështu, pas konfirmimit të mësipërm të Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën nr. 48/1 prot datë 16.01.2006, rezulton se shtetasi **Jamarbër Malltezi**, merr përsipër tagre përfaqësimi, për t'u lidhur me firma ndërtuese apo përfaqësim në **Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**. Sjellim në vëmendje se përgjatë gjithë kohës së zhvillimit të ngjarjeve, ka qenë shtetasi Xhimi Begeja, si në konflikte gjyqësore, në komisionin e kthimit të pronave etj, në noterizime etj që shfaqej si përfaqësues i familjes Begeja. E megjithatë, prokurat e familjes Begeja, lëshohen për shtetasin Jamarbër Malltezi. Ky i fundit, tashmë i kthyer në Shqipëri, kishte filluar si edhe më lart relatuar të rriste pasuritë e tij. Konkretisht lëshohet prokura, me nr 787 rep nr 142 kol datë 31.01.2006.

Ky përfaqësim, mesa rezulton nuk shfaqet falas, pasi personat që i japin tagre shtetasit Jamarbër Malltezi, parashtrajnë se, **vënë në dispozicion të këtij të fundit, 3 – 5% të pasurisë së tyre të paluajtshme, për krijimin e një fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve emergjente dhe të paparashikuara**. Megjithatë, nisur nga tagret e dhëna, që është lidhja me firma ndërtuese apo nënshkrimi i kontratës së parë që vë në dispozicion firma ndërtuese për truallin e tyre, nuk rezulton e qartë, se cilat do të ishin shpenzimet emergjente dhe të paparashikuara, për të cilat shtetasit Jamarbër Malltezi, do t'i duhej kjo pjesë e pasurisë së paluajtshme.

Për më tepër, kur edhe siç rezulton, firma ndërtuese, shoqëria Kontakt sh.p.k. me të cilën lidhen kontratat përkatëse, i përket pikërisht një trashëgimtari tjetër të familjeve që zhvillojnë ndërtime në këto territore, që është shtetasi Fatmir Bektashi, i cili edhe ai si vetë të përfaqësuarit më sipër, ka interes në ndërtime të mundshme në këto territore.

53.1. Me anë të prokurës së posaçme Nr. 787 Rep, Nr. 142 kol, **datë 31.01.2006**, para noteres Ruko Sako, trashëgimtarët ligjorë të Mahmut dhe Xhemal Begeja (*konkretisht Haki Begeja, Nimete Bektashi, Nysret Kacurri, Kreshnik Kacurri, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Merita Kallajxhiu (Begeja), Sanije Velo (Begeja), Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirie Lika, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Graziella Begeja*), të gjithë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklaruan se:

"Emërojmë përfaqësues të përgjithshëm z. Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit dhe iMerxhanes, lindur më 09.11.1972 dhe banues në Tiranë, madhor, me zotëris të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i çertifikatës me fotografi nr 372 674557 dhe regjistri nr 2-62 lëshuar nga Gjendja Civile Njësia Nr 9 Tiranë, të cilit i japim të drejtë dhe kopetencë të plotë që në emër dhe për llogarinë tonë të veprojë përta vijon:

Të paraqitet në çdo organ shtetëror, ose shoqëri private, pranë çdo personi fizik e juridik, pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme Tiranë, pranë çdo zyre noteriale dhe të marri apo depozitohet çdo lloj dokumenti, kontratë, kontratë shkëmbimi etj si dhe ka të drejtë të tërheqë nga këto zyra çdo dokument për pronat tona, kudo që të ndodhen ato.

Të paraqitet në Komitetin Shtetëror të Pronave dhe në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe të kërkojë kthimin dhe në pamundësi të tij kompensimin për pronat tona, duke nënshkruar çdo dokument, duke bërë çdo pagesë.

Për pronat tona, ka të drejtë të lidhet me firma ndërtuese, të përcaktojë përqindjen e ndërtimit, të nënshkruajë kontratën e parë që vë në dispozicion të tyre truallin tonë. Përsa i përket kontratave të tjera që të përcaktohet konkretisht pjesa jonë, kontratën e shkëmbimit të truallit do ta nënshkruajmë vetë.

Përfaqësuesi ynë ka të drejtë që të paraqitet në gjykatë, në të gjitha shkallët gjyqësore deri në Gjykatën Kushtetuese, për çdo lloj gjykimi që do të duhet të zhvillohet për pronat tona, ku mund të jemi palë paditëse, të paditur, ose palë e interesuar, të përpilojë dhe nënshkruajë kërkesë padi, kërkesë ankimore etj, të kërkojë zbatimin e vendimit nëpërmjet zyrës së përbarimit dhe po të jetë e nevojshme të emërojnë avokat duke i deleguar të gjitha kopetencat që ai i ka vetë në këtë paragraf.

Përfaqësuesi ynë ka të drejtë që të kryejë të gjithë veprimet e përshkruara në këtë prokurë me përjashtim të tjetërsimit të pronave.

Për arritjen e këtij qëllimi, të gjithë përfaqësuesit në këtë prokurë, deklarojne se vënë në dispozicion të përfaqësuesit të tyre një kapital që fillon nga 3 – 5 % të pasurisë së tyre të paluajtshme për krijimin e një fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve emergjente dhe të paparashikuara. ...”

Kjo prokurë konstatohet se ndër të tjerë, është nënshkruar nga Nysret Kaçurri dhe Kreshnik Kaçurri.

I pyetur më datë 16.05.2022, shtetasi Gëzim Begeja ka deklaruar: ...Ndoshta mund të jetë zbritur ndonjë përqindje nga sipërfaqet e ndërtimit apo toka e marrë por nuk kam nënshkruar ndonjë gjë tjetër përveç prokurës...

E pyetur më datë 22.06.2022, shtetësja Elona Grabova ka pretenduar se, përqindja e sipër përmendur ishte si fond rezervë për të siguruar strehimin në kompleks të familjeve që kishin zaptuar tokën, të cilave ju prishën ndërtimet.

53.2. Përveç prokurës së mësipërme, nga trashëgimtarët Begeja është bërë edhe një akt marrëveshje për një pronë tjetër e konkretisht atë të ndodhur tek ish Ekspozita. Kështu me anë të akt marrëveshjes Nr. 788 Rep, Nr. 143 kol, datë 31.01.2006, vërtetohet nënshkrimi para noteres Ruko Sako, trashëgimtarët ligjorë të Mahmut dhe Xhemal Begeja (konkretisht Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nysret Kacurri, Kreshnik Kacurri, Ednand Begeja (përfaqësuar nga Syzi Begeja), Syzi Begeja, Merita Kallajxhiu (Begeja), Sanije Velo (Begeja), Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirie Lika, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëksi, Margaret Irëin (Graziella, Vera, dhe Margaret të përfaqësuar nga Ksnathipi Begeja dhe Skënder Begeja), Jamarbër Malltezi, parashtrojnë:

Pronarët: Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nysret Kacurri, Kreshnik Kacurri, Syzi Begeja, Ednand Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëksi, Margaret Irëin, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Merita Kallajxhiu (Begeja), Sanije Velo (Begeja), Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirie Lika, kanë emëruar përfaqësues të përgjithshëm Jamarbër Malltezin, që t' i përfaqësojë në organet shtetërore, në gjykatë etj.

Gjithashtu në atë prokurë kanë përcaktuar se për shpenzimet që do të bëjë përfaqësuesi i tyre,

i vihet në dispozicion të tij një shumë 3 – 5 e pasurisë së tyre të paluajtshme, e cila do të përdoret për raste emergjente. Në rast se ndonjë nga të përfaqësuarit në një moment vendos të anullojë prokurën, është i detyruar që të njohë të gjitha shpenzimet e bëra nga Jamarbër Malltezi deri në këtë moment.

Gjithashtu ndërmjet të përfaqësuarëve dhe përfaqësuesit të tyre me prokurë, lidhet kjo akt marrëveshje, për pronën që të përfaqësuarit kanë tek Ekspozita Shqipëria sot. Për arritjen e objektivit, pra që kjo pronë t'ju kthehet pronarëve, Jamarbër Malltezi lejohet që të përdorë shumën e venë në dispozicion nga 3 – 5 %. Gjithashtu autorizohet Jamarbër Malltezi të kontaktojë studio projektimi arkitektonike ndërtimi vetëm për këtë truall konkret. ...

54. Në deklarinimin e tij, dt 16.05.2022, shtetasi **Gëzim Begeja**, sqaron se ... *ai personalisht nuk është marrë me bërje dokumentash pranë Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave dhe as në Institucione të tjera, pasi me dokumentat sipas tij janë marrë anëtarë të tjerë të fisit...*

Pasi u njoh me prokurën, ai konfirmoi se *kjo prokurë është nënshkruar nga ana e tij*. Ai sqaron se *i kanë dhënë të drejtën e përfaqësimit Jamarbërit që të merrej ai me dokumentat, pasi ishin shume persona në moshë të thyer*. Ndër të tjera ai ka sqaruar se ...*Kreshnik Kaçurri është gjallë por është me probleme psikologjike dhe trajtohet me ilaçe...*

Shtetasi Gëzim Begeja është pyetur në lidhje parashikimin në prokurë përse i përket vendosjes në dispozicion të një kapitali prej 3 – 5 % dhe ka sqaruar se ...*kanë rënë dakort për një përqindje evazive të pasurive, pra pronave të tyre, për shkak të shpenzimeve dhe angazhimit që ai bënte për këto prona. Ai sqaron se nuk ka firmosur dokument tjetër përveç prokurës dhe kjo përqindje mund të jetë zbritur nga sipërfaqet e ndërtimit ose toka e marrë.*

54.1. Shtetasi **Muharrem Lika**, i cili ka përfaqësuar në prokurën Nr. 787 Rep, Nr. 142 kol, datë 31.01.2006 shtetasen Lirije Lika, i pyetur më datë 24.05.2022, ka deklaruar se *nga ana e tij nuk janë dorëzuar dokumenta pranë Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave. Me dorëzimin e dokumentave janë marrë anëtarë të tjerë të fisit. Dijeni në lidhje me privatizimin e ish-kompleksit Partizani ka marrë nga shtetasi Gëzim Begeja, i cili është dhe daja i tij. Në vitin 2004 nëna e tij Lirije Lika i ka dhënë një prokurë deklaruesit dhe burrit të motrës së tij, shtetasit Agim Bani ku ju jepte të drejtën e firmës në emrin e saj, të dyve bashkarisht, në lidhje me çështjet e pronave. ... në prokurë ka firmosur ai dhe shtetasi Agim Bani ku kanë përfaqësuar shtetasen Lirije Lika. Ai deklaron se shtetasin Jamarbër Malltezi e ka takuar vetëm një herë para se të niste ndërtimi i pallateve për të dakortësuar për firmën e ndërtimit, mesa kujton janë mbledhur diku tek 10-12 persona ku ka qënë prezent Gëzim Begeja, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi. Në këtë takim që kanë realizuar në një lokal të shtetasit Xhimi Begeja, tek ekspozita shqipëria sot në kat të 13 dhe është diskutuar që ndërtimet do kryheshin nga firma e Fatmir Bektashi. Gjithashtu sqaron se me këtë punë është marrë më së shumti shtetasi Xhimi Begeja.*

Në lidhje me parashkrimin e vënies në dispozicion të përfaqësuesit të një kapitali që fillon nga 3-5% të pasurisë së tyre të paluajtshme për krijimin e një fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve emergjente dhe të paparashikuara shtetasi Muharrem Lika ka sqaruar se, kapitali është vendosur për shkak të shpenzimeve dhe angazhimeve që shtetasi Jamarbër Malltezi do kryente në lidhje me këto prona. Nisur nga fakti që nuk kanë patur mundësi që te paguanin në leke cash për gjithë shpenzimet që do kryente dhe vendosën një kapital që fillon nga 3-5% të pasurisë së tyre të paluajtshme dhe e vendosën evazive sepse nuk e dinin sesa mund të shkonin shpenzimet totale. Në djeninë e tij këtë kapital shtetasi Jamarbër Malltezi do e përfitonte nga sipërfaqet e ndërtimeve.

54.2. Më datë 22.06.2022, shtetësja **Elona Grabova**, e pyetur nga organi procedues ka deklaruar se *prokura e mësipërme është nënshkruar nga ana e saj dhe nënës së saj Haxhire e*

cila ka ndërruar jetë. Shtetasin Jamarbër e njeh pasi janë fis, ajo ka stërgjysh të ndjerin Mahmut ndërkohë që Jamarbëri ka stërgjysh Xhemalin...Në lidhje me përqindjet e parashikuara në prokurë deklaroi se, me privatizimin e objektit të mësipërm, nuk përfshiheshin vetëm terrenet sportive por kishte edhe mbi 40 familje që kishin zaptuar tokën dhe në momentin që trualli u privatizua nga familja Begeja dhe 3 familjet e tjera, u prishën ndërtimet dhe këto familje ngelen të pastreha. Në mënyrë që të sigurohej strehimi i këtyre familjeve u vendos që kjo përqindje nga pasuria e paluajtshme e cila ishte një fond rezervë për t'ju siguruar strehimin në kompleks këtyre familjeve. Në dijeninë e saj të gjitha familjet e pastreha kanë përfituar strehim në kompleksin që është ndërtuar nga shoqëria Homeplan.

54.3. Më datë 25.09.2023, shtetasi **Xhimi Begeja** ka deklaruar se: ... Familjet pasi kanë marrë pronat dhe lindi e drejta sipas ligjit për privatizim, babai im Haki Begeja, bashkë me pjestarët e tjerë të familjes Begeja, që rridhnin nga Haki Begeja, konkretisht Nimete Bekteshi, Jalldiz Begeja, Nusrete Begeja (Kaçurri), Gëzim Begeja, Ednan Begeja, Suzi Begeja, Jeta Begeja, Merita Begeja, dhe pjestarë të tjerë, zgjodhën përfaqësues **Jamarbër Malltezin, duke menduar se ishte më i ri dhe më i shkolluari.**

Pyetjes nëse ka dijeni nëse është përcaktuar ndonjë shpërblim për shtetasin Jamarbër Malltezi, meqënëse do të ishte përfaqësues i personave si më sipër, i përgjigjet: **Jo, nuk mbaj mend.**

Pyetjes nëse e ka parë ndonjëherë prokurën e përfaqësimit të mësipërm deklaroi: ...*Po, e kam parë, por nuk mbaj mend që t'i kenë dhënë ndonjë përfitim.*

Pavarësisht këtij pretendimi të shtetasit Xhimi Begeja, konstatohet se vetë ai në vijim, lëshon një prokurë ku parashtron një përfitim të tillë.

Ndryshimet e destinacionit të zonës sportive:

55. Referuar ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", neni 62, është përcaktuar se, KRRT-të e rretheve, të bashkive të qyteteve të kategorisë së parë, të Bashkisë së Tiranës dhe KRRTRSH, nuk kanë të drejtë të miratojnë asnjë ndërtim të përhershëm ose provizor, jashtë funksionit të territorit të përcaktuar në studimet e miratuara në territore pronë publike të tilla si...*territore sportive...*të përcaktuara dhe interpretuara në Rregulloren e Urbanistikës. Ndërtimet që mund të bëhen janë vetëm ato të përcaktuara në studimin urbanistik në përputhje të plotë me funksionin e miratuar.

Për rastet e pronave të kthyera nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish pronarëve, kur këto prona gjenden në territore të tilla, KRRT-të e të gjitha niveleve nuk kanë të drejtë të ndryshojnë destinacionin e përcaktuar në studimin e miratuar. Në këto raste pronarët e tokave kanë të drejtë të kërkojnë kompensim sipas ligjeve në fuqi.

Më dt 11.10.2023 është pyetur shtetësja **Ariela Kushi**, e cila ka qenë e punësuar pranë Bashkisë Tiranë në pozicionin e Drejtores së Njësisë së Planit Rregullues. Ajo ka sqaruar se, *plani i përgjithshëm rregullues për qytetin e Tiranës ishte ende ai i vjetri për të cilin ndërkohë merreshin masa për rishikim. Gjatë këtij procesi kur ende nuk kishte përfunduar rishikimi dhe miratimi i planit të ri, ndodhte që të vinin këto kërkesa. Bashkia jepte mendimin, por fjala e fundit dhe vendimi hynte në fuqi vetëm pasi miratohej nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.*

Më dt 22.11.2023 shtetasi **Arben Biçoku**, anëtar i Këhsillit Bashkiak dhe i KRRT Bahskia Tiranë, ka deklaruar se *duke qenë se plani i bërë në kohën e sistemit socialist dhe kushteve ekonomike shoqërore nga ajo kohë në Shqipëri kishin ndryshuar shumë, në mungesë të një*

plani rregullues të plotë mbi Tiranën, shpesh herë dilte e nevojshme të bëheshin ndryshime pjesore.

56. Pikërisht në këtë periudhë, shtetasi Xhimi Begeja, mundohet të shtrijë pronësinë e tij. Me tre kontrata dhurimi të datës **17.03.2006** (nr 2306 rep nr 428 kol; nr 2307 rep nr 429 kol dhe nr 2308 rep nr 430 kol) të lidhura para noterës Ruko Sako, rezulton se shtetasit Graciela Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin, të përfaqësuara me prokurën datë 06.04.2002 nga Ksnathipi Begeja dhe Skënder Begeja, i kanë dhuruar shtetasit Xhimi Begeja, pjesët e tyre gjithsej 210/4200, në pronën SL2 me sip 6345 m², me nr. 3/139 ZK 8220; në pronën me nr. pas. 3/140 dhe në pronën SL1 me sip 3120 m², pasuria me nr. 3/138 ZK 8220 vol 15 faqa 55.

Shtetasi Xhimi Begeja, rezulton nga aktet e administruara se, ka regjistruar më datë 01.03.2002 shoqërinë Begeja 1900 me NIPT K31421105R duke e rithemeluar në vijim më datë 02.02.2006. Si adresë emaili të deklaruar ka xhimibegeja@yahoo.com dhe si seli ka rrugën "Gjergj Fishta", kulla 8, Tiranë. Në sistemin informatik tatimor C@ts rezulton datë regjistrimi 21.02.2003 dhe datë krijimi 01.03.2002.

56.1. Gjithashtu në këtë periudhë, shtetasi Xhimi Begeja, ka regjistruar më datë 02.06.2006 edhe një subjekt tjetër e konkretisht subjektin Begeja 1900 H.T.P. me NIPT K69215305M. Ortak i vetëm themelues dhe administrator shfaqet vetë shtetasi Xhimi Begeja dhe selia shfaqet në Pukë, Hotel Turizmi Pukë. Sipas kontratës së shitblerjes me nr 1967 rep nr 332 kol datë **06.03.2006** para noterës Ruko Sako, shoqëria Begeja 1900 sh.p.k. e përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Xhimi Begeja, ka blerë pasurinë e paluajtshme truall me sipërfaqe 1500 m², ndodhur në qytetin e Pukës "Hotel Tërbuni", me nr pas 1193 ZK 3069 vol 4 faqa 15 dhe godina që ndodhet në këtë pasuri, nga shtetasi Martin Pemoj. **Çmimi total është 200 000 euro**, shumë e cila në kontratë parashikohet se është likujduar totalisht nga përfaqësuesi i shoqërisë blerëse.

57. Nga ana tjetër, vazhdon angazhimi i shtetasit Jamarbër Malltezi duke marrë tagre përfaqësimi nga familjarë të tjerë.

Kështu rezulton se me anë të prokurës së posaçme Nr.2165 rep, nr. 248 kol, datë **03.05.2006** shtetasi **Jamarbër Malltezi** caktohet përfaqësues ligjor i shtetasve **Lumturi Çela, Sejdie Kurti, Mirban Kadiu, Teuta Malka, Bashkim Kadiu, Nerime Piro.**

" – Emërojnë si përfaqësues të tyre të përgjithshëm z. Jamarbër Malltezi, lindur më 09.11.1972, titullar i dokumentit nr 372 674557 dhe regjistri nr 2-62 me qëllim që në emër dhe për llogari të tyre të kryejë sa më poshtë vijon:

- Të paraqitet pranë çdo institucioni shtetëror apo shoqëri private, pranë çdo personi fizik apo juridik, pranë Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, çdo zyre noteriale, të marrë apo depozitohet çdo lloj dokumenti, kontratë, kontratë shkëmbimi etj pa përjashtuar të drejtën për të tërhequr pranë çdo zyre çdo dokumentacion të nevojshëm për pronat që rezultojnë në emër të porositësit dhe personave që ai përfaqëson, kudo që të ndodhen ato;
- të paraqitet pranë Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si dhe pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të kërkuar kthimin dhe në pamundësi kompensimin për pronat e porositësit dhe personave që ai përfaqëson, duke nënshkruar çdo dokument si dhe duke kryer të gjitha pagesat e nevojshme
- Të negociojë me firma ndërtuese për të ndërtuar në pronat në emër të të përfaqësuarëve duke përcaktuar përqindjen e ndërtimit që do përfitohet nga këta të fundit, të nënshkruajë kontratën me anë të së cilës do të verë në dispozicion të firmës

ndërtuese sipërfaqen e truallit në pronësi të të përfaqësuarëve. **Tagrat e dhënë përfaqësuesit nuk përfshijnë nënshkrimin e kontratave të shkëmbimit të truallit ku do të përcaktohet saktësisht pjesa që do t' i përkaëse personave të përfaqësuar nga vetë këta të fundit**

- Përfaqësuesi ka gjithashtu të drejtën për t'u paraqitur në **gjykatë duke përfshirë të gjitha shkallët e gjyqësorit apo edhe Gjykatën Kushtetuese**, për çdo gjykim eventual që mund të duhet të zhvillohet në lidhje me pronat e porositësit dhe ku këta të fundit mund të jenë si në cilësinë e paditësve ashtu në atë të paditurve, si palë e interesuar etj. Përfaqësuesi mund të përpiloje, nënshkruajë kërkesë padi, kërkesë ankimore etj, të kërkojë gjithashtu ekzekutimin e vendimeve pranë Zyrës së Përmbarimit. Për përmbushjen e objektit të kësaj prokure, përfaqësuesi i emëruar, ka të drejtën të emërojë nga ana e tij një avokat, duke i dhënë të gjitha të drejtat që ai vetë gëzon me anën e kësaj prokure
- Nga tagrat e dhëna përfaqësuesit **përfshihet kategorikisht e drejta për të tjerësuar pronat që rezultojnë në pronësi të porositësit dhe personave që ai përfaqëson**
- Shpërblimi i përfaqësuesit për të cilin personat e përfaqësuar kanë rënë dakord, do të jetë një kapital prej **3 – 5 % të pasurisë së paluajtshme për krijimin e një fondi rezervë për përbalimin e shpenzimeve të emergjencës dhe të paparashikuara. Në rast të revokimit të kësaj prokure nga prosi tësi të gjithë së bashku ose çdo njëri prej tyre, atëherë përfaqësuesit do t'i njihen të gjitha shpenzimet e bëra nga ky i fundit deri në momentin e revokimit. Shuma e vënë në dispozicion e cilësuar më lart, është lejuar nga personat që përfaqësuar që të përdoret nga përfaqësuesi Jamarbër Malltezi.**
- Përfaqësuesi së fundmi ka të drejtën që të kontaktojë me çdo studio projektimi & ndërtimi ër truallin në pronësi të porositësit dhe petrosnave që ai përfaqëson, pranë ish Ekspoiztës Shqipëria Sot..."

57.1. Me anë të prokurës së posaçme me nr. 4209 rep nr. 742 kol **datë 09.05.2006**, edhe shtetasi **Xhimi Begeja**, ka emëruar si përfaqësues të përgjithshëm shtetasin **Jamarbër Malltezi** ku ndërmjet të tjerave edhe për veprime në **Komitetin Shtetëror të Pronave dhe në Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave...**, të lidhet me firma ndërtuese etj. Për arritjen e këtij qëllimi, të gjithë përfaqësuesit në këtë prokurë, **deklarojnë se vënë në dispozicion të përfaqësuesit të tyre një kapital që fillon 3 – 5 % të pasurisë së tyre të paluajtshme për krijimin e një fondi rezervë për përbalimin e shpenzimeve emergjente dhe të paparashikuara.**

Megjithatë shtetasi Xhimi Begeja, siç evidentohet në vijim, ka vijuar të mbajë një rol mjaft aktiv bashkë me shtetasin Jamarbër Malltezin në proceset e kthimit të pronës dhe privatizimit.

58. Në këtë periudhë konstatohet se në Këshillin Teknik, Bashkia Tiranë, fillojnë diskutimet për ndryshimin e destinacionit të zonës sportive në vendin e quajtur Rruga "Frosina Plaku" nga zonë sportive në zonë banimi.

Nga aktet e administruara, rezulton se anëtarë të Këshillit Teknik, ndër të tjerë, janë edhe shtetasit **Kozeta Gëdeshi** dhe **Met Kruja**.

58.1. Shtetësja **Kozeta Gëdeshi** si edhe u theksua më sipër, rezulton se ka njohje me shtetasin **Fatmir Bektashi**, të paktën për shkak të funksionit, pasi si drejtoreshë e urbanistikës ka nënshkruar më parë aktin e piketimit në lidhje me ndërtimin që ka bërë shoqëria Kontakt sh.p.k. në rrugën Dëshmorët e 4 Shkurtit. Por gjithashtu, kjo shtetase, rezulton se ble objekt, pikërisht në ndërtimet që marrin jetë fillimisht nga ky ndryshim destinacioni, pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k. Kështu, me kontratën e porosisë nr. 2886 rep nr. 1482 kol datë **01.11.2011** të lidhur

ndërmjet shoqërisë "Homeplan" sh.p.k. që paraqitet si investitore e ndërtimit që kryhet pikërisht mbi territorin që i ndërrohet destinacioni, konkretisht në kompleksin Homeplan me 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë, në adresën Rruga Frosina Plaku, porosit bashkë me shtetasin Leka Gëdeshi, apartamentin me nr. 741 me sip 91.6 m², Homeplan 7. Në nenin 13 është përcaktuar çmimi i porosisë/shitjes në vlerën totale prej **66 868 euro** i cili do të paguhet në këtë mënyrë: Euro 60 000 do të paguhet deri në datë 20.11.2011; Euro 3 000 do të paguhet deri në datë 30.12.2011; Euro 3 868 do të paguhet me dorëzimin e hipotekës. Porositësi duhet të kryejë pagesën në llogaritë bankare të përcaktuara nga sipërmarrësi në rast të kundërt merr përsipër shpenzimet për transferrtën e kryer. ...Në vijim, me kontratën nr 2416 rep nr 1393 kol datë 05.11.2012, para noteres Laura Pustina, rezulton të ketë blerë pasurinë ap nr 19 nr 3/201+7-19 ZK 8220 me sip 79.4 m² rruga Frosina Plaku, kati i katërt, godinë 9 katëshe, shk. 7, Tiranë kundrejt çmimit 66 868 euro i cili deklarohet se është paguar totalisht para lidhjes së kësaj kontrate. Bashkalidhur është faturë tatimore shitje nr 129 datë 05.11.2012 në vlerën 66 868 euro ose 9 344 803 lekë por e panënskruar nga asnjë.

E pyetur më dt **18.07.2024**, shtetësja Kozeta Gëdeshi, ka deklaruar se, *djali i saj Andi jeton në një apartament të blerë nga ajo dhe bashkëshorti i saj, në kompleksin Homeplan, apartament i blerë në vitin 2012 për vlerën 70 000 euro. Burimi i financimit ka qenë nga kursimet e saj dhe të bashkëshortit të saj, ndër vite. Ajo vetë ka punuar nga viti 2000 deri në vitin 2011 pranë Bashkisë së Tiranës kurse bashkëshorti i saj prej vitit 1990 ka punuar si pedagog në Fakultetin e Shkencave Pyjore. Referuar këtyre deklarameteve konstatohet se krijohet dyshimi mbi burimin e vërtetë të pasurisë së shtetasës Kozeta, pasi aktualisht banon në rrugën Myslym Shyri dhe banesa është në emër të saj dhe të bashkëshortit. Në vitin 2005 ka blerë një apartament me sip 40 m² në ish fushën e aviacionit në vlerën 25 000 euro; në vitin 2008 ose 2009 kanë blerë shtëpi plazhi në Orikum me sip 56 m² me vlerë 25 000 euro dhe më pas kanë blerë në vitin 2012 pasurinë e sipërcituar. Ajo deklaron se megjithëse nuk ka qenë e punësuar në sektorin privat, ka pasur raste që ka bërë punë private si vlerësime, kolaudime objektsh.*

Në deklarinimin e dt 18.07.2024, pretendon se shtetasin Fatmir Bektashi e ka njohur kur ka blerë shtëpi. Pagesat për apartamentin tek Homeplan pretendon se janë bërë me transfertë bankare, në nr e llogarisë së kompanisë. Nuk pranon të ketë dhënë lekë cash. Pagesat me bankë pretendon se i ka paguar me një dorë që kohën që pallati ka qenë në gropë dhe më vonë kanë paguar edhe hipotekën. Deklaron se nuk ka dorëzuar ndonjëherë shumë mbi 20 000 euro tek noterja Laura Pustina ose tek shoqëritë Homeplan apo Kontakt sh.p.k. Por në vijim, më datë 22.07.2024 kjo shtetase depoziton mandat arkëitimi 11.04.2011 të Bankës së Tiranës ku rezulton se vetë kjo shtetase ka bërë pagesë 11 300 euro; më datë 17.04.2011 stetasi Leka Gëdeshi ka bërë pagesë 9 000 euro pranë Banka Tirana; më datë 17.11.2011 Leka Gëdeshi ka paguar 9 000 euro pranë Intesa San Paolo Bank. Gjithashtu rezulton se më datë 18.10.2012 Leka gëdeshi ka paguar me mandat arkëitimi shumë prej 3 868 euro; më datë 11.11.2011 po ky shtetas ka paguar shumë prej 30 000 euro dhe më datë 16.11.2011 ka paguar shumë prej 6 033 euro. Më datë 22.07.2024 kjo shtetase ka pretenduar se burimi i financimit janë kursimet e saj dhe të bashkëshortit, punë private që ka kryer gjatë viteve 199 – 2011, pasi bashkëshorti i saj ka bërë projekte teknologjike dhe kanë siguruar të ardhur.

Në deklarinimin e dt 18.07.2024, pretendon se, nuk është angazhuar ndonjëherë me ndonjë projekt apo kërkesë për territorin ku shtirhej ish klubi Partizani. E njohur me proces verbaet e Këshillit Teknik të datës 12.05.2006 dhe 13.05.2006 kjo shtetase më datë 22.07.2024 ka pretenduar se ka qenë në rolin e anëtares si drejtor i urbanistikës ligjore dhe kjo drejtori nuk merrej me studimin apo planifikimet urbane.

58.2. Shtetasi **Met (Muhamet) Kruja** rezulton të identifikohet në liçencën e shoqërisë Kontakt sh.p.k. me nr 3224/1 si drejtues teknik i kësaj shoqërie së bashku me shtetasit Etleva Verzivolli dhe Kozma Heqimi. I pyetur më datë 25.04.2024 në lidhje me këtë fakt, ky shtetas ka deklaruar se, *ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë që në vitin 1998 deri sa ka dalë në pension në vitin 2019. Në vitin 2005, mesa kujton ka qenë në pozicionin e drejtorit të projekteve të Infrastrukturës, drejtori e cila ishte pjesë e Drejtorisë së Urbanistikës e cila në varësi kishte edhe drejtorinë e lejeve të ndërtimit, drejtorinë e projekteve etj dhe e ka mbajtur këtë pozicion për gati 10 vite. Ky shtetas pretendon se nuk ka punuar për subjekte private, pasi nuk lejohej dhe përbënte konflikt interesi pavarësisht se ai kishte licencën e projektimit. Në lidhje me shtetasin Fatmir Bektashi deklaroi se e njeh që prej vitit 2002 prej shtetasit Avenir Kika pasi sipas tij Fatmiri ka qenë ortak me shtetasin Avenir në firmën e ndërtimit Kika dhe kanë bërë bashkë disa ndërtime tek rruga Komuna e Parisit. Prteendon se nuk ka pasur ndonjëherë marrëdhënie me të. Pretendon se nuk ka punuar ndonjëherë për shoqërinë Kontakt. Pasi sheh licencën dhe pranon emrin e tij, garanton se nuk ka firmosur asnjë dokument si drejtues teknik i kësaj shoqërie dhe sqaron se në vitin 2000 i ka dhënë licencën e tij shtetasit Avenir Kika i cili pasi e ka dorëzuar dokumentacionin në Ministrinë e Ndërtimit, kjo e fundit i është përgjigjur se nuk mund ta ushtronte këtë detyrë për shkak të konfliktit të interesit, meqë Muhameti punonte në Bashki.*

Më dt 17.07.2024 është pyetur edhe shtetësja **Etleva Verzivolli**, e cila ka deklaruar se, *rreth viteve 2000-2002, nuk e mban mend, në Komunën e Parisit është ndërtuar një pallat në formë "L", ku ndërtues ka qenë firma Kontakt me pronar Fatmir Bektashi dhe bashkëpronar Lulzëim dhe Avenir Kika. E cila ka qenë një firmë e përbashkët dhe në këtë kohë mund të ketë patur licencën e saj por ajo pretendon se nuk ka punuar ndonjëherë për kompaninë Kontakt sh.p.k. ku të ketë përfutur pagesa. Shtetasin Met Kruja deklaroi se e njeh, di që ka punuar tek Bashkia e Tiranës dhe është konsultuar ndonjëherë me të por bashkëpunim privat me të pretendon se nuk ka pasur.*

Më dt 17.07.2024 është pyetur edhe shtetasi **Kozma Heqimi**, i cili ka deklaruar se, *në vitin 2001 ka punuar tek kompania Kontakt sh.p.k. ku pronarë kanë qenë Fatmir Bektashi, Avenir dhe Lulzëim Kika. Prteendon se nuk e mban mend mirë si ka punuar në këtë kompani, sepse u krijua kompania Kika sh.p.k. dhe pronarët Avni dhe Lulzëim Kika u ndanë nga Fatmiri dhe Kontakti. Në vitin 2010 kujton se ka punuar tek kompania Kontakt sh.p.k. me pronar Fatmir Bektashin për 6 muaj, si inxhinier kantieri tek ish Klubi Partizani dhe është larguar me dëshirën e tij. Shtetasin Met Kruja deklaroi se e njeh si emër, pasi ka dëgjuar se punonte në Bashkinë Tiranë, por nuk ka lidhje me të dhe nuk ka punuar ndonjëherë me të. Pretendon se nuk e ka parë shtetasin Met Kruja ndonjëherë tek kompania Kontakt sh.p.k.*

59. Nga aktet rezulton se, ndryshimi i destinacionit nga zonë sportive në zonë banimi, pikërisht në territorin e familjes Begeja, diskutohet në dy mbledhje të Këshillit Teknik, e konkretisht ato të datës 12.05.2006 dhe 13.05.2006.

Në proces verbalin e datës **12.05.2006 Këshilli Teknik me nr. 36** i përbërë nga: Dritan Agolli, Altin Gagani, Majlinda Dhuka, Enkeleda Bonati, Ariela Kushi, Rezarta Ismailaja, Kozeta Gëdeshi, Gjergj Papavasili, **Met Kruja**, J. Qinami dhe Natasha Lilaj, është pasqyruar në objektin 11: *Kërkesë për ndryshim destinacioni për disa zona të qytetit të Tiranës sipas hartës bashkëlidhur:*

...f) (korrigjuar nga g) Pista e aeroportit të vjetër nga zonë e veçantë në zonë të gjelbër

...i (e korrigjuar nga j) i) Rr. Frosina Plaku dhe rruga e planit rregullues nga zonë sportive në zonë banimi...

Mendimi i Këshillit Teknik:

Këshilli Teknik miraton në parim kërkesat a, c, b, d, e, f, (e fshirë me bojë të bardhë gërma g) për ndryshim destinacioni ndërsa për kërkesat g, h, i, j, k, l, m o, p, q, është i mendimit që këto ndryshime të jenë subjekte të planit rregullues të qytetit të Tiranës.

- Te merret mendimi nga ARM dh M.Ekonomisë.

Në proces verbalin e Këshillit teknik nr. 37 datë 13.05.2006 me pjesmarrës: Altin Gagani, Ariela Kushi, Enkeleda Bonati, J. Qinami, Kozeta Gëdeshi, Natasha Lilaj, Rezarta Ismailaja, Met Kruja, Gjergj Papavasili, Majlinda Dhuka...Në objektin 9 është përshkruar:

Gjergji "Kërkesë për ndryshim destinacioni për disa zona të qytetit të Tiranës "

"g" Pista e aeroportit të vjetër.

Majlinda: Duhet të merret mendimi nga struktura të specializuara. Min Transp, Mbrojtjes, K.Komb. i mbrojtj etj. të cilat administrojnë zonë me karakter të tillë. ..

"j" Rr. Frosina Plaku dhe Rruga P/rregullues nga zonë sportive në zonë banimi.

Ok.

60. Pesë ditë pasi Këshilli Teknik i Bashkisë Tiranë, jep miratimin e mësipërm, rezulton se shtetasi Jamarbër Malltezi vijon të pajiset me akte përfaqësimi edhe nga trashëgimtarë të tjerë të familjes Begeja, siç janë shtetasit Kadiu. Kështu rezulton se me prokurën e përgjithshme nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006 edhe shtetasi Ilir Kadiu emëron si përfaqësues të tij dhe të personave që ai përfaqëson (Vangjelia Kadiu dhe Manjola Kadiu) shtetasin Jamarbër Malltezin.

" – Emëron si përfaqësues të tij dhe të personave që ai përfaqëson z. Jamarbër Malltezi, lindur më 09.11.1972, titullar i dokumentit nr 372 674557 dhe regjistri nr 2-62 me qëllim që në emër dhe për llogari të tyre të kryejë sa më poshtë vijon:

- Të paraqitet pranë çdo institucioni shtetëror apo shoqëri private, pranë çdo personi fizik apo juridik, pranë Zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, çdo zyre noteriale, të marrë apo depozitohë çdo lloj dokumenti, kontratë, kontratë shkëmbimi etj pa përjashtuar të drejtën për të tërhequr pranë çdo zyre çdo dokumentacion të nevojshëm për pronat që rezultojnë në emër të prorisitësit dhe perosnave që ai përfaqëson, kudo që të dnodhen ato;
- të paraqitet pranë Komitetit Shetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si dhe pranë Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të kërkuar kthimin dhe në pamundësi kompensimin për pronat e porositësit dhe perosnave që ai përfaqësson, duke nënshkruar çdo dokument si dhe duke kryer të gjitha pagesat e nevojshme
- Përfaqësuesi ka gjithashtu të drejtën për t'u paraqitur në gjykatë duke përfshirë të gjitha shkallët e gjyqësorit apo edhe Gjykatën Kushtetuese, për çdo gjykim eventual që mund të duhet të zhvillohet në lidhje me prnat e prosositësit dhe ku këta të fundit mund të jenë si në cilësinë e paditësve ahstu në atë të paditurve, si palë e interesuar etj. Përfaqësuesi mund të pëpriluje, nënshkruajë kërkesë padi, kërkesë ankimore etj, të këkrojë gjithahstu ekzcutimin e vendimeve pranë Zyrës së Përmbarrimit. Për përmbushjen e objektit të kësaj prokure, përfaqësuesi i emëruar ka të drjetën të emërojë nga ana e tij një avokat, duke i dhënë të gjitha të drjetat që ai vetë gëzon me anën e kësaj prokure
- Nga tagrat e dhëna përfaqësuesit përjashtohet kategorikisht e drjeta për të tjerësuar pronat që rezultojnë në pronësi të porositësit dhe perosnave që ai përfaqëson
- Shpërblimi i përfaqësuesit për të cilin personat e përfaqësuar kanë rënë dakord, do të jetë një kapital prej 3 – 5 % të pasurisë së paluajtshme për krijimin e një fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve të emergjencës dhe të paparashikuara. Në rast të revokimit të kësaj prokure nga prorisësi të gjithë së bashku ose çdo njëri prej tyre,

atëherë përfaqësuesit do t'i njihen të gjitha shpenzimet e bëra nga ky i fundit deri në momentin e revokimit. Shuma e vënë në dispozicion e cilësiuar më lart, është lejuar nga personat që përfaqësojnë që të përdoret nga përfaqësuesi Jamarbër Malltezi.

- *Përfaqësuesi së fundmi ka të drejtën që të kontaktojë me çdo studio projektimi & ndërtimi të truallin në pronësi të porositësit dhe personave që ai përfaqëson, pranë ish Ekspozitës Shqipëria Sot. Në lidhje me këtë pronë përfaqësuesi ka të drejtë:*
- *Të negociojë me firma ndërtuese për të ndërtuar në të, duke përcaktuar përqindjen e ndërtimit që do të përfitohet nga këta të fundit, të nënshkruajë kontratën me anë të së cilës do të verë në dispozicion të firmës ndërtuese sipërfaqen e truallit në pronësi të tyre. Tagrat e dhëna përfaqësuesit nuk përfshijnë nënshkrimin e kontratës së shkëmbimit të truallit ku do të përcaktohet saktësisht pjesa që do t'i përkasë porositësit dhe personave që ai përfaqëson nga vetë këta të fundit..."*

60.1. Shtetasi *Ilir Kadiu* i pyetur më datë 20.09.2022, ka deklaruar në lidhje me parashikimet në prokurën e përgjithshme me nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006, se... *Ne nuk i kemi dhënë para përfaqësuesit Jamarbër Malltezi dhe madje në dijeninë time as ndonjë pasuri të paluajtshme si shpërblim.*

I pyetur përse që nga viti 1997, nuk kishin kërkuar kthimin e pronës, parashtrojnë se ...*Unë nuk jam marrë kurrë me këto prona. E kam marrë vesh pas vdekjes së babait në 2003. Më thanë disa kushërinj nga Tirana që kemi pronë në Tiranë. Mua më kanë thënë hallat dhe xhajat e mi që të bëja prokurë e të caktoja përfaqësues Jamarbër Malltezin.*

60.2. Shtetasi *Ilir Kadiu*, është një person i rëndësishëm në ndodhjen e ngjarjeve, pasi siç do të pasqyrohet në vijim, ai punësohet pranë Departamentit Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave dhe në kuadrin e kësaj detyre, ngarkohet për kryerjen e një kontrolli në Komandën Mbështetëse, që ka të bëjë pikërisht me pronat e familjeve të sipërcituara, ku edhe vetë është trashëgimtar.

61. Shtetasi *Jamarbër Malltezi*, në respektim të tagreve të dhëna deri më tani, shfaqet në marrëdhënie me shoqërinë *Kontakt sh.p.k.*, duke lidhur një kontratë sipërmarrje. Kështu rezulton se më datë **22.05.2006**, nënshkruhet Kontrata e Sipërmarrjes me nr 4938 Rep / 831 Kol, para noterës *Ruko Sako*, ku nga njëra anë paraqitet shtetasi **Jamarbër Malltezi** si përfaqësues i trashëgimtarëve *Begeja* e konkretisht: **Pala pronare:** 1- *Haki Begeja, Nimete Bektashi, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirije Lika, Myzejen ago, Sanije Velo, Ajete Sulstarova, Gezim Begeja, Haxhire Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Sulejman Cela, Sejdiqe Sulejman Kurti, Meriban Sulejman Kadiu, Bashkim Sulejman Kadiu, Teuta Malka Elona Begeja, Xhimi Begeja, të gjithë të përfaqësuar me prokurë nga Jamarbër Malltezi*; 2- *Ilir Kadiu i cili gjithashtu përfaqësohet me prokurë nga Jamarbër Malltezi*

Dhe nga ana tjetër paraqitet si **palë sipërmarrëse:** *shoqëria Kontakt shpk me NIPT J92108006V, me administrator dhe ortak të vetëm Fatmir Bektashi.*

Sipas n 1, objekti i kontratës së sipërmarrjes është kthimi i destinacionit të tokës nga zonë sportive në zonë për ndërtim banesa, privatizimi i objekteve ekzistuese dhe bashkëpunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional me emër kompleksi Paschal.

Sipas n 4, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse truallin me sip të përgjithshme prej 6345 m² dhe disa magazina një katëshe mbi të.

...Pala pronare është në dijëni të faktit se prona është e njohur dhe e kthyer por me destinacion për ambiente sportive, prandaj ajo dëshiron që në bazë të legjislacionit "Për Urbanistikën" të ndërtojë banesa mbi tokën truall, pronë e saj.

Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të ndërtimit të destinacionit të zonës, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse truallin objekt i kësaj kontrate.

Pala sipërmarrëse pranon të marrë truallin të vënë në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë të gjitha shpenzimet e nevojshme për procesin e kthimit të destinacionit të zonës mbi të cilin ndodhet trualli dhe e përfundon këtë proces në një afat kohor jo më shumë se 3 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje.

Sipas nenit 5, pala pronare bie dakord për bashkëpunimin duke vënë në dispozicion të palës sipërmarrëse shoqësi ndërtimit Kontakt sh.p.k. truallin e kthyer...Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në truallin e vënë në dispozicion si më sipër nga pala pronare kompleksin shumëfunktional me parkime, dyqane, dhe apartamente, në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës. Leja e ndërtimit do të merret 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje.

Në nenin 6 përcaktohet se, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse një kompensim prej 22% të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit të ri për secilin komponent dhe se sipërfaqet e pjesës takuese të pronarëve do të përcaktohen në një SHTOJCE të kësaj Kontrate Sipërmarrje pas përfundimit të projektit të arkitekturës dhe para fillimit të punimeve.

Në nenin 7 përcaktohen të drejtat dhe detyrime e Palës Sipërmarrëse si më poshtë:

- a. *Pala Sipërmarrëse në bazë të Kontratës Sipërmarrje, plotëson dokumentacionin e nevojshëm për realizuar:*
 - 1- *Kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilën ndodhet trualli nga zonë sportive në banim*
 - 2- *Marrjen e Lejes së Sheshit të Ndërtimit dhe*
 - 3- *Lejes së ndërtimit*
- b. *Pala Sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo Kontratë Sipërmarrje.*
- c. *Karakteristikat Teknike të objekteve*

Pala sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje.

Sipas nenit 9 sipërmarrja për ndërtimin e kompleksit të sipërpërmendur fillon brenda tre muajve nga zbardhja e lejes së ndërtimit dhe do të përfundojë brenda 24 muajve nga kjo datë. Palët marrin parasysht shtyrjen e afatit në rastet e forcave madhore sipas përcaktimeve në ligj.

Sipas nenit 9 gërma 'd' sipërfaqja e përcaktuar në kontratën përfundimtare si çmim trualli në nenin 6 të kësaj kontrate sipërmarrje 25% hipotekohet si pronë e palës pronare nëpërmjet kontratës së shkëmbimit, me vlerën e kostos së ndërtimit.

Spas gërmave "e" dhe "f" të nenit 9 shpenzimet e regjistrimit të pjesës takuese të palës pronare në ZRPP i merr përsipër pala sipërmarrëse. Në rast se pala sipërmarrëse nuk do t'i dorëzojë palës pronare, pjesën e saj në afatin e përcaktuar, atëherë është e detyruar t'i paguajë palës

pronare 300 euro për çdo muaj vonesë për secilin apartament dhe për dyqanet 10 euro për m² për çdo muaj vonesë. Nga ky nen përjashtohen rastet e vonesave si rezultat i forcave madhore.

Sipas vërtetimit nga dokumentat hipotekorë bashkalidhur kësaj kontrate, rezultojnë se:

- me vërtetimin nga dokumentet hipotekor datë lëshimi 06.04.2006 në regjistrin hipotekor me nr. 34 datë 04.04.2006 figuron e regjistruar pasuria me nr. **3/138 ZK 8220 me sip 3120 m²** (kjo pronë është kthyer me vendimin nr. 135 të vitit 2006 të KKKP).
- me vërtetimin nga dokumentet hipotekor datë lëshimi 06.04.2006 rezultojnë se në regjistrin hipotekor me nr. 35 datë 04.04.2006 figuron e regjistruar pasuria me nr. **3/139 ZK 8220 me sip 6345 m²** (sipas shkresës nr. 41 prot datë 09.01.2007 të ZRPP përfshirë në dosjen e kthimit të pronës në bazë të kërkesës së datës 20.12.2006 të shtetasit **Bashkim Bektashi**, kjo pronë është kthyer me vendimin nr. 135 të vitit 2006 të KKKP).

61.1. Pra, siç qartësisht duket në këtë kontratë, **merret përsipër ndryshimi i destinacionit brenda tre muajve.**

Nga ana tjetër, referuar prokurave që trashëgimtarët Begeja kishin lëshuar për shtetasin Jamarbër Malltezin, rezultojnë se ky i fundit nuk dokumentohet se çfarë shpenzimi ka kryer deri më tani apo çfarë shpenzimi kryen në vijim, nuk dokumentohet të ketë përfaqësuar deri në këtë moment, personat që i kanë dhënë tagrin pranë Komisionit të Kthimit të Pronave apo pranë ndonjë institucioni tjetër, por ka lidhur vetëm këtë kontratë sipërmarrje, deri në këtë moment, e cila në thelb, mbart një premtim shumë të rëndësishëm për palën pronare, nga ana e të cilës kërkon të qëndrojë shtetasi Jamarbër Malltezi.

Marrëveshja e mësipërme, nuk sillte detyrim për shtetasin Fatmir Bektashi apo shoqërinë Kontakt sh.p.k. për ndryshimin e destinacionit, por sillte detyrim për vetë shtetasin Jamarbër Malltezi, një premtim i dokumentuar për t'ia treguar të përfaqësuarëve prej tij, dhe për t'i bindur që ai kishte pushtetin e mjaftueshëm për të kryer ato që premtonte.

62. Këshilli Teknik si më sipër, jepte mendim, por vendimmarrja i përkiste KRRT së Bashkisë Tiranë për të shkuar në vijim drejt vendimmarrjes përfundimtare, KRRTSH-së e cila drejtohet nga kryeministri i asaj kohe, vetë vjehri i shtetasit Jamarbër Malltezi, shtetasi Sali Berisha.

63. KRRT e Bashkisë Tiranë, pavarësisht se nga kush drejtohej kjo e fundit, në fakt kishte në përbërje, shtetas të cilët kishin varësi nga pushteti qendror që udhëhiqej pikërisht nga shtetasi Sali Berisha. Kështu vetë Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr 29 dt 21.12.2006, arsyetoi se: *"...Neni 19 i ligjit nr. 8405, dt 17.09.1998 "Për Urbanistikën", që parashikon përbërjen e KRRT-së së Bashkisë, Tiranë me një shumicë të cilësuar nga përfaqësues të pushtetit qendror dhe me pakicën prej 1/3-ës të anëtarëve nga pushteti vendor, përbën një tjetër shkak, nga i cili ka lindur mosmarrëveshja e kompetencës ndërmjet dy pushteteve.... Duke iu referuar dispozitës ligjore përkatëse rezultojnë se shumica e cilësuar e anëtarëve të KRRT-së, nuk përfaqësojnë bashkinë. Ekzistenca e një rregullimi normues të tillë, që kërkon minimumin e 2/3-ve të anëtarëve për të konsideruar të vlefshme mbledhjen e KRRT-së, nuk i krijon mundësi autoritetit vendor të gëzojë instrumentet e nevojshme ligjore për ushtrimin normalisht të funksionit dhe të vendimmarrjes në fushën e planifikimit urban, duke e vendosur atë, në këtë mënyrë, nën vullnetin e pushtetit qendror. Për rrjedhojë, neni 19 i ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", bie ndesh me parimin e decentralizimit të pushtetit dhe të*

autonomisë vendore, parashikuar nga neni 13 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga Karta Europiane e Autonomisë Vendore”.

63.1. I pyetur më datë 22.11.2023 shtetasi **Arben Biçoku**, i cili ka qenë anëtar i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë deklaroi se, *deri në vitin 2007, ky këshill përbëhej nga 21 anëtarë ku 13 ishin anëtarë që kishin detyra qeveritare pra që kishin mazhorancën në qeveri kurse 8 anëtarë duke futur edhe kryetarin e Bashkisë, ishin nga organizmat që kishin mazhorancën në qeverisjen vendore.*

64. Në dy mbledhje të Këshillit të Rregullimit të Territorit, Bashkia Tiranë, është diskutuar ndryshimi i destinacionit si më sipër cituar, konkretisht në mbledhjet e datave 03.06.2006 dhe 08.06.2006. Nga pjesmarrësit në këtë mbledhje, sipas akteve të administruara, ka rezultuar se grupi i Partisë Demokratike, rezultoi të ketë pasur në krahun e vet, të paktën shtetasit Sokol Behaj, Adrian Myderizi, Marin Biçoku, Arben Qirjako (*shih vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, nr 21 datë 17.07.2009 mbi shkarkimin dhe emërimin e 3 anëtarëve të KRRT-së të Bashkisë Tiranë, ku pasqyrohen emrat e këtyre shtetasve si propozime të grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Këshillit Bashkiak*).

Në këto mbledhje, konstatohet se kanë marrë pjesë ndër të tjerë edhe shtetasi Marin Biçoku, i cili rezultoi të jetë drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit dhe bashkëpunëtor i ngushtë, si i familjes Malltezi ashtu edhe i familjes Berisha.

64.1. I pyetur më datë 22.11.2023 shtetasi **Marin Biçoku** ka deklaruar se: *“Nga viti 2000 deri në vitin 2005 kam punuar privatisht si arkitekt. Nga nëntori 2005 deri në qershor 2009 kam qenë drejtor pranë Drejtorisë së Politikave Planifikimit urban në Ministrinë e Punëve Publike dhe Infrastrukturës. Pas këtij viti, nga 01.09.2009 kam vijuar të ushtrij aktivitetin tim privat pranë studio MB Studio, si arkitekt ku jam ortak i vetëm dhe administrator. Gjithashtu dua të sqaroj se nga muaji nëntor 2005 deri në qershor 2009 kam qenë anëtar i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë. Periudhën 2005 – 2009 dua të sqaroj se ka qenë e ndarë në dy periudha ku periudha e parë të qënit anëtar vinte sipas parashikimeve ligjore ku drejtor i urbanistikës pranë Ministrisë përkatëse ishte automatikisht anëtar i KRRT-së Bashkia Tiranë dhe periudha e dytë, sipas përcaktimeve ligjore, isha i zgjedhur nga anëtarët e Këshillit Bashkiak si anëtar i KRRT-së Tiranë. ...*

64.1.1. Shtetasi Marin Biçoku, sipas shkresës nr. 1000/1 prot datë 06.02.2024 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, rezultoi se ka qenë punonjës i ish Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Planifikimit Urban në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Planifikimit për Punët Publike dhe Rregullimin e territorit për periudhën **14.11.2005 deri më 14.07.2009**.

Shtetasi **Jamarbër Malltezi**, gjithashtu ka qenë i atashuar në këtë ministri, pasi siç rezultoi nga aktet, ka mbajtur pozicionin e koordinatorit të projektit *“Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare”*. Konkretisht na janë përcjellë disa akte ku evidentohen të dhëna për shtetasin Jamarbër Malltezi si shkresë me nr 909 prot datë 18.12.2007 e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Njësia e Koordinimit të Projektit, Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare nënshkruar nga koordinatori Jamarbër Malltezi; shkresë nr. 6910 prot datë 13.09.2007 të Ministrisë së Punëve Publike i ndjeri Sokol Olldashi, e miratuar nga J.Malltezi, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me anë të cilës dërgohet për përkthim zyrtar Letër Marrëveshja e Grantit të Programit Global të Mjediit (GEF) TF 056176

për bashkëfinancimin e projektit “Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare” në shumën 950 000 \$ midis Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Ministrisë së Financave etj. Gjenden akte me nënshkrimin e shtetasit Malltezi **që në janar 2006**. Evidentohet nga dokumentacioni i përcjellë se, kostoja totale e projektit është 38.56 milionë USD dhe qeveria do të kontribuojë 5.71 milionë USD. Kreditimi aprovohet që më datë 29.06.2005 dhe PCU Coordinator është përcaktuar Jamarbër Malltezi kurse Eorld Bank Task Team Leader Rita Cestti.

I pyetur më datë 22.11.2023 shtetasi *Marin Biçoku* ka deklaruar se: *Nga viti 2000 deri në vitin 2005 kam punuar privatisht si arkitekt. Nga nëntori 2005 deri në qershor 2009 kam qenë drejtor pranë Drejtorisë së Politikave Planifikimit urban në Ministrinë e Punëve Publike dhe Infrastrukturës. Pas këtij viti, nga 01.09.2009 kam vijuar të ushtroj aktivitetin tim privat pranë studio MB Studio, si arkitekt ku jam ortak i vetëm dhe administrator. Gjithashtu dua të sqaroj se nga muaji nëntor 2005 deri në qershor 2009 kam qenë anëtar i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Bashkisë Tiranë. Periudhën 2005 – 2009 dua të sqaroj se ka qenë e ndarë në dy periudha ku periudha e parë të qenit anëtar vinte sipas parashikimeve ligjore ku drejtor i urbanistikës pranë Ministrisë përkatëse ishte automatikisht anëtar i KRRT-së Bashkia Tiranë dhe periudha e dytë, sipas përcaktimeve ligjore, isha i zgjedhur nga anëtarët e Këshillit Bashkiak si anëtar i KRRT-së Tiranë.*

64.1.2 Megjithatë, shtetasi Marin Biçoku², nuk rezulton të ketë vetëm këtë marrëdhënie, por ai shfaqet i angazhuar gjatë gjithë kohës me shtetasit Berisha dhe Malltezi. Konkretisht me shtetasen Liri Berisha, vërehet se angazhohet në ndërtimin e dy vilave në Farkë.

64.1.3. Ky shtetas identikohet në datë 21.04.2007 të ketë hyrje të përbashkët me shtetasin Jamarbër Malltezi, me linjën ajrore Austrian Airlines – OS 847/848 ku shtetasi Marin ka hyrë në orën 00.05 në aeroportin e Rinasit dhe Jamarbëri në orën 00.02.

Më datë 30.05.2008, respektivisht në orën 20.11 dhe 19.55, shtetasit Marin Biçoku, Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi, rezulton të kenë dalë nga territori i R.Shqipërisë me linjën ajrore Al Italia – AZ 506/511 Milano dhe janë kthyer më datë 31.05.2008 në orën 20.18 dhe 20.03.

Më datë 14.11.2010 shtetasi Marin rezulton të ketë dalë nga territori i R.Shqipërisë në orën 11.43 me linjën ajrore Lufthansa Mynih dhe në orën 11.40 ka dalë me të njëjtën linjë edhe shtetësja Liri Berisha. Të dy këta shtetas janë kthyer me të njëjtën linjë ajrore në datë 17.11.2010 në orën 11.55 dhe 11.53.

Më datë 10.01.2011 shtetasi Marin rezulton të ketë dalë nga territori i R.Shqipërisë në orën 10.54 me linjën ajrore Turkish Airlines – TK 1073/1074 Stamb dhe në orën 10.48 ka dalë me të njëjtën linjë edhe shtetësja Liri Berisha. Të dy këta shtetas janë kthyer me të njëjtën linjë ajrore në datë 13.01.2011 në orën 09.45 dhe 09.49.

Më datë 24.09.2012 shtetasi Marin rezulton të ketë dalë nga territori i R.Shqipërisë në orën 13.35 me linjën ajrore Lufthansa-Lufthansa Mynih dhe në orën 13.34 ka dalë me të njëjtën linjë edhe shtetësja Liri Berisha. Të dy këta shtetas janë kthyer me të njëjtën linjë ajrore në datë 28.09.2012 në orën 11.42 dhe 11.43.

² Në mbledhjen e KRRT 2 datë 17.04.2009 konstatohet se shtetasi Marin është shprehur: “Para se të diskutojmë desha të them se ne (pjesa që sipas ligjit përfaqëson krahun e djathtë, emëruar nga Këshilli Bashkiak) kemi ngritur disa probleme shqetësuese për praktikën urbane të qytetit...”

Më datë 22.11.2012 shtetasi Marin rezulton të ketë dalë nga territori i R.Shqipërisë në orën 05.39 me linjën ajrore Belle Air – Londra 555-556 dhe në orën 05.28 ka dalë me të njëjtën linjë edhe shtetësja Liri Berisha. Të dy këta shtetas janë kthyer me të njëjtën linjë ajrore në datë 24.11.2012 në orën 19.16 dhe 18.51.

64.1.4. Me shoqërinë Homeplan sh.p.k., e cila nuk kishte lindur ende në këtë periudhë, por e cila shtrin ndërtimet si investitore në territoret e ish klubeve Partizani, shtetasi Marin Biçoku, në vitin 2010³, lidh akt marrëveshje për përfitimim e një apartamenti të identifikuar me nr 254 me sip 75.02 dhe verandë 34.56 m2. Megjithëse çmimi i përgjithshëm i shitjes është përcaktuar se është **62 302 euro, nuk dokumentohet që ai ta ketë paguar atë.** Madje, përveç mospagimit të kësaj shume, edhe është shpërblyer me një shumë parash në vlerën **12 500 euro për kontributin e dhënë.**

Në një dokument të recuperuar nga Laptop-i i markës SONY, nr serial C3LN0ZA, i sekuestruar pranë Studio Pustina, nëpërmjet aktit të ekspertimit teknik - kompjuterik nr 149 datë 11.08.2023, evidentohet në formatin excel llogaritë e klientëve, të cilët kanë blerë apartamente në kompleksin Magnet. Për shtetasin Marin Biçoku është bërë shënimi: *“Apartamenti 254 + 12.000 euro i janë dhënë Z.Biçoku për të kompensuar kontributin që Z.Biçoku ka dhënë në favor të Homeplan shpk”* :

48	252	Haki Begeja	2	P	100326	130.33	0.0	0.0		
49	253	Roland Tarja	2	K			75.0	63,828.0	60,636.00	
50	254	Marin Biçoku	2	K	kontakt: Apartamenti 254 + 12,000 euro i janë dhene z. Bicoku per te kompensuar kontributin qe z. Bicoku ka dhene ne favor te Homeplan shpk			5.0	62,302.5	
51	251	Fatos Xhafa	2	K				0.0	76,388.9	72,550.00
52	262	Ajete Sulstarova	2	P				0.0	0.0	
53	263	A.Osmani (Kdering I.Shtufi)	2	F				5.0	64,482.8	42,982.00
54	264	Tatjana, Eris dhe Joni Gusho	2	K				0.0	57,315.0	54,000.00
55	271		1			187.12	990.0	185,248.8		

Shuma prej 12 000 euro konstatohet të jetë korrigjuar në vijim duke u bërë 12 500 euro. Në dokumentin e ekstraktuar nga hard drive-i i sekuestruar pranë studio Pustina me emërtimin ‘Raport shitjes_Homeplan_2014_JK44(1) në formatin excel konstatohet se tashmë shënimet për Marinin janë *“Apartamenti 254+12 500 euro që i janë dhënë z. Bicoku për të kompensuar kontributin që z. Bicoku ka dhënë në favor të Homeplan sh.p.k.”* Ky dokument i krijuar më datë 17.12.2010 rezulton të jetë ruajtur për herë të fundit më datë 01.11.2014.

³ Nga kërkimi në të dhënat e laptopit të markës HP, me product ID “Y7Z98EA#ABB” me barcode 40001650, i sekuestruar në datë 28.04.2023 në ambientet e shoqërisë “Studio Pustina”sh.p.k, me termin “Marin Biçoku” u gjend një akt-marrëveshje e vitit 2010 midis palëve: Homeplan shpk (Shoqëria), dhe Marin Biçoku i datëlindjes 01.05.1971 (Porositësi). Objekti i kësaj kontrate është sanksionimi dhe ekzekutimi i një marrëveshje ndërmjet Shoqërisë, e cila përmes këtij akti, angazhohet të ndërtojë dhe të shesë në favor të Porositësit Apartamentin nr 254 me sipërfaqe 75.02 m2 dhe verandë 34.56m2. Çmimi i përgjithshëm i apartamentit me nr 254 është **62,302 euro.**

KODI	Emër/Mbimemër	Gjendja	Përfuturosi	Data	SIP.TOT.(HIP)	Cmimi	Vlera Tot.	Të arkëtuara
				vvmddd	m ²	Euro/(m ²)	Euro	
DEPO								
APARTAMENT								
254	Marr Bico (Pale pronare)	2	K	kontakt: Apartamenti 254 + 12,500 euro i janë dhënë z. Bicoku për të kompensuar kontributin që z. Bicoku ka dhënë në favor të Homeplan shpk		0.0	0.0	-
352	Anton Punavijs	2	K			692.5	88,219.0	88,219.00

Me shkresën me Nr. 2326 Prot, dt 22.05.2013, me lëndë "Rakordimi Homeplan me Studjo Pustina" e dërguar nga administratori i subjektit Kontakt shpk për Eksperten Kontabël Znj. Andia Pustina, kostatohet dhe konfirmimi me anë të nënshkrimit, i marrësit të kësaj shkrese, një prej punonjësve të Studio Pustina (Odeta Fishta), shoq Kontakt i dërgon informacion dhe sqarime lidhur me kërkesat për rakordimin e Homeplan Shpk duke i dërguar tabelat përkatëse në lidhje me pagesat e kryera nëpërmjet arkës së shoqërive të ndara si më poshtë :

- A. Para të përdorura CASH nga vetë Homeplan shpk për periudhën 2010 – 30.04.2013
 1. Pagesat me arkë të kryera nga shoqëria Homeplan shpk, për blerje të ndryshme shërbime dhe kontribute për negociime me të tretë. (pa përfshirë marrëdhënien me Kontakt si furnitor, **Aneksi 1**
- B. Pagesa të kryera nga Kontakt për Homeplan:
 1. Shpenzime për shërbime të paguara nga Kontakt për Homeplan **Aneksi 2**
 2. Studime të paguara nga Kontakt për Homeplan , **Aneksi 3**
 3. Vlera e plotë e taksës së ndikimit në infrastrukturë paguar në Bashki nga Kontakt, bashkëlidhur kopje e shkresës drejtuar Studjos, datë 27.08.2013
 4. Analiza e Vlerës së Përfutuar nga gjyqi me Bashkinë Tiranë, bashkëlidhur kopje e shkresës për dëmin jashtëkontraktor, datë 13.03.2013

Bashkëlidhur kësaj shkrese, gjenden **Aneksat 1; 2 dhe 3 sipas përshkrimeve të sipërcituara ku konstatohet se:**

- I. Në **Aneksin 1**, me emërtimin **HOMEPLAN 2010 – 2013, Pagesat e kryera me arkë 2010-2013'**, reflektohen në formë tabelore, pagesa në monedhën euro, të kryera nëpërmjet arkës nga shoqërisë **Homeplan shpk**, të ndara sipas viteve me emërtimet përkatëse, më konkretisht:
 - a. Në vitin 2010 rezulton se janë paguar gjithësej 13,450 euro nga arka e shoqërisë Homeplan shpk.
 - b. Në vitin 2011 rezulton se janë paguar gjithësej 123,651 euro nga arka e shoqërisë Homeplan shpk.
 - c. Në vitin 2012 rezulton se janë paguar gjithësej 138,681 euro nga arka e shoqërisë Homeplan shpk.
 - d. Në vitin 2013 (deri më 30.04.2013) rezulton se janë paguar gjithësej 13,285 euro nga arka e shoqërisë Homeplan shpk.

Për të gjithë periudhën (2010 – 2013) pagesat totale nëpërmjet arkës janë në shumën **289,069 euro**.

Kjo tabelë përfaqëson paratë CASH të dala nga arka e shoqërisë Homeplan shpk, të cilat janë përdorur për pagesa të ndryshme gjatë viteve 2010,2011,2012 dhe 2013, **informacion i cili i dërgohet shtetases Andia Pustina me qëllim rakordimin e shpenzimeve për projektin e shoqërive Homeplan dhe Konktakt.**

Në këtë tabelë paraqitet të gjitha pagesat e kryera nga arka e shoqërisë, si ato të cilat janë bërë për likuidimin e faturave tatimore të cilat janë deklaruar në librat e shoqërisë Homeplan, ashtu edhe ato pagesa të kryera në mënyrë informale individëve apo subjekteve të ndryshëm si psh. paga cash, komisione për shitje apartamentesh ose shpenzime të cilat janë fshehur qëllimisht si psh. kontribute për negocime me të tretë, etj.

Theksojnë se të dhënat e gjendura në këtë tabelë nuk përfshijnë marrëdhënien me Kontakt si furnitor siç përshkruhet edhe në shkresën përcjellëse me Nr. 2326 Prot, datë 22.05.2013

Në këtë tabelë ndër zërat më me interes për hetimin evidentohen:...Zëri me numër rendor 24, me emërtimin Marin Biçoku, me një vlerë totale prej 12,500 euro të paguara në vitin 2010

Sipas ekspertimit të kryer në hard diskun e sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se është gjendur një dokument "*Arka 2010 Homeplan pdf.*" i modifikuar për herë të fundit më datë 11.07.2011 ku pasqyrohet se me MP 1 datë 16.06.2010 shtetasi Marin Biçoku i është bërë një pagesë prej 12 500 euro ose 1 708 625 lekë. Sipas MA 83 datë 01.12.2010 evidentohet se shtetasi Marin Biçoku, ka bërë një pagesë prej 63.50 euro, për ndryshim, rifinitura në ap 254.

Referuar dokumentave të sekuestruara pranë Studio Pustina, është gjetur një dokument me logon Homeplan Analizë, datë 05.08.2011, ku shfaqet analizë e arkës së shoqërisë Homeplan sh.p.k. për periudhën 01.01.2010 – 31.12.2010, me referenca mandat pagesash ku është bërë shënimi për shtetasin Marin Biçoku se **i janë dhënë me mandat pagesën nr. 1 datë 16.06.2010 një shumë prej 12 500 euro. Me shkrim dore është bërë shënimi: MP nr. 1 Kthim fondi "Klientit" M.Biçoku i cili nuk ka paguar asnjë këst (shpjegim tjetër F.B).** Ky dokument rezulton i nënshkruar nga shtetësja Suzana Aliaj.

Për të njëjtën periudhë (01.01.2010 – 31.12.2010) evidentohet gjithashtu dokumenti i datës 15.08.2011, me përshkrimin *Homeplan – Analizë*, në të cilin paraqiten pagesat në euro, nga arka e shoqërisë Homeplan. Me interes për hetimin konstatohen lëvizjet e mëposhtme: **Mandat Pagese me nr.1, datë 16.01.2010, në vlerën 12.500 euro, për Marin Biçoku. Nga hetimi rezulton se 12,500 euro janë arkëtuar nga Fatmir Bektashi si borxh nga ortakun në të njëjtën datë. Në të njëjtin dokument evidentohen shënimet me shkrim dore si më poshtë:**

Sqarim : 1. MP nr.1 , - Kthim fondi " Klientit M.Biçoku i cili nuk ka paguar asnjë këst (shpjegim tjetër F.B); 2. MP nr. 2,73,74,60 – derdhje në bankë për klientët që kanë paguar në cash (efekte fiskale); 3. MP 72 – është sipas listës që ju keni si likuidim për kontakt.

Kjo faqe është e nënshkruar nga shtetësja Suzana Aliaj.

Gjithashtu rezulton në një dokument tjetër të sekuestruar pranë Studio Pustina me emërtimin "*Homeplan, arkëtim dhe cash out datë 30.09.2013*" i nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi ku është bërë shënimi në lidhje me arkëtimet dhe shpenzimet e shoqërisë Homeplan. Evidentohet se në zërin shpenzime, nën zërin Investime, është shënuar me nr rendor 37 Marin Biçoku, me shumë të dhënë 12 500 euro.

Referuar akt ekspertimit të hard diskut, të sekuestruar pranë studio Pustina, evidentohet një dokument i emërtuar "Kontrata 2010-2011". Në këtë dokument, në faqen e parë të dokumentit excel me emërtimin "Apt 2010-x Pronarin" ku me kodin 254 në strukturën Homeplan 2, shtetasi Marin Biçoku, pasqyrohet më datë 30.12.2010, në shumën 62 302.50 euro, me sip totale **75.02 m2**, me çmim 830.48 euro/m2, por është evidentuar si klient megjithëse gjendet në listën e pronarëve.

Nga i njëjti akt ekspertimi (hard drive sekuestruar tek Studio Pustina), rezulton se në dokumentin në excel "Homeplan shitje 2010 – 2011" evidentohet emri i shtetasit Marin Biçoku, me datë të kontratës 19.06.2010, sip totale 109.58 m2, çmimi 675 euro/m2 sip verande 34.56 euro me çmim 337.50 euro për m2. **Në diferencë nga klientët e tjerë për këtë shtetas nuk evidentohet kryerja e asnjë pagese.**

Nga akti i ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, është gjendur një dokument në pdf me emërtimin "Analiza Llog Klasa 1-4 (1)" i krijuar për herë të fundit më datë 01.04.2012. Në faqen 32 evidentohen veprime në lidhje me shtetasin Marin Biçoku: *VS 2 datë 01.01.2011 E - Çelje viti 2011 klientë Homplena/çelje viti, debituar 12 500 euro dhe më datë 31.12.2011 me VS 48, sistemim veprimi për Marin Biçoku/sistemi 12 500 euro.*

Me kontratën e shitblerjes nr 159 rep nr 94 kol datë **28.01.2013** para noteres Laura Pustina është lidhur kontrata e shitjes mes shitësit shoq Homeplan sh.p.k. dhe blerësit Marin Biçoku, për pasurinë apartament me nr 28 me nr pasurie 3/201+2-28 ZK 8220 me sip 66.6 m2 rruga Frosina Plaku, kati i pestë i godinës 9 katëshe, shk 2 Tiranë. Ap nr 28 ka edhe sip verande 34.56 m2 dhe sip të përbashkët 9.25 m2. Çmimi i shitjes është 62 303 euro i cili sipas nenit 2 deklarohet nga palët se është paguar totalisht nga blerësi përpara lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka më pretendime për të. Me faturen tatimore nr. 8 datë 28.01.2013 rezulton se shoq Homeplan sh.p.k. i ka shitur një njësi ap 28 (254), në vlerën 62 303 euro ose 8 692 515 lekë shtetasit Marin Biçoku.

Nga ekspertimi i lap topit të sekuestruar në studion Pustina, është gjetur një dokument në formatin excel, i modifikuar për herë të fundit më datë 28.10.2013 ku për shtetasin Marin Biçoku më datë 12.02.2013 është bërë shënimi: "*Marin Biçoku, kontratë shitblerje me HP (me ulje)*".

Më datë 12.02.2013, rezulton se është bërë aplikimi nga shtetasi Marin Biçoku për regjistrimin e kontratës por me shkresën datë 21.02.2013 është njoftuar nga ZVRPP se kontratës i mungon vula e njomë e shoq Homeplan sh.p.k. Për këtë arsye është bërë riaplikim më datë 28.02.2013. Pikërisht në këtë datë është regjistruar edhe pasuria e mësipërme në emër të tij.

Më datë 16.01.2024, është pyetur, shtetasi **Marin Biçoku**, i cili ka deklaruar se, *pothuajse gjysmën e shumës e kishte siguruar nga të ardhurat që siguronte prej firmës së tij MB Studio të cilën e ka hapur në vitin 2009 dhe nga viti 1994 ka punuar profesion të lirë si arkitekt, pra aktivitet privat. Dy shkëputje ka nga ky aktivitet e konkretisht në periudhën nga fundi i vitit 2000 deri në fillim të vitit 2001 ku ka punuar në Bashkinë e Tiranës dhe tjetra në Ministrinë e Punëve Publike nga fundi i vitit 2005 deri në mesin e vitit 2009. Gjysmën tjetër të shumës pretendon se e ka siguruar nga miqtë e tij, të cilëve ju ka marrë borxh por nuk preferon të përmendë emra. Pagesën pretendon se e ka bërë me cash, në disa këste, për dy- tre ditë. Pranon se ka përfituar një ulje prej 10 % në çmim pasi mori përsipër pagesën e menjëhershme të vlerës së apartamentit dhe kjo është përcaktuar në akt marrëveshjen e lidhur me shoqërinë Homeplan sh.p.k.*

Me kontratën nr 747 rep nr 431/1 kol datë 22.04.2013 shtetasi Marin Biçoku, e shet pasurinë e mësipërme në vlerën **55 000 euro tek shtetësja Xhulia Rruga, 7 303 euro më pak.**

Më datë 16.01.2024, shtetasi **Marin Biçoku**, i pyetur në lidhje me shumën prej rreth 12 000 euro që pasqyrohet se i është dhënë bashkë me apartamentin, për të kompensuar kontributin që ai ka dhënë në favor të shoqërisë Homeplan sh.p.k. deklaroi se, *nuk ka asgjë për të thënë në lidhje me këtë koment. Nuk është në dijeni të asaj që është shkruar dhe se nuk ka dhënë kontribut në favor të shoqërisë Homeplan.*

Në fakt, rezultojnë një tërësi aktesh që në përputhje me njëra tjetrën vërtetojnë se shtetasi Marin Biçoku nuk ka bërë pagesë çmimi për apartamentin e marrë nga shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe se atij i është paguar plus edhe shuma prej 12 500 euro. Kështu, nga ekspertimi i laptopit të sekuestruar shtetases Andia Pustina, i markës SONY, model PCG-7T1L, me product Key K873M-6JMJ, me barcode 00045-830-720-227, ekspertim ky i pasqyruar në aktin me nr. 149 datë 11.08.2023 është evidentuar një dokument i krijuar më datë **17.12.2010**, me autor user dhe autor të fundit Financa I me emërtimin **"2591744"** në excel, me disa faqe, me modifikim të fundit më **29.11.2011**, ku shfaqen emrat e personave si klient apo pronarë për shoqërinë Homeplan dhe blerjet që kanë bërë apo përfitimet e pasurive. Për shtetasin Marin Biçoku, evidentohet me nr rendor 346, në njësinë apartamente, si klient, më datë **19.06.2010**, me sip **109.6 m2**, me çmim **675 m2**, me shumë totale **62 302.5 euro** dhe lënë bosh rubrikat si të arkëtuara dhe ajo për t'u arkëtuar shënuar me vlerën **0**. Në një dokument i krijuar më datë **17.12.2010**, me autor user dhe autor të fundit Financa I me emërtimin **"2610688"** në excel, me disa faqe, me modifikim të fundit më **09.04.2012**, ku shfaqen emrat e personave si klient apo pronarë për shoqërinë Homeplan dhe blerjet që kanë bërë apo përfitimet e pasurive. Për shtetasin Marin Biçoku, evidentohet se është shënuar si klient: më datë **19.06.2010**, për një njësi ndërtime me sip **109.58 m2**, me çmim **675** në një vlerë totale prej **62 302.5 euro**. **Konstatohet se në rubrikën "Të arkëtuara" nuk është shënuar asnjë vlerë dhe "Për t'u arkëtuar" është shënuar vlera 0.** Në një dokument me emërtimin **"2641920"**, me datë krijimi **17.12.2010**, datë modifikimi **09.07.2012** dhe autor të fundit Financa I. Ky dokument rezulton të ketë disa faqe, mban sipër stemën "Homeplan Rezidencë banimi" ku në faqen e parë "Të dhënat" evidentohet ndarja e dokumentit në këtë mënyrë: Depo nga nr referencës 8 deri në nr 142; Garazhe nga nr referencës 144 deri në 226; Njësi shërbimi nga nr referencës 228 deri më 281; Apartamente nga nr referencës 283 deri më 784. Në këtë dokument identifikohet shtetasi Marin Biçoku si vijon: Me nr rendor 350 në njësinë Apartamente është shënuar: Marin Biçoku (palë pronare), i evidentuar me gërmën "K" që tregon se është klient, më datë **19.06.2010**, me sip **109.58 m2**, çmimi **675 euro/m2**, me vlerë totale **62 30.5 euro**, arkëtuar bosh, vlera për t'u arkëtuar **0**. Në një dokument me emërtimin **"2670080"** gjendur në kompjuterin lap top të sekuestruar pranë studio Pustina, ekstraktuar të dhënat sipas akt ekspertimit nr. 149 të vitit 2023, me datë krijimi **17.12.2010**, datë modifikimi **15.10.2012** dhe autor të fundit Financa I. Ky dokument rezulton të ketë disa faqe, mban sipër stemën "Homeplan Rezidencë banimi" ku në faqen e parë "Të dhënat" evidentohet ndarja e dokumentit në këtë mënyrë: Depo; Garazhe; Njësi shërbimi Apartamente. Shtetasi Marin Biçoku identifikohet me nr rendor 347 me emrin **Marin Biçoku (palë pronare)**, më datë **19.06.2010**, si klient, me apartament sip **110.41 m2**, çmimi **564564.3 euro/m2**, me vlerë totale **62 302.5 euro**, paguar ___ lënë bosh dhe për t'u arkëtuar **0**. Në dokumentin në formatin excel të përpiluar nga User, ruajtur për herë të fundit nga User, përmbajtja e të cilit është krijuar më **17.12.2010** ora **11.13** dhe ruajtur për herë të fundit më datë **04.01.2014** ora **11.47**, në lidhje me shtetasin Marin Biçoku gjendet shënimi: **"Kontakt: Apartamenti 254 + 12,500 euro që i janë dhënë z. Biçoku për të kompensuar kontributin që z. Biçoku ka dhënë në favor të Homeplan sh.p.k."**.

Shtetasi **Marin Biçoku** i pyetur më datë 22.11.2023, i pyetur në lidhje me ndonjë bashkëpunim me shoqërinë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. ky shtetas deklaroi: “...Gjatë periudhës që kam punuar në shtet nuk kam pasur asnjë marrëdhënie kontraktuale apo tregtare ndërkohë që njohjen me shtetasin **Fatmir Bektashi** si dhe me shumë persona të tjerë e kam pasur edhe përpara periudhës që kam qenë anëtar i KRRT-së edhe më pas dhe kam pasur **marrëdhënie kontraktore**. Kontaktet në lidhje me këto marrëdhënie kontraktore i kam pasur më shumë me shoqërinë **Hompelan sh.p.k.** konkretisht me shtetasin **Fatmir Bektashi**.

I pyetur në lidhje me shtetasit **Jamarbër Malltezi** dhe **Xhimi Begeja**, deklaroi:... Unë dua të sqaroj fillimisht se shtetasin **Jamarbër Malltezi** e njoh prej shumë vitesh, **ndoshta që nga fillimet e viteve 1990** dhe kam muhabet me të por në lidhje me marrëdhëniet kontraktore të sipërcituara unë kam komunikuar vetëm me **Fatmir Bektashin**. **Xhimi Begeja e kam njohur gjithashtu shumë vite para dhe mesa kujtoj ma ka prezantuar Jamarbër Malltezi por nuk është se kam ndonjë muhabet me të sa me shtetasin Jamarbër Malltezi. Tjetër gjë nuk kam për të thënë. ..”**

64.1.5. Gjithashtu shtetasi **Marin Biçoku**, rezulton se më datë 02.09.2009 regjistron edhe subjektin **MB Studio sh.p.k.** me NIPT K92102002G me objekt aktiviteti : *Konsulencë dhe shërbime në fushën e territorit dhe ndërtimitarise për : administrimin dhe menaxhimin e projekteve, vlerësimin dhe planifikimin e projekteve, projektim, ofertim, negociim dhe administrimin e kontratave, administrimi i shërbimeve, dhe kontabiliteti i kësaj shoqërie, ahstu si edhe i gjithë familjes Berisha, mbahet nga studio Pustina.*

65. Sipas **Librit të KRRT-së**, rezulton nga aktet se, në proces verbalin e KRRT nr. 2, seanca 4, datë **03.06.2006**, pasqyrohen si pjesëmarrës: *Zoje Vathi, Arben Biçoku, Marin Biçoku, Dritan Agolli, Aldor Karaja, Leonora Zaloshnja, Fahri Maho, Majlinda Dhuka, A. Qirjako, Monda Daja, Kujtim Spahiu, Artan Shkreli, Adrian Myderizi, Arben Rusi, Ilir Bala, Engjëll Dhrami.* Në këtë proces verbal pasqyrohet ky diskutim:...*Objekti 36 – Ariela*

Beni: T'i shohim një për një

...Beni: nga h (korrigjuar në g) tek ___ (e palexueshme në fund) të mbetim në mendimin e K.Teknik. Në rast se ka paqartësi _ (e palexueshme) të japin shpjegime... (me lapës është bërë një shënim – Janë rivotuar më mbrapa)

“i” *A. Sadiku*

Majlinda: Si është pronësia, është pjesë e kompleksit të pishinave? Mos është me enfiteozë?

Beni: E votojmë propoz.

A.Karaja: Zona duhet të mbetet zonë sportive, ka një qëllim që është lënë e tillë

Marini: Impakti në mjedis që tha Aldori nuk qëndron

Beni: Kush është pro 2 vota Marini, Shkreli

Kundra 12, nuk miratohet

“j” *...Shkreli: Pse K.Teknik për disa vendos po dhe disa jo*

Majlinda: Për zonat industriale meqenëse nuk kanë aktivitet industrial është menduar të miratohen ndërsa për zonat e gjelbëra, llogjike është që të mos pakësohen.

Është privatizuar apo kthyer prona?

Beni e votojmë propozimin...

...Beni: Ndërpresim punimet.

Tek çështja 36 pikat i (është bërë një pikëpyetje me lapës) , j, k, l, m, n, o, p, q, h, nuk janë votuar për mungesë numri të anëtarëve të KRRTsë. Votimi do të bëhet seancën e ardhshme.

- Të martën ora 10.00.

Nënshkruajnë në fund: *Arben Rusi, Ilir Bala, Engjëll Dhrami, Kujtim Spahiu, Adrian Myderizi, Artan Shkreli (nuk kishte kuorum te 36/i), Aldor Karaja, Leonora Zaloshnja, Zoja Vathi, Arben Biçoku, Fahri Maho.*

65.1. Në proces verbalin e KRRT nr. 3 datë **08.06.2006**, Seanca 2, pasqyrohen: *Arben Biçoku; Arben Rusi, Adrian Myderizi, Engjëll Dhrami, Monda Daja, Zoja Vathi, Aldor Karaja, Rikard Luka, A. Qirjako, Fahri Maho, Artan Shkreli, Vasil Jorgaqi, Marin Biçoku, Astrit Tartari, Ilir Bala, Kujtim Spahiu, Majlinda Dhuka, Leonora Zaloshnja.*

Çështja 36.... "36 i" Beni: *Votojmë*

Sadiku

Shkreli: Për problemin e rrugës, KRRja t'i drejtohet Institutit të Urbanistikës si e vlerëson. Pro 12

Kundra B.Biçoku, Aldor Karaja, Lal (e palexueshme)

Miratohet

"36 j" Beni: *Votojmë*

Pro 14

Kundra B. Biçoku

Miratohet.

Në përfundim të proces verbalit, ka nënshkrime të emrave: *Astrit Tartari, Arben Rusi; Vasil Jorgaqi, Rikard Luka; Adrian Myderizi; Zoja Vathi; Marin Biçoku, Fahri Maho; Engjëll Dhrami; Arben Biçoku; Monda Daja; Aldor Karaja (i cili ka bërë shënimin KRRT nr. 2 kundër pika 35, 36 i, j, k); Leonora Zaloshnja (edhe kjo e fundit ka bërë disa shënime për pikën 35/a dhe 35/b).*

66. I pyetur më datë 22.11.2023, rreth procedurës që ndiqte KRRT Bashkia Tiranë, në shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve, shtetasi **Marin Biçoku** ka deklaruar se: *...rreth dy ditë para mbledhjes, merrnim njoftimin për organizimin e mbledhjes nga Bashkia dhe shkresa shoqërohej nga një album i cili kishte materiale grafike, mbi çështjet që do të shqyrtonin por pak, ndonjë plan vendosje. Për një çështje mund të kishte rreth dy – tre fletë A3. Përgjithësisht nuk ka pasur relacione nga Këshilli Teknik i Bashkisë por në mbledhjen e KRRT-së prezantohej çështja nga projektuesi që mund të ishte ose punonjës shtetëror në rastet e investimeve publike ose arkitekti i përzgjedhur nga klienti në rastet e investimeve private.*

I pyetur në rastet e ndryshimit të destinacionit, nëse njiheshin me kërkuesin, deklaroi: *...Ndryshimi i destinacioneve, konsiderohet ndryshimi i planit rregullues dhe si i tillë prezantimin e çështjes për kërkesën specifike e bënte institucioni përkatës, Bashkia Tiranë.*

I njohur me proces verbalin e datës 08.06.2006, specifikisht nëse ka pasur diskutime, në lidhje me gërmat "i" dhe "j" ky shtetas deklaroi se: *...Nuk më vjen ndër mend ndonjë diskutim që mund të kemi bërë në lidhje me ndryshimin e destinacionit, vetëm referuar proces verbalit, pasi proces verbali mund të përmbahej edhe në mënyrë të përmbledhur nga mbajtësi i proces verbalit.*

67. Me vendimin nr. 132 datë 08.06.2006 të kryetarit të KRRT-së, Bashkia Tiranë (nr. 277 prot datë 28.06.2006), është vendosur ndër të tjera që, të miratohet kërkesa për ndryshim të destinacionit për "j" Rruga "Frosina Plaku" dhe rruga e Planit Rregullues nga zonë sportive në zonë banimi. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga KRRTSH-ja.

68. Pas miratimit të mësipërm, për ndryshimin e destinacionit, shtetasi Xhimi Begeja, vijon të marrë masa për shtrirjen e pronësisë së tij. Pa u bërë tre javë, nga miratimi i vendimit të mësipërm, konkretisht më datë 27.06.2006, shtetasi Xhimi Begeja, lidh tre kontrata me përfaqësuesin e shtetasve Nerime Piro dhe Sejdiqe Kurti, shtetasin Dion Piro (kontrata nr 6921 rep nr 1144 kol datë 27.06.2006; kontrata me nr 6922 rep nr 1145 kol datë 27.06.2006 dhe kontrata me nr 6923 rep nr 1146 kol datë 27.06.2006). Konstatohet se këto kontrata lidhen më datë 27.06.2006 ndërkohë që shtetasi Dion Piro është pajisur me prokurë, dy ditë më vonë më datë 29.06.2006 (shih prokurën nr 2870 rep nr 913 kol datë 29.06.2006). Kjo gjë, nuk duket ta ketë penguar shtetasen Ruko Sako, që ka ushtruar funksionin e noteres, të lidhë tre kontratat e shitblerjes, sipas të cilave shtetaset Nerime Piro dhe Sejdiqe Kurti i shesin shtetasit Xhimi Begeja, pjesën prej 60/4200 që kanë në bashkëpronësi në pasurinë me nr. 3/138 ZK 8220 truall me sip 3120 m²; në pasurinë me nr. 3/140 ZK 8220 truall me sip 1500 m² dhe në pasurinë me nr. 3/139 ZK 8220 truall me sip 6345 m², secila në vlerën prej 1 000 000 (një milionë) lekë, shumë e cila sipas pasqyrimeve në kontratë, është likujduar totalisht nga blerësi, jashtë zyrës noteriale.

69. Ndërkohë, rezulton se, më datë 15.07.2006 e ndjera Nimete Bekteshi (gjyshja e shtetasit Jamarbër Malltezi) ndërron jetë (shih vendimin nr 6368 datë 15.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë). Ndodhur në këto kushte, shtetasit Jamarbër Malltezi, i kalojnë të drejtat pronësore në vend të nënës së tij Merxhane, e cila ka ndërruar jetë që më 1987.

Pikërisht me vendimin nr. 6368 datë 15.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çelet dëshmia e trashëgimisë për të ndjerën Nimete nga ku rezulton ndër të tjera trashëgimtar shtetasi Jamarbër Malltezi. Konkretisht, me këtë vendim është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore, për trashëgimlënësen **Nimete Bekteshi**, duke u njohur si trashëgimtarë ligjorë të saj: *Bashkim Bekteshi (i biri) me ¼ pjesë takuese; Nervit Hoxha (e bija) me ¼ pjesë takuese; Rajmonda Bekteshi (e bija) me ¼ pjesë takuese; Jamarbër Malltezi (i nipi) me 1/8 pjesë takuese dhe Orinda Malltezi (mbesa) me 1/8 pjesë takuese.*

Kërkesën për çelje të dëshmisë së trashëgimisë, pasqyrohet se e ka kryer shtetasi Bashkim Bekteshi, **përfaqësuar në gjykim nga av. Sokol Barçi**, me deklaram në seancë.

69.1. Av. **Sokol Barçi**, rezulton të ketë qenë i punësuar fillimisht pranë studios së shtetasës Flutura Kola. Në vijim ky shtetas rezulton të jetë punësuar pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k. shoqëri e krijuar në petkun e shoqërisë investuese për zhvillimin e ndërtimeve në territoret e dy ish klubeve sportive Partizani. Gjithashtu, ky shtetas rezulton të ketë qenë vazhdimisht i angazhuar edhe nga shtetasit Malltezi në ofrimin e shërbimeve juridike (shih prokurën e posaçme nr 71 rep nr 31 kol datë 14.01.2013, para noteres Laura Pustina, lëshuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi, me të cilën ka emëruar si përfaqësues të posaçëm av. Sokol Barçi; Prokurë e Posaçme me nr 2031 Rep / 908 Kol datë 29.09.2015 para Noteres Laura Pustina, nga shtetasja Argita Malltezi ku emëron shtetasin Sokol Barçi si përfaqësues të Posaçëm të cilit i jep kompetencë të tërheqë ekstraktet bankare në Bankat e Nivelit të Dytë në Republikën e Shqipërisë dhe ekstraktet bankare për llogari të shoqërisë Malltezi & Kola shpk.; Prokurë e

posaçme nr 1992 rep nr 628 kol datë 09.07.2021, para noteres Laura Pustina, lëshuar nga shtetasi Jamarbër Maltezi për ta përfaqësuar në një gjykim, etj)

70. Vetëm një javë, pas deklarimit të cilësisë së trashëgimitarit të shtetasit Jamarbër Maltezi, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, merr vendimin nr. 4 datë 21.11.2006 "Për miratimin e ndryshimit në planin rregullues të Qytetit të Tiranës në lidhje me zonimin funksional për disa zona të qytetit" ku përfshihet dhe zona me sipërfaqe 0.7 ha në Rrugën "Frosina Plaku", e cila ndryshohet nga "zonë sportive" në "zonë banimi". Ky vendim është firmosur nga Kryetari i KRRT-së Z. Sali Berisha.

Në bazë të VKM nr. 836 datë 03.12.2004 "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të R.Shqipërisë" të ndryshuar me VKM nr. 717 datë 22.11.2005, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, si organ vendimmarrës, kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

- Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit zëvendëskryetar;
- Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës anëtar;
- Ministri i Drejtësisë anëtar;
- Ministri i Brendshëm anëtar;
- Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit anëtar;
- Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve anëtar;
- Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave anëtar;
- Një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes anëtar;
- Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave anëtar;
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sekretar.

Sipas n 2 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e këshillit të rregullimit të territorit të republikës së shqipërisë", KRRTRSH përbëhet nga kryetari, zëvendës kryetari, anëtarët dhe sekretari i KRRTRSH-së. Në bazë të nenit 3 të kësaj rregulloreje, KRRTRSH-ja për çështjet që trajton, merr vendime me shumicë votash. Në rastet kur numri i votave është ndarë në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit vlen sa dy vota.

Në n 6 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e këshillit të rregullimit të territorit të republikës së shqipërisë", është pasqyruar se Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, është Sekretar i KRRTRSH. Në fakt, në vendimin se sipërcituar, konstatohet se për sekretarinë teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të R.Shqipërisë ka nënshkruar në funksionin e sekretarit të KRRTRSH-së shtetasi Marin Biçoku.

Sipas nenit 6 të rregullores, si më sipër cituar, sekretari i KRRTRSH-së, ka për detyrë:

- Të koordinojë dhe të verifikojë nëse materialet e paraqitura për shqyrtim në KRRTRSH janë konform ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", vendimit nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së urbanistikës" dhe të dispozitave ligjore në fuqi që kanë lidhje me objektin e shqyrtimit. Nëse nuk janë në përputhje me kërkesat e dispozitave të kërkuara, i kthen ato për plotësim.
- Të koordinojë dhe kontrollojë procedurën administrative sipas kësaj rregulloreje dhe Kodit të Procedurave Administrative për materialet që do të shqyrtohen në KRRTRSH, para dhe pas vënies në dispozicion nga sekretaria teknike e KRRTRSH-së.
- Pas mbledhjes së KRRTRSH-së, përgatit vendimet e KRRTRSH-së për materialet e shqyrtuara e miratuara në KRRTRSH-ja dhe ndjek e koordinon zbatimin e vendimeve të marra.

Në bazë të n. 7, të rregullores për funksionimin e këshillit të rregullimit të territorit të R.Shqipërisë, KRRTRSH-ja në përfundim të çdo tematike, vendos:

- *Miratimin e materialit të paraqitur*
- *Miratimin me vërejtje për përmirësim*
- *Shtyrje për shqyrtim në mbledhjen më të afërt*
- *Mosmiratimin*

70.1. Në fakt, pushtetin e KRRTRSH-së, në vendimmarrjet e KRRT-së së Bashkisë Tiranë, kjo e fundit, e ka kundërshtuar pranë Gjykatës Kushtetuese. Subjektet e interesuara, e specifikisht KRRTRSH-ja, konstatohet se është përfaqësuar pikërisht nga shtetasi **Marin Biçoku**. Gjithashtu, edhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, konstatohet ndër të tjerë se është përfaqësuar nga shtetasit **Andi Toma dhe Marin Biçoku**. Shtetasi Andi Toma, rezulton të jetë bashkëshorti i shtetases Laura Pustina, noterja tek e cila vijon të bëhet pjesa dërrmuese e akteve noteriale që lidhen me familjen Berisha, Malltezi dhe ato me shoqërinë Homeplan. Shtetësja Laura Pustina është motra e shtetases Andia Pustina që në vijim mban kontabilitetin e shoqërisë Homeplan sh.p.k.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr 29 datë 21.12.2006, ka vendosur të deklarojë të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me Kartën Europiane të Autonomisë Vendore, n 10 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", që parashikonte se, KRRTRSH-ja kryesisht ose me kërkesë të këshillave lokalë, prefekturave, në rastet kur vëren shkelje ligjore në marrjen e vendimeve nga KRRT-të e rretheve dhe të bashkive kur pengohet realizimi i programi të qeverisë, shqyrton dhe merr vendime, duke shfuqizuar vendimet e marra nga KRRT-të e rretheve dhe të bashkive. Prefekturat sipas kompetencave territoriale të tyre kanë të drejtë që të pezullojnë zbatimin e vendimeve të KRRT-ve deri në shqyrtimin e tyre në KRRTRSH.

Megjithatë, si edhe më sipër cituar, rezulton se vendimi i KRRTRSH-së, për rastin konkret, është marrë më datë 21.11.2006, një muaj para se Gjykata Kushtetuese të deklaronte këtë papajtueshmëri.

70.2. I pyetur më datë 22.11.2023 shtetasi **Arben Biçoku** ka deklaruar se, *përsa i përket çështjes së ndërrimit të destinacionit të një zone, vendimi i KRRT të Bashkisë Tiranë ishte një vendim paraprak dhe pa fuqi ligjore sipas ligjit nr 8405 "Për urbanistikën" pasi kjo vendimmarrje ishte kompetencë e KRRT të Republikës së Shqipërisë që mblidhej pranë Kryeministrit... Pra vendimi i KRRT të Bashkisë ishte thjesht një vendim sugjerues. Vendimet e KRRT-së duhet të konfirmoheshin nga Prefekti i Tiranës, me siglim i cili kishte për detyrë të shihte pikërisht përputhshmërinë me ligjin...dhe gjatë kohës që ai ka qenë anëtar i KRRT-së së Bashkisë Tiranë ka pasur edhevendimmarrje që janë anuluar nga prefekti. ...*

70.2.1. E pyetur më datë 11.10.2023 shtetësja **Ariela Kushi**, e punësuar pranë Bashkisë Tiranë në pozicionin e drejtores së Njësisë së Planit Rregullues në vitin 2006 deklaroi se *Bashkia jepte mendimin por fjala e fundit dhe vendimi hynte në fuqi vetëm pasi miratohej nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.*

Ndryshimi i ligjit për kthimin e pronës dhe rritja e pushtetit të kryeministrit:

71. Ndërkohë, në këtë periudhë, konstatohet se vijojnë të lëshohen akte përfaqësimi. Kështu shtetaset Nervit Hoxha dhe Rajmonda Bekteshi, emërojnë si përfaqësues vëllain e tyre,

Bashkim Bekteshi, ku ndër të tjera i japin tagre për t'u paraqitur pranë Agjensisë së Kthimit të Pronave (shih prokurën e posaçme nr. 9605 rep nr. 1550 kol datë 05.09.2006 para noteres Ruko Sako, prokurën e posaçme nr 1108 rep nr. 124/2 kol datë 21.10.2006 para noteres Edlira Hyseni).

Me prokurën e posaçme nr. 6335 rep nr. 877 kol datë 04.11.2006 shtetasit Fadil, Hamide Saliaga, Xhevrije Mullisi, Tire Deda (Luzi), Fatmir Luzi, para noteres Blerina Avrazi, kanë emëruar si përfaqësues të tyre av. **Silvana Bello** për procedurat e pronës. Në pikën 1 të kësaj prokure është përcaktuar se, i jepen tagre përfaqësueses ndër të tjera për veprime që **...kthimin dhe kompensimin e pronës të ndodhur në Tiranë tek Klubi Sportiv Partizani...të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për privatizimin e ndërtesave...**

72. Por, pavarësisht lëshimit të prokurave të mësipërme, konstatohet se para këtyre familjeve, shfaqeshin disa pengesa për kthimin e pronave për të cilat ishin njohur pronarë. Konkretisht, ekzistenca e godinave shtetërore, mbi territoret e dy ish klubeve Partizani, e bënte të kotë paraqitjen e kërkesës për kthimin e pronës.

73. Rreth 9 ditë, pasi Ministri i Mbrojtjes, shtetasi Fatmir Mediu ishte shprehur me shkresën nr 9549/3 prot datë 14.11.2005 se propozonte miratimin e privatizimit të objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit Partizani, Këshilli i Ministrave, merr vendimin nr 723 datë 23.11.2005, vendim ky i nënshkruar nga kryeministri Sali Berisha, për propozimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar. Këto ndryshime, siç do të vërehet më poshtë, i hapin rrugë edhe kërkesave për kthimin e pronës, kryesisht në ndryshimet që u bënë në lidhje me pronat që do të kthehen dhe me krijimin e Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si një strukturë që krijonte një varësi të theksuar me Këshillin e Ministrave dhe Kryeministrin, në të kundërt nga çfarë shfaqej deri tani për Komisionin Shtetëror të Kthimit të Pronave.

73.1. Ajo që konstatohet është se, rol kryesor, ka pasur në këto ndryshime, grupi parlamentar i Partisë Republikane. Megjithatë konstatohet se ky grup parlamentar, ka paraqitur propozime në lidhje me shtesa apo ndryshime, që ndryshonin edhe propozimet e tyre fillestare, disa kohë më pas, duke cituar në dokument se këto ishin pranuar nga qeveria.

Në lidhje me paraqitjen e propozimeve për ndryshimin e ligjit, në proces verbalin e datës 13.07.2006 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, shtetasi **Arian Madhi** është shprehur: **"...Pas një procesi të gjatë bisedimesh me qeverinë, lidhur me disa përmirësime të ligjit dhe projekt ligjit të qeverisë, kemi përfunduar një marrëveshje me mirëkuptim të plotë. Materiali që keni si projekt, shpreh qëndrimin e përbashkët të qeverisë dhe PR, me përjashtim vetëm të një dispozite që ndajmë qëndrime të ndryshme të kthimit të pakufi për ne dhe qeveria deri në 100 ha tokë bujqësore....Jemi të bindur që agjensia e kthimit dhe kompensimit të pronave, që do të varet nga qeveria, do të jetë shumë më efektive, se përgjegjësitë janë të ekzekutivit lidhur me angazhimet që ai ka dhe të mos përsërisë historinë, që për hir të qëndrimit politik, pengojnë procesin me kosto politike.**

...Edmond Spaho: **"...Që në analizën që i kemi bërë Komitetit të Pronave, veprimtaria e tij është konsideruar e pakënaqshme dhe kemi qënë skeptikë, që ai s'do të ishte në gjendje të përballonte detyrat që i ngarkon ligji, se gjatë dy viteve funksionimi, rezultatet e prodhuara kanë qënë inekzistente. E konsideroj me interes kalimin e kësaj strukture si pjesë ekzekutive për të cilën ka praktika dhe ka pasur rezultate të mira..."**

I pyetur më datë 17.07.2024 shtetasi **Arian Madhi** deklaron: **"...Unë në vitin 2006 kam qënë**

kryetar i grupit parlamentar të Partisë Republikane. Në lidhje me propozimet e kryera nga grupi parlamentar i partisë Republikane, e cila në këtë kohë kishte si kryetar të saj shtetasin **Fatmir Mediu**, unë dua të sqaroj se kam qenë plotësisht i pavaruar nga Fatmir Mediu por nuk do të thotë se nuk i konsultoja nismat që merreshin me qëllim ndryshimet në ligjin e pronave, për ta sjellë atë në filozofinë dhe programin e partisë republikane. ... Në lidhje me pjesën ku parashtrohet se këto propozime janë pranuar edhe nga qeveria, dua t'ju sqaroj se **gjatë kohës që unë punoja me përgatitjen e propozimeve mund të kisha kontakte me përfaqësues të qeverisë**, që ishin ngarkuar me çështjen e rakordimit të projekteve për çështjen e pronave. Takimet me përfaqësuesit e qeverisë **nuk është e thënë që të ishin gjithmonë formale**, në kuptimin e një mbledhje zyrtare, por mund të ishin takime të ndryshme që zhvillonim dhe shkëmbejmë ide në ambiente të ndryshme”

74. Ligji nr 9235 datë 27.09.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” në nenin 6 të tij parashikonte: ...Neni 6 Njohja e së drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës

1. Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompensohet deri në 60 ha dhe kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe...

3. Subjektet e shpronësuara dhe të kompensuara sipas ligjeve në fuqi kanë të drejtën e përfitimit nga ky ligj vetëm për pjesën e pronës së pakthyer ose të pakompensuar.

74.1. Me VKM nr 723 datë 23.11.2005 u propozuan ndryshime në këtë dispozitë, përsa i përket rritjes së sipërfaqes nga 60 ha në 100 ha, dhe shtimi i pikës 1/a në lidhje me kompensimin dhe llogaritjen e diferencës, nëse subjekti i shpronësuar kishte përfitur tokë, nga ligji nr 7501 i vitit 1991.

74.2. Megjithëse vërehet se ka pasur diskutime përgjatë muajve shkurt, mars, maj, qershor 2006 në Komisionet përkatëse pranë Kuvendit, Grupi parlamentar i Partisë Republikane, nëpërmjet shtetasit Arian Madhi, në muajin qershor që ishte edhe muaji kur u procedua me ndryshimin e destinacionit nga Bashkia Tiranë, paraqet dokumentin “Propozim për amandamente” nr. 1984 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend), me disa amandamente.

Në nenin 6, sipas këtij dokumenti, kërkohet shtimi i pikës 1.c. me këtë përmbajtje: ...“**Subjekteve të shpronësuara, u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës, si dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale – shkencore të instituteve kërkimore – shkencore si dhe çdo veprimtarie tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre.**”

Nuk ka asnjë koment në lidhje me këtë propozim, ndryshe nga pjesa dërrmuese e shtesave të propozuara.

Normalisht, lind pyetja se përse Partia Republikane, përqëndronte vëmendjen e saj në pronat e ushtrisë. Sjellim në vëmendje, se Ministër i Mbrojtjes në këtë kohë, ka qenë pikërisht shtetasi Fatmir Mediu.

74.2.1. Propozimi i mësipërm, përsëritet edhe me dokumentin “Propozim për amandamente” me nr 2316 datë 06.07.2006 (hyrje në Kuvend) grupi Parlamentar i Partisë Republikane, konkretisht shtetasi Arian Madhi.

74.3. Në fakt, me ligjin nr 9583 të datës 17.07.2006, neni 6 ndryshoi ndër të tjera, në këtë mënyrë: .../c. Subjekteve të shpronësuara u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale - shkencore të instituteve kërkimore-shkencore dhe në çdo veprimtari tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore, por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre. ...

74.4. Sjellim në vëmendje se, për Klubin e Futbollit Partizani tashmë, kishim të shprehur nga Ministria e Mbrojtjes, pikërisht nga Ministri i kohës Fatmir Mediu, me shkresën nr 9549/1 prot datë 12.10.2005, qëndrimin se ishte konkluduar që këto terrene të mos përfshihen në planet e përhapjes së FA-ve. Pikërisht, ndryshimi i mësipërm, i hapte rrugë pa asnjë ekuivok, kthimit të pronave, familjeve të njohura pronare.

I pyetur më datë 17.07.2024 shtetasi *Arian Madhi* në lidhje me ndryshimin e propozuar si më sipër, ka deklaruar: “...Në këtë aspekt një problem mjaft i rëndësishëm, kam konstatuar nevojën për ndryshime në aspektin e pronave të disa institucioneve dhe organeve të cilat mbaheshin në përdorim nga ana e tyre por që nuk ishin funksional. Për shembull mund të ishte instituti i duhanit, etj. Pasi kam bërë një studim të hollësishëm propozova që këto t’i ktheheshin si toka të lira, pronarëve të ligjshëm pasi kishin dalë jashtë destinacionit të tyre. Kjo ishte pa kufizim. U morën të gjitha informacionet nga të gjitha institucionet të cilat mbanin tokat në përdorim por nuk ishin brenda destinacionit, dhe u përgatit një raport. Studimin për këto prona unë e kam bërë vetë dhe kam përgatitur propozimin përkatës dhe e kam depozituar në Kuvend. ... Dua t’ju sqaroj se kur qeveria bëri propozimet për ndryshimin e ligjit për pronat, u konstatua se nuk kishte propozuar ndryshime të tilla që sipas mendimit tim të shkonin në favor sa më të madh të pronarëve për të ulur koston e kompensimit financiar të tyre. Partia Republikane, kishte 11 deputetë dhe si parti kishim qëndrimin që t’i ofronim popullit një ligj që t’i përgjigjej interesave të tij. Prandaj përgjatë diskutimeve të ndryshme në komisionet parlamentare kemi këmbëngulur për ndryshime që nuk ishin propozuar nga qeveria për ta plotësuar më mirë kuadrin ligjor. Në lidhje me faktin se përse kam specifikuar Ministrinë e Mbrojtjes në propozimin e bërë, ju sqaroj se dispozita në fakt referohet edhe për institucione megjithëse nuk i ka të përshkruara me emra konkretë. Unë në atë kohë jam orientuar në respektimin e rregullave të teknikës legjislativë, pasi kishim situata të ndryshme. Ministria e Mbrojtjes, kishte prona jashtë strukturës së forcave të armatosura, kurse institucionet e tjera nuk kerkonin ndonjë specifikë siç ishte miratimi i Presidentit. Mua më kujtohet që ligji i mëparshëm për kthimin e pronave, ka qenë i bashkëshoqëruar me një aneks, listë pronash për të cilat nuk lejohej kthimi dhe ndërmjet tyre mesa më kujtohet kanë qënë edhe pronat që unë i referohen në propozimin për shtimin e nenit 6 me pikën 1.c.”

75. Por përveç qënies së territoreve jashtë strukturës së Forcave të Armatosura duhet të rregullohej edhe problemi i objekteve që gjendeshin në to.

Ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, parashikonte deri në muajin korrik 2006, në nenin 7 të tij, se, **nuk kthehen pronat e paluajtshme që i shërbejnë një interesi publik dhe që:**

...b) kanë investime ose përdoren për realizimin e projekteve me shtrirje territoriale ose vendore në fushën e ... ose në investime të tjera në interes publik, të përcaktuar sipas ligjit “Për shpronësimet për interes publik”...

c) shërbejnë për ruajtjen e...kulturës...

...ç) shërbejnë për mbrojtjen kombëtare dhe që nuk tjetërsohen...

dh) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në Shtojcën 1 të këtij ligji përveç rasteve kur sipas këtyre ligjeve shteti është pronar dhe prona e paluajtshme nuk i shërben një interesi publik. ...

75.1. Me VKM nr. 723 datë 23.11.2005, Këshilli i Ministrave i kryesuar nga kryeministri Sali Berisha, propozon ndryshime në nenin 7 (me nenin 3 të projekt ligjit) duke hequr:

- gërmën "b", që lidhet me pasjen e investimeve në pronat që nuk kthehen,
- gërmën "ç" që parashikon se nuk kthehen pronat që shërbejnë për mbrojtjen kombëtare dhe që nuk tjetërsohen si dhe
- në gërmën "dh" duke hequr shprehjen "prona e paluajtshme nuk i shërben një interesi publik".

Konkretisht parashikimi i qeverisë është:

Neni 7 "Prona që nuk kthehen"

1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe ato që:

- a) Shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë
- b) Janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në shtojcën 1 të ligjit...

75.2. Me ligjin nr. 9583 datë 17.07.2006, dispozita e parashikuar në nenin 7 u ndryshua sipas propozimit të qeverisë, e pikërisht në këtë mënyrë:...Neni 7 Pronat që nuk kthehen

1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe ato që:

- a) shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë;
- b) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në shtojcën 1 të ligjit.

76. Duke hequr logjikën e ligjit të mëparshëm, mbi ekzistencën e investimeve në interes të publikut, ndërhyrja tjetër që vlerësohej, kishte të bënte pikërisht me ndërtime e çfarëdo lloji.

Ligji nr 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" parashikonte në nenin 8 "Truallit" se:

...2. Kur mbi truallin e subjektit të shpronësuar shteti a persona të tretë kanë kryer ndërtime ose investime, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ato llogariten sipas vlerës së tregut në çastin kur i njihet e drejta e pronësisë subjektit të shpronësuar dhe veprohet si më poshtë kur:

a) vlera e investimeve përbën deri në 150 për qind të vlerës së truallit, prona i kthehet subjekteve të shpronësuar, pasi ato të kenë paguar kundërvlerën e investimeve të kryera;

b) vlera e investimeve përbën më shumë se 150 për qind të vlerës së truallit, shteti apo personat e tretë ruajnë pronësinë dhe subjektet e shpronësuar kompensohen sipas këtij ligji.

3. Në rastet e ndërtimeve mbi truall, të bëra para datës 10.8.1991, për të cilat nuk është regjistruar pronësia e truallit, ai që ka në pronësi ndërtesën detyrohet të paguajë vlerën fillestare të truallit, sipas nenit 10 të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" të shumëzuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

4. Në rastet e ndërtimeve të ligjshme të bëra në truallin e dhënë nga shteti me qira ose koncesion, pronari i ndërtesës paguan vlerën e truallit mbi të cilin është bërë ndërtesa, sipas çmimeve të tregut.

76.1. Me VKM nr. 723 datë 23.11.2005, Këshilli i Ministrave ka propozuar ndryshime në këtë dispozitë me nenin 4të projekt ligjit, duke bërë ndër të tjera këto ndryshime:
...1. Pika 2 shfuqizohet.

Pra qartësisht duket qëllimi i qeverisë se, trualli i kthehet ish pronarëve.

76.2. Sërish, konstatohet se me dokumentin, propozim për amendamente, me nr 1984 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend), nga deputeti Arian Madhi, Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, është kërkuar që neni 8 në pikën 2 të qëndrojë siç është, madje duke vendosur një kufizim në kthim, konkretisht në pikën 2 – a, kur propozojnë që të bëhet ky formulim:

2. a) *vlera e investimeve përbën deri në 150 për qind të vlerës së truallit, prona i kthehet subjekteve të shpronësuar, pasi ato të kenë paguar kundërvlerën e investimeve të kryera. "Përfundim nga ky rregull bëhet vetëm për objektet e përcaktuara në fushën e zbatimit të ligjit nr ___ datë ___ "Për legalizimet, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".*

Gjithashtu me të njëjtin dokument, propozohen ndryshime në pikën 2/b dhe shtimi i pikës 3/1 me këtë përmbajtje:

2. b) *vlera e investimeve përbën më shumë se 150 për qind të vlerës së truallit, "subjekteve të shpronësuar u kthehet pronësia e truallit. Personat e tretë ruajnë pronësinë mbi ndërtimet ose investimet dhe kanë të drejtën e blerjes së truallit sipas vlerës së llogaritur, në përputhje me metodologjinë e miratuar me vendim të Kuvendit".*

3/1. *Në rastin e ndërtimeve të ligjshme për të cilat nuk është regjistruar pronësia e truallit, kur sipërfaqja e truallit të subjektit të shpronësuar është më e madhe se sipërfaqja që duhet të zëjë ndërtimi së bashku me truallin funksional sipas normave të ndërtimit, dhe pjesa e mbetur e truallit nuk është funksionale nga pikëpamja urbanistike për t'u përdorur si pronë e veçantë, subjekti i shpronësuar kompensohet sipas këtij ligji për të gjithë sipërfaqen e truallit, e cila konsiderohet e zënë.*

Në këtë rast pronari i ndërtesës i paguan shtetit, vlerën e sipërfaqes së truallit të zënë, që rezulton mbi norma sipas çmimit të tregut".

76.2.1. Edhe me dokumentin "Propozim për amendamente" me nr 2316 datë 06.07.2006 (hyrje në Kuvend), të Grupit parlamentar të Partisë Republikane, përfaqësuar nga shtetasi Arian Madhi, propozohet që pas pikës 3 të nenit 8 të shtohet pika 3.1 si më sipër cituar.

76.2.2. Çuditërisht, Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, përfaqësuar nga deputeti Arian Madhi, me dokumentin "Propozimin për amendamente", me nr 2317 datë 06.07.2006 (hyrje në Kuvend), për të cilat është bërë shënimi se, janë pranuar nga qeveria, ndryshon mendim në lidhje me nenin 8, ku parashtron propozimin e vetëm që, pika 4 e nenit 8 të shfuqizohet.

76.3. Me ligjin nr 9583 datë 17.07.2006, është vendosur përfundimisht që, në nenin 8 pikat 2 dhe 4 shfuqizohen.

I pyetur më datë 17.07.2024 në lidhje me heqjet dorë nga ndryshimet e propozuara në nenin 8, shtetasi Arian Madhi deklaroi: "...Për momentin nuk mund të jap një arsyetim të hollësishëm në lidhje me ndryshimin e propozuar përse i përket nenit 8 pasi në llogjikë dhe në përputhje të

të gjitha dispozitave me njëra tjetrën janë mbajtur parasysh hap pas hapi edhe ndryshimet e propozuara. ...”

77. Me VKM nr. 723 datë 23.11.2005 me të cilin u propozuan ndryshime në këtë ligj, u propozuan këto shtesa në nenin 14 (shih nenin 8 të VKM-së):

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/a, 1/b dhe 1/c me këtë përmbajtje:

1/a. Institucioneve shtetërore nuk u lejohej të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo në përdorim objektet shtetërore, të ndërtuara mbi troje private. Në rast se këto objekte nuk përdoren më për interesa publike, atëherë ato privatizohen, duke u siguruar pronarëve të truallit të drejtën e parablerjes.

77.1. Me dokumentin propozim për amendamente, me nr 1984 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend), Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, përfaqësuar nga deputeti Arian Madhi, është propozuar shtimi i nenit 8/1 si më poshtë:

Neni 8/1 “Trualli i zënë me ndërtime në pronësi të shtetit”

“1. I kthehet apo kompensohet subjekteve të shpronësuara, trualli privat mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme, në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit:

a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit, sipas këtij ligji, shteti detyrohet t’i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim, sipas tarifave që zbaton për dhënie me qira të trojeve shtetërore të tretëve.

...3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioneve shtetërore nuk u lejohej të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo përdorim objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private, përveç rasteve kur kontratat i shërbejnë realizimit të interesave publikë, të përcaktuar në nenin 7/1 të këtij ligji.

4. Në rast se objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private transferohen në pronësi apo në administrim të një institucioni tjetër shtetëror, e drejta e parablerjes nuk shuhet.”

77.2. Të njëjtin qëndrim, ky grup parlamentar e ka edhe me dokumentin “propozim për amendamente”, me nr 1985 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend).

77.3. Me dokumentin “Propozim për amendamente” (pranuar nga qeveria), e Grupit parlamentar të Partisë Republikane, përfaqësuar nga shtetasi Arian Madhi, me nr 2317 datë 06.07.2006 është ripropozuar formulimi i nenit të mësipërm në këtë mënyrë:

Neni 8/1 “Trualli i zënë me ndërtime në pronësi të shtetit”

1. Në ndryshim nga formulimi i nenit 7, u kthehet apo u kompensohet subjekteve të shpronësuara trualli privat mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit:

a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit sipas këtij ligji shteti detyrohet t’i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim sipas tarifave

që zbaton për dhënien me qira të trojeve shtetërore të tretëve. ...

...2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioneve shtetërore nuk u lejohet të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo përdorim objekte shtetërore të ndërtuara mbi troje private, përveç rasteve kur kontratat i shërbejnë realizimit të interesave publik, të përcaktuara në nenin 7/1 të këtij ligji...

77.4. Me ligjin nr. 9583 datë 17.07.2006, është shtuar neni 8/1 "Trualli i zënë me ndërtime në pronësi të shtetit", ku në pikën 1 gërma a parashikohet:

1. Në ndryshim nga formulimi i nenit 7, u kthehet apo u kompensohet subjekteve të shpronësuar trualli privat mbi të cilin janë ngritur ndërtime të përhershme dhe të ligjshme në pronësi të pronarit shtet, sipas rastit:

a) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit sipas këtij ligji shteti detyrohet t'i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qirasë për truallin që ka në posedim sipas tarifave që zbaton për dhënien me qira të trojeve shtetërore të tretëve.

b) Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet janë në përdorim të të tretëve, në bazë të një kontrate qiraje, koncesioni ose enfiteoze mbi truallin ku ngrihet ndërtesa apo vetë ndërtesën, veprohet:

i) kur investimi i kryer është mbi 150 për qind të vlerës së truallit, subjekti kontraktues i paguan shtetit, brenda 6 muajve, vlerën e truallit me çmimet e tregut. Shteti ia paguan menjëherë vlerën e truallit pronarit të tokës. Në rast se subjekti kontraktues nuk paguan vlerën e truallit brenda afatit të mësipërm, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili, deri në përfundim të kontratës, merr nga shteti edhe qiranë e vendosur në kontratë. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes;

ii) kur investimi i kryer është nën 150 për qind të vlerës së truallit, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, i cili merr nga shteti, deri në përfundim të kontratës, edhe qiranë e truallit që paguan subjekti sipas kontratës. Në përfundim të kontratës, pronari i truallit ka të drejtën e parablerjes së objektit.

2. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucioneve shtetërore nuk u lejohet të japin me qira, enfiteozë, koncesion apo përdorim objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private, përveç rasteve kur kontratat i shërbejnë realizimit të interesave publikë, të përcaktuar në nenin 7/1 të këtij ligji.

Në rast se objektet shtetërore të ndërtuara mbi troje private transferohen në pronësi apo në administrim të një institucioni tjetër shtetëror, e drejta e parablerjes nuk shuhet."

77.5. Pra me këto ndryshime, mund të konstatohet se është hequr kufizimi i mëparshëm që ekzistonte në nenin 8 në lidhje me kthimin e pronës, në rast se kishte ndërtime të shtetit mbi troje, kur vlera e investimit, përbënte më shumë se 150 për qind të vlerës së truallit. Investimin tashmë e lidhin vetëm kur ndërtesat janë në përdorim të të tretëve në bazë të një kontrate qiraje, koncesioni ose enfiteoze.

78. Ligji nr 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" parashikonte në nenin 11 të tij "Format e kompensimit"

78.1. Sipas dokumentit "*Propozim për amendamente*" e Grupit parlamentar të Partisë Republikane, nr. 1984 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend) është propozuar në nenin 11 shtimi i pikës 1.1 me këtë përmbajtje:..."*Në ndërmarrjet e transformuara në shoqëri anonime me aksionar shtetin, për rastet kur toka është përfshirë si kontribut në formën e kapitalit themelor të shoqërisë dhe u është njohur subjekteve të shpronësuara, bëhet transferimi i pronësisë mbi aksionet shtetërore për pjesën e kapitalit për zërin toka, në favor të subjektit të shpronësuar. Nëqoftëse shoqëria anonime nuk miraton transferimin e pronësisë mbi aksionet shtetërore, shoqëria detyrohet të blejë aksione, në të kundërt miratimi për transferimin e pronësisë konsiderohet i dhënë.*

Në rast të blerjes së aksioneve nga shoqëria, shteti detyrohet që të kompensojë menjëherë subjektin e shpronësuar për pjesën e kontributit të tij në kapitalin themelor të shoqërisë".

78.2. Ky propozim përsëritet edhe në dokumentin "*Propozim për amendamente*" me nr 2316 datë 06.07.2006 (hyrje në Kuvend), të këtij grupi parlamentar por që mesa duket, nuk ka gjetur mbështetje gjatë diskutimeve me qeverinë, për shkak se nuk gjendet i pasqyruar në dokumentat e përgatitur nga ky grup parlamentar pasi janë kryer diskutime me qeverinë e konkretisht në dokumentin me nr 1985 datë 14.06.2006 dhe në dokumentin me nr 2317 datë 06.07.2006.

79. Në ligjin 9235 të vitit 2004, parashikohej në nenin 14 "*E drejta e parablerjes*":

1. *Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuara kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato të privatizohen.*

2. *Subjektet e shpronësuara kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta e parablerjes përkundrejt kompensimit, sipas nenit 11 të këtij ligji.*

79.1.Me VKM nr. 723 datë 23.11.2005 me të cilin u propozuan ndryshime në këtë ligj, u propozuan këto shtesa në nenin 14 (shih nenin 8 të VKM-së):... 3. *E drejta e parablerjes regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.*

79.2. Me ligjin nr 9583 të korrikut 2006 u parashikua kjo shtesë.

80. Por ajo që vlen të theksohet më shumë, në lidhje me ndryshimet që solli ligji i ri, në ligjin e mëparshëm për kthimin dhe kompensimin e pronës, ka të bëjë, pikërisht me krijimin e një strukture, që do të njihet në vijim si Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në varësi nga Këshilli i Ministrave.

80.1. Në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr 9235 datë 29.07.2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronave*" parashikohej se:

Neni 15 "*Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave*"

1. *Për zbatimin e këtij ligji krijohet Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Komiteti Shtetëror përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi. Dy anëtarë propozohen nga pozita dhe dy anëtarë nga opozita parlamentare. Një anëtar i propozohet nga Këshilli i Ministrave Presidentit të Republikës, i cili e dërgon për miratim me dekret në Kuvend. Anëtari i sjellë nga Presidenti dhe i miratuar nga Kuvendi është Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.*

.... 5. *Anëtari i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave shkarkohet me vendim të Kuvendit të Shqipërisë kur...*

- a) me vendim gjykatë të formës së prerë është dënuar për një vepër penale dhe/ose është ndaluar apo pezulluar të ushtrojë detyrën si nëpunës publik;
- b) është në pamundësi fizike dhe mendore për të ushtruar funksionin e vet me raport mjekoligjor ose me vendim gjykatë;
- c) mungon katër ose më shumë herë radhazi në mbledhjen e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, pa shkaqe të arsyeshme;
- ç) vërtetohet se ka siguruar përfitime të padrejta, që lidhen me ushtrimin e kompetencave të tij;
- d) shkel nenet e këtij ligji.

Asnjë anëtar i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkaqe dhe procedura të tjera të papërmendura në këtë pikë, me përjashtim të rastit kur ai jep dorëheqjen.

Neni 16 "Kompetencat e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave" sanksiononte:

1. Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ka këto kompetenca:

- a) shqyrton dhe merr vendim për ankesat ndaj vendimeve të komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 19 të këtij ligji;
- b) merr vendime për njësimin e praktikave në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave në bazë dhe për zbatim të ligjit;
- c) emëron dhe shkarkon nga detyra kryetarin dhe anëtarët e komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave;
- ç) drejton dhe kontrollon zbatimin e këtij ligji nga komisionet vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave;
- d) propozon për miratim në Këshillin e Ministrave projektbuxhetin, strukturën organizative, organikën dhe tabelën e pagave për administratën e Komitetit shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, të komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe administratën e tyre;
- dh) mbledh dhe përpunon të dhëna për procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe raporton në Kuvend të paktën një herë në vit ose sa herë kërkohet nga Kuvendi, si dhe informon Këshillin e Ministrave me kërkesë të tij;
- e) miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij, si dhe të komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave;
- ë) përcakton dokumentacionin e nevojshëm, mbi bazën e të cilit do të kryhet njohja, kthimi dhe kompensimi i pronës;
- f) përcakton, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifën e shërbimeve që do të paguajë subjekti i shpronësuar në procesin e kthimit e të kompensimit të pronave;
- g) përcakton mënyrën e bashkëpunimit të komisioneve vendore kur prona që njihet, kthehet ose kompensohet shtrihet në dy apo më shumë juridiksione të komisioneve vendore;
- gj) përcakton mënyrën e zëvendësimit të ekspertëve ose anëtarëve të komisioneve vendore kur ata janë në kushtet e pengesës ligjore për kryerjen e veprimtarisë.

2. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave verifikon vendimet e komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave, të ngritura sipas ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Kërkesa për verifikimin e vendimeve të dhëna paraqitet në mënyrë të motivuar nga organet e qeverisjes vendore ose subjektet e shpronësuar brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Komisioni ka të drejtë të shfuqizojë vendimin administrativ të dhënë ose të kërkojë shfuqizimin e tij në rrugë gjyqësore.

3. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave shfuqizon vendimet e komisioneve vendore kur:

a) komisioni vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave ka shkelur dispozitat që rregullojnë juridiksionin dhe kompetencat e tij;

b) vendimi është dhënë mbi bazën e dokumentacionit dhe verifikimeve të paplota;

c) nuk është kërkuar dokumentacioni i nevojshëm, mbi bazën e të cilit duhet të kryhej njohja, kthimi ose kompensimi i pronës.

4. Procedura për kthimin dhe kompensimin e pronave hartohet nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe duhet të përfshijë:

a) disponimin ligjor të pronës që do të përdoret për kompensimin fizik të subjekteve të shpronësuar;

b) njohjen e së drejtës së pronësisë për subjektet e shpronësuar;

c) miratimin nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të studimeve paraprake në nivel qarku për kthimin dhe kompensimin e pronave, sipas propozimit të komisioneve vendore;

ç) botimin në Fletoren Zyrtare të vendimeve të miratuara për kthimin dhe kompensimin e pronave në nivel qarku.

81. Me VKM nr. 723 datë 23.11.2005 me të cilin Këshilli i Ministrave prezanton projekt ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës, konstatohet se propozohet vetëm që, në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 16 të shtohen fjalët "...punonjësit e administratës së Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, si dhe punonjësit e tjerë të administratës së komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, në bazë të kriterëve të konkurrimit, që përcakton ligji "Për shërbimin civil". Kryetari dhe anëtarët e Komitetit Shtetëror për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe të komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe punonjësit e tyre nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1, që ka të bëjë me sekretarin e Komitetit Shtetëror për kthimin dhe kompensimin e pronave, si drejtues i administratës së komitetit shtetëror.

81.1. Sipas dokumentit "Propozim për amandamente" e Grupit parlamentar të Partisë Republikane, nr. 1984 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend), është propozuar, kjo përmbajtje:

Neni 13 "Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave"

1. Për zbatimin e këtij ligji, krijohet Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Komiteti Shtetëror përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen, dhe shkarkohen ose lirohen nga detyra nga Kuvendi. Dy anëtarë propozohen nga shumica dhe dy anëtarë nga opozita parlamentare. Kryetari propozohet nga Këshilli i Ministrave.

...5. Anëtari i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave shkarkohet me vendim të Kuvendit të Shqipërisë. Propozimi për shkarkim bëhet nga Këshilli i Ministrave për kryetarin ndërsa për 4 anëtarët e tjerë nga jo më pak se 7 deputetë të tjerë ose një grup parlamentar në pëprthje me rregulloren e Kuvendit. Propozimin për shkak duhet të jetë i motivuar dhe i argumentuar për pamjaftueshmëri në ushtrimin e detyrës ose akte të kryera në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj. ...

Edhe me dokumentin "Propozim për amandamente" e Grupit parlamentar të Partisë Republikane, nr. 1985 datë 14.06.2006 (hyrje në Kuvend) me shënimin (pranuar nga qeveria) është propozuar e njëjta përmbajtje.

81.2. Megjithatë, me dokumentin "Propozimin për amendamente", me nr 2317 datë

06.07.2006 (hyrje në Kuvend), Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, i përfaqësuar nga deputeti Arian Madhi, parashtron disa amendamente, **për të cilat është bërë shënimi se, janë pranuar nga qeveria**, ku me nenin 7 është propozuar ndryshimi i nenit 15 në këtë mënyrë:

Neni 15 "Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave"

1. Për zbatimin e këtij ligji krijohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP), ka qendër në Tiranë dhe zyrë rajonale në çdo qark. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

a) pranon kërkesat për kthim ose kompensim, sipas këtij ligji;

b) shqyrton kërkesat dhe kontrollon vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin subjektet e shpronësuar dhe e ballafaqon atë me aktet ligjore, nënligjore ose vendimet gjyqësore, sipas nenit 2 të këtij ligji, që kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë nga shteti të pronës;

c) verifikon dhe llogarit detyrimet financiare që lindin për shtetin, subjektin e shpronësuar ose të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

ç) u konfirmon të drejtën e pronësisë subjekteve të shpronësuar, duke lëshuar dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrën e kthimit ose të kompensimit të pronësisë, sipas modelit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;

d) regjistron aktet e njohjes, kthimit ose kompensimit të pronave dhe të drejtat reale të lidhura me to në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. Për ushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, AKKP-ja bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton procedurën dhe afatet e komunikimit ndërmjet institucioneve.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuar përcaktohen nga Këshilli i Ministrave."

Ndërsa në nenin 8 të këtij dokumenti propozimesh, propozohet që përmbajtja dhe titulli i nenit 16 të ligjit në fuqi të ndryshohet në këtë mënyrë:

Neni 16 "Përgjegjësitë e zyrave në qendër dhe në qarqe"

1. Zyra e AKKP-së në qendër udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji në zyrat rajonale të qarqeve, bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim, sipas mënyrës së parashikuar nga neni 11 i këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme të njohur për t'u kompensuar, si dhe shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark. Në zbatim të përgjegjësisë të veta, për kompensimin dhe zgjidhjen e ankimeve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.

2. Zyrat rajonale të AKKP-së në qark kryejnë trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuar për njohje dhe kthim të pasurisë së paluajtshme për pasuritë me vendndodhje brenda territorit të qarkut. Drejtori i zyrës së qarkut nënshkruan vendimin për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin ose kompensimin e pasurisë dhe të drejta të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji. Në zbatim të përgjegjësisë të veta, për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimin ose kompensimin, si dhe të drejta të tjera reale, drejtori i zyrës rajonale të AKKP-së në qark shprehet me vendim.

3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushin kërkesat e parashikuara në Kodin e

Procedurave Administrative për aktin administrativ. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk ankimohet nga kërkuesi, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përmbarimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

81.2.1. Në proces verbalin e datës **07.07.2006** të Komisionit për Çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, në lidhje me ndryshimin e nenit 15 konstatohet se nga pjesmarrësit janë shprehur shqetësime se agjencia vendoset në varësi të ekzekutivit, ku krijimi dhe funksionimi i kësaj agjencie i lihet Këshillit të Ministrave. Madje janë ngritur pretendime se janë njoftuar vetëm një ditë më parë në lidhje me këtë material. Megjithatë konstatohet se nga shtetasi Fatos Beja, shfaqen shqetësime që nuk mund të lihet për sezonin e vjeshtës diskutimi pasi publiku pret.

I pyetur më datë 17.07.2004 stetasi *Arian Madhi* në lidhje me faktin se fillimisht nuk kishin propozuar krijimin e Agjencisë si institucion në varësi të Këshillit të Ministrave dhe përse ndodhi ky propozim më vonë, ai deklaroi: *“...Nuk më kujtohet saktësisht por mbase kam gjykuar që Komitetit Shtetëror të Kthimit të Pronave i mungonte operativiteti dhe kontrolli mbi veprimtarinë e tij nga organet qeverisëse që ishin përgjegjëse në programin e punës për të shpejtuar procesin në kthimin dhe kompensimin e pronave. Ndoshta kam vlerësuar që krijimi i një strukture me një varësi nga qeveria do të ishte më efektiv pasur parasysh ushtrimin e kontrollit dhe procedurat për nxitjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave...”*

81.3. Me ligjin nr 9583 datë 17.07.2006 neni 15 ndryshoi në këtë mënyrë:

Neni 15 *“Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”*

1. Për zbatimin e këtij ligji krijohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person juridik publik. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP), ka qendër në Tiranë dhe zyra rajonale në çdo qark. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kryen këto detyra dhe ka këto përgjegjësi:

- a) pranon kërkesat për kthim ose kompensim, sipas këtij ligji;
- b) shqyrton kërkesat dhe kontrollon vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin subjektet e shpronësuara dhe e ballafaqon atë me aktet ligjore, nënligjore ose vendimet gjyqësore, sipas nenit 2 të këtij ligji, që kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë nga shteti të pronës;
- c) verifikon dhe llogarit detyrimet financiare që lindin për shtetin, subjektin e shpronësuar ose të tretët, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;
- ç) u konfirmon të drejtën e pronësisë subjekteve të shpronësuara, duke lëshuar dokumentin përkatës për njohjen, masën dhe mënyrën e kthimit ose të kompensimit të pronësisë, sipas modelit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave;
- d) regjistron aktet e njohjes, kthimit ose kompensimit të pronave dhe të drejtat reale të lidhura me to në regjistrat e pasurisë së paluajtshme.

2. Për ushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, AKKP-ja bashkëpunon me institucionet që kanë në administrim pronën shtetërore ose publike. Këshilli i Ministrave, jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton procedurën dhe afatet e komunikimit ndërmjet institucioneve.

3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 16 "Përgjegjësitë e zyrave në qendër dhe në qarqe"

1. Zyra e AKKP-së në qendër udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji në zyrat rajonale të qarqeve, bën shqyrtimin fillestar të kërkesës së subjektit të shpronësuar për kompensim, sipas mënyrës së parashikuar nga neni 11 i këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme të njohur për t'u kompensuar, si dhe shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark. Në zbatim të përgjegjësiave të veta, për kompensimin dhe zgjidhjen e ankimeve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.

2. Zyrat rajonale të AKKP-së në qark kryejnë trajtimin e kërkesave të subjekteve të shpronësuara për njohje dhe kthim të pasurisë së paluajtshme për pasuritë me vendndodhje brenda territorit të qarkut. Drejtori i zyrës së qarkut nënshkruan vendimin për njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin ose kompensimin e pasurisë dhe të drejta të tjera reale, që parashikohen sipas këtij ligji. Në zbatim të përgjegjësiave të veta, për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimin ose kompensimin, si dhe të drejta të tjera reale, drejtori i zyrës rajonale të AKKP-së në qark shprehet me vendim.

3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuar, të nënshkruar nga titullari dhe të përmbushin kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative për aktin administrativ. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk ankimohet nga kërkuesi, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përbarimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

82. Përsa më sipër, dukeshëm konstatohet se me ndryshimet e bëra me ligjin 9583 datë 17.07.2006 u rrit pushteti i Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrit.

Pra, sipas nenit 15 e në vijim, të ligjit nr. 9235 të vitit 2004, krijohet Komiteti Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e pronave, i cili përbëhet nga pesë anëtarë që emëroheshin dhe shkarkoheshin nga Kuvendi, kurse komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave sipas nenit 17 përbëheshin nga pesë anëtarë që emëroheshin nga Komiteti mbi bazën e kriterëve të konkurrimit që përcakton ligji për shërbimin civil.

Tashmë pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9583 krijohet Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave si person juridik publik, ku mënyra e organizimit dhe e funksionimit të saj si dhe procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, sipas ndryshimeve të bëra në nenin 15.

Sipas VKM nr. 566 datë 23.08.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e AKKP" e cila hyn menjëherë në fuqi, VKM e miratuar më propozimin e Kryeministrit, rezulton se AKKP është në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

Sipas pikës 4 të kësaj VKM-je, organika dhe struktura e AKKP-së përcaktohen me urdhër të kryeministrit me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Sipas parashikimeve të pikës 5/1. Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësiave të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi: ...ç) Raporton, informon dhe i relaton për veprimtarinë e agjencisë ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton udhëzimet e tij;...

Sipas pikës 6, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP -së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2

zëvendësdrejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 zëvendësdrejtorët e agjencisë propozohen nga radhët e personave të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe integritet të lartë personal.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendësdrejtorin përgjegjës, i cili në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së, për çështjet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar.

Sipas pikës 7, **Drejtuësit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.** Ata përzgjidhen ndërmjet kandidatëve, shtetas shqiptarë, të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

Sipas pikës 9, **Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën,** të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ku ndërmjet të tjerave evidentohet se raportohen edhe: ...gj) të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të Drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit. ...

Ndërkohë, sipas pikës 10, Drejtori i zyrës rajonale u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe Prefektit të Qarkut. Raporti përmban ndërmjet të tjera sipas gërmeës e) të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të zyrës rajonale, duhet të vihet në dijeni drejtori i Përgjithshëm apo prefekti.

82.1. Për projektvendimin që lidhet me VKM-në e sipërcituar, konstatohet se është përgatitur një relacion ku një ndër pikat e diskutuara ka qenë se në varësi të kujt ministrie do të ishte AKKP-ja apo nëse duhet të ishte në varësi të Kryeministrit. Në këtë relacion pasi ofrohen arsyet përse mendohen disa ministri nga të cilat mund të kishte varësi AKKP-ja, arsyetohet edhe në lidhje me faktin se përse kjo agjensi do të ishte më mirë e varur nga Këshilli i Ministrave. Sipas këtij parashtrimi, kryeministri ka vullnet që të mbiqkyrë mënyrën e veprimtarisë së agjencisë nëpërmjet strukturës së Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, ndërsa drejtimi të jetë në varësi të ministrit.

Në vijim në pëprthje me ligjin nr 9000 datë 23.01.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave*" parashikohet që organika dhe struktura e AKKP-së, qendër dhe zyrat rajonale të përcaktohet me urdhër të Kryeministrit. ...Parashikhet që Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së të emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozim të institucionit që do të ketë në varësi AKKP-në...ndërsa dy zëvendës drejtorët do të emërohen, lirohen a shkarkohen nga Kryeministri, sipas të njëjtës formulë propozimi si drejtorët e përgjithshëm. ...Këshilli i Ministrave brenda 3 muajve nga konstituimi i Agjencisë do të miratojë rregulloren e brendshme e funksionimit të saj.

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, Genc Ruli, me shkresën nr 5989/1 prot dt 09.08.2006 ka dhënë këto sugjerime: "*...Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të jetë në varësi të Kryeministrit, pasi kështu s'gurohet një bashkëpunim më i shpejtë me një numër të madh strukturash në varësi të shumë ministrave dhe në këtë mënyrë Kryeministri ushtron vullnetin dhe kompetencat e tij, me anën e mbikqyrjes së drejtëpërdrejtë mbi këtë Agjensi. ...Në lidhje me pikën e dytë...këto janë marrëdhënie që parashikohen në rregulloren e kësaj agjencie, e cila do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.*

Në lidhje me pikën 4 të këtij projekt vendimi, mendojmë se struktura dhe organika e AKKP-së të miratohet nga Kryeministri.

...emërimi, lirimi dhe shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, të bëhet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Kryeministrit, ndërsa dy zëvendës drejtorët të emërohen, lirohen apo shkarkohen nga kryeministri me propozim të drejtorit të përgjithshëm të kësaj agjencie. Kurse emërimi, lirimi apo shkarkimi i drejtuesve të zyrave rajonale, të bëhet nga drejtori i përgjithshëm i agjencisë...".

Me shkresën nr 6170/1 prot datë 09.08.2006 Ministri i Drejtësisë, ka dhënë mendimin mbi projekt vendimin "...zgjidhja më e mirë legislative do të ishte varësia e Agjencisë...nga Kryeministri...vendosja e kësaj agjencie nën autoritetin e Kryeministrit ...do të ndikojë në një masë të dukshme në suksesin e përfundimit të reformës së kthimit dhe kompensimit të pronave mbi bazën e parimit të barazisë dhe drejtësisë sociale...". Madje ky ministër ka sugjeruar që mbikqyrja të kryehet nga Departamenti i Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit.

Me shkresën nr 8228/1 prot datë 15.08.2006 edhe ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Lulzim Basha ka dhënë mendim se AKKP duhet të jetë në varësi të Kryeministrit.

Ndërkohë, ministri Brendshëm, i ndjeri Sokol Olldashi ka dhënë mendimin se në fakt kjo agjenci duhet të jetë në varësi të Ministri të Drejtësisë, mendim ky që duket se është i njëjtë me atë të dhënë nga OSBE.

83. Gjithashtu, neni 19 i ligjit nr. 9235 të vitit 2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*" pika 1, kishte parashikuar që, subjektet e shpronësuara për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, **kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e reja brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.** Ky ligj është botuar në FZ me nr. 61 datë 31.08.2004 duke hyrë në fuqi kështu, më datë 15.09.2004 ndërkohë që afati i bie të ketë qenë deri më datë **15.09.2005** për të paraqitur kërkesa për kthimin e pronës. Sipas ndryshimeve me ligjin nr. 9388 datë 04.05.2005 afati është bërë brenda 2 viteve, duke shkuar kështu ky afat deri më **15.09.2006.**

83.1. Nga aktet e administruara, konstatohet në fakt se, Këshilli i Ministrave me VKM nr 723 datë 23.11.2005, propozoi ndryshime në ligjin nr 9235 të vitit 2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*" duke propozuar në nenin 12, që në fund të pikës 1 të nenit 19 të shtohen fjalët "*...me përjashtim të rasteve kur për shkaqe të përligjura, me vendim gjyqësor, është vendosur rivendosja në afat e paraqitjes së kërkesës...*".

Konstatohet se sipas proces verbalit nr 42 datë 21.02.2006, Komisioni për veprimtarinë prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, projekt ligji i propozuar është miratuar në parim.

Gjithashtu edhe sipas proces verbalit të datës 22.02.2006, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, neni 12 është votuar dhe të gjithë kanë qenë dakord, duke e miratuar.

Edhe në proces verbalin e Komisionit për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, është përcaktuar se është miratuar neni 12 ashtu si është propozuar nga qeveria.

Me Propozimin për amendamente, nga deputeti Arian Madhi, Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, përpara Komisionit parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, me nr 2317 datë **06.07.2006** (hyrje në Kuvend) parashtron disa amendamente, për të cilat është bërë shënimi se, janë pranuar nga qeveria, ku me nenin 9 është propozuar

ndryshimi i nenit 17 duke u përcaktuar aftet tashmë në nenin 17 dhe është parashikuar që subjektet e shpronësuara për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të depozitojnë kërkesa të reja **deri në datën 01.10.2007**. Ky propozim nuk është ndjekur nga asnjë koment.

Në proces verbalin e datës 07.07.2006 të Komisionit për Çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, me kryetar komisioni shtetasin Fatos Beja, në momentin që është hedhur në votim neni 9, shtetasi Besnik Dervishi ka marrë fjalën duke diskutuar në lidhje me nenin 7, dhe duke parashtruar se Agjensia e Kthimit të Pronave vihet në varësi të ekzekutivit. Në vijim shtetasi Fatos Beja ka vijuar me nenin 10, duke u anashkaluar pra neni 9, përsa i përket afatit.

Këto ndryshime të ligjit për kthimin e pronës, shihet se u vijnë në ndihmë familjeve pronare, të cilat deri në këtë kohë nuk kishin paraqitur kërkesa për kthimin e pronës. Kështu, me ligjin nr. 9583 datë 17.07.2006, ligj i miratuar me propozimin e Këshillit të Ministrave, ky afat, në nenin 17 pika 1 u ndryshua, pasi u përcaktua se subjektet e shpronësuara për fitimin e të drejtave të parashikuara nga ky ligj, kanë të drejtë të depozitojnë kërkesa të reja **deri në datën 1 tetor 2007**. Ky ligj është botuar në FZ nr. 81 datë 02.08.2006 duke hyrë kështu në fuqi më datë 17.08.2006.

Kthimi i pjesës tjetër të pronës familjeve të njohura pronare

84. Pikërisht pasi Kryeministri, i cili në këtë kohë rezulton të ketë qenë shtetasi Sali Berisha, ka marrë pushtet të mjaftueshëm në lidhje me Agjensinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, emëron në detyrë si Drejtoreshë të Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shtetasen Justina Boriçi.

84.1. Në deklarinimin e datës 26.09.2023 shtetësja **Justina Boriçi**, parashtron: “...Unë jam emëruar si drejtoreshë e përgjithshme e Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në muajin gusht 2006 deri më 27.06.2007. ... Në muajin gusht të vitit 2006 më ka thirrur kryeministri Sali Berisha, i cili më ka bërë të ditur se isha emëruar si drejtoreshë e përgjithshme e Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Unë kam qenë anëtare e Partisë Demokratike, kam qenë e organizuar, dhe nëpër mbledhje isha njohur edhe me kryeministrin Sali Berisha. ... kryeministri e dinte se kush isha. Sqaroj se në korrik 2006 unë u emërova nga Ministria e Bujqësisë, drejtoreshë e Qendrës së Transformimit (QTTB) ku ishte bashkuar Instituti, Instituti i Zooteknisë dhe Instituti i Foragjerëve, Pas kësaj, pas një muaji, pra në gusht 2006, më kërkoi Sali Berisha. Më tha Ministri i Bujqësisë Emin Gjana dhe më bëri me dije se më kërkonte kryeministri. Mua më erdhi pak e habitshme. E kam takuar kryeministrin Sali Berisha, në zyrën e tij në Kryeministri dhe ai më bëri me dije se më kishte emëruar si drejtoreshë e Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. ...”

84.1.1. Shtetësja Justina Boriçi emëron më pas, drejtoreshën e Zyrës Rajonale të AKKP, shtetasen **Dhurata Hoxha (Çela)**, me urdhërin nr. 203 datë 09.10.2006. Kjo shtetase qëndron në detyrë deri më datë 02.08.2007.

Në deklarinimin e dt 26.09.2023, shtetësja **Justina Boriçi** deklaron: “...Unë nuk e njihja Dhurata Hoxhën dhe emërimi i saj mesa më kujtohet ka ardhur me rekomandim por nuk më kujtohet se kush saktësisht e ka rekomanduar. Përgjithësisht rekomandimet vinin nga lart që mund të ishte zëvendës kryeministri por në rastin konkret nuk di të jap një përgjigje të saktë. ...”

85. Gjithashtu nga shtetësja Justina Boriçi emërohen edhe punonjës të tjerë që rezultojnë më

pas pjesmarrës kryesorë në përgatitjen dhe kthimin e pronës familjes Begeja dhe familjeve të tjera.

Kështu rezulton se, shtetasi **Altin Ceni**, ka filluar punë sipas urdhërit nr. 246 datë **01.11.2006** "Për emërim në detyrë" të drejtorit të përgjithshëm Justina Boriçi, në detyrën e specialistit në Sektorin Juridik.

Me urdhërin nr. 248 datë **01.11.2006** "Për emërim në detyrë" të drejtorit të përgjithshëm Justina Boriçi, rezulton se është emëruar në detyrën përgjegjëse në sektorin juridik shtetësja **Tetis Lubonja**. Sipas të dhënave të deklaruara prej vetë asaj më datë 15.06.2023, ajo ka miqësi të vjetër me shtetasin Jamarbër Malltezin të cilin e ka njohur prej vitit 1992 dhe ka pasur dijeni që ishte një nga trashëgimtarët e familjes Begeja. Gjithashtu ka njohur edhe shtetasen Rudina Llagami, e të cilën deklaroi se ka punuar në Kryeministri.

Për më tepër, shtetësja Tetis Lubonja, ka deklaruar, se ka punuar pranë kësaj zyre vetëm 10 muaj dhe më pas është larguar me kërkesën e saj dhe është ripunësuar pranë Ministrisë së Integritimit Europian. Megjithatë nga të dhënat e hetimit, rezulton se kjo shtetase, ka pasur marrëdhënie punësimi pikërisht me shoqërinë Kontakt sh.p.k. që zhvillon ndërtimet në këto prona që kthehen. Ajo shfaqet në listë pagesat e kësaj shoqërie, përgjatë periudhës tatimore 2009, ose pa përshkrim në lidhje me pozicionin që mban ose si punëtore.

86. Me VKM nr. 747 dt 09.11.2006 "Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit apo Kompensimit të Pronës", botuar në FZ nr 121 dt 24.11.2006, pasqyrohen edhe procedurat përkatëse si do të veprohej me kërkesat e shtetasve.

Kështu në pikën 1 përcaktohet se *Subjektet e shpronësuara, sipas përcaktimit të nenit 3 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, paraqesin pranë zyrave rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në qark kërkesën e argumentuar për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës, si dhe dokumentacionin e nevojshëm, me të cilin provojnë pretendimet e tyre. ...*

Në kreun II, *Administrimi i kërkesave*, sanksionohet:

1. *Subjektet e shpronësuara mund të depozitojnë kërkesën/ankesën për njohje, kthim apo kompensim të pronës, si dhe dokumentacionin shoqërues të saj, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në zyrat e AKKP-së, në qendër apo qark, apo nëpërmjet shërbimit postar.*

2. *Çdo subjekt i shpronësuar vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm dhe dorëzimit të kërkesës, në mënyrë të drejtpërdrejtë, në sekretarinë e zyrave rajonale të AKKP-së, në qark apo në qendër, do të pajiset me vërtetimin përkatës, për numrin e protokollit të dosjes së regjistruar. Ky vërtetim ka numrin e protokollit të kërkesës, që i është vënë në çastin e dorëzimit në organet kompetente.*

3. *Kërkesat e subjekteve të shpronësuara, të cilat administrohen nëpërmjet shërbimit postar dhe kanë mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor, shoqërues të saj, gjë e cila bën të pamundur vlerësimin e tyre, do t'i kthehen kërkuarit në adresën e dhënë, duke i sqaruar dhe kërkuar plotësimin e dokumentacionit, sipas kërkesave të këtij vendimi. Kërkesa, së cilës i mungon adresa e saktë postare, vlerësohet jo e mirëqenë dhe riaktivizohet vetëm me interesimin e kërkuarit pranë zyrave të AKKP-së, në qendër apo qark.*

Në kreun III. *Përpunimi i dokumentacionit*, sanksionohet:

1. Zyra e AKKP-së, në qark apo qendër, në varësi të objektit të kërkesës, plotëson dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e pronave të paluajtshme, që do të njihen, kthehen apo kompensohen, duke kërkuar dokumentet e nevojshme nga institucione të treta, për vërtetimin e gjendjes, juridike apo fizike, të pronës, si dhe konfirmimin e dokumentacionit tekniko-ligjor. Ky dokumentacion, sipas rastit, do të kërkohet nga njëra ose disa nga institucionet e mëposhtme:

a) zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), për gjendjen juridike të pronës;

b) njësitë e qeverisjes vendore, për pronat, që i shërbejnë një interesi publik dhe për të cilat bëhet propozimi për tjetërsim;

c) bashkia (drejtoria e përgjithshme e urbanistikës), komuna, këshilli i qarkut (drejtoria e urbanistikës apo njësitë e legalizimit, për konfirmimin e gjendjes së trojeve dhe të ndërtesave;

... d) ministri/at dhe institucionet e tjera shtetërore;

dh) Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale;

e) Enti Kombëtar i Banesave;

ë) Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

f) çdo institucion tjetër shtetëror, i cili ka në administrim pronën apo që mund të japë informacion për të.

2. Të gjitha kërkesat për njohje dhe kthim, të paraqitura pranë zyrave të AKKP-së, në qendër apo qark, shqyrtohen sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre. Mënyra e trajtimit, shqyrtimit dhe e dhënies së vendimit për kërkesat apo ankesat e subjekteve të shpronësuar, bëhet në përputhje me nenet 15, 16, 17 e 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me vendimin nr.566, datë 28.8.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave", si dhe me aktet e brendshme, të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së.

87. Konstatohet se, pikërisht pas daljes së VKM-së së mësipërme, në muajin nëntor 2006, familjet Alimehmeti, Vaqarri, Saliaga dhe Llagami dhe në muajin dhjetor 2006 familja Begeja, paraqesin kërkesa pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Të gjitha kërkesat, duket me sy të lirë, që janë përpiluar sipas një formati të caktuar, që shkon në përputhje me deklaratimet e anëtarëve të familjeve të njohura pronare, mbi diskutime të përbashkëta. Këto familje, kishin kohë deri në muajin shtator 2006 për të paraqitur kërkesat për kthimin e pronës dhe mund ta kishin bërë në çdo muaj, para gushtit 2006. Megjithatë pritën pikërisht hyrjen në fuqi të ligjit nr 9583 datë 17.07.2006. Përse të gjitha këto familje pritën deri në muajin nëntor e dhjetor 2006, për të paraqitur kërkesat për kthimin e pronës?

I pyetur më dt 23.02.2024, shtetasi **Blendi Marika**, një prej trashëgimtarëve të familjes Alimehmeti, deklaroi se, *takimet me familjet e tjera pronare ish pronare, në fillim, para privatizimit i realizonim në kafe dhe pas privatizimit në zyrat tek Klubi i Futbollit Partizani. Kërkesa për kthimin e truallit mesa kujton është bërë në një kërkesë të vetme pasi ky ka qenë qëllimi i mbledhjes së bashku të të gjitha familjeve ish pronare që të vepronin të gjitha në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën mënyrë.*

I pyetur më dt 28.04.2023, shtetasi **Fatmir Bektashi**, në lidhje me arsyen e kohës së bërjes së kërkesave për kthimin e tokës pikërisht në vitin 2006 – 2007, ka deklaruar se: *...Në vitin 2006 – 2007 jemi mbledhur...të gjithë përfaqësuesit e familjeve ish pronare dhe kemi përgatitur kërkesat për kthimin e tokës. I përgatitëm kërkesat në këtë kohë për kthimin e tokës sepse atëherë u bëmë të vetëdijshëm që duhet ta kërkonim tokën dhe nuk duhet ta falnim...*

Shpjegimi në fakt, nuk gjendet tek ndërgjegjësimi se duhet ta kërkonin tokën por gjendet, në ndryshimet që solli ligji nr 9583 datë 17.07.2006, në ligjin nr 9235 datë 29.07.2004 "Për

kthimin dhe kompensimin e pronës”, ku pronat e Ministrisë së Mbrojtjes u bënë të disponueshme për kthim, ku AKKP u vendos nën kontrollin e kryeministrit etj.

Kërkesat e këtyre shtetasve, merren në shqyrtim thujtë menjëherë, ku në muajin janar 2007 nisin korrespondencat me institucionet, për të konkluduar brenda tre muajve, për pjesën dërrmuese të këtyre familjeve, me vendimmarrje.

E pyetur më datë 15.06.2023, shtetësja *Tetis Lubonja*, ka deklaruar: “...Për një periudhë gati 6 mujore mbaj mend që zyra nuk ka nxjerrë vendime. Kur ka nisur të nxjerri vendime **këto kanë qenë nga dosjet e para që na janë dhënë për t’u shqyrtuar dhe vazhduam shqyrtimin...**”. E pyetur nëse kanë pasur ndonjë ndikim nga eprorët ose persona të tretë për të përshpejtuar procedurën e kthimit të këtyre pronave, ajo është përgjigjur: “**Na është thënë nga Drejtori i Zyrës, e cila ka qenë shtetësja Dhurata Hoxha se këto do të ishin dosjet e para që do të shqyrtoheshin dhe ne kemi zbatuar urdhërin e saj**”.

88. Ndërkohë familja Begeja konstatohet se pas ndryshimit të destinacionit, merr masa të menjëhershme për të proceduar me zhvillimin e ndërtimit, mbi pronën tashmë të njohur dhe të kthyer. Kështu rezultojnë një gen plan (*shih dosjen me nr. 2653 vendimi datë 06.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*), me shënimin: *I porositur nga Xhimi Begeja, nr. 10992 dt. 23.12.2006*, në të cilin konstatohet se në fund janë bërë këto shënime: *....Ky gen plan vlen vetëm për leje ndërtimi. Pjesa e ngjyrosur është zona e azhornuar. Sipas planit rregullues destinacioni i zonës së azhornuar është zonë sportive. Në këtë zonë nuk ka studim urbanistik të miratuar...Kërkesa e sheshit të shoqërohet me studim urbanistik pjesor. Konstatohet se ka një tabelë (legjendë) ku paraqitet data 16.01.2007 dhe nënshkruar nga Drejtori i Urbanistikës Ligjore Kozeta Gëdeshi, Drejtori i projekt infrasktrukturës Muhamet Kruja, Drejtorja e Planit Rregullues Ariela Kushi, Kadastra Urbane Natasha Lilaj, Azhornoi F.Papuli dhe H.Korbi dhe vizatoi L.Pllumbi.*

89. Por tashmë që shtetasit Jamarbër Malltezi që prej muajit korrik 2006, i kishin lindur të drejta mbi një sërë pronash edhe të gjyshes së tij, të ndjerës Nimete, trashëgimtarët Begeja, nisin menjëherë kërkesat për kthimin e pronës për pjesën e mbetur. Por interesi nuk ishte vetëm tek kthimi i pronës familjes Begeja, por për të gjithë territoret ku shtriheshin dy klubet Partizani, që do t’i jepnin jetë siç rezultojnë në vijim, shumë ndërtimeve.

Kthimi i pronave familjes Begeja

90. Me kërkesën dt **15.12.2006**, (*identifikuar si dosja me nr 2 dhe kërkesa me nr. 2 prot dt 20.12.2006*) për kthimin dhe kompensimin e pronës, të nënshkruar nga shtetasi **Bashkim Bekteshi**, (*si përfaqësues me prokurën nr. 1007 rep nr 262 kol dt 13.03.2002*), është kërkuar **kthimi i truallit të njohur**, të sipërfaqes së mbetur, prej 13 925 m², që ndodhet pranë Sport Klub Partizani. Shtetasi Bashkim Bekteshi ka paguar sipas mandat arkëtimit nr. 86 dt 20.12.2006 shumën prej 3 000 lekësh.

Bashkalidhur kërkesës, parashtron se, paraqet hartë e planvendosjes 1937, hartë e planvendosjes 2006, kërkesë AKKP, Dëshmia e trashëgimisë, prokura e posaçme, fotokopje pasaporte, vendimi 532 datë 25.04.1995 dhe vërtetime hipotekore nr. 25, 26, 27 datë 16.03.2006. Këto dokumenta të dorëzuara janë konfirmuar edhe nga pranuesi Mustafa Lila.

Kërkesa që ndodhet në këtë dosje është e ngjashme me atë të familjes Alimhemeti dhe Saliaga.

Me deklaratën datë **18.12.2006** shtetasi Bashkim Bekteshi (si përfaqësues nëpërmjet prokurës nr. 1007 rep nr. 262 kol datë 13.03.2003) ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes për objektin shtetëror të ndërtuar mbi truallin e njohur nga vendimi i zyrës rajonale të AKKP/Komisioni vendor i kthimit dhe kompensimit të pronave. (nuk përcaktohet se cili vendim). **Gjithashtu konstatohet se si email është vendosur xhibeg1900@yahoo.com dhe adresa Gjergj Fishta, kulla 8, kati 10, tel.fax 04236371.**

Pra, adresa e emailit që vendoset më sipër, evidentohet se mban gjeneralitetet identifikuese të shtetasit Xhimi Begeja, ashtu si edhe adresa e ndodhur në Bulevardin "Gjergj Fishta" që është një adresë e vendosur edhe më herët në kërkesën e datës 06.01.2006 drejtuar Ministrisë të Mbrojtjes. Shtetasi Xhimi Begeja, paraqitet në vijim, një bashkëpunëtor i ngushtë me shtetasin Jamarbër Malltezi.

90.1. Konstatohet se, grupi i punës që është ngarkuar me shqyrtimin e kësaj dosje, është shtetasi Altin Ceni (jurist), Petrit Kullolli (topograf) dhe Tetis Lubonja (përgjegjëse e sektorit juridik). Ky grup pune konstatohet se ka filluar menjëherë nga puna, për të punuar me dosjen e sipërcituar.

Shtetasi **Petrit Kullolli** i pyetur më datë 26.05.2022 ka deklaruar se, shtetasin *Jamarbër Malltezi* nuk e njeh dhe nuk e ka takuar asnjëherë, e njeh vetëm nga mediat. Por siç rezulton në vijim, ky shtetas ka përpiluar plane rievrimi për pasuritë e shtetasit Jamarbër Malltezi të ndodhura në Priskë.

Me shkresën nr. 40 prot datë **08.01.2007** ZRKKP Tiranë, i ka kërkuar informacion **Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore** pranë Bashkisë Tiranë, konkretisht dhënien e fragmentit të hartës të zonës, studimit urbanistik të miratuar dhe konfirmimin nëse prona është e lirë për t'u trajtuar. Bashkalidhur pasqyron se i ka dërguar edhe planvendosjen e pronës së pretenduar. Bashkia Tiranë, me shkresën nr. 121/3 prot datë 14.02.2007 (*hyrje me nr. 40/1 prot datë 15.02.2007*) ka kthyer përgjigje se dërgojnë dy kopje të fragmentit nga Planimetria e Tiranës, shk. 1: 500 viti 1993 ku ndodhet prona e pretenduar e ish pronarit Mahmut Xhemal Begeja. Nga informacioni i dhënë nga Njësia e Planit Rregullues bëjnë me dije se, zona për të cilën interesohet KKKP është **pjesërisht zonë sportive dhe zonë banimi dhe sipas planit të përgjithshëm rregullues (për të cilën nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar) dhe pjesërisht përfshihet në studimin urbanistik pjesor të miratuar me vendim të KRRT Tiranë nr. 76 datë 18.03.2005.** Bashkalidhur vendosin një fragment të Planit të Përgjithshëm Rregullues si dhe një fragment të studimit urbanistik pjesor të lartpërmendur ku ndodhet zona në fjalë.

Me shkresën nr. 41 prot dt **09.01.2007**, ZRKKP Tiranë, i ka kërkuar informacion **ZVRPP-së** duke i kërkuar konfirmimin e gjendjes juridike të pronësisë së vijëzuar në planvendosjen bashkalidhur. ZVRPP ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 115/1 prot dt 19.01.2007 duke bërë me dije pronarët e pasurive. Gjithashtu konstatohet se në dosje është administruar edhe shkresa nr. 115/2 (korrigjuar 3) prot dt **15.03.2007** ZVRPP Tiranë, e cila ka kthyer sërish përgjigjes AKKP duke e bërë me dije se në vijim të përgjigjes së tyre me nr. 115 prot dt 11.01.2007 informojnë mbi gjendjen e pasurive të tjera të cilat përfshihen brenda zonës së vijëzuar nga ana e AKKP.

90.2. Me shkresën/kërkesë datë **17.01.2007**, shtetasi **Bashkim Bekteshi**, i drejtohet shtetasës Dhurata Hoxha, AKKP-së duke kërkuar të kthehen në natyrë trojet e lira që janë përdorur si terrene sportive të Sport Klub Partizanit dhe që nuk janë të zëna me objekte. Pasqyrohet se

Sport Klub Partizani ka qenë në pronësi të MM dhe kjo e fundit me shkresën nr. 9543/3 prot datë 14.11.2005 i është drejtuar METE duke i kërkuar privatizimin e këtyre terreneve meqë nuk i shërbejnë më interesave të publikut dhe nuk përdoren më prej saj. **Bashkalidhur shprehet se i ka dërguar edhe shkresën nr. 9453/3 prot datë 14.11.2005 e MM, fotokopje.**

Nga aktet rezulton se, shkresa e cituar si më sipër e Ministrisë së Mbrojtjes mban numrin 9549/3 prot datë 14.11.2005 dhe paraqitet në fotokopje, e panjehsuar me origjinalin që mban nr. hyrje në Ministrinë e Ekonomisë 280/2 datë 14.11.2005. Shkresa e datës 17.01.2007 e paraqitur nga shtetasi Bashkim Bekteshi, nuk konstatohet të mbajë ndonjë numër protokolli hyrës në ZRAKKP Tiranë dhe megjithë kqyrjet e realizuara, pranë Agjensisë së Trajtimit të Pronave, nuk rezulton të gjendet e regjistruar në institucion, duke konkluduar se kjo shkresë është dorëzuar dorazi. Për më tepër, ajo që është për t'u theksuar, është se ky shtetas, konstatohet se disponon një shkresë të Ministrisë së Mbrojtjes, drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe jo subjekteve të interesuara, siç mund të jenë familjet pronare, duke vërtetuar faktin, se kjo shkresë i është vënë në dispozicion privatisht.

ZRAKKP menjëherë pas njohjes me fotokopje të kësaj shkrese, e cila siç mund të konstatohet nuk shihet të jetë as e njehsuar me origjinalin dhe as origjinale, vendos t'i kërkojë informacion Ministrisë së Mbrojtjes, por duke i sjellë në vëmendje përmbajtjen e shkresës së dorëzuar nga shtetasi Bashkim Bekteshi, pa sqaruar as burimin se si kanë ardhur në posedim të saj. Kështu, me shkresën nr. 104 prot datë 18.01.2007 AKKP i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes Fatmir Mediu, duke kërkuar konfirmimin e gjendjes juridike nëse prona është e lirë dhe ndërkohë i bën me dije se Ministria është shprehur një herë, referuar shkresës me nr. 9548/3 prot datë 14.11.2005 drejtuar METE të cilën ia ve edhe bashkangjitur. Bashkalidhur në fakt, konstatohet shkresa fotokopje me nr. 9549/3 prot datë 14.11.2005 e Ministrisë së Mbrojtjes Fatmir Mediu, që i është adresuar METE-s, Ministrisë Genc Ruli, ku i parashtron se në përgjigje të shkresës së këtij të fundit me nr. 280/1 datë 31.10.2005 për prononcimin lidhur me qëndrimin ndaj objekteve dhe terreneve sportive të Klubit të Futbollit Partizani, shprehen se propozojnë miratimin e privatizimit të objekteve dhe terreneve sportive të tij, duke mirëpritur sugjerimet në lidhje me forma të tjera. Bashkalidhur lista e inventarit të pronës nr. 11, Klubi i Futbollit Partizani.

Ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, me shkresën nr. 349/2 prot dt 25.01.2007 (hyrë në dt 31.01.2007 në ZRKKP) i kthen përgjigje ZRKKP duke konfirmuar që Ministria e Mbrojtjes nuk e përdor më këtë pronë, ndaj ka mbetur jashtë destinacionit të veprimtarisë së saj. Për pasojë prona e inventarizuar me nr. rendor 11 dhe me emërtesë Klubi Sportiv Partizani është e lirë të trajtohet sipas legjislacionit në fuqi. Bashkalidhur është Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore për Klubin e Futbollit Partizani me sip. 28 000 m², me ent përgjegjës administrimi MM, Klubi Shumësportesh Partizani i njëjtë edhe enti përdorues.

Ministria e Mbrojtjes, angazhohet edhe me një shkresë tjetër drejtuar ZRAKKP Tiranë. Konkretisht me shkresën nr. 349/3 prot datë 09.03.2007 (hyrë me nr 104/2 prot datë 16.03.2007 pranë ZRKKP) të nënshkruar nga drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, shtetasi Shkëlzen Madani (i emëruar me urdhërin nr 18 datë 11.01.2007 të Ministrisë së Mbrojtjes Fatmir Mediu), i kthen përgjigje ZRKKP dhe për dijeni Komandës Mbështetëse duke theksuar në vazhdim të korrespondencës se me shkresën nr. 9548/3 datë 14.11.2005 drejtuar METE -s janë shprehur parimisht për vazhdimin e procedurave të privatizimit. Për t'i hapur rrugë procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe për të mos krijuar përplasje (mbivendosje) në pronësi, kërkojnë që të gjitha

kërkesat, në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të bëhen pas miratimit të Ministrisë.

Shtetasi Shkëlzen Madani, rezulton me urdhërin nr. 18 dt 11.01.2007 të ministrit Fatmir Mediu, që të ketë qenë drejtor në drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe të jetë emëruar më datë 15.01.2007 si drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes.

90.3. Më dt **09.03.2007**, rezulton se është mbajtur një akt verifikim, nga shtetasit Altin Ceni dhe Petrit Kullolli ku parashtrohet se akt verifikimi u krye **edhe në prani të subjektit të shpronësuar ose të përfaqësuesit të tij me prokurë shtetasit Bashkim Bekteshi. Megjithatë nga akti rezulton se, ky i fundit nuk ka nënshkruar.**

Në këtë akt verifikimi parashtrohet se prona e pretenduar, ka sipërfaqen 14360 m², ndodhet ne rrugën Frosina Plaku, ZK 8220, Tiranë dhe jepen edhe kufizimet. Nga verifikimi në terren i pronës, gjendja aktuale rezulton: Sipërfaqe e pretenduar është 14 360 m²; Sip e zënë 1764 m²; Sipërfaqe e lirë është 12 596 m² e ndarë në sip. të lira dhe të lira nën objekte.

Topografi *Petrit Kullolli* i pyetur në dt 05.10.2023, në lidhje me shprehjen "*sipërfaqe e lirë nën objekte*" nuk di të japë shpjegime duke pretenduar se është term juridik, megjithëse nga ana tjetër pretendon se ka kryer arsimin e lartë juridik dhe për topografinë ka ndjekur kursin dy vjeçar.

Gjithashtu, ky shtetas, pretendon se, kur ka shkuar për verifikimin në vend, **nuk ka konstatuar ekzistencën e ndonjë objekti si banda apo orkestra e ushtrisë dhe as ndonjë objekt me funksion aktivitet sportiv**, gjë që bie ndesh në fakt, me pretendimet e përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes, se janë përballur me përfaqësues të shoqërisë Partizani sh.a.

Në të kundërt nga sa ka pretenduar shtetasi Petrit Kullolli, shtetasi *Altin Ceni* i pyetur më datë 28.09.2023, nëse ka ekzistuar ndonjë klub që ushtronte aktivitet sportiv, është përgjigjur se ... **Ishte fakt i njohur nga ana jonë që aty ishte Klubi Sportiv Partizani, dhe kur vajtëm në terren e konstatuam, por kjo gjë evidentohet edhe në përgjigjen e Ministrisë së Mbrojtjes.**

90.4. Është përgatitur **relacioni**, nga grupi i punës Altin Ceni dhe Petrit Kullolli, datë **12.03.2007** nën mbikqyrjen e përgjegjëses së sektorit juridik Tetis Lubonja, me të cilin është sugjeruar pranimi i kërkesës, **plotësimi i vendimit nr. 532 datë 25.04.1996 të KKKP Tiranë**, duke i kthyer subjektit të shpronësuar Mahmud e Xhemal Begeja, sip e truallit, siç paraqiten në plan vendosje.

Siç konstatohet, **relacioni i mësipërm është përgatitur pa u administruar shkresa me nr. 349/3 prot datë 09.03.2007 e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka hyrë në ZRAKKP Tiranë më datë 16.03.2007. Megjithatë, konstatohet se kjo shkresë është përmendur në faqen e dytë të relacionit në paragrafin e fundit.**

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me shkresën nr. 115/2 datë 15.03.2007 të ZRPP Tiranë, e cila siç shihet nga vetë data, nuk mund të ketë qenë e administruar që më datë 12.03.2007, datë të cilën është përgatitur relacioni (pra ky i fundit është përgatitur pa u pritur përgjigja).

Sa më lart, konkludohet se data që mban relacioni është një datë e vendosur fiktivisht.

90.5. Nga grupi i punës, i përbërë nga juristi Altin Ceni, topografi Petrit Kullolli dhe mbikqyrur dhe pranuar nga përgjegjësi i sektorit juridik Tetis Lubonja, është përgatitur edhe vlerësimi ligjor me nr. 2/2 prot datë 19.03.2007, drejtuar drejtorit të ZRAKKP shtetases Dhurata Hoxha, duke pasqyruar propozimin që të plotësohet vendimi nr. 532 datë 25.04.1996 të KKKP Tiranë, duke i kthyer subjektit të shpronësuar Mahmud dhe Xhemal Begeja (trashëgimtarëve të tij) sipërfaqet e truallit, siç paraqiten në planvendosjen përkatëse.

90.6. Është përgatitur projekt vendimi nr. 2/3 prot datë 19.03.2007, nënshkruar grupi i punës dhe përgjegjësi i sektorit juridik.

Me vendimin Nr. 6 datë 21.03.2007, te Komisionit Kthim Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve, (Drejtor i Zyrës Rajonal të AKKP-së së Qarkut Tiranë, Dhurata Hoxha) është vendosur: T'i kthehet subjektit të shpronësuar Mahmud dhe Xhemal Begeja, nga sipërfaqja e e pronës së njohur, prej 14 360 m² një sipërfaqe prej 12,596 m²:

Sip nën objekte 2 298 m² (Sobj1 = 460 m²; Sobj2 = 685 m²; Sobj 3 = 680 m²; Sobj 4 = 19 m²; Sobje 5 = 47 m²; Sobj 6 = 27 m²; Sobj7 = 380 m²),

sipërfaqe të lira pa objekte SL = 10 298 m² ((SL1 = 9213 m²; SL 2 = 660 m²), SL 3 = 425 m²) Përcaktohet se sip e zënë është 1764 m²; sip e lirë 12 596 që ndahet nën objekte dhe sip të lira pa objekte.

Të njohë të drejtën e kompesimit me një nga format e përcaktuara në këtë ligj subjektit të shpronësuar Mahmud dhe Xhemal Begeja (trashëgimtarëve të tyre ligjor) për pronën me sipërfaqe 1764 m².

Vendimit të mësipërm, i është dhënë formë e prerë më datë 07.05.2007. Po më datë 07.05.2007 nga përfaqësues të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, konkretisht shtetasit Altin Ceni dhe Petrit Kullolli, i është dorëzuar fizikisht prona, shtetasit Bashkim Bekteshi, trashëgimtar i familjes Begeja. 1900+435+12596 = 14 931 m² + 11 305 m² = 26 236 m².

90.7. Me shkresën nr. 1337 prot datë 08.05.2007, AKKP i ka përcjellë ZVRPP vendimin nr. 6 datë 21.03.2007 për regjistrim. Konstatohet se kjo shkresë ka hyrë në ZVRPP Tiranë me nr. 3421 prot datë 08.05.2007 dhe është bërë siglimi: "Z. Fetah, nën kujdesin tuaj të konfirmohet brenda datës 14.05.2007". Po në datë 08.05.2007 shtetasi Fetah Hasanaj ka bërë shënimin për zonën 1, duke iu adresuar punonjësit Helian (ose Elian) për të kryer veprimet sipas ligjit.

Rezulton se, me deklaratën nr. 4593 rep nr. 665/3 kol datë 21.06.2007, para noteres Ruko Sako, shtetasit Haki Begeja, Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi (trashëgimtarë të Nimete Bekteshit), Nusret dhe Kreshnik Kaçurri, Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja (i cili trashëgon edhe Drita Begenë trashëgimtar testamentar), Haxhhire Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Teuta Malka, Elona Begeja, Xhimi Begeja (i cili ka blerë pjesën e trashëgimtarëve të Hysen Begeja, të Graciela, Vera dhe Margarita Begeja), Orinda Malltezi, të gjithë të përfaqësuar me prourë të posaçme nga Jamarbër Malltezi, vetë Jamarbër Malltezi, Ilir Kadiu si përfaqësues i Manjola dhe Vangjeli Kadiu si dhe për vehten e tij, i përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi, në lidhje me pjesën e përfutuar S3L = 425 m², pasqyrojnë se nga matjet ekzakte në hartë, rezulton se sip në fakt, nuk është më shumë se 300 m². Përfaqësuesi i deklaruesve Jamarbër Malltezi, me vullnetin e tij të lirë, deklaroi se janë dakord të pajisen me vërtetim pronësie për sip 300 m².

Gjithashtu për S1=460 m2 nga matjet rezulton se nuk është më shumë se 300 m2. Jamarbër Malltezi si përfaqësues, delaron se janë dakord që të pajisen me vërtetim pronësie për sip 300 m2 për secilën nga pronat më lart.

Rezulton se është bërë e njëjta deklaratë edhe me nr. 4090 rep nr. 592/1 kol datë 05.06.2007.

Mbi këtë bazë rezulton të jenë regjistruar pasuritë: Datë 03.07.2007 pas me nr 3/150 ZK 8220 vol 15 faqa 179, truall me sip 680 m2 rruga Ndre Mjeda; Datë 03.07.2007 pas me nr 3/149 ZK 8220 vol 15 faqa 180, truall me sip 685 m2 rruga Ndre Mjeda; Datë 03.07.2007 pas me nr 3/7/257 ZK 8220 vol 15, faqa 181 truall me sip 300 m2 rruga Ndre Mjeda;

Pra, regjistrimi i mësipërm, nuk ka ndodhur menjëherë për shkak se dy sipërfaqe prone e konkretisht ajo e identifikuar si S3L = 425 m2 rezulton nga sip në fakt se nuk është më shumë se 300 m2 dhe S1=460 m2 nga matjet nuk rezulton më shumë se 300 m2. Pra qartësisht vërtetohet edhe një herë fiktiviteti i procedurave në AKP, pasi prezumohej se shtetasit Altin Ceni dhe Petrit Kullolli kishin dalë në terren dhe kishin bërë verifikimet përkatëse.

90.8. Përsa i përket shtetasit Fetah Hasanaj, funksionar pranë ZVRPP Tiranë, rezulton se gjithashtu si një pjesë e rëndësishme e funksionarëve që përfshihen në procedurat e kthimit të pronës, privatizimit, zhvillimit të pronës etj, gjenden në marrëdhënie shoqërore dhe interesi me shtetasit Fatmir Bektashi, Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja.

Konkretisht, nga ekspertimi i hard diskut, të sekuestruar pranë studio Pustina, është evidentuar një dokument i emërtuar "Kontrata 2010-2011", që ka të bëjë me ndërtimet që realizojnë në vijim shoqëritë Homeplan dhe Kontakt sh.p.k. në këto territore. Në këtë dokument, në faqen e parë të dokumentit excel me emërtimin "Apt 2010-x Pronarin" konstatohet se **me kodin 151 është regjistruar emri i shtetasës Shefikat Hasanaj (nëna e shtetasit Fetah Hasanaj)**, me çmim total 0, për një sip totale prej 108.01 m2 në strukturën Homeplan 1, e cilësuar si "Klient". Pra kjo shtetase është paraqitur si klient por në të vërtetë është në listën e pronarëve dhe nuk paguan asnjë lekë. Nga akti i ekspertimit të hard diskut, të sekuestruar tek studio Pustina është evidentuar një dokument në formatin Word, me emërtimin "Lista e kontratave që disponojmë dt. 26.02.2011", i krijuar më datë 28.02.2011 dhe i ruajtur për herë të fundit më datë 10.03.2011. Bashkalidhur është një listë e kontratave sipas lëndëve ku me interes shfaqen shënimet: "Mungojnë kontrata sipërmarrje me personat e mëposhtëm:

1. Shefikat Hasanaj, apt. 151
2. Marin Bicoku, apt 254..."

Rezulton se ky është një email që është dërguar nga Studio Pustina (mcapustina@yahoo.com), më dt 10.03.2011 ora 15.19 në drejtim të shtetasit Bledar Senja, cc është shtetësja Suzana Aliaj me subjekt: "Dokumenta dhe pyetje ne lidhje me dokumentat" me përmbajtje: "Pershendetje Bledi, Keto jane disa dokumenta dhe pyetje ne lidhje me dokumentacionin e Homeplan per 2010-2011. ...Mungojne kontrata sipermarrje me personat e meposhtem:

1. Shefikat Hasanaj, apt. 151
2. Marin Bicoku, apt. 254...

...Ne pritje te dokumentave dhe pergjigjeve te mesiperme sa me shpejt, sepse duhet te bejme mbylljet e bilancit per vitin 2010.

Gjithe te mirat, Odeta

Studio Pustina

Address:Rr. "Abdyl Frasheri", Pallati "Hekla", Perballe Librit Universitar.
Tirane, Albania
Tel/Fax: 0035542261909, 0035542260429

Pra mungojnë pikërisht kontratat e personave që duket se kanë kontribuar në suksesin e shtetasve Malltezi, Bektashi dhe Begeja, në aktivitetin e shtënies në dorë, regjistrimit dhe zhvillimit të territoreve sportive.

Në një dokument të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton një listë renditen emerat e personave për të cilët mungojnë modalitetet e pagesës. **Në faqen e dytë renditen emrat e personave të cilëve u mungojnë kontratat e sipërmarrjes ku i renditur i dyti gjendet emri i shtetasit Shefikat Hasanaj. Me ngjyrë të kuqe janë bërë shënimet për këtë shtetase se nuk ka lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë dhe nuk e konsiderojnë si kliente.**

Gjithashtu, konstatohet se për shtetasen Shefikat Hasanaj, gjenden shënime edhe në dokumentin me titull "*Hompeplan shitje 2010-2011 (x Orgesën)*" ku në faqen e emërtuar si JK46 evidentohet me kodin 1/010 parkim Shefikat Hasanaj, kliente, me arkëtim total të pagesës 13 500 euro.

Nga hetimi në vijim, nuk u konstatua që të jetë proceduar me konkludimin e pronësisë së këtij apartamenti, por rezulton se shtetësja Shefikat Hasanaj, ka arritur të blejë një objekt pranë shoqërisë Lura sh.p.k., në Lalëz, ashtu si edhe shtetasit Malltezi, dhe ka rezultuar se nuk është kryer e gjithë pagesa për blerjen e vilës, pavarësisht se është deklaruar e shitur dhe e regjistruar tashmë në emrin e shtetasit Shefikat Hasanaj. Për më tepër, nga hetimi i kryer ka rezultuar se shtetësja Shefikat nuk ka pasur mundësi të realizojë blerjen e këtij objekti, duke u pretenduar se është blerë nga djali i saj i vdekur. Ky objekt gëzohet tashmë nga shtetasi Fetah Hasanaj.

Për më tepër, rezulton se në vijim, shtetësja Romina Hasanaj, vajza e shtetasit Fetah, punësohet pranë shtetasit Laura Pustina, notere kjo me lidhje të ngushta me familjen Berisha dhe Malltezi. Madje shtetasit Romina i besohen edhe llogaritë bankare, kryerje pagesash nga kjo notere si edhe vendosja si administratore e shoqërive që shfaqen të ekzistojnë tashmë prej dy vitesh, pa aktivitet.

Kthimi i pronave familjes Saliaga:

91. Ashtu si edhe familja Begeja, është angazhuar edhe familja Saliaga për kthimin e pronës.

Pas pajisjes me prokurën e posaçme nr. 6355 rep nr. 877 kol datë **04.11.2006** që shtetasit *Fadil, Hamide Saliaga, Xhevrije Mullisi, Tire Deda (Luzi), Fatmir Luzi*, i kanë dhënë **av. Silvana Bello**, kjo e fundit, me **kërkesën datë 27.11.2006**, i është drejtuar ZRKP duke kërkuar kthimin e truallit të njohur me vendimin nr. 97 datë 17.12.1999 me sip 4 813 m². Kërkesa tip e shtetasit Silvana Bello është e datës **30.11.2006**.

92. Nga AKP nisin veprimet e menjëhershme ashtu si për familjet e tjera që kërkojnë kthimin e pronës në këtë zonë.

92.1. Me shkresën nr. 36 prot dt **09.01.2007** i është kërkuar **ZVRPP** konfirmimi i gjendjes juridike të pronës. Me shkresën nr. 117/1 prot datë **22.01.2007** ZRPP kthen përgjigje duke bërë me dije se në mbështetje të VKKP nr. 7 datë 05.04.1995 trashëgimtarët e Qamil Saliagës kanë regjistruar këtë vendim nr. hipotekor 3797 të vitit 1995 vetëm pjesët e kthyera. **Pjesa tjetër që**

ndodhet brenda konturit sipas librit të ngastrave të përgatitura nga azhornimi fushor është shtetëror.

Me shkresën nr. 37 prot dt **09.01.2007** i është kërkuar *Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore*, Bashkia Tiranë, dhënia e fragmentit të hartës së zonës, studimit urbanistik të miratuar dhe konfirmimi nëse prona është e lire për t'u trajtuar nga ZRKKPTiranë. Me shkresën nr. 123/3 prot datë 05.02.2007 Bashkia e Tiranës kthen përgjigje se nga informacioni i dhënë nga Njësia e Planit Rregullues, **zona është zonë sportive dhe sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar.**

92.2. Më dt **09.03.2007** është mbajtur një akt verifikimi në terren, por që është nënshkruar vetëm nga Altin Ceni dhe Petrit Kullolli. Nuk rezulton të ketë nënshkruar Silvana Bello.

92.3. Me aktin Relacion datë **12.03.2007** të mbajtur nga grupi i punës Altin Ceni dhe Petrit Kullolli, është pasqyruar analiza mbi dosjen me nr. 3 datë 20.12.2006. Në këtë relacion është sugjeruar kthimi i sipërfaqes së truallit. Ky relacion është nënshkruar edhe nga përgjegjësi i sektorit juridik Tetis Lubonja.

92.4. Me shkresën nr. 3/2 prot datë **19.03.2007** është përgatitur vlerësimi ligjor, nga grupi i punës Altin Ceni, Petrit Kullolli dhe përgjegjësi i sektorit juridik Tetis Lubonja. Duke propozuar plotësimin e vendimit duke i kthyer subjektit sipërfaqet e truallit.

Në vlerësimin ligjor pasqyrohen shkresat me nr. 349/2 prot datë 25.01.2007 (*administruar në ZRKKP Tiranë me nr. 104/1 prot datë 31.01.2007*) të Ministrisë së Mbrojtjes dhe me nr 349/3 datë 09.03.2007 të Ministrisë së Mbrojtjes (administruar me nr 104/2 prot datë 16.03.2007).

92.5. *Me vendimin Nr. 7, dt 21.03.2007* të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Zyra Rajonale e Qarkut Tiranë, është vendosur t'i kthehet subjektit të shpronësuar **Qamil Saliaga**, nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 8, 780 m2 një sipërfaqe trualli prej 4779 m2.

Të njoh të drejtën e kompensimit për pronën me sipërfaqe të zënë prej 34 m2 (kabina elektrike).

Më datë 07.05.2007 është mbajtur proces verbali për dorëzimin e pronës ku kanë nënshkruar shtetasit Altin Ceni, Petrit Kullolli dhe av. Silvana Bello.

93. Nga aktet, rezulton se, me shkresën e nënshkruar nga zv. Regjitrues Alma Halili drejtuar shtetasës Hamide Saliaga, i bëhet me dije se, në përgjigje të aplikimit nr. 721 datë **22.05.2007** informojnë se për pasurinë e regjistruar në ZK 8220 në emër të Hamide Saliaga, nuk mund t'i pajisin me vërtetim pronësie pasi: Prona e pretenduar ka mbulesë me pronën e Kasem Bako (S=123 m2) blerë nga Caje Saliaga nr. hip 4109 i vitit 1995 dhe ka mbulesë me rep ushtarak me nr 20 datë 27.01.2005. Bashkalidhur është edhe fragmenti i hartës. Për t'u pajisur me vërtetim pronësie duhet të paraqesin një deklaratë noteriale ku të cilësohet që heqin dorë nga sip që ka mbulesë.

Me delaratën noteriale nr. 3110 rep nr. 428 kol datë **12.07.2007** shtetasit *Xhevrije Mullisi (Saliaga), Fadil, Luan Saliaga, Hamide Budo (Saliaga), Tire Luzi (Deda), Fatmir Luzi*, parashetrojnë se në kthim përgjigje të ZVRPP Hipoteka Tiranë drejtuar Hamide Saliagës, bashkëpronarëve të mëspërm, u kërkohet që në lidhje me pasurinë e tyre të paluajtshme të regjistruar në ZK 8220 dhe që të pajisen me vërtetimin e pronësisë duhet që të heqin dorë nga regjistrimi i sip prej 123 m2. Në fakt, për sip prej 123 m2 nuk kanë pretendim pasi kjo sip është

shitur prej tyre. Kurse, përsa i përket mbulesës tjetër të pasurisë së tyre të paluajtshme **Repartit Ushtarak nr. 6612**, deklarojnë se për arsye të regjistrimit të kësaj pasurie, bashkëpronarët nuk heqin dorë nga e drejta e tyre si bashkëpronar, por këtë problem e lenë përkohësisht mënjanë për ta zgjidhur në rrugë gjyqësore (sip 845 m²). Prandaj nga sip e mbetur prej 4779 – (123+845) = 3811 m², kërkojnë të pajisen me vërtetim pronësie.

94. Në fakt, nga aktet rezulton se, me vërtetimin nga dokumentat hipotekorë të lëshuar në vitin 2004, nga regjistruesi Gazmend Zeneli, rezulton se në regi hipotekor me nr. 20 datë 27.01.2005 **figuron e regjistruar në pronësi të Repartit Ushtarak nr. 6612, në ZK 8220 Orkestra frymore e ushtrisë me sip totale 1230 m² e përbërë nga zyra 21 m², salla e provave 150 m², depo materiale 72 m², arshivë muzikore 42 m², dhoma muzikore 100 m², kaldaja 25 m², ËC 18 m², korridor 36 m², truall 766 m². Kufizimet e pasurisë janë veriu 3/131; 3/84; Lindja 3/84; 3/2; jugu 3/131 dhe perëndimi 3/84. Origjina e regj të pas së paluajtshme është shtet.**

Me shkresë Nr.3221/1 Prot, datë 14.06.2023 Ministria e Mbrojtjes na ka bërë me dije, si vijon: **...Orkestra Frymore: Prona Nr. 7 në adresën Rruga Frosina Plaku lagja 21 Dhjetori Tiranë me emërtimin “Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura” në vitin 2003 sipas VKM nr. 515 datë 18.07.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes” ka qënë në administrim të Qendrës Kulturore të Ushtrisë Tiranë me sipërfaqe prej 1,230 m² më pas Orkestra Frymore kalon në varësi të Regjimentit të Mbështetjes dhe në zbatim të VKM-së Nr.116 datë 17.02.2011 kjo pronë ka një sipërfaqe prej 1,489.53 m² dhe po me të njëjtën sipërfaqe në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 604, datë 23.07.2014 “Për riorganizimin e batalionit të mbështetjes të SHPPA” është marrë në administrim nga Batalioni i Mbështetjes por me probleme mbivendosje për një sipërfaqe prej 259 m². Për këtë sipërfaqe, prej 259 m² ka pretendime familja Saliaga, me të cilin janë në proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Në shkresë citohet se ky gjyq është fituar nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes/strukturave në varësi dhe procesi vazhdon në Gjykatën e Apelit Tiranë. Sipërfaqja me mbivendosje ndodhet brenda rrethimit të repartit dhe administrohet nga ana e Repartit. Aktualisht e gjithë prona prej 1489.53 m² (përfshi edhe sipërfaqen prej 259 m² për të cilën ka pretendime për mbivendosje) është në ruajtje dhe administrim të batalionit të mbështetjes ku vazhdon të jetë e vendosur dhe të kryejë veprimtarinë e saj Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura.**

Me vërtetimin nga dokumentat hipotekorë datë lëshimi 25.07.2007, me regjistruesi Fadil Kaloshi, vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. 491 datë 24.07.2007 figuron e regjistruar në pronësi të *Caje Saliaga, Xhevis Mullisi (Saliaga), Fadil, Luan, Hamide Saliaga, Shpëtim, Tire dhe Fatmir Luzi*, pasuria me nr. 3/160 dhe 3/161 e ndodhur në ZK 8220 në adresën: sip trualli S 1 (ST = 551 m², SN = 130 m²), sip trualli S2 (ST = 3240 m², SN = 1467 m²) të ndodhur në rrugën Frosina Plaku dhe me kufizime pasurie: Veriu: Kroi i Shëngjinit, Jugu Familja Begeja, Lindje tokë e Sabrije Llagamit dhe Perëndimi Ismail Pëllumbi.

Me shkresën datë 14.06.2010 ZVRPP, regjistruesi Fetah Hasanaj (nënshkruar me P përpara), i kthen përgjigje shtetasit Luan Saliaga, duke i bërë me dije se, në përgjigje të kërkesës së tyre nr. 249 datë 07.06.2010, për t'u pajisur me vërtetim pronësie, për pasurinë me nr. 3/161 me sip trualli St=3240 m² e kthyer sipas vendimit nr. 7 datë 21.03.2007 të AKKP-së informojnë se një pjesë e sipërfaqes së kthyer krijon përplasje me pasurinë e regjistruar në hip 403 datë 15.12.2004 në emër të shoq. G – Kam të fituar mbi bazë të kontratës së shitjes nr. 5847/1703 datë 01.09.1998.

Kthimi i pronave familjes Vaqarri.

95. Me kërkesën datë 30.11.2006 (nr. 2146 rep datë 19.12.2006, datë kur rezulton të jetë bërë edhe pagesa për hapje dosje të re), shtetasi **Igli Vaqarri** paraqet kërkesë për kthimin e truallit. Parashtron se vendos prokurën nr. 524 rep nr. 102 kol datë 25.04.2002. Në këtë kërkesë është vendosur si adresë emaili **Fbektashi**.

Gjithashtu gjendet kërkesë për kthimin e truallit datë 27.11.2006 e ngjashme me kërkesat e familjeve të tjera dhe e panënshkruar por që mban emrin e shtetasit Igli Vaqari.

I pyetur më dt 22.11.2022, shtetasi **Igli Vaqarri**, se përse pikërisht në këtë kohë vlerësuan të bënin kërkesën për kthimin e truallit, përgjigjet se **nuk e mban mend**. I pyetur në lidhje me bisedime me familjet e tjera pronare të pronave që ndodheshin në territorin e Sport Klub Partizanit, shtetasi Igli deklaroi se **ka biseduar vetëm me Fatmirin në lidhje me kërkesën për kthimin e pronës**.

96. Përgjatë kësaj kohe, konstatohet se trashëgimtarët Vaqarri, janë angazhuar me shoqërinë Kontakt sh.p.k., për zhvillimin e truallit të kthyer me vendimin e vitit 1996. Sa më sipër, rezultoi nga prokura me nr. 2146 rep nr. 563 kol datë 19.12.2006, para noteres Gentiana Shkodra, ku shtetasit **Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqarri (përfaqësuar nga Petrit Bektashi), Milva Arapi, Liljana Arapi, Luan Arapi (përfaqësuar nga Bardhyl Qatipi), Arben Arapi (përfaqësuar nga Liljana Arapi) dhe Fiqirete Vaqari dhe Eva Vaqari (përfaqësuar nga Fiqirete Vaqari)** kanë emëruar si përfaqësues të tyre shtetasin **Igli Vaqari**. Në këtë prokurë është shënuar se **tagret e përfaqësimit i jepen edhe përballë shoqërisë Kontakt sh.p.k. duke pasur të drejtën e negocimit dhe të arritjes së marrëveshjeve me objekt sipërmarrjen mbi pasuritë e tyre të paluajtshme etj....duke ruajtur eskluzivisht për ne si të përfaqësuar, të drejtën e nënshkrimit të kontratës me shoqërinë Kontakt sh.p.k. Në këtë prokurë është parashtruar se janë bashkëpronarë të një trualli të lirë prej 3050 m² të ndodhur në Tiranë (sipas vërtetimit të pronësisë me nr. 6294 datë 05.09.1996). Emërojnë si përfaqësues të posaçëm Igli Vaqarin, i cili ka të drejtë që në emër dhe për llogari të tyre të kryejë çdo veprim juridik – civil të nevojshëm për kompensimin në natyrë të pronës së trashëguar...**

97. Ndërkohë, në AKP, paraqitet një kërkesë me shkrim, e shtetasit Igli Vaqari, adresuar AKKP Tiranë, me nr. 0118/2 prot datë 17.01.2007, në të cilën është parashtruar se Sport Klub Partizani ka qenë në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe kjo e fundit me shkresën nr. 9543/3 prot datë 14.11.2005, i është drejtuar METE duke i kërkuar privatizimin e këtyre terreneve sportive meqë nuk i shërbejnë më interesave të publikut dhe nuk përdoren më prej saj. Bashkalidhur kësaj kërkesë, parashtrohet se dorëzojnë edhe shkresën nr. 9543/3 prot datë 14.11.2005 të Ministrisë së Mbrojtjes. **Kjo kërkesë është e njëjtë me atë të datës 17.01.2007 të paraqitur nga shtetasi Bashkim Bektashi.**

97.1. AKKP nuk angazhohet me kërkim të informacionit nga Ministria e Mbrojtjes, pasi në këtë praktikë, nuk gjendet ndonjë shkresë e re dërguar kësaj të fundit, por është administruar korrespondenca me Ministrinë e Mbrojtjes, e gjendur në praktikën e dosjes me kërkues shtetasin Bashkim Bektashi, pa lënë ndonjë gjurmë procedurale se si janë administruar aktet.

97.2. Njësoj si edhe për familjet e tjera të njohura pronare, të sipërcituara, me shkresën nr. 35 prot datë 09.01.2007 i është kërkuar informacion ZRPP-së për konfirmimin e gjendjes juridike të pronësisë së vijëzuar në planvendosjen bashkalidhur shkresës. Me shkresën nr. 116/1 prot

datë **18.01.2007** ZRPP kthen përgjigje se prona ndodhet në ZK 8220, ku janë pasuritë në emër të Fitnete Bektashi, shteti dhe familja Saliaga e konkretisht: Pasuria nr. 3/3 bashkëpronarët Fitnete Bektashi me hipotekë 6294/1996; Pasuria 3/84 shteti; Pasuria 3/112 familja Saliaga me VKKP nr. 7 datë 15.04.1995.

Me shkresën nr. 34 prot datë **09.01.2007** ZRKKP Tiranë i është adresuar Urbanistikës Ligjore, duke i kërkuar dhënien e fragmentit të hartës së zonës, studimit urbanistik të miratuar dhe konfirmimit nëse prona është e lirë për t'u trajtuar. Bashkalidhur sqarojnë se ndodhet planvendosja e pronës së pretenduar. Me shkresën nr. 124/3 prot datë **09.02.2007** Drejtoria e Urbanistikës Ligjore kthen përgjigje duke parashtruar se dërgojnë 2 kopje të fragmentit nga planimetria e Tiranës shk. 1:500 viti 1993 ku ndodhet prona e pretenduar. Nga informacioni i dhënë nga Njësia e Planit Rregullues, **zona për të cilën interesohen është zonë sportive dhe sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar.**

97.3. Si edhe në praktikat e mëparshme, mbahet akt verifikimin datë **09.03.2007** nga Altin Ceni dhe Petrit Kullolli ku pasqyrohet se është kryer verifikimi i pronës. **Megjithëse përshkruhet se është kryer verifikimi në prani të subjektit të shpronësuar ose përfaqësuesit të tij Igli Vaqarri, nuk rezulton që ky i fundit të ketë nënshkruar,** apo të ketë emrin në rubrikën e subjektit të shpronësuar.

97.4. Më datë **12.03.2007** nga grupi i punës i përbërë nga Altin Ceni dhe Petrit Kullolli, dhe nënshkruar edhe nga përgjegjësi i sektorit Juridik shtetësja Tetis Lubonja, është mbajtur relacioni drejtuar drejtorit të ZRKKP Tiranë. Në këtë relacion përshkruhet si edhe për familjet e tjera korrespondenca me Ministrinë e Mbrojtjes që rezultojnë të jetë vetëm një e tillë, e kryer për llogari të dosjes së shtetasit Bashkim Bektashi dhe **shkresa nr. 349/3 datë 09.03.2007 e Ministrisë së Mbrojtjes nuk citohet e plotë në pjesën që parashtron se duhet të njoftohen për regjistrimin e pronave me qëllim për të mos krijuar mbivendosje.** Si sipërfaqe të lirë kanë parashtruar sipërfaqen prej 10 975 m², terrenet sportive të Klubit Partizani. Kanë sugjeruar kthimin e pronës.

Ashtu si edhe më lart konkluduar, data e relacionit nuk përputhet me datën e administrimit të përgjigjes me nr. 349/3 datë 09.03.2007 të Ministrisë së Mbrojtjes.

Me nr. 6/2 prot datë **23.03.2007** është përgatitur vlerësimi ligjor, nga shtetasi Altin Ceni, Petrit Kullolli dhe Tetis Lubonja dhe nënshkruar si i miratuar edhe nga shtetësja Dhurata Hoxha.

97.5. Me vendimin **Nr.09, datë 26.03.2007** të Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Zyra Rajonale e Qarkut Tiranë është vendosur të **kthehet** nga sipërfaqe e pronës së njohur prej 11,070 m², një sipërfaqe trualli prej **10,975 m²** subjektit të shpronësuar Dylbere Vaqarrit (*trashgimtarëve ligjor të saj të njohur me Vendimin Nr. 5517, datë 25.06.1996 të cilat janë Finete Bektashi, Liliana Arapi, Arben Arapi, Fiqiri Vaqarri, Fiqirete Vaqarri, Igli Vaqarri, Eva Vaqarri, Kumrije Vaqarri*). Sipas këtij vendimi SL=10975 m² janë terrenet sportive të cilat janë paraqitur si në gjendje të lirë.

Me shkresën nr. 9/1 prot datë 26.03.2007 rezultojnë se vendimi i mësipërm i është njoftuar subjektit Igli Vaqarri, i cili ka bërë shënimin se ka marrë njoftim po në datë 26.03.2007.

Më datë **09.05.2007** përfaqësues të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, konkretisht shtetasit Altin Ceni dhe Petrit Kullolli, i kanë dorëzuar fizikisht pronën, shtetasit Igli

Vaqarri përfaqësues i posaçëm i trashgimtarëve të Dylbere Vaqarrit. Shtetasi Igli Vaqarri rezulton ta ketë nënshkruar këtë proces verbal.

97.6. Më datë 15.06.2007 regjistrohet në ZVRPP, vendimi i AKP-së nr 9 datë 26.03.2007 dërguar me shkresën përcjellëse nr 1435 prot datë 14.05.2007 (KKP) nr 36539 datë 15.05.2007 ZVRPP + genplan + procs verbal, dëshmi trashëgimie e GJRRT 5517 vendimi datë 25.06.1996. Konkretisht regjistrohet SL = 10 975 m², me nr ind 412 datë 15.06.2007.

Kthimi i pronave familjes Alimehmeti.

98. Me kërkesën datë 30.11.2006 rezulton se shtetasi Blendi Marikaj ka paraqitur kërkesë për kthimin e truallit, ku kjo kërkesë, duket e përgatitur nga e njëjta dorë si ato me av. Silvana Bello dhe ajo me familjen Saliaga.

98.1. Me shkresën nr. 38 prot datë 09.01.2007 i është kërkuar informacion Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore për dhënie të fragmentit të hartës së zonës, studimit urbanistik të miratuar dhe konfirmimi nëse prona është e lire për t'u trajtuar. Me shkresën nr. 122/3 prot datë 05.02.2007 Drejtoria e Urbanistikës kthen përgjigje se është pjesërisht **zonë sportive dhe pjesërisht zonë banimi dhe sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar (drejtor Kozeta Gëdeshi).**

Me shkresën nr. 39 prot dt 09.01.2007 i është kërkuar informacion ZVRPP për konfirmimin e gjendjes juridike. Me shkresën nr. 114/1 prot datë 24.01.2007 ZVRPP kthen përgjigje se pasuritë janë në pronësi të M.Lacej, Xh. Hasanbelliu, shtetërore, A. Kocollari, A. Bica, F. Basha.

98.2. Me relacionin datë 12.03.2007, të nënshkruar nga grupi i punës Altin Ceni dhe Petrit Kullolli si dhe përgjegjësi i sektorit juridik Tetis Lubonja u sugjerua plotësimi i vendimit nr. 722 datë 10.10.1996 duke u kthyer dhe kompensuar subjektit sip trualli. Edhe në këtë relacion, si në rastet e dosjeve të familjeve të tjera, janë pasqyruar shkresat e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat nuk rezultojnë të përsëritura, por janë të përfshira pa ndonjë proces verbal mbi mënyrën e përfshirjes në këtë dosje dhe të cilat mbajnë datën e hyrjes në ZRKKP pas datës së përpilimit të këtij relacioni.

98.3. Me vlerësimin ligjor nr. 5/2 prot datë 21.03.2007, të përgatitur nga grupi i punës Altin Ceni dhe Petrit Kullolli dhe nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit juridik Tetis Lubonja është pasqyruar sugjerimi mbi kthimin e pronës.

98.4. Me vendimin Nr.08, datë 23.03.2007 "Për njohjen e të Drejtës së Pronësisë Kthimin dhe Kompensimin e pronës" i Agjencisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Zyra Rajonale e Qarkut Tiranë është vendosur të **kthehet** nga sipërfaqe e pronës së njohur prej 10,860 m² një sipërfaqe trualli prej 7, 930 m² (që ndahet në SL1 = 7 750 m² dhe SL 2 = 180 m²), subjektit të shpronësuar **Rexhep Alimehmeti** (trashëgimtarëve ligjor të saj të njohur me dëshminë e trashëgimisë Nr. 13, datë 30.08.1994, të cilat janë Fiqiri Alimehmeti, Xhafer Alimehmeti, Fehmi Alimehmeti, Nimete Mulliçi (Alimehmeti), Fatbardha Marika (Alimehmeti)) dhe të kompensojë me një nga format e përcaktuara në këtë ligj subjektin e shpronësuar/trashgimtarët e tij ligjor për pronën me sipërfaqe 1,850 m².

Më datë 22.05.2007, shtetasi Blendi Marika aplikon për regjistrimin e pasurisë dhe rezulton se më datë 15.06.2007 regjistrohet në ZVRPP Tiranë, pasuria me nr. 3/158 ZK 8220 vol 15 faqa

172, me sip 180 m², në pronësi të shtetasve Fiqiri, Xhaferr, Fehmi Alimehmeti, Fatbardha Marika, Skënder Mulliçi, Alma Sulo dhe Genci Mulliçi.

Sipas vërtetimit nga dokumentat hipotekorë, datë lëshimi 16.07.2007, të ZVRPP Tiranë, pasqyrohet se në emër të shtetasve Fiqiri, Xhaferr, Fehmi Alimehmeti, Fatbardha Marika, Skënder Mulliçi, Alma Sulo, Genci Mulliçi rezulton e regjistruar pasuria me nr. 3/158 dhe 3/157 ZK 8220 me sip 7 930 m², truall, që ndahet në SL1=7750 m² + SL 2=180 m², sipas planvendosjes përkatëse, që ndodhet në rr. Frosina Plaku. Regjistrohet me nr ind 411 datë 15.06.2007.

Kthimi i pronave familjes Sabrije Llagami

99. Konstatohet se shtetasit *Behixhe Tafaj, Myhyrije Verzivolli, Rudina, Aleksandra, Ervin, Artur, Adnan, Sadete, Adela, Mirnije Llagami*, me prokurën e posaçme nr. 1908 rep nr. 477 kol datë 20.11.2006, i kanë dhënë tagre shtetasit **Ervin Llagami** për t'u marrë me pronën. Prokura është përpiluar para noteres Gentiana Shkodra. Kërkesa e paraqitur nga subjekti Ervin Llagami është e datës 19.01.2007 (me nr. 20 datë 19.01.2007).

99.1. Me shkresën nr. 665 prot datë 28.02.2007 të ZRKKP, drejtor Dhurata Hoxha i është drejtuar **Ministrisë së Mbrojtjes**, Fatmir Mediu në lidhje me konfirmimin e gjendjes juridike nëse prona është e lirë për t'u trajtuar nga ZRKKP, Tiranë.

Me shkresën nr. 666 prot datë 28.02.2007, drejtoresha Dhurata Hoxha i është drejtuar **Drejtorisë së Urbanistikës Ligjore, Bashkia Tiranë**, duke kërkuar fragment të hartës së zonës, studim urbanistik të miratuar dhe konfirmim nëse prona është e lirë për t'u trajtuar nga ZRKKP Tiranë. Sipas shkresës me nr. 1306/3 datë 04.04.2007, Drejtoria e Urbanistikës Ligjore, Bashkia Tiranë, konfirmohet se zona në të cilën ndodhet prona e pretenduar është **pjesërisht zonë banimi, pjesërisht gjelbërim i zonës së banimit sipas Planit të Përgjithshëm Rregullues dhe nuk ka studim urbanistik të miratuar**

Me shkresën nr. 667 prot datë 28.02.2007, drejtoresha Dhurata Hoxha i është drejtuar **Njësisë Bashkiake Nr. 7 Tiranë**, për informacion nëse pasuria është e lirë për t'u trajtuar nga ZRKKP, nëse ka ndërtime në të, me ose pa leje ndërtimi.

Me shkresën nr. 668 prot dt 28.02.2007 drejtoresha Dhurata Hoxha i është drejtuar **ZRPP Tiranë** duke kërkuar konfirmim të gjendjes juridike të pronës. Në relacion përshkruhet se, sipas shkresës nr. 1574/1 dt 27.03.2007 të ZRPP-së Tiranë konfirmohet se pasuria e vijëzuar e pretenduar nga subjekti i shpronësuar ndodhet në ZK 8220 dhe paraqiten edhe nr. e pasurive dhe pronarët e tyre.

Me shkresën nr. 669 prot datë 28.02.2007 drejtoresha Dhurata Hoxha i është drejtuar **ALUIZNIT** në lidhje me konfirmimin nëse pasuria është e lire për t'u trajtuar nga ZRKKP Tiranë.

Në këtë dosje gjendet gjithashtu, pjesë nga zgjerimi i katërt i kampit të aviacionit Tiranë viti 1942 së bashku me legjendën përkatëse dhe pjesë nga planimetria e aeroportit (shih shkresën me nr. 2 prot datë 05.01.2007 të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit drejtuar shtetasit Ervin Llagami)

99.2. Në dosje gjendet akt verifikimi datë 09.03.2007 ku pasqyrohet se grupi i punës përbëhet nga Altin Ceni, Petrit Kullolli dhe Silvana Bello. Në përfundim ky akt verifikimi është

nënshkruar vetëm nga shtetasit Altin Ceni dhe Petrit Kullolli.

99.3. Në relacionin e përgatitur përshkruhet se nga verifikimi dhe matjet e bëra në terren nga specialistët e Zyrës Rajonale, rezultoi se sip e pronës së pretenduar për kthim janë brenda sip së njohur me vendimin nr. 668 dt 16.08.1996 të KKKP. Përshkruhet në këtë mënyrë: ST = 5650 m². Sip që do trajtohet është: SL = 3910 m² që përbëhet nga sipërfaqe nën objekte SL1=140 m² (palestër), SL 2 = 200 m² (godinë 4 kate), **SL3 = 360 m² (banda e ushtrisë)** dhe sip e lirë që shërben si terren sportiv SL 4 = 3910 m².

Në relacion, përshkruhet korrespondenca me Ministrinë e Mbrojtjes, në të njëjtën mënyrë që është përshkruar edhe në dosjet e familjeve të tjera të trajtuara si më sipër.

99.4. Me vendimin Nr. 64, datë **18.05.2007** "*Për njohjen e të Drejtës së Pronësisë Kthimin dhe Kompensimin e pronës*", Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave **ka vendosur të kthejë nga sipërfaqja e pronës së njohur prej 5650 m², sipërfaqen e lirë prej 3910 m² subjektit të shpronësuar Sabrije Llagami (trashëgimtarëve të saj).**

100. Megjithatë, në ndryshim nga familjet e tjera, rezultoi se familja Llagami nuk ka qenë e kënaqur me vendimmarrjen e mësipërme dhe për këtë arsye ka paraqitur ankim shtetasi Ervin Llagami, për shkak të sip së tokës që i është kthyer familjes Saliaga, duke pretenduar edhe një sip prej 2326 m², sipas kërkesave ankimore nr. 706 prot datë 18.06.2007 dhe nr. 215 prot datë 24.08.2007.

Vendimi i vitit 2007 dhe dosja respektive, për familjen Llagami i është nënshtruar shqyrtimit nga Zyra Qendrore në AKKP, ku me vlerësimin ligjor nr. 215/2 prot datë **15.11.2007** të përgatitur për drejtorin Besnik Maho, grupi i punës i përbërë nga *Irena Mjeshtri, Eglantina Rizvanolli dhe Haki Haxhillari*, është evidentuar fakti se, nga verifikimi i inventarit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen bazë, konstatohet se, **shkresat e Ministrisë së Mbrojtjes që u është referuar ZRKKP Tiranë për ta konsideruar këtë pronë në kuptim të ligjit si të lirë për trajtim, nuk gjenden në dosje.** Pra nuk provohet me asnjë dokument shkresor, fakti që kjo pronë është e lirë për trajtim. Gjithashtu në këtë vlerësim është pasqyruar se, është marrë vendim pa u marrë konfirmimi nga ALUIZNI, nëse ndërtime pas vitit 1990 janë përfshirë apo jo në procesin e legalizimeve.

Në relacion janë pasqyruar një sërë shkeljesh të tjera, siç është fakti që, në planvendosjen e pronës që shqyrton kërkesën për konfirmim ZRKKP Tiranë, nuk ka kërkuar konfirmim vetëm për sip e pronës së pretenduar, por edhe për sip e pronës që i është njohur me vendim familjes Saliaga dhe të njëjtën gjë ka bërë edhe për Njësinë Bashkiake nr. 7 Tiranë.

Pra sipas këtij relacioni, ZRKKP Qarku Tiranë, nuk ka bërë hetim të hollësishëm administrativ për zgjidhjen e çështjes, duke mos zbatuar pikën 1/b të nenit 15 të ligjit nr. 9235 datë 29.04.2004 "*Për Kthimin dhe kompensimin e pronës*" sipas të cilës: *shqyrton kërkesat dhe kontrollon vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin subjektet e shpronësuar dhe e ballafaqon atë me aktet ligjore, nënligjore ose vendimet gjyqësore, sipas nenit 2 të këtij ligji, që kanë shërbyer si bazë për shpronësimin, shtetëzimin, konfiskimin ose marrjen e padrejtë nga shteti të pronës*" dhe në pikën 1 të nenit 81 të K.Pr. Administrative, sipas të cilave: "*Organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji*".

Gjithashtu, në këtë vlerësim, përshkruhet se, është kryer verifikimi i pronës në terren, pa

praninë e subjektit të shpronësuar, duke mos qenë e qartë nëse verifikimi i pronës është bërë në pronën e pretenduar. Në akt verifikim, gjithashtu nuk ka firmosur as juristja e grupit të punës që ka shqyrtuar dosjen dhe verifikimi është kryer pa praninë e subjektit të shpronësuar. Në këtë mënyrë, ZRKKP Tiranë nuk ka zbatuar në mënyrë të saktë **urdhërin nr. 251 datë 03.11.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.**

Për këtë arsye ky grup pune ka sugjeruar shfuqizimin e vendimit nr. 64 datë 18.05.2007.

100.1. Me vendimin nr. 488 dt **22.11.2007** të AKKP Tiranë, është vendosur shfuqizimi i vendimit nr. 64 dt 18.05.2007 të ish ZRKKP Qarku Tiranë dhe kthimi për rishqyrtim në qark (*shih shkresën nr. 782/1 prot dt 26.01.2011 të AKKP-së dhe relacionin nr. 782/27 prot dt 21.09.2012*). Ky vendim nuk është kundërshtuar në gjykatë (*shih shkresën nr. 782/24 prot dt 30.07.2012*).

Konkluzion në lidhje me vendimmarrjet e AKP-së:

101. Përsa më sipër, në konkluzion, konstatohet se Agjensia e Kthimit të Pronave, ka shqyrtuar me shpejtësi të pajustificuar, kërkesat e pesë familjeve të njohura pronare, në krahasim me kërkesat e qytetarëve të tjerë, pasur parasysh ngarkesën dhe volumin e dosjeve që kishte. Kërkesa e familjes Begeja është paraqitur në mesin e muajit dhjetor 2006. Menjëherë pas përfundimit të pushimeve dimërore, më datë 08 dhe 09 janar 2007 grupi i punës është aktivizuar për të nisur nga puna me këtë dosje. Rezulton se në muajin janar 2007 (*menjëherë pas pushimeve të dimrit*) janë nisur kërkesat drejtuar institucioneve si Bashki, ZRPP, konkretisht të kryera më dt 09.01.2007 përveç dosjes së familjes Begeja për të cilën shkresa drejtuar Bashkisë është nisur që më dt 08.01.2007. Vetë shtetësja Tetis Lubonja, sqaron se është një ndër dosjet e para që u janë dhënë për të punuar.

Siç mund të konstatohet, në një periudhë të shkurtër, që hapet në fund të muajit nëntor 2006 me kërkesën e familjes Saliaga, deri më 26.03.2007, rezulton të jenë dhënë 4 (katër) vendime për kthim prone, ku të gjitha pronat e kthyera, janë të përfshira në territorin e Klubeve Partizani. Në vijim, në maj 2007 është dhënë edhe një vendimi për kthimin e pronës, familjes së pestë.

102. Kërkesat e gjendura në dosje, specifikisht ato që i përkasin familjeve Alimehmeti, Saliaga dhe Begeja janë thuajse të njëjta me njëra – tjetrën, duke vërtetuar faktin se janë përgatitur nga e njëjta dorë, mbështetur edhe në deklaratimet e sipërcituara që këto kërkesa janë kryer pas mbledhjeve të anëtarëve të familjeve. Për familjen Begeja, kërkesa është paraqitur nga shtetasi Bashkim Bekteshi, daja i shtetasit Jamarbër Malltezi. Paraqitja e kësaj kërkesë konstatohet se është bërë nën udhëzimet e shtetasve Fatmir Bektashi, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi, siç edhe rezulton nga dëshmitë e ndryshme në lidhje me takimet e zhvilluara ndërmjet trashëgimtarëve në lokalitetin Begeja por edhe siç pasqyrohet në deklaratën e nënshkruar nga shtetasi Bashkim Bekteshi, ku gjendet adresa e emailit të shtetasit Xhimi Begeja dhe adresa e lokalit të tij Begeja.

103. Grupi i punës i ngarkuar me shqyrtimin e dosjeve të pesë familjeve të njohura pronare, përbehet nga tre persona, ku të paktën dy prej tyre konstatohet se kanë lidhje me trashëgimtarët e familjeve të njohura pronare. Konkretisht, shtetësja Tetis Lubonja e cila përveç lidhjes miqësore dhe njohjeve me shtetasin Jamarbër Malltezi dhe Rudina Llagami, rezulton edhe të jetë punësuar disa vite më pas pranë shoqërisë Kontakt sh.p.k. ndërkohë që shtetasi Petrit Kullolli rezulton të ketë ofruar shërbim topografik për shtetasin Jamarbër Malltezi, vetëm dy vite më parë, për pasuritë e blera në Priskë.

104. Ka pasqyruar, sikur janë kryer verifikime në terren, më datë 09.03.2007 për familjet, ndërkohë që nuk rezulton të kenë qenë të pranishëm subjektet kërkuese, duke vërtetuar fiktivitetin e këtyre verifikimeve. Kjo gjë mbështetet edhe nga fakti se ka qenë realisht e pamundur, kryerja e verifikimeve, matjeve të sipërfaqeve të tokave, brenda një dite, pasur parasysh madhësinë e tyre, apo pasur parasysh deklaratimet kontradiktore të dy punonjësve të AKP-së që, prezumohet se kanë qenë në terren (*shtetasi Petrit Kullolli deklaroi se nuk ka konstatuar aktivitete sportive në të kundërt nga shtetasi Altin Ceni*). Verifikimet në terren nuk kanë pasur mundësi të kryheshin pa prezencën e subjekteve dhe përcaktimin e sipërfaqes së saktë, të pretenduar për t' u kthyer si dhe përshkrimin e objekteve të ndodhura në to. Moskryerja e verifikimit mbështetet ndër të tjera edhe në faktin se përgjatë regjistrimit të pasurive të familjes Begeja, ka rezultuar se dy sipërfaqe e konkretisht ajo e identifikuar si S1=460 m² nga matjet rezulton se nuk është më shumë se 300 m² (*sip e konsideruar e lirë, nën objekt*) dhe sip e identifikuar si SL3 = 425 m² (*sip e lirë pa objekte*), nga matjet rezulton se nuk është më shumë se 300 m².

Për më tepër, në rast se do të ishin kryer verifikimet në terren do të ishin konstatuar objekte të shtetit apo të subjekteve të treta ose ndërtime të paligjshme, ku sipërfaqja e truallit e ndodhur nën to, nuk mund të kthehej.

105. Janë administruar shkresa pa protokoll dhe pa pasur ekstremitetet e dokumentave (fotokopje). Rezulton se i është nisur kërkesë Ministrisë së Mbrojtjes, duke u mbështetur në një dokument të dorëzuar fotokopje nga shtetasi Bashkim Bekteshi, një dokument që duke qenë se përbënte korrespondencë mes institucioneve, minimalisht duhet të konfirmohej dhe jo të administrohej e të bëhej pjesë e dosjes, i pakonfirmuar si dokument i vërtetë (*pra noterizuar apo njehsuar me origjinalin*).

105.1. Me shkresën nr. 121/3 prot dt 14.02.2007, Bashkia e Tiranës (*shih dosjen e familjes Begeja*), bën me dije se, nga informacioni i dhënë nga Njësia e Planit Rregullues, zona për të cilën interesohet KKKP është **pjesërisht zonë sportive dhe zonë banimi dhe sipas planit të përgjithshëm rregullues** (*për të cilën nuk ka studim urbanistik pjesor të miratuar*) dhe pjesërisht përfshihet në studimin urbanistik pjesor të miratuar me vendim të KRRT Tiranë nr. 76 dt 18.03.2005.

N 8/1 i ligjit për kthimin dhe kompensimin pronës, pas ndryshimeve të pësuara më dt 17.07.2006, parashikonte në lidhje me truallin e zënë me ndërtime në pronësi të shtetit parashikonte se, **kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik**, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim.

Referuar nenit 2 gërma "b" të ligjit nr 8743 datë 22.02.2001 "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*", "*Pronë e paluajtshme publike*" kuptohet ajo pjesë e pronave të paluajtshme të shtetit, që përmbush funksione themelore dhe të pandashme të shtetit dhe që sjell **përfitime në favor të publikut të gjerë**. Sipas nenit 3 pika 1 gërma "c" i përkasin shtetit dhe bëjnë pjesë në pronat e paluajtshme publike zonat, instalimet dhe objekte të tjera të destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike. Sipas pikës 3 të nenit 3, janë gjithashtu **prona të paluajtshme publike, nëse i përkasin shtetit, edhe aktivitet e ngurtësuar (ose të trupëzuara) që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve publike** si... ndërtesat së bashku me oborret që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti, për arsimin, shkencën, kulturën dhe **sportet**..., për institucionet qendrore dhe vendore ...

Sipas nenit 4 pika 2, Ndryshimi i statusit të një prone të paluajtshme të shtetit nga publike në jopublike bëhet sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

Në nenin 31 pika 1, të ligjit nr 9376 të vitit 2005, para ndryshimeve të mëtejshme, parashikohet se ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qendror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".

Pra nga sa më sipër, qartësisht konstatohet se territoret e sipërcituara, për të cilat vendoset kthimi, janë prona të shtetit që paraqesin një interes publik.

Sipas ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, të ndryshuar më datë 17.07.2006, në nenin 8/1 është parashikuar në lidhje me truallin e zënë me ndërtime në pronësi të shtetit, se kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim.

Për të vërtetuar këtë moment, shtetasi Bashkim Bekteshi, si më sipër u pasqyrua, më datë 17.01.2007 depoziton një shkresë, që mesa konstatohet, i është vënë në dispozicion nga funksionarë shtetërorë, pasi është një korrespondencë institucionale, duke treguar në këtë mënyrë se palët e njohura pronare kanë pasur akses në këto institucione, në të cilën pasqyrohet se Ministria e Mbrojtjes i kërkon METE-s privatizimin. Kjo shkresë administrohet pa u protokolluar nga AKKP dhe bëhet pjesë e dosjes, megjithëse jo e njehsuar me origjinalin, pra pa plotësuar kushtet e aktit zyrtar.

106. Janë përpiluar relacione fiktive për kohën e kryerjes, pra data e vendosur në këto relacione, nuk përputhet me përmbajtjen, pasi janë cituar shkresa që janë administruar më vonë. Shqyrtimi dhe relacioni i katër dosjeve, ka përfunduar deri më dt 12.03.2007, ndërkohë që rezulton se, janë administruar shkresa edhe pas kësaj date, madje edhe shkresa që janë përmendur në këtë relacion (*shih shkresat e Ministrisë së Mbrojtjes hyrë në institucion dt 16.07.2007 apo e ZRPP që mban dt 15.03.2007*). Kjo nënkupton se datat e relacioneve janë fiktive, të vendosura vetëm për të treguar një radhë pune që duket se nuk është ndjekur dhe përpilimi e plotësimi i akteve është kryer formalisht, në mënyrë që të konkludohej sa më parë me vendimmarrje. Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes ka hyrë më dt 16.03.2007 ditë e premtë dhe më dt 19.03.2007, ditën e hënë është proceduar me përpilimin e projekt vendimit.

107. Në relacion dhe vlerësimet ligjore, relacionet janë të paplota siç është shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes, që kërkon të njoftohet para se të bëhet regjistrimi i pronave të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim krijimin e mbivendosjes. Shkresa e Ministrisë së Mbrojtjes, ku kjo e fundit kërkon që të merret prej saj, konfirmimi përpara regjistrimit të pronësisë, nuk rezulton të jetë respektuar dhe as të jetë cituar e plotë, nëpër relacione apo vlerësim ligjor ose vendim.

108. Janë marrë vendime pa u administruar përgjigjet nga institucionet.

109. Nuk është mbledhur informacioni i duhur nga institucionet, pasi këtyre të fundit, nuk i është kërkuar informacioni i saktë vetëm vetëm zonën e pretenduar për kthim.

110. Konstatohet se mënyra se si janë trajtuar këto dosje, është e njëjtë dhe duke u shfrytëzuar dokumentat e njërës apo tjetrës dosje, pa u mbajtur akte dokumentimi të marrjes së akteve nga

njëra dosje tek tjetra. Kështu sjellim në vëmendje konkretisht shkresat e Ministrisë së Mbrojtjes.

111. Janë kthyer prona në kundërshtim me nenin 41 dhe 42 të Kushtetutën e Republikës, që garanton mbrojtjen e pronës. Rezulton se janë kthyer pjesë pronash që kanë çenuar pronësinë e të tretëve, duke krijuar mbivendosje, sepse kanë qenë të regjistruar në emër të personave të tjerë siç është rasti i shoqërisë G-Kam sh.p.k. apo rasti i orkestrës frymore të ushtrisë.

111.1. KKKP dhe AKKP ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 gërma "b" të ligjit nr. 9235 datë 08.06.2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës*" në të cilin sanksionohet se nuk kthehen pronat që janë të zëna sipas akteve ligjore të paraqitura në shtojcën 1 të këtij ligji. Në shtojcën 1 pika 2 të këtij ligji, parashikohen pronat e zëna nga ligji nr. 7512 datë 10.08.1991 "*Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit*" duke sjellë në këtë mënyrë, një konflikt me vëllezërit Kapollari dhe shoqërinë G Kam.

Nga aktet e administruara përgjatë hetimit, të gjendura në dosjet gjyqësore, rezulton se **me kontratën e shitjes datë 13.11.1995** shtetasi Ali Selmani ka blerë nga Ndërmarrja e Transport Makineri Ndërtimi dhe degës së AKP Bashkisë Tiranë, **Ndërmarrjen e transportit Makineri Ndërtimi** me adresë rruga Ndre Mjeda, në vlerën 23 415 282 lekë. Në vijim është lidhur edhe kontrata e shitjes me nr. 4735 rep nr. 7629 kol datë 22.11.1995 me shitës, Ndërmarrja e Transportit të Makineri Ndërtimi dhe shtetasit Ali Selmani në lidhje me godinën që zë sip 7761 m2. Sipas vërtetimit të pronësisë të lëshuar nga Ipoteka, datë 27.07.1998, vërtetohet se në regjistrin ipotekor me nr. 5332 datë 22.11.1995, në pronësi të Adriatik Kapollarit, **figuron e regjistruar godina e transportit të makinerive të ndërtimit të ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, me sip 7761 m2 e kufizuar nga perëndimi me rrugën Ndre Mjeda**, nga veriu me pjesën e nyjes së betonit, një pjesë me raportin ushtarak, nga lindja me Klubin Partizani, nga jugu po me klubin Partizani dhe territorin sportiv Partizani.

Me kontratën e shitblerjes së truallit nr. 5847 rep nr. 1703 kol datë **01.09.1998**, Agjensia Kombëtare e Privatizimit Dega Tiranë, i ka shitur blerësit, shtetasit Adriatik Kapollari, **truallin me sip 7761 m2, truall i cili është sip e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të objektit Ndërmarrja e Transportit Makineri Ndërtimi**. Blerësi ka likujduar të gjithë shumën e përcaktuar për blerjen e këtij trualli dhe me mandat arkëtimi nr. 341278 datë 31.08.1998, të Bankës së Kursimeve Tiranë, ka likujduar shumën prej 9 313 200 lekë dhe pas nënshkrimit të kësaj kontrate noteriale AKP që përfaqëson shtetin shqiptar, e humbet çdo të drejtë pronësie mbi këtë truall. Blerësi Adriatik Kapollari pas nënshkrimit të kësaj kontrate noteriale bëhet pronar i vetëm i pronës: Një truall me sip 7761 m2 dhe i godinës së transportit të makinerive të ndërtimit që ndodhet mbi këtë truall, pronë e ndodhur në rrugën Ndre Mjeda dhe që kufizohet në perëndim me rrugën Ndre Mjeda, veri me pjesën e nyjes së betonit, një pjesë me raportin ushtarak, lindja me Klubin Partizani dhe territorin sportiv Partizani. Sipas vërtetimit nga dokumentat hipotekore datë lëshimi 09.08.2004, vërtetohet se në regjistrin hipteokor nr. 3215 datë **02.09.1998** në emër të shtetasit Adriatik Kapollari, figuron e regjistruar pasuria e ndodhur në ZK 8220, një truall me sip 7761 m2 dhe i godinës së transportit të makinerive të ndërtimit që ndodhet mbi këtë truall, pronë kjo e ndodhur në rrugën "*Ndre Mjeda*". Kufizimet e pasurisë janë: *Veri me pjesën e Nyjes së betonit; Jugu dhe Lindja me Klubin Partizani dhe perëndimi me rrugën Ndre Mjeda*. Në komentet e regjistruarit është bërë shënimi se: Ky vërtetim është i vlefshëm për AKP pasi sip vijëzuar në genplan është 15 050 m2. Pronari ka privatizuar 7761 m2. Origjina e kësaj pasurie është nr hip 5332 datë 22.11.1995.

Me kontratën e shitblerjes nr. 5592 rep nr. 1201 kol datë 09.09.2004, shtetasi Adriatik Kapollari i ka shitur shoqërisë Kam sh.p.k. pasurinë e llojit truall me sip 7 761 m² dhe i godinës së transportit të mainerive të ndërtimit që ndodhet mbi këtë truall, pronë e ndodhur në rruga Ndre Mjeda, ZK 8220. Çmimi është 1 900 000 lekë. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekorë të vitit 2004, vërtetohet se, në regjistrin hipotekor me nr. **403 datë 15.12.2004, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë G Kam sh.p.k. përfaqësuar nga Kujtim Kapollari, pasuria me nr. 2/233 ZK 8220 me sip trualli 7761 m² dhe i godinës së transportit...**

Kthimi i pronës familjes Begeja, si në vitin 2006 ashtu edhe në vitin 2007 ka shkaktuar mbivendosje pikërisht me pronën e mësipërme të regjistruar në emër të shoqërisë G-Kam. Për këtë arsye shoqëria G Kam është detyruar të investojë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë padinë e datës 01.04.2010, ku padit Ministrinë e Financave, Drejtorinë e Administrimit dhe shtjes së pronës Publike, me objekt saktësimin e sipërfaqes së pronës dhe kufizimet përkatëse. Me kërkesën e datës 19.11.2010, të paraqitur në Gjykatën Tiranë, shtetasi Haki Begeja i përfaqësuar nga Xhimi Begeja, paraqet kërkesën për ndërhyrës dytësor në gjykimin që zhvillohet mbi bazë të kërkesë padisë së depozituar më datë 01.04.2010 shoq G-Kam sh.p.k. Me prokurën e posaçme nr. 7486 rep nr 2552 kol datë 14.06.2011 para noterit Julian Zhelegu, Bashkim Bekteshi, emëron si përfaqësues av. Sokol Barçi, që ta përfaqësojë në këtë gjykim. Me kërkesën datë 16.06.2011 për të njëjtin gjykim, shtetasi Bashkim Bekteshi i përfaqësuar nga av. Sokol Barçi paraqet kërkesë për ndërhyrës kryesor në proces. Me kërkesën nr 5317 prot datë 01.07.2011 shtetasi Bashkim Bekteshi i përfaqësuar nga Sokol Barçi paraqet kërkesën për ndërhyrës kryesor duke paditur shoqërinë tregtare G – Kam dhe Drejtorinë e shitjes dhe administrimit të pronës publike pranë MF, me objekt ,konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes nr 5847 rep nr 1703 kol datë 01.09.1998 dhe detyrimin e të paditur G-Kam, ta njohë pronar të godinave të ngritura mbi truallin pronë e tij dhe pasi Bashkimi t'i ketë paguar vlerën e ndërtimit të lirojë dhe dorëzojë sendin.

Nga aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore me nr. 8053 datë 17.10.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton një akt ekspertimi, i përgatitur nga eksperte Lirie Kruja, i datës 13.12.2010, sipas të cilit rezulton se përveç pasurisë së regjistruar me nr. **3/138 ZK 8220 me regj hip 74 datë 21.03.2007**, në emër të trashëgimtarëve Begeja është regjistruar edhe pasuria me nr. **2/325 ZK 8220 e cila bie pjesërisht brenda territorit të ish ndërmarrjes së transportit të makinerive të ndërtimit dhe pjesërisht jashtë tij, në hyrje të ish ndërmarrjes.** Trashëgimtarët Begeja janë pronarë të truallit me nr. **pas 3/162 me sip 190 m² dhe nr pas 3/163 me sip 495 m²** që bien pjesërisht në territorin e ish ndërmarrjes.

Në këtë akt ekspertimi, është përcaktuar se pasuria me nr. **3/138 ZK 8220 me sip 3120 m² bie brenda territorit të ish ndërmarrjes së transportit të makinave të ndërtimit.** Pasuria me nr. **2/325 ZK 8220 me sip 380 m² pjesërisht brenda territorit të ish ndërmarrjes së transportit të makinave të ndërtimit dhe pjesërisht para portës së hyrjes.** Pasuria me nr. **3/162 ZK 8220 me sip 190 m² bie pjesërisht brenda territorit nën godinën 2 kt nr. 5** të ish ndërmarrjes së transportit të makinave të ndërtimit dhe pjesërisht jashtë. Pasuria me nr. **3/163 ZK 8220 me sip 495 m² bie pjesërisht brenda territorit (nën godinën 2 kt nr. 5)** të ish ndërmarrjes së transportit të makinave të ndërtimit dhe pjesërisht jashtë. Prona e familjes Begeja me nr pas 3/138 me sip trualli 3120 m² është e shënuar në planvendosjen fleta nr. 4 me rrjet me ngjyrë të verdhë, mbivendoset me sip e vendparkimit, pronë e shoq G – Kam sh.p.k. në masën 1584 m² dhe me godinën nr. 5 në masën 109.14 m². Pjesa tjetër e kësaj sip prej 1645.14 m² bie në territorin e ish ndërmarrjes para godinës nr. 5 por që nuk është blerë nga pala paditëse.

Prona e familjes Begeja **me nr pas 3/325** me sip trualli 380 m² e shënuar në planvendosjen fleta 4, e konturuar me ngjyrë violë, mbivendoset: -me truallin (**trualli nën objekt + truallin e trotuarit**) nën objektin nr. 6 pronë e shoqërisë G Kam sh.p.k. në masën 160 m²; Me truallin

nën godinën nr. 2 (**trualli nën godinë + trotuar**) në masën 9.1 m²; Me truall të lirë brenda territorit në masën 60 m². Sip prej 150.9 m² është jashtë territorit të ish ndërmarrjes para derës së hyrjes

Prona e familjes Begeja **me nr. pas 2/162** me sip trualli 190 m², e shënuar në planvendosjen fleta nr. 4 e konturuar me ngjyrë blu, mbivendoset si më poshtë: Me truallin (**trualli nën objekt + truallin e trotuarit**) nën objektin nr. 5 pronë e shoq G – Kam sh.p.k. në masën 148 m²; Me truallin nën godinën 3 katëshe ngjitur me godinën nr. 5 në masën 12 m², kjo sip bie tek sip e vendparkimit blerë nga paditësit; Diferenca tjetër e sip së truallit bie jashtë territorit të ish ndërmarrjes

Prona e familjes Begeja **me nr. pas 2/163** me sip trualli 495 m², e shënuar në planvendosjen fleta nr. 4 e konturuar me ngjyrë portokalli, mbivendoset si më poshtë: Me truallin (**trualli nën objekt + truallin e trotuarit**) nën objektin nr. 5 pronë e shoq G – Kam sh.p.k. në masën 223.16 m²; Me truallin nën godinën 3 katëshe ngjitur me godinën nr. 5 në masën 15.5 m², kjo sip bie tek sip e vendparkimit blerë nga paditësi. Pjesa tjetër e sip së truallit është jashtë territorit të ish ndërmarrjes.

Gjithashtu gjatë këtij gjykimi është përgatitur edhe një akt ekspertimi shtesë datë 25.03.2011, për mbivendosje të sipërfaqes prej 2195.7 m² e pretenduar si e blerë nga pala paditëse, në funksion të objekteve ekzistuese.

Shoqëria G-Kam ka investuar gjykatën edhe me kërkesë padinë e datës 17.05.2012 (*shih dosjen gjyqësore me nr. 10002 vendimi datë 24.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*), duke paditur shtetasit trashëgimtarët Begeja, AKKP dhe duke thirrur si person të tretë ZVRPP. Ai ka kërkuar anulimin e pjesëshëm të dy vendimeve si atij me nr 135 datë 20.01.2006 për sip prej 3120 m² regjistruar në emër të familjes Begeja me nr 3/138 ZK 8220 ashtu edhe të vendimit nr 6 datë 21.03.2007 për dy sip 160 m² dhe 60 m² regjistruar po në emër të familjarëve Begeja, me nr pas 2/325, 2/162 dhe 2/163 të ZK 8220, duke pretenduar mbivendosje prej 1584 m² të sip së blerë si dhe pjesa tjetër me oborrin funksional të ish ndërmarrjes. Gjithashtu është pretenduar se ZRPP në mënyrë krejtësisht të jashtëligjshme ka fshirë nga regjistri hipotekor dt magazina të privatizuara nga shoqëria G Kam dhe i ka regjistruar në emër të familjes Begeja.

Me kërkesë padinë datë 16.11.2012 (*shih dosjen gjyqësore me nr 9193 vendimi datë 17.009.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*) shoqëria G – Kam, e përfaqësuar nga administratori Kujtim Kapollari dhe shtetasi Adriatik Kapollari, kanë paditur Drejtorinë e Shitjes dhe Administrimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave si dhe ZVRPP Tiranë, duke thirrur ndërkohë si persona të tretë, Bashkinë Tiranë dhe trashëgimtarët Begeja, me objekt *Saktësimi i kufijve të pasurisë dhe gentplanit që shoqëron kontratën e shitjes me nr 5847 rep nr. 1703 kol datë 01.09.1998. Detyrimi i ZVRPP të regjistrojë pronën.*

Nga akti i ekspertimit i datës 24.05.2013, i administruar përgjatë këtij gjykimi, përgatitur nga eksperte Lirie Kruja rezulton ndër të tjera se: *...ish Ndërmarrja e Transportit të Makinerive të Ndërtimit* përbëhet nga disa objekte, ku të privatizuara janë gjithsej 8 objekte, ku evidentohet ndër të tjera se **Objekti nr. 5** godinë 2 katëshe, nuk ekziston aktualisht, ai ka patur një sip ndërtimore sipas matjeve të realizuara më parë prej 379.72 m². **Mbi truallin ku ka qenë objekti nr. 5 aktualisht është duke u zhvilluar një godinë shumëkatëshe nga pala e tretë.** **Objekti nr. 6** ndodhet në hyrje të oborrit të ish Ndërmarrjes nga ana perëndimore e saj, është godinë një katëshe me konstrukcion mbajtës mur tulle, mbulim i realizuar me soletë b/a, sipas matjeve rezulton se ky objekt ka një sip ndërtimore 112.94 m². Sip e truallit të privatizuar nga

pala paditëse është 7761 m² por nuk është e pasqyruar grafikisht në momentin e privatizimit por është brenda territorit të ish ndërmarrjes. **Sip e truallit nën 8 objektet e blera duke përfshirë edhe trotuari rreth këtyre objekteve është 5850.01 m².** Referuar sip së blerë prej 7761 m² nga pala paditëse, rezulton se sip funksionale e blerë, e cila nuk është e përcaktuar në momentin e privatizimit, rezulton të jetë 1919.99 m² (7761-5850.01). **Sip e truallit nën objektin nr. 5 është 480.2 m² (me trotuaret) dhe nën objektin nr. 6 është 160.13 m² (me trotuaret) të cilët përfshihen në pronën e personit të tretë.**

Në vijim të ekspertimit është theksuar se pasuritë e personave të tretë (familjes Begeja) mbivendosen mbi objektin nr. 5 dhe nr. 6 si dhe me oborrin e ish ndërmarrjes. **Sip e truallit nën të dy objektet prej 640.33 m² ka mbivendosje me të tre pasuritë e familjes Begeja.**

Me vendimin nr. 9193 datë **17.09.2013** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: *Saktësimi i sip së pasurisë së paluajtshme ish Ndërmarrja e Mjeteve të Transportit të Ndërtimit Tiranë, pasuria me nr. 2/233 ZK 8220 rruga Ndre Mjeda, Tiranë, në pronësi të palës paditëse shoqëria G - Kam sh.p.k. prej 7761 m², sipas vërtetimit hipotekor nr. 403 datë 15.12.2004 të lëshuar nga ZVRPP Tiranë me sip ndërtimore 5065.68 m² dhe sip e lirë nën funksion të objekteve 2695.32 m², pasqyruar dhe shënuar në plan vendosjen e aktit të ekspertimit me ngjyrë gri dhe blu, planvendosje e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Detyrimin e palës së paditur ZVRPP Tiranë të regjistrojë pronën e saktësuar në pronësi të palës paditëse shoqëria G – Kam sh.p.k. mbështetur në këtë planvendosje...*

Në regjistrin hipotekor është bërë shënimi në lidhje me këtë pasuri, se në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të sipërcituar, **regjistrohet prona sipas kufijve të përcaktuar vetëm për pjesën e lirë. Përsa i përket pjesës së mbivendosur do të procedohet me urdhër refuzimi.** Sipas vërtetimit nga dokumentat hipotekorë të vitit 2013 me regjistruet Elona Bici, rezulton se vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. 403 datë 15.12.2004 figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë G-Kam sh.p.k. pasuria me nr. 2/352 ZK 8220 me sip ST = 7761 m² në adresë truall me sip 7761 m² dhe i godinës së transportit të makinave të ndërtimit që ndodhet mbi këtë truall ndodhur në rr: "Ndre Mjeda". Origjina e regjistrimit sipas nr hip 3215 datë 02.09.1998. Mbështetur në vendimin e gjykatës nr. 9193 datë 17.09.2013 më datë 14.11.2013, rezulton se është regjistruar në emër të shoqërisë G-Kam sh.p.k., pas me nr. 2/352 ZK 8220 vol 35 faqa 92 e cila vijon nga vol 43 faqa 125 e ndodhur në rrugën Frosina Plaku, me sip totale 7631 m² nga e cila truall **7631 m²** dhe ndërtesë 5065 m². (datë lëshimi certifikate më datë 05.12.2018). Sipas kartelës së pasurisë rezulton se në vol 43 faqa 125 në ZK 8220 me nr pasurie 2/233 ka qenë e regjistruar pasuria e ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, me sip totale 7761 truall e saktësuar me Ref LN 2017 në 7 703.5 m². Pra në ZVRPP rezulton se nga sip e njohur me vendimin gjyqësor të mësipërm, **nuk është regjistruar 130 m²** që është mbivendosje.

112. Janë kthyer prona në kundërshtim me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", pasi rezulton se është kthyer një pjesë prone që ka qenë në planin e përhapjes. Pronat e Ministrisë së Mbrojtjes ktheheshin, por me kushtin që të ishin jashtë strukturës së Forcave të Armatosura.

Përgjatë këtij hetimi, janë ngritur dyshime mbi faktin nëse Klubi i Futbollit Partizani, rezultonte apo jo të ishte në planin e përhapjes. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se në fakt, ajo që ka qenë pjesë e planit të përhapjes ka qenë Orkestra frymore në KS Partizani. Kjo gjë evidentohet në planin e përhapjes të miratuar me nr 336/4 prot datë 10.06.2004, në planin e përhapjes të miratuar me shkresën nr. 231/3 prot datë 29.03.2006 të Presidentit të Republikës. Kjo strukturë

ka vijuar të ngelet e tillë edhe në planet e përhapjes të miratuara me nr 638/1 prot datë 29.08.2007 dhe nr 6358 datë 09.12.2009 nga Presidenti i Republikës.

Orkestra Frymore e Ushtrisë rezultoi se në bazë të VKM-së nr 515 datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes" është identifikuar si prona me nr. 7, e ndodhur në Rrugën "Frosina Plaku", Tiranë, me sip 1230 m2, kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes.

AKP, në vendimin e marrë si më sipër për familjen Saliaga, ka kthyer edhe një pjesë të pronës së orkestrës frymore, që ndodhet në planin e përhapjes, duke sjellë në këtë mënyrë mbivendosje dhe konflikt mes pronarëve.

Në plan veprimin nr. 782/26 prot datë 30.05.2011 "Mbi shqyrtimin paraprak të dosjes me nr. 782 datë 28.12.2010 në emër të subjektit të shpronësuar Sabrije Llagami", të mbajtur nga grupi i punës Laureta Nezaj, Paulin Papekaj dhe Rudina Kumanova, është pasqyruar se nga shqyrtimi paraprak i kërkesës, u konstatua se dokumentacioni i administruar në dosje, nga pikëpamja formale nuk është në përputhje me dokumentacionin e përcaktuar në VKM nr. 255 datë 13.04.2010. Për këtë arsye vlerësojnë se duhen nisur kërkesat për konfirmim pranë institucioneve të treta konform kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 255 datë 13.05.2010.

Me shkresën nr. 782/9 prot datë 08.06.2011 i është kërkuar informacion Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve konfirmim nëse sip e Sport Klub Partizanit, është në inventarin e kësaj ministrie dhe nëse kjo pronë përdoret për nevojat të interesit publik.

Me shkresat nr. 782/16 prot datë 13.09.2011, nr. 782/18 prot datë 31.01.2012, nr. 782/19 prot datë 16.03.2012 (tek kjo shkresë e fundit citohet prona pjesa e oborrit e Bandës së Ushtrisë që ndodhet brenda sip së përgj të Sport Klub Partizanit) i janë përsëritur kërkesat për informacion kësaj ministrie.

Vetëm me shkresën nr. 1830/4 prot datë 25.04.2012 kjo ministri i kthen përgjigje AKKP, duke e bërë me dije se, me VKM nr. 312 datë 15.05.2003 "Për ndryshimin e varësisë së Klubit Sportiv Shumësportesh Partizani nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve" Klubi Sportiv Shumësportesh Partizani ka kaluar në administrim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve së bashku me asetet.

Objekti i Bandës së Ushtrisë bashkë me oborrin, Ministria e Mbrojtjes ia ka kaluar në administrim Bandës së Ushtrisë prej më shumë se 30 vjetësh. Banda e Ushtrisë vazhdon akoma të ushtrisë aktivitetin e saj në këto ambiente. Përsa më sipër, mund t'i drejtohen Ministrisë së Mbrojtjes.

Me shkresën nr. 782/21 prot datë 04.05.2012 AKKP i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, duke i kërkuar konfirmim nëse sip e Sport Klub Partizani, Banda e Ushtrisë e pretenduar nga subjekti i shpronësuar është në inventarin e kësaj ministrie dhe nëse kjo pronë përdoret për nevojat të interesit publik.

Me shkresën nr. 5822/2 prot datë 01.06.2012 Ministria e Mbrojtjes, konkretisht sekretari i përgjithshëm Edvin Kulluri, kthen përgjigje duke bërë me dije se pas verifikimeve të bëra, në bazë të VKM nr. 515 datë 18.07.2003, prona e pretenduar sipas hartës së dërguar, pasuria nr. 3/1 dhe 2/60 janë pjesë e pronës nr. 7 me emërtimin "Reparti Ushtarak nr. 1070, "Orkestra frymore e ushtrisë" me sip 1230 m2 me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku, Tiranë. Kjo

pronë është në Planin e Përhapjes së Forcave të Armatosura miratuar me dekret të Presidentit nr. 6358 datë 09.12.2009.

Gjithashtu ka vendosur kthimin e pronës familjes Llagami, vendim ky që në fakt është shfuqizuar.

Përgjatë hetimit, i është kërkuar informacion Ministrisë së Mbrojtjes se ku ndodhen sot prona e inventarizuar sipas VKM nr. 515 datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes" me Nr. 7 Orkestra frymore rruga "Frosina Plaku", Tiranë me sip 1230 m².

Me shkresë Nr.3221/1 Prot, datë 14.06.2023 Ministria e Mbrojtjes na ka vënë në dispozicion kopje të shkresës që ka administruar nga Komanda e Forcave Ajrore në lidhje me informacionin e kërkuar nga ana jonë ku na informon si vijon:...**Orkestra Frymore: Prona Nr. 7 në adresën Rruga Frosina Plaku lagja 21 Dhjetori Tiranë me emërtimin "Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura" në vitin 2003 sipas VKM nr. 515 datë 18.07.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes"** ka qënë në administrim të **Qendrës Kulturore të Ushtrisë Tiranë** me sipërfaqe prej 1,230 m² më pas Orkestra Frymore kalon në varësi të Regjimentit të Mbështetjes dhe në zbatim të VKM-së Nr.116 datë 17.02.2011 **kjo pronë ka një sipërfaqe prej 1,489.53 m²** dhe po me të njëjtën sipërfaqe në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 604, datë 23.07.2014 "Për riorganizimin e batalionit të mbështetjes të SHPPFA" është marrë në administrim nga Batalioni i Mbështetjes po me të njëjtën sipërfaqe por me probleme mbivendosje për një sipërfaqe prej 259 m². Për këtë sipërfaqe, prej 259 m² ka pretendime familja Saliaga, me të cilin janë në proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Në shkresë citohet se ky gjyq është fituar nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes/strukturave në varësi dhe procesi vazhdon në Gjykatën e Apelit Tiranë. **Sipërfaqa me mbivendosje ndodhet brenda rrethimit të repartit dhe administrohet nga ana e Repartit. Aktualisht e gjithë prona prej 1489.53 m² (përfshi edhe sipërfaqen prej 259 m² për të cilën ka pretendime për mbivendosje) është në ruajtje dhe administrim të batalionit të mbështetjes ku vazhdon të jetë e vendosur dhe të kryejë veprimtarinë e saj Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura.**

Në kuadrin e rishqyrtimit të vendimit të vitit 2007 për familjen Llagami konstatohet se me shkresën nr. 782/8 prot datë 08.06.2011 i është kërkuar informacion **Drejtorisë së Urbanistikës, Bashkia Tiranë**, mbi konfirmimin e gjendjes urbane, nëse ka studim të miratuar nga KRRT-ja, nëse ka ndërtime që përbëjnë interes publik ose përfshihen në listen e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të transferuara në pronësi të qeverisjes vendore. Me shkresën nr. 3954/1 prot datë 26.07.2011 Bashkia e Tiranës kthen përgjigje duke përcaktuar pronat shtetësore publike, rrugë, **pasurinë me nr. 3/84 Klubi i Futbollit Partizani, pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme Bashkia Tiranë, që është në proces miratimi.**

Në lidhje me studimet urbanistike sqaron se, sipas planit rregullues në fuqi prona **ndodhet në një zonë sportive dhe preket nga rrjeti rrugor i planit në fuqi.** Sipas planit të ri rregullues prona ndodhet në një zonë me zhvillim të ulët kompakt dhe në një zonë me zhvillime të reja me parametra urbane të mesëm dhe të latë në të cilat procedohet duke ruajtur karakterin e zonës. Në veri të pronës kalon rrugë dytësore kryesore. **Sa më sipër të mos procedohet me kthimin e pronës dhe trualli të përdoret për interes publik.**

Me shkresën nr. 782/1 prot datë 08.06.2011 i janë drejtuar **Njesisë Bashkiake Nr. 7** për

konfirmimin e statusit të pronës së pretenduar, nga pikëpamja e inventarizimit të pronës shtetërore dhe funksionit aktual, konfirmimin nëse prona i shërben apo jo interesit publik. Me shkresën nr. 1021/1 prot datë 14.06.2011 Njësia Bashkiake kthen përgjigje duke thënë se konfirmojnë gjendjen aktuale të pronës mbi objektet me apo pa leje që gjenden në këtë pronë. Lidhur me statusin e pronës dhe nëse i shërben interesit publik apo jo, është kompetencë e Njesisë Vendore Bashkia Tiranë.

Me shkresën nr. 782/10 prot datë 08.06.2011, i janë drejtuar ALUIZNI-t për të konfirmuar nëse ka objekte në proces legalizimi në këtë sip. Është ripërsëritur kërkesa me nr. 782/15 prot datë 13.09.2011. Me shkresën nr. 2886/1 prot datë 15.09.2011 ALUIZNI kthen përgjigje, duke përcjellë një fragment të hartës vektor të zhornuar deri ditën e sotme nga ALUIZNI në nomenklaturën TR. O-7, P-7, ZK 8220, ku janë evidentuar emrat e pronarëve që kanë kërkuar legalizim dhe kufijtë e pronave të poseduara prej tyre.

Me shkresën nr. 782/7 prot datë 08.06.2011 i janë drejtuar ZVRPP për konfirmin e gjendjes juridike të pronës. Me shkresën nr. 6334/1 prot datë 24.06.2011 ZRPP ka përcjellë informacion mbi pronarët e konkretisht Saliaga, pasuri shtet, Lando Labricosa, Reparti Ushtarak, shtet, Llagami, Begeja, Gjetan Kuta.

Me relacionin nr. 782/27 prot datë 21.09.2012 të përgatitur nga grupi i punës, është propozuar rrëzimi i kërkesës, moskthimi i sip prej 360 m2 duke pasur parasysh faktin se, **prona e pretenduar është në përgjegjësi administrimi të MM dhe është në planin e përhapjes, duke u konsideruar kështu e zënë në mbështetje të ligjit nr. 6358 datë 09.12.2009.** Me shkresën nr. 782/29 prot datë 14.11.2012 përgjegjësi i sektorit juridik ka mbështetur propozimin përfundimtar të grupit të punës. Me vendimin nr. 678 datë 03.12.2012 (nr. 782/30 prot datë 03.12.2012) AKKP ka vendosur moskthimin e sip prej 360 m2.

113. Gjithashtu, rezulton se kthimi i pronave si më sipër, ka sjellë problematika, pasi ka krijuar mbivendosje edhe me institutin Hidrometeorologjik.

Me VKM Nr.440, datë 16.6.2005 *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi akademisë së shkencave”* është vendosur miratimi i listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave.

Kthimi i pronave pikërisht familjes Begeja, ka sjellë mbivendosje me ambjentet e ish Institutit të Hidrometeorologjisë, trull ku ndodheshin objekte që i përkasin Observatorit të Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit. Observatori i IHM sipas listës së inventarit të Pronave të paluajtshme shtetërore (për inventarizimin e pronave të veçanta) ka të përcaktuar se prona Godina e Observatorit Tiranë, ndodhur në rrugën Frosina Plaku, ka sipërfaqe totale të pronës 3700 m2 nga e cila ndërtesë 667.4 m2 dhe sipërfaqe të brendshme 1335 m2.

Me VKM nr 560 datë 22.08.2007, të nënshkruar nga shtetasi Sali Berisha, është vendosur bashkimi i ish Institutit të Hidrometeorologjisë dhe ish Qendrës së Kërkimeve Hidraulike, të Akademisë së Shkencave dhe Organizimin e tyre në Institutin e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (INEUM) si njësi kryesore pranë Universitetit Politik të Tiranës. Pasuritë e paluajtshme të cilat transferohen janë ndër të tjera edhe Observatori i Institutit të Hidrometeorologjisë Tiranë.

Me shkresën datë 05.05.2009 të nënshkruar nga përfaqësuesi i familjes Begeja shtetasi Xhimi Begeja (sjellim në vëmendje se nuk ka ndonjë akt përfaqësimi), ky i fundit i është drejtuar

Universitetit Politeknik të Tiranës duke pretenduar pronësinë mbi truallin dhe lidhjen e një kontrate qeraje e cila sipas tij shfrytëzohet si oborr pa objekte të lidhura me tokën nga Instituti Meteorologjik. Gjithashtu me shkresën datë 10.06.2010 sërish me të njëjtën cilësi, shtetasi Xhimi Begeja i është adresuar sërish Universitetit Politeknik të Tiranës duke i kërkuar marrjen e masave të menjehershme për heqjen e objekteve (aparaturave) nga trualli në pronësi të familjes Begeja. Ndodhur në këto kushte, Universiteti Politeknik i Tiranës i është drejtuar ZVRPP për informacion, duke pasqyruar se ambientet për të cilat familja Begeja pretendon pronësinë, i kanë kaluar Akademisë së Shkencave me VKM nr 440 datë 10.06.2005 dhe me VKM nr 560 datë 22.08.2007 Institutit të Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, pranë UPT. Për këtë arsye kërkon sqarim nëse prona e paluajtshme në fjalë është në përgjegjësi administrimi të këtij universiteti apo në pronësi të familjes Begeja. Me shkresën nr 6238/1 prot datë 29.06.2010, regjistruesi Fetah Hasanaj i ZVRPP Tiranë kthen përgjigje se pasuria për të cilën kërkojnë informacion ndodhet në truallin e regjistruar në kartelat e pas të paluajtshme me nr pas 3/153 vol 15 faqa 184 me sip të përgjithshme 9213 m² në emër të bashkëpronarëve Begeja në bazë të vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave me nr 6 datë 21.03.2007.

114. Në kundërshtim me kreu III të VKM nr. 747 datë 09.11.2006 "*Për procedurat e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit të kërkesave të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës*" nuk janë administruar të dhëna nga ALUIZNI mbi ndërtimet e kryera, nëse janë apo jo në proces legalizimi.

115. Sipas ligjit Nr.9583, datë 17.7.2006 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar*" është shtuar neni 28/1 "*Dispozita kalimtare*" parashikohet se:

Për pasuri të paluajtshme, mbi të cilat janë ngritur nga të tretë objekte pa leje në kundërshtim me ligjin "Për urbanistikën", kthimi fizik nuk zbatohet pa përfunduar afatet ligjore të parashikuara për legalizimin e objekteve në zona informale dhe objekte të tjera informale me vendndodhje brenda territoreve formale.

116. Nga aktet e administruara pranë AKKP-së nuk rezultoi të jetë administruar asnjë dokument që të verifikonte faktin nëse kishte objekte pa leje të ndërtuara dhe nëse ishin në proces legalizimi.

117. Siç edhe në vijim do të shihet, në territoret sportive, ishin vendosur shumë familje të cilat edhe kishin paraqitur praktikën pranë ALUIZNI-t për legalizim apo familje të cilat ishin futur në objektet sportive të klubeve, si të pastrehë. Këta shtetas, në vijim quhen si "*uzurpatorë*" nga shtetasi Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, ku këta të fundit, me qëllim largimin e tyre, detyrohet edhe t'i paguajnë në vlera monetare ose me dhënie njësie banimi.

118. Nga aktet rezultojnë se perkundrejt shperblimeve, qe u jane ofruar qytetareve ata kane hequr me pas dore nga legalizimi. Keshtu mund te permendim praktiken e legalizimit nr 11 prot datë 24.07.2006 te subjektit Arbër Fatbardh Shtylla; nr. 893 datë 24.11.2006 te shtetasve Shkelqim dhe Zeliqe Sina, nr. 207 prot datë 28.08.2006 te shtetasve Fari dhe Thëllëza Muço, nr. 933 prot datë 10.11.2006 te shtetasve Ernset dhe Entela Prençe, nr. 885 prot datë 24.11.2006 te shtetasve Zigur Alimuçaj dhe Elca Alimuçaj, nr. 765 prot datë 21.11.2005 te shtetasve Gëzim, Elida, Florian dhe Gerald Beno, nr. 884 prot datë 24.11.2006 te shtetasve Haredin dhe Luljeta Hasantari, nr. prot 900 datë 24.11.2006 si dhe praktika e legalizimit me nr. 740 prot datë 13.11.2006 te shtetasve Lazam dhe Manushaqe Hasa, nr prot 602 datë 31.10.2006 te shtetasit Ylli Asllani,

119. Nuk janë administruar të dhëna nga Enti Kombëtar i Banesave, në kundërshtim me parashikimin e nenit 9 të ligjit nr 9235 datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe parashikimet e VKM nr 747 datë 09.11.2006, megjithëse nga hetimi ka rezultuar se në objektet e Klubeve Sportive, janë strehuar një kategori qytetarësh. Konkretisht sipas urdhërit nr. 81 regj datë 14.02.1996 (Ministria e Mbrojtjes) dhe nr. 210 regj (Ministria e Punës...) “Për kalimin kapital ndërtese dhe ambientesh” pasqyrohet se, mbështetur në VKM nr. 153 datë 03.04.1993 “Për kalimin kapital të objekteve dhe mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” dhe nisur nga kërkesat e organeve të ish të përndjekurve politikë, që Ushtria të ndihmojë për strehimin e kësaj kategorie qytetarësh me objekte të liruar prej saj, urdhërohet: Ndërtesa 2 katëshe e sh lojërave me dorë dhe ambientet e ndërtesës 2 katëshe ish e atletikës të Klubit Sportiv Olimpik Partizani Tiranë, të cilat që nga viti 1992 kur kanë mbetur të lira nga reduktimi i aktiviteteve të Klubit janë përdorur për të strehuar familje ish të përndjekura politike, i bëhen kalim kapitali Ministrisë së Punës...për t’i përdorur për banesa për familje ish të përndjekura. Dorëzimi të bëhet brenda datës 10.03.1996 nga KSO Partizani. Nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali dhe Ministri i Punës Engjëll Dakli.

120. Nga aktet e administruara kane rezultuar si te strehuar në godinat ekzistuese të ish Klubit Partizani në cilësinë e ish të përndjekurit politik sipas urdhërit nr 81 regj datë 14.12.1996 të Ministrit të Mbrojtjes dhe urdhërit nr 210 regj datë 14.02.1996 të Ministrit të Punës, familjet e shtetasve Meleq Ndreu, Bujar Ndreu, Astrit Ndreu, Enver Ndreu, Shpetim Ndreu, Lavderim Ndreu, Agron Ndreu, Ylli, Melita, Rigers, Ornela Asllani, Bujar, Nevila, Megi dhe Danja Ndreu, Mersin Ndreu, Shpëtim, Mahmudie dhe Kreshnik Ndreu, Ernset dhe Entela Prençe etj.

Sa më lart, tregon qartazi për një urgjencë në kryerjen e veprimeve, që vërteton se, punonjësit e AKKP-së kishin marrë udhëzime për kryerjen e kthimit të kësaj prone, sa më shpejt të ishte e mundur.

Pasur parasysh që shtetasit Altin Ceni dhe Tetis Lubonja ishin emëruar në muajin nëntor 2006, ndërkohë që shtetësja Dhurata Hoxha është emëruar në tetor 2006, konstatohet se puna e tyre ka nisur pikërisht me këto kërkesa të reja.

E pyetur më datë 20.05.2022, shtetësja *Dhurata Hoxha (Çela)* ka deklaruar se vendimi i marrë në kohën e saj për familjen Begeja ka qenë vendim plotësimi, i cili është bërë pasi *me anë të një VKM-je është ndryshuar destinacioni dhe është lejuar nga institucioni përkatës Ministria e Mbrojtjes që t’i kthehej prona*. Ajo di që vendimet e KKP janë quasi gjyqësore dhe mund të prisheshin vetëm nga gjykata e ndodhur në këto kushte mendon se ka mjaftuar vetëm vendimi i mëparshëm i komisionit të kthimit të pronave, megjithatë nuk është e sigurtë për punën e grupit nëse e ka administruar apo jo dosjen e mëparshme.

Angazhimi i familjeve të njohura pronare për zhvillimin e pronës

121. Në këtë periudhë, ndërmjet viteve 2006 – 2007, pas kthimit të një pjesë prone në janar 2006 familjes Begeja, familjet e njohura pronare, fillojnë të angazhohen me shoqërinë Kontakt sh.p.k. për zhvillimin e pronës që ishte kthyer deri në atë moment.

121.1 Kështu rezulton se vetëm tre ditë, pas miratimit të ndryshimeve të ligjit, për kthimin dhe kompensimin e pronave, shtetasi Jamarbër Malltezi përfaqëson trashëgimtarët Begeja, në lindjen e një marrëdhënie tjetër kontraktore, me shoqërinë Kontakt sh.p.k., për zhvillimin e ndërtimit, në pjesën tjetër të pasurisë të kthyer me vendimin e KKKP nr 135 të vitit 2006. Ajo që evidentohet është se një nga personat që shfaqen të kenë lidhur këtë kontratë, duke qenë të

përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi, është edhe shtetësja **Nimete Bekteshi (gijshja e tij)**. Por, kjo e fundit, rezulton se **ka ndërruar jetë më datë 15.07.2006 (shih certifikatën e vdekjes datë 08.09.2006 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr 1, Tiranë), ndërkohë që kontrata është lidhur më datë 20.07.2006. Pra ka ndërruar jetë 5 ditë para lidhjes së kësaj kontrate.**

Ky është një ndër shumë treguesit e tjerë, se menaxhimi i të gjithë situatës, si në drejtim të privatizimit, të zhvillimit të ndërtimeve etj, është bërë nga shtetasi Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi.

Kështu, rezulton se, me kontratën e sipërmarrjes nr. 8032 rep nr 1303 kol datë **20.07.2006** përpara noteres Ruko Sako, janë paraqitur pala pronare: *Haki Begeja, **Nimete Bekteshi**, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstariova, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Drita Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Teuta Malka, Elona Begeja, Xhimi Begeja, të gjithë të përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Jamarbër Malltezi; Ilir Kadiu i cili për vehten e tij dhe si përfaqësues me prokurë i Vangjeli dhe Manjola Kadiu, gjithashtu i përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi dhe Pala sipërmarrëse: Shoq Kontakt sh.p.k.*

Neni 1. Objekt i kontratës së sipërmarrjes: *Vënie në dispozicion të palës sipërmarrëse të truallit me këtë përshkrim hipotekor: ... një truall me sip 3 120 m² regj me nr pas 3/138 ZK 8220 vol 15 faqa 55. Prona kufizohet nga lindja me pas 3/84 dhe nga jugu me pas 3/139.*

Neni 2. Ndërtimi i objektit shumëfunktional: *Pala pronare bie dakord për bashkëpunimin duke vënë në dispozicion të palës sipërmarrëse shoq së ndërtimit Kontakt sh.p.k. pronën...Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në pronën e vënë në dispozicion nga pala pronare, një kompleks shumëfunktional me parkime, dyqane dhe apartamente, në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës. Leja e ndërtimit do të merret 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje.*

Neni 3: *Pjesa takuese e ndërtimit për palën pronare: Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për pronën e vënë në dispozicion, 26% të sip së përgjithshme të ndërtimit të ri...*

Neni 4: *Të drejtat dhe detyrimet e palës sipërmarrëse: Pala sipërmarrëse në bazë të kontratës së sipërmarrjes plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të kryer veprimet administrative dhe për të realizuar marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit.*

Pala sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje...

Personat që kanë nënshkruar këtë kontratë janë shtetasit Jamarbër Malltezi, Fatmir Bektashi dhe Ilir Kadiu.

Bashkalidhur kësaj kontrate, gjendet licenca me nr 3224/1 në emër të shoqërisë Kontakt sh.p.k. ku drejtues teknik shfaqet ndër të tjera shtetasi Muhamet Kruja (konkretisht shfaqen emrat e Muhamet Kruja, Etleva Verzivolli dhe Kozma Heqimi).

121.2. Siç mund të shihet, familja Begeja ishte e varur nga premtimi për ndryshimin e destinacionit të pronës, premtim i dhënë me kontratën nr 4938 rep nr 831 kol datë **22.05.2006** nënshkruar po mes trashëgimtarëve Begeja përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe shoqërisë Kontakt. Sipas kontratës së vitit 2006 vihej në dispozicion vetëm një pjesë e pronës e konkretisht ajo me nr 3/139 ZK 8220 me sip 6345 m², të kthyer me vendimin nr 135 të vitit

2006, kundrejt një sip që do të përfitohej nga ndërtimi nga pala pronare 22% ose 25 % (ka dy nene që parashikojnë dy përqindje të ndryshme).

Zyrtarisht nuk rezulton që shtetasi Jamarbër Malltezi të ketë kryer ndonjë shpenzim të njohur e të ligjshëm, për të cilin mund të justifikohet dhënia e shpërblimit 3 – 5 % e premtuar si më sipër. Gjithashtu, ishte realizuar edhe kthimi i një pjese të pronësisë vitin 2006, por sërish veprimet rezultojnë të jenë kryer nga kërkuesi shtetasi Bashkim Bekteshi.

Trashëgimtarët Begeja, lidhin marrëveshje nëpërmjet përfaqësimit nga ana e shtetasit Jamarbër Malltezi, se do të venë në dispozicion edhe pronën me nr pas 3/138 ZK 8220 me sip **3 120 m²**, kundrejt marrjes së **26 % të ndërtimit**, dhe se të gjitha shpenzimet e lejes së sheshit dhe të ndërtimit, apo të gjitha shpenzimet e tjera për procedurat administrative dhe burokratike do të kryhen nga shoqëria Kontakt sh.p.k.

Qartazi rezulton se qëllimi i shtetasit Jamarbër Malltezi, kur i është premtuar dhënia e një shpërblimi apo vendosja në dispozicion e fondit 3 – 5 % nuk ka qenë ndonjëherë për të kryer shpenzime materiale/monetare, por ka qenë përdorimi i pushtetit, i cili duket se vjen jo vetëm nga gjendja pasurore që mund të kishte shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe shtetasi Fatmir Bektashi, por nga pushteti i derivuar prej vjehrrit të tij, shtetasit Sali Berisha.

121.2. Sa më lart, në fakt vërtetohet edhe nga fakti se, dokumentacioni për lejen e ndërtimit, për objektin e parë që do të ndërtohej nga shoqëria Kontakt sh.p.k., po përgatitej nga shtetasi Xhimi Begeja. Ky i fundit, që ndërkohë pikërisht në lidhje me këtë pasuri, në muajin mars 2006 kishte arritur të merrte si me dhurim pjesë prone nga shtetaset Graciela Begeja, Vera Graboëski dhe Margaret Irëin dhe në muajin qershor 2006 kishte arritur të blinte pjesë nga prona me nr 3/138 nga shtetasit Nerime Piro, Sejdiqe Kurti, siç qartësisht pasqyrohet, përfaqësohet nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe i ka dhënë prokurë këtij të fundit.

Sipas akteve, nuk rezulton që shtetasit Xhimi Begeja, t'i jetë premtuar apo vënë në dispozicion ndonjë fond prej 3 – 5 %. E megjithatë, si edhe në vijim vërtetohet, shtetasi Xhimi Begeja është personi që realizon fizikisht, në terren, kryerjen e shumë veprimeve, duke u paraqitur kështu si person që me vullnetin e tij është përdorur nga shtetasi Jamarbër Malltezi, përkundrejt palëve të treta, kundrejt përfitimeve që edhe atij i kanë ardhur nga kjo marrëdhënie.

121.2.1. Kështu, rezulton se, me formularin nr. 3/1 “Lidhja e objektit me infrastrukturën inxhinierike” kërkuesi Xhimi Begeja, ka nisur veprimet pranë disa institucioneve, dokumentuar të paktën që në dt **02.02.2007**, pranë ujësjellësit, etj. Në këtë formular pasqyrohet: Objekti: **Godinë banimi dhe shërbime 3, 4, 7, 8 e 9 kate me 1 kat parking nëntokë**. Në fund përshkruhet: **Mendimi i zyrës së Urbanistikës sipas përkatësisë: Nuk jemi të njohur me ndryshimet e destinacionit të zonës, nga zonë sportive në zonë banimi. Duhet patur parasysh që brenda territorit ka objekte të tjera private. Përgj sekt urb Nj B nr. 7 ing Mesude Feçi (mbiemri i paqartë –) dt 13.03.2007.**

Ky formular, megjithëse si kërkues është emri i shtetasit Xhimi Begeja, mban vulën e shoqërisë Kontakt sh.p.k. duke i shtuar edhe më tepër vërtetësinë faktit, se megjithëse shoqëria Kontakt sh.p.k. shfaqej në institucione, pas saj, qëndronte emri, reputacioni dhe pushteti i shtetasit Jamarbër Malltezi.

121.2.2. Me formularin e kontrollit, nga juristi *Për fazën A të ndërtimit*, për subjektin **Kontakt sh.p.k.** për objektin “*Godinë banimi dhe shërbimi*” nr. prot K-4250/L datë **26.03.2007**,

pasqyrohet dorëzimi i dokumentave si i rregullt përveç: Nr. rendor 4, studimi inxhiniero sizimik, kur objekti është mbi 8 kat, duke u bërë shënimi se mungon; nr rendor 6 që është **kontrata noteriale midis investitorit dhe subjektit ndërtues që nuk është cituar nëse ekziston**; nr rendor 9 që citon vërtetim nga tregje – taksa ku është bërë shënimi se mungon. Në përfundim është bërë shënimi se për fazën A të ndërtimit, dokumenti i parregullt.

Nga Bashkia, na është përcjellë edhe një formular tjetër i njëjtë si më sipër, me nr. prot K – 4250/L datë **26.03.2007** ku tashmë të gjithë dokumentat paraqiten të rregullt përveç nr. rendor 6, **Kontrata noteriale midis investitorit dhe subjektit ndërtues**, që nuk është pasqyruar nëse ekziston apo jo dhe në fund është bërë shënimi *Për fazën A të ndërtimit, dokument i rregullt.*

122. Me shkresën nr 6883 prot dt **13.09.2007** Drejtoria e Politikave të planifikimit urban pranë Ministrisë së Punëve Publike, i dërgon Drejtores së Institutit të studimeve dhe projekteve urbanistike, studimet e miratuara nga KRRTRSH më dt 21.11.2006 ku ndërmjet tyre shfaqet edhe ndryshimi në planin rregullues të qytetit të Tiranës në lidhje me zonimin funksional për disa zona të qytetit miratuar më vendim nr 4 datë 21.11.2006 të KRRTRSH-së.

123. Pas këtij momenti, rreth një muaj më vonë, mes familjes Begeja përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. vendoset të lidhet një **kontratë shtesë e kontratës së sipërmarrjes me nr 4938 rep nr 831 kol datë 22.05.2006**, kur ishte rënë dakord ndër të tjera për vënien në dispozicion për ndërtim të pasurisë me nr 3/139 me sipërfaqe 6345 m². Për këtë arsye, me nr 8166 rep nr 1249 kol datë **11.10.2007**, para noteres Ruko Sako, lidhet kontratë shtesë e kontratës së sipërmarrjes. Në n. 4 përcaktohet se Palët kontraktuese vendosin të bëjnë këtë shtesë në n 6 të Kontratës së Sipërmarrjes nr 4938 Rep/ 831 Kol 22.05.2006 si vijon: **Pala pronare në vend të 22% të ndërtimit do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërpërmendur të vënë në dispozicion 24 % të sipërfaqes së përgjithshme** të ndërtimit të ri për secilin komponent (parkime, dyqane, fasade) të ndarë proporcionalisht në çdo kat. **Për sa i përket kushteve të tjera të kontratës të Sipërmarrjes ato mbeten të pa ndryshuara.**

123.1. Gjithashtu, konstatohet se ndërmjet **trashëgimtarëve Begeja** dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. lidhet një **kontratë tjetër sipërmarrje duke u marrë përsipër sërish ndryshimi i destinacionit të zonës** ku ndodhen një sërë pronash. Qartësisht, shtetasi Jamarbër Malltezi, tashmë kishte treguar para trashëgimtarëve Begeja se me ndihmën e tij ishte e mundur kthimi i shpejtë i pronave, privatizimi, ndryshimi i destinacionit dhe zhvillimi i ndërtimeve. Konkretisht rezulton se me kontratën e sipërmarrjes nr. 8346 rep nr. 1265 kol datë **22.10.2007** para noteres Ruko Sako, pronarët *Haki Begeja, Bashkim Bekteshi, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Drita Begeja, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bahskim Kadiu, Elona Begeja, Xhimi Begeja të gjithë të përfaqësuar me prokurë nga Jamarbër Malltezi, Ilir Kadiu* për vehte dhe si përfaqësues me prokurë i *Vangjeli Kadiut dhe Manjola Kadiut*, i përfaqësuar me prokurën me nr 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006 nga **Jamarbër Malltezi**, si dhe shtetësja *Teuta Malka* si dhe pala sipërmarrëse shoqëria e ndërtimit *Kontakt sh.p.k.* e përfaqësuar nga shtetasi *Fatmir Bektashi*, pasqyrohet se palët e mësipërme lidhin akt marrëveshjen si më poshtë:

...Neni 4: Ndërrimi i destinacionit të zonës ku ndodhet trualli: Pala pronare në bazë të dokumentave të ZRPP Tiranë:

-Nr. 417 datë 03.07.2007 *truall sip 47 m2, pas nr. 3/152, ZK 8220, vol 15, faqe 177; truall sip 27 m2, pas nr. 3/154, ZK 8220, vol 15, faqe 176; truall sip 19 m2, pas nr. 3/151, ZK 8220, vol 15, faqe 178; truall sip 680 m2, pas nr. 3/150, ZK 8220, vol 15, faqe 179; truall sip 685 m2,*

pas nr. 3/149, ZK 8220, vol 15, faqe 180; truall sip 380 m2, pas nr. 2/325, ZK 8220, vol 15, faqe 181; truall sip 300 m2, pas nr. 3/156, ZK 8220, vol 15, faqe 182; truall sip 9213 m2, pas nr. 3/153, ZK 8220, vol 15, faqe 184; truall sip 300 m2, pas nr. 7/257, ZK 8220, vol 15, faqe 183; truall sip 660 m2, pas nr. 3/155, ZK 8220, vol 15, faqe 185;

- a. Pala pronare është në dijeni të faktit se prona është e njohur dhe e kthyer por me destinacion për ambiente sportive, prandaj ajo dëshiron që në bazë të legjislacionit "Për Urbanistikën" të ndërtojë banesa mbi tokën truall pronë e saj.
- b. Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të ndërrimit të destinacionit të zonës, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse truallin objekt i kësaj kontrate.
- c. Pala sipërmarrëse pranon të marrë truallin të vënë në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë të gjitha shpenzimet e nevojshme për procesin e kthimit të destinacionit të zonës mbi të cilin ndodhet trualli dhe e përfundon këtë proces në një afat kohor jo më shumë se 18 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje.

Sipas n 5 gërma "c" leja e ndërtimit do të merret 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje.

Sipas n 6, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërpërmendur të vënë në dispozicion 25% të sip së përgjithshme të ndërtimit të ri për secilin komponent (parkime, dyqane, apartamente, fasadë) të ndara proporcionalisht për çdo kat. Pjesa takuese e palës pronare me sip përkatëse sipas kateve do të përcaktohet me një kontratë shtojcë të kësaj kontrate sipërmarrje, pas përfundimit të projektit të arkitekturës dhe para fillimit të punimeve. Sipërmarrësi nuk do të fillojë punimet për ndërtimin e objektit pa u përfunduar kontrata shtojcë e kësaj kontrate sipërmarrje.

Sipas gërmës "d" të n 6 në rast se secili nga pronarët do të dëshirojë për pjesën që i takon, të investojë në ndërtim, e ka këtë të drejtë duke u bërë bashkëinvestitor me sipërmarrësin deri në 25% të vlerës së investimit në pjesën e tokës që i takon.

Sipas n 7 pala sipërmarrëse plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të kryer veprimet administrative dhe për të realizuar: Kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilën ndodhet trualli nga zonë sportive në zonë banimi; Marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit dhe Lejen e ndërtimit, Privatizimin e objekteve që ndodhen mbi këtë truall do ta bëjë...

Në nenin 15 janë përcaktuar afatet: Pala sipërmarrëse dhe pala pronare marrin përsipër që të realizojë detyrimet sipas afateve të mëposhtme:

- a) Ndërrimin e destinacionit të zonë sportive në zonë banimi 24 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje
- b) Studimin urbanistik dhe volumetrik, nxjerrjen e lejes së sheshit të ndërtimit, përfundimin e projektit të ndërtimit dhe nxjerrjen e lejes së ndërtimit për 30 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje
- c) Të përfundojë kontratë sipërmarrje shtojcë për përcaktimin e pjesës takuese të palës pronare, zbardhjen e lejes së ndërtimit dhe fillimin e punimeve për 3 muaj
- d) Të përfundojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektin për 24 muaj nga data e zbardhjes së lejes së ndërtimit

Kjo kontratë është nënshkruar nga shtetasi Jamarbër Malltezi, Fatmir Bektashi dhe për shtetasen Teuta Malka nga Artan Malka.

124. Konstatohet se rreth një muaj pas marrjes së vendimit nr. 9 dt 26.03.2007 nga ZRKKP, por pa marrë ende formë të prerë ky vendim, shtetasit Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari, Kumrije Arapi, Milva Arapi, Liliana Shanto (Arapi), Luan Arapi, Arben Arapi, Fiqirete Vaqari, Eva

Vaqari, Igli Vaqari, në cilësinë e palës pronare, lidhin para noteres Gentiana Shkodra, kontratën e porosisë dhe sipërmarrjes me nr 574 rep nr 177 kol datë **16.04.2007**, me shoqërinë e ndërtimit Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës investitore. Në këtë kontratë parashtrohet prona e kthyer me vendimin nr 681 datë 27.08.1996 prej 3050 m², duke u pasqyruar se, pjesa e ngelur prej 11 070 m² vazhdon të rezultojë e pakthyer.

Tagrat e Porosisë: *Të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme ligjore për kthimin e titullit të pronësisë në favor të Pronarëve të Truallit, të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme ligjore për privatizimin e objekteve ekzistuese në respektim të të drejtës së parablerjes mbi truallin objekt kthimi, të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për ndryshimin e destinacionit të truallit objekt porosisë, dhe*

Tagrat e Investimit: *Të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme ligjore për realizimin e një bashkëpunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumë funksional që do të mbajë emri "VAQARI".*

Gjithashtu në një dispozitë të veçantë parashikohet "**3.Kthimi i Truallit dhe Privatizimi i Objekteve mbi Truall, Ndryshimi i Destinacionit të Truallit.**" a. *Pala Pronare*, në bazë të dokumenteve të ZRPP dhe KKKPP bashkëngjitur dhe pjesë të kësaj Kontrate, garanton Palën Investitore për titullin e plotë apo potencial të pronësisë mbi truallin me sipërfaqe të përgjithshme 14 120 m², mbi të cilin ngrihet klubi I futbollit Partizani. Trualli kufizohet si më poshtë : nga Lindja me tokën e Rexhep Alimehmetit, nga Veriu me rrugën e kroit të Shengjinës, nga Jugu me tokën e vëllezërve Begeja dhe nga Perëndimi me tokën që ka marrë për pjesë Sabrije Llagami..

b. *Pala Pronare e informon Palën Investitore se prona është e njohur për 14 120 m², por e kthyer vetëm në masën prej 3050 m² (mbi këtë sipërfaqe ka ndërtime pa leje, mbivendosje prone si dhe një rrugë publike të asfaltuar), si edhe që Pala pronare dëshiron që në bazë të legjislacionit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve" të ushtrojë të drejtën e parablerjes në momentin e privatizimit të klubit të futbollit Partizani, i cili ndodhet mbi tokën truall pronë të saj.*

c. *Pala Pronare është në dijeni të faktit se trualli i kthyer dhe ai i njohur ndodhet në një territor që nga legjislacioni në fuqi ka destinacionin zonë sportive, prandaj ajo dëshiron që në bazë të legjislacionit "Për ndërrimin e destinacionit" të ndryshojë destinacionin nga zonë sportive në zonë banimi.*

d. *Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të privatizimit Pala Pronare vë në dispozicion të Palës Investitore të gjithë dokumentacionin që ajo zotëron për t'u përdorur nga Pala Investitore dhe nuk mban përgjegjësi për atë çfarë është jashtë dokumenteve zyrtare të pasurisë dhe nuk mban përgjegjësi për pretendime nga të tretë.*

e. *Pala Investitore pranon të marrë në dorëzim dokumentacionin e vënë në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë, me shpenzimet dhe mjetet e veta, të gjitha procedurat e nevojshme për procesin e kthimit dhe të privatizimit të tokës dhe ndërrimin e destinacionit të saj nga zonë sportive në zonë banimi në favor të palës pronare.*

f. *Investitori merr përsipër ta pastrojë truallin nga ndërtimet pa leje, nga mbivendosjet si dhe nga linjat e infrastrukturës dhe spostimin e tyre, si dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet që mund të lindin me persona të tretë. Investitori merr përsipër shpenzimet për kryerjen e këtyre veprimeve.*

Në pikën 4 parashikohet "**Ndërtimi i objektit shumëfunksional**".

a. *Pala pronare shpreh miratimin e saj për bashkëpunim duke vënë në dispozicion të Palës Investitore truallin e kthyer dhe me destinacion të ndryshuar sipas përshkrimit në nenin 3 të kësaj Kontrate dhe të korigjuar pas regjistrimit të tij në ZRPP me qëllim që pala investitore, me shpenzimet e veta, të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme ligjore për studimin urbanistik të zonës, marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit, dhe marrjen e lejes të ndërtimit*

sipas specifikimeve; Pronar trualli- familja Vaqari, Sipërmarrës Investitor – Shoqëria KONTAKT Shpk.

b. Gjithashtu, pala investitore do të ndërtojë në truallin e vënë në dispozicion kompleksin shumë funksional në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës.

Në pikën 5 parashikohet: *“Pjesa takuese e sipërfaqes ndërtimore për pronarin e truallit”.*

a. Pala pronare do të kompensohet në masën 24% të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit. Pjesa takuese do të përcaktohet në një Aneksi të kësaj Kontrate. Pala Investitore nuk do të fillojë punimet pa u përfunduar Aneksi i kësaj Kontrate.

b. Pas marrjes së Lejes së Ndërtimit pala Pronare ka të drejtë të caktojë një ekspert i cili së bashku me palën investitore do të përcaktojë sipërfaqet përkatëse.

c. Pas përfundimit të punimeve nga Investitori palët bashkërisht hartojnë kontratën e shkëmbimit. Shpenzimet për kryerjen e këtyre përballohen nga investitori.

Bashkëngjitur Aktit gjenden: Vendim nr 681 datë 27.08.1996 i KKKP; Vërtetim nga Dokumenti hipotekor n. 6294 datë 04.09.1996; Vendimi nr. 21456 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; Licencë nr. 3224/1 nga MPPTT; Certifikatë regjistrimi në organin tatimor me kod fiskal Nr. 3708169

Madje pala investitore merr përsipër që kthimi i pronës deri në nxjerrjen e lejes së ndërtimit do të jetë deri në 24 muaj nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

124.1. Mund të shihet qartësisht, se tagret që i janë dhënë palës investitore, të cilat ajo i ka marrë përsipër për t'i përmbushur, përveçse nuk mund të varen plotësisht prej saj siç është ndryshimi i destinacionit të zonës, privatizimi apo kthimi i pronës, parashikohen edhe me afate të qarta brenda të cilave do të përmbushen. Këto parashikime kontraktore, tregojnë qartësisht ekzistencën e një besimi të plotë se strukturat e shtetit, do të jenë në plotësim të këtyre kërkesave të pronarëve.

Gjithashtu, konstatohet se megjithëse ishte marrë vendimi nga Zyra Rajonale e AKKP-së për kthimin e pronës, familjarët Vaqari, nuk kanë qenë në dijeni, përsa kohë pala sipërmarrëse u premtonte se me shpenzimet e veta do të arrijë të kryejë edhe kthimin e pronës.

Për më tepër, megjithëse familja Vaqari e ka shprehur vullnetin e saj që për truallin prej 3050 m² ta verë në dispozicion të shoqërisë Kontakt sh.p.k. që në vitin 2002 (shih prokurën me nr 524 rep nr 102 kol datë 25.04.2002), duket se ka hasur pengesa, pikërisht mesa duket për shkak të destinacionit sportiv të zonës që ta zhvillojë atë.

125. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 8668 rep nr. 1309 kol datë 02.11.2007 të lidhur para noteres Ruko Sako, rezulton se pronarët Saliaga (Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Tire Deda, Fatmir Luzi, Shpetim Luzi (perfaqesuar nga Mustafa Luzi), kanë lidhur me palën sipërmarrëse shoqëria Kontakt sh.p.k. kontratë me objekt: Pala pronare vë në dispozicion të sipërmarrësit truallin me sip (1 = 551 m² dhe S2=3240 m² bashkarisht me sip totale 3791 m², pasuria me nr. 3/160 dhe 3/161 të ndodhur në ZK 8220 rruga Frosina Plaku, e regj në regj hipotekor nr. 491 datë 24.07.2007 me qëllim ndërtimin e objekteve polifunktionale.

Në n 2.2 është përcaktuar se sipërmarrësi merr përsipër ndryshimin e destinacionit të zonës ku ndodhet trualli duke kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme për procesin e ndërtimit të destinacionit të zonës së truallit.

Sipas n 3, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse në shkëmbim të truallit 25 % të sip së përgjithshme të ndërtimit të ri, për secilin komponent (parkime, dyqane, apartamente,

fasadë) të ndara proporcionalisht për çdo kat...

Sipas n 4, pala sipërmarrëse në bazë të kontratës së sipërmarrjes plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të kryer verimet administrative dhe për të realizuar: **Kthimin e destinacionit të zonës ku ndodhet trualli nga zonë sportive në zonë banimi; Marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit; Marrjen e lejes së ndërtimit; Të gjitha detyrimet ndaj të tretëve do të përballohen nga sipërmarrësi; Ndërrimi i destinacionit që do të kryhet nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij; Pala sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje.**

Lënia jashtë Planit të Përhapjes së Klubit të Futbollit Partizani dhe situata e dy klubeve sportive

126. Përgjatë këtij hetimi, ka rezultuar se Klubi i Futbollit Partizani, ka qenë objekt diskutimesh në lidhje me përfshirjen e tij në planin e përhapjes. Kështu, me shkresën nr. 2585/1 prot datë 24.03.2006, Drejtorja e Logjistikës, pranë Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, shkresë e nënshkruar nga drejtori i drejtorisë Logjistike pranë SHP të FA-së, kolonel Bardhyl Hoxha, i është adresuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Pëllumb Qazimi duke e bërë me dije se: **“Në zbatim të detyrës së vënë nga ana juaj me fonogramin nr. 28 dt 27.02.2006, lidhur me identifikimin e pronave ushtarake si dhe përgatitjen e listave të pronave që përfshihen në planin e përhapjes dhe atyre jashtë planit të përhapjes ju informojmë si më poshtë: Ekipi i inspektimit ka marrë kontakt me komandantët respektiv të forcave dhe të njëjstëve të reparteve të vartësisë së drejtëdrejtë të SHPFA si dhe me specialistët përkatës të ngarkuar për pronat, të cilëve u janë dhënë udhëzime përkatëse e formularë me të dhënat e kërkuara për plotësimin e tyre. Për pasqyrimin dhe evidentimin sa më të plotë të gjendjes së pronave dhe trajtimin e mëtejshëm të tyre, nga komandat përkatëse kemi marrë evidencat e pronave ushtarake dhe mendimet e tyre konkrete. Mbi këtë bazë janë përgatitur listat përmbledhëse të pronave ushtarake në përdorim sipas planit të përhapjes, listat e pronave që propozohen për strehim dhe listat e proave të lira që nuk paraqesin interes për FA. Në plotësimin e listës së parë të pronave në përdorim, sipas planit të përhapjes kemi mbajtur parasysh planin aktual të përhapjes si dhe ndryshimet në planin e ri të propozuar për miratim.**

Emërtimi i pronave është bërë duke patur parasysh kohën kur ka filluar inventarizimi dhe regjistrimi i tyre ndërsa më poshtë kemi vendosur strukturën aktuale të dislokuar...”. Bashkalidhur është **lista e pronave në përdorim sipas planit të përhapjes së FA-së**, ku nuk evidentohet Klubi i Futbollit Partizani. Në këtë listë, në faqen 16, evidentohet me nr rendor 248 Orkestra frymore e FA, e identifikuar si prona me nr 7, rruga Frosina Plaku, me sip 1489 m2, e regj.

Me shkresën nr. 2585 prot dt 24.03.2006, Shefi i SHP të FA Pëllumb Qazimi, i është adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të MM, duke i parashtruar se, në përgjigje të kërkesës së bërë nga Drejtorja e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, me shkresën nr. 500 datë 20.02.2006 **“Mbi caktimin e pronave të paluajtshme që përfshihen në planin e përhapjes së FA”** bashkalidhur dërgojnë: 1) listën e pronave ushtarake në përdorim sipas planit të përhapjes, 2) listën e pronave që propozohen për strehim të FA; 3) Listën e pronave të lira që nuk paraqesin interes për FA dhe 4) Listën e pronave të lira që ruhen me roje. Bashkalidhur, gjendet lista me emërtimin **“1. Lista e pronave në përdorim, sipas planit të përhapjes së FA”** ku me nr. 248 identifikohet Orkestra Frymore e FA me nr pasurie 7, rruga Frosina Plaku Tiranë, me sip 1489 m2, e regjistruar. Kjo listë është nënshkruar nga Drejtorët e Drejtorive në SHPFA e konkretisht J- 1 Dori Spirollari, J-2 Beg Ajazi; J- 3 Viktor Berdaj, J-4 Bardhyl Hoxha, J-5 Flamur Skraparlliu; J-6 Baki Bala dhe J-8 Luan Nikollari.

126.1. Megjithatë, nga aktet rezulton se, me shkresën nr. 1026 prot dt 05.04.2006, drejtori Maliq Xhebra, i Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, i drejtohet drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, kolonelit Xhevdet Zenelit dhe për dijeni Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Pëllumb Qazimit dhe Sekretarit të Përgjithshëm Ardian Mullahi, duke e bërë me dije se në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 27 datë 13.02.2006 dhe detyrave të vendosura nga Ministri i Mbrojtjes me shkresat nr. 500 datë 20.02.2006 dhe nr. 769 datë 16.0.2006 nga SHPFA është kërkuar të dërgohej lista përfundimtare e pronave të paluajtshme të cilat përfshihen dhe janë në funksion të planit të përhapjes së forcave të armatosura si dhe mendimin për destinacionin e pronave, të cilat nuk përfshihen në këtë plan përhapje. Me shkresën nr. 2585 datë 24.03.2006 është dërguar lista e pronave e ndarë sipas destinacionit e pashoqëruar me relacion sqarues. Në renditjen e pronave dhe të dhënave të tyre ka pasaktësi, mbasi nuk janë mbajtur në konsideratë të dhënat e listës së pronave dhe të çdo prone, bashkëlidhur VKM nr. 515 datë 18.07.2003 dhe listave të pronave bashkëlidhur shkresave të SHPFA nr 10467 datë 11.11.2003 dhe nr 3984 datë 27.04.2005. Përsa më lart kërkon ripunimin e listës së pronave sipas destinacionit, studimi dhe përfshirjen e pronave të papërfshira në këtë listë. Tek lista bashkalidhur me emërtimin "Lista e pronave që nuk janë në listën e dërguar nga SHPFA me shkresën nr. 2585 datë 24.03.2006 dhe që nuk u është përcaktuar destinacioni i tyre", e treta në rradhë, është evidentuar prona me nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani. Gjithashtu bashkalidhur gjendet edhe një listë tjetër me emërtimin "Lista e pronave me diferenca nga përmasat që përmban VKM nr. 515 datë 18.07.2003" ku evidentohet me nr rendor 7 Orkestra Frymore e Ushtisë me përmasa sipas VKM 1230 m2 dhe sipas shkresës 1489 m2, ndodhur në rruga Frosina Plaku.

126.2. Me shkresën nr. 6932 prot dt 09.08.2006 zv. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral major Luan Hoxha, i adresohet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, ku pasqyron se janë bërë plotësimet e nevojshme, në përgjigje të shkresës nr 1026 dt 05.04.2006 "Për saktësimin dhe rishikimin e pronave dhe të dhënave të listave të dërguara me shkresën nr 2585 datë 24.03.2006" në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Instalimit e Burimeve të Mbrojtjes dhe bazuar në gjendjen aktuale të pronave. Pasqyrohet se Lista e pronave sipas Planit të Përhapjes së FA është hartuar duke mbajtur parasysh Planin e Përhapjes së FA miratuar nga Presidenti i Republikës me shkresën nr. 231/3 datë 29.03.2006 si dhe nevojat e FA-së. ...Lista e pronave për strehim është përgatitur mbi bazën e përcaktimeve të bëra nga Komandat e Forcave si dhe nga nevojat aktuale e të perspektivës për strehim të FA-së...Në listën e pronave të lira për transferim, përfshihen pronat që nuk paraqesin interes për FA dhe si të tilla lihen të lira për të kaluar në fondin për kompensim në zbatim të urdhërit të kryeministrit nr 27 datë 13.02.2006...Pronat e ish ndërmarrjeve ushtarake dhe ato ekzistuese, shtëpitë e pushimit të ushtarakëve si dhe disa degë të mobilizimit, nuk janë përfshirë në listat përkatëse, sepse nuk janë në planin e përhapjes së FA-së dhe se administrimi e trajtimi i tyre bëhet nga drejtoria e menaxhimit të instalimeve e burimeve të mbrojtjes. Bashkalidhur është **Lista e Pronave sipas Planit të Përhapjes dhe në Përdorim të FA-së** me nr. 6932/3 prot datë 09.08.2006 të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, e miratuar nga zv. shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral Major Luan Hoxha, ku e fundit në rradhë është specifikuar **Klubi i Futbollit Partizani**, prona me nr. 11, me ent me përgjegjësi administrative KML, me status në përdorim. Kjo listë është nënshkruar nga Drejtori i SHPFA Xhevdet Zeneli, Drejtori i J-4 Bardhyl Hoxha, Drejtori i J-3 Viktor Berdaj, zv. Drejtori i J-6 Ulsi Meta, zv. Drejtori i J-1 Alfred Disha, Drejtori i J-7 Perikli Koliqi, Komandanti i FA Shpëtim Spahiu, Komandanti i Forcave Detare Kristaq Gerveni, Komandanti i Forcave Ajrore Astrit Jaupi, Komandanti i KDS Sandër Lleshi dhe Komandanti i KML Elez

I pyetur më datë 02.11.2023 shtetasi **Roland Llazari**, ka deklaruar se, *pronat që janë në listë ku është i listuar Klubi i Futbollit Partizani, nuk mund të tjetërsoheshin ose dilnin për privatizim. Vetëm pronat që ishin jashtë planit të përhapjes mund të tjetërsoheshin, por edhe pse nuk ishin në plan përhapje, gjithmonë kërkohej mendimi i Shtabit të Përgjithshëm për t'u privatizuar, transferuar apo tjetërsuar këto prona. Lista e mësipërme, përsëri mund të ndryshohej nga Shtabi i Përgjithshëm, vetëm shtabi kishte kompetencë dhe autoritet për dhënin e mendimit për ndryshimin e gjendjes së pronave që gjendeshin në këto lista, siç është edhe lista në fjalë.*

127. Pra nga sa më sipër rezulton, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, përfundimisht ka vlerësuar që Klubi i Futbollit Partizani, duhet të ishte pjesë e Planit të Përhapjes, por sjellim në vëmendje se tashmë Ministria e Mbrojtjes, kishte vendosur që të procedohej me privatizimin në lidhje me këtë pronë, pa marrë parasysh më parë, mendimin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

128. Ndërkohë që zhvillohen këto ngjarje, një javë pas miratimit të ndryshimeve të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës (*ndryshime ndodhur më dt 17.07.2006*), me shkresën nr. 5743 prot dt **24.07.2006** të sekretarit të përgjithshëm të Drejtorisë së Privatizimit pranë METE shtetasit Durim Kraja, i është kërkuar informacion Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Turizmit, si vijon: *"Në zbatim të VKM nr. 500 datë 14.08.2000 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë vendore" kërkojmë të na informoni në lidhje me statusin aktual (administrimin, regjistrimin, përdorimin, konflikte pronësie nëse ka etj) përkthësisht të objekteve Klubi i Futbollit Partizani dhe Klubi Shumësportesh Tiranë."*

128.1. Me shkresën nr. 6714/1 prot dt **03.08.2006**, zëvendës ministri Neritan Alibali pranë Ministrisë së Turizmit, i parashtron Sekretarit të Përgjithshëm Durim Kraja, pranë Ministrisë së Ekonomisë, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, se do të gjejnë në tabelë të dhënat përkatëse që kanë të bëjnë me *regjistrimin, përdorimin dhe konfliktet e pronësisë*. Sqarojnë se në respektim të VKM nr. 312 dt 15.05.2003 deri më sot, marrja në dorëzim e këtyre pronave nuk është bërë e mundur, pasi pjesa më e madhe e pronave të klubit kanë qenë dhe janë edhe sot të zëna forcërisht nga familjare. Për këtë arsye, pronat e këtij klubi nuk janë pasqyruar në inventarin e pronave të Ministrisë së Turizmit, pasi nuk janë marrë asnjëherë në dorëzim. Referuar listës bashkalidhur të nënshkruar nga k/degës së Financës dhe drejtori ekzekutiv Afrim Tola janë pasqyruar objekte të zëna forcërisht nga familjarë, në përdorim të KS Partizani dhe ato që janë zënë forcërisht nga FK Partizani.

128.2. Kurse situata në Ministrinë e Mbrojtjes përfshin një marrëdhënie mes Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Megjithëse ndërkohë Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ishte shprehur me shkresën nr. 6932 prot dt **09.08.2006**, që **Prona e identifikuar si prona me nr 11 duhet të përfshihej në Planin e Përhapjes**, duke e renditur pikërisht në këtë listë, Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 5543/1 prot dt **22.08.2006** të drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes **Maliq Xhebra**, i ka kërkuar informacion Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke i bërë me dije se *METE ... kërkon informacion në lidhje me statusin aktual ... të objekteve Klubi i Futbollit Partizani dhe Klubi Shumësportesh Partizani. Klubi Shumësportesh Partizani, me vendim të KM është transferuar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve por nuk është dorëzuar me proces verbal, kurse Klubi i Futbollit*

Partizani nuk është përfshirë në strukturën e re të FA-së dhe bën pjesë në pronat e lira, të inventarit të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të Mbrojtjes. Në këtë kuadër kërkojmë një informacion të hollësishëm, ku t'i jepet përgjigje kërkesës që ka të bëjë me statusin aktual (administrimin, regjistrimin, përdorimin, konfliktet e pronësisë nëse ka etj) për Klubin e Futbollit Partizani.

128.2.1. Në vijim Ministria e Mbrojtjes, reagon, për të plotësuar dokumentacionin në lidhje me Klubin e Futbollit Partizani, me qëllim marrjen në administrim të këtij të fundit nga Komanda Mbështetëse Logjistike dhe për regjistrimin e kësaj prone. Ky qëndrim i Ministrisë së Mbrojtjes, për regjistrimin e pronës, shfaqet kontradiktor, pasi më përpara, në kthimin e përgjigjes më datë 16.01.2006, që i është bërë bashkësisë Kroi i Shëngjinit, kjo ministri është shprehur se *Ministria e Mbrojtjes është organi që administron pronën e Klubit Sportiv Partizani, prandaj si administrator nuk lidhet me pronësinë.*

Një muaj para se të paraqitej kërkesa për kthim prone nga ana e familjes Begeja (siç edhe më lart u theksua kërkesa e shtetasit Bashkim Bekteshi mban datën 15.10.2006), me memon datë 14.09.2006 të hartuesit Drejtori i Drejtorisë së Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes Maliq Xhebra, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm **Ardian Mullahi**, drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Pëllumb Qazimi, me subjekt *“Për marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani”* është pasqyruar se: *“Në zbatim të listës së inventarit të pronave të paluajtshme ndarë sipas destinacionit të pronave, dërguar nga SHPFA me nr. 6392 datë 09.08.2006 dhe të hartuar në mbështetje të planit të përhapjes së FA, miratuar nga Presidenti i Republikës me nr. 231/3 datë 29.03.2006 Komanda e Mbështetjes Logjistike është caktuar të marrë në përgjegjësi administrimi dhe të regjistrojë pronën me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani. Kjo pronë në listën e inventarit të pronave të MM, miratuar me VKM nr. 515 datë 18.07.2003 ka nr.11, me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani në adresën Rruga Frosina Plaku Tiranë. Për këtë kemi përgatitur shkresën bashkalidhur, së bashku me formularin standart të inventarizimit të kësaj prone...”*

Me shkresën nr. 7883 datë 15.09.2006 *“Për marrjen në administrim dhe regjistrimin e KF Partizani”*, Shabi i Përgjithshëm i FA, shefi i shtabit, Gjeneral Lejtnant Pëllumb Qazimi, i është drejtuar Komandës Mbështetëse Logjistike, duke i parashtruar në zbatim të VKM nr. 515 dt 18.07.2003 dhe listës së inventarit të pronave të paluajtshme, ndarë sipas destinacionit, të hartuar sipas Planit të Përhapjes së FA, miratuar nga Presidenti i Republikës me nr. 231/3 dt 29.03.2006, **Komanda e Mbështetjes Logjistike, të marrë në përgjegjësi administrimi dhe të regjistrojë pronën** me emërtimin Klubi i futbollit Partizani, Tiranë. Bashkalidhur është edhe formulari standart i inventarizimit të pronës, e cila në listen e inventarit të miratuar me VKM nr. 515 datë 18.07.2003 ka nr rendor 11, emërtimi klubi i futbollit Partizani, në adresën rruga Frosina Plaku, Tiranë. **Të merren masa për plotësimin e dokumentacionit, kryerjen e aplikimit dhe regjistrimin e pronës pranë ZVRPP Tiranë.**

I pyetur më dt 21.09.2022, shtetasi **Fatmir Mediu** deklaroi se, nga viti 2003 e në vijim, ky objekt (Klubi i Futbollit Partizani) duhet të jetë administruar nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje të detyrimeve të VKM së vitit 2003. Komanda Mbështetëse është varësi e Shtabit të Përgjithshëm dhe pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes.

128.2.1.1. Me shkresën nr. 3425/1 regj dt 28.09.2006, Komanda e Mbështetjes Logjistike, nënshkruar nga Komandant Elez Sakti, i drejtohet Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, dhe për dijeni Drejtorisë së Menxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, ku i bën me dije se, në zbatim të shkresës nr. 7883 dt 15.09.2006 të SHSHP të FA-së, kjo pronë nga ana e

Komandës së Mbështetjes Logjistike, nuk mund të merret në përgjegjësi administrimi, për arsye se:

- 1. Prona me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani, nuk është në planin e përhapjes të Komandës së Mbështetjes Logjistike, miratuar sipas urdhërit nr. 43 datë 28.04.2006 të SHSHP të FA*
- 2. Nga ana juaj nuk përcaktohet administratori i kësaj prone si dhe pika e kontaktit me të*
- 3. Mbështetur në VKM nr. 153 datë 03.04.1993 "Për kalim kapital të objekteve e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore" si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, për marrjen në administrim të kësaj prone, duhet detyrimisht të jenë prezent me komision, të dy palët dorëzuese dhe marrëse*

Theksojmë se nga ana e KML, me ekip specialistësh, u shkua në objekt dhe nuk u mor kontakt me asnjë person dhe as nuk u lejuam të futeshim në objekt.

Në këto kushte, marrja në përgjegjësi administrimi nga ana e KML, e pronës Klubi i Futbollit Partizani është e pamundur.

Sa më sipër i është pasqyruar edhe në shkresën me nr 1487/1 regj dt 19.03.2009 të Komandës Mbështetëse, ku kjo e fundit pasqyron se u organizua puna, duke ngritur grupin e punës dhe duke vajtur në vend për marrjen në administrim të kësaj prone, por **pala dorëzuese nuk është paraqitur në asnjë rast për dorëzimin e kësaj pasurie.** Për më tepër, **grupi i punës, asnjëherë nuk është lejuar të futej në objekt.** Paraqitja e dy palëve (marrës – dorëzues) është detyrim i përcaktuar në VKM nr. 153 dt 03.04.1993 "Për kalimin kapital të objekteve e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore".

Në fakt VKM nr. 153 dt 03.04.1993 "Për kalimin kapital të objekteve e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore" kishte sanksionuar se:

1. Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe këshillat e rretheve, bashkive e komunave, në raste të veçanta dhe pasi të kenë marrë pëlqimin e këshillave drejtues të ndërmarrjeve e institucioneve, bëjnë kalimin kapital (pa pagesë) të objekteve e të mjeteve kryesore, me përjashtim të objekteve e të mjeteve kryesore të institucioneve kulturore.

2. Ky kalim bëhet:

a) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror për ndërmarrjet e institucionet e varësisë.

b) Me urdhër të përbashkët të titullarëve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë.

c) Me urdhër të titullarit të ministrisë e institucionit tjetër qendror nga ndërmarrjet e institucionet e vartësisë, në ndërmarrjet e institucionet e tjera, brenda dhe jashtë sistemit, që janë në vartësi të organeve të pushtetit lokal.

...dh) Me vendim të këshillit të rrethit, të bashkisë e të komunës, nga ndërmarrjet e institucionet që kanë në vartësi, në ndërmarrjet e institucionet e tjera, brenda dhe jashtë sistemit, që janë në vartësi të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore. ...

Gjithashtu, mbështetur edhe në n 38 të rregullores së MM, Drejtoria e Ekonomisë dhe Privatizimit është drejtori në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm. Ajo ka në përbërje të saj, sektorin e privatizimit, të strehimit dhe sektorin e ndërmarjeve. Drejtoria e Ekonomisë e Privatizimit ka përgjegjësi kryesore pasqyrimin dhe dokumentimin e të gjithë pronave në FA duke përcaktuar në përputhje me perspektivën e zhvillimit e të modernizimit të FA, objektet dhe pronat që do të shërbejnë për jetese e stërvitje FA. Drejtoria e Ekonomisë e Privatizimit ka për detyrë:

- Të ndikojë në krijimin e të ardhurave dytësore financiare, nëpërmjet klasifikimit të objekteve të FA, si fond strehimi, fond të ardhurash (qera), fond shitje apo fond privatizimi;
- Të drejtojë dhe ndjekë në vijimësi procesin e transformimit të ndërmarrjeve ushtarake në shoqëri tregtare
- Përgatit praktikat për privatizim objektesh sipas procedurave ligjore dhe kërkesën e Ministrisë të Mbrojtjes për Ministrinë e Ekonomisë
- Ndjek procedurat e dhënies me qera të objekteve që propozohen nga njësitë, repartet, ndërmarrjet dhe institucionet dhe përgatit praktikat për miratim për objekte në kompetencë të dikasterit dhe Ministrisë së Ekonomisë
- Shqyrton propozimet për kalimet kapitale të objekteve nga SHP, komandat, institucionet shtetërore për objektet dhe truallin funksional rreth tyre, që kërkohet të bëhen kalim kapital ose të jepen me huapërdorje (pa pagesë).

128.2.2. Gjendur përpara qëndrimin të Komandës Mbështetëse për mosmarrjen në dorëzim të pronës Klubi i Futbollit Partizani, duket se Ministria e Mbrojtjes, kujtohet për shkresën nr. 6932 prot dt **09.08.2006**, të Shtabit të Përgjithshëm, që Prona e identifikuar e mësipërme duhet të përfshihej në Planin e Përhapjes. Me shkresën nr. 8138/1 prot dt **05.10.2006** të Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, **drejtori Maliq Xhebra**, me lëndë "Për regjistrimin e pronës nr. 11 me emërtim Klubi i Futbollit Partizani" Tiranë, i drejtohet Komandës Mbështetëse Logjistike, duke bërë me dije se, me shkresën nr. 6932 dt **09.08.2006** SHPPFA ka dërguar të miratuara listat e pronave sipas destinacionit, ku në listën e pronave që përfshihen në planin e përhapjes është edhe pronat me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani, në përgjegjësi administrimi të KML-së. Sipas shkresës SHPPFA, lista është hartuar duke mbajtur parasysh Planin e Përhapjes së miratuar me shkresën nr. 231/3 datë 29.03.2006 si dhe nevojat e FA. Para miratimit të listave nga SHPPFA, lista e pronave të KML, është miratuar paraprakisht edhe nga ana e Komandës Mbështetëse. Në informacionet dhe pasqyrat e dërguara nga IGJFA dhe KML që në vitin 2004 e në vazhdim, është raportuar se, është hartuar dokumentacioni teknik i pronës KF Partizani dhe meqënëse nga SHPPFA është përcaktuar KML si strukturë përgjegjëse, nga kjo e fundit duhet të ndiqen dhe të kryhen të gjitha veprimet për kryerjen e aplikimit dhe regjistrimin e pronës pranë ZVRPP Tiranë. Përfshirja ose jo e pronës KF Partizani në listën e pronave të planit të përhapjes nuk sjell pasoja për aplikimin dhe regjistrimin e pronës nga KML. Regjistrimi i pronës do të kryhet nga KML pavarësisht se në cilat lista është e përfshirë pronat. Bashkalidhur dërgon edhe kopje të shkresës së SHPPFA nr. 6932 datë 09.08.2006 dhe të listës, ku është renditur pronat e KF Partizani me entin me përgjegjësi administrativ të miratuar paraprakisht nga KML dhe më pas nga SHPPFA.

128.2.3. Në vijim të procedurave, Komanda e Mbështetjes, ka përgatitur dokumentacionin përkatës dhe me shkresën nr. 4285 dt **13.11.2006** "Kërkesë për regjistrim pasurie të paluajtshme" drejtuar ZVRPP Tiranë, ka aplikuar për regjistrimin e kësaj prone. Kjo shkresë, e nënshkruar nga Kolonel Elez Sakti, komandant, i është paraqitur ZVRPP Tiranë duke u kërkuar të regjistrohet pronat e cila në listën e inventarit ka nr rendor 11. Për regjistrim dorëzojnë VKM nr. 515 datë 18.07.2003, kopje e formularit standart të inventarizimit të pronës, plan vendosje dhe planimetritë. Për regjistrimin e kësaj prone autorizohet zoti Sutki Fana. Po ky shtetas rezulton edhe të ketë përpiluar këtë shkresë. Është bërë likujdimi i tarifës shtetërore me mandat arkëtimin nr. 18804 datë 20.11.2006.

I pyetur më datë 05.06.2023 shtetasi **Elez Sakti**, deklaroi se Komanda Mbështetëse Logjistike ka patur si mision administrimin e pronave të forcave të armatosura. Pronat konkrete Klubi i

Futbollit Partizani është administruar nga Ministria e Mbrojtjes, pra nga qendra jo nga repartet. Ai deklaroi në lidhje me veprimet e kryera nga Komanda për regjistrimin e kësaj prone në ZRPP që në vitin 2006.

128.2.3.1. Është kërkuar pranë ASHK Tirana Jug, praktika e plotë e shkresës 4265 regj dt 13.11.2006 të Komandës Mbështetëse dhe nuk është gjetur asnjë dokumentacion përveç shkresës dhe shënimet që personat përgjegjës kanë lënë në këtë shkresë, konkretisht është lënë shënimi "Zona 1, Të aplikohet dhe të regjistrohet". Nga kqyrja e regjistrit të protokollit rezultoi se kjo shkresë, ka hyrë në protokoll, më datë 13.11.2006 dhe ka një shënim "Zona 1" dhe firmë dhe nuk ka asnjë kthim përgjigje për këtë praktikë ose shënim tjetër.

E pyetur më dt 20.04.2023, shtetësja **Majlinda Bozgo**, ka deklaruar se në vitin 2006 ka qënë e punësuar në pozicionin e Regjistruetit pranë ZVRPP Tiranë, ...Pasi njihet me shkresën e sipërcituar, tregon në lidhje me procedurën që ndiqej për regjistrimin e pronës..... Në atë kohë zona në fjalë nuk ka qënë e hedhur në sistem, në rast se do procedohej me regjistrimin e pasurisë në zonën respektive do regjistrohej me numër regjistri hipotekor dhe do të hapej kartela provizore e pasurisë dhe në hartën provizore do konturohej me të kuqe pasuria. **Fakti që nuk është regjistruar kjo pronë do të thotë që nuk është trajtuar. Kjo kërkesë qëndronte në sektor, në rastin konkret në sektorin e zonës 1, derisa të vinte një aplikim. ZRPP ka detyrimin që t'i kthente përgjigje, pas aplikimit nga përfaqësuesi i caktuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe ti sqaronte institucionit se çfarë veprimi duhej të bëhej në këtë rast nga Komanda Mbështetëse ose nga Ministria e Mbrojtjes. Përgjigja që do t'i kthehej kësaj praktike ishte në formën e aktit të verifikimit dhe ky akt verifikimi nuk kalonte tek regjistruetit, por mesa mban mend trajtohej nga përgjegjësi i sektorit të zonës.**

Më dt 26.04.2023, është pyetur shtetasi **Bujar Tafili**, i cili ka deklaruar se në vitin 2006 ka qënë i punësuar në pozicionin e përgjegjës të Zonës 1 pranë ZVRPP Tiranë. ... Në lidhje me shkresën e sipërcituar, deklaroi se në atë periudhë ka qënë përgjegjësi i Zonës 1,.... Tregon në lidhje me procedurën që duhet të ndiqej për regjistrim. Shkresa e mësipërme, sipas tij, është një kërkesë zyrtare që ka dërguar Ministria e Mbrojtjes ku ka akte të regjistrueshme, por nuk është aplikim. Aplikimi bëhet në sportel me fletën e aplikimit dhe duhet të kishte bashkëlidhur dhe mandatin e pagesës nga Ministria e Mbrojtjes, por mund të ketë ndodhur dhe pagesë fizike në sportel. Kishte dy raste kur nuk bëhej regjistrimi. Rasti i parë kur dosja ka ardhur në ZRPP dhe nuk është bërë aplikimi dhe pa aplikim dosja nuk përpunohej fare ose mundësia e dytë është bërë aplikimi dhe përpunuesi duhet të ketë dalë me akt verifikimi nëse konstatonte parregullsi në dosje ose dokumentacion të paplotë. Akti i verifikimit i dërgohej institucioni që kishte kërkuar regjistrimin dhe dilte nga protokollin me fraksion të shkresës hyrëse në protokoll. Nëse nuk ka fraksion nuk është dërguar përgjigje dhe akt verifikimi.

Në proces verbalin e deklarimeve dt 05.06.2023 shtetasi **Elez Sakti** pasqyron se, në periudhën qershor 2006 - janar 2007 ka qënë komandant i Komandës Mbështetëse Logjistike. Në lidhje me shkresën e mësipërme deklaroi se KML ka pasur si mision administrimin e pronave të FA. Prona konkrete është administruar nga MM pra nga qendra dhe jo nga repartet. Deklaroi se është bërë pagesa cash në shumën prej 2 400 lekësh për regjistrimin e kësaj pasurie. Personi i autorizuar për të dorëzuar dokumentacionin pranë ZRPP është Sutki Fanaj, i cili ka ndërruar jetë.

128.2.3.2. Me shkresën nr. 764 dt 25.02.2007 (28.02.2007) rezultoi se Ministria e Mbrojtjes, Komanda e Mbështetjes Ligjore, i është adresuar sërish ZRPP me aplikimin për regjistrim pasurie Klubi i Futbollit Partizani. Kjo shkresë ka hyrë në ZRPP me nr. 1472 dt 01.03.2007.

Megjithëse është caktuar të merret nga Zona 1 për zbatim, nuk rezulton të jetë ekzekutuar. ZVRPP pasi ka bërë verifikimin e dokumentacionit dhe pronës, i është drejtuar Komandës së Mbështetjes Logjistike, që të rakordojë sipërfaqen e paraqitur në plan vendosje me atë të inventarit sepse ka një diferencë më të madhe në planvendosje se inventari në sipërfaqe 1298.71 m². Komanda e Mbështetjes Logjistike, me shkresën nr. 764 dt 28.02.2007 i është drejtuar ZVRPP për regjistrimin e pronës sipas inventarit, sepse sipërfaqja sipas planvendosjes është sipas gjendjes në fakt dhe nuk mund të ndryshohet...dhe për sipërfaqen do të veprohet më vonë. ZVRPP i është kërkuar informacion për mosregjistrimin e pronës, me shkresën nr. 2121/4 prot dt 17.04.2009, nga Komanda Mbështetëse. Nga ZVRPP nuk duket se ka pasur ndonjë reagim përgjatë disa viteve, deri në momentin që është bërë i mundur regjistrimi i pronës në emër të familjeve të njohura pronare. **Vetëm në vitin 2012, pasi regjistrohet kontrata e shitjes së Klubit të Futbollit Partizani, ZRPP kthen përgjigje.** Kështu pas dërgimit të një shkrese tjetër me nr. 1842 prot dt 08.03.2012 të Brigadës Logjistike, e cila i ka kërkuar ZRPP statusin juridik të pronave të përfshira në plan vendosje duke i sjellë në vëmendje se, mbështetur në VKM nr. 515 datë 18.07.2003, Komanda e Mbështetjes Logjistike, me shkresën nr. 4265 dt 13.11.2006 ka kërkuar regjistrimin e pronës dhe me shkresën nr. 2121/4 dt 17.04.2009 ka kërkuar arsyen e mosregjistrimit, ripërsëritur me nr. 1842/1 prot datë 30.03.2012, me shkresën nr. 3449/1 prot dt 17.04.2012 ZVRPP i kthen përgjigje MM dhe për dijeni i adresohet edhe ZQRPP duke bërë me dije se, pranë ZVRPP është regjistruar kontratë shitje nr. 3553 rep nr. 661 kol datë 21.10.2009 me objekt terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit Partizani.

Ndërkohë, Komanda Mbështetëse, pretendon se me gjithë ndërhyrjet e herë pas hershme pranë ZVRPP Tiranë, nga kjo zyrë nuk është dhënë dokument pronësie me pretendimin se ka mbivendosje dhe është në proces gjyqësor. Komanda Mbështetëse parashtron se DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr. 349/2 dt 09.03.2007 "Përgjigje kërkesës për konfirmim prone" drejtuar ZRKKP Tiranë dhe për dijeni Komandës Mbështetëse, është shprehur se për t'i hapur rrugë procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe për të mos krijuar përplasje mbivendosje në pronësi kërkojnë që mbështetur në ligjin nr. 9235 datë 29.04.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" **ju tërheqim vëmendjen që të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të bëhen pas miratimit të Ministrisë.** (Shih shkresën nr. 1487/1 regj dt 19.03.2009 të Komandës Mbështetëse). Ndodhur në këto kushte Komanda Mbështetëse **ndërpreu procedurën e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 dt 20.03.2007 "Njoftim për regjistrimin e pronës nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani"** drejtuar DMIBM në MM **kërkoj që kjo pronë të hiqej nga administrimi i Komandës Mbështetëse.** Prona n. 11 deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga Komanda Mbështetëse. (Shih shkresën nr. 1487/1 regj datë 19.03.2009 të Komandës Mbështetëse).

129.3. Në muajin mars 2007 kishte përfunduar tashmë kthimi i pronave për pjesën dërrmuese të familjeve të njohura pronare dhe në muajin maj 2007 edhe për familjen e fundit. Përpjekjet e Ministrisë së Mbrojtjes, duke detyruar Komandën e Mbështetjes Logjistike për ta regjistruar këtë pronë, duken jo në konkordancë me atë çfarë kishte ndodhur, deri më tani. Prona sidoqoftë nuk mund të regjistrohej kur për të ekzistonte edhe titulli pronar për familjet e tjera. Madje si edhe më sipër relatuar, në muajin shkurt 2006 familja Begeja kishte regjistruar prona të kthyera me vendimin nr 135 të muajit janar 2006, në muajin korrik 2007 kishte regjistruar prona të kthyera me vendimin nr 6 datë 21.03.2007 e kështu me rradhë edhe për familjet e tjera.

Gjithashtu, pavarësisht se nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ishte përcjellë shkresa me nr 6932 dt 09.08.2006 bashkalidhur së cilës edhe listat e pronave sipas destinacionit, ku për Klubin e Futbollit Partizani, ishte përcaktuar që të ishte pjesë e planit të

përhaqjes, rezulton se në relacionin 205/1 prot dt **02.05.2007** të Ministrit të Mbrojtjes, Fatmir Mediu, për ndryshimin e planit të përhapjes së FA-së, (*planit të cilit i referohet është ai i miratuar nga Presidenti, me shkresën nr. 336/4 datë 10.06.2004*), duke u sjellë në vëmendje **zbatimi i dekretit nr. 5110 dt 13.11.2006** i Presidentit për miratimin e strukturës organizative të FA-së, bashkalidh Planin e Përhapjes së FA-së me nr. 205 prot datë 02.05.2007, të nënshkruar nga Ministri Fatmir Mediu dhe në vend të shefit të SHP të FA-së **Luan Hoxha**, nënshkruar nga zëvendës shefi i shtabit të përgjithshëm të FA-së **Agim Lala**. Në dokumentin **Aneksat e Planit të Përhapjes së FA-së me nr. 205/2 dt 02.05.2007** të nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu dhe kolonel Agim Lala z/shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, konstatohet se në rubrikën IV Struktura të tjera, evidentohet e vendosur Orkestra frymore në KS Partizani me të njëjtat koordinata si në vitin 2004 e cila gjendej në Klubin e Futbollit Partizani, por jo Klubi i Futbollit Partizani.

Me shkresën nr. 295/3 prot dt 14.05.2007 Sekretari i përgjithshëm i Kabinetit të Presidentit, i dërgon disa mendime në lidhje me planin e përhapjes Ministrit të Mbrojtjes Fatmir Mediu, duke i sjellë në vëmendje se, pas bërjes së korigjimeve, të nënshkruhen përveçse nga Ministri edhe nga shefi i shtabit të përgjithshëm Luan Hoxha.

Me relacionin për planin e përhapjes, nr. 171/2 prot dt **17.08.2007**, të nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, dhe L.Hoxha, i është përcjellë Presidentit të Republikës që tashmë prej korrikut 2007 ishte bërë shtetasi Bamir Topi, *ripunimi i planit të përhapjes*. Bashkalidhur gjendet shkresa nr. 171/1 prot datë 17.08.2007 e nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm me titullin "*Plani i përhapjes së FA-së 2007 – 2010*" dhe dokumenti "*Aneksat e Planit të Përhapjes, së FA-së 2007 – 2010*", me nr. 171/2 prot datë 17.08.2007, e nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu dhe Luan Hoxha. Në këtë të fundit, në rubrikën "*Batalioni i Mbështetjes SHP*" gjendet e evidentuar "*Orkestra frymore*" KS Partizani. Me shkresën nr. 638/1 prot dt **29.08.2007** të Presidentit Bamir Topi, rezulton se është miratuar plani i përhapjes së FA-së, ku sipas **Aneksit nr. 638/4 prot datë 29.08.2007** janë miratuar anekset e planit të përhapjes të FA 2007 – 2010, ku në Batalionin e Mbështetjes SHP është evidentuar Orkestra frymore KS Partizani.

Pra, megjithëse që në vitin 2006 kanë nisur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave të tjera të Forcave të Armatosura, siç është Shtabi i Përgjithshëm, diskutimet mbi pronat që duhet të ishin pjesë e Planit të Përhapjes, dhe megjithëse Shtabi i Përgjithshëm ka përcaktuar se pjesë e këtij plani përhapje duhet të ishte Klubi i Futbollit Partizani, pasi plani i propozuar duke lënë jashtë Klubin e Futbollit Partizani është kthyer nga Presidenti i asaj kohe për plotësime, është ridërguar dhe miratuar më pas nga Presidenti Bamir Topi.

I pyetur gjatë këtij hetimi, shtetasi *Gazmend Oketa*, në lidhje me vendosjen e pronave në planin e përhapjes deklaroi se:... *Shtabi i Përgjithshëm është kryesisht ai që shikon nevojshmërinë e terreneve dhe objekteve që duhet të jenë në funksion të forcave të armatosura. Shtabi i Përgjithshëm përgatiste materialin në lidhje me pronat që duhet të bënin pjesë apo jo në planin e përhapjes, e paraqiste tek ministri dhe më pas kalonte procedurat për miratim derisa mbërrinte tek Presidenti i Republikës. Ministri i Mbrojtjes ka këshilltarë ushtarakë me të cilët konsultohej edhe në lidhje me planin e përhapjes ashtu si konsultohej edhe në lidhje me shefin e shtabit apo gjithë zinxhirin e komandës.*

Vijimi i procedurave të Privatizimit, ndryshimi i ligjit për sportin dhe procedurat e vlerësimit të objekteve të klubeve sportive

Miratimi i privatizimeve dhe ndryshimi i ligjit për sportet duke lejuar vetëm dhënien me koncencion

130. Nga ana tjetër, konstatohet se, megjithëse prona u ishte kthyer familjeve të njohura pronare, hapi i mëtejshëm, kishte të bënte me privatizimin e objekteve sportive.

Në këtë kohë, ligji nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" në nenin 31 të tij, parashikonte:

1. *Ndryshimi i statusit të objekteve sportive, në varësi të pushtetit qëndror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare".*

2. *Objektet sportive jepen me koncesion apo privatizohen, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".*

Në fakt, familjet pronare, si më sipër cituar, kishin shprehur gatishmërinë e tyre për të vijuar me aktivitetin sportiv.

131. Vetëm disa muaj pas kthimit të pronave familjeve pretenduese, (vendimet kanë marrë formë të prerë në muajin maj 2007), Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjistikës, **Ministri Genc Ruli**, me shkresën Nr.50/1 Prot, dt 19.09.2007 (sjellim në vëmendje se një muaj dhe dy muaj pas këtij miratimi lidhet kontrata e sipërmarrjes për pasuri të familjes Begeja dt. 22.10.2007 dhe me familjen Saliaga dt. 02.11.2007), i ka dërguar Ministrin të Mbrojtjes, **Fatmir Mediu** duke vënë në dijeni Degen e Shoqërive Publike, shkresë me anë të së cilës, miraton privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të futbollit "Partizani" duke i kërkuar që të përgatitet dokumentacioni për vlerësimin në zbatim të VKM-së Nr.704, datë 11.10.2006 dhe VKM-së 703, datë 11.10.2006 për kriteret dhe procedurat e shitjes. Kjo shkresë referohet se dërgohet në përgjigje të shkresës me nr. 9549/3 datë 14.11.2005.

I pyetur më dt 27.09.2022 shtetasi **Genc Ruli** ka deklaruar: "... Pasi ishin mbledhur nga të gjitha ministrinë, inventaret se cilat do të ishin pronat që do të privatizoheshin dhe ...ato që nuk do të privatizoheshin, METE fillon e bën miratimet Nga mesi i vitit 2007 ... miratojmë privatizimin e Klubit Partizani. ... nga vitit 2005 deri në 2007, ka qenë shumë e ngarkuar për Drejtorinë e Privatizimit, pasi u mor me përpilimin e të gjithë listave të inventareve që vinin nga Ministrinë e ndryshme, u mor me përgatitjen e akteve nënligjore, që kishin të bënin me procedurat e privatizimit, kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore apo procedurat e transferimit dhe transformimit të pronave shtetërore, për t'i bërë sa më pak burokratike dhe eficiente..."

Pra, deri në këtë moment, e vetmja mundësi për vijimin e procedurave të privatizimit, ishte që pronarët që gëzonin të drejtën e parablerjes, të mos ndryshonin destinacionin.

132. Por, ndërkohë, Ministri i Turizmit të asaj kohe, shtetasi Ylli Pango, kishte propozuar siç rezulton nga projekt vendimi "Për propozimin e projekt ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin", shoqëruar me relacionin shoqërues si dhe mendimet e ministrive të interesuara, përcjellë me shkresën me nr 4805 prot dt 08.05.2007, Këshillit të Ministrin, Sekretarit të Përgjithshëm Gjergj Lezhja, disa ndryshime të ligjit për sportin, ku më i rëndësishmi në rastin konkret, **shfaqet heqja e mundësisë së privatizimit të objekteve sportive**. Konkretisht, projektligji i propozuar, në nenin 31 të tij, parashikonte ndryshimin si vijon: "**Objektet sportive jepen me koncension, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë"**". Relacioni që shoqëron këtë projekt ligj, pasqyron ndër të tjera: ... Së katërti: *Është hequr dispozita për privatizimin e*

objekteve sportive. Objektet sportive të rëndësishme së veçantë janë publike, pronë e shtetit. Këto objekte përdoren lehtësisht për nevoja publike nga organizatat sportive.

Në mbledhjen e datës 16.05.2017 të Këshillit të Ministrave, kur janë diskutuar këto ndryshime, ka qenë i pranishëm Kryeministri Sali Berisha, dhe nuk është evidentuar ndonjë diskutim me probleme, në lidhje me parashikimin e mësipërm.

Me VKM nr. 457 datë 16.05.2007 "Për propozimin e projekt ligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" të nënshkruar nga vetë Kryeministri Sali Berisha dhe Ministri i Turizmit Ylli Pango, është vendosur propozimi i projekt ligjit të sipërcituar. Ky projektligj i është përcjellë Kuvendit me nr. 1822/3 prot datë 27.07.2007.

Madje edhe në procesverbalin datë 10.09.2007 ku është pasqyruar mbledhja e Komisionit për edukimin dhe mjetet e informimit publik, shtetësja Violeta Shqevi ka theksuar se: ...është hequr dispozita për privatizimin e objekteve sportive...

Ndryshimet e propozuara nga Ministri Ylli Pango, u miratuan me ligjin nr 9816 datë 22.10.2007 (FZ 148 datë 06.11.2007), hyrë në fuqi në 21.11.2007, ku tashmë, neni 31 i cili përcaktonte rigorozisht vetëm dhënien me koncesion të objekteve sportive me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni dhe jo privatizimin. Konkretisht, pas këtyre ndryshimeve neni 31 parashikonte: "Objektet sportive jepen me koncesion, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë"

133. Ministri Ylli Pango, duket se ka vepruar tërësisht në kundërshtim me n. 31 të ligjit për sportin, i ndryshuar mbi bazë të vetë propozimeve të tij, kur me shkresën Nr. 12248/1 Prot dt 04.01.2008 shprehet dakort për privatizimin e Klubit Shumësportësh "Partizani" dhe kjo shkresë i Drejtohet METE, me Ministër Z. Genci Ruli. Konstatohet se kjo shkresë është dërguar pikërisht pasi më dt 26.12.2007 (nr. 12248 prot dt 31.12.2007) Ministrin të Turizmit Ylli Pango i ishte paraqitur kërkesë nga Bashkësia Kroj i Shëngjinit dhe për dijeni Ministrin të Ekonomisë Genc Ruli, për ushtrimin e të drejtës së privatizimit për Klubin Shumësportësh Partizani. Po në këtë vazhdë shkeljesh të ligjit për sportin, ka vijuar edhe Ministri i METE shtetasi Genc Ruli, kur me shkresën Nr. 953/1 Prot. datë 22.01.2008, me lëndë "Miratim Privatizimi", i drejtohet Ministrisë të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ylli Pangos dhe për dijeni shtetasit Irfan Hoxha, Degës së Shoqërive Publike dhe Familjes Begeja. Në përmbajtje të kësaj shkresë në përgjigje të shkresës Nr. 12248/1 Prot, datë 04.01.2008 është miratuar privatizimi i Klubit Shumësportësh "Partizani". Përsa më sipër dokumentacioni i vlerësimit të objektit dhe trullit do të përgatitet në zbatim të VKM-së 794, datë 21.11.2007 duke respektuar afatet ligjore.

134. Gjithashtu, ajo që evidentohet në këto miratime privatizimesh, është se Klubet sportive janë trajtuar si inekzistente.

Ligji nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" parashikonte në nenin 20 se në shoqëritë tregtare, me objekt ushtrimin e veprimtarisë sportive në një sport të caktuar, pjesa e kapitalit shtetëror ose paketa e aksioneve të zotëruara nga shteti, mund të privatizohen nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar.

Në VKM nr. 195 datë 20.03.1998 "Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen" është parashikuar se:

1. Objekti i këtij vendimi janë ndërmarrjet, të cilat sot për sot e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëritë tregtare", ndryshuar me ligjin nr.8237, datë 1.9.1997 dhe ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
2. Lista e ndërmarrjeve me të dhënat përkatëse i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga organet qendrore dhe pushteti lokal, sipas vartësisë administrative të ndërmarrjeve. Kjo listë publikohet me urdhër të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit
3. Format e privatizimit janë: - shitja; - shitja me rezervë; - kontrata e enfiteozës;
4. Përzgjedhja e formës së privatizimit bëhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, sipas propozimeve të bëra në ofertat parakualifikuese, duke i dhënë përparësi shitjes.
5. Për shitjen dhe shitjen me rezervë ngarkohet AKP-ja ta realizojë atë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 20.3.1998 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedura e shitjes".....

Edhe me VKM nr 819 datë 29.11.2007 "Për privatizimin e pasurive të ndërrarjeve apo të institucioneve shtetërore" që shfuqizoi VKM nr.195, datë 20.3.1998, parashikohej:

1. Objekt i këtij vendimi janë pasuritë e ndërmarrjeve shtetërore, të cilat e kanë ndërprerë veprimtarinë ekonomike, nuk kanë efektivitet dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, si dhe pasuritë e institucioneve shtetërore.
2. Institucionet qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore, për pasuritë e ndërmarrjeve apo të institucioneve, që kanë në varësi administrative, dërgojnë mendimin e tyre për privatizimin e këtyre pasurive në ministrinë përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore, në bazë të kërkesës së kësaj të fundit....

135. Ministri i Mbrojtjes Fatmir Mediu, me shkresën nr. 7945/1 prot datë 19.11.2007, t'i ketë kthyer përgjigje shtetasit Albert Xhani, administrator i Futboll Klub Partizanit me këtë përmbajtje: "Përsa kërkohet në shkresën tuaj me nr. 163 datë 22.10.2007 "Kërkesë për konfirmimin e logos dhe emrin e FK Partizani" ju sqarojmë si më poshtë: Ky entitet nuk është në varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Veprimtaria e tij është e pavarur. .."

Pra, në këtë periudhë Ministria e Mbrojtjes, kërkon ta shkëpusë veten nga aktiviteti sportiv, duke zhvlerësuar në fakt, rëndësinë publike që mbartnin territoret dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani.

Gjendur para situatës pra, kur Ministria e Mbrojtjes në vitin 2007, nuk pretendon të drejta mbi logon e Klubit të Futbollit Partizani dhe para faktit se tashmë kishte ndodhur kthimi i pronave, rezultoi se në të njëjtën datë që Ministri i Ekonomisë nënshkruan për ngritjen e komisionit të vlerësimit në lidhje me privatizimin, si sipër u parashtrua, pra më datë 18.12.2007, me vendim të asamblesë së jashtëzakonshme, të aksionerit të shoq "Partizani" sh.a. nr. 2, është vendosur ndryshimi i n 3 dhe 7 të akt themelimit e konkretisht shfuqizimi i paragrafëve 2, 3, 4, 5, dhe 6 të n 3, shfuqizimi i paragrafit 3 të nt 7 dhe shfuqizimet përkatëse në statut. Këto parashikime të akt themelimit dhe statutit kanë të bëjnë pikërisht me parashikimin e Ministrisë së Mbrojtjes si aksioner referuar emrit dhe stemës së shoqërisë. Në proces verbalin e asamblesë së

jashtëzakonshme të aksionerit të dt 18.12.2007 është përshkruar se është prezantuar shkresa me nr. 7945/1 prot dt 19.11.2007 e lëshuar nga Ministri i Mbrojtjes, kthim përgjigje, drejtuar Albert Xhani-t, ku thuhet se: "...Ky entitet nuk është në varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes. Veprimtaria e tij është e pavarur". Pra referuar kësaj përgjigje është proceduar me vendimmarrjen e mësipërme.

135.1. Por më vonë rezulton se Ministria e Mbrojtjes, por tashmë nën drejtimin e një tjetri ministri, konkretisht shtetasit Arben Imami, pretendon te drejtën mbi stemën e klubit sic pasqyrohet në një padi të dt 25.11.2010⁴ dhe madje edhe merr masa për të themeluar shoqërinë Klubi i Futbollit Partizani, gjë të cilën e realizon më datë 28.05.2012, por duke u vendosur selia e saj, pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes. Nipti i kësaj shoqërie është L21804007A.

Rëndësia e aktivitetit sportiv të Klubit të Futbollit Partizani shfaqet kur po nga Ministria e Mbrojtjes merren masa për regjistrimin e shoqërisë aksionere me aksioner të vetëm Ministrinë e Mbrojtjes, shoqëri kjo e emërtuar si Klubi i Futbollit Partizani.

Sipas raportit për vlerësimin e kapitalit të Klubit të Futbollit Partizani, dt 27.03.2012, ekspertet e caktuara në atë kohë e konkretisht Eneida Rahmani dhe Margarita Kalemasi, sipas urdhërit nr 408 datë 13.03.2012, kanë pasqyruar ndër të tjera se: "...Klubi i Futbollit "Partizani" është krijuar në vitin 1947 dhe rezulton pjesmarrës pa ndërprerje në veprimtaritë kombëtare të futbollit, kjo e vërtetuar sipas shkresës nr prot 322 datë 02.03.2012 të Federatës Shqiptare të Futbollit. Me VKM nr 115 datë 16.02.1998 "Për ndryshimin e varësisë së Klubit Sportiv Olimpik Partizani dhe të Klubit të Futbollit Partizani, ky i fundit (pra Klubi i Futbollit Partizani) kalon në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në shkresën nr 7696 prot datë 08.08.2011 të Ministrisë së Mbrojtjes, me lëndë "Për regjistrimin e KF Partizani" në veprimtaritë kombëtare të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) theksohet se: "Ministria e Mbrojtjes është personi juridik që ka zotëruar dhe zotëron të gjitha të drejtat mbi këtë emër." . Me shkresën nr prot 1514 datë 05.09.2011 të FSHF-së drejtuar z. Arben Imami, në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 7696 prot datë 08.08.2011 "Për regjistrimin e KF Partizani" në veprimtaritë kombëtare të FSHF theksohet se: "Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit me vendimin e tij nr 48 datë 04.09.2011 pranon kërkesën tuaj për njohjen e Ministrisë

⁴ Me kërkesë padinë (shih dosjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 8824 dt 07.11.2011), të nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, me dt depozitimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë 25.11.2010, është investuar kjo e fundit, duke u paditur shoq "Partizani" sh.a. dhe duke u thirrur si person i tretë Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, me objekt: Konstatimi i pavlefshmërisë së veprimit juridik mbi regjistrimin e markës me emrin Futboll Klub Partizani (Fjalë dhe figurë); Zhvlerësimin e regjistrimit të markës Futboll Klub Partizani (fjalë dhe figurë) për llogari të shoqërisë Aksionare; Detyrimin për regjistrimin e markës Futboll Klub Partizani (fjalë dhe figurë) për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë padi është parashtruar se, Ministria e Mbrojtjes ka administruar veprimtarinë e Klubit të Futbollit Partizani që nga viti 1945 kur ky klub është krijuar e deri në vitin 2000 kur ky klub nëpërmjet një procesi jo transparent u shndërrua në shoqërinë anonime Partizani sh.a. Sipas kësaj padie, Ministria e Mbrojtjes nuk ka qenë dakord me këtë vendim pasi kërkesa për shndërrimin e Futboll Klub Partizanit është bërë në mënyrë të njëanshme pa marrë mendimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Në padi theksohet se, në vetë aktin e themelimit dhe në statutin e shoqërisë, parashikohet se emri dhe stema e Klubit të Futbollit Partizani i përkasin dhe do të jenë gjithmonë dhe në çdo rast pronë e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nëpërmjet këtij kontributi konsiderohet edhe si aksionare në vendimmarrjen e kësaj shoqërie. Pra, në këtë mënyrë, Ministria e Mbrojtjes, ngre pretendime mbi zotërimin e një aktiviteti sportiv dhe logos përkatëse të tij. Ndaj vendimit gjyqësor nr. 8824 dt 07.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur rrëzimin e padisë, ka qenë ministri Arben Imami që ka nënshkruar Apelin me nr. 10800 prot dt 22.11.2011 dhe ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit me nr. 1698 dt 27.06.2012 ka qenë po ministri i mbrojtjes Arben Imami që ka nënshkruar rekursin me nr. 8103 prot datë 17.07.2012.

së Mbrojtjes si subjekti i vetëm që zotëron të drejtën e përdorimit të emrit të Klubit të Futbollit Partizani”.

Në vijim të këtij raporti ekspertimi, konstatohet se ekspertet vijnë në mbështetje të kryerjes së vlerësimit mbështetur në Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr 7066 dt 01.10.2010 dhe të METE nr 8758/1 dt 25.10.2010 “Për zbatimin e VKM nr 1718 datë 24.12.2008” ku në pikën 3 parashikohet se kapitali themeltar i shoqërive aksionere që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv do të bazohet: Duke u mbështetur në bilancin e vitit ushtrimor financiar paraardhës; Vlera e emrit të klubit dhe logos së tij, të cilat do të jenë deri në 30 % të vlerës së kapitalit themeltar. Kjo vlerë përcaktohet bazuar në vitin e krijimit të klubit dhe viteve të aktivitetit. Kjo (pra jetëgjatësia dhe pjesmarrja në aktivitete të Klubit) përbën deri në 50 % të vlerës së emrit të klubit dhe logos; Trofetë e arritura dhe pjesmarrja në aktivitete kombëtare përbëjnë pjesën tjetër të vlerës së emrit të klubit dhe logos (deri në 50 %).

Përsa më sipër ekspertet pasur parasysh se Klubi i Futbollit Partizani pasqyrohet se që nga krijimi i tij në vitin 1947 e në vijim figuron pjesmarrës pa ndërprerje në veprimtaritë kombëtare të futbollit, kanë vlerësuar se vitet e aktivitetit të këtij klubi janë më shumë se 50 dhe në këtë mënyrë, jetëgjatësia dhe vitet e aktivitetit vlerësohen me 50 pikë. Sipas ekstraktit historik të Klubit të Futbollit Partizani, rezultojnë se ky klub ka fituar 34 herë (15 herë kampion dhe 19 herë në vend të dytë) kampionatin. Për këtë arsye Klubi i Futbollit Partizani vlerësohet me 25 pikë për trofetë e arritura. Me 25 pikë është vlerësuar pjesmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Në përfundim vlerësojnë kontributin e kapitalit themeltar të pjesës që i takon aksionerit që është Ministria e Mbrojtjes, 30 % të kapitalit total të shoqërisë Aksionere. Në praktikën e regjistrimit gjenden edhe shkresat e Federatës.

Në aktin e themelimit të nënshkruar nga Ministri i Mbrojtjes Arben Imami është përcaktuar se kontributi në para është 2 000 000 lekë që është edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqëritë me ofertë private kurse kapitali themeltar në total është 3 500 000 lekë.

Kjo shoqëri nuk ka pasur aktivitet mesa konstatohet nga të dhënat e ekstraktit të regjistrimit tregtar derisa me shkresën Nr. 15330, datë 13.06.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rajoni Qendror ka kërkuar Vendosje të Mases së Sigurimit të Detyrimit Tatimor, mbi tatimpaguesin shoqëria “Klubi i Futbollit “PARTIZANI”. “ SH.A., pajisur me NUIS (Nipt)- L21804007A, me përfaqësues ligjor Gjergji Thaka. Vendosja e kësaj masë synon të moslejohet tjetërsimi i titujve të pronësisë dhe të drejtat pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesit deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Ndërkohë rezultojnë se me shkresën nr. 06 prot datë 16.01.2008 (protokolluar me nr. 162 prot datë 20.01.2008), pra pak pasi është ngritur Komisioni i vlerësimit në lidhje me privatizimin, shtetasi Albert Xhani i është adresuar Kryeministrit shtetasit Sali Berisha, që në vazhdim të komunikimit të tyre, kërkon edhe një herë vëmendjen, përsa i përket problemit të terreneve të Klubit të Futbollit Partizani. Konkretisht në këtë shkresë kërkon rimbursim për FK Partizani.

135.2. Nga ana tjetër, edhe aktiviteti i Klubit Shumësportesh Partizani, dhe ekzistenca e tij, nuk mund të mohohen. Pavarësisht të gjitha pretendimeve në lidhje me zënien e objekteve të tij, rezultonte se kishte objekte që shfrytëzoheshin. Kështu, me shkresën nr. 7706 prot dt 26.11.2008 të Drejtoreshës së Sporteve Violeta Shqevi, pranë Ministrisë së Turizmit, është informuar me një memo Ministri Ylli Pango dhe zv. Ministri Ekrem Spahia, në vijim të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm Fisnik Brovina, lidhur me situatën në Klubin

Shumësportesh Partizani, ekipet e këtij klubi, rezultatet dhe asetet e tij. Konkretisht ekipet që stërviten në klubin shumësportesh Partizani renditen të jenë 23 ekipe ku jepen edhe rezultatet: *Ekipi i basketbollit në vendin e dytë në Kampionatin Kombëtar 2007 – 2008 dhe me vendin e katërt në Kupën e Republikës; Ekipi i basketbollit të rinj zuri vendin e dytë; Ekipi i Volejbollit femra zuri vendin e trete; Ekipi i volejbollit të reja doli kampion kombëtar; Ekipi i volejbollit të rinj doli kampion kombëtar; Ekipi i gjimnastikës në turneun ndërkombëtar në Bosfor Turqi 2008 është fituar një medalje argjendi, 2 medalje bronxi dhe në turneun ndërkombëtar në Bitola, Maqedoni u fituan 5 medalje ari; Ekipi i alpinizimit në vitin 2008 doli ekipi më i mirë i aktivitetit. Në palestrën e Partizanit në murin alpin u zhvillua kampionati kombëtar dhe kampion kombëtar doli Gerhard Duro i Partizanit dhe në kampionatin ballkanik ky sportist ka marrë kupën "Alpinisti më i mirë" i aktivitetit; Edhe në sporte të tjera si karate, mundje, atletikë, not, ka elementë cilësorë që premtojnë rezultate. Asetet që disponon Klubi Shumësportesh Partizani janë: *Pishinë noti – 1; Palestra – 8; Terrene sportive të thjeshta dhe komplekse – 4.* Thekson se palestra e gjimnastikës është e vetmja palestër kombëtare, palestra e mundjes është ndër më të mirat dhe të tjerat kanë standarte. Në përfundim thekson se, rezultatet e sipërpërmenura dhe faktin se ky klub sportiv ka një histori të vyer dhe aktualisht është një klub që ka një pjesmarrje të madhe në sportet elitare, Drejtoria e Sporteve mendon se është e rëndësishme vazhdimi i mëtejshëm i aktiviteteve në klubin Shumësportesh Partizani. Kjo memo, përveç drejtoreshës Violeta Shqevi është nënshkuar edhe nga specialisti Fatos Korbi dhe përgjegjëse e sportit cilësor Fatbardha Gjaci. Pra, Ky Klub Sportiv duket se ka funksionuar normalisht dhe ekipet që stërviten në të kanë dhënë edhe rezultate mesa reklamohen shumë të mira.*

Për më tepër, ndërkohë që zhvillohen procedurat e privatizimit, rezulton se përgjatë vitit 2006 për Klubin Shumësportesh Partizani evidentohen shpenzime në vlerën 3 500 000 lekë (*Nga regjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2006, të Ministrisë së Turizmit, rezulton se janë kryer prokurime për Klubin Shumësportesh Partizani për kancelari, veshmbathje, ushqim, shpenzime gjyqtarie, shtypi, energji elektrike, telefon fax, karburant e vaj, shpenzime udhëtimi, honoarre, të tjerë, mirëmbajtje ndërtesë gjithsej në vlerën 3 500 000 lekë. Nga kjo shumë 250 000 lekë janë dhënë për mirëmbajtje ndërtesash).*

135.3. Pra, megjithëse të dy klubet kanë funksionuar, nuk janë marrë masa për privatizimin e aksioneve të klubeve por është proceduar sikur këto klube nuk kryenin ndonjë aktivitet me interes publik, nuk ekzistonin, duke i hapur rrugë fillimisht kthimit dhe kompensimit të pronave e më pas edhe privatizimit.

Në respektim të VKM nr. 195 datë 20.03.1998 "*Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen*" duhet që në mënyrë që të procedohej me privatizimin, të ishte ndërprerë *veprimtaria ekonomike dhe të mos plotësoheshin kriteret e transformimit në shoqëri tregtare.*

Edhe me VKM nr. 819 datë 29.11.2007 "*Për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo të institucioneve shtetërore*" sërisht gjendet i njëjti parashikim, pra objekt i këtij vendimi janë pasuritë e ndërmarrjeve shtetërore, të cilat e kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre ekonomike, nuk kanë efektivitetet dhe nuk plotësojnë kriteret e transformimit në shoqëri tregtare, në zbatim të ligjit nr 7926 datë 20.04.1995 "*Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare*" të ndryshuar si dhe pasuritë e institucioneve shtetërore.

Madje, me propozim të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të ministrit të METE, Këshilli i Ministrave, sërisht në kohën që kryeministër ka qenë shtetasi Sali Berisha, ka miratuar VKM nr 1718 datë 24.12.2008 "*Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar*" (FZ 214 datë

31.12.2008, po në këtë datë ka hyrë në fuqi).

1. *Klubet sportive, që do të transferohen në shoqëri aksionare, do të funksionojnë në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".*

2. *Procedura e transformimit të tyre fillon me daljen e urdhrat të titullarit të institucionit, në varësi administrative të të cilit është klubi sportiv.*

3. *Përcaktimi i kapitalit themeltar të këtyre shoqërive, që do të krijohen nga transformimi i klubit sportiv, bëhet në bazë të:*

a) *bilancit të vitit ushtrimor financiar, pararendës;*

b) *emrit të klubit, të logos së tij dhe të vlerës, që do të jetë deri në masën 30 për qind të vlerës së kapitalit themeltar. Kjo vlerë përcaktohet nga viti i krijimit të klubit, trofetë e arritura, pjesëmarrja në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare.*

4. *Përcaktimi i kapitalit të këtyre shoqërive bëhet nga një komision i ngritur pranë çdo klubi, me urdhër të titullarit të tij.*

5. *Klubi sportiv, i transformuar në shoqëri aksionare, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ish-klubit sportiv, në bazë të bilancit financiar, në çastin e transformimit.*

6. *Vlera kontabël e mbetur e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara aktuale rivlerësohet, sipas kriterëve të caktuara në vendimin nr.794, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes".*

7. *Elementet e pasurisë, pa vlerë përdorimi ose të zhvlerësuar, të trajtohen për t'u nxjerrë jashtë përdorimit ose për ulje vlere, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi. Ulja e vlerës të kryhet nga komisioni i vlerësimit, me pjesëmarrjen e dy a më shumë ekspertëve të fushave përkatëse, në varësi nga natyra e elementeve të pasurisë. ...*

Ka qenë pikërisht kjo VKM që ka nxitur ministrin Arben Imami, për të ndërmarrë betejën ligjore në lidhje me stemën, logon e Klubit të Futbollit të Partizani dhe regjistrimin si subjekt.

135.4. Gjithashtu, ligji nr 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" parashikonte: Neni 19 "Klubet sportive"

1. *Klubet sportive organizohen dhe funksionojnë si shoqëri anonime, sipas dispozitave të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".*

2. *Transformimi i klubeve sportive në shoqëri anonime miratohet nga Ministria e Ekonomisë, me kërkesë të organit të pushtetit qendror ose vendor, në varësi të të cilit është klubi sportiv. Ky transformim bëhet brenda një afati prej dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*

3. *Klubi sportiv i transformuar në shoqëri anonime gëzon të drejtën e përparësisë së përdorimit të objekteve sportive të institucionit publik, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet tyre..*

Me ligjin nr 9816 datë 22.10.2007 (hyrë në fuqi më datë 21.11.2007) ndryshime të propozuara nga Ministri i Turizmit Ylli Pango, n 19 pika 2 u ndryshua si vijon: "2. *Procedurat e transformimit të tyre realizohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me propozim të përbashkët të Ministrat të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrat të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.*"

Pra sipas këtij ndryshimi, është hequr afati 2 vjeçar që rëndonte mbi transformimin e këtyre klubeve dhe në vijim, rezulton se ka dalë edhe VKM e vitit 2008 për transformimin e klubeve sportive.

Por megjithatë, siç konstatohet, për klubet sportive Partizani, qëllimi nuk ka qenë asnjëherë për

ndonjë transformim të tyre, pasi procedurat e privatizimit kanë vijuar në shkelje të kuadrit ligjor të cituar.

Neni 27 parashikonte:

1. *Objektet sportive janë publike ose private.*
2. *Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen, rikonstruksionin dhe për ndërtimin e objekteve të reja.*
3. *Objektet sportive private janë në pronësi të personave juridikë privatë.*
4. *Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive. Objektet sportive në pronësi publike përdoren për të ofruar shërbime të nevojshme për sportin për të gjithë.*

Neni 28 sanksiononte:

1. *Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike, të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.*
2. *Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.*

Neni 29 parashikonte: *Organet shtetërore ose organizatat sportive, që i kanë në pronësi a përdorim këto objekte, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.*

Në nenin 29, me ndryshimet me ligjin nr 9816 datë 22.10.2007 të propozuara nga ministri Ylli Pango, pas paragrafit të parë u shtua paragrafi me këtë përmbajtje: *“Në rastet kur vërehet se kushtet dhe kriteret nuk janë plotësuar sipas standardeve të miratuara nga organizatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse, merren masa për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive sportive, deri në përbushjen e tyre.”*

Neni 30

1. *E drejta e shfrytëzimit të mjedisit sportiv i takon administratorit të tij.*
2. *E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë së garës, që zhvillohet në mjedisin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.*
3. *Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale.*
4. *Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie a gare sportive nuk mund t'u vërë sportistëve, pjesëmarrës në këtë veprimtari a garë sportive, asnjë detyrim që cenon lirinë e tyre, qoftë atë të të shprehurit apo çdo lloj lirie tjetër individuale.*

Pra megjithë këto ndryshime në ligjin për sportin, që nxorrën më së miri në pah qoftë interesin publik, qoftë qëllimin e transformimit të klubeve sportive, qoftë përgjegjësinë e institucioneve që i administrojnë, sërish procedurat e privatizimit, vijuan.

Ngritja e Komisioneve të vlerësimeve

136. Sipas VKM 704 dt 11.10.2006 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedura e shitjes" e miratuar po me propozimin e METE si dhe të Këshillit të Ministrave, në kreun IV "Detyrat dhe të drejtat për zbatimin e këtij vendimi" sanksiononte se:

1. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore miratohet nga drejtuesi i institucionit ose i ndërmarrjes, ku kryhet vlerësimi i pasurisë shtetërore. Komisioni duhet të ketë jo më pak se tre anëtarë, njëri prej të cilëve duhet të jetë kryetari i degës së financës ose përgjegjësi i llogarisë së ndërmarrjes dhe të kryesohet nga drejtori ose zëvendësi i tij.

2. Komisioni i vlerësimit, për rastet e përcaktuara në këtë vendim, kërkon të miratohen ekspertët vlerësues. Këta ekspertë, sipas kërkesës së ndërmarrjes a institucionit, miratohen nga titullari i organit administrativ ose pushtetit vendor, sipas varësisë administrative të ndërmarrjes. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe ata duhet të jenë ekspertë të fushës përkatëse të vlerësimit, që do të kryejnë.

136.1. Kjo VKM, megjithatë ndryshon në vijim, me propozim të METE, ku vendimtar për përcaktimin e komisionit, nuk është më institucioni që ka objektin, por ky komision tashmë ngrihet nga METE. Sipas VKM nr 794 datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" në kreun I "Vlerësimi i elementëve të pasurisë dhe kompetencat" sanksionon se:

...2. Komisioni i vlerësimit të pronës shtetërore, në zbatim të këtij vendimi, ngrihet nga titullari i institucionit, që ka të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet.

3. Ky komision kryesohet nga kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën përkatëse, ku ndodhet objekti, dhe në përbërje ka:

a) ekspertë vlerësues të licencuar dhe të autorizuar të fushës përkatëse, sipas rastit;

b) drejtorin e ndërmarrjes apo institucionit, në administrim të të cilit ndodhet aset. ...

Sipas shkresës Nr. 7648 Prot dt 19.11.2007 me lëndë "Dërgohet për miratim një projekt vendim", METE me Ministër Genci Ruli, rezulton si iniciuese e dy projekt vendimeve dhe i paraqet për miratim duke reflektuar dhe vendimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Relacioni "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes" i nënshkruar nga Ministri Genci Ruli, në përmbajtje të tij përshkruan se, përgatitja e këtij projektvendimi, ka rezultuar e nevojshme dhe është diktuar nga vështirësitë që janë hasur gjatë procesit të privatizimit ...dhe një nga këto vështirësi ka të bëjë me faktin që... strukturat administruese, nuk vlerësojnë pronën shtetërore... duke argumentuar këtë, me faktin që nuk kanë njerëz apo mjete financiare. Për të tejkaluar këto vështirësi si dhe për të përshpejtuar kohën e vlerësimit, në këtë projektvendim është përcaktuar që vlerësimin e pronës do ta bëjë një komision vlerësues i ngritur nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës....

Në këtë mënyrë, janë shkurtuar dhe hallkat ndërmjetëse në të cilat kalonte ky dokumentacion, duke përcaktuar në këtë projekt vendim, që dokumentacioni të kalojë nga komisioni i vlerësimit direkt në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës. Ky projekt vendim paraqitet si një variant i VKM-së Nr.704, datë 11.10.2006 dhe VKM-së 703, datë 11.10.2006 për kriteret dhe procedurat e shitjes.

137. Fillimisht është për t'u vlerësuar se, në të dy komisionet e ngritura për vlerësimin e objekteve të dy klubeve Partizani, ekspertët e fushës, janë zgjedhur të njëjtë. Konkretisht ata kanë qenë shtetasit Elvira Aliaj (Lame) dhe Sali Preçi.

Shtetësja Elvira Aliaj, është njohje e shtetasit Jamarbër Malltezi dhe rezulton se edhe ka pasur në vijim marrëdhënie kontraktore me shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Konkretisht, nga aktet ka rezultuar se, shtetësja Elvira Aliaj (Lame) më datë 03.12.2011 është dokumentuar të ketë përgatitur çertifikatën e vlerësimit (*raport vlerësimi*) datë 03.12.2011, bazuar në kërkesën e shtetasit Jamarbër Malltezi për pasurinë tokë arë, me sip 3000 m² vol 8 faqa 219 ZK 3051, nr pas 370/18 regj. në bashkëpronësi të Jamarbër dhe Argita Malltezi, pasuri e ndodhur në fshatin Priskë, për të cilën edhe shtetasi Petrit Kullolli ka përgatitur plan rievimin. Nga të dhënat e esktraktuara, nëpërmjet aktit të ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se është gjendur një dokumenti i emërtuar si “07 Libër blerje korrik 2012 Homeplan ok”, ku evidentohet: - nr 42, nr 86565999 datë 23.07.2012 shitësi Elvira Lame, shuma 120 000 lekë.

Po nga të dhënat e përfutuara nga ky akt ekspertimi, rezulton një dokument në formatin Word, email i emërtuar si “Email dt. 22.06.2011” dokument i krijuar më datë 20.06.2011 dhe i ruajtur e i printuar më datë 23.06.2011, ku ky email i cili i drejtohet një shtetasi të identifikuar si Bledi parashtron disa pyetje. Nga këto pyetje evidentohet: “Pershendetje Bledi, Doja te te pyesja: ...Me date 26.05.2011 keni paguar per fature zj.Elvira Lame, per cilen fature behet fjale, sepse une nuk e kam nje te tille? ... Gjithashtu ju lutem me dergoni dhe librin e arkës nga fillimi deri me sot.

PERGJIGJET E BLEDIT: ...Doja te te pyesja: - *Pergjigjen e kesaj pyetje t'a ka dhene Suzana me mail.* “

Gjithashtu nga aktet e administruara përgjatë hetimit rezulton se për shtetasen Elvira Aliaj (Lame) shoqëria Homeplan sh.p.k. ka lëshuar faturën nr. 42 datë 23.07.2012 me përshkrimin *shërbime “Akt ekspertimi” në vlerën 120 000 lekë*. Në aktin e ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se gjendet dokumenti “07 Libër blerje korrik 2012 Homeplan ok”, ku evidentohet: nr 42, nr 86565999 datë 23.07.2012 shitësi Elvira Lame, shuma 120 000 lekë

Kurse shtetasi **Sali Preçi**, rezulton të ketë qënë administrator i shoqërisë “KLS Auditing” së bashku me shtetasin Lulash Pjetërnikaj dhe të dy këta shtetas, janë caktuar si ekspertë kontabël në vitin 2006, të shoqërisë “ASG Poëer Albania” sh.a. me NIPT K71416002M, me drejtorë të përgjithshëm Paolo Rossi (*shtetas zvicerian*) dhe Agim Gjinali (*shtetas i Serbisë dhe Malit të Zi*), ku anëtarë të Këshillit Mbikqyrës ka qënë Diego Lissi, Marko Luli dhe shtetasi Florenc Kola. (i biri i Pjetrit). Shtetasi Florenc Kola, rezulton të jetë mik i familjes Malltezi (*madje me prokurën e posaçme nr regj 266274524 datë 21.07.2020, të bërë nga shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi, në Konsullatën Shqiptare në Mynih, Gjermani, i janë dhënë tagre shtetasit Florenc Kola, dt. 20.09.1967, për të nënshkruar dhe firmosur për llogarinë e tyre dokumentat në emrin e tyre pranë institucioneve shtetërore dhe private*).

Nga aktet e depozituara në QKB konstatohet se, përkthyesja e akteve të shoqërisë ASG Poëer Albania, është shtetësja *Lealba Pelinku*, që ka qënë në vijim e punësuar pranë subjektit të shtetases Argita Malltezi dhe me noterizimet apo regjistrimet në QKB është ngarkuar shtetësja Joana Qeleshi. Më datë 07.05.2008 si administrator i kësaj shoqërie është caktuar shtetasi Fatmir Bektashi duke u larguar shtetasi Paolo Rossi. Aktualisht kjo shoqëri sot nuk ka aktivitet dhe ka edhe masë sigurimi nga tatimet.

Klubi i Futbollit Partizani

138. I pyetur më dt 27.09.2022 shtetasi **Genc Ruli** ka deklaruar: “...Pas vitit 2007 vijuan me procedurën e dytë që është vlerësimi dhe sipas ligjeve vlerësimi bëhej nga një komision i

pavarur, me persona të licencuar dhe me një përfaqësues nga Ministria përkatëse. Përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes e cakton normalisht Ministria e Mbrojtjes. Ekspertët u zgjedhën nga një listë e miratuar.”

139. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, shtetasi **Genc Ruli**, me shkresën Nr. 9508 Prot. datë 18.12.2007 ka ngritur në zbatim të VKM nr 794 datë 21.11.2007 komisionin e vlerësimit për Klubin e Futbollit Partizani, të përbërë nga Kryetare e Degës së Shoqërive Publike Tiranë: Znj. **Mynyre Pajana** (Kryetare komisioni), Përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes **Z. Stefan Tane** (anëtar); Ekspert Vlerësues i Licensuar i pasurive të paluajtshme Znj. **Elvira Aliaj** (anëtare) dhe Ekspert Kontabël i autorizuar **Sali Preçi** (anëtar).

I pyetur më dt 27.09.2022 shtetasi **Genc Ruli**, nëse i është kërkuar nga ndokush, përsheptimi i procedurave të privatizimit, apo ndonjë ndërhyrje tjetër, është shprehur se *beson se pronarët kanë bërë disa letra kryesisht në vitet 2005, 2006 ku sqaronin gjendjen e pronësisë dhe për të përfutur sipas ligjit, të drejtën e parablerjes. Person tjetër nuk ka pasur. Deklaron se në atë kohë, nuk ka qenë në dijeni që një ndër trashëgimtarët e familjeve që kishin pronësi në këto territore ka qenë shtetasi **Jamarbër Malltezi**, por sot nga mediat e di këtë fakt. Ai e ka ditur që kanë qenë pronare katër – pesë familje, një ndër të cilat familja **Begeja**. Personat që nënshkruanin në emër të kësaj familje ishin kryesisht ose **Fatmir** ose **Bashkim Begeja**.*

I pyetur më dt 21.09.2022, shtetasi **Fatmir Mediu**, deklaroi se, Komisioni i mësipërm, është ndërtuar mbi një bazë të akteve ligjore. Në kujtesën e tij, pas caq kohësh, dijeni se kush e ka përcaktuar përfaqësuesin e Ministrisë së Mbrojtjes nuk ka. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ka pasur një drejtori dhe sektor përkatës e cila merrej me pronat dhe kombinonte bazuar në ligj me ministritë e tjera, dhe veçanërisht me **METE-n**. I pyetur nëse i është kërkuar nga ndokush, që të fillonte procedurat për privatizim deklaroi se, është bazuar vetëm mbi aktet shkresore dhe ligjore në lidhje me veprimtarinë e tij, të korrespondencave të meparshme dhe të kohës që ka qenë ministër. Nuk ka pasur dijeni që trashëgimtar i një pjese të tokës ku shtriheshin terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani, ka qenë shtetasi **Jamarbër Malltezi**.

Klubi Shumësportesh Partizani

140. Nga familjet pronare, vëmendja ishte kthyer edhe në drejtim të privatizimit të Klubit Shumësportesh Partizani. Me shkresën nr. 1226 prot dt 26.12.2007 (hyrje me nr. 12248 prot dt 31.12.2007) Ministrit të Turizmit **Ylli Pango** i paraqitet kërkesë nga **Bashkësia Kroj** i **Shëngjinit** dhe për dijeni Ministrit të Ekonomisë **Genc Ruli**, për ushtrimin e të drejtës së privatizimit për Klubin Shumësportesh Partizani..., i bëhet gjithashtu me dije se, ka filluar procedura e privatizimit të Klubit të Futbollit Partizani. Kjo kërkesë është nënshkruar nga shtetasi **Xhimi Begeja, Igli Vaqari, ...Alimehmeti, Adi Llagami dhe Luan Saliaga**.

141. Gjithashtu edhe për vlerësimin e Klubit Shumësportesh Partizani, ngrihet Komisioni i Vlerësimit, sipas shkresës me nr Nr. 1247 Prot, datë 04.02.2008 të Ministrit **Genc Ruli**, me përbërje si vijon: Znj. **Irfan Hoxha** (Kryetar komisioni), (Kryetar i Degës së Shoqërive Publike Tiranë); **Afrim Tola** (anëtar); Drejtor i Klubit Shumësportesh Partizani; Ekspert Vlerësues i Licensuar i pasurive të paluajtshme Znj. **Elvira Aliaj** (anëtare); Ekspert Kontabël i autorizuar **Sali Preçi** (anëtar).

Sic mund të konstatohet, **ekspertë, caktohen të njëjtit persona** që në datë 18.12.2007, ishin caktuar për vlerësimin e Klubit të Futbollit Partizani.

Dhënia e lejeve për ndërtimin

142. Ndërkohë që si më sipër evidentohet se, sapo kanë nisur procedurat e privatizimit, pasi vetëm më datë 18.12.2007 është ngritur Komisioni për vlerësimin e territoreve dhe objekteve sportive të Klubit të Futbollit Partizani, dhe se ndërkohë ishin miratuar ndryshimet e ligjit për sportin që nuk lejonin privatizimin e objekteve sportive, konstatohet se kërkesa për dhënie leje për shesh ndërtimi, diskutohet në mbledhjen e datës 28.12.2007, të Këshillit Teknik me nr 43, ku rezultojnë pjesmarrës shtetasit D.Agolli, E.Bonati, Gj.Papavasili, A.Kushi, N.Lilaj, M.Kruja dhe J.Qinami. Në proces verbal janë pasqyruar këto diskutime: ...Objekti 1 – Frida

Kërkohet shesh ndërtimi për objekt 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë në pronë të H.Begeja, N.Bekteshi, N.Kaçurri, K.Kaçurri, S.Begeja, M.Ago, G.Begeja, L.Lika, A.Sulstarva, H.Begeja, E.Begeja, S.Begeja, E.Begeja, J.Malltezi, O.Malltezi, në rr. Frosina Plaku

Sip prone 7818 sipas aktit (9483 m² ose 8048 m² sipas hipotekës sip z. Ndërtimi 3377, 04 m² objekti në 400 m² objekte pa leje që nuk prishen, sip totale 36696 m².

Koef i shfrytëzimit 48.31 %

Koef park 100%

Vërejtjet e juristit të Kadastrës:

1. *Kufiri i pronës me nr. 6/163 pret një objekt 2 kat*
2. *Kufiri i pronës me nr 6/165 pret 2 objekte 1 katëshe*
3. *Të sqarohet pronësia e objektit 2 kat dhe 2 objekteve 1 kat*
4. *Sipas azhornimeve të bëra në vend nga kadastra urbane rezulton se brenda sheshit të ndërtimit ndodhen objekte 5 dhe 7 kat pa leje ndërtimi. Nuk është sjellë asnjë dokument vetëdeklarues sipas ligjit për legalizimin. Gjithashtu objekti 7 kat pa leje ekzistues shkel vijën e ndërtimit të propozuar nga drejt e projekteve të infrastrukturës*

Vërejtjet e urbanistit

1. *Brenda kufirit të pronës ka objekte ekzistuese 5 dhe 7 kat të cilat nuk do prishen por nuk është sqaruar situata në lidhje me distancat, koef i shfryt, truall që futet sërish në kërkesë për leje ndërtimi*
2. *Në veri objekti nuk respekton distancat nga kufiri i pronës apo nga objektet ekzistuese në vend*
3. *Në jug nuk janë marrë parasysh objektet ekzistuese në vend*
4. *Në lindje objekti nuk respekton pikën b të nenit 120 të rregullores së urb*
5. *Volumi 9 kat vjen me objektin ekzistues 5 kat në distancë 1 m². Në projekt nuk sqarohet nëse është ruajtur kallkan faqja e objektit të ri që ballafaqohet me faqen e objektit 5 kat. Objekti 5 kat në këtë faqe ka dritare dhe ballkone.*
6. *Brenda bllokut të propozuar volumet 9 kat nuk respektojnë distancë nga njëri tjetri*
7. *Objekti ekzistues 7 kat shkel vijën e ndërtimit*

MK Teknik

Këshilli teknik mendon të kalojë për diskutim në KRRT kërkesën, me kusht që deri në fazën e kërkesës për leje ndërtimi të sqarohen problemet e ngritura në K.Teknik nga juristë urbanistë.

142.1. Me vendimin nr. 136 datë 29.12.2007 (nr. 25 prot datë 08.01.2008) KRRT II, Këshilli

i Rregullimit të Territorit Bashkia e Tiranës, ka vendosur:

- 1) *Të miratojë studimin urbanistik pjesor në kufijtë e sheshit të ndërtimit të ndodhur në rrugën Frosina Plaku sipas studimit bashkalidhur këtij vendimi*
- 2) *Të miratojë kërkesën për shesh ndërtimi për godinë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë, në rrugën Frosina Plaku në pronë të H.Begeja, N.Bekteshi, N.Kaçurri, K.Kaçurri, S.Begeja, M.Ago, G.Begeja, L.Lika, A.Sulstariva, H.Begeja, E.Begeja, S.Begeja, E.Begeja, L.Çela, S.Kurti, T.Malka, N.Hoxha, R.Beteshi, J.Malltezi, O.Malltezi sipas planimetrisë së sheshit bashkalidhur këtij vendimi.*
- 3) *Të lirohet hapësira e oborrit të brendshëm duke reduktuar volumin dhëmbëzimin e volumit 9 kat në jug.*
- 4) *Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Planit Rregullues dhe Drejtoria e Politikave Urbane për zbatimin e këtij vendimi.*

Bashkalidhur është planimetria e sheshit të ndërtimit të objektit e miratuar nga kryetari i KRRT-së së Bashkisë Tiranë, Edi Rama e cila mban gjithashtu nënshkrimet e: Drejtor i përgjithshëm i urbanistikës Dritan Agolli; drejtori i projekteve të infrastrukturës Muhamet Kruja; urbanisti Frida Dragusha dhe kadastra urbane F.Papuli dhe H.Korbi.

143. Me prokurën e përgjithshme nr 10086 rep nr 1542 kol dt 31.12.2007 para noteres Ruko Sako, të përfaqësuarit *Nervit Hoxha* (përfaqësuar nga *Bashkim Bekteshi*), Rajmonda Bekteshi (përfaqësuar nga *Bashkim Bekteshi*) dhe *Bashkim Bekteshi* emërojnë si përfaqësues të tyre nipin **Jamarbër Malltezi**. I japin tagre për t'u paraqitur para çdo organi shtetëror ose shoq private, çdo pers fizik apo juridik, ZRPP, zyrë noteriale, Agjensia Shtetërore e Pronave, AKKP. **Për pjesën tonë prona ka të drejtë të lidhet me firma ndërtuese, të përcaktojë përqindjen e ndërtimit, të nënshkruajë kontratën e parë që ve në dispozicion të tyre truallin tonë. Përsa i përket kontratave të tjera që të përcaktohet konkretisht pjesa jonë, kontratën e shkëmbimit të truallit do ta nënshkruajmë vetë. I kanë dhënë tagre për paraqitje në gjykatë etj.**

144. Me deklaratën noteriale nr. 10084 rep nr. 1541 kol dt 31.12.2007, shoqëria e ndërtimit Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga shtetasi Fatmir Bektashi si dhe shtetasit *Haki Begeja, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Drita Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiye Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Elona Begeja, Xhimi Begeja, të gjithë të përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi Jamarbër Malltezi, Ilir Kadiu i cili për vehten e tij dhe si përfaqësues me prokurë i Vangjeli Kadiut dhe Manjola Kadiut, përfaqësohet në bazë të prokurës së përgjithshme me nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006 kanë deklaruar se: Me pronarët Begeja është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. 4938/831 datë 22.05.2006 dhe pronarët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me prokurë Jamarbër Malltezi kanë vënë në dispozicion të shoqërisë Kontakt sh.p.k. pronën e tyre, truall me sip të përgjithshme 6345 m², pronë kjo që është klubi i sportit Partizani. Në këtë kontratë është përcaktuar se afati për nxjerrjen e lejes së ndërtimit është deri në datën 22.05.2007. **Meqënëse brenda këtij afati shoqëria Kontakt sh.p.k. për shkaqe të pavarura prej saj (mbasi gjatë kësaj periudhe KRRT e Tiranës nuk funksionoi), nuk e nxori dot lejen e ndërtimit, përfaqësuesi i pronarëve Jamarbër Malltezi, deklaron se në emër të pronarëve që ai përfaqëson, e shtyn këtë afat deri në 11.10.2008. Kjo deklaratë është nënshkruar nga shoqëria Kontakt sh.p.k. e përfaqësuar nga Fatmir Bektashi dhe nga shtetasi Jamarbër Malltezi. Deklarata është nënshkruar para noteres Ruko Sako.***

145. Me kërkesën "Për miratimin e lejes së ndërtimit" Formulari nr. 3, dt 10.01.2008, rezulton se kërkuesi Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga Fatmir Bektashi, ka paraqitur kërkesë Formular nr. 3, për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit të banimit, 5, 7 dhe 9 kat dhe 2

kate parkimi nëntokë në pronësi të familjes Begeja, sip e sheshit 7818 m², sip ndërtimi 36235 m², vëllimi i objektit mbi tokë 81212 m², vlera sipas objektit 1062 mil/lekë, koeficienti i shfrytëzimit të truallit 47.5 %, lartësi e përgjithshme 28.68 m, nr maksimal i kateve mbi tokë 9, nëntokë 2. Objekti është projektuar nga Ark. Arben Hondro. Kjo kërkesë është nënshkruar nga Fatmir Bektashi.

Me kërkesën dt **11.01.2008** shoq Kontakt sh.p.k. me dorëzues shtetasin Fatmir Bektashi, me objekt leje ndërtimi ka dorëzuar prokura të posaçme, deklarata, kontratë sip nr. 5938 rep, shtesë kontrate nr. 8166 rep, vendim gjykate nr. 2107, nr. 4081 dt 15.09.2004, nr. 6368, dëshmi trashëgimie, vendim gjykate nr. 1130, licenca EZ dhe MZ. Marrësi në dorëzim shfaqet pranë Drejtorisë së Politikave Urbane. Përshkrimi i kërkesës është "*Plotësim dokumentacioni*" leja e ndërtimit 07001020. Kjo kërkesë është njëhsuar me origjinalin nga shtetasi Xhimi Begeja, sipas vërtetimit nr. 9/6 dt 17.03.2010.

146. Me prokurën nr 176 rep nr 27 kol dt **14.01.2008** para noteres Ruko Sako, Haki Begeja emëron përfaqësues të tij të birin Xhimi Begeja.

147. Me deklaratën nr. 759 rep nr. 99 kol dt **01.02.2008**, shoq e ndërtimit **Kontakt sh.p.k.** përfaqësuar nga shtetasi Fatmir Bektashi, shtetasit *Haki Begeja, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Hgaxhire Begeja, Drita Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Elona Begeja, Xhimi Begeja*, të gjithë të përfaqësuar me prokurë të posaçme nga shtetasi **Jamarbër Malltezi, Ilir Kadiu** i cili për vehten e tij dhe si përfaqësues me prokurë i *Vangjeli Kadiut dhe Manjola Kadiut*, përfaqësohet në bazë të prokurës së përgjithshme me nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006, kanë deklaruar se: *Me pronarët Begeja është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. 8032/1303 datë 20.07.2006 dhe pronarët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me prokurë Jamarbër Malltezi kanë vënë në dispozicion të shoqërisë Kontakt sh.p.k. pronën e tyre, truall me sip të përgjithshme 6345 m², pronë kjo që është klubi i sportit Partizani.*

*Në mënyrë që shoqëria Kontakt sh.p.k. të bëjë ndërtim bashkëkohor dhe të rrisë në maksimum sip e shfrytëzueshme, pronarët e truallit për veç truallit të përshkruar më sipër, vënë në dispozicion të shoqërisë edhe prona të tjera të tyre të cilat përfshihen brenda njollës së studiuar për ndërtim dhe të regjistruara në ZRPP: Nr. 417 datë 03.07.2007, truall me sip 300 m² pasuria nr. 3/156 vol 15 faqa 182; Nr. 741 datë 11.12.2007, truall me sip 495 m², pasuria nr. 3/162 vol 17 faqa 92; Nr. 443 datë 12.12.2007, truall me sip 470 m², pasuria nr. 3/165 vol 17 faqa 94. Kjo deklaratë është nënshkruar nga shoqëria Kontakt sh.p.k. e përfaqësuar nga **Fatmir Bektashi** dhe nga shtetasi **Jamarbër Malltezi**. Deklarata është nënshkruar para noteres Ruko Sako.*

148. Në mbledhjen e Këshillit Teknik nr. 9 datë **11.02.2008**, ku të pranishëm rezultojnë të kenë qenë shtetasit Dritan Agolli, M. Vishka, E.Punavija (Enton Punavija), E.Bonati, M.Kruja, M.Dhuka, A.Kushi, S.Qato dhe A.Greca, pasqyrohet sa vijon: ...Protokolli E.Dino Pasqyrohet: ...*Objekti 3: Kërkesë për leje ndërtimi për objekt 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë në pronë të fam Begeja, N.Bekteshi, N.Kaçurri, M.Ago, L.Lika, A.Sulstarva, K.Kaçurri, L.Çela, S.Kurti, T.Malka, N.Hoxha, R.Bekteshi, J.Malltezi, O.Malltezi, në rrugën Frosina Plaku.*

Sip e pronës 7818 m² sipas arkitektit; 9483 m² sipas vërtetimit hipotekor ose 8018 m² sip trualli zënë me ndërtime 3377,04, objekt i ri, 400 m² objekt pa leje që nuk prishen. Sip totale ndërt 27000 m² mbi tokë, 9696 m² nëntokë; Koef shfrytëzimi territ 48.31%; Koef parkimeve

100%; Subjekt ndërtues Kontakt.

Frida

M.Dhuka:

Të plotësohen vërejtjet që kanë të bëjnë me pronën. Objektet që i pret kufiri i pronës në veri nuk mund të prishen pjesërisht. Nëse janë pa leje duhet të vendosim t'i prishim

Të verifikohen objektet që ndodhen pjesërisht brenda pronës dhe pjesërisht jashtë saj. Të shprehen në lidhje me prishjen e tyre

Çfarë zone është zona ku ndërtohet

Frida: Zona ka qenë sportive. I është ndryshuar destinacioni nga zonë sportive në zonë banimi.

Ariela: Objektet në veri kanë qenë ndërmarrje

M. Dhuka: Objektet në veri janë ndërmarrje që mund të privatizohen. Nuk mund të japim leje ndërtimi.

Agolli: Të verifikohen çështjet e mësipërme.

149. Më datë 18.02.2008 konstatohet se lidhet një akt marrëveshje "Për pjesmarrje në investim ndërtimi të "Kompleksit Begeja 3000" me nr 476 rep nr 277 kol dt 18.02.2008, para noteres Laura Pustina, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi. Sipas nenit 1 të kësaj akt marrëveshje, objekti i saj, është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet investitorëve të cilët kanë rënë dakord të bashkohen sipas raporteve dhe kushteve të caktuara në dispozitat në vijim për të financuar ndërtimin e kompleksit shumëfunksional me emërtimin "Kompleksi Begeja 3000" i cili do të ndërtohet në pronëtrual të familjes Begeja me të dhënat si më poshtë:

Pas nr 3/138 vol 15 faqa 55 ZK 8220 sip 3122 m2, regj hip nr 74 datë 21.03.2007 me adresë rruga Frosina Plaku, Tiranë...; Pas nr 2/325 vol 15 faqa 181 ZK 8220 sip 380 m2, regj hip nr 417 datë 03.07.2007 me adresë rruga Frosina Plaku, Tiranë...; Pas nr 3/162 vol 17 faqa 91 ZK 8220 sip 190 m2, regj hip nr 740 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...; Pas nr 6/164 vol 17 faqa 93 ZK 8220 sip 210 m2, regj hip nr 742 datë 11.12.2007 me adresë rruga Frosina Plaku, Tiranë...; Pas nr 3/166 vol 17 faqa 95 ZK 8220 sip 27 m2, regj hip nr 745 datë 12.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...

Sipas n 2, të drejtat dhe detyrimet ndërmjet ndërtuesit dhe pronarëve të truallit do të rregullohen me akt të veçantë të hartuar dhe nënshkruar midis ndërtuesit dhe pronarëve të truallit.

Neni 3 "Pjesëmarrja në investim" parashikon:

3.1. Kapitali total i parashikuar për realizimin e ndërtimit dhe investimit është në vlerën **3 972 400 Euro** për Kompleksin Begeja 3000. Ky kapital, do të investohet nga investitorët në sasi të dhe afatet e përcaktuara në këtë dispozitë dhe përfshin: Shpenzimet e ndërtimit dhe të investimit, duke filluar me azhurnimin e truallit, realizimin e projektit, ndërtimin, taksat, etj., deri në mbylljen e aktivitetit financiar sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

3.2. Investitorët bien dakord që për realizimin e vlerës totale të mësipërme të kontribuojnë me këto raporte: Jamarbër Malltezi-35% të vlerës totale; Xhimi Begeja-25% të vlerës totale; Fatmir Bektashi -40% të vlerës totale.

3.3. Kontributi i secilit investitor, sipas raporteve të caktuara në këtë Akt-Marrëveshje, do të depozitohet në numrin e llogarisë të hapur nga ndërtuesi posaçërisht për këtë qëllim. Investitorët duhet të derdhin pjesën e tyre takuese sipas fazave të mëposhtme:

Faza e parë: Paguesa e shpenzimeve administrative dhe ato të projektimit, sipas afateve të parashikuara në kontratën/at e projektimit të secilit kompleks

Faza e dytë: Paguesa e taksës lokale, përpara zbardhjes së lejes së ndërtimit nga Bashkia për secilin kompleks.

Faza e tretë: Pagesa e paradhënies, për shpenzimin e ngritjes së kantierit prej 1.5% të investimit respektiv për secilin kompleks.

Si edhe në vazhdimësi, **depozitimin çdo muaj** të kontributit takues të secilit investitor, i cili llogaritet në bazë të shpenzimeve të kryera nga ndërtuesi atë muaj dhe arkëtimeve të realizuara nga shitja e sipërfaqeve ndërtimore.

3.4. *Ndërtuesi i paraqet investitorëve brenda 5 (pesë) të çdo muaji situacionin mujor të aprovuar nga mbikqyrësi i punimeve dhe miratuar nga eksperti kontabël i autorizuar, me të cilin vërtetohet se punimet janë kryer në pëpruthje me projektin, dokumentacionin bashkëngjitur saj dhe shpenzimet e përcaktuara për këtë fazë punimesh. Situacionit mujor i bashkëngjiten dhe proces verbalet e hartuara në bazë të kushteve teknike të zbatimit të nënshruara nga ndërtuesi dhe mbikqyrësi i punimeve.*

3.5. *Secili prej investitorëve depoziton kontributin tij takues në llogarinë bankare brenda datës 20 (Njëzetë) të po atij muaji.*

3.6. *Në mbarim të afatit të përcaktuar në pikën 3.5, nëse ndonjëri prej investitorëve nuk depoziton detyrimin e tij, atëherë ky detyrim i pashlyer do të shlyhet automatikisht prej investitorëve të tjerë, duke ruajtur raportet midis tyre, përveç rastit kur me deklaram me shkrim para Noterit është vendosur ndryshe.*

3.7. *Në varësi nga veprimet e kryera, sipas pikës 3.6, do të ndryshojë automatikisht edhe raporti në përqindje i dividendit të fitimeve të realizuar nga ky investim.*

Dividenti = % e investimit të investitorit – Situacioni mujor – arkëtime mujore. Totali i parashikuar i investimit.

Investitori që nuk shlyen detyrimin në afatin e përcaktuar në pikën 3.5 nuk ka të drejtë të rimbursojë në muajt pasardhës ata investitorë që kanë përmbushur detyrimin e pashlyer të tij. Proces verbali që do të pasqyrojë ndryshimet e dividendit, hartohet nga eksperti kontabël i autorizuar dhe së bashku me dokumentat e pikës 3.6 dhe dokumentat financiarë që vërtetojnë pagimin e detyrimit të prapambetur, hyn në fuqi automatikisht dhe në mënyrë të menjëhershme duke u bërë pjesë integrale e kësaj akt marrëveshje, me fuqi detyruese ndaj Investitorëve, duke revokuar çdo element tjetër të kësaj Akt Marrëveshje apo atki tjetër që rrjedh prej saj, që bie në kundërshtim me të.

3.8. *Kapitalet e depozituara nga investitorët në përputhje me këtë dispozitë, do të përdoren nga ndërtuesi vetëm për realizimin e objektit të kësaj akt marrëveshje, në përputhje me legjislacionin fiskal e tatimor në fuqi, në momentin kur këto kapitale duhen përdorur.*

...Neni 4 Eksperti kontabël i autorizuar dhe/ose konsulenti financiar

4.1. *Sigurimi i rregullshmërisë dhe ligshmërisë së përdorimit të fondeve nga ana e ndërtuesit, në përputhje me pikën 3.8 të kësaj akt marrëveshje, realizohet nga një ekspert kontabël i autorizuar/konsulenti financiar.*

4.2. *Eksperti kontabël i autorizuar zgjidhet një subjekt i cili nuk ka konflikt interesi me investitorët dhe ndërtuesin. Ai kontraktohet prej investitorëve me një kontratë të veçantë ku përcaktohen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrat e tij, të cilat nuk mund të çenojnë në ansjë mënyrë atributet e dhëna me këtë akt marrëveshje, përndryshe kontrata në fjalë do të jetë e pavlefshme.*

4.3. *Pagesa e ekspertimit kontabël të autorizuar/konsulenti financiar do të bëhet nga investitorët në përputhje me pikën 3.2 eventualisht të ndryshuar me pikën 3.7 të kësaj akt marrëveshje.*

4.4. *Eksperti kontabël i autorizuar/konsulenti financiar mund të largohet nga funksionet, me miratimin e dhënë nga 2/3 e investitorëve.*

Neni 5 Mbikqyrësi i punimeve

5.1. Kontrollimi dhe supervizimi i punimeve të realizuara nga ndërtuesi realizohet nga mbikqyrësi i punimeve i kontraktuar nga investitorët me anë të një kontrate të veçantë, ...

...5.3. Pagesa e mbikqyrësit të punimeve do të bëhet nga investitorët në përputhje me pikën 3.2 eventualisht të ndryshuar me pikën 3.7 të kësaj akt marrëveshje.

5.4. Mbikqyrësi i punimeve përveç të drejtave që do t'i përcaktohen në kontratën e hartuar sipas pikës 5.1, ka të drejtë të bëjë pezullimin e punimeve, të vendosë gjoba për punimet me cilësi të dobët, dhe të ndryshojë skemën organizative të ndërtuesit, të kontrollojë respektimin e afateve, sasinë dhe volumet e punimeve si dhe cilësinë e lëndëve të para...

...Neni 6 **Subjekti ndërtues**

6.1. Subjekti që do të realizojë ndërtimin është shoqëria **Kontakt sh.p.k.**..., marrëdhënia e të cilit me investitorët do të rregullohet në mënyrë të detajuar me një kontratë të veçantë, kontratë kjo që nuk do të çënojë rregullimet e përgjithshme të bëra në këtë akt marrëveshje...

Neni 8 **Përfundimi i punimeve**

I gjithë cikli i ndërtimit të "Kompleksit Begeja 3000" do të përfundojë brenda 24 muajve nga fillimi i punimeve. Punimi do të cilësohet i përfunduar kur Kompleksi Begeja 3000 të jetë dorëzuar me aktin e marrjes në dorëzim.

...Neni 9 **Investitorët e rinj**

9.1. Me marrëveshje unanime me shkrim të gjithë investitorëve të kësaj akt marrëveshje, mund të pranohen edhe investitorë të tjerë gjatë realizimit të investimit

9.2. Marrëveshja sipas pikës 9.1 i bashkangjitet kësaj akt marrëveshje...

...Neni 11 **Çmimi i shitjes dhe pronësia e objektit**

11.1. Çmimi i shitjes për m² ose për njësi i të gjitha ambjenteve të Kompleksit Begeja 3000 që janë Pjesë takuese e investitorëve do të përcaktohet me miratimin me shkrim dhe noterial të jo më pak se 2/3 të investitorëve.

"Pjesa takuese e investitorëve" sipas kësaj pike është diferenca midis tërësisë së ambjenteve të Kompleksit Begeja 3000 dhe pjesës takuese të pronarëve të truallit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes të lidhur ndërmjet subjektit ndërtues dhe pronarëve të truallit, ...

Neni 18 **Dokumentat që i bashkangjiten akt marrëveshjes**

...Marrëveshja e kontraktimit ndërmjet përfaqësuesi të investitorit z. Fatmir Bektashi dhe pronarëve të trojeve e dt. 22.05.2006 me nr 4938 rep nr 831 kol dhe shtojcat e saj...

Neni 19 **Nënshkrimi i akt marrëveshjes**

...19.2. Kjo akt marrëveshje pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnet të plotë dhe të lirë të palëve në praninë e noterit sot më datë 18.02.2008.

Neni 20. **Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit rregullisht prej palëve nënshkruese të saj.

149.1. Me nr 477 rep nr 278 kol datë **18.02.2008** miratohet sërish e njëjta akt marrëveshje, ndërmjet të tre shtetasve, Jamarbër Mallezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, por tashmë Kompleksi quhet **Begeja 6000** dhe pasuritë e cituara janë:

Pas nr 3/167 vol 17 faqa 96 ZK 8220 sip 6318 m², regj hip nr 744 datë 12.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...; Pas nr 6/165 vol 17 faqa 94 ZK 8220 sip 470 m², regj hip nr 743 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...; Pas nr 3/163 vol 17 faqa 92 ZK 8220 sip 495 m², regj hip nr 741 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...; Pas nr

3/156 vol 15 faqa 182 ZK 8220 sip 300 m2, regj hip nr 417 datë 03.07.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda, Tiranë...

Me shkrim dore është shënuar shifra 5, por nuk është renditur ndonjë pasuri

...Neni 3 "Pjesëmarrja në investim" parashikon:

3.1. Kapitali total i parashikuar për realizimin e ndërtimit dhe investimit është në vlerën 9 157 354 Euro për Kompleksin Begeja 6000....

...Neni 18 Dokumentat që i bashkangjiten akt marrëveshjes

...Marrëveshja e kontraktimit ndërmjet përfaqësuesi të investitorit z. Fatmir Bektashi dhe pronarëve të trojeve e dt. 22.05.2006 me nr 4938 rep nr 831 kol dhe shtojcat e saj...

Neni 19 Nënshkrimi i akt marrëveshjes

...19.2. Kjo akt marrëveshje pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnet të plotë dhe të lirë të palëve në praninë e noterit sot më datë 18.02.2008.

Neni 20. Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit rregullisht prej palëve nënshkruese të saj.

149.2. Konstatohet se rreth muajit mars 2008 pasur parasysh edhe marrëveshjet e investimit të datës 18.02.2008, përgatiten akte për caktimin e ekspertit që do mbante përlllogaritjet në lidhjet me investimet dhe normalisht edhe fitimet. Kështu nga të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit të hard drive-it të sekuestruar tek Studio Pustina, rezulton të evidentohet një dokument në formatin Word, i emërtuar si "KONTRATA_POROSIE.EKA.final version Homeplan" që pasqyron përpilimin e një kontratë porosie shërbimi financiar, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhemal Begeja dhe Fatmir Bektashi, me cilësinë e Porositësve dhe i porosituri është lënë pa plotësuar. Në këtë kontratë, parashtrohet se, porositësi është subjekt që po financon ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional dhe ka kontraktuar shoqërinë ndërtuese Kontakt sh.p.k. për realizimin e këtij ndërtimi. Në kuadër të kësaj veprimtarie, porositësi shpreh vullnetin e tij, të kontraktojë të porositurin me cilësinë e ekspertit kontabël të autorizuar/konsulent financiar, me qëllim kontrollimin e aktivitetit financiar të shoqërisë ndërtuese në realizimin e ndërtimit të financuar prej porositësit dhe rregullimin e marrëdhënieve midis vetë personave që përbëjnë porositësin.

Konkretisht në nenin 2 "Objekti i kontratës" së dokumentit të sipërcituar është parashtruar: Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis Porositësit dhe Të Porositurit në plotësimin e detyrimeve që Porosituri ka marrë përsipër me anë të kësaj kontrate e cila konsiston në (këtu gjendet një shënim i datës 13.03.2008 me autor staffl si vijon: "Plotësoni objektin e veprimtarisë së EKA, është pika më e rrëndësishme. DETAJOJENI"):

- kontrollimin e ligshmërisë së përdorimit të fondeve nga ana e shoqërisë ndërtuese,
- kontrollimin e shpenzimeve të shoqërisë ndërtuese që lidhen me realizimin e kompleksit shumëfunksional,
- të hartimit të "proces-verbalit të ndryshimit të dividendëve" sipas pikës 3.7 të Marveshjes së Bashkëinvestimit me Nr. ___ Rep. dhe Nr. ___ Kol., dt. _____

Ndërkohë në nenin 4 "Të drejtat dhe detyrimet e të porositurit" është parashikuar:

4.12. I Porosituri ka detyrimin që nën përgjegjësinë e tij personale dhe profesionale të hartojë "proces-verbalit e ndryshimit të dividendëve" sipas pikës 3.7 të Akt-Marveshjes së Bashkëinvestimit me Nr. ___ Rep. dhe Nr. ___ Kol., dt. _____, duke mbajtur parasysh rregullimet e kësaj Akt-Marveshje.

Në nenin 4 " Të drejtat dhe detyrimet e të porositurit " është parashtruar:

...4.2. I Porosituri ka të drejtën dhe detyrën të kontrollojë nën përgjegjësinë e tij personale dhe profesionale aktivitetin financiar të shoqërisë investitore dhe asaj ndërtuese me synim kontrollimin e përdorimit të financimeve të dhëna nga Porositësi për ndërtimin e kompleksit shumëfunksional. Në kuadër të kësaj të drejte dhe detyre, i Porosituri duhet:

- të verifikojë rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e faturave të blerjes së materialeve dhe shërbimeve të nevojshme për ndërtimin e kompleksit.
- të verifikoj rregullshmërinë dhe vlerën e pagave dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore të punësuarve për ndërtimin e kompleksit si dhe numrin total dhe pozicionet e punonjësve në bazë të kontratëve të punës. (nuk besoj se është e nevojshme pasi kontrolli i pagave të personelit të KONTAKT- do të bëhet nepermjet verifikimit të zerave të situacioneve mujore të punimeve)
- të kontrollojë dhe verifikojë mbajtjen nga ana e shoqërisë ndërtuese të librave kontabël sipas kërkesave të legjislacionit fiskal në fuqi. (Idem sa me sipër)
- të verifikoj rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e faturave të pagesave të nënkontraktorëve, të detyrimeve ndaj shtetit (taksa, tatime etj.)

të kontrollojë rregullshmërinë e mbledhjes të të ardhurave nga shitjet e ambienteve pjesë takuese e Porositësit (këtu gjendet një koment I datës 13.03.2008 me autor staff1 si vijon: Plotësoni nëse gjykoni nëse duhen edhe më.").

149.3. Shoqëria Kontakt sh.p.k. paraqet kërkesën për leje ndërtimi pjesore nr. 0221/1 prot datë 21.02.2008, duke pasqyruar se ka kërkuar leje ndërtimi në truallin pronë e familjes Begeja, me dosja; 07001020 me nr prot K – 4250. Pronarët e truallit, familja Begeja, për shkak se megjithëse janë pronarë të tokës, duhet të privatizojnë edhe objektet shtetërore të ndodhura mbi tokën e tyre, proces të cilin sipas informacionit që kemi sjellë e kanë filluar dhe e përfundojnë më datë 05.03.2008, si firmë ndërtimi, janë dakord që Bashkia të miratojë lejen e ndërtimit për fazën A, sipas skicës bashkangjitur. Me përfundimin e procesit të privatizimit do të bashkëpunojnë përsëri për lejen e ndërtimit në fazën B. Kërkesa është nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi.

149.4. Sa më sipër, evidentohet se para përfundimit të procedurave të privatizimit, tre shtetasit e sipërcituar, Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, formalizojnë marrëveshjen e tyre për hyrjen në këtë sipërmarrje të përbashkët. Për të mbajtur nën mbikqyrjen llogaritë dhe nxjerrjen e përfitimit të padrejtë (pasi siç u vërtetua nuk është bërë asnjë investim nga shtetasi Jamarbër Malltezi përveç një shume rreth 45 000 euro), shtetësja Argita Malltezi duket se ka qenë në dijeni dhe ka ofruar garanci duke caktuar studion Pustina, si mbikqyrëse të aktivitetit që zhvillohet se bashku me bashkeshortin e vet shtetasin Jamarber Malltezi. Gjithashtu rezulton nga tërësia e akteve se, familja Berisha ka qenë plotësisht e angazhuar në lidhje me pronat ku janë zhvilluar ndërtimet. Kështu në një dokument të sekuestruar pranë studio Pustina, të dërguar nga shtetasi Xhimi Begeja më datë 23.11.2022, ndër të tjera ky i fundit është shprehur: "...Ju besova verbërisht sepse Gita dhe Abi më garantuan qysh ditën e parë ku studio e e juaj të jetë garantuesja ligjore dhe financiare në marrëveshjet e kontratat tona, ndaj dhe unë për kaq e kaq vite nuk i besova tjetër kujt përveç jush. Nuk kam qenë pengesë në asnjë moment të firmosja vetëm "letër të bardhë" sepse e konsideroja veten turp në qoftë se nuk do ju besoja. Kam përshtypjen se ajo Gocë e Familjes nuk ka pas dhe as ka dijeni për situatën e krijuar tani mes nesh. Unë nuk e kam shqetësuar dhe nuk do e shqetësoj kurrë për hallin e madh që ka zënë, por aq më tepër i kemi borxh të madh Familjes Berisha për shqetësimet që i kemi sjellë ku shkaktare është prona jonë..."

149.5. Në proces verbalin e Këshillit Teknik nr. 17 datë 22.02.2008 pasqyrohet pjesmarrja e:

shtetasve Dritan Agolli, Kujtim Spahiu, Enkeleda Bonati, Sonila Qato, Migena Vishka, Ariela Kushi, Muhamet Kruja, Majlinda Dhuka dhe Adelina Greca. ...Protokolli E.Dino

Pasqyrohet në objektin 3: *Kërkesë për leje ndërtimi për godinë banimi dhe shërbimesh 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë në rrugën Frosina Plaku, në pronësi të H.Begea, N.Bekteshi, N.Kaçurri, K.Kaçurri, S.Begeja, M.Ago, G.Begeja, L.Lika, A.Sulstarova, H.Begeja, E.Begeja, S.Begeja, E.Begeja, L.Çela, S.Kurti, T.Malka, N.Hoxha, R.Bekteshi, J.Malltezi, O.Malltezi.*
Subjekti ndërtues Kontakt

Majlinda: *Sheshi është i miartuar, nuk ka përse vjen një kërkesë e re për shesh ndërtimi. Ndërtimi mund të bëhet me fazë.*

E.Bonati: *Janë plotësuar vërejtjet e Këshillit Teknik nr. 9? Ky objekt që në fazën e sheshit ka patur vërejtje të cilat duhet të plotësoheshin para se të vinte për leje ndërtimi.*

Meti: *Sa është pjesërrësia e terrenit?*

Frida: *Rreth 1 m.*

Meti: *Parkimi është i veçantë për çdo fazë?*

Frida: *Parkimi është paraqitur për të gjithë bllokun.*

E.Bonati: *Projekti të vijë vetëm për korpusin që do të ndërtohet në fazën e parë.*

Adelina: *Të lehtësohet, të zbrazet volumetria e objekteve në jug duke u kompensuar në pjesën veriore që është në ballin e rrugës. Në këtë mënyrë shmanget përballja me objektet në jug.*

Ariela: *Për mua problem përbën rruga në lindje e cila përfundon tek klubi Partizani.*

Majlinda: *Të reduktohet volumi 9 kat në jug për të shmangur përballjen e objektin 6 kat në jug dhe objektin e vet në perëndim*

Meti: *Në fazën e studimit dhe sheshit i është lënë si vërejtje që të trajtohet rrjeti i bllokut. Të sillet skema e rrjetit rrugor.*

Sonila: *Këshilli teknik mendon të plotësohen vërejtjet e mësipërme. Këshilli Teknik miraton kërkesën (kalon për miratim në KRRT) për leje ndërtimi me vërejtjet.*

Miratohet

Lida

150. Sjellim në vëmendje se shtetasi Enton Punavija, rezulton të jetë nipi i kolonel Bashkim Punavija, specialist auditi në drejtorinë e auditit në MM, i cili në kohën kur Ministër Mbrojtje ka qenë shtetësja Mimi Kodheli është ngarkuar të ushtrojë një audit, në lidhje me këtë procedurë.

Shtetasi *Enton Punavija*, evidentohet si një person që përfshihet në vijimësi pikërisht në lidhje me ndërtimin e objekteve që kanë marrë jetë fillimisht nga këto leje ndërtimi që trajtohen në këto momente. Ky shtetas, në vijim, shfaqet në marrëdhënie të ngushta me shtetasin Fatmir Bektashi. Kështu më datë 21.02.2012 e në vijim gjenden Emaile të shkëmbyera ndërmjet shoq Albatlas Travel Agency dhe shtetasve **Fatmir Bektashi, Ardit Bektashi, Enton Punavija** (ky i fundit me email enton.punavija@kontakt.al) në lidhje me një udhëtim në këtë muaj, me qëllim që të arrijnë në Amsterdamb më datë 27 në mënyrë që më datë 28 të organizojnë një panair. Shtetasi Enton deklaroi se do të udhëtojë me bashkëshorten, Nadën.

Nga aktet, rezulton se me kontratën e sipërmarrjes datë 16.02.2011 (shkruar me shkrim dore 414 kol datë 16.02.2011) të lidhur ndërmjet shoq **Homeplan** sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasve Enton Punavija dhe Nada Zeqja, parashtrohet se sipërmarrësi po ndërton kompleksin Homeplan, me 9 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë në rruga Frosina Plaku...Porositësit janë subjekte të interesuar të cilët dëshirojnë dhe shprehin vullnetin të porosisin ndërtimin ap nr 352 me sip 127.3 m2, **Homeplan 3**. Çmimi i përgjithshëm i shitjes

është 88 219 euro dhe pagesa do të bëhet në këtë mënyrë: **83 809 euro do të paguhen me lidhjes e kontratës së sipërmarrjes në llogarinë bankare të sipërmarrësit dhe 4 410 euro me dorëzimin e hipotekës.** Objekti do të dorëzohet më datë 30.09.2011. Bashkëlidhur kësaj kontrate gjenden pagesat që dokumentohen: *më datë 26.02.2011 në shumën 20 000 euro, datë 21.02.2011 në shumën 10 000 euro, datë 16.03.2011 në shumën 30 000 euro, datë 13.07.2011 në shumën 10 000 euro, datë 22.08.2011 në shumën 5 000 euro, datë 23.08.2011 në shumën 5 000 euro.* Pagesa e fundit është evidentuar: *Mandat Arkëtimi Nr. 125, datë 07.08.2012 i nënshkruar nga shtetasja Suzana Aliaj, "Enton Punavija kësti i fundit dhe hipoteka 252" paguar shuma 8,219 Euro.*

Në dokumentin e datës 28.03.2013, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012,* konstatohen lëvizjet me përshkrim ndër të tjera: *Mandat Arkëtimi nr. 125 datë 07.08.2012 në shumën 8,219 euro me përshkrimin "Enton Punavija kësti dhe hip ap. 352 dhe Mandat Pagease nr. 129 datë 07.08.2012 në shumën 8,219 euro me përshkrimin "Kontakt Shpk Ap. 352".*

Me kontratën e shkëmbimit nr 400 prot datë 23.02.2011, "*Kontratë sipërmarrje*", janë paraqitur palët: *Shoq Homeplan sh.p.k. si sipërmarrës dhe Enton Punavija dhe Nada Zeqja si porositës, në lidhje me porositjen e... Apartamentit nr 352 me sip 127.3 m2 Homeplan 3. Neni 13 parashikon se...Çmimi i përgjithshëm i shitjes së ap nr 352 është 88 219 euro. Në çmimin e përgjithshëm të shitjes përfshihet çmimi i kalimit në pronësi mbas ndërtimit...Pagesa do të bëhet në këtë mënyrë: 83 809 euro do të paguhen me lidhjen e kontratës së sip në llogarinë bankare të sipërmarrësit dhe 4 410 euro me dorëzimin e hipotekës.....*

Me anë të kontratës së shitblerjes Nr. 838 Rep, Nr.414 Kol, datë **08.05.2015** shtetasit Enton Punavija dhe Nada Zeqja, kanë blerë nga shoqëria Homeplan shpk, apartament me Nr. 3/201+3-26, zk.8220, me sipërfaqe 115.3 m2 të ndodhur në Rrugën Frosina Plaku, në katin e 5 të Godinës 9 katëshe, shkalla Nr. 3 Tiranë. Palët kanë rënë dakort që çmimi i shitjes së pasurisë së paluajtshme të jetë në total në shumën 88,219 Euro. Palët deklarojnë se ky çmim është paguar totalisht nga blerësi para lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka pretendime për të.

I pyetur përgjatë këtij hetimi, shtetasi **Enton Punavija**, ka deklaruar se, *ka filluar punë në Bashkinë Tiranë në vitin 2000 në pozicionin e specialistit në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, më pas në vitin 2003 u krijua Drejtoria e Transportit pranë Bashkisë Tiranë dhe aty u emërua Drejtor i kësaj Drejtorie. Ka vijuar punën pranë kësaj Drejtorie deri në vitin 2011 ku është larguar me dorëheqje. Për periudhën kohore 2011-2016 ka punuar privat duke ofruar konsulencë për subjekte të ndryshme në fushën e transportit dhe sinjalistikës rrugore, sistemet inteligjente të transportit për menaxhimin e trafikut etj. Në mars të vitit 2016 është rikthyer përsëri në Bashkinë Tiranë po në të njëjtin pozicion pune që kishte mbajtur dhe vite më parë, pra atë të Drejtorit të Transportit ku vijon të jetë dhe aktualisht.*

Në lidhje me shtetasin Fatmir Bektashi, deklaroi se e njeh, mund ta ketë takuar në vitet 2004-2006 për shkak të punës, por dhe më vonë ka mbajtur kontakte me këtë shtetas. Me këtë shtetas vitet e fundit nuk komunikoi shumë shpesh. Në lidhje me porositjen e apartamentit pretendon se

ka kontaktuar me shtetasin Fatmir Bektashi, pasi është interesuar edhe në disa vende të tjera për blerje banese. Ka shkuar fizikisht në objektin që po bëhej ndërtimi nga firma Kontakt, pallati ka qënë pjesërisht i ndërtuar dhe shtetasi Fatmir Bektashi i tregoi planimetrinë e apartamenteve që i kishte të pa shitura. Nuk ishte zgjidhja më e mirë, por në atë periudhë ai i kishin kushtet për të përballuar. Çmimi për të cilin ranë dakort mesa kujtoj ishte 780 Euro/

m2, ballkoni mesa kujton ishte me gjysëm çmimi dhe totali i duket se shkoi 88,000 Euro. Pagesa është kryer në disa këste nga 2011 dhe në vijim, kryesisht me bankë. Mandat pagesat duhet të jenë në kontratën e shitjes që është lidhur me shoqërinë Homeplan shpk. Të ardhurat që janë përdorur për të paguar apartamentin kanë qënë nga burime të ndryshme disa nga kursimet familjare të cilat i kanë mbledhur nga rroga ai dhe bashkëshortja e tij që që ka punuar pranë Raiffeisen Bank, një pjesë e kanë marrë borxh dhe më vonë në vitin 2013-2014 bashkëshortja e tij ka marrë një kredi pranë Raiffeisen Bank për të mbuluar pagesat. Pra shuma nuk është paguar në një total dhe janë sajuar deri në momentin që është shlyer pagesa totale. Në vitin 2015 kur është lidhur kontrata e shitblerjes vlera e apartamentit ka qënë totalisht e shlyer.

Bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes janë evidentuar pagesat për shtetasin Enton Punavija, ku për këstin e fundit, si më lart theksuar, është pasqyruar Mandat Arkëtimi Nr. 125, datë 07.08.2012 i nënshkruar nga shtetasja Suzana Aliaj, "Enton Punavija kësti i fundit dhe hipoteka 252" paguar shuma 8,219 Euro. Në dokumentin e datës 28.03.2013, me përshkrimin "Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012, në lidhje me këtë mandat arkëtimi konstatohet se evidentohet dhe Mandat Pagese nr. 129 datë 07.08.2012 në shumën 8,219 euro me përshkrimin "Kontakt Shpk Ap. 352". Për më tepër, nga të dhënat e ekstraktuara nga ekspertimet, konstatohet se shuma prej 8219 euro vijon të transportohet edhe në vitin 2017 si parapagim i Homeplanit për këtë objekt, njësoj siç shfaqet gjithë shuma e apartamentit të shtetasit Marin Biçoku, i cili siç rezultoi nga hetimi nuk ka bërë ndonjë pagesë për apartamentin.

Në dokumentin e ekstraktuar nga hard drive-i i sekuestruar pranë studio Pustina me emërtimin 'Raport shitjes_Homeplan_2014_JK44(1) në formatin excel konstatohet se ndërsa pagesa për shtetasin Marin Biçoku me përshkrim në kllapa (palë pronare), pasqyron në rubrikën e % së paguar si =DIV/0! dhe në mënyrën e pagesës nuk është bërë asnjë shënim, për shtetasin Enton Punavija është pasqyruar se është bërë pagesa por, në rubrikën se si janë bërë këto pagesa, ndërsa për një pjesë të qytetarëve pasqyrohet numri i kësteve për shtetasin Enton Punavija është bërë shënimi "mix".

Në dokumentin "Arkëtime klientë (3)" në formatin excel pasqyron arkëtimet për shtetasin Enton Punavija gjithsej në vlerën 80 000 euro, të kryera të gjitha në vitin 2011, ndërkohë që në vitet në vijim nuk rezultojnë më arkëtime në lidhje me apartamentin. Madje viti 215 lind me detyrimin 8 219 euro si debi.

Në dokumentin e ekstraktuar nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, në formatin excel me emërtimin "Pasqyra shpjeguese 2015_VSI" shuma prej 8 219 euro për shtetasin Enton Punavija, vijon të raportohet si debi ndaj shoqërisë Homeplan sh.p.k. Gjithashtu edhe në dokumentin e ekstraktuar sërish nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, "Raport shitjesh_Homeplan_2011_JK 52 (1)" rezulton se gjenden shënimet për shtetasin Enton Punavija ku është pasqyruar, arkëtim 80 000 euro dhe shënimi në diferencë "0 - OK". Po në këtë dokument në fakt gjenden edhe shënime për shtetasin Marin Biçoku ku për këtë shtetas nga gjithë vlera e apartamentit prej 62 302.5 euro është bërë shënimi tek arkëtimi '0' dhe diferenca "0-ok".

Në ndërthurje të të dhënave të administruara rezulton pra, se shuma prej 8 219 euro në të vërtetë nuk është paguar nga shtetasi Enton Punavija. Për më tepër, shtetasi Enton Punavija pretendon ka kryer shlyerje të këtij apartamenti nëpërmjet një kredie të marrë në vitet 2013 – 2014 kur ndërkohë nga aktet kjo pagesë pasqyrohet e kryer në vitin 2012.

Gjithashtu rezulton se në vitin 2021, shtetasit Enton Punavija dhe Nada Punavija kanë lidhur kontratë sipërmarrje (për prenotim garazhi) Nr.4226 Prot, datë **12.08.2021 me shoqërinë e thjeshtë Kontakt shpk dhe Magnet Imo shpk**. Objekti i kësaj kontrate është porosia e një garazhi me Nr. 10080, me sipërfaqe të përgjithshme 28.4 m², me sipërfaqe individuale 15.8 m² të ndodhur në katin -1 nëntokë të të objekteve Ursa dhe Leo në rrugën Frosina Plaku. Çmimi i përgjithshëm i shitjes së Garazhit është **14,000 Euro nga të cilat 4000 Euro do të paguhen me nënshkrimin e kontratës së porosisë dhe 10,000 Euro deri më datë 31.03.2022**.

Bashkëlidhur gjenden të pasqyruara dy veprime bankare një i datës 24.08.2021 ku është kryer pagesa prej 4,000 Euro me përshkrimin "Kontratë sipërmarrje prenotim Garazhd Enton Punavija, Nada Punavija" dhe pagesa e datës 14.06.2022 prej 10,000 Euro me përshkrimin "Transfertë në mbërritje, kësti përfundimtar sipas kontratës së sipërmarrjes".

Kontrata e shitjes për garazhin e sipërcituar është lidhur më datë 22.11.2023 sipas kontratës Nr.3507 Rep, Nr.2912 Kol me palë shitëse shoqërinë Kontakt shpk dhe palë blerëse shtetasit Enton dhe Nada Punavija. Objekti i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë nëpërmjet shitjes së pasurisë Nr. 3/506-G254, pasuri e llojit garazh me sipërfaqe 15.08 m². Palët sipas kontratës së sipërmarrjes kanë rënë dakort që çmimi i shitjes të jetë 14,000 Euro, çmim për të cilin palët deklarojnë se është paguar totalisht dhe rregullisht në rrugë bankare para lidhjes së kësaj kontrate, bazuar në kontratën e sipërmarrjes.

I pyetur përgjatë këtij hetimi, shtetasi *Enton Punavija*, ka deklaruar se, *para një viti e gjysëm ka blerë dhe një garazhd nga firma Kontakt shpk, po në kompleksin Homeplan, por jo në të njëjtin pallat ku ka apartamentin. Garazhdin e ka blerë për shumën 14,000 Euro, ku 70% e vlerës është mbuluar me kredinë që kanë marrë së bashku me bashkëshorten tek Raiffeisen Bank dhe 30% e vlerës ka qënë nga kursimet e përbashkëta.*

Me një dokument të gjendur në studio Pustina me emërtimin "*Homeplan 2014 Analizë*" dt *17.10.2014 a01-a01z dt 01.01.2014 – 30.09.2014*" evidentohet se shtetasit Enton Punavija i janë dhënë si kontribut patriotik shuma prej 15 000 euro, që konstatohet se përputhet me vlerën e garazhit të sipërcituar. Konkretisht në këtë dokument janë pasqyruar mandate arkëtimi nga data 18.04.2014 deri në 04.08.2014 me shuma nga 2 000 euro përveç një mandati që është 5 000 euro. Në dokumentin dt 07.10.2014, me përshkrimin "*HOMEPLAN 2014 – Analizë*", të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën euro, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2014 – 30.09.2014, ku ndër të tjera konstatohen shënimet në lidhje me kontributin patriotik të dhënë shtetasit Enton Punavija të cilat përputhen edhe me të dhënat e gjendura në tabelën e sekuestruar me proces verbalin datë 28.04.2023 sekuestruar pranë studio Pustina, me emërtimin "*Pagesa cash për Homeplan*".

I pyetur në lidhje me shënimet e mësipërme, shtetasi *Enton Punavija*, ka deklaruar se, *këto pagesa nuk kanë lidhje me blerjen e apartamentit nga shoqëria Homeplan shpk. Nuk di të thotë se përse është përdorur termi kontribut patriotik për këto pagesa. Këto pagesa mund të jenë kontrollit dhe menaxhimit të trafikut. Ai ka qënë menaxher operacional i Sëarco Mizar Albania dhe shtetasi Fatmir Bektashi ka qënë nënkontraktor i kësaj kompanie për pjesën e punimeve civile. Beson që këto pagesa kanë lidhje me kontratën e bashkëpunimit që ka patur me kompaninë Sëarco Mizar Albania. Gjithashtu në llogaritë e tij bankare ka patur pagesa nga kjo shoqëri për punën që ka kryer. Marrëdhënia e tij e punës me këtë kompani është lidhur gjatë periudhës që ishte larguar me dorëheqje nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu sqaron se ka qënë në fushën e transportit dhe infrastrukturës. Kontratën me shoqërinë Japoneze e ka lidhur*

shtetasi Fatmir Bektashi si administrator i shoqërisë Kontakt shpk, pasi nuk mund ta lidhte Entoni në mënyrë direkte sepse nuk kishte NIPT. Kontrata me kompaninë Japoneze është lidhur në vitin 2011-2012 dhe kjo kompani ka ndejtur gati 1 vit e gjysëm në Shqipëri. Nuk di të thotë nëse këto pagesa kanë lidhje me kontratën e lidhur me kompaninë Japoneze. Ai ka marrë pagesa nga Fatmiri në bazë të kontratave që citoi më sipër.

Pavarësisht se shtetasi Enton Punavija rezulton i punësuar pranë shoqërisë Sëarco Mizar Albania, që nga data 01.08.2013, në fakt si më sipër, pasqyrohen si kontribute patriotike, janë përfshirë në analizën e shoqërisë Homeplan sh.p.k. dhe jo të shoqërisë Swarco.

151. Në proces verbalin e mbledhjes së KRRT I datë 26.02.2008 me të pranishëm shtetasit: Adrian Myderizi, Sokol Behaj, Marin Biçoku, Sokol Lekaj, Artan Shkreli, Arben Biçoku dhe Anila Alite, si dhe shënuar emri "Rama" por pa nënshkrim, pasqyrohet se ky i fundit është shprehur që drejtimin e mbledhjes ta bëjë Arben Biçoku. Në lidhje me objektin 62 v. 61 leje ruga Frosina Plaku, shoqëria Kontakt është bërë ky diskutim:

Marini: *Për pronën të flasin pronarët. Kur të plotësohen kushtet mos zbardhet vendimi, për verifikimin e objekteve në veri të sheshit të ndërtimit.*

Investitori: Nuk e kemi pronësinë për objektet, për të shmangur problemet, zbardhja të merret me faza.

Beni: *Shprehemi sot.*

Vendim. *Faza A (i është hequr një vijë në mes). Leja e ndërtimit për fazën B mos zbardhet pa u verifikuar objektet në veri, të kryhen procedurat për regjistrimin në hipotekë. Miratohet leja për gjithë bllokun, zbardhja bëhet me faza, fillimisht Faza A dhe pas verifikimit nga Drj.Urba. të pronësisë objekteve në veri të bëhet zbardhja e Fazës B.*

Majlinda: *Bashkia e ka merak verifikimin e pronësisë për objektet në veri. Duhet zbazur sheshi. Sugjeruam Fazën A. Sheshi është miratuar. Vendimet kanë data, vështirësohen procedurat. Dokumentat e pronësisë do kenë data të mëvonshme se vendimi i KRRT.*

Investitori: *Të miratohet gjithë korpusi. Zbardhja të bëhet me faza, mos vijmë përsëri në KRRT për fazën B.*

Shkreli, Sokol Lekaj

Të miratohet gjithë leja edhe zbardhja të bëhet me faza, pas privatizimit të objekteve në shesh.

Beni: *Nuk bëhet zbardhja e fazës B pa u zgjidhur pronësia e objekteve në veri. Miratohet leja për gjithë korpusin (dy fazat).*

Të bëhen dy vendime përkatësisht për fazën A dhe fazën B. Faza B të zbardhet pas privatizimit dhe marrjes së pronësisë për objektet në veri.

Miratohet.

Në fund të proces verbalit, kanë nënshkruar Adrian Myderizi, Arben Biçoku, Marin Biçoku, Sokol Behaj, Artan Shkreli, Anila Alite. Përveç anëtarëve të pranishëm që kanë nënshkruar, gjendet i shkruar emri Edi Rama por nuk shoqërohet me nënshkrim.

152. Në bazë të një dokumenti “*Lista e vendimeve të KRRT-së 1-rë datë 26.02.2008*” është pasqyruar ndër të tjera:

Vendimi nr. 61 leje ndërtimi (faza e parë) për bllok banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkimi nëntokë në pronë të H.Begeja, N.Bekteshi, N. Kaçurri, K.Kaçurri, S.Begeja, M. Ago, G.Begeja, L.Lika, A.Sulstarova, H.Begeja, E.Begeja, S.Begeja, E.Begeja, L.Çela, S.Kurti, T. Malka, N.Hoxha, R.Bekteshi, J.Malltezi, O. Malltezi, rruga Frosina Plaku, subjekti ndërtues Kontakt. – miratim.

Vendimi nr. 61/1 leje ndërtimi (faza e dytë) për bllok banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkimi nëntokë në pronë të H.Begeja, N.Bekteshi, N. Kaçurri, K.Kaçurri, S.Begeja, M. Ago, G.Begeja, L.Lika, A.Sulstarova, H.Begeja, E.Begeja, S.Begeja, E.Begeja, L.Çela, S.Kurti, T. Malka, N.Hoxha, R.Bekteshi, J.Malltezi, O. Malltezi, rruga Frosina Plaku, subjekti ndërtues Kontakt. – Miratim.

153. Shtetësja Anila Alite si edhe më sipër kemi theksuar, është bashkëshortja e shtetasit Ruben Alite. Ky i fundit është bashkëortak i shoqërisë Leal – CSE sh.p.k. me NIPT K31529014H, bashkë me shtetasin Frederik Lena. Nga analizimi i Librave të blerjes të shoqërisë Homeplan shpk që është shoqëria që krijohet me qëllim investimin e ndërtimeve që marrin jetë pikërisht nga lejet e mësipërme, rezulton se shoqëria LEAL - CSE gjatë periudhës 2012-2016, ka kryer shitje ndaj Homeplan në një vlerë totale prej 34,583,861 lekësh. Konstatohet se në vitin 2012, janë evidentuar edhe fatura në të cilat pasqyrohet se shoqëria Leal – CSE ka projektuar strukturën e objektit Magnet I. Nga analizimi i Librave të shitjes të deklaruar nga subjekti Leal CSE për periudhën **Janar 2012 - Dhjetor 2016**, rezulton se klienti kryesor i këtij subjekti është shoqëria Homeplan shpk.

154. Me formularin nr. 2 Këshilli i Rregullimit të Territorit të Tiranës, Sekretaria Teknike e KRRT-së, vendimi i KRRT nr. 136 datë 29.12.2007 “*Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij*” (nr. 246 prot datë **04.04.2008**) miraton sheshin e ndërtimit, me sip **8540 m²**, sip e zënë me objekte pa leje 400 m², sip e ndërtimit e objektit të miratuar 3377.04 m², koeficienti i shfrytëzimit të territorit 0.44, nr i kateve mbi tokë 5, 7, 9 kat, nr i kateve nëntokë 2, volumi i objektit 85505 m³, lartësia e përgjithshme 28.68 m, nr total i kateve (mbi dhe nëntokë) 11. **Afati ligjor i këtij vendimi është deri më datë 29.06.2008.** Ky formular është nënshkruar nga sekretari i KRRT-së Dritan Agolli dhe kryetari i KRRT-së Edi Rama.

Pasuritë janë: 6/165; 3/166; 3/163; 3/156; 3/116; 3/162; 3/167 për objektin “*Shesh ndërtimi për godinë banimi dhe shërbime 5, 7, dhe 9 kat me 2 kat parkimi nëntokë në rrugën Frosina Plaku*”.

Procedurat e vlerësimit, Lindja e shoqërisë Homeplan sh.p.k.

155. Në periudhën e lulëzimit të lidhjes së kontratave, me objekt kryesor jo vetëm vënien në dispozicion të truallit, por edhe ndryshimin e destinacionit si dhe privatizimin si dhe zhvillimeve në lidhje me investimin për ndërtime dhe marrje lelesh për ndërtime në territoret e Klubeve Sportive Partizani, komisionet e ngritura për vlerësimin e objekteve të këtyre klubeve, vijnë punën.

Konstatohet se, propozimet e bëra nga Ministri Ylli Pango, hyjnë në fuqi, **në muajin nëntor 2007**, me ligjin nr. 9816 dt **22.10.2007** “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9376 datë*

21.04.2005 "Për Sportin", ku ndër të tjera, sjellin një pengesë të madhe në lidhje me procedurat e privatizimit. Konkretisht, në nenin 31, është hequr mundësia e privatizimit të këtyre objekteve duke mbetur vetëm mundësia e dhënies me koncension. Neni 31 pas këtyre ndryshimeve, parashikonte: "Objektet sportive jepen me koncension, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".

Por mesa duket, ky ndryshim dispozite, për momentin nuk i ka shqetësuar institucionet dhe specifikisht komisionet e vlerësimit, të cilat kanë vijuar punën në lidhje me vlerësimin e objekteve të Klubit të Futbollit Partizani dhe Klubit Shumësportesh Partizani.

Madje, ndërkohë që kryheshin procedurat e privatizimit, por pa u konkluduar ato, shoqëria Kontakt sh.p.k. kishte marrë masa për të proceduar me rrethimin e pronës ku do të bëhej ndërtimi.

Gjithashtu, merren edhe masa për t'i hequr fondet klubeve sportive. Kështu me shkresën nr. 1484 prot dt **26.02.2008** (ditën që është mbajtur proces verbali i KRRT-së për zbardhjen me faza të lejes së ndërtimit), Drejtori i Kabinetit të Ministrisë së Turizmit Flamur Shehu, i është drejtuar Degës së Thesarit Tiranë, me kërkesë për konfirmim pakësim fondesh, duke i bërë me dije se në mbështetje të udhëzimit nr. 4 datë 17.01.2008 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008" kërkojnë pakësimin e fondit: prej 2 000 000 lekësh, që do të përdorej për projektin Klubi Partizani, rikonstruksion palestra e volejbollit, basketbollit. Me shkresën nr 6693/3 prot datë 23.07.2008 ministri i Financave Ritvan Bode, i është drejtuar Degës së Thesarit dhe për dijeni Miistrisë së Turizmit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku i parashtorn se në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Turizmit me nr 4499/1 prot datë 30.06.2008 si dhe në mbështetje të shkresës përcjellëse të drejtorisë së menaxhimit dhe investimeve publike, bëjnë transferimin e fondeve, ku ndër të tjera, evidentohet shuma prej 2 000 000 lekësh për Klubin Shumësportesh Partizani për rikonstruksion palestra volejball, basketboll, transferohet në Komunën Tropojë për ndërtim terreni sportiv. Me shkresën nr 5415 prot datë 01.08.2008 (datë kur botohen në FZ ndryshimet e ligjit për sportin që lejonin edhe privatizimin e objekteve sportive) Ministri Ylli Pango i dërgon Klubit shumësportesh Partizani pakësimin e fondeve të investimit konkretisht shumë në orë 2 000 000 lekësh që ishte për rikonstruksionin e palestrës së volejbollit, basketbollit.

156. Nga ana tjetër konstatohet se trashëgimtarët Begeja dhe Vaqarri angazhohen në lidhje me procedurat e privatizimit dhe të ndërtimit, duke u theksuar se të gjitha shpenzimet do të merren përsipër nga shoqëria Kontakt sh.p.k.

156.1. Kështu rezulton se me deklaratën e trashëgimtarëve të familjes Begeja nr 1852 rep nr 279 kol datë **25.03.2008** para noteres Ruko Sako, deklaruesit: Haki Begeja, Nusret Kaçurri, Kresnik Begeja (mund të jetë gabim), Lirije Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Drita Begeja, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Elona Begeja, Xhimi Begeja, të gjithë të përfaqësuar me prokurën e posaçme nga Jamarbër Malltezi, si dhe Ilir Kadiu, Sulejman Kadiu për vete dhe përfaqësues me prokurë i Vangjel Kadiut dhe Manjola Kadiu si trashëgimtar i Xhelan Kadiu përfaqësuar me prokurën e përgjithshme nr rep 2442 dhe nr kol 304 datë 18.05.2006, si deklarues, deklarojnë: "...Si pjestarë të fam Begeja në bashkëpunim me fam Saliaga, Vaqarri, Alimehmeti dhe Llagami gjatë dhe pas privatizimit të objekteve të ndodhura në pronën tonë me qëllim përfundimin sa më të shpejtë të këtij procesi; Në ushtrim të së drejtës sonë të pronësisë mbi objektet e Klubit Shumësportesh Partizani dhe Klubit të Futbollit

Partizani vendosim të shembim këto objekte dhe të lirojmë truallin duke hequr mbetjet inerte të objekteve të prishura me qëllim për të respektuar kufijtë e pronësisë së truallit mes familjeve. Shpenzimet e privatizimit dhe të largimit të inerteve do të përballohen nga firma Kontakt dhe do të rimbursohen më pas duke u reflektuar në kontratën e ndërtimit (sipërmarrjes që fam përfituese kanë lidhur apo do lidhin më pas me këtë firmë ndërtuese). As privatizimi i objekteve të Klubit Shumësportesh Partizani dhe Klubit të Futbollit Partizani dhe as prishja e objekteve të rrënuara nuk do të ndikojnë në marrëdhëniet dhe në raportet e pronësisë mbi truallin siç paraqiten në vendimin nr 6 datë 21.03.2007 të AKKP. Si përfaqësues i fam Begeja deklaroj se respektojme vërtetimet hipotekore të fam sonë dhe nuk kemi pretendime pronësore në pjesët e tjera brenda klubit sportiv në rr. Frosina Plaku të cilat janë pjesë e diskutimit mes familjeve Llagami dhe Saliaga. ...Kjo deklaratë është nëshkruar vetëm nga shtetasi Jamarbër Malltezi.

156.2. Me deklaratën noteriale e trashëgimtarëve të familjes Vaqarri nr 912 rep nr 204 kol datë 28.04.2008 para notere Gentiana Shkodra janë paraqitur shtetasit: Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari (përfaqësuar nga Petrit Bektashi), Kumrije Arapi, Milva Arapi, Liljana Shanto (Arapi) (përfaqësuar nga av Mujo Haxhiaj), Luan Arapi (përfaqësuar nga Bardhyl Qatipi), Arben Arapi (përfaqësuar nga av. Mujo Haxhiaj), Fiqerete Vaqari (përfaqësuar nga Igli Vaqari), Eva Vaqari (përfaqësuar nga Igli Vaqari), Igli Vaqari. ..Deklaruesit paraqiten me cilësinë e pronarit të një trualli që ndodhet brenda territorit të ish Klubit të Futbollit Partizani, të njohur dhe kthyer me vendim të AKKP nr 9 datë 26.03.1997. Deklaruesit, deklarojnë se....Familjet Vaqari, Begeja, Saliaga, Alimehmeti dhe Llagami janë ligjërisht pronare të truallit me sip të përgjithshme (të njohur dhe të kthyer pronarëve) të ish Klubit Sportiv Partizani (Klubi i Futbollit Partizani që ka sip 26 500 m² dhe Klubi Shumësportesh Partizani që ka 18 235 m²), mbi të cilin janë ndërtuar objektet sportive...Jemi të interesuar dhe dëshirojmë të përfitojmë nga e drejta jonë ligjore e parablerjes, duke privatizuar asetet e ish klubit të futbollit Partizani të ndërtuara në truallin pronë e jona. Privatizimin do ta realizojmë sipas çmimit dhe formulës së privatizimit që do të përcaktojë organi kompetent shtetëror i privatizimeve, në përputhje me raportet mbi pronësinë e truallit mbi të cilin janë ngritur këto ndërmarrje dhe sipas akteve ligjore në fuqi. Pas privatizimit objektet do të regjistrohen në ZRPP në emër të pronarëve të truallit mbi të cilin ngrihen objektet. Si pjestarë të familjes Vaqarri deklarojmë se do të bashkëpunojmë me fam Saliaga, Alimehmeti, Llagami dhe Begeja gjatë dhe pas privatizimit të objekteve të ndodhura në pronën tonë, me qëllim përfundimin sa më të shpejtë të këtij procesi. Familjet pronare të truallit angazhohen të menaxhojnë se bashku objektet që në bazë të së drejtës së parablerjes do të privatizojnë. **Shpenzimet e privatizimit do të përballohen nga firma Kontakt pa cënuar titullin e pronësisë mbi 24% siç është përcaktuar në kontratë porosie dhe sipërmarrje të datës 16.04.2007 me nr 574 rep nr 177 kol në pikën 5 gërma "a". Privatizimi i objekteve të Klubit Shumësportesh Partizani dhe të ish klubit të futbollit Partizani nuk do të ndikojnë në marrëdhëniet dhe në raportet e pronësisë të fituara nga vendimi nr 9 datë 26.03.2007 të AKKP-së....**

156.3. Me deklaratën noteriale e trashëgimtarëve të familjes Vaqarri nr 911 rep nr 203 kol datë 28.04.2008 para notere Gentiana Shkodra janë paraqitur shtetasit: Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari (përfaqësuar nga Petrit Bektashi), Kumrije Arapi, Milva Arapi, Liljana Shanto (Arapi) (përfaqësuar nga av Mujo Haxhiaj), Luan Arapi (përfaqësuar nga Bardhyl Qatipi), Arben Arapi (përfaqësuar nga av. Mujo Haxhiaj), Fiqerete Vaqari përfaqësuar nga Igli Vaqari), Eva Vaqari (përfaqësuar nga Igli Vaqari), Igli Vaqari. ..Deklaruesit paraqiten me cilësinë e pronarit të një trualli që ndodhet brenda territorit të ish Klubit të Futbollit Partizani, të njohur dhe kthyer me vendim të AKKP nr 9 datë 26.03.1997. Deklaruesit, deklarojnë se....Si pjestarë të familjes Vaqarri deklarojmë se do të bashkëpunojmë me fam Begeja, Saliaga, Alimehmeti, Llagami gjatë dhe pas privatizimit të objekteve të ndodhura në pronën tonë, me qëllim përfundimin sa

më të shpejtë të këtij procesi. Në ushtrim të së drejtës sonë të pronësisë mbi objektet e Klubit Shumësportesh Partizani dhe ish Klubit të Futbollit Partizani vendosim të shembim këto objekte dhe të lirojmë truallin duke hequr mbetjet inerte të objekteve të prishura me qëllim për të respektuar kufijtë e pronësisë së truallit mes familjeve. **Shpenzimet e privatizimit dhe të largimit të inerteve, do të përballohen nga firma Kontakt pa cënuar titullin e pronësisë mbi 24% siç është përcaktuar në kontratë porosie dhe sipërmarrje të datës 16.04.2007 me nr 574 rep nr 177 kol në pikën 5 gërma "a".** As Privatizimi i objekteve të Klubit Shumësportesh Partizani dhe të ish klubit të futbollit Partizani dhe as prishja e objekteve të rrënuara nuk do të ndikojnë në marrëdhëniet dhe në raportet e pronësisë mbi trallinsiq paraqiten në vendimin nr 9 datë 26.03.2007 të AKKP-së. Si përfaqësues të fam Vaqari deklaorjmë se respektojmë vërtetimet hipotekore të familjes sonë dhe nuk kemi pretendime pronësore në pjesët e tjera brenda Klubit Sportiv Partizani në rrugën Frosina Plaku, të cilat janë pjesë e diskutimit mes familjeve Llagami dhe Saliaga.....

157. Në këtë kohë, megjithëse nuk ishin privatizuar ende objektet, kjo gjë nuk e ka penguar shoqërinë Kontakt sh.p.k. për fillimin e punimeve. Nga aktet e administruara pranë Ministrisë së Turizmit, konstatohet se me një memo të drejtorit të Sportit Violeta Shqevi, nr. 1800/3 prot datë 14.04.2008 drejtuar Ministrit të Turizmit Ylli Pango, i është parashtruar se, nga Drejtuesi i Klubit Shumësportesh Partizani, është ngritur një shqetësim që është verifikuar në vend. Në bazë të verifikimeve, ka rezultuar se, vendi i ish fushave të basketbollit, është rrethuar për të filluar punimet, bazuar në Vendimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit KRRT II nr. 136 datë 29.12.2007 (kjo leje është dhënë pikërisht për familjen Begeja) për shesh ndërtimi. Ndër të tjera i sjell në vëmendje zënie forcërisht të shumë pronave të këtij klubi. Prandaj i propozon se duhet të kryhet regjistrimi i pronës sipas VKM nr. 7843 datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe të përcaktohet një person për ndjekjen e procedurës së regjistrimit.

Korrespondencat në lidhje me përcaktimin e sipërfaqeve, pronësinë dhe çmimin e truallit

158. Me shkresën nr. 72/3 prot datë 03.03.2008, Dega e Shoqërive Publike pranë METE, nënshkruar nga kryetari Irfan Hoxha, i ka kërkuar Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Planifikimit Urban, miratimin e gentplanit, me sipërkatëse si dhe aktin e konfirmimit të sipër truallit të objektit "Terrene sportive dhe objekteve të Klubit të Futbollit Partizani, Tiranë". Bashkalidhur i dërgon miratimin e privatizimit dhe 5 kopje të genplanit të objektit. Me shkresën nr. 2136/1 datë 18.04.2008 Drejtoria e Planifikimit Urban, shtetësja Ariela Kushi, i ka kthyer përgjigje, duke i bërë me dije se, i dërgon pesë ekzemplarët origjinale të genplanit të objektit "Terrene sportive dhe objekte të Klubit të Futbollit Partizani" me vendndodhje në rruga Frosina Plaku, Tiranë, ku specialistët e sektorët të GIS Kadastrës kanë konfirmuar sipër sipër vijon: S nën objekt 775 m²; S funksionale 26 005 m², S. Totale 26 524 m².

METE, me shkresën Nr. 22/1 datë 03.03.2008 i kërkon Bashkisë Tiranë, konfirmim për sipërfaqen e objektit "Klubi Shumësportësh Partizani". Drejtoria e Planifikimit Urban pranë Bashkisë Tiranë, shkresë e nënshkruar nga shtetësja Ariela Kushi, me shkresë Nr. 2137/1 Prot. datë 14.04.2008 ka përcjellë pesë egzemplarët origjinalë të genplanit të "Klubit Shumësportësh Partizani" ku specialistët e GIS Kadastrës kanë konfirmuar sipërfaqet si më poshtë vijon: Sipërnen objekt 4,857 m²; sipërfaqe funksionale 13,934 m² dhe sipërfaqe totale 18,211 m².

Kryetari Irfan Hoxha, i Degës së Shoqërisë Publike, me shkresën nr. 92/2 prot datë 07.03.2008, i ka kërkuar Drejtorisë së Planifikimit Urban Tiranë, Bashkisë Tiranë, konfirmim për sipërfaqen e objektit "Pishina Laprakë" pjesë e Klubit Shumësportesh Partizani, Tiranë. Drejtoria e

Planfikimit Urban, konkretisht shtetësja Ariela Kushi, me shkresën nr. 2263/1 prot datë 18.04.2008, i kthen përgjigje duke i dëgruar ekzemplarët origjinalë të genplanit të objektit "Pishina Laprakë" në administrim të Klubit Shumësportesh Partizani, me vendndodhje në Laprakë – Tiranë, ku specialistët e Sektorit të GIS Kadastrës kanë konfirmuar sip që vijojnë: S nën objekt = 600 m²; S funks = 320 m²; S tot = **920 m²** (nga të cilat, sipas konfirmimit të dhënë nga Sektori i Projektimit dhe Standartizimit, 40 m² i zë rruga e Planit Rregullues).

158.1. Me shkresën nr. 92/4 prot datë **15.04.2008** të Kryetarit Irfan Hoxha, Dega e Shoqërive Publike, pranë METE i është drejtuar shtetasit **Fetah Hasanaj**, ZQRPP dhe ZVRPP Tiranë, duke i kërkuar një informacion të saktë, si për objektin dhe për truallin e tij për Klubin Shumësportesh Partizani. Me shkresën nr. 3431/1 prot datë 22.04.2008 Zv. Regjistruesi Fetah Hasanaj, i është përgjigjur Degës së Shoqërisë Publike, duke i dërguar këto të dhëna mbi pasuritë:

Pasuria nr. 3/153 ZK 8220 sip trualli 9213 m² në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria nr. 3/84 ZK 8220 sip trualli 9740 në pronësi shtet; Pasuria nr. 3/112 ZK 8220 sip trualli 480 në pronësi të familjes Saliaga; Pasuria nr. 3/161 ZK 8220 me sip trualli 3240 në pronësi të familjes Saliaga; Pasuria me nr. 3/114 ZK 8220 me sip trualli 1574 në pronësi të familjes Saliaga; Pasuria me nr. 3/164 ZK 8220 me sip trualli 210 m² në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/165 ZK 8220 me sip trualli 470 m² në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/167 ZK 8220 me sip trualli 6318 m² në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/151 ZK 8220 me sip trualli 19 m² në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/166 ZK 8220 me sip trualli 27 m² në pronësi të B.P.Begeja.

Me shkresën nr. 92/6 prot dt **21.04.2008** kryetari Irfan Hoxha i kërkon ZVRPP saktësimin e truallit dhe objektit Pishina Laprakë dhe Klubin Shumësportesh Partizani. Me shkresën nr. 3485/1 prot dt **22.04.2008** zv. Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, informon se nuk kanë të regjistruar objekt me emërtimin "Pishina Laprakë". Objekti, në genplanin bashkangjitur sipas materialeve grafike të kësaj zyre është pjesë e pasurisë me nr. 12/27 që sipas librit të ngastrave dhe regjistrimit hipotekor 347 figuron në ZK 8310 dhe regjistruar në favor të Esat Adem Pira, me nr hip 663 dt 07.02.1998, transkriptuar nga regj hipotekor 5602 dt 27.11.1997. Për origjinën e kësaj prone, nuk mund të shprehen, pasi mungon dokumentacioni. Po kështu, ajo ka mbivendosje me pasurinë 12/28, e cila sipas librit të ngastrave i përket Roland Isufit, si dhe pasurinë 12/25 që sipas librit të ngastrave i përket Andre Buxhelit. Bashkalidhur dërgon edhe fotokopjen e kontratave të shitjes.

Me shkresën nr. 3485/2 prot datë **06.05.2008** Zv. Regjistruesi Fetah Hasanaj informon sërish se nuk kanë të regjistruar objekt me emërtimin "Pishina Laprakë". Objekti në genplan, është pjesë e pasurisë me nr. 12/27 që figuron në ZK 8310 dhe regjistruar në favor të Esat Adem Pira dhe Marita Dilaver Osmani, me nr hipoteke 663 datë 07.02.1998, transkriptuar nga regjistri hipotekor nr. 5602 datë 27.11.1997. Për origjinën e kësaj prone, nuk mund të shprehen pasi mungon dokumentacioni. Po kështu, ajo ka mbivendosje me pasurinë me nr. 12/28 e cila sipas librit të ngastrave i përket shtetasit Roland Isufi dhe pasurinë nr. 12/25 që sipas librit të ngastrave i përket Andre Buxheli. Përsa më sipër shprehen se nuk mund të pajisin me vërtetim hipotekor, pasi prona nuk ka origjinë. Bashkalidhur shprehet se janë edhe fotokopjet e kontratave të shitjes, por këto të fundit nuk rezultojnë në praktikën e administruar gjatë hetimit.

158.2. Me shkresën nr. 72/5 prot datë **21.04.2008** Dega e Shoqërive Publike pranë METE, nënshkruar nga kryetari Irfan Hoxha, i kërkon informacion shtetasit **Fetah Hasanaj**, ZQRPP dhe ZVRPP, duke e sqaruar se i dërgojnë një kopje të genplanit të terreneve sportive dhe të objekteve të Klubit të Futbollit Partizani dhe për të marrë një informacion të saktë si për

objektin dhe për truallin kërkojnë: **Saktësimin e pronësisë së truallit dhe të objekteve të paluajtshëm** që përfshihen në genplanin bashkalidhur; Harta treguese të objektit në fjalë 5 copë. Vetëm një ditë më pas, me shkresën nr. 3484/1 prot datë **22.04.2008**, ZVRPP zv. Regjistruesi Fetah Hasanaj, i kthen përgjigje ku i sqaron si vijon:

Pasuria me nr. 3/153 ZK 8220 me sip truall 9 213 m2 në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/84 ZK 8220 me sip truall 9740 m2 në pronësi shtet; Pasuria me nr. 3/159 ZK 8220 me sip truall 10 975 m2 në pronësi të Dylbere Vaqarri; Pasuria me nr. 3/157 ZK 8220 me sip truall 7 750 m2 në pronësi të Rexhep Alimehmeti; Pasuria me nr. 3/152 ZK 8220 me sip truall 47 m2 në pronësi të B.P.Begeja; Pasuria me nr. 3/115 ZK 8220 me sip truall 1900 m2 në pronësi të B.P.Begeja;

Me shkresën nr. 72/11 prot datë **16.06.2008**, Dega e Shoqërive Publike pranë METE, nënshkruar nga kryetari Irfan Hoxha, i është drejtuar shtetasit Fetah Hasanaj, ZQRPP dhe ZVRPP-së, ku i pasqyron se, në shkresën e këtyre me nr. 3484/1 datë **22.04.2008**, kthejnë përgjigje për një territor **39 625 m2**, sip kjo më e madhe se sip e kërkuar (**26 524 m2**) po e cila gjithashtu lë jashtë një pjesë territori. Përsa më sipër, kërkojnë konfirmimin e gjendjes juridike të pronësisë që shtrihet vetëm brenda territorit **26 524 m2** që është e kufizuar në planvendosjen që kjo ministri ka përcjellë me shkresën nr. 72/5 prot datë 21.04.2008. Ditën e nesërme, me shkresën nr. 5574/1 prot datë 17.06.2008 Fetah Hasanaj, ZVRPP i kthen përgjigje METE-s për shkresës nr. 72/11 prot datë 16.06.2008 duke i parashtruar: *Pasuria nr. 3/157 me sip truall 7 750 m2 në pronësi të Repxhep Alimehmet; Pasuria nr. 3/153 sip truall 9 213 m2 në pronësi të BP Begeja ndërsa brenda vijës së kuqe të vijëzuar 3 491 m2; Pasuria nr. 3/159 me sip truall 10 975 m2 në pronësi të Dylbere Vaqarri; Pasuria nr. 3/152 me sip truall 47 m2 në pronësi të BP Begeja; Pasuria me nr. 3/84 me sip truall 9740 m2 në pronësi shtet dhe brenda vijës së kuqe të vizuar 4 261 m2.* Bashkangjitur fragment harte.

Pra, brenda sipërfaqes prej 26 524 m2 të Klubit të Futbollit, rezulton se:

- a) familja Vaqarri ka 10 975 m2,
- b) familja Begeja ka 9 260 m2,
- c) familja Alimehmeti 7 750 m2 dhe
- d) 9 740 m2 figuron pronar shteti.

Me shkresën Nr. 3991/1 Prot. datë **06.05.2008** ZVRPP të nënshkruar nga Zv. Regjistruesi Fetah Hasanaj i ka dërguar informacion Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, Degës së Shoqërive Publike Tiranë, në përgjigje të shkresës nr. 92/14 datë 06.05.2018, duke i konfirmuar nëse pasuritë ndodhen brenda konturit të hartës treguese konkretisht:

- 1) *Pasuria Nr. 3/153, zk.8220, vol.15, fq.184 ...nr regj hip Nr.417, dt 03.07.2007 është regjistruar një truall sip 9,213 m2. Brenda pjesë së konturuar me vijë të kuqe ndodhen 4,300 m2 në pronësi të familjes Begeja.*
- 2) *Pasuria Nr. 3/112, zk.8220, vol.12, fq.201 ... nr regj hip Nr.3797, dt 04.09.1995 është regjistruar një truall sip 480 m2. Brenda pjesë së konturuar me vijë të kuqe ndodhen po 480 m2 në pronësi të familjes Saliaga.*
- 3) *Pasuria Nr. 3/161, zk.8220, vol.15, fq.187 ... nr regj hip Nr.461, datë 24.07.2007 është regjistruar një truall sip 3240 m2. Brenda pjesë së konturuar me vijë të kuqe ndodhen 3,160 m2 në pronësi të familjes Saliaga.*
- 4) *Pasuria Nr. 3/114, zk.8220, vol.12, fq.204 ... nr regj hip Nr.3797, datë 04.09.1995 është regjistruar një truall sip 1574 m2. Brenda pjesë së konturuar me vijë të kuqe ndodhen po 1,574 m2 në pronësi të familjes Saliaga.*
- 5) *Pasuri nr. 3/164, Vol. 17, Fq. 93, ZK 8220, sip 210 m2, ... nr regj hip Nr.742, datë*

- 11.12.2007 në pronësi të familjes Begeja e përfshirë brenda konturit me vijë të kuqe.
- 6) Pasuri nr. 3/165, Vol. 17, Fq. 94, ZK 8220, sip 470 m2, ... nr regj hip Nr.743, datë 11.12.2007 në pronësi të familjes Begeja e përfshirë brenda konturit me vijë të kuqe.
- 7) Pasuri nr. 3/167, Vol. 17, Fq. 96, ZK 8220, sip 6318 m2, ... nr regj hip Nr.744, datë 11.12.2007 në pronësi të familjes Begeja, sipërfaqe 5060 m2 e përfshirë brenda konturit me vijë të kuqe
- 8) Pasuri nr. 3/151, Vol. 15, Fq. 178, ZK 8220, sip 19 m2, ... nr regj hip Nr.417, datë 03.07.2007 në pronësi të familjes Begeja, e përfshirë brenda konturit me vijë të kuqe
- 9) Pasuri nr. 3/166, Vol. 17, Fq. 96, ZK 8220, sip 27 m2, ... nr regj hip Nr.745, datë 12.12.2007 në pronësi të familjes Begeja, e përfshirë brenda konturit me vijë të kuqe
- 10) Pasuri nr. 3/138, Vol. 15, Fq. 55, ZK 8220, sip 3120 m2... nr regj hip Nr.745, dt 12.12.2007 në pronësi të familjes Begeja, ndërsa brenda konturit me vijë të kuqe është 375 m2.
- 11) Pasuri nr. 3/87, ZK 8220, sipas librit të ngastrave sipërfaqe trualli 178 m2, SN 83 m2, në pronësi të Halim Ramahitës, mungon dokumentacioni ligjor pasi nga kërkimi i bërë në arkivën dixhitale nuk ka asnjë pasuri në emër të këtij shtetasi, ndërsa pjesa brenda konturit në vijë të kuqe është 137 m2.
- 12) Pasuri nr. 3/88, ZK 8220, sipas librit të ngastrave shesh me sipërfaqe 52 m2 shtet ndërsa brenda konturit me vijë të kuqe 20 m2.
- 13) Pasuri nr. 3/85, ZK 8220, sipas librit të ngastrave truall me sipërfaqe 35 m2, sip.Sn 35 m2, e cila përfshihet brenda pjesës së konturuar me ngjyrë të kuqe kabinë elektrike.
- 14) Pasuri nr. 3/94, ZK 8220, sipas librit të ngastrave truall sip 70 m2, sip.Sn 70 m2, garazh në bashkëpronësi të banorëve të pallatit, brenda konturit me vijë të kuqe 10.5 m2, sipas librit të ngastrave.
- 15) Pasuri nr. 3/84, ZK 8220, sipas librit të ngastrave sipërfaqe 9740.7 m2, brenda pjesës së konturuar me ngjyrë të kuqe 866.5 në pronësi shtet.

158.3. Me shkresën nr. 72/7 prot datë 22.04.2008, Dega e Shoqërive Publike pranë METE, i ka kërkuar shtetasit Enton Drogu, Drejtor i zyrës rajonale për kthim dhe kompensim dhe shtetasit Besnik Maho, Drejtori i përgjithshëm i Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit, konfirmimin e çmimit të truallit sipas hartës së vlerës së tokës si dhe nëse ka vendime të KKKP për terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani. Me shkresën nr. 1090/1 prot datë 24.04.2008 të Zyrës Rajonale të KKKPronave, i është dërguar informacion Agjensisë së KKP ku pasqyron se pronarë janë: *Mahmut e Xhemal Begeja me vendimin nr. 6 datë 21.03.2007; Sabrije Llagami me vendimin nr. 97 datë 17.12.1999; Dylbere Vaqarri me vendimin nr. 9 datë 26.03.2007; Rexhep Alimehmeti me vendimin nr. 8 datë 23.03.2007; Qemal Saliaga me vendimin nr. 7 datë 21.03.2007.*

Me shkresën nr. 92/10 prot dt 22.04.2008, Kryetari i Degës së Shoqërive Publike pranë METE shtetasi Irfan Hoxha, i përcjell drejtorit të ZRKKP shtetasit Enton Drogu dhe për dijeni drejtorit të përgjithshëm të AKKP Besnik Maho, shkresë me të cilën kërkojnë konfirmimin e çmimit të truallit, sipas hartës së vlerës së tokës si dhe nëse a ka vendime të KKKP për objektin Klubin Shumësportesh Partizani Tiranë. Bashkalidhur dërgon hartën treguese.

Me shkresën nr. 1036/1 prot dt 29.04.2008 të AKKP-së drejtuar METE-s, për objektet që janë në proces privatizimi, mbështetur në konfirmimin e marrë nga Zyra Rajonale e AKKP Tiranë, sqaron se vendimet e marra për objektin Klubi Shumësportesh Partizani janë:

- Vendimi nr. 6 datë 21.03.2007 në vijim të vendimit nr. 532 datë 25.04.1996 për subjektin e shpronësuar *Mahmut dhe Xhemal Begeja*;
- Vendimi nr. 97 datë 17.12.1999 në emër të subjektit të shpronësuar *Sabrije Llagami duke u trajtuar së bashku me vendimin nr. 97 datë 17.12.1999 në emër të subjektit të*

shpronësuar **Qamil Saliaga**, referuar një akt marrëveshje mes palëve të miratuar me vendimin gjyqësor 10016/84 akti datë 12.06.1997, kanë të drejtën e parablerjes për një sipërfaqe prej 901 m²; Vendimi nr. 7 datë 21.03.2007 i cili i përket po subjektit të shpronësuar **Qamil Saliaga** në vijim të vendimit nr. 98 datë 17.12.1999.

Mbështetur në hartën e vlerës së trojeve, për zonën urbane të qytetit të Tiranës, objektet e sipërpërmendura ndodhen në ZK 8220 brenda zonës administrative nr. 7 të nëndarjes 7/3 të vlerësimit dhe vlera e truallit të kësaj zone të miratuar me VKM nr. 139 datë 13.02.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuara në hartat përkatëse për Qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës" është **26 787 lekë/m²**.

Me shkresën nr. 1089/1 prot dt 24.04.2008 të ZR të AKKP, i kthen përgjigje AKKP Tiranë, duke i bërë me dije se, në përgjigje të shkresës me nr. 92/8 prot dt 22.04.2008, të Degës së Shoqërive Publike Tiranë, në të cilën kërkohet konfirmimi për pronësinë dhe çmimin e shitjes së truallit për objektin Pishina Laprakë, pjesë e **Klubit Shumësportesh Partizani**, sqarojnë se duke mos patur të informatizuar arshivën e dokumentacionit të dosjeve nuk mund të shprehen nëse ka pronarë toke të njohur apo të kthyer me vendim të KKKP-ve të ish pronarëve.

Me shkresën nr. 1091/1 prot datë 24.04.2008, drejtori Enton Drogu, i Zyrës Rajonale të Qarkut Tiranë, AKKP i kthen përgjigje AKKP në përgjigje të shkresës me nr. 92/10 datë 22.04.2008 të Degës së Shoqërive Publike Tiranë, me të cilën kërkohet konfirmim për pronësinë dhe çmimin e shitjes së truallit, për objektin **Klubi Shumësportesh Partizani**, Tiranë. Përsa i përket pronësisë kemi këta pronarë: **Mahmut e Xhemal Begeja** me vendimin nr. 6 datë 21.03.2007; **Sabrije Llagami** me vendimin nr. 97 datë 17.12.1999; **Qamil Saliaga** me vendimin nr. 7 datë 21.03.2007.

Me shkresën nr. 1034/1 prot datë **29.04.2008** Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i ka kthyer përgjigje Degës së Shoqërive Publike, në përgjigje të shkresave me nr. 72/7 datë 22.04.2008, 92/8 prot datë 22.04.2008 dhe 92/10 datë 22.04.2008 duke i bërë me dije në lidhje me vendimet për subjektet e shpronësuar e konkretisht:

- **Vendimi nr. 532 datë 25.04.1996 për Mahmut dhe Xhemal Begeja**, gjithsej 14 483 m² të zëna me objekte të **KS Partizani** dhe **Vendimi nr. 6 datë 21.03.2007** ku janë kthyer trojet e lira dhe e drejta e parablerjes për objektet e ndërtuara mbi truall në pronësi të shtetit;
- **Vendimi nr. 722 datë 10.10.1996 për Rexhep Alimehmeti**, vendimi nr. 8 datë 23.03.2007 ku shprehet për kthimin e sip së lirë prej 7 930 m²;
- **Vendimi nr. 97 datë 17.12.1999 për Sabrije Llagamin** duke u trajtuar bashkë me vendimin nr. 98 datë 17.12.1999 në emër të subjektit **Qamil Saliaga**. Këto subjekte në bazë të një akt marrëveshje të miratuar me vendimin gjyqësor nr. 10016/84 akti datë 12.06.1997 kanë të drejtën e parablerjes për objektet e **KS Partizani për një sip prej 901 m²**.
- **Vendimi nr. 681 datë 27.08.1996** me subjekt **Dylbere Vaqarri**, ku trajtohet e drejta e parablerjes për objekte të terreneve sportive prej 11 112.5 m² **Vendimi nr. 9 datë 26.03.2007** ku trajtohet kthimi i trojeve të lira që janë përdorur si terrene sportive, kthimi i sip prej 10 975 m²'
- **Vendimi nr. 7 dt 21.03.2007** subjekti **Qamil Saliaga**, vijim i vendimit nr. 98 datë 17.12.1999.

Mbështetur në hartën e vlerës së trojeve për zonën urbane të qytetit të Tiranës, objektet e sipërpërmendura ndodhen në ZK 8220 brenda zonës administrative nr. 7 të nëndarjes 7/3 të vlerësimit dhe vlera e truallit të kësaj zone të miratuar me VKM nr. 139 datë 13.02.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit,

Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësi dhe Shkodrës” është 26 787 lekë/m². Bashkalidhur shprehet për fotokopje të konfirmimit të Zyrës Rajonale Tiranë.

Me shkresën nr. 92/8 prot datë **22.04.2008** Kryetari i degës së shoqërive Publike, pranë METE-s, Irfan Hoxha i adresohet ZRKKP dhe AKKP duke kërkuar konfirmimin e çmimit të truallit sipas hartës së vlerës së tokës si dhe nëse ka vendime të KKKP për objektin **Pishina Laprakë**, pjesë e Klubit Shumësportesh Partizani Tiranë.

Me shkresën nr. 1035/1 prot datë **29.04.2008** Besnik Maho, drejtor i përgjithshëm i AKKP-së, i kthen përgjigje METE-s, Degës së Shoqërive Publike, në përgjigje të shkresës me nr. 92/8 prot datë 22.04.2008 duke treguar këtë konfirmim: *Për objektin Pishina Laprakë pjesë e Klubit Shumësportesh Partizani...sqarojnë se sipas konfirmimit të dërguar nga Zyra Rajonale e KKP të Qarkut Tiranë nuk mund të shprehen për njohje pronësie në pamundësi të identifikimit të tyre; Objekti i mësipërm sipas hartës treguese të ZVRPP Tiranë është në pronësi të shtetasit Esat Pira me nr. pasurie 12/27.*

Objekti ndodhet në ZK nr. 8310 e cila pozicionohet brenda zonës administrative nr. 11 të nëndarjes 11/3 të vlerësimit dhe vlera e truallit të kësaj zone të miratuar me VKM nr. 139 datë 13.02.2008 *“Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës” është 20 473 lekë/m².*

Në fakt, nga aktet e administruara rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. 7938 rep nr. 2764 kol datë **27.11.1997**, para noteres Mimoza Shehu, shtetasi **Jorgo Qirko** i ka shitur shtetasit **Novruz Nurka**, një sip trualli të lirë kundrejt vleftës prej 1 900 000 lekë. Jorgo Qirko është pronar i këtij trualli me sip **1200 m²** i ndodhur në rrugën **“Kongresi i Përmetit” Laprakë** dhe figuron i regjistruar në regjistrin ipotekor me nr. 3652 datë 31.12.1993.

Sipas vërtetimit të pronësisë datë 27.11.1997 të nënshkruar nga nëpunese e ipotekës Nertila Biçoku, është pasqyruar se në regjistrin ipotekor nr. 5602 dt. 27.11.1997 në pronësi të z. **Novruz Nurka** i biri i **Laverit**, figuron e regjistruar një truall me sip **1200 m²**, ndodhur në rrugën **“Kongresi i Përmetit”**, në **Laprakë**, kufizohet nga veriu ndërtesë 1 kate me tulla silikate, lindja rrugë e lirë, jugu rrugë për në **Durrës**, përballë doganës dhe perëndimi ndërtesë me tjegulla të kuqe. Regjistrimi ipotekor është bërë në bazë të kontratës së shitjes nr. 7938/2766 dt. 27.11.1997 e noterisë Tiranë me notere **Mimoza Shehu**. Gjithashtu në këtë vërtetim është bërë shënimi me shkrim dore nga nëp e ipotekës **Silvana Dani** *“Prona është e lirë. Dt. 7.2.1998”*. Me kontratën e shitblerjes nr. 967 rep nr. 100 kol datë **07.02.1998** para noteres **Meri Çala**, shtetasi **Novruz Nurka** i shet shtetasve **Esat Pira** dhe **Marita Osmani**, pasurinë e mësipërme, në shumën 1 900 000 lekë

159. Ndërkohë rezulton që anëtarët e familjeve të njohura pronare nisin të lëshojnë prokura për përfaqësimin e tyre në procedurat privatizimit. Këhstu rezulton se me prokurën e posaçme nr. **2017 rep nr. 282 kol datë 04.06.2008** shtetasit **Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqarri, Milva Arapi, Liljana Arapi, Luan Arapi, Arben Arapi, Fiqierete Vaqari, Eva Vaqari, Kumrije Arapi kanë emëruar si përfaqësues të posaçëm Igli Vaqarin** që t'i përfaqësojë në Agjensinë Kombëtare të Privatizimit në procesin e privatizimit të objekteve që ndodhen në truallin e tyre në **Klubin Futbollit Partizani**, truall që është kthyer dhe regjistruar në ZVRPP etj. I pyetur më datë 22.11.2022 shtetasi **Igli Vaqarri** se nga kanë ardhur në dijeni që do të bëhej privatizimi i objektit, deklaroi se **Fatmiri dhe gjithë pronarët e tjerë bënë dokumentat përkatëse në dikastere si tek kthimi i pronave, tek Ministria e Ekonomisë.**

Vlen për t' u theksuar se më datë **29.06.2008** ndërron jetë shtetësja **Fitnete Bektashi**. Ajo ka pasur në përbërje familjare bashkëshortin **Petrit Bektashi**, si dhe dy fëmijët e saj **Fatmir** dhe **Genci Bektashi**.

Me nr 4998 rep nr 667 kol datë 10.07.2008 para notere Ruko Sako rezulton se shtetasit *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan saliaga, Hamide Saliaga, Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi* emërojnë si përfaqësues të tyre **Silvana Bellon** ku ndërmjet të tjerave i japin tagre t'i përfaqësojë në procedurat e privatizimit të objekteve që ndodhen në Klubin Shumësportesh Partizani dhe Klubin e Futbollit Partizani...

Me nr 1375 rep nr 743 kol datë 10.07.2008 para notere Gentiana Brati rezulton se shtetasit *Ervin Llagami* gjithashtu përfaqësues i *Artur Llagami dhe Aleksandra Llagami, si dhe Myhyrije Verzivolli (Llagami)*, emërojnë si përfaqësues të tyre **Fatri Tafaj** ku i japin tagre t'i përfaqësojë në procedurat e privatizimit të objekteve që ndodhen në Klubin Shumësportesh Partizani.

Me nr 2805 rep nr 336 kol datë 14.07.2008 rezulton se shtetësja *Sadete Llagami* emëron përfaqësues të posaçme vajzën e saj *Adela Llagami* që të paraqitet në Drejtorinë e Administrimit dhe shitjes së pronave publike, ...në lidhje me ushtrimin e të drejtës së parablerjes të objekteve të ndërtuara mbi truallin pronë u është bashkëpronare me të tjerë, që gjendet në Klubin Sportiv Shumësportesh Partizani....

Me nr 1693 rep nr 294 kol datë 16.07.2008 rezulton se shtetësja *Mirniye Llagami* emëron përfaqësues të posaçme mtrën e saj *Adela Llagami* që të paraqitet në Drejtorinë e Administrimit dhe shitjes së pronave publike, ...ku të kryejë të gjitha procedurat ligjore që lidhen me blerjen e klubit sportiv Partizani, etj.

Raportet e vlerësimit në kuadrin e procedurës së privatizimit.

160. VKM nr 794 datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" në kapitullin I "Vlerësimi i elementëve të pasurisë dhe kompetencat" sanksionon:

...3. ...**Komisioni i vlerësimit mban përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit, që ata kryejnë, dhe për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre (akte vlerësuese, situacione, genplane etj.).**

4. **Vlerësimi i pasurisë shtetërore, të miratuar për privatizim, bëhet, për çdo element të pasurisë, nga komisioni i vlerësimit, duke përcaktuar vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi.**

5. **Në përcaktimin e vlerës reale të tregut për pronën shtetërore, ekspertët kanë parasysh edhe vlerën fillestare sipas kontabilitetit, nëse ka, si dhe amortizimin sipas kontabilitetit, në zbatim të vendimit nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të reja të amortizimit të makinerive, të pajisjeve, si dhe të mjeteve të transportit", pjesa "Amortizimi për zëvendësim", për vitet që prona është në përdorim, nëse ka**

Raporti i Vlerësimit për Klubin Shumësportesh Partizani

161. Më datë 07.05.2008 (datë kur shtetasi *Fatmir Bektashi* caktohet si administrator i shoqërisë *ASG Poëer*) është përgatitur raporti i vlerësimit, nga ekspertët *Elvira Aliaj dhe Sali Preçi*.

Adresa e pronës është **Klubi Shumësportesh Partizani**, Rruga "Frosina Plaku" Tiranë dhe **Pishina e Klubit Shumësportesh** rruga e Durrësit, Laprakë, Tiranë.

Në pjesën përshkruese të këtij raport vlerësimi është evidentuar se objekteve u janë bërë shtesa anësore pa leje, se fasadat e objekteve dhe planimetritë e brendshme të godinave janë të ndryshuara. Sikurse dhe një pjesë e mirë e rifiniturës së brendshme e të jashtme të tyre është gjithashtu e ndryshuar pa miratimin e instancave përkatëse. Sallat e basketbollit e të volejbollit, me lartësi 10.6 m deri në 12.25 m janë të shtruara pothuaj tërësisht me parket druri përveç korridoreve anësore të kalimit që janë me pllaka granili. Janë evidentuar investime të mëvonshme në vitet 1996 – 2003 që kanë konsistuar në rikonstruksionine rifiniturës së brendshme të disa ambjenteve, si në palestrën e gjimnastikës, sallat e lojërave me dorë, kafazin e shkallëve e shesh pushimin që të ngjitet në katin e dytë të palestrës (*pikërisht atë të gjimnastikës*), në parket, pllaka veshje e shtrimi, suvatime muresh e tavani, punime gipsi, tavane të varura, dritare duralumini dopioxham, ndriçim, veshje kafazi shkalle, parmak shkallësh, disa dyer të jashtme e të brendshme, tualete e dhoma dushesh, në vlerën 1 424 009 lek. Ish palestra e mbyllur e atletikës, ka ndryshuar destinacion, përmasa dhe nëndarje në planimetri në vitet pas 1990 po që nuk figurojnë në investime të kryera nga Klubi Shumësportesh Partizani. Në palestrën e mundjes, është ndërhyrë me rikonstruksion të rifiniturës së brendshme të viteve 1996 – 2003 në vlerë 3 517 315 lekë. Kabinës elektrike, ndërtim i vitit 1971, pas rikonstruksionit të realizuar në Klub, në vitet 1996 – 2003, iu shtua dhe një kat në funksion të palestrës së gjimnastikës. Rrethimi është ndërtim i vitit 1971 – 1984, ndonëse e rikonstruktuar me investime në vitin 1996 – 2003 me vlerë 484 453 lekë.

Në lidhje me pishinën e notit në Laprakë, e cila në inventar figuron e përbërë nga një palestër, zyrë e vetë pishina, ndërtime të vitit 1988, në terren, për rrjedhojë të rikonstruksionit e zgjerimit të rrugës së Durrësit, ndërtimi dikur një katësh zyra e palestër e notarëve, është prishur totalisht, e si rrjedhojë e ndërtimeve pa leje, vetë gjurma e pishinës së dikurshme është zhdukur, **duke u ngritur mbi një godinë një katëshe pa dokumenta**. Objekti 1 katësh funksiononte si pikë servisi makinash, lavazh e magazinë.

Sip totale e truallit është 18 211 m² nga ku sip funksionale 13 934 m², sip nën objektet legale 4 277 m², sip e ndërtimit është 5 518 m². Në shkresën e Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Planifikimit Urban nr. 2263/1 prot datë 18.04.2008 për pjesën e Klubit Shumësportesh Partizani, që shtrihet në rrugën e Durrësit, **pishina e notit + zyra e palestra e notarëve, sip e truallit është 920 m²**, nga e cila sip nën objektin aktual jashtë inventarit është 600 m², sip funksionale është 320 m². Nga sip funksionale, infrastruktura rrugore sipas planit rregullues (*zgjerim i rrugës së Durrësit*) zë një sip prej 40 m². Theksojnë se për objektin aktual me sip 600 m² nuk kanë dokumentacion leje ndërtimi e projekt të miratuar për këtë arsye kemi: sip e truallit sipas inventarit (*duke hequr ato të cilat janë përdorur e do përdoren për qëllime publike, në rastin konkret rikonstruksion infrastrukturë rrugore sipas planit rregullues*) është 880 m² e sip nën objektin në inventar është 0 m².

Infrastruktura e zonës: ...Nuk janë bërë investigime nëse lidhjet me rrjetet e këtyre shërbimeve për objektet në inventar të zaptuara nga të tretët, janë legale apo jo.

Pronësia: Bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, pronar i objekteve të Klubit Shumësportesh Partizani është shteti dhe administrues është Ministria e Turizmit.

Bazuar në shkresën nr. 1036/1 prot datë 29.04.2008 të AKKP janë trajtuar me vendime të KKKP familjet Saliaga, Llagami e Begeja.

Bazuar në shkresën e ZVRPP nr. 3991/1 prot datë 06.05.2008 brenda sip totale të truallit prej 18 211 m² kanë të regjistruar pronësi mbi truall familjet **Begeja dhe Saliaga**, për sip totale 17 344.5 m² dhe mbi sip prej 866.5 m², sipas librit të ngastrave të asaj zyre është pronar shteti.

Bazuar në shkresën nr. 1035/1 prot datë 29.04.2008 të AKKP për territorin mbi të cilin ka qenë ndërtuar pishina e notit në Laprakë, nuk kemi konfirmim për njohje dhe kthim prone në favor të ndonjë ish pronari. Bazuar në shkresën e ZVRPP Tiranë nr. 3485/2 prot datë 06.05.2008 kjo pronë e cilësuar në kontratat bashkalidhur kësaj shkrese, si truall me sip 1200 m², mban nr. 12/27 dhe figuron e regjistruar në bashkëpronësi të **Esat Pira dhe Marita Osmani**. Ky regjistrim ka mbivendosje me pasuritë me nr. 12/25 dhe 12/28. Nga kjo zyrë, është vazhduar me konkluzionin se për këtë pronë nuk lëshohet vërtetim pronësie pasi prona nuk ka origjinë.

*Zhvillimi urban dhe përcaktimi i zonimit:Në planvendosjen e objektit që privatizohet ... janë përcaktuar funksionet e territorit në zona: **Banimi e sportive.***

Në pjesën e përcaktuar zonë banimi, ndodhur brenda territorit të Klubit Shumësportesh Partizani, ka plan studimor urban të miratuar nga KRRT e Bashkisë Tiranë për ndërtimin e godinave rezidenciale shumëkatëshe (*parkim+ambjente shërbimesh+banim*).

Bazuar në shkresën e ARKKP nr. 1036/1 datë 29.04.2008 përcaktohet se territori i Klubit Shumësportesh i ndodhur në Rr. "Frosina Plaku", shtrihet brenda zonimit nr 7/3 dhe në shkresën nr. 1035/1 prot datë 29.04.2008 të atij institucioni përcaktohet se territori i Klubit Shumësportesh i ndodhur në rrugën e Durrësit (*pishina e notit – Laprakë*) shtrihet brenda zonimit nr. 11/3.

Vlerësimi: Vlerësimi i objektit Klubi Shumësportesh Partizani është bazuar në VKM nr. 794 datë 21.11.2007 Kapitulli I paragrafi i 4 dhe paragrafi 5.

Vlera reale e tregut e pronës shtetërore objekt vlerësimi është shumatorja e elementëve të pasurisë:

Vlera e ndërtimit + vlera e truallit + vlera e mjeteve të xhiros.

Vlera e ndërtimit: Paraqitet në mënyrë tabelare vlera e ndërtimit të objekteve në inventar, të cilat i nënshtrohen privatizimit, total 4 325 47 40 lekë.

Vlera ndërtimore e pronës shtetërore në privatizim është 43 254 740 lekë.

Vlera e truallit: Bazuar në shkresën e ARKKP Tiranë, nr. 1036/1 prot datë 29.04.2008 pjesa e territorit të Klubit Shumësportesh Partizani e ndodhur në rrugën Frosina Plaku, në zonimin 7/3 e cila ka çmimin për 1m² truall = 26 787 lekë ose për të gjithë territorin kemi 18 211m² X 26 787 lekë/m² = 487 818 057 lekë.

Ndërsa bazuar në shkresën nr. 1035/1 prot datë 29.04.2008 të ARKKP Tiranë, përcaktohet se territori i Klubit Shumësportesh Partizani, i ndodhur në rrugën e Durrësit (*pishina e notit Laprakë*) në zonimin 11/3 ka çmim për njësinë e sip 1 m² = 20 473 lekë/m², që do të thotë që për gjithë territorin prej 880 m² kemi vlerën 18 016 240 lekë. Vlera e truallit objekt privatizimi është 505 834 297 lekë. Vlera e mjeteve të xhiros: është 0 lekë.

...Vlera reale e tregut e pasurisë shtetërore është përcaktuar në zbatim të legjislacionit në fuqi, në zbatim të VKM nr. 794 datë 21.11.2007, kapitulli I, paragrafi 4 dhe paragrafi 5...

...U tërhoqën pranë Institutit të Statistikave Tiranë, koeficienti i rivlerësimit, për zbatim për ndërtim e para viteve 1991 i cili është 7.671 herë, indeksi i kushtimit në ndërtim i cili për herë të parë nga ky institut është përcaktuar për vitin 1993 i cili është 48.7 %, indeksi i kushtimit në ndërtim i cili për tre mujorin e fundit të vitit 2007 (i fundit indeks i nxjerrë nga ky institut deri në datën e përgatitjes së raportit) i cili është 127.2 %.

Ndonëse në VKM – në nr. 794 datë 21.11.2007 kërkohet përcaktimi i vlerës reale të tregut të pronës shtetërore që privatizohet, për faktin se vlera kërkohet e ndarë për çdo element të pasurisë: vlerë ndërtimore + vlerë trualli + vlerë e mjeteve të xhiros, si dhe ku diktohet që çmimi për njësinë e truallit do të jepet nga AKKP dhe për përcaktimin e vlerës ndërtimore të kihen parasysh në rast se ka, vlera fillestare kontabël dhe amortizimi sipas VKM nr. 401 datë 23.10.1989 për përcaktimin e vlerës ndërtimore janë bazuar në standartet europiane të aprovuara për vlerësimin e pasurive, libri blu "Guiden Blu" autorizuar nga Tegova (Grupi European i shoqatave të vlerësuesve) në përputhje me standartet ndërkomëbtare të vendosura nga Tiavsc (Komiteti ndërkombëtar i standarteve të vlerësimit të aktivëve).

Prona objekt vlerësimi është një pronë, e cila haset rrallë në treg. Në të gjithë zonën përreth, nuk ka vlera tregu krahasuese, pasi nuk ka asnjë objekt sportiv (*palestër e terrene sportive*) që të jetë shitur në treg të lirë, ndërmjet një shitësi të vullnetshëm e një blerësi po të vullnetshëm, në transaksion ku palët të mos kenë lidhje me njëra tjetrën e të kenë vepruar me dije, kujdes e pa detyrime.

Për të gjitha përcaktimet e kufizimet e mësipërme, për rastin konkret mund të përdoret metoda e vlerësimit me krahasim të drejtëpërdrejtë apo metodat e vlerësimit si ajo e zhvillimit, fitimit e investimit apo metoda e mirëfilitë e kostos si dhe për faktin që kërkohet vlera e ndërtimit e ndarë nga ajo e truallit, grupi i ekspertëve ka përdorur vlerën fillestare kontabël (koston e ndërtimit në vitin përkatës) duke e sjellë në vlerën aktuale, duke i zbritur amortizimin fizik sipas kontabilitetit....

Përfundimi: Në përfundim të raportit të vlerësimit, grupi i ekspertëve përcakton se: Vlera reale e tregut për pronën shtetërore në privatizim Klubi Shumësportesh Partizani është shuma totale **549 089 037 lekë** e cila e ndarë në vlera të veçanta sipas elementëve të pasurisë është:

1. Ndërtesa – vlera **43 254 740 lekë**
2. Trualli – 505 834 297 lekë
3. Mjetet e xhiros – 0

Gjithsej 549 089 037 lekë

161.1. Komisioni i Vlerësimit me një informacion pa datë, ka parashtruar ndër të tjera se:....Mbështetur në VKM nr.794, datë 21.12.2007, **vlera totale e ndërtimit është 43 254 740 lekë ...Vlera e përgjithshme e truallit për Klubin Shumësportësh Partizani është 505 843 297 lekë.**

161.2. Me shkresën nr. 169 prot datë **12.05.2008** të Degës së Shoqërive Publike, Kryetari Irfan Hoxha, i ka dërguar METE-s, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare, Drejtorisë së Privatizimit Tiranë, kopje të dokumentacionit të vlerësimit për privatizimin e objektit Klubi Shumësportesh Partizani, Tiranë, njësi në administrim të Ministrisë së Turizmit, miratuar me shkresën nr. 953/1 datë 22.01.2008 të METE. Vlerësimi për privatizimin është si vijon: **Mjete kryesore në lekë - 43 254 740 lekë kurse mjete xhiro nuk ka.**

Sip e përgjithshme e truallit në m2 për Klubin Shumësportesh Partizani - 19 091 m2

1. Sip e përgjithshme për objektet dhe terrenet sportive për Klubin Shumësportesh Partizani në m2- 18 211 m2 nga të cilat Sip nën objekt në m2 - 4 277 m2 dhe Sip funksionale në m2- 13 934 m2
2. Sip e përgjithshme "Pishina Laprakë" në m2 - 880 m2 nga të cilat Sip nën objekt në m2- 560 m2 dhe Sip funksionale në m2 -320 m2

Vlera e truallit në lekë 505 834 297 lekë

162. Ndërkohë sipas aktit të ekspertimit të kryer nga ekspertët e caktuar nga prokuroria, vlera shumatore e ndërtimeve është 388 713 429 lekë, pra 345 458 689 lekë më shumë.

Ekspertët kanë përcaktuar vlerën e mësipërme, pasur parasysh pikën 4 dhe 5 të VKM nr 794 datë 21.11.2007 që kërkon përcaktimin e vlerës reale të tregut në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe amortizimin. Kështu ata i janë referuar Udhëzimit nr 2 datë 04.04.2007 "Për miratimin e koston mesatare të Ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit K për vitin 2007".

163. Me shkresën e METE nr 4660/1 prot datë 20.05.2008 Ministri i Ekonomisë, Genc Ruli, i ka përcjellë Ministrisë së Financave Drejtorisë së Administrimit dhe shitjes së Pronave Publike, dokumentacionin e vlerësimit për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani Tiranë.

163.1. Me memon dt 26.05.2008, shefi i sektorit të shitjes së pronave, shtetasi Nuri Sopaj, i është drejtuar shtetasit Urim Muja, me detyrë drejtor duke i dërguar informacion lidhur me fillimin e procedurave ligjore për privatizimin e objektit Klubi Shumësportesh Partizani. Sipas kësaj memo i bëhet me dije se me shkresën nr. 4660/1 prot datë 20.05.2008 të METE është dërguar dokumentacioni i vlerësimit për privatizim i objektit Klubi Shumësportesh Partizani Përpos të tjerave i është bërë me dije se në shkresën e ZVRPP Tiranë nr. 3431/1 dt 22.04.2008 "Kthim përgjigje" për pronësinë e truallit dhe HTR për objektin Pishina Laprakë, rezulton me mbivendosje me dy bashkëpronarë, pra rezulton të jetë private. ...Në miratimin e genplanit nga Urbanistika Ligjore e Bashkisë Tiranë, është vënë shënimi "Territori përfshihet në zonë sportive sipas planit rregullues dhe zonë banimi sipas vendimeve të KRRTRSH nr. 1 dt 07.03.2006 dhe nr 4 dt 21.11.2006 dhe sipas n 31 të ligjit për sportin "Objektet sportive jepen me koncension, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë". Pra nuk thuhet se mund të privatizohet.

Përsa më sipër, gjykojnë se, para se të fillojnë procedurat për privatizimin e këtij objekti duhet të kërkojmë pranë Zyrës Rajonale të KKP Tiranë vendimet përkatëse të kthimit dhe kompensimit të pronave subjekteve të shpronësuar. Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë lidhur me dokumentacionin e regjistrimit të pronësisë për Pishinën Laprakë.

Ndryshimi i dytë i ligjit për sportin

164. Sipas ndryshimeve që pësoi ligji nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për Sportin" me ligjin nr. 9816 datë 22.10.2007, hyrë në fuqi më 21.11.2007, neni 31 ndryshon duke u parashikuar se: "Objektet sportive jepen me koncension, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë".

Sipas ligjit nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet", neni 4 "Fusha e zbatimit të koncensioneve" parashikohet se: *1. Ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese për veprimtaritë ekonomike, në këta sektorë:dh) në arsim dhe sport...*

Sapo, parashikimi ligjor mbi ndalimin e privatizimit, i është sjellë në vëmendje shtetasit Urim Muja, nga shefi i sektorit Nuri Sopaj, konstatohet se me shkresën nr. 3845 prot datë **02.06.2008** Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i është adresuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Brendshme duke i dërguar për mendim projekt vendimin "Për propozimin e projekt ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" i ndryshuar dhe relacionin shoqërues. ...

Me shkresën nr. 4039 prot datë **16.06.2008** Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ylli Pango, i është adresuar Këshillit të Ministrave, Sekretarit të Përgjithshëm Gjergj Lezhja, me lëndë "Dërgohet projekt akt për shqyrtim dhe miratim" për projekt vendimin "Për propozimin e projekt ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për Sportin" i ndryshuar si dhe relacionin shoqërues.

Bashkalidhur konstatohet relacioni me nr. 2689 prot datë 16.06.2008 i nënshkruar nga ministri Ylli Pango ku parashtrohet sa vijon: " ...Ministria e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e ka parë si të domosdoshëm rishikimin e ligjit nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" i ndryshuar si pasojë e problemeve dhe boshllëqeve të hasura në ligjin për sportin në favor të mbështetjes dhe zhvillimit të tij për arritjen e niveleve ndërkombëtare". Të reja të këtij projekt ligji janë:

1. Në ligjin aktual është parashikuar vetëm një mënyrë e dhënies në përdorim me anë të koncensionit, të objekteve sportive. Në përputhje me politikën qeveritare për zhvillimin e sportit, rritjen e shërbimit cilësor për arritjen e niveleve të larta në sport, tashmë vlerësohet se këto objekte sportive e kryejnë funksionin e tyre edhe nëse ju jepen në pronësi të tretëve pa ndryshuar destinacionin e tyre. ...Përsa më sipër, duke shpresuar që ky projekt ligj do të gjejë mbështetjen tuaj si një nga hapat më të rëndësishëm që po bëhet në këtë kuadër, si dhe duke ju falenderuar për mirëkuptimin. "

164.1. Më datë 18.06.2008, dokumentohet të jetë mbajtur proces verbali për mbledhjen e Këshillit të Ministrave të kësaj date, për projekt ligjin "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" të ndryshuar. Mbledhja drejtohet nga Kryeministri Sali Berisha. Në mbledhje mungojnë ministri i punëve të jashtme Lulzim Basha dhe ministri i Turizmit Ylli Pango.

Përveç anëtarëve të Këshillit të Ministrave në mbledhje marrin pjesë edhe zëvendës ministri i punëve të jashtme Anton Gurakuqi dhe zëvendës ministri i Turizmit, Ekrem Spahia.

Përmbajtja e proces verbalit:

Sali Berisha: Ky projekt ligj vjen i propozuar nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Jemi dakord?

Ekrem Spahia: Kisha unë diçka. Ndoshta është mirë që të diskutohet sepse amendimet e ligjit "Për sportin" i cili është miratuar në muajin tetor të vitit shkuar dhe pa kaluar 8 muaj përsëri bëhen.

Sali Berisha: Ta them unë pse bëhen. Sepse ai amendim ishte një lobing i turpshëm që ishte bërë në kurriz të pronarëve. Me atë amendim ne kishim hequr një nen, kishim amenduar ligjin, i cili i njihte pronarët të drejtën e pronës kur e kishte të vetën dhe mizorisht, komplotisht na ishte sjellë për të mos i njohur të drejtën atij (meqënëse flasim haptas këtu) dhe unë u

mahnita, e ndjeva veten të turpëruar vet, që kisha pranuar një gjë të tillë dhe ajo nuk mund të vinte. Kjo është arsyeja.

Nëqoftë se do Presidenti i Klubit, të shkojë të blejë tokë, të ndërtojë stadium, por jo në kurriz të atij që ka ngelur i rrjepur, i pjekur 60 vjet t'ia mbaj dhe të bëj pas me mafie. Me këto nuk jam dakord unë, nuk kam këtë moral. Çfarë i takon pronarit do ta marrë pronari, çfarë nuk i takon pronarit, të jepet me koncension. Kështu e kishim ne, por lobet e presidentëve, na kishin prurë këti ndryshimin si pa gjë të keq dhe përjashtuar tërësisht pronarin.

Ekrem Spahia: Nuk kam kundërshtim, se ajo është politikë tamam në drejtimin...Ka qenë koncensione ose privatizohet, kurse me projekt ligjin e ri në mënyrë taksative...

Sali Berisha: Kur ka pronarë sigurisht që privatizohet. A e di ti, që ne merremi me pronën dhe ç'është e vërteta nuk jemi aty ku duhet. Çfarë na dilte në mbledhjen e fundit që bëmë për pronat? Na dilte që ligji i pronave nuk na lejon ne asnjë veprim. Zero veprim në pronën publike pa kompensuar pronarët. Edhe ne në ligjin e legalizimeve kemi bërë përmirësim në interes të pronarit dhe në çdo ligj tonë, nëqoftë se duam ta zgjidhim problemin. Po t'i them unë pronarit se do ta mbash ti këtë për sport, unë i them para teje. Këtë i the, po se çfarë bën ai, atëherë nuk më intereson më.

Ekrem Spahia: Nëse do të kemi procedurat e sakta, besoj se edhe këto terrene sortive asgjesohen. Kam parasysh që disa gjëra, ambjentet përtej stadiumit ose përballë stadiumit Selman Stërmasi, mbarapa stadiumit Qemal Stafa, Klubit Partizani dhe klubit Dinamo.

Sali Berisha: Që të gjitha t'i marrin pronarët. Nuk ekzistojnë më stadiume brenda qyteteve si në Tiranë. Unë po të isha kryetar bashkie dhe po e bëri ai, e përgëzoj. Stadiumet të dyja i zëvendësoj, i çoj në zona të tjera, stadiumet nuk duhen në mes të qytetit, por dalin anash gjithmonë. Dhe ka shumë kërkesa për stadiumet, por ajo nuk është punë e qeverisë, është punë e bashkisë dhe çdo kërkesë që vjen u them "shko tek bashkia". Por që t'i mbaj unë për presidentët, që vijnë e bëjnë baste gjithë ditën, prona pronarëve, asnjë milimetër nuk mbaj.

Ekrem Spahia: Nuk pengon askënd ligji, që një president të blejë tokë.

Sali Berisha: Ata duan të luajnë me pronë publike dhe me pronë private, të bëhen vetë milionerë, të bëjnë baste...Merr fund kjo punë. Ata që na kanë sjellë ne atë ndryshim, ata janë treguar tmerrësisht të ndikuar, të kapur nga presidentët. Merre ndrysho ligjin, e miratuar ligjin në fund të 2005 dhe për 8 muaj është bërë ndryshimi.

Ekrem Spahia: Pikërisht kjo do të jetë që ndoshta do të hasë problem atje në parlament. Duhet parë arsyeja pse.

Sali Berisha: Arsyeja pse është, sepse ai ka qenë lobist.

Ekrem Spahia: Prandaj thashë ...

Sali Berisha: Dakord. Duhet të keni parasysh një gjë që ndryshime të tilla nuk duhet të bini më në qeveri. Unë mbeta shumë i zhgënjyer.

Ridavn Bode: Se i kemi pranuar që t'i sjellin drejtëpërdrejtë, siç i ka sjellë dhe ky. Edhe ndryshimet e ligjit, kur janë bërë herën e parë janë bërë me shpejtësi. Dhe këti ka shumë ministri, që pa i konsultuar fare me ministrinë e linjës, na i sjellin direkt në mbledhjen e qeverisë dhe nuk jemi në gjendje që në mbledhje te qeverisë t'i shikojmë....

164.2. Është miratuar VKM nr. 906 dt 18.06.2008, nënshkruar nga Kryeministri Sali Berisha, dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ylli Pango, me të cilën është vendosur "Propozimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" të ndryshuar" për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkalidhen këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".

Projekt ligji bashkalidhur VKM ka parashikimin e ndryshimit të nenit 31 në këtë formë: "Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të kundërt jepen me

koncension, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukture" me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.

165. VKM nr. 906 datë 18.06.2008 është depozituar në Kuvend me nr. 2344 datë 02.07.2008.

Më dt 16.07.2008 ora 10.00, është dokumentuar mbledhja e drejtuar nga nënkryetar i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, për diskutimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 dt 21.04.2005 " Për Sportin" i ndryshuar', ku në këtë mbledhje e ftuar nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve shfaqet si përfaqësuese shtetësja **Violeta Shqevi**.

Në relacionin për projektligjin është parashikuar se: *...Në ligjin në fuqi është parashikuar vetëm një mënyrë e dhënies në përdorim, me koncension, të objekteve sportive. Në përputhje me politikën qeveritare, për zhvillimin e sportit, rritjen e shërbimit cilësor, për arritjen e niveleve të larta në sport, vlerësohet se këto objekte sportive mund ta kryejnë funksionin edhe po t'u jepen në pronësi ish pronarëve të truallit. ...*

Në raportin e mbajtur më dt 16.07.2008 në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, është shqyrtuar ky projekt ligj. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në relacion parashtrohet se ky projekt ligj është në vijim të përmirësimeve të njëpasnjëshme ligjore që i shërbejnë funksionimit sa më të mirë të federatave sportive dhe Komitetit Olimpik Shqiptar për zhvillimin e sportit, me synim që sportistët shqiptarë të arrijnë nivele sa më të larta në të gjitha veprimtaritë sportive në vendin tonë e jashtë tij. **Këtij qëllimi i shërben mënyra e dhënies së objekteve sportive në pronësi edhe ish pronarëve, kur ka të tillë, angazhimi i ndjeshëm i pushtetit vendor për financimin e klubeve sportive që janë në juridiksionin e tyre etj. ...**Në aspektin procedural, **projektligji vjen si nismë legjislative e Këshillit të Ministrave**, është depozituar në Kuvend dhe i është nënshtruar rregullave procedurale të shqyrtimit e miratimit të projektligjeve sipas Rregullores së Kuvendit...

Pra sipas relatorëve në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, është se, edhe mënyra e dhënies së objekteve sportive në pronësi ish pronarëve, kur ka të tillë, i shërben qëllimit të këtij projektligji që është zhvillimi i sportit. Edhe në relacionin për projektligjin është parashikuar shprehimisht se zhvillimi i sportit..., mund ta kryejnë funksionin objektet sportive edhe po t'u jepen në pronësi ish pronarëve të truallit.

165.1. Megjithatë risjellim në vëmendje ndryshimin e propozuar dhe miratuar të nenit 31 të ligjit të sipërcituar: *...Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të kundërt jepen me koncension, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 "Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukture" me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.*

Pra në këndvështrim të leximit sipas teknikës legjislative, interpretimi i kësaj dispozite është që objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit kur ka të tillë, pa i vendosur asnjë kufizim. Kurse, në rast se jepen me koncension, atyre duhet të mos u ndryshojë legjislacioni. Ky konkluzion arrihet pikërisht pasur parasysh formulimin e nenit 31 para ndryshimeve që ka pësuar ligji "Për sportin" me ligjin nr. 9816 datë 22.10.2007: Neni 31 i ligjit për sportin parashikonte se *ndryshimi i statusit të objekteve sportive në varësi të pushtetit qendror apo vendor bëhet në përputhje me ligjin nr. 7926 datë 20.04.1995 "Për transformimin e*

*ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” dhe sipas pikës 2 **objektet sportive jepen me koncension apo privatizohen me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni në përputhje me ligjin nr. 7973 datë 26.07.1995 “Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë”.***

Pra nëse qëllimi, që befas qeveria vlerësoi se duhet të rikthehej, pra që edhe ish pronarët mund të privatizonin objektet pa u ndryshuar destinacioni, atëherë formulimi i duhur për të thënë këtë gjë, ishte pikërisht parashikimi i para vitit 2007. Por tashmë, në vitin 2008, qartësisht qëllimi që ish pronarët që kryenin privatizimin të mos ndryshonin destinacionin është hequr.

166. **Me ligjin nr. 9963 datë 21.07.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 datë 21.04.2005 “Për sportin” të ndryshuar” me propozim të Këshillit të Ministrave përcaktohet ndryshimi i nenit 31 në këtë mënyrë: *Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të kundërt jepen me koncension, në përputhje me ligjin nr. 9663 datë 18.12.2006 “Për koncensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.* Ky ndryshim i fundit është botuar në FZ më datë 01.08.2008, duke hyrë në fuqi më datë **16.08.2008.****

167.1. I pyetur më datë 22.01.2024, shtetasi *Ylli Pango*, deklaroi se, *ka mbajtur detyrën e Ministrit të Kulturës në periudhën kohore mars 2007 – mars 2009 dhe më vonë ka qenë Drejtor i Agjencisë së Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit në varësi të Kryeministrit dhe disa ministrave, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në vitin 2013. Ai deklaroi se, nuk ka pasur dijeni që shtetasi Jamarbër Malltezi ka qenë një nga trashëgimtarët e familjes Begeja dhe njohja me të ka ndodhur kur është bërë ministër, pasi Jamarbëri ka qenë Drejtor i Projektit të Bankës Botërore për zhvillimin e turizmit dhe shtetasi Ylli Pango, e ka gjetur drejtor. Në lidhje me ndryshimet e propozuara në ligjin për sportet, që të lejohej edhe privatizimi, theksoi se, që në mbledhjet e para të qeverisë ku ai ka marrë pjesë, është insistuar vazhdimisht për të gjitha ministratë për të përshpejtuar proceset e privatizimit të aseteve publike mbasi nga Kryeministri është vënë në dukje që ministratë ishin mbrapa me procesin e privatizimit. Kjo i është fiksuar sepse ka qenë Ministër i ri, baza që kërkohej kjo gjë i referohej faktit që meqënëse ishin ekonomi tregu, është ngulmuar shumë për privatizimin. Për rrjedhojë dhe ndryshimet që ndodhën në ligjin e sipërcituar kanë ardhur si pasojë e kërkesës së vazhdueshme të Kryeministrit për të gjitha ministratë, për të përshpejtuar proceset e privatizimit, mbasi gjykohej se kishin mbetur prapa.*

Raporti i Vlerësimit për Klubin Futbollit Partizani:

168. Vetëm një ditë pas vendimit të Këshillit të Ministrave për propozimin e ndryshimeve në ligjin për sportin që i jep mundësi pronarëve të privatizonin objektet sportive pa asnjë kufizim, përgatitet Raporti për Vlerësimin për **Klubin e Futbollit “Partizani”, Tiranë**, më datë 19.06.2008, nga ekspertët Elvira Aliaj dhe Sali Preçi. Evidentohet se shtetësja Mynyre Pajana është zëvendësuar nga shtetasi Irfan Hoxha.

Në këtë raport vlerësimi, parashtrahet ndër të tjera se *brenda këtij rrethimi përfshihet, një pjesë e sip funksionale të ish Institutit Hidro Meteorologjik sot Instituti i Energjisë i Ujit dhe i Mjedisit Tiranë dhe dy fushat e lojërave me dorë të Klubit Shumësportesh Partizani.*

Në lidhje me hotelin dhe dhomat e dusheve dhe tualeteve, përshkruhet kryerja e një investimi në vitin 1995. Nga dokumentacioni teknik i vënë në dispozicion (*fletë projekti të rikonstruksionit të objektit*) vihet re se ndarjet e funksioni i ambjenteve të brendshme në

katet e objektit 4 katësh (*hoteli*) ndryshojnë me atë faktike. Në projekt për secilin kat kemi një bllok tualetesh pranë kafazit të shkallëve ndërkohë që me ndërhyrje të mëvonshme kemi pothuaj çdo dhomë gjumi me tualetet e instaluara pranë tyre. Fushat e futbollit të cilat janë të rikompozuara në krahasim me pozicionin e tyre të para vitit 1993, duke u krijuar nga një fushë e vetme e madhe, në tre fusha futbollit të përmasave më të vogla. Fushat janë të konturuara me kangjiella, janë të sheshuara. Të mirëmbajtura por ende larg standarteve bashkëkohore.

Nga matjet në terren, bazuar edhe në konfirmimin me shkresën nr. 2136/1 prot datë 18.04.2008 të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Planifikimit Urban, sip totale e truallit të pronës Klubi i Futbollit Partizan është **26 524 m²**. Sip nën objektet aktuale ku përfshihen objektet në inventar dhe ndërtimet pa leje, shprehur ndryshe ato jashtë inventari është **775 m²**. Sipas nën objektet në inventar është **519 m²**. Sip totale e ndërtimit (e shtrirë në të gjitha katet) për hotelin + dushet + garderoba është **1613.2 m²**. Sa më sipër, sip nën objektet legale në inventar është **519 m²** dhe sip funksionale **26 005 m²**.

Bazuar në shkresën e ZVRPP nr. 5574/1 prot datë 17.06.2008 brenda sip totale të truallit prej 26 524 m² kanë të regjistruar pronësi mbi truall familjet Alimehmeti, Begeja, Vaqarri që mbulojnë me këto pronësi sip totale **22 263 m²** dhe mbi sip prej **4261 m²**, është pronar shteti.

Pasur parasysh zonën, ekspertët kanë vlerësuar se, çmimi për 1 m² truall është 26 787 lekë ose për të gjithë territorin **710 498 388 lekë**.

Pra sipas këtyre përllogaritjeve, për sipërfaqen prej 4261 m², pronarët duhet të paguanin edhe shumën prej 114 139 407 lekë.

Si referencë për vlerën kontabël është marrë ajo e pasqyruar në dokumentacionin e vënë në dispozicion e cila ka rezultuar nga rivlerësimi i fundit i bërë në vitin 1997.

Shuma totale 720,607,168 lekë e cila është e ndarë në vlera të vecanta:

- Ndërtesa (10,108,780 lekë),
- Trualli (710,493,388 lekë),

Ky raport vlerësimi mban firmën e ekspertëve Elvira Aliaj dhe Sali Preçi.

168.1. E pyetur më datë 21.09.2022 shtetësja **Elvira Aliaj** deklaroi se: “...Unë jam vlerësuese e pasurive të paluajtshme, që nga shkurti 2004 deri në dhjetor 2018 dhe kam punuar si person fizik, e regjistruar pranë QKR-së me nr nipti K41406009P. Unë nuk e di se si më kanë përzgjedhur për këtë procedurë por di që më kanë njoftuar. Më ka ardhur njoftim me postë, urdhëri për ngritjen e komisionit. Në atë kohë kisha mbiemrin Aliaj. Unë me ekspertin Sali Preçi kam bashkëpunuar në përgatitjen e këtij raporti ku vlerat kontable, informacioni i marrë nga Instat, normat e amortizimit ekonomik janë vlera që i percakton nga eksperti kontabël. Pretendoj se, kur kanë shkuar në terren nuk kanë gjetur njeri, ambjenti ishte bosh.

E pyetur nëse në vlerësimin e pronës, a kanë mbajtur parasysh investime të mundshme ndër vite, deklaroi se ...ne kemi marrë në konsideratë si vlerë fillestare rivlerësimin e bërë në fundvitin 1997. Kemi shkruar një paragraf në raport në faqen 19, se supozojmë se ky rivlerësim

*i vënë në dispozicionin tonë, është i ligjshëm, autorët e tij kanë pasur në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të cilat ne na mungojnë. Pra këtë vlerë ne e kemi marrë siç ishte. Në vijim kemi marrë koeficientin e rritjes të indeksit të kushtimit në ndërtim nga '97 deri në 2008, i cili ka rezultuar 162.6 % më e lartë. Vlerës fillestare kontabël të fund vitit 1997 i është zbritur amortizimi fizik sipas kontabilitetit, shprehur në faqen 20 – 21 sikurse bazuar në koeficientin e vendndodhjes së pronës, kjo vlerë ka një koeficient në rritje 0.70. Për të parë ndryshimet e ndodhura në terren kemi shfrytëzuar informacionin nga ortofotot në vite. Shoh gjithashtu që në raport vlerësimi kemi parashtruar në faqen 7 të tij se kemi shënuar në kllapa (fletë projekti të rikonstruksionit të objektit). Ndërkohë në lidhje me sende të luajtshme nuk kemi bërë rivlerësim pasi unë jam vlerësuese e pasurive të paluajtshme. **Kemi konstatuar në disa nga dhomat e hotelit, që ka pasur krevate por jo shtresa, si çarçafë etj.***

*.... Unë jam inxhinieri gjeodete (topografe) dhe ndodhur në këto kushte, **mbështetur në dokumentacionin përkatës dhe në matjet në terren kemi konstatuar sa m2 tokë e regjistruar në favor të familjeve pronare binte në territorin e sport klub Partizanit duke specifikuar se pikërisht një pjesë prej 4261 m2, është pronar shteti.***

E pyetur nëse kanë kryer vlerësimin sipas vlerës së tregut referuar parashikimeve përkatëse në aktet nënligjore, deklaroi se *...Unë vetë kam bërë studim tregu pavarësisht se nuk e kam shënuar në raport, kam shkuar edhe në ZVRPP dhe kam parë vlerat e shitjes të tokave dhe nëse kishte objekte hotel te shitura, qoftë edhe ambjente sportive, dhe ajo çfarë ka rezultuar është fakti që vlera e tokës ishte e barabartë me vlerën e referencës, sa u mor në konsideratë. Mund të shihni në faqen 20. **Për objektin dhe ambjente sportive nuk ka pasur vlera krahasuese.***

.... Shtetasin Jamarbër Malltezi e njoh por nuk kam asnjë lloj marrëdhënie me të. Kur kam bërë raportin e vlerësimit nuk e kam ditur se ky ishte trashëgimtar i familjeve pronare. Më vonë, nga media kam mësuar se ky shtetas është trashëgimtar i familjes Begeja.

169. Me shkresën nr. 72/13 prot dt 27.06.2008 Dega e Shoqërive Publike, e nënshkruar nga kryetari Irfan Hoxha, pranë METE, i përcjell METE-s, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare, Drejtorisë së Privatizimit Tiranë, dy kopje të dokumentacionit të vlerësimit për privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të Futbollit Partizani, njësi nën administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me shkresën nr. 50/1 datë 19.09.2007 të METE.

Ky dokumentacion pasqyrohet se është përgatitur në zbatim të VKM nr. 794 datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes". Vlerësimi për privatizim është si vijon: Mjete kryesore 10 108 780 lekë; Sip e përgjithshme e truallit 26 524 m2, Sip nën objekt 775 m2, Sip funksionale 26 005 m2, Vlera e truallit 710 498 388 lekë.

170. Ndërkohë sipas aktit të ekspertimit të kryer nga ekspertët e caktuar nga prokuroria, vlera e ndërtimeve është Vlera e Ndërtimit për Zonën Fiskale me Nr.7/3 të Qytetit të Tiranës, në referencë të Udhëzimit me Nr. 2 datë.04.04.2007 e skontuar me Normat e Amortizimit 0975% në Vit, 100'045'744 Lek kurse vlera e Ndërtimit për Murin Rrethues është konsideruar Vlera Fillestare Kontabël në shumën e skontuar me Normat e Amortizimit, vlera përfundimtare rezulton 1'048'791 Lek.

Pra referuar grupit të ekspertëve të caktuar nga Ministria që kanë nxjerrë vlerën e ndërtesave 10 108 780 lekë dhe vlerës që kanë nxjerrë ekspertët e caktuar nga prokuroria 101 094 535 lekë, kemi një diferencë të vlerësuar më shumë nga ekspertët e caktuar nga organi procedues, prej 90 985 755 lekë.

Ekspertët kanë përcaktuar vlerën e mësipërme, pasur parasysh pikën 4 dhe 5 të VKM nr 794 datë 21.11.2007 që kërkon përcaktimin e vlerës reale të tregut në zbatim të legjislacionit në fuqi si dhe amortizimin. Kështu ata i janë referuar Udhëzimit nr 2 datë 04.04.2007 "Për miratimin e kostos mesatare të Ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit K për vitin 2007".

Lindja e shoqërisë Homeplan dhe angazhimi i mëtejshëm për zhvillimin e pronës

171. Shtetasi Fatmir Bektashi, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë Kontakt sh.p.k., në këtë kohë, vijon lidhjen e kontratave me shtetasin Jamarbër Malltezi, ku ky i fundit paraqitet në cilësinë e përfaqësuesit të familjes Begeja, kontrata këto në kuadrin e zhvillimit të ndërtimeve. Kështu, me dy kontrata e konkretisht ato me nr. 3306 rep nr. 422 kol datë **15.05.2008** dhe nr 3307 rep nr 423 kol datë **15.05.2008**, të lidhur para noteres Ruko Sako, rezulton familja Begeja e përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe shoqëria e ndërtimit Kontakt sh.p.k. të cilat lidhin marrëveshje që familja Begeja të bllokojë pronën e saj deri më datë 31.12.2008.

Respektivisht pronat janë: *Pasuri nr. 3/167 vol 17 faqa 96 ZK 8220 sip 6318.0 m2 regj hipotekor nr. 744 datë 12.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuri nr. 3/165 vol 17 faqa 94 ZK 8220 sip 470 m2 regj hipotekor nr. 743 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuri nr. 3/163 vol 17 faqa 92 ZK 8220 sip 495 m2 regj hipotekor nr. 471 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuri nr. 3/156 vol 15 faqa 182 ZK 8220 sip 300 m2 regj hipotekor nr. 471 datë 03.07.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuri nr. 3/116 vol 12 faqa 211 ZK 8220 sip 435 m2 regj hipotekor nr. 713 datë 12.02.1997 me adresë rruga Frosina Plaku;*

Dhe me kontratën e dytë, pronat janë: *Pasuri nr. 3/138, Vol. 15, Fq. 55, ZK 8220, me sipërfaqe 3120 m2, e regjistruar me numër regjistri hipotekor Nr.74, datë 21.03.2007; Pasuria nr. 2/235 vol 15 faqa 181 ZK 8220 sip 380 m2 regj hipotekor 417 datë 03.07.2007 me adresë rruga Frosina Plaku; Pasuria me nr. 3/162 vol 17 faqa 91 ZK 8220 sip 190 m2 regj hipotekor nr. 740 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuria me nr. 3/164 vol 17 faqa 93 ZK 8220 sip 210 m2 regj hipotekor nr. 742 datë 11.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda; Pasuria me nr. 3/166 vol 17 faqa 96 ZK 8220 sip 27 m2 regj hipotekor nr. 745 datë 12.12.2007 me adresë rruga Ndre Mjeda*

Kontratat nënshkruhen nga shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi.

172. Pikërisht në këtë kohë, megjithëse shtetasi Fatmir Bektashi ishte angazhuar nëpërmjet shoqërisë Kontakt sh.p.k. për kryerjen e privatizimit, zhvillimin e pronës, konstatohet se ndërmer një nismë tjetër, krijimin e një shoqërie të re tregtare, e cila do të përdorej si investitore.

Por nëse shoqëria Kontakt sh.p.k. kishte marrë përsipër të gjitha shpenzimet, investitorët kishin lidhur që më datë 18.02.2008 një marrëveshje investimi, çfarë roli dhe cila ishte nevojshmëria e krijimit të kësaj shoqërie? Nga tërësia e provave të administruara dhe specifikisht duke sjellë në vëmendje edhe dokumentin e cituar më sipër "Kontratë porositë EKA. Final version Homeplan" ku shfaqen shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhemal Begeja dhe Fatmir Bektashi si porositës që financojnë ndërtimin, duke parë në vijim se shoqëria Homeplan sh.p.k. fillimisht financohet nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe shoqëria Kontakt sh.p.k. e më pas vetëfinancohet nga ndërtimet, vërteton se shoqëria Homeplan sh.p.k., në fakt ka shërbyer vetëm si një hallkë e dokumentimit të gjithë fitimeve, që realizohen nga ndërtimet që zhvillohen në territoret e

Klubeve Sportive Partizani dhe si kanal i kalimit të shpërblimit të padrejtë/mitës shtetasit Jamarbër Malltezi por edhe shpërblimit të shtetasit Xhimi Begeja. Shtetasi Jamarbër Malltezi shpërblehej për angazhimin e tij që dokumentohet të jetë nëpërmjet ushtrimit të pushtetit të vjehrrit të vet, shtetasit Sali Berisha kurse shtetasi Xhimi Begeja, për ndihmën e ofruar duke u shfaqur kryesisht ai në terren, në institucione etj, për kryerjen e procedurave.

Pra, nëse shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, kishin rënë dakord që do të investonin, sipas marrëveshjeve të datës 18.02.2008, atëherë derdhjen e parave për investim, fare mirë mund ta kishin bërë në një llogari të hapur posaçërisht, si edhe kishin përcaktuar ose ta krijonin së bashku shoqërinë e re që emërtohet Homeplan sh.p.k., duke investuar shumat që ata kishin përlllogaritur në fakt, 3 972 400 euro dhe 9 157 354 euro, për financimin,

I pyetur si deklarues shtetasi *Fatmir Bektashi* ka deklaruar: *"...në vijim kam krijuar edhe shoqërinë Homeplan sh.p.k. fillimisht si ortak i vetëm dhe më pas janë shtuar si ortakë shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja. Mua nuk më kujtohet nëse këta dy ortakë, Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja kanë qenë apo jo që në fillim ortakë themelues me mua në shoqërinë Homeplan sh.p.k... Konceptualisht Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja kanë qenë gjithmonë pjesë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. pavarësisht kur janë pasqyruar gjërat në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ne kemi pasur marrëveshje verbale me Jamarbër Malltezin dhe Xhimi Begeja ku unë kam pasur vetëm 40 % të kësaj shoqërie."*

I pyetur si person nën hetim shtetasi *Fatmir Bektashi* ka deklaruar: *"...me Jamarbërin dhe Xhimin bëmë një akt marrëveshje ortakërie, me pjesë unë 40 %, Jamarbëri 35% dhe Xhimi 20%. Këto përqindje nënkuptonin pjesët që do merrnim nga ndërtimi, zhvillimi i pronës. Kjo marrëveshje më kujtohet që është bërë në vitin 2008 dhe pas lidhjes së kësaj marrëveshje vendosëm që të krijojmë shoqërinë Homeplan sh.p.k. Dua të them se ne i kërkuam të gjithë pronarëve të tjerë që nëse deshën të merrnin më shumë pjesë të përfshiheshin në ortakëri, me qëllim që të bllokoni kërkesat pafund të tyre për të rritur përqindjen por ata u tutën. Qëllimi i përfshirjes në marrëveshje me mua të Jamarbërit dhe Xhimit, ishte që ata të mbulonin problematikat që na shkaktonte nga pronarët dhe poseduesit e paligjshëm. Unë, Jamarbëri dhe Xhimi vendosëm të krijojmë shoqërinë Homeplan. ..."*

172.1. Rezulton se me nr 1429/844 rep/kol dt **19.05.2008**, para noteres Laura Pustina, shtetasi **Fatmir Bektashi**, në cilësinë e ortakut themelues të shoq tregtare Homeplan sh.p.k., ka kërkuar redaktimin e aktit të themelimit të shpk Homeplan sh.p.k. Bashkalidhur është edhe statuti i kësaj shoqërie tregtare dt 19.05.2008, vërtetuar nënshkrimi me nr 1474 rep nr 870 kol dt 22.05.2008 nga notere Laura Pustina. Për regjistrimin e kësaj shoqërie dhe përgatitjen e akteve të nevojshme, me prokurën nr 1532 rep nr 896 kol dt 28.05.2008, para noteres Laura Pustina, është autorizuar shtetësja Joana Qelesi. Më dt 03.06.2008 regjistrohet kjo shoqëri, me NIPT K81803020E, me adresë rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet AL – 1023, me kapital themeltar 100 000 lekë.

Shtetësja Laura Pustina, nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit të saj si notere dhe motra e saj Andia Pustina, shfaqen si persona që kanë një rol të veçantë në zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, në drejtim të ushtrimit të aktivitetit të shoqërive Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k.

Të dyja këto shtetase, qartësisht rezulton se janë zgjedhur nga shtetasit Malltezi, po meqënëse shtetësja Andia Pustina në këtë periudhë rezultonte të ishte e punësuar pranë AKSHI-t,

marrëdhëniet siç është përmendur, krijohen me të atin e saj shtetasin Luan Pustina, pikërisht ditën që në emrin e tij regjistrohet shoqëria Studio Pustina.

I pyetur si deklarues, shtetasi **Fatmir Bektashi** deklaroi: “...Me çdo letër të shoqërisë Homeplan sh.p.k. është marrë shtetësja Andia Pustina e cila është motra e noteres Laura Pustina dhe unë deklarim të hollësishëm mund të jap vetëm pasi të konsultohem me Andian dhe dokumentacionin e mbajtur prej saj. Unë di të them që shoqëria Homeplan sh.p.k. është krijuar që në fillim bashkë me dakordësinë e Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja, ku ata do të quheshin investitorë pavarësisht se prej tyre nuk u dha asnjë lekë por kishin marrë përsipër të bindnin pronarët e tokës për të lidhur marrëveshje për realizim ndërtimi. Çdo dokument është përgatitur tek notere Laura Pustina në lidhje me shoqërinë Homeplan sh.p.k. Po tek kjo notere është përgatitur edhe marrëveshja e investimit që kam lidhur me Jamarbër Malltezin dhe Xhimi Begeja. Unë aktualisht nuk mbaj asnjë dokument të shoqërisë Homeplan sh.p.k. pasi i mban Andia Pustina. Që në fillim nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja është vendosur si financiare e shoqërisë Homeplan sh.p.k. shtetësja Andia Pustina pas kërkesës që unë i bëra Jamarbërit dhe Xhimit që Homeplani të kontrollohej nga një person që ishte person i besuar i Jamarbërit dhe Xhimit. Unë i thashë ta merrnin ata vetë kontrollin financiar....Këtyre dy personave, Jamarbërit dhe Xhimit po me marrëveshje verbale i kam thënë që të caktonin ata vetë përfaqësuesin e tyre për financat e shoqërisë Homeplan, dhe ata kanë pasur si ekonomiste, pra përfaqësuesin e tyre për të mbajtur bilancet e Homeplan shtetasen Andia Pustina, kurse unë kam pasur financiarë të punësuar. Ligjërisht çdo dokument financiar e çoja unë tek Andia. Raportet i mbaja unë me Andian dhe ia çoja muaj për muaj. Andia i fuste gjithçka në bilancet e Homeplane...”

I pyetur si person nën hetim shtetasi **Fatmir Bektashi** është shprehur: “...Me përgatitjen e dokumentacionit për krijimin e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është marrë Laura dhe Andia Pustina. ... Dua të sqaroj se që në fillim unë me Jamarbërin dhe me Xhimi Begejen ramë dakort që letrat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. do të mbaheshin nga një ekonomist kontabël i autorizuar i zgjedhur nga Jamarbëri dhe Xhimi. Këta dy të fundit zgjodhën studion Pustina. Të atin e Andias, emrin e të cilit nuk e mbaj mend e kam takuar nja dy herë para se të ndërronte jetë, pranë zyrës së Andias, zyrë e cila ndodhet tek Libri Universitar, por unë di që me letrat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është marrë Studio Pustina, pasi edhe unë kontaktet i kam pasur vetëm me këtë të fundit, mesa më kujtohet.”

I pyetur si person nën hetim, shtetasi **Fatmir Bektashi** deklaroi: “..... që në fillim unë me Jamarbërin dhe me Xhimi Begejen ramë dakort që letrat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. do të mbaheshin nga një ekonomist kontabël i autorizuar i zgjedhur nga Jamarbëri dhe Xhimi. Këta dy të fundit zgjodhën studion Pustina. Të atin e Andias, emrin e të cilit nuk e mbaj mend e kam takuar nja dy herë para se të ndërronte jetë, pranë zyrës së Andias, zyrë e cila ndodhet tek Libri Universitar, por unë di që me letrat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është marrë Studio Pustina, pasi edhe unë kontaktet i kam pasur vetëm me këtë të fundit, mesa më kujtohet. ...Une përpara dhe madje ishte kërkesë e imja ndaj Jamarbërit dhe Xhimit që të zgjidhnin një person që unë nuk e njihja për të mbajtur letrat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. Edhe dokumentacioni që është përgatitur për krijimin e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është bërë nga Andia Pustina. ...”

Gjithashtu nga aktet ka rezultuar se auditues i shoqërisë Homeplan sh.p.k. është zgjedhur shtetësja Shpresa Breçani. I pyetur si deklarues, shtetasi **Fatmir Bektashi** deklaroi: “...Unë nuk e kam njohur fare shtetasen Shpresa Breçani, por ka qenë Andia Pustina që ma ka

rekomanduar. ..” I pyetursi person nën hetim shtetasi Fatmir Bektashi, ka deklaruar: “...Shpresa Breçani nuk njihet prej meje por di që është zgjedhur si audituese për shoqerine Homeplan sh.p.k. nga studio Pustina...” .

Madje shtetasi Fatmir Bektashi qartësisht nxjerr në pah, faktin se shoqëria Homeplan sh.p.k. pavarësisht se nuk paraqitet e dokumentuar deri në vitin 2018 me tre ortakë, është udhëhequr dhe menaxhuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi. I pyetur si deklarues shtetasi **Fatmir Bektashi** është shprehur: “...Të gjitha aktet që lidhen me aktivitetin e shoqërisë Homeplan sh.p.k. si nga ana financiare dhe juridike i kanë përgatitur shtetaset Andia Pustina dhe Laura Pustina dhe unë vetëm i nënshkruaja. Dua të sqaroj se shoqëria Homeplan sh.p.k. nuk ka pasur asnjëherë arkë dhe çdo gjë, çdo veprim financiar është kryer nëpërmjet llogarive bankare. Edhe tërheqja e dividendit kryhet në të njëjtën mënyrë. Edhe në lidhje me vendimmarrjet e shoqërisë Homeplan sh.p.k. unë nuk kam ndonjë rol, pra që të shpreh mendim për vendimet e shoqërisë. Unë nuk kam marrë pjesë ... në procesin e vendimmarrjes por vetëm i nënshkruaj. Për nënshkrimin e çdo akti që lidhet me shoqërinë Homeplan sh.p.k. unë shkoj tek zyra e Andia Pustinës, që ndodhet përballë librit Universitar dhe i nënshkruaj aty. Mua më telefonon Andia për të vajtur dhe për të nënshkruar. Gjithashtu shtoj se selia e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është në zyrën e Andia Pustinës, përballë me librin Universitar...”

Më datë 02.05.2023 është pyetur shtetësja *Andia Pustina*, e cila ka deklaruar se, me Jamarbër Malltezin, kanë miqësi ajo, motra e saj e quajtur Laura. Me Jamarbërin janë njohur në shkollë, rreth viteve 1994 – 1995, ku motra e saj Laura, vazhonte juridikun dhe Jamarbëri ishte në rrethin shoqëror të motrës dhe kështu është njohur edhe Andia me ta. Po kështu, deklaroi njohje edhe me Argita Berishën, e cila ka qenë gjithashtu në shkollë në të njëjtat vite me ta.

Shtetësja Laura Pustina, rezulton të jetë e martuar me shtetasin Andi Toma, ku ky i fundit, evidentohet se më datë 08.01.2008, është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 07.10.2013. Shtetasi Andi Toma së bashku me shtetasin Marin Biçoku, rezultojnë madje të kenë përfaqësuar ndër të tjerë Këshillin e Ministrave në çështjen e konkluduar me vendimin nr 24 datë 10.11.2006 të Gjykatës Kushtetuese me objekt shfuqizimin si të të papajtuësëm me Kushtetutën të akteve normative të Këshillit të Ministrave për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike dhe për disa shtesa në ligjin për prokurimin publik dhe për urbanistikën si dhe për interpretimin përfundimtar të nenit 101 të Kushtetutës. Po ky shtetas, ndër të tjerë bashkë me shtetasin Marin Biçoku kanë përfaqësuar Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit në çështjen e konkluduar me vendimin nr 29 datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore (Bashkia Tiranë) dhe pushtetit qendror (KRRTRSH, MPPTT dhe Policia e ndërtimit) etj.

Gjithashtu emri i këtij shtetasi shfaqet dhe në planin e veprimit për reformimin e kapaciteteve institucionale dhe shëndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Ent Publik të miratuar me VKM nr 341 datë 27.02.2008, ku shtetasi Andi Toma evidentohet si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Ligjore Mbështetëse dhe i cituar si zyrtar i konsultuar.

Shtetësja Andia Pustina, rezulton të jetë e martuar me shtetasin Endri Pema. Ky i fundit me VKM nr 329 datë 16.04.2009 të nënshkruar nga shtetasi Berisha është emëruar në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, detyrë të cilën e ka mbajtur deri sa është luruar me VKM nr 259 datë 27.04.2010.

Shtetësja Andia Pustina, rezulton se pak kohë, pasi shtetasi Sali Berisha, ka marrë pushtetin, është emëruar në dt 09.03.2006 sipas mbledhjes së këshillit mbikqyrës të shoqërisë Albelekom sh.a., me aksioner Ministrinë e Ekonomisë, në kohën që ministër ka qenë shtetas Genc Ruli, si zv/drejtorë Ekonomike e kësaj shoqërie (*shih proces verbalin dt 09.03.2006 mbi zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Ministrave*). Vetë shtetësja Andia Pustina ka deklaruar se ka punuar pranë Albelekom deri në shtator 2007. Konstatohet se anëtarë të Këshillit Mbikqyrës, ndër të tjerë kanë qenë edhe shtetasit Neritan Sejamini dhe Etion Kapedani. (*shtetasi Etion Kapedani shfaqet, si më poshtë pasqyrohet, si zyrtar i Bashkisë Tiranë, në vendimmarjet në lidhje me lejet e ndërtimit mbi territoret ku shtriheshin dy klubet sportive Partizani.*).

Më pas kjo shtetase, rezulton të ketë qenë e punësuar pranë Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në periudhën 2007 – 2011 (*shih deklarin datë 02.05.2023*). Rezulton se ka qenë pikërisht shtetasi Etion Kapedani, që ka urdhëruar me urdhërin nr 2 datë 01.10.2007, emërimin e shtetases Andia Pustina si drejtor i drejtorisë së Koordinimit të Projekteve dhe Standarteve Teknike. Me urdhërin nr 62 datë 26.08.2008 kjo shtetase është komanduar sërish nga drejtori i përgjithshëm Etion Kapedani, në pozicionin e Zëvendës Drejtores së Përgjithshme të AKSHI-t.

Me urdhërin nr 1128 datë 21.09.2011, shtetësja Andia Pustina, rezulton të jetë emëruar si **drejtorë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik** në Bashkinë e Tiranës, nga kryetari i bashkisë Lulzim Basha dhe me urdhërin nr 131 datë 06.02.2012 të po këtij kryetari bashkie, emërohet si **Drejtorë e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore** pranë Bashkisë së Tiranës dhe me urdhërin nr 132 datë 06.02.2012 komandohet edhe drejtorë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik në Bashkinë e Tiranës, duke qëndruar e komanduar deri në prill 2012. Kjo shtetase është larguar nga detyra e saj pranë Bashkisë Tiranë, përfundimisht më datë 29.07.2015.

Nga ana tjetër, rezulton se, shtetasi Etion Kapedani, ka mbajtur pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i emëruar nga vetë kryeministri shtetasi Sali Berisha, me urdhërin nr 148 dt 12.09.2007 deri më dt 01.10.2009. Pas lirimit nga kjo detyrë, mesa konstatohet nga urdhëri nr 652 dt 01.10.2009 të nënshkruar nga Ministri i Brendshëm Lulzim Basha, ky shtetas ka mbajtur pozicionin e punës të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme. Ky shtetas rezulton se në vijim, me urdhërin nr 927 dt 27.07.2011 emërohet nga Kryetari i Bashkisë Lulzim Basha, administrator i përgjithshëm në Bashkinë Tiranë për të qëndruar në këtë detyrë deri më dt 29.07.2015, njësoj si shtetësja Andia Pustina.

172.2. Shoqëria Homeplan sh.p.k. **regjistrohet më dt 03.06.2008** me NIPT K81803020E, me adresë rruga Budi, me objekt ndërtim dhe kryerje e operacioneve ndërtim pasurish të paluajtshme, blerje, shitje etj. Administrator i kësaj shoqërie është shtetasi Fatmir Bektashi.

173. Sjellim në vëmendje se shtetasi Fatmir Bektashi, më dt 07.05.2008 ishte caktuar si administrator i shoqërisë ASG Power Albania sh.a. Kjo shoqëri e regjistruar me NIPT K71416002M më dt 16.06.2006, si ekspert kontabël ka ndër të tjerë shtetasin **Sali Preçi**, anëtar të këshillit mbikqyrës ndër të tjerë shtetasin Florenc Kola (*bashkëshorti i shtetases Flutura Kola*) dhe që prej dt 07.05.2008 si administrator shtetasin Fatmir Bektashi. Referuar VKM nr 778 dt 14.11.2007 të nënshkruar nga kryeministri i kohës, shtetasi Sali Berisha, i është miratuar leja nr 1 datë 13.11.2007 për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare me rrymë të cazhduar, të interkonjeksionit Seman (Shqipëri) – Foxhia (Itali), leje kjo e lëshuar nga ministri i

Ekonomisë. Kjo shoqëri shfaqet si kliente e shoqërisë Kola & Associates përgjatë viteve 2007 – 2009.

173.1. Lidhjet e shtetasve Malltezi me shtetasen Flutura Kola, gjithashtu shfaqen të forta. Shtetësja Argita Malltezi, për vitin 2006 e në vijim, në varësi të periudhave, deklaroi pagesa si konsulente ligjore apo si avokate pranë ILDKPKI. Sipas akteve të depozituara në QKB, rezultoi se më datë **05.10.2005** Banka Emporiki pasqyroj bllokimin e një shumë prej 100 000 lekë si kapital fillestar për regjistrimin e shoqërisë *Malltezi & Kola* sh.p.k. Konstatohet është përpiluar akti i themelimit dhe statuti i kësaj shoqërie, me ortakë themelues, shtetaset Argita Malltezi dhe Flutura Kola (Tafaj), me shëbime në fushën juridike, akte këto të vërtetuara më datë 24.10.2005 para noteres Laura Pustina. Mbështetur në kërkesën e këtyre dy bashkëortakeve të datës 26.10.2005, është vendosur me vendimin nr 34263 akti datë 28.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistrimi i shoqërisë me emërtimin "*Malltezi & Kola*" sh.p.k. Sipas një vërtetimi me nr 582 rep datë 08.12.2005 të noteres Laura Pustina pasqyrohet se dy bashkëortaket kanë bërë kërkesë për mbylljen e kësaj shoqërie dhe fshirjen e regjistrimit si person juridik. Bashkalidhur gjendet edhe vendimi nr 1 i asamblesë së ortakëve datë 08.12.2005 për mbylljen e kësaj shoqërie. Me vendimin datë 29.12.2005, rezultoi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur depozitimin e vendimit të asamblesë së ortakëve për mbylljen e shoqërisë dhe fshirjen e regjistrimit.

Më dt **16.12.2005** shtetësja Argita Malltezi paraqet kërkesë për t'u regjistruar si person fizik për të ushtruar veprimtari private me objekt shërbime avokatie dhe konsulente me vend të ushtrimit të aktivitetit në adresën rruga e Barrikadave, Pall. Ndërtim Vila, Ap. 7 që është edhe selia që ishte caktuar për shoqërinë "*Malltezi & Kola*". Mbështetur në këtë kërkesë me vendimin nr 34858 dt 19.12.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendos regjistrimin si person fizik të shtetasës Argita Malltezi. **Ky subjekt rezultoi i çrregjistruar sipas të dhënave në QKB më dt 16.10.2009.**

Sipas informacionit të dhënë nga organet tatimore, kjo shtetase rezultoi në fakt të jetë regjistruar si person fizik me nipt K61415009Q, të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 15.02.2006 me objekt aktiviteti "*Avokate*", me status "*Aktiv*" nga data 15.02.2006 kurse në QKB më datë 19.12.2005. Organet tatimore përveç për vitin 2008, nuk disponojnë të dhëna, pra deklarata të këtij subjekti.

Por megjithëse duket se shtetësja Argita Malltezi, ka çrregjistruar subjektin e saj të çelur në dhjetor 2005, duket se ajo ka vijuar të punojë me shtetasen Flutura Kola. Kjo e fundit, rezultoi të ketë regjistruar fillimisht personin fizik me Nipt K61415010U, më dt 19.12.2005, i cili është çrregjistruar me dt 15.05.2008 me vend ushtrim aktiviteti, rruga e Barrikadave. Në datë 13.12.2007 ka regjistruar subjektin "*Kola & Associates*" sh.p.k. me NIPT K72413009J, me emrin tregtar *Kola & Associates*, me adresë Rruga e Barrikadave, pall. Ndërtim vila, ap. 7, si **ortake e vetme.**

Fakti që shtetësja Argita Malltezi ka vijuar të punojë me shtetasen Flutura Kola, evidentohet ndër të tjera, nga një dokument i gjendur nga të dhënat e ekstraktuara nga hard drive i sekuestruar pranë studio Pustina, sipas të cilave, kjo shtetase ka lëshuar dy vërtetime për shtetasen Jonida Rustemaj, në vitin 2019, me të cilin vërtetoi se shtetësja Jonida Rustemaj ka qenë e punësuar pranë subjektit "*Kola & Associates*" sh.p.k. me NIPT K72413009J në periudhën nga dt 01.09.2008 deri në dt 01.09.2009 dhe nga data 01.09.2009 deri në datë 01.12.2009.

Gjithashtu, referuar bilanceve të viteve 2008 dhe 2009 të subjektit "Kola & Associates" sh.p.k. me NIPT K72413009J shtetësja Argita Malltezi është paguar si furnitor, ku në vitin 2008 specifikohet në librin e madh se ka ofruar konsulenca ligjore.

Edhe nga të dhënat e llogarive bankare konstatohet se ka një llogari të përbashkët pranë ABI Bank, me nr 001420100011249 në euro në emër të shtetasve Argita Malltezi dhe Flutura Kola. Për vitin 2006 në këtë llogari janë kredituar nga disa subjekte pagesa të ndryshme.

E pyetur më datë 01.03.2024 shtetësja **Flutura Kola** ka deklaruar se, në vitin 1995 është emëruar pedagogje në Universitetin e Tiranës ku dhe vazhdon aktualisht. Në periudhën 2000-2005 është shkëputur dhe ka punuar për UMNK në Kosovë fillimisht si përkthyes dhe më pas si këshilltare ligjore. Në vitin 2005 u rikthye në fakultet dhe hapi aktivitet privat fillimisht si person fizik me emrin Flutura Kola, më vonë është regjistruar shoqëria me emrin "KOLA & ASSOCIATES" sh.p.k, subjekt i cili prej vitit 2019 është pezulluar. Ndërkohë në vitin 2019 ka hapur subjektin Flutura Kola Person Fizik të cilin e ka aktiv dhe aktualisht. Në lidhje me punësimin përveç punësimin në Universitetin e Tiranës ka dhënë mësim part time dhe në shkollën e Magjistraturës dhe të Avokatisë. Argitën e njej prej vitit 1991 pasi e ka pasur shoqe klase në Fakultetin e Drejtësisë. Abin e ka njohur po në vitin 1991 fillimisht si i dashuri i Gitës dhe më pas si bashkëshortin e saj. Me të dy ka marrëdhënie shoqërore shumë të mira, i ka shumë miq. Ka punuar në fakultet me Gitën dhe në Kosovë kanë qënë përsëri bashkë dhe ruan marrëdhënie miqësore shumë të mira me të dy. Gjithashtu me Argitën në tetor ose nëntor të vitit 2005 në momentin kur dëshironte të regjistronte studio ligjore i është sygjerruar nga dhoma e avokatisë që studio duhet të kishte dy avokatë dhe së bashku me Argitën i duket se kanë krijuar një shoqëri të thjeshtë dhe kur shkuan ta regjistrojnë tek dhoma e avokatisë kuptuan që nuk ishte kërkesë ligjore funksionimi si ent juridik, por mjaftonte që dy avokat të ishin në një zyrë. Në këto kushte e prishën krijimin e shoqërisë së thjeshtë dhe të dyja krijuan secila më vete zyrën e vetë, por që ishte në të njëjtin ambient i cili ishte në pronësinë e Fluturës. Deri në fillim të vitit 2009 e kanë ushtruar aktivitetin në të njëjtën zyrë me Argitën, por secila me NIPT-in e vetë.

Shtetasin Fatmir Bektashi e njej, me siguri e ka njohur para vitit 2009 pasi vinte tek zyra e Argitës, por nuk di të thotë me siguri datën e saktë kur e ka njohur. Pas njohjes së parë këtë shtetas e ka takuar shumë rrallë.

Aktiviteti i shtetasës Flutura Kola lidhet vazhdimisht me atë të shtetasve Malltezi, si në drejtim të sigurimit të përfitimeve në mënyre private (rasti i blerjes së një sërë tokash në vitin 2007 që i shiten më pas shoqërisë Alpha përfaqësuar nga shtetasi Damir Fazllic) ashtu edhe të ndërthurrjes së aktivitetit të ushtruar në fushën juridike (kështu mund të përmendim regjistrimin e shoqërisë tregtare Petrol Slovenia Tirana Éholesale sh.a. mbi bazë të kërkesës së shtetasës Flutura Kola (Tafaj) në muajin korrik 2007, ku ndër të tjerë ka si anëtarë të këshillit mbikqyrës shtetasin Damir Fazllic etj.).

Shtetësja Joana Qeleshi e autorizuar për regjistrimin e shoqërisë Homeplan, rezulton të jetë autorizuar për veprime pranë QKB-së edhe nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe Agim Gjinali (shih prokurën nr 1436 rep nr 850 kol dt 16.06.2008) apo nga shtetasi Damir Fazllic për shoqërinë Croën Acquisitions sh.p.k. (shih prokurën nr 2177 rep nr 1223 kol dt 16.07.2008).

E pyetur më dt 01.03.2024 shtetësja **Flutura Kola**, ka deklaruar se, ndër të tjerë, ka pasur të punësuar në zyrën e saj avokatët Sokol Barçi, Joana Qeleshi. Kujton që Joana Qeleshi ka bërë praktikën tek studio e avokatisë dhe më vonë është punësuar për një periudhë kohore para se të fillonte magjistraturën. Nuk e kujton me saktësi kohën kur Joana ka qënë e punësuar e saj.

E pyetur nëse punonjësit e saj kanë kryer shërbime për shoqëritë Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k., deklaroi se nuk kujton ndonjë gjë konkrete por nuk përjashtohet mundësia që të kenë kryer ndonjë regjistrim në QKB.

Shoqëria Homeplan sh.p.k. është lënë në menaxhim të shtetases Andia Pustina, pjesë e studios Pustina. Fillimisht shtetësja Andia Pustina rezultoi e regjistruar si person fizik me NIPT K31518039G, e regjistruar më datë 30.03.1999 por që me vendimin e gjykatës datë 02.04.2007 është çregjistruar, pra disa muaj para se të emërohej pranë AKSHI-t. Megjithatë, shtetësja Andia Pustina pretendon se nuk është marrë në këtë periudhë me aktivitet kontabël, duke dashur të shpëtojë edhe veten nga aktiviteti fillestar i shoqërisë Homeplan sh.p.k., në fakt rezultoi në dosjen e punësimit të kësaj shtetaseje, të administruar pranë AKSHI-t, sipas CV-së së gjendur aty, që vetë kjo shtetase ka vetëdeklaruar se **që nga prilli 1998 deri në shkurt 2006 ka qenë e punësuar pranë Studio Pustina si drejtoreshë.**

173.2. Aktiviteti i studios Pustina, ndërkohë që shtetësja Andia mbante detyra të tjera shtetërore, vijon të ushtrohet nën emrin e babait të saj Luan Pustina, i regjistruar më dt 19.06.2006 me NIPT K71819004J. Por shtetësja Andia Pustina, nga të dhënat e administruara nga akti i ekspertimit, rezultoi se evidentohet në emailin e përcjellë nga adresa mcipustina@yahoo.com, në lidhje me aktivitete të ndryshme, siç është psh në komunikime që lidhen me Albëind Energy (shih emailin e datës 12.04.2008, ekstraktuar nga akti i ekspertimit të aparateve telefonike të shtetases Andia Pustina). Nga të dhëna të ekstraktuara nga aktet e ekspertimit të pajisjeve kompjuterike të sekuestruara pranë studio Pustina, qartësisht evidentohet angazhimi i kësaj shtetaseje me aktivitetin kontabël që rezultonte në emër të babait të saj por që për shkak të punësimit të saj në funksione shtetërore, nuk mund ta evidentonte. Në këtë mënyrë ajo rezultoi e angazhuar që në fillim me shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Nga një prej dokumentave të sekuestruar pranë studio Pustina, dokument i lëshuar nga shoqëria Homeplan sh.p.k. nënshkruar nga Fatmir Bektashi dhe konceptuar nga asistente financiare Denada Dosti, me nr. 234 prot datë 01.04.2010 me lëndë "Lista e faturave dhe dokumentave drejtuar zyrës kontabile Pustina" pasqyrohet se : "Poshtë shënuar janë lista e dokumentave që do i dërgohen zyrës kontabile"...Në vijim evidentohen të renditura dokumenta si fatura tatimore shitje, statement bankar... Dorëzimi i dokumentave të tilla, ka vijuar dhe në një prej tyre, evidentohet se më datë 20.04.2010 në krah të nënshkruesit Fatmir Bektashi është vendosur emri i Andia Pustina. Në vijimësi të këtyre dokumentave konstatohet se më datë 19.05.2010 krahas Fatmir Bektashit ka nënshkruar edhe Andia Pustina. Kjo shtetase vijon të nënshkruajë këto dokumenta herë pas here. Në një ndër këto dokumenta, konkretisht ai me datë 04.06.2010 për shkruhet me nr rendor 9 "Mandat tërheqje F.Bektashi për Xh.Begeja". Nga tërësia e këtyre dokumentave gendet me vlerë të përmendet se dërgohen situacione punimesh, statement bankar, kontrata sipërmarrje, akt marrëveshje, kontrata shkëmbimi, kontrata porosie dhe vënie trualli në dispozicion për investime, fatura, listëpagesa të kontributeve, formularurdhër pagese tatimesh etj.

Më dt 25.01.2011 shtetasi Luan Pustina lëshoi prokurë duke autorizuar shtetasit Besmir Ali dhe Odeta Fishta që kryejnë veprime për çregjistrimin e personit fizik në emrin e tij dhe ky çregjistrim bëhet i mundur dhe pasqyrohet në QKB më dt 31.03.2011. Shtetasi Luan Pustina, më dt 18.01.2011 themelon shoqërinë Studio Pustina të cilën e regjistron më dt 20.01.2011 me NIPT L11320002B ku qartësisht nga tërësia e të dhënave aktiviteti i kësaj shoqërie është ushtruar nga shtetësja Andia Pustina, e cila shfaqet zyrtarisht vetëm më dt 05.02.2018 kur emërohet si administratore në emër të të atit dhe më dt 17.12.2018 kur i dhurohen aksionet nga i ati. Kjo shoqëri, pasqyrohet të lidhë kontratë shërbimi profesional me shoqërinë tregtare

Homeplan sh.p.k., sipas të cilës studio do të shpërblehet me 500 euro në muaj, më dt 30.01.2011. Konstatohet se shtetasi Luan Pustina nënshkruan akte edhe në vitin 2011, 2012.

173.3. Fakti që për kontrollin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë Homeplan, është angazhuar drejtpërdrejtë shtetasi Jamarbër Malltezi, pasi nga sa rezulton nga tërësia e të dhënave i është premtuar dhënia e përfitimit nga zhvillimi i ndërtimeve si mitë/përfitim i paligjshëm për pushtetin e ushtruar dhe atë që do të ushtronte në vijim vjeherri i tij shtetasi Sali Berisha, rezulton edhe nga fakti se punonjës të shoqërisë Homeplan apo persona që merren me regjistrimin e shoqërisë Homeplan janë shtetas që punojnë për shtetasen Flutura Kola siç është shtetasi Sokol Barçi dhe Joana Qeleshi.

Si audituese e kësaj shoqërie, shtetësja Shpresa Breçani, është mbesa e shtetasit Sali Berisha (vajza e motrës së këtij të fundit e quajtur Hajrie Osmani). Kjo shtetase pasqyrohet me lidhje të ngushta me familjen Malltezi dhe Berisha (shih prokurën e posaçme nr 601 rep nr 109 kol datë 09.09.2021 me të cilën shtetësja Argita Malltezi i ka dhënë një sërë tagresh kësaj shtetaseje).

Vijimi i procedurave të privatizimit, publikimi për privatizim

Publikimi për privatizim

Klubi i Futbollit Partizani:

174. Megjithëse Dega e Shoqërive Publike kishte përcjellë që me shkresën e datës 27.06.2008, Drejtorisë së Privatizimit Tiranë, pranë METE, dy kopje të dokumentacionit të vlerësimit për privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të **Klubit të Futbollit Partizani, vetëm një ditë pas miratimit të ligjit nr. 9963 dt 21.07.2008 (miratuar me ligjin nr. 9963 datë 21.07.2008) për ndryshimet në lidhje me ligjin "Për Sportin", me shkresën Nr. 6120/1 Prot, dt 22.07.2008, Drejtoria e Privatizimit pranë METE, i dërgon Ministrisë së Financave, dokumentacionin për privatizim. Në këtë shkresë parashtrohet se është përcaktuar vlera e objektit gjithsej 720 607 000 lekë: mjete kryesore 10 109 000 lekë dhe vlera e truallit 710 498 000 lekë, sip gjithsej 26 524 m² dhe sip nën objekt 775 m².**

Me memon dt 11.08.2008 shtetasi Nuri Sopaj, shefi i sektorit i është adresuar Drejtorit Urim Muja, ku i ka bërë me dije se nga verifikimi i dosjes për privatizim, rezulton se dokumentacioni i përcjellë nga METE me shkresën nr. 6120/1 prot datë 22.07.2008, ka mangësi e konkretisht nuk janë dërguar vendimet përkatëse të KKP të cilat duhet të jenë pjesë e dosjes bashkë me hartat e pronësisë përkatëse. Me shkresën Nr. 8362 Prot, datë 12.08.2008 Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, i ka kërkuar Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave "Konfirmim pronësie trualli të objekteve në proces privatizimi". Konkretisht janë kërkuar vendimet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të vitit 2007 për katër familje dhe për familjen Llagami ai i vitit 1999. Këto vendime, i janë dërguar me shkresën nr. 2489/1 prot datë 15.08.2008 të drejtorit Bledar Dervishaj, të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë.

174.1. Me shkresën Nr. 8378 Prot. dt 13.08.2008, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, i ka dërguar Degës së Shoqërive Publike material për njoftim me afishe, për privatizim objekti, ku referuar përmbajtjes së shkresës, njoftimi bëhet në zbatim të udhëzimit Nr. 6364, datë 03.07.2008 "Për zbatimin e VKM-së Nr.794, datë 23.11.2007", pasi ka pronarë trualli. Por në këtë kohë ende nuk kishin hyrë në fuqi ndryshimet e ligjit për sportin

që lejonin privatizimin e objekteve sportive. Për këtë arsye, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9963 datë 21.07.2008 që pas solli ndryshime në ligjin "Për sportin" (hyrja në fuqi ka ndodhur më datë 16.08.2008), më datë **25.08.2008**, nga Dega e Shoqërisë Civile është vendosur publikimi për privatizim i objektit "Klubi i Futbollit Partizani" në rrugën Frosina Plaku. Në njoftim është përcaktuar vlera fillestare e ankandit 10 109 000 lekë, sip e përgjithshme 26 524 lekë, vlerë trualli 710 498 000 lekë. **Afati i publikimit fillon më datë 18.08.2008 dhe mbaron më datë 06.09.2008.** Specifikisht njoftimi i referohet ish pronarëve ku i orienton se çfarë dokumentash duhet të paraqesin.

Shtetasit Mynyre Pajana dhe Fitore Korbi, kanë dokumentuar në proces verbalin dt **25.08.2008** mbi vendosjen e publikimit për privatizim të Klubit të Futbollit Partizani, duke parashtruar se në ambjentet e objektit në fjalë, punonjësi që ishte prezent, nuk pranoi të firmosë proces verbalin.

174.2. Nga përfaqësuesit e familjeve të njohura pronare fillojnë të paraqiten kërkesat për të ushtruar të ushtruar të drejtën e parablerjes, siç është ajo me nr. 1425 prot dt **29.08.2008** (hyrje), drejtuar Drejtorisë së Ankandit dhe shitjeve të pronave publike, nga shtetësja **Adela Llagami**, kërkesa nr. 1428 prot datë 01.09.2008 (hyrje) nga shtetësja **Mirniye Llagami**, kërkesa nr. 1435 prot datë 02.09.2008 (hyrje) nga shtetasi **Fatri Tafaj**, kërkesa nr. 1458 prot datë **05.09.2008**, e shtetasit **Blendi Marika** (si trashëgimtarë të **Rexhep Alimehmeti**), duke sqaruar se si pronarë të truallit me sip 7440 m² që shtrihet në territorin e Klubit të Futbollit Partizani, **mbi sip e pronës së tyre nuk shtrihet asnjë objekt por është truall në gjendje të lirë**), kërkesa nr. 1459 prot datë **05.09.2008**, e shtetasve **Rudina, Ardian dhe Adnan Llagami**.

Me kërkesën nr. 1456 prot datë 04.09.2008 (hyrje) drejtuar shtetasit Ridvan Bode, Ministër i Financave, shtetasit Urim Muja drejtor i AKKP, trashëgimtarët e familjeve pronare **Begeja, Saliaga, Vaqarri dhe Alimehmeti**, paraqesin kërkesën për ushtrim të së drejtës së parablerjes. Këto familje, sipas kërkesës, **përfaqësojnë mbi 86.6 % të truallit nën objekt të Klubit të Futbollit Partizani.** Sjellin në vëmendje VKM nr. 794 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes" datë 21.11.2007 pjesë e katërt "Procedura e shitjes së pronës shtetërore" pika 17 ku përcaktohet se: "Kur sip e tokës pronë e subjektit të shpronësuar shtrihet në mbi 70 % të sip së truallit nën objekt, për objektin që privatizohet, e drejta e parablerjes shtrihet në të gjithë objektin. Kjo vlen edhe për rastet kur ka disa bashkëpronarë dhe ndërmjet tyre ka një marrëveshje të dokumentuar". Përsa më sipër, trashëgimtarët e familjeve të sipërcituara, gëzojnë të drejtën e parablerjes për të gjithë objektin e privatizimit që në këtë rast është Klubi i Futbollit Partizani.

Për familjen Begeja, kjo kërkesë është nënshkruar nga shtetasi Xhimi Begeja, megjithëse nuk rezulton të ketë ndonjë akt përfaqësimi për këtë të fundit.

175. Blerja e Klubit të Futbollit, **rezulton se është marrë përsipër nga shoqëria "Kontakt" sh.p.k.** Me shkresën dt **04.09.2008**, Banka Credins, i drejtohet Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pranë Ministrisë së Financave, me Garancinë nr. 2810/04.09.2008 duke parashtruar se: *Duke qenë se shoqëria Kontakt sh.p.k. me administrator Fatmir Bektashi, ka marrë përsipër të realizojë blerjen e Klubit të Futbollit Partizani, për llogari të ish pronarëve të truallit dhe trashëgimtarëve të familjeve: Mahmut dhe Xhemal Begeja, ata (Banka) janë garantuesit e blerjes së mësipërme deri në shumën totale prej 2 021 800 lekë, shumë e cila është e pagueshme në mënyrën dhe monedhen e përcaktuar në shpalljen*

për shitje. Marrin përsipër të paguajnë sapo të bëhet kërkesa e parë me shkrim dhe pa qenë nevoja të bëhet argumentim i kërkesës, çdo shumë brenda kufirit prej 2 021 800 lekë në llogarinë nr. 01040307880....Kjo garanci është e vlefshme deri më datë 04.02.2009.

176. Me akt marrëveshjen nr 2892 rep nr 487 kol dt **29.09.2008** para noteres Gentjana Shkodra, janë paraqitur shtetasit **Jamarbër Malltezi** në cilësinë e palës dhe përfaqësuesit: *Haki Begeja, Nysret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirije Lika, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin*; me prokurën nr 2165 rep nr 248 kol datë 03.05.2006 *Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Teuta Malka, Bashkim Kadiu, Mirban Kadiu, Nerime Piro*; me prokurën nr 9 rep nr 7 kol datë 04.01.2007 të notere Edlira Hyseni i *Orinda Malltezi*; me prokurën nr 10086 rep nr 1542 kol datë 31.12.2007 të notere Ruko Sako i *Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Bashkim Bekteshi*); **Silvana Bello**, në cilësinë e palës dhe të përfaqësuesit (me prokurën nr 4998 rep nr 667 kol datë 10.07.2008 të notere Ruko Sako të: *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Tirëe Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi*); *Behixhe Tafaj* përfaqësuar nga **Fatri Tafaj**; *Myhyrije Verivolli, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnand Llagami, Sadete Llagami*, përfaqësuar nga *Adela Llagami, Adela Llagami, Mirnije Llagami* (përfaqësuar nga *Adela Llagami*), *Aleksandra Llagami* (përfaqësuar nga *Ervin Llagami*), *Ervin Llagami, Artur Llagami* (përfaqësuar nga *Ervin Llagami*), **Igli Vaqari** personalisht dhe në cilësinë e përfaqësuesit të *Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari, Milva Arapi, Liliana Arapi, Luan Arapi, Arben Arapi, Fiqerete Vaqari, EvaVaqari*. Sa më lart cilësohen Familjet pronare, të cilat paraqiten në këtë akt marrëveshje, me cilësinë e pronarit të truallit në të cilën aktualisht ushtron veprimtarinë Klubi i Futbollit Partizani.

...Pjesa II...Neni 1. *Pjesmarrja në privatizim*. Familjet pronare në bashkëpunim me njëra tjetrën angazhohen që në bazë të së drejtës së parablerjes që zotërojnë të hyjnë në procesin e privatizimit të Klubi i Futbollit Partizani me qëllim privatizimin e objekteve dhe aseteve të tjera të kësaj ndërmarrje. Familjet pronare në privatizimin e aseteve të Klubit të Futbollit Partizani do të kontribuojnë sipas vlerës së përcaktuar nga agjensia kompetente e privatizimit për objektet që ndodhen në pronat respektive të çdo fam pronare

Neni 2. *Pronësia mbi truallin*. Familjet pronare njohin dhe respektojnë faktin se Privatizimi i Klubit të Futbollit Partizani nuk do të ndikojë dhe as të çënojë të drejtën e pronësisë mbi tokën dhe në kufijtë e njohur dhe kthyer sipas vendimeve respektive të dhëna në favor të familjeve pronare nga KKKP (AKKP)

Neni 3. *Plotësimi i dokumentacionit*. Familjet pronare nënshkruese të kësaj (pjestarët e tyre) akt marrëveshje angazhohen që pjestarët e tyre drejtëpërdrejtë ose me anë të përfaqësuesve të emëruar prej tyre së bashku apo veç e veç të plotësojnë dhe nënshkruajnë çdo dokument të nevojshëm për privatizimin sipas ligjit të objekteve të Klubit të Futbollit Partizani.

Shtetasi **Igli Vaqari**, i pyetur më dt 22.11.2022, se kush i ka propozuar për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, si dhe kur kanë biseduar me përfaqësuesit e familjeve të tjera për këtë akt marrëveshje, deklaroi se, *ka biseduar me përfaqësuesit e tij dhe kanë rënë dakort, sikurse kanë rënë dakort edhe të tjerët. Igli ka biseduar me Fatmir Bektashin, i cili i bëri me dije për lidhjen e kësaj akt marrëveshje dhe i ka thënë edhe tek cila notere duhet të vinte dhe të nënshkruante akt marrëveshjen. Ranë dakord si fis që ta nënshkruanin këtë akt marrëveshje duke qenë se Fatmiri ishte pjesë e familjes së tyre.*

Me akt aneksin nr. 2966 rep datë 09.10.2008 para noteres Gentiana Shkodra, rezulton se **Blendi Marika** përfaqësues i një pjese të trashëgimtarëve Alimhemeti pranon dhe ratifikon akt marrëveshjen e datës 29.09.2008 me nr. 2892 rep nr. 487 kol.

176.1. Me deklaratën noteriale nr. 2902 rep nr. 452 kol datë **01.10.2008**, shtetasi **Blendi Marika** në cilësinë e përfaqësuesve me prokurë nr. 5451 rep/592 kol datë 12.11.2005 të *Alma Sulo (Mullici), Fatbardha Marika (Alimehmeti), Genci Mullici, Fiqiri Alimehmeti, Fehmi Alimehmeti, Xhaferr Alimehmeti* të cilët janë trashëgimtarë ligjorë të **Rexhep Alimehmeti** të njohur si pronarë të një parcele toke në territorin e KF Partizani, deklaroi se si përfaqësues i përgjithshëm i pronarëve të familjes Alimehmeti, për pronën që shtrihet në territorin e KFPartizani, shpreh vullnetin e **plotë për privatizimin e objekteve dhe të sipërfaqeve funksionale të objekteve sportive të KF Partizani** në raportet e bashkëpronësisë me familjet e tjera pronare në sip rezultuese të tyre të përcaktuara në vendimet respektive të KKP (AKKP). Familja Alimehmeti është e gatshme të përmbushë çdo procedurë të nevojshme ligjore, të kontirbuojë sipas vlerës së përcaktuar nga Agjësia Kombëtare e Privatizimit, të bashkëpunojë dhe koordinojë për procedurat juridiko adminsitrativë me familjet e tjera pronare si Begeja, Llagami, Vaqarri dhe Saliaga me qëllim privatizimin e objekteve dhe aseteve të tjera të KF Partizani që ndodhen në sip respektive të pronave përkatëse. **Blendi Marika ka derdhur sipas mandatit datë 04.09.2008 shumën prej 20 000 lekësh.**

Klubi Shumësportesh Partizani

177. Në lidhje me vijimësinë e procedurave të privatizimit për territoret dhe objektet ku shtrihet Klubi Sportiv Partizani, shfaqeshin dy probleme: Së pari mbivendosja me disa pronarë (*pra një pjesë e ndodhur tek Pishina Laprakë rezultonte të ishte blerë nga shtetas të tjerë*) dhe pengesat që kishin krijuar ndryshimet e ligjit mbi sportin.

178. Me shkresën nr. 5309 datë **29.05.2008** Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Drejtori Urim Muja, i ka kërkuar ZVRPP informacion për objekte në proces privatizimi, duke i sjellë në vëmendje se **për truallin e objektit Pishina Laprakë Tiranë, janë konstatuar mbivendosje pronash të regjistruar në emër të Esat Adem Pira, Marita Dilaver Osmani, Roland Isufi dhe Andre Buxheli**. Me qëllim që të mos pengohen në procesin e privatizimit të këtij objekti, kërkojnë edhe një herë hartën treguese me të dhënat e nevojshme gjeografike të objektit Pishina Laprakë, dokumentacionin nëse ekziston mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi në emër të personave të sipërpërmendur dhe kërkojnë statusin përfundimtar të truallit të këtij objekti, pasi për këtë objekt janë paraqitur individë për të ushtruar të drejtën e parablerjes në privatizim, dhe mbivendosja e pengon procesin e privatizimit. Bashkalidhur i dërgojnë edhe shkresën me nr. 3485/2 datë 06.05.2008 lëshuar nga ZVRPP Tiranë bashkë me HTR.

178.1. Me shkresën nr. 5309/2 prot datë **29.05.2008**, drejtori Urim Muja, i është drejtuar **AKKP-së**, për dijëni KVKKP duke kërkuar vënie në dispozicion të dokumentacionit për konfirmimin mbi pronësinë e truallit. Kërkon konkretisht vendimet e familjeve ish pronare bashkë me gen planet përkatëse të konfirmuara. Me shkresën nr. 1512/1 prot datë 11.06.2008 Drejtori Enton Drogu i ZRKKP Qarku Tiranë i kthen përgjigje Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike duke i parashtruar se i përcjell vendimet e kthimit të pronave, e konkretisht vendimin nr. 532 të vitit 1996 për subjektin Begeja, vendimin nr. 97 të vitit 1999 për subjektin Llagami dhe vendimet nr. 98 të vitit 1999 dhe nr. 7 të vitit 2007 për subjektin Saliaga.

178.2. Me shkresën nr. 5309/3 prot datë **29.05.2008** të drejtorit Urim Muja, drejtuar **METE**, kërkohej **prononcim për privatizim objekti**. I bëhet me dije se nga verifikimi i dokumentacionit të vlerësimit dhe gen planit të miratuar nga Kadastra Urbane e Bashkisë

Tiranë, rezulton se vendimeve të KRRTRSH nr. 1 datë 07.03.2006 dhe nr 4 datë 21.11.2006, një pjesë e territorit të këtij objekti bashkë me objektet e ndërtuara mbi të, është zonë sportive. Përsa më sipër, kërkojnë nga ana e METE të konfirmojnë nëse objektet e dërguara për privatizim vazhdojnë të jenë objekte sportive apo e kanë humbur funksionin e tyre si të tilla. Me shkresën Nr. 4660/3 Prot. datë 02.06.2008, Drejtoria e Privatizimit pranë METE i ka përcjellë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, gjithë dokumentacionin në lidhje me terrenet e objektit "Klubi shumësportësh Partizani". Pjesë e dokumentacionit konstatohet se është edhe Vendimi Nr. 04, datë 21.11.2006 i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e ndryshimit në planin rregullues të Qytetit të Tiranës në lidhje me zonimin funksional për disa zona të qytetit" në këtë vendim përfshihet dhe zona me sipërfaqe 0.7 ha në Rrugën Frosina Plaku nga "zonë sportive" në "zonë banimi". Ky vendim është firmosur nga Kryetari i KRRT-së Z. Sali Berisha.

Por duket që ky sinjalizim ka çuar në sjelljen në vëmendje të situatës së krijuar pas ndryshimeve të ligjit për sportin, pra situatën konfliktuale me interesat e familjeve të njohura pronare për privatizimin. Kjo gjë konfirmohet nga fakti se më datë 02.06.2008, me shkresën nr. 3845 prot Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shtetasi Ylli Pango, i është adresuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Brendshme duke i dërguar për mendim projekt vendimin "Për propozimin e projekt ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9376 dt 21.04.2005 "Për sportin" i ndryshuar. ...Ky është pikërisht ndryshimi që objektet sportive përveçse të jepen me koncension edhe të privatizohen.

178.3. Me shkresën nr. 5900 prot dt 11.06.2008 Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, drejtori Urim Muja, i **kërkon ZVRPP informacion**, referuar problemeve të truallit të objektit Pishina, Laprakë Tiranë në përbërje të Klubit Shumësportësh Partizani, pasi pretendon se nuk rezulton të kenë sqaruar statusin e truallit të këtij objekti. **Rikërkojnë edhe një herë: Hartën treguese me të dhënat e nevojshme gjeografike të objektit pishina Laprakë**; Dokumentacion nëse ekziston mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi në emër të personave të sipërpërmendur; Statusin përfundimtar të truallit të këtij objekti, pasi për të janë paraqitur individë, për të ushtruar të drejtën e parablerjes në privatizim pasi, mbivendosja e pengon procesin e privatizimit. Bashkalidhur shprehet se përcjell edhe shkresën nr. 3485/2 datë 06.05.2008 lëshuar nga ZVRPP Tiranë bashkë me hartën treguese.

178.3.1. Ndërkohë rezulton se shtetasi **Xhimi Begeja**, angazhohet drejtëpërdrejtë të zgjidhë situatën e krijuar me shtetasit Pira dhe Osmani. Më dt 13.06.2008, me nr. 1958 rep., nxjerr nga arkiva e zyrës noteriale të noteres Meri P. Çala, kontratën e shitblerjes nr. 967/100 rep.kol dt 07.02.1998 që i përket blerësit Esat Pera, sipas kërkesës së ZRPP Tiranë. Nga kjo praktikë, rezulton se në kontratën e shitblerjes nr. 7938/ 2764 rep/kol dt 27.11.1997, para noteres Mimoza Shehu, shtetasi Jorgo Qirko i ka shitur shtetasit Novruz Nurka, një sip trualli të lirë kundrejt vlefës prej 1 900 000 lekë. Jorgo Qirko është pronar i këtij trualli me sip 1200 m2 i ndodhur në rrugën "Kongresi i Përmetit" Laprakë dhe figuron i regjistruar në regjistrin ipotekor me nr. 3652 dt 31.12.1993.

Sipas vërtetimit të pronësisë datë 27.11.1997 të nënshkruar nga nëpunese e ipotekës Nertila Biçoku, është pasqyruar se në regjistrin ipotekor nr. 5602 dt. 27.11.1997 në pronësi të z. Novruz Nurka i biri i Laverit, figuron e regjistruar një truall me sip 1200 m2, ndodhur në rrugën "Kongresi i Përmetit", në Laprakë, kufizohet nga veriu ndërtesë I kate me tulla silikate, lindja rrugë e lirë, jugu rrugë për në Durrës, përballë doganës dhe perëndimi ndërtesë me

tjegulla të kuqe. Regjistrimi i ipotekor është bërë në bazë të kontratës së shitjes nr. 7938/2766 dt. 27.11.1997 e noterisë Tiranë me notere Mimoza Shehu. Gjithashtu në këtë vërtetim është bërë shënimi me shkrim dore nga nëp e ipotekës Silvana Dani "Prona është e lirë. Dt. 7.2.1998". Me kontratën e shitblerjes nr. 967 rep nr. 100 kol datë 07.02.1998 para noteres Meri Çala, shtetasi Novruz Nurka i shtetasi Esat Pira dhe Marita Osmani, pasurinë e mësipërme në shumën 1 900 000 lekë.

178.3.2. Me shkresën nr. 5469/1 prot datë 17.06.2008 ZVRPP shtetasi Fetah Hasanaj, i kthen përgjigje Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe shitjes së pronave publike, duke i bërë të ditur, se pranë zyrës së tyre, **nuk ekziston i regjistruar në regjistrat hipotekorë, kartela pasurie, apo në librin e ngastrave dhe harta treguese ndonjë objekt me emërtimin Pishina Laprakë.** Në shkresën nr. 3485/2 dhe 5208/1 prot kanë sqaruar gjendjen juridike të sip që truallit që përfshin planvendosja bashkangjitur kërkesës. Sip e konturuar në plan vendosje që i është vënë në dispozicion me shkresën nr. 92/6 prot datë 22.04.2008 sipas hartave, përfshihet pjesërisht në pasurinë me nr. 12/27 dhe pjesërisht në pasurinë me nr. 12/28. Pasuria me nr. 12/27 është e regjistruar në numrin hipotekor 663 datë 07.02.1998 në bashkëpronësi të Esat Pira dhe Marita Osmani ...

179. Pasi është marrë VKM nr. 906 dt 18.06.2008 për propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9376 dt 21.05.2005 "*Për Sportin*", megjithëse nuk rezulton të ishin miratuar këto ndryshime dhe të kishin hyrë në fuqi (*miratuar me ligjin nr 9963 datë 21.07.2008 dhe hyrë në fuqi më datë 16.08.2008*), me shkresën nr. 6554 prot datë 25.06.2008 drejtori Urim Muja, i DASHPP i dërgon Degës së Shoqërive Publike, materialin për njoftim me afishe për privatizim objekti.

Pra qartësisht konstatohet se në këtë kohë ende nuk lejohej privatizimi i objekteve sportive dhe prona në Klubin Shumësportesh Partizani, rezultonte me mbivendosje në pjesën e pishinës si dhe dërgohej për afishim për privatizim edhe një pjesë e objektit që rezultonte tashmë me pronarë të tjerë.

179.1. Më datë 01.07.2008 nga përfaqësuesit e Degës së Shoqërive Publike Tiranë është publikuar afishe për privatizimin e objektit "*Klubi shumësportësh Partizani*" dhe objektit "*Pishina Laprakë*", megjithëse ende nuk lejohej privatizimi i objekteve sportive. Sipas Njoftimit Klubi Shumësportesh Partizani: **Vlera Fillestare e ankandit (mjete kryesore + mjete xhiro) në shumën 43 255 000 lekë; Vlera mjete kryesore 43 255 000 lekë; Sip gjithsej 19 091 m²; Sip nën 5 457 m². Vlera e truallit 505 834 000 lekë.**

180. Pikërisht në këtë periudhë ka ndodhur edhe transferimi i fondeve në shumën 2 000 000 lekë nga Klubi Shumësportesh Partizani për Komunën Tropojë, për ndërtim terreni sportiv tek kjo e fundit, referuar shkresës nr 6693/3 prot datë 23.07.2008 të Ministrit të Financave Ridvan Bode dhe me shkresën nr. 5415 prot datë 01.08.2008 Ministri i Turizmit Ylli Pango, i është adresuar Klubit Shumësportesh Partizani, për pakësimin e fondit të investimeve.

181. Nga aktet rezulton se në këtë periudhë lëshohen edhe aktet e përfaqësimit për pjesmarrje në procedurat e privatizimit në lidhje me Klubin Shumësportesh Partizani. Konkretisht me prokurën e posaçme datë 10.07.2008 *Ervin Llagami dhe Myhyrije Llagami*, emërojnë si përfaqësues të tyre **Fatri Tafaj** që t'i përfaqësojë pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në lidhje me privatizimin e **Klubit Shumësportesh Partizani**, objekt për të cilin si trashëgimtarë të familjes së Sabrije Llagamit kanë të drejtën e parablerjes. Me prokurën nr. 4998 rep nr. 667 kol datë 10.07.2008 *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide*

Saliaga, Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi, kanë emëruar si përfaqësuese **Silvana Bellon**. Ndërmjet të tjerave i kanë dhënë tagër të paraqitet në Agjensinë Kombëtare dhe Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ..., t'i përfaqësojë në procesin e privatizimit të objekteve që ndodhen në Klubin Shumësportesh Partizani dhe klubin e futbollit Partizani në truallin e tyre... Me prokurën e posaçme nr. 2805 rep nr. 336 kol datë 14.07.2008, *Sadete Llagami*, emëron si përfaqësuese **Adela Llagamin**, ku ndër të tjera të paraqitet dhe të kryejë veprimet e nevojshme tek drejtorja e ankandëve dhe shitjes së pronave publike ...si dhe kudo tjetër, në lidhje me ushtrimin e të drejtës së parablerjes të objekteve të ndërtuara mbi truallin pronë ku ajo është bashkëpronare me të tjerë që gjendet në *Klubin Sportiv Shumësportesh Partizani*... Me prokurën nr. 1693 rep nr. 294 kol datë 16.07.2008 *Mirrije Llagami*, ka emëruar si përfaqësuese **Adela Llagamin** që të paraqitet në drejtorinë e amdotsimit dhe shitjes së pronave publike pranë Ministrisë së Financave Tiranë ku të kryejë të gjitha procedurat ligjore që lidhen me blerjen e Klubit Sportiv Partizani., të nënshkruajë çdo akt juridik që lidhet me blerjen e pjesës që i takon tek *Klubi sportiv Partizani*, të marrë në dorëzim pjesën që i takon dhe ta regjistrojë në ZVRPP.

182. Gjithashtu në këtë periudhë bëhen edhe pagesat për ngurtësimin e fondit. Ndër të tjerë, rezulton se me kërkesën për transfertë fondesh datë 10.07.2008 pranë Emporiki Bank, shtetasi Gjon Gjonaj, ka paguar në drejtim të Raiffeisen Bank, për klientin përfitues Ministria e Financave, për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani, ngurtësim 20 % të fondit nga familja Mahmut Begeja, Sabrije Llagami dhe Qamil Saliaga, konkretisht **shumën prej 8 700 000 lekë**.

183. Me shkresën nr. 11/1 datë 11.07.2008, trashëgimtarët e familjeve pronare **Begeja dhe Saliaga**, i kanë drejtuar Ministrinë të Financave Ridvan Bode dhe shtetasit Urim Muja "Kërkesë për ushtrim të të drejtës së parablerjes", duke pretenduar se pasuritë e tyre bien mbi 90 % të truallit nën objekt të Klubit Shumësportesh Partizani, **prandaj kërkojnë të privatizojnë të objektin**. Për familjen Begeja ka nënshkruar shtetasi **Xhimi Begeja** dhe për familjen Saliaga shtetasja **Silvana Bello**. Shtetasi **Xhimi Begeja**, nuk rezulton të ketë pasur ndonjë akt përfaqësimi.

Por shtetasi **Xhimi Begeja**, konstatohet se ka qenë vazhdimisht aktiv duke u paraqitur pranë institucioneve si në rastin konkret edhe në procedurat e privatizimit. Në dosjen e privatizimit të administruar pranë Ministrisë së Mbrojtjes në lidhje me privatizimin e Klubit të Futbollit Partizani janë evidentuar akte të ndryshme të njehsuara me origjinalin nga shtetasi **Xhimi Begeja** ku përmendim ndër të tjera Vërtetim nr. 6747 rep dt 27.08.2008 ku shtetasi **Xhimi Begeja** ka njehsuar me origjinalin vendimin nr. 9 dt 26.03.2007 të AKKP; Vërtetim nr. 6748 rep dt 27.08.2008 ku shtetasi **Xhimi Begeja** ka njehsuar me origjinalin vendimin nr. 681 dt 27.08.1996 të KKKP etj.

Ngritja e Komisionit të verifikimit të dosjeve dhe njohja e të drejtës së privatizimit

Klubi i Futbollit Partizani

184. Me urdhërin Nr. 10011 Prot, datë 26.09.2008 nga Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Drejtor Urim Muja, në zbatim të VKM-së Nr. 794, datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes" është ngritur komisionin për verifikimin e dosjeve të vlerësimit për objektet në privatizim me pronar, i përbërë nga përbërë nga shtetasit: Nuri Sopaj (kryetar); Sotiraq Veizi (anëtar), Kliton Rusi (anëtar) dhe Liza Lleshi (anëtar). Konkretisht në urdhër

pasqyrohet se, ky grup ngrihet për vlerësimin e dokumentacionit të vlerësimit të objektit **Klubi i Futbollit Partizani**, rruga F.Plaku, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, për ushtrimin e të drejtës së parablerjes sipas kërkesës së trashëgimtarëve të familjarëve Mahmut e Xhemal Begeja, etj.

185. Por pa u ngritur ende ky komision, Drejtori Urim Muja, me shkresën nr. 9699 prot datë **22.09.2008**, i është adresuar AKKP me anë të të cilit kërkojnë kopje të vendimit nr. 668 datë 16.08.1996, së bashku me planvendosjet e pronës. Me shkresën nr. 2900/1 prot datë **02.10.2008** të drejtorit Bledar Dervishaj të ZRKKP i është përcjellë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjeve të Pronave Publike, si dhe për dijeni Agjensisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, një kopje e vendimit nr. 668 datë 16.08.1996 (*që i përket familjes Llagami*) bashkë me plan vendosjen përkatëse.

186. Me shkresën nr. 10585 prot datë **09.10.2008**, Drejtori Urim Muja, i Sektorit të Shitjeve pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Ministria e Financave, i adresohet ZVRPP ku i pasqyron se nga azhornimi i bërë për sip që zënë subjektet e shpronësuar me genplanin e dosjes së privatizimit, rezulton se një pjesë e truallit sipas gen planit nuk bie në pronën e subjekteve të shpronësuar.

Me shkresën nr. 9626/1 datë **10.10.2008** ZVRPP Tiranë, me regjistruese Dorina Stringa, i bën me dije Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, se sip e truallit në m2 që nuk është në pronën e subjekteve të shpronësuar, është pasuria me nr. **3/84 me sip truallit 857 m2 në pronësi shtet**. Bashkalidhur është edhe fragmenti i hartës treguese.

187. Me procesverbalin datë **15.10.2008** i mbajtur në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Sektori i Shitjes së Pronave nga komisioni i përbërë nga Nuri Sopaj (përgjegjës sektori), Sotiraq Veizi (*Jurist*), Kliton Rusi (*specialist*) dhe Liza Lleshi (*specialiste për shqyrtimin e dokumentacionit të vlerësimit për privatizim objekti*), për shqyrtimin e dokumentacionit të vlerësimit për privatizim të objektit, ... mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga ish pronarët e truallit, ku evidentohet ndër të tjera se janë krahasuar të dhënat gjeografike sipas genplanit të terreneve dhe objekteve të klubit të futbollit Partizani, HTR dhe hartës së pronës sipas vendimeve të KKP, dhe të depozituara nga vetë ish pronarët, konstatoi se **Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani, bien mbi 70 % në pronën e ish pronarëve të subjekteve të shpronësuar Xhemal e Mahmut Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqarri, Sabrije Llagami, Rexhep Alimehmeti**. Nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë dhe krahasimit të hartave të pronës së ish pronarëve me gen planin e objektit që privatizohet dhe HTR të lëshuara nga ZRPP rezulton se për objektin "*Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit Partizani*" me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku Tiranë, **një pjesë e truallit prej 857 m2 nuk përfshihet në pronën e njohur ish pronarëve të truallit të sipërpërmendur**. Përsa më sipër, u ka njohur të drejtën e privatizimit, me të drejtën e parablerjes me vlerën fillestare gjithsej **10 109 000 lekë**. Komisioni në zbatim të VKM-së Nr.794, datë 21.11.2007 shprehet që trashëgimtarëve të familjeve të shpronësuar Xhemal e Mahmut Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqarri, Sabrije Llagami dhe Rexhep Alimehmeti t'ju njoh të drejtën e privatizimit të objektit, me të drejtën e parablerjes në vlerën 10,109,000 lekë.

Siç mund të konstatohet, nga ana e këtij komisioni, është konkluduar se sipërfaqja e truallit shtesë, që nuk përfshihet në pronën e njohur ish pronarëve të truallit është 857 m2 në kundërshtim me atë që kanë konkluduar ekspertët Elvira Aliaj dhe Sali Preçi, që kishin lënë jashtë familjen Llagami, duke u shprehur se shteti rezultonte pronar në një sipërfaqe prej 4261

m2. Sidoqoftë, pasur parasysh vlerën prej 26 787 m2 X 857 m2, sipas përlllogaritjeve të këtij komisioni, familjet që po kryenin privatizimin, duhet të paguanin edhe shumën prej 22 956 459 lekë.

187.1. Me memon dt **16.10.2008** shtetasi Nuri Sopaj, përgjegjës i sektorit të shitjeve, i është drejtuar drejtorit Urim Muja, duke i parashtruar se po i paraqesin për miratim proces verbalin datë 15.10.2008 **për dhënien e të drejtës së parablerjes për objektin "Terrenet sportive dhe objekte të klubit të futbollit Partizani"** me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku Tiranë, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, në favor të trashëgimtarëve të familjeve Begeja, Saliaga, Llagami, Alimehmeti dhe Vaqarri.

Klubi Shumësportesh Partizani

188. Me urdhërin Nr.7711, dt **22.07.2008** të drejtorit Urim Muja, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike është ngritur **komisioni për verifikimin e dosjeve të vlerësimit** për objektet në privatizim me pronar truall; konkretisht: Klubi Shumësportesh Partizani në administrim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Komisioni përbëhet nga shtetasit Nuri Sopaj, Përgjegjës i Sektorit të Shitjes; Ildir Xhoxhi, Specialist, Sotiraq Veizi jurist dhe Gentiana Shata juriste.

188.1. Ndërkohë, ky komision nuk rezulton të ketë dalë me ndonjë vendimarrje derisa sa ZRPP të ndërmerre veprime për fshirjen e pronësisë së shtetasve Pira e Osmani. Kështu rezulton se, mbështetur në Udhëzimin nr 4 dt 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave "*Për procedurën e fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe atyre që krijojnë mbivendosje, në ZRPP*" (i shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën me vendimin nr 17 datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese), me vendimin Nr. 7, dt **01.09.2008** të regjistruarit të ZVRPP, është vendosur: Fshirja e regjistrimit të kryer në nr. 663 hipotekor, dt 07.02.1998 në emër të Esat Pira dhe Marita Osmani dhe Fshirja e regjistrimit të kryer në nr. 5602 hipotekor, dt 27.11.1997 në emër të Novruz Nurka si regjistrime të kryera në kundërshtim me ligjin.

Me vendimin Nr.39 Prot. dt **12.09.2008** "*Për fshirje e regjistrimeve të paligjshme të pasurive të paluajtshme*" Kryeregjistruesi **Arben Qirjako**, mbështetur ndër të tjera edhe në Udhëzimin nr. 4 datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, pasi ka marrë në shqyrtim vendimin Nr. 7, datë **01.09.2008** të regjistruarit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ka vendosur lënien në fuqi e vendimit Nr. 7, datë 01.09.2008.

Në këtë vendim, kryeregjistruesi parashtron se, pasi është njohur me shkresën nr. 5309 datë 29.05.2008 të DASHPP, nga verifikimi i kryer nga ZVRPP, ka rezultuar se sipas informacionit të marrë nga libri i ngastrave (në të cilin është pasqyruar informacioni i marrë gjatë azhurnimit fillestar të ZK 8310 të kryer në vitin 1998, si një fazë e parë e fillimit të procesit të regjistrimit pasuria me nr. 12/27 ZK 8310 rezulton të ketë një sipërfaqe truall prej 1205 m2 nga e cila 535 ndërtesë, me pronar Esat Pira (Pira sh.p.k.) dhe në seksionin "*dokumenta pronësie*" të librit të ngastrave është shënuar "*S' ka dokumenta*".

Ndërkohë nga informacioni hartografik i zyrës, rezulton që pasuria nr. 12/27 ZK 8310, **ndodhet pikërisht brenda sip për të cilën kërkohet informacioni i nevojshëm për vazhdimin e procedurave të privatizimit**. Libri i ngastrave nuk përbën dokument ligjor. ZVRPP ka kryer veprimet e nevojshme të hetimit administrativ, bazuar pikërisht në pikën 3 të Udhëzimit nr. 4 datë 21.11.2007 të KM, në përfundim të të cilave ka konstatuar se në nr 663

hipotekor datë 07.02.1998 figuron e regjistruar në emrin e Esat Pira dhe Marita Osmani "Truall me sip 1200 m2, i ndodhur në rr "Kongresi i Përmetit" në Laprakë i kufizuar V- Ndërtesë 1 kat me tullë silikate, L – Rrugë e lirë; J- Rruga për në Durrës, P – Ndërtesa me tullë të kuqe". Ky regjistrim është bërë në bazë të kontratës së shitjes nr. 967/100 datë 07.02.1998 e lidhur midis Novruz Nurka në cilësinë e shitësit dhe Esta Pira e Marita Osmani në cilësinë e blerësve. Në kontratë është përcaktuar se pasuria e regjistruar në favor të Novruz Nurka me nr. 5602 hipotekor datë 27.11.1997 me përshkrim *truall me sip 1200 m2 i ndodhur në rr Kongresi i Përmetit Laprakë ...i shitet Esat Pira e Marita Osmani për shumën 1 900 000 lekë*. Kjo kontratë nuk rezulton të jetë shoqëruar nga ndonjë planvendosje në të cilën të jetë pozicionuar pasuria objekt i kësaj kontrate, mungesa e së cilës e bën të pamundur identifikimin e sip prej 1200 m2, objekt i kontratës së lartpërmendur të shitjes në hartën treguese.

Dhe nga konfirmimi i kontratës së shitjes nr. 967/100 datë 07.02.1998, nga notere Meri Cala paraqitur në ZVRPP më datë 04.08.2008, në përgjigje të kërkesës së bërë nga kjo e fundit nr. 620 datë 02.07.2008, konstatohet se kjo kontratë nuk shoqërohet me asnjë planvendosje ku të jetë përcaktuar pozicioni i pasurisë objekt shitje dhe identifikimi i saj në HTR. Ndërkohë, duke verifikuar origjinën e regjistrimit nga e cila ka rrjedhur regjistrimi i kryer, konstatohet se ky regjistrim është kryer bazuar në kontratën e shitjes nr. 7938/0766 datë 27.11.1997 e lidhur para noteres Mimoza Shehu midis Jorgo Qirko në cilësinë e shitësit dhe Novruz Nurka në cilësinë e blerësit, në të cilën përcaktohet se Jorgo Qirko, në cilësinë e pronarit të një trualli me sip 1200 m2 të ndodhur në Laprakë, Tiranë...të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 3652 datë 31.12.1993 në emër të Jorgo Qirko, ia shet këtë pasuri Novruz Nurkës. Kjo kontratë nuk rezulton të jetë shoqëruar nga ndonjë planvendosje në të cilën të jetë pozicionuar pasuria objekt i kësaj kontrate, mungesa e të cilës e bën të pamundur identifikimin e sip prej 1200 m2 truall objekt i kontratës së sipërcituar...

Nga konfirmimi i kontratës së shitjes e nr. 7938/0766 datë 27.11.1997 nga notere Mimoza Shehu rezulton se bashkalidhur është një vërtetim pronësie që mban datën 25.11.1997 i lëshuar nga nëpunësja e hipotekës Nertila Biçoku sipas të cilit në nr 3652 hipotekor datë 31.12.1993 në pronësi të Jorgo Qirko, figuron një truall me sip 1200 m2...

Për kontratën nr. 5125 rep nr. 142 kol datë 06.05.1992 tek notere Shpresa Kurti, bashkalidhur kontratës së shitjes nr. 7938/0766 datë 27.11.1997 në bazë të së cilës është bërë regjistrimi i pasurisë në emrin e z. Nurka, me shkresën nr. 21 datë 09.08.2007 (*mund të jetë 2008*) ka konfirmuar se kjo kontratë shitje nuk figuron pranë kësaj zyre dhe këto nr rep e kol më datë 06.05.1992 nuk përputhen me nr e akteve noteriale të vërtetuar nga kjo notere në atë periudhë.

Për të përligjur të drejtën e pronësisë, shtetasi Jorgo Qirko, ka paraqitur një kontratë shitje në formë fotokopje të noterizuar që mban nr 5125/1426 datë 06.05.1992 lidhur midis Jorgo Qirko në cilësinë e blerësit dhe K.Ek.PP Rajoni 3 Tiranë në cilësinë e shitësit, sipas të cilit ky i fundit i shet Jorgo Qirkos truallin me sip 1200 m2 i ndodhur në Laprakë....Në këtë kontratë nuk jepet asnjë e dhënë lidhur me të drejtën e disponimit të shitësit mbi truallin prej 1200 m2...sipas përcaktimeve të n. 89 të K.Civil të R.P.S. Shqipërisë. Kjo kontratë nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrat e kësaj zyre me nr. 3652 hipotekor datë 31.12.1993 si dhe nuk rezulton të jetë regjistruar në ndonjë regjistër të administruar nga ZVRPP Tiranë.

Ndërkohë, në nr 3652 hipotekor datë 31.12.1993 figuron e regjistruar në favor të bashkëpronarëve Emmini, pasuria me përshkrimin një truall i lirë me sip 1566 m2 i zënë me lokale (klub privat) me sip 30 m2 një truall i zënë me ndërtime shtetërore ish godina e organizatës së frontit si dhe trualli para godinës me sip 243 m2 duke i lindur e drejta e

parablerjes së këtij objekti, kur të privatizohet në bazë të Vendimit nr. 190 datë 28.12.1993 të KKKP Tiranë. ...Nga verifikimi i planvendosjes ...sip e kthyer në favor të Mehmet Emiri ndodhet në rr. Niko Avrami dhe pas pasqyrim të saj në HTR rezulton në rrugën e Dibrës.

Përsa më sipër është konkluduar me lënien në fuqi të vendimit nr. 7 datë 01.09.2008 të regjistruarit të ZVR Tiranë.

Vendimi nr. 39 dt 12.09.2008 i ZQRPP Tiranë njehsohet me origjinalin nga shtetasi Xhimi Begeja, para noterit Ruko Sako me nr. 7189 rep dt **17.09.2008**. Me shkresën nr. 8258/1 dt **17.09.2008** është dërguar vendimi nr 39 datë 18.09.2008 i ZQRPP Tiranë për fshirjen e pronësisë së truallit të objektit Pishina Laprakë në emër të Esat Pira dhe Marita Osmani. (*shih proces verbalin e komisionit datë 29.09.2008*).

189. Me Deklaratën noteriale nr 2517 rep nr 476 kol dt **23.09.2008**, para noterit Gentiana Shkodra, shtetasit *Behixhe Tafaj, Myhyrije Verzivolli, Rudina, Ardian, Adnan, Sadete, Adela, Mirnije, Aleksandra, Ervin dhe Artur Llagami*, si trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës Sabrije Llagami, **kanë shprehur vullnetin për privatizimin e objekteve dhe të sipërfaqeve funksionale të objekteve sportive, në raportet e bashkëpronësisë të përcaktuara në dëshminë përkatëse të trashëgimisë ligjore. Janë të gatshëm të përmbushin çdo procedurë ligjore të nevojshme, të nënshkruajnë çdo akt, si dhe të paguajnë çmimin e përcaktuar nga Agjensia Kombëtare e Privatizimit me qëllim privatizimin e objekteve Janë gjithashtu të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të koordinojnë procedurat e nevojshme juridiko administrative me qëllim privatizimin e objekteve me pronarët kufitarë bashkëpronarët Vaqarri, Saliaga, Begeja dhe Alimehmeti.**

189.1. Me akt marrëveshjen nr 2894 rep nr 489 kol dt **29.09.2008** para noterit Gentjana Shkodra, janë paraqitur: **Jamarbër Malltezi** në cilësinë e palës dhe të përfaqësuesit (prokurën e posaçme nr 784 rep nr 142 kol datë 31.01.2006 të notere Ruko Sako: *Haki Begeja, Nysret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirije Lika, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin*; prokurën nr 2165 rep nr 248 kol datë 03.05.2006 *Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Teuta Malka, Bahskim Kadiu, Mirban Kadiu, Nerime Piro*; prokurën nr 9 rep nr 7 kol datë 04.01.2007 të notere Edlira Hyseni i *Orinda Malltezi*; prokurën nr 10086 rep nr 1542 kol datë 31.12.2007 të notere Ruko Sako i *Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Bashkim Bekteshi*); **Silvana Bello**, (në cilësinë e palës dhe të përfaqësuesit me prokurën nr 4998 rep nr 667 kol datë 10.07.2008 të notere Ruko Sako të: *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi*); *Behixhe Tafaj* përfaqësuar nga **Fatri Tafaj**; *Myhyrije Verivolli, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnan Llagami, Sadete Llagami* (përfaqësuar nga *Adela Llagami*), **Adela Llagami**, *Mirnije Llagami* (përfaqësuar nga *Adela Llagami*), *Aleksandra Llagami* (përfaqësuar nga *Ervin Llagami*), *Ervin Llagami, Artur Llagami* (përfaqësuar nga *Ervin Llagami*), **Igli Vaqari** personalisht dhe në cilësinë e përfaqësuesit të *Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari, Milva Arapi, Liliana Arapi, Luan Arapi, Arben Arapi, Fiqerete Vaqari, Eva Vaqari*. Sa më lart cilësohen Familjet pronare.

Pjesa I. ...Familjet pronare paraqiten në këtë akt marrëveshje me cilësinë e pronarit të truallit në të cilën aktualisht ushtron veprimtarinë Futboll Klub Partizani (KFP) dhe Klubi Shumësportesh Partizani (KSHP). **Familja Llagami paraqitet gjithashtu si pronare e një trualli me sip të përafërt prej 1750 m2 jashtë sip së klubeve të lartpërmendura, e kthyer me vendimin përkatës të KKKP. E cila për efekt të kësaj akt marrëveshje do të cilësohet prona.**

...Pjesa II...Neni 1. *Aktiviteti i ndërmarrjes*. Familjet pronare bien dakord që menjëherë pas privatizimit të lëvizin KFP dhe KSHP ndërsa asetet do të ndahen ndërmjet familjeve pronare sipas kufijve të njohura në vendimet respektive të KKP (AKKP). Aktiviteti sportiv nëse është pjesë e privatizimit do të menaxhohet nga familjet pronare me anë të një bordi i cili do të jetë i përbërë nga anëtarë pjestarë të familjeve pronare sipas sip së pronësisë që çdo familje pronare zotëron te prona.

Neni 2. Zhvillimi i pronës. Familjet pronare bien dakord dhe angazhohen të zhvillojnë pronën si zonë ndërtimi si dhe të shembin objektet që ndodhen në pronën e tyre për të realizuar zhvillimin e pronës. Në zhvillimin e pronës koeficienti i shfrytëzimit të truallit do të jetë i njëjtë për të gjitha fam pronare. Në zhvillimin e pronës familjet pronare njohin si firmën ndëruese firmën Kontakt sh.p.k. dhe pranojnë si përfitim nga ndërtimi 25% të sip ndërtimore për çdo komponent në bazë të sip së pronës të çdo familje pronare që do të shfrytëzohet për ndërtim. Familja Llagami në zbatim të këtij neni (si e vetmja familje pronare që s'ka marrëveshje me ndërtuesin) angazhohet të lidhje kontratën e sip me firmën ndërtuese Kontakt sh.p.k. si përfaqësuese e investitorëve.

Neni 3. Shpenzimet për urbanizimin dhe zhvillimin e pronës. Shpenzimet për urbanizimin dhe zhvillimin e pronës do të përballohen nga familjet pronare në raportin që sip e tyre e pronësisë zë te prona. Familjet pronare në një fazë të mëvonshme mund të merren vesh që ndarja e shpenzimeve të bëhet në një formë tjetër

Neni 4. Privatizimi i tokës shtesë. Toka shtesë te rruga Frosina Plaku me sip 1300 m2 e cila nuk bën pjesë në tokën e njohur dhe kthver familjeve pronare me vendim KKP (AKKP) dhe e cila përfitohet nga privatizimi i Klubit të Futbollit Partizani dhe i Klubit Shumësportesh Partizani do të privatizohet sipas cmimit të përcaktuar nga organi kompetent në emër të Familjes Llagami (pjestarëve të saj) me shpenzimet e shoq Kontakt sh.p.k. pa asnjë detyrim rimbursimi nga ana e familjes Llagami.

Familjet e tjera pronare nga momenti i privatizimit heqin dorë nga çdo e drejtë pronësie mbi tokën e sipërcituar...në favor të familjes Llagami nëse kjo familje pronare i bashkohet kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese Kontakt sh.p.k....

189.2. Me kontratën e porosisë dhe vënie trualli në dispozicion për investime, nr 2831 (2891) rep nr 486 kol datë 29.09.2008, para noteres Gentiana Shkodra, janë paraqitur personalisht palët: Behixhe Tafaj (përfaqësuar nga Fatri Tafaj), Myhyrije Verzivolli, Rudina, Ardian, Adnand, Sadete, Adela Llagami, Mirnije Llagami përfaqësuar nga Nuriye Kavaja, Aleksandra Llagami përfaqësuar nga Ervin Llagami, Ervin Llagami dhe Artur Llagami përfaqësuar nga Ervin Llagami si palë pronare Dhe shoq Kontakt sh.p.k. si palë investitore.

Neni 1. Palës pronare, sipas vendimit nr 668 datë 16.08.1996 të AKKP-së Qarku Tiranë, i është njohur titulli i pronësisë mbi një sip totale prej 3910 m2...Pala investitore është subjekt juridik i regjistruar rregullisht...Objekt i kësaj kontrate është të prodhojë dhe sanksionojë një marrëveshje ndërmjet palës pronare dhe palës sipërmarrëse e cila përmes këtij akti angazhohet të përmbushë tagrat:

Neni 3: **Tagrin e porosisë: Ndërrimin e destinacionit të zonës ku ndodhet trualli**

Pala pronare, ka të njohur në emër të saj një sip toke truall prej 3910 m2 sipas vendimit nr 668 datë 16.08.1996 të AKKP të qarkut Tiranë...Gjithashtu objekt i kësaj kontrate do të jetë dhe sip shtesë e tokës truall që do të përfitohet nga privatizimi i Klubit Shumësportesh Partizani, sip që duhet të jetë jo më e vogël se 1300 m2

- a. **Pala pronare është në dijeni të faktit se prona është e njohur dhe jo e kthyer, me destinacion për ambjente sportive,** prandaj ajo dëshiron që, në bazë të legjislacionit Për Urbanistikën të ktheje tokën, të privatizojë ndërmarrjen mbi të, të ndryshojë destinacionin nga zonë sportive në zonë banimi dhe të ndërtojë banesa mbi tokën truell pronë e saj duke përfshirë edhe sip shtesë të tokës truell që do të përfitohet nga privatizimi sipas paragrafit të lartpërmendur
- b. **Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të mësipërme, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse truallin objekt i kësaj kontrate**
- c. Pala sipërmarrëse pranon të marrë truallin e vene në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë të gjitha shpenzimet e nevojshme për procesin e përmendura më lart dhe i përfundon këto procese në një afat kohor jo më shumë se 18 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sip

Neni 4: Tagrin e investimit: Ndërtimi i objektit shumëfunksional... Pala pronare bie dakord për bashkëpunim duke vënë në dispozicion të palës sip shoq së ndërtimit Kontakt sh.p.k. tokën truell sipas përshkrimit në nenin 3 të kësaj kontrate; Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në truallin e vënë në dispozicion si më sipër nga pala pronare kompleksin shumëfunksional me parkime, dyqane, dhe apartamente në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës; Leja e ndërtimit do të merret 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje

Neni 5: Pjesa takuese e ndërtimit për palën pronare... Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e vënë në dispozicion objekt të kësaj kontrate **25 % të sip së përgjithshme** të ndërtimit që do të ndërtohet nga shoq Kontakt sh.p.k. Në kuptim të kësaj pike, me sip të përgjithshme të ndërtimit, do të kuptohet gjithë sip e ndërtimit e bërë dhe në tokat e trashëgimtarëve të fam Mahmut dhe Xhemal Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqarri, Rexhep Alimehmeti të cilat janë kufitare të sip pjesë e kësaj kontrate në përpjestimet përkatëse ndaj totalit të tokës, gjithsej që do të jetë në sipërmarrje të kësaj shoqërie. Sip prej 25 % e ndërtimit sa më sipër do të shpërndahet për secilin komponent....

Neni 6: Të drejtat dhe detyrimet e palës sipërmarrëse. Të drejtat dhe detyrimet e palës sipërmarrëse janë:

- a. Pala sipërmarrëse në bazë të kësaj kontrate sipërmarrje, plotëson dok e nevojshëm për të kryer veprimet adminsitative dhe për të realizuar:
 1. **Kthimin e tokës nga e njohur në të kthyer**
Kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilën ndodhet trualli nga zonë sportive në zonë për banim
 2. **Marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit dhe**
 3. **Lejes së ndërtimit**
 4. **Privatizimin e objekteve që ndodhen mbi këtë truall do ta bëjë sipërmarrësi dhe pronarët nuk kanë asnjë detyrim financiar për të.** Gjithashtu, **sipërmarrësi duhet të sigurojë edhe privatizimin e tokës truell që është në pronësi të shtetit, në favor të palës pronare me sip jo më të vogël se 1300 m².** Në rast se kjo sip trualli nuk kalon në pronësi të palës pronare, kontrata do të quhet e zgjidhur dhe pala pronare nuk kanë asnjë detyrim kundrejt palës sipërmarrëse.
 5. Të gjitha detyrimet ndaj të tretëve do të përballohen nga sipërmarrësi
 6. **Ndërrimin e destinacionit do ta bëjë sipërmarrësi me shpenzimet e tij**
- b. Pala sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje...

190. Me akt marrëveshjen nr 2893 rep nr 488 kol datë **29.09.2008** para noteres Gentjana Shkodra, janë paraqitur shtetasit **Jamarbër Malltezi** në cilësinë e palës dhe të përfaqësuesit (me – prokurën e posaçme nr 784 rep nr 142 kol datë 31.01.2006 të notere Ruko Sako: Haki Begeja, Nysret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstarova, Gëzim Begeja, Lirije Lika, Haxhire Begeja, Elona Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin; me prokurën nr 2165 rep nr 248 kol datë 03.05.2006: Lumturi Çela, Sejdije Kurti, Teuta Malka, Bahskim Kadiu, Mirban Kadiu, Nerime Piro; me prokurën nr 9 rep nr 7 kol datë 04.01.2007 të notere Edlira Hyseni i Orinda Malltezi; me prokurën nr 10086 rep nr 1542kol datë 31.12.2007 të notere Ruko Sako i Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Bashkim Bekteshi); **Silvana Bello**, në cilësinë e palës dhe të përfaqësuesit (me prokurën nr 4998 rep nr 667 kol datë 10.07.2008 të notere Ruko Sako të: Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi); Behixhe Tafaj përfaqësuar nga **Fatri Tafaj**; Myhyrije Verivolli, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnand Llagami, Sadete Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), **Adela Llagami**, Mirnije Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), Aleksandra Llagami (përfaqësuar nga Ervin Llagami), **Ervin Llagami**, Artur Llagami (përfaqësuar nga Ervin Llagami), Sa më lart cilësohen Familjet pronare ...paraqiten në këtë akt marrëveshje me cilësinë e pronarit të truallit në të cilën aktualisht ushtron veprimtarinë Futboll Shumësportesh Partizani...

Pjesa II..Neni 1. **Pjesmarrja në privatizim**. Familjet pronare në bashkëpunim me njëra tjetrën angazhohen që në bazë të së drejtës së parablerjes që zotërojnë të hyjnë në procesin e privatizimit të Futboll Shumësportesh Partizani me qëllim privatizimin e objekteve dhe asetëve të tjera të kësaj ndërmarrje. Familjet pronare në privatizimin e asetëve të **Futboll Shumësportesh Partizani** do të kontribuojnë sipas vlerës së përcaktuar nga agjensia kompetente e privatizimit për objektet që ndodhen në pronat respektive të çdo fam pronare

Neni 2. **Pronësia mbi truallin**. Familjet pronare njohin dhe respektojnë faktin se Privatizimi i Futboll Shumësportesh Partizani nuk do të ndikojë dhe as të çënojë të drejtën e pronësisë mbi tokën dhe në kufijtë e njohur dhe kthyer sipas vendimeve respektive të dhëna në favor të fam pronare nga KKKP (AKKP)

Neni 3. **Plotësimi i dokumentacionit**. Familjet pronare nënshkruese të kësaj (pjestarët e tyre) akt marrëveshje angazhohen që pjestarët e tyre drejtëpërdrejtë ose me anë të përfaqësuesve të emëruar prej tyre së bashku apo veç e veç të plotësojnë dhe nënshkruajnë çdo dokument të nevojshëm për privatizimin sipas ligjit të objekteve të Futboll Shumësportesh Partizani.

191. Komisioni i mësipërm, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e vlerësimit për privatizim të objektit "*Klubi shumësportesh Partizani*", i ka paraqitur Memo Drejtorit Urim Muja, datë **29.09.2008** "*Informacion për të drejtë parablerje objekti*", përgatitur nga përgjegjësi i sektorit të shitjes Nuri Sopaj, me të cilën i kanë dërguar bashkëlidhur për miratim procesverbalin e datës **29.09.2008** për dhënien e të drejtës së parablerjes për objektin "*Klubi shumësportesh Partizani*" me vendodhje në rrugën "*Frosina Plaku*" në favor të trashgimtarëve të familjeve Mahmut e Xhemal Begeja, Qamil Saliaga dhe Sabrije Llagami.

Sipas proces verbalit datë **29.09.2008** të mbajtur nga Komisioni i përbërë nga Nuri Sopaj, Sotiraq Veizi, Gentjana Sata dhe Ildir Xhoxhi, nga verifikimi i dokumentacionit të pronësisë dhe krahasimit të hartave të pronës së ish pronarit, me gen planin e objektit që privatizohet dhe HTR lëshuar nga ZRPP, rezulton se për objektin Klubi Shumësportesh Partizani me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku Tiranë, një pjesë e truallit prej **315 m2** dhe trualli i

objektit Pishina Laprakë e ndodhur në rrugën e Durrësit, gjithsej 880 m² nuk përfshihet në pronën e njohur ish pronarëve të truallit të sipërpërmendur, pra gjithsej 1195 m² e cila duhet të paguhet nga ish pronarët.

Përsa më sipër, komisioni shprehet që trashëgimtarët e familjeve të shpronësuara Xhemal e Mahmut Begeja, Qamil Saliaga dhe Sabrije Llagami, t'u njohë të drejtën e privatizimit të objektit "Klubi Shumësportesh Partizani" në rrugën Frosina Plaku dhe "Pishina Laprakë" në rrugën e Durrësit, Tiranë, me të drejtën e parablerjes me vlerë fillestare gjithsej 43 255 000 lekë dhe bashkëpronarët duhet të paguajë edhe truallin prej 1195 m² gjithsej 26 454 145 lekë.

Kryerja e pagesave për privatizimin dhe lidhja e kontratave. Formalimi i marrëdhënies së investimit

Klubi Shumësportesh Partizani

192. Me autorizimin për kalim pronësie nr. 10168 prot datë **01.10.2008**:

- trashëgimtarëve ligjorë të Xhemal e Mahmut Begeja, që janë: *Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nysret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri, Lirie Lika, Sanije Velo, Ajete Sulstarova, Myzejen Ago, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Merban Kadiu, Teuta Malka, Bahskim Kadiu, Nerim Piro, Jamarbër Malltezi, Oirinda Malltezi, Ilir Kadiu, Graziella Begeja, Vera Grabovskëi dhe Margaret Irëin*, të përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 787 rep nr. 142 kol datë 31.01.2006, prokurën e posaçme nr. 10086 rep nr. 1542 kol datë 31.12.2007, prokurë e posaçme nr. 2165 rep nr. 248 kol datë 03.05.2006, prokurë e posaçme nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006 nga shtetasi **Jamarbër Malltezi, Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Ramonda Bekteshi** të përfaqësuar me prokurën e posaçme me nr. 9605 rep nr. 1550 kol datë 05.09.2006 dhe nr 1108 rep nr. 124/2 kol datë 21.10.2006 nga **Bashkim Bekteshi**
- Trashëgimtarët ligjorë të familjes Sabrije Llagami që janë *Behixhe Tafaj, (Llagami), Aleksandra Llagami, Ervin Llagami, Artur Llagami dhe Myhyrije Verzivolli* të përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 691 rep nr. 144 kol datë 30.03.2000, nr. 1375 rep nr. 743 kol datë 10.07.2008; nr. 5997 rep nr. 660 kol datë 30.12.2005 nga **Fatri Tafaj; Adela Llagami, Mirnije Llagami dhe Sadete Llagami** të përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 1693 rep nr. 294 kol datë 16.07.2008 dhe nr. 2805 rep nr. 336 kol datë 14.07.2008 nga **Adela Llagami, Rudina Llagami, Ardian Llagami dhe Adnand Llagami**; Trashëgimtarët ligjorë të familjes Qamil Saliaga që janë *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Fatmir Luzi, Tire Luzi dhe Shpëtim Luzi* të përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 4998 rep nr. 667 kol datë 10.07.008 nga **Silvana Bello**;

Autorizim që i drejtohet shtetasve sa më lart si dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; Bashkisë Tiranë dhe ZVRPP Tiranë nga drejtori Urim Muja, ...**autorizohet kalimi i objektit "Klubi Shumësportesh Partizani Tiranë"** deri tani pronë shtetërore në administrim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve **në pronësi private të trashëgimtarëve ligjore** të mësipërm, si fitues të së drejtës së privatizimit të objektit me vlerë fillestare, me të drejtën e parablerjes si pronarë trualli, sipas vendimeve të KKKP nr. 532 dt 25.04.1996; nr. 97 dt 17.12.1999; nr. 98 dt 17.12.1999 dhe nr. 6 dt 21.03.2007; nr. 7 dt 21.03.2007 të zyrës Rajonale të KK Pronave Qarku Tiranë. **Vlera totale e objektit** në bazë të shkresës përcjellëse të METE nr. 4660/1 prot dt 20.05.2008 është **43 255 000 lekë**, mjetet kryesore dhe sipërfaqja totale e objektit është 19 091 m² nga e cila nën objekt 5 417 m² me vlerë totale **505 834 000 lekë**.

Vlera fillestare e objektit prej 43 255 000 lekë bashkë me vlerën e truallit prej 26 454 145 lekë (880 m² X 20 473 lekë + 315 m² X 26 787 lekë) në total 69 709 145 lekë, duhet të arkëtohet nga blerësit me lekë në llogarinë ...30780 pranë Raiffeisen Bank për lloagri të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të këtij autorizimi nga e cila 8 694 000 lekë është paguar për pjesmarrje në blerje. Në të kundërt, në rast se blerësi nuk arkëton shumën e mësipërme, brenda afatit të përcaktuar në këtë autorizim, ai e humbet të drejtën e blerjes së objektit bashkë me truallin dhe shumën e pagesës së 20 % e paguar sipas transfertës bankare nr. B1/08/991 datë 10.07.2008 kaluar në degën e thesarit Tiranë më datën 11.07.2007, në shumën prej 8 694 000 lekë për llogari të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Tiranë për të ushtruar të drejtën e parablerjes, nuk i kthehet. Në zbatim të VKM nr. 794 datë 21.11.2007 kreu V pika 1, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 35 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit. Kalimi i pronësisë do të bëhet nëpërmjet kontratës së shitjes që do të lidhet midis palëve pasi të jetë bërë pagesa e vlerës së plotë të objektit, duke plotësuar kushtet e vëna në këtë autorizim të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes

193. Pikërisht, një ditë pas autorizimit të sipërcituar, për kalim pronësie, konstatohet, se gjendet i përpiluar, një dokument me nr 3000 rep nr 1783/1 kol datë 02.10.2008, me emërtimin "Akt marrëveshje për pjesmarrje në investim ndërtimi të "Kompleksit Begeja 6000"". Kjo akt marrëveshje konstatohet se është përpiluar para noteres Laura Pustina.

Palët e kësaj marrëveshje, rezultojnë të jenë shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. e përfaqësuar nga shtetasi Fatmir Bektashi, ku të tre, për efekt të kësaj kontrate do të cilësohen si investitor dhe palë.

Neni 1 parashikon se objekti i kësaj Akt Marrëveshje, është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Investitorëve, të cilët kanë rënë dakord të bashkohen, sipas raporteve dhe kushteve të caktuara në dispozitat në vijim për të financuar ndërtimin e kompleksit shumë funksional me emërtimin "Kompleksi Begeja 6000" që do të ndërtohet në pronën truall të familjes Begeja si vijon: *Pasuria Nr.3/167; Pasuria Nr.3/165; Pasuria Nr.3.163; Pasuria Nr.3/156 dhe Pasuria Nr.3/116.*

Neni 2 "Marrëveshja me pronarët e truallit" sanksionon se: Të drejtat dhe detyrimet ndërmjet ndërtuesit dhe pronarëve të truallit, do të rregullohen me akt të veçantë të hartuar dhe nënshkruar midis ndërtuesit dhe pronarëve të truallit.

Neni 3 "Pjesëmarrja në investim" parashikon:

3.1. Kapitali total i parashikuar për realizimin e ndërtimit dhe investimit është në vlerën 9 157 354 Euro për Kompleksin Begeja 6000.

Ky kapital, do të investohet nga investitorët në sasi të dhe afatet e përcaktuara në këtë dispozitë dhe përfshin: Shpenzimet e ndërtimit dhe të investimit, duke filluar me azhurnimin e truallit, realizimin e projektit, ndërtimin, taksat, etj., deri në mbylljen e aktivitetit financiar sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

3.2. Investitorët bien dakord që për realizimin e vlerës totale të mësipërme të kontribuojnë me këto raporte: **Jamarbër Malltezi- 35% të vlerës totale; Xhimi Begeja- 25% të vlerës totale; Shoqëria Homeplan Shpk.- 40% të vlerës totale**

3.3. Kontributi i secilit investitor, sipas raporteve të caktuara në këtë Akt-Marrëveshje, do të depozitohet në numrin e llogarisë të hapur nga ndërtuesi posaçërisht për këtë qëllim.

Investitorët duhet të derdhin pjesën e tyre takuese sipas fazave të mëposhtme:

Faza e parë: Pagesa e shpenzimeve administrative dhe ato të projektimit, sipas afateve të parashikuara në kontratën e projektimit të kompleksit

Faza e dytë: Pagesa e taksës lokale, përpara zbardhjes së lejes së ndërtimit nga Bashkia për kompleksin.

Pagesa e paradhënies, për shpenzimin e ngritjes së kantierit prej 1.5% të investimit të kompleksit.

Si edhe në vazhdimësi, **depozitimin çdo muaj** të kontributit takues të secilit investitor, i cili llogaritet në bazë të shpenzimeve të kryera nga ndërtuesi atë muaj dhe arkëtimeve të realizuara nga shitja e sipërfaqeve ndërtimore.

...3.5. Secili prej investitorëve depoziton kontributin tij takues brenda datës 20 (Njëzetë) të po atij muaji në llogarinë bankare të Investitorit si më poshtë specifikuar: **Homeplan sh.p.k. Banka Tregtare Kombëtare, Nr 422233578...**

3.6. Në mbarim të afatit të përcaktuar në pikën 3.5, nëse ndonjëri prej investitorëve nuk depoziton detyrimin e tij, atëherë ky detyrim i pashlyer do të shlyhet automatikisht prej investitorëve të tjerë, duke ruajtur raportet midis tyre, përveç rastit kur me deklaram me shkrim para Noterit është vendosur ndryshe.

3.7. Në varësi nga veprimet e kryera, sipas pikës 3.6, do të ndryshojë automatikisht edhe raporti në përqindje i dividendit të fitimeve të realizuar nga ky investim.

Dividenti = % e investimit të investitorit – Situacioni mujor – arkëtime mujore. Totali i parashikuar i investimit.

Investitori që nuk shlyen detyrimin në afatin e përcaktuar në pikën 3.5 nuk ka të drejtë të rimbursojë në muajt pasardhës ata investitorë që kanë përmbushur detyrimin e pashlyer të tij.

...

...Neni 6. Subjekti që do të realizojë ndërtimin është shoqëria Kontakt sh.p.k...., **marrëdhënia e të cilit me investitorët do të rregullohet në mënyrë të detajuar me një kontratë të veçantë, kontratë kjo që nuk do të çënojë rregullimet e përgjithshme të bëra në këtë akt marrëveshje...**

...Neni 11 Investitorët e rinj

10.1. **Me marrëveshje unanime me shkrim të gjithë investitorëve të kësaj akt marrëveshje, mund të pranohen edhe investitorë të tjerë gjatë realizimit të investimit**

10.2. Marrëveshja sipas pikës 10.1 i bashkangjitet kësaj akt marrëveshje...

193.1. Kjo akt marrëveshje dukshëm, me sy të lirë, **konstatohet të ketë ndërhyrje të jashtme, në pjesën e pullave të taksës.**

Nga të dhënat e administruara nga akti i ekspertimit të hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, evidentohet se gjenden dy variante të kësaj akt marrëveshje, me datë printimi 23.09.2008 por me orë printimi të ndryshme dhe me datë krijimit ë ndryshme ku njëra është e datës 27.07.2012 dhe tjetra e datës 16.11.2015.

193.1. 1. Dokumenti "**Marrëveshja Begeja 6000 final version**" e printuar më datë 23.09.2008 ora 06.22 PM, shfaq tre palë, si më sipër cituar e konkretisht shtetasit *Jamarbër Mallezi,*

Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. Ky dokument me autor staffl_2 dhe i ruajtur për herë të fundit nga User, i revizionuar 2 herë, ka pësuar ndryshime në datë 27.07.2012 ora 21.00 dhe paraqitet i ruajtur për herë të fundit në datë 27.07.2012 ora 21.00, në këtë mënyrë.

**“REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

**AKT-MARRËVESHJE
PËR PJESËMARRJE NË INVESTIM NDËRTIMI
TË “KOMPLEKSIT BEGEJA 6000”**

E lidhur në Tiranë në datë ___/___/2008, përpara Noteres Laura Pustina, ndërmjet palëve personalisht të pranishme:

- 1. Z.Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;*
- 2. Z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër _____, me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
- 3. Shoqëria “Homeplan” Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, e pajisur me NIPT: _____
E cila përfaqësohet cëlësin e administratorit Z.Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar.*

Që për efekt të kësaj Akt-Marrëveshje do të cilësohen si: “INVESTITOR” dhe “PALË”.

...3.2. Investitorët bien dakort që për realizimin e vlerës totale të mësipërme të kontribuojnë në këto raporte:

- Z. Jamarbër Malltezi 35% të vlerës totale.*
- Z. Xhimi Begeja 25% të vlerës totale.*
- Shoqëria “HOMEPLAN” Sh.p.k. 40% të vlerës totale.*

3.5. Secili prej Investitorëve depoziton kontributin e tij takues brenda datës 20 (njëzetë) të po atij muaji në llogarinë bankare të Investitorit.si më poshtë specifikuar:

...3.7. Në varësi nga veprimet e kryera sipas pikës 3.6., do të ndryshojë automatikisht edhe raporti në përqindje i dividendit të fitimeve të realizuara nga ky investim.

Situacioni mujor – Arkëtimet mujore

Dividenti = % e investimit të Investitorit – $\frac{\text{Totali i parashikuar i Investimit}}{\text{Totali i parashikuar i Investimit}}$

Investitori që nuk shlyen detyrimin në afatin e përcaktuar në pikën 3.5., nuk ka të drejtë të rimburojë në muajt pasardhës ata Investitorë që kanë përmbushur detyrimin e pashlyer të tij.

Proces-verbali që do të pasqyrojë ndryshimet e dividendit, hartohet nga Eksperti Kontabël i Autorizuar dhe së bashku me dokumentat e pikës 3.6. dhe dokumentat financiarë që vërtetojnë pagimin e detyrimit të prapambetur, hyn në fuqi automatikisht dhe në mënyrë të menjëhershme duke u bërë pjesë integrale e kësaj Akt-Marrëveshjeje, me fuqi detyruese ndaj Investitorëve, duke revokuar çdo element tjetër të kësaj Akt-Marrëveshjeje apo akti tjetër që rrjedh prej saj, që bie në kundërshtim me të.

193.1.2. Dokumenti me titull "*Marreveshja Begeja 6000 final version – 2015*" e printuar më datë **23.09.2008 ora 07.22 PM**, shfaq dy palë, në ndryshim nga varianti që tashmë kemi në qarkullim e konkretisht shtetasit *Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k.* Ky dokument me autor staffl_2 dhe i ruajtur për herë të fundit nga Laura, i revizionuar 3 herë, ka pësuar ndryshime në datë **16.11.2015 ora 16.03** dhe paraqitet i ruajtur për herë të fundit në datë **16.11.2015 ora 17.15**, në këtë mënyrë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3000 Rep.
Nr. 1783 Kol.

AKT-MARRËVESHJE
PËR PJESËMARRJE NË INVESTIM NDËRTIMI
TË "KOMPLEKSIT BEGEJA 6000"

E lidhur në Tiranë në datë 02.10.2008, përpara Noteres publike, ndërmjet palëve personalisht të pranishme:

4. *Z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues në Tirane, në adresen: Rruga Dibrës, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z1660874 me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
5. *Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qëndrës Kombëtare të Rregjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E, e cila përfaqësohet cilësin e administratorit Z.Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,*

Që për efekt të kësaj Akt-Marrëveshjeje do të cilësohen si: "INVESTITOR" dhe "PALË".

... 3.2. *Investitorët bien dakort që për realizimin e vlerës totale të mësipërme të kontribuojnë në këto raporte:*

- *Z. Xhimi Begeja 25% të vlerës totale.*
- *Shoqëria "HOMEPLAN" Sh.p.k. 75% të vlerës totale.*

3.5. *Secili prej Investitorëve depoziton kontributin e tij takues brenda datës 20 (njëzetë) të po atij muaji në llogarinë bankare të Investitorit, si më poshtë specifikuar:*

Titullar: Homeplan shpk
Banka Kombetare Tregtare

... 3.7. Në varësi nga veprimet e kryera sipas pikës 3.6., do të ndryshojë automatikisht edhe raporti në përqindje i dividendit të fitimeve të realizuara nga ky investim.

$$\text{Dividenti} = \% \text{ e investimit të Investitorit} - \frac{\text{Situacioni mujor – Arkëtimet mujore}}{\text{Totali i parashikuar i Investimit}}$$

Investitori që nuk shlyen detyrimin në afatin e përcaktuar në pikën 3.5., nuk ka të drejtë të rimburojë në muajt pasardhës ata Investitorë që kanë përmbushur detyrimin e pashlyer të tij.

Proces-verbali që do të pasqyrojë ndryshimet e dividendit, hartohet nga Eksperti Kontabël i Autorizuar dhe së bashku me dokumentat e pikës 3.6. dhe dokumentat financiarë që vërtetojnë pagimin e detyrimit të prapambetur, hyn në fuqi automatikisht dhe në mënyrë të menjëhershme duke u bërë pjesë integrale e kësaj Akt-Marrëveshjeje, me fuqi detyruese ndaj Investitorëve, duke revokuar çdo element tjetër të kësaj Akt-Marrëveshjeje apo akti tjetër që rrjedh prej saj, që bie në kundërshtim me të.

193.1.3. Gjatë kqyrjes së të dhënave të përfuara nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, evidentohet i ruajtur një dokument me emërtimin "Marrëveshja Magnet final Version" i krijuar më datë 28.06.2016 ora 17.25, i printuar po në këtë datë dhe orë dhe i ruajtur për herë të fundit më datë 28.06.2016 ora 17.23. Autor shfaqet satffl_2 dhe është ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi Laura. Kjo shtojcë është revizionuar 2 herë. Në përmbajtje të saj shfaqen të tre emrat, shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe është e ngjashme me akt marrëveshjen për pjesmarrje në investim të kompleksit Begeja por referon në kompleksin Magnet. Konkretisht kjo akt marrëveshje shfaqet e tillë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE

Nr. ___ Rep.
Nr. ___ Kol.

AKT-MARRËVESHJE
PËR PJESËMARRJE NË INVESTIM NDËRTIMI
TË "KOMPLEKSIT MAGNET"

E lidhur në Tiranë në datë ___/___/2008, përpara Noteres Laura Pustina, ndërmjet palëve personalisht të pranishme:

6. Z.Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;
7. Z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues në Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z1660874 me zotësi të plotë për të vepruar dhe
8. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E
E cila përfaqësohet cilësin e administratorit Z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Që për efekt të kësaj Akt-Marrëveshje do të cilësohen si: "INVESTITOR" dhe "PALË"....

194. Më datë 15.10.2008 me nr 3193 rep nr 1891 kol datë **15.10.2008** para noteres Laura Pustina pasqyrohet përpilimi i një dokumenti i emërtuar si "**Shtojca I e akt marrëveshjes për pjesëmarrje në investim ndërtimi e kompleksit Begeja 6000**". **Si palë paraqiten tre subjekte e konkretisht shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Shoqëria Homeplan e përfaqësuar nga Fatmir Bektashi, administrator.**

Në pjesën e I-rë, hyrëse, është parashtruar se palët kanë rënë dakord me anë të Akt Marrëveshjes Nr.3000 Rep Nr. 1783 Kol dt. 02.10.2008 të bashkojnë mjetet e tyre financiare për realizimin e Kompleksit shumë funksional me emërtimin "Kompleksi Begeja 6000". Bashkëpunimi i Palëve sipas kësaj Akt Marrëveshje është parashikuar të shtrihet në pronën e familjes Begeja, të përshkruar në Nenin 1 të Akt Marrëveshjes. Palët për realizimin e Kompleksit Begeja 6000 kanë përcaktuar si subjekt ndërtues Shoqërinë Kontakt Shpk....Shoqëria ndërtuese Kontakt Shpk, në vazhdimësi ka lidhur kontrata "Porosie dhe Sipërmarrje" me disa familje të tjera kufitare të familjes Begeja.

Në pjesën e II-të, Rregullime të Shtojcës, në nenin 1 "*Qëllimi i shtojcës*" kanë sanksionuar se: Palët realizojnë këtë Shtojcë me qëllim të përfshijnë rregullimet e bëra në Akt Marrëveshjen Nr 3000 Rep Nr 1782 Kol dt. 02.10.2008 edhe pronat e përcaktuara në Nenin 2 të kësaj Shtojce.

Neni 2 parashikon: Akt Marrëveshja për pjesëmarrje në Investim Ndërtimi të "*Kompleksi Begeja 6000*" me Nr 3000 Rep Nr 1782 Kol dt. 02.10.2008 (notere L. Pustina) e realizuar midis palëve i shtrin efektet e rregullimeve të saj ligjore edhe në pronat më poshtë të përshkruara:

- Pronat e familjes Vaqarri sipas "*Kontratë porosie dhe sipërmarrje*" Nr 374 Rep dhe Nr 177 Kol dt 16.04.2007 të realizuar para noteres Gentiana Shkodra, midis pjesëtarëve/trashëgimtarë të familjes Vaqarri dhe Shoqërisë Kontakt shpk.
- Pronat e familjes Llagami sipas "*Kontratë porosisë dhe sipërmarrje*" Nr. 2831 Rep Nr 486 Kol dt 29.09.2008 të realizuar para noteres G. Shkodra midis pjesëtarëve/trashëgimtarë të familjes Llagami dhe Shoqërisë Kontakt Shpk
- Pronat e familjes Saliaga sipas kontratës së sipërmarrjes Nr 8668 Rep Nr 1309 Kol dt 01.11.2007 realizuar para noteres R. Sako midis pjesëtarëve/trashëgimtarë të familjes Saliaga dhe Shoqërisë Kontakt Shpk.
- Pronat e familjes Begeja këtu të përshkruara: Pasuritë Nr. 3/138, Nr.2/325, Nr.3/162, Nr.6/164, Nr.3/166, Nr.3/149, Nr.3/150, Nr.3/151, Nr.3/152, Nr.3/153, Nr.3/154, Nr.3/155, Nr.7/257

Neni 3 "*Interpretimi i Shtojcës*" parashikon: Kjo Shtojcë përbën pjesë integrale të Akt Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Investim Ndërtimi të "*Kompleksit Begeja 6000*" të realizuar përpara noteres L. Pustina (me Nr 3000 Rep Nr. 1872 Kol d. 02. 10. 2008) dhe interpretimi juridik i saj do të bëhet në unitet me këtë Akt Marrëveshje.

Sipas nenit 4, Kjo Shtojcë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët sot me dt. 15.10.2008 (dymijë e tetë).

194.1. Në këtë shtojcë konstatohet se merret përsipër investimi edhe në pronat e familjes Llagami që nuk ishin kthyer por që do të përfitoheshin nga privatizimi.

195. Në lidhje me dokumentin "Shtojca I Akt marrëveshjes për pjesëmarrjen në investim ndërtimi të "Kompleksit Begeja 6000" konstatohet se gjendet një variant tjetër, në hard drive-in e sekuestruar pranë studio Pustina dhe nënshtruar ekspertimit. Konkretisht ky dokument i ruajtur me emërtimin "Shtojcë Begeja 6000 Homeplan 2015" i krijuar më datë 16.11.2015 me autor User dhe i ruajtur dhe printuar më datë 16.11.2015 ora 17.17 i ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi Laura, paraqet tashmë si palë **vetëm shtetasin Xhimi Begeja dhe shoqërinë Homeplan sh.p.k.** Konkretisht ky dokument paraqitet në këtë mënyrë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3193 Rep.
Nr. 1891 Kol.

SHTOJCA I
AKT MARRËVESHJES
Per Pjesëmarrje ne Investim Ndertimi te "Kompleksit Begeja 6000"

E lidhur në Tiranë sot më dt. 15/10/2008 (dy mije e teje), përpara meje Noteres publike me adresë: Rr. "Abdyl Frasheri", pll. 31, ndërmjet Palëve personalisht:

9. Z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z 1660874, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
10. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E, e cila përfaqësohet cilësin e administratorit Z.Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Të cilët për efek të kësaj Shtojce do të cilësohen "PALË"

BAZA LIGJORE

Kjo Shtojcë Akt Marrëveshje lidhet me vullnet të plotë dhe të lirë të Palëve në bazë të Nenit 79 e vijues si dhe 419, 420 442 , të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 17 te Akt-Marrëveshjes date 02/10/2008 (nr.rep.kol.3000/1783)

PJESA I
HYRJA

Palët kanë rënë dakort me anë të Akt Marrëveshjes Nr. 3000 Rep Nr. 1782 Kol. Dt. 02.10.2008 të bashkajnë mjetet e tyre financiare për realizimin e Kompleksit shumëfunksional me emërtimin "Kompleksi Begeja 6000".

Bashkëpunimi i Palëve sipas kësaj Akt Marrëveshje është parashikuar të shtrihet në pronën e Familjes Begeja të përshkruar në Nenin 1 të Akt Marrëveshjes.

Palët për realizimin e Kompleksit Begeja 6000 kanë përcaktuar si subjekt ndërtues shoqërinë KONTAKT Sh.p.k., e pajisur kjo me; Licensë Nr. 3224/1, me kod fiskal 3708169 dhe NIPT J92108006V.

Shoqëria ndërtuese Kontakt Sh.p.k në vazhdimësi ka lidhur kontrata "Porosie dhe Sipërmarrje" me disa Familje të tjera kufitare të Familjes Begeja....

195.1. Gjithashtu gjatë kqyrjes së aktit të ekspertimit të hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, konstatohet se gjendet një dokument i emërtuar si "*Shtojce Akt marrëveshje Magnet*" me datë krijimi **28.06.2016** ora 17.09, ruajtur për herë të fundit më datë 28.06.2016 dhe printuar po në këtë datë. Autori është user kurse ruajtja për herë të fundit është bërë nga përdoruesi Laura. Kjo shtojcë është revizionuar tre herë. Kjo shtojcë, konstatohet se në përmbajtje është e ngjashme me shtojcën I të akt marrëveshjes për pjesmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Magnet dhe i referohet akt marrëveshjes nr 3000 rep nr 1782 kol datë 02.10.2008 por i referohet jo kompleksit Begeja 6000 por kompleksit Magnet. Në këtë shtojcë është cituar edhe kontraktimi i studios arkitekturore amerikane të emërtuar Studio Daniel Liebeskind (SDL). Emrat e pjesmarrësve janë tre, pra shtetasi Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. Konkretisht paraqitet në këtë mënyrë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

SHTOJCA I
AKT MARRËVESHJES

Per Pjesemarrje ne Investim Ndertimi te "Kompleksit Magnet"

E lidhur në Tiranë sot më dt. _____ (_____), përpara meje Noteres publike me adresë: Rr. "Abdyl Frasheri", pll. 31, ndërmjet Palëve personalisht:

- 11. Z.Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;*
- 12. Z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tiranë, banues ne Tiranë, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z 1660874, me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
- 13. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E, e cila përfaqësohet cilësin e administratorit Z.Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tiranë, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,*

Të cilët për efekt të kësaj Shtojce do të cilësohen "PALË"

BAZA LIGJORE

Kjo Shtojcë Akt Marrëveshje lidhet me vullnet të plotë dhe të lirë të Palëve në bazë të Nenit 79 e vijues si dhe 419, 420 442 , të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 17 te Akt-Mareveshjes date 02/10/2008 (nr.rep.kol.3000/1783)

PJESA I
HYRJA

*Palët kanë rënë dakort me anë të Akt Marrëveshjes Nr. 3000 Rep Nr. 1782 Kol. Dt. 02.10.2008 të bashkojnë mjetet e tyre financiare për realizimin e Kompleksit shumëfunktional me emërtimin "*Kompleksi Magnet*".*

196. Me aktin "*Deklaratë noteriale*" nr 3660 rep nr 2146 kol datë **19.11.2008**, të përpiluar para

noteres Laura Pustina, rezulton se janë paraqitur palët: **Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Shoqëria Homeplan**, e përfaqësuar nga Fatmir Bektashi, administrator. Palët deklaruan sa më poshtë vijon: "Më dt. 02.10.2008 kemi lidhur një "Akt Marrëveshje për pjesëmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000" (rep/kol nr 3000/1783, në Dhomën e Noterisë, Tiranë) për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh në cilësinë e bashkë-investitorëve për financimin e ndërtimit të kompleksit Begeja 6000. **Duke qenë se projekti është ende në fazat fillestare të implementimit dhe nuk është përfunduar akoma kriteri burokratiko-administrativ, veçanërisht pajisja me lejen e ndërtimit të kompleksit në fjalë, personat këtu të pranishëm dhe palë të marrëveshjes së sipërpërmendur, me dëshirën dhe vullnetin tonë të plotë dhe të pakushtëzuar, biem dakord dhe deklarojmë nëpërmjet këtij akti që të pezullojmë marrëveshjen në fjalë për një periudhë kohe të pacaktuar dhe për rrjedhojë efektet juridike të saj, deri në një vendim të ndryshëm nga ana jonë, në bazë të ecurisë dhe përfundimit të procedurave të sipërpërmendura dhe fillimit të zbatimit konkret të projektit. Gjithashtu, nëpërmjet këtij akti angazhohemi dhe deklarojmë se kushtet e "Akt Marrëveshje për pjesëmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000" do të mbeten të njëjta dhe të pandryshuara me ato të vendosura nga palët, në momentin që ajo do të riaktivizohet."**

Edhe për këtë dokument janë gjendur variante vetëm me emrin e shtetasit Xhimi Begeja dhe shoqërisë Homeplan sh.p.k. por do të trajtohen bashkë me deklaratën e mëposhtme noteriale të datës 17.01.2012, për riaktivizimin e akt marrëveshjes pas pezullimit.

197. Pikërisht në ditën që shtetasi Fatmir Bektashi derdh 245 000 euro për blerjen e Klubit Shumësportesh Partizani në llogarinë e shoqërisë Homeplan sh.p.k., lidhet një **kontratë sipërmarrje ndërtimi** me nr 3329 rep nr 1967 kol datë 28.10.2008, para notere Laura Pustina, mes palëve: Shoq **Homeplan sh.p.k.** në cilësinë e investitorit dhe ndërtues shoqëria **Kontakt sh.p.k.** Sipas nenit 1, **Objekti, Investitori do të financojë ndërtuesin për ndërtimin e një kompleksi shumëfunktional me emërtimin kompleksi Homeplan**, sipas projektit dhe preventivit që i bashkangjitet kësaj kontrate. Kompleksi do të ndërtohet në truallin e pronarëve sipas kontratës së shkëmbimit no...Ndërtuesi merr përsipër ndërtimin e objektit konform projektit, duke zbatuar edhe të gjitha kushtet teknike të zbatimit (KTZ) **kundrejt shpërblimit që do të përfitojë nga investitori** sipas një grafiku pagesash të rënë dakord ndërmjet tyre me akt të veçantë. Ndërtesa do të ndërtohet tërësisht me kontributin financiar të investitorit. ...

Në nenin 12 janë përcaktuar *Detyrimet e investitorit*:

1. *Të financojë rregullisht ndërtuesin për kryerjen e punimeve të ndërtimit të kompleksit siç të përshkruar në nenin 1 të kësaj kontrate...*
2. *Të financojë të gjitha shpenzimet e ndërtimit si dhe t'i rimbursojë shoqërisë ndërtuese të gjitha shpenzimet për azhurnimin e truallit, kostot e privatizimit të truallit shtetëror si dhe shpenzime të tjera të ngjashme me to në lidhje me truallin mbi të cilin do të bëhet ndërtimi*
3. *Të shpërblejë ndërtuesin sipas volumit të punimeve të kryera...*
4. *Të caktojë një supervisor për kontrollin e ecurisë së punimeve në objekt si dhe cilësinë e materialeve të ndërtimit të përdorura...*

Kjo kontratë, si për shoqërinë Homeplan ashtu edhe për shoqërinë Kontakt sh.p.k. nënshkruhet nga shtetasi Fatmir Bektashi.

198. Me aktin "Deklaratë noteriale" nr 54 rep nr 30 kol datë 17.01.2012 para noteres Laura Pustina rezulton se janë paraqitur shtetasit **Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k.** të cilët kanë deklaruar:

“...Më dt. 02.10.2008 kemi lidhur një “Akt Marrëveshje për pjesëmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000” (rep/kol nr 3000/1783, në Dhomën e Noterisë, Tiranë) me qëllim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh në cilësinë e bashkë investitorëve, për financimin e ndërtimit të kompleksit Begeja 6000.

Këtë Akt-Marrëveshje, me vullnetin tonë të lirë e kemi pezulluar me anë të Deklaratës Noteriale, datë 19.11.2008 (rep/kol 3660/2146, Dhoma e Noterisë Tiranë) deri në një vendim të ndryshëm të palëve të saj, që ka të bëjë me përfundimin e procedurave administrative-ligjore. Nëpërmjet këtij Akti, ne deklaruesit, palë të Akt-Marrëveshjes këtu të cituar, me ndryshimin e rrethanave, biem dakord dhe shprehim vullnetin tonë të lirë për të aktivizuar Akt-Marrëveshjen e datës 02.10.2008 (rep/kol nr 3000/1783) sipas të njëjtave kushte dhe të njëjtës përmbajtje.

Për këtë arsye deklarojmë se jemi dakord të riformalizojmë këtë marrëdhënie nëpërmjet konfirmimit të vullnetit tonë për aktivizimin e “Akt-Marrëveshjes për pjesëmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000” pa ndryshuar asgjë nga kushtet dhe përmbajtja e saj, sot më datë 17. 01. 2012.

Me nënshkrimin e kësaj Deklarate Noteriale, riaktivizohet me fuqi të plotë ligjore “Akt Marrëveshja për pjesëmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000”.

199. Në lidhje me deklaratat noteriale nr 3660 rep nr 2146 kol datë **19.11.2008** për pezullimin e marrëveshjes së investimit dhe deklaratën noteriale nr 54 rep nr 30 kol datë **17.01.2012** për riaktivizimin e kësaj akt marrëveshje, nga kqyrja e akt ekspertimit të hard driv-it të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se janë gjendur disa versione të dokumentave të mësipërme.

199.1. Në dokumentin me emërtimin “**Deklaratë noteriale Begeja 6000-1**” evidentohet se data e printimit është 23.09.2008, pra e njëjta datë që shfaqet me marrëveshjen e sipërcituar për investim me nr 3000 rep, duke sugjeruar se është punuar mbi këtë të fundit. Përmbajtja e dokumentit është krijuar më datë **27.07.2012 ora 20.53** në të njëjtën datë që është krijuar edhe marrëveshja nr 3000 rep për investim me autor staff1_2 dhe është ruajtur për herë të fundit më datë **02.08.2012** në orën orën 7.23 PM, nga User. Kjo deklaratë noteriale mban tre emra, pra Jamarbër, Xhimi dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. **Bashkalidhur saj gjendet deklaratë noteriale e vitit 2012, për aktivizimit e pezullimit të kësaj akt marrëveshje, po me tre emra.** Kjo deklaratë është revizionuar **4 herë**. Më konkretisht dokumenti shfaqet me rubrika të paplotësuar e në këtë mënyrë:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2008, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

14. z. Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;
15. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër _____, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
16. Shoqëria “Homeplan” Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: _____, e cila përfaqësohet në cilësinë e administratorit nga z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar,

lindur më 24.11.1957, në Tiranë, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit Begeja 6000" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tirane) per rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilësinë e bashke investitorëve, per financimin e ndertimit te kompleksit Begeja 6000...."

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2012, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

- 1. z. Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7. Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;*
- 2. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tiranë, banues ne Tiranë, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër _____, me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
- 3. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: _____, e cila përfaqësohet cilësinë e administratorit z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tiranë, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,*

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit Begeja 6000" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tirane) me qellim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilësinë e bashke investitorëve, për financimin e ndertimit te kompleksit Begeja 6000.

*Kete Akt marrveshje, me vullnetin tone te lire, e kemi pezulluar me ane te **Deklarates Noteriale**, date ___/___/2008, (rep/kol nr. _____, Dhoma e Noterise Tirane) deri ne nje vendim te ndryshem te paleve te saj, qe ka te beje me përfundimin e procedurave administrative – ligjore.*

Siç mund të konstatohet, në pjesën e dokumentit ku paraqitet deklarata noteriale për riaktivizimin e akt marrëveshjes së pezulluar, nuk është vendosur numër repertori dhe koleksioni dhe as data, duke treguar se kjo deklaratë pezullimi nuk ka qenë e përpiluar.

199.1.2. Dokumenti me emërtimin "Deklaratë noteriale Begeja 6000 finale 2015" me datë printimi 23.09.2008, rezulton i krijuar më 16.11.2015 në orën 16.16 PM me autor staff1_2 dhe ruajtur për herë të fundit nga Laura, po në këtë datë dhe orë, revizionuar 2 herë. Në këtë deklaratë shfaqen vetëm emrat e shtetasit Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe në faqet e tjera të dokumentit gjendet edhe deklarata e vitit 2012 për riaktivizimin pas pezullimit të akt marrëveshjes së invetsimit me nr 3000 rep, sërish me dy emra, pra shtetasi Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi.

Konkretisht kjo deklaratë shfaqet në këtë mënyrë:

**“REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2008, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

17. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr. 124, personalisht i njohur prej meje noteres, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
18. Shoqëria “Homeplan” Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet ne cilësinë e administratorit nga z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:...

“Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje “Akt Marreveshje per pjesëmarrje ne investim ndertimi te kompleksit Begeja 6000” (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tirane) per rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilesine e bashke investitorëve, per financimin e ndertimit te kompleksit Begeja 6000.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2012, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

4. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër _____, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
5. Shoqëria “Homeplan” Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet cilësinë e administratorit z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

“Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje “Akt Marrëveshje per pjesëmarrje ne investim ndertimi te kompleksit Begeja 6000” (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tirane) me qellim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilësinë e bashke investitorëve, për financimin e ndertimit te kompleksit Begeja 6000.

Kete Akt marrëveshje, me vullnetin tone te lire, e kemi pezulluar me ane te Deklarates Noteriale, date 19.11.2008, (rep/kol nr. 3660/2146 Dhoma e Noterise Tirane) deri ne nje vendim te ndryshem te paleve te saj. qe ka te beje me përfundimin e procedurave administrative – ligjore...

Siç mund të shihet, dokumenti i dytë që është deklarata për riaktivizimin e marrëveshjes së pezulluar, tashmë mban numrin e repertorit dhe koleksionit si dhe datën e deklaratës noteriale të pezullimit. Kjo tregon që në vitin 2015 ishte përpiluar tashmë deklarata e pezullimit.

199.1.2. Dokumenti me emërtimin “*Deklaratë noteriale Begeja 6000-final*” e cila shfaqet vetëm me dy emra, pra Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. ku bashkalidhur është deklarata për riaktivizimin e këtij pezullimi, konstatohet i krijuar më datë 02.08.2012 ora 21.58, me autor staff1_2, pra në të njëjtën kohë që është ruajtur për herë të fundit dokumenti me emërtimin “*Deklarata Begeja 6000-1*” me tre emra dhe është ruajtur dhe printuar për herë të fundit më datë 16.11.2015 në orën 5.19 PM, nga përdoruesi Laura, pra pas deklaratës “*Deklaratë noteriale Begeja 6000 finale 2015*”.

Kjo deklaratë shfaqet me dy emra dhe ka të plotësuar me kompjuter edhe nr e repertorit edhe të koleksionit, edhe datën, duke nënkuptuar se tashmë ishin plotësuar deklaratat dhe regjistruar në regjistër. Kjo deklaratë noteriale për pezullimin e akt marrëveshjes përmban dy emra, konkretisht shtetasin Xhimi Begeja dhe shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Në pjesën e poshtme evidentohet se gjendet dokumenti për pezullimin e kësaj akt marrëveshjeje i vitit 2012, ku gjenden gjithashtu të plotësuar numri i repertorit dhe i koleksionit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 3660 Rep.
Nr. 2146 Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë 19/11/2008, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

- 19. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z1660874 me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
- 20. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit, e cila përfaqësohet ne cilësine e administratorit nga z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,*

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon...

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marreveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit Begeja 6000" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tirane) per rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilesine e bashke investitorëve, per financimin e ndertimit te kompleksit Begeja 6000.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 54 Rep.
Nr. 30 Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë 17/01/2012, përpara meje noteres, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31, jane paraqitur palët e meposhtme:

6. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tiranë, banues në Tiranë, në adresën: Rruga Dibres, nr. 124, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z1660874 me zotësi të plotë për të vepruar dhe
7. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet cilësinë e administratorit z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tiranë, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrëveshje per pjesëmarrje ne investim ndërtimi te kompleksit Begeja 6000" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomen e Noterise Tiranë) me qellim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilësinë e bashke investitorëve, për financimin e ndërtimit te kompleksit Begeja 6000.

Kete Akt marrëveshje, me vullnetin tone te lire, e kemi pezulluar me ane te Deklarates Noteriale, date 19/11/2008, (rep/kol nr. 3660/2146, Dhoma e Noterise Tiranë) deri ne nje vendim te ndryshem te paleve te saj, qe ka te beje me përfundimin e procedurave administrative – ligjore....

199.1.3. Nga të dhënat e kqyrura nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se është gjendur një dokument i emërtuar si "Deklaratë noteriale Magnet finale 2015" i krijuar dhe printuar më datë 28.06.2016 ora 17.03, i ruajtur për herë të fundit më datë 28.06.2016 ora 18.20 me autor staff1_2 dhe ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi Laura. Në këtë dokument gjenden dy akte e konkretisht deklarata noteriale e vitit 2008 për pezullimin e akt marrëveshjes me emrat e të tre subjekteve, pra shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan dhe është e ngjashme me deklaratën për pezullimin e akt marrëveshjes së vitit 2008 për kompleksin begeja por i referohet Kompeksit Magnet. Bashkangjitur gjendet deklarata noteriale e vitit 2012 për riaktivizimin e kësaj akt marrëveshje duke iu referuar me nr repertori dhe koleksioni dhe datë akt marrëveshjes për invetsimin në kompleksin Begeja por e identifikon si kompelksi Magnet. Edhe kjo deklaratë është me tre emra e konkretisht shtetasit Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. Konkretisht paraqitet në këtë mënyrë:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ____/____/2008, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

21. Z.Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;
22. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tiranë, banues në Tiranë, në adresën: Rruga Dibres, nr. 124, personalisht i njohur prej meje noteres, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
23. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet ne cilësinë e administratorit nga z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tiranë, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit "Magnet" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomën e Noterisë Tirane) per rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilesine e bashke investitorëve, per financimin e ndertimit te kompleksit "Magnet"....

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2012, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

- 8. Z.Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër BB2244743, me zotësi të plotë për të vepruar;*
- 9. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues ne Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr.124, i njohur prej meje noteres sipas ligjit, me zotësi të plotë për të vepruar dhe*
- 10. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet cilësinë e administratorit z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,*

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit Magnet" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomën e Noterisë Tirane) me qellim rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilësinë e bashke investitorëve, për financimin e ndertimit te kompleksit Magnet.

199.1.4. Nga kqyrja e të dhënave të përfutuara nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton të jetë gjendur një dokument i emërtuar si "Republika e Shqipërisë" me datë krijimi 28.06.2016 ora 17.59, i printuar po në këtë datë në orën 18.01 dhe i ruajtur për herë të fundit po në këtë datë në orën 18.20. Në përmbajtje është e njëjta deklaratë për pezullimin e akt marrëveshjes si më sipër, e vitit 2008 por që i referohet kompleksit Magnet. Konkretisht ka këtë përmbajtje:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË**

Nr. ___ Rep.

Nr. ___ Kol.

DEKLARATE NOTERIALE

Sot me datë ___/___/2008, përpara Noteres Laura Pustina, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me adrese ne Rr. Abdyl Frasheri, 31 palët e meposhtme:

24. z. Jamarbër Malltezi, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 09.11.1972, në Tiranë, banues në Tiranë, rruga Mustafa Matohiti, Pall.7, Ap.8/2, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër Z2033480, me zotësi të plotë për të vepruar;
25. z. Xhimi Begeja, i biri i Hakiut, shtetas shqiptar, lindur më 01 prill 1965 në Tirane, banues në Tirane, në adresen: Rruga Dibres, nr. 124, personalisht i njohur prej meje noteres, me zotësi të plotë për të vepruar dhe
26. Shoqëria "Homeplan" Sh.p.k., me seli në Tiranë, Rruga Budi, Nr. 115, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, e pajisur me NIPT: K81803020E e cila përfaqësohet në cilësinë e administratorit nga z. Fatmir Bektashi, i biri i Petritit, shtetas shqiptar, lindur më 24.11.1957, në Tirane, banues në Rr. Sulejman Delvina Pall. 140 Shk. 1 Ap. 4, mbajtës i pasaportës shqiptare me numër, Z0158246 me zotësi të plotë për të vepruar,

Te cilet nen pergjegjesine e tyre te plote me deklaruan sa me poshte vijon:

"Me date 02.10.2008, kemi lidhur nje "Akt Marrveshje per pjesemarrje ne investim ndertimi te kompleksit "Magnet" (rep/kol nr. 3000/1783, ne Dhomën e Noterisë Tirane) per rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet nesh ne cilesine e bashke investitorëve, per financimin e ndertimit te kompleksit "Magnet"....

200. Në një dokument të emërtuar "Kontratat (mungesa)" datë krijimi 03.10.2019 dhe datë ruajtje për herë të fundit 10.10.2019, sipas të dhënave të ekstraktuara nga akti i ekspertimit të hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se, për vitin 2012 janë bërë shënime në lidhje me deklaratën nr 54 rep nr 30 kol datë 17.01.2012 mes palëve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi e konkretisht gjendet shënimi: "Janë dakort për të investuar në projektin Begeja 6000" dhe në vijim është bërë shënimi se nuk ndodhet në arkiv por është e shënuar në regjistër.

Në regjistrin e veprimeve noteriale, konstatohen të regjistruara veprimet noteriale si të vitit 2008 dhe të vitit 2012 që i referohen deklaratave noteriale të pezullimit dhe riaktivizimit të akt marrëveshjes.

Në regjistrin e veprimeve noteriale të vitit 2008, faqen ku është shënuar deklarata noteriale për pezullimin e akt marrëveshjes gjendet i vendosur nr repertori dhe koleksioni e konkretisht 3660 rep 2146 kol. Në të njëjtin rresht konstatohet se data 19.11.2008 është vendosur me një mjet shkruar të ndryshëm nga ai që është përdorur për numrin e repertorit dhe koleksionit dhe në rubrikën e emrit dhe mbiemrit të kërkuesit dhe shërbimit është shënuar thjesht "Abi" që duket se është shënim i bërë me të njëjtin mjet shkruar që është shkruar data. Në përshkrimin e aktit apo llojin e dokumentit nuk ka shënime.

Në regjistrin e veprimeve noteriale të vitit 2012, në faqen ku është shënuar deklarata noteriale për riaktivizimin e akt marrëveshjes, gjendet i vendosur numri i repertorit dhe koleksionit konkretisht 54 rep dhe 30 kol ndërkohë që data 17.01.2012 duket e shënuar me të njëjtin mjet shkruar që është shënuar data 19.11.2008 si më sipër cituar dhe emri *Abi*. Në rubrikën e emrit të kërkuesit dhe shërbimit është shënuar "Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja, Fatmir Bektashi", lloji i dokumentit "Deklaratë noteriale" dhe në përshkrim "Janë dakord për të investuar në projektin Begeja 6000", kur llogjikisht duhet të ishte përshkrimi për riaktivizimin e akt marrëveshjes dhe jo për dakordësinë që prezumohet se ishte dhënë që në muajin shkurt e më pas tetor 2008.

201. Pasur parasysh si më sipër, aktet e sipërcituara ju nënshtruan ekspertimit grafik – teknik.

201.1. Në dokumentin *akt marrëveshje për pjesmarrje në investim ndërtimi të kompleksit Begeja 6000* me nr 3000 rep nr 1783/3 kol datë **02.10.2008** i lidhur ndërmjet shtetasve Xhimi Begeja, Jamarbër Malltezi, shoqëria Homeplan sh.p.k., konstatohet se, në pullën e taksës së aplikuar në pjesën e sipërme të faqes së parë të dokumentit, **u evidentuan prishje të elementëve kornizues, shkolitje të parregullta në kornizimet e kësaj pulle, mbetje fibrash dhe materiali (letër) në hapësirën e krijuar mes elementëve kornizues të pullës.**

Nëse pjesën e shkronjave të munguara në shenjën e vulës rrethore me tekst të lexueshëm "*...Blika e Shqipërisë – Laura L.Gj.Pustina – Noter Tiranë*" evidentohet shkolitje e materialit (mungesë materiali/fibrave të letrës) **në trajtë të çrregullt, krijuar nga procesi i shkuljes në mënyrë mekanike**, i një objekti tjetër, duke u shoqëruar (pas shkuljes) me marrje materiali nga fleta e letrës së dokumentit objekt ekspertimi.

Shenja e vulës së njomë rrethore me tekst me lexueshmëri "*...Ublika e Shqipërisë – Laura L.Gj.Pustina – Noter Tiranë*" ndodhur në faqen e parë, nuk e prek pullën e taksës së sipërcituar.

Tek/rreth shenjës së vulës së njomë rrethore, me tekst me lexueshmëri "*...Ublika e Shqipërisë – Laura L.Gj.Pustina – Noter Tiranë*" evidentohet një tjetër shenjë vule, e cila ka formë drejtëkëndore me tekst "*Taksa e pullës u likujdua*".

201.1.1. Në lidhje me *deklaratën noteriale nr 3660 rep nr 2146 kol datë 15.10.2008* i lidhur mes shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. për pezullimin e akt marrëveshjes, rezulton se **gjendet në fund një vulë e pakonturuar me tekst "Notere – Laura Pustina"**.

Me aktin e ekspertimit nr 4362 datë 24.06.2024 në lidhje me këtë dokument është konkluduar ndër të tjera se nga ekzaminimi i pullave të taksës aplikuar në pjesën e sipërme të dokumentit, është evidentuar shkolitje e shtresës së letrës së letrës shoqëruar me heqje materiali në pjesën e letrës së dokumentit, pas pullës së djathtë. Mbi këto pulla nuk evidentohet prezencë e vijimësi e shenjës së vulës rrethore e ndodhur pranë tyre.

Shenja e vulës rrethore e sipërcituar nuk është unike në raport me pullën e sipërcituar.

Pullat aktuale në këtë dokument janë vendosur pas shenjës së vulës së sipërcituar..

Në pjesën fundore të këtij dokumenti evidentohet një shenjë vule e njomë me tekst "*Notere Laura Pustina*"

201.1.2. Në lidhje me *deklaratën noteriale nr 54 rep nr 30 kol datë 17.01.2012* i lidhur mes shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k., referuar qoftë edhe shikimit me sy të lirë por edhe si rezultat i aktit të ekspertimit nr 4362 datë 24.06.2024, rezulton se janë evidentuar korrigjime në rreshtin e pestë të faqes së parë të tekstit ku numri i pasaportës së personit është i dorëshkaruar mbi një shtresë të bardhë (korrektor). Nga ekzaminimi, sipas akt ekspertimit rezulton të ketë qenë nën dorëshkrimin aktual BB2244743 printimi Z2033480. Ky është numri që i korrespondon dokumentit identifikues të shtetasit Jamarbër Malltezi dhe në variantet e dokumentit të gjendur në kompjuter është vednosur pikërisht numri i mëparshëm Z2033480 që edhe është korrigjuar më vonë.

Në pjesën fundore të këtij dokumenti evidentohet një shenjë vule e njomë me tekst "*Notere Laura Pustina*".

201.1.3. Përsa i përket dokumentit “ *Shtojca I – akt marrëveshjes për pjesmarrje në investim ndërtimit të Kompelskit Begeja 6000*” me nr 3193 rep nr 1891 kol datë 15.10.2008 i lidhur mes shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. në faqen e katërt të këtij dokumenti evidentohet **një shenjë vule e njomë me tekst “Laura Pustina”**.

201.1.4. Shenjat e vulave të njoma rrethore të noteres ndodhur në dokumentat objekt ekspertimi të vitit 2008 dhe ato të ndodhura në deklaratën noteriale nr 54 rep nr 30 kol datë 17.01.2012 objekt ekspertimi janë formuar nga e njëjta klishe vule dhe janë të njëjta edhe me vulat e përdorura në dokumentat model ekspertimi të vitit 2008 dhe 2012.

Shenjat e vulave të thata të dokumentave objekt ekspertimi të vitit 2008 janë formuar nga e njëjta klishe vule përveç dokumentit Kontratë sipërmarrje ndërtimi nr 3329 rep nr 1967 kol datë 28.10.2008 e cila është formuar nga një klishe tjetër vule. Këto gjurmë vulash të thata përputhen edhe me modelet e vulave të gjurmëve të thata të dokumentave të vitit 2008 dhe 2012.

201.1.5. Në dokumentat objekt ekspertimi Deklaratë noteriale nr 3660 rep nr 2146 kol datë 19.11.2008 dhe deklaratë noteriale nr 54 rep nr 30 kol datë 17.01.2012 pra ato për pezullimin dhe aktivizimin e akt marrëveshjes së investimit, shkrimet emër, mbiemër dhe nënshkrimet e shtetasve Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi si dhe nënshkrimet e shtetases Laura Pustina, janë plotësuar për secilin prej tyre, me mjet shkruar që ka të njëjtin tonalitet boje (pra që në dy dokumenta me diferencë katër vjet mes tyre, është përdorur i njëjti tonalitet boje ose derivuar i njëjti mjet shkruar).

201.1.6. Përsa i përket gjurmëve të vulave me tekst “Laura Pustina” dhe “Notere Laura Pustina” të pakonturuara përputhen me gjurmët e të njëjtave vula të gjendura në dokumentat model të vitit 2012 por nuk gjenden në asnjë dokument të vitit 2008 përveç atyre të çuar për ekspertim.

Gjithashtu këto vula të gjendura në dy deklaratat e konkretisht ajo me nr 3660 rep nr 2146 kol datë 19.11.2008 dhe nr 34 rep nr 30 kol datë 17.01.2012 janë krijuar në kohë të afër me njëra tjetrën.

Në fakt, në vijimësi të hetimit, me vendimin datë 19.06.2024, proces verbalin datë 19.06.2024 është realizuar kqyrje pranë subjektit Grandidea, subjekt që ka prodhuar vulat e pakonturuara të shtetases Laura Pustina. Nga kqyrja e të dhënave në kompjuter ka rezultuar se dokumentat që pasqyrojnë figurën e këtyre vulave mbajnë datën 11.02.2009 dhe firma e shtetases Laura Pustina në trajtë gjurmë vule, mban datën 26.07.2012.

Pagesat e privatizimit dhe konkludimi i procedurës së privatizimit të Klubit Shumësportesh

202. Pagesat, sipas shkresës me nr. 647/1 prot datë 17.01.2024 të Drejtorisë së Privatizimit dhe Shitjes pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për **privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani dhe Pishina Laprakë, Tiranë**, rezulton të jenë kryer si vijon:

- a) Transfertë bankare e nr ref B1/08/1991 datë **10.07.2008** në shumën **8 700 000 lekë** kryer nga **Gjon Gjonaj**, në Emporiki Bank
- b) Mandat pagesa me nr reef 00044 datë 10.07.2008 në shumën 621 000 lekë, kryer nga Fatri Tafaj (përfaqësues familjes Llagami) në Raiffeisen Bank
- c) Mandat pagesa me nr reef 00014 datë 15.07.2008 në shumën 69 000 lekë, nga Mirnije Llagami në Raiffeisen Bank
- d) Mandat pagesa me nr reef 00015 dt 15.07.2008 shuma 138 000 lekë, nga Adela Llagami

në Raiffeisen Bank

- e) Mandat pagesa me nr reef ...0009 dt **29.10.2008** në shumën prej **30 380 000 lekë**, e kryer nga shoqëria **Kontakt sh.p.k.** me administrator Fatmir Bektashi në Union Bank;
- f) Mandat pagesa me nr reef 1...0010 datë 29.10.2008 në shumën prej **27 883 658 lekë** e kryer nga shoqëria **Kontakt sh.p.k.** me adminsitator Fatmir Bektashi në Union Bank;
- g) Mandat pagesa me nr reef 1...0006 datë 30.10.2008 në shumën prej **1 923 487 lekë** e kryer nga shoqëria **Kontakt sh.p.k.** me adminsitator Fatmir Bektashi në Union Bank;

202.1. Pra siç mund të konstatohet nga aktet, rezulton se një shumë prej 8 700 000 lekë, janë paguar në muajin korrik 2008, nga shtetasi Gjon Gjonaj, i cili qartësisht rezulton se nuk është ndonjë trashëgimtar i pronarëve.

Më datë 18.12.2023, është pyetur shtetasi **Gjon Gjonaj**, banues në Hotel Turizëm Pukë, aktualisht i punësuar në pozicionin e Zv. Prefektit të Pukë- Fushë Arrës, i cili ka deklaruar se, ... *Shtetasin Xhimi Begeja e njeh prej vitit 2003, kur një shoku i Gjonit ka blerë tokë në Tiranën e Re nga shtetasi Xhimi Begeja dhe prej asaj kohe dhe deri më sot, ka ruajtur marrëdhënie me shtetasin Xhimi Begeja. Marrëdhënia që ka me Xhimin është dhe marrëdhënie biznesi dhe marrëdhënie miqësore të afërt. ...Në vitin 2005 së bashku me shtetasin Xhimi Begeja kanë blerë Hotel Turizëm Pukë, nga shtetasi Martin Përdoj në shumën 200,000 Euro. Në momentin e blerjes Hotel Turizëm Pukë ishte si ndërtim por kërkonte rikonstruksion të plotë. Pas një viti, konkretisht në vitin 2006 e ka hapur Hotelin i cili prej asaj kohe vijon të ushtrojë veprimtarinë. Gjoni pretendon se nuk ka qënë asnjëherë ortak me letra në Hotel Turizëm Pukë, por nga viti 2005 dhe në vazhdim e kanë së bashku këtë firmë. Gjoni edhe investon dhe merr fitime nga Hotel Turizëm Pukë që prej vitit 2005. Marrëdhënien me Xhimin për subjektin "Begeja HTP" e kanë verbale prej fillimit deri tani pa asnjë problem. Aktualisht Hotel Turizëm Pukë ushtron veprimtarinë si "Bar restorant, Hotel dhe prodhim birre". Nga viti 2015 deri në 14 Maj të vitit 2023, ka qënë Kryetar Bashkie në Pukë dhe prej shtatorit të vitit 2023 mban pozicionin e zv. Prefektit Pukë- Fushë Arrëz. Në lidhje me pagesën për privatizimin e klubit sportiv, deklaroi se, efektivisht kjo shumë është paguar pas një kredie të marrë tek Raiffeisen Bank dhe NBG Bank, kredi të marra nga firmat që shtetasi Xhimi Begeja kishte në pronësi, konkretisht Begeja 1900 dhe Begeja HTP. Mesa kujton, shtetasi Xhimi Begeja nëpërmjet firmave të tij ka marrë kredi në shumën afërsisht 600,000 Euro në total në të dyja bankat e sipërcituara. Nuk i kujtohet arsyeja se përse i ka derdhur Gjoni këto lekë dhe përse e ka paguar ai këtë shumë, por nisur nga fakti që ka punuar me Xhimin, kjo mund të ketë qënë një kërkesë e tij për të përmbushur detyrimin që ka patur Xhimi për privatizimin e Klubit Shumësportësh Partizani. Shpesh herë edhe për këstet e kredisë që kishin për të paguar në bankë, bëhej e njëjta procedurë, domethënë kush kishte mundësi fizike për të qënë më disponibël bënte derdhjen e kësteve pranë bankës. Thekson se Gjoni nuk ka asnjë lidhje, veprimtari të përbashkët me ish klubin Partizani me pronarë dhe ish pronarë dhe nuk është i përfshirë në asnjë aktivitet financiar ose pjesë takuese të kësaj veprimtarie. Në atë periudhë kishte dijeni që shtetasi Xhimi Begeja dhe trashëgimtarët e tjerë në terrenet e ish Klubit Partizani po kërkonin privatizimin sepse e ka ndihmuar dhe me gjetjen e dokumentacioni arkivor për këtë pronë dhe gjithashtu ka marrë pjesë në takimet që ka bërë me trashëgimtarët sepse duhej një konsensus i gjerë që të gjithë së bashku të përfundonin këto procedura.*

Gjoni di që, trashëgimtarët e familjes Begeja ishin në gjëndje jo të mirë ekonomike. Ka marrë pjesë në takime që janë zhvilluar me trashëgimtarët e familjes Begeja dhe ata i janë shprehur drejtëpërdrejtë Xhimit se janë në pamundësi të paguajnë dhe këtë shumë duhet ta paguante Xhimi dhe ata do t'i njihnin këtë shumë dhe shpenzimet e bëra nga shtetasi Xhimi Begeja do të merreshin parasysh nga ata në momentin që do të bëhej ndarja e pjesëve me trashëgimtarëve. Pagesa është kryer nga Xhimi dhe ai ju ka bërë prezent herë pas here

trashgimtarëve gjatë takimeve të gjitha shpenzimet që ka bërë.

Shtetasin Fatmir Bektashi e ka njohur në vitin 2012 kur prona ku ishte trashëgimtar Xhimi Begeja u dha për ndërtim firmës së tij Kontakt SHPK. Pas kësaj periudhe Gjoni është shkëputur totalisht dhe nuk ka ndjekur asnjë problem në lidhje me Xhimin për pronat, pasi ka patur rezervat e tij për trajtimin që shtetasi Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi kanë bërë në lidhje me Xhimin.

Në vitin 2005 Gjoni ka njohur dhe shtetasin Jamarbër Malltezi të cilin e ka njohur nëpërmjet Xhimit dhe i është prezantuar si nipi i Xhimit.

Nuk ka patur kontakte dhe nuk është ulur të pij kafe asnjëherë me shtetasit Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi. Të dy këta shtetas i ka njohur më së shumti prej Xhimit.

Në dijeninë e tij, shtetasi Xhimi Begeja ka qënë ortak i shoqërisë Homeplan shpk që nga fillimi. Kujton një bisedë që ka bërë me Xhimin i cili i ka thënë që Arbëri me Fatmirin i kanë propozuar që ai së bashku me anëtarët e tjerë të familjes Begeja të bien në marrëveshje që të zgjedhin firmën e Fatmir Bektashit për të kryer ndërtimin dhe zhvillimin e pronës së tyre në terrenet e Klubit të Futbollit Partizani, meqënëse shtetasi Fatmir Bektashi ishte dhe trashgimtarë i familjes Vaqarri. Gjoni, në atë kohë i ka thënë Xhimit që të shikojë nëse fiton diçka nga kjo marrëdhënie të bëhet pjesë, në të kundërt të tërhiqet. Pavarësisht se Xhimi u bashkua në firmën Homeplan shpk, ai nuk ka patur asnjë rol vendimarrës dhe ska patur asnjë përfitim, pasi gjithcka e vendoste Fatmiri me Jamarbërin. Nëse Xhimi do kishte marrë ndonjë përfitim nga kjo marrëdhënie do ia kishte shprehur në një formë ose në një tjetër nisur dhe nga marrëdhënia që Gjoni ka me të prej 20 vitesh.

Shtetasi Xhimi Begeja, rezulton nga aktet e administruara se, ka regjistruar më datë 01.03.2002 shoqërinë Begeja 1900 me NIPT K31421105R. Rezulton se për këtë aktivitet, shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar në vitin 2005 një fitim prej 1 775 335 lekë dhe në vitin 2006 një fitim prej 241 792 lekë; në vitin 2007 evidentohet humbje në masën – 800 481 lekë, në vitin 2008 një fitim prej 899 307 lekë, por nuk evidentohen ndarje dividendi⁵.

Shtetasi Xhimi Begeja, ka regjistruar më dt 02.06.2006 edhe një subjekt tjetër e konkretisht subjektin Begeja 1900 H.T.P. me NIPT K69215305M. Nga këqyrja e bilanceve dhe e deklaratave të tatimit mbi fitimin rezulton që shoqëria “Begeja 1900 H.T.P.” sh.p.k. për vitet që ka rezultuar me fitim, me vendim të asamblesë së ortakëve, fitimi është destinuar për shtimin e rezervave të tjera dhe për investime. Në vitin 2008 ky subjekt ka rezultuar me fitim 0⁶.

Kjo pagesë, mesa konstatohet, i është kthyer në vijim shtetasit Gjon Gjonaj, siç rezulton nga llogaria bankare e shoqërisë Homeplan sh.p.k. në bankën Societe Generale Albania sh.a., në datën 18.05.2011, me Numër 0000939216-86 në monedhën euro. Konkretisht rezulton se në drejtim të shtetasit Gjon Jakë Gjonaj, të jenë paguar më datë 28.02.2013, nga shoqëria Homeplan sh.p.k. shuma prej 50 000 euro, me emërtimin “Trf. Nisje 13001656 11099 TRF1 transfertë në nisje, rikthim pages e kryer per privatizi e Klubit sh. Sportesh Partizani 20%, ngurtesim fondi nga familja Begeja, Llagami, Saliaga dt. 10.07.2008 Emporiki”.

⁵ Edhe në vitet në vijim për këtë shoqëri, nuk rezulton të ketë ndonjë fitim të madh, kështu në vitin 2009 evidentohet një fitim prej 168 489 lekë; në vitin 2010 një fitim prej 106 291 lekë; në vitin 2011 një fitim prej 54 999 lekë; në vitin 2012 një fitim prej 71 818 lekë; në 2013 prej 145 439 lekë; në 2014 prej 52 363 lekë; në 2015 humbje në masën – 884 602 lekë dhe në vitin 2016 një fitim prej 718 915 lekë.

⁶ Edhe në vitet në vijim nuk evidentohet ndonjë fitim i madh. Kështu në vitin 2009 rezulton fitim 48 813 lekë; në vitin 2010 një fitim prej 231 227 lekë; në vitin 2011 një fitim prej 320 605 lekë; në vitin 2012 një fitim prej 1 964 lekë; në vitin 2013 një shumë prej 228 360 lekë; në vitin 2014 një shumë prej 431 736 lekë; në vitin 2015 një shumë prej 713 883 lekë; në vitin 2016 një shumë prej 802 087 lekë; në vitin 2017 një shumë prej 381 574 lekë; në vitin 2018 një shumë prej 258 133 lekë; në vitin 2019 një shumë prej 333 013 lekë; në vitin 2020 një shumë prej 328 750 lekë, në vitin 2021 një shumë prej 625 512 lekë; në vitin 2022 një shumë prej 1 013 774 lekë.

Gjithashtu, konstatohet sipas deklarimeve të dhëna në ILDKPKI nga vetë shtetasi Gjon Gjonaj, më datë 5028 rep nr 2274 kol datë 20.06.2008 ai ka shitur pasurinë që e kishte blerë nga shtetasi Xhimi Begeja të llojit tokë ullishte me sip 13 500 m2 ndodhur në Selitë ZK 3292 me nr pas 51/34 nga e cila ka përfiturar shumën prej 675 000 euro.

Pas kryerjes së pagesës për privatizimin si më sipër cituar, në vitin 2009, shtetasi Gjon Gjonaj është bërë pjesë e aktivitetit të hotelit të blerë nga shtetasi Xhimi Begeja, në Pukë.

202.2. Kurse shoqëria Kontakt sh.p.k. rezulton të ketë paguar shumën prej **60 187 145 lekë**, në fund të muajit tetor 2008. Konstatohet se këto pagesa të kryera nga shoqëria Kontakt sh.p.k. janë bërë fillimisht në drejtim të shoqërisë Homeplan sh.p.k. e më pas në drejtim të shoqërisë Kontakt që përfundimisht kjo e fundit i kalon për llogari të blerjes së objekteve dhe terreneve si më sipër.

Kështu rezulton se:

- në llog bankare të shoq Homeplan sh.p.k. me nr. ...020121 në euro, pranë Bankës Union, shtetasi Fatmir Bektashi ka kryer **derdhje cash** më dt **28.10.2008** të një shume prej **245 000 euro**, shumë e cila më dt 29.10.2008 është transferuar nga një llogari në tjetrën, konkretisht nga llogaria në fjalë tek llogaria me nr ...20110 në lekë, po e shoq Homeplan sh.p.k. duke u bërë edhe konvertimi në lekë, në shumën **30 380 000 lekë**. Me urdhër pagesën e lëshuar nga Union Bank KIB 21411508 dt **29.10.2008**, rezulton se urdhëruesi Kontakt sh.p.k. me nr llogarie ...020111 ka paguar për llogari të Degës së Thesarit shumën prej 30 380 000 lekë në favor të privatizimit të **Klubit Shumësportesh Partizani** me burim të ardhurash nga biznesi. Urdhër pagese i nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi
- më dt **29.10.2008** në llogarinë bankare0121 euro shoq Homeplan sh.p.k. është kredituar nga shoq Kontakt sh.p.k. me një shumë prej **230 000 euro** me përshkrim "**...kalim për privatizim të klubit shumësportesh Partizani Tiranë**". Në po të njëjtën datë kjo shumë transferohet tek llogaria në lekë e shoq Homeplan me nr. ...0110 lekë, duke u bërë konvertimi përkatës në vlerën **28 520 000 lekë**. Më pas kjo shumë nga shoq Homeplan sh.p.k. kalon në shoqërinë Kontakt sh.p.k. **me të njëjtin përshkrim**. Me urdhër pagesën e lëshuar nga Union Bank KIB 21411508 dt **29.10.2008** të Union Bank, rezulton se urdhëruesi Kontakt sh.p.k. me nr llogarie 1...020111 ka paguar për llogari të Degës së Thesarit shumën prej 27 883 658 lekë në për Ministrinë e Financave, Dr. Regj e shitjes së pronave publike Tiranë për privatizimin e Klubit shumësportesh Partizani Tiranë. Urdhëri i pagesës është nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi. Burimi i të ardhurave nga biznesi.
- më dt **30.10.2008**, është bërë një depozitim cash nga shtetasi Fatmir Bektashi në shumën **10 450 euro** në llogarinë me nr. ...121 të shoqërisë Homeplan, dhe po në këtë datë është transferuar kjo shumë është konvertuar në lekë në vlerën **1 287 912 lekë** dhe më pas bashkë me pjesën tjetër të parave që kanë ngelur në këtë llogari bankare, është transferuar shuma prej 1 923 487 lekë në drejtim të shoqërisë Kontakt sh.p.k. me përshkrimin "**...kalim për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani, Tiranë**". Me mandat pagesën e Union Bank datë **30.10.2008** rezulton se shoqëria Kontakt me nr llogarie 111100431020111 ka paguar shumën prej **1 923 487 lekë**, për Ministrinë e Financave për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani. Urdhër pagesa KIB 21411508 nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi, me burim të ardhurash nga biznesi.

202.2.1. Sa më sipër, lëvizja e parave fillimisht si depozitim cash në vlerën 245 000 euro nga

shtetasi Fatmir Bektashi, shumën prej 230 000 euro nga shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe shumën prej 10 450 euro cash depozituar nga Fatmir Bektashi, dhe kalimi i tyre në llogarinë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. për të rikaluar prapë në llogarinë e shoqërisë Kontakt sh.p.k., para këto të përdorura për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani, vërtetojnë më së qarti, se **llogaria e shoqërisë Homeplan sh.p.k. është përdorur me qëllim lënien e gjurmëve të parave që investohen për privatizimin**, si një llogaridhënie dhe qëllim përllogaritje në të ardhmen e përfitimit që do t'i jepej shtetasit Jamarbër Malltezi, pasi të zbriteshin shpenzimet e privatizimit. Pra në këtë marrëdhënie, shtetasi Fatmir Bektashi, tashmë rezulton e qartë se kishte premtuar dhe kishte ndërmarrë hapa për të shpërblyer në mënyrë të padrejtë shtetasin Jamarbër Malltezi për pushtetin që ai ushtronte nëpërmjet vjehrrit të tij, por duket se në këtë marrëveshje, shtetasi Fatmir Bektashi, ka kërkuar që shpenzimet e kryera në kuadrin e privatizimit dhe të ndërtimit, të shlyheshin nga fitimet që do të realizoheshin nga këto ndërtime.

Kjo shumë ka vijuar të mbartet dhe të shlyhet ndër vite nga të ardhurat e shoqërisë Homeplan sh.p.k. pasi është pasqyruar si detyrim për këtë të fundit. Nga ekspertimi i hard diskut, sekuestruar pranë zyrës Pustina, rezulton se gjendet një dokument në Word, me emërtimin "Email dt. 24.03.2011 (mospërputhje në 467)" dokument i krijuar më datë 24.03.2011 dhe i ruajtur për herë të fundit po në këtë datë. Emaili ka përmbajtjen si më poshtë:

"Pershendetje Z. Artan, Pas verifikimeve tona per llogarite 467 te subjektit "Kontakt" shpk kemi mosperputhje te mbartjes se gjendjes nga viti 2008-2009 per llogarine 467 ne ALL, perkatesisht:

Gjendja sipas "Kontakt" 467 Homeplan Debitore per 2.021.800 leke.

Gjendja sipas "Homeplan" 467 Kontakt Debitore per 60.187.145 leke.

Kjo gjendje vjen nga transfertat e kryera prane bankes "Union Bank", valuta ALL, si me poshte:

	<i>Kalim per Kontakt per</i>	
<i>29/10/2008</i>	<i>Priv.Klubi Partizani</i>	<i>30,380,000.00</i>
	<i>Kalim per Kontakt per</i>	
<i>29/10/2008</i>	<i>Priv.Klubi Partizani</i>	<i>27,883,658.00</i>
	<i>Kalim per Kontakt per</i>	
<i>30/10/2008</i>	<i>Priv.Klubi Partizani</i>	<i>1,923,487.00</i>
		<i>-----</i>
	<i>TOTALI</i>	<i>60,187,145.00</i>

...Ju lutem te kryeni verifikimet Tuaja per sa me siper si dhe per mosrakordimet e meparshme sipas e-mailit te meposhtem. Faleminderit dhe gjithë te mirat, Odeta Fishta"

203. Me shkresën nr. 6830/1 prot datë **23.10.2008**, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Fisnik Brovina, i drejtohet shtetasit Urim Muja, drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në përgjigje të shkresës nr. 10746 prot datë 15.10.2008, se personi që do të përfaqësojë Ministrinë e Turizmit, në procedurën e privatizimit të objektit "Klubi Shumësportesh Partizani" me adresë Rruga "Frosina Plaku", Tiranë (dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes) do të jetë juristja Drita Liço.

204. Më dt **03.11.2008** përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike **Z. Nuri Sopaj** dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve **Drita Liço**, ju kanë dorëzuar trashgimtarëve ligjorë të familjeve **Xhemal dhe Mahmud Begeja; Sabrije Llagami; Qamil Saliaga**. Përfaqësimi i ish- Pronarëve është bërë me anë të prokurave të posaçme dhe të përgjithshme të përshkruar në këtë relacion,

objektin. Në këtë akt përshkruhet se në momentin e dorëzimit, gjendja e objektit është në përputhje me vlerësimin dhe dokumentacionin e dërguar nga METE me shkresën nr. 4660/1 prot dt 20.05.2008.

Vlera totale e objektit "*Klubi Shumësportesh Partizani*" me vendndodhje në rrugën "*Frosina Plaku*" në administrim të Ministrisë së Turizmit në përbërje të të cilit është edhe objekti "*Pishina Laprakë*" me vendndodhje Rruga e Durrësit është 43 255 000 lekë mjete kryesore kurse mjete xhiro nuk ka. Sipërfaqja totale e objektit sipas genplanit është 19 091 m² dhe nën objekt 5 417 m².

205. Më datë **04.11.2008**, rezulton se është nënshkruar kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme Nr. 3298 Rep, Nr. 562 Kol para notere Gentiana Shkodra Tiranë.

Objekti i kontratës: shitja dhe kalimi në pronësi private i objektit "*Klubi Shumësportesh Partizani*" në përbërje të të cilit është edhe *Pishina Laprakë Tiranë*, në administrim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Tiranë me sipërfaqe totale **19 091 m²** nga e cila **5417 m² nën objekt** sipas vendimeve të Komisionit të Kthim Kompesimit të Pronave Ish-pronarëve Tiranë Nr. 532, datë 25.04.1996, Nr.97 datë 17.12.1999, Nr.98, datë 17.12.1999 dhe Nr.6 datë 21.03.2007, Nr.7 datë 21.03.2007 të Zyrës Rajonale të KK Pronave Qarku Tiranë.

Nga sipërfaqja e përgjithshme, sipërfaqja prej **1,195 m²** nga e cila **880 m²** për objektin "*Pishina Laprakë*" pronë shtet, që nuk bie në pronën e ish-pronarëve, i është shitur blerësve.

Objekti Klubi Shumësportësh Partizani ndodhet në ZK.8220 Tiranë dhe kufizohet: Veriu- Banda e Ushtrisë, Pronë Private, Lindje- Klubi i Futbollit Partizani, Jugu- Pronë private, Perëndimi Ish-AlbBeton 5, pronë private. **Objekti "Pishina Laprakë" Tiranë ndodhet në ZK.8310 Tiranë dhe kufizohet si më poshtë vijon:** Veri: Ish- Repart Ushtarak, Lindje: Rruga e Durrësit, Lindja: Ish- Repart Ushtarak, Perëndimi: Ish-Territor i Pularisë Laprakë.

Çmimi i shitjes së objektit është **43,255,000 lekë** dhe çmimi i shitjes së truallit prej **1,195 m²** është **26,454,145 lekë**. Çmimi kompleksiv i shitjes së pasurisë është **69 709 145 lekë** i cili është paguar në bankë për llogari të Ministrisë së Financave.

Kontrata e shitjes është nënshkruar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike shtetasi Urim Muja dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Drita Liço në cilësinë e palës shitëse, ndërkohë që në cilësinë e palës blerëse kanë qënë të gjithë trashgimtarët e ish pronarëve të përfaqësuar me anë të prokurave të përshkruara në këtë relacion.

Në këtë kontratë është vendosur si palë ndër të tjerë edhe emri i shtetases Nimete Bekteshi, për të cilën nga noterja është bërë shënimi se mungojnë të dhënat e pasaportës. Sjellim në vëmendje se shtetësja Nimete Bekteshi, ka ndërruar jetë që më datë 15.07.2006 dhe shtetasi Jamarbër Malltezi është bërë trashëgimtar i saj më datë 15.07.2006, megjithatë, megjithëse person i vdekur, ajo paraqitet si palë në këtë kontratë dhe shtetasi Jamarbër Malltezi vijon të nënshkruajë në emër të saj.

205.1. Drejtorja e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike me Drejtor Urim Muja me shkresë Nr. 11587 Prot. datë **05.11.2008**, i ka dërguar ZVRPP Tiranë kontratën e shitjes të

objektit “Klubi Shumësportësh Partizani” me vendodhje Rruga Frosina Plaku dhe Pishina Laprakë në Rugën e Durrësit Tiranë. Me shkresën pa nr prot e vitit 2009 e ZVRPP Tiranë, e regjistruarit Fetah Hasanaj, drejtuar Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Sektorit të Shitjes së Pronave, pasqyrohet se në dosjen e privatizimit me nr. 11587 datë 05.11.2008 në të cilën është depozituar kontrata e shitjes/privatizimit e Klubit Shumësportësh Partizani me nr. Rep 3298/562 datë 04.11.2008 notere Gentiana Shkodra, objekt i kësaj kontrate, është kalimi në pronësi private i objektit shumësportësh Partizani me sip totale 19091 m2. Nga sip e mësipërme, *një pjesë e tij, rezulton që me vendimin e KKKP nr. 668 datë 16.08.1996 në favor të ish pronarëve Llagami* u është njohur pronësia mbi truallin dhe në bazë të nenit 16 të ligjit u lind e drejta e bashkëpronarëve për kompensim, gjithashtu sipas n 21 të ligjit këta bashkëpronarë kanë edhe të drejtën e parablerjes së objekteve që qëndrojnë mbi këtë truall. Në kontratën e mësipërme, përkatësisht në dispozitën ku parashikohet objekti i kontratës, **nuk rezulton të jetë përmendur ky vendim komisioni mbi të cilin edhe një pjesë e objektit të privatizuar me këtë kontratë.** Duke qenë para faktit që e drejta e parablerjes është ekzekutuar për këtë objekt, **na përcaktoni dhe saktësoni juridikisht marrëdhënien me truallin që kanë ish pronarët (truall i njohur me vendim të KKKP 668/1996) si dhe sipërfaqen përkatëse.**

206. Sipas urdhërit nr. 404 datë 04.02.2019 të ZVRPP Tiranë, rezulton se mbi bazë kontratës së mësipërm, janë regjistruar pasuritë si vijon:

- Pas nr. 3/112 vol 12 faqa 202 zk 8220 truall 480 m2 nga kjo ndërtesë 48 m2
- Pas nr. 3/114 vol 12 faqa 204 zk 8220 truall 1574 m2 me shënimin “ *mbi këtë pasuri ka dy ndërtime pa leje*” ku sipas planvendosjes së kontratës së privatizimit, **këto dy ndërtime nuk janë privatizuar**, gjithashtu nga matjet në hartë rezulton se kjo pasuri ka sip 1649 m2 ndërkohë që sipas dok në re 3498 sip e kësaj pasurie është 1574 m2 truall.
- Pas nr. 3/155 vol 15 faqa 185 zk 8220 truall 660 m2 pajisur me certifikatë pronësie datë 24.12.2018 ka shënimin në seksionin E të kartelës së pasurisë “*ka ndërtim pa leje*” **ndërtim i cili nuk është objekt i kontratës së privatizimit**
- Pas nr. 3/160 vol 23 faqa 238 zk 8220 truall 390 m2 nga kjo ndërtesë 130 m2 ku referuar planvendosjes së kontratës së privatizimit, përfshihet ky objekt
- Pas nr. 3/215 vol 37 faqa 233 zk 8220 truall 3294 m2 nga kjo ndërtesë 1467 m2 me shënim në seksionin e veçantë “*diferenca fakt – dokument*” 426.8 m2 dhe në seksionin E të kartelës “*ka ndërtim pa leje*” por nga shqyrtimi i kontratës së privatizimit dhe planvendosjes së kësaj kontrate, objekti ka sip 1467 m2 dhe përputhet me hartën e zyrës.

Përsa më sipër është urdhëruar korigjimi i hartës për disa prej pasurive dhe ndarja e pasurisë si dhe heqja e shënimit.

207. Ndërkohë, nga ana e shoqërisë Kontakt sh.p.k. vijnë veprimet pranë Bashkisë Tiranë në lidhje me ndërtimin. Sjellim në vëmendje se ndërtimi ishte miratuar me faza, por zbardhja do të bëhet me faza, pasi të realizohej privatizimi i objekteve dhe terreneve. Kështu rezulton se me kërkesën datë **24.11.2008** me marrës në dorëzim nga shtetësja Adelina Gjonaj, shtetësja Irina Branko, ka dorëzuar pranë Bashkisë Tiranë, plotësim dokumentacioni, pranë Drejtorisë së Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik e konkretisht 1 CD, preventiv, sip apartamentesh, **dokumentacion privatizimi, te Klubit Shumësportësh Partizani** dhe 12 vërtetime pronësie.

Gjithashtu, shtetasi Xhimi Begeja i cili siç rezulton nga tërësia e akteve ka qenë një

bashkëpunor i ngushtë i shtetasve Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi, në lidhje me shtënien në dorë të këtyre territoreve, vijon të shfaqet shumë aktiv. Me kërkesën me nr. 7847 prot datë 03.12.2008 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Fisnik Borova, pikërisht nga shtetasit **Xhim Begeja dhe Fatmir Bektashi të vetëidentifikuar si përfaqësues të pronarëve, i kërkohet që të njoftohen drejtuesit e klubit dhe organet e rendit për të mos patur probleme gjatë procesit të marrjes në dorëzim të këtyre aseteve.**

Sipas akteve, rezulton se me urdhërin nr. 508/1 prot dt 27.11.2008, administratori i përgjithshëm i shoqërisë Kontakt sh.p.k. shtetasi Fatmir Bektashi, **megjithëse ende nuk ishte përfunduar procedura e privatizimit të Klubit të Futbollit Partizani**, ka nxjerrë një urdhër sipas të cilit për të gjitha menxhimin e problemeve administrative të objektit, **Klubi Shumësportesh Partizani dhe Klubi i Futbollit Partizani**, të ndodhur në pronën tonë, rr. Frosina Plaku, nr. 40, emërohet z. Xhimi Begeja, drejtor i përgjithshëm.

208. Ndërkohë familjeve Saliaga dhe Llagami u merren deklarata noteriale, ku shprehin dakordësinë për bllokimin e pasurive të tyre dhe shembjen e objekteve.

208.1. Me deklaratën nr. 9321 rep nr 1313 kol datë 25.11.2008 deklaruesit *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan, Hamide Saliaga, Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi*, të gjithë të përfaqësuar me prok nga Silvana Bello, deklarojnë: Në bazë të kontratës së sipër nr 8668 rep nr 1309 kol datë 02.11.2007, pronarët (deklaruesit e mësipërm) kanë vënë në dispozicion të shoqërisë së ndërtimit Kontakt sh.p.k....pronat e tyre të përcaktuara shprehimisht në kontratën e sipërmarrjes me sip të përgjithshme 3791 m². Brenda kësaj sip ndodhen objektet në bashkëpronësi të pronarëve të regjistruar në ZVRPP Tiranë me nr 217 datë 20.11.2008: *Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 09 m²; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 48 m²; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 100 m²; Godinë dy katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 611 m²; Godinë dy katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 135 m²; Godinë dy katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 2175 m² të cilën e kemi në bashkëpronësi me pronarët Llagami dhe pjesën e tyre të pandarë me bashkëpronarët Begeja e Llagami; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 240 m²; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 195 m²; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 315 m².*

Përfaqësuesja e pronarëve Saliaga, Silvana Bello, deklaroi se janë plotësisht dakord që objektet e mësipërme që ndodhen brenda truallit i cili është i bllokuar në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k. të bllokohen në favor të kësaj shoqërie. Janë dakord që objektet në pronësinë e tyre të shemben dhe shoqëria është e lirë që të fillojë ndërtimin...

208.1.1. Me kontratën e hipotekimit nr 3778 rep nr 639 kol datë 09.12.2008 para notere Gentiana Shkodra, rezulton se janë paraqitur palët: *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Shpëtim Luzi (përfaqësuar nga Mustafa Luzi), Fatmir Luzi, Tire Deda (Luzi)*, të përfaqësuar me prokurën e posaçme nr 4998 rep nr 667 kol datë 10.07.2008 të notere Ruko Sako nga Silvana Bello dhe shoq e ndërtimit Kontakt sh.p.k. Në këtë kontratë është parashtruar se ...meqënëse kanë lidhur kontratën nr 8668 rep nr 1309 kol datë 02.11.2007 të notere Ruko Sako, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë të fundit, në bazë të vullnetit të lirë e të pavesuar dhe në bazë të parashikimeve ligjore të K.Civil mbi Hipotekën, do të garantohen me mjete të përmbushjes së detyrimeve. Me anë të kësaj kontrate trashëgimtarët e familjes Saliaga dhe shoqëria Kontakt sh.p.k. parashikojnë rëndimin me barrë hipotekore (inskriptimin) e pasurive në pronësi të fam Begeja, në favor të shoq Kontakt sh.p.k., konkretisht 9 pasuri të regjistruara në regj hip me nr 217 datë 20.11.2008 ku për 8 prej tyre citohen

specifikisht se ndodhen tek Klubi Shumësportesh Partizani, pasuri të llojit objekte dhe një është pasuria e llojit truall me nr 3/182 ZK 8220 me sip 315 m2 në bashkëpronësi me fam Llagami dhe Saliaga. Kjo kontratë është e vlefshme për të njëjtin afat të parashikuar në kontratën nr 8668 rep nr 1309 kol datë 02.11.2007 te Notere Ruko Sako...

208.2. Me deklaratën noteriale nr 3683 rep nr 627 kol datë **27.11.2008** përpiluar para noteres Gentiana Shkodra, pasqyrohet se janë paraqitur personalisht palët: *Behixhe Tafaj (përfaqësuar nga Fatri Tafaj), Myhyrije Verzivolli, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnan Llagami, Sadete Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), Adela Llagami, Mirnije Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), Aleksandra Llagami (përfaqësuar nga Ervin Llagami), Ervin Llagami dhe Artur Llagami (përfaqësuar nga Ervin Llagami)* dhe shoqëria Kontakt sh.p.k. Këta shtetas deklarojnë se kanë lidhur kontratën e porosisë dhe të vënies së truallit në dispozicion për investime **nr 2831 rep nr 486 kol datë 29.09.2008** te notere Gentiana Shkodra. Me anë të këtij akti, neni 10 "Regjistrimi në ZRPP" amendohet dhe pas nënshkrimit të aktit prezent lexohet: ...Neni 10... *Gjatë periudhës së nevojshme për përfundimin e procedurave të lejes së sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit nga KRRT pranë Bashkisë Tiranë, pala pronare nuk ka të drejtën e shitjes apo tjetërsimit të pronës dhe të ndërtesës së ndodhur mbi të...* Kontrata prezente regjistrohet në ZRPP në regj hip duke rënduar me barrë hipotekore në favor të palës sipërmarrëse... citohen 4 pasuri të regj me nr hip 217 datë 20.11.2008 ku tre prej tyre të llojit objekte janë në ish Klubin Shumësportesh Partizani kurse një e regj me nr 3/182 ZK 8220 sip 315 m2 ka përshkrimin truall - Pasuri në bashkëpronësi me familjet Saliaga dhe Begeja.

208.2.1. Me deklaratën noteriale nr 3685 rep nr 628 kol datë **27.11.2008** përpiluar para noteres Gentiana Shkodra, pasqyrohet se janë paraqitur personalisht palët: *Behixhe Tafaj (përfaqësuar nga Fatri Tafaj), Myhyrije Verzivolli, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnan Llagami, Sadete Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), Adela Llagami, Mirnije Llagami (përfaqësuar nga Adela Llagami), Ervin Llagami dhe Artur Llagami (përfaqësuar nga Ervin Llagami)*. Me këtë deklaratë, trashëgimtarët Llagami kanë shprehur dakordësinë për shembjen e të gjitha ndërtesave që ndodhen në trojet në bashkëpronësinë e tyre.

208.3. Me deklaratën noteriale nr 9441 rep nr 1340 kol datë **28.11.2008**, para noteres Ruko Sako, deklaruesit: *Haki Begeja, Bashkim Bekteshi, Nusret Kaçurri, Kreshnik Begeja, Lirie Lika, Sanije Velo, Myzejen Ago, Ajete Sulstariva, Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Dita Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Lumturi Çela, Sejdiqe Kurti, Meriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Elona Begeja, Xhimi Begeja* të gjithë të përfaqësuar me prokurën e posaçme nga **Jamarbër Malltezi, Ilir Kadiu**, për vehten e tij dhe si përfaqësues me prokurë i *Vangjeli Kadiut dhe Manjola Kadiut, përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi, Teuta Malka* përfaqësuar nga **Artan Malka**, parashtrajnë se në bazë të kontratave të sipërmarrjes nr 3306/422 dhe 3307/423 datë 15.05.2008, pronarët (deklaruesit e mësipërm) kanë vënë në dispozicion të shoqërisë së ndërtimit Kontakt sh.p.k....pronat e tyre të përcaktuara shprehimisht në kontratat e sip me sip të përgjithshme 11 945 m2. Brenda kësaj sipërfaqe, ndodhen objektet në bashkëpronësi të pronarëve të regj në ZRPP Tiranë në nr 217 datë 20.11.2008: *Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 122 m2; Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizanime sip 175 m2; Godina një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 10 m2.* Dhe Pjesën e tyre të pandarë me bashkëpronarët Tafaj, Saliaga, Llagami dhe Luzi: *Godinë një katëshe ish Klubi Shumësportesh Partizani me sip 240 m2; Godinë një katëshe ish klubi shumësportesh partizani me sip 195 m2; Godinë një katëshe ish klubi shumësportesh Partizani me sip 315 m2.*

Përfaqësuesi i pronarëve Begeja, z. **Jamarbër Malltezi** deklaroi se janë plotësisht dakord që objektet e mësipërme që ndodhen brenda truallit i cili është i bllokuar në favor të shoq Kontakt sh.p.k. të bllokohen në favor të kësaj shoqërie. **Janë dakord që objektet në pronësinë e tyre të shemben dhe shoqëria është e lirë të fillojë ndërtimin.**

208.3.1. Me kontratën e hipotekimit (*aneks i kontratës nr 3306 rep/nr 422 kol datë 15.05.2008 të notere Ruko Sako dhe aneks i kontratës nr 3307 rep nr 423 kol datë 15.05.2008 të notere Ruko Sako*) nr 3777 rep nr 638 kol datë **09.12.2008** para notere Gentjana Shkodra, janë paraqitur: Pala hipotekuese: Trashëgimtarët e familjes Begeja: **Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nysret Kaçurri (Bekteshi), Kreshnik Kaçurri, Lirije Lika (Begeja), Sanie Velo (Begeja), Ajete Sulstarova (Begeja), Myzejen Ago (Begeja), Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin (këto tre të fundit të përfaqësuar me prkurën e posaçme nga Ksnathipi Begeja), të gjithë të përfaqësuar me prokurën e posaçme nr 787 rep nr 142 kol datë 31.01.2006 të noteres Ruko Sako nga shtetasi Jamarbër Malltezi** si dhe **Lumturi Çela, Sjedije Kurti, Mirban Kadiu, Bashkim Kadiu, Nerime Piro** të gjithë këta të përfaqësuar me prokurën e posaçme nr 2165 rep nr 248 kol datë 03.05.2006 nga shtetasi **Jamarbër Malltezi, Teuta Malka (përfaqësuar nga Artan Malka), Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi (përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi), Ilir Kadiu (përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi), Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi** (tre të fundit përfaqësuar me prokurën nr 10086/1542 kol datë 31.12.2007 të noteres Ruko Sako nga **Jamarbër Malltezi**) dhe Pala përfituese hipotekës: shoq e ndërtimit Kontakt sh.p.k. Në këtë kontratë parashtrohet se meqënëse kanë lidhur kontratat nr 3306 rep nr 422 kol datë 15.05.2008 dhe 3307 rep nr 423 kol datë 15.05.2008 të notere Ruko Sako...Me anë të kësaj kontrate trashëgimtarët e familjes Begeja dhe shoqëria Kontakt sh.p.k. parashikojnë rëndimin me barrë hipoteke (inskriptimin) e pasurive në pronësi të trashëgimtarëve Begeja në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k. pasuri të specifikuar si më poshtë vijon:

- a- Pas e regj në regj hip nr 217 datë 20.11.2008, nr N3/171 ZK 8220 me sip 175 m2 me përshkrim Objekt 1 kt **ish klubi shumësportesh Partizani**, me sip 175 m2;
- b- Pas e regj në regj hip nr 217 datë 20.11.2008, nr N3/170 ZK 8220 me sip 122 m2 me përshkrim Objekt 1 kt me sip 122 m2 (**ish klubi shumësportesh Partizani**);
- c- Pas e regj në regj hip nr 217 datë 20.11.2008, nr N3/172 ZK 8220 me sip 10 m2 me përshkrim Objekt 1 kt (**ish klubi shumësportesh Partizani**), me sip 10 m2;....

208.3.2. Në këtë kontratë, siç mund të konstatohet, shtetasi Jamarbër Malltezi paraqitet si përfaqësues i të ndjerës Nimete Bekteshi, ndërkohë që kjo e fundit ka ndërruar jetë që më datë 15.07.2006 dhe shtetasi Jamarbër Malltezi është bërë trashëgimtar i saj më datë 15.11.2006. Pra dy vjet më vonë, ai vijon të kryejë veprime në emër të një personi të vdekur.

Klubi i Futbollit Partizani

209. Megjithëse procedurat e privatizimit në lidhje me Klubin e Futbollit Partizani ende nuk ishin konkluduar, shoqëria Kontakt sh.p.k. vijon lidhjen e kontratave. Kështu rezultoi se, me kontratën e porosisë nr 3735 rep nr 630 kol datë **03.12.2008**, para noteres Gentjana Shkodra, janë paraqitur palët: **Fiqiri Alimehmeti, Xhafer Alimehmeti (përfaqësuar nga Artan Alimehmeti), Fehmi Alimehmeti, Fatbardha Marika (Alimehmeti) (përfaqësuar nga Blendi Marika), Alma Sulo, Genci Mullici, Skënder Mullici (përfaqësuar nga Nimete Mullici (Alimehmeti) dhe shoqëria Kontakt sh.p.k.** Kanë rënë dakord dhe përpilojnë këtë kontratë **vënie në dispozicion truall për investime....Neni 1...Pala pronare ka të njohur në emër të saj një sip toke truall prej 7440 m2 sipas vendimit të KKKP...truall funksional i Klub Futboll Partizani ...**

Neni 3 *Tagrin e porosisë: Ndërrimin e destinacionit të zonës ku ndodhet trualli.* Pala pronare ka të njohur në emër të saj një sip toke truall prej 7440 m² sipas vendimit të KKKP qarku Tiranë, truall funksional i Klub Futbollit Partizani...Pala pronare dëshiron që, në bazë të ligjit për urbanistikën, të kthejë tokën, të privatizojë ndërmarrjen mbi të, të ndryshojë destinacionin nga zonë sportive në zonë banimi dhe të ndërtojë banesa mbi tokën truall pronë e saj duke përfshirë dhe sipërfaqen shtesë të tokës truall që do të përfitohet nga privatizimi...Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të mësipërme, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse me qëllim studimi e ndërtimi të sipërfaqes së truallit...Pala sipërmarrëse pranon të marrë truallin e vënë në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë të gjitha shpenzimet e nevojshme për procesin e përmendur më lart dhe i përfundon këto procese në një afat kohor jo më shumë se 18 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje

Neni 4: *Tagrin e investimit: Ndërtimi i objektit shumëfunksional.* Në zhvillimin dhe urbanizimin e zonës do të përfshihet e gjithë prona e familjes Alimehmeti me sip 7440 m². Pala pronare bie dakord për bashëpunim duke vënë në dispozicion të palës sipërmarrëse, shoqërisë së ndërtimit Kontakt sh.p.k., të gjithë sipërfaqen e tokës truall, përmendur më sipër, për studimin dhe miratimin deri në fazën e lejes së sheshit si një e tërë. **Mbas kësaj, 2/3 e sipërfaqes së miratuar shesh ndërtimi në truallin e familjes Alimehmeti, do ta ndërtojë shoqëria Kontakt sh.p.k. me investimin e saj.** Pjesa prej 1/3 e sipërfaqes së miratuar shesh ndërtimit në truallin e familjes Alimehmeti do ta ndërtojë dhe investojë vetë pala pronare **me anë të shoqërisë së saj të ndërtimit**, e cila mbas miratimit të lejes së sheshit i lind e drejta të kërkojë leje ndërtimi në emër të saj për këtë sip (1/3). Shoqëria e ndërtimit të përmendura më lart, angazhohen të bashkëpunojnë nëpërmjet tyre në veprimtarinë ndërtuese në pronën e familjes Alimehmeti. Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në truallin e vënë në dispozicion si më sipër nga pala pronare kompleksin shumëfunksional me parkime, dyqane dhe apartamente, në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës. Leja e ndërtimit do të merret 24 muaj nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate sipërmarrje. Shpenzimet për projektin dhe lejen e ndërtimit në 1/3 e sipërfaqes së investuar nga pala pronare **me shoqërinë e saj Eralb sh.p.k.** Tiranë do të përballohen nga kjo e fundit.

Neni 5: *Pjesa takuese e ndërtimit për palën pronare.* Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e vënë në dispozicion objekt të kësaj kontrate, 25% të sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit që do të ndërtohet nga shoq Kontakt sh.p.k. Në kuptim të kësaj pike, me sip të përgjithshme të ndërtimit, do të kuptohet gjithë sipërfaqja e ndërtimit të bërë dhe në tokat e trashëgimtarëve të familjes Mahmut e Xhemal Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqarri, Rexhep Alimehmeti të cilat janë kufitarë të sipërfaqes pjesë e kësaj kontrate, në përpjestimet përkatëse ndaj totalit të tokës, gjithsej që do të jetë në sipërmarrje të kësaj shoqërie. Sipërfaqja prej 25 % të ndërtimit, sa më sipër, do të shpërndahet për secilin komponent (parkime, dyqane, apartamente, fasadë) të ndarë proporcionalisht për çdo kat. Pjesa takuese e palës pronare e sipërfaqes përkatëse sipas kateve, do të përcaktohet me një kontratë shtojcë të kësaj kontrate sip...Pjesa takuese që pala pronare do të përfitojë nga shoqëria e ndërtimit në sipërfaqen prej 1/3 do të rregullohet midis vetë pjestarëve të familjes Alimehmeti në mënyrë të pavarur nga kjo kontratë...Nga ndërtimi mbi këtë truall pala pronare do të marrë 25% të gjithë sipërfaqes së ndërtimit **përqindje kjo e barabartë me përqindjen që do të marrin familjet e tjera pronare**...

Neni 6. *Të drejtat dhe detyrimet e palës sipërmarrëse.*

...a) pala sipërmarrëse në bazë të kësaj kontrate plotëson dokumentacionin e nevojshëm për të kryer veprimet administrative dhe për të realizuar: **Kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilën ndodhet trualli nga zonë sportive në zonë për banim; Marrjen e lejes së sheshit të**

ndërtimit; Lejen e ndërtimit; Privatizimi e objekteve që ndodhen mbi këtë truall do ta bëjë sipërmarrësi dhe pronarët nuk kanë asnjë detyrim financiar për të

Të gjitha detyrimet ndaj të tretëve në lidhje me pronën e përshkruar në nenin 3 do të përballohen nga sipërmarrësi. Ndërrimin e destinacionit do ta bëjë sipërmarrësi me shpenzimet e tij. Pala sipërmarrëse merr përsipër të gjitha shpenzimet për realizimin e të gjitha procedurave administrative dhe burokratike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje...

210. Shtetasi Fatmir Bektashi, vijon të marrë kredi dhe të rëndojë me barrë hipotekore pasuritë e tij. Kështu rezulton se ndërmjet Union Bank sh.a. dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. e shtetasit Fatmir Bektashi në cilësinë e kredimarrësit si dhe shtetasit Fatmir Bektashi në cilësinë e dorëzanësit, është lidhur kontrata e kredisë bankare nr. 6353 rep nr. 1140 kol datë **29.10.2008** para noterës Frida Muçmata. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, banka i jep kredimarrësit një kredi në shumën 600 000 (gjashtë qind mijë) euro (shih edhe nenin 3 për shumën), **me qëllim konsolidimin e kredive të marra më parë pranë Union Bank sh.a.** Sipas nenit 9, për të garantuar përmbushjen e kredisë, vendoset garanci në favor të bankës pasuritë e mëposhtme: *Truall me sip 4900 m2, ndërtesë 2160 m2, nr pas 7/23, vol 15 faqa 185, ZK 2679, me adresë në Mëzez, Tiranë, në pronësi të Fatmir Bektashi; Arë me sip 2 880 m2, nr. pasurie 7/24 vol 15 faqa 186 ZK 2679 me adresë Mezez, Tiranë në pronësi të Fatmir Bektashi; Zyrë nr 6 me sip 134.5 m2, nr hipotekor 412/8160 datë 09.09.2004 pasurie 4/505-26 vol 23 faqa 61 ZK 8160, kati i dytë shkalla e parë e pallatit 13 katësh në kryqëzimin e rr Budi me rr e Elbasanit, në pronësi të Fatmir Bektashi.* Kredia e marrë nga shoqëria Kontakt sh.p.k. është ristrukturuar me kontratën e kredisë bankare me nr. 6946 rep nr. 1523 kol datë 22.12.2009 dhe kontratën e hipotekës nr. 6947 rep nr. 1533 kol datë 22.12.2009.

Nga kjo kredi, është përdorur një pjesë e shumës e konkretisht 230 000 euro, për të kryer pagesën për privatizim, si më sipër cituar.

210.1. Me kontratën e hipotekimit nr 7373 rep nr 1545 kol datë **18.12.2008**, para notere F.Muçmata, të lidhur ndërmjet Union Bank sh.a. dhe shtetasve Fatmir Bektashi dhe Aneta Bejko (Bektashi) e përfaqësuar kjo e fundit nga shtetasi Fatmir Bektashi, është vendosur **vënia e hipotekës së shkallës së katërt në favor të Bankës mbi pronat e hipotekuesit: Truall me sip totale 4900 m2 nga e cila ndërtesa 2 160 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 7/23 vol 15 faqa 185 ZK 2679, Mëzez, Tiranë, në pronësi të Fatmir Bektashi dhe Arë me sip totale 2880 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 7/24 vol 15 faqa 186 ZK 2679 me adresë Mezez, Tiranë, në pronësi të Fatmir Bektashi.** Union Bank është aktualisht përfituese e hipotekës mbi pronat e përshkruara më sipër të vendosura si garanci, sipas kontratës së hipotekimit nr. 4430 rep nr. 1112 kol lidhur më datë 30.10.2007, kontratës nr. 1459 rep nr. 420 kol lidhur më datë 03.05.2007 dhe kontratës nr. 3609 rep nr. 767 kol lidhur më datë 26.09.2006 Dhe vënia e hipotekës së shkallës së parë, në favor të Bankës mbi pronën e Hipotekuesit *Njësi me sip totale 134.5 m2, regjistruar në regjistrin hipotekor me nr pasurie 4/505-N21, vol 19 faqa 61, ZK 8160, ndodhur në katin e dytë të shallës së parë të pallatit 13 katësh, në kryqëzimin e rr. Budi, me rr e Elbasanit, Tiranë në pronësi të Fatmir Bektashi.* Pronat që hipotekohen në favor të Bankës, shërbejnë si mjet sigurimi për të garantuar bankën për shlyerjen e çdo kredie ekzistuese dhe të ardhshme në formën e huasë, overdraftit, letër garancisë, letër kredisë etj dhe të gjitha detyrimeve të lidhura me to që Banka i ka dhënë dhe do t'i japë kredimarrësit (Kontakt sh.p.k.) deri në limitin kreditor të akorduar prej **1 500 000 euro.**

Miratimi i VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që

privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”.

211. Tashmë që rezultonte të ishin bërë pagesat e mësipërme për Klubin Shumësportesh Partizani, lindte e nevojshme edhe kryerja e pagesave për Klubin e Futbollit Partizani, konkretisht në vlerën **10,109,000 lekë** për objektet dhe në vlerën **22 956 459 lekë**, për tokën truall që rezultonte në pronësi shtet.

Por mesa duket, shtetasit Fatmir Bektashi, Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja ndodheshin në vështirësi për të realizuar këtë blerje. Siç pasqyrohet edhe më sipër, tashmë ishin marrë kredi, ishin marrë para nga shtetasi Gjon Gjonaj, duke treguar se situata e tyre ekonomike nuk ishte e mirë.

212. Nga aktet rezulton se pikërisht në këtë kohë, me shkresën Nr. 10807 Prot. dt **16.12.2008**, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, **Ministri Genc Ruli** i dërgon Këshillit të Ministrave për miratim një projektvendim, që lidhet me ndryshimin e pagesës për objektet që i nënshtroheshin privatizimit.

Sipas relacionit *“Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”* nënshkruar nga Ministri i Financave **Ridvan Bode** dhe Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës **Genc Ruli**, ndër të tjera është përshkruar se, përgatitja e këtij projektvendimi është e nevojshme dhe e **diktuar edhe nga vështirësitë që janë hasur në procesin e privatizimit**. Amendamentet e ligjit Nr.9235, datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”* të bërë me ligjin Nr. 9583, datë 17.07.2006 kanë sjellë të domosdoshme, **përshpejtimin e këtij procesi për të realizuar kështu detyrimin që shteti në zbatim të këtij ligji ka ndaj ish pronarëve**. Kështu, vështitësitë e paraqitura në komunikimin ndërinstitutional janë evidentuar kryesisht në vonesa ose mos përgjigje të konfirmimit të genplaneve nga strukturat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore. Në këtë projekt vendim është parashikuar që konfirmimi i genplaneve të bëhet nga struktura e urbanistikës së Prefekturës së Qarkut, në juridiksionin e të cilit ndodhet objekti. Ky projekt vendim paraqitet si variant i përmirësuar i VKM-së 794, datë 21.11.2007, me nevoja për të adresuar çështjet e mëposhtëme:

1. *Vlerësimi i truallit me çmimin e përcaktuar nga AKKP-ja, sipas hartës së cmimeve në zbatim të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.183, datë 23.04.2005. Tashmë kjo hartë ka përfunduar në të gjithë territorin e RSH dhe në zbatim të vendimit të mësipërm rifreskohet cdo vit.*
2. *Ndryshimi i metodologjisë së pagesës së vlerës së objektit, i cili më parë bëhej vetëm në lekë, ndërsa tani parashikohet të bëhet 20% në lekë dhe 80% në bono privatizimi dhe letra me vlerë.*
3. *Pagesa e vlerës së truallit bëhet vetëm në lekë.*
4. *Nëse trualli i objektit ka pronar dhe ai nuk paraqitet për blerjen e tij me të drejtë parablerje brenda afateve ligjore, objekti së bashku me truallin, shitet në ankand me dhe vlera e truallit kalon direkt për kompensim në llogari të pronarit të truallit, sipas cmimeve të përcaktuar në hartën e vlerës...*

Më datë **17.12.2008** është mbajtur procesverbal P.2.27 i mbledhjes së Këshillit të Ministrave për projektvendimin *“Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”*. Konstatohet se vetë shtetasi Sali Berisha është aktivizuar fuqishëm duke u shprehur se do të mbrojë pronarët, si t’ja bëjnë që t’i favorizojnë këta të fundit.

Më poshtë është e pasqyruar një pjesë e diskutimeve të mbledhjes në fjalë.

Sali Berisha: *Ky projektvendim është propozuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës. Jemi dakort?*

Genc Ruli (Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës): *Për këtë mund të them një shpjegim se çfarë kemi bërë.*

Sali Berisha: *Po, e di, keni zgjidhur çështjen e ankandit.*

Genc Ruli: *Jo ankandi është veç doktor por futëm 20% me lekë dhe 80% me letra me vlerë.*

Sali Berisha: *Bravo, jepe këtë njoftim, se edhe kjo përbën risi.*

Ma thuaj, si jua keni vlerësuar letrat me vlerë juve këtyre? *Unë do të mbroj pronarët, do të bëj avokatin e tyre. Dmth si t'ja bëjmë që t'i favorizojmë, t'i marrim ato, se ja ke mbajtur tjetrit, ti e ke shfrytëzuar.*

Ridvan Bode (Ministër i Financave): *Ne po ia lehtësojmë tani, ai e paguante 100% me para, tani po i themi do ta paguash me letra me vlerë.*

Genc Ruli: *20% me lekë dhe 80% me letra me vlerë*

Sali Berisha: *Vetëm se na del një problem këtu, na e rrit kursin e letrave me vlerë shumë kjo pastaj*

Ridvan Bode: *Oferta e letrave me vlerë është shumë e madhe në krahasim me këtë tjetrën.*

Sali Berisha: *Atëherë çfarë duhet të bëjmë ne me letrat me vlerë, se unë për letrat me vlerë po mendoj me cdo kusht që t'u qëndrojmë, por nuk mund ti qëndrojmë 800 mijëshit, ajo ka qënë një gjë jashtëzakonisht e rëndë që na u imponua, për shkak të lekëve të privatizimit të të përndjekurve, kështu që ne do ti etalonim me vlerë.*

Ridvan Bode: *I kemi etaluar, është pjesë e vendimit, ky vendim i ka të gjitha brenda.*

Sali Berisha: *Letrat me vlerë ua kemi borxh se nuk i kemi shpërndarë, duhet të gjejmë mënyrat që t'i ndihmojmë, t'i heqim këto letrat me vlerë. Këtë e kemi bërë shumë mirë, jam shumë dakort me ty, se nuk i marrim dot, absolutisht. *Jepe këtë lajm, është një lajm shumë i rëndësishëm, që u miratua, që 80 për qind ta paguajnë me letra me vlerë vetëm pronarët.* Ai borxh do të shlyhet qeveria ka borxh, ma gjej ti mua mënyrën sesi ta shlyejmë, unë me atë borxh nuk rri, unë do ta shlyej po qe se Shqiptarët më japin mandatin e dytë, unë ta them se do t'ua shlyej borxhin. Unë atyre letrave do tju qendroj se kanë një sens ato të shpërndarjes së pasurisë, kanë një bazë shumë morale, shumë të fuqishme, tjetër punë se tani nuk po merret kush me këto në botë, por ne do të merremi, nuk kemi se çfarë të bëjmë.*

Përfundimisht Këshilli i Ministrave e miratoi projektvendimin.

Në këtë procesverbal kanë nënshkruar Luiza Lolo (Stenografe) dhe Gjergj Lezhja (Sekretar i Përgjithshëm).

212.1. Ndryshimet e mësipërme, miratohen po më datë 17.12.2008 me VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 e cila është botuar në FZ me nr. 198 datë 31.12.2008 dhe ka hyrë në fuqi në këtë datë.

213. Megjithëse, që më datë 16.10.2008, shtetasi Nuri Sopaj, përgjegjës i sektorit të shitjeve, i është drejtuar drejtorit Urim Muja, duke i parashtruar se po i paraqesin për miratim proces verbalin datë 15.10.2008 **për dhënien e të drejtës së parablerjes për objektin "Terrenet sportive dhe objekte të klubit të futbollit Partizani"**, kjo procedurë e ndjekur deri në këtë moment me hapa të përshpejtuar, duket se është bllokuar, deri në hyrjen në fuqi të VKM-së së mësipërme.

Vetëm në muajin janar, e konkretisht me shkresën nr. 657 prot datë **21.01.2009** Drejtori Urim Muja, i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së pronave publike, i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në këtë shkresë është pasqyruar se nga azhornimi i sipërfaqes së truallit sipas vendimeve të KKP për secilin subjekt me gen planin e dosjes së

privatizimit si dhe konfirmimi i bërë nga ZVRPP rezulton se nga sipërfaja totale e objektet, sipërfaqja prej 857 m² nuk bie në pronat e ish pronarëve dhe duhet të privatizohet nga ana e kësaj drejtorie në favor të tyre. Për këtë sipërfaqe, subjektet e shpronësuar, shprehen se janë në proces marrje vendimi për t'u kompensuar nga AKKP Tiranë dhe kërkojnë që të vazhdojnë procedurat e përfundimit të procesit të privatizimit por me kushtin për të mos u shitur sip e truallit prej 857 m² deri në marrjen e vendimit përkatës të kompensimit. Përsa më sipër, kërkojnë që të konfirmohet procesi i kompensimit të kësaj sip truallit në favor të këtyre subjekteve, me qëllim që të vazhdojnë procedurat e privatizimit të objektit të mësipërm, duke lënë të patrajtuar (shitur) sip e truallit prej 857 m².

Me shkresën Nr. 280/1 Prot, datë 05/02/2009 Agjencia e Kthim Kompensimit të Pronave i konfirmon Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave se asnjë nga nga familjet e shpronësuar nuk ka paraqitur dokumentacion për kompensim në vitin 2008-të.

214. Pavarësisht se AKKP ka bërë me dije se nuk është paraqitur dokumentacioni për kompensim, me shkresën nr. 812 prot datë 26.01.2009 të sektorit të shitjes, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së pronave publike, me lëndë "Autorizim për kalim pronësie" e nënshkruar nga drejtori Urim Muja, i është drejtuar trashëgimtarëve ligjorë të Xhemal e Mahmut Begeja, Sabrije Llagamit, Qamil Saliaga, Rexhep Alimehmeti, Dylbere Vaqarri, Ministrisë së Mbrojtjes, Bashkisë Tiranë dhe ZVRPP Tiranë, ku autorizon kalimin e objektit "Terrenet sportive dhe objekte te klubit të futbollit Partizani Tiranë" deri tani pronë shtetërore në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes në private të trashëgimtarëve ligjorë të sipërcituar.

Vlera totale e objektit në bazë të shkresës përcjellëse të METE nr. 6120/1 prot datë 22.07.2008 është 10 109 000 lekë mjete kryesore dhe sip totale e objektit është 26 524 m², nga e cila nën objekt 775 m² me vlerë totale 710 498 000 lekë.

Vlera fillestare e objektit prej 10 109 000 duhet të arkëtohet nga blerësit me bono privatizimi e letra me vlerë përkatësisht në llogarinë 0010959319, 0010959309 pranë Raiffeisen Bank për llogari të Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave publike Tiranë, brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të këtij autorizimi nga e cila 2 021 800 lekë është paguar me lekë cash për pjesmarrje në blerje. Në zbatim të VKM nr. 1638 datë 17.12.2008, kreu IV pika 1, dorëzimi i objektit do të behet brenda 35 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit.

Kalimi i pronësisë do të bëhet nëpërmjet kontratës së shitjes që do të lidhet midis palëve pasi të jetë bërë pagesa e vlerës e plotë të objektit duke plotësuar kushtet e vëna në këtë autorizim të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes.

215. Me shkresën Nr. 898 Prot, datë 28.01.2009, Drejtori Urim Muja, i Sektorit të Shitjeve pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Ministria e Financave i **kërkon Bankës Credins "Ç'bllokim fondi"**, pasi në ankandin e zhvilluar në Ministrinë e Financave trashëgimtarët e familjeve të shpronësuar Mahmut dhe Xhemal Begeja, Rexhep Alimehmeti, Sabrije Llagami, Dylbere Vaqarri dhe Qamil Saliaga **u shpallën fitues me të drejtën e parablerjes së objektit dhe ngurtësimi i vlerës 20% në vlerë absolute 2 021 800 lekë,** e ngurtësuar nga shoqëria "Kontakt shpk" sipas formularit të garancisë nr. 2810/04.09.2008 të kalojë për llogari të Ministrisë së Financave.

Me shkresën nr. 647/1 prot datë 17.01.2024 të Drejtorisë së Privatizimit dhe Shitjes, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, jemi bërë me dije se në lidhje me pagesat e bëra për privatizimin e objektit "Terrenet Sportive dhe Objektet e Klubit të Futbollit Partizani" Tiranë, si më poshtë:

- Garanci bankare me nr. 2810/04.09.2008 datë **04.09.2008** në shumën 2 021 800 lekë e kryer nga shoqëria Kontakt sh.p.k. me administrator Fatmir Bektashi në Credins Bank, (e shoqëruar me evidencën e të ardhurave të thesarit, ku është pasqyruar kalimi përfundimtar i kësaj shume në llogarinë e të ardhurave 111100925160118);
- Formular për pranimin e bonove të privatizimit (Dega 043) datë **13.02.2009** për shumën 8 200 000 bono privatizimi, depozituar nga Xhimi Begeja në Raiffeisen Bank;

Në vijim, konstatohet se bazuar në favorizimin që VKM-ja e miratuar si më sipër i ka sjellë familjeve të njohura pronare, që 80 % e çmimit, pikërisht sa duhet edhe të paguanin për privatizimin e objekteve sportive, do të bëhej me bono privatizimi, shtetasi Xhimi Begeja, dorëzon sipas formularit për pranimin e bonove të privatizimit datë **13.02.2009** të Raiffeisen Bank, për objektin në privatizim "*Terrenet sportive dhe objekteve të klubit të futbollit Partizani Tiranë*", **bonot e privatizimit në vlerën 8 200 000 lekë.**

Nuk konstatohet të jetë bërë ndonjë pagesë në lidhje me **22 956 459 lekë për truallin që rezultonte pronë shtetërore.**

Me deklaratën noteriale nr 2335 rep nr 1019 kol dt 10.11.2017 para noteres Xhoana Omari shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar se, *nëpërmjet bonove të privatizimit është kryer pagesa në shumën 8 200 000 lekë në Raiffeisen Bank më datë 13.02.2009 për privatizimin dhe blerjen e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të Futbollit Partizani sipas kontratës së shitblerjes nr 3553 rep nr 661 datë 21.10.2009. Deklaron se shuma prej 8 200 000 lekë në formën e bonove të privatizimit është siguruar nga shoq Kontakt sh.p.k. dhe këto shpenzime janë përballuar plotësisht prej saj sipas deklaratës noteriale të nënshkruara nga fam Begeja nr. 1852 rep nr 279 kol datë 25.03.2008 ku përcaktohet se të gjitha shpenzimet e privatizimit do të përballohen ga kjo shoqëri. Njëkohësisht nga ana e e Xhimit, në cilësinë e bashkëpronarit të fam Begeja njëkohësisht edhe djali i të ndjerit Haki Begeja, është bërë vetëm depozitimi i kësaj shume në bankë për llog të shoq Kontakt sh.p.k.*

216. Konstatohet se pikërisht në këtë kohë, shtetasi Florenc Kola, bashkëshorti i shtetases Flutura Kola, merr përsipër të kryejë një investim të madh, në shumën prej **200 000 euro**, në ndërtimet që priten të zhvillohen në territoret ku shtriheshin Klubet Sportive Partizani. Kështu pasqyrohet lidhja e një kontrate premtim shitje me nr nr 2722 rep nr 1621 kol datë **08.09.2008**, para noteres Laura Pustina, ndërmjet palëve **Xhimi Begeja** në cilësinë e premtuesit shitës dhe **Florenc Kola**, i biri i Pjetrit, dtl. 20.09.1967, në cilësinë e Premtuesit Blerës, ku parashtrohet se: *Premtuesi shitës është bashkëpronar në truallin në të cilën do të ndërtohet kompleksi i banimit polifunksional i quajtur Begeja 6000 me 8 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, në adresën rruga Frosina Plaku, në të cilën ai ka të drejtën e pronësisë për ambientet e saj në përpjestim me përqindjen e tij të bashkëpronësisë së truallit dhe nga të cilat, i premtton shitjen premtuesit blerës, të një apartamenti dhe 2 vendparkimeve dhe/ose garazheve sipas rregullimeve të kësaj kontrate, ...me sipërfaqe të përgjithshme 300 m², 10 % e së cilës janë ambiente të përbashkëta sipas zgjedhjes që premtuesi blerës do të bëjë kur shoqëria ndërtuese do të fillojë punimet. Çmimi i përgjithshëm i shitjes së apartamentit dhe 2 vend parkimeve poste kontrate i paguan njëkohësisht shitësit edhe këstin e parë të çmimit që është në vlerën 150 000 euro. Pjesën e mbetur, premtuesi blerës, do ta paguajë me nënshkrimin e kontratës përfundimtare të shitjes. ...*

217. Përsa më sipër, vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se ndryshimi i VKM-së së mësipërme, është bërë pikërisht në kohën kur duhet të bëhej pagesa për Klubin e Futbollit

Partizani. Vërtetohet se shpenzimet për privatizimin ishin marrë përsipër nga shoqëria Kontakt sh.p.k. por kjo e fundit duket se gjendet në vështirësi përsa kohë kishte bërë ndërkohë pagesat për privatizimin e Klubit Shumësportesh Partizani. Vetë fakti i ndërprerjes pa asnjë arsye i konkludimit të procedurave të shitjes së objekteve dhe terreneve të Klubit të Futbollit Partizani dhe rinisja e tyre vetëm pas hyrjes në fuqi në këtyre procedurave, mbështet më tepër vërtetësinë e sa më lart.

Për më tepër, vetëm 7 (shtatë) muaj më vonë, me VKM nr. 738 datë 01.07.2009, të miratuar po nga ky këshill ministrash, pika 26 e kapitullit III ka ndryshuar përsëri, duke u përcaktuar se pagesa bëhet vetëm në lekë. VKM nr 738 datë 01.07.2009 është botuar në FZ nr 116 datë 31.07.2009.

Nga administrimi i akteve pranë Këshillit të Ministrave në lidhje me mbledhjen e zhvilluar për diskutimin dhe miratimin e ndryshimeve të VKM-së nr. 1638 datë 17.12.2008, ndryshime këto të ndodhura si më sipër cituar, në muajin korrik 2009, konstatohet se iniciatore ka qenë Ministria e Ekonomisë dhe këto ndryshime janë diskutuar me shkresat respektive të muajit maj 2009 nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave. Pra as pesë muaj pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 1638 datë 17.12.2008, siç shihet është ndjerë nevoja për të ndryshuar këtë VKM. Me shkresën nr. 4334/4 prot datë 15.06.2009 Ministri i Ekonomisë Genc Ruli i dërgon Këshillit të Ministrave projekt vendimin për ndryshimin e VKM nr. 1638 datë 17.12.2008. Pas një rikthimi nga Sekretari i përgjithshëm i KM shtetasi Gjergj Lezhja, me shkresën datë 17.06.2009, Ministria e Ekonomisë i ridërgon me shkresën nr. 4334/6 prot datë 22.06.2009 Këshillit të Ministrave sërish projekt vendimit për ndryshimin e VKM së sipërcituar. Sipas këtij projekt vendimi konstatohet se nën pikën 8 është propozuar që paragrafi i parë i pikës 26 në kapitullin e III të riformulohet si më poshtë: "*Brenda 30 ditëve nga data e zhvillimit të ankandit, blerësi është i detyruar të bëjë pagesën vetëm me lekë të pjesës së mbetur të çmimit të arritur në ankand të objektit bashkë me truallin*". **Relacioni shoqërues nuk mban asnjë shpjegim në lidhje me këtë ndryshim.** Gjithashtu nga KM bëhemi me dije se nuk rezulton të jetë administruar proces verbal mbledhje ku të jenë diskutuar këto ndryshime.

Ushtrimi i kontrollit në Komandën Mbështetëse

218. Ndërkaq, sjellim në vëmendje se Klubi i Futbollit Partizani, i cili ishte propozuar për t'u përfshirë në Planin e Përhapjes nga ana e Shtabit të Përgjithshëm, nuk ishte bërë pjesë e tij dhe gjithashtu as nuk ishte regjistruar në pronësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 2008 largohet si Ministër i Mbrojtjes shtetasi Fatmir Mediu dhe emërohet në vend të tij, shtetasi Gazmend Oketa, sipas dekretit nr. 5675 datë 21.03.2008.

Në muajt e përfundimit të procesit të privatizimit të këtij klubi, konstatohet se Komanda Mbështetëse e cila ishte ngarkuar me regjistrimin e kësaj prone, vihet nën trysinë e kontroleve. Kështu, rezulton se, me programin e punës "*Për auditim të plotë në Komandën Mbështetëse*", nënshkruar nga drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm shtetasi Maliq Xhebra, me nr. 8993 prot datë 27.11.2008, dhe të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes Gazmend Oketa, është përcaktuar kryerja e një kontrolli në Komandën Mbështetëse nga auditimi i fundit deri më 30.10.2008. Grupi i punës i auditimit është përcaktuar të jetë: *Agim Zenelaj, përgjegjës grupi, Bashkim Punavija dhe Bardhyl Xhafa.*

219. Me shkresën nr. 809 prot datë 26.01.2009 Drejtori Urim Muja, i Sektorit të Shitjeve pranë Dretorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Ministria e Financave, i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të

Mbrojtjes, Sektori i Administrimit të Pronës, me atë së cilës, **kërkon përfaqësues për përfundim procedurash privatizim objekti (dorëzim dhe lidhje kontratë shitje)**, mbështetur në VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 *“Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”*.

Me autorizimin nr. 1001 prot datë **12.02.2009** të drejtorit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Maliq Xhebra, është autorizuar grupi i punës i auditimit sipas programit të miratuar me nr. 8993 datë 27.11.2008 **për një shtyrje të periudhës së auditimit të plotë**.

219.1. Me shkresën nr. 1996 prot datë **20.02.2009**, Drejtori Urim Muja, i Sektorit të Shitjeve pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Ministria e Financave, **i është drejtuar sërish Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa duke kërkuar përfaqësuesin e kësaj ministrie me qëllim që të realizohet përfundimi i procedurave të privatizimit**.

220. Me shkresën nr. 7883/1 regj datë **03.03.2009** gjenerali Maksim Malaj, Shef i Shtabit të Përgjithshëm (i emëruar më datë 25.07.2008 deri më datë 08.08.2011), i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, me lëndën **“Prononcim lidhur me pronën nr. 11, Klubi i Futbollit Partizani”**. Në këtë shkresë është shprehur se, *Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes, nëpërmjet projekt shkresës “Autorizim për dorëzim prone dhe lidhje kontrate” kërkon të autorizojë Komandën Mbështetëse të dorëzohet dhe të lidhe kontratën e shitjes për pronën nr. 11 me emërim Klubi i Futbollit Partizani Tiranë. Në memon që shoqëron këtë projekt shkresë, kërkohet edhe firma e shefit të shtabit të përgjithshëm. Për këtë arsye nëpërmjet drejtorive J-3 dhe J-4, ky shef, ka kërkuar të informohet për statusin e kësaj prone si dhe detyrimet e Shtabit të Përgjithshëm në këtë proces. Nga informacioni i marrë, rezulton se prona nr. 11, nuk bën pjesë në planin e përhapjes së FA të miratuar nga Presidenti me shkresat nr. 638/2 dhe 638/4 datë 29.08.2007. Prona bën pjesë në listën e pronave në administrim të MM në bazë të VKM nr. 515 datë 18.07.2003. Kjo pronë, duhet të merrej në administrim nga Komanda e Mbështetjes Logjistike, në zbatim të shkresës së shefit të përgjithshëm të FA nr. 7883 datë 15.09.2006. Në zbatim të kësaj shkrese, Komanda me grup pune ka vajtur në vend, për marrjen në administrim të kësaj prone, por pala dorëzuese nuk është paraqitur në asnjë rast dhe për më tepër, grupi i punës nuk është lejuar të futej në objekt. Paraqitja e të dy palëve marrës dhe dorëzues, është detyrim i përcaktuar në VKM nr. 153 datë 03.04.1993 “Për kalimin kapital të objekteve e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore”. Komanda e mbështetjes logjistike, me shkresën nr. 3425/1 datë 28.09.2006 “Mbi disa probleme lidhur me marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin KF Partizani”, ka informuar DMIBM në MM. Me shkresën nr. 8138/1 datë 05.10.2006 DMIBM nuk i përgjigjet shqetësimit të KML për marrjen në administrim të kësaj prone, por kërkon kryerjen e veprimeve për aplikimin dhe regjistrimin e pronës pranë ZVRPP Tiranë. Në vijim të procedurave KML ka përgatitur dokumentacionin përkatës dhe me shkresën nr. 4285 prot datë 13.11.2006 “Kërkesë për regjistrim pasurie të paluajtshme” drejtuar ZVRPP ka aplikuar për regjistrim. Me gjithë ndërhyrjet e herë pas herëshme pranë ZVRPP, nga kjo zyrë nuk është dhënë dokument pronësie, me pretendimin se prona është me mbivendosje dhe në proces gjyqësor. Për këtë problem, KML me shkresën nr. 764 datë 25.02.2007 drejtuar ZVRPP, dhe për dijeni DMIBM në MM ka kërkuar regjistrimin e pronës sipas inventarit të miratuar me VKM nr. 515 datë 18.07.2003. DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes me shkresën nr. 349/2 datë 09.03.2007 drejtuar ZRKKP dhe për dijeni Komandës Mbështetëse, është shprehur për t’i hapur rrugë procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe për të mos krijuar përplasje (mbivendosje) në pronësi, kërkojnë që mbështetur në ligjin nr. 9583 datë 17.03.2006 për ndryshime të ligjit nr. 9235 datë 29.04.2004 për kthimin*

e pronave, tërheqin vëmendjen që të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të MM të bëhet pas miratimit të ministrisë. Ndodhur në këto kushte, KM ndërpreu procedurat e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 datë 20.03.2007 drejtuar DMIBM në MM kërkoi që kjo pronë të hiqej nga administrimi i KM. Prona me nr 11 deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga KM. Për privatizimin e kësaj prone nuk është marrë mendimi i Shtabit të Përgjithshëm të FA. KM nuk i është kërkuar dhe nuk është angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit të kësaj prone referuar VKM n. 703 datë 11.01.2006 dhe VKM nr. 704 datë 11.10.2006. Shtabi i Përgjithshëm i FA nuk ka dijeni se nga kush është përgatitur ky dokumentacion dhe si kanë vijuar procedurat e privatizimit. Në komisionin e vlerësimit të pronës nuk ka marrë pjesë asnjë përfaqësues i KM. Mesa informacion kanë, ky objekt menaxhohet nga një person i emëruar në detyrë nga MM. Në këto kushte KM nuk mund të dorëzojë dhe të lidhë kontratën e shitjes për pronën nr. 11.

220.1. I pyetur më datë 28.09.2022, shtetasi Maksim Malaj, ka deklaruar se: "..... në periudhën 2008 – 2011 kam qenë shef i shtabit të përgjithshëm. Më kujtohet se ka ardhur një shkresë nga një drejtori e instalimeve të burimeve të mbrojtjes, një memo që thoshte se kjo pronë do të dorëzohej si pasojë e privatizimit. Unë nuk e kam ditur se klubi Partizani kishte dalë nga plani i përhapjes. Unë u vendosa pas Gërdecit si shef shtabi dhe stafi ishte i ri. Kur erdhi kjo për privatizimin, unë u habita se çna që kjo drejtori më dërgon mua një shkresë të tillë dhe aty mora vesh se nga ana e ministrit ishte dërguar një urdhër në komandën e mbështetjes logjistike por unë nuk e kam parë urdhërin. Kam thirrur dy drejtorët, drejtorin e operacioneve Hysen Cekodhima dhe drejtorin e e logjistikës J4, Perikli Tiko. U kam thënë të më sqaronin për këtë punë pasi nuk kisha dijeni. Ata të dy më sqaruan, më përgatitën një material me shkrim, për mua dhe për ministrin dhe ia kemi nisur Ministrin më datë 03.03.2009. Numri i shkresës mund të jetë 8875 ose 8873. Në këtë material bëhej një shpjegim në lidhje me këtë pronë ku rezultonte se kjo pronë kishte dalë nga plani i përhapjes në vitin 2006 dhe ishte miratuar nga Presidenti në vitin 2006. Këtë pronë me urdhër të shefit të shtabit duhej që komanda e mbështetjes logjistike ta merrte në administrim. Nga ana e komandës së mbështetjes logjistike është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të pronës nr 11 (të Klubit Partizani). Në shkresën që komanda e mbështetjes logjistike i ka dërguar Drejtorisë së Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes shprehet se jo vetëm nga ana e Klubit nuk ishte ngritur ndonjë grup pune por edhe nuk ishin lejuar të futeshin në ambientet e pronës së Klubit Partizani. Nga ana e drejtorisë ju vu detyrë Komandës së Mbështetjes Logjistike të aplikonte për regjistrimin e pronës pranë ZVRPP-së. ZVRPP ktheu përgjigje me arsyetimin se nuk mund të jepte certifikatën e pronës, me arsyen se kishte mbivendosje dhe se është në proces gjyqësor. Kështu që kjo pronë nuk u mor në administrim nga Komanda e Mbështetjes Logjistike. Pra nuk ishte bërë e mundur që nga 2007 që të merrej në dorëzim. Më pas në dijeninë time ka dalë një urdhër i Ministrin të Mbrojtjes, a VKM nuk e mbaj mend mirë, që për regjistrimin e pronave ngarkonte Drejtorinë e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes. Sidoqoftë tek informacioni që theksova mund ta gjenin të shkruar saktësisht, pra informacioni që unë i jam drejtuar Ministrin. Gjithashtu i kemi ngritur Ministrin të Mbrojtjes si problem edhe faktin që në procedurat e privatizimit nuk ka pasur përfaqësues të Komandës Mbështetëse Logjistike. Kështu që unë e kam informuar me këtë shkresë Ministrin e Mbrojtjes, që Klubi Partizani ka një përfaqësues të emëruar nga Ministri, mbiemrin e ka pasur Tole por nuk jam i sigurt për identifikimin e këtij personi, dhe i kam thënë që Komanda e Mbështetjes Logjistike duke mos e pasur në administrim nuk ka çfarë të dorëzojë si pasojë e privatizimit. Dua të theksoj se përveç të quajtur Vladimir Qiriaz. Vladimiri më ka parashtruar problematikat dhe unë i kam thënë të ndiqte procedurat. Por që nga momenti që unë kam nënshkruar shkresën si më sipërcituar,

e pronave, tërheqin vëmendjen që të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të MM të bëhet pas miratimit të ministrisë. Ndodhur në këto kushte, KM ndërpreu procedurat e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 datë 20.03.2007 drejtuar DMIBM në MM kërkoi që kjo pronë të hiqej nga administrimi i KM. Prona me nr 11 deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga KM. Për privatizimin e kësaj prone nuk është marrë mendimi i Shtabit të Përgjithshëm të FA. KM nuk i është kërkuar dhe nuk është angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit të kësaj prone referuar VKM n. 703 datë 11.01.2006 dhe VKM nr. 704 datë 11.10.2006. Shtabi i Përgjithshëm i FA nuk ka dijeni se nga kush është përgatitur ky dokumentacion dhe si kanë vijuar procedurat e privatizimit. Në komisionin e vlerësimit të pronës nuk ka marrë pjesë asnjë përfaqësues i KM. Mesa informacion kanë, ky objekt menaxhohet nga një person i emëruar në detyrë nga MM. Në këto kushte KM nuk mund të dorëzojë dhe të lidhë kontratën e shitjes për pronën nr. 11.

220.1. I pyetur më datë 28.09.2022, shtetasi Maksim Malaj, ka deklaruar se: "..... në periudhën 2008 – 2011 kam qenë shef i shtabit të përgjithshëm. Më kujtohet se ka ardhur një shkresë nga një drejtori e instalimeve të burimeve të mbrojtjes, një memo që thoshte se kjo pronë do të dorëzohej si pasojë e privatizimit. Unë nuk e kam ditur se klubi Partizani kishte dalë nga plani i përhapjes. Unë u vendosa pas Gërdecit si shef shtabi dhe stafi ishte i ri. Kur erdhi kjo për privatizimin, unë u habita se çnë që kjo drejtori më dërgon mua një shkresë të tillë dhe aty mora vesh se nga ana e ministrit ishte dërguar një urdhër në komandën e mbështetjes logjistike por unë nuk e kam parë urdhërin. Kam thirrur dy drejtorët, drejtorin e operacioneve Hysen Cekodhima dhe drejtorin e e logjistikës J4, Perikli Tiko. U kam thënë të më sqaronin për këtë punë pasi nuk kisha dijeni. Ata të dy më sqaruan, më përgatitën një material me shkrim, për mua dhe për ministrin dhe ia kemi nisur Ministrin më datë 03.03.2009. Numri i shkresës mund të jetë 8875 ose 8873. Në këtë material bëhej një shpjegim në lidhje me këtë pronë ku rezultonte se kjo pronë kishte dalë nga plani i përhapjes në vitin 2006 dhe ishte miratuar nga Presidenti në vitin 2006. Këtë pronë me urdhër të shefit të shtabit duhej që komanda e mbështetjes logjistike ta merrte në administrim. Nga ana e komandës së mbështetjes logjistike është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të pronës nr 11 (të Klubit Partizani). Në shkresën që komanda e mbështetjes logjistike i ka dërguar Drejtorisë së Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes shprehet se jo vetëm nga ana e Klubit nuk ishte ngritur ndonjë grup pune por edhe nuk ishin lejuar të futeshin në ambientet e pronës së Klubit Partizani. Nga ana e drejtorisë ju vu detyrë Komandës së Mbështetjes Logjistike të aplikonte për regjistrimin e pronës pranë ZVRPP-së. ZVRPP ktheu përgjigje me arsyetimin se nuk mund të jepte certifikatën e pronës, me arsyen se kishte mbivendosje dhe se është në proces gjyqësor. Kështu që kjo pronë nuk u mor në administrim nga Komanda e Mbështetjes Logjistike. Pra nuk ishte bërë e mundur që nga 2007 që të merrej në dorëzim. Më pas në dijeninë time ka dalë një urdhër i Ministrin të Mbrojtjes, a VKM nuk e mbaj mend mirë, që për regjistrimin e pronave ngarkonte Drejtorinë e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes. Sidoqoftë tek informacioni që theksova mund ta gjenin të shkruar saktësisht, pra informacioni që unë i jam drejtuar Ministrin. Gjithashtu i kemi ngritur Ministrin të Mbrojtjes si problem edhe faktin që në procedurat e privatizimit nuk ka pasur përfaqësues të Komandës Mbështetëse Logjistike. Kështu që unë e kam informuar me këtë shkresë Ministrin e Mbrojtjes, që Klubi Partizani ka një përfaqësues të emëruar nga Ministri, mbiemrin e ka pasur Tole por nuk jam i sigurt për identifikimin e këtij personi, dhe i kam thënë që Komanda e Mbështetjes Logjistike duke mos e pasur në administrim nuk ka çfarë të dorëzojë si pasojë e privatizimit. Dua të theksoj se përveç të quajtur Vladimir Qiriaz. Vladimiri më ka parashtruar problematikat dhe unë i kam thënë të ndiqte procedurat. Por që nga momenti që unë kam nënshkruar shkresën si më sipërcituar,

por pala dorëzuese nuk është paraqitur në asnjë rast për dorëzimin e kësaj pasurie. Për më tepër grupi i punës asnjëherë nuk është lejuar të futej në objekt. **Paraqitja e dy palëve (marrës – dorëzues) është detyrim i përcaktuar në VKM nr. 153 datë 03.04.1993 “Për kalimin kapital të objekteve e mjeteve kryesore të ndërmarrjeve e nstitucioneve shtetërore”.** KML me shkresën nr. 3425/1 dt 28.09.2006 ... ka informuar DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes për problemet e dala. Me shkresën nr. 8138/1 dt 05.10.2006 “Për regjistrimin e pronës nr. 11 me emërtim “Klubi i Futbollit Partizani” Tiranë, DMIBM nuk i përgjigjet shqetësimit të KML për marrjen në administrim të kësaj prone por kërkon kryerjen e veprimeve për aplikimin dhe regjistrimin e pronës pranë ZVRPP Tiranë. Në vijim të procedurave KML ka pregatitur dokumentacionin përkatës dhe me shkresën nr. 4285 dt 13.11.2006 “Kërkesë për regjistrim pasurie të paluajtshme” drejtuar ZVRPP Tiranë, ka aplikuar për regjistrimin e kësaj prone. Me gjithë ndërhyrjet e herë pas hershme pranë ZVRPP Tiranë, nga kjo zyrë nuk është dhënë dokument pronësie me pretendimin se ka mbivendosje dhe është në proces gjyqësor. Për këtë problem KML me shkresën nr. 764 dt 25.02.2007 “Regjistrim pasurie” drejtuar ZVRPP Tiranë dhe për dijeni DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes, ka kërkuar rejgitrimin e pronës sipas inventarit të miratuar me VKM nr/, 515 dt 18.07.2003. DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr. 349/2 datë 09.03.2007 “Përgjigje kërkesës për konfirmim prone” drejtuar Zyres Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Tiranë, dhe për dijeni komandës Mbështetëse, është shprehur “Për t’i hapur rrugë procedurave të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe për të mos krijuar përplasje (mbivendosje) në pronësi, kërkojmë që mbështetur në ligjin nr. 9235 datë 29.04.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” i ndryshuar, ju tërheqim vëmendjen që të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të bëhen pas miratimit të Ministrisë. Ndodhur në këto kushte, KM-ja ndërpreu procedurën e regjistrimit të pronës dhe me shkresën nr. 913/1 datë 20.03.2007 ... drejtuar DMIBM në MM kërkoi që kjo pronë të hiqej nga administrimi i KM. Prona nr. 11 ... deri më sot nuk është marrë në dorëzim nga KM. **Komandës Mbështetëse nuk i është kërkuar dhe nuk është angazhuar në përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit të kësaj prone ... VKM nr. 794 dt 21.11.2007....** Në komisionin e vlerësimit të pronës, nuk ka marrë pjesë asnjë përfaqësues i Komandës Mbështetëse, kjo sipas VKM nr. 1638 dt 17.12.2008 ... Mesa informacion që kemi, ky objekt menaxhohet nga një person i emëruar në detyrë nga Ministria e Mbrojtjes. Në këto kushte KM-ja nuk mund të dorëzojë dhe të lidhë kontratën e shitjes për pronën nr. 11 me emërtimin “Klubi i Futbollit Partizani”. Për zbatimin e urdhërit të ministrit të Mbrojtjes nr. 334 dt 13.03.2009 “Për dorëzim prone dhe lidhje kontrate” mendojmë që më përpara kjo pronë duhet të merret në dorëzim nga Komanda e Mbështetjes. Me marrjen në dorëzim dhe kompletimin e dokumentacionit përkatës lind e drejta për vijimin e procedurave të mëtejshme. Për përshpjëtimin e procesit, jemi ngritur një grup pune për plotësim të dokumentacionit të pronës, marrje në administrim e veprime të mëtejshme...” Kjo shkresë është konceptuar nga N/kol Naim Ramaj, daktilografuar dhe printuar nga major N.Tushi, nënshkruar nga gjeneral brigade Vladimir Qiriazzi dhe i është drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Gjeneral Brigade Maksim Malaj.

221.2. Përsa më sipër, me urdhërin nr. 1487/2 dt **19.03.2009** “Për marrjen në administrim dhe hartimin e dokumentacionit teknik për pronën me nr. 11 “Klubi i Futbollit Partizani” Komandanti i Komandës Mbështetëse Vladimir Qiriazzi, ka urdhëruar që **në repartin ushtarak 4001 të krijohet grupi i punës për marrjen në dorëzim të pronës nr. 11 “Klubi i Futbollit Partizani” me këtë përbërje: Naim Ramaj, Ahmet Roçi, Nikoll Tushi, Agim Bardhoshi, Shkëlqim Isufi dhe Isak Rama. Prona me nr. 11 me t’u marrë në dorëzim do të administrohet nga Reparti Ushtarak 4400 (Regjimenti i mbështetjes). Instituti Gjeografik i Ushtrisë të marrë masa që brenda datës 20.03.2009 të hartojë dokumentacionin teknik në tre kopje dhe ta verë në dispozicion të komisionit të mësipërm. Grupi të kontaktojë me drejtorinë që e ka në**

administrim aktualisht pronën nr. 11 dhe të rakordojë punën për ta marrë në dorëzim atë. Regjimenti i mbështetjes, me marrjen në administrim të kësaj prone, të marrë masa për ruajtjen e saj, deri në përfundim të procesit të privatizimit. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhëri, grupi i punës dhe komandanti i repartit ushtarak 4400. Ndjek zbatimin e këtij urdhëri shefi i shtabit në KM. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë. Shtetasi Vladimir Qiriazhi në lidhje me urdhërin e sipërcituar, vë në dijeni Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa (shih shkresën nr. 1487/3 regj datë 19.03.2009), duke i bërë me dije ndër të tjera se prona nr. 11 nuk është marrë asnjëherë në dorëzim nga ana e Komandës Mbështetëse dhe si e tillë nuk është kontabilizuar në llogarinë e Komandës.

Me shkresën nr. 1487/4 regj dt 25.03.2009 gjeneral Brigade Vladimir Qiriazhi i parashtroi Ministrin të Mbrojtjes Gazmend Oketa, se specialistët e Komandës Mbështetëse morën takim me përfaqësuesin e Agjensisë Kombëtare të Privatizimit i cili vuri në dispozicion dosjen e privatizimit me të dhënat teknike të pronës nr. 11. Gjatë shqyrtimit të dosjes, rezultojnë se, përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes në Komisionin e vlerësimit për privatizimin e kësaj prone është caktuar nga Ministria e Mbrojtjes z. Stefan Tane, specialist në DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes. Komanda e Mbështetjes pra, nuk e ka marrë në dorëzim këtë pronë dhe në këto rrethana nuk mund të kryejnë veprime të mëtejshme por janë në pritje të mendimeve të ministrit.

Me shkresën nr. 1697 regj dt 26.03.2009 gjeneral brigade Vladimir Qiriazhi, i është drejtuar sërish Ministrin të Mbrojtjes Gazmend Oketa, ku e bën me dije se për zbatimin e urdhërit nr. 334 datë 13.03.2009 po ndeshen në vështirësi zbatim pasi: Prona nr. 11 nuk është marrë në administrim nga Komanda e Mbështetjes; nuk është kontabilizuar në librat e llogarisë pasi nuk u është dorëzuar asnjëherë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes; nuk disponojnë certifikatë pronësie të kësaj prone, nuk kanë në administrim asnjë dokument për privatizimin e pronës; në Ministrinë e Mbrojtjes për pronat në administrim të saj ekziston zyra përkatëse.

221.3. Nga emergjenca e kryerjes së veprimeve dhe leximit të provave në tërësinë e tyre dhe në përputhje me njëra – tjetrën, konstatohet se ndaj shtetasit Vladimir Qiriazhi ushtrohej presion për marrjen sa më shpejt në administrim të pronës së mësipërme me qëllim konkludimin e procedurave të privatizimit. Për këtë arsye, me shkresën nr. 1697/1 regj datë 26.03.2009 shtetasit Vladimir Qiriazhi i është drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm shtetasit Maksim Malaj, ku parashtroi se, më datë 26.03.2009 me telefon i është kërkuar zbatim me urgjencë i urdhërit nr. 334 datë 13.03.2009 "Për dorëzim prone e lidhje kontrate" për pronën nr. 11. ... Aktualisht është i paqartë dhe kjo del jashtë përgjegjësisë së tij si komandant. Ndjejhet i shqetësuar për mënyrën se si i kërkohet kjo firmosje ndaj dhe kërkon mendimin e tij. Kjo shkresë është konceptuar nga Major Ahmet Roçi.

I pyetur më datë 26.09.2022 shtetasi Vladimir Qiriazhi ka deklaruar: "... Nuk e mbaj mend se kush më ka telefonuar por telefonata kam pasur nga personat e interesuar për të firmosur urdhërin, nga ministri i mbrojtjes dhe nga drejtorja përkatëse në ministri. ..."

221.4. Me shkresën nr. 1697/2 regj datë 27.03.2009 të Komandës Mbështetëse, nënkolonel Naim Ramaj, Kryetar i Grupit të punës i ngritur nga shtetasi Vladimir Qiriazhi për marrjen në dorëzim të pronës, i drejtohet këtij të fundit duke i bërë me dije se, grupi i punës mori masa për hartimin e dokumentacionit teknik (u hartuan në tre kopje planimetritë e objekteve dhe një kopje e planvendosjes së pronës) ku rezultoi se, sipërfaqja sipas VKM nr. 515 datë 18.07.2003 është 28 000 m² kurse sipas dokumentacionit teknik (plan vendosjes) është 31 002, 5 m².

Në përfundim të kësaj shkrese, pasi parashtron qëndrimet e Komandës Mbështetëse, deklaron se, **KM nuk mund të dorëzojë dhe të lidhë kontratën e shitjes për pronën nr. 11.**

221.5. Me shkresën nr. 1697/3 regj datë **27.03.2009** Komanda Mbështetëse, konkretisht Vladimir Qiriaz, shkresë e konceptuar nga *Naim Ramaj dhe Ahmet Roçi*, i drejtohen **Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes** pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe sekretarit të Përgjithshëm të MM shtetasit Fiqiri Kupe. Në këtë shkresë sërish parashtrojnë gjithë pretendimet në lidhje me kontratën nga ana e tyre.

222. Ministria e Mbrojtjes, duket se është shqetësuar nga mosveprimi i Komandës për të marrë në administrim pronën dhe për të lidhur kontratën, pasi drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes shtetasi Ardian Shashaj i dërgon më datë 31.03.2009 dy shkresa Komandës Mbështetëse duke bërë me dije në lidhje me këto shkresa edhe Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa, Sekretarin e Përgjithshëm Fiqiri Kupe dhe Shefin e Shtabiot të Përgjithshëm Maksim Malaj.

Konkretisht, me shkresën nr. 2084/1 prot datë 31.03.2009, **i tërhiqet vëmendje Komandës Mbështetëse për sjelljen e saj dhe i bëhet me dije se prona nr. 11, është jashtë planit të përhapjes** së miratuar nga Presidenti me shkresat nr. 638/2 dhe 638/4 datë 29.08.2007 dhe me detyrën e shefit të SHPFA-së të vendosur me shkresën nr. 7883 datë 15.09.2006 "*Për marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin KF Partizani*", ngarkohet Komanda Mbështetëse për marrje në administrim të kësaj prone. **Vazhdimi i procedurave ligjore të administrimit nuk varen nga DMIBM por vetë Komanda Mbështetëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar.** Komanda Mbështetëse ka ndërprerë me inisiative të saj procedurat e regjistrimit të pronës që prej vitit 2007 dhe ka kërkuar në DMIBM të hiqet nga administrimi KM. Ngrihet pretendimi për dorëzim kur në fakt nuk ka palë dorëzuese. **Moslejimi në pronë është i pajustificuar** pasi KM në zbatim të ligjit nr. 9069 datë 15.05.2003 "*Për policinë ushtarake*" neni 12, duhej të bashkëpunonte me këtë strukturë. Citohet se, emri që ju përmendni është zëvendësuar nga METE pas diskutimeve dhe praktikave shkresore që KM ka dërguar për pronën 11.

Me shkresën nr. 2147/1 prot datë 31.03.2009, i kthehet përgjigje Komandës Mbështetëse, ku parashtrohet se, **nuk gjejnë asnjë informacion në lidhje me dorëzimin apo lidhje kontrate.** Lidhur me mënyrën e raportimit të pronave që kanë në administrim, luten të dërgojnë informacionin periodik të përmuajshëm pranë Drejtorisë së Menaxhimit, **lidhur me ecurinë e procesit të privatizimit. Mungesa e këtij raportimi sjell probleme në memon informuese që duhet të dërgohet pranë Ministrin të Mbrojtjes.**

223. Vërtetohet nga tërësia e provave të administruara se presioni mbi funksionarët e Ministrisë së Mbrojtjes për nënshkrimin e kontratës së privatizimit po rritej dhe rrjedhimisht presioni rritej edhe mbi komandantin e Komandës Mbështetëse shtetasin Vladimir Qiriaz. Ky i fundit, mesa rezulton ka pasur takime me Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa i cili i ka kërkuar të firmoste pasi kjo gjë po i kërkohej edhe atij. Madje, takimet kanë qenë jo vetëm me shtetasin Gazmend Oketa por edhe me funksionarë të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Këtë gjë shtetasi Vladimir e ka dokumentuar në shkresën me Nr. 1858 Regj. datë **02.04.2009**, drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Maksim Malaj, **në lidhje me takimet e zhvilluara me Ministrinë e Mbrojtjes Z. Gazmed Oketa** për çështjen e dorëzimit të pronës me Nr. 11, ku në përmbajtje të shkresës ka sqaruar se, **ka refuzuar të firmosi pa marrë më parë pronën në dorëzim.** Në fund të kësaj shkrese ai ka

informuar dhe për raste të tjera që Ministria e Mbrojtjes kërkon ushtarakët për të firmosur ndërkohë që ka në dispozicion Drejtorinë e Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes. Në këtë shkresë shtetasi Vladimir është shprehur se, Ministri i ka kërkuar Vladimirit që të firmoste pasi kjo gjë i kërkohej edhe atij. Sqaron se, ka marrë takim me ministrin më datë 31.03.2009 në orën 18.15 dhe se është ballafaquar më datë 01.04.2009 rreth orës 13.00 me personelin e DMIBM shtetasit Ardian Shashaj, Roland Llazari dhe Erinda Ndroqi, sekretarin e përgjithshëm Fiqiri Kupe dhe Drejtorin e Kabinetit të MM Besnik Dervishi.

Konkretisht në këtë shkresë parashtron: "...Dëshiroj t'ju ve në dijeni se, më datën 31 mars 2009 në orën 18.15 më ka thirrur në takim Ministri i Mbrojtjes zoti Gazmend Oketa. Në takim kemi diskutuar lidhur me zbatimin e urdhërit nr. 334 datë 13.03.2009 "Për dorëzim prone e lidhje kontrate" për pronën nr. 11 "Terrenet sportive dhe bjektet e Klubit të Futbollit Partizani". Në takim i cili zgjati një orë e gjysëm, Ministri i Mbrojtjes më kërkoi që unë të firmosja për kontratën në fjalë. Unë insistova se jam duke punuar për zbatimin e urdhërit, por se kam shumë probleme ligjore të cilat nuk mund t'i shkel. Themelore është se kjo pronë nuk është në kontabilitet të KM dhe se për shkak të problemeve të mbivendosjes nuk është marë certifikata e pronësisë. Insistova se në këto kushte nuk mund të firmos ndaj dhe i kërkova që të autorizohet për firmosje nëse është ligjore përfaqësuesi i tij, i cili ka qenë pjesë e vlerësimit të procedurave për këtë objekt.

Në takim erdhi edhe Sekretari i Përgjithshëm zoti Fiqiri Kupe, i cili nuk ju dha asnjë mendim ndryshe argumentave që unë parashtroj. Në përfundim u ra dakord që të bënim një ballafaqim me përfaqësuesin e Ministrisë së Fianncave zotin Urim Muja të nesërmen datë 01.04.2009 ku dhe të sqaronim problemet që unë kisha. Në pritje të këtij takimi, aty rreth orës 12.00 dt. 01.04.2009 më ka marrë në telefon sekretari i përgjithshëm zoti Kupe i cili më ka thënë se në orën 12.30 duhet të isha në ballafaqim për këtë problem në zyrën e MM. Për shkak të angazhimeve të mija në këtë ditë i thashë se mund të jem aty në orën 13.00 dhe ai ra dakord.

Shkova në takim në zyrën e MM dhe aty u ballafaqova me personelin e DMIBM zotërinjtë Ardian Shashaj, Roland Llazari dhe Zonjën Erinda Ndroqi, sekretarin e Përgjithshëm Zotin Fiqiri Kupe dhe Drejtorin e Kabinetit të Ministrisë të Mbrojtjes zotin Besnik Dervishi.

Pas një ekspozije të gjendjes së pronës nr. 11 nga zonja Erinda, ndërhyra dhe ju thashë të gjitha argumentat e mija të cilat edhe jua kam bërë prezent në shkresat që ju kam informuar më parë. Këmbëngulja e tyre ishte se keni përgjegjësi pse s'e keni marë, keni urdhër të shefit të shtabit dhe se nuk ka rëndësi pse nuk ka certifikatë pronësie. I thashë se jam dakort që të punojmë së bashku për ta marrë pronën në dorëzim dhe pastaj të vijoj normalisht detyrën për zbatimin e urdhërit të nxjerë (Urdhëri 344 të MM). Hodha argumentin se si kjo pronë ne kemi shumë të tjera të cilat nuk na duhen dhe nuk po veprohet. Në diskutim i thashë Ministrinë të Mbrojtjes se kjo është përgjegjësi e DMIBM dhe se ata janë përfaqësuesit tuaj të parë.

Debati u nxeh dhe Ministri i Mbrojtjes largoi ekipin e DMIBM-së dhe qëndruan aty sekretari e drejtori. Instistojta se nuk i takon kjo përgjegjësi firmosje Komandës Mbështetëse apo çdo pjestari tjetër të FA-së, duke ju sjellë në qendër të vëmendjes, argumentet e mëparshme. Gjithsesi ju kërkova që së pari, të më dorëzojnë objektin, pastaj të vijojë procedura. Pas insistimit të Drejtorit të Kabinetit se duhej që të firmosja i jam drejtuar Ministrinë të Mbrojtjes dhe i kam thënë, zoti Ministër unë mendoj se drejtori juaj i kabinetit është shumë më afër përfaqësimit tuaj në këtë problem se sa jam unë, ndaj autorizoni atë për ta firmosur.

Debati u nxeh dhe pastaj Ministri i Mbrojtjes, nxori jashtë ata dhe qëndruam bashkë.

Ministri më kërkoi se unë duhej të firmosja pasi kjo gjë i kërkohet edhe atij. Unë i thashë se nuk mund të firmosja pa plotësuar praktikën përkatëse dhe se nuk e di pse duhet ta bëjmë me urgjencë. **Më tha se kjo punë mund të shkojë deri në masë** dhe unë ju përgjigja se ju mund të bëni si të doni por kjo nuk është aspak e drejtë. E mbyllëm bisedën duke i thënë se si do të ndejheshit ju zoti Ministër nëse neso për shkak të problemeve ligjore të praktikës, përsëri një gjeneral i ushtrisë të jetë dëshmitar në gjyq për problemet që mund të kenë privatët që pretendojnë blerjen e kësaj prone. Ja përsërita se kjo nuk ka aspak sens zoti ministër, ndaj dhe dua që edhe ju të rishikoni urdhërin tuaj.

Zoti Gjeneral. Përsa më sipër, desha që t'ju informoj por edhe njëkohësisht t'ju bëja me dije se kam informacion dhe për raste të tjera të kësaj ku ushtarakët do të kërkohen për të shkuar e të firmosin ndërkohë që MM ka në dispozicion të kësaj veprimtarie DMIBM. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, jam në pritje të mendimeve e sugjerimeve tuaja...".

223.1. I pyetur në lidhje me sa ka parashtuar më lart, shtetasi **Vladimir Qiriaz** gjatë hetimit, ka deklaruar se: ...Mbah mend që jam thirrur në një takim në Ministrinë e Mbrojtjes ku kam qenë unë, Ministri Gazmend Oketa dhe gjithë personat e tjerë që përmendët më sipër. E kam sqaruar ministrin dhe personalin e tij dhe ju kam thënë pse firmosja për dorëzimin e klubit sportiv Partizani ishte jashtë kompetencave të mia dhe përgjegjësisë sime. I kam thënë ministrit Gazmend Oketa që prona i përket Ministrisë së Mbrojtjes dhe shumë mirë mund ta firmosë personeli juaj, një anëtar i kabinetit juaj, konkretisht drejtori i kabinetit. **Ata, të gjithë personat që ju përmendët më sipër, u nervozuan kur unë e thashë këtë gjë dhe u krijua një situatë debati.** Ministri i nxorri jashtë të gjithë dhe ngela vetëm me të. Unë i thashë Ministrit Gazmend Oketa se nuk mund të firmosja dhe ai më tha se edhe atij po ia kërkonin që të firmosej. **Më tha "Duhet firmosur" por nuk më sqaroi se kush ia kishte kërkuar firmosjen. Ministri Gazmend Oketa me tha se kjo gjë mund të shkonte deri në masë se faktikisht në raportin e komisionit të auditit Ministrit Oketa i kërkohet që unë të ndeshkohesha me masë disiplinore.**

223.2. Siç mund të shihet, në këtë takim rezultoi se rol të drejtëpërdrejtë përveç ministrit Gazmend Oketa ka pasur edhe shtetasi Besnik Dervishi i cili në atë kohë ushtronte detyrën e Drejtorit të Kabinetit të Ministrit. I pyetur në lidhje me takimin e zhvilluar si më sipër, shtetasi **Besnik Dervishi** ka deklaruar: ... **Ardian Shashaj e kam pasur koleg në policinë ndërtimore, i kemi pasur zyrat në një godinë, ku unë kam qenë drejtor i policisë ndërtimore të Tiranës kurse ai ka qenë drejtor i policisë ndërtimore të Tiranës për rrethinat. Më pas edhe Ardian Shashaj është punësuar në Ministrinë e Mbrojtjes, në pozicionin e një drejtorie, më duket drejtoria ekonomike. Nuk më kujtohet mirë. Fiqiri Kupe ka ndërruar jetë dhe ka qenë sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Roland Llazari dhe Erinda Ndroqi nuk më kujtohen. ...Nuk më kujtohet si takim. Vladimir Qiriazin e njoh, pasi ky ka qenë gjeneral. Unë kohën që kam ushtruar detyrën e drejtorit të kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes, kujdesesha për performancën politike të ministrit, më konkretisht ishte periudhë intensive e përgatitjes për t'u futur në Nato dhe unë kisha si detyrë të merrja masat përpërgatitjen e takimeve të ministrit, këshillohesha me këshilltarët e kabinetit të ministrit për të gjithë mbarëvajtjen. ...unë di që ka pasur një procedurë, mesa më kujtohet për dorëzimin e pronës, nga Ministria e Mbrojtjes tek pronarët. Unë nuk kam pasur asnjë rol në këtë procedurë pasi është procedurë administrative dhe kjo procedurë kryhej nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm dhe hallkat e veta.**

223.2.1. Në fakt pretendimi i shtetasit Besnik Dervishi se nuk ka pasur ndonjë rol në këtë procedurë, përveçse bie në kundërshtim mesa më sipër ka parashtuar shtetasi Vladimir Qiriaz, pra që e vendos shtetasin Besnik Dervishi në një takim ku i është kërkuar me ngul nënshkrimi, rezultoi gjithashtu sipas rregullores së brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me

urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 120 datë 18.0.2003 i ndyrshuar me Urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 318 datë 17.05.2005, se duke qenë drejtor kabineti Kabineti, ka pasur funksion të rëndësishëm. Konkretisht sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, *kabineti është strukturë organizative që funksionin pranë drejtuesit më të lartë civil e ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes. Ai luan një rol të rëndësishëm konsultativ për problemet dhe fushën e përgjegjësisë që mbulon drejtuesi, si dhe shërben si strukturë filtruese e problemeve administrative të drejtuesit duke e lehtësuar atë nga problemet e rutinës së përditshme.* Sipas nenit 30, *Kabineti i Ministrit është struktura bazë e cila shërben si organi konsultativ dhe koordinativ në çështjet që lidhen me anën ligjore, ekonomike etj të Ministrit me strukturat e tjera në MM dhe SHP të FA. Ai ndjek problemet e përditshme duke krijuar kushtet dhe kohën e nevojshme në angazhimin e Ministrit në çështjet kryesore të drejtimit politik të FA.*

223.3. Shtetasi **Gazmend Oketa**, i pyetur përgjatë këtij hetimi, në lidhje me pretendimin e shtetasit Vladimir Qiriazit se nga ana e Ministrit të Mbrojtjes i është kërkuar të firmoste pasi kjo gje i kërkohej edhe atij, deklaroi se: *...Takimi është bërë por deklarata se unë i kam kërkuar të firmoste pasi më kërkohej edhe mua, është absolutisht e pavërtetë. Unë si ministër kam nxjerrë urdhër*

223.4. Shtetasi **Ardian Shashaj**, i pyetur më dt 23.01.2024 ka deklaruar se *ka qenë fillimisht i punësuar në Drejtorinë e Policisë Ndërtimore të Qarkut Tiranë për periudhën kohore dhjetor 2005 deri në vitin 2008. Pranë Ministrisë së Mbrojtjes ka filluar punë në mars të vitit 2008, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Instalimit, Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes e cila pëfshinte 4 sektorë, ku bënte pjesë sektori i pronave, i projekteve të huaja, i ndërmarrjeve ushtarake dhe i prokurimeve publike, që ishin në varësinë e tij. Në pozicionin që kishte merrej me koordinimin e punës së sektorëve dhe midis sektorëve. Këtë pozicion punë e ka mbajtur deri në nëntor 2009. Ka filluar punën në Ministrinë e Mbrojtjes me propozim të ministrit Gazmend Oketa të cilin e njihte nga puna e mëparshme. Pasi ka lënë punën, ka nisur të punojë në subjektin Fital sh.p.k. ku është bashkëortak me 50 % të kuotave të kapitalit me bashkëortak shtetasin Skënder Pashaj.*

Në lidhje me takimin e mësipërm, të muajit prill 2009, të pasqyruar nga shtetasi Vladimir Qiriazit, deklaroi se nuk i kujtohet fare ky takim.

Në lidhje me procedurën e regjistrimit të pronës nr 11, Klubi i Futbollit Partizani, deklaroi se si drejtori kanë qenë vetëm përcjellës dokumentacioni pranë Ministrisë së Ekonomisë në raste privatizimi për prona që ishin jashtë planit të përhapjes kurse me regjistrimin merrej Shtabi i Përgjithshëm me komandat në varësi. Nuk ka asnjë dijeni për regjistrimin e kësaj prone.

223.5. Shtetasi **Roland Llazari**, i pyetur më dt 02.11.2023 deklaroi se, *ka qenë në takimin e sipërcituar. Ai deklaroi se një ditë para takimit, në orën 6 të pasdites, pasi ishte duke dalë nga puna, i ka thënë drejtori i kabinetit shtetasi Besnik Dervishi që të takimin që do të bënin të nesërmen në Ministri me komandën mbëhstetëse duhet të ishte edhe Rolandi. Ky i fundit e ka pyetur për arsyen por Besniku nuk i dha asnjë shpjegim. Të nesërmen shkuan në zyrën e ministrit në orarin e përcaktuar të takimit bashkë me drejtorin Ardian Shashaj dhe Erinda Ndroqi. U futën në zyrë dhe prezent ishin ministri Gazmend Oketa, sekretari i përgjithshëm i ministrit Fiqiri Kupe, drejtori i kabinetit Besnik Dervishi, komandanti i komandës mbëhstetëse Vladimir Qiriazit. Ministri pyeti se çfarë problemi kishin dhe aty filluan të debatojnë Erinda me Vladimirin. Nuk kaluan as dy minuta dhe ministri i nxorri jashtë përfaqësuesit e DMIBM-së. Rolandi nuk e dinte përse po zhvillohej ky takim por aty mori vesh që bëhej fjalë për marrjen në dorëzim të Klubit të Futbollit Partizani nga Komanda Mbëhstetëse. Pretendoi se diskutohej në drejtori që Vladimiri nuk po e merrte pronën në dorëzim dhe Rolandi ishte në dijeni që nuk po e merrte në dorëzim por nuk ishte në dijeni që kjo pronë po privatizohej.*

224. Konstatohet në lidhje me shtetasin Besnik Dervishi që rezulton i pranishëm në takimin e mësipërm, se është një bashkëpunëtor i ngushtë i shtetasve Malltezi dhe Berisha.

224.1. Shtetasi Besnik Dervishi, rezulton të ketë qenë i punësuar pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Ndërtimore dhe INUK** në vitin 2007 – 2008.

Ai fillimisht rezulton të ketë themeluar duke qenë ortak i vetëm, shoqërinë **Standart Alb sh.p.k.** me NIPT K81528015P e cila është regjistruar më datë **28.03.2008** me objekt *ndërtime civile dhe ekonomike, kanalizime, ujësjellësa etj.*

Por vetëm disa më pas, konkretisht më datë **14.04.2008** (shih urdhërin nr 502 dt 14.04.2008) rezulton të jetë emëruar nga **Ministri i Mbrojtjes, Gazmend Oketa, si Drejtor i Kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes**. Duket se punësimi në këtë pozicion nuk e ka penguar të vijojë aktivitetin me shoqërinë Standart Alb pasi rezulton me deklaratën noteriale nr 2526 rep nr 1483 kol dt 21.08.2008 para noteres Laura Pustina (*deklaratë kjo që çuditërisht mban vulën e pakonturuar të noteres në një kohë që kjo vulë nuk ekzistonte*), ky shtetas ka deklaruar që në cilësinë e ortakut të vetëm tek dy shoqëritë Standart dhe Standart Alb deklararon se të drejtat dhe detyrimet e ndërmarra nga kontrata e sipërmarrjes për ndërtimin e një kompleksi banimi në Linzë i kalojnë shoqërisë Standart Alb sh.p.k.

Një vit pas emërimit si drejtor i kabinetit të ministrit të mbrojtjes, shtetasi Besnik Dervishi, më datë **9 qershor 2009** me kontratën nr. 1433 rep nr. 733/1 kol para noteres Laura Pustina, i ka shitur shtetasit **Andrea Miço**, të gjitha kuotat e kapitalit themeltar të kësaj shoqërie. Pas liritimit nga detyra e drejtorit të Kabinetit të Ministrit, sipas urdhërit nr 1390 datë 29.09.2009 të MM Arben Imami, shtetasi Besnik Dervishi me kontratën nr. 868 rep nr. 477/1 kol datë **27.04.2010** ka blerë nga shtetasi Andrea Miço, sërish kuotat.

Më datë 23.01.2024, është pyetur shtetasi **Andrea Miço**, i cili ka deklaruar, *që në vitin 1995 ka qenë i punësuar në subjekt privat e konkretisht në subjektin The Blue Star. Me periudha të caktuara ka qenë i punësuar dhe në shtet. Në periudhën 2005 – 2009 ka qenë drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në vitin 2014 për një periudhë 8 mujore ka qenë Drejtor i Zyrës Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë. Shtetasin Besnik Dervishi deklaroi që e njehtë nga koha e fakultetit si bashkëstudent të inxhinierisë së ndërtimit, pasi kanë përfunduar studimet bashkë. Nuk hyn në rrethin e tij shoqëror dose familjar. Në lidhje me shitblerjen e kuotave të shoqërisë së shtetasit Besnik Dervishi deklaroi se i ka blerë këto kuota pasi i duheshin për punë personale, çështje aplikimi dhe firma që administronte "The Blue Star" kishte si objekt veprimtarie fasonerinë. I duhej një kompani që ushtronte veprimtari në fushën e ndërtimit për të aplikuar për një ndërtim mesa i kujtohet në fushën e energjitikës. Sipas tij ka qenë ai që ka kontaktuar shtetasin Besnik Dervishi, pra ka qenë interesi tij që të blinte kuotat e kësaj shoqërie. Vlera e paguar nuk i kujtohet dhe i rishiti kuotat sepse kishte kosto administrative vetë shoqëria dhe nuk i interesonte ta mbante.. Pretendon se nuk i njehtë shtetasit Andia Pustina, Laura Pustina, Fatmir Bektashi, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi.*

Aktet e shoqërisë konstatohet se mbahen nga studio Pustina si në aspektin noterial (Laura Pustina) ashtu edhe të kontabilitetit (Andia Pustina). Me kontratën e shërbimit profesional, datë 20 (korigjuar).01.2011, Studio Pustina me Nipt L11320002B, përfaqësuar nga Luan Pustina, ka marrë përsipër t'i ofrojë shërbimin e mbajtjes së kontabilitetit, plotësimin e detyrimeve tatimore si dhe çdo detyrimi tjetër që parashikohet nga legjislati në fuqi.

Gjithashtu po ky shtetas rezulton të jetë ortak i vetëm i shoqërisë *Supervizion Profesional* sh.p.k. me NIPT L01315030D me datë regjistrimi 15.01.2010, me të dhëna të njoftuara vullnetarisht info.pustina@yahoo.com me nr telefoni 042261909.

Rezultoni se subjekti *Supervizion Proffesional* me NIPT L01315030D ka qenë supervizori i punimeve që shoqëria Kontakt shpk do të kryente për llogari të investitorit Homeplan Shpk në kompleksin Magnet. Nga analizimi i librave të blerjes të shoqërisë Homeplan shpk me NIPT K81803020E rezultoni se subjekti *Supevizion Proffesional* me NIPT L01315030D ka kryer shitje në një vlerë totale prej **21,374,241 lekësh në periudhën 2010 – 2020**.

Nga analizimi i librave të blerjes të shoqërisë Kontakt shpk me NIPT J92108006V rezultoni se subjekti *Standart Alb* me NIPT K81528015P ka kryer shitje ndaj Kontakt në një vlerë totale prej **181,166,979 lekësh në periudhën 2010 – 2021**. Nga aktet e administruara rezultoni se është gjetur një kontratë sipërmarrjes e datës **01.10.2010**, lidhur ndërmjet shoqërive **Standart Alb Shpk përfaqësuar nga Andrea Miço, dhe Kontakt Shpk**, përfaqësuar nga Fatmir Bektashi, për punime që do të realizohen në objektin "*Homeplan*", rruga "*Frosina Plaku*".

Më datë 23.01.2024 shtetasi Andrea Miço, ka deklaruar se "*...Gjatë periudhës që ka qenë administator, kjo firmë nuk ka patur fare aktivitet, nuk ka krijuar të ardhura...Adresën e shoqërisë nuk e mban. Të punësuar nuk ka patur*". Pra duket që ky shtetas ka mbajtur në mënyrë fiktive pozicionin e ortakut dhe veprimet janë kryer nga shtetasi Bensik Dervishi. Madje, koha kur rezultoni të pasqyrohet kontrata e mësipërme e lidhur me shoqërinë Kontakt sh.p.k. është e datës 01.10.2010, kohë kur ka qenë shtetasi Besnik Dervishi ortak dhe jo shtetasi Andrea Miço.

Gjithashtu rezultoni se shtetasi Besnik Dervishi, ka qenë i punësuar edhe pranë **Autoritetit Rrugor Shqiptar** në periudhën 20.08.2012 deri më 19.11.2013.

I pyetur më datë 14.11.2023 shtetasi **Besnik Dervishi** ka deklaruar se: *... Nga shtatori 2001 deri në Gusht 2005 kam qenë i punësuar në pozicionin e inxhinierit pranë firmës "Tirhino shpk", me ortak Vasil Angjeli dhe Vladimir Avrami, me objekt të veprimtarisë, firmë ndërtimi. Nga gushti 2005 dhe deri në vitin 2007 kam qenë i vetëpunësuar në punë të ndryshme. Për një periudhë dy – tre muajore, më duket në vitin 2006 kam punuar inxhinier në Komunën Kashar. Më pas në vitin, në muajin mars – prill, 2007, nuk e mbaj mend mirë, unë kam filluar punë në policinë ndërtimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Ndërtimore, Tiranë, në pozicionin e drejtorit teknik ose kryetari i degës teknike. Drejtori që më ka punësuar ka qenë shtetasi Hekuran Hoxhalli. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Ndërtimore Tiranë u ristrukturua në verën e vitit 2007 dhe u kthye në Inspektoriatin Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar (INUK) ku unë vijova në janar të vitit 2008 në pozicionin e zëvendës kryeinspektorit. Në këtë pozicion kam punuar deri nga muaji mars ose prill 2008 për të kaluar në vijim në pozicionin e drejtorit të Kabinetit, në Ministrinë e Mbrojtjes, ku u emërova nga Ministri i Mbrojtjes Gazmend Oketa. Unë me Gazmend Oketën jam njohur që në fakultet, pasi kemi pasur shokë të përbashkët dhe na ka lidhur edhe puna më vonë si inxhinier. Unë kam punuar si inxhinieri ndërtimi kurse Gazmend Oketa ka punuar si projektues. Më kujtohet që unë kam qenë inxhinier kurse Gazmend Oketa ka qenë projektues për objektin ish selia e Bashkimit European në Laprakë, me investitor Tirhino, ku kam qenë i punësuar. Kam qëndruar në këtë detyrë, pra si drejtor i kabinetit, deri në muajin shtator të vitit 2009, ku me përfundimin e*

mandatit të Ministrit, jam larguar duke dhënë dorëheqjen. Drejtori i Kabinetit kishte për detyrë për mbarëvajtjen e veprimtarisë politike të ministrit të mbrojtjes.

Pas largimit nga Ministria e Mbrojtjes deklaroi se ...*Kam punuar në biznes privat dhe konkretisht kam pasur firmën time Standart ALB me objekt veprimtarie ndërtim, dhe pas vitit 2010 më lindi e drejta të hap edhe supervizim prandaj kam krijuar shoqërinë Supervizion profesional. Tek të dyja këto shoqëri jam ortak i vetëm. Si drejtues teknik jam tek shoqëria Supervizion Profesional. Të dyja shoqëritë aktualisht janë aktive. Studio Pustina mban ekonominë për të dyja këto shoqëri. Në shtator 2001 kur kam qenë inxhinier pranë shoqërisë Tirhino studio Pustina mbante ekonominë e e shoqërisë Tirhino dhe në atë kohë na lidhte puna dhe jam njohur me Andia Pustinën dhe të motrën e saj të quajtur Laura Pustina. Andia merrej me financën e shoqërisë Tirhino kurse mesa më kujtohet me anë juridike, është marrë e jëma e Andias, pasi më duket se ka qenë notere dhe më pas noterinë më duket e trashëgoi motra e Andias, Laura ecila vijoi të merrej me aktivitetin e shoqërisë Tirhino sh.p.k.*

Në lidhje me njohjen me shtetasin Jamarbër Malltezi deklaroi: ... *Nuk e di saktësisht se kur e kam njohur por e njoh, dhe jemi njohur në aktivitete politike. Pretendon se në kohën që ka punuar në Ministrinë e Mbrojtjes, nuk ka qenë në dijeni që shtetasi Jamarbër Malltezi ishte një nga trashëgimtarët e familjeve të njohura pronare për truallin e ndodhur në territoret e Klubit të Futbollit Partizani. I pyetur nëse ka punuar ndonjëherë për shtetasin Jamarbër Malltezi deklaroi: ...*Unë kam qenë supervizor i Homeplan-it që miratoja punën e Kontaktit. Homeplane ishte kompania zhvilluese kurse Kontakti ishte kompania ndërtuese, në lidhje me ndërtime që kryheshin në territorin e ish Klubit Partizani. Kontaktet për punën dhe kontratën për marrjen në punë e kam bërë me shtetasin Fatmir Bektashi, më duket nga viti 2011 ose 2012 por nuk jam i sigurtë. Pagesat mua më kryheshin sipas faturave që realizoja, nga shoqëria Homeplan sh.p.k. Mua më ka adresuar Andia Pustina që shoqëria Homeplan sh.p.k. kishte nevojë për një supervizor, unë kisha nxjerrë edhe licencën në atë kohë. Andia më tha të vendosja kontakte me shtetasin Fatmir Bektashi. Di që pjesë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. ka qenë edhe shtetasi Jamarbër Malltezi por nuk di të them se kur kam ardhur në dijeni, si dhe Xhimi Begeja. Kur kam filluar punë si supervizor në lidhje me punimet që kryenin Kontakti me Homeplan, unë i kam gjetur punimet në proces, ndoshta kati i katërt apo i pestë, nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet kush ka qenë supervizor para meje. Unë kam vijuar me këtë punë deri në përfundim të ndërtimeve, rreth dy – tre vite para dhënies së deklaratimit të sotëm. Me shoqërinë Kontakt kam punuar mesa më kujtohet nga viti 2016 – 2017. Kam bere ndertim karabinaje, kallepe.**

224.2. Gjithashtu, nga aktet rezulton se, shoqëria Standart Alb sh.p.k. ka kryer edhe punime për llogari të ndërtimit të dy vilave, në pronësi të shtetasit Ardian Kamberi, ndodhur në Farkë, ku referuar akteve të administruara rezulton se këto punime kanë nisur në vitin 2011. Një nga këto vila është blerë sipas kontratës së shitjes nr. 12901 rep nr 3623 kol datë 19.11.2014, nga Fonadacioni i Fëmijëve Shqiptarë Domenick Scaglione përfaqësuar nga presidentja Liri Berisha, në vlerën 370 000 euro. Në këto ndërtime, shtetasi Besnik Dervishi është shfaqur në marrëdhënie të ngushta me shtetasin Marin Biçoku.

225. Në Kryeministri, është gjendur një shkresë fotokopje (por jo origjinalja) e datës 30.03.2009, drejtuar z. Sali Berisha, Kryeministër, me lëndë "Njoftim për keqpërdorim funksioni zyrtar", nënshkruar nga përfaqësuesit e familjeve pronare Artan Alimehmeti, Ardian Llagami, Kreshnik Kaçurri, Igli Vaqari.

Është kërkuar pranë Arkivës së Këshillit të Ministrave në Kryeministri shkresa origjinale e sipërcituar, por kjo shkresë/ankesë gjendet vetëm në fotokopje. Gjithashtu nga këqyrja e

regjistrin të korrespondencës Model Nr.1 në Kryeministri për periudhën 27.03.2009 - 02.04.2009 nuk u konstatua e regjistruar në protokoll hyrje e shkresës/ankesës datë 30.03.2009.

Me urdhërin e brendshëm "Për forcimin e mëtejshëm të punës me dokumentat zyrtare në aparatit e Këshillit të Ministrave" të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm Arian Madhi, datë 08.01.1997, është përcaktuar ndër të tjera se Zyra e Arkivit, merr në dorëzim të gjitha dokumentat zyrtare që hyjnë në aparatit e Këshillit të Ministrave, bën protokollimin e tyre dhe ua dorëzon titullarëve kundrejt firmës. Nuk protokollohen aktet që vijnë në adresë të udhëheqjes së Këshillit të Ministrave personale. Dorëzimi i zarfeve u bëhet sekretarëve kundrejt firmës.

225.1. I pyetur më dt 25.11.2022 shtetasi **Oerd Bylykbashi**, me detyrë Drejtor i Departamentit Antikorrupsion në Kryeministri, se cila ka qenë procedura e arkivimit të praktikës së denoncimit dhe si shpjegohet që ky denoncim nuk gjendet në original dhe a e ka parë ai ndonjëherë originalin, përgjigjet se, *ankesa së bashku me të gjithë praktikën e kontrollit arkivohej në arkivën e Kryeministrit. Si rregull i përgjithshëm ankesa në Kryeministri duhet të vinte në original pasi nuk pranoheshin fotokopje dhe ankesa anonime. Nuk e kujton nëse e ka parë ankesën originale apo jo. Pasi është arkivuar praktika, nuk di të thotë se çfarë është bërë me dokumentacionin. Nuk di të thotë përse nuk gjendet në original.*

225.2. E pyetur më dt 25.01.2024 shtetësja **Nexhmije Jata**, deklaroi se, *ka filluar punë në Kryeministri në vitin 1979 dhe ka mbajtur pozicione të ndryshme pune. Në vitin 2006 ka filluar punë në arkivë protokollin e Këshillit të Ministrave në pozicionin e specialistes dhe vijon ta mbajë këtë pozicion edhe sot. Marrja e korrespondencës zyrtare që përfshin shkresta e ardhura nga Ministritë dhe institucionet e tjera qëndrojnë të cilat i adresohen Kryeministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrave të shtetit, protokollohen dhe ju shpërndahen sipas rastit këtyre funksionarëve të cilët i shpërndajnë sipas drejtorive dhe personat që marrin në dorëzim praktikën, janë të detyruar ta kthejnë përsëri në arkivë – protokoll brenda 40 ditëve. Në lidhje me ankesat apo denoncimet e qytetarëve drejtuar Kryeministrit, sqaron se në lidhje me trajtimin e kërkesave të qytetarëve, ankesat apo edhe denoncimet, ka qenë një sektor më vetë në Kryeministri që quhej sektori i letrave të popullit (Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun) dhe sektor/drejtori trajtonte të gjitha ankesat e qytetarëve që vinin në Kryeministri. Në dijeninë e saj dhe tek sektori i letrave, kishte vulë hyrëse dhe si rregull të gjitha letrat protokolloheshin. Në vitin 2009, tek protokollin letrave hyrëse ka qenë e punësuar shtetësja **Anduela Kroqi (Caçli)**. Duke iu referuar denoncimit të sipërcituar, deklaroi se nuk ka dijeni dhe nuk i ka rënë në dorë ndonjëherë.*

225.3. E pyetur më dt 28.02.2024, shtetësja **Anduela Kroqi**, ka deklaruar se *ka filluar punë provizore në Kryeministri në vitin 1984 në pozicionin e daktilografistes në Arbitrazhin e Lartë të Shtetit. Në vitin 1987 u emërova në Drejtorinë për Marrëdhënie me Publikun në Kryeministri ku vazhdon të punojë dhe sot edhe pse struktura nuk është e njëjtë si në vitin 1987. Në vitin 2009 ka qenë specialiste e arkiv protokollit në Drejtorinë për Marrëdhënie me Publikun në Kryeministri. Si specialiste në këtë pozicion punë merrej vetëm me letrat e popullit. Në lidhje me letrat e popullit ndiqej kjo rrugë, fillimisht bëhej hapja e zarfave që vinin nga posta, regjistroheshin në librin e protokollit dhe data hyrëse e zarfit dhe të gjitha këto dhe shoqëritë tregtare drejtuar Kryeministrit dhe Zv. Kryeministrit. E pyetur në lidhje me denoncimin e mësipërme, të muajit mars 2009, sqaron se denoncimi në fjalë nuk i kujtohet. Si rregull nëse ky denoncim ka ardhur me postë duhet të jetë hapur nga ana e saj pasi ajo ka*

qënë specialistja e vetme në atë periudhë. Ky denoncim gjithmonë nëse ka ardhur me postë hapej nga ana e tyre, vendosej numri i protokollit në shkresë, data dhe vula dhe i kalohej specialistëve në Drejtorinë për Marrëdhënien me Publikun të cilët pasi përgatitnin një Memo përmbledhëse të letrës, Memo së bashku me letrën/ denoncimin i kalohej Kryeministrit. Pasi mbarohej punë me trajtimin e ankesës/letrës ajo administrohej në protokoll së bashku me shënimet sesi kjo letër do të trajtohej sipas problematikave të përshkruara në të. Për rastin në fjalë nuk i kujtohet diçka konkrete për mënyrën sesi është vepruar. Mënyra sesi do të trajtohej ky denoncim varej nga shënimi që bënte Kryeministri dhe sipas shënimit që ai linte, letra i kalonte për trajtim Drejtorisë përkatëse. Për aq kohë sa fotokopja nuk ka asnjë shënim nuk di të thotë sesi është vepruar me këtë denoncim. Nëse denoncimi do kishte shënime është shumë e lehtë që të ndjekësh mënyrën e trajtimit dhe të administrimit të këtij denoncimi. Nuk di të thotë sesi mund të ketë hyrë në institucion për aq kohë sa nuk ka asnjë shënim.

226. Gjithashtu fakti që letra e mësipërme gjendet vetëm fotokopje sjell dyshime edhe për vërtetësinë e nënshkrimit të saj.

226.1. I pyetur më datë 22.11.2022 në lidhje me shkresën e sipërcituar, shtetasi **Ardian Llagami** është shprehur: ...Mesa shoh firma duket që është e imja, ajo që gjendet nën emrin tim, në shkresën që më tregoni, datë 30.03.2009 por nuk e kam idenë se për çfarë bëhet fjalë se kam firmosur letra në mirëbesim. Pasi e lexoj dhe e shoh me vëmendje këtë shkresë, nuk më kujtohet të kem nënshkruar një shkresë të tillë pasi unë kam firmosur aty ku kanë qenë firma të të gjithë trashëgimtarëve dhe nuk mbaj mend të kem nënshkruar kështu më vete. Personat që tjerë që kanë emrin shoh se është Igli Vaqarri të cilin e njoh pasi e kam kushëri, Artan Alimehmeti është personi që djali i Ramazanit i ka shitur tokën, por nuk e njoh personalisht, kurse Kreshnik Kaçurrin nuk e njoh dhe nuk e kam dëgjuar si emër. Nuk më kujtohet ta kem nënshkruar këtë shkresë por dua të theksoj se ndoshta kur më janë vënë para disa shkresa edhe mund të kem hedhur firmën pa e lexuar. Është e vërtetë që në atë kohë unë kisha atë lloj nënshkrimi që gjendet në shkresë por tani e kam ndryshuar. Dua të saktësoj se firma që bëri ndërtimin ishte ajo e Fatmir Bektashit, i cili është fis me ne dhe gjithashtu është trashëgimtar i familjes Vaqarri. ...Unë aktualisht kam marrë një apartament 2+1 me sipërfaqe 90 – 95 m², dy apartamente 1+1 nga 58 m² dhe një garazh. Kjo është pjesa ime që kam marrë pasi kemi lidhur kontratën e shkëmbimit me ndërtuesin, Fatmir Bektashi.

226.2. Shtetasi **Igli Vaqarri**, i pyetur më datë 22.11.2022, nëse është nënshkruar prej tij shkresa e mësipërme deklaron: “Nuk më kujtohet kjo shkresë fare. Firma në fund duket si e imja, por nuk më kujtohet ta kem nënshkruar apo jo.” I pyetur nëse e njeh shtetasin Kreshnik Kaçurri, deklaron se, e njeh vetëm si emër por nuk e di çfarë është dhe kush është. E ka dëgjuar si emër. Ardian Llagamin dhe Artan Alimehmetin i njeh si pronarë në territorin ku shtrihet Sport Klub Partizani.

Pyetjes nëse Igli vetë ose me të tjerë ka paraqitur ndonjë ankesë në Kryeministri, përgjigjet: Nuk më kujtohet. Pasi i lexohet shkresa e datës 30.03.2009 drejtuar shtetasit Sali Berisha, kryeministër me lëndë “Njoftim për keqpërdorim funksioni zyrtar”, pyetet se nga ka ardhur në dijeni në lidhje me rrethanat e pasqyruara në këtë shkresë, shtetasi Igli Vaqarri përgjigjet: Nuk e di pasi nuk më kujtohet fare kjo shkresë.

226.3. Shtetasi **Artan Alimehmeti**, i pyetur më datë 10.06.2024 deklaron: ... Pasi njihem me shkresën që ju më treguat dhe e lexoj atë, jam një milionë për qind i sigurtë se nuk e kam parë kurrë me sy këtë dokument dhe kjo është hera e parë që unë e shoh. Shkrimi në faqen e dytë ku është shënuar emër, mbiemër dhe nënshkrim i imi mesa shoh janë të miat por nuk e di se si është vendosur ky shkrim dhe ky nënshkrim i imi tek ky dokument, pasi mesa shoh dhe theksova

edhe më lart unë këtë dokument nuk e kam nënshkruar kurrë. Ju sqaroj se ne kemi pasur një përfaqësues ligjor i quajtur Blendi Marikaj dhe ai merrej me nënshkrimin e çdo dokumenti, me çështjet e Klubit Partizani. Pra unë nuk kam pasur asnjë tagër për të nënshkruar. Nënshkruesit e tjerë konkretisht Kreshnik Kaçurrin nuk e kam dëgjuar asnjëherë dhe nuk e njoh fare. Ardian Llagamin nuk e njoh fare por mbiemrin Llagami e kam dëgjuar si familje. Edhe Iglj Vaqarrin e kam dëgjuar si familje dhe më duket e kam takuar nja dy herë tek kompleksi Partizani por njihemi thjesht si fytyrë, si komshinj, nuk kemi muhabet. Dua të theksoj se kjo letër është mashtrim total, pasi unë nuk kam nënshkruar një dokument të tillë dhe do të desha të shihja dokumentin origjinal. Unë jam i sigurtë se me këta persona që rezultojnë sikur e kanë nënshkruar këtë letër unë nuk kam qenë asnjëherë i pranishëm me ta në ndonjë vend për të realizuar këtë nënshkrim dhe as të tjera gjëra, dokumenta të tjera. Marrëveshjet në lidhje me përqindje dhe me gjithçka, janë kryer nga përfaqësuesi Blendi Marika dhe unë shkoja e firmosja kur na thërriste firma. Me firmën e ndërtimit nuk jam lidhur unë, janë lidhur të tjerët por nuk e di kush e ka sjellë, nuk e mbaj mend. Fatmir Bektashin e kam njohur vonë, kur filluan të bëheshin kontratat, marrëveshjet, diskutimet. Diskutimet që ishin bërë me Fatmirin na i përcillte Blendi Marika pasi ai diskutonte me ta. Në lidhje me shtetasin Jamarbër Malltezi nuk kam ndonjë dijeni që të jetë marrë me ndërtimin. Në çdo gjë mesa di unë, si kontrata shkëmbimi etj i kemi bërë me Fatmir Bektashin. Gjithashtu di që edhe Xhimi Begeja merrej me këto punë, me diskutimet me Blendi Marikaj-n si përfaqësues i familjes Alimehmeti pasi na ka thënë vetë Blendi. ...”

226. Për këtë arsye është proceduar me kryerjen e një akti ekspertimi tekniko grafik. Ky akt me nr 5060 date 23.07.2024, ka konkluduar se dokumenti objekt ekspertimi, shkresa “Lenda: Njoftim per keqperdorim funksioni zyrtar” Tirane, 30 mars 2009 drejtuar z. Sali Berisha Kryeminister, nënshkrimet (emer-mbiemer e firma te plote e te pjesshme) ne emer te shtetasve Iglj Vaqarri, Kreshnik Kaçurri, Artan Alimehmeti dhe Ardian Llagami, duhet te jene shkruar nga shtetasit Iglj Vaqarri, Kreshnik Kaçurri, Artan Alimehmeti dhe Ardian Llagami...Nënshkrimet (emer – mbiemer e firma) ne emer te shtetasve Iglj Vaqarri, Kreshnik Kaçurri, Artan Alimehmeti dhe Ardian Llagami ne dokumentin objekt ekspertimi, ...nuk mund te konkludohet nese jane hedhur drejteperdrejte, apo te jene transferuar ne rruge elektronike nga dokument/dokumente te tjera te nënshkruara prej tyre per shkak te paraqitjes se dokumentit objekt ekspertimi ne fotokopje.

227. Në shkresë/ankesën e mësipërme, është pretenduar, **mbi një rast flagrant të keqperdorimit të funksionit, nga zyrtarë pranë Ministrisë së Mbrojtjes, duke qenë në kundërshtim të ligjit dhe mbi baza të dyshimta korruptive.** Parashtojnë se me shkresën nr. 9549/3 prot dt 14.11.2005 Ministria e Mbrojtjes i shkruan METE ku kërkon miratimin e privatizimit të objekteve dhe terreneve të Klubit të Futbollit. Përmendim Miratimi Privatizimit nr. 50 prot dt 19.09.2007 me anë të së cilës Ministria e Ekonomisë njofton Ministrinë e Mbrojtjes, për miratimin e privatizimit të objekteve. Ministria e Ekonomisë ngriti komision vlerësimi nr. 9508 prot dt 18.12.2007 ku në komisionin prej 5 anëtarësh përfshihet një anëtar nga Ministria e Mbrojtjes. Me letrën nr. 809 prot dt 26.01.2009 Ministria e Financave (Sektori i shitjeve) njofton Ministrinë e Mbrojtjes për të dërguar përfaqësues për firmosjen e proces verbalit të dorëzimit të objektit dhe kontratës përkatëse.

227.1. Pra referuar përmbajtjes së letrës së mësipërme, konstatohet qartësisht se përpiluesi i saj zotëronte të dhëna që janë marrë nga institucione, megjithëse nuk ka rezultuar e vërtetuar se këto të dhëna janë marrë në mënyrë zyrtare. Gjithashtu vërtetohet se përpiluesi i kësaj letre, është personi që ka pasur edhe dijeni në lidhje me qëndrimin që po mbante shtetasi Vladimir Qiriazi.

228. Me shkresën nr. 1161 prot datë 03.04.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, shtetasit Gjergj Lezhja, konceptuar nga shtetasi Ilir Kadiu dhe miratuar nga shtetasi Oerd Bylykbashi, drejtuar Komandantit të Forcës Mbështetëse shtetasit Vladimir Qiriazhi dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, Fiqiri Kupe, është pasqyruar ndër të tjera se, është kryer një denoncim nga familjet *Alimehmeti, Vaqarri, Saliaga, Begeja dhe Llagami*, aktualisht pronarët ligjorë të truallit të klubit të futbollit Partizani. Në këtë shkresë i bën me dije se, pranë Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në KM është kryer denoncim nga familjet *Alimehmeti, Vaqarri, Saliaga, Begeja dhe Llagami* aktualisht pronarët ligjorë të truallit të klubit të futbollit Partizani. Nga verifikimi i kryer, rezultoi se janë kryer të gjitha procedurat ligjore dhe administrative nga ana e këtyre familjeve, me qëllim privatizimin e objekteve dhe terreneve sportive në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, janë dërguar shkresa të përsëritura Ministrisë së Mbrojtjes dhe konkretisht nr. 809 datë 26.01.2009, nr. 1996 datë 20.02.2009, mbi procedurat e përfundimit të privatizimit të objektit (dorëzim dhe lidhje kontrate). Në vijim është nxjerrë urdhëri nr. 334 datë 13.03.2009 i Ministrit të Mbrojtjes i cili autorizon Komandën Mbështetëse për dorëzimin e pronës dhe nënshkrimin e kontratës për shitjen e pronës nr. 11, por përsëri nga Komanda nuk është kryer asnjë veprim, duke neglizhuar në mënyrë të pajustificuar kërkesat ligjore të institucioneve përkatëse. Në përfundim duke gjykuar se, janë shkelur haptazi dhe në mënyrë të përsëritur afatet ligjore të parashikuara në KPRA kërkojnë marrjen e masave të menjëherëshme për përfundimin e procedurave ligjore. Bazuar në VKM nr. 94 datë 15.02.2006 "Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të Ministrave" brenda 10 ditësh pas vënies në dijeni me këtë shkresë, duhet të njoftohet DKBAA për zbatimin e masave konkrete.

228.1. Siç mund të shihet, në letrën e sipërcituar drejtuar Komandës, flitet për verifikim të kryer dhe përmenden shkresa konkrete, me nr prot e datë, por nga aktet nuk rezulton në këtë fazë që të jetë kryer ndonjë verifikim nga Departamenti antikorrupsion pranë Kryeministrisë.

Në dijeni të plotë dhe në posedim të kësaj shkrese, konstatohet se ka qenë vetë shtetasi Jamarbër Malltezi. Ky shtetas, me shkresën e datës 30.05.2023 (nr 2588 prot datë 05.06.2023 hyrje në Këshillin e Ministrave) i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave ku parashtron se, është palë blerëse në procedurën e privatizimit të ish Klubit Sportiv Partizani. Me anë të shkresave nr 1161 prot datë 03.04.2009 të Këshillit të Ministrave dhe Raportit të Departamentit Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion i ka dhënë informacion Komandës Mbështetëse të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes për procedurën e mësipërme të privatizimit. ...për shkak të një procesi gjyqësor më nevojitet një kopje e njehsuar me origjinalin e këtyre shkresave. Bashkangjitur kërkesës shkresat me nr 1161 prot datë 03.04.2009 të Këshillit të Ministrave dhe Raportit të Departamentit Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion...

Bashkalidhur kësaj shkrese gjendet shkresa me nr 1161 prot datë 03.04.2009 e Këshillit të Ministrave dhe Raporti i Kontrollit dalë mbi bazë të urdhërit të kryeministrit dhe programit të kontrollit me nr 1289 datë 16.04.2009.

Përsa më sipër, tej çdo dyshimi të arsyeshëm vlerësohet e provuar se ka qenë ky shtetas që ka bërë të mundur dorëzimin e letrës/denoncim, kryeministrit të kohës shtetasit Sali Berisha. Madje interesi ka qenë aq i lartë, sa reagimi i kryeministrisë nëpërmjet departamentit antikorrupsion, përveçse ka qenë brenda katër ditëve por edhe pretendon se kryer verifikim

brenda këtij katër ditëshi, duke marrë të dhëna të detajuara si në lidhje me procedurën e privatizimit ashtu edhe me procedurat që ndiqeshin pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandës Mbështetëse.

229. Përsa i përket shtetasit **Ilir Kadiu** (i cili në bazë të shkresës nr. 108 prot datë 10.01.2008 të Sekretarit të Përgjithshëm Gjergj Lezhja, me të cilën i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, Departamentit të Administratës Publike për marrjen me kontratë të përkohshme pune, është punësuar sipas kontratës me nr. 109 datë 10.01.2008, që fillon që më datë 09.01.2008, në pozicionin e inspektorit), i cili ka qenë shtetasi, që ka konceptuar shkresën e mësipërme, konstatohet se është trashëgimtar i familjes Begeja dhe ka autorizuar shtetasin Jamarbër Malltezi për ta përfaqësuar atë vetë dhe pjestarët e familjes së tij, në lidhje me procedura të ndryshme që lidhen me pronën e tij, kundrejt edhe një shpërblimi të premtuar (shih prokurën nr. 2442 rep nr. 304 kol datë 18.05.2006).

Shtetasi Ilir Kadiu, krejtësisht në konflikt interesi, është caktuar të merret me këtë praktikë dhe siç rezulton në vijim edhe të ushtrojë kontroll, bashkë me një kolegun e tij.

229.1. I pyetur më datë 20.09.2022, shtetasi **Ilir Kadiu** ka sqaruar se: “Unë fillimisht kam punuar në Bashkinë e Durrësit si jurist në periudhën 1999 – 2001. Më pas në periudhën 2001 – 2005 kam punuar në organizata jo qeveritare ICMC, Terre des hommes. Më pas kam punuar rreth gjashtë muaj në autoritetin portual të Durrësit, më pas në kontrollin e Lartë të Shtetit 2005 – 2007, më pas në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm administrativ dhe antikorrupsion në Kryeministri, më pas kancelar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2013, më pas avokat dhe aktualisht jam në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. ... jam trashëgimtar i famjes Begeja.

Në lidhje me denoncimin e pretenduar të familjeve Alimehmeti, Vaqarri, Saliaga, Begeja dhe Llagami pretendon se ... Denoncimi ka qenë me shkrim por nuk e di përse nuk është identifikuar me nr protokollit dhe datë në këtë shkresë. Mesa më kujtohet ky denoncim është nënshkruar nga përfaqësuesit e familjeve të cituara në shkresën e sipërpërmendur. Ne kemi qenë rreth 8 apo 10 inspektorë dhe mua si praktikë në varësi të ngarkesës së punës ma jepte drejtori Oerd Bylykbashi për ta ndjekur. Në rastin konkret më është dhënë mua kjo praktikë besoj bashkë me inspektor tjetër. Në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të tijin deklarohet se... Ne së pari nuk ishim organ vendimmarrës por vetëm rekomandues dhe së dyti nuk e dija nëse ky denoncim që lidhej me dorëzimin e pronës së privatizuar, më përfshinte edhe mua si pronar pasi ne kemi shumë prona. Në lidhje me bërjen me dijeni të eprorëve mbi cilësinë e tij si trashëgimtar i familjes Begeja, pretendon se nuk i ka bërë me dijeni pasi nuk ka qenë në dijeni të faktit nëse kjo pronë e përfshinte edhe atë.

229.2. I pyetur më datë 28.09.2022 shtetasi **Gjergj Lezhja** ka deklaruar: “Që nga maji i vitit 2007 deri në shtator 2013 kam ushtruar detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. ... Shtetasi Oerd Bylykbashi ka qenë drejtor i Departamentit Antikorrupsion. Në lidhje me faktin nëse është njohur me ankesën e familjeve pronare të sipërcituar ka deklaruar se... Ankesa nuk vinte tek unë, unë thjesht e kam nënshkruar këtë shkresë si titullar....

229.3. I pyetur më datë 25.11.2022 shtetasi **Oerd Bylykbashi**, në lidhje me faktin se përse shkresa e datës 30.03.2009, nuk rezulton e protokolluar, deklarohet se shkresën në fjalë nuk e kujton por e kujton çështjen në total pasi kujton mbiemrat e familjeve trashëgimtare, të cilat i ka rastisur edhe në çështje të tjera pronash edhe si kufitar. Shkresa sigurisht që ka rënë në dorën e tij sepse mbi bazën e saj është hartuar plani i kontrollit. Shkresat ai i merrte direkt nga vasketa e tij dhe nuk i merrte me protokoll nga sekretaria. Shkresa në fjalë i është

drejtuar Kryeministrin dhe më pas u ka ardhur atyre për ndjekje si departament. I pyetur nëse ankesa i drejtohej institucionit ku do të kryhej kontroll, deklaroi se: *Nuk e kujton, nuk di ta thotë me siguri këtë gjë.* I pyetur në lidhje me pozicionin e shtetasit Ilir Kadiu, deklaroi se, *ky i fundit ka qenë inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave. Mban mend që ishte nga Durrësi pasi ishte vëllai i një shokut të deklaruesit dhe ishte me profesion jurist dhe në çështjet kur nevojiteshin njohuri juridike merrej më së shumti ai.* I pyetur se sa specialistë apo inspektorë ka pasur departamenti dhe përse për këtë praktikë është zgjedhur pikërisht shtetasi Ilir Kadiu, sqaroi se *në atë kohë, mesa kujton kanë qenë 6 inspektorë kontrolli dhe struktura ishte me mangësi. Zgjedhja e inspektorëve bëhej në bazë të ngarkesës që kishte gjithsecili nga inspektorët dhe profili i kontrollit (kontroll ekonomik ose kontroll juridik) dhe grupi i kontrollit përzgjidhej nga ana e deklaruesit. Kontrolli në fjalë është kryer nga inspektor Ilir Kadiu i cili kishte profil juridik (kontrolli që do të kryhej ishte me profil juridik) dhe Saimir Struga i cili ishte më shumë profil ekonomik. Pra inspektori Ilir Kadiu është zgjedhur prej profilit që mbulonte dhe kishte eksperiencë të mëparshme në KLSH mesa kujton.*

Referuar urdhërit të kryeministrin Sali Berisha nr. 145 datë 10.09.2007 "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së kryeministrisë*", Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit përbëhej nga 10 punonjës, nga të cilët 1 është drejtor dhe 9 janë inspektorë. Pikërisht në 9 inspektorë, konstatohet se zgjidhet pikërisht shtetasi Ilir Kadiu, në konflikt të hapur interesi me situatën në fjalë.

230. Pikërisht në këtë periudhë ka edhe një reagim nga shtetasi Albert Xhani i cili me kërkesën nr. 64 prot. datë **03.04.2009**, i cili i është drejtuar Komandës Mbështetëse dhe për dijeni Ministrin të Mbrojtjes, duke kërkuar mosmiratimin dhe refuzimin e kërkesave për kthimin fizik dhe kompensimin e pronës. Në këtë kërkesë parashtron se, *një grup specialistësh nga komanda mbështetëse kanë ardhur në ambjentet e klubit më datë 02.04.2009. ...Prej vitit 2000, në këto terrene parashtron se ka bërë shumë investime si në shifra që kapin miliona dollarë, shndërrimin e godinave rrënoja në hotel dhe ambiente të tjera funksionale të kohës për një klub futbollit, rrethimi i gjithë ambjentit i cili bëri të mundur paprekshmërinë e terreneve, krijimin e 5 fushave moderne ku sot funksionon Akademia Partizani, e vetmja e këtij lloji në Shqipëri. Njëpërmjet rrugëve jo zyrtare, disponojnë një letër të ish ministrit Mediu, me nr. prot 9549/1 datë 12.10.2005 dhe 9549/3 datë 14.11.2005 i cili i drejtohet METE për hapat e mëtejshëm që duhet hedhur për administrimin e këtij terreni për llogari të --- (ndërpritet faja e parë). I parashtron se kërkon nga Vladimir Qiriazit që krahas dokumentacionit që u nevojitet për përcjellje në institucionet përkatëse, në lidhje me privatizimin e terreneve të FK Partizanit, të përcillet çdo dokumentacion real me origjinën e tokës edhe pse i padëshirueshëm për shumë drejtues të lartë ministrish, emri dhe influenca e Partizanit do të bëjë çdo përpjekje ligjore për të nxjerrë në dritë të vërtetën e padëshiruar për shumë zyrtarë ...Me anë të rrugëve jo zyrtare, kanë siguruar disa dokumenta arkivore që hedhin poshtë pretendimin e ish pronarëve. Përmend një akt dhurimi të qeverisë italiane për disa prona. Neni 31 i ligjit nr. 9376 datë 21.04.2005 "Për sportin" parashikon se edhe nëse i referohemi ligjit të vitit 2008 për ambjentet sportive, këto terrene nuk kanë pronar dhe nuk mund të jenë objekt i AKKP-së. Ndryshimi i statusit sipas nenit 31 të objekteve sportive në varësi të pushtetit qendror a vendor, bëhet në përputhje me ligjin nr. 7926 datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare". Objektet sportive jepen me koncension apo privatizohen me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni në përputhje me ligjin nr. 7973 datë 26.07.1995 "Për kocensionet dhe pjesmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë". Pretendon se në shkresat e mëparshme, ka bashkalidhur dokumentacionin e plotë të marrë nga Arkivi i Shtetit në të cilin vërtetohet dhe*

pasqyrohet saktë se sip mbi të cilën ndodhen terrenet e objektet e KF Partizani nuk ka asnjë ish pronar dhe aq më tepër të ngrejë pretendime pronësie mbi to. Kjo pasi të gjithë pronarët që kanë pasur prona në këtë zonë janë shpronësuar për interes publik kundrejt shpërblimit nga ana e shtetit në vitet 1940 e 1941 për shkak të zgjerimit të aeroportit të Tiranës. Në këtë dokumentacion mund të gjeni listën e plotë me gjithë nënshkrimet e pronarëve që u janë shpronësuar prona kundrejt shpërblimit nga ana e shtetit.

230.1. I pyetur gjatë këtij hetimi, shtetasi **Gazmend Oketa**, në lidhje me kërkesën e mësipërme, nëse është njohur dhe nëse është marrë ndonjë masë në lidhje me faktin se prona në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes po shfrytëzohej nga një subjekt privat, deklaroi se: *...Besoj se shkresa duhet të ketë ardhur pranë meje përsa kohë është dërguar në Ministrinë e Mbrojtjes. Unë nuk e di se çfarë marrëdhëniesh ka pasur Albert Xhani me pronën në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.*

230.2. I pyetur në lidhje me kërkesën nr. 64 prot datë 03.04.2009 të shtetasit Albert Xhani, i cili referon në disa dokumenta reale në lidhje me origjinën e pronës, shtetasi **Vladimir Qiriazhi**, i pyetur përgjatë hetimit, deklaroi se: *... Unë nuk kam pasur dokumenta që lidheshin me ndonjë origjinë të vjetër të pronës. Por unë shkresës së Albert Xhanit i kam vënë shënimin përkatës për juristin: Të shikohen me kujdes dhe më përgatisni një përgjigje për Futboll Klub Partizanin si dhe një informacion për Shefin e Shtabit dhe Ministrin e Mbrojtjes për çfarë na ka ardhur. Jurist ka qenë Ahmet Roçi.*

231. Me shkresën nr. 1926 prot datë 06.04.2009 të Komandës Mbështetëse, Vladimir Qiriazhi, konceptuar kjo shkresë nga shtetasit **Nikoll Tushi dhe Ahmet Roçi**, i është drejtuar sh.a. Klubit të Futbollit Partizani, në zbatim të VKM nr. 515 datë 18.07.2003, shkresës së SHSHP të FA nr. 7883 datë 15.09.2006 *"Për marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani"* e cila mban nr. 11, kërkojnë lirin e pronës për t'u marrë në administrim nga ana e Komandës. Më datë 13.04.2009 komisioni i KM do të paraqitet për marrjen në dorëzim të kësaj pasurie sipas inventarit përkatës. Po në këtë datë, me shkresën nr 1932 prot datë 06.04.2009, shtetasi Vladimir Qiriazhi, ka ifnormuar Ministrin e Mbrojtjes shtetasin Gazmend Oketa, ku e bën me dije se, *në zbatim të urdhërit nr. 334 datë 13.03.2009 kanë marrë takim me përfaqësues të sh.a. Klubi i Futbollit Partizani dhe gjatë bisedimeve me ta, ju drejtuan zyrtarisht që brenda datës 13.04.2009 duhet të lirojnë dhe t'i dorëzojnë komandës mbështetëse pronën nr. 11. Aktualisht sh.a. klubi i futbollit Partizani, në ambjentin ku ushtron aktivitetin e tij nuk ka kontratë me Ministrinë e Mbrojtjes për përdorimin e këtyre ambjenteve.*

Me shkresën nr. 65 prot datë 07.04.2009, sërish shtetasi Albert Xhani, i drejtohet Komandës Mbështetëse dhe për dijeni Ministrin të Mbrojtjes. *Parashtron se pranë ambjenteve të tyre ka mbërritur shkresa me nr. 1926 prot datë 06.04.2009 me lëndë Njoftim për dorëzim prone. Ambjentet që kërkohen të merren në dorëzim janë në përdorim nga FK Partizani prej ndryshimit të këtij territori nga aeroport ushtarak në ambjente sportive e deri më sot. Në vitin 2000 pronësia e FK Partizani nga Ministria e Mbrojtjes ka kaluar në favor të shoqërisë Partizani sh.a. bashkë me ambjentet ku kryen aktivitetin e saj. Gjithashtu Partizani sh.a. ka kryer investime të mëdha që kapin shumën të konsiderueshme.*

232. Në këtë kohë, shtetasit **Fatmir Bektashi, Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja**, prisnin zbardhjen e lejes e cila ishte vendosur të miratohej me faza. Ky fakt, lexohet nga sjellja e vetë këtyre shtetasve. Kështu, me ankesën datë 09.04.2009, shtetasi Xhimi Begeja i është adresuar Bashkisë Tiranë, Drejtorisë së Planifikimit Urban, si përfaqësues i familjes Begeja, (ndërkohë

sjellim në vëmendje se nuk ka pasur ndonjë akt përfaqësimi por këto akte i ka pasur vetë shtetasi Jamarbër Malltezi) duke kërkuar një të drejtë të ligjshme që po u mohohet qysh prej shumë muajsh. Pronarët ligjorë të truallit në rrugën Frosina Plaku në bashkëpunim me kompaninë Kontakt kanë marrë lejen e sheshit nga KRT Tiranë me vendimin nr. 136 datë 29.12.2007. Në mbledhjen e KRT Tiranë, më datë 17.02.2008 është miratuar leja e ndërtimit duke vendosur kushtin e vetëm, që ishte privatizimi i objekteve të vjetra që ndodheshin mbi truallin privat. Ky kusht u plotësua duke u kushtuar pronarëve mbi 6 muaj kohë dhe një vlerë të madhe financiare. Kontrata e shitjes u krye më datë 04.11.2008. Siç jeni në dijeni, kompania Kontakt deri në fund të dhjetorit 2008 plotësoi të gjitha kërkesat shtesë së Bashkisë për dokumentat teknike. Që prej asaj periudhe e deri më sot, janë në pritje të ndarjes së pjesëve takuese me firmën ndërtuese por për fat të keq mësojnë se, firma ende nuk ka marrë në dorëzim formularin 4 dhe as njoftimin mbi detyrimin që duhet t'i paguajë shtetit për këtë leje, pasi nuk ka asnjë reagim nga ana e Bashkisë së Tiranës. "Nëse dëshironi që pronarët të ndërrojnë firmën ndërtuese, ju lutem na e thoni së bashku me ndonjë sugjerim përkatës". Kjo pritje u ka shkaktuar një dëm financiar të konsiderueshëm si familjeve pronare ashtu edhe firmës së ndërtimit. Ju kujtojmë se në bazë të kodit administrativ organet shtetërore janë të detyruar të kthejnë përgjigje brenda një afati që varion sipas rastit nga 2 javë deri në 1 muaj, ndërkohë që vonesa e shkaktuar nga institucioni juaj në këtë rast është jashtë të gjithë parametrave liugjore. Rrjedhimisht në mungesë të një përgjigje të shpejtë nga ana juaj në lind e drejta e zgjidhjes së këtij problemi në rrugë ligjore. Ju faleminderit për vëmendjen tuaj në këtë çështje. Përfaqësuesi i familjeve pronare.

Me kërkesën nr. 06861J prot datë 14.04.2009 K – 6822 kërkuesi Alfred Dhaskali, për llogari të shoqërisë Kontakt sh.p.k. i është adresuar Bashkisë Tiranë, ku kërkojnë që t'i dorëzohet formulari nr. 4 si dhe detyrimi që kanë për të paguar lejen e ndërtimit në emër të subjektit ndërtuesit Kontakt sh.p.k. në rrugën Frosina Plaku. Marrësi është shtetësja Adelina Gjonaj, kërkesa i adresohet Dr. Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik, bazuar në procedurat e Bashkisë së Tiranës dhe përgjigje do të merret më datë 14.05.2009.

233. Nga ana tjetër, shtetasi Vladimir Qiriazhi vijon korrespondencat e tij shkresore. Me shkresën nr. 2103 regj datë 14.04.2009 i ka kthyer përgjigje shtetasit Gjergj Lezhja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe për dijeni Fiqiri Kupe, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA Maksim Malaj, ku i parashtron në përgjigje të shkresës me nr. 1161 datë 03.04.2009 mbi zbatimin e procedurave ligjore të dorëzimit të pronës "terrenet sportive dhe objektet e KF Partizani, pronarëve të truallit", hapat e ndjekur, dhe duke specifikuar se, kjo pronë nuk është marrë asnjëherë në administrim nga Komanda Mbështetëse dhe nuk është kontabilizuar. Në përfundim i sqaron se, nuk mund të marrin pjesë në një proces dorëzimi e shitje për një pronë të cilën nuk e disponojnë sipas ligjeve në fuqi. Kjo shkresë është përpiluar nga major Ahmet Roçi.

234. Sidoqoftë shtetasi Vladimir Qiriazhi sërish duket se vijon përpjekjet për të marrë në posedim pronën pasi me shkresën nr. 2121 prot datë 15.04.2009, i adresohet sh.a. Klubit të Futbollit Partizani, duke i kërkuar që, brenda datës 21.04.2009, të sjellë pranë kësaj Komande, praktikën shkresore të shkëputjes nga MM, për formimin e sh.a. Partizanit, të gjithë dokumentacionin e plotë të ushtrimit të aktivitetit, hapat dhe ecurinë e deritanishme për privatizimin e ambjenteve të kësaj prone, bazën ligjore të cituar për këtë veprim. Mosparaqitja në kohë e këtyre dokumentave do të detyrojë komandën të ndërpresë aktivitetin e këtij klubi në pronën e komandës. Kjo shkresë është konceptuar nga Major Nikoll Tushi dhe Ahmet Roçi.

Me kërkesën nr. 69 prot datë 15.04.2009 shtetasi Albert Xhani i është drejtuar Komandës Mbështetëse dhe për dijeni Ministrit të Mbrojtjes, Gazmend Oketa duke e bërë me dije se **FK Partizani është shndërruar në shoqëri aksionere. Para dhe pas këtij momenti të shndërrimit është ndërprerë çdo ndihmë financiare që akordohej çdo vit nga Ministria e Mbrojtjes. Shoqëria në momentin e themelimit nuk ka privatizuar terrenet, por duke u bazuar në ligjet e shndërrimit të pronave shtetërore në private të azhornuara së fundmi nga ligji nr. 9235 datë 29.07.2004 shihet qartë se, çdo pronë shtetërore e administruar nga shoqëri aksionere e njohur ligjërishit e cila zhvillon aktivitetin e saj mbi prona shtetërore ka të drejtën e parablerjes së pronës. Shoqëria ka investuar prej 10 vitesh shuma në miliona euro. Zërat më kryesore kanë qenë ndërtimi i një hoteli modern 5 katësh; restaurim zyrash për administratën si dhe mobilimin e hotelit dhe zyrave, ndërtimi nga fillimi i ambjenteve të akademisë Partizani, ndërtimi nga fillimi i ambjenteve të palestrës dhe sallës së forcës, rrethimin me mur 4 m të lartë të gjithë perimetrit të terrenit, investime për krijimin e gjashtë fushave me bar natyral...FK Partizani është themeluar nga Ministria e Mbrojtjes.**

Shtetasi Vladimir Qiriazhi, i drejtohet Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, me shkresën nr. 2121/1 regj datë 15.04.2009 ku e sqaron ndër të tjera për pretendimet e sha Partizani dhe se kanë marrë takim me drejtues të sh.a. Partizani, shtetasin Genc Tomorri dhe se i kanë kërkuar dokumenta e janë në pritje. Kjo shkresë është përpiluar nga Naim Ramaj. Me shkresën nr. 2121/3 regj datë 17.04.2009, informon Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm Maksim Malaj, në lidhje me pretendimet e Partizani sh.a.

Me shkresën nr. 2121/4 prot datë 17.04.2009, shtetasi Vladimir Qiriazhi i është drejtuar ZVRPP ku i kërkon arsyet e mosregjistrimit të pronës.

235. Duket se kjo sjellje e shtetasit Vladimir Qiriazhi ka sjellë alarmim në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi me **tre shkresa të së njëjtës datë**, datë 16.04.2009, Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimit dhe Burimeve të Mbrojtjes, shtetasi Ardian Shashaj, i është drejtuar Komandës Mbështetëse dhe për dijeni Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa dhe Sekretarit të Përgjithshëm Fiqiri Kupe.

Me shkresën nr. 2326/1 prot datë 16.04.2009 kërkojnë që të informohen lidhur me vazhdimin e procedurave të përcaktuara në titullin administrativ pasi afati që kanë vënë në shkresën e vetë është tejkaluar dhe me shkresën nr. 2085/1 prot datë 16.04.2009 ku parashtron se është prononcuar lidhur me zbatimin e urdhërit nr. 334/2009 me shkresat 1939/1 datë 31.03.2009, nr. 2084/1 datë 31.03.2009, nr. 2147/1 datë 31.03.2009 dhe nr. 587/1 datë 09.03.2009. Për këtë arsye kërkon që të vazhdohen procedurat në përputhje me urdhërin.

Me shkresën nr. 2084/2 prot datë 16.04.2009 parashtron se **Komanda Mbështetëse nuk ka zbatuar urdhërin e lartëpërmendur. Ky urdhër vlerësohet sipas kësaj shkrese, urdhër ekzekutiv. Argumentat ligjorë që DMIBM ka paraqitur në të gjitha rastet janë si vijon: ...lidhur me mënyrën e shitjes dhe ngritjen e komisionit të ankandit, VKM në pikën 28 përcakton midis të tjerash, pjesmarrjen e përfaqësuesit të organit që ka në administrim objektin që në këtë rast është Komanda Mbështetëse, në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes dhe në mbështetje të të gjithë dokumentave strategjike në fuqi të Ministrisë së Mbrojtjes.**

Shtetasi Ardian Shashaj, i pyetur më datë 23.01.2024 ka deklaruar se, shkresat nuk përpiloheshin dhe as konceptoheshin prej tij. Kjo shkresë është përpiluar dhe konceptuar nga shtetësja Erinda Ndroqi. Klubi i Futbollit Partizani ishte në adminsitrim të Ministrisë së

Mbrojtjes por Komanda që e kishte në varësi ishte Komanda Mbëhstetëse dhe për këtë arsye dorëzimi duhej të bëhej prej saj. Sipas tij dorëzimi i kësaj prone nuk nisi kur ai filloi punë. Mesa i kujtohet i është thënë nga sektori i pronës që ishte një problem që kishte më shumë se një vit. Nuk ka vënë re asnjë nxitim për dorëzimin e kësaj prone dhe as interesim të veçantë. Ka punuar në pozicionin e sipërcituar në Ministrinë e Mbrojtjes pas ngjarjes së Gerdecit dhe 80% e punës së tij lidhej me mënyrën industriale të demontimit të armëve dhe okupimi më i madh ka qenë me këtë sektor. Shtetasin Jamarbër Malltezi deklaroi se nuk e njeh dhe nuk është takuar me të, vetëm si emër e ka dëgjuar në media kurse shtetasin fatmir Bektashi e ka njohur nga fakulteti sepse ka përfunduar studimet për inxhinier mekanik një vit para deklaruesit. E njeh dhe e përshendet nga larg por nuk ka lidhje shoqërore dhe as ndonjë marrëdhënie biznesi me të.

Shtetësja Erinda Ndroqi, e pyetur më datë 25.01.2024, ka deklaruar se, në Ministrinë e Mbrojtjes ka filluar punë në amjt tetor ose nëntor 2007, në sektorin e privatizimit, ku ishte vetëm një specialiste e quajtur Natasha hroni. Drejtori i tyre mesa kujton ka qenë shtetasi Maliq Xhebra. Sektori i privatizimit kur ajo ka filluar punë, praktikisht nuk merrej me asgjë, ka qenë një sektor që kishte kishte korrespondencë me Ministrinë e Ekonomisë për pronat që dilnin në privatizim. Ka qenë një situatë e paqartë sepse pronat në atë periudhë ishin në inventarin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe zyra e inventarizimit ishte tjetër. Ajo personalisht asnjëherë nuk e ka kuptuar nëse zyra e inventarizimit ishte në varësinë e tyre apo në varësi të Shtabit të Përgjithshëm. Sipërfaqja e pronave në atë periudhë ishte ende e përcaktuar me hapa dhe jo në mënyrë të saktë, domethënë ka patur shumë mangësi në përcaktimin e sipërfaqeve të pronave. Mesa kujton ka qëndruar në këtë pozicion pune deri në vitin 2009-2010 ku më pas e kanë transferuar në një strukturë ushtarake.

Shtetasin Roland Llazarri e ka gjetur në sektor kur ka filluar punë në Ministrinë e Mbrojtjes, mesa kujton ai ka qenë përgjegjës i sektorit të inventarizimit. Shtetasin Ardian Shashaj e ka patur Drejtor në drejtorinë e Menaxhimit dhe Instalimit të Burimeve të Mbrojtjes dhe ajo me Roland Llazarin kanë qenë në varësinë e këtij Drejtori. Shtetasin Fiqiri Kupe nuk e kujton. Shtetasin Besnik Dervishi e mban mend se ka qenë Drejtor Kabineti i Ministrisë. Takimi në fjalë nuk i kujtohet. I kujtohet që ka patur një problematikë dhe debate në lidhje me Klubit e Futbollit Partizani dhe Klubin Shumësportësh Patizani. Drejtorja e saj nuk ka patur asnjë lloj dokumentacioni në lidhje me këtë pronë, inventarin e pronave nuk e kishin si drejtori dhe nuk mban mend të jetë bërë ndonjë procedurë në lidhje me këtë pronë për aq kohë sa ka qenë ajo në këtë drejtori. Nuk mban mend të jetë diskutuar ndonjëherë që këtë pronë ta kishte Ministria e Mbrojtjes në administrim. Gjithmonë çështja trajtohej sikur kjo pronë ishte në administrim të strukturave ushtarake, por ajo ka qenë punonjëse e re dhe nuk ishte shumë e qartë për këtë çështje. Asnjëherë nuk e ka kuptuar se cila ka qenë procedura për këtë pronë. Të paktën edhe nga specialistët në sektor thuhej që prona ishte e Shtabit të Përgjithshëm nuk ishte e Ministrisë së Mbrojtjes. Nuk ka kuptuar nëse ka qenë e regjistruar apo janë bërë tentativa për ta regjistruar dhe as në lidhje me planin e përhapjes nëse ka qenë apo jo në planin e përhapjes.

236. Pa u pritur më përgjigje nga Komanda Mbështetëse, në të njëjtën ditë që janë dërguar tre shkresat e mësipërme për Komandën Mbështetëse, pra më datë **16.04.2009**, nga ana e drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimit dhe Burimeve të Mbrojtjes, shtetasi Ardian Shashaj, ditë që mesa duket ka pasur një angazhim të theksuar dhe këmbëngulje të madhe për marrjen në dorëzim të Klubit të Futbollit Partizani, rezultoi se ka një reagim të menjëhershëm nga Kryeministri Sali Berisha, i cili më datë **16.04.2009** nxjerr urdhërin Nr. 1289 Prot, "Mbi kontrollin tematik në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës me Nr.11, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes".

Sipas VKM nr. 94 datë 15.02.2006 "Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave", periudhë kur kryeministër ka qenë shtetasi Sali Berisha, parashikohet se: ... 4. Departamenti ka këto të drejta dhe përgjegjësi: ...ç) ndjekjen dhe zbatimin e detyrave, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave apo nga Kryeministri; 6. Departamenti kryen detyrat e kontrollit dhe verifikimit në institucionet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi: a) sipas një grafiku dhe plani pune, të miratuar nga Kryeministri; b) për raste të veçanta, me urdhër të Kryeministrit ose me porosi të tij...

Përsa më sipër, qartësisht evidentohet se ky ka qenë një kontroll për rast të veçantë, i kryer mbështetur në interesimin personal të Kryeministrit Sali Berisha, mbi një procedurë që lidhej drejtëpërdrejtë me dhëndrrin e tij shtetasin Jamarbër Malltezi. Në rastin konkret, rezulton më se e dukshme, se shtetasi Sali Berisha, ka përdorur funksionin e tij si Kryeministër, për të ushtruar presion ndaj Komandës Mbështetëse, nëpërmjet një kontrolli, që nga kjo e fundit të merrej në administrim prona dhe të dorëzohej duke u nënshkruar edhe kontrata e shitjes.

Drejtori Oerd Bylykbashi, mbështetur në konceptimin e bërë nga shtetasi Ilir Kadiu, ka përgatitur programin e kontrollit me nr. 1289 prot datë 16.04.2009, i cili në vijim rezulton të jetë miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm Gjergj Lezhja.

236.1. I pyetur më datë 28.09.2022, shtetasi **Gjergj Lezhja** ka deklaruar: "... Nga shkurti i vitit 2006 me vendim qeverie është miratuar rregullore e Departamentit Antikorrupsion. Aty përcaktohen qartë detyrat e sekretarit të përgjithshëm, detyrat e departamentit, si bëhet kontrolli, nga kush iniciohet dhe pas kontrollit si bëhet akti i kontrollit, i çohet dikastereve dhe përfundimisht ky akt kontrolli është sugjerues për çdo dikaster dhe ent shtetëror, i cili i zbaton apo jo detyrat që merr përsipër t'i zbatojë. Në këtë rregullore detyra e Sekretarit të Përgjithshëm është krejt periferike që do të thotë se duke qenë unë menaxheri i gjithë administratës patjetër që gjithë shkresat dilnin me firmën time por ato përgatiteshin në departament nga drejtuesi i këtij departamenti. Në kontroll në dijeninë time shkonin për kontroll dy persona. Për rastin konkret nuk më kujtohet gjë. Urdhëri i kontrollit nuk dilte nga sekretari i përgjithshëm. Drejtori i departamentit sillte tek unë shkresën për aktin e kontrollit. Unë nënshkruaja kur fillonin kontrollin. Në fund kur bëhej akti i kontrollit përsëri ato vinin rezultatet e kontrollit tek unë dhe me shkresë përcjellë i shkonin dikasterit/institucionit përkatës ku ishte kryer kontrolli. Unë nuk dija as pse kontrollohej. Nëse Kryeministri njihej me rezultatet e kontrollit, përgjigjet: ...Patjetër që njihej.

236.2. I pyetur më datë 25.11.2022, shtetasi **Oerd Bylykbashi** ka deklaruar se: Mënyra e funksionimit të Departamentit rregullohej nga VKM nr. 94 e vitit 2006 e cituar edhe në aktet e mbajtura...Departamenti autorizohej të bënte kontroll të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion në çdo organ të administratës qendrore dhe ndërmarrje shtetërore me kapital shtetëror. Në pushtetin vendor dhe institucionet e pavarura nuk ndërhyhej. Nga ana e Departamentit në përfundim të raportit nxirreshin vetëm rekomandime. Në përgjithësi puna fillohej me ankesa nga qytetarë ose institucionet që kishin konstatuar parregullsitë dhe në bazë të ankesës nxirrej një urdhër kontrolli me firmë të Kryeministrit. Pjesa më e madhe e ankesave lidheshin me çështjet e pronësisë dhe tenderave të cilat hetoheshin në bazë të kapaciteteve që kishte Departamenti. Në momentin që nxirrej urdhëri i Kryeministrit, hartohej plani i kontrollit i cili i dëgrohej me shkresë institucionit ku do të kryhej kontrolli i cili vihej në dijeni për planin e kontrollit që do të ushtrohej, më pas ekipi i kontrollit shkonte në institucion ku merrte dokumentat e nevojshme për të kryer kontrollin. Inspektorët që kryenin kontrollin kishin një lloj

autonomie në ushtrimin e detyrës së tyre deri në përpilimin e aktit të kontrollit të cilin ia paraqisnin. Akti i kontrollit i dërgohej institucionit i cili bënte observacionet dhe pasi shqyrtoheshin observacionet hartohej raporti i kontrollit me firmën e deklaruesit si drejtor departamenti. Raporti i kontrollit i cili përfshinte edhe përgjigjet për observacionet i dërgohej përsëri institucionit ku ishte kryer kontrolli me shkresë përcjellëse ku i kërkohej institucionit që brenda një afati 10 ditor duhet t'i njoftonte për zbatimin e rekomandimeve. Në rast se nuk merrej përgjigja brenda afatit i dërgohej përsëri shkresë institucionit për të marrë një përgjigje nëse kishin nisur ndonjë procedurë për ndjekjen e rekomandimeve.

237. Pa u pritur tashmë kryerja e kontrollit nga Departamenti Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm shtetasi Maliq Xhebra, informon Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, shtetasin Fiqiri Kupi, në lidhje me auditimin e Ministrisë së Mbrojtjes sipas programit të punës nr 8993 datë 27.11.2008, megjithëse në këtë kohë, ende nuk rezultonte ndonjë raport përfundimtar mbi këtë auditim. Kështu, me shkresën nr. 981 prot datë 17.04.2009 me lëndë "Dërgim informacioni për marrje në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani", parashtron: "Gjatë misionit të auditimit të plotë të ushtruar në Komandën Mbështetëse, sipas programit të punës nr. 8993 datë 27.11.2008, miratuar nga Ministri i Mbrojtjes dhe sipas porosisë suaj, në auditimin e bilancit, u konstatua se ... Opinionit i auditit, është se Komanda Mbështetëse pavarësisht mungesës së dokumentacionit kontabël dhe pikës së kontaktit me ish administruesit, bazuar në ligjin nr. 9642 datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" duhet të merrte në dorëzim, me komision, duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën, sipas gjendjes në fakt, veprim i cili nuk është kryer edhe aktualisht. Z. Sekretar. Problemi është trajtuar edhe në projekt raportin e auditimit të mbajtur në Komandën Mbështetëse, në përfundim të auditimit të plotë të ushtruar në këtë institucion dhe i është rekomanduar marrja e pronës në dorëzim, sipas kërkesave ligjore. Gjithashtu përgjegjësitë dhe masat e propozuara nga auditimi do të trajtohen në raportin final dhe urdhërin përkatës të mbylljes së misionit të auditimit". Me memon datë 11.06.2009 drejtuar Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm Fiqiri Kupe, nga drejtori Bardha Kola "Memorandum (Përmbledhje e raportit final) i auditimit të plotë të ushtruar në Komandën Mbështetëse (Reparti Ushtarak nr 4001) Tiranë", ndër të tjera parashtron: "...Nga verifikimi i zbatimit të shkresës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr 7883 datë 15.09.2006 "Për marrje në administrim dhe regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani, rezultoi se nuk ishte realizuar, për të cilën u la detyrë për zbatim...."

238. Me shkresën nr. 1932/4 regj datë 21.04.2009 shtetasi Vladimir Qiriaz, i drejtohet Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, ku e pyet se kush e administronte këtë pronë deri në 15.09.2006, kush ia ka dhënë në administrim ose me qera sh.a. Partizani, pasi KF Partizani dhe më vonë sh.a. Partizani ka shumë vite para kësaj date që është i vendosur në këto ambiente e terrene sportive. Në zbatim të ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, neni 13 thekson se, Këshilli i Ministrave cakton organin shtetëror përgjegjës për administrimin e çdo e njësie të pronës së paluajtshme duke bërë shënimin përkatës në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për privatizimin e pronës Komanda Mbështetëse nuk ka marrë pjesë në komisionin e vlerësimit të pronës shtetërore sipas VKM nr. 794 datë 21.11.2007. Nuk kanë marrë pjesë në ndonjë komision vlerësimi për ankandin, pavarësisht se këtu nuk bëhet fjalë për ankand.

239. Me shkresën dt 24.04.2009 shtetasi Gjergj Lezhja, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit

të Ministrave, i ka kërkuar shtetasit Vladimir Qiriazit, të verë në dispozicion të grupit të kontrollit, fotokopje të njehsuar me origjinalin, të gjithë praktikës që kanë në lidhje me pronën, në kuadër të kontrollit, nga departamenti i kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion. Shtetasi Vladimir Qiriazit ka informuar me shkresën nr 2205/2 regj datë 24.04.2009 Ministrin e Mbrojtjes Gazmend Oketa, mbi paraqitjen në Komandën Mbështetëse të inspektorëve Ilir Kadiu dhe Saimir Struga dhe vijon me parashtrimet, që kjo pronë nuk është marrë në administrim nga Komanda Mbështetëse, dhe nuk kanë pasur përfaqësues në procedurat.

240. Nga ana tjetër, konstatohet se vijohet me këmbëngulje të kërkohet pranë Bashkisë Tiranë, zbardhja e lejes së ndërtimit. Me kërkesën nr. 07889J prot datë 29.04.2009 k – 7888 drejtuar Bashkisë Tiranë, nga kërkuesi Fatmir Bektashi (Alfred Dhaskali), është kërkuar t'i vihet në dispozicion llogaritja e detyrimit të pagesës së taksës, për objektin me leje ndërtimi, të miratuar më datë 17.02.2008 në favor të subjektit ndërtues Kontakt sh.p.k. në vijim të kërkesave me nr prot K-6822 datë 14.04.2009 dhe datë 09.04.2009.

241. Inspektorët e Departamentit Antikorrupsion pranë Kryeministrit, konkretisht shtetasit Ilir Kadiu dhe Saimir Struga, mbajnë aktin e kontrollit datë 04.05.2009. Në këtë të fundit është pasqyruar se, me shkresën nr. 9549/3 prot datë 14.11.2005 të Ministrit të Mbrojtjes i është propozuar METE propozimi i miratimit të privatizimit të objekteve dhe terreneve të Klubit të Futbollit Partizani dhe ky propozim për privatizim është miratuar nga METE me shkresën nr. 50/1 datë 19.09.2007. Në zbatim të VKM nr. 794 datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transferohet dhe për procedurën e shitjes" më datë 18.12.2007 është ngritur komisioni i vlerësimit për privatizimin e terreneve sportive dhe objekteve të Klubit të futbollit Partizani. Me shkresën nr. 6120/1 datë 22.07.2008 METE ka dërguar për privatizim dokumentacionin e vlerësimit, për këtë objekt, në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Kjo drejtori, në zbatim të VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" kapitulli III, pika 29 dhe kapitulli IV, pika 5 i ka kërkuar MM me shkresën nr. 809 datë 26.01.2009 përfaqësues të kësaj ministrie me qëllim përfundimin e procedurës së privatizimit për dorëzimin dhe lidhjen e kontratës. Në zbatim të detyrimeve që ka MM në këtë proces, nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, është përgatitur korrespondenca shkresore (memo dhe autorizimi përkatës) që datojnë më datë 01.02.2009 drejtuar Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Kjo praktikë është dërguar pranë SHPFA pasi ky objekt, është jashtë planit të përhapjes së miratuar nga Presidenti me shkresat 638/2 dhe 638/4 datë 29.08.2007 dhe me detyrën e shefit të SHPFA, të vendosur me shkresën me nr. 7883 datë 15.09.2006 ngarkohet Komanda Mbështetëse për marrje në administrim të kësaj prone. Në vijim pasqyrohet se Komanda Mbështetëse, me inisiativën e saj ka ndërprerë procedurat për regjistrimin e pronës dhe ndërprerja e këtyre procedurave si dhe heqja nga administrimi i pronës është kompetencë e SHPFA. Përsa më sipër, gjejnë përgjegjës shtetasin Vladimir Qiriazit për veprime të kryera në kundërshtim me ligjin nr. 6942 datë 28.12.1984 si dhe VKM nr. 70 datë 11.03.1985 "Për evidentimin, ruajtjen, administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare", Kreu II, neni 5, 6 i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Me urdhërin nr. 334 datë 13.03.2009 MM ka urdhëruar Komandën Mbështetëse të përfaqësojë Ministrinë e Mbrojtjes në dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes për pronën. Argumentimet për moszbatimin e urdhërit janë të pabazuara ligjrisht. Komanda jo vetëm që duhet ta kishte marrë në administrim këtë pronë por nuk duhej të lejonte që të shfrytëzohej nga një subjekt privat që nuk ka asnjë marrëdhënie juridike me institucionet që e administrojnë këtë pronë. Mosadministrimi dhe mosvjelja e të ardhurave, nga shfrytëzimi i

pronës nr. 11, ka sjellë fitim të munguar për buxhetin e shtetit, çka ngarkon me përgjegjësi Vladimir Qiriazin. Në këto kushte moskryerja e veprimeve të mësipërme bie në kundërshtim me kreun IV, neni 11, 12 gërma a, c e ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", neni 19 pika 2 të ligjit nr. 8671 datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të R.Shqipërisë". Komanda Mbështetëse si organi që juridikisht administron këtë pronë dhe me tagrin e institucionit administrues dhe përfaqësues të MM për dorëzimin e objektit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" kapitulli III, pika 29 dhe kapitulli IV pika 5 si dhe kapitulli IV pika 1. Komanda Mbështetëse në zbatim të VKM duhej të kishte dorëzuar objektin brenda afateve ligjore, pasi zvarritja e mëtejshme e kësaj procedure ngarkon me detyrim financiar buxhetin e shtetit kur referuar n. 8 pika 1 gërma "a) e ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave" shteti detyrohet t'i paguajë qera deri në dorëzim ish pronarëve."

241.1. I pyetur më datë 20.09.2022 shtetasi Ilir Kadiu në lidhje me faktin nëse duhet të evidentonin nëse kishte shkelje që Ministria e Mbrojtjes kishte caktuar përfaqësues të saj dhe jo Komanda Mbështetëse në Komisionin e Vlerësimit, si dhe pasur parasysh faktin që kishin gjetur shkelje se mosadministrimi dhe mosvjelja e të ardhurave nga shfrytëzimi i pronës për Komandën Mbështetëse që duhet ta kishte marrë nga viti 2006 në administrim, por nuk kanë gjetur shkelje për Ministrinë e Mbrojtjes nga viti 2003 kur ka dalë VKM që e ka lejuar këtë pronë të shfrytëzohet nga të tretë dhe cili ishte qëllimi që i kërkohej me ngulm Komandës Mbështetëse dorëzimi i pronës dhe jo Ministrisë së Mbrojtjes, deklaroi se: ... Ne kemi parë që Komanda Mbështetëse duhet ta kishte marrë këtë pronë dhe objekt i kontrollit tonë ishte vetëm marrja në dorëzim dhe dorëzimi i pronës. Të tjerat nuk kanë qenë objekt i kontrollit tonë. Dua të shtoj se Saimir Struga në dijeninë time është në Amerikë. ...

241.2. Me shkresën nr. 2464/1 regj datë 08.05.2009, shtetasi Vladimir Qiriaz i ka parashtruar **observacionet e veta** mbi akt kontrollin e datës 04.05.2009 duke ia drejtuar Këshillit të Ministrave, Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion. Ndërmjet të tjera në këto observacione sjell në vëmendje se, Ministria e Mbrojtjes, ka nxjerrë urdhërin nr. 729 datë 16.05.2007 "Për dhënien me qera ose enfiteozë të pronave mbi e nëntokësore në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes" pika 5 që dhe për objektet me sip deri 200 m2 duhet të merret miratimi në DMIBM.

Gjithashtu me shkresën nr. 2464/2 prot datë 08.05.2009 Vladimir Qiriaz i ka përcjellë Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Maksim Malaj, kopje të akt kontrollit dhe observacionet.

241.3. Me shkresën nr. 1289/2 prot datë 19.05.2009 Këshilli i Ministrave e konkretisht Sekretari i Përgjithshëm Gjergj Lezhja (konc nga Ilir Kadiu dhe nënshkruar nga drejtori Oerd Bylykbashi), ka dërguar raportin e kontrollit pranë Ministrisë së Mbrojtjes Gazmend Oketa dhe Komandantit Vladimir Qiriaz i.

Në këtë raport kontrolli, është pasqyruar: ...u ushtrua kontroll në Ministrinë e Mbrojtjes mbi zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative në dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës nr. 11 në përgjegjësi administrimi të këtij institucioni. Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të kontrollit, rezultoi se: ... Komanda Mbështetëse jo vetëm që duhej ta kishte marrë në administrim këtë pronë por nuk duhej të lejonte që të shfrytëzohej nga një subjekt privat që nuk ka asnjë marrëdhënie juridike me institucionet që administrojnë këtë pronë. **Theksojmë se Komanda Mbështetëse me**

mosveprimet e saj dhe pengesat artificiale ka favorizuar subjektin privat që në mënyrë të paligjshme ka uzurpuar pronën në fjalë. Komanda Mbështetëse kundërshton pa argumenta ligjorë detyrat dhe urdhërat e Ministrisë të Mbrojtjes dhe të SHPPFA-së që bëjnë fjalë për administrimin e pronave pasi në listën e investuarit është edhe prona e KF Partizani në administrim të KM-së. Mosadministrimi dhe mosvjelja e të ardhurave nga shfrytëzimi i pronës nr. 11 ka sjellë një fitim të munguar për buxhetin e shtetit çka ngarkon me përgjegjësi komandantin e Komandës Mbështetëse z. Vladimir Qirjazi. Në këto kushte moskryerja e veprimeve të mësipërme duke cënuar interesat e shtetit në administrimin e pronës publike bien në kundërshtim me kreu IV, nenin 11, 12 gërma a, c të ligjit nr. 8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", nenin 19 pika 2 të ligjit nr. 8671 datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të FA-së të R.Shqipërisë". Urdhëri nuk 334 datë 13.03.2009 i Ministrisë të Mbrojtjes në zbatim të K.Pr.Administrative dhe nenit 17 të Rregullores së funksionimit të Ministrisë së Mbrojtjes (...nga tërësia e akteve që sjellin pasoja juridike nëpërmjet të cilave formohet dhe manifestohet vullneti i MM si dhe ekzekutimi i këtij vullneti...) përbëjnë aktet administrative të MM. Komanda Mbështetëse si organ të cilit i janë deleguar kompetencat nga autoriteti përkatës ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 KPRA mbi afatet kohore të zbatimit të akteve administrative duke tejkaluar afatet në mënyrë të paargumentuar ligjërisht për zbatimin e urdhërit të sipërcituar. Komanda Mbështetëse si organi që juridikisht administron këtë pronë dhe me tagrin e stitucionit administrues dhe përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes për dorëzimin e objektit, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" kapitulli III, pika 29 dhe kapitulli IV pika 5 si dhe Kapitulli IV pika 1 "Detyrat dhe të drejtat për zbatimin e këtij vendimi" "Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave (Drejtorisë së Administrimit dhe shitjes së pronave publike) dhe drejtori i ndërmarrjes, janë të detyruar të përfundojnë dorëzimin me proces verbal, të objektit që privatizohet brenda 35 ditëve nga data e dhënies së autorizimit nga Ministria e Financave Blerësit". Komanda Mbështetëse, në zbatim të VKM së sipërcituar, duhej ta kishte dorëzuar pronën nr. 11 brenda afateve ligjore që parashikon ky vendim. Duhet të theksojmë se Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 9549/3 datë 14.11.2005 drejtuar METE-së e ka konfirmuar faktin që nuk e përdor më këtë pronë pasi ka mbetur jashtë destinacionit të veprimtarisë së saj, duke i kërkuar kësaj Ministrie privatizimin e objekteve dhe terreneve të pronës nr. 11. Në këtë mënyrë pas kryerjes së gjithë procedurës së privatizimit konform legjislacionit përkatës, faza përmbyllëse e këtij procesi siç është akti i dorëzimit të pronës nga ky institucion mbetet një akt formal në kuptimin procedural të tij. Në përfundim, duke konstatuar se palët blerëse të cilat gëzojnë të drejtën e parablerjes së objektit në këtë procedurë privatizimi janë pronarët e trullit (subjektet ankuese pranë DKBAA-së) të cilët prej vitit 2007 e kanë regjistruar këtë truall në ZRPP Tiranë, rezulton se "Zvarritja e mëtejshme e kësaj procedure ngarkon me detyrim financiar buxhetin e shtetit, ku referuar nenit 8 pika 1 gërma a të ligjit nr. 9235 datë 29.07.2004 i ndryshuar "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" citohet se: Kur ndërtesat në pronësi të pronarit shtet nuk përdoren më për interes publik, trualli i kthehet subjektit të shpronësuar, duke i njohur atij të drejtën e parablerjes së objektit në privatizim. Deri në privatizimin e objektit, sipas këtij ligji shteti detyrohet t'i paguajë subjektit të shpronësuar çmimin e qerasë për truallin që ka në posedim sipas tarifave që zbaton për dhënin me qira të trojeve shtetërore të tretëve". Përsa më sipër, bazuar në VKM nr. 94 datë 15.02.2006 "Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave" rekomandojmë:

1. Komanda Mbështetëse në zbatim të VKM nr. 1638 datë 17.12.2008 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes" kapitulli III, pika 29 si dhe në zbatim të urdhërit nr. 334 datë 13.03.2009 të

Ministrit të Mbrojtjes të përfundojë procedurat e dorëzimit të pronës nr. 11 brenda 5 ditëve

- 2. Ministri i Mbrojtjes të fillojë menjëherë procedurat disiplinore për z. Vladimir Qiriazin me detyrë Komandant i Komandës Mbështetëse për shkeljet e konstatuara në këtë raport kontrolli,*

Bazuar në VKM nr. 94 datë 15.02.2006 "Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion të Këshillit të Ministrave" për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme të njoftohet zyrtarisht Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion pranë Këshillit të Ministrave brenda 10 (dhjetë) ditëve.

Shtetasi Vladimir Qiriazin, me shkresën Nr. 2867/2 Regj. datë 22.05.2009 i ka kthyer përgjigje Këshillit të Ministrave, Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në lidhje me Raportin Kontrollin, ku ka konstatuar se, *ky raport është tendencioz dhe i paargumentuar, pasi kërkon të përligjë zbatimin e një detyre dhe urdhëri aspak ligjor dhe nuk janë marrë parasysh observacionet e argumentuara ligjërisht. Në përmbajtje ai ka sqaruar se në bazë të VKM Nr. 515, datë 18.07.2003 ...është inventarizuar prona Nr.11, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe jo Komandës Mbështetëse. Prona me Nr.11 është dërguar për privatizim me shkresën Nr.9549/3 Prot, datë 14.11.2005 të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka dalë nga plani i përhapjes me shkresat Nr. 638/2 dhe 638/4 datë 29.08.2007, pra prona ka dalë në privatizim duke qënë në planin e përhapjes. Në gjithë përmbajtjen e shkresës Komanda Mbështetëse refuzon dorëzimin e pronës pasi kjo pronë nuk është marrë asnjëherë në administrim nga Komanda Mbështetëse. Në shkresën e komandës Mbështetëse janë specifikuar të gjitha korrespondencat që kjo Komandë ka patur me Ministrinë e Mbrojtjes në lidhje me problematikat që ka hasur për marrjen në administrim të pasurisë, për regjistrimin e pasurisë në ZVRPP Tiranë, shkresat me anë të të cilave i ka kërkuar Ministrisë së Mbrojtjes mendim dhe ndihmë të specializuar juridike. Kjo shkresë është konceptuar nga n/kol Naim Ramaj dhe major Ahmet Roçi.*

241.3.1. I pyetur më datë 25.11.2022, shtetasi **Oerd Bylykbashi**, në lidhje me faktin se përse është evidentuar si shkelje vetëm mosmarrja në administrim nga Komanda Mbështetëse e objekteve dhe terreneve sportive dhe jo shkelje të tjera deklaroi se, *objekti i kontrollit nuk ka qenë as procedura e privatizimit dhe as kontrata e blerjes pasi kjo procedurë ishte mbyllur, por objekti nuk ishte dorëzuar. Komanda Mbështetëse ka pasur një urdhër të vitit 2006 nga Ministria e Mbrojtjes për marrjen në administrim të kësaj prone. Komanda Mbështetëse deri në vitin 2006 dhe ta kishte marrë në administrim këtë pronë pavarësisht procedurës së privatizimit. Nuk kanë kontrolluar linjën e brendshme që ka ndjekur Ministria e Mbrojtjes për këtë çështje.*

I pyetur nëse e ka njohur shtetasin Jamarbër Malltezi në vitin 2009 dhe nëse ka qenë në dijeni që ky ishte një nga trashëgimtarët e familjeve që kishin privatizuar objektet e sipërcituara, deklaroi se, *me shtetasin Jamarbër njihet prej shumë vitesh si shokun e një kushëririt të tij në Durrës, prej shkollës tetë vjeçare. Nuk ka pasur dijeni në atë kohë që ishte një nga trashëgimtarët në pronën nr. 11 dhe as mbiemri nuk lidhej me çështjen. ...*

I pyetur nëse e ka ditur që shtetasi Ilir Kadiu ka qenë gjithahstu një nga trashëgimtarët e familjeve përfituese që kanë kryer këtë privatizim deklaroi se, *nuk ka patur dijeni. Edhe mbiemri i tij nuk i thoshte gjë dhe nuk e mendonte që mund të ishte pronar në Tiranë.*

241.3.2. I pyetur gjatë këtij hetimi, shtetasi **Gazmend Oketa**, nëse është njohur me raportin e vlerësimit të përgatitur në kuadrin e privatizimit, më datë 1.06.2008, deklaroi se ... *Nuk më kujtohet të jem njohur me këtë raport vlerësimi*. I pyetur pasur parasysh faktin se Klubi i Futbollit Partizani, duke qenë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, a ka qenë i inventarizuar dhe cila drejtori merrej me pronat e Ministrisë së Mbrojtjes, përgjigjet: *Në Ministrinë e Mbrojtjes ka pasur strukturë të posaçme që merrej me pronat në administrim ashtu si edhe Shtabi i Përgjithshëm ka pasur një strukturë përkatëse që është Komanda Mbështetëse. Strukturat që mund të ishin, siç thamë drejtoria përkatëse në Ministrinë e Mbrojtjes apo Shtabi i Përgjithshëm, administronin pronat në varësi të funksionit që këto të fundit kishin*.

242. Sjellim sërish në vëmendje, se me shkresën nr. 2588 prot datë 05.06.2023 (hyrje në Kryeministri) rezultoi se shtetasi Jamarbër Malltezi, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Ministrave, duke kërkuar kërkesën me nr. 1161 prot datë 03.04.2009 të Këshillit të Ministrave dhe Raportin e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsion të njehsuara me origjinalin duke bashkalidhur kopje të këtyre akteve. Ai rezultoi të ketë disponuar pra edhe raportin e kontrollit, para se ta kërkonte zyrtarisht.

243. Po në këtë periudhë, konstatohet se edhe Ministria e Mbrojtjes konkludon raportin e saj të kontrollit. Kështu me raportin final të auditimit, sipas programit të punës nr 8993 datë 27.11.2008, konstatohet në pikën 14 të këtij auditi që është lënë si detyrë që **Komanda Mbështetëse** bazuar në ligjin nr 6942 datë 25.12.1984 "*Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare*" dhe në shkresën e shefit të shtabit të përgjithshëm nr 7883 datë 15.09.2006 "*Për marrje në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani*" të marrë në dorëzim, me komision, duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën Klubi i Futbollit Partizani sipas gjendjes në fakt. Komandanti i KM-së të informojë në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MM për zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna në raportin final brenda datës 31.10.2009. Ky raport final është mbajtur më datë **19.05.2009** dhe për grupin e auditimit ka nënshkruar Agim Zenelaj, **Bashkim Punavija** dhe Bardhyl Xhafa.

244. Me shkresën nr. 2867/1 prot datë **20.05.2009** shtetasi Vladimir Qiriazhi, shkresë e konceptuar nga shtetasi *Naim Ramaj*, i është drejtuar Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, me kërkesë për ndihmë juridike mbi zbatimin e urdhërit të MM nr. 334 datë 13.03.2009 "*Për dorëzim dhe lidhje kontrate*". Në këtë shkresë është parashtruar se, në bisedë telefonike nga ana e ministrit është tërhequr vëmendja për arsyen se pse nga ana e komandës, komisioni për marrjen në administrim dhe hartim të dokumentacionit teknik, ka kontaktuar me personat e sh.a Partizani që aktualisht ndodhen dhe ushtrojnë aktivitet në këtë pronë.

244.1. I pyetur gjatë këtij hetimi, shtetasi **Gazmend Oketa**, nëse kishte dijeni nëse terrenet sportive dhe objektet e Klubit të futbollit Partizani, shfrytëzoheshin nga ndonjë subjekt privat, deklaroi se ...*Kam qenë në dijeni që shfrytëzoheshin nga Klubi i Futbollit Partizani por nuk e di se në çfarë mënyre ishte vendosur kjo marrëdhënie me terrenet dhe objektet që ishin në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes*. I pyetur në lidhje me pretendimin në shkresën e sipërcituar të shtetasit Vladimir Qiriazhi, se në një bisedë telefonike, nga ana e ministrit është tërhequr vëmendja për arsyen se pse nga ana e komandës komisioni për marrjen në administrim dhe hartim të dokumentacionit teknik ka kontaktuar me personat e sh.a. Partizani që aktualisht ndodhen dhe ushtrojnë aktivitet në këtë pronë, deklaroi se: ... *Nuk më kujtohet të kem bërë ndonjë bisedë telefonike me shtetasin Vladimir Qiriazhi e t'i kem kërkuar llogari përse ka marrë kontakt me personat e sh.a. Partizanit*.

245. Me shkresën nr. 3606 prot datë 26.05.2009 drejtuar Repartit Ushtarak 4001, me lëndë "Dërgim raporti final mbi auditimin e plotë të kryer në Repartin Ushtarak nr. 4001, Komanda Mbështetëse Tiranë" drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm Maliq Xhebra i ka përcjellje Repartit Ushtarak 4001, Komandës Mbështetëse, kopje të raportit final së bashku me detyrat dhe rekomandimet përkatëse. I kërkon konfirmimin e raportit final dhe masat e marra për zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve brenda datës 30.06.2009. Gjithashtu, me shkresën nr. 3606 prot datë 26.05.2009, ky raport i është përcjellë edhe Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit të Brendshëm.

245.1. Shtetasi Vladimir Qiriazhi, reagon duke vënë në dijeni Presidentin e Republikës, shtetasin Bamir Topi. Konkretisht, me shkresën nr. 3039 prot datë 26.05.2009 i ka disa probleme dhe shqetësime në lidhje me pronat në administrim ose jo të Komandës Mbështetëse të cilat kanë dalë nga plani i përhapjes i FA-së. Ka bërë me dije në lidhje me urdhërin e Ministrit të Mbrojtjes nr.344 datë 13.03.2009 për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes duke pasqyruar se, kjo pronë nuk është në administrim e kontabilitet të Komandës, për rrjedhojë nuk mund ta dorëzojnë apo të lidhin kontratë me pronarët. Ka parashtruar se ka informuar Ministrin e Mbrojtjes dhe është takuar disa herë me të duke i kërkuar argumenta ligjore nga strukturat e varësisë direkte të tij por vijimisht i është kërkuar se kjo kontratë duhej nënshkruar.

Pasqyron se për këtë pronë kanë treguar vëmendje të veçantë Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, i cili ka ardhur për verifikim me autorizim të kryeministrit Sali Berisha.

Parashtron pretendime të tij në lidhje me raportin dhe observacionin e bërë, ndërkohë që pretendon se në mënyrë krejt të pakuptimtë kërkohet nga ky kontroll, që brenda 5 ditëve të mbyllet procedura e shitjes dhe vetëm kaq, ndërkohë që bazuar në rregulloren e punës së këtij departamenti ka institucione të tjera të cilat mund dhe duhet të vijojnë kontrollin.

Sqaron se prona në fjalë, është duke u përdorur nga një subjekt privat që ushtron aktivitetin që nga viti 2000 si sh.a. FK Partizani dhe nuk dihet kush ia ka dhënë në përdorim, kjo pronë nuk i është dorëzuar asnjëherë dhe për asnjë rrethanë Komandës Mbështetëse nga Ministria e Mbrojtjes apo Shtabi i Përgjithshëm, prona sipas Institutit të Gjeografisë Ushtarake është 30 002.50 m² ndërkohë që kërkohet të dorëzohet dhe shitet rreth 27 000 m². Prona sipas prononcimit të ZRPP rezulton me mbivendosje, nuk kanë marrë certifikatë pronësie dhe për rrjedhojë nuk mund të shitet.

Për vlerësimin e kësaj prone nuk ka pasur asnjë përfaqësues të KM-së dhe nuk kanë asnjë dijeni për procedurat e ndjekura.

245.1.1. I pyetur përgjatë këtij hetimi, më datë 26.09.2022, shtetasi **Vladimir Qiriazhi**, deklaroi se... unë i kam bërë një shkresë Presidentit Bamir Topi lidhur me problematikat që më ishin shfaqur, ku në këtë shkresë e informoj për punën që ka bërë komanda logjistike deri në këtë periudhë dhe për problemin që më ka ndodhur me klubin Partizani. Shkresa më duket se është rreth datës 26.05.2009. Pas kësaj shkrese, rreth 4 – 5 ditë më pas më ka thirrur Presidenti i Republikës, nëpërmjet njoftimit që më ka bërë drejtori i kabinetit të Presidentit, më duket me mbiemër Xhaxhia dhe më ka lënë takim. Më kujtohet se takimi ka qenë ditë e premte, ora 10.30, më duket se ka qenë data 29.05.2009. Në këtë takim kam biseduar me Presidentin Bamir Topi rreth një orë, duke qenë vetëm e më pas edhe në prani të juristëve të Presidentit. Di që ka qenë Shvarci një ndër personat por kanë qenë dy - tre. Më kanë dhënë të drejtë në praktikën e punës dhe atë që unë nuk duhet të firmosja një dokument që nuk ishte ligjor. "

246. Me shkresën nr. 3505 regj datë 16.06.2009 shtetasi Vladimir Qiriazhi i është drejtuar

Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Maksim Malaj, duke i kërkuar mbështetje ligjore përsa vijon: Seksioni i pronave në repartin Ushtarak 4500 të marrë në administrim fillimisht pronat e Komandës Mbështetëse dhe pastaj gradualisht të gjitha pronat e FA; të ndjekë në vazhdimësi të gjithë procedurën për regjistrimin e pronave të paregjistruara dhe procedurën e privatizimit të pronave që i nënshtrohen këtij procesi; të gjitha shkresat për problemet e pronave për shpejtim procedurash të drejtohen në Repartin Ushtarak 4500.

246.1. I pyetur më datë 26.09.2022 shtetasi **Vladimir Qiriazi** ka deklaruar: "... Korrik 2008 – shtator 2009 kam qenë komandant i mbështetjes logjistike. Shtator 2009 – prill 2009 kam qenë zëvendës komandant i forcës së bashkuar. Unë fillimisht dua t'ju sqaroj se nuk kam pasur korrespondencë vetëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, por kam pasur korrespondencë edhe me Kryeministrinë, zotin Lezhja dhe Drejtorinë e Antikorrupsionit, si dhe me komandantin e përgjithshëm z. Bamir Topi. ...

247. Me shkresën nr. 1832 prot datë **21.07.2009** të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me lëndë "Memorandum (përmbledhje e raportit final) të auditimit të plotë të ushtruar në Repartin Ushtarak nr. 4001 (KM) Tiranë", të nënshkruar për grupin e auditimit nga Agim Zenelaj, **Bashkim Punavija** dhe Bardhyl Xhafa dhe drejtori Bardha Kola, drejtuar Ministrit të Mbrojtjes Gazmend Oketa, në lidhje me auditimin e kryer, në faqen 20 të kësaj memo, pasqyrohet ndër të tjera se: "... Marrja në dorëzim dhe regjistrimi i Klubit të Futbollit Partizani. **Opioni i auditit, është se Komanda Mbështetëse pavarësisht mungesës së dokumentacionit kontabël dhe pikës së kontaktit me ish administruesit, bazuar në ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare" duhet të merrte në dorëzim, pronën sipas gjendjes në fakt, me komision, duke mbajtur proces verbalin përkatës, veprim i cili nuk është kryer edhe aktualisht.**" Në përfundim të raportit, në masat organizative, në pikën 19 kanë përcaktuar: "...19. Komanda Mbështetëse, bazuar në ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", ligjin nr. 9228 datë 26.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në shkresën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 7883 datë 15.09.2006 "Për marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani" të marrë në dorëzim me komision duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën Klubi i Futbollit Partizani, sipas gjendjes në fakt.

Me urdhërin nr. 1003 datë **21.07.2009** Ministri Gazmend Oketa ka vendosur "Për dhënie masash dhe zbatim detyrash në përfundim të auditimit të plotë të ushtruar në komandën mbështetëse (Reparti Ushtarak nr. 4001.) Tiranë", ku në pikën 20 ka udhëruar: "...20. Komanda Mbështetëse, bazuar në ligjin nr. 6942 datë 25.12.1984 "Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare", ligjin nr. 9228 datë 26.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në shkresën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm nr. 7883 datë 15.09.2006 "Për marrjen në administrim dhe për regjistrimin e pronës me emërtimin Klubi i Futbollit Partizani" të marrë në dorëzim me komision duke mbajtur proces verbalin përkatës, pronën Klubi i Futbollit Partizani, sipas gjendjes në fakt. Ky urdhër mban edhe nënshkrime të Bardha Kola, Agim Zenelaj, B.Punavija dhe B. Xhafa.

Me shkresën nr. 5576 datë **20.08.2009** "Për përfaqësim në ankand, dorëzim objekti dhe nënshkrim kontrate" është dhënë autorizim nga Ministri.

Lidhja e kontratës dhe dorëzimi i Klubit të Futbollit Partizani

248. Pas pengesave të mësipërme që po nxirrte shtetasi Vladimir Qiriazi, duket se është

proceduar me zgjidhjen e këtij problemi, duke e hequr nga detyra që mbante deri në atë kohë. Me dekretin nr. 6231 datë **02.09.2009** të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, shtetasit Bamir Topi, gjeneral brigade Vladimir Qirjazi, Komandant i Komandës Mbështetëse, shkarkohet nga detyra si komandant i Komandës Mbështetëse dhe me dekretin nr. 6234 datë 02.09.2009 emërohet në detyrën e zëvendës komandantit të Komandës së Forcave të Bashkuara të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kurse me dekretin e Presidentit të Republikës Bamir Topi, nr. 6291 datë **07.10.2009** gjeneral Brigade Xhemal Gjunksi, emërohet Komandant i Komandës Mbështetëse. Ky i fundit, ka qëndruar në këtë detyrë deri më datë 01.03.2010.

Më datë **14.09.2009** shtetasi Arben Imami emërohet Ministër i Mbrojtjes.

249. Siç konstatohet nga aktet, brenda një muaji pasi shtetasi Arben Imami është emëruar si Ministër i Mbrojtjes dhe një javë pasi është emëruar Komandanti i ri i Komandës Mbështetëse, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit shtetasi Armand Tartari, me shkresën nr. 6915 prot datë **15.10.2009** i është drejtuar Komandës Mbështetëse dhe shtetases Mirela Cano, këshilltare e Ministrit, duke parashtruar se, **lidhur me vlerën në kontabilitetet të pasurive të paluajtshme të Klubit të Futbollit Partizani bashkalidhur dërgohen fotokopje të llogarisë vjetore të vitit 2000 (gjithsej 12 fletë) të depozituar nga ish ky institucion buxhetor në varësi të MM në të cilat pasqyrohen të dhënat mbi gjendjen e aktiveve të qëndrueshme.**

Me memon e datës **16.10.2009** drejtuar Gjeneral Brigade Xhemal Gjunksi, nëpërmjet kolonel Adem Halilaj nga n/kol Naim Rama, shefi i sek. Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës, ka parashtruar se në zbatim të detyrës së vënë më datë 15.10.2009 për zbatimin e urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 334 datë 13.03.2009 "*Për dorëzim dhe lidhje kontrate*", shkresës së Drejtorisë së Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit në Ministrinë e Mbrojtjes nr. 6915 datë 15.10.2009 "*Dërgim të dhënash*", si dhe detyrave të lëna nga auditi i Kryeministrit, **u bë kontabilizimi në llogarinë e Repartit Ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse).** Për këtë kanë përgatitur informacionin për sekretarin e përgjithshëm, drejtorinë e planifikimit, programimit dhe buxhetimit si dhe DMIBM në Ministrinë e Mbrojtjes.

250. Me Autorizimin Nr. 6927, datë **15.10.2009** "*Për dorëzimin prone dhe lidhje kontrate*" **Ministri i Mbrojtjes (Arben Imami i emëruar sipas dekretit nr. 6248 datë 14.09.2009),** ka Autorizuar Komandantin e Komandës Mbështetëse Gjeneral Brigade Z. **Xhemal Gjunksi** të përfaqësojë Ministrinë e Mbrojtjes për dorëzimin dhe nënshkrimin e kontratës së shitjes së pronës Nr. 11 me emërtimin **Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit "Partizani", Tiranë,** në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes. Ky autorizim, është vërtetuar nënshkrimi sipas vërtetimit nr. 3438 rep datë 15.10.2009 të noteres Gentiana Shkodra dhe i është përcjellë Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike me shkresën nr. 6927/1 prot datë 15.10.2009.

251. Me urdhërin nr. 6094/3 datë **16.10.2009** "*Për marrjen në administrim dhe dorëzimin e pronës nr 11 Klubi i Futbollit Partizani*" komandanti i Komandës Mbështetëse, Xhemal Gjunksi, Komanda Mbështetëse, ka urdhëruar të ngrihet në Repartin ushtarak 4001, **grupi i punës për marrjen në dorëzim të pronës nr. 11,** me këtë përbërje: Naim Ramaj, Gjete Bushi, Figali Golemi, Ahmet Roçi, Nikoll Tushi dhe Gani Lata. **Prona nr. 11 me t'u marrë në dorëzim, do të administrohet nga Reparti Ushtarak 4001** sipas vlerës kontabël të dërguar nga Drejtoria e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit në MM me shkresën nr. 6915 datë 15.10.2009 "*Dërgim të dhënash*". Grupi i punës me të marrë në dorëzim pronën të hartojë

proces verbalin e marrjes në dorëzim sipas dokumentacionit teknik të hartuar nga IGJU dhe pastaj të hartojë proces verbalin e dorëzimit të pronës Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.

Me proces verbalin datë **16.10.2009** nr. 6094/3 prot është pasqyruar nga grupi i punës marrja në dorëzim e klubit të futbollit me vlerë kontabël viti 2000 në **shumën 9 9551 139 lekë** dhe vlerë kontabël të ngelur 8 876 416 lekë, sip **sipas faktit 31 002, 5** ku gjenden ndërtesë katër katëshe me sip 436.77 m², objekt një katësh me sip 22.78 m² dhe truall me sip 30542.94 m². Ky proces verbal është nënshkruar nga Naim Ramaj, Gjetë Bushi, Figali Golemi, Ahymet Roçi, Nikoll Tushi dhe Gani Lata.

251.1. I pyetur më datë 19.01.2023 shtetasi **Naim Rama**, në lidhje me faktin se, ka konceptuar vazhdimisht shkresa për problematika që i ka vlerësuar se kanë ekzistuar të cilat i pengonin në marrjen në dorëzim të pronës me nr 11 e më pas më datë 16.10.2009 e ka marrë në dorëzim këtë pronë, sqaron se... *Ra Në vijim u bë ndërrimi i komandantave dhe në krye të repartit erdhi Xhemal Gjunksi. Edhe komandanti që erdhi i ka kërkuar të gjithë praktikën dhe korrespondencën e kryer për këtë dosje. Pas një farë kohe me aq sa i kujtohet ka ardhur autorizimi i dytë për dorëzimin e pronës. Në këtë kohë është ngritur një urdhër për marrjen në dorëzim të pronës nga Ministria e Mbrojtjes dhe kontabilizimi i kësaj prone në inventar të Komandës Mbështetjes Logjistike. Mesa i kujtohet ka ardhur një dokument dalje (nuk i kujtohet nëse ka qenë fletë dalje apo dokument tjetër) nga Ministria e Mbrojtjes dhe është kontabilizuar në Komandën e Mbështetjes Logjistike. Pas këtij veprimi me një urdhër ja kanë dorëzuar Agjensisë Kombëtare të Privatizimit në mos gabon, dokumentacionin e plotë të kërkuar nga ana e tyre. Do të sqarojë se i kujtohet që i kanë dërguar ZRPP mbi statusin e pronës dhe i kanë kërkuar paisjen e kësaj prone me certifikatë pronësie. Këtë gjë e ka kërkuar gjeneral Vladimir Qiriazhi gjatë periudhës së tij në detyrë. Mendon se ka qenë rreth vitit 2009 por gjithashtu me aq sa i kujtohet ka pasur edhe kërkesa të tjera para këtyre viteve për ta regjistruar nga Komanda Mbështetëse Logjistike. Mesa i kujtohet përgjigja që kanë marrë nga ZRPP ka qenë negative pasi pretendimi i tyre ishte se në këtë pronë ka mbivendosje. Me aq sa i kujtohet prona nr. 11 Klubi i Futbollit Partizani mendon që nuk ka qenë në planin e përhapjes. Arsyeja përse e morën në dorëzim ishte pasi, bashkalidhur urdhërit që iu dha për marrjen në dorëzim ishte edhe dokumentacioni që kërkonin, i cili ishte kontabilizimi i kësaj prone.*

252.2. E pyetur më datë 23.01.2023 shtetësja **Figali Golemi**, deklaroi se, **gjithë zanafilla e kësaj historie është Xhemal Gjunksi për arsye se ai ishte strumbullari i detyrimit tim për të marrë pronën nr. 11, Klubi I Futbollit Partizani, e cila nuk ishte në kontabilitet si aset i komandës Mbështetëse. Në komunikimin me gjeneralin Xhemal Gjunksi, e kam pyetur se kush ishte arsyeja përse më detyronte të merrja në kontabilitet një pronë e cila nuk qe e mbartur tek ne, përgjigja e tij ishte: sepse Komanda Mbështetëse ishte për pronat. Lidhur me aktivitetin e grupit sqaron se Naim Ramaj dhe Nikoll Tushi kanë shkruar në pronën nr. 11 ndërsa Figalia jo, madje nuk i ka thënë njeri dhe të shkonte, ndërkohë që ajo ishte përfaqësuese e financës dhe duhet të firmoste lidhur me vlerën në kontabilitet. Në dijeninë e saj vlera ka ardhur nga Ministria e Mbrojtjes. Lidhur me sipërfaqen në momentin e marrjes në administrim, nuk ishte njohur me ndonjë problematikë por rreth vitit 2012 kur nuk më ishte pjesë e Komandës Mbështetëse ka dëgjuar se një auditim i procedurës së marrjes në administrim të pronës nr 11 ka nxjerrë problematika lidhur me sipërfaqen por më saktësisht nuk e di pasi nuk ishte më në përcaktimin e sipërfaqes së pronës ishin Naim Ramaj dhe Nikoll Tushi. Por siç e tha, personi që ishte dhe ngelet ai që e ka detyruar të firmosë është gjenerali Xhemal Gjunksi.**

252.3. I pyetur më datë 19.01.2023 shtetasi **Nikoll Tushi**, ka deklaruar se para daljes së këtij urdhëri, prona me nr. 11 nuk ka qenë në përgjegjësi administrimi nga Komanda Mbështetëse. Pavarësisht se kishte dalë një shkresë nga ish Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Pëllumb Qazimi për ta marrë në inventar, paraardhësit e tij ku ka pasë punuar tek Komanda Mbështetëse nuk arritën ta marrnin pasi nuk kishte palë dorëzuese, pasi nuk paraqitej njeri për ta dorëzuar. Kur e ka marrë detyrën pranë KM si specialist pronash u është kërkuar me shkresë nga Ministria e Mbrojtjes që ta marrnin në dorëzim. Nga pala dorëzuese (Ministria e Mbrojtjes) përsëri nuk është paraqitur njeri. Njëkohësisht në fillim si komision nuk u është lejuar të futen brenda nga poseduesi i pronës Albert Xhani, gjë për të cilën nuk kshin informacion si e administronte këtë pronë. Më pas u lejua që të futej brenda ambjenteteve të kësaj prone dhe mesa mban mend janë takuar me ish presidentin e KF Partizani Albert Xhani dhe Genc Tomorri mesa i kujtohet ky i fundit drejtues teknik i KF Partizani. Pas kësaj i kanë parashtruar kërkesën për të liruar ambjentin gjë për të cilën Albert Xhani e ka kundërshtuar. Për çdo rast që komisioni ka vepruar është informuar titullari i KM Vladimir Qiriazhi dhe nëpërmjet tij Ministria e Mbrojtjes. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk është paraqitur asnjëherë si palë dorëzuese dhe si rezultat nuk kanë arritur ta marrnin pronën në dorëzim. Deklaruesi ka gjetur praktikën e paraardhësve të tij në detyrë për të regjistruar këtë pronë, pra pronën me nr 11 Klubi i Futbollit Partizani dhe nga informacionet e pasqyruara nga këta paraardhës ka parë se ishin bërë përpjekje për regjistrim por ZVRPP kishte kthyer përgjigje se prona nuk mund të regjistrohej për shkak se krijonte mbivendosje me vendime të Komisionit të Kthimit të Pronave. Me këto vendime të KKP Komanda Mbështetëse nuk është njohur ndonjëherë.

Nga ana e zyrës antikorruption pranë kryeministrisë janë paraqitur dy specialistë të kësaj zyre, ku emrat nuk i kujtohen, mesa i kujtohet rreth vitit 2009. Këta specialistë kanë marrë takim me gjeneralin Vladimir Qiriazhi dhe kanë kërkuar t'u vihet në dispozicion e gjithë korrespondenca zyrtare për marrjen e kësaj prone në administrim të Komandës Mbështetëse. Komandanti i Komandës Mbështetëse Vladimir Qiriazhi e ka thirrur në prezencë të specialistëve antikorruption të Këshillit të Ministrave që kishin ardhur, për të bërë një sqarim më të detajuar si specialist i sektorit. Kanë sqaruar grupin e kontrollit, që nga Ministria e Mbrojtjes nuk u është dorëzuar prona në administrim dhe njëkohësisht gjenerali Qiriazhi pas insistimit të tyre u ka kërkuar autorizimin që atyre u jepej e drejta të marrnin në dispozicion dokumentat që kërkonin. Në atë moment nuk ishin të pajisur me autorizimin përkatës me pretendimin që ligji antikorruption ua jepte këtë të drejtë. Nga ana e gjeneralit u tha se pa paraqitur autorizimin nuk do t'u jepet asnjë dokumentacion. Brenda asaj dite, rreth orës 14.00 ata janë paraqitur përsëri në Komandën Mbështetëse me autorizimin të firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë Gjergj Lezhja. Pas kësaj u është vënë në dispozicion dokumentacioni zyrtar që ata kërkuan, korrespondencat që kishin me Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen në dorëzim të pronës me nr 11 ose mosmarrjen në dorëzim. Më vonë është shkarkuar gjeneral Qiriazhi dhe në javën e parë të emërimit të komandantit bashkë me përgjegjësin e sektorit Naim Ramaj janë thirrur nga gjenerali Xhemal Gjunkshi për t'u paraqitur në Ministrinë e Mbrojtjes tek zyra e Këshilltares Ekonomike të Ministrisë së Mbrojtjes, nuk i kujtohet emri, për të sqaruar edhe një herë mosmarrjen në dorëzim të kësaj prone. Në atë kohë, ministër i mbrojtjes mesa i kujtohet ka qenë Arben Imami. Në momentin që deklaruesi dhe Naim Ramaj janë paraqitur në zyrën e mësipërme, aty kanë gjetur gjeneral Xhemalin, Drejtorin e Aseteve dhe të Pronave Shkëlqim Berisha, ka qenë drejtori i financës a ekonomisë nuk i kujtohet emri dhe u është kërkuar arsytet e mosmarrjes së kësaj prone në dorëzim. Nga ana e deklaruesit dhe Naimit dorëzuese. Si rezultat i kësaj Komanda Mbështetëse nuk ka çfarë të dorëzojë kur nuk e kanë as në inventar këtë pronë. Nga ana e titullarëve të mësipërm, iu vu detyrë që të merrej prona në dorëzim sipas gjendjes kontabël që kishte Ministria e Mbrojtjes dhe dokumentacioni teknik

i hartuar për të nga IGJU-ja. Nga ana e drejtorisë ekonomike të Ministrisë së Mbrojtjes u është dorëzuar gjendja kontabël e kësaj prone dhe nga ana e Komandës Mbështetëse është marrë në dorëzim, sipas sipas gjendjes kontabël dhe dokumentacionit teknik të hartuar nga IGJU-ja. Pas kësaj ka dalë urdhëri i gjeneralit për marrjen në dorëzim të kësaj prone. Nga ana e komisionit është marrë në dorëzim prona me sip sipas dokumentacionit teknik të hartuar nga IGJU-ja dhe fakti që është e barabartë me 31 002.5 m2. Kjo sipërfaqe i përgjigjet konturimit të murit rrethues që kishte kjo pronë.

Në vitin 2010 – 2012 i ka thirrur një audit i Ministrisë së Mbrojtjes duke i pyetur në lidhje me një diferencë që rezultonte mes të dhënave që kishte IGJU-ja dhe ato që kishte kontrata e privatizimit, konkretisht një diferencë mbi 4000 m2. Nga ana e deklaruesit dhe kolegëve, në rrugë shoqërore pasi zyrtare nuk kishin të drejtë t'ia kërkonin drejtorisë së shitjes pranë METE kanë marrë dokumentacionin teknik të hartuar nga AKKP, për vendimet e marra nga kjo agjensi. Nga punimi i këtyre dokumentave hartografikë, përputhja e tyre, ka rezultuar se sip e kthyer ish pronarëve nuk ishte 26000 e ca por është mbi 40 000 m2 në të cilën futet komplet sipërfaqja prej 31002.5 m2 e ish pronës nr. 11 KF Partizani për të cilën nga ana e deklaruesit është hartuar dokumentacioni teknik ku pasqyrohen sip e këtyre vendimeve mbi pronën nr. 11 dhe ia ka vënë në dispozicion drejtorisë së auditit të Ministrisë së Mbrojtjes.

252.4. Më datë 19.01.2023, është pyetur shtetasi *Armir Balili* i cili ka deklaruar se me daljen e urdhërit të komandantit të Komandës Mbështetëse *Xhemal Gjunkshi*, u ngrit komisioni që do kishte kompetencë përgatitjen e dokumentacionit për përcjelljen në Ministrinë e Ekonomisë. Për procedurë duhej të konfirmohej inventari ekonomik i pronës, në ishte i njëjtë me çfarë ndodhej në dosje apo jo. Paraprakisht sqaron se prona nr. 11 ndodhej në inventarin e asetëve të Komandës Mbështetëse në Bilancin e vitit 2008. Për vlerësimin e godinave dhe të truallit është ngritur komisioni i vlerësimit. Me privatizimin e pronës 11, financa nuk ka pasur lidhje pasi nuk ka qenë pjesë e komisionit dhe në këto kushte i vuri në dispozicion komisionit vetëm vlerën e asetit sipas bilancit të vitit 2008. Financa nuk prodhon dokumenta por i administron ato dhe i pasqyron në librat kontabël.

253. Me shkresën Nr. 6094/1 Prot, datë **16.10.2009**, Komanda Mbështetëse (Gjeneral Xhemal Gjunkshi) i ka dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Planifikimit, programimit dhe buxhetimit në Ministrinë e Mbrojtjes, “*Informacion mbi zbatimin e urdhërit të MM Nr. 334, datë 13.03.2009*”, ku në përmbajtje të shkresës është cituar fakti që është bërë kontabilizimi i pasurisë në repartin Ushtarak 4001 (Komanda Mbështetëse) sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit në Ministrinë e Mbrojtjes me shkresë Nr. 6915, datë 15.10.2009.

254. Më datë **16.10.2009** është bërë dorëzimi i pronës, ku Ministria e Mbrojtjes është përfaqësuar nga Gjeneral Brigade Z. Xhemal Gjunkshi, përfaqësues i Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike Nuri Sopaj, dhe marrësit janë për trashëgimtarët Begeja shtetasi **Jamarbër Malltezi** dhe **Bashkim Bekteshi**, për trashëgimtarët ligjorë Llagami, shtetasi Fatri Tafaj, Adela Llagami, Rudina, Ardian dhe Adnand Llagami, trashëgimtarët ligjorë të Qemal Saliaga av. **Silvana Bello**, trashëgimtarët ligjorë të familjes Rexhep Alimehmeti është shtetasi **Blendi Marika** dhe **Skënder Mulliqi**, trashëgimtarët ligjorë të familjes Vaqarri përfaqësuar nga **Igli Vaqarri**. Përfaqësues i Drejtorisë së Privatizimit në Ministrinë e Financave është Nuri Sopaj.

Në momentin e dorëzimit, përshkruhet se gjendja e objektit është në përputhje me vlerësimin dhe dokumentacionin e dërguar nga METE me shkresën nr. 6120/1 prot datë **22.07.2008**. Vlera totale është **10 109 000** lekë, mjete kryesore kurse mjete xhiro nuk ka. Sip totale e objektit

sipas gent planit në dosje është **26 524 m2 dhe nën objekt 775 m2**. Pagesa e vlerës së objektit gjithsej 10 109 000 lekë është bërë sipas transfertës bankare **nr. 2810 datë 04.09.2008 me vlerën 2 021 800 lekë**, formulari për pranimin e bonove të privatizimit dega 043 datë 13.02.2009 për shumën 8 200 000 bono privatizimi për llogari të Ministrisë së Financave.

254.1. Pra siç mund të konstatohet dorëzimi është bërë i plotë, edhe për sipërfaqen e truallit që nuk është paguar.

Gjithashtu konstatohet se ende nuk kishte dalë urdhëri që autorizonte shtetasin Nuri Sopaj për të dorëzuar objektin, pasi vetëm me autorizimin datë **20.10.2009** të Setorit të Shitjes së Pronave Publike, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave, autorizim i nënshkruar nga drejtori Urim Muja, është autorizuar përfaqësuesi i Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike z. Nuri Sopaj (Sektori i Shitjeve) të kryejë procedurën ligjore për dorëzimin e objektit "**Terrenet Sportive dhe objekte të Klubit të Futbollit Partizani**" me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku, Tiranë, në administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Dorëzimi i këtij objekti të kryhet brenda datës 25.10.2009.

255. Me kontratën e shitjes me nr. 3553 rep nr. 661 kol dt **21.10.2009**, para **noteres Gentiana Shkodra**, Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike përfaqësuar nga **Urim Muja**, Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse përfaqësuar nga **Xhemal Gjunksi**, sipas autorizimit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 6927 prot datë 15.10.2009 dhe trashëgimtarëve ligjorë të ish pronarëve, është lidhur kontrata e shitjes për objektin terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë. Blerësit janë:

- **Trashëgimtarët ligjorë të Mahmut dhe Xhemal Begeja: Haki Begeja, Nimete Bekteshi, Nysret Kacurri (Bekteshi), Kreshnik Kacurri, Lirie Lika (Begeja), Sanie Velo (Begeja), Ajete Sulstarova (Begeja), Myzejen Ago (Begeja), Gëzim Begeja, Haxhire Begeja, Ednand Begeja, Syzi Begeja, Graziella Begeja, përfaqësuar me prokurën nr. 4842 rep datë 11.01.2006 nga Ksanthipi Begeja, Vera Graboëski, përfaqësuar me prokurën nr. 4842 rep datë 11.01.2006 nga Ksanthipi Begeja, Margaret Irëin përfaqësuar me prokurën nr. 4842 rep datë 11.01.2006 nga Ksanthipi Begeja, të përfaqësuar nga shtetasi **Jamarbër Malltezi** me anë të prokurës së posaçme Nr. 787 Rep, Nr. 142 kol, datë 31.01.2006.**

*Lumturi Çela; Sejdiye Kurti; Mirban Kadiu Teuta Malka (bërë shënimi nga noterja se nuk ka të dhëna për pasaportën), Bashkim Kadiu (bërë shënimi nga noterja se nuk ka të dhëna për pasaportën), Nerime Piro, të përfaqësuar me anë të prokurës së posaçme Nr.2165 rep, nr. 248 kol, datë 03.05.2006 nga shtetasi **Jamarbër Malltezi**.*

*Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ilir Kadiu, Bashkim Bekteshi, përfaqësuar nga **Jamarbër Malltezi**, Nervit Hoxha, përfaqësuar nga **Jamarbër Malltezi**, Rajmonda Bekteshi, përfaqësuar nga **Jamarbër Malltezi** (Pra shtetasit Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha dhe Rajmonda Bekteshi, me anë të prokurës së përgjithshme Nr.10086 rep, nr. 1542 kol, datë 31.12.2007 shtetasi **Jamarbër Malltezi** caktohet përfaqësues ligjor i tyre)*

- **Trashëgimtarëtligjorë të trashëgimlënëses Sabrije Llagami: Behixhe Tafaj, përfaqësuar me prokurën nr. 691 rep nr. 144 kol datë 30.03.2000 nga Fatri Tafaj, Myhyrije Verzivoll, Rudina Llagami, Ardian Llagami, Adnand Llagami, Sadete Llagami, Adela Llagami, Mirnije Llagami, përfaqësuar me prokurën nr. 1693 rep nr. 294 kol datë 16.07.2008 dhe nr 2805 rep nr. 336 kol datë 14.07.2008 nga Adela Llagami, Aleksandra Llagami, përfaqësuar me prokurën nr. 5997rep/669 kol datë 30.12.2005 nga Ervin Llagami; Ervin Llagami, Artur Llagami (përfaqësuar me prokurë nr. 5997 rep / 669 kol datë 30.12.2005 nga Ervin Llagami (i vëllai).**

- **Trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit Qamil Saliaga:** *Fadil Saliaga, Xhevrije Mullisi, Luan Saliaga, Hamide Saliaga, Shpëtim Luzi, Fatir Luzi, Tire Deda (Luzi), Të përfaqësuar me prokurën nr. 4998 rep nr. 667 kol datë 10.07.2008 nga Silvana Bello.*

- **Trashëgimtarët ligjorë të familjes Alimehmeti:** *Fiqiri Alimehmeti, Xhafer Alimehmeti, Fehmi Alimehmeti, Fatbardha Marika (Alimehmeti), Alma Sulo, Genci Mullici, Të përfaqësuar me prokurën nr. 5451 rep nr. 592 kol datë 12.11.2005 nga Blendi Marika dhe Skënder Mullici*

- **Trashëgimtarët ligjorë të familjes Vaqarri:** *Fitnete Bektashi, Fiqiri Vaqari, Kumurije Vaqari, Liliana Arapi, Luan Arapi, Arben Arapi, përfaqësuar me prokurën nr. 7664 rep nr. 1235 kol datë 08.08.1996 nga Liliana Arapi, Fiqirete Vaqari, Eva Vaqari, Igli Vaqari, Të përfaqësuar me prokurën nr. 2017 rep nr. 282 kol datë 04.06.2008 nga Igli Vaqari.*

Sipas nenit 2, të kësaj kontrate, objekt është kalimi në pronësi private i objektit "Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit Partizani", me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku, Tiranë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë, me sip totale 26 524 m², nga e cila 775 m² nën objekt, sipas vendimeve të KKKP-ish Pronarëve. Në nenin 2 janë përmendur edhe vendimet e KKKP, por nuk është përmendur vendimi nr. 64 i vitit 2007, i familjes Llagami.

Po në këtë nen, parashikohet se ky objekt ndodhet në ZK nr. 8220 Tiranë dhe kufizohet si më poshtë: Veri me pronë private; jug me Institutin Hidrometereologjik, pronë private; lindja me pasurinë nr. 3/155, 3/154 dhe perëndim me Klubin Sportiv shumësportesh Partizani.

Në nenin 3 parashikohet çmimi i shitjes së objektit është 10,109,000 (dhjetë milionë e njëqind e nëntë mijë) lekë. Sipas këtij neni, kjo vlerë është paguar plotësisht nga pala blerëse në Raiffeisen Bank në nr. e llogarisë 0104030780 (Dega e Thesarit) në favor të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) Tiranë sipas kushteve të vendosura në autorizimin për kalim të pronësisë objekti dhe trualli me nr. 812 prot datë 26.01.2009.

Pala shitëse deklaroi se, në favor të saj është derdhur e gjithë shuma e përcaktuar, para kohës së përpilimit të kësaj kontrate, *transfertës bankare nr. 2810 datë 04.09.2008 në shumën 2 021 800 lekë, formulari i pranimit të bonove nr. 043 dega, datë 13.02.2009 për shumën 8 200 000 bono privatizimi.*

Në nenin 6, pika 6.4 është përcaktuar se blerësi është i detyruar të bëjë pagesën e pjesës së truallit që do të mbetet shtet, pas konfirmimit të dhënë nga ZRKK Pronave Tiranë, brenda afatit 30 ditor nga data e njoftimit që do t'u bëhet për këtë qëllim.

Konstatohet se kontrata është nënshkruar edhe për shtetasin Ilir Kadiu nga shtetasi Jamarbër Maltezi.

255.1. Me shkresën nr. 11287 prot datë 21.10.2009, Drejtori i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, Urim Muja, i përcjell ZVRPP kontratën e shitjes me nr. 3553 rep nr. 661 kol datë 21.10.2009.

Me shkresën Nr. 11370 Prot. datë 22.10.2009, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (Drejtor Urim Muja) i dërgon Repartit Ushtarak 4001 kontratën e shitjes së objektit "Terrenet sportive dhe objektet e Klubit të Futbollit "Partizani", në administrim të

Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë, Nr.3553 Prot. Nr. 661 Kol, datë 21.10.2009.

Me shkresën nr. 6094/4 regj datë 26.10.2009 të nënshkruar nga Komandanti i Komandës Mbështetëse Xhemal Gjunksi, i është drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Menaxhimit të Instalimeve dhe Burimeve të Mbrojtjes, dhe për dijeni Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, Drejtorisë Logjistike, duke informuar se për pronën 11 ka përfunduar procedura e privatizimit dhe firmosja e kontratës së shitjes. Regjistrimi i pronës në kontabilitetin e Repartit Ushtarak 4001 (KM) është bërë sipas të dhënave të dërguara nga drejtoria e planifikimit, programimit dhe buxhetimit në MM me shkresën nr. 6915 datë 15.10.2009 "Dërgim të dhënash".

Auditimi i Ministrisë së Mbrojtjes

256. Risjellim në vëmendje se Këshilli i Ministrave, në kohën që kryeministër ka qenë shtetasi Sali Berisha, ka miratuar VKM nr 1718 datë 24.12.2008 "Për procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar" (FZ 214 datë 31.12.2008, po në këtë datë ka hyrë në fuqi).

Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, në tentativa për të transformuar Klubin e Futbollit Partizani sipas VKM-së së mësipërme i është dashur të iniciojë një procedurë fillimisht gjyqësore, sipas padisë së datës 25.11.2010 për të kërkuar të drejtën e përdorimit të stemës e më pas të procedojë me regjistrimin e shoqërisë tregtare.

Pas vendimit gjyqësor nr. 8824 dt 07.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur rrëzimin e padisë, me nr 12071 dt 23.12.2011 me objekt "Vlerësimin e veprimtarisë ekonomike financiare në ish Komandën Mbështetëse (ish Reparti Ushtarak nr. 4001), Tiranë" Ministri i Mbrojtjes ka vendosur ushtrimin e auditimit në ish Komandën Mbështetëse (ish Reparti Ushtarak nr. 4001) Tiranë. Sipas raportit final (grupi i punës i përbërë nga Agim Zenelaj dhe Tonin Tuci dhe drejtore e auditit të brendshëm Bardha Kola), përcjellë me shkresën nr 7557 prot dt 28.06.2012 të drejtores së drejtorisë së auditimit të brendshëm pranë MM Brigadës logjistike repartit usharak nr 4300, (një ditë pas vendimit të Gjykatës së Apelit nr 1698 dt 27.06.2012 që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me mosdhënien të drejtë të përdorimit të stemës), është pasqyruar në pikën 5 të tij se: ...Referuar formularit nr. 6 të bilancit "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të gendrueshme" (vlera bruto) 2009, gjendja e llogarisë 212, në mbyllje të ushtrimit është në shumën 29 286 476 lekë ku shtesa në shumën 11 412 095 lekë përbëhet nga 3 315 799 lekë e paargumentuar ndërsa shuma 8 096 296 lekë (e paraqitur si në shtesë ashtu edhe pakësim të llogarisë 212 të formatit nr. 6) përfaqëson vlerën e pronës nr. 11 "Klubi i Futbollit Partizani".

Për administrimin e kësaj prone si dhe në zbatim të detyrave të lëna në auditimin e mëparshëm, nga ish komandanti i KM ishte nxjerrë urdhëri i brendshëm nr. 6034/3 dt 16.10.2009 "Për marrjen në administrim dhe dorëzimin e pronës nr. 11 "Klubi i Futbollit Partizani", duke ngritur grupin e punës të përbërë nga N/kolonel Naim Ramaj, Kryetar n/kolonel Gjetë Bushi, n/kolonele Figali Golemi, Major Ahmet Roçi, Major Nikoll Tushi dhe reshter Gani Lata, anëtar. Nga grupi i punës është përpiluar proces verbali nr. 6034/3 prot dt 16.10.2009 dhe miratuar nga ish komandanti i KM, për marrjen në administrim të pronës nr. 11 Klubi i futbollit Partizani, ku shprehet se komisioni shkoi në vend dhe mori gjendjen në fakt sipas gjendjes kontabël, të dërguar nga Drejtoria e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit në MM me shkresën nr. 6915 dt 15.10.2009 "Dërgim të dhënash lidhur me vlerën në kontabilitet të pasurive të paluajtshme të Klubit të Futbollit Partizani" (sa dërguar fotokopje

e llogarisë vjetore të vitit 2000), bilancit si dhe dokumentacionit teknik të dërguar nga IGJU-ja (por pa bashkalidhur ndonjë praktikë të IGJU-s për këtë vlerësim) ku rezulton si më poshtë: Klubi i Futbollit Partizani, me vlerë kontabël viti 2000 në masën 9 951 139 lekë, amortizim 2000 – 2009 në vlerën 1 074 723 lekë, vlera kontabël e ngelur 8 876 416 lekë, me sip totale e pronës nga IGJU-ja 31002.5 m², vendndodhja rruga Frosina Plaku. Objektet: Ndërtesë 4 katëshe me sip 436.77 m²; Objekt një katësh me sip 22.78 m²; Truall me sip 30542.94 m². Në përpilimin e këtij proces verbali nga ana e komisionit të mësipërm, **nuk jepet informacion i saktë dhe i qartë për marrjen në dorëzim të pronës nr 11, pasi komisioni shprehet se shkoi në vend dhe mori gjendjen në fakt, sipas gjendjes kontabël, ku këto dy shprehje nuk kanë të njëjtin kuptim dhe nuk shprehin të njëjtën gjë.**

Si vlerë, është paraqitur vetëm vlera e objektit të marrë, sipas pasqyrimin në kontabilitet në bilancin e vitit 2000 (të dërguar nga Drejtoria e PPB në MM) por pa pasur parasysh e marrë në konsideratë rikonstruksionet që mund të jenë kryer gjatë kësaj periudhe në komponentët e kësaj prone, ndërsa amortizimi është llogaritur i plotë për gjithë periudhën.

Nga auditimi i kryer për regjistrimin e vlerës së pronës nr. 11 me emërtimin "Klubi i Futbollit Partizani" në vlerën 8 096 296 lekë, në librin e llogarisë së pronave të repartit, u konstatua se, për këtë objekt nuk është prerë dokument hyrje për marrjen në administrim, nuk është hapur kartelë për pronën, objektin dhe komponentët e saj, për pasojë nuk është pasqyruar në librat e llogarisë si hyrje, shtesë e AOT si dhe sipërfaqja e marrë në dorëzim nuk kuadron me sipërfaqen e përcaktuar në VKM nr. 515 datë 18.07.2003...me një diferencë prej 3002.5 m² (31 002.5 – 28 000).

Vlera e këtij objekti nuk është kontabilizuar, duke mos zbatuar rregullat e administrimit dhe standartet e kontabilitetit si dhe pikën 2 të urdhërit të brendshëm të Komandantit të KM nr. 6094/3 datë 16.10.2009 "Për marrjen në administrim dhe dorëzimin e pronës nr. 11..." edhe pse nga grupi i punës në përbërje Figali Golemi, Naim Ramaj dhe Nikoll Tushi është raportuar se janë kryer veprimet e kontabilizimit të pronës nr. 11 në llogarinë e Rep. Ushtarak nr. 4001 (KM) si në memon e dërguar më datë 16.10.2009 ish Komandantit të KM Gjeneral Brigade Xhemal Gjunkshi si dhe në informacionin e dërguar Sekretarit të Përgjithshëm me shkresën nr. 6094/1 datë 16.10.2009 me lëndë "Informacion mbi zbatimin e urdhërit të MM nr. 334 datë 13.03.2009 "Për dorëzim prone dhe lidhje kontrate".

Nga auditimi u kërkuan sqarime në grupit të punës në lidhje me informimin e gabuar për kontabilizimin e kësaj prone, të cilët nuk pranuan të japin shpjegimet e nevojshme **duke u shprehur se, e dinim të regjistruar në llogari këtë pronë.**

Sipas kontratës së mësipërme, në bazë të nenit 2, objekti i kontratës, është kalimi në pronësi private i objektit "Terrenet sportive dhe objektet e klubit të futbollit Partizani" me vendndodhje,... me sip totale 26 524 m²...nga 28 000 m² në bazë të VKM nr. 515 të vitit 2003, të inventarizuar si prona me nr. 11, ose **me një diferencë më pak në sasinë 1 476 m², duke mos dhënë asnjë sqarim për këtë diferencë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, i cili nuk i është referuar këtij vendimi në proces verbalin e marrjes në administrim të pronës nr. 11, "Klubi i Futbollit Partizani" protokolluar me nr. 6034/3 datë 16.10.2009.**

Nga grupi i punës është përpiluar proces verbali me nr. Prot 6034/3 datë 16.10.2009 dhe miratuar nga ish komandanti i KM për marrjen në administrim të pronës nr. 11 ...ku shprehet se, komisioni shkoi në vend dhe mori gjendjen në fakt sipas gjendjes kontabël të dërguar nga Drejtoria e Planifikimit...si dhe nuk është marrë për bazë VKM nr. 515 e vitit 2003...duke rezultuar diferenca e patrajtuar më sipër.

Opinionin e auditit është se: Për marrjen në administrimin dhe dorëzimin e pronës nr. 11...nga grupi i punës si dhe shefi i financës, nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të përcaktuara në kreun III Dokumentimi i veprimeve ekonomike financiare, neni 7 i ligjit nr. 9642 datë 25.12.1984....

neni 6 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, kapitulli I, pika 2 gërma c, dokumentat kontabël të VKM nr. 783 datë 22.11.2006...duke mos përcaktuar saktë pronën nr. 11 sipas komponentëve përkatës, përcaktuar në VKM nr. 515 të vitit 2003 për miratimin e listës..., nuk është prerë dokument hyrje për administrimin e saj, njëkohësisht nuk është prerë dokument dalje apo akt dorëzimi për dorëzimin e saj, nuk janë kryer regjistrimet në librin e llogarisë së AQT, për shtesën dhe pakësimin e tyre, **për pasojë rezultojnë diferencat si më poshtë:**

Kontrata e shitjes është bërë për sip totale 26 524 m²...nga 28 000 m² në bazë të VKM nr. 515 të vitit 2003, inventarizuar si prona me nr. 11, ose me një diferencë më pak në sasinë 1476 m², ndërsa krahasuar me proces verbalin e marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, referuar matjeve të IGJU-s, kjo sip është 31 002.5 m² dhe kjo diferencë arrin në sasinë prej 4 478 m².

Për parregullsitë e shkeljet e konstatuara sa më sipër, për këtë fushë llogarie, mbajnë përgjegjësi Naim Ramaj, Gjetë Bushi, Figali Golemi, Ahmet Roci, Nikoll Tushi, Gazni Lata, Armir Balili në zbatim të n. 23 të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004, nenit 71 gërma e të ligjit nr. 9936 të vitit 2008.

Nisja e ndërtimeve dhe financimi i tyre:

257. Ndërkohë, si edhe më sipër theksuar, shoqëria Kontakt sh.p.k. kishte nisur punimet për kryerjen e ndërtimeve, megjithëse ende nuk kishin përfunduar procedurat e privatizimit. Kjo evidentohet ndër të tjera edhe në memon e drejtorit të Sportit Violeta Shqevi, nr. 1800/3 prot datë 14.04.2008 drejtuar Ministrit të Turizmit Ylli Pango, ku i është parashtruar se, nga Drejtuesi i Klubit Shumësportesh Partizani, është ngritur një shqetësim që është verifikuar në vend, nga ku ka rezultuar se, vendi i ish fushave të basketbollit, është rrethuar për të filluar punimet.

Nga aktet e sekuestruara, pranë studio Pustina, është administruar një dosje me kapak me ngjyrë të zezë, e cila mban sipër një inventar me emërtimin "Dosja e vitit 2010- Homeplan sh.p.k.", me dorëzues dokumentacioni Eksperte kontabël Shpresa Breçani dhe nënshkruar në pjesën e sipërme të faqes së parë të këtij dokumenti edhe nga shtetësja Odeta Fishta. Nga një dokument, me emërtimin "Homeplan – arka leke", bashkalidhur këtij inventari, konstatohet se për vitin 2008, pasqyrohet depozitim më datë 25.11.2008 nga shtetasi Fatmir Bektashi të shumës prej 100 000 lekë. Në këtë vit janë pasqyruar edhe shpenzime të bëra për taksë të gjelbër, taksë vendore kësti I, taksë pastrimi, taksë tabelë.

Sipas Urdhërit nr. 4136 datë 17.12.2008 të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Tiranë, është urdhëruar **Bllokimi i ambjenteve me pronarë të paregjistruar për efekte fiskale pranë DPTTV**, Bashkia Tiranë, në të cilat ushtron aktivitet tregtar taksapaguesi Homeplan, me adresë Rruga Budi. Bashkalidhur gjendet një letër me shkim dore e nënshkruar nga shtetasi Genci Bektashi, me këtë përmbajtje: "Znj.Laura, Lidhur me adresën e Homeplan, Bashkia Tiranë, kërkon taksë për zyrën e selisë së Homeplan. Ndoshta duhet bërë një kontratë midis pronarit F.Bektashi dhe Homeplan sh.p.k. për dhënien me qera të një sipërfaqe ndoshta 10 m² me qëllim pagimin e taksës zyres."

257.1. Nga aktet rezulton se, fillimi i punimeve, është formalizuar nga shoqëria Kontakt, vetëm në vitin 2010, kohë kur ka nisur një proces gjyqësor mbi detyrimin e Bashkisë Tiranë për zbardhjen e lejes së ndërtimit, por që ndërkohë nuk rezulton të ishte konkluduar nga gjykata me vendim. Konkretisht rezulton sipas proces verbalit konstatim për fillim punimesh me nr. 366 prot mbajtur ndërmjet shtetasve Fatmir Bektashi, si përfaqësues i shoqërisë Kontakt

sh.p.k. dhe shtetasve Loren Bami dhe Shpëtim Dervishi si përfaqësues i shoq Synergy – 21 sh.p.k. në lidhje me konstatimin e fillimit të punimeve për pilotim dhe përforcim punimesh nëntokë, gjatë ose mbas procesit për gjermim dherash dhe punime shtresash me qëllim dorëzimin e gropës së gatshme për të filluar themelet sipas matjeve topografike në objektin Homeplan faza A, mban datën **22.02.2010** (ndërkohë në krah të nr të protokollit është pasqyruar data 21.04.2010).

Në datë **23.03.2010** (nr. 367 prot datë 21.04.2010) shtetasit Fatmir Bektashi dhe Shpëtim Dervishi, respektivisht për shoq Kontakt sh.p.k. dhe Synergy – 21 sh.p.k., mbajnë proces verbal **për shtyrjen e afatit** për përfundimin e punimeve të pilotimit/përforcimit të punimeve nëntokë. Arsyet që kanë bërë të pamundur realizimin e detyrimeve të nënsipërmarrësit dhe në bazë të të cilave kërkohet dhe miratohet shtyrja e afateve janë: *Përkeqësime të motit me rreshje shiu të vazhdueshme, Konflikte (të cilat pasqyrohen edhe në disa fotografi) me Avni Hasa, komshi i z. Avni, Viktor Pola, Paro Laçi, Albert Xhani; Devijim i kanaleve të ujërave të zeza pa leje (punime të kryera nga z. Pullumb Bajrami). Nga motivet e sipërpërmendura rezultojnë, pezullimi i punimeve për 15 ditë kalendarike, afat kohor i cili i shtohet afatit 14 ditor të parashikuar në kontratë (22.02.2010 – 08.03.2010) ndaj afatit maksimal për realizimin e punimeve të marra përsipër, shtyhet deri në datë 23.03.2010.*

257.2. Shoqëria Kontakt sh.p.k. me NIPT J92108006V, me ortak dhe administrator shtetasin Fatmir Bektashi, me shkresën nr. 197 prot datë 25.03.2010 njofton QKR, se do të fillojë punimet për ndërtim banesë 7 – 9 dhe 1 – kat parkim nëntokë në rrugën Frosina Plaku Tiranë dhe kërkon pajisjen me NIPT sekondar.

258. Financimi i zhvillimit të ndërtimit, duket se bëhet fillimisht nga shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe vetë shtetasi Fatmir Bektashi, derisa fillojnë të mbliidhen të ardhura të mjaftueshme nga porositë/shitjet e objekteve të premtuara/porositura për ndërtim nga shoqëria Homeplan sh.p.k..

Sipas aktit të ekspertimit kontabël por edhe si rezultojnë nga tërësia e akteve, në vitet e para të aktivitetit shoqëria Homeplan sh.p.k. është financuar nga shtetasi Fatmir Bektashi, ku në vitin 2008 ka depozituar 255 450 euro dhe nga shoqëria Kontakt sh.p.k. e cila në vitin 2008 ka financuar 230 000 euro. Në vitin 2010 është financuar nga shtetasi Fatmir Bektashi që ka depozituar 378 050 euro dhe 3 471 000 lekë dhe nga klientë për blerje pronash 3 534 991 euro dhe 7 580 000 lekë.

258.1. Shtetasi Fatmir Bektashi, merr kredi pranë **Union Bank**, pasqyruar ky fakt, në kontratën e kredisë bankare, me nr nr. 6946 rep nr. 1532/3 kol dt **22.12.2009** të lidhur me shoqërinë **Kontakt sh.p.k.** në cilësinë e kredimarrësit si dhe vetë shtetasi **Fatmir Bektashi**, në cilësinë e dorëzanësit. Sipas kësaj kontrate, rezultojnë se banka i jep kredimarrësit, një limit kreditor në formën e një linje overdrafti dhe një kredie standarte (me ripagim me këste mujore) sipas limiteve të përcaktuara më poshtë **për qëllimin e vetëm të financimit të nevojave të kompanisë, për mjete xhiro**. Limiti total i tërheqjes së linjës së overdraftit të akorduar është **200 000 euro** dhe limiti total i tërheqjes së kredisë standarte (me ripagim me këste mujore) të akorduar është **650 000 euro**. Për të garantuar këtë kredi, kredimarrësi vendos garanci dy pasuri e konkretisht: **Truall dhe arë**, respektivisht me nr pasurie 7/23 dhe 7/24 ZK 2679 me adresë Mezez, Tiranë, në pronësi të dyja këto pasuri të shtetasit **Fatmir Bektashi**. Po në këtë datë, lidhet edhe kontrata e hipotekës nr. 6947 rep nr. 1533/3 kol dt **22.12.2009** ndërmjet Union Bank dhe shtetasve **Fatmir Bektashi** dhe **Aneta Bejko (Bektashi)**, mbi vënien në hipotekë të pasurive të sipërcituara. ...Pronat që hipotekohen në favor të Bankës shërbejnë si mjet sigurimi për të garantuar bankën për shlyerjen e çdo kredie ekzistuese dhe të ardhshme ...

dhe të gjitha detyrimeve të lidhura me to, që Banka i ka dhënë dhe do t'i japë kredimarrësit (Kontakt sh.p.k.), deri në limitin kreditor të akorduar prej 1 000 000 euro.

258.2. Gjithashtu, nga aktet e sekuestruara pranë studio Pustina, konkretisht dosja me kapak me ngjyrë të zezë, e cila mban sipër një inventar, me emërtimin "Dosja e vitit 2010- Homeplan sh.p.k." me dorëzues dokumentacioni Eksperte kontabël Shpresa Breçani dhe nënshkruar në pjesën e sipërme të faqes së parë të këtij dokumenti edhe nga shtetësja Odeta Fishta, në një dokument bashkalidhur këtij inventari, dokument me emërtimin "Homeplan – arka leke" konstatohet se për vitin 2010 pasqyrohen sa më poshtë:

- 23.03.2010 - Derdhje Fatmir Bektashi – 500 000 lekë
- 30.04.2010 – Xhirim në arka... 124 968.04 lekë; 01.06.2010403 825.50 lekë; 19.07.2010 – 406 800 lekë; 14.12.2010 – ...278 520 lekë

Më datë 13.12.2010, është bërë shënim " Rimbursim paradh Fatmiri"; më datë 30.12.2010 "Rimbursim paradh. Fatmir Bektashi" në vlerën 600 000 lekë" dhe në vijim i është hequr një shënim me stilolapës duke u përcaktuar si 580 000 lekë.

Në një tabelë tjetër me emërtimin Homeplan – arka euro është pasqyruar: 19.03.2010 derdhje paradh për pagesa Fatmiri 1 700 euro; dhe më pas janë pasqyruar Derdhje në arkë Fatmiri më datë 30.04.2010 - 908 euro; 01.06.2010 – 3000 euro; 19.07.2010 - 3 000 euro; 13.12.2010– 1700 euro; 14.12.2010 - 2 000 euro

Sipas dokumentit të ekstraktuar nga Hard disku i jashtëm, sekuestruar pranë studio Pustina, dokument i emërtuar si "10 Format bilanc Homeplan" në formatin excel, në faqen "details 2010" evidentohen ndër të tjera se për shtetasin Fatmir Bektashi pasqyrohen kreditime si vijon:

- a) Fatmir Bektashi ALL vlera 19 875 lekë (me shënimin se Ortaku 35 698 100.60 – Financa 1: Kam zbritur 100 000 lekë për derdhje kapitali);
- b) Fatmir Bektashi euro – 260 800 euro ose 36 191 216 lekë
- c) Kontakt sh.p.k. ose 312 609.91 euro ose 43 380 044.59 lekë

Në një dokument të sekuestruar pranë studio Pustina, i lëshuar nga shoqëria Homeplan sh.p.k. nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe konceptuar nga asistente financiare Denada Dosti, me nr. 234 prot datë 01.04.2010 me lëndë "Lista e faturave dhe dokumentave drejtuar zyrës kontabile Pustina" pasqyrohet se: "Poshtë shënuar janë lista e dokumentave që do i dërgohen zyrës kontabile"... Evidentohen të renditura, dokumenta si fatura tatimore shitje, statement bankar... Dorëzimi i dokumentave të tilla, ka vijuar për disa kohë, ku më datë 20.04.2010, 19.05.2010, në krah të nëshkruarit Fatmir Bektashi, është vendosur emri i shtetases Andia Pustina, megjithëse kjo e fundit rezultonte të ishte e puënsuar pranë AKSHI-t. Kjo shtetase, vijon të nënshkruajë këto dokumenta herë pas here.

Mesa duket, shtetasi Fatmir Bektashi dhe shoqëria Kontakt sh.p.k., në bashkëpunim me shtetasit Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi, kanë kryer pagesa jo vetëm në drejtim të financimit por edhe të një sërë personash apo shoqërisë të tjera, në formën e asaj që ata e quajnë shpesh "kontribut patriotik". Sipas dokumentit të ekstraktuar nga Hard disku i jashtëm, sekuestruar pranë studio Pustina, dokument i emërtuar si "10 Format bilanc Homeplan" në formatin excel, në faqen "details 2010" evidentohet ndër të tjera se, për shtetasin Marin Biçoku është bërë përshkrimi për një debi në fund të vitit 2010 në shumën 62 302.50 euro ose 8 645 094.90 lekë.

258.3. Përgjatë zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k., konstatohet se shtetasit Jamarbër Malltezi, Fatmir Bektashi dhe Xhimi Begeja, pagesën e

privatizimit, gjithmonë e kanë vlerësuar si investim dhe për këtë arsye kanë lënë edhe gjurmë duke u derdhur paratë nga shoqëria Kontakt sh.p.k. apo shtetasi Fatmir Bektashi, në drejtim të shoqërisë Homeplan sh.p.k. Nga ekspertimi i hard diskut, sekuestruar pranë zyrës Pustina, rezultojnë gjendet një dokument në Word, me emërtimin "Email dt. 24.03.2011 (mospërputhje në 467)" dokument i krijuar më datë 24.03.2011 dhe i ruajtur për herë të fundit po në këtë datë. Emaili ka përmbajtjen si më poshtë: "Pershendetje Z. Artan, Pas verifikimeve tona per llogarite 467 te subjektit "Kontakt" shpk kemi mosperputhje te mbartjes se gjendjes nga viti 2008-2009 per llogarine 467 ne ALL, perkatesisht:

Gjendja sipas "Kontakt" 467 Homeplan Debitore per 2.021.800 leke.

Gjendja sipas "Homeplan" 467 Kontakt Debitore per 60.187.145 leke.

Kjo gjendje vjen nga transfertat e kryera prane bankes "Union Bank", valuta ALL, si me poshte:

29/10/2008 Kalim për Kontakt për Priv. Klubi Partizani 30 380 000.00; 29/10/2008 Kalim për Kontakt për Priv. Klubi Partizani 27 883 658.00; 30/10/2008 Kalim për Kontakt për Priv. Klubi Partizani 1 923 487.00. Totali 60 187 145.00

Gjithashtu z. Fatmir ka kryer gjate vitit 2010 pagesa per 314.000 leke per llogari te shoqerise "Kontakt" per gjoba per bllokimin e pronave te pronareve te truallit.

Ju lutem te kryeni verifikimet Tuaja per sa me siper si dhe per mosrakordimet e meparshme sipas e-mailit te meposhtem. Faleminderit dhe gjithë te mirat, Odeta Fishta"

Kalimi në llogaritë e shoqërisë Homeplan sh.p.k., është bërë fiktivisht, pasi origjina e kësaj pagese, siç shihet, është po nga shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe shtetasi Fatmir Bektashi. Gjithashtu, nga aktet e gjendura në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt shpërbllim dëmi, me nr. 2653 të vitit 2011 vendimi, konkretisht statement bankar, të llog bankare të Kontakt sh.p.k. Union Bank, me nr ... 3102 0122 në euro, konstatohen më së miri se paratë që ndodhen në Homeplan i kalojnë shoqërisë Kontakt sh.p.k. ndërkohë që është po kjo e fundit që i kalon tek Homeplan. Kështu ndër të tjera rezultojnë se, më dt 15.03.2010 bëhet një transfertë e brendshme Homeplan sh.p.k. për Kontakt sh.p.k. për tender Kontakt sh.p.k. në vlerën 35 000 euro dhe po në të njëjtën datë 15.03.2010 Kontakt sh.p.k. i transferon Homeplan sh.p.k. për tender Kontakt 35 000 euro; Dt 23.08.2010 Transfertë e brendshme Kontakt sh.p.k. për Homeplan sh.p.k. likujdim 6 500 euro; Dt 24.08.2010 Transfertë e brendshme Kontakt sh.p.k. për Homeplan sh.p.k. likujdim 6 000 euro; Dt 30.08.2010 Transfertë e brendshme Kontakt sh.p.k. për Homeplan sh.p.k. likujdim detyrimi 13 000 euro; Dt 10.09.2010 Transfertë e brendshme Kontakt sh.p.k. për Homeplan sh.p.k. kalim fondi 13 000 euro.

259. Gjithashtu, konstatohet se në periudhën që ende nuk ishte zbardhur leja e ndërtimit apo nuk ekzistonin vendime gjyqësore për detyrimin e Bashkisë për zbardhjen e saj, lidhen edhe kontrata të ndryshme për kryerje punimesh etj. Këto kontrata vijojnë normalisht të lidhen edhe pas marrjes së vendimit gjyqësor për detyrimin e Bashkisë për zbardhjen e lejes së ndërtimit. Sidoqoftë këtu pasqyrohen për të treguar aktivitetin e nisur të ndërtimit.

Në vitin 2010 konstatohet se shpenzime ka pasur për disa subjekte, të identifikuarat pagesat me numër fature ku mes tyre evidentohet subjekti Breçani Rosp. Nga këqyrja e ekstraktit e Historik të subjektit "Breçani R.O.S.P" me Nipt K52116005E, rezultojnë se administrator është shtetasi Fatbardh Breçani. Kjo shoqëri konstatohet se më datë 30.06.2009 ka caktuar si eksperte kontabël shtetasen Shpresa Breçani. Shtetasi Fatbardh Breçani, rezultojnë të jetë vëllai i shtetasit Erzen Breçani. Ky i fundit siç rezultojnë në vijim, ka qenë në drejtimin e Komisarariatit të Policisë nr 2 në kohën që shtetasit Fatmir Bektashi, Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja konfliktoheshin me shtetas të ndryshëm që banonin apo punonin në këto territore.

Gjithashtu, për datën **04.06.2010** është bërë shënim me stilolaps për një pagesë **40 000 euro konvertuar në lekë për Standart Alb.** Pra, ndër personat që kanë ofruar shërbimet e tyre për zvillimin e ndërtimeve, natyrisht gjendet me vend të përmendet shtetasi **Besnik Dervishi**. Referuar vitit 2010, nga ekspertimi i laptopit të sekuestruar shtetases Andia Pustina, i markës SONY, model PCG-7T1L, me product Key K873M-6JMJ, me barcode 00045-830-720-227, ekspertim ky i pasqyruar në aktin me nr. 149 datë 11.08.2023 është evidentuar një dokument në formatin Word, me nr 11 prot datë **11.12.2010**, i panëshkruar, me lëndë: *Shqyrtim situacioni nr. 3, objekti C, për periudhën nëntor 2010, në objektin Rezidencë banimi 5 – 7 – 9 katësh, rruga Frosina Plaku, drejtuar shoqërive Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k.* Ky dokument në fund në rubrikën “Për Supervision Profesional sh.p.k.” mban emrin e administratorit ing **Besnik Dervishi**, por është i panëshkruar. Ky dokument, ka si autor “Veranda”, last saved nga “Beso” dhe përmbajtja e tij është krijuar më datë 10.12.2010 ora 12.32.

259.1. Nga shqyrtimi i dokumentave të administruara, përgjatë këtij hetimi, konstatohet se rezultojnë të lidhura kontrata si nga shoqëria Homeplan sh.p.k. për ndërtimin që do të realizohet, faza A, për kompleksin Rezidencial Homeplan ashtu edhe nga shoqëria Kontakt sh.p.k.

260. Në këtë kohë, nga aktet rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. merr përsipër edhe të lidhë kontrata qeraje për objektet sportive. Në këto kontrata qeraje, pasqyrohet sikur shoqëria Homeplan sh.p.k. do të kryejë edhe punime në objektet që jep me qera me qëllim përshtatjen e tyre në zyra, duke pretenduar që edhe të paguhet për këto përshtatje. Nuk evidentohet të ketë pasur leje nga organet kompetente për kryerje të këtyre punimeve. Të paktën vetëm nga disa kontrata të identifikuar përgjatë hetimit, shoqëria Homeplan sh.p.k. ka premtuar në kontratat e periudhës 09.03.2010 deri më 21.04.2010 kryerjen e punimeve për përshtatje ambjentesh për zyra në shumën prej 34 166,18 euro. Konstatohet gjithashtu se si qeramarrës shfaqen ndër të tjerë subjekte të cilat kanë lidhur kontrata për qëllime të ndryshme me shoqërinë Kontakt sh.p.k. apo shoqërinë Homeplan sh.p.k. si Synergy 21 sh.p.k. për qëllime të tjera (kontrata e datës 16.04.2010/19.04.2010 me nr 343 prot) apo shoqëria DNX Nitro Industria Kimike sh.p.k. (datë 09.03.2010). Shumat mujore të qerave, variojnë sipas subjekteve nga 820 euro deri në 1 085 euro.

E pyetur më datë 28.05.2024 shtetësja **Aurela Tahiri** e cila ka punuar pranë shoqërisë DNX Nitro si ekonomiste, ka deklaruar se kjo shoqëri ka pasur si objekt import dhe tregtim të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe në periudhën 2007 – 2009, si klient kryesor ka qënë shoqëria Bechtel Enka që do të kryente punimet e rrugës Durrës – Kukës, ku shoq DNX Nitro ka qënë një ndër nënkontraktorët e saj. Ajo tregon në lidhje me një marrëdhënie kontraktore me shoqërinë Kontakt sh.p.k. , ku kjo e fundit ishte kontraktuar për të ndërtuar disa depo për magazinimin e lëndëve plasëse dhe një kapanon për prodhimin e këtyre lëndëve, në Zall Herr. Në këtë periudhë shoqëria DNX Nitro ka shkuar me zyra pranë ish Klubit Partizani. Në deklarinim e datës 26.06.2024 kjo shtetase ka deklaruar se kanë ndërruar selinë me vendosjen e marrëdhënieve me shoqërinë Kontakt sh.p.k. duke u zhvendosur në ambjentet e objekteve sportive Partizani. Në këto zyra kanë qëndruar nga viti 2010 – 2012. Zyrat që morën ish-in 6 ambjente të vogla dhe nuk u bë ndonjë investim kur kanë hyrë, vetëm është vendosur ndonjë derë dhe mbase lyerje e mirëmbajtje.

Ndër qeramarrësit, evidentohen edhe shtetasi Xhimi Begeja, që merr ambjent për zyra në katin e tretë të ish Klubit Shumësportesh Partizani (shih kontratën datë 19.04.2010) dhe çuditërisht

shoqëria **Homeplan sh.p.k.**, i jep me qera shoqërisë Kontakt sh.p.k. ambiente zyrash po në të njëjtin klub. Shoqëria Homeplan sh.p.k. deri në këtë moment shfaqet si investitore por nuk evidentohen tagre të dhëna nga pronarët për këtë shoqëri për lidhjen e këtyre kontratave.

261. Shtetasi Xhimi Begeja, duket i aktivizuar maksimalisht në aktivitetin e shoqërisë Homeplan dhe vërehet se nënshkruan dokumenta financiarë siç janë faturat tatimore të shitjes, në rubrikën e blerësit (*shih ato të lëshuara nga shoqëria Breçani R.O.S.P. për shoqërinë Homeplan sh.p.k. për muajin dhjetor 2010; për Dealb Konstruksion sh.p.k. datë 24.09.2010; për subjektin Alban Prifti, nr. 05 datë 06.05.2010*), megjithëse nuk rezulton të ketë asnjë rol në shoqërinë Homeplan sh.p.k. apo Kontakt sh.p.k.

262. Më datë **01.11.2010** nga pasqyra e të punësuarëve rishtazi dhe e të larguarëve nga puna është pasqyruar se, **shtetasi Sokol Barçi** deklarohet pranë organeve tatimore, si i punësuar nga data 02.11.2010, pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k.

Lidhja e kontratës së sipërmarrjes me familjen Vaqarri dhe Alimehmeti dhe premtimi për ndryshim destinacioni

263. Në vitin 2010, konstatohet se merret përsipër ndryshimi i destinacionit të ndërtimit edhe për pjesën tjetër të pasurisë.

263.1. Sa më sipër, rezulton nga kontrata që lidhet me trashëgimtarët e familjes **Vaqarri**, trashëgimtar i së cilës është edhe vetë shtetasi Fatmir Bektashi. Me kontratën nr 1466 rep nr 421 kol datë **03.05.2010** të lidhur para noteres Gentiana Shkodra, ndërmjet shtetasve *Petrit Bektashi, Genc Bektashi, Fatmir Bektashi*, të tre në cilësinë e trashëgimtarëve të Fitnet Bektashi; *Fiqiri Vaqari, Kumrije Arapi, Milva Arapi, Lilana Shanto (Arapi), Luan Arapi, Arben Arapi, Fiqerete Vaqari, Eva Vaqar, Igli Vaqari*, në cilësinë e **palës pronare dhe shoq e ndërtimit Kontakt sh.p.k.** në cilësinë e palës investitore, në nenin 1, parashikohet se pala pronare ka në pronësi të saj:

1. *Pasuri e regj në regj hip me nr 6294 datë 05.09.1996 të ZVRPP Tiranë ku janë bashkëpronare në pas me sip 3050 m2 truall në rrugën Frosina Plaku Tiranë*
2. *Pasuri e regj në regj hip me nr 412/8220 datë 15.06.2007 të ZVRPP Tiranë, pasuri me nr 3/159, ZK 8220 truall i lirë SL-10 975 m2 në Lagjen e Re të Tiranës, Sinori Shëngjin aktualisht rruga Frosina Plaku*
3. *Pasuri e regj në regj hipotekor nr 739 datë 03.11.2009 të ZVRPP Tiranë bashkëpronarë në pjesë të pandara mbi pasurinë, nr ND 3/189 dhe ND 3/190 ZK nr 8220 sip Sn1=494 m2 dhe Sn2=25 m2, me përshkrim: 1) ndërtesë 2 dhe 4 kate me sip ndërtimore 494 m2 (ish Klubi i Futbollit Partizani); 2) ndërtesë me sip 25 m2 (ish Klubi i Futbollit Partizani) të ndodhur në rr. Frosina Plaku në bashkëpronësi me familjen Begeja, Llagami, Saliaga dhe Alimehmeti.*

Pala pronare, vë në dijeni palën investitore se, në lidhje me pasurinë e regjistruar në regjistrin hipotekor nr 6294 datë 05.09.1996 të ZRPP Tiranë me sip 3050 m2 ka mbivendosje dhe ndërtime pa leje si dhe një rrugë të asfaltuar.....**Pala investitore pranon...të kryejë...me shpenzimet dhe me mjetet e veta, të gjitha procedurat e nevojshme për ndërrimin e destinacionit të saj nga zonë sportive në zonë banimi në favor të palës pronare.** Investitori merr përsipër të pastrojë truallin nga ndërtimet pa leje nga mbivendosjet si dhe nga linjat e infrastrukturës dhe spostimin e tyre si dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet që mund të lindin me persona të tretë. Investitori merr përsipër shpenzimet për kryerjen e këtyre veprimeve.

...Pala investitore me shpenzimet e veta, pasi të ndryshojë destinacionin, të krvejë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit dhe marrjen e lejes së ndërtimit sipas specifikimeve: Pronar trualli – familja Vaqari, sip investitor shoq Kontakt sh.p.k. Gjithashtu pala investitore do të ndërtojë, në truallin e vënë në dispozicion si më sipër nga pala pronare kompleksin shumëfunksional me parkime, dyqane, zyra dhe apartamente, në përputhje me planin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës....Pala pronare në shkëmbim të titullit të pronësisë mbi truallin, do të marrë nga pala investitore titull të plotë pronësie mbi 25% të sip së përgjithshme të ndërtimit të ri për secilin komponent.

263.2. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 9284 rep nr. 2687 kol datë 27.09.2010, para noterit Julian Zhelegu, rezulton se familja Alimehmeti e konkretisht shtetasit *Fiqiri Alimehmeti, Xhafer Alimehmeti, Fehmi Alimehmeti, Fatbardha (Marika) Alimehmeti, Alma (Sulo) Mullici, Genci Mullici dhe Skënder Mullici*, dhe shoqëria *Kontakt* sh.p.k. e përfaqësuar nga Fatmir Bektashi, lidhin kontratën duke pasqyruar se pala pronare, ka në pronësi një sip toke truall prej 7 930 m² me nr pasurie 3/158 dhe 3/157 ZK 8220 të regjistruar në regj hipotekor nr. 411 datë 15.06.2007. Objekti i kontratës është të prodhojë dhe sanksionojë një marrëveshje, ndërmjet palës pronare dhe sipërmarrëse me qëllim zhvillimin e truallit.

Sipas nenit 3 përcaktohet se pala sipërmarrëse (Kontakti) ka krver të gjitha procedurat ligjore dhe ka marrë përsipër të gjitha shpenzimet lidhur me privatizimin e ish ndërmarrjes sportive Partizani. Pala pronare dëshiron që të ndryshojë destinacionin nga zonë sportive në zonë banimi me qëllim ndërtim objektesh banimi mbi tokën truall pronë e saj duke përfshirë edhe sipërfaqen shtesë të tokës truall që është përfutur nga privatizimi.

Me qëllim përfundimin sa më parë të procedurave të mësipërme, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse, truallin objekt të kësaj kontrate dhe jep pëlqimin për prishjen e ndërtesave ekzistuese të ndodhura mbi pasurinë në bashkëpronësi me familjet Begeja, Llagami, Saliaga dhe Llagami, pas me nr. ND 3/189 dhe ND3/190 ZK 8220 në regj hipotekor me nr 739 datë 03.11.2009, me sip ndërtimi SN=494 m² (përshkrimi: një ndërtesë 2 dhe 4 kate me sip ndërtimore 494 m² e ndodhur te ish Klubi i Futbollit Partizani) dhe SN2=25 m² (përshkrimi ndërtesë me sip 25 m² ish Klubi Sportiv Partizani e ndodhur në Rr.Frosina Plaku). Pala sipërmarrëse, pranon të marrë truallin e vendosur në dispozicion nga pala pronare dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ndryshimin e destinacionit të këtij trualli nga zonë sportive në zonë banimi si dhe zhvillimin e objekteve mbi të, sipas studimit urbanistik të Bashkisë së Tiranës.

Pasi të nxirret leja e sheshit, 1/5 e sip së përgjithshme të truallit në pronësi të familjes Alimehmeti mbi të cilën është miratuar leja e sheshit të ndërtimit, do të zhvillohet nga kompania *Eralb sh.p.k.* (Kjo shoqëri, me NIPT J91712002C ka si administratore *Alma Sulo (Mullici)* dhe ortak *Ferdinand Sulo, Alma është vendosur si administratore më datë 31.12.2019*).

Pala pronare do të marrë si kompensim për truallin e vënë në dispozicion, 25% të sip së përgjithshme të ndërtimit që do të ndërtohet nga shoq Kontakt sh.p.k. Me sip të ndërtimit do të kuptohet gjithë sip e ndërtimit e realizuar edhe në tokat e trashëgimtarëve të familjeve **Mahmut e Xhemal Begeja, Qamil Saliaga, Dylbere Vaqari, Rexhep Alimehmeti** që janë kufitarë të sip pjesë e kësaj kontrate.

Sipas nenit 6 pala sipërmarrëse ka të drejtë dhe merr përsipër si më poshtë: a) Pala pronare i vë në dispozicion palës sipërmarrëse dokumentacionin e nevojshëm për të kryer veprimet administrative dhe për të realizuar: Kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilën ndodhet trualli nga zonë sportive në zonë banimi; Marrjen e lejes së sheshit të ndërtimit; Marrjen e lejes së ndërtimit për 4/5 e sip në fjalë; Merr përsipër të përballojë tërësisht me shpenzimet e

veta finaciare e të gjitha procedurave administrative dhe burokraktike të nevojshme për kryerjen e sipërmarrjes që rrjedh nga kjo kontratë sipërmarrje. ...

264. Vetëm më datë **04.12.2010**, ortaku i vetëm i shoqërisë **Homeplan sh.p.k.**, shtetasi Fatmir Bektashi, vendos që selia e shoqërisë të jetë në rruga Frosina Plaku nr. 40, Tiranë. Kurse shoqëria Kontakt sh.p.k. më datë 04.01.2011 ndryshon selinë nga Komuna e Parisit në rruga Frosina Plaku, nr. 400 AL – 1009, Tiranë.

Zbardhja e lejes së ndërtimit dhe miratimi i ndryshimit të saj

Gjykimi për zbardhjen e lejes së ndërtimit

265. Konstatohet se ndërtimi kishte filluar, por leja e ndërtimit që ishte vendosur të zbardhej me faza, nuk ishte zbardhur ende.

Me kërkesën nr. 19007J prot datë **09.11.2009** K - 18594 shoqëria Kontakt sh.p.k. i është adresuar Bashkisë Tiranë, duke kërkuar zbardhjen e lejes së ndërtimit nr. 61 datë 26.02.2008 dhe 61/1 datë 26.02.2008 në emër të subjektit ndërtues Kontakt sh.p.k. në rrugën Frosina Plaku.

265.1. Më datë **27.01.2010** (shih dosjen gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. 2433 vendimi datë 26.03.2010), konstatohet se shtetasi **Xhimi Begeja** dhe shoqëria "**Kontakt**" sh.p.k., investojnë me padi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke paditur Bashkinë Tiranë, Këshillin e Rregullimit të Territorit, me objekt detyrimin për të lëshuar aktin për të zbardhur lejen e ndërtimit. Shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe shtetasi Xhimi Begeja, në bazë të prokurës me nr. 293 rep nr. 123 kol datë 29.01.2010 rezulton të jenë përfaqësuar nga av. **Sokol Barçi**.

266. Pala e paditur, Bashkia Tiranë, ka prapësuar se, *pala paditëse ka bërë kërkesën për zbardhjen e lejes së ndërtimit vetëm për fazën A, për më tepër vetë subjekti e ka kërkuar lejen e ndërtimit të pjesshme, ndërkohë që objekt gjykimi është edhe faza B. Sipas ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 "Për urbanistikën" i ndryshuar, kërkesa për leje ndërtimi, kryhet sipas formularit nr. 3 dhe 3/1 pjesë integrale e këtij ligji. Në nenin 45, disponohet se kërkesa për leje ndërtimi, bëhet sipas formularëve 3 dhe 3/1 pjesë e ligjit, përveç lejeve të ndërtimit për projektet e infrastrukturës rrugore.*

267. Me vendimin nr. 2433 datë **26.03.2010**, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur, detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga kryetari i saj me cilësinë e kryetarit të Këshillit të Rregullimit të Territorit, të zbardhë aktin administrativ, të përfaqësuar nga vendimi nr. 61 datë 22.02.2008 për Fazën A dhe Fazën B në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1297 datë **01.07.2010** të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërkohë që me vendimin nr. 00-2013-1943 datë **27.09.2013** Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të Bashkisë Tiranë.

Gjykimi për shpërblimin e dëmit

268. Në kohën që shoqërisë Kontakt sh.p.k. i nevojitej financim në lidhje me vazhdimin e punimeve, i ka lindur mendimi, që të investonte gjykatën dhe të kërkonte nga Bashkia Tiranë shpërblimin e dëmit të pretenduar se u ka ardhur, nga moszbardhja e lejes. Me autorizimin nr 726 prot datë **20.07.2010**, shoqëria Kontakt sh.p.k., autorizon av. Sokol Barçi për ta përfaqësuar në këtë gjykim, mbështetur në kërkesë padinë e nënshkruar më datë 09.07.2010

dhe depozituar më datë **16.09.2010** (shih dosjen me nr 2653 vendimi datë 06.04.2011). Sipas mandatit të BKT-së datë **28.12.2010**, është pasqyruar edhe pagesa e taksës së padisë në vlerën 371 935 lekë.

269. Përgjatë kohës që zhvillohej gjykimi, rezulton se Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Bashkia Tiranë, me vendimin "*Për pezullimin e punimeve në ndërtim*" nr. 127 datë **29.10.2010**, (nr. 1323 prot datë 19.11.2010) ka pasqyruar se në bazë të proces verbalit datë 25.10.2010 me nr serie 006332 të mbajtur në subjektin juridik Kontakt sh.p.k., ka rezultuar se është kryer kundravajtja *Punime për hapje grope për ndërtimin e një objekti pa leje ndërtimi*. Për këto arsye, **ka vendosur pezullimin e punimeve të ndërtimit** për afatin 10 ditor. Ky vendim pezullimi është pasndjekur edhe nga një vendim "*Për dënimin me gjobë*" nr. 428 datë **29.10.2010**, (nr. 1323 prot datë 19.11.2010) për shoqërinë Kontakt sh.p.k. në masën 500 000 lekë.

Me proces verbalin datë **24.12.2010** "*Për shqyrtimin e kundërfirmosjeve të studimeve urbanistike të projekteve e shesheve të ndërtimit*" të Sektorit të PMNZSH-së, pranë prefektit të Qarkut Tiranë, rezulton që për subjektin Kontakt sh.p.k. për objektin *Godinë banimi 7 – 5 kat, 1-2 kat A/P, që lidhet me formularin nr 3 të kërkesës për miratimin e lejes së ndërtimit të objektit godinë banimi 7 kat me 1 deri 2 kate nëntokë, rruga Frosina Plaku, ish klubi sportiv Partizani*, nga shqyrtimi i kryer, ju kundërfirmos dokumentacioni duke lënë këto detyra për marrjen e masave kundër zjarrit: Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Bashkalidhur praktikës konstatohet genplani me nr 617 prot datë 20.06.2010, ku evidentohet se ka nënshkruar edhe **Enton Punavia**.

Në këtë periudhë konstatohet edhe lidhja e kontratës së sipërmarrjes me shtetasin Enton Punavija, pikërisht më datë 16.02.2011, ku ky i fundit, bashkë me bashkëshorten, kanë porositur një apartament me sip të përgjithshme 123.7 m2, pikërisht në kompleksin Homeplan sh.p.k., për të cilin Enton Punavija kishte marrë pjesë në ndryshimin e destinacionit.

270. Gjatë kësaj periudhe, nga të dhënat e administruara nga sistemi TIMS rezultojnë udhëtime të përbashkëta të shtetasve Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi. Konkretisht rezulton se sipas emailit të përcjellë nga shtetësja Alma Kraja nga emaili albatlas@hotmail.com drejt shtetasit Fatmir Bektashi fatmir.bektashi@kontakt.al, shtetësja Alma e bën me dije se situata është shumë e keqe dhe për momentin në ekonomi nga Tirana në Munich nuk ka vende. Janë në listë të pritjes. Bashkalidhur përcjell të dhëna për udhëtimin e shtetasve Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi më datë 13.08.2010.

Më datë 30.10.2010 shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi**, fluturojnë me linjën e fluturimit Austrian Airlines OS 849/850 Viena për t' u kthyer më datë 04.11.2010 me të njëjtën linjë fluturimi. Biletat e avionit, në shumën 1644 euro për udhëtim TIA-VIE -JFK-VIE-TIA, janë blerë me faturën faturën nr 19 të muajit tetor 2010, të lëshuar nga Premier Travel për shoqërinë Homeplan sh.p.k. me përshkrimin "*Bileta avioni 1644 euro...*" për shtetasin Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi, për udhëtim, në periudhën 30 tetor – 03 nëntor, Tia-Vie-JFK-VIE-TIA, pagesë e kryer me Intesa San Paolo Bank.

271. Konstatohet se ndërkohë që zhvillohet gjykimi, me kërkesën nr. prot K - 18286 datë **09.12.2010** nr dok 12107761 subjekti Kontakt sh.p.k. i drejtohet Bashkisë Tiranë dhe kërkon t'i vihet në dispozicion leja e ndërtimit nr. 61 datë 22.02.2008 si dhe dokumentacioni i kësaj leje.

272. Në parashtrimet e dorëzuara në këtë gjykim, nga ana e palës paditëse, konstatohet se citohet se: "...Nga aktet rezulton se ndërmjet shoqërisë Kontakt sh.p.k. dhe Union Bank sh.a. është lidhur kontrata e kredisë bankare nr. 6353 rep nr. 1140 kol datë 29.10.2008 para noteres Frida Muçmata. Vlera e kredisë së marrë është 230 000 euro. Për llogari të kësaj kredie janë bllokuar në ZVRPP Tiranë me anë të kontratës së hipotekës nrt. 7373 rep nr. 1545 kol datë 18.12.2008 dhe dy pasuritë personale të Fatmir Bektashi. Shoqëria Kontakt sh.p.k. ka paguar gjatë gjithë kohës këstet mujore të pagesave të kredisë, megjithëse ajo nuk është përdorur për qëllimin të cilin është marrë, financimin e ndërtimit të godinave. Kredia e marrë nga shoqëria Kontakt sh.p.k. është ristruktuar me kontratën e kredisë bankare me nr. 6946 rep nr. 1523 kol datë 22.12.2009 dhe kontratën e hipotekës nr. 6947 rep nr. 1533 kol datë 22.12.2009.

273. Me shkresën datë 13.12.2010 të shoqërisë Homeplan sh.p.k. me lëndë "Lista e faturave dhe dokumentave drejtuar zyrës kontabile Pustina" me përmbajtje: "Poshtë shënuar janë lista e dokumentave që i dërgohen zyrës kontabile; Raporti i llogaritjes së dëmit efektiv dhe fitimit të munguar; Fatura tatimore shitje, blerje për rrethimin e kantierit; Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën e mbyllur më dt. 31.12.2009 (identifikimi i pagave të punonjësve për vitet 2008 dhe 2009); Listëpagesa e kontributeve të sig shoqërore dhe shëndetësore muaji nëntor (2 kopje)."

Në fund mban nënshkrimin e shtetasit Fatmir Bektashi dhe për shtetasen Andia Pustinën ka nënshkruar shtetësja Jola Haxhistasa.

Bashkalidhur gjendet një raport për përlllogaritjen e dëmit efektiv dhe fitimit të munguar për shoqërinë e ndërtimit Kontakt sh.p.k. si pasojë e shtyrjes së afatit të ndërtimit të kompleksit Rezidencë banimi Homeplan i ndodhur në rr. Frosina Plaku për shkak të moszbardhjes së lejes së ndërtimit nga Bashkia Tiranë, i përgatitur nga shtetësja Suzana Aliaj por i panënshkruar.

Me kërkesën nr. K – 18961 prot datë 24.12.2010 nr dok 12108048 Bashkia Tiranë, subjekti Kontakt sh.p.k. (me përfaqësues Sokol Barçi) drejtuar Bashkisë Tiranë, kërkon dhënien e shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor që i është krijuar subjektit ndërtues si rezultat i moszbardhjes deri më sot të lejes së ndërtimit. Bashkalidhur është kërkesa e datës 21.12.2010 drejtuar Bashkisë Tiranë, nga shoqëria Kontakt sh.p.k. e nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi, ku parashtrrohet se shoqërisë së tyre nga veprimet e paligjshme të kryera nga Bashkia Tiranë, i janë shkaktuar dëme të mëdha jashtëkontraktore që sipas përlllogaritjeve të tyre shkojnë në vlerën 54 865 003 lekë. Në këto kushte kërkojnë pagimin e kësaj shume të dëmit jashtëkontraktor.

Më datë 28.12.2010, shoqëria Kontakt sh.p.k., pa pritur përgjigjen e bashkisë, ka shtuar objektin e padisë, duke kërkuar edhe shpërblim dëmi moral, shkaktuar shoqërisë në shumën 12 369 166 lekë dhe fitimin e munguar dhe ka paguar taksën e padisë në shumën 371 935 lekë.

Me shkresën nr 18961/3 prot datë 14.02.2011, të adresuar shoq Kontakt (Sokol Barçi), nga Bashkia Tiranë, në përgjigje të shkresës nr prot K-18961 datë 24.12.2010 me anë të së cilës kërkohet shpërblim dëmi jashtëkontraktor, bëhet me dije se objekti i kërkesës është duke u shqyrtuar nga gjykata me çështje datë regjistrimi 15.09.2010 dhe prandaj kjo kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim.

Në parashtrime, shoqëria Kontakt sh.p.k. arsyeton se, ***në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit shoqëria ka paguar rrogat, detyrimet për sig shoqërore dhe shëndetësore të stafit të caktuar me zbatimin e ndërtimit të godinës. Shuma e këtyre detyrimeve të paguara punonjësve të cilët nuk punuan për shkak se nuk ishte zbardhur leja e ndërtimit është 4 755 984.30 lekë. Kanë dorëzuar listë pagesat, formularët e deklarimit dhe pagesës së kontributeve së bashku me pagesat e kryera në bankë. Shoq Kontakt sh.p.k. për periudhën që ka filluar të zbatojë punimet e ndërtimit sipas lejeve të ndërtimit të miratuar dhe deri më tani ka realizuar një fitim në shumën 228 454 euro.***

274. Me vendimin për prishjen e objektit nr. 5029 datë **28.02.2011** të mbajtur nga INUK Bashkia Tiranë, është pasqyruar se inspektorët, në subjektin Kontakt sh.p.k. kanë konstatuar ndërtim objekti pa leje ndërtimi. Për këto arsye, është vendosur dënimi për prishje të objektit ndaj kundravajtësit Kontakt sh.p.k. me adresë rruga Frosina Plaku, pranë Klubit Partizani.

275. Nga aktet, rezulton se në këtë dosje, gjendet i administruar një akt ekspertimi, i përgatitur nga shtetësja **Suzana Aliaj**, i cili është përqëndruar në katër pika, ku pretendohet se duhet të mbështetet dëmshpërblimi:

- a) **Vonesa për fillimin e projektit, përgjatë viteve 2008 – 2009, solli marrjen e kredisë prej 230 000 euro dhe duhet të dëmshpërblehen interesat**
- b) **U paguan punëtorë (paga dhe sigurime shoqërore) gjatë viteve 2008 – 2009**
- c) **Dëmi moral**
- d) **shuma e gjobave të vendosura nga INUV**

Konkretisht, në këtë raport (akt ekspertimi), pasqyrohet ndër të tjera se, **në vitin 2008, si pasojë e vonesës për fillimin e projektit dhe rënien e ndjeshme të likuiditetit për mjete xhiroje, shoqëria u detyrua të marrë hua** pranë një banke private për të vazhduar ekzistencën e saj dhe kryerjen e pagesave ndaj të punësuarëve dhe ndaj fiskut si dhe **për të vazhduar përpjekjet për fillimin e projektit**. Kostoja që shoqëria paguan për këtë hua është pasojë e kësaj vonese dhe shkon në shumën: **Shuma e huasë 230 000 euro**. Për të dy vitet 2008 – 2009 kosto nga interesat e paguara është 41 400 euro. Gjithashtu është pasqyruar se, **pagat dhe sigurimet shoqërore të administratës dhe punëtorëve që nuk u larguan nga puna, në pritje të fillimit të projektit për vitet 2008 – 2009 përkatësisht në vitin 2008 janë 83 874 euro dhe në vitin 2009 janë 57 114 euro**. Duke bërë llogaritë me punën e realizuar dhe efektivitetin e administratës për këto vite, llogaritet që shuma prej 26 000 euro është kosto shtesë. **Dëmi moral** për xhiron e porealizuar e vlerësojnë me 7 200 euro. **Shuma e gjobave** të vendosura nga Bashkia Tiranë për pezullim punimesh, në shumën prej 3 600 euro kërkohet të dëmshpërblehen.

275.1. Në dosje është administruar akt ekspertimi dhe vlerësimi i përgatitur nga ekspertët Yliana Dhozhi (Sejfo) dhe Edmond Selimaj, datë **08.02.2011**.

Në këtë akt ekspertimi është pasqyruar se, nga kqyrja në vend, u konstatua se në sheshin e ndërtimit ka përfunduar së ndërtuari të gjitha katet dhe në të gjitha punimet e konstruksionit dhe rifiniturës blloku i ndërtimit i klasifikuar në proces verbalin e miratimit të KRRT I datë 26.01.2008 (dorëshkrim) faza A e ndërtimit. Blloku tjetër i cili sipas këtij proces verbali është klasifikuar në fazën B pjesërisht është në punimet e pllakës së betonit në katin – 1 nëntokë e pjesërisht në dy nga seksionet është në fazën e ndërtimit në dy katet e para mbi tokë skeleti i karabinasë.

Nëse blloku i banimit i fazës A, do të kishte përfunduar brenda afatit 2 vjeçar pas zbardhjes së lejes së ndërtimit, sipas proces verbalit të KRRT I datë 26.01.2008 (dorëshkrim) ai do të

kishte përfunduar në shkurt 2010 ... nuk është bërë edhe hipoteka e tij. ...nëse leja e ndërtimit do zbardhej brenda 30 ditëve, pra do ishte zbardhur më datë 26.03.2008 dhe ndërtimi do të fillonte në këtë datë, duke parë ecurinë e punimeve të bllokut të fazës A, 12 muaj, mendojnë që ndërtimi do të kishte përfunduar për fazën A më datë 26.03.2009.

Për bllokun e fazës B, punimet janë në fazën fillestare të tyre, ... Privatizimi i ndërtimeve që ndodheshin mbi sip e truallit, në fazën B, ka përfunduar më datë 04.11.2008. Nëse leja e ndërtimit do zbardhej brenda janarit 2009, investitori do të kishte filluar ndërtimin e këtij blloku normalisht dhe sot ndërtimi do kishte avancuar e si rrjedhojë do ishin realizuar edhe të ardhurat nga shitjet. Ndërtimi i Fazës B, në sipërfaqe është më shumë se dyfishi i fazës A ...mendojnë që ndërtimi do të përfundonte për një periudhë maksimale 18 mujore. Nëse ndërtimi do të fillonte 30 ditë pas zbardhjes së lejes që do të ishte data (04.12.2008 data e privatizimit), 04.01.2009 atëherë ndërtimi do të përfundonte për një periudhë 18 mujore, pra ndërtimi i fazës B do të përfundonte më datë 04.07.2010.

Shoqëria për periudhën janar 2008 deri në mars 2010 ka deklaruar një staf punonjësish që nuk ndryshojnë nga muaj në muaj, përjashtuar rasteve me ndryshime të vogla. Në përlllogaritjet që janë bërë, janë marrë në konsideratë vetëm shpenzimet për punëtorët që kanë hyrë në shoqëri. Shpenzime për paga për punëtorët është në shumën 4 245 242 lekë për kontributet për sigurime është 714 007 lekë.

Ky akt ekspertimi mban datën 08.03.2011 dhe është nënshkruar përveç ekspertit Edmond Selimaj edhe nga Eksperti Yljana Dhozhi.

275.1.1. Gjithashtu është administruar akti ekspertimi shtesë i kryer në zbatim të vendimit të Gjykatës Tiranë, nga shtetasi Edmond Selimaj, më datë 08.03.2011. Pyetja që i është kërkuar nga gjykata t'i përgjigjet eksperti është: **Të llogariten interesat bankare të paguara nga shoqëria që janë përdorur për të financuar blerjen e ambjenteve pronë publike, interes ky që rrjedh nga vonesa e zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe që do të fillojë nga momenti i lëvrimit të kredisë deri në momentin e fillimit të punimeve, kredi në vlerën 230 mijë euro.**

Në këtë akt ekspertimi është pasqyruar se: Shoqëria Kontakt sh.p.k. më datë 29.10.2008 ka lidhur një kontratë kredie me nr. 6353 rep nr. 1140 kol me Union Bank sh.a. për vlerën 600 000 euro. Nga shuma 600 000 euro që është totali i kredisë, është përdorur shuma prej 230 000 euro për blerjen e ambjenteve pronë publike, kurse pjesa tjetër është përdorur për qëllime të tjera të shoqërisë. **Interesi i kredisë që duhet të paguajë shoqëria deri në fillimin e punimeve për shumën 230 000 euro është 26 601.30 euro.**

276. Me vendimin nr. 2653 datë 06.04.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konstatohet se është vendosur:

- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë që të dëmshpërblejë paditësin shoqëria Kontakt sh.p.k. për dëmin jashtëkontraktor që i është shkaktuar në shumën 34 743 803 lekë nga të cilat: 29 784 554 lekë janë dëm material shkaktuar nga vonesa e fillimit të punimeve dhe 4 959 249 lekë janë pagesa punonjësish e kontribute për sigurimet shoqërore.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë që të dëmshpërblejë paditësin shoqëria Kontakt sh.p.k. për dëmin e shkaktuar nga pagimi i interesave të kredisë në shumën 26 601.30 euro.
- Detyrimin e të paditurit Bashkia Tiranë që të dëmshpërblejë paditësin shoqëria Kontakt sh.p.k. për dëmin moral të shkaktuar në vlerën 1 500 000 lekë.

- ...Shpenzimet gjyqësore (shuma në total 1 433 935 lekë) në ngarkim të të paditurit.

Njeri prej gjyqtareve, ka dalë me mendim pakice duke vlerësuar se padia duhet të rrëzohet si e pambështetur në ligj.

276.1. Sipas arsyetimit të këtij vendimi, rezulton se pavarësisht faktit që, i padituri Bashkia Tiranë është urdhëruar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për zbardhjen e lejes së ndërtimit (referuar vendimit gjyqësor nr. 2433 datë 26.03.2010) zbardhja e saj nuk është kryer akoma.

Në këtë arsyetim, citohet se shoqëria Kontakt sh.p.k. ka marrë kredi nga Union Bank sh.a. me kontratën e kredisë nr. 6353 rep nr. 1140 kol datë 29.10.2008 në vlerën 600 000 euro nga e cila deri në momentin e fillimit të punimeve është disbursuar shuma prej 230 000 euro për blerjen e ambjenteve pronë publike. Si rezultat i moszbardhjes në kohë të lejes së ndërtimit të sipërcituar dhe mosfillimit në kohë të ndërtimit të objekteve, paditësi shoqëria Kontakt sh.p.k. pretendon se ka pësuar një dëm edhe nga pagimi i interesit të kredisë së marrë.

Paditësi, shoqëria Kontakt sh.p.k. ka pretenduar se i është dashur të paguajë edhe punëtorët në kushtet e pritjes së zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe prandaj kërkon të dëmshpërblehet edhe për këtë dëm.

Paditësi, shoqëria Kontakt sh.p.k. është gjobitur për punimet e kryera nga Bashkia Tiranë me vendim dënimi me gjobë nr. 428 datë 29.10.2010 me 500 000 lekë. Me padinë në gjykim, ky i paditur kërkon që të dëmshpërblehet edhe për këtë dëm.

Paditësi shoqëria Kontakt sh.p.k. pretendon gjithashtu se vonesa në fillimin e punimeve i ka shkaktuar edhe një dëm moral në vlerën 12 369.166 lekë që rezulton nga cënimi i personalitetit të shoqërisë për shkak të mungesës së uljes së imazhit të saj, pasojë kjo e mungesës së korrektësisë në përmbushjen e detyrimeve kontraktore ndaj të tretëve të cilët kanë lidhur kontrata me paditësin për ndërtimin e ambjenteve dhe prandaj kërkon dëmshpërblim edhe për këtë dëm. ...

277. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 2698 datë 13.12.2011 nga Gjykata e Apelit Tiranë, ndërkohë që kjo e fundit ka bërë edhe saktësimin si vijon: **Shuarjen e detyrimit të palës së paditur Bashkia Tiranë në masën 39 883 803 lekë për efekt të pagimit të taksës së ndërtimit nga pala paditëse shoqëria Kontakt sh.p.k. për vlerën 44 202 504 lekë.**

278. Nga dokumentat e sekuestruara pranë studio Pustina, rezulton se në një dokument me nr. 2940 prot datë 06.09.2013, drejtuar shtetases Andia Pustina, EKA Homeplan, të nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe bërë edhe shënimi në fund "mora në dorëzim 10.09.2023" nga marrësi i dokumentit, pasqyrohen rakordime financiare midis Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. prej fillimit të vitit 2010 deri më 31.08.2013. Konstatohet se, në një tabelë të përfshirë në këtë shkresë me emërtimin "Faturimi dhe likuidimi i punimeve datë 31.08.2013" është listuar edhe një zë "Taksa BT+St.Kola" në shumën 382 216.93 euro.

Në faqen e dytë të kësaj shkresë në një tabelë me emërtimin "Tabela e detyrimit për taksën dhe gjyqin me Bashkinë Tiranë" tab 2 (euro) janë bërë shënimet: **HP i detyrohet Kontaktit:**

- Për taksën e Bashkisë (Vlera e gjyqit+pagesat për plotësim takse) = 332 216.93 euro
- KP Studio Kola (për fillimin e gjyqit) = 50 000 euro.

Në vijim të kësaj shkrese është theksuar se: "**E gjithë vlera e taksës si dhe shpenzimet për hapjen dhe deri në përfundimin e gjyqit janë përballuar nga Kontakt, pra për shumën 382 216.93 euro Homeplan i detyrohet për pagesë Kontakt-it, pasi shumat sipas pikave 2 dhe 3 në**

tabelën më lart janë paguar nga Kontakt, por kështu edhe diferenca e taksës mbi vlerën e fituar nga gjyqi...”.

278.1. Përsa më sipër është pyetur shtetësja **Flutura Kola**, më datë 01.03.2024, nëse ka ofruar shërbime për shoqëritë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k.. Ajo ka deklaruar se, *nuk di të thotë me saktësi se për cilën nga subjektet e mësipërme studio ka ofruar shërbim, por kujton që shtetasi Fatmir Bektashi e ka kontaktuar dhe i ka kërkuar që të ndjekë një gjyq. Flutura i ka thënë që personalisht nuk e ndjek dot gjyqin por do caktonte një të zyrës që merrej me gjyqet dhe në atë kohë ka caktuar Av. Sokol Barçi pasi ishte i vetmi avokat në zyrën e saj që merrej me gjyqet. Në atë kohë caktoi Sokolin të merrej me gjyqin dhe Fatmiri nuk e pati problem. Nuk di të thotë për çfarë gjyqi bëhej fjalë. Me kalimin e kohës po shikonte që Sokoli po mungonte në zyrë dhe kishte angazhim shumë më të madh me shtetasin Fatmir Bektashi për gjyqin sesa për zyrën e saj. E gjenduar në këtë situatë ra dakort me Sokolin që të mbyllte marrëdhënien financiare me Fluturën dhe të vazhdonte me Fatmirin me kushtin që të përfundonte të gjitha çështjet që i kishte në ndjekje. Marrëdhëniet financiare u shkëputën që në fillim dhe Sokoli filloi të paguhej nga Fatmiri por ndërkohë ndoqi deri në përfundim gjyqet që kishte patur në ndjekje dhe në studion e Fluturës. E pyetur nëse shtetasi Fatmir Bektashi i ka bërë ndonjë pagesë, në lidhje me gjyqin që ka ndjekur av. Sokol Barçi, deklaroi se jo, nuk është kryer asnjë pagesë për llogari të studios së saj.*

E njohur me dokumentin si më sipër, ajo deklaroi se, shtetasi Fatmir Bektashi nuk i ka kryer asnjë lloj pagese. Nuk di të thotë përse në këtë dokument është përmendur Studio Kola. Gjatë punës së tyre mund të ndodhë që klienti lë pagesat administrative në zyrë si vlera e padisë, vlera e ekspertit, por këto janë pagesa që studio i kryen për llogari të klientit. Në rastin konkret nuk i ka bërë ajo pagesat administrative të këtij gjyqi dhe nuk ka marrë asnjë pagesë nga shtetasi Fatmir Bektashi.

Ky deklaram i shtetases Flutura Kola, duket se vjen në kundërshtim me funksionimin e një studio ligjore. Shtetasi Sokol Barçi, i punësuar pranë studios së saj, ka kryer përfaqësimin e shoqërisë Kontakt sh.p.k. që në muajin janar 2010, të paktën referuar prokurës së lëshuar për gjykimin për zbardhjen e lejes dhe shtetasi Sokol Barçi, ka vijuar të qëndrojë i punësuar i saj deri më datë 01.11.2010 kur është punësuar nga shoqëria Homeplan sh.p.k. Pra minimalisht për 10 muaj, studio ligjore Kola, ka ofruar shërbimin juridik për shoqërinë Kontakt sh.p.k.

278.2. Në këtë gjykim, ajo që të tërheq vëmendjen, është se, nga trupa gjykuese, në shpërblimin e dëmit, janë përfshirë edhe interesat e një kredie të marrë për privatizimin e objekteve, duke u quajtur si autor i dëmit, Bashkia Tiranë, megjithëse kjo e fundit, nuk rezulton të ketë pasur ndonjë rol në privatizim. Kredia është marrë për të paguar detyrimet për privatizim, siç edhe në fakt i ishte premtuar trashëgimtarëve të familjeve të njohura pronare dhe nuk lidhet juridikisht në asnjë moment, me lejen e ndërtimit.

278.3. Në parashtrimet e palës paditëse në këtë gjykim, pretendohet se është marrë kredia me kontratën e kredisë bankare me nr 6353 rep nr 1140 kol datë 29.10.2008 në shumën 230 000 euro duke u bllokuar me kontratën e datës 18.12.2008 dhe dy pasuri personale të shtetasit Fatmir Bektashi. Pretendohet se: ***Shoqëria Kontakt sh.p.k. ka paguar gjatë gjithë kohës këstet mujore të pagesave të kredisë megjithëse ajo nuk është përdorur për qëllimin të cilin është marrë, financimin e ndërtimit të godinave.*** Kredia e marrë nga shoqëria Kontakt sh.p.k. është ristruktuar me kontratën e kredisë bankare me nr. 6946 rep nr. 1523 kol datë 22.12.2009 dhe kontratën e hipotekës nr. 6947 rep nr. 1533 kol datë 22.12.2009. Në fakt, në kontratën e kredisë bankare nr. 6353 rep nr. 1140 kol datë 29.10.2008 të lidhur para noterës Frida Muçmata, evidentohet se, banka i jep kredimarrësit një kredi në shumën 600 000 (gjashtë qind mijë) euro

(shih edhe nenin 3 për shumën), me qëllim konsolidimin e kredive të marra më parë pranë **Union Bank sh.a.**

Nga ana tjetër, konstatohet se padia ngrihet nga shoqëria Kontakt sh.p.k. ndërkohë që lekët kësaj të fundit, për privatizim, siç edhe vetë i kanë bërë veprimet, i janë kaluar nga shoqëria Homeplan sh.p.k., **por kjo e fundit, nuk evidentohet përgjatë këtij gjykimi**, megjithëse kontrata për investim, është lidhur që më datë 28.10.2008.

Referuar Procesverbalit për Këqyrjen e Pjesëshme dhe Marrjen e Provave materiale nga laptopi i markës HP, me product ID "Y7Z98EA#ABB" me barcode 40001650 kanë rezultuar dokumentat të gjendura si vijon: Folderat: *Homeplan 2021, Abi_pergjigje, Bilance, 2010, dokumenti "10 Format Bilanc Homeplan_me_fx", faqe "Details 2009"*. Tek ky dokument, këto shuma në vlerat 255 450 euro dhe 230 000 euro, janë pasqyruar **si hua të dhëna shoqërisë Homeplan sh.p.k.** respektivisht nga shtetasi Fatmir Bektashi si individ dhe nga shoqëria Kontakt sh.p.k., dhe kjo evidentohet në emërtimin e llogarisë 467, si hua të dhëna në vitin 2009 shoqërisë Homeplan sh.p.k. Këto shuma, përputhen me ato që janë derdhur në bankë si më sipër cituar për kryerjen e privatizimit të Klubit Shumësportesh Partizani. Sa më sipër përputhet edhe **me të dhënat e pasqyruara në bilancin e dorëzuar në tatime, ku vlerat në euro janë pasqyruar në lekë të ndara në dy zëra si hua nga ortaku dhe si hua nga të tjerët. Kjo hua nga të tjerët është ajo që është dhënë nga shoqëria Kontakt sh.p.k.** Nga ana tjetër shoqëria Homeplan sh.p.k. këto shuma në total në një vlerë prej 60 190 180 lekë i ka pasqyruar në bilancin e dorëzuar në organet tatimore në zërin "*Parapagesa për furnizime*" llogaria 468. Pra huaja pasqyrohet si e përdorur për aktivitetin e shoqërisë për furnizime dhe shpenzime të periudhave të ardhshme.

Tek një dokument i gjendur në kompjuterin lap top të sekuestruar pranë Studio Pustina, me emërtimin "*Libri i madh_2010-2022*" reflektohet shuma prej 60 187 145 lekë, me shënimin "*Pag. Priv. Klubit*".

Edhe nga bilancet e vitit 2010 të dorëzuara në organet tatimore në përputhje me dokumentat e gjendura në kompjuterin e studio Pustinës, ka rezultuar se për vitin 2010, shoqëria Homeplan sh.p.k. deklaroi një rritje të zërit "*Debitorë dhe kreditorë të tjerë*", pra të borxhit/huasë në një shumë prej 11 742 045 lekë si dhe një rritje të zërit "*të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve*" që nënkupton dhënie nga vetë Fatmir Bektashi në shumën prej 456 219 lekë.

278.4. Gjithashtu, duke sjellë në vëmendje edhe dy akt marrëveshjet për investim të kompleksit Begeja 3000 dhe Kompleksit Begeja 6000, kanë qënë edhe shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja që mermin përsipër më shumë se gjysmën e investimit. Ndodhur në këto kushte, fakti që ata nuk evidentohen palë në këtë proces gjyqësor, përveç shoqërisë Kontakt sh.p.k. tregon më së miri, se personalisht nga ana e tyre nuk ishin investuar asgjë.

Lidhja e një kontrate tjetër për investim që i referohet kompleksit Homeplan sh.p.k. dhe lidhja e kontratave të porosisë ndërmjet shoqërive Homeplan dhe Kontakt

279. Sjellim në vëmendje se në ditën që shtetasi Fatmir Bektashi derdh 245 000 euro për blerjen e Klubit Shumësportesh Partizani në llogarinë e shoqërisë Homeplan sh.p.k., është lidhur një **kontratë sipërmarrje ndërtimi** me nr 3329 rep nr 1967 kol datë **28.10.2008**, para notere Laura Pustina, mes palëve: **Shoq Homeplan sh.p.k. në cilësinë e investitorit dhe ndërtues shoqëria Kontakt sh.p.k.** sipas së cilës investitori do të financojë ndërtuesin për ndërtimin e një kompleksi shumëfunktional me emërtimin kompleksi **Homeplan**. Kjo kontratë, si për

shoqërinë Homeplan ashtu edhe për shoqërinë Kontakt sh.p.k. nënshkruhet nga shtetasi Fatmir Bektashi.

279.1. Por duket se përveç kësaj kontrate, **po për kompleksin Homeplan** është lidhur edhe një kontratë tjetër sipërmarrje, nr 1532 rep nr 872 kol datë **01.09.2010** para noteres Luara Pustina, **ndërmjet porositësit shoq Homeplan sh.p.k. dhe sipërmarrësit shoq Kontakt sh.p.k.** sipas të cilës synohen ndërtime edhe në prona që posedohen prej institucioneve shtetërore si ish stacioni Metereologjik apo orkestra frymore. Në nenin 1, është pasqyruar se Porositësi është i interesuar për realizimin e **objektit Homeplan** në pronat e zotëruara të familjes Begeja, Saliaga, Alimehmeti, Llagami dhe Vaqarri, të ndodhura në **ish ambjentet e Klubit Shumësportesh dhe Klubit të Futbollit Partizani**, në rrugën Frosina Plaku si dhe pronat e ndodhura në **ish stacionin Metereologjik, pronën Begeja 3000 te ish parku i Autobuzëve, pronën e familjes Saliaga dhe Llagami te ish Banda e Ushtrisë** dhe prona të tjera, për të cilët pronarët kufitarë, janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe t'i japin për zhvillim. Për këtë qëllim, shpreh dëshirën dhe vullnetin, që të **kontraktojë dhe financojë shoqërinë ndërtuese Kontakt sh.p.k.**, në mënyrë që kjo shoqëri të realizojë, por pa u kufizuar vetëm në këto: **dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin, ndërtimin e Kompleksit Homeplan** sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, regjistrimin e këtij kompleksi në ZRPP, veprimtari kjo që do të kryhen në emër dhe për llogari të porositësit në përputhje me rregullimet e kësaj kontrate. ...

280. Në janar të vitit 2011 pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k. konstatohet se punësohet shtetasi Gentian Hoxha, kushëri i personit nën hetim Jamarbër Malltezi, duke qënë në këtë subjekt tregtar ka patur vetëm dy të punësuar e konkretisht shtetasit Sokol Barçi dhe Gentian Hoxha, të dy shtetas me lidhje të ngushtë me shtetasit Malltezi.

Shtetasi Gentian Hoxha në vijim, në vitin 2013, punësohet edhe në subjektin **Homeplan Administrim me Nipt L32426002P**, subjekt të cilin e ka themeluar më datë 23/12/2013 dhe ka autorizuar shtetasen Jola Haxhistasa për ta regjistruar në QKB, me seli në rrugën Frosina Plaku, kompleksi Homeplan, me objekt **administrim i ambjenteve të përbashkëta në pronësi të banorëve**. Kjo shoqëri regjistrohet më datë 26.12.2013. Ndërkohë, në periudhën 13.01.2014 – 21.09.2015, ky shtetas rezulton se ka qënë i punësuar edhe pranë Drejtorisë së Tatimeve si "*punonjës taksash*".

280.1. Viti 2011, është viti kur edhe formalizohet marrëdhënia mes studio Pustina dhe shoqërisë Homeplan sh.p.k.

281. Gjatë kësaj periudhe, nga dokumentat e sekuestruara pranë studio Pustina, janë evidentuar disa dokumenta që ofrojnë të dhëna, **në lidhje me dhënie pagesash cash nga arka e shoqërisë Homeplan sh.p.k., shtetasit Jamarbër Malltezi**. Për vitin 2011, për shtetasin Jamarbër Malltezi, megjithëse nuk rezulton të ketë qënë ortak i kësaj shoqërie dhe as të ketë investuar në zhvillimin e ndërtimeve konstatohet se është përlogaritur **se i është dhënë një shume prej 90 000 euro** (për më tepër shih rubrikën "*Përfitimet*".) dhe për shtetasin Xhimi Begeja, i cili gjithashtu nuk rezulton të ketë qënë ortak i kësaj shoqërie dhe as të ketë investuar në zhvillimin e ndërtimeve, konstatohet se është përlogaritur se i është dhënë një shumë prej 10 500 euro.

282. Fatmir Bektashi kryen edhe pagesa për shoqata apo fondacione me lidhje të shtetasve Jamarbër Malltezi/Sali Berisha dhe Xhimi Begeja.

Konkretisht në vitin 2011 ai paguan 2 000 euro si sponsorizim alpinizmi për shoqatën “*Dajti Alpino Turistik*”. Kjo evidentohet nga dokumenti i datës 10.11.2011, ora 15:01:44 me emërtimin *Homeplan shpk 2011 për periudhën 01.07.2011-31.10.2011*, ku ndër të tjera konstatohen kryerje pagesash si vijon: Mandat Arkëtimi me nr. 81, datë 22.07.2011, në vlerën 2,000 euro , nga Kontakt shpk, Kthim fondi dhe Mandat Pagease me nr.109, datë 22.07.2011, në vlerën 2,000 euro me përshkrimin “*Shoqata Dajti Alpino Turistik, Sponsorizim alpinizmi*”.

Konfliktet gjatë zbatimit të punimeve. Zbardhja e lejes së ndërtimit me nr 61 datë 22.02.2008 dhe ndryshimet e aprovuara

Konfliktet gjatë zbatimit të punimeve

283. Përgjatë viteve nga 2008 – 2012 por edhe në vijim, që është një periudhë zhvillimi ndërtimesh, konstatohet në dokumentat e sekuestruara dhe dokumentat e gjendura elektronikisht pranë studio Pustina, kryerja e disa pagesa të quajtura “*Kontribute patriotike*”, që pasqyrojnë jo vetëm pagesa përfitimesh për shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja por edhe pagesa cash të dhëna për llogari të zhvillimit të ndërtimit. Siç dokumentohet në vijim, ndërtimi ishte kryer kur leja nuk ishte zbardhur ende duke sjellë minimalisht kryerjen e veprës penale të vetëgjyqësisë por edhe konflikte me një tërësi institucionesh apo personash.

284. Kështu, fillimisht evidentohen konfliktet me përfaqësues të shoqërisë Partizani sh.a. që madje edhe janë referuar në Prokurorinë e Rrretit Tiranë në kohën e ndodhjes së ngjarjeve ku shtetasi Paro Laçi dhe Xhimi Begeja kanë paraqitur kallzim penal më datë 15.03.2010. Shtetasi Paro Laçi, ka kallzuar në lidhje me me mbylljen e derës së klubit dhe duke pretenduar edhe se kanë pasur investime si dhe një sasi parash prej 30 000 euro ndërkohë dhe se *ka komunikuar në rastet e mëparshme me shtetasit Xhim Begeja dhe Fatmir Bektashi që janë shprehur se do i shpërblejnë...*

284.1 Kurse shtetasi Xhimi Begeja ka pretenduar se ka vendosur të bllokojë derën kryesore që të mos hynin automjete, ndërkohë që dera tjetër ku futen sportistët ka qenë dhe është e hapur. Ditën e kallzimit, rreth orës 11.20, Paro Laçi i ka thyer këto rregulla duke hyrë me forcë në ambjentet e klubit, duke bërë shantazh, duke ofenduar çdo person që i del para duke e kërcënuar personalisht Xhimin. Prandaj Xhimi ka njoftuar policinë.

284.2 I pyetur përgjatë hetimit, shtetasi *Paro Laçi* më datë 23.10.2023, ka pretenduar se përgjatë periudhës së konflikteve që kanë pasur me me shtetasit Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, policët ishin në asistencë të këtyre dy të fundit, dhe se *urdhërat i jepte Xhim Begeja duke thënë: “Këtu është Sali Berisha. Është prona e Sali Berishës dhe e familjes së Sali Berishës. Unë jam daja i Jamarbër Malltezit”*... shtetasit Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi i kanë thënë se *prona ishte e tyrja, e familjes së Sali Berishës, është vetë Sali Berisha në këtë mes, urdhërat i jep Sali Berisha*. Pretendon se *Jamarbër Malltezi dhe Shkëlzen Berisha, bashkë ose veç e veç ... I kanë bërë presion. Me Shkëlzenin ka shkëmbyer edhe mesazhe telefonike. Një rast Shkëlzeni i ka thënë “Është pronë e familjes sonë, është pronë e jona, e kanë trashëgimi të vjetër”*... *Jamarbër Malltezi ka dashur t’i mbushë mendjen, janë takuar para marsit 2011 në ambjentet e Klubit të Futbollit Partizani*. Sipas tij, *Jamarbëri i ka thënë: “Unë jam përfaqësues i pronarëve.. Unë do të ndërtoj kulla këtu. Unë kudo që shkoj në emër të Berishës dhe nuk m’i mbyll dot ti rrugët. Dyert i kam të hapura kudo”*....

Ai pretendon se nga shtetasit Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi i janë ofruar si shpërblim 500 000 euro dhe ambjent banimi e garazh me kusht që të largohet dhe nënshkruante largimin nga

ambjentet.

Shtetasi Paro Laçi pretendon edhe se Ministri i Mbrojtjes Arben Imami, e ka kontaktuar dhe i ka thënë shprehimisht “*Është pronë e Sali Berishës, ka dorë Sali Berisha, ma ka dhënë postin e Ministrisë për të firmosur për ambjentet e Partizantit, kam firmosur dhe do firmos çdo letër*” etj.

Gjithashtu ky shtetas pretendon edhe takime nga drejtues të policisë së shtetit të cilët fillimisht kanë dashur ta bindnin që të mos rezistonte në dorëzimin e ambjenteve dhe të nënshkruante kontratën siç kishin bërë edhe vëllezërit Hasa që kishin përfituar garazhe, apartamente dhe lokal dhe më vonë edhe kërcënime prej tyre. Ndërmjet drejtuesve të policisë, ai përmend edhe shtetasin **Erzen Breçani**, i cili edhe është emëruar shef i Komisarariatit të Policisë nr 2 Tiranë dhe nga policia në atë kohë ka pasur një dhunë të vazhdueshme duke mos i lënë të hynin në ambjentet e Klubit të Futbollit. Në fakt, nga aktet ka rezultuar se shtetasi Erzen Breçani teksa ka qenë në drejtimin e Komisarariatit të Policisë nr 2 Tiranë, shfaqet i angazhuar në përballjen me këto konflikte. Kështu me shkresën nr 201 prot datë 06.02.2012, shtetasi Fatmir Bektashi, nën siglën e shoq Kontakt sh.p.k., i është drejtuar shefit të Komisarariatit të Policisë nr 2 Tiranë **Erzen Breçani**, ku i ka kërkuar prishjen e objektit pa leje, të merren masa urgjente për prishjen e murit pa leje të ndërtuar nga shtetasit Flamur Kolmarku dhe Dritan Saka, i ngritur mbi pronat e fam Begeja, për të cilat është nënshkruar kontratë për zhvillimin e tokës me kompaninë Kontakt sh.p.k. Paralelisht, bën me dije se për zonën në fjalë, është aprovuar nga Bashkia e Tiranës leja e sheshit dhe leja ndërtimit për ndërtesë 5, 7 dhe 9 kate. Ndërtesa në fjalë po zhvillohet në respektim të legjislacionit shqiptar për ndërtimin. **Kjo kërkesë i ka kaluar punonjësit të policisë G.Jakollari**. Në vijim rezulton se nga më datë 08.02.2012, ndihmës specialisti i hetimit dhe parandalimit të krimit të lagjes nr 38, **Genci Jakollari**, ka paraqitur një informacion sipas të cilit, lidhur me kërkesën e bërë nga shoq investitore Kontakt me administrator z. Fatmir Bektashi, u mor takim me z. Fatmir Bektashi administratori i shoq Kontakt dhe u sqarua pozicioni ligjor i policisë së shtetit, në mbështetje të policisë ndërtimore dhe policisë bashkiake.

285. Në një dokument të gjendur pranë Studio Pustina, me emërtimin “*Homeplan sh.p.k. 2012 Analizë – datë 28.03.2013 A02-A02Z datë 01.01.2012 – 31.12.2012*” evidentohet ndër të tjera, ky shënim: **MP 207 datë 28.12.2012 Genci Jakollari kontribut patriotik 50 000 lekë**. Nga dokumenti tabelë me emërtimin “*Pagesa cash për Homeplan*” sekuestruar pranë studio Pustina, është bërë shënimi që i referohet datës datë 28.12.2012, ku pasqyrohet pagesa më përshkrimin “*Genci Jakollari KP policia*” vlera e pagesës **363.00 Euro**.

286. Më datë 26.02.2024 është pyetur shtetasi **Genci Jahollari**, i cili ka deklaruar se, ...*Në vitin 2007 është emëruar SPZ- Inspektor Rendi Zone ku ka mbuluar disa zona, ..Shtetasin Fatmir Bektashi e njeh. Mesa kujton mund ta ketë njohur nga periudha 2010-2012 kur ka qenë i Inspektori i Zonës, në zonën e parkut ku ky shtetas kryente ndërtime në zonën e Ish-Klubit Partizani. Në atë periudhë shtetasi Fatmir Bektashi i dërgonte shefit të Komisarariatit shkresa ku kërkonte mbështetje pasi haste pengesa dhe vështirësi për kryerjen e punimeve në kompleksin e pallateve nga banorët të cilët kishin zënë një pjesë të godinave të klubit të futbollit “Partizani”. Banorët që kishin zënë këto godina nuk dilnin nga këto ambjente dhe për më tepër ju dilnin përpara makinerive. Shtetasi Fatmir Bektashi ka bërë disa kërkesa në Komisarariatin e Policisë Nr.2 për mbështetje. Komisarariati hartonte plane masash në mbështetje të kërkesës së shtetasit Fatmir Bektashi dhe në zbatim të planit të masave angazhoheshin shumë punonjës policie dhe kanë nxjerrë banorët nga objektet, nuk i kanë lejuar që të dilnin para makinerive, fadromëve dhe eskavatorëve. Mesa kujton më vonë shtetasi Fatmir Bektashi, gjeti*

gjuhën e përbashkët me këto banorë informalë, nuk e di nëse ju ka dhënë ndonjë hyrje, që u qetësua situata sepse ishte shumë shumë e vështirë. Kanë qënë të paktën 5 ose 6 familje që bënë rezistencë dhe nuk dilnin nga këto ambiente. Fillimisht shefi i Komisarariatit ka qënë i ndjeri Nikoll Vatnikaj, më vonë ka qënë shtetasi Erzen Breçani. Më së shumti planet e masave janë zbatuar në kohën që shef Komisaritati ishte shtetasi Erzen Breçani. I njohur me shënimet e mësipërme, mbi kontributin patriotik, ky shtetas ka deklaruar se, në lidhje me këtë pagesë kujton që ka qënë Viti i Ri dhe shtetasi Fatmir Bektashi ia ka dhënë si shpërblim ose dhuratë për Vitin e Ri. Ky shtetas nuk i ka kërkuar asnjë nder dhe as Genci nuk i ka bërë ndonjë nder, pasi vetë personalisht nuk ka patur mundësi dhe kompetenca që ta ndihmonte. Gjithashtu nuk i ka kërkuar asnjë përfitim monetar për punën që po kryente. Çdo marrëdhënie në lidhje me punën me këtë shtetas ka qënë shkresore me komisariatin. Çdo veprim kryej në zbatim të planit të masave të hartuar nga eprorët dhe shefi i Komisarariatit.

287. Gjithashtu konflikte ka pasur edhe për shkak të mbivendosjeve që janë krijuar me pronën "Observatori meteorologjik". Nga aktet e administruara përgjatë hetimit (*shih vendimin e mosfillimit të procedimit penal datë 25.02.2011*) rezulton se më datë 17.05.2010 rreth orës 10.00 është konstatuar prishja dhe rrëzimi i murit rrethues të kësaj prone. Sipas kallzimit, prishjen dhe rrëzimin e këtij muri, e kanë kryer personat që pretendojnë pronësinë mbi këtë tokë, ku ndër këto është edhe shtetasi Xhimi Begeja. Në vijim të kallzimit, parashtrohet se, më datë 05.06.2010 rreth orës 10.10, në të njëjtin objekt, shtetasi Xhimi Begeja, me 10 persona të tjerë, duke mos iu bindur punonjësve të policisë private e cila është kontraktuar nga UP, ka prishur rrethimin e instrumentave të matjes së kohës duke i spostuar dhe lënë jashtë këtij rrethimi me pretendimin se janë në pronësi të tij.

Reagimi i shtetasit Xhimi Begeja në fakt lexohet nëpër akte siç është shkresa e datës 10.06.2010 që i ka nisur Universitetit Politeknik të Tiranës, duke i kërkuar qera ose largimin e objekteve që pretendon se ndodhen në pronë e tyre.

Me shkresën nr 1100/1 prot datë 02.09.2010 UPT i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku i bën me dije se i ka vënë në dispozicion fotografi të murit rrethues të objektit "Observatori" dhe se mbështetur në VKM nr 440 datë 16.06.2005 ky objekt ka kaluar në përgjegjësi administrimi të Akademisë së Shkencave dhe më pas me VKM nr 560 të vitit 2007 i ka kaluar në administrim UP. Dërgon edhe dokumenta që vërtetojnë se objekti është në inventarin e mjeteve të institucionit të tyre. Gjithashtu bën me dije se **pas prishjes së murit, Xhimi Begeja ka vepruar më tej, duke ngritur një mur të ri, brenda territorit të objektit**, në pjesën që ai pretendon se është pronar. Ky veprim ka bërë që të ngelen **jashtë territorit të stacionit meteorologjik dhe një pjesë e magazinave**. Kjo gjë vë në rrezik ruajtjen e pasurisë së sipërcituar.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur mosfillimin më datë 25.02.2011, për veprën penale të shkatërrimit të pronës me pretendimin se kërkohet pasoja jo të lehta.

Konfliktet kanë vijuar edhe në vitin 2011 kur ka pasur hyrje me forcë me fadromë në territorin e Observatorit dhe shkuljen e elementëve matës të sinoptikës, pajisjeve. (*shih informacionin e mbajtur nga roja i objektit të observatorit datë 19.03.2011*).

288. Konflikte ka pasur edhe me familjarë me mbiemrin Hasa (*Avni dhe Ermir Hasa*), ku për të shuar këto konflikte u është kërkuar heqja dorë nga procesi i legalizimit të ndërtimeve të tyre përkundrejt dhënies së ambienteve ndërtimore si dhe pagesave në formën e pagës

në shumën 1 000 euro në muaj (shih kontratat e shkëmbimit të lidhur me këta shtetas në vitet 2010 dhe 2011).

Në një akt marrëveshje me nr 3924 prot datë 16.10.2013, shtetasi Xhimi Begeja futet madje në cilësinë e dorëzanësit, duke dalë vetë si debitor ndaj shtetasve Hasa.

Në vijim lidhen edhe kontratat nr 2329 rep nr 1206 kol; nr. 2330 rep nr 1207 kol datë 17.10.2013 dhe nr 2372 rep nr 1224 kol dhe 2373 rep nr 1225 kol datë 22.10.2013, para noteres Laura Pustina, ku me qëllim dhënien vlefshmëri ligjshmëri, këtyre veprimeve shoqëria Homeplan paraqitet si dhuruese për tre apartamente dhe njësi për shtetasit Hasa duke u pasqyruar se **dhurimi bëhet pa kusht dhe pa shpërblim, gjë që në fakt nuk është e vërtetë pasi këto dhurime janë bërë kundrejt detyrimit për heqjen dorë nga procedurat e legalizimit.**

289. Kontrata si të mësipërmet, gjenden edhe për familjen Shtylla, e cila ka përfituar apartamente, njësi dhe parkime, si dhe pagesa mujore prej 1 000 euro, kundrejt kushtit të heqjes dorë nga procesi i legalizimit dhe prishjes së objekteve të ndërtuara prej tyre (shih kontratat nr 11366 rep 3716 kol datë 02.09.2011 me shtetasit Fatbardh dhe Gerhard Shtylla, nr 13099 rep nr 4342 datë 07.10.2011, kontratën e dhurimit nr 323 rep nr 184 kol datë 18.02.2013 etj., shënimet në dokumentat me emërtimin Homeplan shpk 2011 për periudhën 01.07.2011-31.10.2011, "Homeplan sh.p.k. 2012 Analizë – datë 28.03.2013 A01-A01Z datë 01.01.2012 – 31.12.2012"; Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012; Aneksi 1, me emërtimin "HOMEPLAN 2010 – 2013" i shkresës me Nr. 2326 Prot, datë 22.05.2013, me lëndë "Rakordimi Homeplan me Studjo Pustina" ku gjenden të evidentuara edhe pagesat mujore të paraqitura si pagë).

290. Në lidhje me konfliktet e lindura me familjen Kapollari dhe shoqërinë G- Kam, ka rezultuar përgjatë hetimit se korrespondenca mes INUV Bashkia Tiranë dhe INUK duke nisur nga muaji tetor 2011 deri në muajin janar 2012, ku evidentohet se mbi kërkesën e shoqërisë Kontakt sh.p.k. është prishur objekti i ndërtuar nga shtetasi Adriatik Kapollari, sipas vendimit për prishjen e objektit nr 5471 datë 28.09.2011. Por shoqëria Kontakt sh.p.k. ka vijuar të kërkojë prishje objektivash të tjera të këtij shtetasi.

Edhe me shtetasit Kapollari, sërisht shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe shtetasi Xhimi Begeja, kanë vendosur të nënshkruajnë akt marrëveshje siç është ajo që dokumentohet me vërtetim nënshkrimi nr 7277 rep nr 1834 kol datë 05.10.2012 e ndryshuar me nr 7880 rep nr 1982 kol datë 24.10.2012, e lidhur me shtetasin Adriatik Kapollari, ku ky i fundit merr përsipër të respektojë pronësinë e pretenduar të familjes Begeja në një sipërfaqe prej 4000 m², ndërkohë që shtetasi Xhimi Begeja merr përsipër të ndihmojë shoqërinë G-Kam të regjistrojë pronën në ZVRPP Tiranë, sipas gendplanit që i bashkangjisin akt marrëveshje. Të dyja palët do të rihapin gjyq për përcaktimin e kufijve, dhe të arrijnë edhe privatizimin e pjesës së mbetur të truallit nga ana e shoqërisë G-Kam. Por ndërkohë do të tërhiqen nga gjyqet e tjera. Si rezultat i kësaj marrëveshje familja Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k. marrin përsipër të paguajnë shoqërinë G-Kam me 250 000 euro dhe me sipërfaqe ndërtimore. Shtetasi Xhimi Begeja lë madje garanci lokalit e tij Begeja 1900.

290.1. Siç konstatohet nga këto marrëveshje, **Familja Begeja e cila pasqyrohet se përfaqësohet nga shtetasi Xhimi Begeja, kur në të vërtetë prokurë përfaqësimi ka pasur shtetasi Jamarbër Malltezi (një fakt më tepër që tregon se shtetasi Xhimi Begeja ka vepruar**

në terren për llogari të shtetasit Jamarbër Malltezi), merr përsipër detyrime që nuk mund të realizohen pa ndihmën e funksionarëve, siç janë:

- Të ndihmohet shoq G – Kam sh.p.k. të bëjë regjistrimin në ZVRPP Tiranë të pasurisë sipas genplanit nr 1 që do t'i bashkangjiten akt marrëveshjes duke ju referuar gjithashtu dhe piketimit në terren të pronës
- Të rihapin gjyqin për përcaktimin e kufijve të rënë dakord nga të dyja palët me objekt detyrimin e ZVRPP Tiranë që regjistrojë në regjistrat hipotekorë pasurinë e shoq G – Kam sh.p.k., detyrimin e DASHPP për të privatizuar pjesën e mbetur të truallit
- Të realizohet dhe të miratohet plani vendor në zonë.

Shtetasi Xhimi Begeja dhe Fatmir Bektashi, duken të sigurtë në arritjen e objektivave të tyre pasi vendosin të paguajnë një shumë prej 250 000 euro, t' i japin sip banimi 360 m2 shtetasve Kapollari dhe për më tepër, vetë shtetasi Xhimi Begeja vë si garanci lokalin e tij.

290.2. Pikërisht më datë 24.10.2012, kur është bërë amendimi i kontratës së mësipërme, konstatohet se ka qenë për t'u zhvilluar seanca gjyqësore në Gjykatën e Tiranës për padinë e paraqitur në muajin 2012 nga shoqëria G – Kam, por me vendimin nr 10002 datë 24.10.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes për shkak se shtetasi Kujtim Kapollari ka kërkuar pushimin e gjykimit.

290.3. Në vijim konstatohet se premtimet mbahen nga familja Begeja e përfaqësuar nga Xhimi Begeja dhe nga shoqëria Homeplan sh.p.k. Nga dokumentat e sekuestruara pranë Studio Pustina, rezulton se me faturën tatimore të shitjes nr. 11 datë 24.10.2012 shoqëria G Kam sh.p.k. i shet shoq Homeplan sh.p.k. (nënshkruar nga Kujtim Kapollari) me përshkrimin "Sa faturojmë shitje objekteve sipas akt marrëveshjes nr. 7277 rep nr. 1834 nr kol datë 05.10.2012 (notere E.Hyseni)", vlefte 250 000 euro ose 34 915 000 lekë. Ky fakt gjendet i dokumentuar edhe në dokumentin me emërtimin "10 Libër blerje tetor 2012 Homeplan", ekstraktuar nga akti i ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, me përshkrime si vijon: 11 nr serial 70129672 datë 24.10.2012 shitësi G. Kam, shuma 34 915 000 lekë, vendosur tek shitjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh.

Nga dokumentat e gjendura në studio Pustina, konstatohet një dokument që fillon: "Përshendetje Odeta, Lidhur me saldon e furnitorëve gjej komentet e mëposhtme:...". Viojnë me nr rendor nga 1 – 28 përshkrime të ndryshme ku evidentohet: ...20. Gkam është është shuma e kaluar në garanci bankare në Credins Bank

290.3.1. Gjithashtu lidhet kontratë shkëmbimi, Nr. 7811 Rep, Nr. 1962 Kol, datë 22.10.2012 përpara noteres Edlira Hyseni me palë shtetasin Adriatik Kapollari në cilësinë e palës përfituese dhe shoqërisë Homeplan sh.p.k në cilësinë e Investitorit, ku shtetasit Adriatik i janë dhënë tre apartamente, me detyrimin që brenda datës 22.10.2012, të largohet familjarisht dhe të largojë çdo person tjetër të strehuar në objekt si dhe çdo pasuri nga objekti i tij i ndërtuar pa leje "Vilë tre katëshe" të ndodhur në Tiranë me sipërfaqe ndërtimi 360 m2 e përjashtuar nga procesi i legalizimit. Ai gjithashtu jep pëlqimin për prishjen e objektit "Vilë tre katëshe" të ndërtuar pa leje ...Kontrata e mësipërme, është amenduar me kontratën nr 1637 rep nr. 652 kol të datës 13.11.2013, para notere Xhoana Omari të lidhur ndërmjet Adriatik Kapollari dhe shoq Homeplan sh.p.k. duke u përcaktuar këmbimi i objekteve që përfitojnë.

290.4. Me vendimin nr 9193 datë 17.09.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, paditësat shoq G – Kam sh.p.k. dhe Adriatik Kapollari, kanë paditur Drejtorinë e Administrimit dhe shitjes së pronës publike, pranë Ministrisë së Financave, si dhe ZVRPP Tiranë, si persona të

tretë të thirrur Bashkinë Tiranë, si dhe trashëgimtarët Begeja, përfaqësuar në gjykim këta të fundit nga av. Sokol Barçi, me Objekt saktësim i kufijve të pasurisë dhe gentplanit që shoqëron kontratën e shitjes nr 5847 rep nr 1703 kol datë 01.09.1998 të noteres Ruko Sako. Sipas këtij vendimi, pasqyrohet se me vendimin nr 532 datë 25.04.1996 të ish KKP ish pronarëve personat e tretë familja Begeja janë njohur pronarë, të një sip truall prej 28 000 m2 truall që pjesërisht mbivendoset me pronën e ish ndërmarrjes së transportit të makinerive të ndërtimit. Me vendimin nr 656 datë 08.08.1996 atyre iu është kthyer pjesërisht një sip e këtij truall dhe me vendimet nr 135 datë 20.01.2006, nr 6 datë 21.03.2007 të AKKP është vendosur kthimi i të gjithë sip së truallit duke u njohur edhe e drejta e parablerjes së objekteve shtetërore mbi këtë truall. Nga ekspertimi teknik rezulton se, sip e truallit që posedohet nga pala paditëse ka një mbivendosje prej 640.33 m2 me pasuritë e familjeve Begeja por mes tyre nuk ka konflikt dhe kufiri i pronave është i vendosur saktësisht. Përsa më sipër, është vendosur saktësimi i sip së pas së paluajtshme ish ndërmarrja e mjeteve të transportit të ndërtimit Tiranë, pas me nr 2/233 ZK 8220 rruga Ndre Mjeda Tiranë prj 7761 m2 sipas vërtetimit hipotekor të lëshuar nga ZVRPP Tiranë me nr 403 datë 15.12.2004 me sip ndërtimore 5065.68 m2 dhe sip e lirë në funksion të objekteve 2695.32 m2...

290.5. Më datë 20.11.2023 është pyetur shtetasi *Adriatik Kapollari* i cili ka sqaruar në lidhje me blerjen e objekteve të *Ndërmarrja e Transportit Makineri Ndërtimi që më pas e emërtuan Shoqëria G-KAM sh.p.k.* Në vitin 1997 ka filluar të ndërtojë një vilë tre katëshe të cilën e ka përfunduar në vitet 1998-1999 ... ku ka jetuar me familjen e tij deri në momentin që arriti një marrëveshje me firmën *Kontakt shpk ose Homeplan shpk.* Deklaron në lidhje me prishjen e murit kufizues nga shoqëria *Kontakt sh.p.k.* dhe pretendimet që ngriheshin në lidhje me pronën e tij. **Konfliktet i ka pasur me shtetasin Xhimi Begeja, me të cilin ka pasur edhe përplasje fizike, duke treguar se ka ardhur edhe policia. Sipërfaqja prej 4 000 m2 që përmendet në akt marrëveshjen me nr 1917 prot datë 05.10.2012 si pronë e familjes Begeja, sipas deklaruësit, përfshihej në truallin që Adriatiku ka blerë në vitin 1998 nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit. Xhimi Begeja pretendonte që prona ishte e tija dhe megjithëse Adriatiku dokumentat i kishte në rregull, nuk kishte si të vepronte sepse Xhimi Begeja i sillte policinë aty dhe u detyrua të pranonte kushtet e akt marrëveshjes që të zgjidhte këtë situatë. ... Fatmir Bektashin e ka njohur kur ka marrë dokumentat e pronësisë për hyrjet që përfitoi tek kompleksi Magnet në bazë të akt marrëveshjes që bëri me shtetasin Xhimi Begeja. Të gjitha kontaktet për pronën e tij i ka patur vetëm me shtetasin Xhimi Begeja.**

291. Si edhe më sipër u theksua, tërësia e këtyre konflikteve ka sjellë dhënien e pagesa korruptive në drejtim të një sërë institucionesh ku specifikisht në drejtim të inspektoriatit ndërtimor apo punonjësve të policisë. Gjithashtu pagesa, si për një pjesë u relatua më lart, janë dhënë edhe në drejtim të qytetarëve që të detyruar përballë situatës së krijuar dhe qartazi mosreagimit dhe mosmbrojtjes së tyre nga ana e strukturave shtetërore, janë detyruar të tërheqin procedurat e legalizimit apo të pranojnë të largohen, kundrejt shpërblimeve të ofruara. Pagesat e kryera në këto drejtime, si gjithmonë përmblihen në termin "*kontribut patriotik*".

291.1 Kështu nga dokumenti i datës 06.07.2011, me përshkrimin *Homeplan shpk 2011, Analizë, ku paraqiten veprimet në arkën e shoqërisë Homeplan në monedhën Lekë, për periudhën 01.01.2011 – 30.06.2011*, apo tabela e sekuestruar me proces verbalin e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin *Pagesa Cash për Homeplan* konstatohet një pagesë prej 10 000 lekë, që i është dhënë shtetasit Xhimi Begeja si kontribut patriotik për Homeplan. (*Mandat Arkëtimi me nr.17, datë 24.06.2011, në vlerën 10,000 lekë, me përshkrimin "Kontakt/Fatmir Bektashi, Kthim fondi dhe Mandat Pagesa me nr. 16, datë*

24.06.2011, në vlerën 10,000 lekë, me përshkrimin "Xhimi Begeja, kontribut patriotik për HP dhe datë 24.06.2011 / 71 euro / Xhim Begeja KP për HP).

291.1.1 Konstatohet gjithashtu edhe një pagesë në vlerën 1 000 euro dhënë po për Homeplan, shtetasit Ber Begeja. Ky i fundit duket se është angazhuar si njeri i besuar dhe i afërm i shtetasit Xhimi Begeja. Në dokumentin e datës 10.11.2011, ora 15:01:44 me emërtimin *Homeplan shpk 2011 për periudhën 01.07.2011-31.10.2011*, por edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan, evidentohet *Mandat Arkëtimi me nr.100, datë 10.09.2011, në vlerën 1,000 euro, nga Kontakt shpk "Kthim fondi për pagesën e Ber Begeja dhe Mandat Pagese me nr. 126, datë 10.09.2011, në vlerën 1,000 euro, me përshkrimin " Ber Begeja, Kontribute patriotike për HP 7" dhe datë 10.09.2011 / 1000 euro / Ber Begeja KP për HP7.*

Në dokumentin e sekuestruar pranë studio Pustina, me emërtimin *Homeplan shpk 2011 për periudhën 01.07.2011-31.10.2011*, ndër të tjera konstatohen lëvizjet me përshkrimin si vijon: *Mandat Arkëtimi me nr. 41, dt 19.09.2011, në vlerën 46,000 lekë, me përshkrim "Kontakt, Kthim Fondi" dhe Mandat Pagese me nr. 39, dt 19.09.2011, në vlerën 46,000 lekë, me përshkrimin "kontribut patriotik për Policinë ndërtimore".* Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin *Pagesa Cash për Homeplan: Konkretisht: dt 19.09.2011 /328,28 euro/Ber Begeja, KP për Policinë ndërtimore.* Edhe nga akti i ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, në dokumentin "*Llogaria e shpenzimeve (1)*" janë të evidentuara: 6221.... MP39 19/09/2011 A A02 **Ber Begeja /Kontribut patriotik per Policin 46,000 leke.**

292. I pyetur më datë 17.05.2024, për pagesën e sipërcituar, shtetasi **Ber Begeja** pretendon se nuk mban mend që të ketë bërë pagesa për të bërë ndonjë punë për llogari të shoqërisë Homeplan sh.p.k. apo shtetasit Fatmir Bektashi.

292.1 Përgjatë vitit 2012 konstatohet se janë bërë shpenzime të evidentuara si kontribute patriotike, në drejtim të inspektoriatit të ndërtimit. Kështu në dokumentin e sekuestruar pranë studio Pustina, në dokumentin e datës 28.03.2013, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012*, konstatohen lëvizjet me përshkrimet e mëposhtme: *Më datë 04.0.2012, pranë bankës Credins, shtetësja Silva Kushi kryen depozitim në vlerën 27,300 euro me përshkrimin " Derdh Silva Kushi këst për blerje apartamenti".* Reflektohet po në këtë datë: *Mandat Pagese nr. 63 datë 04.07.2012 në shumën 27,300 euro me përshkrimin "Pagesë për kontribut patriotik për uzurpuesit".* Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. *Konkretisht: datë 04.07.2012 / 27,300 euro / KP Uzurpuesit (policia e ndërtimit).*

Zbardhja e lejes së ndërtimit me nr 61 datë 22.02.2008 dhe ndryshimet e aprovuara

293. Më dt 21.09.2011, shtetësja **Andia Pustina** është emëruar në Bashkinë Tiranë, si drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik ndërkohë që mbante edhe kontabilitetin e shoqërisë Homeplan sh.p.k.. Në këtë kohë, me shkresën nr. 2511 prot dt **10.10.2011** (nr. 7054 prot dt 17.10.2011 hyrje në Bashki) shtetasi Fatmir Bektashi, si administrator i shoqërisë Kontakt sh.p.k. dhe shtetasi **Xhimi Begeja** si përfaqësues i pronarëve të truallit (po nuk evidentohet ndonjë prokurë), i janë drejtuar kryetarit të Bashkisë Tiranë Lulzim Basha, me kërkesë për lëshim akti.... llogaritjen dhe nxjerrjen e detyrimit që shoqëria ka për të paguar dhe zbardhjen e akteve administrative të miratuara nga KRRT e Bashkisë Tiranë.

293.1 Me autorizimin e nënshkruar nga administratori i përgjithshëm **Etion Kapedani**, me nr 7209 prot dt **21.10.2011**, për lejen e ndërtimit të objektit bllok banimi dhe shërbimesh **5, 7 dhe 9 kat me 2 kat parkim nëntokë (faza A dhe faza B)** në rrugën Frosina Plaku, **në pronësi të familjarëve Begeja**, në favor të subjektit ndërtues Kontakt, ky i fundit ose investitori, **autorizohen të kryejnë pagesën ... gjithsej në vlerën 44 202 504 lekë**. Me urdhërin nr 131 dt 06.02.2012 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetësja Andia Pustina, emërohet si **Drejtores e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore** pranë Bashkisë së Tiranës dhe me urdhërin nr 132 dt 06.02.2012 komandohet **edhe drejtores e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik në Bashkinë e Tiranës**.

293.2 Me shkresën nr. 224 prot dt **08.02.2012** shoqëria Kontakt sh.p. administratori Fatmir Bektashi, i është drejtuar shtetasit Lulzim Basha kryetar i Bashkisë Tiranë, ku i bën me dije në lidhje me vendimin gjyqësor mbi shuarjen e detyrimit, të taksës së sipërcituar, në masën 39 883 803 lekë. Me shkresën nr. 294 prot dt **24.02.2012** shoqëria Kontakt sh.p.k. i është drejtuar sërish Bashkisë, ku e njofton mbi kryerjen e pagesës pranë Raiffeisen Bank më dt 22.02.2012. Kërkojnë zbardhjen e lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin nr. 61 dt 22.02.2008 të KRRT Bashkia Tiranë për fazën A dhe B. Konstatohet se vetëm rreth 20 ditë pas emërimit, **shtetësja Andia Pustina**, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm, duket se është marrë me praktikën e shoqërive Homeplan dhe Kontakt, siç dokumentohet në vërtetimin e lëshuar prej saj, për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 4 318 701 lekë të subjektit Kontakt, me nr. 480 prot dt **27.02.2012**.

294. Me memon nr. 999 prot dt **28.03.2012** drejtuar **Etion Kapedanit**, administrator i përgjithshëm, nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Përgjegjësi i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit, dt 12.03.2012 me lëndë "*mbi zbardhjen e lejes së ndërtimit të miratuar me vendimin e KRRT-së së Bashkisë Tiranë nr. 61 dt 22.02.2008 në favor të subjektit Kontakt*" është pasqyruar se me nr prot 294 dt 03.02.2012 nga shoqëria Kontakt sh.p.k., është kërkuar zbardhja e lejes së ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. 61 dt 26.02.2008 të KRRT-së Bashkisë Tiranë.

294.1 Nga autorizimi nr. 2216 prot dt **25.04.2012** që shoqëria Kontakt sh.p.k. ka lëshuar për të autorizuar av. Sokol Barçi për përfaqësimin pranë Bashkisë Tiranë në procedurën për zbardhjen e lejes së ndërtimit të miratuar nga KRRT e Bashkisë Tiranë të sipërcituar dhe **në procedurën e ndryshimit të projektit të miratuar** me këtë leje, konstatohet se ndërtimet janë kryer në shkelje të kushteve të lejes së parë.

294.2 Më dt **25.04.2012** është ushtruar kontroll nga ana e INUV Bashkia Tiranë dhe me vendimin nr. 846 datë 25.04.2012 është vendosur për dënim me gjobë, **për punime të kryera në shkelje të kushteve të lejes së miratuar**. Me një mandat pagese të Credins Bank dt **27.04.2012**, rezulton se shtetësja Suzana Aliaj ka bërë një pagesë prej 100 000 lekësh si gjobë nr. 846.

294.3 Shoqëria Kontakt sh.p.k. i adresohet Kryetarit të Bashkisë Tiranë që në atë kohë ka qenë shtetasi Lulzim Basha, me kërkesën me nr extra prot dt **27.04.2012**, duke i parashtruar ndër të tjera se u është dashur të bënin ndryshimin e projektit por meqënëse Bashkia e Tiranës ishte bërë pengesë për zbardhjen e lejes nuk e kanë pasur mundësinë të kërkonin miratimin e ndryshimit të projektit. Me kërkesë për kryerje punimesh, nr. 4263 prot datë **27.04.2012** aplikanti shoqëria Kontakt sh.p.k. e përfaqësuar nga Sokol Barçi, ka paraqitur formularin për **kërkesë për kryerje punimesh, ndryshime në projektin e miratuar** me vendimin e KRRT-së nr 61 datë 26.02.2008 si rezultat i punimeve të zbatimit në shkelje të projektit të miratuar.

295. Me vërtetimin nr. 4263/1 prot datë **30.04.2012** të nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit **Florian Pustina**, drejtuar Fatmir Bektashit dhe për dijeni INU, informohet se, u mor në dorëzim kërkesa për ndryshim të projektit të zbatimit, ...pasi shqyrtuan dokumentacionin ... vetëm për çështje të përmbushjes së formës, njoftojnë se **kërkesa është pranuar dhe do të nisë procedura për shqyrtimin administrativ të kërkesës.**

Me memon nr. 4263/3 prot datë **10.05.2012** të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, drejtuar kryetarit të Bashkisë Tiranë shtetasit Lulzim Basha, nëpërmjet administratorit të përgjithshëm **Etion Kapedani** nga drejtori i drejtorisë së përgjithshme të planifikimit dhe zhvillimit të territorit **Florian Pustina**,Procedura e ndjekur për këtë leje, raportuar përsa më sipër në memo, është kryer konform urdhëresës nr. 275 datë 06.04.2012 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Në konkluzion, **propozojnë miratimin e kërkesës për pajisjen me leje të punimeve të kryera në shkëlqe të kushteve të lejes fillestare sipas projektit të miratuar.**

295.1. Nga Bashkia Tiranë, është marrë vendimi nr. 1 datë **21.05.2012** "**Miratimin e punimeve të kryera në shkëlqe të kushteve të lejes fillestare, të miratuar me vendimin e KRRT-së nr. 61 datë 26.02.2008**". për një afat 1 (një) vjeçar. Ky vendim është nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Lulzim Basha dhe gjenden ndër të tjerë edhe emrat si vijon: Miratoi **Etion Kapedani** administrator i përgjithshëm, **Florian Pustina** Drejtor i Përgjithshëm ... Nga Bashkia Tiranë me nr. protokolli 1/1 datë **21.05.2012**, zhvilluesit Kontakt sh.p.k. i është dhënë leja e zhvillimit për punimet të kryera në shkëlqe të kushteve të lejes fillestare. Afati kohor i kësaj leje është deri në datën 21.05.2013. Kjo leje është nënshkruar nga kryetari Lulzim Basha. Bashkalidhur gjendet edhe plani i vendosjes së zonës në zhvillim i nënshkruar përveç kryetarit të Bashkisë Tiranë Lulzim Basha, ndër të tjerë edhe nga: Drejtori i përgjithshëm **Florian Pustina**

296. Më datë 18.06.2012 Albatlas Travel Agency i dërgon email shtetasit Fatmir Bektashi në lidhje me të dhënat e biletës së shtetasit Jamarbër Mallezi, për datën 22.06.2012 për udhëtim në drejtim të Dyseldorfi nëpërmjet Vienes e më pas kthimin sërish me të njëjtin itinerar më datë 23.06.2012.

297. Duke iu rikthyer akteve të administruara përgjatë hetimit, konstatohet se sipas akteve të administruara pranë noteres Laura Pustina, me nr 54 rep nr 30 kol datë **17.01.2012** përpilohet para noteres një deklaratë noteriale ndërmjet shtetasve **Jamarbër Mallezi, Xhimi Begeja dhe shoqëria Homeplan sh.p.k.**, ku bien dakord të riaktivizojnë akt marrëveshjen nr 3000 rep nr 1783 kol datë 02.10.2008, për **ndërtimin e kompleksit Begeja 6000** të cilën e kishin pezulluar sipas deklaratës me nr 3660 rep nr 2146 kol datë 19.11.2018.

Në fakt siç rezultoi nga hetimi, si deklarata e pezullimit e datës **19.11.2008** ashtu edhe deklarata për riaktivizimin e saj e datës **17.01.2012**, janë përpiluar në të vërtetë në muajin korrik 2012 pasi është dhënë certifikata e përdorimit për kompleksin Homeplan (*shih më poshtë*) por janë paraqitur si të kryera, pezullimi në vitin 2008 dhe riaktivizimi në muajin janar 2012. Pra aktivizimi duket se është filluar pasi tashmë kanë arritur suksesin e rradhës që është jo vetëm zbardhja e lejes së një ndërtimi që e kishin përfunduar por edhe të ndryshimeve të tij.

Konkretisht konstatohet se shoqëria Kontakt sh.p.k. pajiset me lejen e përdorimit nr **46 prot datë 02.07.2012** (nënshkruar nga Lulzim Basha), për Strukturë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe

9 kate me 1 kat parkimi nëntokë, miratuar me vendim KRRT-je nr 61 datë 26.02.2008 dhe vendim kryetari nr 1 datë 21.05.2012, në rrugën Forsina Plaku, ndërtuar nga shoq Kontakt sh.p.k.

Aplikimi për regjistrimin e pasurive të këtij objekti është bërë më datë **03.07.2012** nga shoqëria Kontakt sh.p.k. me një pagesë prej **4 510 000 lekë**, dhe **412 500 lekë** paguar më datë 03.07.2012, sipas mandateve të Credins Bank. Regjistrimi ka përfunduar më datë 22.07.2012.

Investimet e shtetasit Malltezi në blerje pasurish – toka

298. Pas përfundimit të procedurave të privatizimit dhe lidhjes së kontratave për blerjen e objekteve dhe terreneve sportive, shtetasi Jamarbër Malltezi filloi të shtojë pasuritë e tij, duke realizuar blerje pasurish, pikërisht në këto territore. Kështu rezulton se ky shtetas ka blerë nga shtetësja Nerime Piro.

298.1. Me kontratën e shitblerjes nr 272 rep nr 117 kol dt **27.01.2010**, rezulton se paraqitet si palë shitëse shtetësja **Nerime Piro** kurse si palë blerëse paraqiten shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Teuta Malka**. Këto palë pasqyrohen se janë bashkëpronarë në pasuritë si vijon:

- Pasuri të regj në regj hip me nr 417 datë 03.07.2007, ZK 8220, në rrugën Ndre Mjeda, me nr pasurie *3/165 sip trualli 300 m2; nr. 2/325 sip trualli 380 m2; nr. 3/155 sip trualli 660 m2; nr pas 7/257 sip 300 m2; nr pas 3/151 sip trualli 19 m2; nr pas 3/154 sip trualli 27 m2; nr pas 3/152 sip trualli 47 m2*
- Pasuri të regjistruara në regjistrin hipotekor me nr 740 dhe 742 më dt 11.12.2007 ZK 8220, rruga Ndre Mjeda, me nr *3/162 sip trualli 190 m2 dhe nr me sip trualli 210 m2;*
- Pasuri të regj në regj hip nr 214, 215, 216 dt 03.11.2008, ZK 8220 rruga Ndre Mjeda, me nr pas *3/165 sip trualli 470 m2; nr. 3/163 sip trualli 495 m2 dhe 3/153 sip trualli 9213 m2.*

Sipërfaqe në total e pasurive të mësipërme, është 12,311 m². **Pala shitëse, është bashkëpronare** në këto pasuri duke zotëruar **175,87 m²**, dhe i shet blerësve e konkretisht shtetasit **Jamarbër Malltezi i cili deri në këtë kohë zotëronte 192.35 m²** si dhe shtetases Teuta Malka e cila zotëronte 175.87 m², pjesën e vet, ku secili ble nga ½ pjesë, konkretisht **87.85 m² secili**. Çmimi për m² është 26,787 lekë për m² dhe në total pasuria vlen **4,711,029 lekë** e cila ndahet në ½ pjesë të barabarta dhe është likujduar nga palët para lidhjes së kësaj kontrate.

298.2. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr 1946 rep nr 931 kol datë **14.09.2012** para noteres Gentiana Shkodra janë paraqitur shtetësja **Nerime Pirro**, në cilësinë e shitëses dhe **Teuta Malka dhe Jamarbër Malltezi në cilësinë e blerësit**. Të dy palët, janë bashkëpronarë mbi pasurinë me regj hip nr 410 datë 20.04.2012 pas me nr *3/115 ZK 8220 truall i lirë me sip 1900 m2*. Nerime Pirro është bashkëpronare me 480/33600 pjesë të pandarë ose 27.14 m². Teuta Malka është bashkëpronare me 480/33600 pjesë të pandarë ose 27.14 m² dhe Jamarbër Malltezi është bashkëpronar me 2205/33600 pjesë të pandarë ose 124.68 m². Shtetësja Nerime Piro i shet blerësve: Teuta Malka pjesën 1/480/33600 ose 13.57 m² truall dhe Jamarbër Malltezi pjesën ½ e 480/33600 ose 13.57 m² truall. Çmimi është 30 000 lekë/m². Çmimi kompleksiv është **814.200 (tetëqind e katërmëdhjetë e dyqind lekë)**. Çmimi kontraktor është lëvruar i plotë dhe pa diferenca në masën ½ pjesë të barabartë secili prej blerësve, jashtë zyrës noteriale. Jamarbër Malltezi bëhet tashmë pronar me 2445/33600 ose me 138.25m²

298.3. Pasi shoqëria Kontakt sh.p.k., arrin të fitojë një gjyq, ku është detyruar Bashkia Tiranë të zbardhë lejen e ndërtimit, rezulton të jetë lidhur edhe një kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me Nr. 2659 Rep nr. 149 Kol datë **05.08.2010** me palë shitëse shtetasen **Sejdije Kurti** dhe palë blerëse shtetasit **Jamarbër Malltezi** dhe **Teuta Malka**. Palët, janë bashkëpronar në pasuritë e mëposhtme;

- Pasuri e regj në regj hip nr. 742 datë **11.12.2007** me nr ZK 8220 me sip trualli 210 m2 me përshkrim truall me sip 210 m2 ndodhur në rrugën *Ndre Mjeda*
- Në pas e regj në regj hip nr. 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, dhe 59 dt **17.02.2010**, ZK 8220, rruga *Ndre Mjeda*, nr 3/162 sip trualli 190 m2; nr 3/152 sip trualli 47 m2; nr 3/154 sip trualli 27 m2; nr 3/151 sip trualli 19 m2; nr 3/164 sip trualli 210 m2; nr pas 7/257 sip 300 m2; nr pas 3/155 sip 660 m2, nr 2/325 sip trualli 380 m2; nr 3/156 sip trualli 300 m2; nr 3/153 sip trualli 9213 m2; nr 3/163 sip trualli 495 m2; nr 3/165 sip trualli 300 m2;

Sipërfaqe në total e pasurive të mësipërme është **12,311 m2**. Pala shitëse është bashkëpronare e 480/33,600 pjesë të pandara të pasurisë konkretisht **175,87 m2**. Shtetasja Teuta Malka është bashkëpronare e 720/33,600 pjesë të pandara të pasurisë konkretisht **263.72 m2**. Shtetasi **Jamarbër Malltezi** është bashkëpronar e 765/33,600 pjesë të pandara të pasurisë konkretisht **280.2 m2**. Me anë të kontratës së shitblerjes, blerësit Teuta Malka dhe Jamarbër Malltezi, blejnë secili $\frac{1}{2}$ e pasurisë së palës shitëse, konkretisht **87.85 m2 secili**. Çmimi për m2 është 26,787 lekë për m2 dhe në total pasuria vlen **4,711,029 lekë e cila ndahet në $\frac{1}{2}$ pjesë të barabarta** dhe është likujduar nga palët para lidhjes së kësaj kontrate.

298.4. Gjithashtu shtetaset *Graciela Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin*, të përfaqësuara nga shtetasi Maksim Begeja, i shesin shtetasit **Jamarbër Malltezi**, disa pasuri, kontrata këto të përpiluara para noteres Laura Pustina. Në këto kontrata shfaqet si e pranishme edhe shoqëria Kontakt sh.p.k. meqënëse mbi këto prona ka inskript barrë në favor të kësaj të fundit. Çmimi është përcaktuar se do të derdhet në llog bankare të përfaqësuesit të shitësave Maksim Begeja, në bankën Intesa San Paolo nr 43017238002. Pasuritë që shiten janë:

- 1) pasurinë e llojit truall me sip 380 m2 regj hip 128 datë 24.02.2012...pas nr 2/325 ZK 8220 vol 15 faqa 181, të gjitha pjesët e tyre, përkatësisht secila nga 560/33600 pjesë e pandarë. Pjesët takuese të shitësave, me sip totale **19 m2** kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **2280 USD**. (kontrata nr 692 rep nr 425 kol datë 05.04.2012)
- 2) pasurinë e llojit truall me sip 47 m2 regj hip 133 datë 28.02.2012..... pas nr 3/152 ZK 8220 vol 15 faqa 177, të gjitha pjesët e tyre përkatësisht secila nga 560/33600 pjesë e pandarë, me sip totale **2.35 m2** kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **282 USD**. (kontrata nr 732 rep nr 440 kol datë 06.04.2012)
- 3) pasurinë e llojit truall me sip 1900 m2 regj hip 122 datë 24.02.2012, ...pas nr 3/115 ZK 8220 vol 12 faqa 210, bashkëpronarë me nga 560/33600 pjesë të pandarë të pasurisë së paluajtshme në. Gjithashtu po sipas këtij vërtetimi hip të datës 28.02.2012 në seksionin "Komente nga regjistruesi" specifikohet: "U krye rivlerësimi i pasurisë për pjesët takuese të B/P, Vera, Graciella dhe Margarita Begeja ekuivalent me 95 m2, përcaktohet vlera 2 544 765 lekë". Shitësit i shesin blerësit të gjitha pjesët e tyre, me sip totale **95 m2** i shiten blerësit kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **11 400 USD**. (kontrata nr 733 rep nr 441 kol datë 06.04.2012)
- 4) pasurinë e llojit truall me sip 19 m2 regj hip 136 datë 28.02.2012...nr 3/151 ZK 8220 vol 15 faqa 178, bashkëpronarë me nga 560/33600 pjesë të pandarë... "Mbi këtë truall qëndron objekti me nr pas 3/180/ND vol 17 faqa 249". Të gjitha pjesët e tyre përkatësisht secila nga

- 560/33600 pjesë e pandarë, me sip totale **0.95 m2** kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **114 USD** (kontrata nr 734 rep nr 442 kol datë 06.04.2012).
- 5) pasurinë e llojit truall me sip 9213 m2 regj hip 134 datë 28.02.2012, pas nr **3/153 ZK 8220** vol 15 faqa 184, bashkëpronarë me nga 560/33600 pjesë të pandarë ... "Mbi këtë truall qëndron objekti me nr pas 3/171/ND vol 17 faqa 240". ...shesin të gjitha pjesët e tyre përkatësisht secila nga 560/33600 pjesë e pandarë, me sip totale **460.65 m2** kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **55 278 USD**. (kontrata e shitjes nr 735 rep nr 443 kol datë 06.04.2012)
- 6) pasurinë e llojit truall me sip 210 m2 regj hip 126 datë 24.02.2012. ... pas me nr **3/164 ZK 8220** vol 17 faqa 93, bashkëpronarë me nga 560/33600 pjesë të pandarë të pasurisë së paluajtshme (bashkë me 25 b/pronarë të tjerë) në... "Mbi këtë truall qëndron objekti 3/170/ND sip 122 m2, vol. 17 faqa 239 qëndron objekti 3/171/ND vol 17 faqa 240"....shesin, të gjitha pjesët e tyre takuese secila nga 560/33600 pjesë të pandarë. Pjesët takuese të shitësive, me sip totale 10.5 m2 i shiten blerësit kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **1260 USD**. Pavarësisht se shoq Kontakt është quajtur e pranishme, nuk konstatohet ndonjë firmë e shtetasit Fatmir Bektashit. (kontrata nr 1984 rep nr 1106 kol datë 30.08.2012)
- 7) pasurinë e llojit truall me sip 190 m2 regj hip 127 datë 24.02.2012, pas me nr **3/162 ZK 8220** vol 17 faqa 91 faqa 93 ...Shitësit janë bashkëpronarë me nga 560/33600 pjesë të pandarë të pasurisë së paluajtshme (bashkë me 25 b/pronarë të tjerë), i shesin blerësit, të gjitha pjesët e tyre takuese përkatësisht secila nga 560/33600 pjesë të pandarë, me sip totale 9.51 m2 kundrejt çmimit prej 120 USD për m2. Në total ky çmim është **1141.2 USD**. Pavarësisht se shoq Kontakt është quajtur e pranishme nuk konstatohet ndonjë firmë e Fatmir Bektashit. (kontrata nr 1985 rep nr 1107 kol datë 30.08.2012)

298.5. Gjithashtu, në vitin 2010, evidentohet ekzistenca e një akt marrëveshje, për dhurimin e pjesëve takuese, dt **27.04.2010** e cila nuk rezulton të jetë përpiluar para noterit, marrëveshje kjo e lidhur ndërmjet palëve si vijon: **Nusret Kaçurri, Haki Begeja, Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Raimonda Bekteshi** (përfaqësuar nga Bashkim Beshteshi), **Nervit Hoxha** (përfaqësuar nga Bashkim Beshteshi), **Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi** (përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi). Në përmbajtje të kësaj akt marrëveshje, parashtrohet se: **Nusret Kaçurri së bashku me bashkëpronarët e tjerë, kanë vënë në dispozicion të shoq Kontakt sh.p.k. pronën e tyre që ndodhet tek Klubi Partizani me kontratën nr 4938/831 datë 22.05.2006 dhe shtesën e kontratës nr 8166/1249 datë 11.10.2007. Nga ndërtimi në këtë truall pronarët do të marrin 24% të tij.** Një dokument i paraqitur me shënimin e përfaqësuesit të shoq ndërtuese përcaktohet se pjesa e znj. **Nusret Kaçurri është 721.93 m2 apartamente, dyqane me sip 64.39 m2, veranda është me sip 23.11 m2 dhe parkimi është 4.13 njësi.**

Nusrete Kaçurri deklaron se pjesën e saj të përshkruar më sipër, jua dhuron nipërve të saj dhe konkretisht Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli, Anila Maçit dhe Xhimi Begeja, të cilët deklarojnë se pranojnë dhurimin që u bëhet nga halla e tyre.

Shoqëria ndërtuese, secilit prej nipërve të përcaktuar më sipër, do u shtojë pjesën që ata marrin vetë sa vijon: Apartamente 90.24 m2, dyqane 8.05 m2, verandë 2.89 m2, parkim 0.52 njësi. Në këtë kontratë palë është Haki Begeja i cili nënshkruan për pjesët që marrin dy vajzat e tij Ermira Rizvanolli dhe Anila Maçi.

Konstatohet se për shtetasen **Nusret Kaçurri, është hedhur një gjurmë gishti**, ndërkohë që, kanë nënshkruar **Haki Begeja, Bashkim Bekteshi, Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi.**

298.5.1. Në deklaratën e pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI, shtetasi Jamarbër Malltezi, deklaroi: *Trashëgimi nga gjyshja, (e ndjera Nimete Bekteshi) dhe dhuratë e pjesës takuese ndërtimore nga motra e gjyshes Nusret Kaçurri (kontratë dhurimi nr. 3505 rep nr. 774 kol) në total 3 apartamente dhe garazh.*

Siç mund të shihet nga akt marrëveshja e mësipërme, nuk rezulton që të jenë përcaktuar pjesët siç i deklaroi shtetasi Jamarbër Malltezi.

Rezulton se, me nr 3505 rep nr 774 kol dt 27.04.2010 noterja Ruko Sako, me vërtetim nënshkrimi, pasqyron se, shtetasit Nusret Kaçurri, Haki Begeja, Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi përfaqësuar nga Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha përfaqësuar nga Bashkim Bekteshi, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi, nënshkruan rregullisht akt marrëveshjen e lidhur ndërmjet tyre për dhurimin e pjesëve takuese të Nusret Kaçurri dhe noterja vërteton nënshkrimet e tyre. Për më tepër, nuk rezulton që në aktin e dhurimit të jetë pasqyruar se sa apartamente apo garazhe, i dhurohen shtetasit Jamarbër Malltezi.

298.5.2. Shtetësja Nusrete Kaçurri, në fakt konstatohet se, në tërësinë e akteve të tjera, ka nënshkruar vetë, kurse këtu është hedhur gjurma e gishtit. Më shtetur në këtë fakt dhe duke pasur parasysh edhe vijimësinë e fitimit të pronësisë së këtyre pronave, me vendimin dt 23.05.2024, është vendosur kryerja e ekspertimit grafik teknik. Sipas aktit të ekspertimit nr 4176 dt 19.06.2024, ekspertët në lidhje me akt marrëveshjen e datës 27.04.2010, kanë konkluduar se, **nuk mund të realizohet kryerja e ekspertimit, për shkak se nuk pasqyrohen karakteristika të përgjithshme dhe të veçanta me vlera identifikuese.**

Përgjatë hetimit nuk është bërë e mundur të pyeten shtetësja Nusrete Kaçurri pasi ka ndërruar jetë dhe as shtetasi Kreshnik Kaçurri, i cili shfaqet me probleme shëndetësore (*shih deklarinë e datës 12.04.2013 të shtetasit Ermal Kaçurri*).

Megjithatë, përgjatë hetimit, ka rezultuar se me pronat e shtetasve Kaçurri ka pasur abuzime. Kështu nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, ka rezultuar ndër të tjera dokumenti në formatin Word, me emërtimin "*Email dt. 24.06.2011.doc*", i krijuar më datë 24.06.2011, i ruajtur për herë të fundit më datë 25.06.2011, me autor Financel. Në këtë dokument paraqitet korrespondenca me email ndërmjet Studio Pustina dhe shoqërisë Homeplan (Bledi) në lidhje me kontratat e apartamenteve. Janë shënuar me ngjyrë të kuqe përgjigjet e pyetjeve të bëra në e-mailin e datës 22.06.2011. Konkretisht: *Pershendetje Bledi, Te lutem lexo me poshte: ...Gjithashtu jane nxjerre ne shitje me urdher te Z. Bektashi, te gjitha njesite e Kreshnik Kacurri (Pale Pronare) si : Apartamentet 311, 316, 321, 326 , 423 dhe 732; Njesia tregtare 302; Postet e Parkimit 33, 34, 35, 36 (kode te vjetra ne kontrate). Nuk jane pergatitur revokime kontratash per keto njesi dhe as nuk eshte njoftuar pala pronare. Keto njesi nuk jane shitur ende por mund te kerkohet i njejti informacion per keto njesi nga Studio Pustina kur te realizohet shitja e tyre.*

298.5.3. Për më tepër, rezulton se shtetasit Bashkim Bekteshi dhe Jamarbër Malltezi apo Haki Begeja, që deklarojnë mbi pranimin e këtij dhurimi për llogari të të tretëve, nuk citohet të kenë ndonjë akt përfaqësimi, në lidhje me këtë dhurim.

Për më tepër, jo të gjithë përfituesit e këtij dhurimi, kanë pasur dijeni mbi vetë bërjen e dhurimit.

Më datë 19.06.2024, është pyetur shtetësja *Ermira Rizvanolli*, motra e shtetasit Xhimi Begeja, në lidhje me akt marrëveshjen e datës 27.04.2010. Kjo shtetase ka pretenduar se, *nuk e*

disponon këtë marrëveshje, por më vonë, nga Xhimi, i është vënë në dispozicion një fotokopje e keqe. Sqaron se është në gjyq në lidhje me pasuritë që pretendon se i janë dhuruar nga Nusreti. Në fakt nga një deklaratë noteriale me nr. 1534 rep nr 517 kol datë 07.11.2012 para noteres Nexhla Këllezi, kjo shtetase ka deklaruar se nuk ka nënshkruar këtë akt marrëveshje dhe se sot merr dijëni dhe e pranon dhurimin që i ka bërë halla e saj Nustret. Në fakt, nga aktet rezulton se pavarësisht ekzistencës së akt marrëveshjes së mësipërme, shtetësja Ermira Rizvanolli ngre pretendime se nuk e ka përfituar pjesën e pretenduar të dhuruar.

Më datë 20.06.2024 është pyetur shtetësja **Nervit Hoxha**, e cila në lidhje me marrëveshjen e datës 27.04.2010 gjithashtu pretendon se nuk e disponon.

298.5.4. Gjithashtu, nga aktet konstatohet se, megjithëse shtetësja Nustrete Kaçurri, paraqitet si më sipër cituar, se i ka dhuruar shtetasve të lartpërmendur, pasurinë e saj, shtetasi Jamarbër Malltezi duket se e ka harruar ekzistencën e kësaj pasurie, pasi i regjistron të gjitha pasuritë që i takonin nga zhvillimi i ndërtimeve, në emër të saj. Për këtë fillimisht duke përfaqësuar këtë shtetase, lidh kontratën e shkëmbimit me shoqërinë Homeplan dhe me përfituese nga vendosja e truallit në dispozicion për zhvillimin e ndërtimit, shtetasen Nustrete Kaçurri (kjo e fundit përfaqësohet nga shtetasi Jamarbër Malltezi). Nga kjo kontratë shkëmbimi, shtetësja Nustrete Kaçurri përfiton 13 objekte.

Kështu, nga aktet konstatohet se me nr 1636 rep nr 863 kol datë 23.07.2012, para noteres Laura Pustina, lidhet kontratë shkëmbimi ku, në cilësinë e palës investitore është shoqëria Homeplan shpk dhe në cilësinë e palës pronare është shtetësja Nustret Kaçurri, përfaqësuar me anë të prokurës së përgjithshme Nr. 10086 Rep, nr. 1542 kol, datë 31.12.2007 nga shtetasi Jamarbër Malltezi. Objekti i kësaj kontrate është shkëmbimi i truallit të palës pronare konkretisht të pjesëve të tyre takuese në pasuritë e mëposhtme;

- Pas e regj në regj hip nr.50 dt 26.01.2012, pasuri me nr. 3/156 ZK 8220 me sip 300 m2
- Pas e regj në regj hip dt 24.02.2012 ZK 8220, nr. 122, 125, 124, 121 dhe 123 e konkretisht: pas nr. 3/116 e sip 435 m2, pasuri nr. 3/163 ZK 8220 sip 495 m2; pasuri nr. 3/165 ZK 8220 sip 470 m2; pasuri nr. 3/166 ZK 8220 sip 27 m2; pasuri nr. 3/167 ZK 8220 sip 6318 m2.

Pala pronare, ka përfituar nga shkëmbimi i pjesës së saj takuese mbi pasuritë e lartpërmendura pasurinë e mëposhtme;

1. Apartament Nr.28, me sipërfaqe 104.4 m2, me numër pasurie Nr.3/201+3-28, vol.28, faqe 137, zk.8220, i ndodhur në katin e pesë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 3, , nr.regjistri hipotekor Nr.755, datë 09.07.2012
2. Apartament Nr.36, me sipërfaqe 105.5 m2, me numër pasurie Nr.3/201+3-36, vol.28, faqe 145, zk.8220, i ndodhur në katin e pesë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 3, , nr.regjistri hipotekor Nr.763, datë 09.07.2012
3. Apartament Nr.42, me sipërfaqe 107.2 m2, me numër pasurie Nr.3/201+3-42, vol.28, faqe 151, zk.8220, i ndodhur në katin e tetë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 3, , nr.regjistri hipotekor Nr.769, datë 09.07.2012
4. Apartament Nr.29, me sipërfaqe 68.1 m2, me numër pasurie Nr.3/201+4-29, vol.28, faqe 236, zk.8220, i ndodhur në katin e pestë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 4, , nr.regjistri hipotekor Nr.854, datë 09.07.2012
5. Apartament Nr.34, me sipërfaqe 81 m2, me numër pasurie Nr.3/201+5-34, vol.29, faqe 81, zk.8220, i ndodhur në katin e shtatë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, , nr.regjistri hipotekor Nr.949, datë 09.07.2012

6. Njësia nr 6, me sipërfaqe 48 m², me numër pasurie Nr.3/201+1-N6, vol.27, faqe 199, zk.8220, i ndodhur në katin përdhetë godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 1, nr.regjistri hipotekor Nr.567, datë 09.07.2012
7. Njësia nr 7, me sipërfaqe 26.7 m², me numër pasurie Nr.3/201+5-N7, vol.29, faqe 43, zk.8220, i ndodhur në katin përdhe të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, nr.regjistri hipotekor Nr.911, datë 09.07.2012
8. Njësia nr 8, me sipërfaqe 21.2 m², me numër pasurie Nr.3/201+5-N8, vol.29, faqe 44, zk.8220, i ndodhur në katin përdhetë godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, nr.regjistri hipotekor Nr.912, datë 09.07.2012
9. Garazh nr 6, me sipërfaqe 19.2 m², me numër pasurie Nr.3/201+1-G6, vol.27, faqe 187, zk.8220, i ndodhur në katin e parë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 1, nr.regjistri hipotekor Nr.555, datë 09.07.2012
10. Garazh nr 3, me sipërfaqe 18.7 m², me numër pasurie Nr.3/201+5-G3, vol.29, faqe 28, zk.8220, i ndodhur në katin e parë nëntokë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, nr.regjistri hipotekor Nr.896, datë 09.07.2012
11. Garazh nr 4, me sipërfaqe 19.2 m², me numër pasurie Nr.3/201+5-G4, vol.29, faqe 29, zk.8220, i ndodhur në katin e parë nëntokë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, nr.regjistri hipotekor Nr.897, datë 09.07.2012
12. Garazh nr 5, me sipërfaqe 17.2 m², me numër pasurie Nr.3/201+5-G5, vol.29, faqe 30, zk.8220, i ndodhur në katin e parë nëntokë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 5, nr.regjistri hipotekor Nr.898, datë 09.07.2012
13. Garazh nr 4, me sipërfaqe 18.6 m², me numër pasurie Nr.3/201+6-G4, vol.29, faqe 108, zk.8220, i ndodhur në katin e parë nëntokë të godinës 9 (nëntë) katëshe, Tiranë shkalla 6, nr.regjistri hipotekor Nr.976, datë 09.07.2012

Pala pronare deklaron se ka marrë në dorëzim pasuritë e mësipërme.

Për pasuritë e shtetases Nusrete Kaçurri, konstatojmë një aplikim të datës **23.08.2012** të shtetases Elsa Ago, që ka vënë si adresë **Rruga Dëshmorët e 4 shkurtit**, konkretisht për pas nr 3/201+2 vol 28 faqa 26. Konstatohen edhe disa rivlerësime me pagesa respektive në shumat dhe pagesa më datë 09.08.2012 në vlerat 5 358 lekë, 2 800 lekë, 2 800 lekë, dhe rivlerësim pasurish me tatim për t' u paguar 37 777.11 lekë; 5 357.38 lekë. ; 31 243.076 lekë, 31 243.08 lekë.

Pasuritë e rivlerësuarja janë: Nr pas 3/201+4-29 vol 28 faqa 236 ZK 8220, ap me sip 68.1 m², pall. 3/201 vol 27 faqa 156; Nr pas 3/201+5-N8 vol 29 faqa 44 ZK 8220, njësi me sip 21.2 m², pall. 3/201 vol 27 faqa 156; Nr pas 3/201+1-G6 vol 27 faqa 187 ZK 8220, garazh me sip 19.2 m², pall. 3/201 vol 27 faqa 136;

Si gjithmonë, përgjatë fazave të zhvillimit të këtij ndërtimi, konstatohet se paguhen të ashtuquajturat "*Kontribute patriotike*" siç rezulton nga dokumenti i datës 28.03.2013, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012*", ku evidentohet **Mandat Pagese nr. 92 datë 24.07.2012 në shumën 2,000 euro me përshkrimin "Sokol Barci kontribut patriotik hipotekimi"**. Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin *Pagesa Cash për Homeplan*.

298.5.4.1. Ajo që është për t' u evidentuar në këtë kontratë, është sërish fakti se në emër të shtetases Nusrete Kaçurri shfaqet sërish si përfaqësues shtetasi Jamarbër Malltezi, duke mos pasur asnjë gjurmë të dijenisë së këtyre veprimeve nga personi, emri i së cilës rezulton në këto akte, pra nga shtetësja Nusrete Kaçurri.

Në kontratën e sipërcituar, theksohet se shtetësja Nustret përfaqësohet nga shtetasi Jamarbër Malltezi, mbështetur në prokurën e përgjithshme me nr 10086 rep nr 1542 kol datë 31.12.2007, të pëpriluar para noteres Ruko Sako. Por në fakt kjo prokurë rezulton të jetë lëshuar nga shtetasit Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi dhe Bashkim Bekteshi (të përfaqësuar nga shtetasi Bashkim Bekteshi). Nga aktet rezulton se shtetësja Nustret Kaçurri ashtu si edhe shumë trashëgimtarë të tjerë Begeja, i kanë dhënë tagër përfaqësimi shtetasit Jamarbër Malltezi, me anë të prokurës së posaçme *Nr. 787 Rep, Nr. 142 kol, datë 31.01.2006*, para noteres Ruko Sako. Por në këtë prokurë specifikisht është përcaktuar se, **përsa i përket kontratave të tjera që të përcaktohet konkretisht pjesa jonë, kontratën e shkëmbimit të truallit do ta nënshkruajnë vetë...**

298.5.5. Për një pasuri tjetër, shtetasi Jamarbër Malltezi duke përfaqësuar veten e tij dhe shtetasen Nustrete Kaçurri, lidh kontratën e shkëmbimit duke e marrë në bashkëpronësi këtë pasuri. Kështu, me kontratën e shkëmbimit nr. 1656 rep nr. 873/1 kol datë **23.07.2012** të lidhur para noteres Laura Pustina, ndërmjet investitorit Homeplan sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Genci Bektashi dhe palës pronare Jamarbër Malltezi dhe Nustret Kaçurri **përfaqësuar kjo e fundit nga Jamarbër Malltezi**, rezulton se në shkëmbim të pasurive të cituara në kontratën nr 1636/853 datë 23.07.2012, shtetasit Nustret Kaçurri dhe Jamarbëri Malltezi, përfitojnë:

1. **Njësia nr. 3 me nr pas 3/201+2-N3 ZK 8220 me sip 107 m2** rruga Frosina Plaku, në katin përdhe të godinës 9 katëshe, Tiranë, shk. 2, regj në regj hipotekor me nr. 644 datë 09.07.2012 pronësi e cila vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë lëshuar nga ZVRPP Tiranë, më datë 21.07.2012 bashkangjitur kontratës ndodhet planimetria...vol 28 faqa 26.

Pala pronare deklaron se, kjo njësi tregtare, është në bashkëpronësi midis Nustret Kaçurri e cila zotëron **60 % të sip totale** të njësisë tregtare nr. 203 ndërsa Jamarbër Maltezi zotëron **40 % të sip totale** të kësaj njësie.

Kjo kontratë është nënshkruar nga shtetasit Genci Bektashi dhe Jamarbër Malltezi.

298.5.5.1. **Në deklaratën e pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI, më datë 31.03.2013 nga shtetasi Jamarbër Malltezi, kjo kontratë dhe kjo pasuri nuk deklarohet.**

298.5.5.2. Gjithashtu konstatohet se kjo kontratë është lidhur më datë 23.07.2012 por në pjesën hyrëse, parashtrohet se investitori Homeplan sh.p.k. përfaqësohet nga administratori Genci Bektashi, i cili është autorizuar në bazë të vendimit të ortakut të vetëm datë 24.07.2012, pra një ditë më vonë.

Bashkalidhur është aplikimi i datës 26.07.2012 nga shtetasi Jamarbër Malltezi dhe mandat pagese datë 27.07.2012 pranë Credins Bank. Rezulton se bashkalidhur gjendet: Vërtetim nga dok hipotekor ku pasqyrohet se në regj hip nr 201 datë 26.03.2013 figuron e regj në emër të *Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Emira Rizvanolli dhe Alida Maçi*, pasuria me nr 3/201+2-N3 ZK 8220 me sip 107 m2, njësi me nr 3, kati përdhe i godinës 9 katëshe. Më datë 02.04.2013 kjo pasuri regjistrohet me nr 3/201+2-N3 vol 28 faqa 26 ZK 8220 me sip 107 m2, njësi në pronësi të Jamarbër Malltezi si pasojë e një kontrate pjestimi (kontratë pjestimi si më poshtë). Regjistrues për të gjitha pasuritë e mësipërme ka qenë Fetah Hasanaj.

298.5.5.3. Siç mund ta shihni, nuk ka asnjë shpjegim përse shtetasi Jamarbër Malltezi do të gëzonte në bashkëpronësi me shtetasen Nustret një dyqan.

298.6. Sidoqoftë, rezulton se nga shtetësja Ermira Rizvanolli, i është nisur shoqërisë Kontakt sh.p.k. një kujtesë noteriale, me nr 1535 rep nr 518 kol dt **07.11.2012**, me të cilën kërkon pjesën e saj takuese nga pasuria e pretenduar e dhuruar nga shtetësja Nustret Kaçurri. Nga disa emaile të administruara në dosjen gjyqësore me nr 9841 regj themeltar dt 18.02.2013 regjistri të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ka pasur diskutime mbi pjesën takuese të shtetasës Ermira Rizvanolli nga dhurimi i sipërcituar. Kështu evidentohet ndër të tjera se, më dt 31.08.2012, shtetasi Fatmir Bektashi, i ka dërguar email shtetasit Sokol Barçi, duke vendosur në cc, shtetasit Aida Zisi, Xhimi Begeja, ku ndër të tjera, evidenton se, përsa i përket pjesës së Ermira Rizvanolli, ajo përzgjedh ap 715 mqs është brenda pjesës që i takon nga Nustreti....

298.6.1. Pasi shtetësja Ermira Rizvanolli, kishte investuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë padi duke kërkuar pjesën që pretendonte se i takonte nga dhurimi i pretenduar i bërë nga shtetësja Nustrete Kaçurri, rezulton se shtetasi Jamarbër Malltezi ndërmerr një nismë tjetër. Duket sikur në këtë kohë, kujtohet se, pasuritë e mësipërme i janë dhuruar në vitin 2010 nga shtetësja Nustrete Kaçurri. Si palë në këtë kontratë, nuk shfaqet shtetësja Nustrete Kaçurri në emër të së cilës janë edhe pasuritë e mësipërme, por shfaqet vetëm shoqëria Homeplan sh.p.k. dhe përfituesit e dhurimit të përfaqësuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi.

Kështu, me kontratën e shkëmbimit (shtesë) nr 353 rep nr 151 kol datë **18.03.2013** para noteres Xhoana Omari, është lidhur një kontratë mes palëve: **Shoq Homeplan sh.p.k.** përfaqësuar nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe bashkëpronarët **Xhimi Begeja, Bashkim, Rajmonda Bektashi, Nervit Hoxha, Jamarbër, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi të gjithë të përfaqësuar me prokurë nga Jamarbër Malltezi.** Në kontratë përcaktohet se, Dhënësi është pronar i godinave të realizuara mbi truallin në bashkëpronësi të trashëgimtarëve Begeja, **ku midis të tjerëve bën pjesë edhe Nusrete Kaçurri.** Bashkëpronarët e truallit, të ndodhur në Tiranë në rrugën Frosina Plaku, me anë të akt **marrëveshjes nr 3505 rep nr 774 kol datë 27.04.2010** notere Ruko Sako, kanë përfituar të gjithë së bashku të drejtat e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore që përfiton Nusrete Kaçurri në kompleksin e ndërtimit në pronësi të shoqërisë Homeplan.

Qëllimi i kësaj kontrate shtesë, e lidhur në vijim të kontratave të shkëmbimit nr 1636 rep nr 853 kol datë 23.07.2012 dhe nr 1656 rep nr 873 kol datë 23.07.2012 notere Laura Pustina, është për korrigjimin e palës përfituese Nusret Kaçurri në cilësinë e pronares së truallit (*sipas rastit të bashkëpronësisë që i takon*) si palë, shkëmbyer me Homeplan sh.p.. të cilit i ka vënë në dispozicion pasuritë e përshkruara më poshtë dhe kjo e fundit në këmbim do t'i jepte pasuritë e përshkruara në n 2 të kësaj kontrate. Duke qenë se Nusret Kaçurri me akt **marrëveshjen nr 3505 rep nr 774 kol datë 27.04.2010** notere Ruko Sako ka hequr dorë nga pasuria që ajo do merrte nga shoq Homeplan sh.p.k. si pronare truallit (*pra rrjedhimisht edhe nga truallit që i takon*) atëherë për këtë sipërfaqe truallit të vënë në dispozicion, nuk do të jetë Nusret Kaçurri, por pala bashkëpronare e përcaktuar në kontratë, me të cilët rrjedhimisht duhet të ishte lidhur kontrata e shkëmbimit me shoq Homeplan (për pjesën e Nusret Kaçurrit që kjo ka dhuruar).

Neni 1. *Objekt i kësaj kontrate është shkëmbimi midis shoqërisë dhe bashkëpronarëve i pjesës së ndërtimit që përfitojnë bashkëpronarët si pasojë e akt marrëveshjes nr 3505 rep nr 774 kol datë 27.04.2010 notere Ruko Sako në këmbim të pjesës ideale të truallit në pronësi të dhurueses Nusret Kaçurri.*

...Neni 3. Midis palëve në këtë kontratë është rënë dakord se, në këmbim të pjesës së truallit që zotëron Nusrete Kaçurri do t'u kalojnë në bashkëpronësi këto pasuri:

1. Njësia nr 3 me sip 107 m², nr pas 3/201+2-3 ZK 8220 regj hip nr 1097 datë 30.07.2012;
2. Ap nr 36 me sip 105.5 m², nr pas 3/201+3-36 ZK 8220 regj hip nr 1099 datë 30.07.2012;
3. Ap nr 28 me sip 104.4 m², nr pas 3/201+3-28 ZK 8220 regj hip nr 1098 datë 30.07.2012;
4. Garazh nr 4 me sip 16.8 m², nr pas 3/201+5-G4 ZK 8220 regj hip nr 1108 datë 30.07.2012;
5. Njësia nr 8 me sip 21.2 m², nr pas 3/201+5-N8, ZK 8220 regj hip nr 1105 datë 30.07.2012;
6. Njësia nr 6 me sip 48 m², nr pas 3/201+1-N6, ZK 8220 regj hip nr 1103 datë 30.07.2012;
7. Garazh nr 5 me sip 17.2 m², nr pas 3/201+5-G5, ZK 8220 regj hip nr 1109 datë 30.07.2012;
8. Njësia nr 7 me sip 26.7 m², nr pas 3/201+5-N7, ZK 8220 regj hip nr 1104 datë 30.07.2012;
9. Garazh nr 4 me sip 18.6 m², nr pas 3/201+5-G4, ZK 8220 regj hip nr 1110 datë 30.07.2012;
10. Garazh nr 3 me sip 18.7 m², nr pas 3/201+5-G3, ZK 8220 regj hip nr 1107 datë 30.07.2012;
11. Garazh nr 6 me sip 19.2 m², nr pas 3/201+1-G6, ZK 8220 regj hip nr 1106 datë 30.07.2012;
12. Apartament nr 42 sip 107.2 m², nr pas 3/201+3-42, ZK 8220 regj hip nr 1100 dt 30.07.2012;
13. Apartament nr 29 me sip 68.1 m², nr pas 3/201+4-29, ZK 8220 regj hip nr 1101 dt 30.07.2012;
14. Apartament nr 34 me sip 81 m², nr pas 3/201+5-34, ZK 8220 regj hip nr 1102 datë 30.07.2012;

Bashkalidhur është edhe aplikimi i datës 18.03.2013 i bërë nga shtetasi Xhimi Begeja dhe mandat pagese pranë Credins Bank më datë 26.03.2013.

Bashkalidhur gjenden edhe kartelat e pasurive së paluajtshme të sipërcituara, të regjistruara më datë **26.03.2013** në emër të shtetasve Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli dhe Alida Maçi.

298.6.1.1. Siç mund të shihet edhe në këtë rast, shtetasi Jamarbër Malltezi ka vepruar, pa pasur tagre ligjore për të kryer këtë veprim. Për më tepër, shton në këtë kontratë **edhe njësinë e cila më parë, në vitin 2012 ishte përcaktuar se i përkiste 60 % shtetasës Nustret dhe 40 % shtetasit Jamarbër.**

Në këtë kontratë shkëmbimi shtesë të vitit 2013, përcaktohet sikur bëhet korrigjimi i kontratave të shkëmbimit të mëparshme ku janë përcaktuar pjesët që do të përfitonte shtetësja Nusrete Kaçurri. E quajnë korrigjim, meqënëse në vitin 2012 pasuritë e sipërcituara i janë regjistruar shtetasës Nusrete ndërkohë që sipas akt marrëveshjes së vitit 2010 ajo ia ka dhuruar shtetasve të sipërcituar.

Nëpërmjet kësaj kontrate shkëmbimi shtesë ku pretendohet se korrigjohen pasuritë e shtetasës Nustret, konstatohet se kjo e fundit eliminohet krejtësisht si palë. **Normalisht shtetësja Nustret në rast se po korrigjohej një kontratë në të cilën kishte qënë palë, duhet të ishte e pranishme.**

Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI në datë 18.11.2013, shtetasi Jamarbër Malltezi nuk e ka deklaruar këtë kontratë.

298.6.1.2. Natyrisht që në ndihmë, në regjistrimin e kontratës së mësipërme, vjen shtetasi Fetah Hasanaj, regjistruar në ZVRPP Tiranë, i cili me urdhërin nr 1233 datë **29.03.2013**, vendos mbi korigjimin e të dhënave në seksionin "*Pronari i pasurisë*" të regjistrimeve hipotekore dhe seksionin C të pronësisë në KPP përkatëse për pasurisë e regjistruara në:

1. Nr hip 1097 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+2-N3, vol 28, faqa 26, ZK 8220;
2. Nr hip 1099 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+3-36, vol 28, faqa 145, ZK 8220;
3. Nr hip 1098 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+3-28, vol 28, faqa 137, ZK 8220;
4. Nr hip 1108 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-G4, vol 29, faqa 29, ZK 8220;
5. Nr hip 1105 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-N8, vol 29, faqa 44, ZK 8220;
6. Nr hip 1103 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+1-N6, vol 27, faqa 199, ZK 8220;
7. Nr hip 1109 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-G5, vol 29, faqa 30, ZK 8220;
8. Nr hip 1104 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-N7, vol 29, faqa 43, ZK 8220;
9. Nr hip 1110 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+6-G4, vol 29, faqa 108, ZK 8220;
10. Nr hip 1107 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-G3, vol 29, faqa 28, ZK 8220;
11. Nr hip 1106 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+1-G6, vol 27, faqa 187, ZK 8220;
12. Nr hip 1100 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+3-42, vol 28, faqa 151, ZK 8220;
13. Nr hip 1101 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+4-29, vol 28, faqa 236, ZK 8220;
14. Nr hip 1102 datë 30.07.2012 për pas nr 3/201+5-34, vol 29, faqa 81, ZK 8220;

Në bazë të përcaktimeve të kontratës së shkëmbimit shtesë nr 353/151 datë **18.03.2013**, notere Xhoana Omari.

Konkretisht përcaktohet se si bashkëpronarë janë: *Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi*, duke u shprehur se, me këta shtetas duhet të ishte lidhur kontrata e shkëmbimit me shoqërinë Homeplan sh.p.k. për pjesën e Nusret Kaçurri që kjo i ka dhuruar sipas akt marrëveshjes.

Më datë 26.03.2013 është bërë regjistrimi në emër të shtetasve *Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Ramonda Beteshi, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi* i pasurive të sipërcituara. Aplikimi për këto ndryshime, është bërë më datë **18.03.2013** nga shtetasi *Xhimi Begeja* dhe përfunduar praktika më datë **27.03.2013**. Vërtetimet e pronësisë janë lëshuar më datë 27.03.2013.

298.6.2. Veprimet e shtetasit *Jamarbër Malltezi* më datë **18.03.2013** nuk mbarojnë këtu me këto pasuri, pasi, me kontratën e pjestimit nr 438 rep nr 180 kol datë **28.03.2013** para noteres Xhoana Omari, ka përfaqësuar bashkëpronarët: *Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Ermira Rizvanolli dhe Alida Maçi*. Sipas n.1, pasuria që i nënshtrohet pjestimit, është në bashkëpronësi sipas pjesëve të përcaktuara në vërtetimet nga dokumentat hipotekore dhe që janë:

1. Njësia nr 3 me sip 107 m², nr pas 3/201+2-3 ZK 8220 regj hip nr 1097 datë 30.07.2012;
2. Ap nr 36 me sip 105.5 m², nr pas 3/201+3-36 ZK 8220 regj hip nr 1099 datë 30.07.2012;
3. Ap nr 28 me sip 104.4 m², nr pas 3/201+3-28 ZK 8220 regj hip nr 1098 datë 30.07.2012;
4. Garazh nr 4 me sip 16.8 m², nr pas 3/201+5-G4 ZK 8220 regj hip nr 1108 datë 30.07.2012;
5. Njësia nr 8 me sip 21.2 m², nr pas 3/201+5-N8, ZK 8220 regj hip nr 1105 datë 30.07.2012;
6. Njësia nr 6 me sip 48 m², nr pas 3/201+1-N6, ZK 8220 regj hip nr 1103 datë 30.07.2012;
7. Garazh nr 5 me sip 17.2 m², nr pas 3/201+5-G5, ZK 8220 regj hip nr 1109 datë 30.07.2012;
8. Njësia nr 7 me sip 26.7 m², nr pas 3/201+5-N7, ZK 8220 regj hip nr 1104 datë 30.07.2012;

9. *Garazh nr 4 me sip 18.6 m2, nr pas 3/201+5-G4, ZK 8220 regj hip nr 1110 datë 30.07.2012;*
10. *Garazh nr 3 me sip 18.7 m2, nr pas 3/201+5-G3, ZK 8220 regj hip nr 1107 datë 30.07.2012;*
11. *Garazh nr 6 me sip 19.2 m2, nr pas 3/201+1-G6, ZK 8220 regj hip nr 1106 datë 30.07.2012;*
12. *Apartament nr 42 me sip 107.2 m2, nr pas 3/201+3-42, ZK 8220 regj hip nr 1100 datë 30.07.2012;*
13. *Apartament nr 29 me sip 68 m2, nr pas 3/201+4-29, ZK 8220 regj hip nr 1101 datë 30.07.2012;*
14. *Apartament nr 34 me sip 81 m2, nr pas 3/201+5-34, ZK 8220 regj hip nr 1102 datë 30.07.2012;*

Sipas n. 2, objekt i kësaj kontrate është pjestimi midis bashkëpronarëve i pasurive të mësipërme të cilat janë në bashkëpronësi të pandarë të tyre. Sipas nenit 3, me vullnetin e lirë dhe të plotë bashkëpronarët ndajnë pasuritë si më poshtë: ...citohen vetëm shtetasit Xhimi Begeja dhe Jamarbër Malltezi...

Xhimi Begeja përfiton nga ndarja e pasurisë si më poshtë: *Apartament nr 29 me sip 68 m2, nr pas 3/201+4-29, ZK 8220 regj hip nr 1101 datë 30.07.2012; Garazh nr 6 me sip 19.2 m2, nr pas 3/201+1-G6, ZK 8220 regj hip nr 1106 datë 30.07.2012; Garazh nr 4 me sip 18.6 m2, nr pas 3/201+5-G4, ZK 8220 regj hip nr 1110 datë 30.07.2012;*

...**Jamarbër Malltezi** përfiton nga ndarja pasurinë si më poshtë: *3/5 pjesë ideale të njësisë nr 3, me sip të përgjithshme 107 m2 me nr pasurie 3/201+2-N3, ZK 8220, regj hip 201 datë 26.03.2013*

Sipas këtij pjestimi, mbetet një pasuri pa u përcaktuar pronari e konkretisht: **Ap nr 28 me sip 104.4 m2, nr pas 3/201+3-28 ZK 8220 regj hip nr 1098 datë 30.07.2012;**

Tek rubrika e bashkëpronarëve, në fund të kontratës, konstatohet se janë shënuar vetëm emrat e **Xhimi Begeja, Bashkim Bekteshi, Rajmonda Bekteshi, Jamarbër Malltezi dhe Orinda Malltezi**, të gjithë të përfaqësuar nga **Jamarbër Malltezi**. Mungojnë emrat e **Nervit Hoxha, Ermira Rizvanolli dhe Alida Maçi**.

Kjo kontratë pjestimi (shih vendimin e mëposhtëm të Gjykatës së Apelit), është regjistruar në regjistrat hipotekorë më datë 02.04.2013. Më datë **02.04.2013**, pasuria me nr **3/201+2-N3 vol 28 faqa 26 ZK 8220 me sip 107 m2**, regjistrohet si njësi në pronësi të Jamarbër Malltezi si pasojë e një kontrate pjestimi. **Regjistrues ka qenë shtetasi Fetah Hasanaj.**

298.6.3. Nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton ndër të tjera se gjendet dokumenti në formatin excel, me emërtimin "*Doks HP 2012.xls*", i krijuar më datë **28.03.2013**, i ruajtur për herë të fundit më datë 28.03.2013, me autor Financa 1. Në nënndarjet e tretë të këtij dokumenti me emërtimin "*Listë Klientësh HP*" paraqitet në formë tabelore lista e klientëve të shoqërisë Homeplan, ku ndër të tjera konstatohen shënimet e bëra nga përdoruesi, konkretisht në krah të disa pasurive ku shënohet emri i shtetasve **Xhimi Begeja, Nervit Hoxha, Jamarbër Malltezi, Bashkim Bekteshi, Orinda Malltezi**, është vendosur shënimi "**n. kacurri**":

- *Kodi 1136 – Xhimi Begeja me shënimin në krah N.Kacurri*
- *Kodi 5133 – Nervit Hoxha me shënimin në krah N.Kacurri*

- Kodi 6134 – Xhimi Begeja me shënimin në krah N.Kacurri
- Kodi 203 – Jamarbër Malltezi me shënimin në krah N.Kacurri
- Kodi 366 – Bashkim Bektashi me shënimin në krah N.Kacurri
- Kodi 381 – Orinda Malltezi me shënimin në krah N.Kacurri
- Kodi 572 – Nervit Hoxha me shënimin në krah N.Kacurri

Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI më datë 18.11.2013, shtetasi Jamarbër Malltezi tek të dhënat konfidenciale deklaroi: **Përfitim dyqani në kompleksin Magnet si palë pronare dhe kontratë premtim – shitja e dyqanit – kontratë nr rep 1040 nr. kol 572/1 datë 30.05.2013.** (shtetasi Jamarbër Malltezi ka dorëzuar kontratë nr 1040 rep nr 572/1 kol datë 30.05.2013 sipas të cilët Jamarbër Malltezi është premtuesi shitës ndaj Albert Muharremi premtues Blerës për dy njësi tregtare e konkretisht me nr 1001 seks 1 sip 80.9 m2 dhe nr 1003 seks 1, sip 21.1 m2).

298.6.4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr 6944 datë 22.09.2013 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, së shtetases Ermira Rizvanolli, konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratës së pjestimit nr 438 rep nr 180 kol datë 28.03.2013 për pjesën e paditëses Ermir Rizvanolli për shkak se kjo e fundit në këtë akt, është përfaqësuar nga shtetasi Haki Begeja dhe ky i fundit nga Jamarbër Malltezi por në prokurë nuk ka pasur tagre përfaqësimi për këtë kontratë. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1948 datë 30.09.2016 dhe dërgimi i çështjes për rigjykim në po atë gjykatë por me tjetër trup gjykues.

Tashmë, në rigjykimin e kësaj çështje, konstatohet se shtetasi Xhimi Begeja, nëpërmjet Deklaratës së Mbrojtjes, drejtuar gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, parashton se, **dhurimi i bërë nga shtetësja Nustrete Kaçurri, në drejtim të shtetases Ermira është i pavlefshëm (referuar dhurimit të vitit 2010), pasi neni 761 i K.Civil sanksionon se dhurimi bëhet për një send të caktuar që ekziston në momentin e dhurimit kurse në momentin që është nënshkruar kontrata nr 8166/1249 datë 11.10.2007, është krejtësisht jashtë llogjikës, sendet nuk kanë ekzistuar. Citon edhe nenin 762 të K.Civil që shprehet se dhurimi nuk mund të përmbajë veçse pasurinë e tashme. Nëse përfshin pasurinë e ardhshme dhurimi është i pavlefshëm përse i takon kësaj.**

Daniel Libeskind

299. Në realizimin e projekteve ndërtimore, konstatohet se është vendosur një marrëdhënie me shtetasin Daniel Liebeskind, dokumentuar kjo marrëdhënie, që në fillim të vitit 2010. Më datë 18.04.2024 është pyetur shtetësja **Hidajete Kraja (Muça)**, e cila ka deklaruar se, **është përzgjedhur nga zyra e kontabilitetit që mbante kontabilitetin e studios së Daniel Libeskind në Zvicër. Danielin deklaroi se nuk e ka takuar kurrë. Shtetasin Fatmir Bektashi deklaroi se e ka njohur në vitin 2010, pasi ka shkuar me administratoren e Daniel Libeskind, Zhanetën, me qëllim prezantimin e saj si përfaqësuese tatimore e shtetasit Daniel Libeskind. Sqaron në lidhje me përgatitjen e faturave tatimore ku asaj i kalonte vetëm tvsh kurse pagesa për shërbimin kryej në llog bankare të arkitektit Daniel Libeskind në Zvicër. Faturat nuk kanë patur projekt bashkalidhur.**

Në fakt nga aktet, rezulton për vitin 2010 të jenë lëshuar disa fatura tatimore nga shtetësja Hidajete Kraja (Muça) si përfaqësuese tatimore e shoqërisë Architect Daniel Libeskind AG me NIPT L073300011, për shoqërinë Homeplan sh.p.k. në të cilat evidentohet se shërbimi i

projektimit do të likujdohet në llogarinë e shitësit Bank Credit Suisse...Zurich me Iban CH62048350938281 3200 1 (USD). Tvsh t'i transferohet në llogarinë e përfaqësuesit tatimor.

300. Në nëntor 2011 konstatohet se, kryetari i Bashkisë Lulzim Basha, paraqet ftesë për pjesmarrje në konkursin "*Building Tirana's green future: Tirana Northern Boulevard and River Project*". Mesa duket, anëtar jurie është përzgjedhur edhe shtetasi Daniel Libeskind, i cili ofronte shërbime për shoqëritë Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k. Ky fakt, dokumentohet pasi më datë 16.03.2012, studio Daniel Libeskind, paraqet faturë për Bashkinë Tiranë në shumën 5 000 euro, për pjesmarrjen në jurinë finale për konkursin design për "*Tirana Northern Boulevard and River Project*" dhe 2 144.70 USD për Daniel Libeskind airfare.

Edhe shtetasi **Flamur Kuçi**, i cili ka qenë gjithashtu anëtar jurie në këtë konkurs, më datë 16.04.2012, deklaroi: *...Shtetasin Fatmir Bektashi e njeh por nuk i kujtohet me saktësi data kur e ka njohur për herë të parë. Kujton që e ka njohur gjatë kohës që arkitekti Daniel Libeskind ka vizituar Shqipërinë, pasi me këtë arkitekt Flamuri ka qenë anëtar jurie në konkursin për Bulevardin e ri të qytetit të Tiranës. Konkursi është realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe prezantimi i projekteve ka qenë publik. Konkursi mesa i kujtohet është zhvilluar në vitet 2011 – 2012. Në fakt, me faturën datë 12.11.2012, edhe shtetasi Flamur Kuçi i paraqet Bashkisë Tiranë, faturën për honorar për pjesmarrje, si anëtar i jurisë ndërkombëtare për "*Tirana Northern Boulevard and Tirana River Rehabilitation Project*" në shumën 1 000 euro.*

300.1. Gjatë kohës që zhvillohet ky konkurs, rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. paguan për akomodimin e shtetasit Daniel Libeskind, por duket se të ardhurat derivojnë nga shoqëria Kontakt sh.p.k. apo shtetasi Fatmir Bektashi. Kështu, në dokumentin e datës 10.11.2011, me emërtimin *Homeplan shpk 2011 për periudhën 01.07.2011-31.10.2011*, ndër të tjera konstatohen përshkrimet, si më poshtë: *Mandat Arkëtimi me nr. 105, datë 29.09.2011, në vlerën 324 euro, me përshkrimin "Kithim Fondi për pagesën."* dhe *Mandat Pagese me nr.131, datë 29.09.2011, në vlerën 324 euro, me përshkrimin "Fatmir Bektashi, Likujdim fature Hotel Sheraton për D.Libeskind"*. Sa cituar, përputhet edhe me deklaratimet e bëra nga shoqëria Homeplan sh.p.k. për vitin 2011, kur ka deklaruar në librat e blerjes, faturat me nr serial 118600 dhe 118601 të dt 29.09.2011 në shumat respektive 27 547 lekë dhe 18 163 lekë.

301. Në muajin janar 2012, konstatohet nga aktet e administruara, se shoqëria Homeplan sh.p.k. nis pagesa në drejtim të shtetasit Hidajete Kraja, përfaqësuese e shtetasit Daniel Libeskind, për shërbimet që ai ofron **për projektin ndërtimor Magnet**, projekt që pasqyrohet më poshtë. Sipas faturave të lëshuara nga përfaqësuesja tatimore Hidajete Karaja (Muça) në drejtim të shoqërisë Homeplan sh.p.k., theksohet se paratë do të kalojnë në llogarinë bankare në Zvicër kurse tvsh-ja transferohet në llogarinë e përfaqësuesit tatimor.

Përgjatë kësaj kohe, sërish evidentohen pagesa në lidhje me akomodimin e shtetasit Daniel Libeskind në hotel në Shqipëri. Kështu në dokumentin e sekuestruar pranë Studio Pustina, i datës 28.03.2013, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012*", konstatohen lëvizjet me përshkrimet: *Mandat Arkëtimi me nr. 20 datë 21.02.2012, në vlerën 368.00 euro me përshkrimin "Fatmir Bektashi, Hyrje nga ortaku"* dhe *Mandat Pagese me nr. 23 datë 21.02.2012, në vlerën 368.00 euro, me përshkrimin "Hotel Sheraton, Prenotim dhome D. Libeskind"*

302. Në vitin 2012, marrëdhëniet me shtetasin Daniel Libeskind, nuk krijohen vetëm me Bashkinë Tiranë, por edhe me shtetasin Flamur Kuçi, i cili, vetëdeklaroi se, nga viti 2008 – 2009 ka filluar punë si këshilltar për Çështjet e Territorit i Kryeministrit Sali Berisha

dhe ka qëndruar në këtë pozicion deri në vitin 2013. Nga të dhënat e administruara nga organet tatimore, rezulton se shtetasi Flamur Kuçi nga data 01.01.2012 deri më datë 24.10.2013 ka qenë i punësuar pranë Këshillit të Ministrave; nga data 24.04.2013 deri më datë 14.09.2013 ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

302.1 Konkretisht rezulton se, shtetasi Flamur Kuçi bashkë me shtetasin Fatmir Bektashi, nisen në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të takuar shtetasin Daniel Libeskind. Shpenzimet për këtë udhëtim, paguhen nga shoqëria Homeplan sh.p.k.

302.2 Nga aktet e administruara përgjatë hetimit, rezulton se më datë 06.09.2012, Albatlas Travel Agency i dërgon me email shtetasit Fatmir Bektashi dy biletat e prera prej tij, për shtetasin Fatmir Bektashi dhe Flamur Kuçi, për të udhëtuar më datë 06.10.2012 në drejtim të Neë York-ut nëpërmjet Vienës dhe kthimi më datë 09.10.2012 po nëpërmjet Vienës. Për shtetasin Flamur Kuçi çmimi është 911 euro. Nga aktet e administruara ka rezultuar se, sipas faturës tatimore nr 302 datë 07.09.2012 lëshuar nga shitësi Albatlas, është paguar udhëtimi me Austrian TIA-VIE-VIE-TIA për datën 06 – 10.10.2012 për shtetasit Fatmir Bektashi dhe Flamur Kuçi në shumën 1 777 euro, nga shoqëria Homeplan sh.p.k.

Sipas një dokumenti të administruar përgjatë hetimit nga studio Pustina, në lidhje me shpenzime të shoqërisë Homeplan, me emërtimin me shkrim dore: "HP Mbyllje TR-shp. 2012" evidentohet në një tabelë, se si janë shpërndarë shpenzimet ku evidentohet ndërmjet të tjerave: ...62501 (Të ardhura – shpenzime) – bileta avioni – të shpërndara në 2012 = 2 286.91 euro dhe - 60502 (Të ardhura – shpenzime) – akomodim hotel – të shpërndara në 2012 = 216.53 euro.

302.3 Më datë 16.04.2024 është pyetur shtetasi *Flamur Kuçi*, i cili ka deklaruar se, në vitin 2006 ka filluar punë fillimisht si këshilltar i zv. Kryeministrit Ilir Rusmaili, më vonë si këshilltar i zv. Kryeministrit Gazmend Oketa dhe nga viti 2008 – 2009 ka filluar punë si këshilltar për Çështjet e Territorit i Kryeministrit Sali Berisha dhe ka qëndruar në këtë pozicion deri në vitin 2013. Njëkohësisht për një periudhë disa mujore, që fillon nga pranvera e vitit 2013 deri në vjeshtën e vitit 2013 ka qenë zv ministër në Minsitrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Nga viti 2013 deri më sot ka punuar pjesërisht në Kosovë në lidhje me disa konsulenca për planifikim urban. Në vitin 2009 ka hapur një shoqëri me emrin Invest Construction në të cilën është ortak dhe administrator dhe operante në fushën në fushën e projektim ndërtimit. Para dy vitesh ka regjistruar edhe subjektin JFK Construction ku është ortak dhe administrator dhe operon në fushën e ndërtimit. Shtetasin Fatmir Bektashi deklaroi se e njeh por nuk i kujtohet me saktësi data kur e ka njohur për herë të parë. Kujton që e ka njohur gjatë kohës që arkitekti Daniel Libeskind ka vizituar Shqipërinë, pasi me këtë arkitekt Flamuri ka qenë anëtar jurie në konkursin për Bulevardin e ri të qytetit të Tiranës. Konkursi është realizuar nga Bashkia e Tiranës dhe prezantimi i projekteve ka qenë publik. Konkursi mesa i kujtohet është zhvilluar në vitet 2011 – 2012. Nuk di të thotë nëse arkitekti Daniel ka qenë më herët në Shqipëri. Në një takim informale që ka pasur me të pas përfundimit të konkursit gjithmonë në nivel profesional, mban mend që ka takuar shtetasin Fatmir Bektashi i cili ka qenë pjesë e tavolinës ku kanë pirë kafe ose konsumuar ndonjë drekë. Gjatë këtij takimi interesi i Flamurit ka qenë profesional dhe mban mend që në atë kohë Danieli po punonte me projektin e kompelsit të Kullave Binjake dhe pas diskutimeve ai e ka ftuar në Amerikë pasi aty jeyon dhe ka studion. Për të udhëtuar në Amerikë, është nisur bashkë me shtetasin Fatmir Bektashi dhe kanë fluturuar me tranzit ku ndalesa e parë është bërë në Vienë dhe mesa kujton shtetasi Fatmir ka pasur një problem me pasaportën dhe nuk është lejuar të udhëtojë dhe Flamuri ka shkuar vetëm në Amerikë ku ka takuar Danielin për një ditë dhe të nesërmen është kthyer. Më vonë nuk ka pasur asnjë lloj raporti tjetër as shoqëror dhe as pune me shtetasin Fatmir Bektashi. Nuk i

kujtohet kush i ka paguar biletat për udhëtimin në Amerikë. Anëtarët e jurisë së cituar më sipër janë caktuar nga organizatori që ishte Bashkia Tiranë. Shtetasin Jamarbër Malltezi deklaroi se e ka njohur në vitet 2005 – 2006 pasi ka qenë i punësuar në Ministrinë e Punëve Publike me një projekt. E ka takuar vazhdimisht nëpër tryeza profesionale.

303. Pagesat për shtetasin Daniel Libeskind vijojnë edhe përgjatë vitit 2013 dhe 2016 (*shih llogaritë bankare pranë Union Bank dhe BKT në euro dhe USD të shoqërisë Homeplan sh.p.k.*) por shtetësja *Hidajete Kraja (Muça)*, deklaroi se ... Në periudhën 2015 – 2016 për projektin *Tirana Magnet* deklaroi se nuk ka qenë përfaqësuese tatimore për subjektin Daniel Libeskind.

Investimi i vetëm i shtetasit Jamarbër Malltezi në shoqërinë Homeplan sh.p.k.

304. Nga muaji prill 2012, shoqëria Homeplan sh.p.k. fillon të shtojë punonjësit e saj ku ndërmjet të tjerëve konstatohet se punësohet edhe shtetasi Fatmir Ymaj si shofer. Ky shtetas rezultoi të ketë marrëdhënie të ngushta me shtetasin Malltezi pasi i jepet tagre nëpërmjet prokurave nga shtetasit Jamarbër dhe Argita, për tërheqje psh pasaporte për vete apo edhe për fëmijët e tyre, apo nga shtetasi Jamarbër Malltezi i jepet në përdorim automjet pa asnjë kundërshtim (*shih prokurën nr 559 rep nr 224 kol datë 26.03.2015 lëshuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi; prokurën nr 3059 rep nr 1029 kol datë 21.11.2018 lëshuar nga shtetësja Argita Malltezi; prokurën nr 124 rep nr 37 kol datë 20.01.2016 lëshuar nga shtetasit Jamarbër dhe Arita Malltezi, kontratën nr 979 rep nr 407 datë 31.07.2014 dhe atë me nr 1961 rep nr 759 kol datë 06.08.2019 me huadhënës shtetasin Jamarbër Malltezi*).

304.1 Në muajin nëntor 2012 shtetësja Suzana Aliaj që rezultonte të ishte e punësuar pranë shoqërisë Kontakt sh.p.k. punësohet pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k.

305. Nga të dhënat e administruara, konstatohet se shtetasi Jamarbër Malltezi, referuar akteve të administruara përgjatë këtij hetimi, sipas të cilave paraqitet si investitor, së bashku me shtetasin Xhimi Begeja dhe shoqërinë Homeplan sh.p.k., rezultoi të derdhë në vitin 2012, vetëm një shumë prej 45 128 euro në llogaritë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. Kjo është e vetmja vlerë që ky shtetas ka derdhur në kuadër të nismës së përbashkët për ndërtimin. Madje këtë vlerë shtetasi Jamarbër Malltezi konstatohet se e ka deklaruar edhe në deklaratën e pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2012, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, si vijon: ***Investim për ndërtim në tokën në bashkëpronësi- 6 300 000 lekë***. Pra, shtetasi Jamarbër Malltezi deklaroi në këtij investim e ka paraqitur për tokën në bashkëpronësi dhe jo për çdo sipërfaqe toke ku shtriheshin ndërtimet që po zhvilloheshin dhe u zhvilluan nga shoqëria Homeplan sh.p.k.

305.1 Është këqyrur edhe llogaria bankare e shtetasit Jamarbër Malltezi nga e cila është bërë ky kreditim, konkretisht llogaria pranë Procredit Bank. Nga kjo këqyrje rezultoi se shtetasi Jamarbër Malltezi, pasi ka konvertuar shumën 6,300,000 lekë në **45.128.94 euro**, i ka transferuar në llogarinë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. me përshkrimin "***pagesë detyrimi Homeplan sh.p.k.***". Shoqëria Homeplan sh.p.k. rezultoi që paratë e mësipërme i kalon në llogarinë bankare me nr. ...1000755060402 të shoqërisë Kontakt sh.p.k. me përshkrimin "***pagesë pjesore për situacione punimesh, Kontakt sh.p.k.***"

304.2 Në një dokument të sekuestruar pranë Studio Pustina me emërtimin "***Homeplan 2012 Libri i madh ...46719: Jamarbër Malltezi Eur...DB/I datë 24.12.2012 Lik Det. Jamarbër Malltezi, kredituar 45 128.94 euro (ose 6 281 948.45 lekë) , gjendje – 45 128.94...***"

Referuar dokumentit të gjendur në kompjuterin Laptop, të sekuestruar shtetasës Andia Pustina si më sipër cituar, në Folderat: Homeplan 2021, Abi_pergjigje, Bilance, 2012, dokumenti "12 Format Bilanc Homeplan_me_fx", faqe "Details 2012", pasqyrohet nga shoqëria Homeplan sh.p.k. si hua që i është dhënë nga shtetasi Jamarbër Malltezi në vlerën prej 45,128 Euro. Kjo shumë rezulton të jetë pasqyruar në bilanc në zërin 467 si "hua e dhënë ortakut" (46719).

306. Për vitin 2012, shtetasi Jamarbër Malltezi nuk deklarohet të ketë marrë përfitime nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në vlerë monetare përveç një pagesë të bërë për të, në lidhje me regjistrimin e pasurisë së paluajtshme që ai ka blerë pranë rrugës Dëshmorët e 4 shkurtit, në vlerën 246,525 lekë.

X. Fillimi i ndërtimit të kompleksit Magnet

307. Përgjatë vitit 2011 kanë nisur procedurat për marrjen e një leje ndërtimi për një kompleks tjetër, i cili quhet kompleksi **Magnet**. Sërish, këto procedura janë shoqëruar me kryerjen e pagesave të ashtuquajtur "kontribut patriotik".

307.1 Në një dokument të sekuestruar tek studio Pustina i emërtuar "Homeplan sh.p.k. 2011 Analizë datë 06.07.2011 A01 – A01z dt. 01.01.2011 -30.06.2011" rezulton të evidentohet ndërmjet të tjerave: MA 55 datë 18.3.2011 Kontakt sh.p.k. kthim shume Kontribut patriotik Magnet shuma 10 000 euro. Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me proces verbalin e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina. Konkretisht në tablen me emërtimin **Pagesa CASH dhe Bankë Homeplan për JM** konstatohet se në datë 18.03.2011 është paguar 10,000 euro Kontribut Patriotik Magnet (JM).

Lidhja e kontratave të sipërmarrjes për kompleksin Magnet

308. Tre muaj, pas miratimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Tiranë, rezulton se është lidhur kontratë sipërmarrje nr. 971 rep nr. 546 kol datë 22.05.2013, para noterës Laura Pustina, me familjen **Begeja**. Konkretisht rezulton se kontrata është lidhur mes shtetasve Haki Begeja, Nysret Kaçurri, Xhimi Begeja, Kreshnik Kaçurri, Meriban Kadiu, Bashkim Bekteshi, SanieVelo, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi, Ednan Begeja, Jamarber Malltezi, Orinda Malltezi, Rajmonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Gëzim Begeja, Elona Grabova, Haxhire Begeja, Vangjelia Kadiu, Ilir Kadiu, Manjola Kadiu, Lirije Lika, Myzejen Aga, Teuta Malka, Ajete Sulstarova, Lumturi Çela, Bashkim Kadiu të gjithë të përfaqësuar nga Jamarbër Malltezi dhe shoqërisë **Homeplan** sh.p.k. ku qytetarët si porositës dhe Homeplan si sipërmarrës. ...

Neni 1: Objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i një kompleksi shumëfunksional të emërtuar "**Magnet I**" me parkim, dyqane, zyra dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion pasuritë e llojit truall...: Pasuri regj hip 423 datë 23.04.2012, me nr 2/325 ZK 8220 sip trualli 380 m2, ndodhur në Rr. Ndre Mjeda; Pasuri regj hip 129 datë 24.02.2012, me nr 3/138 ZK 8220 sip trualli 3 120 m2, ndodhur në Tiranë; Pasuri regj hip 1400 datë 20.09.2012, me nr 3/162 ZK 8220 sip trualli 190 m2, ndodhur në Rr. Ndre Mjeda; Pasuri regj hip 1399 datë 20.09.2012, me nr 3/164 ZK 8220 sip trualli 210 m2, ndodhur në Rr. Ndre Mjeda....

Neni 2. ...pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e ndërtesave të ndodhura mbi truallin objekt të kësaj kontrate ...citohen ndërtesat...

Neni 3: ... pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërcituar 28% të sip ndërtimore që do të zhvillohet mbi pasurinë, objekt i kësaj kontrate sipas kushteve urbanistike që do të miratohen nga Bashkia Tiranë....

Në nenin 4 përcaktohet se, pala sipërmarrëse, do realizojë ndërtimin, së bashku me shoqërinë Kontakt në cilësinë e ndërtuesit

308.1. Gjithashtu në zbatim të sipërmarrjes së mësipërme, lidhet edhe kontrata ndërmjet shoqërive **Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k.** Kështu me kontratën e sipërmarrjes nr. 987 rep nr. 557 kol datë **24.05.2013**, të lidhur para noteres Laura Pustina, **mes shoqërisë Homeplan sh.p.k. dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k.** Homeplan si porositës dhe Kontakt si sipërmarrës, parashikohet se **porositësi është subjekt i interesuar për realizimin e objektit Magnet 1, në pronat e zotëruara nga Begeja të ndodhura në rr. Ndre Mjeda, Tiranë, për të cilat pronarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe t'i japin për zhvillim, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 971 rep nr. 546 kol datë 22.05.2013 të noteres Laura Pustina.** Objekt i kësaj marrëdhënie është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet porositësit dhe sipërmarrësit me qëllim realizimin e ndërtimit të kompleksit Magnet 1, kompleks ky që do të ndërtohet në emër dhe për llogari të porositësit, me financimin e këtij të fundit. **Sipas nenit 3, fitimi i sipërmarrësit do të jetë 10%.** Nëse sipërmarrësi nuk dorëzon objektin në afatin e parashikuar, detyrohet të paguajë edhe penalitete, sipas nenit 12.

309. Në vijim, lidhet një kontratë tjetër me familjen Begeja, për kompleksin Magnet, kontratë e cila konstatohet se **shton pasuritë që vihen në dispozicion të ndërtimit.** Me kontratën e sipërmarrjes nr. 1741 rep nr. 857/3 kol datë **12.08.2013**, shtetasit *Haki Begeja, Nysret Kaçurri, Xhimi Begeja, Meriban Kadiu, Bashkim Bekteshi, Sanie Velo, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Ednan Begeja, Jamarber Malltezi, Orinda Malltezi, Raimonda Bekteshi, Nervit Hoxha, Kreshnik Kaçurri, Gëzim Begeja, Elona Grabova, Haxhire Begeja, Vangjelia Kadiu, Ilir Kadiu, Manjola Kadiu, Lirije Lika, Myzejen Aga, Teuta Malka, Ajete Sulstarova, Lumturie Çela, Sejdiqe Kurti dhe Bashkim Kadiu,* të gjithë në cilësinë e palës pronare dhe të përfaqësuar nga shtetasi **Jamarbër Malltezi** kanë lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë **Homeplan sh.p.k.** e përfaqësuar nga administratori **Fatmir Bektashi.**

Neni 1. Objekti i kësaj kontrate është **ndërtimi i një kompleksi shumëfunksional i emërtuar Magnet** me parkim, dyqane, zyra dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë e llojit truall si vijon:

- *Pas e regj në regj hip nr. 1434 dt 01.10.2012 nr 3/115 ZK 8220 sip trualli 1 900 m2; në regj hip nr. 137 dt 28.02.2012 nr 3/140 ZK 8220 sip trualli 1500 m2, me shënimin nga regjistruesi "I vlefshëm për sipërfaqen 1500 m2"; në regj hip nr. 412 dt 20.04.2012 nr 3/151 ZK 8220 sip trualli 19 m2, me shënimin nga regjistruesi "Mbi këtë truall qëndron objekti 3/180/ND v. 17 faqa 249"; në regj hip nr. 414 dt 20.04.2012 nr 3/152 ZK 8220 sip trualli 47 m2, me shënimin nga regjistruesi "Mbi këtë truall ndodhet objekti 3/189/ND v. 19 faqa 235"; në regj hip nr. 413 dt 20.04.2012 nr 3/153 ZK 8220 sip trualli 9213m2, me shënimin nga regjistruesi "Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr. pas 3/171/ND v. 17 faqa 240"; në regj hip nr. 409 dt 20.04.2012 nr 3/154 ZK 8220 sip trualli 27 m2; në regj hip nr. 411 dt 20.04.2012 nr 3/155 ZK 8220 sip trualli 660 m2;*

Neni 2: ...pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e ndërtesave të ndodhura mbi trojet, objekt të kësaj kontrate.

*Neni 3: Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërpërmendur **25 % të sip ndërtimore** që do të zhvillohet mbi pasurinë, objekt i kësaj kontrate, sipas kushteve urbanistike që do të miratohen nga Bashkia Tiranë.*

Në nenin 4 është përcaktuar se, **pala sipërmarrëse merr përsipër zhvillimin e kompleksit në bashkëpunim me shoqërinë Kontakt në cilësinë e shoqërisë ndërtuese.**

309.1. Me kontratën aneks i kontratës së sipërmarrjes (nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013) datë 30.08.2013, para noteres Laura Pustina, rezulton se **pala pronare e truallit shtetasi Jamarbër Malltezi**, me zotësi për të vepruar në bazë të prokurave...**Lidh kontratën me palën sipërmarrëse shoqëria Homeplan sh.p.k. duke shtuar edhe troje të tjera.** Pala pronare e truallit deklaroi se ka në pronësi të saj edhe dy troje të tjera të ndodhura në krah të atyre që ka vënë ndërkohë në dispozicion të sipërmarrësit me kontratën e sipërmarrjes së lartpërmendur (të cilat i ka fituar si rezultat i procesit të privatizimit). Pala pronare dëshiron t'i verë edhe ato në dispozicion të sipërmarrësit, për t'i zhvilluar në kuadër të një projekti të përgjithshëm dhe maksimalisht gjithëpërfshirës të trojeve në pronësi të palës pronare truall. Palët bien dakort: **Shtimin e sip së truallit për zhvillim edhe me dy pasuri të tjera të llojit truall përkatësisht me këto përshkrime kadastrale: Pas nr. 3/182 lloji truall ZK 8220 sip 315 m² (regj në regj hip nr. 217 dt 20.11.2008) dhe Pas nr. 12/139 lloji truall ZK 8310 sip 880 m² (regj në regj hip nr. 20 dt 30.01.2009).**

309.2. Me kontratën e sipërmarrjes për ndërtimin e kompleksit Magnet, nr. 1742 rep nr. 858/1 kol datë 12.08.2013 para noteres Laura Pustina rezulton se **shoqëria Homeplan sh.p.k. në cilësinë e porositësit dhe shoqëria Kontakt sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit, përfaqësuar të dyja nga administratori Fatmir Bektashi, kanë nënshkruar kontratën për realizimin e objektit Magnet në pronat e zotëruara nga familja Begeja të ndodhura në rrugën Ndre Mjeda, për të cilat pronarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe t'i japin për zhvillim sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 1741 rep nr. 867 kol datë 12.08.2013 të noteres Laura Pustina. Sipas nenit 3 fitimi i sipërmarrësit 10 %.**

309.3. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 1743 rep nr. 859 kol datë 12.08.2013, të lidhur para noteres Laura Pustina, **mes shoqërisë Homeplan sh.p.k. si porositës dhe shoqërisë Kontakt sh.p.k. si sipërmarrës, është pasqyruar se porositësi është subjekt i interesuar për realizimin e objektit Magnet në pronat e zotëruara nga familjet Vaqarri dhe Alimehmeti të ndodhura në rr. Frosina Plaku, Tiranë, për të cilat pronarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe t'i japin për zhvillim sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 1466 rep nr. 421 kol datë 03.05.2010 të noteres Gentiana Shkodra dhe kontratës së sip nr. 9284 rep nr. 2687 kol datë 27.09.2010 të noterit Julian Zhelegu.**
Sipas nenit 3 fitimi i sipërmarrësit do të jetë 10%.

Ndryshimi i dytë i destinacionit.

310. Me shkresën nr 979 prot datë 21.05.2013 të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, nga Drejtori i Përgjithshëm **Andia Pustina (nënshkruar me P përpara)** është lëshuar vërtetim për likuidimin e detyrimeve vendore për shoq Homeplan sh.p.k. ku pasqyrohet se, subjekti ka likuiduar detyrimet vendore për vitin 2013.

311. Shoqëria Homeplan sh.p.k. pajiset me leje mjedisore e tipit C nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës me nr PN-5538-05-2013 për strukturë banimi dhe shërbime 4 – 13 kat dhe një kat parkimi nëntokë, kodi III.1.A me datë lëshimi 29.05.2013 dhe pa afat. Vendi i kryerjes së aktivitetit është përcaktuar Rruga Ndre Mjeda, Tiranë. Bashkalidhur është akti i

miratimit nr. 185 prot datë **21.05.2012** nr identifikimi LC-9482-16.05.2013 nr 5 vendimi Leje mjedisore tipi C (autorizim mjedisor) për veprimtarinë strukturë banimi & shërbime 4 – 13 kat me 1 kat parkimi nëntokë, me sip trualli 4100 m2 sip ndërtimi 1426 m2, koeficient shfrytëzimi 36.5 %, për shoqërinë Homeplan sh.pk. me administrator Fatmir Bektashi dhe vendndodhje rruga Ndre Mjeda, Tiranë. Ky akt miratimi është nënshkruar nga kryetari i ARM-së Qarku Tiranë Ylli Shehu.

312. Për të vijuar me ndërtimin e pjesës tjetër, normalisht, ashtu si edhe është premtuar në kontratat e lidhura me pronarët, ishte e nevojshme ndryshimi i destinacionit të zonës. Sjellim në vëmendje, se deri në këtë kohë, ky ndryshim është bërë pjesërisht. Konstatohet se në relacionin e planit të përgjithshëm të Bashkisë Tiranë, plani i përgjithshëm vendor, në listën e anëtarëve të Grupit Strategjik për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Qytetit të Tiranës, ndërmjet të tjerëve evidentohet edhe emri i shtetasit Jamarbër Malltezi. Gjithashtu, në listën e e anëtarëve të Grupit Teknik për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Qytetit të Tiranës, ndërmjet të tjerëve evidentohet sërish edhe emri i shtetasit Jamarbër Malltezi.

312.1 Në faqen 59 dhe 60 me emërtimin “3.2.4 ELEMENTET E FORTA TË INFRASTRUKTURËS SOCIALE”, gërma c “c. Qendrat sportive” është specifikuar ndër të tjera se *Elemente të forta territoriale janë dhe qendrat e mëdha të aktiviteteve sportive, të cilat për vetë funksionin rikrijues dhe pozicionin e tyre, përbëjnë pole të rëndësishme zhvillimore.* Disa nga këto qendra janë:

- kompleksi sportiv “Partizani”;

- terrene të tjera sportive në Rr. “Ali Demi”, në Laprake e në Kombinat.

Disa prej këtyre elementeve kanë karakter kombëtar dhe janë faktor zhvillimi jo vetëm për qytetin por edhe për vendin.

Ndër emrat e tjerë që kanë kontribuar për këto ndryshime, evidentohen edhe si specialist i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë, emri i shtetasit Arlind Okaj. Edhe ky shtetas, si disa punonjës të tjerë të Bashkisë Tiranë, duket se kanë prenotuar vetë apo familjarë të tyre, banesa në ndërtimet që zhvillohen në territoret e ish komplekseve Partizani.

312.2. Me vendimin nr. 57 datë **24.12.2012** “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Tiranë dhe instrumentave vendore të planifikimit pjesë përbërëse e tij” rezulton se Këshilli Bashkiak Tiranë, vendim i nënshkruar nga kryetari Njazi Kosovrasti, ka vendosur:

- 1) *Miratimin e planit të përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë dhe instrumentave vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij*
- 2) *Plani i përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë, instrumentat vendore të planifikimit, pjesë përbërëse e tij si dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak t’i dërgohen brenda 15 ditëve nga data e miratimit Agjensisë Komëbtare të Planifikimit të Territorit, për miratim përfundimtar nga Këshilli Kombëtar i Planifikimit të territorit*
- 3) *Ngarkohet kryetari i Bashkisë Tiranë, drejtoria e përgjithshme e planifikimit të territorit, drejtoria e përgjithshme e projekteve strategjike dhe investimeve të huaja dhe drejtoria e përgjithshme e planifikimit dhe menaxhimit të shërbimeve për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4) *Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.*

312.3. Me vendimin nr. 1 datë **15.02.2013**, Këshilli Kombëtar i Territorit, me kryetar

shtetasin Sali Berisha, ka vendosur:

- 1) *Miratimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Tiranë.*
- 2) *Ngarkohet Bashkia Tiranë për reflektimin e vërejtjeve të KKT-së të paraqitura në mbledhjen e datës 15.02.2013.*
- 3) *Ngarkohet Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4) *Ky vendim hyn në fuqi pasi të jenë reflektuar vërejtjet e KKT-së dhe hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar.*

Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë, miratuar nga kryetari i KKT Sali Berisha, miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1 datë 15.02.2013 me kryetar këshilli bashkiak Niazi Kosovrasti, miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 57 datë 24.12.2012 nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Lulzim Basha, për nën njësinë strukturore 7/3 faqa 269, pasqyron: ...2. Llojet e lejuara të përdorimit dhe të zënies së territorit. *Lejohen zhvillime brenda nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të, përfshirë struktura për institucione publike në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes.*

Sipas rregullores së mësipërme, konstatohet se për nën njësinë strukturore 7/25 (*shih faqa 287 e në vijim*), është përcaktuar se kjo është një nënjësi e përzier (mikse), banim dhe shërbime publike. Gjatë hartimit të PDV-ve duhet të përcaktohet raporti për secilin përdorim. Në pikën 2 është përcaktuar se lejohen zhvillime brenda nënkategorive të lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të. Përdorimi dhe zënia e territorit lejohet vetëm për zhvillimin e banesave me aktivitete të kombinuara, në përputhje me rregullat e nënjësi strukturore të banimit. Aktivitetet tregtare janë të lejuara në katet e para të objekteve. Sipas pikës 4, është parashikuar zhvillim i strukturave të larta për përdorim banim. Sipas pikës 5 rindërtim ose rizhvillim përcaktohet se aktualisht në nënjësi për kategorinë Banim, mbizotërojnë strukturat e ulëta, të cilat do t'i nënshtrohen rizhvillimit sipas përcaktimeve të PDV. Ndërhyrja në territor do të bëhet sipas propozimeve të PDV të cilat duhet të mbajnë në konsideratë përmirësimin dhe shtimin e infrastrukturave publike për nën njësinë.

313. Në dy dokumenta të datës 18.01.2014 të sekuestruara pranë Studio Pustina me përshkrimin "*Homeplan shpk 2013 – Analizë*", kua paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën lekë, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 -30.12.2013 evidentohen *Mandat Arkëtimi nr.29, dt 11.07.2013, në vlerën 200,000 lekë, me përshkrimin " Kontakt, kalim shume nga kontakt për pagesën e topografit" dhe Mandat Pagese nr.38, dt 11.07.2013, në vlerën 200,000 lekë, me përshkrimin " Fatmir Bektashi, pagesë topografi për pdev".* Në pjesën ku paraqiten arkëtimet në monedhën euro, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 -30.12.2013 evidentohet: *Mandat Arkëtimi nr.27, dt 13.07.2013, në vlerën 2,000 euro, ose 280 700 lekë, me përshkrimin "Kontakt, kalim shume për kontribut patriotik PDV Magnet".* Kjo datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me proces verbalin e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. Konkretisht: datë 13.07.2013 / 2,550 euro / Kontribut patriotik PDV magnet.

313.1 Në dokumentin e datës 28.03.2013, sekuestruar pranë studio Pustina, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012*" konstatohen lëvizjet: Mandat Pagese nr. 96 datë 27.07.2012 në shumën 3,500 euro me përshkrimin "*Fatmir Bektashi kontribut patriotik PDV Magnet*". Këto të dhëna janë nxjerrë edhe nga ekspertimi i hard diskut të sekuestruar tek studio Pustina, dokumenti "*Arka euro 2012*" i krijuar më datë 28.03.2013. Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me proces verbalin e datës 23.04.2023,

tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. Konkretisht: *datë 24.07.2012 / 3500 euro / KP për PDV Magnet*

Evidentohet dokumenti i datës 28.03.2013, me përshkrimin "*Homeplan – Analizë, në të cilin paraqiten arkëtimet dhe pagesat nga arka e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2012 – 31.12.2012, ku konkretisht evidentohet: Mandat Pageze nr. 99 datë 30.07.2012 në shumën 1,180 euro me përshkrimin Lili Dhame studimi gjeo-inxhinierik Magnet*".

314. Në dokumentin e datës 18.01.2014, sekuestruar pranë studio Pustina, me përshkrimin "*Homeplan shpk 2013 – Analizë*", paraqiten arkëtimet në monedhën **euro**, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 -30.12.2013, ku ndër të tjera konstatohen lëvizjet si vijon: *Mandat Arkëtimi me nr.23, datë 11.07.2013, në vlerën 900 euro, ose 126 000 lekë me përshkrimin "Kontakt, kalim shume per KP për lejen e ndërtimit"*. Kjo vlerë dhe datë, reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me proces verbalin e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. Konkretisht: *datë 11.07.2013 / 900 euro / KP leje ndërtimi*.

Instituti i Ndërtimit rezulton të ketë lëshuar faturën tatimore të shitjes me nr 40 datë **29.07.2013**, me përshkrim "*Oponencë teknike për strukturë banimi dhe shërbime 4 – 13 kate në një kat parkimi nën tokë, Tiranë në vlerën 314 497 lekë. Kjo faturë për shitësin është nënshkruar nga Lorena Lika dhe për blerësin nga Genci Bektashi. Pranë llogarisë bankare pranë BKT në lekë të shoqërisë Homeplan rezulton se më datë **30.07.2013** të jetë paguar shuma 314 497 lekë, Instituti i Ndërtimit me përshkrimin "Payment DI Lik Fat nr. 29"*

315. Në vijim konstatohet se arrihet miratimi i fazës së parë të planit të detajuar vendor për nën njësinë 7/25. Konkretisht me vendimin nr. 7651/11 datë **05.08.2013** "*Për miratimin e Fazës së I-rë të Planit të Detajuar Vendor të nën njësisë nr. 7/25*" të Kryetarit të Bashkisë Lulzim Basha është vendosur:

1. *Miratimi i fazës së I-rë të planit të detajuar vendor të nën njësisë nr. 7/25 e cila kufizohet nga rrugët Frosina Plakum, Ndre Mjeda, Artan Lenja*
2. *Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 të "Manualit të procedurave dhe Organizimit të Këhsillit Teknik të Bashkisë Tiranë" miratuar me vendimin nr. 6887/2 datë 15.07.2013 të kryetarit të bashkisë....*

Gjendet e administruar në aktet e Bashkisë, harta "*Plani i detajuar vendor i nën-njësisë strukturore 7 – 25*" propozim për ndërhyrjen në territor, e nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Lulzim Basha, miratuar me vendim të kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 7651/_ datë 06.08.2013 dhe nënshkruar gjithashtu nga: Drejtoria e përgjithshme/DPPZHT drejtor **Florian Pustina**,...Sektori i projekttimeve përgj sektori **Muhamet Kruja**....

316. Nga Instituti i Ndërtimit rezulton të jetë lëshuar faturë tatimore shitje nr 42 dt **15.08.2013** për shoqërinë Homeplan sh.p.k. me emërtimin "*Oponencë teknike për godina banimi e shërbimi 4 – 11 kat rruga Artan Lenja, Frosina Plaku*" copë 1, në shumën 1 286 743 lekë. Kjo faturë, për shitësin, është nënshkruar nga Ilir Muço kurse për blerësin nga Genci Bektashi. Me shkresën nr 127/1 prot dt **19.08.2013** të Institutit të Ndërtimit i është përcjellë shoq Homeplan sh.p.k. Oponenca teknike, në bazë të kërkesës prot nr 127 dt 30.07.2013 për strukturë banimi dhe shërbime 4 – 13 kate me 1 kat nëntokë, në rrugën Ndre Mjeda. Grupi i oponencës konstatohet se janë *Ing Çelestina Lazeri, Lorenc Islamaj, Fatmir Milo dhe Bashkim Shahinaj dhe shefe e departamentit Silvana Pasho*.

316.1 Evidentohen pagesa të quajtura "**kontribut patriotik**" për oponencën. Për vitin 2013 janë administruar pranë studio Pustina, dy dokumenta të datës 18.01.2014 me përshkrimin "**Homeplan shpk 2013 – Analizë**", ku paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën **lekë**, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 -30.12.2013, ku ndër të tjera konstatohen lëvizjet, si vijon: Mandat Arkëtimi nr.47, dt **22.08.2013**, në vlerën 10,000 lekë, me përshkrimin "**Fatmir Bektashi, derdhje të ortakut**" dhe Mandat Pagese nr.56, dt 22.08.2013, në vlerën 10,000 lekë, me përshkrimin "**kontribut patriotik oponenca Magnet**". Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me proces verbalin dt 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin *Pagesa Cash për Homeplan*. Konkretisht: datë 22.08.2013/ 71.43 euro / **Kontribut patriotik oponenca Magnet**.

Me shkresën nr 135/1 prot dt **02.09.2013** Instituti i Ndërtimit ka përcjellë oponencë teknike të projektit *Magnet Strukturë banimi dhe shërbime 4-13 kat me 1 kat parkim nëntokë në rrugën Ndre Mjeda, Artan Lenja dhe Frosina Plaku*.

317. Me proces verbalin nr. 008485 datë 17.08.2013, inspektorët Sh.Gega dhe K.Dulli në rrugën Frosina Plaku, për subjektin Kontakt sh.p.k. kanë konstatuar se po kryhen punime ndërtimore në proces për ndërtim *shtesë kati me fazë punimesh karabina kollona + soletë beton arme me sip 1300 m2 pa dokumentacion tekniko ligjor në momentin e konstatimit*. Me vendimin nr. 1671 datë **20.08.2013** nr serial 0001671 INU Bashkia Tiranë, rezulton të ketë gjobitur subjektin Kontakt sh.p.k. me gjobë në masën 100 000 lekë, *për ndërtim kati shtesë në fazë punimesh karabina + soletë betonuar në s = 1300 m2, pa dokumentacionin përkatës tekniko ligjor*. Gjithashtu me vendimin nr. 1071 datë **20.08.2013** (nr. 2913 prot datë 30.08.2013) të INU, Bashkia e Tiranës, është vendosur pezullimi i punimeve të ndërtimit në objekt për afatin 10 ditor.. Me vërtetimin nr. 1510 prot datë **02.09.2013** të nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave vendore Bashkia e Tiranës, shtetësja **Andia Pustina**, rezulton se taksapaguesi subjekti Kontakt, ka likuaduar detyrimet për gjobë të INU.

318. Konstatohet se në kohën që kryetar Bashkie ka qenë shtetasi Lulzim Basha, njerëzit e besuar të shtetasve Malltezi por edhe Berisha, siç janë shtetasit **Andia Pustina, Etion Kapedani, Florian Pustina**, mbajnë pranë Bashkisë Tiranë, pozicione drejtuese, që duket se kanë ndikim në fazat e miratimit të lejes që kërkohet për zhvillimin e ndërtimeve apo për përlllogaritjen e taksave dhe pagesës e mënyrës së pagesës së tyre.

Për shtetasin Etion Kapedani kemi parashtruar edhe më lart lidhjet me shtetasin Sali Berisha dhe shtetasen Andia Pustina.

318.1 Shtetësja Andia Pustina, megjithëse rezulton të punojë pranë Bashkisë Tiranë vijon edhe të menaxhojë shoqërinë Homeplan sh.p.k. dhe marrëdhëniet e kësaj të fundit me shoqërinë Kontakt sh.p.k. në këto ndërtime. Kështu, nga aktet e sekuestruara pranë studio Pustina, është administruar një dosje me kapak me ngjyrë të zezë, e cila fillon me shkresën me nr. 2627 prot datë 02.07.2013 të shoq Homeplan sh.p.k. me lëndë "*Lista e faturave dhe dokumentave dretuar zyrës kontabile Pustina*" me përmbajtje: *Poshtë shënuar anë lista e dokumentave që do i dërgohen zyrës kontabile...në vijim përshkruhen tërësia e dokumentave si fatura tatimore, statement bankare etj*. Shkresa të tilla vijnë edhe në muajt e tjerë në vijim të vitit 2013, ku **pasqyrohet se nënshkruhen nga Fatmir Bektashi dhe Andia Pustina ose përfaqësues të tyre/punonjës të tyre**.

318.2 Shtetasi Florian Pustina, me nr personal H80707062O, rezulton nga të dhënat e administruara nga sistemi se deri në muajin korrik 2015 është paguar nga Bashkia e Tiranës, por nga muaji shtator 2015 rezulton i punësuar pranë studio Pustina. Kjo e dhënë pasqyrohet në procesverbalin e datës 01.09.2024, për këqyrjen e sistemit C@ts.

318.3 Shtetësja *Andia Pustina*, e pyetur në lidhje me shtetasin Florian Pustina, deklaroi se, *e ka kushëri, por jo të afërt. Flori ka punuar në Ministrinë e Jashtme dhe pas Ministrisë së Jashtme, nuk e mban mend një periudhë kohe ku ka punuar, më pas ka punuar këshilltar në Bashkinë e Tiranës, këshilltar i kryetarit Lulzim Basha dhe më pas ka kaluar në Bashkinë e Tiranës në pozicionin e Drejtorit të Urbanistikës. Më pas, ka bashkëpunuar me Andian në studio, duke u punësuar në studion Pustina prej saj.*

318.4 Shtetësja Irida Hasa, rezulton të jetë vajza e shtetases Sofika Hasa dhe kjo e fundit rezulton të ketë porositur apartament dhe garazh, pikërisht në ndërtime të zhvilluara nga shoqëritë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. që në vitin 2011 (shih librin e arkës) në territoret e dy ish Klubeve Partizani.

319. Kështu nga aktet rezulton se sekretarja e Këshillit Teknik shtetësja Irida Hasa pikërisht nëpërmjet kryetarit të Këshillit Teknik shtetasi Florian Pustina, i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë shtetasi Lulzim Hasa me memon nr. 8165/7 prot dt 27.08.2013 me lëndë: *“Opinionet e mbledhjes së Këshillit Teknik nr. 4 datë 26.08.2013”* në të cilën parashtrahet: *...Në dt 26.08.2013 në sallën e mbledhjeve në Bashkinë Tiranë, u zhvillua mbledhja e Këshillit Teknik nr. 4. ... u njoh nëpërmjet specialistëve të DPU dhe DKZHT me memot dhe materialet grafike për projekt PDV-të (Faza e II-të) për disa nënjesi strukturore të qytetit të Tiranës. Më poshtë rendisim çështjet e shqyrtuara të shoqëruara me opinionet e Këshillit Teknik për secilën.*

1. Faza e II-të e Planit të detajuar Vendor të nënjesisë strukturore nr. 7/25 Zona A3
Kjo zonë e nënjesisë strukturore 7/25 u relatua nga specialistja ... konfirmoi se materiali i paraqitur është konform përcaktimeve të PPV-së, PDV faza e I-rë, dhe legjisllacionit në fuqi në fushën e planifikimit të territorit. Pas diskutimeve të gjithë anëtarët e Këshillit Teknik prezent në mbledhje u shprehën unanimitisht dakord për të kaluar për miratim propozimin për miratimin e fazës së II-të të planit të detajuar vendor të nënjesisë strukturore 7/25 Zona A3, sipas kufijve të miratuar me vendimin nr. 7651/11 datë 05.08.2013 të Kryetarit të Bashkisë për miratimin e fazës së I-rë të planit të detajuar vendor të nënjesisë strukturore 7/25. ...

Në fund është nënshkruar nga anëtarët prezent në mbledhje ku midis tyre konstatohen edhe shtetasit Florian Pustina dhe Muhamet Kruja.

319.1. Me vendimin nr. 8197/1 datë 28.08.2013 *“Për miratimin e fazës së II-të të planit të detajuar vendor të nënjesisë nr. 7/25 zona A3”* kryetari i bashkisë Lulzim Basha ka vendosur:

- 1. Miratimi i fazës së II-të të planit të detajuar vendor të nënjesisë nr. 7/25 Zona A3 sipas kufijve të miratuar me vendimin nr. 7651/11 datë 05.08.2013 të kryetarit të Bashkisë për miratimin e fazës së I-rë e të planit të detajuar vendor të nënjesisë 7/25.*
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës....*

320. Nga shtetasi Jamarbër Malltezi rezulton të jetë përgatitur vlerësimi i ndikimit në mjedis, në një raport të emërtuar *“Raporti tekniko – ligjor”* e në përmbajtje *“Raporti i vlerësimit të*

ndikimit në mjedis Magnet_1". Ky raport është nënshkruar nga shtetasi **Jamarbër Malltezi**. Gjithashtu gjendet i administruar një raport vlerësimi strategjik mjedisor Nënjesia Strukturore 7/25, Zona A3 midis rrugëve "Ndre Mjeda", "Frosina Plaku", "Artan Lenja" Tiranë. Në fund përshkruhet se është përgatitur ky raport dhe kanë nënshkruar shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Sulejman Sulçe**.

320.1 Me nr. 5976/1 prot dt **29.08.2013** është lëshuar deklarata mjedisore "*Për veprimtari që kanë ndikim në mjedis*" rezulton që nga Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Mjedisit, për projektin "*Plan i detajuar vendor për nënjesinë strukturore 7-25 Bashkia Tiranë me kërkes Homeplan, për nënjesinë 7 – 25, me sip toke 44 141 m2 (shih më poshtë të dhëna më të detajuara kondicioneve urbanistike)*", është nënshkruar nga Ministër **Fatmir Mediu**.

321. Me kërkesën nr 4024 prot dt **02.09.2013** shtetasi **Fatmir Bektashi, shoq Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh/.p.k.** kanë paraqitur kërkesë për leje zhvillimore ndërtimi për strukturën Kompleksi Magnet të përbërë nga strukturat *Eagle 4-13 kat banim dhe shërbime me 1 kat parkim nëntokë dhe për 12 struktura me 1 kat parkim nëntokë të përbashkët: të ndodhur në rrugën Ndre Mjeda me zhvillues Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k. dhe subjekt ndërtues Kontakt sh.p.k.*

Sipas kërkesës për kryerje punimesh, pasuritë ku propozohet të ndërtohet, janë në ZK 8220 si vijon: *Nr pas 2/325 vol 15 faqa 181; Nr pas 3/138 vol 15 faqa 56; Nr pas 3/162 vol 17 faqa 91; Nr pas 3/164 vol 17 faqa 93; Nr pas 3/115 vol 12 faqa 210; Nr pas 3/140 vol 15 faqa 57; Nr pas 3/151 vol 15 faqa 178; Nr pas 3/152 vol 15 faqa 178; Nr pas 3/153 vol 15 faqa 184; Nr pas 3/157 vol 15 faqa 172 dhe Nr pas 3/159 vol 15 faqa 174*, Në pronësi të: *Familja Kacurri, Kadiu, Bektashi, S.Velo, M.Kallajxhi, familja Malltezi, N.Hoxha, E.Grabova, L. Lika, M. Aga, T.Malka, A.Sulstarova, L.Çela, S.Kurti, Familja Bektashi, Vaqarri, Arapi, Alimehmeti, Mullici*. Sip në m 2 e pasurisë **35 304 m2** e cila ka ndërtesa ekzistuese. Në kontratën sip nr 1741 rep nr 857/3 kol datë 12.08.2013 dhe nr 9284 rep nr 2687 kol datë 27.09.2010 nga ana e bashkëpronarëve janë dhënë për zhvillim pas me nr 3/115; 3/140; 3/151; 3/152; 3/153; 3/154; 3/155; 3/157; 3/158 por pasuritë **3/154; 3/155; 3/158 nuk përfshihen brenda konturit të pronave që do të zhvillohen me lejen zhvillimore të ndërtimit të sipërpërmendur.**

Tek informacioni mbi projektuesit, konstatohet se evidentohet emri i shtetasit **Ruben Alite** si ing Konstruktor.

322. Nga aktet rezulton se shtetasi Florian Pustina në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë, ka nënshkruar ndër të tjerë autorizimin nr 8427/1 prot dt **04.09.2013**, për pagesën prej **39 357 115 lekë**, si tarifë për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime, për kompleksin Magnet, nënjesia strukturore 7/25. Shtetësja Andia Pustina në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, po pranë Bashkisë Tiranë, ka lëshuar vërtetimin nr 1583 prot dt **18.09.2013** me të cilin vërteton se subjekti ka shlyer detyrimin...

Nëpërmjet drejtorit Florian Pustina, është përcjellë memo nga specialistët përkatës në drejtim të Administratorit të Përgjithshëm Etion Kapedani, memo kjo me nr 8427/3 prot dt. 04.09.2013, ku parashtrohet se kërkesa për leje zhvillimore ndërtimi për kompleksin Magnet, vetëm për çështje të përmbushjes së formës, është pranuar dhe do të nisë procedura për shqyrtimin administrativ të saj.

322.1 Nga Përgjegjësjë e Sektorit të Shqyrtimit të Aplikimeve, Sektorit të Sekretariatit Teknik, nëpërmjet shtetases **Irida Hasa** Drejtor i Drejtorisë së kKontrollit të Zhvillimit të

Territorit/Sekretar i Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë i është përcjellë Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit/Kryetar i Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë memo nr. 8427/5 prot dt **11.09.2013**, me lëndë *relacion mbi aplikimin për leje zhvillimore ndërtimi për kërkesën me nr prot 8427 datë 02.09.2013*, parashtrohet se: ... mbështetur ndër të tjera edhe në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës miratuar me vendimin nr. 1 datë **15.02.2013** të Këshillit Kombëtar të Territorit, specialistët, ..., sip e pronës që zhvillohet 35 304 m², sip e tokës e zënë nga struktura 12 887 m². Zona që do të zhvillohet ndodhet në NJB nr. 7, rruga Ndre Mjeda, në ZK 8220. ...Realizimi i këtij projekti kërkon prishjen e disa strukturave ekzistuese për të cilat është dhënë pëlqimi nga bashkëpronarët e këtyre objekteve në bazë të deklaratave noteriale për prishje ...Në bazë të kontratave të sip me nr 1741 rep nr. 857/3 kol datë **12.08.2013** dhe nr 9284 rep nr. 2687 kol datë **27.09.2010** nga ana e bashkëpronarëve janë dhënë për zhvillim pasuritë me nr 3/115, 3/140, 3/151, 3/152, 3/153, 3/154, 3/155, 3/157, 3/158 por pasuritë me nr 3/154, 3/155, 3/158 nuk përfshihen brenda konturit të pronave që do të zhvillohen me lejen zhvillimore të sipërpërmendur. ...Kërkesa për leje zhvillimore ndërtimi është bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës miratuar me vendimin nr. 1 datë **15.02.2013** të Këshillit Kombëtar të Territorit; planin e detajuar vendor Faza e II-të për nënnjësitë strukturore 7/25, Zona A3, miratuar me vendimin nr. 8197/2 datë **28.08.2013**. ...Gjurma e strukturës 4-13 kat përputhet me konturin e gjurmës për të cilin, punimet kanë filluar. ...Dokumentacioni tekniko ligjor i aplikimit është shqyrtuar për përmbajtje dhe është i rregullt, në përputhje me ligjin, aktet nënligjore në zbatim të tij, me planin e detajuar vendor, faza e II-të, për nënnjësinë strukturore 7/25 zona A3, miratuar me vendimin nr. 8197/2 datë **28.08.2013** të Kryetarit të Bashkisë....

Sekretare e këshillit teknik Irida Hasa, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë **Florian Pustina** i përcjell kryetarit të Bashkisë, memon nr. 8426/6 dhe 8427/6 prot dt **13.09.2013**, me lëndë: *Opinionet teknike të mbledhjes së Këshillit Teknik të Bashkisë së Tiranës, nr. 5 datë 13.09.2013 dhe dokumentacioni shoqëruar parashtrohet se: ...Në datën 13.09.2013 në sallën e mbledhjeve në Bashkinë Tiranë u zhvillua mbledhja e Këshillit Teknik nr 5 e Bashkisë së Tiranës. Në këtë mbledhje Këshilli Teknik u njoh ...Kërkesa nr. prot 8427 datë **02.09.2013** për leje zhvillimore ndërtimi për kompleksin Magnet ...Relatuesja konfirmoi se materiali i paraqitur është konform përcaktimeve të PPV-së dhe planeve të detajuara vendore të shqyrtuara me dy faza dhe të miratuara përkatësisht me vendime të kryetarit të Bashkisë Nr. 7651/11 datë **05.08.2013** dhe nr. 8197/2 datë **28.08.2013** si dhe legjislacionit në fuqi në fushën e planifikimit të territorit....Pas diskutimeve të gjithë anëtarët e Këshillit Teknik të pranishëm në mbledhje u shprehën unanimisht dakord për të kaluar për miratim propozimin për aplikimin e mësipërm, për leje zhvillimore ndërtimi me vërejtjen e mëposhtme: Të plotësohet dhe të përmirësohet nga subjekti zhvillues projekti i zbatimit si dhe trajtimi i fasadave të bëhet me materiale cilësore. ...specilistët e sekretarit teknik ... kanë përgatitur dhe konfirmuar dokumentacionin shoqëruar për secilën kërkesë si më poshtë: Draft/vendimi për kryetarin; Draft/plani i vendosjes së zonës së zhvillimit të propozuar...* Anëtarët prezent në mbledhje dhe që kanë nënshkruar ndër të tjerë evidentohen **Florian Pustina** dhe **Muhamet Kruja**.

322.3 Me autorizimin nr prot 8427/7 dt **18.09.2013** "Për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukture" të Bashkisë së Tiranës, për nënnjësinë strukturore 7/25, subjekti ose investitori autorizohet të kryejë ... Vlerën total të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukture 156 732 743 lekë. Ky autorizim është i nënshkruar ndër të tjerë nga drejtori i përgjithshëm **Florian Pustina**. Me vërtetim, nr 1586 prot dt 19.09.2013, nënshkruar nga drejtori i Përgjithshëm **Andia Pustina**, rezulton se taksapaguesi Homeplan dhe Kontakt, për pagesën e diferencës së

vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 150 432 743 lekë është lidhur akt marrëveshje për pagesë me këste me DPTTV me nr prot 2659 dt 19.09.2013 për likuidim deri në dt. 30.09.2013. Me shkresën nr. 2915 prot dt 14.10.2013 të drejtores së përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore Bashkia Tiranë drejtuar **Florian Pustinës**, drejtor i përgjithshëm i planifikimit dhe zhvillimit të territorit me lëndë konfirmim pagese, informohet se subjekti Homeplan sh.p.k. ka kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 156 732 743 lekë. Me shkresën nr. 2915/1 prot dt 14.10.2013 të drejtores së përgjithshme të taksave dhe tarifave vendore Bashkia Tiranë drejtuar **Florian Pustinës**, drejtor i përgjithshëm i planifikimit dhe zhvillimit të territorit me lëndë konfirmim pagese, informohet se subjekti Kontakt sh.p.k. ka kryer pagesën e kamatvonesës mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë me akt mandatin nr 9719 datë 14.10.2013 në vlerën 3 484 649 lekë.

322.4 Rezulton se, me vendimin nr. 8427/8 datë **18.09.2013**, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Lulzim Basha, është dhënë leja zhvillimore ndërtim për kompleksin **Magnet** të përbërë nga: strukturat *Eagle 4+13 kat banim dhe shërbime me 1 kat parkim nëntokë dhe 12 struktura me 1 kat parkim nëntokë të përbashkët*. Në rrugën Ndre Mjeda, në pronë të familjeve *Begeja, Kaçurri, Kadiu, Bekteshi, S.Velo, M.Kallajxhiu, Malltezi, N.Hoxha, E.Grabova, L.Lika, M.Aga, T.Malka, A.Sulstariva, L.Çela, S.Kurti, Bektashi, Vaqarri, Arapi, Alimehmeti, Mulliçi*. Me zhvillues **Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k. dhe subjekt ndërtues Kontakt sh.p.k.**

Në pikën 12 të këtij vendimi është përcaktuar se në përfundim të ndërtimit dhe pas regjistrimit të objekteve në ZVRPP Tiranë, subjektet do të bëjnë kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, për objektin Kopësht për fëmijë me sip 1156 (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim dhe kalimi në përdorim eskuziv të sheshit prej 1020 m² si sipërfaqe funksionale e këtij objekti sipas akt marrëveshjes që do të lidhet mes zhvilluesve dhe Bashkisë Tiranë.

323. Ndërkohë, mesa konstatohet konfliktet vijnë gjatë zbatimit të punimeve. Kjo dokumentohet nga dokumentat e administruara, të sekuestruara dhe gjetur në apartetet kompjuterike të sekuestruara pranë Studio Pustina ku gjenden shënime të tilla si: *Mandat Arkëtimi me nr.43, datë 12.10.2013, në vlerën 2,500 euro, me përshkrimin "Kontakt, kalim shume". ...Pagesa Cash për Homeplan, datë 12.10.2013 / 2,000 euro/ Kontribut patriotik kundra dhunës në rrugë (policisë).*

324. Në një dokument të emërtuar "*Homeplan sh.p.k. 2013, Analizë datë 18.01.2014 A01-A01 Z datë 01.01.2013- dok ma-*" evidentohet ndër të tjera: **MP 86 datë 17.10.2013 Fatmir Bektashi kontribut patriotik për Bashkinë TR 10 720 lekë.**

324.1 Në dy dokumenta të datës 18.01.2014 të sekuestruara pranë Studio Pustina me përshkrimin "*Homeplan shpk 2013 – Analizë*", paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën lekë, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 -30.12.2013 evidentohen: *Mandat Arkëtimi me nr.69, datë 16.10.2013, në vlerën 2,500,000 lekë, me përshkrimin " Fatmir Bektashi, tërhequr nga UB" dhe Mandat Arkëtimi me nr.70, datë 17.10.2013, në vlerën 1,305,720 lekë, me përshkrimin " Fatmir Bektashi, konvertim Brenda llogarisë me kurs 140.4 për pages..". Mandat Pagese nr nr.84, datë 16.10.2013, në vlerën 30,484,649 lekë, me përshkrimin " Bashkia Tiranë, pagesë kamatvonesa për pagesën e taksës së nder..." Mandat Pagese me nr.86, datë 17.10.2013, në vlerën 10,720 lekë, me përshkrimin " Fatmir Bektashi, kontribut patriotik për bashkinë TR". Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me process verbalin e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. Konkretisht: dt 17.10.2013/ 76.57 euro / Kontribut patriotik për bashkinë TR.*

325. Me lejen zhvillimore ndërtimi nr. prot 8427/10 dt **18.10.2013** miratuar me vendim të kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 8427/8 datë 18.09.2013 nënshkruar nga kryetari Lulzim Basha, është dhënë leja zhvillimore ndërtimi për strukturën Kompleksi Magnet i përbërë nga strukturat: *Eagle 4-13 kat banim dhe shërbime me 1 kat parkimi nëntokë dhe 12 strukturat me 1 kat parkim nëntokë të përbashkët; Në rrugën Ndre Mjeda, në pronë të familjeve Begeja, Kacurri, Kadiu, Bekteshi, S.Velo, M.Kallajxhi, Malltezi, N.Hoxha, E.Grabova, L.Lika, M.Agsa, T.Malka, A.Sulstarova, L.Çela, S.Kurti, Bektashi, Vaqarri, Arapi, Alimhemti, Mulliçi. Zhvillues janë Kontakt sh.p.k., Homeplan sh.p.k. dhe ndërtues Kontakt sh.p.k., Sip e truallit që zhvillohet 35 304 m², Sip e truallit të zënë nga struktura 12 887 m², Nr kateve mbi tokë 4 – 13 kate, Nr i kateve nëntokë 1 kat.*

325.1. Sërish shtetësja Irida Hasa, nëpërmjet shtetasit Florian Pustina i përcjell shtetasit Eton Kapedani, memon nr 8427/11 prot dt **18.10.2013** me lëndë “Mbi kërkesën për leje zhvillimore ndërtimi për kompleksin Magnet nr prot 8427 datë 02.09.2013 në rrugën Ndre Mjeda me zhvillues Kontakt sh.p.k dhe Homeplan sh.p.k. dhe subjektit ndërtues Kontakt sh.p.k.”, me të cilën kërkohet nga Drejtoria e Marrëdhënieve me publikun afishimi e njoftimit për subjektet e interesuara.

Me shkresën nr 8427/13 prot datë 21.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm **Florian Pustina** drejtuar Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k. si dhe ZVRPP Tiranë, me lëndë përcjellje dokumentacioni për regjistrim të lejes zhvillimore ndërtimi, është përcjellë vendimi nr 8938/7 dt 07.10.2013, planvendosje e zonës për zhvillimin e strukturës, projekti i zbatimit..., plani i sistemit, organizimit etj kompleks Magnet me 12 struktura..., Struktura Eagle...Kjo shkresë është nënshkruar ndër të tjerë edhe nga Irida Hasa.

Me shkresën nr 8427/14 prot datë 21.10.2013 të drejtorit të përgjithshëm **Florian Pustina** drejtuar Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k. si dhe Arkivit Qendror Shtetëror Teknik Tiranë, është dërguar projekti i zhvillimit, të miratuar me vendim të kryetarit të Bashkisë nr 8427 prot datë 02.09.2013 , planvendosje e zonës së zhvillimit të strukturës, projekti i zbatimit të arkitekturës... etj....Kjo shkresë është nënshkruar ndër të tjerë edhe nga shtetaset Irida Hasa.

326. Megjithëse shoqëria Homeplan sh.p.k. paraqitet si investitore, konstatohet se ajo ka nevojë për para dhe financimin e saj e kryen shoqëria Kontakt sh.p.k. e cila në fakt duhet të ishte shoqëria e financuar. Kjo është një ndër provat e tjera që mbështet faktin se shoqëria Homeplan sh.p.k. nuk është krijuar realisht për financimin e ndërtimit dhe se ndërtimet e kryera nuk janë financuar nga shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja.

326.1. Kështu rezulton se me kontratën e huasë nr 1793 rep nr 894 kol datë 26.08.2013 të lidhur para noterës Laura Pustina rezulton se shoqëria **Kontakt sh.p.k.** në cilësinë e huadhënësit i ka dhënë hua shoqërisë **Homeplan sh.p.k.** në cilësinë e huamarrësit, një shumë prej 300 000 euro e cila do të përdoret për pagesën e pjesshme të lejes së ndërtimit të kompleksit **Magnet**, duke kaluar në llogarinë bankare të huamarrësit pranë Union Bank sh.a. Si interes do të jetë norma bazë e interesit plus 4 %. Kjo shumë do të shlyhet brenda 4 vitesh.

Sipas dokumentave të sekuestruara pranë studio Pustina, evidentohet një dokument me emërtimin “Kontakt 2013 – studim veprime llogarie” ku evidentohet se, më datë 18.09.2013 është pasqyruar: “kalim shume për HP sh.p.k. për pagesën e taksës së ndërtesës – 282 000 euro” Datë 19.09.2013 “kalim shume për homeplan sh.p.k. për pagesën e taksës së ndërtesës” në shumën 45 000 euro.

327. Në vijim edhe shoqëria Homeplan merr edhe një kredi por sërish si garant del shoqëria Kontakt sh.p.k. dhe vetë shtetasi Fatmir Bektashi. Me kontratën e Kredisë bankare Nr. 1865 rep. nr. 1172 kol. datë 11.10.2013, midis Union Bank në cilësinë e kredidhënësit, shoqërisë "Homeplan" në cilësinë e kredimarrësit, shoqërisë "Kontakt" shpk në cilësinë e dorëzanësit dhe shtetasi Fatmir Bektashi në cilësinë e dorëzanësit, banka i jep kredi në formën e overdraftit, 300 000 euro. Për këtë kredi të marrë, hipotekuesi Fatmir Bektashi ka nënshkruar Kontratën Hipotekore me nr. 1832 rep/ nr. 1151 kol. datë 03.10.2013 në të cilën, për të garantuar kredinë, janë vendosur në favor të Union Bank sh.a. 5 njësi në pronësi të shoqërisë Kontakt sh.p.k. të regjistruar në rrugën Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tiranë, ZK 8270. pasuritë e paluajtshme si vijon:

327.1. Gjithashtu lidhet edhe një kontratë tjetër kredie, me Nr. 9007 rep. nr. 1661 kol. datë 28.10.2014, midis "Union Bank" në cilësinë e kredidhënësit, shoqërisë "Homeplan" në cilësinë e kredimarrësit, shoqërisë "Kontakt" shpk në cilësinë e dorëzanësit dhe shtetasi Fatmir Bektashi në cilësinë e dorëzanësit. Banka i jep kredi 300,000 euro me qëllim pagesën e pjesshme të lejes së ndërtimit të kompleksit Magnet dhe kthim overdraft- i në kredi standarde.

Për të garantuar kredinë janë vendosur në favor të Union Bank sh.a. dy pasuri në pronësi të vetë shtetasit Fatmir Bektashi e konkretisht trualli me nr pasurie 7/23 dhe arë me nr 7/24, ZK 2679 ndodhur në adresën Mëzez Tiranë. Gjithashtu vendosen garanci edhe pasuri të tjera të shtetasit Fatmir Bektashi si "Truall + ndërtesë" me Nr. Pasurie 111/188, ZK 2291, i ndodhur ne Kryemedhenj, Kavajë; Vendosen tre pasuri të, të llojit njësi, të shoqërisë Kontakt sh.p.k. të ndodhura në ZK 8270, Rruga: "Deshmoret e 4 Shkurtit".

Per te garantuar permbushjen e kushteve dhe afateve te kesaj kontrate dhe pagesave te Kredise, Hipotekuesit Aneta Bektashi dhe Ilirjan Bejko vendosin garanci në favor të Bankës në formën e hipotekës mbi pasurine: "Truall" me Nr. Pas 1/756, ZK 8270, ne Rrugen: "Emin Duraku", Tiranë, në pronësi të këtyre shtetasve.

Dorezanesi Z. Fatmir Petrit Bektashi garanton pa rezerva Banken/Kredidhënëse se do te pergjigjet me te gjithë te ardhurat e tij, pasurine e tij, per permbushjen e detyrimeve totale qe rrjedhin nga kjo Kontrate-Kredie, ne rast se Kredimarrësit nuk i permbushin detyrimet e tyre.

Per te garantuar permbushjen e kushteve dhe afateve te kesaj kontrate dhe pagesave te Kredise, Hipotekuesi Homeplan sh.p.k. vendosin garanci në favor të Bankës në formën e hipotekës mbi 6 pasuri në pronësi të shoqërisë Homeplan të ndodhura në ZK 8220, në rrugën Frosina Plaku.

328. Edhe për vitin 2013, shtetasi Fatmir Bektashi, si ortak i vetëm, me vendimin e datës 25.06.2014, vendos kalimin prej 296 045 114 lekë, i gjithë fitimi, për investime.

329. Në këtë vit konstatohet në fakt se është shlyer një pjesë e pagesës që ka bërë shtetasi Gjon Gjonaj për llogari të privatizimit. Nga llogaria bankare pranë Societe Generale Albania me nr ...939216 në euro e shoqërisë Homeplan, rezulton se më datë 28.02.2013 evidentohet veprimi Transfertë në nisje Ref: TRF 13001656 në favor të Gjon Jakë Gjonaj rikthim i pages së kryer për privatizim e klubit Sh.Sportesh Partizani 20% ngurtësim fondi nga familja, Begeja, Llagami, Saliaga dt. 10.07.08 Emporiki në vlerën 50 0000 dhe në vijim shfaqet - Datë 06.03.2013 pagesë komisioni OUR Ref COM 13000112 kom OUR TRF 11099TRF13001656 euro 50 000 F/O Gjon Jakë Gjonaj – 75 euro.

330. Viti 2013 i cili ka qenë vit zgjedhësh, ku mesa konstatohet në këtë fushatë zgjedhësh është angazhuar edhe shoqëria Homeplan e cila ka pasur shpenzime të shumta në drejtim të

shoqërisë Connex sh.p.k. (pasqyruar si shpenzim për marketing) dhe të pritjes së shtetasit Ricardo Cocciantë.

Sa më lart evidentohet edhe në dokumentat e sekuestruara pranë studio Pustina, konkretisht dy dokumenta të datës 18.01.2014 përshkrimin “*Homeplan shpk 2013 – Analizë*”, ku paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën lekë, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2013 - 30.12.2013, në të cilat evidentohet **Mandat Pagese me nr.25, datë 05.06.2013, në vlerën 45,000 lekë, me përshkrimin “Ber Begeja, pagesë punonjës për FRPD”**. Kjo vlerë dhe datë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 23.04.2023, tek Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash për Homeplan. Konkretisht: **datë 05.06.2013 / 321 euro / pagesë punonjës për FRPD**.

331. I pyetur më datë 17.05.2024, për pagesën e sipërcituar, dokumentuar për punonjës të FRPD, shtetasi *Ber Begeja* pretendon se në vitin 2013 ka qenë Kryetar Seksioni pranë Partisë Demokratike. Nuk ka bërë ndonjë pagesë për FRPD dhe as për partinë demokratike por si pjesë e kryesisë bënin një pagesë prej 10 000 lekësh në vit, që e bënin të gjithë anëtarët e kryesisë.

332. Në muajin qershor 2014, është mbajtur akt kolaudimi për objektin **Eagle 4 – 13 kat banim dhe shërbime me 1 kat parkim nëntokë**, strukturë e kompleksit Magnet. Në lidhje me truallin në të cilën është ndërtuar struktura Eagle, pasqyrohet se ndodhet në pasuritë: *Pasuria nr 2/325 ZK 8220 me sip 380 m2; Pasuria nr 3/164 ZK 8220 me sip 210 m2; Pasuria nr 3/162 ZK 8220 me sip 190 m2; Pasuria nr 3/138 ZK 8220 me sip 3120 m2 (kontrata e lidhur me familjen Begeja)*. Kontrata e sipërmarrjes e nënshkruar është ajo me nr 971 rep nr 546/2 kol datë 22.05.2013. Supervizor Besnik Derishi, drejtues teknik Liljana Vllamasi, kolaudator Ermijona Vongli (Mehilli).

333. Në lidhje me gjithçka që ndodh në fazën e zhvillimit të punimeve, shtetasi Fatmir Bektashi, informon studion e shtetases Andia Pustina. Kështu nga dokumentat e gjendura në studio Pustina, konstatojmë një dokument që fillon: “*Përshendetje Odeta, Lidhur me saldon e furnitorëve gjëj komentet e mëposhtme:...*” Vijojnë me nr rendor nga 1 – 28 përshkrime të ndryshme ku evidentojmë:...1. **Supervizion Profesional është likujduar cash, nuk ka kupon tatimor (me shkronja dore shënuar: do mbetet e hapur)**

...9. *Sheraton Tirana është e paguar.*

...15. *Belle Air e papaguar. Detyrim për 2014*

...20. *Gkam është është shuma e kaluar në garanci bankare në Credins Bank*

...27. *Begeja 1900 HTP është e papaguar. Detyrim për 2014*

28. *Homeplan Administrim e papaguar. Detyrim për 2014.*

333.1 Me një dokument datë 03.10.2014 drejtuar nga Homeplan, studio Pustinës me lëndë “*Lista e faturave dhe dokumentave drejtuar zyrës Pustina. Poshtë shënuar janë lista e dokumentave që do i dërgohen zyrës kontabël:...*” përshkruhen të dhëna mbi fatura tatimore statement etj. Dokumenti është nënshkruar për Andia Pustinën nga Odeta Fisha. Evidentohet ndër të tjera: ...5. *Faturë tatimore nr. 272 datë 15.09.2014 Begeja 1900...Faturë tatimore nr 05 datë 09.09.2014 Supervizion Profesional*

333.2 Me një dokument datë 04.12.2014 drejtuar nga Homeplan studio Pustinës me lëndë “*Lista e faturave dhe dokumentave drejtuar zyrës Pustina. Poshtë shënuar janë lista e dokumentave që do i dërgohen zyrës kontabël:...*” përshkruhen të dhëna mbi fatura tatimore statement etj. Dokumenti është nënshkruar nga Fatmir Bektashi dhe për Andia Pustinën nga Odeta Fisha.

Evidentohet ndër të tjera:.....5. *Faturë tatimore nr. 336 datë 17.11.2014 Begeja 1900*

333.3 Me një dokument të gjendur në studio Pustina me emërtimin “*Homeplan 201 Analizë*” datë 17.10.2014 a01-a01z dt 01.01.2014 – 30.09.2014” evidentohet ndër të tjera: ...*MA 26 datë 30.05.2014 Kontakt kthim shume 120 000 lekë dhe në vijim MP 29 datë 30.05.2014 Ber Begeja kontribut patriotik 120 000 lekë. ...MP 39 datë 22.07.2014 Fatmir Bektashi kontribut patriotik 500 000 lekë.*

333.4 Në një dokument me nr 3871 prot datë 24.11.2014 (data ka qenë 13 por është bërë 24) drejtuar Andia Pustinës nga shtetasi Fatmir Bektashi me lëndë “*A. Rakordimi financiar midis Homeplan sh.p.k. porosites dhe Kontakt sh.p.k. sipërmarrës prej fillimit të vitit 2010 deri 31.10.2014*

B. Informacion për kreditë HP dhe kolaterale Kontakt të ngurtësuar në bankë për to...”

Në vijim të kësaj fletë rakordimi evidentohet ndër të tjera:....4. *Ap Uz. EF (Kontakt) Viti 2014 – 137 000 euro. ...Duke filluar nga maj 2013 Kontakt krediton Homeplan për punimet dhe taksën e objektit HP. ...”*

334. Sërish në këtë periudhë duket se kanë vijuar konfliktet me subjekte të ndryshëm gjatë fazës së zbatimit të ndërtimit. Kështu me shkresën nr 3851 prot dt 11.11.2014 shoq Kontakt sh.p.k. i është drejtuar ALUIZNI-t dhe për dijeni INUK, Komisaritat nr 2 të policisë së shtetit duke kërkuar përjashtimin nga procesi i legalizimit të ndërtimit pa leje të ndërtuar mbi pronat e familjes Vaqari nga shtetasi Gjergji Hasanaj dhe prishjen e tij.

334.1. Gjithashtu evidentohet edhe një ankesë e nënshkruar nga 26 persona që në emër të shoqatës së zonjës Mari me shkresën nr. 4965 prot dt 05.07.2014, i janë drejtuar INUK Tiranë dhe për dijeni Kryeministrit shtetasit Edi Rama si dhe kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Lulzim Basha, në të cilën kanë parashtruar shqetësimin e tyre për ndërtimet që kryen subjekti Kontakt sh.p.k. për kompleksin Magnet, duke pretenduar se nuk po zbaton kushtet dhe standartet urbanistike.

Me shkresën nr 5744 prot dt 12.11.2014 INUK, i është drejtuar Kryeinspektorit, drejtorisë së shërbimeve mbështetëse, sektorit të arkivë protokollit, duke parashtruar se:....Drejtoria e Inspektimit, konstatoi se gjatë kontrollit të ushtruar më dt 03.11.2014 në adresën Rruga Frosina Plaku, nga grupi i inspektorëve është konstatuar se **subjekti juridik Kontakt sh.p.k. ishte duke punuar në mangësi e kontrollit nga drejtoria e kontrollit të zhvillimit të territorit Bashkia Tiranë, ndryshimin në fasadën jugore.** Për këtë arsye ka proceduar me proces verbalin e konstatimit me nr 07 datë 03.11.2014 me nr serie 0000697. Në proces verbal është shënuar se për aktet e kontrollit është bërë kërkesa pranë Bashkisë Tiranë. Për këtë arsye duhet pritur më parë veprimi dhe dokumentacioni nga Bashkia Tiranë. Përsa më sipër, praktika nr 5744 prot datë 04.11.2014 duhet të kalojë për arkivim sektorit të arkiv protokollit. Konkretisht shkeljet sipas kontrollit janë: Mungojnë kontrollet nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të territorit Bashkia Tiranë, ndryshim në fasadën jugore (Për katin në kuotën +0, 000 dhe + 4.0)....konsiderohet në hapjen e dritareve dhe vetratave.

334.2 Në dokumentin e datës 19.11.2015, me përshkrimin “*HOMEPLAN 2015 – Arka - Analizë*”, të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën euro, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2015 – 30.11.2015, ku ndër të tjera konstatohen MP 28, datë 10.03.15, në vlerën 10,000 euro, me përshkrimin “*Fatmir Bektashi, kontribut patriotik Inuk rr Artan Lenja.*”. Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 28.04.2023, pranë Studio Pustina me emërtimin *Pagesa Cash per HOMEPLAN.*

Konkretisht: Në datë 10.03.2015, vlera 10,000 euro, me përshkrimin “ *Fatmir Bektashi kontribut patriotik INUK Rr Artan Lenja*”

335. Me nr 13929/4 prot datë 22.12.2014 të Bashkisë Tiranë, me kryetar Lulzim Basha, rezulton të jetë dhënë Çertifikatë përdorimi si më poshtë: **Leje Zhvillimore ndërtimi nr prot 8427/10 datë 18.10.2013 për strukturën Eagle 4 – 13 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë**, pjesë e kompleksit Magnet, në pronë të familjeve *Begeja, Kaçurri, Kadiu, Bektashi, S.Velo, M.Kallajxhi, Malltezi, N.Hoxha, E.Grabova, L.Lika, M.Aga, T.Malka, A.Sulstarova, L.Çela, S.Kurti, Bektashi, Vaqari, Arapi, Alimehmeti, Mulliçi*, në rrugën Ndre Mjeda, ndërtuar nga Kontakt.....Lëshohet çertifikata e përdorimit për objektin e ndërtuar nga subjekti ndërtues Kontakt dhe zhvillues Kontakt dhe Homeplan...

336. Më datë 25.06.2015, ortaku i vetëm i shoqërisë Homeplan sh.p.k., shtetasi Fatmir Bektashi, vendos miratimin e rezultatit ekonomik për vitin 2014, me fitim 1 308 500 lekë dhe kalimin 100 % në rezerva të tjera.

337. Përgjatë vitit 2015, vijojnë të konstatohen pagesat e identifikuara si “*Kontribute patriotike*”.

Në dokumentin me emërtimin “*Homeplan sh.p.k. 2015 Arka – Analizë*” A01-A01Z dt 01.01.2015 – 30.11.2015, dok MP, të sekuestruar pranë studio Pustina, evidentohet ndërmjet të tjerave: Datë 14.03.2015 Fatmir Bektashi kontribut patriotik – MP 35 datë 14.03.2015 – pagesë 40 000 lekë; Datë 14.05.2015 Fatmir Bektashi kontribut patriotik EF – MP 68 datë 14.05.2015 – pagesë 1 160 362.50 lekë; Datë 05.06.2015 Fatmir Bektashi kontribut patriotik Arkiva BTR – MP 85 datë 05.06.2015 – pagesë 5 000 lekë.

Në dokumentin me emërtimin “*Homeplan sh.p.k. 2015 Arka – Analizë*” A02-A02Z dt 01.01.2015 – 30.11.2015, dok MP, të sekuestruar pranë studio Pustina, evidentohet ndërmjet të tjerave:

- Dt 28.04.2015 *Fatmir Bektashi kontribut patriotik INUK*– MP 51 dt 28.04.2015 – pagesë 2 000 euro ose 280 280 lekë. Në dokumentin dt 19.11.2015, përshkrimi “*HOMEPLAN 2015 – Arka -Analizë*”, të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën euro, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2015
- Dt 22.05.2015 *Fatmir Bektashi kontribut patriotik*– MP 69 dt 22.05.2015 – pagesë 25 000 euro ose 3 500 000 lekë. Në dokumentin dt 19.11.2015, përshkrimi “*HOMEPLAN 2015 – Arka -Analizë*”, të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën euro, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2015 – 30.11.2015, ku ndër të tjera konstatohen MA 69 datë 22.05.15, në vlerën 25,000 euro, me përshkrimin “*Kontakt Kalim Fondi*” dhe MP 69, datë 22.05.15, në vlerën 25,000 euro, me përshkrimin “*Fatmir Bektashi, kontribut patriotik*”. Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV dt. 28.04.2023, pranë Studio Pustina emërtimi Pagesa Cash per HOMEPLAN. Konkretisht: Dt 22.05.2015, vlera 25,000 euro, përshkrimi “*Fatmir Bektashi leje përdorimi Orion*”
- Dt 30.11.2015, ku ndër të tjera konstatohen MA 52, dt 28.04.15, vlera 2,000 euro, përshkrimi *Kontakt kthim fondi* dhe MP 51, dt 28.04.15, vlera 2,000 euro, përshkrimi *Fatmir Bektashi, kontribut patriotik INUK*. Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV dt 28.04.2023, pranë Studio Pustina emërtimi Pagesa Cash per HOMEPLAN”: Në dt 28.04.2015, vlera 2,000 euro, përshkrimi *Kontribut patriotik INUK*
- Dt 19.11.2015 *Kontakt sh.p.k. kalim fondi për KP; JM*; MP 266 dt. 19.11.2015, faturë nr 173 dt 19.11.2015 – arkëtuar 20 000 euro ose 2 753 400 lekë e në vijim: dt 19.11.2015 *JM KP nga FB faturë 161 dt 19.11.2015 shuma 20 000 euro ose 2 753 400 lekë*.

Në dokumentin e datës 19.11.2015, me përshkrimin "*HOMEPLAN 2015 – Arka -Analizë*", të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën **euro**, në arkën e shoqërisë, për periudhën 01.01.2015 – 30.11.2015, ku ndër të tjera konstatohen:

- MA 92, dt 06.06.15, vlera 30,000 euro, me përshkrimin "Kontakt kthim shume" dhe MP 89, dt 06.06.15, vlera 30,000 euro, përshkrimin "*Fatmir Bektashi, kontribut patriotik ORION*". Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV e datës 28.04.2023, pranë Studio Pustina me emërtimin Pagesa Cash per HOMEPLAN". Konkretisht: Në datë 06.06.2015, vlera 30,000 euro, me përshkrimin "Fatmir Bektashi leje përdorimi Orion"
- MA, 107, dt 11.07.15, në vlerën 17,500 euro, përshkrimi "Kontakt shpk MP 163 dt 06/07/2015 dhe MP 104, dt 11.07.15, në vlerën 17,500 euro, përshkrimi "*Fatmir Bektashi, 1. 15000 EURO KP Orion & 2. 2500 Gjyqi Kuka*". Kjo vlerë reflektohet edhe në tabelën e sekuestruar me PV dt 28.04.2023, pranë Studio Pustina emërtimi Pagesa Cash per HOMEPLAN: DT 11.07.2015 vlera 15,000 euro me përshkrimin "*fatmir Bektashi KP leje perdorimi Orion dhe në vlera 2500 euro me përshkrimin Kontribut patriotik gjyqi kuka*"

337.1. Mesa konstatohet nga aktet e administruara përgjatë hetimit, rezulton se shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja kanë përfutuar pagesa cash apo dhënë në forma të tjera, nga fitimet e shoqërisë Homeplan sh.p.k. si pagesa për konsulenca mjedisore për shtetasin Jamarbër Malltezi dhe pagesa për subjektet Begeja 1900HTP dhe Begeja 1900 për shtetasin Xhimi Begeja.

Në një bllok të kuq të sekuestruar pranë studio Pustina, ku duket se prej shtetases Andia Pustina janë mbajtur shënime të ndryshme evidentohet për vitin 2015 ky shënim: "*Konsulenca e Abi për pjesën e div (tetor – nëntor – dhjetor)*. ...A----(e palexueshme) si pronar trualli. 1. *Vendim i korrigjuar..* 2. *Kontratë Abi konsulence 01/01*".

Shënim tjetër në të njëjtin bllok: "*ABC 1, Ilir Shtufi 3, Ervis sh.p.k. 1, HTT 1, Alfafab 2, Elida I*" Të gjitha të përmbledhura me emrin **Abi dhe PCP**. Gjithashtu shënim tjetër: "*+15 000 eur tërhequr nga arka për Xhimin. Fotokopje nga Suzana*"

Shënim tjetër: "*faturë konsulence 20 – 30 + tat burim + 700 F.B. Pagesë tatim fitimi Homeplan. Nëntor – dhjetor. Në bilancin e 2015 të deklarohet objekti Eagle + Orion. Shpenzimet (kartat e arkitekturës) Investitori apo ndërtuesi*"

332. Deri në fund të vitit 2015, shoqëria Homeplan sh.p.k. **ka pasur fitime të pashpërndara, të deklaruar, të kaluara në rezerva në shumën totale prej 455,032,383 lekësh.**

Më datë 30.06.2016 ortaku i vetëm vendos miratimin e rezultatit ekonomik për vitin 2015, me fitim 174 319 583 lekë dhe shpërndarjen në këtë mënyrë: **Shuma prej 82 800 000 lekë ose ekuivalenti në euro 600 000 euro si dividend për ortakun e vetëm pas pagesës së tatimit mbi dividendin dhe kalimin e shumës prej 91 319 583 lekë në rezerva të tjera.** Gjithashtu në këtë vendim është përcaktuar edhe emërimi i shtetases Shpresa Breçani si auditor kontabël e shoqërisë Homeplan sh.p.k. për vitin fiskal 2016.

338. Me vendimin nr. 25907/2 datë **29.08.2016** "Për ndryshim të vendimit nr. 5513/6 datë 14.04.2014 për " Miratim të fazës II të planit të detajuar vendor të nënjesisë nr. 7/25 zona A1" nënshkruar nga kryetari i Bashkisë Erion Veliqaj është vendosur:

1. Miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 5513/6 datë 14.04.2014 të Kryetarit të Bashkisë për "Miratimin e fazës II të planit të detajuar vendor të nënjesisë strukturore 7/25, zona A1" sipas hartës dhe dokumentacionit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi
2. Ngarkohet drejtorja e përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbarhden e dokumentacionit përfundimtar dhe hartës
3. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në Regjistrin e integruar të Territorit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

339. Më datë 15.05.2017 ortaku i vetëm vendos miratimin e rezultatit ekonomik për vitin 2016, me fitim 17 998 258 lekë dhe ndarjen si vijon: Shuma prej 17 998 258 lekë kalon në rezerva të tjera. Miratimin e shpërndarjes së fitimeve të akumuluarra deri më datë 31.12.2016: Shpërndarjen e shumës prej 450 000 000 lekë sipas marrëveshjes së investimit nr. 3000 rep/nr. 1783 kol datë 02.10.2008. Kjo shpërndarje do të bëhet brenda një periudhe prej 5 vitesh me këste sipas gjendjes së likuiditetit që do të ketë shoqëria.

Në një bllok me ngjyrë të zezë të sekuestruar pranë studio Pustina janë gjendur shënime që i përkasin datës 10.05.2017 si vijon: " Llogaria e Homeplanit. 31.12.2016.

- 1) marrja e dividendit nëpërmjet apartamenteve tek ARA (Xhimi proposal) të mos nxirren në shitje
 - 2) likuidimi i vlerës së mbetur të Xhimit nga dividendi i fundit i ndarë 200 000 euro marrë 170 000 euro kanë mbetur edhe 30 000 euro
 - 3) Ap i mbesës (e dyta) apartamenti me verandë të madhe që nuk shitet
- Të miratohet pasi duhen për ____ (...). "

339.1. Mesa konstatohet nga aktet, ka pasur diskutime në lidhje me miratimin e shpërndarjes së dividendit si më sipër. Për këtë arsye, më datë 27.06.2017 ortaku i vetëm i shoqërisë Homeplan sh.p.k. Fatmir Bektashi, **vendos të ndryshojë vendimin** e datës 15.05.2017, duke miratuar shpërndarjen e fitimeve të akumuluarra deri më 31.12.2016, ku shuma prej 200 000 000 lekë sipas marrëveshjes së investimit rep 3000/kol 1783 datë 02.10.2008 dhe shtojcave e ndryshimeve të saj. Kjo shpërndarje do të bëhet brenda një periudhë prej 5 vitesh me këste sipas gjendjes së likuiditetit që do të ketë shoqëria.

Subjekti Homeplan ka shpërndarë Divident në vitin 2017 në vlerën 200,000,000 lekë, sipas deklaratave tatimore.

Shtetasi **Fatmir Petrit Bektashi** me ID ADENO00047E, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), për vitin 2017, 17-A, në rubrikën 5 ka deklaruar: *Të ardhura bruto nga Dividenti deklararon vlerën 200,000,000 lekë* e cila përputhet me vendimin e ortakut të datës 27.06.2017.

Por nga ana tjetër edhe shtetasi **Jamarbër Luan Malltezi** me ID H21109073R, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), për vitin 2017, 17-A, në rubrikën 5 deklaroi: *Të ardhura bruto nga Dividenti deklararon vlerën 150,000,000 lekë.*

Kurse shtetasi **Xhimi Haki Begeja** me ID G50401203S, nuk ka bërë deklaratë (DIVA) për vitin 2017.

Pavarsisht se në vendimin e ortakut të datës 27.06.2017 është vendosur se shuma 200 000 000 lekë, do të shpërndahet sipas marrëveshjes së investimit rep 3000/kol 1783 datë 02.10.2008 dhe shtojcave e ndryshimeve të saj, siç mund të vërehet e gjithë shuma prej 200,000,000 lekësh është deklaruar si Divident i marrë nga shtetasi Fatmir Bektashi duke paguar edhe Tatimin mbi dividendin në vlerën 30,000,000 lekë (DIVA 17- A; Rubrika 23) dhe duke ardhur në kundërshtim me deklaratën DIVA të shtetasit Jamarbër Malltezi.

339.2 Me një shkresë datë 21.12.2017 të gjendur pranë studio Pustina, të nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi, me emërtimin "Raport për ndarjen e fitimit" me logon e Homeplanit drejtuar shtetases Andia Pustina, pasqyrohet: *...Gjeni bashkalidhur raportin për pagesat e kryera dhe takuese për ortakët Homeplan, për fitimin e realizuar në vite, sipas pjesëve takuese në marrëveshjen e përbashkët. Sqaroj se:*

1. *Për secilin ortak, që janë kryer pagesa, keni tabelat bashkalidhur. Në pagesa janë përfshirë përveç dividendit të ndarë në vitin 2016 dhe 2017 edhe të gjitha tërheqjet e realizuara prej tyre, nga viti 2010 e deri në datë 10.12.2017, me cash, me faturë si dhe me njësi mbi pjesën takuese (mbi 25%) sipas kontratës së sipërmarrjes nga HP me pronarët e truallit.*
2. *Shuma e mësipërme për ortakët me 25% dhe 35% është marrë si bazë e llogaritjes së pjesës takuese për pagesë për ortakun me 40 %. Pagesa e llogaritur për pagesë, do të fillojë të bëhet në vitin 2018, pas hartimit të vendimit për përdorimin e fitimit të vitit 2017.*
3. *Komentet tuaj ju lutem përsa më lart".*

339.3 Në një bllok shënimesh të shtetases Odeta Fishta me ngjyrë blu me shënimin në kapak "The Classical...Retro Style 1889..." konstatohen shënime që duket se janë kryer para muajit korrik 2018 por i referohen vitit 2017, si vijon:

*"JM. 1. 957 107 euro – 127 503 368.78 ALL neto
Bruto 150 003 963 lekë TR dividendi
45 000 E – Intesa – 22 500 datë 27.01.17 ... 159 Intesa Fat 12/16 dhe 22 500 – 23.2. 17... 191
Intesa Fat 12/2016
40 000 E është 45 000 në kartela
RZB Euro pagesë fature – 83 dt. 20.02.17 dhe 84 dt. 24.02.17."*

339.4 Nga akti i ekspertimit telefonik të shtetases Andia Pustina janë evidentuar emaile ku ndër të tjera konstaohen komunikimet që janë bërë në lidhje me pagesat e shtetasit Xhimi Begeja.

Email Nr.338; Datë 31.08.2018 ora 11:00:55 nga andiapustina@gmail.com për xhimibegeja@yahoo.com; suzana.aliaj@kontakt.al; fatmir.bektashi@kontakt.al dhe abi.malltezi@gmail.com
Subject: Re: Pagese dividendi
Body:
<Pershendetje Suzana te konfirmoj se pagesa prej Eur 350K eshte e perfshire ne fitimin e vitit 2017. Ndaj mund ta levroni pa asnje hezitim .
Gjithe te mirat
Andia Pustina
BS Business Administration

Email Nr. 339 Datë 31.08.2018 ora 09:26:53 nga xhimibegeja@yahoo.com për suzana.aliaj@kontakt.al andiapustina@gmail.com; fatmir.bektashi@kontakt.al dhe abi.malltezi@gmail.com

Subject: RE: Pagese dividenti

Body:

Pershendetje!

Se kuptoj gjithë keto paqartesi. Besoj se jam treguar i qarte me Andian por dhe me ju ...

1. Me duhen neto 350 k

2. Per sa i perket dyqaneve e kam sqaruar Andian qe do me zbriten ne Vitin 2018 meqe ne dorezim si edhe kontratat po i lidh ne 2018.

Une kërkoj qysh sot te fillojm me kalimin .

Kam dy muaj qe zvarritemi me ke ceshtje.

Me respekt Xhimi

Sent from Yahoo Mail on Android

Më datë **30.06.2018** ortaku miraton rezultatin ekonomik për vitin 2017, me fitim në shumën 121 398 676 lekë dhe e kalon në rezerva të tjera. Gjithashtu miraton shpërndarjen e fitimeve të akumuluarra deri më datë 31.12.2017. Shuma prej 204 954 000 lekë e barazvlefshme në vlerën bruto prej 1 403 000 euro sipas marrëveshjes së investimit rep 3000 kol 1783 datë **02.10.2008** dhe shtojca e ndryshimeve të saj. Kjo shpërndarje do të bëhet me këste sipas gjendjes së likuiditetit që do të ketë shoqëria.

Investime në prona të shtetasit Jamarbër Malltezi

340. Me kontratën e shitjes nr. 2951 rep, nr. 1145 kol dt **24.10.2016**, para noteres Laura Pustina, shtetasi **Adnan Llagami** i ka shitur shtetasit **Jamarbër Malltezi** pasuritë:

- **nr. 3/188**, vol, 19, fq. 235, zk. 8220, sip 2 280 m², përshkrimi “*Një sipërfaqe trualli në të cilën ndodhen terrenet sportive, të klubit të futbollit Partizani, me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku, me sipërfaqe 2 280 m²*” konkretisht shet pjesën takuese prej 240 m² në shumën **72 000 euro**
- **nr. 3/194**, vol, 21, fq. 236, zk. 8220, sip 760 m², me përshkrimin “*Truall me sipërfaqe 760 m² në të cilën ndodhen objektet ish - klubi Partizani, me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku*”, konkretisht në pjesën takuese prej 126 m² në shumën **37 800 euro**.

Shtetasi Adnan Llagami për të dy pasuritë shet pjesën e tij takuese, të pandarë nga bashkëpronarët e tjerë, respektivisht 240 m² dhe 126 m² për një shumë totale prej **109 800 euro**. Pagesa do të jepet në ditën e nënshkrimit të kontratës në një kësht të vetëm. Bashkalidhur praktikës është edhe mandati i Raiffeisen Bank ku pasqyrohet Jamarbër Malltezi që bën pagesën prej 109 800 euro për kontratën e shitjes nr. 2951/1145 datë 24.10.2016 në llogarinë e noteres Laura Pustina.

341. Kontratë shitje pasuri e paluajtshme, nr. 3463 Rep., nr. 1158 Kol datë **08.12.2017**, para notere Laura Pustina, shtetësja **Tire Deda (Luzi)** i shet shtetasit **Jamarbër Malltezi**, me pëlqimdhënës shoq Kontakt sh.p.k. pasurinë me nr. 3/215, zk. 8220, me sip trualli prej 3 294 m² dhe sip ndërtesë 1 467 m², rruga Frosina Plaku, Tiranë, me komente nga regjistruesi: *I vlefshëm vetëm për sip e truallit mbi këtë truall ndodhet objektet 3/173-ND, 3/174-ND, 3/175-ND, 3/176-ND, 3/177-ND, 3/178-ND, 3/180-ND, 3/181 – ND, ZK 8220*, konkretisht shet pjesën

e saj prej 114 m2 sipërfaqe trualli të cilën e shet për shumën monetare prej **74 762 Euro**. Kështu që Jamarbër Malltezi bëhet me 416/12000 pjesë.

Me formularin urdhër transferte të Union Bank rezulton se urdhërues Laura Pustina ka bërë pagesën prej **1 289 464.92 lekë** në Credins Bank për llogari të ZVRPP Tiranë.

Me urdhër pagese nga llogaria urdhëruese 11339896465012J është bërë nga Jamarbër Malltezi pagesa prej **74 762 euro** në llogarinë 113431929260125, më datë 18.12.2017

Shoqëritë e tjera tregtare me lidhje me shtetasin Jamarbër Malltezi

342. Pasur parasysh sa më sipër, sjellim në vëmendje krijimin e disa subjekteve tregtare nga ana e shtetasit Jamarbër Malltezi dhe miqve apo të afërmeve të tij.

342.1. Konkretisht shtetasi Gentian Hoxha, i cili rezulton të ketë qënë **punonjës i subjektit Homeplan (punëtor mirëmbajtjeje për ndërtesa)**, më pas në periudhën **13.01.2014 – 21.09.2015**, rezulton se ka qënë i punësuar edhe pranë Drejtorisë së Tatimeve si **“punonjës taksash”**.

342.1.1. Shtetasi **Gentian Hoxha** në vijim, në vitin 2013, themelon shoqërinë **Homeplan Administrim me Nipt L32426002P**, subjekt të cilin e ka themeluar më datë 23/12/2013 dhe ka autorizuar shtetasen Jola Haxhistasa për ta regjistruar në QKB, me seli në rrugën Frosina Plaku, kompleksi Homeplan, me objekt **administrim i ambjenteve të përbashkëta në pronësi të banorëve**. Kjo shoqëri regjistrohet më datë 26.12.2013.

Nga analizimi i Librave të blerjes të shoqërisë **Homeplan shpk** me NIPT K81803020E, në raport me blerjet nga shoqëria **Homeplan Administrim** me NIPT L32426002P, rezulton e deklaruar vetëm një faturë në datën **31.12.2013**, në vlerën **1,769,230 lekë**.

Aktivitetin kryesor kjo shoqëri e ka me shoqërinë Kontakt siç rezulton nga analizimi i Librave të blerjes të shoqërisë **Kontakt shpk** me NIPT J92108006V, në raport me blerjet nga shoqëria **Homeplan Administrim** me NIPT L32426002P rezultojnë përgjatë periudhën 2014 – 2021, në një vlerë totale prej **97 567 899 lekë**.

342.2. Ndërkohë, në periudhën 13.01.2014 – 21.09.2015, shtetasi Gentian Hoxha, rezulton se ka qënë i punësuar edhe pranë Drejtorisë së Tatimeve si **“punonjës taksash”**.

342.3. Nga analizimi i daljeve nga territori Shqiptar me automjetin me targë TR9929R, rezulton se shtetasi Gentian Hoxha ka udhëtuar në të njëjtin automjet me shtetasin Jamarbër Malltezi më 17.03.2016 dhe më datë 14.09.2017.

Në muajin tetor 2014 shoqëria Kontakt sh.p.k. deklaroi blerje nga shtetasi Gentian Hoxha nëpërmjet faturës të datës 31.10.2014 në shumën 1 078 674 lekë.

342.4. Në fund të dhjetorit 2015 ai regjistron **personin fizik Gentian Hoxha** të cilësuar edhe më sipër, **me NIPT L52222056M, me emër tregtar GE-DA**.

Edhe si person fizik, ky shtetas aktivitetin kryesor e ka me shoqërinë Kontakt sh.p.k. Për periudhën Dhjetor 2015 – deri në fund të janarit 2018 ka faturuar ndaj kësaj shoqërie në vlerën **128 985 694 lekë**.

Pa u mbushur tre muaj nga regjistrimi i këtij personi fizik dhe pas udhëtimit që rezulton si më sipër, ku shtetasi Gentian Hoxha ka udhëtuar me shtetasin Jamarbër Malltezi, evidentohet se Gentian Hoxha ka lidhur katër kontrata sipërmarrje me shoqërinë Kontakt sh.p.k. konkretisht

ato me nr 10844 prot, 10845 prot, 11537 prot, 11538 prot të datave 10.03.2016 dhe 09.04.2016 për FV laminat, punime gipsi, pllaka dhe bojatisje në objektin Lyra. Në kontratat e mësipërme, është rënë dakord midis palëve, neni 4 pika 3 që mënyra e bashkëpunimit dhe modaliteti i pagesës do të jetë **30 % e vlerës së situacionit të punimeve klering dhe 70 % me pagesë cash sipas situacioneve mujore të punimeve.**

Po në datë 09.04.2016, lidhet një marrëveshje kleringu me nr 11599 prot datë 09.04.2016, ndërmjet shoqërive Kontakt sh.p.k. në cilësinë e ndërtuesit, Homeplan sh.p.k. në cilësinë e investitorit dhe personit fizik Gentian Hoxha me NIPT L52222056 M në cilësinë e sipërmarrësit. Objekti i kësaj akt marrëveshje është regullimi i marrëdhënieve ndërmjet investitorit Homeplan, ndërtuesit Kontakt dhe sip Gentian Hoxha...Ndërtuesi Kontakt sh.p.k. dhe sip Gentian Hoxha kanë rënë dakord që ky i fundit të realizojë punimet e FV Laminat, FV pllaka, FV bojatisje, FV Gips në objektin Lyra, struktura DA ndodhur në rrugën Ndre Mjeda. Mënyra e pagesës për punimet në objektin Lyra do të realizohet si më poshtë: **30 % me klering me ap e ndodhura në strukturën EC – 4, 8, 9 kate banim dhe shërbime** të përcaktuara në poshtë në këtë ap marrëveshje dhe 70 % e punimeve do të likuidohet me pagesë sipas situacioneve të punimeve të miratuara nga palët. Investitori deklaron se është dakord të vendosë në dispozicion të sip Gentian Hoxha duke bllokuar në favor të tij pasuritë e përshkruara si më poshtë:

- Ap 1093 me sip të përgjithshme 83.83 m2 nga të cilat sip individuale 76.77 m2 sip e përbashkët 7.06 m2
- Ap nr 1094 me sip të përgj 92.85 m2 nga të cilat sip indivd 85.02 m2 sip e përbashkët 7.82 m2

Pasuritë e lartpërmendura ndodhen në strukturën EC (Auriga) – 4, 8, 9 kate banim dhe shërbime dhe një kat parkim nëntokë në rrugën Ndre Mjeda, Tiranë, sipas lejes së zhvillimit të ndërtimit nr 8427/10 datë 18.10.2013 të lëshuar në emër të Homeplan sh.p.k. dhe subjektit ndërtues Kontakt sh.p.k. Vlera totale e shit së ap nr 1093 me sip totale 83.83 m2 është 46 107 euro; Vlera totale e shit së ap nr 1094 me sip totale 92.85 m2 është 51 068 euro; Vlera totale e shit së ap nr 1093 dhe ap 1094 në strukturën EC (Auriga) do të jetë 97 175 euro.

343. Më datë 19.08.2017, nga shtetasi **Jamarbër Malltezi** si ortak me 60 % dhe shtetasi Ervin Kalemi si ortak me 40 %, themelohet shoqëria "**MAGNET GYM & FIT**" SHPK me Nipt L72022010B, me zyra kryesore të shoqërisë në adresë "**Njësia Bashkiake nr 7, Kompleksi Magnet, rruga Frosina Plaku, objekti Ara, kati 2**", Tiranë. Administrator është caktuar shtetasi Ervin Kalemi. Nga këqyrja e të dhënave nga ekstrakti historik i shoqërisë rezulton se ky subjekt tregtar ka deklaruar e-mail: ervintrainer@gmail.com abi.malltezi@gmail.com dhe Nr. Telefoni 0698902578. Shoqëria ka si objekt aktiviteti: "**Veprimtari në fushën e mirëmbajtjes fizike, estetike dhe shëndetësore ... Shit-blerjen me shumicë dhe pakicë të pajisjeve për palestër, spa, shërbime estetike dhe fizioterapeutike.**"

343.1 Në të njëjtën datë që është themeluar shoqëria, është lidhur një kontratë bashkëpunimi në investim (joint venture) me nr 2419 rep nr 804 kol datë 19.08.202017, para noteres Laura Pustina, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Ervin Kalemi me objekt përcaktimin e kushteve të bashkëpunimit të palëve lidhur me fillimin, pjesëmarrjen dhe ushtrimin e aktivitetit në fushën e mirëmbajtjes fizike, estetike dhe shëndetësore të trupit (palestër dhe qendër sportive). Jamarbër Malltezi 1 kuotë të barabartë me 60% të pjesmarrjes dhe Ervin Kalemi 1 kuotë të barabartë me 40 % të pjesmarrjes. Administrator do të jetë Ervin Kalemi. Për fillimin e aktivitetit të shoqërisë është i nevojshëm një investim fillestar prej **240 000 euro** i cili do përballohet si vijon: Jamarbër Malltezi 51 % dhe Ervin Kalemi 49%. Jamarbër Malltezi do të derdhë shumën që i takon për efekt të investimit fillestar menjëherë sipas nevojave të blerjeve

dhe pagesave që duhet të realizojë shoqëria. Për të derdhur pjesën e tij si investim fillestar Ervin Kalemi do të marrë hua nga Jamarbër Malltezi shumë prej 50 000 euro. Pjesmarrja e palëve në fitim do të jetë në raportet Jamarbër Malltezi 51 % dhe Ervin Kalemi 49% me përjashtim të periudhës deri në shlyerjen e plotë të huasë nga Ervin Kalemi tek Jamarbër Malltezi, ku pjesmarrje në fitim do të jetë Jamarbër Malltezi 60 % dhe Ervin Kalemi 40 %. Në nenin 2 pika 2.8 kanë përcaktuar se shuma e përbashkët e rrogave të Ervin dhe Ela Kalemit, do të jetë e barabartë me atë të qerasë që do të përfitohet nga Jamarbër Malltezi sipas kontratës përkatëse të qerasë.

Në nenin pika 5 është përcaktuar se deri në shlyerjen e plotë të shumës së marrë hua nga Jamarbër Malltezi, Ervin Kalemi nuk do të ketë të drejtë të transferojë kuotën e tij pa miratimin paraprak të ortakut. Kuotat e Ervin Kalemi do të barrësohen si garanci për shlyerjen e huasë përmes një marrëveshje siguruese që do të lidhet në të njëjtën kohë me lidhjen e kontratës së huasë.

343.2 Po në të njëjtën datë, ndërmjet Jamarbër Malltezi dhe Ervin Kalemi është lidhur një Kontratë Huaje me Nr. 2420 Kol., dhe Nr. 805 Rep. Datë 19.08.2017, përpara noterës Laura Pustina, sipas të cilës shtetasi Jamarbër Malltezi i jep shtetasit Ervin Kalemi hua në shumë monetare prej 50,000 euro, me qëllim investimin në shoqërinë Magnet Gym & Fit Shpk, shoqëri në krijim e sipër, pa interes apo ndonjë shpërblim. Menjëherë në momentin e shlyerjes së huamarrjes, kuotat e tyre do të ndryshojnë përkatësisht Jamarbër Malltezi 51% dhe Ervin Kalemi 49%.

343.3 Me kontratën e huasë nr. Kol. 2421, nr. Rep. 806 dt 19.08.2017 ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Ervin Kalemi (Huadhënës) dhe shoqërisë Magnet Gym & Fit shpk (Huamarrës) është rënë dakort që t' i japin një hua prej 240 000 euro kësaj shoqërie. Huaja në shumë 240 000 euro do të përballohet nga huadhënësi si vijon: Jamarbër Malltezi 51 % dhe Ervin Kalemi 49%.

Pasi janë lidhur kontratat e huasë te sipërcituara, Ervin Kalemi ka autorizuar shtetaset **Elda Guni dhe/ose Romina Hasanaj**, me anë të autorizimit të datës 06.12.2017, që në emër të shoqërisë të depozitojnë pranë Regjistrisë Tregtar, vërtetimin për barrësimin e 40% të pjesëmarrjes në shoqëri dhe të ndjekin praktikën deri në pasqyrimin e ndryshimeve të reja.

Mesa duket dy vitet e para, 2017 dhe 2018 shoqëria del me humbje.

343.4 Në një bllok me ngjyrë të zezë të sekuestruar pranë studio Pustina janë gjendur shënime që në faqen e datës 07 gusht 2017 përshkruhet:

"I) Magnet Gym 22 000 eur shtesë kontrate huaje

II) 250 K Xhimi i kalohen tek kontrata e tokës së pjesës së palestrës

III) Magnet – Pub, Piceri + Pasta

Kati III sallë konferencash

Zyra

Kati V+VI qeradhënie

Shoqatë

24) 10 28 800 me përfaqësi 30 000 = 900 000"

Në bllokun me ngjyrë të zezë të sekuestruar tek Studio Pustina me mbishkrimin "2018" konstatohen në faqen 9 shkurt 2018 evidentohet:

"Magnet Gym...Pagat netto 30 000 lekë...2 sanitare..1 recepsioniste..3 instrukturë...Vini + Ela – data e fillimit 01.05.2018 – 50 000...Kontrata e qerasë Abi 01.05.2018 – 100 000 lekë – 50 000

Kontratat e punës"...

Në faqen datë 10 shkurt 2018 gjenden shënimet: *"Pubi, American Bar (Magnet Bar), Kontratë bashkëpunimi Abi – Genti, 100% pronar Abi, Genti do marrë 25 % të fitimit, Investimi: 120 000 – 150 000 Euro, TV – 20 copë (60 – 65 milionë), Bankar, Guzhinë gatimi, Foni, Parkimi (Nipt) i ri + korrse . Investimi"*

Në faqen datë 22.02.2018 në formën e një tabelë gjenden të dhënat si vijon:

<i>Parking</i>	<i>Shpk</i>	
<i>+qera</i>	<i>Bar</i>	<i>Palestër</i>
<i>Nipt</i>	<i>Nipt</i>	<i>Nipt</i>

Vijojnë të dhëna në faqen datë 23 shkurt 2018 si vijon: IMMO:

- 1) Regj të hënën dt 12*
- 2) Kasë fiskale 15 + llog banka Suela*
- 3) 17 deklarimi i të ____ (e palexueshme) + foto karta + kontrata pune*
- 4) Kontrata për banakun – Pubi*

13 000 eur

TV greke 13 000 Eur

Kontratë huaje Abi – IMMO – deri në 150 000 euro

Xhimí"

Në faqen 5 janar 2018 në formë skemë është paraqitur:

Palestra – NIPT Kasa Lis...(e palexueshme)

Pub – Nipt

Park – Nipt + administrata

R-B

Rest

Kopsht

Këto shënime, në fakt duket se gjejnë pasqyrim edhe në dokumenta pasi me shtojcën e kontratës së huaje (për investim për start up të shoqërisë), nr. Rep. 293, nr. Kol. 143 datë **15.02.2018**, para noteres **Laura Pustina**, të lidhur ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet Gym & Fit shpk të cilët kanë nënshkruar kontratën e Huasë (Për investim për start – up të shoqërisë) nr. Rep. 2421/ Kol 806 datë 19.08.2017, kanë rënë dakort që është e nevojshme që shtetasi **Jamarbër Malltezi t'i japi një hua shtesë prej 25 000 euro, me qëllim për investimin për start up të shoqërisë Magnet Gym & Fit shpk.**

Gjithashtu lidhet një shtojcë 2 e kontratës së huaje (për investim për start up të shoqërisë), nr. Rep. 233, nr. Kol. 516 datë **20.03.2018**, notere Laura Pustina, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet Gym & Fit shpk (Huamarrës) të cilët kanë nënshkruar kontratën e Huasë (Për investim për start – up të shoqërisë) nr. Rep. 2421/ Kol 806 datë 19.08.2017, kanë rënë dakord që është e nevojshme që shtetasi **Jamarbër Malltezi t' i japi një hua shtesë prej 15 000 euro, me qëllim për investimin për start up të shoqërisë Magnet Gym & Fit shpk.**

Nga aktet e administruara është evidentuar edhe një shtojcë 3 e kontratës së huaje (për investim për start up të shoqërisë), nr. Rep. 255, nr. Kol. 558 datë 27.03.2018, notere Laura Pustina, ndërmjet shtetasve **Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet Gym & Fit shpk** (Huamarrës) të cilët kanë nënshkruar kontratën e Huasë (Për investim për start – up të shoqërisë) nr. Rep. 2421/ Kol 806 datë 19.08.2017 kanë rënë dakord që është e nevojshme që shtetasi Jamarbër Malltezi ti japi një hua shtesë prej **11 000 euro**, me qëllim për investimin për start up të shoqërisë Magnet Gym & Fit shpk.

344. Në një bllok me ngjyrë të zezë të sekuestruar pranë studio Pustina, me mbishkrimin “2018” evidentohen këto shënime:

Tek i njëjti bllok në faqen e datës 05 prill 2018, konstatohet:

H.P. Pronar truallit ARA ... (i palexueshëm).

Me përafërsi 9000 m² (≈ 9000 m²)

Abi me përafërsi 1000 m². (≈ 1000 m²)

Paraqitet një skemë e tokës ku evidentohen emrat e familjeve Saliaga dhe Llagami.

Hompelan të marrë 1000 m.

2100-3000 (2100 nuk dallohet qarte)

K.S. Shtesë kontrate me pronarët e truallit për Ara-n pjesa 8 katëshe

Pjesa e II katësh pub + gym të bëhet me blerje

HP – Abi do japë të gjithë tokën tek Saliag për HP në këmbim të 8 kat ARA

Xhim – kontratë këmbimi

(e palexueshme) Dividenti: (e palexueshme) për Sant Clear (jo e qartë)

Zhaneta (10 000 lekë)

Kjo shoqëri ka vijuar të dalë me humbje edhe në vitin 2019, 2020, 2021.

Nga analizimi i Librave të blerjes të shoqërisë **Kontakt shpk** me NIPT J92108006V, në raport me blerjet nga shoqëria **Magnet Gym & Fit** me NIPT L72022010B rezultojnë të deklaruara 3 fatura përgjatë periudhës 01.05.2018 deri më datë 30.04.2019, në një vlerë totale prej **2,349,480 lekë**.

344.1. Shoqëria “**MAGNET IMO**” SHPK me Nipt *L81714031D* është themeluar në datë **11.05.2018**, me zyra kryesore të shoqërisë në adresë “*Njesia Administrative nr. 7, Rruga Frosina Plaku, Kompleksi Magnet, objekti “Ara”, kati i dytë*”, Tiranë. Kjo shoqëri, është themeluar nga ortaku i vetëm me 100% të kuotave, shtetasi **Jamarbër Malltezi**, ndërsa administrator i shoqërisë është caktuar shtetasi **Vladimir Xheka**. Kapitali i themelimit është 100 lek. Nga këqyrja e të dhënave nga ekstrakti historik i shoqërisë rezulton se ky subjekt tregtar ka deklaruar e-mail: nfo.studiopustina@yahoo.com dhe Nr. Telefoni 0692136996. Shoqëria ka si objekt aktiviteti: *Veprimtari në fushën e pasurive me pasuritë e paluajtshme, ...Shitje – blerje të pasurive të paluajtshme; Dhënie me qira ...; Mirëmbajtje të gjitha veprimeve administrative/ligjore për administrimin e pasurive të paluajtshme të veta ose të personave të tretë. Pjesëmarrje në shoqëri tregtare; ...* Pasi është themeluar shoqëria, me anë të Prokurës së Posaçme me Nr. 1018 Rep dhe Nr. 441 Kol., datë 11.05.2018, e mbajtur para noteres Laura Pustina, shtetasi Vladimir Xheka (*i biri i Ushtarakut*)...u ka dhënë të drejtë dhe kompetencë të plotë shtetasve **Elda Guni, Romina Hasanaj dhe Jola Haxhistasa**, që të kryejnë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e saj në QKB. Në dt 14.05.2018, shtetasja Elda Guni, ka bërë regjistrimin e shoqërisë.

Në datë **20.08.2018**, është bërë ndryshim i objektit të veprimtarisë së shoqërisë, e më konkretisht është shtuar: *"...Shoqëri Administrimi për administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës së përbashkët në godinat e banimit, administrimi i bashkëpronësisë në ndërtesa."*

Në datë **03.12.2018** është bërë ndryshim i objektit të veprimtarisë së shoqërisë, e më konkretisht është shtuar: *"...Hapja, menaxhim dhe shfrytëzim të çdo lloji dhe madhësie bare, restorante, hoteleri turizëm, fast food, diskoteka dhe lojra argëtuese për fëmijë, etj të ngjashme; Import - eksport të produkteve ushqimor edhe të tjera, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë si më sipër. Organizim eventesh të ndryshme, ekspozita etj. Administrim ambjentesh për parkim."* Ky veprim është bërë nga shtetasja Elda Guni, e cila është pajisur me një Autorizim të datës 27.11.2018, nga shtetasi Vladimir Xheka.

Në këtë shoqëri konstatohet se që në vitin 2018 punësohet ndër të tjerë edhe shtetasi **Ber Begeja**, i cili më parë sipas vetëdeklarimit, deri në vitin 2013, ka qenë i punësuar pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë, si nënoficer. Shtetasi Ber Begeja konstatohet se ka marrë një apartament nga shoqëria Homeplan të cilin ai e deklaroi se e ka marrë pa kundërshtim meqenëse ka qenë banues në një nga godinat e kompleksit Partizani, ish klubi sportiv Partizani, pasi është kthyer nga internimi. Sipas tij apartamenti është diku tek 127 m² dhe është trajtuar si edhe 42 familje të tjera. Por nga aktet në të vërtetë rezultoi se në përlllogaritjen e dividendit të shtetasit Xhimi Begeja, apartamenti që është marrë nga shtetasi Ber Begeja i është përlllogaritur këtij të fundit (*shih dokumentin në excel nga ekspertimi i hard drive-it me titull "Xhimi Begeja marrje dividend" ku në faqen e parë "Sheet 1" në përlllogaritjet e dividendit të shtetasit Xhimi Begeja është pasqyruar në një tabelë të emërtuar "KALIMET PER NJESITE NGA XHB- HOMEPLAN" është pasqyruar "BER BEGEJA" në vitin 2016, me vlerësimin në shumën 26229 euro.*)

344.2 I pyetur më datë 20.02.2024, shtetasi **Vladimir Xheka** sqaron se, në shtet ka qenë i punësuar për periudhën 2011 – 2013 në pozicionin e specialistit të financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Postës Shqiptare. Në lidhje me shoqërinë Magnet Imo, deklaroi se i gjithë informacioni financiar për këtë shoqëri raportohet tek studio Pustina.

344.3 Gjithashtu edhe shtetasi **Fatmir Ymaj**, i cili deri më 31.05.2022 rezultonte i punësuar pranë shoqërisë Homeplan sh.p.k. nga data 01.06.2022 rezultoi i punësuar pranë shoqërisë Magnet Imo sh.p.k.

345. Në një bllok me ngjyrë të zezë, sekuestruar tek studio Pushtina me mbishkrimin "2018" konstatohet në faqen 14 prill 2018 shënimi në formë tabelore C.C. (*me shigjetë që tregon shenjën ardhur*) nga IMO 2 200 E – Me shigjetë që tregon ardhur nga ABI.
Në krah është shënimi 1 000 m².
"SDT...ka shënime në shifra ..."

Në fletën e datës 15.04.2018 është paraqitur një grafik që duket se pasqyron tokë dhe poshtë shënimet: "1) këmbim 2000 m²; 2) H 1000; 3) Blerje/DIV".

Në faqen 26 prill 2018 gjenden shënimet: "Magnet IMO
1) Apart –; 2) Parkimi – 3) Bar –"

Në faqen e datës 27 maj 2018 gjenden shënimet: "...200 000 euro Xhimi si dividend..."

Në faqen e datës 10.11.2018 gjenden shënimet si vijon:

“ABI QKR.....(e palexueshme) i QKR-së. Deklaratat e tatimeve DIVA – 2011. Raporti i kontrollit Pastrimit të Parave. Raporti i kontrollit tatimor 1+2. Alma Balilo...”

Në bllokun me ngjyrë të zezë të sekuestruar tek Studio Pustina me mbishkrimin “2018” konstatohen të dhëna në lidhje me shoqërinë Magnet Immo ku ndër të tjera shënohet “*Kontratë huaje Abi – Immo – deri 150 000 euro. Xhimi*”. Në vijim në faqen e datës 3 mars 2018 është bërë shënim “*Kontratë huaje (u firmos ... (... + Ladi). Hua e Xhimit.....etj.*”

345.1 Nga kontratat e administruara rezulton se, me Kontratën e Huapërdorimit me nr. Rep. 1045, nr. Kol. 456 datë 15.05.2018, para noteres Laura Pustina, lidhur **ndërmjet palëve Shoqëria “Homeplan” shpk (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet IMO shpk (Huamarrës)**, është bërë **kalimi në përdorim për periudhë 9-vjeçare pa asnjë pagesë i një pjesë të ambienteve, konkretisht truall që huadhënësi i ka në zhvillim sipas Lejes Zhvillimore të Ndërtimit Nr.8427/10 datë 18.10.2013**. Ambjenti objekt i kësaj kontrate do të përdoret nga huamarrësi si, **ambjent parkimi automjetesh** dhe çdo lloj aktiviteti që huamarrësi e shikon të arsyeshme. Me mbarimin e afatit të kontratës huamarrësi detyrohet të lirojë ambjentin nga të gjitha pajisjet e vendosura aty dhe t’i dorëzojë ambjentin huadhënësi me proces verbal.

Pra siç mund të shihet, shtetasi Jamarbër Malltezi, përveç përfitimeve që ka marrë deri më tani nga shoqëria Homeplan sh.p.k. duke investuar vetëm një shumë prej rreth 45 000 euro, i jepet edhe për një periudhë 9 vjeçare, pa asnjë pagesë ambienti që përdoret për parkim automjetesh.

345.2 Me kontratën e huasë, (për investim për start up të shoqërisë), nr. Rep. 1112, nr. Kol. 482 datë 22.05.2018, notere Laura Pustina, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet Imo shpk (Huamarrës) është rënë dakord që shtetasi Jamarbër Malltezi t’i japi një hua prej **150 000 euro**, me qëllim për investimin për start up të shoqërisë Magnet IMO shpk.

Në vijim, rezulton të jetë nënshkruar edhe një akt Shtojcë 1 e kontratës së huaje (për investim për start up të shoqërisë), nr. Kol. 2608, nr. Rep. 919 datë 26.10.2018, notere Laura Pustina, ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet IMO shpk (Huamarrës) të cilët kanë nënshkruar kontratën e Huasë (Për investim për start – up të shoqërisë) nr. Rep. 1112/ Kol 482 datë 22.05.2018 kanë rënë dakord që është e nevojshme që shtetasi Jamarbër Malltezi t’i japi një hua shtesë prej **25 000 euro**, me qëllim për investimin për start up të shoqërisë Magnet IMO shpk.

346. Me nr. Rep. 2919, nr. Kol. 972 datë 09.11.2018, para notere Laura Pustina, lidhet shtojcë 2 e kontratës së huasë (për investim për start up të shoqërisë), ndërmjet shtetasve Jamarbër Malltezi (Huadhënës) dhe Shoqëria Magnet Imo shpk (Huamarrës) përfaqësuar nga Vladimir Xheka. Në kontratë pasqyrohet se duke qenë se: Palët kanë lidhur midis tyre një kontratë huaje (për investim për start – up të shoqërisë) rep 1112/kol 482 datë 22.05.2018 (notere L.Pustina) dhe Shtojcën 1 të kontratës së huasë nr rep 2608/kol 919 datë 26.10.2018 (notere L.Pustina); Palët kanë konstatuar se është e nevojshme edhe një shumë shtesë për start – up të aktivitetit të shoqërisë. Ortaku Jamarbër Malltezi ka shfaqur disponibilitetin për të ceduar shumën e nevojshme për investim për start – up të shoqërisë.

Neni 1: Palët e kësaj shtojce 2 të kontratës kanë rënë dakord që ortaku i vetëm i shoq Magnet IMO sh.p.k. Jamarbër Malltezi t’i japë kësaj shoqërie një hua në shumën prej **10 000 euro** me qëllim investimin për start – up të shoqërisë Magnet - Imo sh.p.k.

Neni 2: Shoqëria do të jetë e detyruar t'i a kthejë huanë huadhënësit me kërkesën e parë të tij, me përjashtim të rasis kur ortakët me vendim unanim të tyre vendosin ndryshe..

Neni 3: ...Palët e kësaj shtojce 2 të kontratës kanë rënë dakord që shuma e huasë të përdoret për investim në shoqëri sipas planit të biznesit të miratuar paraprakisht nga ortaku i vetëm i saj dhe për këtë arsye ajo të derdhet drejtëpërdrejtë në llogarinë e shoqërisë...

Ndërkohë konstatohet se vijon investimi i shtetasit Jamarbër Malltezi, në shoqërinë Magnet Imo sh.p.k. Me shtojcë 3 të kontratës së huasë, me nr. 179 rep nr. 425 kol datë **20.02.2019**, para noteres Laura Pustina, shtetasi Jamarbarër Malltezi në cilësinë e huadhënësit dhe shoqëria Magnet IMO sh.p.k.përfaqësuar nga shtetasi Vladimir Xheka, në cilësinë e huamarrësit, bien dakort që ortaku i vetëm i shoqërisë Imo sh.p.k. t'i japë hua kësaj shoqërie shumë prej **30 000 euro** me qëllim investimin për start up të shoqërisë Magnet Imo sh.p.k., në referencë të kontratave të huase 1112/482 datë 22.05.2018, shtojca 2608/919 datë 26.10.2018 dhe shtojca 2 2919/972 datë 09.11.2018. Shoqëria do të jetë e detyruar t'i a kthejë huanë huadhënësit me kërkesën e parë të tij, me përjashtim të rasis kur ortakët me vendim unanim të tyre vendosin ndryshe.

N 3 Kushtet specifike: Palët e kësaj shtojce 3 të kontratës së huasë kanë rënë dakord që **kjo hua t'i jepet shoqërisë pa interes, kolateral apo ndonjë kusht tjetër**. Huaja në shumë prej 30 000 euro do të transferohet huadhënësi në llogarinë bankare të huamarrësit. Palët e kësaj shtojce 3 të kontratës kanë rënë dakord që shuma e huasë të përdoret për investim në shoqëri sipas planit të biznesit të miratuar paraprakisht nga ortaku i vetëm i saj dhe për këtë arsye ajo të derdhet drejtëpërdrejtë në llogarinë e shoqërisë...

Kjo shoqëri, nuk rezulton të ketë ndarë dividend, pasur parasysh aktivitetin e saj.

347. Nga analizimi i Librave të blerjes të shoqërisë **Homeplan shpk** me NIPT K81803020E, në raport me blerjet nga shoqëria **Magnet IMO** me NIPT L81714031D rezultojnë të deklaruara **fatura** përgjatë periudhën **2018- 2019**, në një vlerë totale prej **4,331,302 lekë**.

Ndër të tjera rezulton se shtetasi Jamarbër Malltezi ka faturuar Magnet IMO (*11 fatura*) në vlerë totale 8,418,395 lekë (*fatura mesatare 765,309 lekë*) në periudhën janar – dhjetor 2020 dhe në vlerën 6,007,142 lekë (*fatura mesatare 2,002,381 lekë*), në periudhën janar – dhjetor 2021.

347.1 Kjo shoqëri, konstatohet se në mënyrë periodike ka faturuar kompani të cilat në fokus kanë si objekt aktiviteti "*shërbim telefonik/call center*". Nga aktet e sekuestruara pranë Studio Pustina rezultojnë ndër të tjera të dhëna të llogarisë bankare pranë Union Bank me nr AL05 2141 1302 0113 4705 7502 0113 në lekë, ku veçohen ndër të tjera disa të dhëna si më poshtë vijon:

- përgjatë vitit 2021 shoq Volans sh.p.k. bën pagesa për shoqërinë Magnet Imo sh.p.k. në vlerën 411 036 lekë për qera në muajin janar 2021 (*shoq Volans sh.p.k. me NIPT L92223006J, rezulton e themeluar më datë 21.10.2019 me objekt konsulencë tregtare etj/call center. ...Kjo shoqëri ka kaluar në status pasiv më datë 21.01.2022 dhe aktualisht është e çregjistruar*).
- në muajin janar 2021, bën pagesë qeraje në vlerën 441 942 lekë shoq Avorio sh.p.k. (*shoq Avorio sh.p.k. me NIPT L92224010T, rezulton e themeluar më datë 21.10.2019 ... Më datë 27.01.2022 është pezulluar aktiviteti i kësaj shoqërie dhe aktualisht është e çregjistruar*).
- në muajin janar 2021 bën pagesa edhe shoq Bellister Call sh.p.k. në vlerën 275 054 lekë. (*shoq Bellister Call e themeluar më datë 11.07.2016 me objekt veprimtarie call center etj me NIPT L62002043O, rezulton të jetë themeluar nga shoqëria Dayrache Limited shoqëri e themeluar kjo e fundit dhe që vepron në bazë të ligjit të shtetit të*

Qipros. ...Më datë 19.10.2020 në QKB është pasqyryar ndryshimi i ortakut ku tashmë shfaqet shoqëria Perpitia Limited gjithashtu shoq qipriote).

- në muajin janar 2021, shoq Magnet Imo sh.p.k. i paguan shtetasit Jamarbër Malltezi qera mujore në vlerën 650 455 lekë.

Ndërkohë që shoq Homeplan sh.p.k. më dt 15.05.2018 me kontratën nr 1045 rep nr 456 kol i kishte dhënë shoqërisë Magnet IMO sh.p.k. një truall në përdorim për 9 vjet pa asnjë pagesë, tashmë shoqëria Magnet IMO sh.p.k. përfaqësuar nga Vladimir Xheka, me kontratën e qerasë datë **15.06.2019**, i jep me qera shoq Homeplan sh.p.k. një sip të përgjithshme prej **37.2 m2** zyrë, nga të cilat sip individuale 20.6 m2 dhe sip ballkoni 16.6 m2 ndodhur në rruga Frosina Plaku, kati 3, objekti ARA (Struktura EB) në Tiranë, me afat deri më datë 15.12.2019 kundrejt **500 euro** në muaj.

Me kontratën e qerasë datë **01.08.2019** shoq Magnet Imo sh.p.k. përfaqësuar nga Vladimir Xheka, i jep me qera shoq Homeplan sh.p.k. një sip të përgjithshme prej **47.4 m2** zyrë, nga të cilat sip individuale 31 m2 dhe sip e përbashkët 16.4 m2 ndodhur në rruga Frosina Plaku, kati 3, objekti ARA (Struktura EB) në Tiranë, me afat deri më datë 30.12.2019 kundrejt **500 euro** në muaj.

Vijimi i lidhjes së kontratave të sipërmarrjes për zhvillimin e ndërtimit

348. Përgjatë vitit 2018 lidhen kontrata të tjera sipërmarrje me shoqërinë e ndërtimit Kontakt sh.p.k., ku konstatohet se familjet heqin dorë nga përfitimi i pjesës takuese në pasurinë me nr 3/182 ZK nr. 8220 me sip 315 m2 me pretendimin se është blerë nga shoqëria sipërmarrëse. Konstatohet se në një nga këto kontrata përdoret termi "*blerë me para të thata*" që është term i përdorur në deklarinimin e tij nga shtetasi Jamarbër Malltezi. (shih deklaratën e pasurisë dorëzuar në ILDKPKI ku në pjesën konfidenciale ka deklaruar ... *Shpenzime familjare të tërhequra në para të thata nga llogaritë bankare – 10 298 euro dhe Shpenzime familjare të tërhequra në para të thata nga llogaritë bankare – 3 000 000 lekë*).

348.1. Me kontratën nr. 153 rep nr. 87/1 kol dt **30.01.2018** shtetasit *Tire Deda (Luzi), Shpëtim Luzi dhe Fatmir Luzi*, në cilësinë e palës pronare, kanë lidhur kontratë me shoqërinë e ndërtimit Kontakt sh.p.k., në cilësinë e palës sipërmarrëse, ku objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i një kompleksi shumëfunksional me parkime, depo, dyqane, dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare, vë në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë në bashkëpronësi në pjesë të pandarë, lloji truall, sipas vërtetimeve të pronësisë së lëshuara nga ZVRPP Tiranë:

- Pas nr regj hip 08 dt 10.01.2018, nr pas **3/215** ZK 8220 sip trualli S2 (St=3294 m2 Sn = 1467 m2), rruga Frosina Plaku. Në këtë pasuri është bërë komenti nga regjistruesi: "*Mbi këtë truall janë objektet 3/173/ND vol 17 faqa 242; Nr. 3/174/ND, vol 17 faqa 243, 3/175/ND vol 17 faqa 244, 3/176/ND vol 17 faqa 245, 3/177/ND vol 17 faqa 243/178, 3/180, 3/181/ND*" me inskriptim nr. 471 datë 18.03.2008. Ky vërtetim është i vlefshëm vetëm për sip trualli.
- Pas nr regj hip 916 dt 21.09.2013, nr pas **3/160** ZK 8220 sip trualli S1 (St=390 m2 Sn = 130 m2), rruga Frosina Plaku, me inskriptim nr. 471 datë 18.03.2008. Për këtë pasuri objekt zhvillimi do të jetë vetëm sip që ndodhet brenda ish Klubit Partizani.
- Pasuri nr regj hip 985 dt 06.12.2017, nr pas **3/112** ZK 8220 përshkrimi "*Një truall i lirë me sip 480 m2 i njihet e drejta e parablerjes, palestra e basketbollit, lavanteria Godina 1 kat, klubi dhe palestra, një pjesë e lokalit K.Partizani, magazina 1kat e klubit Partizani, pjesa e parkut dhe ofcina e 21 dhjetorit, dushet e Klubit Partizani si dhe ndërtesat që do të*

privatizohen". Komente nga regji: Mbi këtë truall pozicionohet ndërtesa 3/175 – ND, vol 17 faqa 244

- Pasuri e regj në regj hip nr. 986 dt 06.12.2017, nr 3/114 ZK 8220 përshkrimi "*Një truall i lirë me sip 1574 m2, i njihet e drejta e parablerjes, palestra e basketbollit, lavaneria Godina 1 kat, klubi dhe palestra, një pjesë e lokalit K.Partizani, magazina 1 kat e Klubit Partizani, pjesa e parkut dhe ofcina e 21 dhjetorit, dushet e Klubit Partizani si dhe ndërtesat që do të privatizohen*". Për këtë pasuri objekt zhvillimi do të jetë vetëm sip që ndodhet brenda ish Klubit Partizani.

Pala pronare deklaron gjithashtu se, nëpërmjet kësaj kontrate, jep pëlqimin për përfshirjen në zhvillim edhe të pasurisë me nr. 3/182 ZK 8220 me sip 315 m2 me përshkrimin "*Truall me sip 315 m2 në bashkëpronësi me familjen Llagami dhe Begeja*", me qëllim rritje të koeficientit të ndërtimit, duke deklaruar gjithashtu, se bie dakord që për këtë pasuri, **nuk do të ketë pretendime aktuale ose në të ardhmen për të përfitur në këmbim sip ndërtimore, pasi kjo pasuri pavarësisht se është e regjistruar në ZVRPP në emër të bashkëpronarëve Saliaga, Begeja dhe Llagami realisht nuk i përket palës pronare por është blerë nga pala sipërmarrëse.**

Palët bien dakord që zhvillimi do të realizohet vetëm për sip e truallit që ndodhet brenda ish Klubit Partizani. Gjithashtu jep pëlqimin për shkatërrimin e ndërtesave në bashkëpronësi në pjesë të pandarë ...citohen 11 pasuri.

Sipas n 3, pala pronare në përputhje me pjesën e saj takuese në truall, do të marrë nga pala sipërmarrëse, si kompensim për truallin me nr pas 3/215, 3/160, 3/114, 3/112, **25% të sip së ndërtuar mbi këto pasuri...Për pas me nr. 3/182 pala pronare heq dorë nga përfitimi i pjesës takuese në ndërtim duke qenë se kjo pasuri është blerë nga pala sipërmarrëse.** Sip e legalizuara nga persona të tretë do të zbriten nga trualli i palës pronare pasi këto sip nuk i takojnë më kësaj të fundit.....

348.2. Me kontratën nr. 152 rep nr. 86/1 kol dt **30.01.2018**, shtetësja *Hamide Budo*, si palë pronare lidh kontratë me shoq **Kontakt sh.p.k.**, në cilësinë e palës sipërmarrëse, para noteres Laura Pustina. Pasuritë e cituara dhe përmbajtja është e njejtë si në kontratën e mësipërme me nr 153 rep nr. 87/1 kol datë **30.01.2018** me shtetaset *Tire Deda (Luzi), Shpëtim Luzi dhe Fatmir Luzi*.

348.3. Me kontratën nr. 435 rep nr. 205 kol dt **08.03.2018** shtetaset *Xhevrije Mullisi, Luljeta Qatibi, Merita Bardhi, Silvana Bello*, si palë pronare, lidhin kontratë me shoq e ndërtimit **Kontakt sh.p.k.**, në cilësinë e palës sipërmarrëse. Pasuritë e cituara dhe përmbajtja është e njejtë si në kontratën e mësipërme me nr 153 rep nr. 87/1 kol datë **30.01.2018** me shtetaset *Tire Deda (Luzi), Shpëtim Luzi dhe Fatmir Luzi*.

348.4. Konstatohet se me shtetasen *Silvana Bello (Saliaga)*, lidhet edhe një kontratë tjetër sipërmarrje me nr 487 rep nr 229 kol datë **15.03.2018** para noteres Laura Pustina, me shoq ndërtimit "*Kontakt*" sh.p.k. ku pasqyrohet se, kjo kontratë është **vazhdim i kontratës së sip me nr 982 rep nr 299 kol dt 24.03.2010 para noteres Gentiana Shkodra**...Pasuritë që vihen në dispozicion janë të njëjta si ato të cituara më sipër dhe gjithashtu është edhe parashikimi në lidhje me përfshirjen në zhvillim të pasurisë me nr 3/182 ZK 8220 me sip 315 m2. Në këtë kontratë është përcaktuar se porositësi do të përfitojë respektivisht 480 m2 apartamente, 40 m2 dyqan/njësi dhe 80 m2 garazh dhe tarraca të shfrytëzueshme (nëse do të ketë) të kompleksit që do të ndërtohet në truallin e saj...Porositësi ka të drejtë t'i shesë sipërmarrësit deri në 200 m2 sip ndërtimi, ap nga sip e saj takuese ...

N 20...Kjo kontratë shfuqizon kontratën e sip nr 435 rep nr 205 kol datë 08.03.2018 të noteres Laura Pustina, shfuqizimi i së cilës do të shtrihet për të gjitha ato nene dhe kushte të kontratës që bien ndesh me këtë kontratë individuale, **ndërkohë që për efekt të dorëzimit në Bashki për pajisje me leje ndërtimi, kontrata e mëparshme e sip e përmendur më lart do të ruajë fuqinë e saj deri në zbardhjen e plotë të lejes së ndërtimit.** Në këtë kontratë flitet edhe për heqjen dorë nga gjykimi i një padie, ku shoq Kontakt ka paditur me objekt kthimin e shumës së paguar për privatizimin.

348.5. Me kontratën për zhvillim dhe shkëmbimin e pasurive të paluajtshme, nr. 393 rep nr. 186 kol dt **28.02.2018**, para noteres Laura Pustina, *shtetasit Mirnije Llagami, Adela Vasili (Llagami), Ardian Llagmi, Rudina Llagami, Argjend Tafaj, Fatri Tafaj, Arta Shehu (Verzivolli), Artan Verzivolli, Ervin Llagami, Aleksandra Llagami, Artur Llagami* në cilësinë e palës pronare dhe shoq Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës sipërmarrëse, kanë rënë dakort për zhvillimin nëpërmjet ndërtimit të një kompleksi shumëfunksional me vendparkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë në bashkëpronësi në pjesë të pandarë, lloji truall sipas vërtetimeve të lëshuara nga ZVRPP si më poshtë:

- a) Pas e regj në regj hip nr. 775 dt 21.11.2016 të ZRPP nr pas **3/188** vol 19 faqa 235, ZK 8220 sip 2280 m2 përshkrimi "*Një sip trualli mbi të cilën ndodhen terrenet sportive (objektet) të klubit të Futbollit Partizani, me vendodhje rruga Frosina Plaku*". Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr pas 3/189 ND v. 19 faqa 236.
- b) Pas e regj në regj hip nr. 776 dt 21.11.2016 të ZRPP Tiranë nr. pas **3/194** vol. 21 faqa 236, e ndodhur në ZK nr. 8220 me sip 760 m2, me përshkrimin "*Truall me një sip prej 760 m2, mbi të cilin ndodhen objektet e ish klubit të Sportit Partizani, ndodhur në rrugën "Frosina Plaku"*". Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr. pas 3/173 vol 17 faqa 242.

Shkëmbimi i pasurive të paluajtshme ndërmjet palëve, duke kryer të gjitha regjistrimet e nevojshme në ZVRPP Tiranë si dhe duke dorëzuar edhe sendet e paluajtshme njëra - tjetrës pa asnjë barrë mbi pasuritë.

Pala pronare deklaron gjithashtu se nëpërmjet kësaj kontrate, jep pëlqimin e saj për përfshirjen në zhvillim edhe të pasurisë me nr. **3/182** (*e cila nuk është pjesë takuese e asnjë prej familjeve të pronare....por u ble me para të thata nga shoqëria Kontakt sh.p.k. sipas detyrimit për privatizim nga shteti*) ...për qëllim rritje të koeficientit të ndërtimit, duke deklaruar gjithashtu se bie dakord që për këtë pasuri **nuk do të ketë pretendime** aktuale ose në të ardhmen për të përfituar në këmbim sip ndërtimore, pasi kjo pasuri pavarësisht se është regjistruar në ZVRPP në emër të bashkëpronarëve të familjes Begeja, Saliaga dhe Llagami realisht nuk i përket palës pronare por është blerë nga pala sipërmarrëse. Jep pëlqimin edhe për shkatërrimin e ndërtesave në bashkëpronësi në pjesë të pandarë...citohen 6 pasuri.

Sipas n 3, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse, si kompensim në përputhje me pjesën e saj takuese në truallin e familes Llagami, me nr pasurie 3/188 dhe 3/194 të vënë në dispozicion, **25 % të sip së përgjithshme ndërtimore...Për pasurinë me nr. 3/182 pala pronare heq dorë nga përfitimi i pjesës takuese në ndërtim, duke qenë se kjo pasuri është blerë nga pala sipërmarrëse....**

Me deklaratën noteriale nr. 330 rep nr. 114/2 kol dt **06.02.2019** para noteres Laura Pustina, deklaruesit *Lindita Tafaj, Kamelia Tafaj dhe Megi Tafaj (trashëgimtarët e të ndjerit Fatri Tafaj)*, deklarojnë se janë plotësisht dakord me të gjitha kushtet e përcaktuara në kontratën për zhvillimin dhe shërbimin e pasurive të paluajtshme nr. 393 rep nr. 186 kol datë 28.02.2018.

348.5.1. Në një bllok me ngjyrë të zezë, sekuestruar tek studio Pustina me mbishkrimin "2018" konstatohet Tek i njëjti bllok evidentohet një shënim në fletën e datës 18.01.2018 si vijon: "*Toka (J.M.), pagesë tokës tek Union 120 UK. Toka (rruga e Dibrës)*".

Menjëherë pasi familja Llagami, lidh kontratën e mësipërme nr. 393 rep nr. 186 kol datë **28.02.2018**, konstatohet se një ditë më pas, pasuria e cituar në atë kontratë, i shitet shtetasit **Jamarbër Malltezi**, nga disa prej bashkëpronarëve Llagami. Konkretisht lidhet kontratë shitblerje, pasuri e paluajtshme, nr. rep. 395, nr. kol. 188 dt **01.03.2018** ndërmjet shtetasve **Ervin Llagami, Aleksandra Llagami dhe Artur Llagami (Pala shitëse), Jamarbër Malltezi (Pala blerëse)**, me objekt: shitjen e pjesëve takuese në pasurinë në bashkëpronësi me pjesë ideale në truallin me nr. **Pas 3/188 me sip 2880 m²** dhe në truallin me nr. **Pas. 3/194 me sip 760 m²** ZK 8220 rruga Frosina Plaku.

Shitësit si bashkëpronarë të pasurisë me nr. 3/188 ku zotërojnë në total bashkarisht 114/684 pjesë ideale takuese të truallit që përkon me sip **380 m² truall**, ia shesin gjithë pjesën e tyre takuese 114/684 pjesë ideale shtetasit Jamarbër Malltezi, kundrejt vlerës **90 000 euro**. Ky çmim do paguhet në llogarinë e noterit deri më datë 05.03.2018 nëpërmjet transfertës bankare.

Si bashkëpronarë të pasurisë me nr. 3/194 ku zotërojnë në total bashkarisht 6/36 pjesë ideale të truallit që përkon me sip totale prej **126.67 m²**, ia shesin gjithë pjesën e tyre takuese në total 6/36 pjesë ideale bashkëpronarit Jamarbër Malltezi. Çmimi i shitjes **30 000 euro**.

Me urdhër pagese të Union Bank datë **16.03.2018** rezulton se Laura Pustina ka bërë pagesën prej **120 000 euro për këtë kontratë**.

348.6. Me kontratën për zhvillimin dhe shkëmbimin e pasurive të paluajtshme, nr.rep.478, nr.kol. 225 datë 13.03.2018, para noterës Laura Pustina, të lidhur ndërmjet shtetasve **Jamarbër Malltezi dhe shoqëria "Kontakt" shpk (Pala pronare)**, si dhe **Shoqëria e Ndërtimit "Kontakt" shpk (Pala sipërmarrëse)**, me objekt ndërtimin e një kompleksi shumë funksional me parkime, depo, dyqane dhe apartamente, pasqyrohet se: Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse, pasurinë në bashkëpronësi në pjesë të pandarë, llojit truall, me numër pasurie **3/188, vol. 19, fq.235, zk.8220, me sipërfaqe prej 2 280 m²** me shënimin: "*Një sipërfaqe trualli mbi të cilën ndodhen terrenet sportive të klubit të futbollit Partizani, me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku*", "*Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr. Pasurie 3/189 ND, vol. 19, fq. 236*". Në këtë pasuri shtetasi **Jamarbër Malltezi rezulton bashkëpronar me 186/684 pjese dhe Shoqëria Kontakt shpk rezulton bashkëpronare me 42/684 pjesë në këtë pasuri**.

Gjithashtu, edhe pasurinë me numër **3/194**, vol.21, fq. 236, zk. 8220, me sipërfaqe 760 m², me shënimin: "*Një sipërfaqe trualli prej 760 m² mbi të cilën ndodhen terrenet sportive të ish-klubit të futbollit Partizani, me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku*", "*Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr. Pasurie 3/173, vol. 17, fq. 242*". Në këtë pasuri shtetasi **Jamarbër Malltezi rezulton bashkëpronar me 12/36 pjesë**. Jep gjithashtu pëlqimin për shkatërrimin e ndërtesave...citohen 6 pasuri. Në n 3, është përcaktuar se, pala pronare, do të marrë nga pala sipërmarrëse, si kompensim, në përputhje me pjesën e saj takuese në truallin e familjes Llagami, me nr. Pas 3/188 dhe 3/194 të vënë në dispozicion **25 % të sip së përgjithshme ndërtimore** që do të zhvillohet mbi pasuritë objekt i kësaj kontrate. Pjesa takuese e palës zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe para fillimit të punimeve.

Në ASHK kjo kontratë gjendet e lidhur me vërtetimet nga dokumentet hipotekore për pasuritë me nr 3/188 ZK 8220 me sip 2280 m², truall ku gjenden objektet e klubit të futbollit Partizani dhe nr 3/194 ZK 8220 me sip 760 m², truall ku gjenden objekte të ish klubit sportit Partizani.

348.7. Me kontratën e sipërmarrjes, nr.rep 436, nr.kol. 206 datë **08.03.2018**, para noteres Laura Pustina, të lidhur ndërmjet shtetasve **Jamarbër Malltezi dhe shoqëria "Homeplan" shpk (Pala pronare)**, Shoqëria e Ndërtimit "**Kontakt**" shpk (Pala sipërmarrëse), me objekt ndërtimin e një kompleksi shumë funksional me parkime, depo, dyqane dhe apartamente, pasqyrohet sa vijon:

Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse, pasurinë në bashkëpronësi në pjesë të pandarë, llojit truall, pasuri e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. 08 datë 10.01.2018, me numër pasurie **3/215, zk.8220, me sipërfaqe trualli prej 3 294 m²** nga të cilat sipërfaqe ndërtesë prej 1 467 m², pasuri e ndodhur në rrugën Frosina Plaku. Kjo pasuri ka shënimin: "**Mbi këtë truall janë objektet 3/173/ND, vol.17, f1. 242; NR. 3/174/ND, vol.17, fq. 243; nr. 3/175/ND, vol.17, fq.244; NR. 3/176/ND, vol. 17, fq. 245; NR. 3/177/ND, vol.17, fq. 24; 3/178; 3/180; 3/181/ND**". Në këtë pasuri shtetasi Jamarbër Malltezi rezulton bashkëpronar me 416/12 000 pjese dhe Shoqëria Homeplan shpk rezulton bashkëpronare me 543/12 000 pjesë në këtë pasuri.

Gjithashtu, pala pronare është dakord që të përfshijë në ndërtim edhe pasurinë e regjistruar në regj hip nr. 1269 dt 05.12.2011 të ZRPP Tiranë me nr **3/182, zk. 8220, me sipërfaqe 315 m²** pasuri e cila, pavarësisht se është e regjistruar në ZVRPP në emër të bashkëpronarëve të **familjes Saliaga, Begeja dhe Llagami**, nuk i përket palës pronare, pasi është blerë nga **pala sipërmarrëse dhe pala pronare**, për këtë pasuri nuk do të ketë pretendime aktuale ose në të ardhmen për të përfituar në këmbim sip ndërtimore. Jep gjithashtu pëlqimin për shkatërrimin e ndërtesave....citohen 11 pasuri.

Pala pronare, në përputhje me pjesën e saj takuese në truall, do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim, për truallin me nr. Pas. 3/215, 25 % të sip së ndërtuar mbi këtë pasuri të përshkruar në n 1. **Për pas me nr. 3/182 pala pronare heq dorë nga përfitimi i pjesës takuese në ndërtim duke qenë se kjo pasuri është blerë nga pala sipërmarrëse.** Sip e legalizuara nga persona të tretë do të zbriten nga trualli i palës pronare, pasi këto sip nuk i takojnë më kësaj të fundit.

Pjesa takuese e palës pronarë me sip përkatëse sipas kateve do të përcaktohet me një kontratë shtojcë të kësaj kontrate sip, pas zbardhjes së lejes së ndërtimit. Pala pronare ka të drejtë që të përzegjdhë pjesën e saj takuese edhe në objektet e kompleksit Magnet që janë në ndërtim në truallin e familjeve Begeja, Vaqarri, Alimehmeti, kufitare dhe të ndërthurrura me sip e tokës së familjes Saliaga.

348.8. Me kontratën me nr. 630 rep nr. 297/5 kol datë **07.04.2018** para noteres Laura Pustina, shtetasit **Luan, Elton dhe Ledion Saliaga** si palë pronare kanë lidhur kontratë me shoq e ndërtimit **Kontakt sh.p.k.** përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi, në cilësinë e palës sipërmarrëse.

Pasuritë e cituara dhe përmbajtja është e njejtë si në kontratën e mësipërme me nr 153 rep nr. 87/1 kol datë **30.01.2018** me shtetaset **Tire Deda (Luzi), Shpëtim Luzi dhe Fatmir Luzi.**

348.8.1. Me kontratën me nr. 965 rep nr. 418/3 kol datë **07.05.2018** shtetasi **Viktor Saliaga** i përfaqësuar nga Altin Hysi, si palë pronare, ka lidhur kontratë me shoq e ndërtimit Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi, ky i fundit në cilësinë e palës sipërmarrëse. Pasuritë e cituara dhe përmbajtja është e njejtë si në kontratën e mësipërme me nr 153 rep nr. 87/1 kol datë **30.01.2018** me shtetaset **Tire Deda (Luzi), Shpëtim Luzi dhe Fatmir Luzi.**

349. Nga aktet rezulton se **familja Alimehmeti**, e konkretisht **Fehmi Alimehmeti, Skënder Mulliçi, Alma Sulo, Genci Mulliçi, Astrit Alimehmeti, Zana Gurra (Alimehmeti), Artan Alimehmeti, Ortenca Binjaku** (përfaqësuar me prokurë të posaçme datë 14.08.2017 nga Edmond

Binjaku (Pala shitëse), me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, nr.rep. 2800, nr.kol. 934 datë **30.10.2018**, para notere Laura Pustina, i shesin shtetasit **Jamarbër Malltezi (Pala blerëse)**, pjesën takuese në pasurinë në bashkëpronësi me nr. Pasurie **3/158**, vol.15, fq.172, zk.8220, me sip totale prej 180 m², me vendndodhje në rrugën "Frosina Plaku", respektivisht: *Artan Alimehmeti 3/30 pjesë ose 18 m², me vlerë 10 000 euro; Ortenca Binjaku 3/30 pjesë ose 18 m², me vlerë 10 000 euro; Fehmi Alimehmeti 6/30 pjesë ose 36 m², me vlerë 20 000 euro; Skënder Mulliçi 2/30 pjesë ose 12 m²; me vlerë 6 667 euro; Alma Sulo (Mullici) 2/30 pjesë ose 12 m², me vlerë 6 660 euro; Genci Mullici 2/30 pjesë ose 12 m², me vlerë 6 667 euro; Astrit Alimehmeti 3/30 pjesë ose 18 m², me vlerë 10 000 euro; Zana Gurra (Alimhmeti) 3/30 pjesë ose 18 m², me vlerë 10 000 euro.* Në total ia shesin blerësit, pjesën e pandarë të truallit, që kanë në bashkëpronësi 24/30 ose 144 m² në truallin me nr. Pas. 3/158, me vlerë totale **80 000 euro**. Pas shitjes, pjesët takuese në pasurinë me nr. 3/158 do të jenë: Jamarbër Malltezi 24/30 dhe Fatbardha Marika (Alimehmeti) 6/30.

Bashkalidhur janë edhe urdhër pagesat pranë Union Bank të datës 26.11.2018, ku evidentohet pagesa prej 80 000 euro.

349.1. I pyetur më datë 23.02.2024, shtetasi *Blendi Marika*, një prej trashëgimtarëve të familjes Alimehmeti, deklaroi se, *u ka ardhur një email nga administrata e Fatmir Bektashit, një draft për ndërtim të përbashkët në këtë pasuri. Në takimet me trashëgimtarët e tjerë të familjes Alimehmeti Blendi është shprehur se nuk ishte dakord për ndërtimin nga firma Kontakt për ndërtimin e kësaj sipërfaqe që kishte ngelur nga Klubi i Futbollit Partizani. Nuk donte të vazhdonte bashkëpunimin me firmën Kontakt pasi kishte pakënaqësitë e tij. Më vonë, mësoi nga familjarët e tij që trashëgimtarë të tjerë të familjes Alimehmeti ia kishin shitur pjesën e tyre takuese në këtë pasuri shtetasit Jamarbër Malltezi. Madje i sugjeruan dhe Blendit të vepronte në të njëjtën mënyrë por ai nuk pranoi. E ka kontaktuar shtetasi Vladimir Xheka i cili e ka garantuar për zbatimin e kërkesave të Blendit lidhur me cilësinë e punimeve. Në këto kushte pranoi që në këtë pronë të ndërtohej dhe për sipërfaqen ku ishte pronare nëna e tij, Fatbardha dhe sipas kontratës së sipërmarrjes së lidhur, ka përfutur një apartament.*

349.2. Megjithëse siç konstatohet shoqëria **Magnet Imo sh.p.k.** me administrator shtetasin Vladimir Xheka, nuk duket se ka ndonjë aktivitet në fushën e ndërtimit, rezultoi se ajo me cilësinë e **palës sipërmarrëse**, lidh kontratën e sipërmarrjes, me nr 3027 rep nr 1008/3 kol dt **19.11.2018**, para notere Laura Pustina, me shtetasen **Fatbardha Marika (Alimehmeti)** e përfaqësuar nga djali i saj Blendi Marika, **me cilësinë e palës pronare dhe pëlqim dhënës shoqëria Kontakt sh.p.k.** e përfaqësuar nga administrotori Fatmir Bektashi.

Objekti i kësaj kontrate është **ndërtimi i një objekti rezidencial** me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit që do të miratohet nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse, **pjesën e saj takuese** prej 6/30 pjesë ideale në pasurinë e llojit truall sipas vërtetimit të pronësisë së lëshuar nga ZVRPP Tiranë për pas e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr 456 datë 06.05.2015, **pasuri me nr 3/158 ZK 8220 sip trualli 180 m²**, vol 15 faqa 172, ndodhur në rrugën Frosina Plaku, inskript nr. 964 datë 06.10.2010 në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k. Shoq Kontakt sh.p.k. në favor të së cilës është kryer inskriptimi i kësaj prone jep pëlqimin e saj për lidhjen e kësaj kontrate sipërmarrëse.

Sipas n 2, pala pronare, do të marrë nga pala sipërmarrëse, si kompensim për truallin e sipërpërmendur, të vënë në dispozicion për zhvillim, një apartament 1+1. Meqënëse sip e apartamenteve 1+1 variojnë rreth 65 m², është rënë dakord midis palëve që 50 m² do të përfitohen nga pala pronare në formën e shkëmbimit të pjesës së vetë takuese të truallit të vënë në dispozicion për zhvillim, ndërsa pjesa tjetër e m² që do të përbëjnë apartamentin 1+1 që do të përfitohet nga pala pronare, rreth 15 m² shtesë do të paguhet nga pala pronare me çmimin

prej 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/m², pagesë që do i kryhet sipërmarrësit nga pala pronare në momentin e përfundimit të objektit dhe dorëzimit të apartamentit tek pala pronare. Përcaktimi dhe përshkrimi i partamentit 1+1 që do të përfitohet nga pala pronare në objektin që do të ndërtohet do të specifikohet me një kontratë shtojcë të kësaj kontrate sipërmarrje, pas zbardhjes së lejes së ndërtimit. ...

I pyetur më datë 20.02.2024 shtetasi *Vladimir Xheka*, deklaroi se **nuk i kujtohet gjë në lidhje me këtë kontratë**. I qëndron kontratës që ka nënshkruar por nuk është jurist të bëjë interpretimin e kontratës pasi është ekonomist. Di vetëm të thotë që shoqëria e thjeshtë që është krijuar Kontakt sh.p.k. dhe Magnet IMO, nuk kanë ushtruar ndonjëherë veprimtari të përbashkët.

Qartësisht nga këto deklaramë, evidentohet se veprimet kryhen në ë vërtetë nga shtetasi Jamarbër Malltezi i cili përdor emrat e personave me të cilët bashkëpunon dhe subjektet që zotëron.

349.3. Përsa më sipër, me kontratën e sipërmarrjes nr. 3080 rep nr. 1043/2 kol dt **24.11.2018** para noteres Laura Pustina, kanë lidhur kontratë shoqëria **Magnet Imo** e përfaqësuar nga administratori **Vladimir Xheka** në cilësinë e porositësit dhe shoqëria **Kontakt sh.p.k.** e përfaqësuar nga administratori Fatmir Betashi, në cilësinë e sipërmarrësit. Porositësi është i interesuar për realizimin e një objekti rezidencial në pasurinë me nr. 3/158 sip 180 m² i llojit truall ZK 8220 pasuri për të cilën midis porositësit shoq Magnet Imo sh.p.k. dhe bashkëpronares Fatbardha Marika është lidhur kontrata e sip nr. 3027 rep nr. 1008 kol datë 19.11.2018. Sipërmarrësi është e interesuar dhe shpreh vullnetin që me financimet e porositësit të realizojë po pa u kufizuar vetëm në këto: Dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin objektit, aplikimin në bashki për pajisje me leje ndërtimi, ndërtimin e objektit rezidencial sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, veprimtari këto që do të kryhen në emër dhe për llogari të porositësit në përputhje me rregullimet e kësaj kontrate. Porositësi shpreh dëshirën dhe vullnetin e tij që të kontraktojë sipërmarrësin, shoqërinë Kontakt sh.p.k. e licencuar në fushën e ndërtimit, në mënyrë që kjo shoqëri të realizojë detyrat e lartpërmendura. Fitimi i sipërmarrësit 10 %. Nëse sipërmarrësi nuk dorëzon objektin në afatin e parashikuar është parashikuar edhe penalitet.

349.4. Për të njëjtën pasuri më sipër, edhe shtetasi **Jamarbër Malltezi, tashmë me cilësinë e palës pronare**, lidh kontratën e sipërmarrjes me nr. 3262 rep nr. 1112 kol., datë **14.12.2018** para noteres Laura Pustina, me shoqërinë Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi në cilësinë e palës sipërmarrëse.

N 1: Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasurinë në bashkëpronësi në pjesë të pandara, lloji truall ...e konkretisht pasurinë me nr. **3/158 ZK 8220 sip trualli 180 m²**, vol 15 faqa 182 rruga Frosia Plaku. Barrë mbi pasurinë: Nuk ka.

...N 2: Pala pronare në përputhje me pjesën e saj takuese në truall do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin me nr pas 3/158, **25% të sip së ndërtuar mbi këtë pasuri**. ... Pjesa takuese e palës pronare me sip përkatëse sipas kateve do të përcaktohet me një kontratë shtojcë të kësaj kontrate sip pas zbardhjes së lejes së ndërtimit. ...Pala pronare ka të drejtë që të për zgjedhë pjesën e saj takuese edhe në objektet e kompleksit Magnet që janë ndërtuar në truallin e fam Begeja, Vaqarri, Alimhmeti, kufitare dhe të ndërthurrura me sip e tokës së vënë në dispozicion për zhillim në këtë kontratë....

349.5. Po një tjetër kontratë sipërmarrje, me nr.rep. 3262, nr.kol. 1112 datë 14.12.2018, lidhet para notere Laura Pustina, ku shtetasi **Jamarbër Malltezi (Pala pronare) dhe Shoqëria Kontakt shpk** (Pala sipërmarrëse) bien dakord për e një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasurinë nr. 3/158, vol. 15, fq. 172, zk. 8220, me sipërfaqe trualli 180 m², rruga Frosina Plaku, Tiranë, dhe si kompensim do marr 25% të sipërfaqes së ndërtuar mbi këtë pasuri.

350. Nga aktet rezultojnë se shtetasit Gentian Hoxha dhe Jamarbër Malltezi fitojnë të drejta si bashkëpronarë si rezultat i dy kontratave të dhurimit të lidhura me shtetasit Kreshnik Kaçurri dhe Nustret Kaçurri.

350.1. Konkretisht, me kontratën e dhurimit nr. 1217 rep nr. 590 kol dt 01.06.2018, para noteres **Xhoana Omari**, shtetasi **Kreshnik Kaçurri**, si dhurues, dhe shtetasit **Gentian Hoxha dhe Jamarbër Malltezi** si pranues të dhurimit, **Shoqëria Homeplan** e cila përfaqësohet nga **Fatmir Bektashi** si administrator me cilësinë e dhënies së pëlqimit, pasqyrohet se:

Të dhënat paraprake: Dhuruesi së bashku me persona të tjerë, është bashkëpronar i truallit me sip 660 m² i përfutur me vendim të KKKP. Për zhvillimin e këtij trualli janë lidhur me shoqërinë Homeplan sh.p.k. kontratat e sipërmarrjes nr. 971 rep nr. 546 kol datë 22.05.2013 dhe nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013 para noteres Laura Pustina. **Dhuruesi në shenjë respekti dhe dashurie, i dhuron pranuesve, pjesët e tij ideale të pronësisë që ai zotëron në pasuritë e përcaktuara në nenin 2 të kësaj kontrate dhurimi. Neni 1: ...Dhurimi bëhet pa asnjë kundërshtim.**

*Neni 2...*Dhuruesi garanton pranuesit se është bashkëpronar i pasurisë së dhuruar, truallit me sip 660 m², pas me nr. 3/155 të regjistruar me nr. 236 dt 29.03.2018, ZK 8220 dhe pas nr. 12/139 regjistruar ne vol 20 faqa 170 ZK 8310, rruga e Durrësit.

Sipas akteve bashkalidhur kësaj kontrate, rezultojnë se: me vërtetimin nga dokumentat hipotekorë dt lëshimi 04.04.2018 pasqyrohet se vërtetohet se në regjistrin hipotekor me nr. 236 datë 29.03.2018 figuron e regjistruar në pronësi të 29 bashkëpronarëve **pasuria me nr. 3/155 ZK 8220 me sip 660 m², e llojit truall**, ndodhur në rr. Ndre Mjeda. Origjina e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nr hip 411 datë 20.04.2012 dhe barrë mbi pasurinë rezultojnë Insk. 432 datë 30.08.2012 në favor të Homeplan. Bashkalidhur është edhe kontrata e sipërmarrjes me nr 971 rep nr 546/2 kol datë 22.05.2013 dhe me nr. 1741 rep nr. 857/3 kol datë 12.08.2013 e lidhur para noteres Laura Pustina. Aplikimi nr 115194 datë 22.11.2018.

350.2. Me kontratën e dhurimit nr 1218 rep nr 591 kol datë 01.06.2018 para noteres Xhoana Omari, shtetësja **Nustret Kaçurri**, në cilësinë e dhurueses, i dhuron shtetasve **Gentian Hoxha dhe Jamarbër Malltezi** me pëlqimin e shoq Homeplan sh.p.k. pjesët e saj ideale, që ajo zotëron tek pasuria me sip 660 m² truall me nr pasurie 3/155, regjistruar me nr 236 datë 29.03.2018 ZK 8220 Tiranë dhe pasurisë nr 12/139 të regj me vol 20 faqa 170 ZK 8310 rruga e Durrësit.

Shtetasi Ermal Kaçurri i pyetur gjatë hetimit ka deklaruar se është në dijeni se shtetasi Nustret Kaçurri i ka dhuruar nipërve dhe mbesave.

350.3. Nga hetimi ka rezultuar se megjithëse **dy kontratat e mësipërme mbajnë datën 01.06.2018, rezultojnë se ato që janë depozituar në ASHK, mbajnë data të muajit maj 2008.** Konkretisht janë sekuestruar pranë ASHK-së praktika e regjistrimit të pasurive të sipërcituara, dhe ka rezultuar se **gjenden kontratat me nr 1217 rep nr 1218 rep respektivisht të datave 30.05.2018 dhe 31.05.2018.** Në të dyja këto kontrata siç mund të shihet lehtësisht,

mospërputhja e datës së pasqyruar në regjistrin noterial dhe me kopjen origjinale të gjendur tek noterja.

Në ASHK në praktikën e pasurisë me nr ref 00017104, për pasurinë me nr 12/139 ZK 8310 rezulton se shtetasi **Kreshnik Kaçurri pasqyrohet sikur është kërkuesi**, aplikimi i bërë nga shtetësja Laura Pustina, më datë 18.04.2019, për regjistrimin e kontratës me nr 1217 rep nr 590 kol **por tashmë kontrata që gjendet në këtë praktikë aplikimi mban datën 30.05.2018 dhe jo 01.06.2018**. Pagesa në bankë për taksën e regjistrimit, gjithsej 159 137 lekë është bërë nga **Romina Hasanaj**. Në praktikën e kqyrrur pranë ASHK-së, me nr ref 00017104 kërkues është paraqitur shtetësja **Nustret Kaçurri** dhe aplikues Laura Pustina, më datë 18.04.2019 kurse pagesën e taksës prej 159 137 lekë e ka bërë Romina Hasanaj.

Është administruar praktika me nr reference 015686 për pasurinë me nr 3/155 ZK 8220, në të cilën gjenden mandat arkëtime datë 22.11.2018, me pagesën në vlerën 228 172 lekë nga shtetësja Alma Koxha, 5 700 lekë dhe 50 750 lekë. Aplikimi konstatohet se është bërë për shtetasen **Nustret Kaçurri** nga shtetësja Laura Pustina.

350.4. Më datë 11.06.2024 është pyetur shtetësja **Xhoana Omari**, e cila ka deklaruar në lidhje me kontratat e mësipërme. Kjo shtetase në lidhje me firmat e shtetasve Kreshnik dhe Nusret Kaçurri **ka deklaruar se ua ka marrë në shtëpi, pasi i është kërkuar nga pala, kurse shtetasit Gentian Hoxha dhe Jamarbër Malltezi kanë firmosur në zyrën e saj. Në lidhje me ndryshimet e datave, pretendon se janë lapsus. Për të gjitha rastet kur Nusreti apo Kreshniku kanë nënshkruar në kontrata të ndryshme, pretendon se firmat ua ka marrë në shtëpi. E pyetur për të sqaruar në lidhje me ambjentin e shtëpisë së këtyre shtetasve, nuk di ta përshkruajë, pasi pretendon se ka qëndruar në korridor. Në lidhje me Nustretin pretendon se e ka takuar për herë të fundit kur ka bërë kjo e fundit një prokurë të përgjithshme që të firmoste në emër të saj për pronat, kurse Kreshnikun ka më shumë se dy vjet që nuk e ka takuar.**

350.5. Më datë 14.06.2024 është pyetur shtetësja **Romina Hasanaj**, e cila e pyetur në lidhje me regjistrimin e kontratave të përpiluara nga notere Xhoana Omari të sipërcituara, të cilave u ndryshon data, duke qenë se Romina i ka depozituar këto kontrata me datë të majit në ASHK, **nuk di të japë shpjegime në lidhje me ndryshimin e datave. Ajo sqaron në lidhje edhe me tagret që i janë dhënë për arkëtime, pagesa në llogaritë e shtetasve Laura Pustina dhe të personit fizik por edhe për pagesa të kryera për klientët siç është në një rast të evidentuar përgjatë hetimit për shtetasin Jamarbër Malltezi për rivlerësime pasurish, duke sqaruar se në dijeninë e saj, klientët sillnin lekët për këto shërbime dhe i mbanin tek arka e Laurës për të bërë pagesat.**

Sjellim në vëmendje se shtetësja Romina Hasanaj, është vajza e shtetasit Fetah Hasanaj, regjistruerit në ZVRPP që ka kryer një sërë veprimesh për regjistrimin e pasurive dhe specifikisht ato të pretenduara të dhuruara nga shtetësja Nustrete Kaçurri me gjurmë gishti.

351. Në pasurinë me nr 3/155 shtetasi Jamarbër Malltezi fiton të drejta të tjera pronësie edhe nga një kontratë që lidh me shtetasen Rajmonda Bektashi. Konkretisht me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, nr. rep. 3209, nr. kol. 1083 datë 05.12.2018, para noteres Laura Pustina, ndërmjet shtetasve **Raimonda Bektashi (Pala shitëse)** dhe shtetasit **Jamarbër Malltezi (Pala blerëse)** si dhe Shoqërisë Homeplan shpk (Pëlqimdhënësi), parashtrohet se: ... Raimonda Bektashi është bashkëpronare me pjesë ideale në truallin me nr pas 3/154 sip 27 m2 dhe në truallin me nr pas 3/155 me sip 660 m2 ZK 8220 të ndodhur në Rr. Frosina Plaku, Tiranë. Këto pasuri janë përfutur nga trashëgimia ligjore. Pala blerëse Jamarbër Malltezi është

gjithashtu bashkëpronar në pjesë ideale në truallin me nr pas 3/154 dhe nr pasurie 3/155 dhe ka rënë dakord që të realizojë blerjen e pjesëve takuese të palës shitëse në këto dy pasuri ... Sa më sipër palët bien dakord që të hartojnë këtë kontratë shitblerje midis tyre sipas kushteve të mëposhtme:

A. ... u konstatua se në emër të bashkëpronarëve: ...Raimonda Bekteshi 1050/33600 pjesë, Jamarbër Malltezi 2685/33600 pjesë, Orinda Malltezi 525/33600 pjesë...figuron e regjistruar pasuria e përshkruar si më poshtë: "pasuria me nr. 3/154, ndodhur në ZK 8220 me sip 27 m2, lloji truall vol 15 faqa 176, vendndodhja në rrugën Ndre Mjeda (më poshtë e quajtur Pasuria 1). " Barrë mbi pasurinë: Inskriptuar në favor të shoqërisë Homeplan sh.p.k. me nr 432 datë 30.09.2013. Shoq Homeplan sh.p.k. në cilësinë e pëlqimdhënësit në këtë kontratë e përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi deklaroi se është plotësisht dakord për transferimin e pronësisë së pjesëve takuese të truallit nga shitësja Rajmonda Bekteshi tek blerësi Jamarbër Malltezi duke dhënë pëlqimin e saj për realizimin e kësaj kontrate shitblerje....

Shitësja Rajmonda Bekteshi si bashkëpronare e pasurisë me nr 3/154 ku zotëron 1050/33600 pjesë ideale takuese të truallit, që përkon me sip totale prej 0.84 m2 truall me dëshirën e saj të lirë e të plotë deklaroi se ia shet gjithë pjesën e saj takuese bashkëpronarit tjetër të kësaj pasurie Jamarbër Malltezi. ... Në marrëveshje të përbashkët të palëve, vlera totale e shit blerjes së pjesës ideale të Rajmonda Bekteshi prej 1050/33600 pjesë ideale në pasurinë 3/154 është caktuar në shumën euro 203. ...blerësi Jamarbër Malltezi bëhet pronar i pjesëve që i shiten në pasurinë me nr 3/154 prej 1050/33600 pjesë ideale që përkon me sip e pandarë të truallit prej 0.84 m2. Në këto rrethana ZRPP i lind e drejta të bëjë transkriptimin e pjesëve të shitura në pasurinë 3/154 nga emri i palës shitëse tek emri i palës blerëse duke e regjistruar në emër të bashkëpronarëve si më poshtë vijon: ...Jamarbër Malltezi 3735/33600 pjesë...

B. ... u konstatua se në emër të bashkëpronarëve: ...Raimonda Bekteshi 1050/33600 pjesë, Jamarbër Malltezi 6885/33600 pjesë, Orinda Malltezi 525/33600 pjesë...Pasuria me nr 3/155 e ndodhur në ZK 8220 me sip 660 m2, lloji truall vol 15 faqa 185 me vendndodhje në rrugën Ndre Mjeda (më poshtë e quajtur Pasuria 2). Barrë mbi pasurinë: Inskriptuar në favor të shoqërisë Homeplan sh.p.k. me nr 432 datë 30.09.2013. Shoq Homeplan sh.p.k. në cilësinë e pëlqimdhënësit në këtë kontratë e përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi deklaroi se është plotësisht dakord për transferimin e pronësisë së pjesëve takuese të truallit nga shitësja Rajmonda Bekteshi tek blerësi Jamarbër Malltezi duke dhënë pëlqimin e saj për realizimin e kësaj kontrate shitblerje....Shitësja Rajmonda Bekteshi si bashkëpronare e pasurisë me nr 3/155 ku zotëron 1050/33600 pjesë ideale takuese të truallit, që përkon me sip totale prej 20.62 m2 truall me dëshirën e saj të lirë e të plotë deklaroi se ia shet gjithë pjesën e saj takuese bashkëpronarit tjetër të kësaj pasurie Jamarbër Malltezi. ...Në marrëveshje të përbashkët të palëve, vlera totale e shit blerjes së pjesës ideale të Rajmonda Bekteshi prej 1050/33600 pjesë ideale në pasurinë 3/155 është caktuar në shumën euro 4 797. ...blerësi Jamarbër Malltezi bëhet pronar i pjesëve që i shiten në pasurinë me nr 3/155 prej 1050/33600 pjesë ideale që përkon me sip e pandarë të truallit prej 20.62 m2. Në këto rrethana ZRPP i lind e drejta të bëjë transkriptimin e pjesëve të shitura në pasurinë 3/154 nga emri i palës shitëse tek emri i palës blerëse duke e regjistruar në emër të bashkëpronarëve si më poshtë vijon: ...Jamarbër Malltezi 7935/33600 pjesë...

Bashkalidhur praktikës është edhe ekstrakti i QKB-së së shoqërisë Homeplan sh.p.k., datë ekstrakti 17.04.2018, ku rezulton qartësisht se ortak i vetëm është shtetasi Fatmir Bektashi.

Bashkalidhur është edhe urdhër pagesa nga Union Bank me datë 11.12.2018, ku evidentohet se shtetasi Jamarbër Maltezi ka bërë pagesë prej 5 000 euro në drejtim të noteres Laura Pustina.

352. Me deklaratën noteriale nr. 3343 rep nr. 1156/1 kol datë 24.12.2018 para noteres Laura Pustina janë paraqitur **shoqëritë Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k.** të dyja të përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi, të cilat kanë deklaruar: Fatmir Bektashi për llogari të shoqërisë Homeplan sh.p.k. deklaroi se ka nënshkruar kontratën e sip me nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013 si dhe aneksin bashkalidhur me bashkëpronarët e familjes Begeja për zhvillimin e truallit me nr pas 3/182 ZK 8220 me sip 315 m2...deklaroi se angazhon shoq Kontakt sh.p.k....që të përgatisë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik si dhe gjithë procedurat përkatëse me Bashkinë e Tiranës, për t'u pajisur me leje ndërtimi, për zhvillimin e këtij trualli...deklaroi se është dakord që shoqëria Kontakt sh.p.k. të ketë tagrin e zhvilluesit dhe subjektit ndërtues ...si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013...Në cilësinë e administratorit të shoq Kontakt sh.p.k. shtetasi Fatmir Bektashi deklaroi se është dakord dhe disponon të gjitha kapacitetet financiare, ligjore dhe teknike që të realizojë zhvillimin e truallit me nr pas 3/182 me sip 315 m2 me qëllim ndërtimin e një objekti rezidencial...

352.1. Me deklaratën noteriale me nr. 3344 rep nr. 1157/1 kol datë 24.12.2018 para noteres Laura Pustina, paraqiten deklaruesit shoqëria Kontakt sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi, shoqëria Homeplan sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi, shoqëria Magnet IMO sh.p.k. përfaqësuar nga administratori Vladimir Xheka. Në këtë deklaratë shtetasi Vladimir Xheka deklaroi: *Unë i nënshkruari Vladimir Xheka, në cilësinë e administratorit të shoqërisë Magnet Imo sh.p.k. deklaroj se kam nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. 3027 rep nr. 1008 kol datë 19.11.2018 me bashkëpronaren Fatbardha Marika për zhvillimin e truallit me nr pas 3/158 ZK 8220 me sip 180 m2 (sipas çertifikatës është bashkëpronar për këtë pasuri Fatbardha Marika me 6/30 dhe Jamarbër Malltezi me 24/30). Në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën e lartpërmendur të sipërmarrjes dhe mbështetur në nenin 9 pika 1 të saj ku parashikohet bashkëpunimi me një shoqëri të licencuar në fushën e ndërtimit për realizimin e projektit të ndërtimit, deklaroj se angazhoj shoqërinë Kontakt sh.p.k. e cila është e licencuar në fushën e projektuar dhe ndërtimit të objekteve rezidenciale që të përgatisë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik si dhe gjithë procedurat përkatëse me Bashkinë e Tiranës për t'u pajisur me leje ndërtimi për zhvillimin e këtij trualli. Deklaroj se jam dakort që shoq Kontakt sh.p.k. të aplikojë në sistemin e albania për t'u pajisur me leje ndërtimi si dhe të ketë tagrin e zhvilluesit dhe subjektit ndërtues në lejen e ndërtimit që do të miratohet për këtë truall duke marrë përsipër ndërtimin në afat të objektit sipas lejes së ndërtimit, dorëzimin e pjesëve takuese palës pronare nëpërmjet shkëmbimit, transaksionet e shitblerjes me klientët, përfundimin e objektit në afat, pajisjen e tij me lejen e përdorimit, regjistrimin e objektit në ZVRPP Tiranë si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata e sipërmarrjes nr. 3027 rep nr. 1008 kol datë 19.11.2018 si dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera të parashikuara në ligj*

“Unë i nënshkruari Fatmir Bektashi në cilësinë e administratorit të shoqërisë Homeplan sh.p.k. deklaroj se kam nënshkruar kontratën e sip nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013 si dhe aneksin bashkalidhur e bashkëpronarët e familjes Begeja për zhvillimin e truallit me nr pas 3/155 ZK 8220 me sip 660 m2. Në cilësinë e sipërmarrësit, në kontratën e lartpërmendur të sipërmarrjes dhe mbështetur në nenin 10 pika b të saj ku parashikohet zhvillimi i ndërtimit të objektit me shoqërinë Kontakt sh.p.k. deklaroj se angazhoj shoq Kontakt sh.p.k. e cila është e licencuar në fushën e projektimit dhe ndërtimit të objekteve rezidenciale që të përgatisë të gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik si dhe gjithë procedurat përkatëse me Bashkinë e Tiranës për t'u pajisur me leje ndërtimi për zhvillimin e këtij trualli. Deklaroj se jam dakort që shoq Kontakt sh.p.k. të aplikojë në sistemin e albania për t'u pajisur me leje ndërtimi si dhe të ketë tagrin e zhvilluesit dhe subjektit ndërtues në lejen e ndërtimit që do të miratohet për këtë

truall duke marrë përsipër ndërtimin në afat të objektit sipas lejes së ndërtimit, dorëzimin e pjesëve takuese palës pronare nëpërmjet shkëmbimit, trasnaksionet e shitblerjes me klientët, përfundimin e objektit në afat, pajisjen e tij me lejen e përdorimit, regjistrimin e objektit në ZVRPP Tiranë si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata e sipërmarrjes nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013 si dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera të parashikuara në ligj”.

“Unë i nënshkruari **Fatmir Bektashi** në cilësinë e administratorit të shoq Kontakt sh.p.k. shoqëri e licëncuar në fushën e projektimit dhe ndërtimit të objekteve rezidenciale, deklaroj se jam dakord dhe disponoj të gjitha kapacitetet financiare, ligjore dhe teknike që të realizoj zhvillimin e trojeve me nr pas 3/158 me sip 180 m2 dhe nr pas 3/155 me sip 660 m2 me qëllim ndërtimin e një objekti rezidencial. Gjithashtu marr përsipër që të përgatis gjithë dokumentacionin ligjor dhe teknik si dhe gjithë procedurat përkatëse me Bashkinë e Tiranës për t'u pajisur me leje ndërtimi për zhvillimin e këtij trualli...”.

I pyetur më datë 20.02.2024 shtetasi **Vladimir Xheka**, deklaroi se, ka dijeni për kontratën e nënshkruar (nr 3027 rep nr 1008/3 kol datë 19.11.2018) por nuk mban mend që shoqëria të ketë marrë ndonjë përfitim nga kontrata dhe deklarata e sipërcituar. Shoqëria Magnet Imo nuk kryen asnjë aktivitet jashtë fushës së veprimtarisë, pra merret vetëm me administrim, mirëmbajtje, pastrim dhe dhënie me qera. Kjo shoqëri nuk merret me ndërtim.

352.2. Me deklaratën noteriale nr. 1376 rep nr. 538/1 kol datë 05.06.2019 para noteres Laura Pustina, rezultoi se kanë paraqitur deklaram, shoqëria **Kontakt sh.p.k.** përfaqësuar nga administratori **Fatmir Bektashi**, shoqëria **Homeplan sh.p.k.** përfaqësuar nga **Fatmir Bektashi** dhe shoqëria **Magnet Imo sh.p.k.** përfaqësuar nga **Vladimir Xheka** si më poshtë: “Unë i nënshkruari **Fatmir Bektashi** në cilësinë e administratorit të shoq Homeplan sh.p.k. deklaroj se kam nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. 1741 rep nr. 857 kol datë 12.08.2013 me bashkëpronarët e familjes **Begeja** për zhvillimin e truallit me nr pas 3/155 ZK 8220 vol 15 faqa 185 me sip 660 m2 (në këtë pasuri është bashkëpronar edhe **Malltezi** sipas vërtetimit datë 24.12.2018). Në cilësinë e sip në kontratën e lartpërmendur të sip dhe mbështetur në nenin 10 pika b të saj, ku parashikohet zhvillimi i ndërtimit të objektit me shoq Kontakt sh.p.k. deklaroj se jam dakord që shoq Kontakt sh.p.k. të jetë bashkëzhvilluese në këtë projekt së bashku me shoq Homeplan sh.p.k. dhe njëkohësisht shoq Kontakt sh.p.k. të jetë dhe në cilësinë e subjektit ndërtues të këtij zhvillimi...”

Unë i nënshkruari **Vladimir Xheka** në cilësinë e administratorit të shoq Magnet Imo sh.p.k. deklaroj se kam nënshkruar kontratën e sip me nr. 3027 rep nr. 1008 kol datë 19.11.2018 me bashkëpronaren **Fatbardha Marika** për zhvillimin e truallit me nr pas 3/158 ZK 88220 me sip 180 m2 (në këtë sip është bashkëpronar **Fatbardha Marika** me 6/30 dhe **Jamarbër Malltezi** me 24/30 sipas çertifikatës datë 20.11.2018). Në cilësinë e sip në kontratën e lartpërmendur të sip dhe mbështetur në nenin 9 pika 1 të saj ku parashikohet bashkëpunimi me një shoqëri të licencuar në fushën e ndërtimit për realizimin e projektit të ndërtimit, deklaroj se jam dakord që shoq Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. të jenë bashkëzhvilluese në këtë projekt ndërtimi dhe njëkohësisht shoq Kontakt sh.p.k. të jetë dhe në cilësinë e subjektit ndërtues të këtij zhvillimi ...

Unë i nënshkruari **Fatmir Bektashi** në cilësinë e adminsitrorit të shoq Kontakt sh.p.k...deklaroj se jam dakord që së bashku me shoq Homeplan sh.p.k. të jem në cilësinë e **Bashkëzhvilluesit** në ndërtimin që do të zhvillohet në truallin në bashkëpronësi të fam **Begeja** me nr pas 3/155, ZK 8220 vol 15 faqa 185 me sip 660 m2 dhe në truallin me nr pasurie 3/158 ZK 8220 me sip 180 m. Gjithashtu deklaroj se në këtë projekt ndërtimi do të jem njëkohësisht dhe në cilësinë e subjektit ndërtues duke marrë përsipër ndërtimin...”

352.3. Në lidhje me pasurinë 3/155 tashmë futet në sipërmarrje edhe shtetasi Gentian Hoxha. Konkretisht rezulton se me kontratën e sipërmarrjes nr. 350 rep nr. 127/3 kol datë **11.02.2019**, shtetasi **Gentian Hoxha në cilësinë e palës pronare**, ka lidhur kontratë me shoqërinë Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës sipërmarrëse. Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasurinë në bashkëpronësi në pjesë të pandara, lloji truall e konkretisht pasurinë me nr. 3/155 ZK 8220 sip truall 660 m2, vol 15 faqa 185 rruga Frosia Plaku. Pala pronare në përputje me pjesën e saj takuese në truall do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin me nr pas 3/155, **25% të sip** së ndërtuar mbi këtë pasuri....

353. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 385 rep nr. 154/1 kol datë **15.02.2019**, shtetasit **Hajdar Çela dhe Majlinda Spahi**, trashëgimtarë të të ndjerës Lumturi Çela, në cilësinë e palës pronare kanë lidhur kontratë me shoqërinë Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe pëlqimdhënës shoqëria Homeplan sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori Fatmir Bektashi. Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë e llojit truall sipas vërtetimeve të pronësisë së lëshuara nga ZVRPP Tiranë e konkretisht për pasuritë: pas me nr. 3/154 ZK 8220 sip truall 27 m2 vol 15 faqa 176, rr. Ndre Mjeda, inskript nr. 432 datë 30.09.2013 në favor të shoq Homeplan sh.p.k. dhe pasuria me nr. 3/155 ZK 8220 me sip truall 660 m2 vol 15 faqa 185, inskriptuar në favor të shoq Homeplan sh.p.k. Pëlqimdhënësi shoqëria Homeplan sh.p.k. jep pëlqimin e saj për lidhjen e kësaj kontrate sipërmarrje. Pala pronare deklaron gjithashtu se nëpërmjet kësaj kontrate jep pëlqimin e saj për përfshirjen në zhvillim edhe të pasurisë me nr. 3/182 me të dhënat e përshkruara më poshtë, **për qëllim të shuarjes së mosmarrëveshjeve midis familjeve Llagami dhe Saliaga duke deklaruar gjithashtu se bie dakord që për këtë pasuri nuk do të ketë pretendime aktuale ose në të ardhmen për të përfutuar në këmbim sip ndërtimore pasi kjo pasuri pavarësisht se është e regjistruar në ZVRPP në emër të bashkëpronarëve të familjes Begeja, Saliaga dhe Llagami, realisht është jashtë pjesës përkatëse të tokës së familjes Begeja por është blerë nga shoq Kontakt sh.p.k. gjatë privatizimit, përndryshe nuk do të mbyllej procesi i privatizimit. Familja Begeja ka rënë dakord paraprakisht që të mos ketë pretendime në toka që janë jashtë pjesës takuese të të parëve të tyre, me qëllim që këto sip të blera nga Kontakt sh.p.k. të shërbejnë për shuarjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese mes familjeve Saliaga dhe Llagami: pasuria me nr. 3/182 ZK 8220 me sip 315 m2 truall vol 18 faqa 1 në bashkëpronësi me familjen Saliaga dhe Llagami. ... Sipas n 2, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sip të vënë në dispozicion **25% të sip** ndërtimore që do të zhvillohet...Ndërkohë për pasurinë 3/182 objekt zhvillimi ...pala pronare nuk ka pretendime për të përfutuar pjesë takuese nga ndërtimi që do të zhvillohet....**

354. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 445 rep nr. 193/1 kol datë **22.02.2019** shtetasi **Adnan Llagami** në cilësinë e palës pronare ka lidhur kontratë me shoq e ndërtimit Kontakt sh.p.k. kjo e fundit në cilësinë e palës sipërmarrëse. Objekti i kësaj kontrate është vendosja në dispozicion të palës sipërmarrëse të pasurive ndërtesa, ku Adnani rezulton bashkëpronar në pjesë të pandara, me qëllim shkatërrimin dhe prishjen e tyre. Pasuritë janë:
Pas nr. 3/173 ND ZK 8220 sip 2175 m2, përshkrim objekt 2 kat + 1 kat (ish klubi shumësportesh Partizani) vol 17 faqa 242. Pasuri në bashkëpronësi me familjen Saliaga; Pas nr. 3/178 ND ZK 8220 sip 195 m2, përshkrim objekt 1 kat (ish Klubi shumësportesh Partizani) vol 17 faqa 147. Pasuri në bashkëpronësi me familjet Saliaga dhe Begeja; Pas nr. 3/179 ND ZK 8220 sip 240 m2, përshkrim objekt 1 kat (ish Klubi shumësportesh Partizani) vol 17 faqa

248 . Pasuri në bashkëpronësi me familjet Saliaga e Begeja; Pas nr. **3/189 ND**, ZK 8220 sip 494 m2 vol 19 faqa 236. Në bashkëpronësi me familjet Begeja, Saliaga, Vaqarri, Alimehmeti; Pas nr. **3/190 ND**, ZK 8220 sip 25 m2 vol 19 faqa 237. Në bashkëpronësi me familjet Begeja, Saliaga, Vaqarri, Alimehmeti; Çdo pasuri tjetër ndërtesë që mund të ndodhet mbi trojet e familjes Llagami ku Adnani ka qenë bashkëpronar por pjesët e tij takuese i ka transferuar nëpërmjet kontratave të shitblerjes tek persona të tretë, konkretisht për shkatërrimin e ndërtesave që ndodhen mbi pasurite:

1. Pasuri nr. **3/188** vol 19 faqa 235 ZK 8220, me sip 2 280 m2. Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr pasurie 3/189 ND vol 19 faqa 236
2. Pasuri nr. **3/194** vol 21 faqa 236 ZK 8220 me sip 760 m2 vol 21 faqa 236. Mbi këtë truall ndodhet objekti me nr pas 3/173 vol 17 faqa 242

Pala pronare deklaron gjithashtu se, nëpërmjet kësaj kontratë jep **pëlqimin për përfshirjen në zhvillim edhe të pasurisë me nr. 3/182 ZK 8220** me sip 315 m2 vol 18 faqa 1 e cila është blerë nga shoq Kontakt sh.p.k. gjatë privatizimit të ish klubit Partizani dhe për të cilën nuk ka pretendime përfitimi apo pronësie dhe i jep të drejtën palës sipërmarrëse që të prishë çdo ndërtesë të ndodhur mbi këto pasuri.

355. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 1194 rep nr. 498 kol datë **24.05.2019**, shtetësja **Ermira Rizvanolli** në cilësinë e palës pronare dhe shoq Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës Sipërmarrëse si dhe **pëlqimdhënës shoq Homeplan sh.p.k.** e përfaqësuar po nga administratori Fatmir Bektashi, kanë lidhur kontratë, me objekt ndërtimi i një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë e llojit truall sipas vërtetimeve të pronësisë të lëshuara nga ZVRPP Tiranë: Pasuri me nr. **3/155 ZK 8220** sip trualli 660 m2 vol 15 faqa 185, lloji truall, rruga Ndre Mjeda inskriptuar në favor të shoq Homeplan sh.p.k. dhe Pasuri me nr. **3/182 ZK 8220** me sip 315 m2 lloji truall vol 18 faqa 1 në bashkëpronësi me familjen Saliaga dhe Llagami. Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në truallin e vënë në dispozicion si më sipër, nga pala pronare, një objekt rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente në pëpruthje me pëlanin urbanistik të miratuar nga Bashkia e Tiranës. Me qëllim zhvillimin e kompleksit rezidencial. Pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e të gjithë ndërtesave që ndodhen në truallin objekt zhvillimi ...citon 4 pasuri...dhe çdo ndërtesë tjetër që ndodhet mbi truallin objekt zhvillimi. Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërpërmendur të vënë në dispozicion **25% të sip ndërtimore** që do të zhvillohet mbi pasuritë objekt i kësaj kontrate...

356. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 1377 rep nr. 539/1 kol dt **05.06.2019** para noteres Laura Pustina, rezulton se trashëgimtarët e të ndjerit **Meriban Kadiu shtetasit Fatbardha Kadiu, Edlira Xhija dhe Blerina Jorgji** në cilësinë e palës pronare, kanë lidhur kontratë me shoqërinë Kontakt sh.p.k. në cilësinë e palës sipërmarrëse dhe me pëlqimdhënës shoqërinë Homeplan sh.p.k. përfaqësuar dy shoqëritë nga adminsitatori Fatmir Bektashi. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë e llojit truall sipas vërtetimeve të pronësisë të lëshuara nga ZVRPP Tiranë: Pasuria me nr. **3/155 ZK 8220** me sip trualli 660 m2 vol 15 faqa 185, lloji truall, rruga Ndre Mjeda, inskriptuar në favor të shoq Homeplan sh.p.k. dhe Pasuri me nr. **3/182 ZK 8220** e sp 315 m2, lloji truall vol 18 faqa 1 në bashkëpronësi me familjen Saliaga dhe Llagami, me qëllim zhvillimin e kompleksit rezidencial. Pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e të gjithë ndërtesave që ndodhen në truallin objekt zhvillimi ...citon 4 pasuri....dhe çdo ndërtesë tjetër që ndodhet mbi truallin objekt zhvillimi. Sipas n 3, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si komepnsim për trojet e sipërpërmendura të vëna në dispozicion **25 % të sip ndërtimore**...

357. Me kontratën e sipërmarrjes me nr. 1421 rep nr. 558 kol dt **10.06.2019** shtetasit *Ariana, Lorina dhe Arba Bektashi*, në cilësinë e palës pronare kanë lidhur kontratë me shoq **Kontakt sh.p.k. dhe pëlqimdhënës shoqërinë Homeplan sh.p.k.** të dyja këto shoq të përfaqësuara nga administratori Fatmir Bektashi. Objekt i kësaj kontrate është ndërtimi i objekteve rezidenciale, me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të mirtauar nga Bashkia Tiranë. Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse pasuritë e llojit truall sipas vërtetimeve të pronësisë të lëshuara nga ZVRPP Tiranë: Pasuria me nr. **3/155 ZK 8220** me sip trualli 660 m² vol 15 faqa 185, rruga Ndre Mjeda, inskriptuar në favor të shoq Homeplan sh.p.k.dhe Pasuri me nr. **3/182 ZK 8220** sip 315 m², lloji truall vol 18 faqa 1 në bashkëpronësi me familjen Saliaga dhe Llagami, me qëllim zhvillimin e kompleksit rezidencial. Pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e të gjithë ndërtesave që ndodhen në truallin objekt zhvillimi me nr pasurie ...citon 4 pasuri...dhe çdo ndërtesë tjetër që ndodhet mbi truallin objekt zhvillimi. Sipas n 3, pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për trojet e sipërpërmendura të vëna në dispozicion **25 % të sip ndërtimore...**

358. Raporti për projektin e strukturave rezulton të jetë përgatitur nga Leal – CSE sh.p.k. për Phoenix – strukturë banimi dhe shërbime 5, 7 kate me 1 kat parkimi nëntokë, mban datën 27.12.2018.

Deklarimi i shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja si bashkëortakë

359. Viti 2018, është një vit vendimtar ku pas përpjekjeve në vitet 2015, 2016, 2017 për përgatitjen e alternativave të deklaramit të shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja në marrëdhënie me shoqërinë Homeplan sh.p.k. por pa u arritur konkluzioni se si do të mund të bëhej ky deklaram dhe justifikohet marrja prej tyre e përfitimeve nga shoqëria Homeplan sh.p.k., duket se rimendohen sërish disa variante. Një variant është përjashtimi nga tërësia e kësaj sipërmarrje e shtetasit Xhimi Begeja dhe një variant tjetër, që është edhe ai që zyrtarizohet, është prezantimi i shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja si bashkëortakë të shoqërisë Homeplan sh.p.k. që në vitin 2014.

360. Në një bllok me ngjyrë të zezë, sekuestruar tek studio Pustina me mbishkrimin “2018” konstatohet në faqen 20 janar 2018 shënimi: “**250 K Xh.B.**” dhe paraqitja e një skeme me tre rathë.

Në të njëjtin bllok konstatohet ndër të tjera shënimi i bërë më datë 02 mars 2018 si vijon:
“*Homeplan i ri. Të sistemohet bordi i A prej 250 000 lekë. Të shihet mundësia e largimit të Xh. Pas blerjes së kuotave nga A dhe të futet në ... (palexueshëm) A + F, 50 + 50”.*

Tek i njëjti bllok në faqen e datës 05 prill 2018, konstatohet:

H.P. Pronar trualli ARA ... (i palexueshëm).

Me përafërsi 9000 m²

Abi me përfaqësi 1000 m².

Paraqitet një skemë e tokës ku evidentohen emrat e familjeve Saliaga dhe Llagami.

Hompelan të marrë 1000 m.

2500-3000

K.S. Shtesë kontrate me pronarët e truallit për Ara-n pjesa 8 katëshe

Pjesa e 11 katësh pub + gym të bëhet me blerje

HP – Abi do blejë të gjithë tokën tek Saliaga për HP në këmbim të 8 kat ARA

Xhim – kontratë këmbimi

(e palexueshme) Dividenti: (e palexueshme) për Sant Clear

Zhaneta (10 000 lekë)

Vijon në faqen e datës 06 prill 2018...e palexueshme...

Në faqen 14 prill 2018 gjendet shënimi në formë tabelore
C.C. (me shigjetë që tregon shenjën ardhur) nga IMO 2 200 E – Me shigjetë që tregon ardhur nga ABI. Në krah është shënimi 1 000 m2.

“SDT...ka shënime në shifra

Në fletën e datës 15.04.2018 është paraqitur një grafik që duket sikur pasqyron tokë dhe poshtë shënimet

“1) këmbim 2000 m2

2) H 1000

3) Blerje/DIV”.

Në faqen e datës 27 maj 2018 gjenden shënimet:

“...200 000 euro Xhimi si dividend...”

Në faqen e datës 10.11.2018 gjenden shënimet si vijon:

“ABI QKR...

....(e palexueshme) i QKR-së.

Deklaratat e tatimeve DIVA – 2011

Raporti i kontrollit Pastrimit të Parave

Raporti i kontrollit tatimor 1+2

Alma Balilo...”

Në bllokun me ngjyrë të zezë të sekuestruar tek Studio Pustina me mbishkrimin “2018” konstatohen në faqen e datës 3 mars 2018 është bërë shënimi “...Hua e Xhimit.....etj.”

361. Me autorizimin nr. 5653 prot datë **21.12.2018** shtetasi Fatmir Bektashi, autorizon punonjëset e tij, që të depozitojnë dokumentat pranë QKB-së për **ndryshimin e ortakërisë së shoqërisë**. Konkretisht rezulton se depozitohet vendimi i ortakut të vetëm, datë **23.01.2014**, me të cilin është vendosur shitja e 35% e pjesmarrjes së shoqërisë Homeplan sh.p.k. në zotërim të ortakut Fatmir Bektashi përkatësisht shtetasit Jamarbër Malltezi dhe shitjen e 25 % të pjesëmarrjes së shoqërisë Homeplan sh.p.k. përkatësisht Xhimi Begeja. Ky vendim është nënshkruar edhe nga Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja.
Megjithëse ky vendim i refohet datës 23.01.2014, është depozituar vetëm në vitin 2018 në QKB.

Gjithashtu në QKB është dorëzuar edhe kontrata e shitjes datë **23.01.2014** ku shtetasi Fatmir Bektashi pasi është dhënë edhe pëlqimi nga bashkëshortja e tij Aneta, i shesin shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja përqindjet respektive. Në këtë kontratë pasqyrohet se palët, kanë lidhur midis tyre, një akt marrëveshje për pjesmarrje në investim nr. 3000 rep nr. 1782 kol datë 02.10.2008 para noteres Laura Pustina, ku kanë përcaktuar në parim, pjesmarrjen e tyre në investimin për realizimin e kompleksit të godinave, në truallin siç më saktë në **nenin 2 të shtojcës 1 të akt marrëveshjes për pjesmarrje në investim nr. 3193 rep nr. 1891 kol datë 15.10.2008.**

Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, 35% e pjesmarrjes së zotëruar nga ortaku Fatmir Bektashi t'i shiten blerësit Jamarbër Malltezi për vlerën prej 35 000 lekë, çmim i cili është shlyer tërësisht

midis palëve dhe 25 % të pjesmarrjes i shiten blerësimi Xhimi Begeja, për vlerën prej 25 000 lekë.

Kjo kontratë mban nënshkrimin e të gjithë palëve por nuk është bërë para ndonjë noteri.

Me vendimin e asamblesë së ortakëve, tashmë nënshkruajnë të tre ortakët, datë 30.06.2019 është miratuar bilanci i vitit 2018 me fitim 130 701 619 lekë dhe i shpërndahet ortakëve si dividend sipas përqindjes së pjesmarrjes së tyre në kapital. Gjithashtu kanë vendosur që të shpërndajnë fitimet e akumuluarra deri më 31.12.2018 konkretisht shumë prej 189 675 318 lekë si dividend ortakëve të shoqërisë sipas përqindjes së pjesmarrjes së tyre në kapital.

Subjekti Homeplan ka shpërndarë Divident në vitin 2018 në vlerën 204,954,000 lekë, sipas deklaratave tatimore.

361.1. Vendosja e muajit janar 2014 si kohë e realizimit të kësaj shitje, nga tërësia e provave të administruara rezulton se tregon një kohë të rreme.

Shitja e mësipërme, përveç faktit se nuk është deklaruar për shumë vite, pasi, vetëm me autorizimin nr. 5653 prot datë 21.12.2018 shtetasi Fatmir Bektashi autorizon punonjëset e tij që të depozitojnë dokumentat pranë QKB-së për ndryshimin e ortakërisë së shoqërisë, rezulton se deri në vitin 2018, shtetasi Fatmir Bektashi ka vijuar të nënshkruajë të gjitha aktet e shoqërisë si ortak i vetëm i shoqërisë. Madje, jo vetëm shtetasi Fatmir Bektashi është paraqitur si ortak i vetëm por kështu është pranuar dhe deklaruar edhe në aktet kur ka përfaqësuar shoqërinë Homeplan sh.p.k. si kontrata, të lidhura me vetë shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja.

361.2. Gjithashtu, nga kqyrja e aktit të ekspertimit të hard drive-it të jashtëm të gjendur në studion Pustina, rezulton i ruajtur dokumenti "*Praktika e shitjes së pjesmarrjes*" ku gjendet vendimi i ortakut dhe kontrata e shitjes. **Ky dokument rezulton të jetë krijuar më datë 21.09.2018 me autor Laura dhe të jetë printuar po më datë 21.09.2018.**

Gjithashtu po nga ky ekspertim është gjendur i ruajtur dokumenti në Word me emërtimin "*Homeplan-shitje kuotash*" ku gjendet i përpiluar draft vendimi i ortakut (pa datë) për shitjen e kuotave me datë krijimi 05.10.2017, datë e ruajtjes 06.10.2017 dhe datë e printimit 24.05.2017.

Po nga ky ekspertim, është gjendur i ruajtur dokumenti me datë krijimi 05.10.2017, datë printimi 06.10.2017 dhe datë ruajtje për herë të fundit 23.10.2017 me autor dhe ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi "*Laura*" dokumenti me emërtimin "*Kontratë shitje Homeplan*". Në këtë dokument në formatin Word, gjendet kontratë shitje e datës 20.02.2015 mes shitësit Fatmir Bektashi dhe blerësve Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Pra në ndërthurje të gjithë situatës së sipërcituar, rezulton si edhe janë pasqyruar nëpër dokumenta të ndryshme, se janë bërë përpjekje ndër vite për të justifikuar shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja në vjeljen e përfitimeve nga shoqëria Homeplan sh.p.k. por deri në fund të vitit 2018 nuk ishte gjetur forma si do të bëhej ky prezantim.

Risjellim edhe një herë në vëmendje shënimet e gjendura në një bllok me ngjyrë të zezë, sekuestruar tek studio Pustina me mbishkrimin "*2018*" në faqen 20 janar 2018: "*250 K Xh.B.*" dhe paraqitja e një skeme me tre rathë. Në të njëjtin bllok konstatohet ndër të tjera shënimi i

bërë më datë 02 mars 2018 si vijon: "Homeplan i ri. Të sistemohet bordi i A prej 250 000 lekë. Të shihet mundësia e largimit të Xh. Pas blerjes së kuotave nga A dhe të futet në ... (palexueshëm) A + F, 50 + 50".

361.3 Për më tepër, sjellim në vëmendje se shtetasi Fatmir Bektashi ka shitur kuotat në vlerë të papërfillshme krahasuar me fitimet që shoqëria kishte akumuluar deri në vitin 2014 kur edhe pretendohet se realisht janë bërë ortakë shtetasit Malltezi dhe Begeja.

361.4 Shtetasi Xhimi Begeja i pyetur përgjatë hetimit ka dhënë disa deklaramë në lidhje me përfshirjen e tij në shoqërinë Homeplan:

Më datë 27.02.2022, shtetasi Xhimi Begeja, ka deklaruar se: ... shoqëria Homeplan u formua në fillim në bazë të pjestarëve të familjeve që janë pronarë të investimit, në territorin e ish klubit Partizani. Shoqëria Homeplan ishte shoqëria investitore në lidhje me ndërtimet që do të kryheshin në territorin e ish sport klub Partizani. Secila familje vuri lekë aq sa kishte mundësi me qëllim kryerjen e këtyre investimeve. Dokumentat në lidhje me lekët që ka vënë secila familja janë tek shoqëria. Mesa më kujtohet nga viti 2008 – 2009 unë kam blerë kuota të shoqërisë por nuk e mbaj mend sa lekë kam dhënë pasi pagesa në fakt nuk është thjesht me lekë cash por edhe me pjesë takuese të pronave. Administrator i kësaj shoqërie është Fatmir Bektashi dhe letrat mund t'i kërkonte tek ai. Ndërkohë që prona zhvillohej familjet që investuan pjesë pjesë kanë marrë edhe pjesë takuese në bazë të vlerës së investimit dhe të pjesës së truallit që i takonte. Aktualisht prona është ende në zhvillim. Tjetër gjë nuk kam për të thënë. Të gjitha janë të dokumentuara në tatime, në banka. Janë kryer të gjitha veprimet sipas ligjeve të shtetit.

Më datë 18.07.2022, shtetasi Xhimi Begeja deklaroi se: ...jam ortak tek shoqëria Homeplan por nuk e mbaj mend datën e saktë dhe kuotat e sakta që i kam blerë dhe as nga kush i bleva. Dua të shoh letrat pastaj do përgjigjem dhe për këtë arsye më lini një datë tjetër për deklaramë...

Më datë 25.09.2023 shtetasi Xhimi Begeja deklaroi se: ... Babai im Haki Begeja, më dha të drejtën mua, verbalisht që të punoja dhe të investoja në pronën e familjes Begeja. Me shoqërinë Homeplan unë, Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi kemi hyrë në një marrëveshje, në vitin 2008 për zhvillimin e pronës, në bazë të përqindjeve ku unë do investoja me 25%. Lekët që do vija unë ishin kursimet e mia, kredi që morëm në bankë, administratori i kompanisë që ishte Fatmir Bektashi dhe investimi vazhdoi në bazë të shitjeve gjatë punës. Nuk më kujtohet se sa lekë kam futur nga kursimet e mia por ishin gjëra të vogla.

I pyetur nëse ka investuar në shoqërinë Homeplan dhe nëse disponon ndonjë dokument, shtetasi Xhimi Begeja përgjigjet: ... Unë vetë kam paguar lekë për blerjen si rrjedhojë e privatizimit të objekteve, dhe më pas në shoqërinë Homeplan kam bërë investimin vetëm referuar shitjes së apartamenteve që më takonin, pra vlerat që merreshin nga këto shitje shkonin për llogari të investimit. Ne kemi investuar që kur kemi hyrë në shoqëri në vitin 2008 por jemi bërë ortakë të shoqërisë Homeplan, unë dhe Jamarbëri, në vitin 2014, pasi ashtu ishte ligji, por nuk e di se cili ligj. Në muajin qershor 2023 unë kam dalë nga shoqëria Homeplan, kuotat ia shita Jamarbërit dhe Fatmirit, por nuk e di në çfarë vlere. Tërhoqa dividend rreth 500 000 (pesëqind mijë) euro. Paratë për shitjen e kuotave m'i kanë hedhur në bankë. Unë kam gjithsej 7 – 8 njësi në pronat në të cilat kemi investuar. Në lidhje me trashëgiminë sqaroj se babai im Hakiu ka përfutur nga trashëgimlënësi Xhemal Begeja. Xhemali ka lënë katër fëmijë e konkretisht Hakiun, Nusretin, Jalldizin dhe Nimetin. Kurse Mahmut Begeja ka pasur si

trashëgimtarë Mehmet, Osman, Muratin, Meleqen dhe Hamitin. Nesër do t'ju sjell disa dokumenta që lidhen me pronësinë tonë.

Më datë 25.09.2023 është pyetur shtetasi **Xhimi Begeja** cili ka deklaruar dhe dhënë sqarime në lidhje me ortakërinë e tij në shoqërinë Homeplan shpk si vijon: *Babai im Haki Begeja, më dha të drejtën mua, verbalisht që të punoja dhe të investoja në pronën e familjes Begeja. Me shoqërinë Homeplan unë, Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi kemi hyrë në një marrëveshje, në vitin 2008 për zhvillimin e pronës, në bazë të përqindjeve ku unë do investoja me 25 %. Lekët që do vija unë ishin kursimet e mia, kredi që morëm në bankë, administratori i kompanisë që ishte Fatmir Bektashi dhe investimi vazhdoi në bazë të shitjeve gjatë punës. Nuk më kujtohet se sa lekë kam futur nga kursimet e mia por ishin gjëra të vogla.*

I pyetur në lidhje me faktin se nëse ka bërë derdhje apo jo në llogari të shoqërisë Homeplan Nr. 422233578, referuar parashtrimin në akt marrëveshjen marrëveshjen nr. 3000 rep nr. 1783/1 kol datë 02.10.2008 shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar.. *“... U shitën apartamentet e para që u ndërtuan me lekët e klientëve dhe pas vitit 2014 kemi marrë dividendët. Kam hedhur lekë në këtë llogari nga shitjet. Lekët i kam hedhur nëpërmjet kompanisë Homeplan. ...”.*

Në lidhje me faktin se përse nuk rezulton bashkëortak në shoqërinë Homeplan sh.p.k. që në fillimet e veta deklaroi se: *...Unë jam bashkë me Jamarbërin investitorë të shoqërisë Homeplan, pa qenë e nevojshme të jemi ortakë të kësaj shoqërie. Në vijim, kemi vlerësuar të futemi si bashkëortakë me Fatmir Bektashin në shoqërinë Homeplan. Për këtë arsye kemi blerë kuota në vitin 2014, nuk e di sa lekë i kam blerë dhe nuk e di pse në QKB janë pasqyruar në vitin 2018. Andia Pustina ka qenë kryefinanciaerja e kësaj pune dhe të tre ne, pra unë, Jamarbëri dhe Fatmiri i mbanim kontaktet me njëri tjetrin dhe me Andian...*

Zhvillimi i mëtejshëm i ndërtimeve

362. Me raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis shtojca II, pika 10 nënpika B, për objektin “Phoenix” strukturë 5 dhe 7 kate banimi, shërbim dhe me 1 kat parkim nëntokë, në rrugën Frosina Plaku, njësia strukturore TR/385 Bashkia Tiranë, investitor Kontakt sh.p.k. që mban si periudhë përpilimi dhjetor 2018 – janar 2019, e nënshkruar elektronikisht nga eksperti i licencuar Fatjona Levani, vlerësues i ndikimit në mjedis dhe auditues mjedisor më datë **20.02.2019**, parashtrohet se projekti Objekti Phoenix është pranë zonës së njohur me emrin njësia strukturore 3/385.

Zhvilluesi Kontakt sh.p.k. synon të zbatojë këtë projekt që do të ndërtohen sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. 1742 rep nr. 858/1 kol datë 12.08.2013 dhe me nr 3080 rep nr. 1043/2 kol datë 24.11.2018 me subjektin ndërtues Kontakt sh.p.k., që do të kryejë punime konstruktive të objektit dhe punimet e rifiniturës të objektit Phoenix, strukturë 5 dhe 7 kate banim, shërbim dhe me 1 kat parkim nëntokë, rruga Frosina Plaku, sipas studimit të realizuar nga grupi projektues i vetë kompanisë Kontakt arkitekthe Ardita Gusho e kontraktuar nga zhvilluesi/investitori.

Sip e tokës që zhvillohet 840 m², sip e tokës e zënë nga struktura 387.5 m², nr i kateve mbi tokë 5 – 7, nr i kateve nëntokë 1.

Me Vendimin për VNM paraprake nr. 1328 prot datë **11.03.2019**, e lëshuar nga Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor, pasqyron se AKM pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar për

zhvilluesin Kontakt sh.p.k. për të zhvilluar strukturë 5 dhe 7 kate banimi dhe shërbimi me 1 kat parkimi nëntokë, me sipërfaqe 840 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 387.5 m².

363. Me aplikimin për leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m², rezulton se shtetësja Ardita Gusho për llogari të shoqërisë Kontakt sh.p.k. ka aplikuar për leje ndërtimi, për objektin e identifikuar si Phoenix, në pasuritë nr. 3/158 vol 15 faqa 172 me sipërfaqe 180 m² dhe nr. 3/155 vol 15 faqa 185 me sipërfaqe 660 m². Relacioni i projektit arkitektonik për Objektin Phoenix strukturë 4, 5, 6 dhe 7 kate banim, shërbim dhe me 1 kat parkim nëntokë në rr. Frosina Plaku, njësi strukturore TR/385 mban datën 25.07.2019.

364. Me shkresën nr. 14505 prot datë 29.05.2019 të Drejtorisë Ekonomike Bashkia Tiranë, pasqyrohet se subjekti Kontakt sh.p.k. ka kryer pagesën e tarifës për shqyrtimin e kërkesës për leje punime sipas autorizimit me nr prot A – 11536/2 më datë 23.05.2019 me Union Bank, më datë 27.05.2019 në vlerën 956 325 lekë.

365. Me vendimin nr A-10845/3 prot datë 28.06.2019 nga Kryetari i Bashkisë është miratuar kërkesa për shtyrje të afatit të lejes zhvillimore ndërtimi, miratuar me vendimin nr 8427/8 datë 18.09.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për kompleksin Magnet...

366. Megjithatë shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja pretendojnë se janë bërë ortakë të kësaj shoqërie që në vitin 2014, vetëm pas deklarimit në QKB nisnin e lëshojnë akte përfaqësimi në lidhje me aktivitetin e saj apo të nënshkruajnë vendimet e kësaj shoqërie.

366.1. Me prokurën e posaçme nr 1845 rep nr 717 kol datë 23.07.2019 para noteres Laura Pustina, shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Xhimi Begeja në cilësinë e ortakëve të shoq Homeplan sh.p.k. autorizojnë shtetasin Fatmir Bektashi për të kryer një sërë veprimesh si pranë bankave etj. Sjellim në vëmendje se këta shtetas që pretendojnë se kanë qenë ortakë të shoqërisë që në vitin 2014, vetëm në vitin 2019 kujtohen t'i japin prokurë shtetasit Fatmir Bektashi.

366.2. Me vendim të asamblesë së ortakëve të shoq Homeplan sh.p.k. datë 29.07.2019, Fatmir Bektashi, Jamarbër Malltezi, Xhimi Begeja, është vendosur: Garantimin në cilësinë e dorëzanësit të kredisë në formën e huasë, overdraft-it, garancisë, letër kredisë, etj deri në shumën totale (limitin kreditor) prej 1 000 000 (vetëm një milionë euro) që do të merret nga Kontakt sh.p.k. pranë Union Bank sh.a. Autorizohet Fatmir Bektashi që në emër dhe për llogari të shoq Homeplan sh.p.k. në cilësinë e dorëzanësit të nënshkruajë kontratën e kredisë/overdrasfitit të cituar në pikën 1 dhe çdo dokument që lidhet me të.

Gjithashtu, pas miratimit të lejes si më poshtë cituar, me prokurën e posaçme me nr 1969 rep nr 767 kol datë 07.08.2019 të përfaqësuarit Jamarbër Malltezi, në cilësinë e ortakut me pjesëmarrje në masën 35% të kapitalit të shoq Homeplan sh.p.k., Xhimi Begeja me cilësinë e ortakut me pjesëmarrje në masën 25% të kapitalit të shoq Homeplan sh.p.k.caktojnë si përfaqësues të tyre në cilësinë e ortakëve të shoq Homeplan sh.p.k.ortakun dhe administratorin e shoq Homeplan sh.p.k. Fatmir Bektashi...për të kryer një sërë veprimesh të ndryshme si nënshkrim kontratash, të paraqitet pranë çdo banke për të hapur llogari për shoqërinë Homeplan etj, të aplikojë për kredi, marrje kredie, për në depozitim QKB, ASHK etj.

367. Me shkresën nr. 1995 prot datë 01.08.2019 shoqëria Kontakt, shtetasi Fatmir Bektashi ka depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit të Territorit Bashkia Tiranë, në vijim të procesit të aplikimit me nr AN140520190100 për leje ndërtimin dokumentacion shoqëruar

e konkretisht kartelë dhe hartë treguese për pasurinë me nr. 3/155 dhe 3/158. (Struktura Phoenix).

368. Me vendimin nr. A – 11536/7 nënshkruar nga kryetari i bashkisë Erjon Veliaj më datë **06.08.2019**, "Për miratimin e lejes së ndërtimit për Godinë banimi dhe shërbime 4, 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë në rrugën Frosina Plaku dhe Ndre Mjeda, NjA nr. 7" në pronë të familjes Bekteshi, Begeja, Kadiu, dhe Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Gentian Hoxha, Ermira Rizvanolli, Alida Maci, Nervit Hoxha, Lirije Lika Sanie Velo, Ajete Sulstarova, Myzejen Aga, Elona Grabova, Merita Kallajxhi, Lumturi Çela, Teuta Malka, Fatbardha Marika, me zhvillues **Homeplan sh.p.k., Kontakt sh.p.k., Magnet Imo sh.p.k. dhe subjekt ndërtues Kontakt sh.p.k.**

Është vendosur:

1. Të miratojë leje ndërtimit për "Godinë banimi dhe shërbime 4, 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkimi nëntokë në rrugën Frosina Plaku dhe Ndre Mjeda, në Njësinë strukturore 7/25 (TR/385) NjA nr. 7 në pronë të familjes Beteshi, Begeja, Kadiu, dhe Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Gentian Hoxha, Ermira Rizvanolli, Alida Maci, Nervit Hoxha, Lirije Lika Sanie Velo, Ajete Sulstarova, Myzejen Aga, Elona Grabova, Merita Kallajxhi, Lumturi Çela, Teuta Malka, Fatbardha Marika, me zhvillues Homeplan sh.p.k., Kontakt sh.p.k., Magnet Imo sh.p.k. dhe subjekt ndërtues Kontakt sh.p.k. ...
2. Afati i lejes së ndërtimit është 24 muaj...
3. Zhvilluesi/subjekti sipas marrëveshjes ndërmjet tyre autorizohet të kryejë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 16 215 960 lekë.

368.1. Me lejen e ndërtimit nr. prot A – 11536/9 nënshkruar elektronikisht nga Kryetari i Bashkisë Erion Veliaj, më datë **17.08.2019**, miratuar me vendim të kryetarit të Bashkisë Nr. A – 11536/7 datë 06.08.2019 me zhvillues shoq **Kontakt sh.p.k., Magnet Imo sh.p.k., Homeplan sh.p.k.; subjekt ndërtues shoqëria Kontakt sh.p.k.**, jepet leje ndërtimi për objektin: Godinë banimi dhe shërbime 4, 5, 6 dhe 7 kat, me 1 kat parkimi nëntokë, në pronë të familjeve Bekteshi, Begeja, Kadiu dhe Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Gentian Hoxha, Ermira Rizvanollim, Alida Maçi, Nervit Hoxha, Lirije Lika, Sanie Velo, Ajete Sulstarova, Myzejen Aga, Elona Grabova, Merita Kallajxhi, Lumturi Çela, Teuta Malka, Fatbardha Marika, me adresë realizimi punimesh Rruga Frosina Plaku, Ndre Mjeda, NjA nr. 7, afati kohor 24 muaj, me sip truall qe zhvillohet 840 m2, sip e truallit të zënë nga struktura 388 m2, nr i kateve mbi tokë 4, 5, 6 dhe 7 kat, nr i kateve nëntokë 1 kat, lartësia e strukturave 24.33 m. Kjo leje është e vlefshme për një periudhë 24 mujore nga data e lëshimit të saj.

369. Rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. ndërmerr veprime për largimin e shtetasit Xhimi Begeja, duke përllogaritur dhe mbajtur parasysht pretendimet e tij në lidhje me përfitimet që i takojnë për kontributin që ai ka dhënë në zhvillimin e ndërtimeve (pasur parasysht edhe çfarë është relatuar).

Kështu, me kontratën e huasë nr 2266 rep nr 895 kol dt **24.09.2019**, para noterës Laura Pustina, të lidhur mes Shoq Homeplan sh.p.k. (huadhënësi) dhe shtetasit Xhimi Begeja (Huamarrësi), pasqyrohet sa vijon: Neni 1....Me anë të kësaj kontrate huadhënësi do i japë huamarrësit një hua një shumën euro 167 560 e cila do të përdoret për qëllimet e mëposhtme:
1. Shuma euro 135 000 do të transferohet nga llog bankare e huamarrësit në llog bankare pranë Union Bank sh.a. të mbesës së tij Marsida Shehu me qëllim që kjo e fundit të likujdojë plotësisht shoq Homeplan sh.p.k. për vlerën e ap nr 156 të ndodhur në strukturën BA

(Eridanus), kompleksi Magnet të prenotuar prej saj dhe bashkëshortit Gentian Shehi sipas kontratës së sip nr 1951 rep nr 643 kol datë 03.07.2017⁷

2. Shuma prej euro 30 000 do të përdoret nga huamarrësi për arsye shëndetësore

3. Shuma prej euro 2 560 do të përdoret nga huamarrësi për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe aktuale të kontratave të furnizimit me ujë nga UKT dhe kontratave të furnizimit me energji elektrike nga OSHEE sh.a. që figurojnë në emrin e tij sipas listës bashkalidhur...shuma e huasë do të lëvrohet me këste në llogarinë bankare të huamarrësit pranë Union Bank sh.a. deri më datë 27.09.2019.

Kontrata e huasë do të jetë pa interes e mbështetur mbi bazën e ortakërisë që palët kanë në biznes, duke qenë se huamarrësi është ortak në masën 25% të kapitalit të huadhënësit shoq Homeplan sh.p.k.

Neni 3. Vlera e dhënë hua prej euro 167 560 do të shlyhet nga huamarrësi në llog bankare të huadhënësit pranë Union Bank më datë 31.07.2020 pas shpërndarjes së dividendit të vitit 2019 në cilësinë e tij si ortak i shoq Homeplan sh.p.k....

369.1. Duket se përgjatë viteve shtetasi Xhimi Begeja ka ngritur vazhdimisht pretendime në lidhje me pjesën që duhet t'i jepet atij. Nga akti i ekspertimit telefonik të shtetases Andia Pustina janë evidentuar disa emaile, ndër të cilat përmendim sa më poshtë:

Datë 10.07.2021, ora 20:39:53 Nga xhimibegeja@yahoo.com për fatmir.bektashi@kontakt.al; abi.malltezi@gmail.com; begeja1900shpk@yahoo.it; laurapustina@yahoo.com; andiapustina@gmail.com

Subject: Fw: Vendim miratim bilanci 2020

Pershendetje te Gjitheve

Dy fjale per sejcilin nga ne , por ne vecanti per Studion Pustina ku per respekt te bashkpunimit shum vjecar nuk duhet te me anashkalonte pa më njoftuar rreth situates financiare te veprimtarise se Homplan . Une gjithmone ju kam kerkuar qe te me njoftoni ne vija te trasha sa jane sa kan ngelur e si duhet te vazhdojë me te ardhurat e mija nga kjo ortakeri, dhe ka vite qe nuk me eshte dhene informacioni i duhur dhe i plote rreth administrimit te financave te Homeplan. Gjithsesi kur une vazhdoj t'i permbahem parimeve te mija per te nenshkruar vetem "letra te bardha" pse por nuk është etike qe % ime te huazohet pa dijenine time per interes te Kontaktit ne objekte tjera dhe ai te vazhdoje te me jape keste qe te "lepije kockat". Studijos Pustina i besova se do qendronte korrekte ne kete ortakeri tonen te brishte por jo aq sa une tju dukem si send me perqindje te vogel. Ne kete kohe te veshtire te gjithë nga ne kemi halle prandaj si gjithmone kam zgjedh respektin e kok ul por jo perbuzje. Une kerkoj nga ju ballafaqim mqs Abi e Fatmiri jane dhe te diskutojme, por keto ceshtje si me prioritare i kam nxjerre vetem nga bilanci 2020 ;

1-Lista e njesive te pashitura duke pare realitetin ne objekt shikohet qe procesi I ndertimit ka

2- Zeri I aktivitetit nr 7 (tituj te huadhenies) ne vlere 498. 369.436 lek kerkoj informacion te detajuar , kujt ja ka dhene kompania keto leke dhe kontrata perkatese per keto shuma(te pakten per pjesen qe m tako mua) dua nje Informacion analize se kur eshte krijuar kjo llogari deri

3. Zeri nr 13(te ardhura te shtyra) vlere 2.207.881.708 lek .Duke pare realitetin qe objektet

⁷ Sipas kontratës nr 1951 rep nr 643 kol datë 03.07.2017 para noterës Laura Pustina, Gentian Shehi dhe Marsida Shehi kanë blerë ap 230.8 m2 dhe i gjithë çmimi është 135 000 euro.

jane perfunduar procesi I hipotekimit ka perfunduar si edhe procesi I dorezimit pse nuk kalojne te ardhura te periudhes???????

*Me respekt
Xhimi BEGEJA*

369.1.2. Me kontratën e huasë së zakonshme nr 3422 rep nr 1074 kol datë 13.12.2021 para noteres Laura Pustina, Huadhënës shoq Homeplan sh.p.k., Huamarrës Xhimi Begeja. Sipas kësaj kontrate, Huadhënësi i jep huamarrësit shumën prej 50 000 euro...pa interes apo kusht tjetër të natyrës financiare...Palët deklarojnë se shuma e huasë do t' i dorëzohet huamarrësit me anë të transfertës bankare në llogarinë e indikuar prej tij...

370. Me vendimin nr. 36967/2 datë 04.10.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Erion Veliaj "Për ndryshim të vendimit nr. 39815 datë 25.10.2018 "Për miratimin e fazës I të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore TR/386" ka vendosur:

1. Miratimin e ndryshimit të vendimit nr. 3985 datë 25.10.2018 "Për miratimin e fazës I të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore TR/386" sipas hartës dhe dokumentacionit bashkalidhur pjesë e këtij vendimi....

371. Me vendimin nr. 37483 datë 08.10.2019 Kryetari i Bashkisë Tiranë Erion Veliaj ka vendosur:

1. Miratimin e fazës së dytë të planit të detajuar vendor të nënnjësisë strukturore TR/386_5, sipas kufijve të miratuar me vendimin nr. 39815 datë 25.10.2018 të Kryetarit të Bashkisë për " Miratimin e fazës I të planit të detajuar vendor të njësisë strukturore TR/386" (i ndryshuar)
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, zbardhjen e dokumentacionit përfunditar dhe hartës.
3. Ngarkohet Drejtoria e përgjithshme e planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e këtij vendimi në regjistrin kombëtar të planifikimit të territorit brenda 15 ditëve nga data e miratimit të tij
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në regjistrin kombëtar të planifikimit të territorit.

Bashkalidhur është një hartë Plani i detajuar vendor i njësisë strukturore TR/386 – Faza II / leje zhvillimi nën – njësia 5 e nënshkruar nga kryetari i bashkisë Erion Veliaj.

372. Me raportin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis me emërimin "Struktura Ursa dhe Leo të përbëra nga 5 deri 11 kate banimi dhe shërbimesh dhe me 2 katë parkim nëntokë dhe struktura Sirius e përbërë nga 2 kate kopësht" vendodhja Rruga Frosina Plaku, Njësia Strukturore TR/386 ZK 8220 me subjekt zhvillues dhe ndërtues Kontakt sh.p.k. Ky raport paraprak i vlerësimit të ndikimit në mjedis është hartuar nga studio Green Solution nënshkruar nga administratori Laert Shehu dixhitalisht më datë 11.10.2019 dhe punoi raportin ing Laert Shehu dhe ing Viola Mydini.

Sip e tokës që zhvillohet 9093 m²3, sip e tokës e zënë nga struktura është 2937 m², koeficienti i sfrytëzimit të truallit është 32.3%, nr i kateve mbi tokë është 5 – 11 dhe nr i kateve nëntokë është 2. Strukturat që do të ndërtohen mbi njollën e objekteve ekzistuese që janë prishur në bazë të vendimit nr. A – 9866/6 për miratimin e lejes së ndërtimit për " Prishje të objekteve ekzistuese 1 dhe 2 kat" në rrugën Frosina Plaku dhe shkresës përzhjellëse me lëndë "Mbi verifikimin e prishjes së objekteve ekzistues 1 dhe 2 kat" e nr. 27646/1 prot datë 02.08.2019. Pronat në të cilën do të ndërtohen këto struktura janë të llojit truall dhe konkretisht pronat e ndodhura në ZK 8220:

Nr. pas 3/188 vol 19 faqa 235 truall me sip totale 2280 m²; Nr. pas 3/194 vol 21 faqa 236, truall me sip totale 760 m²; Nr. pas 3/112 vol 12 faqa 202, truall me sip totale 480 m²; Nr pas 3/160 vol 23 faqa 238, truall me sip totale 390 m² nga kjo ndërtesa 130 m²; Nr pas 3/182 vol 18 faqa 1 truall me sip totale 3294 m² nga kjo ndërtesa 1467 m²; Nr pas 3/486 vol 52 faqa 145 truall me sip totale 1574 m²; Ndodhur në Tiranë, rruga Frosina Plaku.

373. Me Vendim për VNM paraprake nr. 5222 prot të muajit tetor 10.2019 e Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor Agjensia Kombëtare e Mjedisit, pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së vendosi që ky projekt nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar për zhvilluesin Kontakt, për të zhvilluar strukturat Ursa dhe Leo të përbërë nga 5 deri 11 kate banim dhe shërbim dhe 2 kate shërbim nëntokë si dhe struktura Sirius e përbërë nga dy kate kopësht, vendodhja rruga Frosina Plaku, Njësia Strukturore TR/386 ZK 8220 Bashkia Tiranë.

374. Me aplikimin për leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sip më të madhe se 250 m² të bërë nga shtetësja Ardita Gusho, më datë 13.11.2019, për ndërtim në pasurinë me nr. 3/182 vol 18 faqa 1, sip e parcelës 315 m², lloji i pronësisë truall, që nuk ka ndërtesa mbi këtë pasuri, pasqyrohet se emërtimi i objektit është struktura Ursa dhe Leo të përbërë nga 5 deri 11 kate banim dhe me 2 kate parkim nëntokë dhe struktura Sirius e përbërë nga 2 kate kopësht, rruga Frosina Plaku njësia strukturore TR/386 Tiranë. Sip e tokës e zënë nga struktura 2937 m², sip e përgjithshme e ndërtimit mbi tokë 29260 m², nr i katevemi tokë 11 dhe nr i kateve nën tokë 2, përdorim i përzier, banim dhe kopësht 2 kate. Në lidhje me dokumentat e pronësisë janë renditur çertifikatat e pronësisë për pasuritë e llojit truall me nr. 3/188 Llagami; 3/194 Llagami; 3/112 Saliaga; 3/160 Saliaga; 3/486 Saliaga; 3/215 Saliaga; 3/182.

375. Shtetaset Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin, të përfaqësuara nga shtetasi Maksim Begeja, i shesin disa pasuri të tjera shtetasit Jamarbër Malltezi.

375.1. Kështu lidhet kontratë shitje pasuri e paluajtshme, nr.rep. 2539, nr.kol. 981 datë 22.10.2019, para noteres Laura Pustina, ndërmjet: *Shitës shtetasve Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin (Pala shitëse), të përfaqësuara nga Maksim Begeja (me prokurë të datës 03.05.2009), dhe Jamarbër Malltezi (Pala blerëse dhe njëkohësisht edhe bashkëpronar me 2/315 pjesë) dhe Shoqëria Kontakt shpk (Pëlqimdhënësi), me objekt shitjen e pjesëve të pandara takuese në truallin në bashkëpronësi, me nr. Pasurie 3/182, vol.18, fq.1, zk.8220, me sipërfaqe totale prej 315 m², ku është rënë dakord që blerësi të blejë 5.25 m² pjesë takuese të shitësve (secili nga 1.75 m²) për shumën monetare prej 1 050 Euro (pra i ble secilës të gjithë pjesën që zotërojnë nga 2/135 pjesë). Çmimi është rënë dakort që të jetë 200 euro për m². Bashkalidhur kësaj kontrate është edhe urdhër pagesa për shumën 1050 euro datë 17.11.2019.*

375.2. Me kontratën nr. 295 rep nr. 61 kol datë 05.02.2020 para noteres Laura Putina, shitësit Graziella Begeja, Vera Graboëski, Margaret Irëin, përfaqësuar nga Maksim Begeja, me prokurë të datës 03.05.2009, i shesin blerësit Jamarbër Malltezi (gjithashtu edhe bashkëpronar me 27/576 pjesë), pjesën e tyre në pasurinë me nr. 12/139 ZK 8310 me sip të përgjithshme 880 m², vol 20 faqa 170, në adresën ish objekti Pishina Laprakë ndodhur në rrugën e Durrësit, konkretisht nga 4.89 pjesë ose 14.67 m², me 200 euro për m² ose në total 2 934 euro ose nga 978 euro secili.

Këto shtetase janë bashkëpronare secila me nga 5/580 pjesë ose 4.89 m² dhe e shesin gjithë pjesëne tyre takuese.

376. Shtetësja Nervit Hoxha (nëna e shtetasit Gentian Hoxha) dhe shtetasi Gentian Hoxha, së bashku me shtetasin Jamarbër Malltezi, kryejnë disa dhurime, në drejtim të shoqërisë Kontakt sh.p.k.

376.1. Me kontratën e dhurimit, të pasurisë së paluajtshme (Truall), nr.rep. 2844, nr.kol. 1050 datë 27.11.2019, para noteres Laura Pustina, shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Nervit Hoxha (Dhuruesi)**, i dhurojnë shoqërisë **Kontakt shpk (Pranuese e dhurimit)**, pasurinë nr. 3/182, vol.18, fq.1, zk.8220, lloji truall, me sip totale prej 315 m², në rrugën Frosina Plaku, Tiranë. Konkretisht Jamarbër Malltezi me 8/315 pjesë ideale dhe Nervit Hoxha me 3/315 pjesë ideale i dhurojnë pjesët ideale takuese të tyre, në total 11/315 pjesë në sip totale të truallit, shoqërisë Kontakt sh.p.k.

376.2. Me kontratën nr. 953 rep nr. 220 kol datë 17.04.2020 para noteres Laura Pustina, rezulton se shtetasi **Gentian Hoxha (i biri i Nervit) dhe shtetasi Jamarbër Malltezi si dhe shtetësja Nervit Hoxha**, me cilësinë e dhuruesit, i dhurojnë shoqërisë Kontakt sh.p.k. më cilësinë e pranuesit të dhurimit, pjesët e pandara të pasurisë me nr. 12/139 ZK 8310, ish pishina Laprakë, vol 20 faqa 170, ndodhur në rrugën e Durrësit. Në këtë pasuri evidentohet se shtetasi Gentian Hoxha disponon 24/576 pjesë, Nervit Hoxha disponon 6/576 pjesë dhe Jamarbër Malltezi disponon 27/576 + pjesën e Vera Graboëski, Graziella Begeja, dhe Margaret Irëin.

377. Para notere Xhoana Omari, lidhet kontratë sipërmarrje me nr. 3842 rep nr. 1406 kol dt 27.11.2019, ku shtetësja **Nerime Piro, përfaqësuar me prokurën nr. 2165 rep nr. 248 kol dt 03.05.2006 nga shtetasi Jamarbër Malltezi**, me cilësinë e palës pronare lidh kontratë me shoqërinë **Kontakt sh.p.k.** përfaqësuar nga shtetasi **Fatmir Bektashi**, me objekt ndërtimin e një objekti rezidencial me parkime, depo, dyqane dhe apartamente sipas kushteve urbanistike dhe lejes së ndërtimit të miratuar nga Bashkia Tiranë.

Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse, **pjesën e saj takuese, pasuri e llojit truall, me nr. 3/182 ZK 8220** me sip 315 m², vol 18 faqa 1, në bashkëpronësi me familjen Saliaga dhe Llagami. Me qëllim zhvillimin e kompleksit rezidencial, pala pronare jep pëlqimin për shkatërrimin e të gjitha ndërtesave që ndodhen në truallin objekt zhvillimi, në bashkëpronësi të palës pronare ...citon katër pasuri...dhe çdo ndërtesë tjetër që ndodhet mbi truallin objekt zhvillimi

Neni 3: Pala pronare do të marrë nga pala sipërmarrëse si kompensim për truallin e sipërpërmendur të vënë në dispozicion, **25 % të sipërfaqes ndërtimore** që do të zhvillohet mbi pasurinë, objekt i kësaj kontrate sipas kushteve urbanistike që do të miratohen nga Bashkia Tiranë. ...

378. Me kontratën e dhurimit nr 2982 rep nr 1095 kol datë 16.12.2019 para noteres Laura Pustina, shtetasit **Tire Deda, Shpëtim Luzi, Fatmir Luzi, Xhevrije Mullisi, Luljeta Qatibi, Merita Bardhi, Viktor Saliaga, Silvana Bello, Hamide Budo dhe Luan Saliaga** i dhurojnë shoq **Kontakt sh.p.k.** pjesën takuese ideale që zotërojnë në pasurinë me nr 12/139 ZK 8310 sip 880 m² vol 20 faqa 170, në adresën ish Objekti Laprakë, rruga e Durrësit. Konstatohet se për shtetasin Viktor Saliaga pasqyrohet me shënim nga noteri se nuk u paraqit për nënshkrim të kësaj kontrate pala Viktor Saliaga dhe as përfaqësuesi i tij me prokurë Altin Hysi. Për rrjedhojë kjo kontratë ka efekte ligjore vetëm për palët nënshkruese të tij dhe nuk cënon pjesën takuese të Viktor Saliaga.

378.1. Me kontratën e dhurimit nr 131 rep nr 21 kol datë 16.01.2020 para noteres Laura Pustina shtetasit **Mirrije Llagami, Adela Llagami, Ardian, Rudina Llagami, Argjend, Lindita, Kamelia, Megi Tafaj, Arta Shehu, Artan Verzivolli, Ervin, Aleksandra, Artur, Adnan**

Llagami, i dhurojnë shoq **Kontakt sh.p.k.** pjesën takuese në pasurinë me nr **12/139 ZK 8310** me sip trualli **880 m²**.

379. Me vendimin nr. A – 26019/6 datë nënshkrimi **26.12.2019** nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erjon Veliaj “Për miratimin e lejes së ndërtimit për “Rishikim i kushteve të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, në projektin teknik të lejes zhvillimore të ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. 8427/8 datë 18.09.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë”, lidhur me shqyrtimin e kërkesës, për leje ndërtimi për “Rishikim i kushteve të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, në projektin teknik të Lejes Zhvillimore të Ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. 8427/8 datë 18.09.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë” është vendosur:

1. Të miratoj lejen e ndërtimit për “Rishikim i kushteve të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, në projektin teknik të lejes zhvillimore të ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. 8427/8 datë 18.09.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë” sipas plan vendosjes së zonës së zhvillimit bashkalidhur vendimit.
2. Zhvilluesi/subjekti, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre, autorizohet të kryejë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për sipërfaqen shtesë në vlerën 10 823 482 lekë.
3. Formulari i lejes së ndërtimit i jepet zhvilluesit vetëm pas kofnirmimit të pagesës për shlyerjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, dorëzuar elektornikisht përmes llogarisë suaj në protalin e – Albania.
4. Kondicionet urbane dhe kushtet e tjera të lejes së ndërtimit, miratuar me vendimin nr. 8427/8 datë 18.09.2013 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë mbeten të pandryshuara.....

379.1. Më datë **26.01.2020** është dhënë Leje ndërtimi nga kryetari i Bashkisë Tiranë nr prot A – 26019/8 për zhvilluesin shoqërinë **Kontakt sh.p.k.** dhe **Homelan sh.p.k.** me subjekt ndërtues shoqëria **Kontakt sh.p.k.** Leje ndërtimit për objektin “Rishikim i kushteve të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, në projektin teknik të Lejes Zhvillimore të Ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. 8427/8 datë 18.09.2013 për projektin “Kompleksi Magnet” i përbërë nga strukturat me 1 kat të përbashkët parkim nëntokë, ...12 struktura..... Afati kohor i kësaj leje është 24 muaj sipas vendimit me nr. prot A-10845/3 datë 28.06.2019 për shtyrje afatit të lejes zhvillimore të ndërtimit. Struktura Eagle ka marrë leje përdorimi me vendimin nr. 13929/4 datë 22.12.2014.

380. Me vendimin nr. A – 26619/7 datë nënshkrimi **27.02.2020** nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Erjon Veliaj “Miratimin e lejes së ndërtimit për Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkimi nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10, dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 kat me mur rrethues ..., për Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkimi nëntokë dhe Godinë banimi 7, 9, 10, dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë Si dhe kopësht 2 kat me mur rrethues, ... është vendosur:

1. Të miratoj lejen e ndërtimit për “Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkimi nëntokë dhe Godinë banimi 7, 9, 10, dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 kat me mur rrethues
-3. Zhvilluesi/subjekti, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre, autorizohet të kryejë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 209 020 230.7 lekë.
- ...5. Zhvilluesi është subjekt i përcaktimeve të ligjit nr. 19/2018 “Për strehim social” sipas aplikimit të kryer më datë 13.11.2019 i cili ka depozituar në sistem deklaratën noteriale me nr. 3843 rep nr. 1407 kol datë 27.11.2019 ku deklaroi se do kalojë si fond të banesave sociale 3 % të sip funksionale totale banim, ku sip takuese banim është 878 m² sipas projektit teknik të depozituar në sistemin e – lejet...

380.1. Më datë **09.03.2020** është dhënë Leje ndërtimi nga kryetari i Bashkisë Tiranë Erjon Veliaj nr prot A – 26619/9 për zhvilluesin/ndërtues shoqërinë Kontakt sh.p.k. Leje ndërtimit për objektin “*Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 kat* Sip e truallit që zhvillohet është 9 093 m², sip e truallit e zënë nga struktura 2 937 m² (2 455 m² godinat e banimit, 482 m² kopshti); Nr i kateve mbi tokë 5, 7, 10 dhe 11 kat (Str. Ursa); 7, 9, 10 dhe 11 kat (Str Leo); 2 kat kopësht

Nr i kateve nëntokë 2 kat. Afati kohor i kësaj leje është 48 muaj

381. Me kontratën e sip për supervizion (mbikqyrje) punimesh Ursa, Leo dhe Sirius me nr 5533 prot datë 22.03.2020 është lidhur kontratë mes palës investitore shoq Kontakt sh.p.k. dhe shoq Supervizion Profesional sh.p.k. për mbkqyrjen e punimeve të ndërtimit të sipërcituaratë cilat po ndërtohen në bazë të lejes me nr A26619/9datë 09.03.2020.

382. Me kontratën nr 1187 rep nr 281 kol datë **13.05.2020** para noteres Laura Pustina, ndërmjet palëve të mëposhtme: Shitësit: *Xhimi Begeja, Fatbardha Kadiu, Edlira Xhija, Blerina Jorgji, Bashkim Kadiu, Sanie Velo, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Ednan Begeja, Orinda Malltezi, Rajmonda Bekteshi, Gëzim Begeja, Elona Grabova, Vangjelia Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Ilir Kadiu, Manjola Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Lirije (Antigoni) Lika, Myzejen Aga, Teuta Malka (përfaqësuar me prok e përgjithshme me nr 9874 rep nr 794/2 kol datë 19.09.2007 të noterit Ilirjan Isaj nga Artan Malka), Ajete Sulstarova, Hajdar Çela, Majlinda Spahi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi, Nerime Piro, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi, **Blerësi: Shoq Kontakt sh.p.k.,** Pëlqimdhënës: Shoq. Homeplan sh.p.k.Hyrje: ... në bazë të certifikatës për vërtetim pronësie, kartelës dhe hartës treguese në emër të bashkëpronareve, sipas listës bashkalidhur kësaj kontrate figuron e regjistruar në bashkëpronësi pasuria e përshkruar si më poshtë:*

“Pasuri me nr **12/139** ndodhur në ZK 8310, me sip 880 m² vol 20 faqa 170 në adresën ish Objekti Pishina Laprakë, e ndodhur në rrugën e Durrësit Tiranë. ...Barrë mbi pasurinë: Nuk ka. Kjo pasuri është e lirë dhe nuk ka barrë, fakt ky që vërtetohet nga kartela e pasurisë bashkalidhur nga verifikimi i së cilës konstatohet se prona është e lirë dhe pa barrë, çka e bën lirisht të transferueshme në qarkullimin juridik – civil.

Blerësi ka shprehur interesin dhe dëshirën e tij për të blerë pjesë të pandara të truallit në bashkëpronësi nga shitësit e lartpërmendur, sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

A. Shitësit kanë shprehur dëshirën për të shitur secili prej tyre nga pjesët e veta takuese në truallin në bashkëpronësi, pjesët si më poshtë vijon: ...Në total shitësit kanë rënë dakord që bashkarisht t'i shesin shoq Kontakt sh.p.k. pjesën e pandarë prej 186/880 pjesë takuese ose e shprehur në m² – **187.39 m² në truallin me nr pas 12/139....**

...Neni 2: Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes për pjesët e pandara të truallit, objekt kontrate është **200 euro/m²**. Vlera e shitblerjes për secilin nga bashkëpronarët këtu në cilësinë e shitësve është sipas tabelës së mëposhtme...renditen të dhënat mbi pjesët në bashkëpronësi të secilit dhe vlera në euro që i takon në bazë të kësaj shitje. ...Vlera totale e shitjes së pjesëve të pandara të truallit në total prej 186/880 pjeë takuese ose e shprehur në m² – 187.39 m² është në shumën **37 474 euro**. Vlera totale e shitblerjes do të depozitohet në llogarinë bankare të noterit...

Kjo kontratë nuk rezulton të jetë nënshkruar nga Sanije Velo ndërkohë që nuk rezulton të jetë përshkruar ndonjë prokurë përfaqësimi për të, gjithahstu nuk rezulton

të kenë nënshkruar Elona Grabova, Alida Maçi, Nerime Piro, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi).

Shënim i noterit: Nuk u paraqitën për nënshkrimin e kësaj kontrate personat vijues: Sanie Velo, Elona Grabova, Alida Maçi, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi. **Për rrjedhojë kjo kontratë ka efekte ligjore vetëm për personat nënshkrues të saj dhe nuk cënon pjesët takuese të personave të sipërcituar. Ata ruajnë të njëjtat pjesë takuese.**

382.1. Me kontratën nr 1371 rep nr 337 kol datë **26.05.2020** para noteres Laura Pustina, ndëmrjet palëve të mëposhtme: Shitësit: *Xhimi Begeja, Fatbardha Kadiu, Edlira Xhija, Blerina Jorgji, Bashkim Kadiu, Sanie Velo, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Ednan Begeja, Orinda Malltezi, Gëzim Begeja, Elona Grabova, Vangjelia Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Ilir Kadiu, Manjola Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Lirije (Antigoni) Lika, Myzejen Aga, Teuta Malka (përfaqësuar me prok e përgjithshme me nr 9874 rep nr 794/2 kol datë 19.09.2007 të noterit Ilirjan Isaj nga Artan Malka), Ajete Sulstarova, Hajdar Çela, Majlinda Spahi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi, Blerësi: **Shoq Kontakt sh.p.k.**, Përqimdhënës: Shoq. Homeplan sh.p.k.Hyrje: ...u konstatua se në bazë të çertifikatës për vërtetim pronësie me nr serial 1861631 të lëshuar nga ZVRPP Tiranë më datë 06.02.2019 në emër të bashkëpronarëve sipas listës së bashkëpronarëve bashkëlidhur kësaj kontrate, figuron e regjistruar pasuria e përshkruar si më poshtë: "Pasuri me nr 3/155 ndodhur në ZK 8220 vol 15 faqja 185 lloji truall, me sip 660 m2 me vendndodhje në rrugën Nre Mjeda....Barrë mbi pasurinë: Pasuria bllokohet në favor të shoq Homeplan sh.p.k. Ky inskriptim rezulton në favor të shoq Homeplan sh.p.k. këtu palë në cilësinë e përqimdhënësit i cili deklaroi se është dakord për realizimin e kësaj kontrate shit bejrje dhe transferimin e pronësisë së pjesëve ideale të truallit tek blerësi shoq Kontakt sh.p.k.*

Blerësi ka shprehur interesin dhe dëshirën e tij për të blerë pjesë të pandara të truallit në bashkëpronësi nga shitësit e lartpërmendur, sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

*B. Shitësit kanë shprehur dëshirën për të shitur secili prej tyre nga pjesët e veta takuese në truallin në bashkëpronësi, pjesët si më poshtë vijon: ...Në total shitësit kanë rënë dakord që bashkarisht t'i shesin shoq Kontakt sh.p.k. pjesën e pandarë prej 20415/33600 pjesë takuese ose e shprehur në m2 - **401 m2** në truallin me nr pas 3/155....*

*...Neni 2: Vlera e shitblerjes për secilin nga bashkëpronarët këtu në cilësinë e shitësve është sipas tabelës së mëposhtme...renditen shitësit, pjesët e tyre takuese dhe vlera në euro që i përket secilit. ...**Vlera totale e shitjes së pjesëve të pandara të truallit në total prej 20415/33600 pjesë takuese ose e shprehur në m2 - 401 m2 është në shumën 260 775 euro.** Vlera totale e shitblerjes do të depozitohet në llogarinë bankare të noterit...*

Kjo kontratë nuk rezulton të jetë nënshkruar nga Sanije Velo ndërkohë që nuk rezulton të jetë përshkruar ndonjë prokurë përfaqësimi për të, gjithashtu nuk rezulton të kenë nënshkruar Elona Grabova, Myzejen Aga, Alida Maçi, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi.

Shënim i noterit: Nuk u paraqitën për nënshkrimin e kësaj kontrate personat vijues: Sanie Velo, Elona Grabova, Myzejen Aga, Alida Maçi, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi. **Për rrjedhojë kjo kontratë ka efekte ligjore vetëm për personat nënshkrues të saj dhe nuk cënon pjesët takuese të personave të sipërcituar. Ata ruajnë të njëjtat pjesë takuese.**

382.2. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr 1751 rep nr 474 kol datë **23.06.2020** para noterës Laura Pustina, është lidhur kontratë shitje pasuri e paluajtshme ndëmrjet palëve: *Shitësit: Xhimi Begeja, Nysret Kaçurri, Kreshnik Kaçurri, Fatbardha Kadiu, Edlira Xhija, Blerina Jorgji, Bashkim Kadiu, Sanie Velo, Syzi Begeja, Merita Kallajxhi (Begeja), Ednan Begeja, Orinda Malltezi, Raimonda Bekteshi, Gëzim Begeja, Elona Grabova, Vangjelia Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Ilir Kadiu, Manjola Kadiu (përfaqësuar me prok të përgj nr 4518 rep nr 618 kol datë 23.12.2005 të noterit Bujar Troci nga Ilir Kadiu), Lirije (Antigoni) Lika, Myzejen Aga, Teuta Malka (përfaqësuar me prok e përgjithshme me nr 9874 rep nr 794/2 kol datë 19.09.2007 të noterit Ilirjan Isaj nga Artan Malka), Ajete Sulstarova, Hajdar Çela, Majlinda Spahi, Ermira Rizvanolli, Alida Maçi, Nerime Piro, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi, Blerësi: Shoq Kontakt sh.p.k.Hyrje: ...u konstatua se në bazë të çertifikatës për vërtetim pronësie me nr serial 1861631 të lëshuar nga ZVRPP Tiranë më datë 06.02.2019 në emër të bashkëpronarëve sipas listës së bashkëpronarëve bashkalidhur kësaj kontrate, figuron e regjistruar pasuria e përshkruar si më poshtë: "Pasuri me nr **3/182** ndodhur në ZK 8220 vol 18 faqa 1 lloji truall, me sip 315 m² me vendndodhje në rrugën Frosina Plaku. ...Barrë mbi pasurinë: Inskriptim nr 2029 datë 12.12.2008 në favor të shoqërisë Kontakt sh.p.k., inskriptim nr 2031 datë 12.12.2008 në favor të shoq Kontakt sh.p.k. Ky inskriptim rezulton në favor të shoq Kontakt sh.p.k. këtu palë në cilësinë e blerësit i cili pranon blerjen e pjesëve ideale të truallit. Blerësi ka shprehur interesin dhe dëshirën e tij për të blerë pjesë të pandara të truallit në bashëpronëis nga shitësit e lartpërmendur, sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.*

- C. Shitësit kanë shprehur dëshirën për të shitur secili prej tyre nga pjesët e veta takuese në truallin në bashkëpronësi, pjesët si më poshtë vijon: ...Në total shitësit kanë rënë dakord që bashkarisht t'i shesin shoq Kontakt sh.p.k. pjesën e pandarë prej 92/315 pjesë takuese ose e shprehur në m² 93.33 m² në truallin me nr pas 3/182....

...Neni 2: Palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes për pjesët e pandara të truallit objekt kontrate është 200 euro/m². Vlera e shitblerjes për secilin nga bashëpronarët këtu në cilësinë e shitësve është sipas tabelës së mëposhtme...renditen emrat e bashkëpronarëve, pjesa në bashkëpronësi dhe vlera që i takon secilit...Vlera totale e shitjes së pjesëve të pandara të truallit në total prej 92/315 pjesë takuese ose e shprehur në m² **93.33 m² është në shumën 18 666 euro**. Vlera totale e shitblerjes do të depozitohet në llogarinë bankare të noterit...

Edhe kjo kontratë nuk rezulton të jetë nënshkruar nga Sanije Velo ndërkohë që nuk rezulton të jetë përshkruar ndonjë prokurë përfaqësimi për të, gjithashtu nuk rezulton të kenë nënshkruar Alida Maci, Nerime Piro, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi, Elona Grabova.

Shënim i noterit: *Nuk u paraqitën për nënshkrimin e kësaj kontrate personat vijues: Sanie Velo, Elona Grabova, Myzejen Aga, Alida Maçi, Ariana Bekteshi, Arba Bekteshi, Lorina Bekteshi. Për rrjedhojë kjo kontratë ka efekte ligjore vetëm për personat nënshkrues të saj dhe nuk çënon pjesët takuese të personave të sipërcituar. Ata ruajnë të njëjtat pjesë takuese.*

383. Me kontratën nr 3244 rep nr 1184 kol datë **22.10.2020** para noterës Laura Pustina, shitësit Ariana, Arba, Lorina Bekteshi i shesin shoq Kontakt sh.p.k. pjesët e tyre në pasurinë me nr 12/309 ZK 8310 vol 59 faqa 234 lloji truall me sip 534 m², konkretisht të gjithë pjesën e tyre që përbëhet nga secila prej 3/534 pjesë. Pra blerësi do të blejë 9/534 pjesë ose 9 m² duke paguar secilin nga shitësit me 3 100 euro, në total **9 300 euro**.

384. Gjithashtu rezulton se me çertifikatën e përdorimit nr A-6219/3 prot datë **31.03.2020** është dhënë leje përdorimi për kompleksin Magnet i përbërë nga strukturat Eagle dhe 12 strukturat me 1 kat parkim nëntokë të përbashkët duke u sjellë në vëmendje se për strukturën Eagle 4-13 kat banim dhe shërbime me nr 1 kat parkim nëntokë është miratuar çertifikata e përdorimit nr prot 13929/4 datë 22.12.2014. Kjo çertifikatë përdorimi dhënë për objektet e ndërtuara në bazë të lejes së miratuar me nr 8427/8 datë 18.09.2013, zbardhur me lejen nr 8427/10 prot datë 18.10.2013; me vendim të kryetarit të Bashkisë nr A-10845/3 datë 28.06.2019 për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit ; me vendim nr 26019/6 datë 26.12.2019 për rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit datës 18.09.2013, objekte këto të ndërtuara nga shoq Kontakt sh.p.k. dhe me zhvillues shoq Kontakt sh.p.k. dhe Homeplan sh.p.k.

385. Me çertifikatën e përdorimit nr A-14727/3 datë **20.09.2020**, për godinë banimi dhe shërbime 4, 5, 6 dhe 7 kat me 1 kat parkim nëntokë është miratuar çertifikata e përdorimit për objektin me zhvillues shoq Kontakt sh.p.k., Homeplan sh.p.k. dhe Magnet Imo dhe subjekt ndërtues shoq Kontakt sh.p.k. Miratuar me vendim të kryetarit të bashkisë me nr A-11536/7 datë 06.08.2019 me leje ndërtimi nr prot A-11536/9 datë 17.08.2019 në rrugën Frosina Plaku dhe Ndre Mjeda.

386. Me çertifikatën e përdorimit nr A-12195/4 prot datë **27.06.2022**, është dhënë leja e përdorimit për objektin Godinë banimi 5, 7, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë dhe godinë banimi 7, 9, 10 dhe 11 kat me 2 kat parkim nëntokë si dhe kopësht 2 kat me mur rrethues, miratuar me vendimin nr A-26619/7 datë 27.02.2020, me leje ndërtimi nr prot A-26619/9 datë 09.03.2020, me adresë rruga Frosina Plaku (Artan Lenja dhe Ndre Mjeda), NJA nr 7, Tiranë, me ndërtues shoq Kontakt sh.p.k. dhe zhvillues po shoqërinë Kontakt sh.p.k.

Në brendësi gjendet aplikimi datë 28.05.2022 i bërë nga shoq Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga Eralda Ikonomi, ku rezulton edhe një pagese prej 7 270 000 lekë pranë Union Bank nga Fatmir Bektashi.

387. Me kontratën nr 1490 rep nr 507 kol datë **02.06.2021** para noteres Laura Pustina është lidhur kontratë shitje të pasurisë truall ndërmjet Sanie Velo dhe **blerës shoq Kontakt sh.p.k.** Pasqyrohet se në emër të bashkëpronarëve rezulton pas me nr **12/309 ZK 9310** vol 59 faqa 234, lloji truall, me sip 534 m². Sanie Velo i shet shoq Kontakt pjesën e saj të pandarë prej 6/534 pjesë takuese ose e shprehur në m² pjesën prej 5.87 m², në vlerën 2 250 euro dhe shoq Kontakt bëhet bashkëpronare me 486/534 pjesë.

388. Rezulton se shtetasi Jamarbër Malltezi ble sërish pasuri të tjera.

388.1. Me kontratën e shitjes nr. Rep 469 nr. Kol 141 dt **11.02.2021**, para noteres Laura Pustina, rezulton se shtetësja **Nustret Kaçurri** në cilësinë e shitëses dhe shtetasit **Jamarbër Malltezi** (i përfaqësuar ky i fundit nga shtetasi Florenc Kola) dhe **Nervit Hoxha**, në cilësinë e blerësit, bien dakord që këta të fundit të blenë pjesën që ka në bashkëpronësi shtetësja Nustret, në pasuritë:

1. Nr. 10/184 vol 11 fq 195 ZK 8370 sip 33 m² truall, (5/20 pjesë ideale), në bashkëpronësi me shtetasit Xhimi Begeja, Arjan Leskaj, Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Jamarbër Malltezi dhe Orinda Malltezi (Në seks D është shënimi dt 27.10.2020 se pasuria rivlerësohet për shumën 773 491.95 lekë vetëm për pjesën e Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi dhe Nustret Kaçurri), e shet për **1 584 euro**;
2. Nr. 10/121 vol 20 faqa 132 ZK 8370 sip 1 341 m² truall dhe 565 m² ndërtesë, (87.5/700 pjesë ideale), në bashkëpronësi me Bashkim Bekteshi, Nervit Hoxha, Rajmonda Bekteshi, Jamarbër Malltezi, Orinda Malltezi, Gezim Begeja, Arjan Leskaj, Lirie Lika,

Ajete Sulstarova, Myzejen Ago, Elona Grabova, Ednan Begeja, Syzi Begeja, Neriban Kadiu, Bashkim Kadiu, Fatbardha Begeja, Ermira Begeja, Alida Begeja, Xhimi Begeja, Vangjelia Kadiu, Ilir Kadiu, Manjola Kadiu, Teuta Malka, Lumturi Çela (*Në seksionin D është bërë shënimi më datë 10.02.2021 se pasuria rivlerësohet në shumën ...20 402 004 lekë për pjesën takuese të Nusret Kaçurri...*), e shet për 32 184 euro;

Blerësit siç dalin nga kartelat e pasurive të mësipërme janë bashkëpronarë në këto pasuri dhe për rrjedhojë kanë të drejtën e parablerjes. **Gjithsej i shet për shumën 33 768 euro.** Vlera totale e shitblerjes do të depozitohet në llogarinë bankare të noterit ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate nëpërmjet transfertës bankare. Me nënshkrimin e kësaj kontrate i kalohet Jamarbër Malltezi pronësia si më poshtë: Pasuria nr 10/184 ZK 8370, me 5/40 pjesë takuese dhe Pasuria nr 10/121 ZK 8370, me 43, 75/700 pjesë takuese. Nervitit i kalohet pronësia: Pas nr 10/184 ZK 8370 me 5/40 pjesë takuese dhe Pasuria nr 10/121 ZK 8370 me 43,75/700 pjesë.

388.2. Me kontratën e shitjes së pasurisë së me nr. Rep 470 nr. Kol 142 datë **11.02.2021**, para noteres Laura Pustina, shitësja Nustrete Kaçurri i shet blerësit **Jamarbër Malltezi**, përfaqësuar ky i fundit nga shtetasi Florenc Kola, dhe shtetases **Nervit Hoxha**, pasurite: *Pas nr 10/178 ZK 8370, Pas nr 10/179 ZK 8370, Pas nr 10/180 ZK 8370. Pas nr 10/181 ZK 8370.* Me nënshkrimin e kësaj kontrate i kalohet Jamarbër Malltezi pronësia si më poshtë: *Pas nr 10/184 ZK 8370 , me 5/40 pjesë takuese dhe Pas nr 10/121 ZK 8370, me 43, 75/700 pjesë takuese.* Nervitit i kalohet pronësia: Pas nr 10/184 ZK 8370 me 5/40 pjesë takuese dhe Pas nr 10/121 ZK 8370 me 43,75/700 pjesë. Gjithsej shitet për **26 232 euro.**

Shitja e kuotave të shtetasi Xhimi Begeja të shoqërisë Homeplan sh.p.k. dhe kalimi për likuidim i kësaj shoqërie

389. Me kontratën nr 1387/455 rep/kol dt **19.05.2023**, para notere Laura Pustina, shtetasi Xhimi Begeja, me Pëlqimdhënëse Luljeta Begeja, i shet kuotat bleresve **Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi**. Konkretisht ne kete kontrate, pasqyrohet se *shtetasi Xhimi Begeja, i cili zotëron 25% të pjesmarrjes në kapitalin e shoq Homeplan sh.p.k. shet të gjithë pjesmarrjen e tij në këtë shoqëri ortakëve të tjerë të shoqërisë përkatësisht Fatmir Bektashi 15 % dhe Jamarbër Malltezi 10 %, duke u zhveshur kësisoj nga çdo e drejtë pronësie mbi këtë pjesmarreje si dhe nga çdo detyrim ndaj të tretëve për shkak të kësaj pjesmarrje. Pjesmarrja objekt i kësaj kontrate dhe çdo e drejtë dhe detyrim i cili buron prej kësaj pjesmarrje, transferohet nga pala shitëse në pronësi të palës blerëse vetëm në datën e shlyerjes së pjesës së mbetur të detyrimit për pagesë dividendi që shoqëria ka ndaj palës shitëse, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 14.04.2022 (për miratimin e bilancit të shoqërisë të vitit 2021) përkatësisht në shumën 500 000 euro. Për garantimin e sa më sipër, deri sa të plotësohen kushtet ligjore për realizimin e kësaj pagese (për shkak të bllokimit të llogarive bankare të shoq Homeplan sh.p.k.), palët bien dakord që kjo shumë të derdhet fillimisht në llogarinë e dedikuar të noteres, në një nga bankat e nivelit të dytë...Menjëherë pas zhblokimit të llogarive bankare të Homeplan sh.p.k. dhe heqjes së masës së sigurimit të detyrimit tatimor (moslejimi i tjetërsimit të titujve të pronësisë dhe të drejtave pasurore që i përkasin këtij tatimpaguesi deri në shlyerjen e detyrimeve tatimore), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Ttaimeve, Rajoni Qendror, ku është kërkuar: Vendosije të masës së sigurimit të detyrimit tatimor mbi tatimpaguesin shoq Homeplan sh.p.k. ...e gjithë shuma do të transferohet nga llogaria e noteres në llog e shoq Homeplan sh.p.k. me qëllim që kjo e fundit të realizojë kështu pagesën e pjesës së mbetur të dividendit që duhet t'i paguhet palës shitëse, Xhimi Begeja, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 14.04.2022 (për miratimin e bilancit të shoqërisë të vitit 2021) në shumën prej 500 000 euro. Pjesmarrja e zotëruar nga Xhimi Begeja në kapitalin e shoq*

Homeplan sh.p.k. shitet përkatësisht: 15% e pjesmarrjes e cila i shitet Fatmir Bektashi, për vlerën 15 000 lekë dhe 10% e pjesmarrjes i shitet Jamarbër Malltezi për vlerën 10 000 lekë. Blerësit fitojnë pronësinë e pjesmarrjes...me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që mbart kjo pjesmarrje, të cilat kanë lindur para shitjes së kësaj pjesmarrje dhe që do të lindin në vazhdim si pasojë e zotërimit të kësaj pjesmarrje, përfshirë detyrimet ndaj institucioneve shtetërore, ndaj të tretëve, shoq tregtare dhe pers fizikë, duke përfshirë çdo të drejtë/detyrimi cili nuk është përmendur shprehimisht në këtë kontratë dhe pala shitëse zhvishet nga pronësia mbi këtë pjesmarrje dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me të, duke mos patur asnjë pretendim të mëtejshëm në lidhje me këtë pjesmarrje. Në përfundim të këtij procesi, pjesmarrja në shoq do të jetë si në vijim: Fatmir Bektashi zotëruar i 55% të pjesmarrjes të barabartë me 55 000 lekë dhe Jamarbër Malltezi zotëruar 45 % të pjesmarrjes të barabartë me 45 000 lekë. ...3. Shitësi deklaron se me pagesën nga ana e shoqërisë të pjesës së mbetur të detyrimit të papaguar nga dividendi i vendosur për t'u shpërndarë, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve të datës 14.04.2022 (për miratimin e bilancit të shoq të vitit 2021) në shumën 500 000 euro ai nuk do të ketë pretendime financiare apo të ndonjë natyre tjetër, as tani dhe as në të ardhmen si ndaj shoq Homeplan sh.p.k. ahstu edhe ndaj ortakëve të saj Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi apo trashëgimtarëve të tyre...

390. Me deklaratën noteriale nr 1404 rep nr 463 kol dt 22.05.2023 para notere Laura Pustina, janë paraqitur deklaruesit Xhimi Begeja dhe Luljeta Bega, ku konstatohet se Xhimi Begeja deklaron: *Unë nënshkruesi Xhimi Begeja, me vullnetin tim të lirë dhe të pavesuar, deklaroj se me pagesën nga ana e shoqërisë Homeplan sh.p.k. të pjesës së mbetur pa paguar nga dividendi i vendosur për t'u shpërndarë, sipas vendimit të asamblesë së ortakëve datë 14.04.2022 (për miratimin e bilancit të shoqërisë të vitit 2021) në shumën prej 500 000 euro nuk do të kem pretendime financiare apo të ndonjë natyre tjetër, as tani dhe as në të ardhmen, si ndaj shoq Homeplan sh.p.k. edhe ndaj ortakëve të saj Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Maltezi apo trashëgimtarëve të tyre. Sa më sipër deklarohet edhe nga Luljeta Begeja në cilësinë e bashkëshortes së Xhimi Begeja...".*

391. Më dt 04.10.2023 është depozituar pranë QKB-së vendimi i datës 03.10.2023 për **kalimin e shoqërisë në status "likuidim e sipër" dhe caktim likuidatori**. Aktet e depozituara janë:

- Vendimi i asamblesë së ortakëve datë 03.10.2023 e nënshkruar nga dy ortakët e shoqërisë shtetasi Fatmir Bektashi dhe shtetasi Jamarbër Malltezi të cilët kanë vendosur:
 - Fillimin e procedurës së likuidimit për shoqërinë Homeplan shpk
 - **Emërimin e shtetasit Fatmir Bektashi si likuidatorin e shoqërisë**
 - Depozitimimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar të QKB, Tiranë
 - Me depozitimimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë emrit të shoqërisë shtohet fjala (në likuidim).

Pas depozitimit të këtij vendimi statusi i shoqërisë Homeplan sh.p.k ka kaluar nga "Aktiv" në "Shoqëri në likuidim e sipër"

Investimet në pasuri të paluajtshme të shtetasve Malltezi dhe shtetasve Berisha

392. Familja Malltezi, kryen investime në bletje pasurish të paluajtshme pergjate viteve. Në periudhën, që nga viti 1998 deri në vitin 2005, konstatohet se burimi kryesor i të ardhurave të kësaj familje, shfaqet nga organizma ndërkombëtarë. Kështu rezulton se për periudhën 1998 – 2001, sipas akteve të gjendura në ILDKP, nga shtetësja Argita Malltezi, deklarohet se:

Bashkëshorti i saj Jamarbër Malltezi, përgjatë vitit 1998 – 2001 është paguar 40 000 USD nga UNDP Tirana dhe në periudhën maj 2001 deri në nëntor 2005, deklaroi të ardhura prej 5 200 USD në muaj.

Kurse për të ardhurat e vetë shtetases Argita, kjo e fundit deklaroi, si të ardhura nga rroga, DOJ UNMIK për periudhën 2000 – 2001 – 7 500 USD në muaj (12 muaj) dhe 2001 – deri në nëntor 2005 shumën prej 6 500 USD në muaj (56 muaj).

Gjithashtu, shtetësja Argita Malltezi, deklaroi për vitin 2006 edhe të ardhura nga Fondi i Pensionit UN, në vlerën 45 000 USD.

Nga ILDKPKI është kërkuar informacion pranë UNMIK për punësimin e shtetasve Argita Malltezi dhe Jamarbër Malltezi. Në vërtetimin e datës 28.09.2006 të UNMIK, firmosur nga shefi i personelit Danielle Pecorini, pasqyrohet se:

- shtetasja Argita Malltezi ka filluar punë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) më datë 16.04.2000 deri më datë 30.11.2005, datë në të cilën ajo dha dorëheqjen. Paga vjetore bruto 83,342 dollarë, neto 61,606 dollarë. Gjithashtu kompensim për përballimin e jetesës 68 euro/ ditë, si dhe kompensime për shpenzime të tjera, që në vit llogariten 3 872 dollarë.
- shtetasi Jamarbër Malltezi ka filluar punë në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) më datë 31.05.2001 deri më datë 30.11.2005, datë në të cilën ai dha dorëheqjen. Paga vjetore bruto 61,344 dollarë, neto 44,057 dollarë. Gjithashtu kompensim për përballimin e jetesës 68 euro/ ditë.

392.1. Pas ardhjes në pushtet si Kryeministër të shtetasit Sali Berisha, konstatohet se, shtetasi Jamarbër Malltezi pajiset nga Ministria e Mjedisit me çertifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi, referuar çertifikatave të datës 07.12.2005.

Nga aktet e evidentuara pas ekstraktimit të të dhënave nga hard drive-i i jashtëm i sekuestruar pranë studio Pustina, konstatohet se shtetasi Jamarbër Malltezi më datë 02.04.2012 ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me shoqërinë UAECC sh.p.k. me ortak shtetasin Kostaq Kaskaviqi, me shtetasit Kestrin Katro, Lindita Oshafi dhe me shoqërinë Geo Consulting sh.p.k. sipas të cilës pasqyrohet se personat e mësipërm janë bashkëpunëtorë prej vitit 2007 në fushën e projektimit dhe planifikimit urban dhe secili prej tyre ushtron aktivitetin projektues në fushën e përcaktuar sipas licencës profesionale të lëshuar nga MRRT dhe MMPAU në përputhje të plotë me KTP dhe KTZ. Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshje do të vazhdojë edhe për një periudhë pesë vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Rezulton nga kqyrja e regjistrimit të veprimeve noteriale të noteres Laura Pustina se është regjistruar një marrëveshje e tillë me nr 642 rep dhe nr 409 kol datë 02.04.2012.

392.2. Kurse shtetësja Argita Malltezi, për vitin 2006 e në vijim, në varësi të periudhave, deklaroi pagesa si konsulente ligjore apo si avokate. Sipas akteve të depozituara në QKB, rezulton se më datë 05.10.2005 Banka Emporiki pasqyron bllokimin e një shumë prej 100 000 lekë si kapital fillestar për regjistrimin e shoqërisë Malltezi & Kola sh.p.k. Konstatohet është përpiluar akti i themelimit dhe statuti i kësaj shoqërie, me ortakë themelues, shtetaset Argita Malltezi dhe Flutura Kola (Tafaj), me shëbime në fushën juridike, akte këto të vërtetuara më datë 24.10.2005 para noteres Laura Pustina. Mbështetur në kërkesën e këtyre dy bashkëortakeve të datës 26.10.2005, është vendosur me vendimin nr 34263 akti datë 28.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, regjistrimi i shoqërisë me emërtimin

"Malltezi & Kola" sh.p.k. Sipas një vërtetimi me nr 582 rep datë 08.12.2005 të noteres Laura Pustina pasqyrohet se dy bashkëortaket kanë bërë kërkesë për mbylljen e kësaj shoqërie dhe fshirjen e regjistrimit si person juridik. Bashkalidhur gjendet edhe vendimi nr 1 i asamblesë së ortakëve datë 08.12.2005 për mbylljen e kësaj shoqërie. Me vendimin datë 29.12.2005, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur depozitimim e vendimit të asamblesë së ortakëve për mbylljen e shoqërisë dhe fshirjen e regjistrimit.

Më datë 16.12.2005 shtetësja Argita Malltezi paraqet kërkesë për t'u regjistruar si person fizik për të ushtruar veprimtari private me objekt shërbime avokatie dhe konsulence me vend të ushtrimit të aktivitetit në adresën rruga e Barrikadave, Pall. Ndërtim Vila, Ap. 7 që është edhe selia që ishte caktuar për shoqërinë "Malltezi & Kola". Mbështetur në këtë kërkesë me vendimin nr 34858 datë 19.12.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendos regjistrimin si person fizik të shtetases Argita Malltezi. **Ky subjekt rezulton i çregjistruar sipas të dhënave në QKB më datë 16.10.2009.**

Sipas informacionit të dhënë nga organet tatimore, kjo shtetase rezulton në fakt të jetë regjistruar si person fizik me nipt K61415009Q, të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë më datë 15.02.2006 me objekt aktiviteti "Avokate", me status "Aktiv" nga data 15.02.2006 kurse në QKB më datë 19.12.2005. Organet tatimore përveç vitit 2008, nuk disponojnë të dhëna, pra deklarata të këtij subjekti.

Në deklaratën e dorëzuar për vitin 2006 (datë 30.03.2007) shtetësja Argita Malltezi deklaron të ardhura nga konsulencë ligjore në vlerën 413 280 lekë dhe të ardhura nga puna si avokat, xhiro vjetore në shumën 7 632 200 lekë. Në deklaratën e dorëzuar për vitin 2007 (dorëzuar më datë 31.03.2008), shtetësja Argita Malltezi deklaron të ardhura nga aktiviteti i avokatisë në shumën 7 900 000 lekë. Në deklaratën për vitin 2008 (dorëzuar më datë 25.03.2009) shtetësja Argita Malltezi deklaron të ardhura nga aktiviteti i avokatisë në shumën 5 264 363 lekë. Në deklaratën për vitin 2009 (datë dorëzimi 25.03.2010) shtetësja Argita Malltezi deklaron të ardhura nga aktiviteti i avokatisë deri në datën e mbylljes në shumën 419 543.54 lekë. Më pas kjo shtetase nuk deklaron të ardhura nga aktiviteti i avokatisë përveç se për vitin 2011 kur deklaron një pagesë të prapambetur që nga viti 2008 në shumën 8 000 euro.

Nga ana tjetër, shtetasi Shkëlzen Berisha, për vitin 2005 deklaron se ka të ardhura nga puna si konsulent pranë av. Argita Malltezi, në shumën prej 2 000 euro në muaj. Por sjellim në vëmendje se në vitin 2005 shtetësja Argita Malltezi vetë nuk deklaron të ardhura. Për të sqaruar këtë situatë me shkresën e datës 23.01.2007, shtetases Argita Malltezi i është dashur të sqarojë në ILDKPKI se mendon se i vëllai i referohet në fakt tre muajve të parë të vitit 2006. Shtetasi Shkëlzen Berisha sidoqoftë ka vijuar të deklarojë në vitin 2006 të ardhura nga motra e tij, për periudhën 01.01.2006 deri më 30.09.2006 duke pretenduar se është paguar me 202 818 lekë në muaj.

Por megjithëse shtetësja Argita Malltezi, ka çregjistruar subjektin e saj të çelur në dhjetor 2005, duket se ajo ka vijuar të punojë me shtetasen Flutura Kola. Kjo e fundit, rezulton të ketë regjistruar fillimisht personin fizik me Nipt K61415010U, më datë 19.12.2005, i cili është çregjistruar me datë 15.05.2008 me vend ushtrim aktiviteti, rruga e Barrikadave. Në datë 13.12.2007 ka regjistruar subjektin "Kola & Associates" sh.p.k. me NIPT K72413009J, me emrin tregtar *Kola & Associates*, me adresë Rruga e Barrikadave, pall. Ndërtim vila, ap. 7, si ortakë e vetme.

Fakti që shtetësja Argita Malltezi ka vijuar të punojë me shtetasen Flutura Kola, evidentohet ndër të tjera, nga një dokument i gjendur nga të dhënat e ekstraktuara nga hard drive i

sekuestruar pranë studio Pustina, sipas të cilave, kjo shtetase ka lëshuar dy vërtetime për shtetasen Jonida Rustemaj në vitin 2019, me të cilin vërteton se shtetësja Jonida Rustemaj ka qenë e punësuar pranë subjektit "Kola & Associates" sh.p.k. me NIPT K72413009J në periudhën nga data 01.09.2009 deri në datë 01.12.2009. Gjithashtu rezulton vërtetimi për shtetasen Jonida Rustemaj për punësimin pranë subjektit "Argita Malltezi" Person Fizik me nipt K61415009Q në periudhën nga data 01.09.2008 deri në datë 01.09.2009.

Referuar dokumentit të gjendur nga të dhënat e ekstraktuara nga hard drive i sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton në format Libri i madh 2008 dhe në bilanc të vitit 2009 të subjektit "Kola & Associates" sh.p.k. me NIPT K72413009J, se shtetësja Argita Malltezi është paguar si furnitor, ku në vitin 2008 specifikohet në librin e madh se ka ofruar konsulencë ligjore.

Edhe nga të dhënat e llogarive bankare konstatohet se ka një llogari të përbashkët pranë ABI Bank, me nr 001420100011249 në euro në emër të shtetasve Argita Malltezi dhe Flutura Kola. Për vitin 2006 në këtë llogari janë kredituar nga disa subjekte pagesa të ndryshme. Kjo llogari është hapur më datë 05.01.2006 dhe është mbyllur më datë 20.12.2006.

E pyetur më datë 06.09.2024, shtetësja *Lealba Pelinku* ka deklaruar: "...kam filluar punë pranë studio ligjore Malltezi dhe Kola mesa më kujtohet rreth fillimit të vitit 2006. Zyrat kjo studio i ka pasur tek rruga e Barrikadave. Unë kam qenë e para që jam punësuar pasi zyra sapo ishte hapur. Me kujtohet që diskutimi për punësimin tim ishte bere nga ana ime me zonjen Argita Malltezi dhe Flutura Kola. Mesa më kujtohet unë kam punuar në këtë studio deri nga vjeshta e vitit 2008. Pas meje ka filluar punë në këtë studio shtetësja Migena Muçaku, më pas zoti Sokol Barçi, Brikena Kasmë dhe Joana Qeleshi, Jonida Rustemaj. Ka punuar edhe një djalë që quhej Altin i cili ka ndërruar jetë që në ato vite. Fillimisht ka qenë vetëm një apartament dhe më pas jemi ndarë edhe tek apartamenti ngjitur, përballë. Gjithashtu këtu ka punuar edhe shtetësja Flutura Kola. Nuk jam shumë e qartë se si ka funksionuar kjo studio nën drejtimin e Argitës, Fluturës apo të dyja bashkë por unë di që jam paguar në periudha të ndryshme prej tyre veç e veç ose së bashku. ...Më kujtohet por nuk e mbaj mend vitin që nga shtetësja Argita më është kërkuar të bëja një depozitim parash në një llogari bankare të shtetasve Sali Berisha dhe Liri Berisha. Paratë më janë dhënë cash nga shtetësja Liri Berisha dhe më kujtohet që jam pajisur me prokurë ose autorizim, pra më është dhënë një akt që më legjitimonte për të bërë veprime pranë bankës. Banka më kujtohet që ka qenë tek Torre Drin dhe më duket se ka qenë ish Banka Amerikane. Për të marrë paratë kam shkuar tek shtëpia e shtetasve Liri Berisha që është e njëjta shtëpi ku jetojnë sot. Di që ka pasur lidhje ky depozitim me deklarinimin e pasurisë në ILDKPKI pasi edhe periudha mesa më kujtohet ka qenë diku nga muaji mars. Shumën nuk e mbaj mend se sa ka qenë. Ndonjë sqarim i mëtejshëm nuk m'u dha për këtë shumë parash. Gjithashtu sqaroj se në kohën që kam punuar pranë kesaj studio si me siper cituar, kemi pasur adresa emaili që mbaronin me malltezi dhe kola dhe me duket se me vone ishte bere malltezi associates. ..."

Në fakt, nga aktet rezulton se shtetësja Lealba Pelinku ka bërë një depozitim cash në llogarinë bankare të shtetasve Sali dhe Liri Berisha me nr ...24135102 pranë Intesa San Paolo Bank më datë 28.03.2008.

Gjithashtu në llogarinë e shtetasve Sali dhe Liri Berisha nr. 44024135101 monedha euro konstatohet se kryen veprime edhe shtetasi Sokol Barçi (evidentohet më datë 10.02.2009 që bën aktivizimin e llogarisë).

392.3. Subjektet që duket se ofrojnë pagesa, si për shtetasin Jamarbër Malltezi ashtu edhe për shtetasen Argita Malltezi, në kuadrin e ushtrimit të aktivitetit të tyre, rezultojnë të kenë arritur të sigurojnë kontrata të rëndësishme me shtetin në periudhën që shtetasi Sali Berisha ka qenë kryeministër i Republikës së Shqipërisë.

392.3.1. Nga aktet rezulton se me VKM nr 1363 datë 17.10.2008, VKM kjo e nënshkruar nga shtetasi Sali Berisha, është miratuar marrëveshja e koncensionit ndërmjet METE si autoritet kontraktues dhe shoqërisë Österreichische Elektrizitäts- und Fernwärme-Gesellschaft për ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të një hidrocentrali të ri në Ashtë... Me vendimin nr 170 datë 18.12.2012, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregulltar të Energjisë (ERE) ka vendosur të miratojë marrëveshjen e shitjes së energjisë elektrike mes KESH sh.a. dhe Energji Ashta sh.p.k. miratuar e VKM nr 1363 datë 17.10.2008.

Përgjatë viteve, konstatohet se shtetasi Ardian Shehu, për llogari të një marrëdhënie të shoqërisë Energji Ashta si më sipër krijuar dhe të projektit të mësipërm rezulton se paguan shtetasin Jamarbër Malltezi si vijon:

- Në vitin 2008 në llogarinë Abi Bank 000063808 EURO, ISH 1420200004652 të shtetasit Jamarbër Malltezi, ka kaluar transertë nga Adrian Shehu, *Hec Ashta plani i menaxhimit dhe moint/honorare, hec ashta, mjedisi biologjik*, 18,900 euro (dy kreditime në muajin gusht).
- Në vitin 2009, në llogarinë OTP Bank 00000213070-35 EURO të shtetasit Jamarbër Malltezi, është paguar nga Ardian Shehu 8,820 euro (tre kreditime, muajt nëntor dhe dhjetor) me përshkrimin *projekti Devolli, mjedisi biologjik*.
- Në vitin 2010, në llogarinë OTP Bank 00000213070-35 EURO të shtetasit Jamarbër Malltezi, paguar nga Ardian Shehu+ interesa 25,754 euro (pesë kreditime, në muajt shkurt, prill, nëntor dhe dhjetor) me përshkrimet: *kampi Koshaj, projekti Devolli, VNM Qefbari- Tirez*
- Në vitin 2011, në llogarinë OTP Bank 00000213070-35 EURO të shtetasit Jamarbër Malltezi, është paguar nga Ardian Shehu + int shumë 12,129 euro (tre kreditime, në muajt mars, shtator dhe dhjetor) me përshkrimet: *projekt monitorimi Hec Ashta, projekt Ashta monitorimi i mjedisit biologjik, monitorimi Hec Ashta, mjedisi biologjik*.
- Në vitin 2012, në llogarinë OTP Bank 00000213070-35 EURO të shtetasit Jamarbër Malltezi, kreditim nga Adrian Shehu 7,985 euro (pesë kreditime në muajt maj, korrik dhe nëntor) me përshkrimet: *monitorimi hidrocentral Hec Ashta, monitorimi Hec Ashta, monitorimi Hec Ashta, mjedisi biologjik, monitorimi Hec Ashta, ekologjia tremujori i dytë*.
- Në vitin 2012, në llogarinë e Raiffeisen Bank me numër 815451-EUR-3824000000-01-022 të shtetasit Jamarbër Malltezi, kreditim nga Ardian Shehu PF për Jamarber Malltezi me përshkrim *ASHTA HPP Medisi Biologjik, Environmental ans Social Survey on VJOSA RIVER mjedisi biologjik, studim paraprak kaskata e Vjoses, Ekologji* 5,760 euro (tre kreditime në muajt shtator, nëntor dhe dhjetor).
- Në vitin 2013, në llogarinë OTP Bank 00000213070-35 EURO të shtetasit Jamarbër Malltezi, kreditim nga Ardian Shehu për Jamarber Malltezi 2,220 euro (një kreditim në mars) me përshkrimin *paguar nga Ardian Shehu, Hec Ashta, monitorim Hec Ashta, tremujori i 4 per 2012, mjedisi biologjik*.

Shtetasi **Ardian Shehu**, i pyetur përgjatë këtij hetimi, më dt 03.04.2024, ka deklaruar se, *shtetasin Jamarbër Malltezi e njuh prej shumë vitesh, pasi në projekte të ndryshme bashkëpunonte me specialistë të ndryshëm, por kryesisht i besonin më shumë pedagogëve dhe shtetasi Jamarbër Malltezi ka qenë pedagog në Universitetin Bujqësor të Kamzës. Ky shtetas*

ka qënë në grupin e punës për raportin e vlerësimit të ndikimit në Mjedis Hidrocentrali i Ashtës, i cili ndodhet në Shkodër, pjesë e grupit që ka bërë vlerësimin në mjedis kanë qënë shumë shtetas të tjerë specialistë të fushës, ku gjithsecili përgatistë atë pjesë të raportit që lidhej me fushën e vetë. Në këtë projekt janë paguar nga VEVE Group me të cilën kanë patur dhe punë të tjera dhe projekte të tjera në Shqipëri. Kujton që përsëri me VEVE-në kanë punuar për vlerësimin mjedisor të kapacitetit që mund të kishte Drini i Zi për prodhimin e energjisë elektrike. Me shtetasin Jamarbër Malltezi kanë bërë disa punë në fushën e mjedisit dhe nuk e kujton me saktësi vitin por së bashku me të dhe shtetasin Lirim Selfo krijuan një shpk që të punonin bashkarisht me emrin 'Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm' të cilin e kanë mbyllur brenda muajit për shkak të komenteve politike që u bënë në lidhje me hapjen e kësaj shoqërie. Sqaron në lidhje me pagesat e bëra shtetasit Jamarbër Malltezi duke pretenduar se pagesat nga Veve Group kryheshin në emër të Ardianit, si përfaqësues i cili edhe ka lidhur kontratën me VEVE Group dhe pasi merrte këtë pagesë, Ardiani ia shpërndante anëtarëve të tjerë të grupit që kanë marrë pjesë në hartimin e raportit për vlerësimin e mjedisit. Gjithashtu edhe pagesa të kryera shtetasit Jamarbër Malltezi për projektin Devolli, sqaron se kanë punuar për llogari të VEVE Group. Për projektin e vlerësimit në mjedis punonin si grup, pagesën e merrte vetëm Ardiani dhe jua kalonte pjesëtarëve të tjerë të grupit. Kryesisht vlerësimi kryhej nga një grup pedagogësh të cilët ishin nga Shkencat e Natyrës, Kamzës dhe Fakulteti Gjeologji Minerave.

392.3.2. Gjithashtu rezulton se me VKM nr 1356 datë 10.10.2008, nënshkruar nga kryeministri i kohës Sali Berisha, rezulton se është vendosur që autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncension të formës BOT të hidrocentralit Stavec 1 është METE. Miratimin e bonusit prej 3% të pikëve për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) që i jepet shoqërisë Koka sh.p.k. METE në procedurën konkurruese të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali. Me kontratën e koncensionit të formës BOT ndër ndërtimin e hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luci, Shoshaj, Zenishti dhe Burreli datë 21.09.2012 rezulton të jetë lidhur kontrata mes METE dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive Riviera, EHW, Energji Project dhe Atlantik. Në vijim krijohet subjekti "Mati Hidropower" shpk me NIPT L22212004 A me datë regjistrimi 12.10.2012 e cila është një shoqëri konçesionare, e krijuar nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive EHË shpk, ENERGY PROJECT shpk, Atlantik - Shoqeri Sigurimesh sh.a dhe RIVIERA shpk për zbatimin e kontratës së konçesionit të datës 21.09.2012 me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me objekt: Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luçi, Shoshaj, Zenishti, Burreli, me vendodhje në lumin Mat dhe transferimin e tyre në përfundim të kontratës nga konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.

Në vitin 2013, rezulton se shtetasi Jamarbër Malltezi, paguhet nga Qendra e Monitorimit me përshkrim pagesë konsulentit, projekti *MATI HIDROPOWER PLANT EIA*, (tatim i mbajtur në burim) shuma 10,300 euro.

Në vitin 2014 "Qend Kerkim për Zhvill Rural" paguan shtetasin Jamarbër Malltezi pagese kontrate sherbimi+ dieta+ udhetim 20,174.1 euro, "transfer, pune ne projektin Emso-Mati Hydro Poëer Pant/ KOORDINATOR/ projekt UNDP".

392.3.3. Gjithashtu shtetasi **Jamarbër Malltezi**, në muajin janar 2006 konstatohet se është përfshirë në një projekt të rëndësishëm, duke mbajtur pozicionin e koordinatorit të projektit "Menaxhimi i Integruar dhe Pastrimi i zonës bregdetare" me financim në shumën 950 000 \$ midis Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) dhe Ministrisë së Financave dhe duke u atashuar me zyra pranë Ministrisë së Punëve Publike.

392.4. Kurse shtetësja **Argita Malltezi** e cila rezulton të ketë bashkëpunim me shtetasen Flutura Kola, si edhe më sipër rezultoi, vijon të paguhet prej saj, në vitet 2008, 2009 (*shih edhe të dhënat e ekstraktuara nga hard drive-i i sekuestruar pranë studio Pustina, dokumenti "Format Bilanc Kola & Associates"*). Pikërisht në këto vite, studio *"Kola & Associates"* rezulton të ketë si klientë subjektet ASG Poëer, Diekat Ndërtim & Konstruksion, Vil Oil, Rompetrol, Unione Eolica Albania, Veve, Stream Oil & Gas Limited.

Shoqëria ASG Power Albania sh.a. e cila rezulton të jetë regjistruar me NIPT K71416002M më datë 16.06.2006, e cila si ekspert kontabël ka ndër të tjerë shtetasin Sali Preci, anëtar të këshillit mbikqyrës ndër të tjerë Florenc Kola dhe që prej datës 07.05.2008 si administrator ka shtetasin Fatmir Bektashi, rezulton që referuar VKM nr 778 datë 14.11.2007 të nënshkruar nga kryeministri i kohës, shtetasi Sali Berisha, i është miratuar leja nr 1 datë 13.11.2007 për ndërtimin dhe shfrytëzimin e linjës tregtare me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit Seman (Shqipëri) – Foxhia (Itali), leje kjo e lëshuar nga ministri i Ekonomisë. Madje me prokurën e posaçme nr 501 rep nr 275 kol datë 26.02.2009 para noteres Laura Pustina, shtetasi Fatmir Bektashi në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ka emëruar shtetasin Sokol Barçi që të kryejë veprime në QKB.

Në lidhje me shoqërinë Union Eolica Albania sh.p.k. e regjistruar me NIPT K72428007A më datë 28.12.2007, konstatohet se me Vendimin nr 88 datë 06.08.2008 të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE) është vendosur licencimi i kësaj shoqërie në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre.

Shoqëria Stream Oil & Gas Limited, Dega në Shqipëri, e cila aktualisht ka emrin Transatlantic Albania Ltd. – Dega Shqiptare është regjistruar më datë 05.10.2007 me NIPT K72205016P, rezulton që në bazë të VKM-së nr 509 datë 08.08.2007 të nënshkruar nga kryeministri i kohës Sali Berisha, t'i jenë miratuar 4 marrëveshje hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Ballsh – Hekal; Gorisht – Kocul; Cakran – Mollaj dhe Delvinë, marrëveshje këto të lidhura ndëmrjet kësaj shoqërie dhe Albpetrol sh.a.

Në llogarinë e Abi Bank, Argita Malltezi & Flutura Tafaj (Kola) me numër 001420100011249 euro, për vitin 2006 ka kreditim në llogari, pagesa likujdim faturash Viloil Albano Aliko.

392.5. Në vijim, pas shtimit të pasurisë së paluajtshme, konstatohet se një pjesë e rëndësishme e të ardhurave të shtetasve Malltezi, derivon nga dhënia me qera e këtyre pasurive.

Si qeramarrës evidentohen ndër të tjerë shoqëria *Irene Acqua Gas Albanian Branch*. Kjo shoqëri me NIPT K71808002H e regjistruar më datë 22.05.2007, sipas raportit të auditimit të depozituar në QKB, rezulton se është degë e shoqërisë italiane Iren Acqua Gas s.p.a. Në fund të vitit 2009, ka marrë në dorëzim projekte në Golem e Tiranë lidhur me shërbimet e integruara të ujit dhe të shpërndarjes së gazit. Në vitin 2010 është angazhuar më një projekt të tretë në Bovillë. Projekti i Tiranës dhe Bovillës ka përfunduar në vitin 2013 ndërsa projekti i Golemit do të përfundojë në tre mujorin e parë të vitit 2014.

Konkretisht në ILDKPK është dorëzuar një kontratë qeraje e datës 01.01.2012 lidhur mes shtetasve Argita Malltezi dhe Raimondo Chiodi menaxher i përgjithshëm i shoqërisë Iren Acqua Gas, Dega Shqipëri, i lindur në Libi, për dhënie me qera të pasurisë ap 12/5 me sip 120.5 m² pranë ETC-së, në shumën prej 8 000 euro në muaj.

393. Pasi në vitin 1992 shtetasi Sali Berisha është zgjedhur President i Republikës së Shqipërisë, duke qëndruar në pushtet deri në vitin 1997, shtetasit **Malltezi**, konstatohet se kanë filluar investimet në përfitim të drejtash mbi pasuri të paluajtshme.

394. Referuar deklaratave të pasurisë të dorëzuara në ILDKPKI, konstatohet se, shtetësja Argita Malltezi, ka evidentuar në deklaratën e dorëzuar më dt 16.08.2006, referuar edhe deklaratës dt 31.03.2006, **për vitin 1993, pronësinë vetëm të një apartamenti** banimi, me sipërfaqe 77 m², Rr. **P. Myzeqari, 1993**, përfituar nga privatizimi. Pjesa që zotëron 1/3. Gjithashtu edhe shtetasi **Sali Berisha**, deklaron se zotëron një Apartament 3+1 i privatizuar, të drejta reale zotërojnë deklaruesi, bashkëshortja dhe djali. Në fakt, si shtetasit Argita Malltezi dhe shtetasi Sali Berisha, mesa duket, i referohen të njëjtit apartament, pavarësisht disa diferencave.

Kjo pasuri konstatohet se në vijim, kalon tërësisht në pronësinë e shtetases Argita Malltezi, kundrejt shlyerjes së një huaje që pretendohet se i është dhënë nga i ati, shtetasi Sali Berisha dhe duke përfituar ky i fundit në vijim, në vitin 2007, një pasuri të blerë nga shtetasit Jamarbër dhe Argita Malltezi, të ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti.

394.1. Konkretisht shtetasit Sali dhe Liri Berisha, përfitojnë në bazë të një kontrate shkëmbimi dy pasuri (*apartament dhe garazh*) të ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti që kanë qenë në pronësi të shtetasve Malltezi, më datë **16.07.2007** dhe po në këtë datë, për banesën e ndodhur në rrugën Prokop Myzeqari, konstatohet se bëhet pagesa nga blerësit Vorpsi.

Kontrata e shitjes me nr 1280 rep nr 316 kol, është lidhur më datë **17.07.2007**, ndërmjet **shitësit Argita Malltezi, me pëlqimdhënës shtetasin Jamarbër Malltezi dhe palë blerëse Kujtim dhe Valdete Vorpsi**, për shitjen pikërisht të apartamentit të ndodhur në Tiranë, rruga Prokop Myzeqari, pall. 31, shk. 3, kati 2, ap 29 me sip 76 m² me nr 4/122+3-29 vol 10 faqa 206, kundrejt shumës prej 70 000 euro. Nga informacioni i marrë nga bankat e nivelit të dytë, në bankën Raiffeisen me numër llogarie 201182-EUR-3824000000-01-001, rezulton **një pagesë nga shtetasi Kujtim Vorpsi në datën 16.07.2007** me përshkrim "*të ardhura nga shitja e apartamentit shtetasit Kujtim Vorpsi Rexhep 70,000 euro (8,463,700 lekë)*". Kjo pagesë është deklaruar edhe nga shtetësja Argita Malltezi në deklaratën e datës 31.03.2008.

395. Shtetësja **Argita Malltezi**, në vijim, deklaron (*shih deklaratën për vitin 2005 me datë dorëzimi 16.08.2006 referuar edhe deklaratës dt 31.03.2006*) në lidhje me pronësinë e një **Apartamenti 95 m²**, Rr. L. Prizrenit dhe **garazh 1995-1997** (*dorëzuar entit të banesave 1 apt 65 m² ne rr. A. Demi + 14,000 usd*), në vlerën **24,000 dollarë**. Pjesa që zotëron ½.

Nga aktet konstatohet se, ky apartament është përfituar pikërisht në kohën që shtetasi Sali Berisha ka qenë President i Republikës së Shqipërisë, ku në listën përkatëse të përfituesve, evidentohen disa shoqërues dhe shtetasi Jamarbër Malltezi. Kështu rezulton se, me shkresën nr. 2114 prot. datë 11.06.1996, të nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, Aleksandër Mexhi, i është përcjellë Bashkisë, EKB, Ministrisë së Ndërtimit, Presidencës dhe Ministrisë së Brendshme, duke i bërë me dije se, është miratuar lista nominale, për trajtim me banesë, të shtetasve si vijon: *Pallati në rrugën Lidhja e Prizrenit shkalla 1: Besnik Murati – shoqërues; Jamarbër Malltezi* jurist; *Arjan Adhami* shoqërues; *Ndrea Prendi* shoqërues; *Ylli Pasha* ndërlihdës; *Mehmet Shkreli* shofer; *Izet Haxhia* shoqërues, *Agim Pasha* shofer dhe *Arben Rumniçi* shoqërues. Shtetasi Jamarbër Malltezi është identifikuar se do do të marrë **apartament 3+1 me nr 3 dhe garazh** ndërkohë që dorëzon ap 1+1.

Në praktikën e privatizimit, konstatohet se, **shtetasi Jamarbër Malltezi, identifikohet i vetëm me gjyshen e tij Nimete Bekteshi, në përbërje familjare**, sipas çertifikatës së gjendjes familjare datë 01.12.1992. Në vitin 1995 ai rezulton të jetë martuar me shtetasen Argita Malltezi, martesë nga e cila në dhjetor 1995 kanë një vajzë dhe nga përbërja e çertifikatës familjare, shtetasi Jamarbër Malltezi, rezulton të jetë **në përbërje familjare me bashkëshorten, vajzën Dasara dhe gjyshen Nimete.**

Shtetasit Jamarbër dhe Argita Malltezi, kanë poseduar fillimisht një apartament 1+1 ndodhur në lagjen Ali Demi, me sip të shfrytëzueshme 51.29 m² të cilin me kontratën e shitjes nr 2578 rep nr 498 kol datë 25.08.1997 ia kanë shitur EKB-së, në shumën 802 273 lekë. Në vijim, me kontratë shitje apartamenti banimi me pagesë të njëhershme, datë 31.10.2000, të lidhur ndërmjet shtetasve Jamarbër, Argita dhe Nimete (*kjo e fundit nuk ka nënshkruar*) dhe EKB-së, rezulton se EKB i ka shitur blerësve një ap me nr 3, ndodhur në katin e dytë, shk. 1, banesa nr 4, në rrugën Lidhja e Prizrenit, me sip shfrytëzimi 93 m² (*tre dhoma+një kuzhinë+ambjente të tjera ndihmëse+ garazh = 28.39 m²*). Vlera e apartamentit është 2 175 146 lekë dhe garazhit 340 770 lekë. **Pas uljes së çmimit, rezulton se janë paguar deri në vitin 2000 shuma prej 1 471 003 lekë.** Më datë 28.05.2001 me nr 1487 rep nr 82 kol është lidhur kontratë shitje për këtë pasuri (*apartament dhe garazh*) të ndodhur në rrugën Lidhja e Prizrenit, mes shitësit EKB dhe blerësve Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi (shtetësja Nimete nuk përmendet më), para noteres Gjyltere Pustina.

395.1. Në lidhje me këtë apartament të dytë, mesa konstatohet nga vetëdeklarimet (*deklaratë e datës 16.08.2006 dhe referuar edhe asaj të datës 31.03.2006*), përveç 14 000 USD, janë paguar edhe **20 000 USD përgjatë viteve 1997 – 2000, për kryerje të një ndërtimi shtesë prej 60 m².** Shtetësja Argita Berisha, ka vetëdeklaruar në lidhje me këtë apartament, *Shtesë anësore e pallatit 1997- 2000, 60 m², pa hipotekuar. Pjesa që zotëron 1/2. Vlera 20,000 dollarë.*

Nga aktet e dorëzuara në ILDKPKI, rezulton në fakt se, bazuar në një akt marrëveshje të vitit 1998, pa datë të përcaktuar, është rënë dakord, për ndërtimin e një shtese pallati, me sip 55 m² ndërmjet 6 banorëve të pallatit nr. 4, rruga Lidhja e Prizrenit. Konstatohet se palë janë shtetasit *Besnik Murati, Jamarbër Malltezi, Arjan Adhami, Ndreja Prendi, Urim Bujari, Ylli Pasha* dhe firma ndërtuese *Qoqi* dhe pagesat janë: sip e shtesës 55 m² kushton 495 000 lekë të reja për çdo kat dhe themelet kushton 60 000 lekë të reja për çdo kat. Kjo akt-marrëveshje e dorëzuar në ILDKPKI, është firmosur nga shtetasi Ndreja Prendi, kurse në emrat e banorëve të tjerë në akt- marrëveshje, nuk ka firmë.

Është njohur me këtë dokument shtetasi *Ndreja Prendi*, i cili sqaron se, *firma është bërë nga ana e tij, por, deklaroi se këtë dokument e sheh për herë të parë dhe fakti që gjendet firma e tij, mendon se ka të bëjë me dakordësinë për apartamentin e ri në të njëjtin kat ku kishte shtëpinë. Pra ka firmosur për të shprehur dakordësinë vetëm për katin e tij.*

Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare me nr. 40201835101 (dollarë), ne emer te Jamarber Malltezi, pranë Intesa San Paolo, rezulton se emri i shtetasit *Ndreja Prendi*, shfaqet, kur rezulton të ketë bërë tërheqje me çek rreth vlerës 15 550 USD përgjatë viteve 2003 – 2005, **ku në një nga tërheqjet është cituar për rregullim apartamenti.** I pyetur në lidhje me këto tërheqje parash, shtetasi *Ndreja Prendi*, deklaroi se *ka kryer tërheqje me çek, për porosi që mund t'i ketë dhënë Jamarbri. Në një nga dokumentet shikon që është, për rregullim apartamenti dhe ka qenë për apartamentin që Jamarbër Malltezi ka patur në rrugën Mustafa Matohiti. Sipas porosisë së tij, ka tërhequr me çek paratë nga banka dhe i ka çuar në destinacionin që Jamarbër Malltezi i ka kërkuar me porosi të tij. Edhe tërheqjet e tjera me çek*

që ka bërë në llogari bankare janë sipas kërkesave të shtetasit Jamarbër Malltezi për porosi që i ka lënë për të kryer pagesa të ndryshme për të cilat nuk i mban mend.

Nuk rezulton, transaksion i regjistruar në bankat e nivelit të dytë, për pagesë firmës ndërtuese Qoqi, që referohet të ketë marrë përsipër për ndërtimin e shtesës.

Në një shkresë të datës 20.11.2006 të nënshkruar nga shtetësja Argita Malltezi, administruar pranë ILDKPKI-së, është bërë ky sqarim: "*Akt – marrëveshje sipërmarrje për ndërtimin e pjeshëm të shtesës anësore të pallatit. Akt marrëveshje mbulon ndërtimin e themeleve dhe kollonave. Sqaron se pjesa tjetër e shtesës që konsiston në muret e apartamentit dhe punimet e brendshme, janë bërë me punëtorë artizanë, të punësuar në bazë ditore*". Bashkalidhur është dorëzuar akt marrëveshje e vitit 1998 e nënshkruar vetëm nga shtetasi Ndrea Prendi dhe Aleksandër Krate.

395.2. E gjithë pasuria e ndodhur në rrugën Lidhja e Prizrenit, rezulton në vijim, t'i jetë shitur shtetasit Safet Gjici.

Nga aktet rezulton se, me kontratën e shitjes nr 209 rep nr 30/2 kol datë **26.02.2008**, shtetasit **Argita dhe Jamarbër Malltezi**, i shesin shtetasit Safet Gjici, pasurinë me nr **4/62 ZK 8270 me sip 113.87 m2** pallati 4 shk 1 ap 3, kundrejt vlerës **129 800 euro**, ku çmimi për m 2 është afërsisht 1139.89 euro.

Me kontratën e shitjes nr 210 rep nr 31 kol datë **26.02.2008**, rezulton se shtetasit **Argita dhe Jamarbër Malltezi**, në cilësinë e poseduesit, i kanë shitur shtetasit Safet Gjici, edhe shtesën e apartamentit, e cila ka hyrje më vete, me sip **72 m2**, në krah të apartamentit të sipërcituar, e cila është në proces legalizimi. Çmimi i shitjes është **79 200 euro**. Përfituesi do të mbajë një vlerë prej 10 000 euro, deri në realizimin e kontratës përfundimtare të shitjes, ndërsa pjesa tjetër prej **69 200 euro** do të derdhet brenda dy ditëve nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Për vitin 2007 (*deklaratë datë 31.03.2008*), shtetësja Argita Malltezi ka deklaruar: **Shitur apartament në rr. Lidhja e Prizrenit B. 2 ap. 3 (derdhur tek ABA) në shumën 129 800 euro dhe Shitur shtesë apartamenti Rr. L. Prizrenit, B. 2 (paguar 69 200 euro derdhur tek ABA) në shumën 79 200 euro.**

Referuar të dhënave bankare, rezulton që në nr. e llogarisë 41027535102 në monedhën euro, pranë Bankës Intesa San Paolo, në emër të shtetasës Argita Malltezi, në datën **26.02.2008**, shtetasi Safet Gjici, ka transferuar shumën **199,000 euro** me përshkrim "*likujdim për blerje apartamenti 118 m2* 1100 euro dhe blerje shtese apartamenti 72 m2* 1100 euro, 199,000 euro (24,512,820 lekë)*".

Transaksioni bankar është i vitit 2008, por shtetasja Argita Malltezi, e ka deklaruar në DVIP për vitin 2007, duke bërë shënimin se në llogarinë rrjedhëse pranë ABA, është transferuar i gjithë çmimi për shitjen e apartamentit dhe se kalimi i 50 % të shumës në llogari të bashkëpronarit, do të bëhet më vonë.

Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr 98 rep nr 29 kol datë **11.02.2012** të lidhur ndërmjet shtetasve Argita dhe Jamarbër Malltezi në cilësinë e shitësit dhe shtetasit Safet Gjici në cilësinë e blerësit, duke iu referuar kontratës së shitjes së shtesës së apartamentit, nr 210 rep nr 31 kol datë 26.02.2008, pasqyrojnë se procesi i legalizimit ka përfunduar dhe shitësi është pajisur me certifikatën e pronësinë për pasurinë me nr 4/820+1-2 datë 13.01.2012. Objekt i kësaj kontrate është shitja përfundimtare e apartamentit, ZK 8270 vol 69 faqa 136, me sip 75 m2. Çmimi është vendosur sipas kontratës së mëparshme 79 200 euro nga të cilat janë likuiduar 69 200 euro.

Në kreditimet në bankën Intesa Sanpaolo të shtetases Argita Malltezi, me numër llogarie 41027535102 në monedhën euro, në datë 16.02.2012, shtetasi Safet Gjici ka transferuar shumën 10,000 euro me përshkrim "a/c to a/c transfer, Safet Gjici trfr to Argita Malltezi, parapagim per blerje apartamenti.

395.3. Me kontratën e shitjes garazh, nr 118 rep nr 35/1 kol datë 20.02.2012 rezulton se shtetasi Argita dhe Jamarbër Malltezi, i shesin shtetasit Safet Gjici, pasurinë me nr 4/62-G2 ZK 8270 vol 69 faqa 171 me sip 28.39 m² me adresë rruga Lidhja e Prizrenit ZK 8270, kundrejt çmimit prej 45 424 euro (çmimi për m² është 1600 euro).

Në kreditimet në bankën Intesa Sanpaolo të shtetases Argita Malltezi, me numër llogarie 41027535102 në monedhën euro, në datë 20.02.2012 shtetasi Safet Gjici ka transferuar shumën 45,424 euro me përshkrim "a/c to a/c transfer, likujdim detyrimi për blerje garazhi 28.39 m²".

395.3.1. Për vitin 2012 (deklarata datë 29.03.2013) shtetësja Argita Malltezi deklaroi: *Shitja e një garazhi në rrugën Lidhja e Prizrenit në vlerën 45 424 euro... - Të ardhura nga shitja e pronës së patundshme në rrugën Lidhja e Prizrenit në vlerën 55 424 euro. Tek të dhënat konfidenciale ka deklaruar (kontratë për shitje prone të patundshme për një vlerë prej 45 424 euro dhe një pagesë e prapambetur prej 10 000 euro pas shitjes së një apartamenti ndaj të njëjtit blerës, pagesë që sipas kontratës së mëparshme, do paguhej vetëm pas regjistrimit të pronës në ZRPP) (nr. 118 rep nr. 35 kol datë 20.02.2012).*

395.4. Gjithashtu, konstatohet se shtetësja Argita Malltezi, pavarësisht se rezultoi të ketë shitur apartamentin dhe shtesën në vitin 2008, ka vijuar të deklarojë përfitim qeraje për pasuri të ndodhura në rrugën Lidhja e Prizrenit.

Për vitin 2008, në deklaratën periodike vjetore shtetësja Argita Malltezi deklaroi Qera: *...Nga dhënia me qera e një apartamenti Rr. Lidhja e Prizrenit 1170 euro/ muaj neto, për 4 muaj.* Edhe në DVIP për vitin 2009, kjo shtetase deklaroi: *"...nga dhënia me qera e një apartamenti Rr. Lidhja e Prizrenit 1170 euro/muaj neto X 12 muaj"* Edhe në DVIP për vitin 2010 kjo shtetase deklaroi: *"...nga dhënia me qera e një apartamenti Rr. Lidhja e Prizrenit 1170 euro/muaj neto X 12 muaj"* Edhe në DVIP për vitin 2011 zëri i të ardhurave nga qeraja *...Nga dhënia me qera e një apartamenti Rr. Lidhja e Prizrenit 1170 euro/ muaj neto, për 12 muaj.*

Në lidhje me këtë pasuri, në deklaratën për vitin 2012, shtetësja Argita Malltezi deklaroi: *"... Të ardhura nga shitja e pronës së patundshme në rrugën Lidhja e Prizrenit në vlerën 55 424 euro".* Kurse tek të dhënat konfidenciale deklaroi: *Kontratë për shitje prone të patundshme për një vlerë prej 45 424 euro dhe një pagesë e prapambetur prej 10 000 euro pas shitjes së një apartamenti ndaj të njëjtit blerës pagesë që sipas kontratës së mëparshme do paguhej vetëm pas regjistrimit të pronës në ZRPP. Nr 118 rep nr 35 kol datë 20.02.2012."*

Në vitin 2012 shtetësja Argita Malltezi ka shitur garazhin por nuk e cilëson në deklaratë si garazh por përdor emërtimin "pasuri e patundshme".

396. Me kontratën e shitjes, nr. 4306 rep nr. 1029 kol datë 29.12.2001, para noteres Majlinda Lleshi, parashtohet se shtetasi *Isuf Hoxha* i shet shtetases *Argita Malltezi*, *dyqanin* e ndodhur në katin përdhe të pallatit me sip 30 m², e regj në regj hipotekor nr. 309 datë 22.11.2001, ZK 8350 pasurija nr. 2/193, ndodhur në rrugën *H.Dalliu*. Çmimi i shitjes është 24 000 USD dhe kjo shumë është likujduar nga palët jashtë kësaj zyre noteriale.

Shtetasi Isuf Hoxha, rezulton se këtë pasuri e ka blerë më datë 03.11.2001, para noteres Tamara Malaj, me kontratën nr 4758 rep nr 509 kol datë 03.11.2001 pasi i është shitur nga shtetësja Lirie Kuçi, në vlerën 1 900 000 lekë.

Shtetësja Argita Malltezi, për periudhën 2005 (*deklaratë datë 16.08.2006 referuar edhe deklaratës 31.03.2006*), deklaroi: **Dyqan rruga H. Dalliu 33 m2, blerë në vitin 2003 në vlerën 26,000 euro. Pjesa takuese 1/2. (me shkresën datë 20.11.2006 rezulton se nga shtetësja Argita Malltezi është dorëzuar një kontratë shitje nr. 4306 rep nr. 1029 kol datë 29.12.2001 para noteres Majlinda Lleshi.)**

Referuar këtij vetëdeklarimi, konstatohet se, të dhënat që vetëdeklaroi në lidhje me këtë dyqan, kanë mospërputhje me kontratën e mësipërme, konkretisht përsa i përket sipërfaqes, e cila vetëdeklarohet 33 m2, viti i blerjes i cili vetëdeklarohet 2003 dhe shuma e blerjes, e cila vetëdeklarohet 26 000 euro.

Kurse shtetasi Jamarbër Malltezi, me deklaratën e dorëzuar më datë 31.03.2010 (si person i lidhur me shtetasin Luan Malltezi) deklaroi "...dyqan 33 m2 rr. H.Dalliu" por nuk deklaroi vlerë të pasurisë.

Me një shkresë datë 23.01.2007 (*korrigjuar viti pasi ka qenë 2006*) shtetësja Argita Malltezi i është adresuar ILDKPKI-së si vijon:... **Mospërputhja e konstatuar në vlerën e dyqanit në rrugën Haxhi Dalliu ... janë gabime të rastësishme. Vlera e saktë është ajo e deklaruar në kontratë e cila përputhet dhe me deklaratimet e mia publike.**

396.1. Ky dyqan, rezulton më vonë të jetë shitur sipas vetëdeklarimit të shtetasës Argita Malltezi për vitin 215, (*deklaratë datë 01.04.2016*): **Shitur dyqani prej 28 m2 Rr. Haxhi Dalliu, sipas kontratës noteriale nr. 746 rep nr 350 kol datë 24.04.2015 notere Laura Pustina – 45 000 euro dhe Te ardhura nga shitja e dyqanit 28 m2 te rr. Haxhi Dalliu ...në vlerën 45,000 euro...**

Sërish këtu evidentohet se sip e dyqanit nga 30 m2 zbrit në 28 m2.

Nga aktet, rezulton se, është lidhur një kontratë shitje pasurie e paluajtshme me nr. 746 rep nr. 350 kol datë 24.04.2015 ndërmjet shtetasve Jamarbër dhe Argita Malltezi me shtetasit **Ledio dhe Alma Mushi**, ku këta të fundit, kanë blerë pasurinë e shtetasve Malltezi, e pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie nr serial 1019088 lëshuar datë 21.04.2015, për pasurinë njësi, ndodhur në Tiranë, rruga Haxhi Dalliu, hyrja 1 së bashku me të gjitha shtesat dhe aksesoret e tij, e regjistruar në regjistrin hipotekor me sip total 28 m2, ZK 8350 pas nr. 2/654/ND-N3 vol 30 faqa 73, e rivlerësuar 8 100 000 lekë. Kjo pasuri shitet në vlerën 45 000 euro ose 6 300 000 lekë e cila transferohet ditën e lidhjes së kontratës, në një kësht të vetëm fillimisht në llog e noterit pranë Intesa dhe më pas i kalon shitëses.

Në llogarinë pranë Intesa Sanpaolo me nr 41027535102 në euro, të shtetasës Argita Malltezi, është kredituar nga shtetësja Laura Pustina për Argita Malltezi, me dt. 08.05.2015, kalim i vlerës së shitjes së dyqanit sipas kontratës rep 746 kol 350 dt 24.04.2015, shuma 45,000 euro.

397. Gjithashtu, konstatohet se familja Malltezi, bën një investim të madh, në rrugën Mustafa Matohiti, duke nisur në vitin 2002 me shitës shoqërinë **A.B.A.U. sh.p.k.** e për të vijuar më pas me shoqërinë **Burimi Construction sh.p.k.** apo me shtetasin **Albert Hani**.

398. Me kontratën e sipërmarrjes, datë 10.04.2002 të lidhur ndërmjet shtetasit **Jamarbër Malltezi** dhe shoqërisë **A.B.A.U. sh.p.k.** e përfaqësuar kjo e fundit nga shtetasi **Isuf Çelaj**,

është porositur **ap 2/8 shk 1 sip 195 m2, kati 8, me nr. 2 në planimetri dhe parking nr. 8 në katin nëntokë kundrejt vlerës 125 250 USD**. Mënyra e pagesës është parashikuar të kryhet në këtë mënyrë: 30 000 USD me nënshkrimin e kontratës; 20 000 USD më datë 06.07.2002; 30 000 USD më datë 06.01.2003 dhe 32 725 USD më datë 06.07.2003 kurse diferenca prej 12 525 do të jetë 30 ditë para dorëzimit të çelësve të ambjentëve.

Sipas vërtetimit pa datë, të lëshuar nga shtetasi **Bashkim Ulaj**, ortak i shoqërisë A.B.A.U. sh.p.k. rezulton se ky apartament, përfshirë ambjentet ndihmëse, verandat dhe sip e përbashkëta është **188 m2**.

Në deklaratën për vitin 2005 (datë 16.08.2006 referuar deklaratës datë 31.03.2006), shtetësja Argita Malltezi deklaron: **Apartament dhe vend parkimi, Rr. Musatafa Matohiti, kati 8, sip.188 m2, pa regjistruar, blerë në vitin 2002. Vlera 125,000 dollarë. Pjesa takuese 1/2.**

Pra sipas këtij deklarimi, shtetësja Argita Malltezi konstatohet se nuk deklaron vlerën e saktë, duke hequr një pjesë prej 250 USD.

Gjithashtu, prane ILDKPKI-se, nuk jepen shpjegime në lidhje me pagesën e plotë apo jo të këtij apartamenti dhe garazhi, kohën e kryerjes së pagesës. Nëse i referohemi thjesht deklarimit të saj "blerë" nëkuptohet që deri në vitin 2005, shuma të jetë shlyer tërësisht.

398.1. Me kontratën e shitjes nr 1017 rep nr 228 kol datë **10.07.2007**, para noteres Laura Pustina, rezulton se shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. përfaqësuar nga Ahmet Ulaj, i shtetësit Jamarbër Malltezi, **vendparkimin me sip 21 m2**, me nr ND/2/261-B8 vol 28 faqa 55 ZK 8160 me çmim 10 000 USD, duke u cituar në pikën 5.1 të nenit 5, se **Blerësja i ka paguar shitësit plotësisht çmimin e blerjes së bodrum – vendparkimit**. Konkretisht në nenin 4.1 parashtrohet se, **shitësi ka përfituar çmimin e shitjes së bodrum-vendparkimit në një vlerë prej 10 000 USD i cili i është paguar plotësisht atij, nga blerësi, sipas afateve dhe sasisë së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe jashtë kësaj zyre**. Ai deklaron se këtë çmim e ka përfituar tërësisht.

Për vitin 2007 (deklaratë datë 31.03.2008) rezulton se shtetësja Argita Malltezi, **nuk e deklaron këtë kontratë dhe këtë shpenzim prej 10 000 USD, duke çuar drejt prezumimit sipas edhe të dhënave në kontratë, që paratë për vendin e parkimit, janë paguar sipas kontratës së sipërmarrjes së vitit 2002.**

Për vitin 2020 (deklaratë e interesave private periodike para fillimit të detyrës datë dorëzimi 07.10.2021) shtetësja Argita Malltezi deklaron: **"Bodrum në rr. Mustafa Matohiti, pall. 7 me nr prone ND/2/261-B8 sipas kontratës së shitjes nr 1017 rep nr 228 kol – 10 000 USD"**

Për vitin 2021 (në deklaratën e interesave private periodike vjetore në format elektronik për subjekte në funksion, me nr indeksi 1227 me datë dorëzimi 24.11.2022) shtetësja Argita Malltezi deklaron: **"Pasuri e paluajtshme bodrum, datë regj 13.07.2007, bashkëpronare, vlera 10 000 USD nr pas ND/2/261-B8, ZK 8160 vol 28 faqa 55, sip 21 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 1017 rep nr 228 kol datë 10.07.2007."** Si burim deklaron të gjitha të ardhurat ndër vite, pa përcaktuar saktësisht referuar kohës së blerjes.

398.2. Në lidhje me apartamentin e mësipërm, konstatohet se ndryshon kontrata, **duke u rritur në sipërfaqe apartamenti dhe duke u shtuar edhe një tarracë**. Nga leximi i kontratës së shitjes së poshtë shënuar, konstatohet se është revokuar kontrata për apartamentin me sip 188 m2 **duke u zëvendësuar me një apartament me sip 312 m2**, kundrejt shtimit të një pagese prej 70 000 euro.

Me kontratën e shitjes nr 2720 rep nr 1506 kol datë 26.10.2009, para noteres Laura Pustina, shitësi shoq A.B.A.U. sh.p.k. i ka shitur shtetasve Argita dhe Jamarbër Malltezi, pasurinë e paluajtshme, **apartament**, ndodhur në Tiranë, në rrugën Mustafa Matohiti, **shkalla 1, kati i 8-të, ap. Nr. 26**, me një sip në total prej 312 m2 nga të cilat 253.07 m2 sipërfaqe banimi dhe 58.93 m2 **tarracë**, e identifikuar si pasuria me nr ND/2/261+1-26, volumi 27 faqa 191. Në nenin 4 është përcaktuar se blerësi i kalon shitësit si çmim total për blerjen e pronës objekt i kësaj kontrate:

a. *Shumën prej 125 250 USD të likujduara nga blerësit sipas kontratës së sipërmarrjes datë 10.04.2002 për blerjen e ap nr 2/8 ndodhur në Tiranë rruga Mustafa Matohiti, shkalla 1, kati i tetë (i ndodhur në të njëjtën godinë me ap 26), apartament të cilin blerësit aktualisht ia kanë kthyer shoqërisë A.B.A.U. sh.p.k. duke hequr dorë përfundimisht nga e drejta e pronësisë dhe të drejtat reale të lidhura me të.*

Si dhe vlerën shtesë (për sipërfaqen shtesë të përfutur në ap nr 26)

b. *Shumën prej 70 000 euro si diferencë në çmim përkatësisht si shtesë vlere, përveç apartamentit të kthyer siç përcaktohet në pikën a) ndërmjet kthimit të apartamentit të porositur me kontratën e sipërmarrjes datë 10.04.2002 dhe blerjes së apartamentit sipas përshkrimit të bërë në nenin 2 pika 2.1 e kësaj kontrate (i referohet ND/2/261+1-26)*

Çmimi i shitjes deklarohet se është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi deklaron se këtë çmim e ka përfituar tërësisht.

Pra gjithsej 195 250 USD.

Nga sa më lart, rezulton që shtesa në m2 e konkretisht prej 65.07 m2 më tepër për apartament dhe 58.93 m2 tarracë, është blerë në vlerën 70 000 euro.

Por referuar këtyre të dhënave kontraktore, tërësia e çmimit prej 125 500 USD është dhënë vetëm për apartamentin dhe jo edhe për garazhin, duke çuar në këtë mënyrë, drejt konkludimit se garazhi nuk është paguar dhe është përfituar falas.

Në deklaratën për vitin 2009, (datë 25.03.2010), shtetësja Argita Malltezi deklaron: *Shtim sip. Apartament. Rr. Mustafa Matohiti, kati 8, 65 m2 sip brendshme dhe 59 m2 verande. **Pagesa do kryhet brenda prill 2010***, dhe tek të dhënat konfidenciale ka deklaruar: *kontrata nr 2720 rep nr 1506 kol dt 26.10.2009, 70,000 euro.*

Shtetasi Jamarbër Malltezi për vitin 2009 (dorëzuar më datë 21.03.2010 si person i lidhur me shtetasin Luan Malltezi) deklaron: *Bashkëpronësi apt 253 m2+ 58 m2 verandë + **2 garazhe në rr. M. Matohiti***, - nuk deklaron vlerë....

Konstatohet se shtetasi Jamarbër Malltezi nuk deklaron apartamentin tjetër të porositur në vitin 2002 si më poshtë pasqyrohet, po në rrugën Mustafa Matohiti.

Në llogarinë e shoqërisë Intesa Sanpaolo 41027535102 në euro, më datë 28.12.2010 shtetasja Argita Malltezi, ka tërhequr cash për pagesë shtesë apartamenti, shumën 70,000 euro. **Por në deklaratën për vitin 2010 (datë 30.03.2011), nuk konstatohet të jetë deklaruar bërja e kësaj pagese në këtë vit.**

Në deklaratën e pasurisë (datë 24.11.2022), shtetësja Argita Malltezi deklaroi: **Pasuri e paluajtshme apartament datë regj 29.12.2009, bashkëpronare. Vlera 195 250 euro, nr pas ND/2/261+1-26 ZK 8160 vol 27 faqa 191, me sip 312 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 2720 rep nr 1506 kol datë 26.10.2009.**

Gjithashtu, në të njëjtën deklaratë kjo shtetase deklaroi edhe: **Pasuri e paluajtshme, bodrum, datë regj 13.07.2007, bashkëpronare, vlera 10 000 USD, nr pas ND/2/261-B8, ZK 8160 vol 28 faqa 55 sip 21 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 1017 rep nr 228 kol datë 10.07.2007.**

Pra referuar këtyre të dhënave të deklaruara në vitin 2022, bën që shuma totale e paguar për apartamentin e mësipërm dhe për garazhin të shkojë në vlerë 205 250 euro, ndërkohë që ndër vite, nuk jepen të dhëna në deklarim se kur dhe si janë paguar këto para.

Në nenin 7 të kontratës së shitjes nr 2720 rep nr 1506 kol datë 26.10.2009 për shitjen e apartamentit me sip në total 312 m2, është cituar se pjesë integrale është edhe deklarata noteriale nr 2131 rep nr 549 kol datë 04.07.2007 e notere Xhevahire Brahaj me anë të së cilës është revokuar kontrata e sipërmarrjes datë 16.01.2003 ndërmjet Arben Kadiu dhe shoq ABAU sh.p.k. për apartamentin objekt i kësaj kontrate.

Nga një deklaratë noteriale për, **revokim kontratë sipërmarrje**, nr 2131 rep nr 549 kol datë 04.07.2007, me deklarues shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. përfaqësuar nga Ahmet Ulaj dhe shtetasi Arben Kadiu, rezulton se pasqyrohet, se mes këtyre palëve, është lidhur kontrata më datë 16.01.2003 për një apartament dhe parkim të cilësuar si: **Ap 1/8 shk 1, sip 312 m2 në katin e tetë teknik dhe Parkim nr 4, sipas lejes së ndërtimit nr 22 datë 27.10.2001.** Por në fakt, nga deklarimet e shtetasit Arben Kadiu, rezulton se ai ka porositur një apartament me sip 145 m2. Më datë 30.07.2024 është pyetur shtetasi **Arben Kadiu** i cili ka deklaruar se, **ka porositur te kompania A.B.A.U një apartament në katin e tetë, i nënti banim, në rrugën Mustafa Matohiti, si dhe një garazh po në këtë pallat. Apartamenti ndodhej në shkallën 1, dhe hyrja kryesore ishte nga Mustafa Matohiti, te dera e lokal Meduzës. Këtë apartament, mban mend se e ka porositur rreth vitit 2003 dhe në verën e vitit 2005 ka nisur banimin. Apartamenti ka qenë me sipërfaqe 145 m2, dhe kanë rënë dakort për një çmim rreth 700 euro m2. Në lidhje me këtë apartament ka pagur rreth 70,000 dollarë dhe nuk po e plotësonte dot shumën totale 101,500 euro për apartamentin. Vlera e Garazhit ka qenë dhjetë ose pesëmbëdhjetë mijë euro. Duke qenë se kishte mosmarrëveshje me përfaqësuesit e ABAU-t, për mosplotësim shume, me propozim të atyre dhe dakortësinë e tij, në vitin 2008 ka marrë një apartament me sipërfaqe 100 m2, në të njëjtën zonë, por me hyrje nga rruga Ismail Qemali. Apartamenti ishte në katin e tetë, i nënti banim. Vlera e paguar nga ana e tij 70,000 dollarë e mbulonte koston për 100 m2 dhe në vitin 2008 ka nisur jetesën në objektin e ri. Apartament me kontratën e dytë nuk kishte hipotekë, për vlerën 165,000 euro, ku palën blerëse aktualisht nuk e mban mend. Me lekët që mori, ka blerë apartamentin ku jeton sot, te Gener 2, me sipërfaqe 109 m2 + garazh, për vlerën totale 105,000 euro. Apartamentin të cilin do e linte, është në dijeni që do e merrte shtetasi Jamarbër Malltezi.**

399. Me kontratën e sipërmarrjes datë 10.04.2002, e lidhur ndërmjet shtetasit **Jamarbër Malltezi** dhe shoqërisë **A.B.A.U. sh.p.k.** e përfaqësuar kjo e fundit nga **Isuf Çelaj**, është porositur **ap 3 kati IV, shk. 1, nr. ¼, sip 140.36 m2 në katin e katërt me nr 3 në (3+1) planimetri, parking 7 në katin nën tokë, kundrejt shumës 110 252 USD.** Mënyra e pagesës është parashikuar të kryhet në këtë mënyrë: **20 000 USD me nënshkrimin e kontratës; 10 000 USD më datë 06.07.2002; _____ (nuk është përcaktuar shumë) më datë 06.03.2003 dhe _____**

(nuk është përcaktuar shumë) më datë 06.10.2003, kurse diferenca prej 10 252 do të jetë 30 ditë para dorëzimit të çelësve të ambjentëve.

Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2005 (datë 16.08.2006 referuar edhe deklaratës datë 31.03.2006), shtetësja Argita Malltezi, deklaroi **apartamentin dhe vendparkimin e mësipërm, por çmimin e blerjes e deklaroi 10 252 USD më pak, konkretisht e deklaroi në vlerën 100 000 USD.**

Konstatohet në fakt, se me kontratën e shitjes nr. 961 rep nr. 209 kol datë 03.07.2007, para noteres Laura Pustina, shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. përfaqësuar nga Ahmet Ulaj, në cilësinë e shitësit, lidh kontratë me blerësen Argita Malltezi, me objekt kalimin e të drejtës së pronësisë së apartamentit që aktualisht ndodhet në posedim të blerëses por jo në pronësi të saj. Ky apartament posedohet si pasojë e kontratës së sipërmarrjes në vitin 10.04.2002. Sipas pikës 1.3. të nenit 1, palët pranojnë se blerësja ka shlyer me kohë të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes. Në pikën 4.1. të nenit 4 është cituar se shitësi ka përfituar çmimin e shitjes së apartamentit prej 100.252 USD që është paguar plotësisht sipas afateve dhe sasisë së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe jashtë kësaj zyre. Ai deklaroi se këtë çmim e ka përfituar tërësisht. Apartamenti identifikohet të jetë në rrugën Mustafa Matohiti, shkalla 1, kati 4, nr 11, në një sipërfaqe totale prej 175.36 m² nga të cilat 140.36 m² banim dhe pjesa tjetër, tarrace. Pasuria identifikohet me nr 2/261+1-11 vol 27 faqa 176, ZK 8160.

Sic mund të shihet, në këtë kontratë shitje, nuk përmendet parkingu, por konstatohet se shtohet tarraca me sip 35 m². Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007 (datë 31.03.2008) shtetësja Argita Malltezi, **nuk evidentohet të ketë deklaruar këtë kontratë apo rritjen e sipërfaqes, konkretisht 35 m² të tarracës.**

Gjithashtu çmimi i shitjes vetëm për apartamentin dokumentohet të jetë 100 252 USD duke prezumuar se 10 000 USD janë për parkingun.

Ndodhur në këto kushte, konkludohet se për sipërfaqen prej 35 m² të tarracës, shtetasit Malltezi nuk kanë kryer ndonjë pagesë.

399.1. Me kontratën e shitjes nr 1018 rep nr 229 kol dt 10.07.2007 para noteres Laura Pustina, rezultoi se shitësi shoq tregtare A.B.A.U. sh.p.k. i shet shtetasen Argita Malltezi, një bodrum, si pjesë e porosisë së një apartamenti me anë të kontratës së sip me firmën ndërtuese të pallatit ku ndodhet bodrumi – vendparkimi A.B.A.U. sh.p.k. në 10.04.2002. Kjo pasuri identifikohet si pasuria me nr ND/2/261-B7 vol 28 faqa 544 prej 21 m², dhe rezultoi të jetë e lirë nga çdo barrë e detyrim hipotekor. Sipas nenit 4.1 shitësi ka përfituar çmimin e shitjes së bodrum vendparkimit në një vlerë prej 10 000 USD i cili i është paguar plotësisht atij nga blerësi sipas afateve dhe sasisë së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe jashtë kësaj zyre.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2007 (datë 31.03.2008) shtetësja Argita Malltezi, **nuk evidentohet të ketë deklaruar këtë kontratë.**

Gjurmimi i shlyerjes së pagesave për apartamentet e mësipërme

400. Me një shkresë datë 23.01.2007 (korrigjuar viti pasi ka qenë 2006) shtetësja Argita Malltezi i është adresuar ILDKPKI-së si vijon: ... Mospërputhja e konstatuar në vlerën e

...apartamentit në rrugën Mustafa Matohiti janë gabime të rastësishme. Vlera e saktë është ajo e deklaruar në kontratë e cila përputhet dhe me deklaratimet e mia publike.

Kujtoj se të dy kontratat mbi dy apartamentet e banimit në rr. Mustafa Matohiti janë kontrata sipërmarrje dhe jo kalimi pronësie, rrjedhimisht forma e noterizuar nuk kushtëzon vlefshmërinë e tyre.

Në lidhje me evidentimin e faktit nëse rezultojnë të jenë bërë pagesa për pasuritë e mësipërme janë studiuar llogaritë bankare nga të cilat ka rezultuar:

Në lidhje me pagesa të bëra për shoqërinë A.B.A.U. sh.p.k. rezultojnë të shfaqen në llogaritë bankare si më poshtë:

- Më datë 08.07.2002, është transferuar në llogarinë e shoqërisë A.B.A.U shpk (Saba Dervishi) 20,000 usd me përshkrim "A/C to A/C transfer with check A.B.A.U shpk (Saba Dervishi)".
- Më datë 07.01.2003 është transferuar në llogarinë e shoqërisë A.B.A.U shpk 10,000 usd me përshkrim "A/C to A/C transferim J. Malltezi to A.B.A.U sh.p.k."
- Më datë 07.07.2003 është tërhequr me cek nga shoqëria A.B.A.U shpk (Saba Dervishi) shuma 12,500 usd me përshkrim "cheque withdrawal A.B.A.U. Saba Dervishi".

Pra gjithsej 42 500 USD. Shtetasi Saba Dervishi, rezultojnë të jetë punonjës i shoqërisë Gener 2, siç dokumentohet nga aktet e depozituara në QKB, nga kjo shoqëri.

401. Shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. me NIPT J82427008C, e regjistruar në vitin 1998, rezultojnë të jetë në pronësinë e vëllezërve Ulaj. Fillimisht, ka pasur si ortakë shtetasit *Ahmet dhe Astrit Ulaj*, deri në 26.11.2005, kur me kontratën e shitjes nr 3696 rep nr 539 kol shtetasi Ahmet i ka shitur shtetasit Astrit, kuotat e tij në kapitalin e kësaj shoqërie. Më datë 31.03.2009, edhe shtetasi Astrit Ulaj i shet kuotat e shoqërisë shtetasit Bashkim Ulaj, duke u bërë ky i fundit ortaku i vetëm i kësaj shoqërie, sipas kontratës me nr 1957 rep nr 263 kol. Me kontratën nr 1830 rep nr 348 kol datë 22.04.2009, shtetasi Bashkim Ulaj i shet shtetasit Ahmet Ulaj sërish kuotat e shoqërisë.

Shtetasi Bashkim Ulaj, rezultojnë që në vitin 2005 të ketë blerë 95% të kuotave të shoqërisë Gener 2, e krijuar kjo e fundit në vitin 2003, nga shtetasi Kujtim Dinaj. Në vijim, në muajin tetor 2006, ka blerë edhe 5% të kuotave të ngelura. Aktualisht, ortakë të kësaj shoqërie janë shtetasit *Astrit Ulaj, Bashkim Ulaj dhe Ahmet Ulaj*.

Shoqëria Gener 2 sh.p.k., e cila rezultojnë e regjistruar me dy NIPT-e, e konkretisht më datë 06.07.2003 me NIPT K58615301M, shoqëri e cila në vijim konstatohet se ka depozitime të shumta të akteve në QKB dhe Gener 2 me NIPT K38207306V e regjistruar më datë 14.11.2003 por për të cilën pas vitit 2007 nuk ka më shënime në QKB, është themeluar fillimisht nga shtetasi Kujtim Dinaj, i cili si më lart u theksua i ka shitur kuotat shtetasit Bashkim Ulaj.

401.1. Pasi në muajin tetor 2006 shtetasi Bashkim Ulaj ka blerë përfundimisht kuotat e kësaj shoqërie, dhe pasi më datë 06.12.2006 ka vendosur shtimin e objektit të aktivitetit të saj edhe në fushën minerare, konstatohet se, kjo shoqëri është pajisur me **leje shfrytëzimi minerar nr 1045 datë 31.07.2007, nr 1072 datë 21.09.2007 dhe nr 1073 datë 21.09.2007.**

Konstatohet se shoqëria Gener 2 në kohën që shtetasi Sali Berisha ka qenë kryeministër i Republikës së Shqipërisë, ka siguruar një marrëveshje minerare shfrytëzimi, të lidhur ndërmjet shoqërisë së tij dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, me ministër

në atë kohë shtetasin Genc Ruli. Kjo marrëveshje është miratuar me ligjin nr 9847 datë 17.12.2007, me propozim të Këshillit të Ministrave. Periudha e shfrytëzimit minerar është dhënë për 99 vjet.

I pyetur më datë 29.07.2024, shtetasi *Ahmet Ulaj*, ka deklaruar se, *njihet me të gjithë anëtarët e familjes Berisha. Shtetasin Sali Berisha e njuh personalisht, e ka njohur si pedagog, mjek, si dhe gjatë kohës që ka qenë i angazhuar në politikë, Ahmeti ka patur takime me të, por jo ndonjë marrëdhënie pune. Ka patur raste kur ka qenë në takime me të, si për shembull kur vinin grupe përfaqësuesish nga jashtë vendit, i është kërkuar nga njerëzit e tij apo pjesëmarrës të tjerë në takim që dhe Ahmeti të ishte prezent në ato takime, për shkak se një periudhë kohe të gjatë ka jetuar në Amerikë. Po kështu, i njuh fëmijët e shtetasit Sali Berisha. Argitën e njuh që të vogël. Kujton se në kohën kur ajo ka punuar në Prishtinë, në të njëjtën kohë Ahmeti ka patur një projekt në këtë qytet, gjë e cila e ka bërë që të takoheshin me të më shpesh. Në të njëjtën kohë ka takuar dhe Jamarbrin, si grup shqiptarësh që punonin në Prishtinë. Me Shkëlzenin apo me Argitën nuk ka patur ndonjëherë marrëdhënie të afërt shoqërore.*

402. Pikërisht, në këtë valë rritje aktiviteti të shoqërisë Gener 2, shtetasi Sali Berisha, i cili në vitin 2003, kur vajza e tij kishte nisur blerjen e pasurive të paluajtshme, kishte deklaruar se i kishte dhënë Lekë cash hua, vajzës së tij, me të drejtë kthimi (nga instituti i ish presidentit), në shumën 2 100 000 lekë të reja, për shlyerjen e kësaj pagese, kryen një shkëmbim me pasurinë e të bijës.

Konkretisht, konstatohet se në njërin nga apartamentet e blera tek rruga Mustafa Matohiti, zhvendoset në vitin 2007 familja e shtetasit Sali Berisha. Nga aktet rezulton se, më datë 13.07.2007 është regjistruar në emër të shtetasës Argita Malltezi pasuria me nr ND-2/261+1-11 vol 27 faqa 176 apartament me sip 175.36 m2 dhe pasuria me nr ND 2/261-B7 vol 27 faqa 148 ZK 8160, bodrum me sip 21 m2.

Me kontratën e shkëmbimit nr. 1271 rep nr. 310 kol datë 16.07.2007 (korrigjuar data 16), shtetasit Sali dhe Liri Berisha nga njëra anë e identifikuar si pala 1 dhe shtetësja Argita si pala 2, me pëlqimdhënës shtetasin Jamarbër Malltezi, kanë nënshkruar kontratën, me objekt *kalimi i pronësisë së një apartamenti dhe një bodrum vendparkimi* në pronësi të palës 2 tek pala 1, në shkëmbim të faljes së detyrimit që ka pala 2 ndaj palës 1 prej 2 100 000 lekë dhe pjesëve ideale që pala 1 ka në pronësi në apartamentin e privatizuar (2 pjesë - i ndodhur në rrugën Prokop Myzeqari) dhe që ka qenë në bashkëpronësi ndërmjet palëve të kësaj kontrate. Konkretisht, apartamenti që përfiton familja Berisha, është ai i ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti, shk. 1, kati i katërt, ap. Nr. 11, me sip 175.36 m2, ZK 8160 pasuria nr. 2/261+1-11, vol 27, faqa 176 dhe bodrumi vendparkim ndodhet në rrugën Mustafa Matohiti pallati 7 kati nën tokë, me sip 21 m2, ZK 8160 pasuria ND 2/261 – B7 vol 28 faqa 54. Nëpërmjet kësaj kontrate, kundrejt shumës 2 100 000 lekë të dhënë hua, Argita i kalon prindërve apartamentin dhe vendparkimin të apartamentit tek Mustafa Matohiti, kurse shtetasit Sali dhe Liri, i kalojnë 2/3 që kanë tek rruga Prokop Myzeqari, që e kanë fituar me privatizim.

Si edhe më sipër theksuam, në të njëjtën ditë, që bëhet kontrata për shkëmbimin e pasurive të mësipërme, në të njëjtën ditë rezulton se bëhet edhe pagesa nga shtetasi Kujtim Vorpsi për blerjen nga shtetasit Malltezi të pasurisë së nddhur në rrugën Prokop Myzeqari.

Pra konstatohet se shtetasit Berisha, përfitojnë një apartament për të cilin, nuk është deklaruar ndonjëherë shtimi i tarracës prej 35 m2 dhe nuk është deklaruar apo evidentuar që të jetë kryer, pagesë shtesë për këtë tarracë apo mënyra, koha se si janë kryer pagesat. E

njëjta gjë rezulton edhe për garazhin, ku nuk evidentohet ndonjë gjurmë e kryerjes së kësaj pagese.

Në deklaratën për vitin 2007 (datë dorëzimi 26.03.2008) shtetasi Sali Berisha deklaroi: *një pakësim të 2/3 pjesë të apartamentit që ndodhet në rrugën Prokop Myzeqari p.31 ap 29 dhe likuidim i huasë financiare prej 2.1 milionë lekë dhënë më parë vajzës së tij Argitës, nëpërmjet shkëmbimit pra duke shtuar një apartament në rr. Mustafa Matohiti p. 7 kati 4 dhe një vend parkimi nëntokësor.*

Në deklaratën për vitin 2007 shtetësja Argita Malltezi deklaroi: *Shkëmbyer apartament rr. M.M. P. Z. K4+vendparkimi me 2/3 pjesë apartamenti rr. P. Myzeqari P. 31 ap 29 dhe fshirjen e një huaje pa afat prej 2.1 mln lekësh – pronësinë e një apartamenti në rr. Prokop Myzeqari p. 31 ap. 29, 100% pjesë takuese.*

Nga ana tjetër, në deklaratën e dorëzuar më datë 24.11.2022 shtetasi Sali Berisha përshkruan si burim të dy pasurive apartament dhe garazh, që kanë shkuar në shumën e shpenzimeve të paktën sipas kontratave në vlerën **110 252 USD**, vlerën e apartamentit të mëparshëm sipas privatizimit dhe shumën prej **2 100 000 lekë (89, 1814 lekë kursi mesatar për muajin korrik 2007 dhe gjithsej në USD vlera rreth 23 547 USD)** që kishte deklaruar se i kishte dhënë hua vajzës së tij.

403. Nga aktet rezulton se, me kontratën e shitjes nr 3956 rep nr 924 kol datë 17.10.2007 shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. i shet shtetasit Bashkim Ulaj pasurinë me nr 2/261+1-25 vol 27 faqja 190 ZK 8160 me sip 195 m2, në rrugën Mustafa Matohiti kundrejt shumës prej 58 500 USD. Me kontratën nr 2573 rep nr 860 kol datë **01.09.2010** Bashkim Ulaj, pasurinë e mësipërme e shkëmben me një pasuri tjetër të shoqërisë A.B.A.U. sh.p.k. e konkretisht bodrumi i identifikuar si pasuria me ND-2/261-B29 me sip 20.3 m2. Vetë shoqëria A.B.A.U. konstatohet se e ka regjistruar më datë 03.09.2010 në bazë të një kontrate shkëmbimi.

Me kontratën e shitjes nr 1535 rep nr 875/1 kol datë **04.09.2010**, para noteres Laura Pustina, shoqëria A.B.A.U. sh.p.k. e përfaqësuar nga Ahmetaj Ulaj, në cilësinë e shitësit, i ka shitur shtetasve **Jamarbër dhe Argita Malltezi**, pasurinë e paluajtshme të llojit apartament të ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti, **shkalla 1, kati 8, ap. 25**, së bashku me të gjitha shtesat dhe lidhjet me aksesoret e tij dhe të drejtat reale mbi to (korridoret e brendshme, ambjentet, ballkonet etj) me një sip prej **195 m2**, e identifikuar si pasuria me nr **ND/2/261+1-25 vol 27 faqja 190 ZK 8160**. Sipas nenit 5, pika 1, shitësi ka të drejtë të përfitojë çmimin e shitjes së apartamentit prej **200 000 euro**, i cili i është paguar plotësisht atij nga blerësit, **jashtë kësaj zyre noteriale.**

Shtetasi Jamarbër Malltezi, deklaron për vitin 2009 (deklarim i bërë si person i lidhur me shtetasin Luan Malltezi më datë 21.03.2010): *Bashkëpronësi ap. 195 m2 Rr. M. Matohiti - nuk deklaroi vlerë. Tek të dhënat konfidenciale sërish ky shtetas deklaroi: Ap 195 m2 tek rr. M.Matohiti blerë nga kompania ABAU/Gener 2 - 200 000 euro*

Shtetësja Argita Berisha për vitin 2009, nuk e deklaroi këtë pasuri, por e deklaroi vetëm për vitin 2010: *Apartament 195 m2 te rr. Mustafa Matohiti kati 8, paguar tërësisht nga të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi dhe trashëgimia siç deklarohen në deklaratën e tij të pasurisë, vlera 200,000 euro (50 %). Tek të dhënat konfidenciale ka deklaruar: Kontrata për blerjen e apartamentit me sip 195 m2 në rrugën M.Matohiti është paguar me të ardhurat e bashkëshortit, të krijuara nga punësimi dhe trashëgimia, siç pasqyrohen në deklaratën e tij të pasurisë.*

Pasuria si më sipër, konstatohet se deklarohet që në vitin 2009 ndërkohë që në emër të vetë shitësit, shoqërisë A.B.A.U. sh.p.k. pronësia ka kaluar mbi bazë të një kontrate shkëmbimi të datës 01.09.2010. Ky fakt çon drejt konkluzionit se aktet për fitimin e pasurisë nuk janë kryer në kohën reale të fitimit të pronësisë.

Për vitin 2020 (datë 07.10.2021), shtetësja *Argita Malltezi* ka deklaruar: *Apartament ne rr. M.Matohiti, pall. 7, shk. 1 sipas çertifikatës së pronësisë nr. 230318 datë 16.09.2010 me nr prone ND/2/26+1-25 sipas kontratës së shitjes me nr 1535 rep nr. 875 kol datë 04.09.2010 – 200 000 euro.*

Tek të dhënat konfidenciale kjo shtetase ka deklaruar: *Në deklarinimet e kaluara kam deklaruar pasuri të cilat janë blerë me fonde vetjake të bashkëshortit ose me fonde të përbashkëta, por që janë regjistruar në emrin e bashkëshortit si psh ap në Bulevardin Bajram Curri (ndërtesa ETC), rruga Dervish Hima dhe Rruga Dëshmorët e 4 shkurtit. ...Në këtë deklarinim nuk i kam përfshirë pasi e kam vlerësuar me të drejtë t'u përmbahem strikt kërkesave të ligjit.*

Për vitin 2021 (datë 24.11.2022), shtetësja *Argita Malltezi*, deklaron: *Pasuri e paluajtmshme, apartament, datë regj 04.09.2010, bashkëpronare, vlera 200 000 euro, nr pas ND/2/261+1-25, ZK 8160, vol 27 faqa 190, sip 195 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 1535 rep nr. 875 kol datë 04.09.2010.*

Si burim të ardhurash deklaron: *të ardhura nga puna në Fakultetin e Drejtësisë, UT, në shkollën e Magjistraturës, univeristete private, bursa të ndryshme, 1/3 ap fituar nga privatizimi, puna pranë Unmik, OK, zyrë avokatie, konsulenca, qeratë nga pasuritë e patundshme, botime të disa librave e teksteve universitare, shitje e patundshmërive në bashkësi ligjore, kredi bankare. Shumica e patundshmërive janë blerë me fonde të bashkësisë ligjore. Përyashimisht ato që janë blerë vetëm me fondet vetjake të bashkëshortit (trashëgimia) dhe janë regj në emrin tim 50 % janë deklaruar që janë blerë me fonde të bashkëshortit në deklarinimet e mëparshme pranë ILDKPKI si dhe në këtë deklarinim.*

Pra, shtetësja Argita Malltezi kërkon të vendosë barriera në deklarinimin në ILDKPKI, duke u shprehur se deklaron vetëm ato që janë regjistruar 50 % në ASHK edhe në emrin e saj, pavarësisht se me fonde të kujt janë blerë.

404. Nga aktet rezulton se, në vitin 2007 në emër të shoqërisë A.B.A.U. sh.p.k., është e regjistruar pasuria me nr pas nr. ND/2/261+2-19 vol 27 faqa 213 ZK 8160. Me kontratën e shitjes nr 2120 rep nr 538 kol datë 02.07.2007 shoqëria ABAU sh.p.k. ia shet shtetasit Arben Burimi, kundrejt çmimit 42 303 USD dhe me kontratën e dhurimit nr 4956 rep nr 619 kol datë 10.07.2009, ky i fundit ia ka dhuruar shoqërisë Burimi Construction sh.p.k.

Me Vendimin e ortakut të vetëm datë 07.05.2015 të shoqërisë Burimi Construction sh.p.k. shtetasit Arben Burimi, është vendosur shitja e pasurisë nr ND/2/261+2-19 vol 27 faqa 213 me çmimin 179 000 euro dhe pasuria e llojit garazh e ndodhur në të njëjtën godinë me çmim 17 000 euro shtetasve Malltezi. Ky dokument, evidentohet të jetë gjendur edhe në hard driv-in e sekuestruar pranë studio Pustina, me emrëtimin “Vendim Burimi Construction (1)” datë krijimi 04.05.2015 dhe datë ruajtje për herë të fundit 07.05.2015 ora 13.25. Autor dhe përdorues i fundit, shfaqet përdoruesi “Laura”. Gjithashtu i njëjti dokument është gjendur me emrëtimin “Vendim burimi Construction” me datë krijimi 07.05.2015, me autor Laura, i ruajtur për herë të fundit nga përdoruesi Alma, me datë ruajtje për herë të fundit 05.08.2015.

Me nr. 817 rep nr. 402 kol datë 07.05.2015, rezulton se është lidhur kontratë shitje me rezervë, para noteres Laura Pustina, mes shitësit *shoq Burimi Construction sh.p.k.* përfaqësuar nga *Luan Kastrati* dhe shtetasve *Argita dhe Jamarbër Malltezi*, në cilësinë e blerësit. Konkretisht rezulton se, shitësi në bazë të certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar më datë 13.04.2010, është pronar i pasurisë apartament, të ndodhur në një godinë banimi në Tiranë, në rrugën M. Matohiti, **shk. 2, kati V, ap. 19** së bashku me të gjitha shtesat dhe aksesoret. Ap është i regj me sip **128.3 m²**, ZK 8160, pas nr. **ND/2/261+2-19 vol 27 faqa 213** dhe figuron me barrë hipotekore në favor të Societe, sipas kontratës së hipotekës rep/kol 5368/681 datë 28.07.2009. Çmimi është **179 000 euro** ose 25 060 000 lekë dhe likujdohet me dy këste: *Kësti i parë prej 47 860 euro e barabartë me shumën 6 700 000 lekë ditën e nënshkrimit në llog e noteres që do të shërbejë edhe për shlyerjen e kredisë për të cilën është barrësuar kjo pronë dhe kësti i dytë prej 131 140 euro e barabartë me shumën 18 359 600 lekë në momentin e lëshimit të deklaratës për fshirje hipoteke.*

Nga llogaria bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, 41027535101 në dollarë shtetësja Argita Malltezi, më datë **08.05.2015** transferon në drejtim të noteres Laura Pustina, një shumë prej Shuma **201,554 dollarë** (25,524,798.56 lekë) me përshkrim "*outward transfer overseas txn check, blerje pasurie e paluajtshme, apartament sipas kontrates dt. 08, nr. 817 rep. nr. 402 kol.*"..

Sipas dokumentacionit bashkëlidhur kontratës me mandatin datë **12.05.2015** të Societe Generale Albania dokumentohet: Më datë 11.05.2015 transferta prej **179 000 euro** për kontratën nr. 817/402 datë 08.05.2015 (*ky mandat gjendet tek praktika e kontratës 823/408 datë 08.05.2015*).

Për vitin 2015 (datë deklaratë 01.04.2016) shtetësja Argita Malltezi ka deklaruar: *Blerë apartament 128.3 m² ne rr. Mustafa Matohiti, shkalla 2, kati V, ap 19 sip kont nr 817 dhe nr 402 kol dt 07.04.2015, para noteres Laura Pustina, në vlerën 179,000 euro,*

Për vitin 2020 (datë 07.10.2021) shtetësja Argita Malltezi deklaroi: *Apartament ne rr. M.Matohiti, pall. 7, shk. 1 sipas certifikatës së pronësisë nr. 1127258 datë 05.06.2015 me nr prone ND/2/26+2-19 sipas kontratës së shitjes me nr 817 rep nr. 402 kol datë 07.05.2015 – 179 000 euro*

Për vitin 2021 (datë 24.11.2022), shtetësja Argita Malltezi, deklaroi: *Pasuri e paluajtshme, apartament, datë regj 03.06.2015, bashkëpronare, vlera 179 000 euro, nr pas ND/2/261-2-19, ZK 8160, vol 27 faqa 213, sip 128.30 m², rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 817 rep nr. 402 kol datë 07.05.2015*

405. Shtetasit Malltezi, kanë blerë edhe një pasuri tjetër të paluajtshme, nga shoqëria Burimi Construction sh.p.k. në vitin 2015, pasuri e llojit bodrum.

Nga aktet, rezulton se, me kontratën nr. 823 rep nr. 408 kol datë **08.05.2015**, shoq *Burimi Construction sh.p.k.* e përfaqësuar nga administratori *Luan Kastrati*, i ka shitur shtetasve Argita dhe Jamarbër Malltezi, pasurinë për të cilën disponon certifikatën për vërtetim pronësie nr serial 1009623 lëshuar më datë 05.05.2015, bodrum i ndodhur në Tiranë, rruga M.Matohiti, së bashku me të gjithë shtesat dhe lidhjet me aksesoret e tij, i regj në regj hipotekor me sip **18 m²**, ZK 8160 pas nr. **2/261-B9**, vol 28, faqa 56, kundrejt çmimit prej **17 000 euro** ekuivalente me 2 387 650 lekë, e cila likujdohet në një kësht të vetëm në llog e noteres pranë Intesa – deklaruar nga Argita në ILDKPKI se është paguar nga llog e Jamarbër Malltezi nga Intesa).

Lidhja e kësaj kontrate, kjo pasuri dhe ky shpenzim, nuk është deklaruar nga shtetësja Argita Malltezi, kur është dorëzuar deklarata për vitin 2015.

Në deklaratën për vitin 2018, duke pretenduar se është harruar, shtetësja Argita Malltezi e deklaron: *Bodrum/ parkim rr. Mustafa Matohiti sipas kont nr 823 rep nr 408 kol dt 08.05.2015, në vlerën 17,000 euro (50%) paguar nga llog e bashkeshortit (deklaruar në deklaratën e v. 2018). Konkretisht pasqyrohet deklarimi i saj: Sqaroj se në deklaratën e vitit 2015 blerja e një bodrum/parkim në rrugën Mustafa Matohiti, me vlerën 17 000 euro me anë të kontratës nr 823/408 datë 08.05.2015 është harruar pa deklaruar (pjesa 50%) pasi deklarata e pasurisë dhe interesave është bërë nisur nga shtesat dhe pakësimet në llogaritë e mia bankare ndërkohë që njësisia në fjalë është paguar 100% nga llogaria bankare e bashkeshortit tim. Pjesë e transaksionit (por kontrata të veçanta) ka qenë dhe blerja e një apartamenti dhe parkimi tjetër, në të njëjtën adresë, të cilët janë paguar nga llogaritë e mia bankare dhe janë deklaruar rregullisht. Përsa më lart po ia bashkëngjis sqarimin deklarimit periodik të vitit 2018.*

Për vitin 2020 (datë 07.10.2021) shtetësja Argita deklaron: *Bodrum në rr. M.Matohiti, pall. 7 certifikatë pronësie nr. 1009658 datë 18.05.2015, me nr prone ND/2/261-B9 sipas kontratës së shitjes nr. 823 rep nr. 408 kol datë 08.05.2015 – 17 000 euro.*

Për vitin 2021 (datë 24.11.2022) shtetësja Argita deklaron: *Pasuri e paluajtshme, bodrum, datë regj 13.05.2015, bashkëpronare, vlera 17 000 euro, nr pas ND/2/261-B9, ZK 8160, vol 28 faqa 56, sip 18 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 823 rep nr. 408 kol datë 08.05.2015.*

Sipas dokumentave bashkëlidhur kontratës, me mandatin datë 12.05.2015 të Societe Generale Albania dokumentohet: *Më datë 11.05.2015 transferta prej 17 000 euro për blerje pasurie garazh sipas kontratës 823/408 datë 08.05.2015.*

Më datë 13.03.2015 nga llogaria me numër 41027535102 në monedhën euro e shtetasës Argita Malltezi është transferuar shuma 218,600 euro me përshkrim “Fund transfer from –Argita Malltezi c/a Eur- to- Argita Malltezi C/A usd, këmbim, Eur- Usd”. Më datë 13.03.2015 në llogarinë me numër 41027535101 në monedhën dollarë të shtetasës Argita Malltezi është transferuar shuma 231,060.2 dollarë me përshkrim “Fund transfer from –Argita Malltezi c/a Eur- to- Argita Malltezi C/A usd, këmbim, Eur- Usd”.

Në llogarinë e Intesa Sanpaolo 41027535101 në dollarë të shtetasës Argita Malltezi, më datë 08.05.2015 shtetasja Argita Malltezi transferon te notere Laura Pushtina me përshkrim “outëard transfer overseas txn check, blerje pasurie e paluajtshme, garazh sipas kontratës dt. 08.05.2015, nr. 823 rep. nr. 408 kol.”. Shuma 19,142 dollarë.

Bashkëlidhur gjendet lëvizja e llogarisë së Laura Pushtina nga 01.05.2015 – 12.05.2015 ku reflektohen pagesat për kontratat 823/408 dhe 817/402 në datën 11.05.2015 përkatësisht :
- më datë 11.05.2015 trasnferta prej 17 000 euro për blerje pasurie garazh sipas kontratës 823/408 datë 08.05.2015
- më datë 11.05.2015 trasnferta prej 179 000 euro për kontratën nr. 817/402 datë 08.05.2015

406. Nga aktet, rezulton se, me kontratën nr. 2477/1119 rep/kol dt 20.11.2015, shoq Burimi Construction sh.p.k. e përfaqësuar nga administratori Luan Kastrati, i ka shitur shtetasve Argita dhe Jamarbër Malltezi, pasurinë për të cilën disponon certifikatën për vërtetim pronësie nr serial 1283806 dt 19.11.2015, bodrum i ndodhur në Tiranë, rruga M.Natohiti, së bashku me të gjithë shtesat dhe lidhjet me aksesoret e tij, i regj në regj hipotekor me sip 28 m2,

ZK 8160 pas nr. 2/261-B24, vol 28, faqa 71, kundrejt çmimit prej **26 370 euro** ekuivalente me 3 665 200 lekë, e cila **likujdohet në një kësht të vetëm në llog e noteres pranë Intesa**).

Për vitin 2015 (deklaratë datë 01.04.2016) shtetësja Argita Malltezi, ka deklaruar: *Bodrum/ parkim ne rr. Mustafa Matohiti, shk 2, sipas kont nr 2477 rep nr 1119 kol dt 20.11.2015, notere Laura Pustina në vlerën 26,370 euro.*

Për vitin 2020 (deklaratë datë 07.10.2021) shtetësja Argita deklaroi: *Bodrum në rr. M.Matohiti, certifikatë pronësie nr. 1283322 datë 26.11.2015, me nr prone 2/261-B24 sipas kontratës së shitjes nr. 2477 rep nr. 119 kol datë 21.11.2015 – 26 370 euro*

Për vitin 2021 (deklaratë datë 24.11.2022), shtetësja Argita deklaroi: *Pasuri e paluajtshme, bodrum, datë regj 24.11.2015, bashkëpronare, vlera 26 370 euro, nr pas ND/2/261-B24, ZK 8160, vol 28 faqa 71, sip 28 m2, rruga Mustafa Matohiti, kontratë shitje nr 2477 rep nr. 1119 kol datë 20.11.2015...*

Nga llogaria e Intesa Sanpaolo Bank 40201835102 euro, më datë **23.11.2015** shtetasi Jamar Malltezi transferon te notere Laura Pushtina me përshkrim "*outward transfer.fund transfer from Jamarbër Malltezi c/a eur to Laura Pustina kontratë shitje nr. 2477 rep. Nr. 1119 kol. Dt. 20.11.2015, blerje garazh*". Shuma 26,370 euro.

Bashkëlidhur gjendet Kontrata e Dhurimit me nr 4955 Rep /618 Kol, datë 10.07.2009 ku shtetasi Arben Burimi i dhuron një budrum prej 28.1 m2 me nr pasurie ND -2/261-B24, në rrugën Mustafa Matohiti, subjektit Burimi Construction me administrator Luan Kastrati .

Edhe për këtë pasuri, konstatohet se nga ekspertimi i kryer për hard drive-in e sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton dokumenti "*Vendim Burimi Construction nëntor 2015*" me datë krijimi 20.11.2015 me autor Laura dhe i ruajtur për herë të fundit më datë 20.11.2015 nga përdoruesi Alma. Sipas këtij vendimi më datë 19.11.2015 shtetasi Arben Burimi si ortak i vetëm i shoqërisë Burimi Construction sh.p.k. vendos shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit apartament të ndodhur në ZK 8160, pas e llojit garazh me nr pas 2/261-B24, vol 28 faqa 71 me çmimin prej 26 370 euro përkatësisht z. Jamarbër Malltezi dhe znj. Argita Malltezi, sipas kushteve dhe modaliteteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

407. Shtetasi *Albert Muharrem Hani*, ka blerë një pasuri të identifikuar si pasuria me nr ND-2/261+1-10 vol 27 faqa 175, ZK 8160 me sip 121.9 m2, në rrugën Mustafa Matohiti, në shumën **150 000 euro**. Konkretisht nga aktet rezulton se, me kontratën nr 7226 rep nr 1832 kol datë **23.12.2010**, shtetasit *Maurizio Magnanelli dhe Alma Lena* i kanë shitur shtetasit **Albert Hani** apartamentin me sip 121.9 m2 ZK 8160 me nr pas ND/2/261+1-10 vol 27 faqa 175 pall 1 shk. 4 ap nr 10, ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti kundrejt shumës prej 150 000 euro, shumë e cila është likujduar jashtë zyrës noteriale. Konstatohet se me kontratën e huasë nr 2127 rep nr 1675 kol datë 29.06.2011 shtetasi Eduart Demiri i jep hua shumën prej 160 000 euro shtetasit Albert Hani dhe për këtë qëllim vendoset garanci hipotekore mbi apartamentin e mësipërm. Huaja do të shlyhet deri më datë 15.09.2011.

Nga analizimi i llogarisë me numër 417072533CLIDCFEURJH, në monedhën euro, në Bankën Kombëtare Tregëtare rezulton se shtetasi Albert Hani më datë 23.12.2010 ka kryer një depozitim në këtë llogari në vlerën 150,000 euro dhe po në datën 23.12.2010, ka kryer dy transferta në shumat 50,000 euro dhe 100,000 euro.

Shtetasi Albert Hani rezulton të jetë njohje e shtetasit Shkëlzen Berisha. Ai rezulton të përfshihet në dy transaksione qeraje dhe shitje/shkëmbimi me shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Shkëlzen Berisha.

407.1. Fillimisht evidentohet se shtetasi Albert Hani, ka shkëmbyer pasurinë e mësipërme, prej 121.9 m² me pasurinë e shtetasve Gashi, në të njëjtën me ndërtesë me sip prej 102.6 m². Më pas këtë pasuri ia jep me qera dhe ia shet në vijim shtetasit Jamarbër Malltezi.

Shtetasi **Halil Gashi**, në deklarinimin e dhënë më datë 02.08.2024, ka deklaruar se *me bashkëshorten kanë dy apartamente në rr. Mustafa Matohiti. Këto apartamente ndodhen në katin e katërt në këtë rrugë, dhe është i njëjti kat me banesën ku jeton Sali Berisha. Për shkak të arsyeve ndryshme, si disa probleme shëndetësore të bashkëshortes, dëshira për të qenë afër qendrës së Tiranës, si dhe për të patur vajzat pranë njëra tjetrës, kanë vendosur që të largohen nga Fieri, pasi atje kanë banuar më përpara, dhe kanë kërkuar që të blenin apartamente në Tiranë. Kanë patur disa variante, por, më i leverdisshmi për ta ishte pallati që ndërtohej nga ABAU në rrugën Mustafa Matohiti. Porosia për dy apartamente është bërë në vitin 2001 ose 2002, nuk e mban mend saktë, ndërsa fizikisht kanë hyrë në apartament në janar të vitit 2004. Në janar të 2004 Halili i kishte të dy apartamentet, te njëri jetonte, ndërsa tjetri ishte bosh. Çmimi total i blerjes, sipas kontratës, mesa kujton ka qenë rreth 80,000 dollarë. Në fakt, çmimi real i blerjes ka qenë pak më i lartë, rreth 90,000 dollarë. Të gjitha pagesat janë bërë cash, me tre kështe, por në vitin 2007 kur kanë marrë certifikatat e pronësisë, kanë paguar dhe pjesën 10% të shumës 80,000 USD. Apartamentet nuk i kanë dhënë me qera asnjëherë, i kanë patur gjithmonë në përdorimin dhe pronësinë e tyre. Albert Hanin e njeh vetëm si person, por nuk ka marrëdhënie shoqërore me të. Mban mend se në katin e tyre, kanë patur si komshi Alma dhe Mauricio, të cilët kanë banuar aty të paktën deri në vitin 2010. Më vonë, nuk e di se për çfarë arsye, por Alma e shiti hyrjen e saj te shtetasit Albert Hani. Ky apartament ka qëndruar bosh të paktën deri në vitin 2013, kur Alberti i ka propozuar për ta ndërruar kokë me kokë me apartamentin e Halilit. Në katin e tyre ka qenë banor edhe Sali Berisha, pasi gjithsej janë 4 apartamente. Kur Sali Berisha u bë kryeministër dhe siguria e tij u rrit shumë në katin që jetonin, Albert Hani ka biseduar me Halilin dhe i ka propozuar që të bënin shkëmbim apartamentesh. Ky shkëmbim ishte në favorin e tyre, pasi përpos që do të merrnin një apartament pak metra më të madh, por gjithashtu apartamentet do të afroreshin njëri me tjetrin dhe do ta shmangnin pjesën e sigurisë së kryeministrit të asaj kohe Sali Berisha. Ndodhi shkëmbimi, sot Halili ka apartamentet përballë njëri tjetrit. Di të thotë gjithashtu se Albert Hani nuk ka jetuar asnjëherë në këtë apartament. Nuk e di shumë mirë motivin, përse Albert Hani u fut në tratativa me shtetasin Halil, por ishte çështje shoqërie me Shkëlzenin, djalin e Sali Berishës. Noterja ku është lidhur kontrata e shkëmbimit (notere Laura Pustina), nuk është zgjedhur nga ana e Halilit dhe tek kjo notere, ka qenë vetëm për këtë gjë.*

Shtetësja **Luljeta Gashi** ka deklaruar më datë 02.08.2024 se në katin e katërt, përveç dy apartamenteve që kishte familja e saj, ishin dhe dy apartamente të tjera. Njërin e kishte Sali Berisha, ndërsa tjetrin e kishte një zonjë me emrin Alma dhe bashkëshorti i saj italian. Në kohën kur Sali Berisha është bërë banor pallati, ai nuk kishte detyra shtetërore por ishte vetëm kryetar partie. Pas disa kohësh, sic ka marrë vesh, Alma dhe shtetasi Italian ndahen, dhe Alma kërkonte të shiste shtëpinë. Pas disa kohësh, **blerës është bërë Albert Hani**, të cilin personalisht nuk e njeh, por i di vetëm emrin. Pasi Alberti bleu apartamentin, për rreth 1-2 vjet ka qëndruar bosh. Më vonë, Sali Berisha u bë kryeministër dhe siguria e tij u rrit shumë në katin që jetonin. Për këtë gjë, ishin pak të shqetësuar, pasi ndiheshin si në monitorim dhe të skeduar. Apartamentet që kishte familja Gashi ndodheshin përballë me apartamentin e Sali Berishës dhe Albert Hanit. Në këto kushte, Albert Hani ka biseduar me bashkëshortin e Luljetës, dhe i ka propozuar që të bënin shkëmbim apartamentesh. Ky shkëmbim ishte në favorin e familjes Gashi, pasi përpos që do të merrnin një apartament pak metra më të madh, por gjithashtu

apartamentet do të afroheshin njëri me tjetrin dhe do ta shmangnin pjesën e sigurisë së kryeministrit të asaj kohe Sali Berisha. Ndodhi shkëmbimi.

407.2. Nga aktet rezulton se, më datë 03.09.2013, sipas të dhënave përfuara nga ekspertimi kompjuterik i hard drive-it të jashtëm të sekuestruar pranë studio Pustina, është përgatitur kontrata e shkëmbimit për vitin 2013 mes shtetasve *Albert Hani, Edlira Hani dhe shtetasve Halil Gashi e Luljeta Gashi*. Këta dy të fundit kanë në pronësi apartamentin nr **ND/2/261+1-12 ZK 8160 vol 27 faqa 177 me sip 102.6 m2** dhe e shkëmbejnë me apartamentin e ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti, shk. 1, kati 4, ap. 10 me sip 121.9 m2.

Me kontratën e shkëmbimit nr 1944 rep nr 986 kol datë **04.09.2013**, para noteres Laura Pustina është lidhur kontrata e shkëmbimit mes shtetasve *Albert Hani dhe Edlira Hani* nga njëra anë dhe *Halil Gashi dhe Luljeta Gashi* nga ana tjetër. Albert Hani ka shkëmbyer pasurinë apartament me nr 10 shk. 1 kati 4, rruga Mustafa Matohiti, me **sip 121.9 m2** i regjistruar më datë 04.01.2011 me nr ND/2/261+1-10 ZK 8160 vol 27 faqa 175 me apartamentin me sip 102.6 m2 i regjistruar më datë 13.07.2007 në pronësi të shtetasve Gashi, i identifikuar si i ndodhur në shk. 1, kati 4, ap. 12 regjistruar me nr pas ND-2/261+1-12 ZK 8160 vol 27 faqa 177.

Shtetasit Gashi, e kanë blerë këtë pasuri në shumën 33 828 USD dhe e kanë regjistruar më datë 13.07.2007.

407.3. Nga aktet, rezulton se, disa ditë më vonë, pasi shtetasi *Albert Hani* e ka përfituar këtë pasuri si më sipër cituar, **sapo e regjistron më datë 10.09.2013, ka lidhur kontratë qeraje për të njëjtin apartament me shtetasin Jamarbër Malltezi**, para noteres Laura Pustina, me nr 20517 rep nr 1071 kol datë **13.09.2013**, për një periudhë një vjeçare, nga data **10.09.2013**, për shumën mujore prej 35 000 lekë në muaj.

407.4. Me kontratën e shkëmbimit nr 1153 rep nr 408 kol datë **25.04.2017** para noteres Laura Pustina, shtetasi Jamarbër Malltezi, shkëmben pasuri me shtetasit Albert Hani dhe Edlira Hani. Konkretisht, shtetasi Jamarbër Malltezi pasqyrohet se është pronar i vetëm i dy pasurive të paluajtshme të llojit njësi, ndodhur në rrugën Frosina Plaku në Tiranë, Kompleksi Homeplan, regjistruar në ZRPP Tiranë. Origjina e prejardhjes është nga trashëgimia ligjore (*e ndjera mamaja e tij*)...Pasuritë identifikohen të jenë: *Pasuria e llojit njësi me nr 3/201+3-N2 ZK 8220 njësi me nr 2 sip 56.4 m2, vol 28 faqa 101*, inskriptuar më datë 16.03.2015 në favor të Raiffeisen Bank, në katin përdhe të godinës 9 katëshe, shk. 3, kompleksi Homeplan dhe *Pasuria e llojit njësi me nr 3/201+4-N3 ZK 8220 njësi me nr 3 sip 66.8 m2, vol 28 faqa 199*, inskriptuar më datë 13.10.2015 në favor të BKT, në katin përdhe të godinës 9 katëshe, shk. 4, kompleksi Homeplan.

Pala e dytë, **shtetasi Albert Hani**, rezulton të ketë në pronësi të tij: Pasuri e llojit apartament me nr **ND/2/261+1-12 ZK 8160 vol 27 faqa 177 me sip 102.6 m2** ndodhur në Tiranë rruga Mustafa Matohiti. Përsa më sipër bien dakord për shkëmbimin e pasurive të mësipërme.

407.4.1. I pyetur më dt 30.07.2024, shtetasi *Albert Hani*, ka deklaruar se, është biznesmen në fushën e ndërtimeve, prej 25 vitesh dhe aktualisht ka një shoqëri me emrin *Altansed Construction Shpk*. Në këtë kompani është administrator dhe pronar me 50% të kuotave, ndërsa pjesën tjetër të kuotave e ka Etnik Sopot. Me këtë kompani ka ndërtuar një objekt në Yzberisht, 11 kate, dhe aktualisht është në fazë për plotësimin e dokumentacionit për miratimin e lejes së ndërtimit për një objekt tjetër pranë Liqenit të Farkës. Ai sqaron se ka patur një apartament të cilin e ka blerë nga një shtetase shqiptare që ishte e martuar me një italian, emrin nuk ia di, në

vitet 2009-2010. Mesa mban mend, apartamenti ka qenë 2+1, rreth 100 m², dhe çmimi i blerjes, ka qenë rreth 150,000 euro. Apartamenti ndodhej në katin e dytë ose të tretë të banimit, me aq sa kujton. Rreth 2-3 vite më vonë, pra në vitet 2012-2013, këtë apartament e ka shkëmbyer me një person tjetër, me mbriemrin Gjeci, ose Kola, i cili kishte nevojë për të pasi kishte banesën tjetër ngjitur, ndërkohë që Albertit i interesonte ta shkëmbente sepse nuk po plotësonte pritshmëritë e tij. Kështu që, e shkëmbeu me një apartament tjetër, kokë më kokë, por ky që mora Alberti, ishte me pamje nga jugu dhe me pritshmëri më të mira për ta shitur. Apartamentin e ri, e ka mbajtur dy - tre vjet, e më vonë, në vitin 2016-2017, iu krijua një mundësi për ta shkëmbyer me një dyqan te kompleksi Partizani, te ndërtimet e reja te Fatmir Bektashi. Dyqani ishte rreth 110 m², por që ishte i ndarë në dy numra pasurie. Shkëmbimi është bërë me shtetasin Jamarbër Malltezi, të cilin e njihte si njeri publik por që nuk kishte patur ndonjëherë marrëdhënie me të. Nuk e kujton mirë si moment, por i duket se është bërë shkak administratori i pallatit, i cili ishte një meso burrë, e që merrej me çështjet administrative. Me shumë mundësi ky ka qenë negociatori, duke qenë se Alberti tentonte ta shiste. Duke qenë se ndodhi shkëmbimi, dyqanet i ka akoma dhe nuk i ka shitur. Me Jamarbërin kanë diskutuar dhe kanë rënë parimisht dakort. Ai i ka thënë të shkonte të shihte dyqanin rreth 110 metra dhe të vendoste. Alberti ka shkuar në objekt vetëm dhe ka menduar se ka pritshmëri të mira për të ardhmen, për ta shitur shpejt dhe me një çmim të favorshëm. Kanë rënë dakort dhe kanë lidhur kontratën. Me bashkëshorten e vet nuk e ka diskutuar këtë çështje. Nuk ka dashur të impenjohet me dhënien me qira të pasurive të përfituara tek kompleksi Partizani. Dëshira e tij është që t'i shesë, por që nuk ka gjetur ende një blerës. **Në lidhje me apartamentin që ka shkëmbyer me shtetasin Jamarbër Malltezi deklaron se nuk ka jetuar ndonjëherë dhe nuk e ka dhënë ndonjëherë me qera.**

Gjendur para deklarimeve të tij se apartamentin në fjalë nuk e ka dhënë ndonjëherë me qera dhe se shtetasin Jamarbër Malltezi e njihte si person publik kur ka bërë shkëmbimin por nuk e ka njohur më parë, është njohur me kontratën e qeradhënies së vitit 2013. Shtetasi Albert Hani ka deklaruar se, nuk e kujton dhe nuk e mban mend por nëse ka dokumenta nuk e kundërshton. Lekët pretendon se duhet t'i ketë marrë në dorë, të gjithë shumën menjëherë, pasi nuk ka transaksione bankare me të.

I ripyetur më datë 12.08.2024, shtetasi **Albert Hani** pasi është paraqitur vetë me qëllim që të jepte deklarime shtesë, ka pretenduar se ia ka dhënë me qera shtetasit Jamarbër Malltezi me qëllim që ta shihte nëse i pëlqente apo jo dhe ia ka dhënë për rreth një vit. Vlera nuk i kujtohet dhe pretendon se e ka marrë cash, jo muaj për muaj por në shuma pjesore. Pretendon se pagesa në organet tatimore në lidhje me qeranë, është bërë nga punonjësit e firmës së tij, duke orientuar në drejtim të firmës Altan Sed Construction.

Shtetasi Albert Hani, nga të dhënat e ofruara nga QKB rezulton se është ortak në 10 subjekte tregtare, nga të cilat, vetëm tre subjekte kanë qenë ekzistuese në vitin 2013, kur presumohet se është dhënë qeraja. Konkretisht:

- subjekti *Frideus* sh.p.k. i regjistruar më datë 29.10.2008 me NIPT K82229010T në bashkë ortakëri me shtetasin Ali Çerenishti, dhe ky subjekt rezulton me flamur të kuq për shkak të mbarimit të afatit të administratorit.
- Subjekti *Misk* sh.p.k. i regjistruar më datë 03.12.2008 me NIPT K82403002T në bashkë ortakëri me shtetasin Gerhard Sulaj, dhe ky subjekt rezulton me flamur të kuq për shkak të mbarimit të afatit të administratorit.
- Subjekti *Ge – Al Security* sh.p.k. me NIPT L11620004D i regjistruar më datë 20.04.2011 në të cilin rezulton në bashkë ortakëri me shtetasin Genti Sauku dhe ky subjekt rezulton me flamur të kuq për shkak të mbarimit të afatit të administratorit.

Në deklaratat e pasurive të shtetasve Argita Malltezi dhe Jamarbër Malltezi, (për vitin 2013 të dy këta shtetas kanë plotësuar deklaratë pasurie) nuk rezultojnë të jetë deklaruar marrëdhënia e qerasë së sipërpërshkruar.

407.5. Ndërkohë, në lidhje me dy pasuritë e ndodhura në kompleksin Partizani, rezultojnë se ato kanë qenë fillimisht të regjistruara në emër të shoqërisë Homeplan sh.p.k. në vitin 2012. Këto pasuri fillimisht rezultojnë të kenë qenë të bllokuara në bazë të kontratës së hipotekimit me Nr. 1817 Rep dhe Nr. 1139 Kol e lidhur me dt. 27.09.2013, në favor të Union Bank dhe vijojnë të bllokohen edhe në vitet në vijim.

Me kontratën nr 9007 rep nr 1661 kol datë **28.10.2014**, shoqëria Homeplan sh.p.k. rezultojnë të ketë marrë kredi në vlerën 300 000 euro pranë Bankës Union Bank, me qëllim pagesën e pjesëshme të lejes së ndërtimit të kompleksit Magnet dhe kthim overdrafti në kredi standarte. Për të garantuar kredinë, vendosen në favor të Union Bank sh.a. disa pasuri të paluajtshme ku ndërmjet tyre evidentohen edhe dy pasuritë e mësipërme e konkretisht: pasuria **Njësi Nr.2 me sipërfaqe totale 56.4 m²**, regjistruar ne regjistrin hipotekor me Nr.719, Date 09.07.2012 dhe me Nr.Pasurie 3/201+3-N2, Volumi 28, Faqe 101, ne ZK 8220, i ndodhur ne adresen kati perdhe te Godines 9-kate, ne Rrugen: "*Frosina Plaku*", Tiranë, dhe **Njësi Nr.3 me sipërfaqe totale 66.8 m²**, regjistruar ne regjistrin hipotekor me Nr.817, date 09.07.2012 dhe me Nr.Pasurie 3/201-4-N3, Volumi 28, Faqe 199, ne ZK 8220, i ndodhur ne adresen kati perdhe te Godines 9-kate, ne Rrugen: "*Frosina Plaku*". Tiranë.

Në deklaratën noteriale, me nr 1380 Rep /614 Kol , dt **10.06.2016**, deklarohet si më poshtë: Raiffeisen Bank sha ka lidhur me Kredimarrësit **S. Naqellari dhe K.Naqellari** një kontratë kredie bankare me nr 773 Rep/ 375 Kol më datë 26.02.2015; një kontratë Kredie bankare me nr 774 Rep/376 Kol dhe një Kontratë Hipoteke me nr 775 Rep/377 Kol, datë 26.02.2015 me hipotekues shoqërinë Homeplan sh.p.k. Sipas Kontratës së Hipotekës, Hipotekuesi Homeplan, ka hipotekuar në favor të përfituesit Bankë Raiffeisen sh.a ndër të tjera pasurinë e paluajtshme "Njësi" me nr. Pasurie **3/201 + 3 – N2**, Rruga "*Frosina Plaku*", Godina 9 kateshe, Njësi nr 2, Shk 3, ZK 8220, me sipërfaqe totale 56.4 m², Vol 28, faqe 101. Me kërkesë të kredimarrësve dhe hipotekuesit dhe sipas Draft Shtese Kontrate Shkëmbimi i Kontratës së Shkëmbimit nr **1892 Rep / 1038 Kol, datë 17.08.2012** lëshohet kjo deklaratë noteriale ku Raiffeisen Bank shprehet dakord për kalimin e pronësisë mbi pasurinë e përshkruar më sipër nga shoqëria HOMEPLAN në favor të **Z. Jamarbër Malltezi**. Njëkohesisht banka deklaroi se barra hipotekore vendosur mbi pronën e mësipërme në favor të Raiffeisen Bank dhe mbartet nga pronari i ri **Jamarbër Malltezi**, i cili do të bëjë një kalim pronësie me barrë, që do të regjistrohet në ZRPP Tiranë dhe pasuria do të vazhdojë të mbetet e bllokuar në favor të Raiffeisen Bank deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve që Kredimarrësi Znj. **S. Naqellari** dhe **Z. K. Naqellari** kanë ndaj Raiffeisen Bank në bazë të kontratave të kredisë bankare dhe kontratës së hipotekës së sipërshtetë.

407.5.1. Më datë **24.08.2016** është nënshkruar Shtesë Kontratë Shkëmbimi me nr. 2070 Rep nr. 921 Kol, para noteres Laura Pustina, ndërmjet **Shoqërisë Homeplan shpk** (Investitori) dhe **Jamarbër Malltezi (pala pronare)**. Fillimisht është parashtruar se, *midis investitorit dhe palës pronare është lidhur kontrata e shërbimit nr. 1892 rep nr. 1038 kol datë 17.08.2012, sipas të cilës, pala pronare ka përfituar në shkëmbim të pjesës së tij takuese të truallit pasuritë apartament nr. 44 me nr pasurie 30/201+3-44 dhe garazh nr. 4 me nr pasurie 3/201+3-G4, pasuri të ndodhura në objektin Strukturë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kate dhe 1 kat parkim nëntokë ndodhur në rruga Frosina Plaku. Në vijim të përmbushjes plotësisht të shkëmbimit të pjesës takuese të palës pronare me sip ndërtimore në objektin "Strukturë banimi dhe*

shërbime 5, 7 dhe 9 kate dhe 1 kat parkim nëntokë” në rrugën Frosina Plaku, i ndërtuar në përputhje me lejen e sheshit të ndërtimit sipas vendimit nr. 136 datë 29.12.2007 të KRRT, lejen e zhvillimit nr. 1/1 prot datë 21.05.2012 dhe lejes së përdorimit nr. 46 prot datë 02.07.2012, **palët vendosin të bëjnë shtesat e mëposhtme në kontratën e shkëmbimit:**

Objekt i kësaj kontrate është shkëmbimi i truallit të palës pronare, të specifikuar në nenin 2.1 duke respektuar pjesën takuese të palës pronare në sip e përgjithshme ndërtimore të rënë dakort me shtesën e kontratës së sipërmarrjes nr. **8166 rep nr. 1249 kol datë 22.10.2007** të noteres Ruko Sako dhe konkretisht të ndarë në apartamente, njësi tregtare dhe parkime sikurse specifikohen në nenin 2 pika 2 të kësaj kontrate të cilat ndodhen në objektin Strukturë banimi dhe shërbime 5, 7 dhe 9 kate dhe 1 kat parkimi nëntokë, në rrugën Frosina Plaku, Tiranë.

Ndërtesa është ndërtuar me kontributin financiar të investitorit në përputhje me lejen e sheshit të ndërtimit sipas vendimit nr. 136 datë 29.12.2007 të KRRT, lejen e zhvillimit nr. 1/1 prot datë 21.05.2012, lejes së përdorimit nr. 46 prot datë 02.07.2012 si dhe planvendosjes së zonës së zhvillimit të lëshuar nga Bahskia Tiranë.

Bazuar në kontratën e sipërmarrjes nr. **4938 rep nr. 831 kol datë 22.05.2006** të noteres Ruko Sako, palët kanë rënë dakort për ndërtimin e një objekti në trojet e bashkëpronarëve të familjes **Begeja** duke vendosur në dispozicion të investitorit pasuritë e ndodhura në ZK 8220 me të dhënat e mëposhtme: pasuri nr. 3/116, me sipërfaqe truall 435 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.122, datë 24.02.2012, pasuri nr. 3/156, me sipërfaqe truall 300 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.50, datë 26.01.2012, pasuri nr. 3/163, me sipërfaqe truall 495 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.125, datë 24.02.2012, pasuri nr. 3/165, me sipërfaqe truall 470 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.124, datë 24.02.2012, pasuri nr. 3/166, me sipërfaqe truall 27 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.121, datë 24.02.2012, pasuri nr. 3/167, me sipërfaqe truall 6318 m², e ndodhur në regjistrin hipotekor nr.123, datë 24.02.2012, **Pala pronare krahas pasurive të përfituara në kontratën e shkëmbimit nr. 1892 rep nr. 1038 kol datë 17.08.2012 me qëllim përmbushjen e plotë të shkëmbimit do të përfitojë nga shkëmbimi i pjesës së tij takuese mbi pasuritë e lartpërmendura të vendosura në dispozicion të investitorit edhe pasuritë e përshkruara më poshtë:**

1. Pala pronare do të përfitojë njësinë e llojit Njësi të përshkruar më poshtë:

Njësi nr. 3 me nr. Pasurie 3/201+4-N3, vol 28 faqa 199, ZK 88220 me sip **66.8 m2** të ndodhur në rrugën Frosina Plaku në katin përdhe të godinës 9 katëshe Tiranë, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 817 datë 09.07.2012 pronë e cila vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë lëshuar nga ZVRPP Tiranë më datë 30.05.2016, bashkangjitur kontratës ndodhet planimetria.

Kjo pasuri është e inskriptuar me nr. 253 datë 13.10.2015 në favor të BKT-së. Pala pronare ka dhënë pëlqimin e saj për transferimin e pronësisë në emër të saj duke mbartur edhe transkriptimin përkatës për këtë pasuri në favor të BKT-së.

2- Pala pronare do të përfitojë njësinë e llojit Njësi të përshkruar më poshtë:

Njësi nr. 2 me nr pasurie 3/201+3-N2, ZK 8220, vol 28 faqa 101, me sip **56.4 m2**, ndodhur në rrugën Frosina Plaku, në katin përdhe të godinës 9 katëshe, Tiranë, regjistruar në regj hipotekor me nr. 719 datë 09.07.2012, pronë e cila vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë lëshuar nga ZVRPP Tiranë, më datë 30.05.2016, bashkangjitur kontratës ndodhet planimetria.

Kjo pasuri është e inskriptuar me nr. 25 datë 16.03.2015 në favor të Raiffeisen Bank sh.a. Pala pronare ka dhënë pëlqimin e saj për transferimin e pronësinë në emër të saj duke mbartur edhe inskriptimin përkatës për këtë pasuri në favor të Raiffeisen Bank.

407.6. Nga të dhënat e përfuara nga ekspertimi kompjuterik i hard drive-it të jashtëm të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se është gjendur dokumenti i ruajtur me emërtimin “Draft kontrate shkëmbimi Albert Hani – J.Malltezi” i krijuar më datë **15.09.2016** dhe i ruajtur për herë të fundit po në këtë datë nga “Laura”. **Kjo kontratë shkëmbimi, konstatohet se është**

përgatitur për t'iu vendosur data e muajit shtator 2016 dhe ka të bëjë me shkëmbimin e pasurive të sipërcituara me pasurinë e shtetasit Albert Hani prej 102.6 m² ndodhur në rrugën Mustafa Matohiti.

Gjithashtu, konstatohet nga të dhënat e përfuara nga ekspertimi si më sipër, se është përgatitur sërish kontrata e shkëmbimit, mes shtetasve Jamarbër Malltezi dhe Albert Hani më datë **15.11.2016** për t'iu vendosur **data e muajit nëntor 2016**. Personi i fundit që ka ruajtur këtë dokument më datë 15.11.2016 është shtetësja "*Laura*".

Në përfundim, rezulton se është përgatitur më datë 24.04.2017 dhe është ruajtur për herë të fundit më datë 27.04.2017 **kontrata e shkëmbimit** për këtë apartament, duke i vendosur datën **25.04.2017**.

Marrëdhënia e shtetasve Albert Hani dhe shtetasit Shkëlzen Berisha si dhe përfshirja e shtetasit Jamarbër Malltezi

408. Nga aktet rezulton se, shtetasi Albert Hani ka pasur një marrëdhënie kontraktore edhe me shtetasin Shkëlzen Berisha.

Me kontratën e qerasë nr 2305 rep nr 734 kol datë 15.11.2007, para noteres Laura Pustina, shtetasi **Albert Hani i jep me qera shtetasit Shkëlzen Berisha**, një pasuri të llojit apartament banimi me sip 216.6 m² i ndodhur në katin e dhjetë të ndërtesës në kullën nr 2, të cilën e dispononte në bazë të një kontrate shitje me rezervë, me nr 588 prot datë 23.11.2006, lidhur me shoqërinë Edil Al-It. **Qeraja do të ketë një afat pesë vjeçar, duke filluar nga data 01.11.2007 deri më 31.12.2012** dhe qeraja do të jetë në shumën mujore prej 500 euro, e cila do të paguhet brenda datës 05 të çdo muaji në formë paradhënie në cash.

Me kontratën nr 22/ 10/4 rep/kol dt **07.01.2013** është vendosur zëvendësimi i kreditorëve në kontratën e porosisë me objekt Apartamentin tip 7 me sip. ndertimi 193.1 m², kati 10, godina European Trade Centre, Kulla nr. 2, me orientim perendim dhe veriperendim, duke kaluar, te drejtat reale, te njohura, ne baze te kontrates se shitjes me rezerve nr. 588 prot. dt 23.11.2006 ndermjet z. Albert Hani dhe shoq. Edil Al It dhe kontrates se porosisë me objekt garazhin nr. 50 ne katin nendhe sip 20.2 m², duke kaluar te gjitha te drejtat reale te njohura ne baze te kontrates se shitjes me rezerve nr. 61 prot. dt 02.02.2007 ndermjet z. Albert Hani dhe shoq. Edil Al It, **te pala e dyte kreditori zevendesues z. Shkelzen Berisha**. Kalimi i te drejtave dhe detyrimeve mbi apartamentin dhe garazhin kundrejt pageses **346,000 euro (do shlyhet brenda 8 muajsh me ane te kredise bankare qe do akordohet nga 1 banke e nivelit te dyte per shlyerjen e cmimit te kalimit te pasurive)**. Me marrjen e certifikatave te pronesisë ne zvrpp A. Dulaku njuh si pale ne kontraten perfundimtare te shitblerjes se ketij ambjenti banimi dhe garazhit z. Shkelzen Berisha.

Me kontratën nr 1484 rep nr 768/2 kol datë **22.07.2013**, para noteres Laura Pustina, shitësi shoqëria "*Edil Al It*" i shet palës blerëse Shkëlzen Berisha, Apartament Rr. Bajram Curri, Shk. 1, kati IX, ap. 7, sip 198.1 m², zk 8160, pasuri nr. 2/276+1-7, vol 39, fq. 179. Tiranë dhe Garazh Rr. Bajram Curri, sip 20.2 m², zk 8160, pasuri nr. 2/276-G50, vol 39, fq. 11. Tiranë. Çmimi i shitjes sipas kontratave të shitjes me rezervë nr. 588 prot. date 23.11.2006 ne shumen **270,750 euro** dhe nr. 61 prot. dt 02.02.2007 ne shumen **49,500 euro që jane shlyer tërësisht nga z. Albert Hani (porositës i parë i apartamentit)**. **Z. Albert Hani likujdohet per kete shume nga pala blerese sipas Kontratë per zevendesim kreditori Nr. 22 Rep. Nr. 10/4 Kol dt. 07.01.2013**. Ky apartament në vijim i është shitur shtetasit Myftar Lumeshi në vlerën **600 000 euro** sipas kontratës më nr 2718 rep nr 1183 kol datë 09.12.2015.

Nga një dokument i evidentuar nga të dhënat e ekstraktuara nga hard drive-i i sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se më datë 15.11.2018 është krijuar një dokument i ruajtur për herë të fundit më datë 18.03.2019 nga autore "Odeta" me emërtimin "Sqarime për ILDKPK-në Z..." ku në pikën 7 jepen sqarime për këto marrëdhënie mes shtetasit Shkëlzen Berisha dhe shtetasit Albert Hani.

409. Me kontratën e hipotekimit nr 3326 rep nr 1146 kol datë 21.12.2018, të lidhur ndërmjet Intesa San Paolo Bank dhe shtetasit Jamarbër Malltezi, ky i fundit, pasurinë e përfituar si rezultat i shkëmbimit më shtetasin Albert Hani, e vendos me barrë hipotekore referuar një kredie që ka marrë shoqëria Logal sh.p.k. (Shkëlzen Berisha) sipas kontratës me nr 3346 rep nr 1158 kol datë 24.12.2018 në vlerën 1 800 000 euro. Fondet e kësaj kredie do të përdoren për blerjen e tokave në Marqinet. Nga aktet, rezulton se, bëhet fjalë për 3 pasuri të llojit arë, me sip të përgjithshme 6183 m²; truall + ndërtesë me sip 14 220 m², blerë me kontratën e shitjes nr 7217 rep nr 2198 kol datë 1.12.2018 para noteres Gentiana Shkodra, nga shitësit shoq Abduramani sh.p.k., shoq Mulliri i Artë sh.p.k., dhe Agur Guramani.

Shtetasi Albert Hani fillimisht mohon ekzistencën e qerasë, e më pas i gjendur para dokumentit, pretendon se, *në fakt nuk ka qënë ndonjëherë qëllimi i dhënies me qera por që ka shërbyer thjesht si një hallkë e fshehjes së përfitimit të pasurisë. Ai pretendon se tatimi mbi qeranë është paguar nga shoqëria Altaen Seed Construction ndërkohë që kjo shoqëri nuk ka ekzistuar në atë kohë.* Ky shtetas, më datë 02.08.2024, pretendon se, *apartamentin e mësipërm ia kishte lënë me qera një zyrtari të OSHEE-së, pasi shtetasi Shkëlzen Berisha e ka marrë me qera këtë apartament dhe e ka shfrytëzuar mbi bazë të kësaj kontrate, ndoshta për një vit.* Ai dorëzon edhe një kopje të statement bankar, ku evidentohen pagesa nga shtetasi Najem P.Hejsek në shumat mujore prej 2 500 euro. Nga data 09.02.2010 deri më datë 24.01.2012, janë bërë derdhje parash pranë llogarisë bankare të shtetasit Albert Hani, me urdhërues CEZ A.S.

Pikërisht vitet 2013, 2015 dhe 2016, kanë rezultuar edhe me problematikë për shtetasen Argita Malltezi në ILDKPKI, ku kjo e fundit ka pasqyruar në dokumentin mbikërkimin e informacioneve sqaruese: *"...1. Familjari i subjektit, shtetësja Argita Berisha rezulton me mosmbulim (të ardhurat neto nuk mbulojnë shtesën e aseteve neto) në shumën rreth 5 900 000 lekë v. 2013, në shumën 8 000 000 lekë v. 2015, në shumën rreth 2 600 000 lekë v. 2016. Sqarime dhe dokumentacion justifikues në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shtesën e aseteve për periudhën 2012, 2013, 2015, 2016 (psh të ardhurat nga b/shorti, shitje e aseteve të luajtshme ose të paluajtshme, kopje kontratash qiraje etj). ...1. Duke qënë se familjari i subjektit, shtetësja Argita Berisha rezulton me mosmbulim (të ardhurat neto nuk mbulojnë shtesën e aseteve neto) në v. 2012, v. 2013, v. 2016, duhet të jepen sqarime dhe të paraqitet dokumentacion justifikues në lidhje me të ardhurat e b/shortit për të bërë të mundur llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë periudhë (psh të ardhurat nga paga, honorare, shitje e aseteve të luajtshme ose të paluajtshme, të ardhura qiraje etj)..."*

Të dhënat që deklarohen nga shtetasit Malltezi dhe Berisha në ILDKPK tashmë prej vitesh duket se mbahen dhe përpunohen nga studio Pustina, siç rezulton edhe nga të dhënat e ekstraktuara nga akti i ekspertimit të hard drive-it të jashtëm të gjendur në studion Pustina. Në vitin 2014 përgjatë muajit mars ruajtur për herë të fundit nga useri me emrin "Odeta" rezulton se janë përgatitur tabelat në lidhje me llogaritë bankare, të ardhurat dhe shpenzimet e shtetasve Malltezi dhe Berisha për vitin 2013. Pasi janë ruajtur në formate excel në datë 25.03.2014 në orën 16.36 pa u vendosur shpenzime për pasuritë, në orën 20.17 të po kësaj dite është vendosur të ruhet sërish dokumenti me ndryshime e konkretisht deklarimin e pagesës për rikonstrukcion

shtëpie (i referohet pasurive tek Gjiri i Lalzit si më poshtë) në vlerën 5 000 000 lekë për shtetasin Jamarbër Malltezi dhe 45 000 euro ose 6 291 000 lekë për shtetasen Argita Malltezi (në të njëjtën pasuri).

Më datë 06.11.2018 konstatohet se përgatitet përgjigja për ILDKPKI-në me autor dhe ruajtur për herë të fundit nga useri "Odeti", përgjigje e cila rezulton se pasi i është vënë datë 07.11.2018, është dorëzuar në ILDKPKI. Në lidhje me të ardhurat, shtetësja Argita Malltezi, për vitin 2013 ka cituar sërish të ardhurat e vendosura në delaratën e pasurisë duke u shprehur se janë të mjaftueshme për të mbuluar shtesën e aseteve. Nuk konstatohet të ofrojë të dhëna mbi të ardhurat e bashkëshortit.

410. Në vitin 2004, familja Malltezi, investon në fshatin Priskë, duke blerë dy sipërfaqe toke prej 3 000 m², në shumën totale prej 4 950 000 lekë, si dhe ka bërë edhe një shpenzim në drejtim të shtetasës Laura Pustina, në vlerën 1 000 000 lekë për t'u marrë me procedurat administrative. Konstatohet se në kontratat që lidhen për blerjen e tokës, **referohet se pagesat bëhen cash.**

Konkretisht, rezulton se më datë 05.06.2004, është lidhur një kontratë porosie, ku shtetasi **Jamarbër Malltezi** në cilësinë e porositësit dhe **Laura Pustina** në cilësinë e të porositurës, pasqyrojnë se **Jamarbëri ka për synim blerjen e një sipërfaqe toke prej 3 000 m² në fshatin Priskë**, pronë e familjes së Selman Myrta. Sipërfaqja është në gjendje të lire, por **e paazhurnuar dhe regjistruar në ZRPP**. Porositësi ka rënë dakord me të porositurën, që kjo e fundit të ndjekë të gjithë procedurat administrative, ligjore, ndërmjetësuese me pronarin e tokës dhe të tretët si të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e kontratës së shitblerjes së tokës. **Për këtë qëllim porositësi i ve në dispozicion të porositurës e cila pranon, një shumë prej 1 000 000 lekë të reja.** Palët bien dakord që kjo shumë do të përdoret për azhurnim, rilevim, regjistrim, bashkimin e ngastrave, veprime ligjore hipotekore etj.

410.1. Më datë 05.10.2004 realizohet shitja e dy pasurive tokë arë. Planet e rilevimit për këto pasuri për shtetasin Selman Myrta janë përgatitur në dhjetor 2003 dhe në shtator dhe tetor 2004 nga shtetasi **Petrit Kullulli**.

410.1.1. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr 1817 rep nr 133 kol datë 05.10.2004 para noteres Gjyltere Pustina, janë paraqitur me cilësinë e shitësit shtetasi Selman Myrta dhe të pranishëm bashkëshortja dhe fëmijët e tij dhe me cilësinë e blerësit **Jamarbër dhe Argita Malltezi**. Konkretisht është rënë dakord të shitet pasuria e llojit tokë arë, **në fshatin Priskë e madhe, Tiranë, nr pasurie 370/14 ZK 3051 regj në ZVRPP Tiranë 2, vol 8 faqa 201 me sipërfaqe 730 m², kundrejt çmimit 1 000 000 lekë. Shitësi konfirmon se ka marrë në dorëzim cash në dorë shumën prej 1 000 000 lekë jashtë zyrës noteriale, para momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate.**

410.1.2. Me kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. 1818 rep nr. 134 kol datë 05.10.2004 para noteres Gjyltere Pustina, me shitës Selman Myrta dhe të pranishëm bashkëshortja dhe fëmijët e tij dhe blerës **Jamarbër dhe Argita Malltezi**, është rënë dakord të shitet pasuria e llojit tokë arë, **në fshatin Priskë e madhe, Tiranë, nr pasurie 370/16 ZK 3051 regj në ZVRPP Tiranë 2, vol 8 faqa 203 me sipërfaqe 2270 m², kundrejt çmimit 3 950 000 lekë. Shitësi konfirmon se ka marrë në dorëzim cash në dorë shumën prej 3 950 000 lekë jashtë zyrës noteriale para momentit të nënshkrimit të kësaj kontrate.**

410.2. Në deklaratën e vitit 2005 shtetësja Argita Malltezi, deklaron: *3,000 m² tokë, fshat Priskë, Blerë në vitin 2004, Vlera 6,000,000 lekë. Pjesa takuese 1/2.*

Siç mund të shihet ky deklaram nuk përputhet në vlerë. E gjithë toka ka kushtuar 4 950 000 lekë dhe 1 000 000 lekë i janë dhënë për shërbime shtetases Laura Pustina. Pra në total janë shpenzuar 5 950 000 lekë dhe siç u theksua shumë prej 1 000 000 lekë i është dhënë shtetases Laura Pustina.

Në deklaratën për vitin 2009, shtetasi Jamarbër Malltezi deklaron: *Bashkëpronësi 3 000 m² tokë Priskë - nuk deklaron vlerë*

Në deklaratën, e dorëzuar më datë **07.10.2021**, shtetësja Argita Malltezi, deklaron: *Tokë bujqësore 3 000 m² në fshatin Priskë sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr pasurie 370/18 me kontratë shitblerje nr 1817 rep nr. 133 kol datë 05.10.2004 dhe kontratë me nr 1818 rep nr 134 kol datë 05.10.2004. Vlera sipas kontratës së blerjes është në shumën 4 950 000 lekë por janë bërë pagesa për punime shtesë në infrastrukturë me rreth 1 000 000 lekë – deklaron vlerën 4 950 000 lekë.*

Siç mund të vërehet, deklarimi referon për shpenzime në infrastrukturë, duke mos u pasqyruar të dhënat e sakta në lidhje me qëllimin e shpenzimit të shumës prej 1 000 000 lekë, të cilat rezultojnë se i janë dhënë shtetases Laura Pustina për shpenzime.

Deklarimet nuk janë konsistente referuar shumës së shpenzimit dhe arsyet e shpenzimit.

Në deklaratën e dorëzuar më datë **14.11.2022** shtetësja Argita Malltezi deklaron: *Pasuri e paluajtshme, arë, datë regj 20.10.2004, bashkëpronare, vlera 4 950 000 lekë, nr pas 370/18, ZK 3051, vol 8 faqa 219, sip 3000 m², përshkrimi: Vlera sipas kontratës së blerjes është në shumën 3 950 000 lekë por që janë bërë pagesa për punime shtesë në infrastrukturë, rreth 1 000 000 lekë, kontratë shitje nr 1818 rep nr. 134 kol datë 05.10.2004. Si burim deklaron të ardhura nga puna pranë UNMIK, OKB, prill 2000 – dhjetor 2005.*

Sërish vijon të deklarohet se 1 000 000 lekë janë paguar për punime shtesë në infrastrukturë.

410.3. Konstatohet se, për pasurinë, pas nr 370/14+16 vol 8 faqa 201, Priskë e Madhe më datë 16.10.2004 nga shtetasi **Petrit Kullolli** është përgatitur Plan rilevimi, me qëllim bashkim pasurie. Madje në plan rilevimi **gjendet edhe emër, mbiemër e nënshkrim i shtetasit Jamarbër Malltezi.**

Emri i shtetasit Petrit Kullolli, është një emër i cili shfaqet në vendimet e Komisionet të Kthimit të Pronave, në lidhje me pronat e njohura dhe kthyera familjes Begeja, pikërisht në cilësinë e anëtarit të grupit që ka shqyrtuar dokumentacionin për kthimin e pronës pesë familjeve të njohura pronare.

I pyetur më datë **05.10.2023**, ky shtetas ka deklaruar se është punësuar pranë Zyrës Rajonale të AKKP-së Tiranë reth muajit janar – shkurt të vitit 2006 në pozicionin e topografit, pasi familjes Begeja, si për shembull shtetasin Jamarbër Malltezi dhe nëse kishte kryer ndonjëherë e punë për ta, si plan rilevime etj. ai është përgjigjur: “...*Kurrë, asnjehere. Une e njoh Jamarber kam bere asnje pune per te apo per trashegimtarët e tjere Begeja.*”

Sipas çertifikatës së rivlerësimit datë **03.12.2011**, ekspertja **Elvira D.Lame**, e ka rivlerësuar pasurinë me nr 370/18 ZK 3051, vol 8 faqa 219 mbi bazë të kërkesës së Jamarbër Malltezit, në shumën **15 000 000 lekë**.

411. Një investim tjetër në këtë periudhë, shfaqet edhe në Gjirin e Lalzit. Konstatohet se kontrata është lidhur me shoqërinë Lura sh.p.k.

Nga aktet rezulton se, me Vendimin nr 4 datë 16.09.2000 të KRRTRSH, nënshkruar nga shtetasi Ilir Meta, është vendosur të miratohet studimi urbanistik dhe sheshi i ndërtimit me sip 12 ha për fshat turistik në parcelën nr 5 të zonës turistike të Gjirit të Lalzit në Rrethin e Durrësit, në distancë 150 m2 nga bregu i detit, sipas planimetrisë bashkëlidhur. (Lura 1). Gjithashtu me vendimin nr 10 datë 19.10.2001 të KRRTRSH nënshkruar nga shtetasi Ilir Meta, është miratuar leja e ndërtimit për fshatin turistik në parcelën nr 5 në zonën turistike të Gjirit të Lalzit.

412. Me kontratën e sipërmarrjes, nr 4268 rep nr 1382 kol datë **08.09.2004**, para noteres Arjana Mallkuçi, ndërmjet shoqërisë Lura sh.p.k. dhe porositësve Argita Malltezi dhe Jamarbër Malltezi, nga ana e porositësve, është porositur një vilë dy katëshe me çati me sip **166 m2**. Kjo sip ndodhet: *Në katin e pare është 85 m2 e ndarë me: 71 m2 sip e brendshme, 4 m2 sip shkalle, 10 m2 sip shkalle + verandë; Në katin e dytë është 81.05 m2 e ndarë në: 71.16 m2 sip e brendshme, 3.41 m2 sip ballkonesh, 6.48 m2 sip ballkoni*

Së bashku me vilën, klientit do t'i jepet edhe një pjesë trualli që përbëhet nga bazamenti i vilës, ambjentet e përbashkëta, parkimi i saj. Kjo sipërfaqe, jepet në përdorim për një periudhë **99 vjeçare** në bazë të marrëveshjes së qerasë, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe shoqërisë Lura, mbi dhënien me qera të pronës së paluajtshme që ndodhet në parcelën nr. 5 në zonën turistike të Lalzit. Porositësi do të paguajë një qera mujore të truallit prej 20 euro në muaj. *Çmimi i vilës që është rënë dakord është 50 000 euro ose 300 euro/m2*. Mënyra e pagesës është me çek nr. 313 me vlerë 15 000 USD dhe pjesë – pjesë deri në përfundimin e objektit.

412.1. Me vërtetimin datë **26.07.2005** të lëshuar nga administratori dhe ortaku Dod Doçi, është pasqyruar se, pas mbarimit të punimeve të vilës me sip 166 m2 kontraktuar nga Jamarbër Malltezi, **vlera e paguar prej këtij të fundit është 56 000 euro** për shkak të punimeve të kërkuara nga porositësi.

Sipas deklarimit të datës 31.07.2024, shtetësja **Esmeralda Doçi**, ka deklaruar se kontrata e parë është kontratë sipërmarrje e lidhur në vitin 2004 për një apartament tip dubleks, në kompleksin Lura 1, objekt i emërtuar nga shoqëria Lura sh.p.k. me nr D5, me palë Lura sh.p.k. si sipërmarrës dhe palë porositëse shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi Ky ndërtim është nga të parat që ka bërë shoqëria Lura sh.p.k. Ia kanë shitur shtetasve Malltezi me 300 euro/m2 kur kostot kanë qënë rreth 200 euro/m2. Likujdimi është bërë me pjesë, disa pagesa janë bërë me çek bankar, një pjesë janë bërë cash.

412.2. Nga kqyrja e dokumentave pranë shoqërisë Lura sh.p.k., rezulton se është gjetur një dokument i titulluar "Faturë" për klientin Jamarbër dhe Argita Malltezi. Në këtë faturë paraqitet detyrimi sipas kësaj kontrate dhe pagesat e kryera për vlerën 50 000 USD. Konkretisht pasqyrohen këto pagesa:

- çek nr 313 (15 000 USD) (e cila ka si dokument shoqërues çek nr 314 datë **09.09.2004**, në vlerën 15 000 USD lëshuar për Marte Doçin, në emër të Jamarbër Malltezi referuar bankës Chevy Chase Bank);

- MA 27 datë **11.04.05** (10 000 euro) (që i referohet mandatit të arkëtimit nr 27 datë 11.04.2005 arkëtuar nga Jamarbër Malltezi, "Prenotim vile Gjiri i Lalzit (kësti i II-të), paguar cash);
- MA 43 datë **26.05.2005** (8 000 euro) (që i referohet mandat arkëtimi me nr serial 0002938 paguar nga Jamarbër Malltezi 8 000 euro, paguar cash);
- Çek BIA datë **26.07.2005** (12 000 USD). Nga analizimi i të dhënave bankare, në vitin 2005, në bankën Intesa, me numër llogarie 40201835101 monedha dollar, është paguar shuma 12,000 usd (1,167,960 lekë) me përshkrim "Tërheqje me çek Dode Doci (Firma Lura), kësti i 4-të".

Sipas kësaj fature, kanë mbetur **pa u paguar 9 879 euro**, por duke qenë se klienti ka bërë edhe punime të tjera shtesë në verandë, ristela, alumini etj. në vlerën **6 281.40 euro**, detyrimi sipas kontratës plus punime shtesë ka arritur në vlerën **16 160.4 euro** të cilat janë paguar nëpërmjet çekut nga ABI Bank në emër të Jamarbër dhe Argita Malltezi më datë **10.04.2006** nga nr i llogarisë 40201835101 në vlerën **19 634.89 USD** ekuivalente me 16 160.4 euro.

Në deklarinimin e saj të datës 31.07.2024 shtetësja *Esmeralda Doçi* sqaron se, *pala blerëse ka bërë edhe disa punime shtesë të kryera nga shoqëria Lura sh.p.k. në një vlerë rreth 6 000 dollarë të cilat i ka paguar por nuk i kujtohet nëse është bërë pagesa me bankë apo cash.*

Në lidhje me blerjen e vilës së mësipërme, shtetësja Argita Malltezi, për vitin 2005, sipas deklaratës datë 16.08.2006 referuar në deklaratën e datës 31.03.2006, deklaroi: *Gjysëm vile në bregdet Gjiri i Lalzit 166 m2. Blerë në vitin 2003, pa regjistruar. Vlera 56,000 euro.*

Kurse në deklaratën e datës 03.11.2010 (për vitin 2009) e shtetasit Jamarbër Malltezi, deklaruar si person i lidhur me shtetasin Luan Malltezi, është deklaruar "...1/2 vilë 160 m2 në Lalëz" pa u deklaruar vlerë.

Gjithashtu duke iu rikthyer, deklarinimit në ILDKPKI për vitin 2005 të shtetasës Argita Malltezi, në lidhje me blerjen e vilës së mësipërme, shtetësja Argita Malltezi, sipas deklaratës deklaroi: *Gjysëm vile në bregdet Gjiri i Lalzit 166 m2. Blerë në vitin 2003, pa regjistruar. Vlera 56,000 euro*, konstatohet se:

- nuk përputhet viti i blerjes i cili nga shtetësja Argita deklarohet si e blerë që në vitin 2003 ndërkohë që në kontratë është viti 2004.
- Për më tepër, në vitin 2005 konkretisht **në muajin korrik 2005**, shtetasi Dod Doçi ka lëshuar vërtetim sikur shtetasi Jamarbër Malltezi e ka paguar shumën prej **56 000 euro** por nga **statement bankar rezulton se një pagesë në shumën 19 620 USD është bërë në vitin 2006. Në deklaratën e dorëzuar më datë 30.03.2007 nuk rezulton që shtetësja Argita Malltezi ta ketë deklaruar këtë pagesë.**

Nga aktet rezulton se, kjo pasuri është regjistruar fillimisht më datë 18.04.2013 në emër të shoqëria Lura sh.p.k. me nr pas 171/65+ND+1-1 vol 8 faqa 240 si apartament me sip 85 m2; më datë 28.04.2013 është regjistruar si pas me nr 171/65 ND+1-1 vol 8 faqa 24, me sip totale 85 m2, apartament por me shënim në rubrikën e veçantë: **Dupleks, kati përdhe 85 m2 dhe kati i parë 81 m2.** Në seksion D është shënim se trualli është shtet.

Me kontratën nr. 167 Rep nr. 80 kol datë **29.04.2013**, rezulton se shoqëria Lura sh.p.k. përfaqësuar nga Esmeralda Doçi, i ka shitur shtetasve Jamarbër dhe Argita Malltezi, përfaqësuar këta dy të fundit nga Agim Ramaj (sipas prokurës me nr 363 rep nr 154 kol datë 17.04.2013 lëshuar nga shtetasit Malltezi për t' u marrë me pasurinë e tyre të ndodhur në

Lalëz, me shoqërinë ndërtuese Lura sh.p.k. përfshirë edhe legalizimin e shtesës etj), një pasuri të paluajtshme, apartament tip dubleks, me nr pas 171/65-ND+1-1 vol 8 faqa 241 e ndodhur në ZK 2375 me sip: kati përdhe 85 m2 dhe kati i parë 81 m2.

Palët bien dakord që çmimi i shitblerjes të jetë 50 000 euro dhe pagesa është kryer jashtë kësaj zyre noteriale.

Po më datë 29.04.2013, pra ditën që është bërë kontrata e shitblerjes pasuria e mësipërme regjistrohet në emër të shtetasve Malltezi.

Shtetasi *Agim Ramaj* i pyetur në lidhje me kontratën me nr 167 rep nr 80 kol datë 29.04.2013 deklaroi se, *objekti për të cilën po pyetet lidhet me vilën që ndodhet tek Gjiri i Lalzit, ishte për dy familje, ku njëri e mori mbesa e tij ndërsa tjetri e mbajti vetë shtetasi Agim Ramaj. Në kohën kur vila po ndërtohej, gjysma u prenotua nga Agimi dhe gjysma nga mbesa e tij Argita.*

413. Ndërkohë, përgjatë viteve rezultoi se shtetasi Sali Berisha, ka nënshkruar akte që lidhen me ndërtimet që kryhen nga shoqëria Lura sh.p.k. pikërisht në vendin e quajtur Gjiri i Lalzit.

Me vendimin nr 16 datë 13.01.2009 të KRRTRSH -së, nënshkruar nga shtetasi **Sali Berisha**, është vendosur të miratohet ndryshimi i studimit urbanistik dhe sheshit të ndërtimit me sip 12 ha për fshat turistik në parcelën nr 5 në zonën turistike të Gjirit të Lalzit për shoqërinë Lura. Konstatohet se ky vendim është nënshkruar edhe nga sekretari i KRRTRSH shtetasi **Marin Biçoku**.

Me vendimin nr 7 datë 01.06.2012 të Këshillit Kombëtar të Territorit, nënshkruar nga shtetasi **Sali Berisha** është vendosur të miratohet studimi urbanistik pjesor për zonë hoteleri dhe rezidenca me sip 6 ha, në parcelën 9 A, pjesë e studimit urbanistik për zonën turistike të Gjirit të Lalzit, me investitor shoq Lura sh.p.k.

Konstatohet se, me Vendimin nr 14 datë 10.05.2013, Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar lejen zhvillimore komplekse për ndërtimin e resortit turistik në parcelën 9 dhe 9 D, me sip 6.08 ha, për shoqërinë Lura sh.p.k., komuna Ishëm, qarku Durrës. Ky vendim rezultoi i nënshkruar nga Kryetari i KKT-së, shtetasi **Sali Berisha**.

414. Në vitet 2012 dhe 2013 nga shtetasit Malltezi konstatohet se kryhen rikonstruksione dhe shtesa në ndërtim.

Kështu referuar deklaratës për periudhën e vitit 2012, shtetasi Jamarbër Malltezi deklaroi një shpenzim që lidhet me rikonstruksionin e vilës së mësipërme. Konkretisht ai deklaroi: *Rikonstruksion shtëpie në Gjirin e Lalëzit – 51 000 euro.* Nga të dhënat e llogarive bankare, rezultoi se, nga llogaria bankare në bankën Credins Bank 00000204471 në euro, më datë 09.11.2012, është bërë pagesa për përfituesin Agim Ramaj me përshkrimin “*Pagesë për shërbime rikonstruksion shtëpie*”.

Shtetasi *Agim Ramaj*, është vëllai i shtetasës Liri Berisha, e në këtë mënyrë daja i shtetasës Argita. Ai është administrator dhe aksioner i vetëm i shoqërisë “*Martini*” sh.p.k. me nipt J61918015U, me datë regjistrimi 02.02.1996, me objekt të të aktivitetit “*Prodhimi dhe zbatimi i fasadave të vazhduara apo të sistemeve të ndryshme të fasadave, dyerve, dritareve, vetratave, kangjellave, paneleve sandwich, paneleve të drurit apo produkteve të ndryshme në fushën e aluminit, të celikut dhe të xhamit, për punime të brendshme dhe të jashtme, të aksesoreve të*

tyre, etj. Supervizimi i punimeve të kryera nga firma të tjera ...etj. Tregëtimi, shitje-blerje e materialeve, produkteve të gatshme apo gjysëm të gatshme, sistemeve apo te profileve të aluminit, aksesorëve dhe profileve për fasada, dyer, dritare, kangjella, etj. Transporti i mallrave me mjetet e vet të transportit. Import eksport të shërbimeve të ndryshme në fushën e tregëtisë së aluminit.etj”

Për vitin 2013, shtetasi Jamarbër Malltezi, ka deklaruar *Pagesë e pjesshme për shtesë dhe rikonstruksion shtëpie në Gjirin e Lalzit nga llogaria në Procredit – 5 000 000 lekë (në bashkëpronësi)*. Nga llogaritë bankare rezulton se më datë 04.02.2013 në Bankën Procredit me numër 128486540001 monedha Lekë, është transferuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi, shuma prej 5,000,000 lekë për tek subjekti **Martini sh.p.k.**

Për vitin 2013 shtetësja Argita Malltezi, deklaron: *“Pagese e pjesshme per shtese dhe rikonstruksion vile Gjiri Lalzit (paguar nga llog euro Intesa Sanpaolo)- 45,000 euro- Fatura nr. 2 dt. 03.02.2013 Martini shpk.. Çertifikate pronësie 468 m2 nga e cila 163 m2 eshte trualli per ndertimin e shtepise.”* Më datë 18.02.2013 në Bankën Intesa Sanpaolo 41027535102 euro, nga llogaria e shtetases Argita Malltezi, është bërë debitimi outward transfer overseas txn check, 45,000 euro por pa përshkrim përfituesi. Nga shpjegimet në ILDKPI ka qënë likujdim fatura nr.2 datë 03.02.2013 **Martini sh.p.k.**

Pra, deri në vitin 2013, referuar vetëdeklarimeve rezulton se janë kryer shpenzime për rikonstruksion në vlerën 96 000 euro dhe 5 000 000 lekë të gjitha të dhëna shtetasit Agim Ramaj ose firmës së tij **Martini sh.p.k.**

Shoqëria **Martini sh.p.k.** në muajin shkurt 2013 deklaron shitje me vlerën 12,986,195 lekë në faturën me numër serie 3804968 me përshkrimin në emrin e blerësit “Privat”. Nuk konstatohen shitje të tjera për shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi nga verifikimi i librave të shitjeve të shoqërinë **Martini sh.p.k.** me nipt J61918015U.

Gjithashtu konstatohet nga të dhënat e administruara se rikonstruksioni dhe shtesa kanë sjellë në vijimësi edhe legalizimin dhe blerjes e tokës.

Për vitin 2013, shtetasit Malltezi, kanë deklaruar në ILDKPKI *“Pagesa per legalizimin e viles dhe blerjen e tokes (nga llog b/shortit)- 922,425 lek.”*

Për vitin 2013 shtetasi Jamarbër Malltezi tek të dhënat konfidenciale ka deklaruar: *Shpenzime për blerje toke dhe rikonstruksion shtëpie në Gjirin e Lalzit, çertifikatë pronësie 468 m2 tokë nga e cila 163 m2 truall i shtëpisë.*

Në deklaratën e dorëzuar më datë 07.10.2021, shtetësja Argita Malltezi, deklaron: *Gjysmë vile në kompleksin Lura, Lalëz, blerë në 2004, më pas rikonstruktuar. Sipas çertifikatës nr. 667592 datë 23.05.2013 nr pas 171/86-ND. Ndërtesa është blerë sipas kontratës së shitblerjes me nr rep 167 nr kol 80 datë 29.04.2013 ndërsa trualli është blerë nga ALUIZNI sipas kontratës së shitjes me nr. Rep 3547 dhe kol 1426 datë 04.05.2013. Vlera sipas kontratës së blerjes në shumën 50 000 euro por janë bërë pagesa për punime shtesë me mandat pagese. – Në lidhje me vlerën deklaron: Godina 50 000 euro + toka 908 176 lekë*

Nuk deklaron pagesa të kryera për punime shtesë se sa janë ato.

Në deklaratën e dorëzuar më datë 24.11.2022, shtetësja Argita Malltezi deklaron: *Pasuri e paluajtshme, truall + ndërtesë, datë regj 16.05.2013, bashkëpronare, vlera 8 788 496 lekë, nr pas 171/86-ND, ZK 9, vol 36, sip 632.10 m2, me sip totale truall+ndertese me sip totale 468.8 m2 truall dhe 163.3 ndërtesë, Lalëz.*

Siç mund të shihet pasuria e deklaruar më datë 24.11.2022 nuk përputhet as në datë, as në vlerë me pasuritë e deklaruara më parë në Gjirin e Lalzit.

Nga deklarimi i bërë më datë 07.10.2021, megjithëse në deklaratimet më përpara nuk rezulton, shfaqet edhe blerja e një ndërtese që nga mënyra se si është deklaruar, krijohet përshtypja se i referohet ndërtesës së vjetër. Ky është i vetmi moment ku është përmendur kontrata me nr 167 rep nr 80 kol datë 29.04.2013. Në deklaratën e vitit 2013 flitet për rikonstrukcion dhe punime shtesë.

Nga aktet e administruara nga ASHK rezulton se për pasurinë me Nr. 171/70-ND dhe 171/72 e ndodhur në Lalëz Durrës, është lëshuar Leje legalizimi Nr. 99892 datë **07.05.2013** për objektin "Shtesë anësore 2 kate në objekt banimi 2 kate" i jepet Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi, me adresë "Zonë e stimuluar "Lura" Lalëz, komuna Ishëm, Qarku Durrës. **Objekti ndodhet në ZK.2375, me numër pasurie 172/36, sipërfaqja e parcelës ndërtimore 468.8 m2, sipërfaqja e ndërtimit 78.3 m2, sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 171.4 m2, numri I kateve 2 kate dhe verandë me sipërfaqe 107.62 m2.**

Bashkalidhur është edhe kontrata e shitjes nr 3847 rep nr 1426 kol datë 04.05.2013, për kalimin e të drejtës së pronësisë së truallit me palë shitëse Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/ ndërtimeve informale dhe palë blerëse shtetasit Jamarbër dhe Argita Malltezi, çmimi i blerjes së truallit është 868,9678 lekë, paguar në llogari të Aluiznit Drejtoria Tiranë 3

- Janë regjistruar pasuritë 171/70- ND (ndërtesë) dhe trualli me numër pasurie 171/72

414.1. Me kontratën e shitjes nr 9847 rep nr 1426 kol datë **04.05.2013** rezulton se shitësi ALUIZNI i shet blerësve **Argita dhe Jamarbër Malltezi** truallin me sip **468.8 m2**, me sip baze njësie 161.3 m2, ZK 2375 me nr pas 172/36. Blerësi ka paguar vlerën e shitjes së truallit në shumën 868 968 lekë, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 25 144 lekë dhe vlera e tarifës së përditësimit të pronës 14 064 lekë. Leja e legalizimit është me nr 99892 datë 07.05.2013.

Në emër të shtetasve Jamarbër dhe Argita Malltezi regjistrohet më datë 10.05.2013, pasuria me nr **171/70 – ND vol 9 faqa 19 ZK 2375, godinë me sip 78.3 m2 ku në përshkrimin e veçantë pasqyrohet shtesë pasurie, kati përdhe 78.3 m2, kati i parë 92.84 m2 dhe verandë 107.62 m2.**

Në emër të po këtyre shtetasve, regjistrohet më datë 10.05.2013, pasuria me nr 171/72 vol 9 faqa 18 ZK 2375, **truall me sip 468.8 m2.**

414.2. Me deklaratën noteriale, nr 270 rep nr 148 kol datë 23.05.2013, deklaruesit Jamarbër dhe Argita Malltezi parashtojnë se janë pronarë të këtyre pasurive:

- a) Tokë truall ZK 2375 nr pas 171/72 vol 9 faqa 18, me sip 468.8 m2;
- b) Apartament duplex ZK 2375 nr pas 171/65-ND+1-1, regj në vol 8 faqa 240 me sip 85 m2
- c) Godinë 2 kat ndodhur në ZK 2375 nr pas 171/70-ND regjistruar në vol 9 faqa 19 me sip totale 78.3 m2.

Të tre këto pasuri kërkojnë t' i bashkojnë.

Sa më sipër u identifikua si Vila D 5.

415. Konstatohet se pjesë e vilës D 5 bëhet edhe një pasuri e shtetasit Agim Ramaj, vëllai i shtetasës Liri Berisha. Me leje legalizimi nr 99891 datë 07.05.2013, rezulton se është arritur të lidhet me nr 3885 rep nr 1443 kol datë 07.05.2013 kontratë shitje mes ALUIZNI-t dhe shtetasit Agim Ramaj. Konkretisht ky shtetas ka blerë truallin prej 924.2 m², sip e bazës 157 m² ZK 2375 nr pas 172/71, kundrejt çmimit 1 713 098 lekë dhe tarifë aplikimi 2 500 lekë dhe vlera e tarifës së përditësimit 27 726 lekë.

Më datë 10.05.2013 regjistrohet në pronësi të shtetasve Agim dhe Miranda Ramaj pas me nr 171/73 ZK 2375 vol 9 faqa 20, truall me sip 924.2 m² dhe pasuria me nr 171-74-ND vol 3 faqa 21, ndërtesë me sip 80.72 m² me përshkrimin e veçantë: shtesë anësore 2 kt, kati përdhe 80.72 m², kati i parë 111.84 m² dhe verandë 106+5 m².

416. Nga kqyrja e pjesshme e kompjuterit e markës HP, me ngjyrë gri, me Product ID "Y7Z98EA#ABB", mbrapa së cilës është ngjitur një letër barcode me Nr "40001650", në përdorim të shtetasës **Odeta Fishta**, e punësuar pranë Studio Pustina, i sekustruar më datë 28.04.2023 evidentohet ndër të tjera: Dokument në format word me emërtimin "Rakordim_Eralda_08.02.2022", i cili ka përmbajtjen si vijon: "Pikat per diskutim (pika 5):...
5. Martini – 100k eshte perfshire edhe kjo ne marrredhenien Kontakt-Homeplan, Martini fillimisht ia ka faturuar Kontaktit, me pas Kontakti – Homeplanit, por realisht ka qene kosto e Abit dhe i takon vetem ketij. Per diskutim si do trajtohet"

Kjo shifër siç mund të konstatohet, përputhet në një pjesë, me shpenzime të kryera për vilat në Lalëz. Nga aktet rezulton se subjekti Martini sh.p.k. ka deklaruar vetëm faturën nr 3804968 në vlerën 03.02.2013 për privat në vlerën 12 986 195 lekë, ndërkohë që në vitin 2013 evidentohet se atij i janë bërë pagesa nga shtetasit Malltezi në vlerën 45 000 euro dhe 5 000 000 lekë.

Nga kqyrja e librave të shitjeve dhe blerjeve, rezulton që shoqëria "Martini" sh.p.k. ka marrëdhënie tregëtare me shoqërinë "Kontakt" me nipt J92108006V. Konkretisht ajo ka lëshuar fatura shitje për shoqërinë "Kontakt" për periudhën 27.09.2010- 13.06.2012, në shumën 64 702 014.1 lekë (nga numri 18 me nr serial 36229541 deri në nr 19 me nr serial 83891000). (Për vitin 2010 Kontakti është faturuar në vlerën 6 506 803.2 lekë; Për vitin 2011 Kontakti është faturuar në vlerën 21 941 146 lekë; Për vitin 2012 Kontakti është faturuar në vlerën 36 254 064.9 lekë.)

Përsa më sipër, konstatohet se shtetasi Jamarbër Malltezi ka shfrytëzuar paratë e shoqërisë Homeplan sh.p.k. për të kryer pagesa për interesa të tij, në pasuritë e ndodhura në vendin e quajtur Gjiri i Lalzit.

417. Gjithashtu, ndërkohë që bëhen pagesa për rikonstruksione apo shtesa, rezulton se në vitin 2015, shtetësja Argita Malltezi ka deklaruar **Blerje apt 50 m² Gjiri i Lalzit (pagesa e kryer nga llog bashkeshortit)- 25,220 euro. Kontrate ne 1040 rep nr 572/1 kol dt 30.05.2013.**

Në fakt, ky numër kontrate, i referohet në deklarimin e shtetasit Jamarbër Malltezit, përfitimit të një dyqani në kompleksin Magnet si palë pronare dhe kontratë premtim shitje e dyqanit.

Në lidhje me këtë apartament, më datë 21.05.2015 (me nr. 2704 prot datë 21.05.2015) shtetësja Argita Malltezi, i është drejtuar ILDKPKI-së, duke pretenduar se, **apartamenti është blerë tërësisht nga bashkëshorti por ajo mësoi se ZVRPP kishte regjistruar edhe emrin e saj edhe prandaj bashkalidh disa dokumenta.**

Rezultojn se, është lidhur një kontratë shitblerje nr. 738 rep nr. 316 kol datë 28.08.2013 ndërmjet shitësit shoqëria Lura sh.p.k. përfaqësuar nga Esmeralda Doci dhe Jamarbër Malltezi për shitjen e pasurisë së paluajtshme, apartament me nr pas 172/113-ND +2-3 vol 7 faqa 137 ZK 2375 me sip ap 50.68 m2 sip ballkoni 5.58 m2, sip shkalle 10.11 m2, me sip totale 66.37 m2. Palët bien dakord që çmimi i shitblerjes së pasurisë është 25 220 euro, pagesa është krver jashtë zyrës noteriale.

Në bankat e nivelit të dytë, është evidentuar pagesë për shoqërinë Lura sh.p.k. në datën 29/08/2013 nga Jamarbër Malltezi në shumën 25,220 euro në llogarinë numër 815451-EUR-3824000000-01-022. I korrespondon shumës së përcaktuar në kontratën e shitjes me nr. 738 rep nr. 316 kol datë 28.08.2013, të pasurisë me nr. 172/113-ND +2-3 vol 7 faqa 137 ZK 2375.

E pyetur më datë 31.07.2024 shtetësja Esmeralda Doçi, ka deklaruar se, *kontrata e dytë me shtetasit Malltezi është kontratë shitje e lidhur në vitin 2013 për një apartament rreth 50 m2 në kompleksin Lura 1, objekt i emërtuar nga shoqëria Lura sh.p.k. me nr A 15, me palë Lura sh.p.k. si shitës dhe palë blerëse shtetasin Jamarbër Malltezi. Likujdimi është bërë me bankë.*

Per vitin 2015, **deklarohet nga shtetësja Argita Malltezi shitja e kësaj pasurie.** Nga aktet rezultojn se me kontratën me nr. 260 rep nr. 229 kol datë 24.07.2015 para noteres Sonila Bejtja, shtetasit Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi i shesin shtetases Florida Xhixha, pasurinë e llojit apartament, nr. 172/113 – ND + 2-3 vol 7 faqa 137 ZK 2375 me sip ap 50.68 m2, sip ballkoni 5.58 m2 sip shkalle 10.11 m2 me adresë Lalëz, Durrës, në vlerën 50 000 euro.

Nga kqyrja e llogarive bankare rezultojn se më datë 10.08.2015 nga noterja i është kaluar në llogarinë Raiffeisen Bank me numër 815451-EUR-3824000000-01-022, shtetasit Jamarber Malltezi shuma prej 50 000 euro.

418. Me kontratën e sipërmarrjes nr. 339 rep nr. 96 kol datë 27.04.2015, ndërmjet palëve shoqëria Lura me cilësinë e sipërmarrësit dhe Jamarbër Malltezi në cilësinë e Porositësit, është rënë dakord që sipërmarrësi do të ndërtojë një vilë, **vila nr. 2** e vendosur në kompleksin turistik Lura 3, Parcela 9 dhe 9 D. Kati përdhe, me sip ap. 85 m2 dhe sip verande 19.28 m2. Kati i parë me sip ap. 90.44, me sip tarracë 90.44 m2, me sip trualli 177.88 m2. Sipërfaqja totale e ndërtimit të vilës është 194.72 m2. Çmimi total i vilës do të jetë **155 000 euro.**

Nga verifikimi i të dhënave nga bankat e nivelit të dytë, në bankën IntesaSanpaolo me numër 40201838001 euro e shtetasit Jamarbër Malltezi, ka pagesa shumash monetare:

- Më datë 29.04.2015 nga Jamarbër Malltezi te "Lura" shpk, me përshkrim blerje pasurie të patundshme, blerje vile sipas kontratës nr. 339 rep. Nr. 96 kol. Dt. 27.04.2015, shuma 50,000 euro
- Më dt 25.06.2015 nga Jamarbër Malltezi te "Lura" shpk, me përshkrim likujdim kësti 2, blerje vile sipas kontratës nr 339 rep nr 96 kol dt 27.04.2015, shuma 50,000 euro.
- Më datë 25.06.2015 nga Jamarbër Malltezi te "Lura" shpk, me përshkrim tarifë mirëmbajtje për sherbime në resortin turistik Lura në Lalez, 240 euro.
- Nga verifikimi i të dhënave nga bankat e nivelit të dytë, në bankën Union me numër llogarie 113398964650127 euro e shtetasit Jamarbër Malltezi, ka pagesë shume monetare më datë 08.07.2021 shuma 55,000 euro me përshkrim Jamarbër Malltezi për Lura sh.p.k., paguar kësti i fundit sipas kontratës sip. Nr. Rep. 339 nr. Kol. 6 dt. 27.04.2015.

Në Deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI për vitin 2015, nuk rezulton që shtetësja Argita Malltezi, të ketë deklaruar porositjen, blerjen e kësaj vile.

Më datë 15.07.2019 në emër të shoq Lura sh.p.k. regjistrohet pas me nr 172/277 vol 14 faqa 77 ZK 2375 me sip truall 187.70 m2 dhe ndërtesë 76.23 m2. Në përshkrimin e veçantë është bërë shënimi *Dublex kati përdhe 76.23 m2, kati i parë 76.22 m2 dhe verandë 22.73 m2.*

Vetëm në vitin 2021, shtetësja Argita Malltezi, deklaroi se, ka blerë edhe *Ndërtesë banimi në kompleksin Lura 3, Lalëz, blerë nëpërmjet kontratës së shitjes nr 1091 rep nr 392 kol datë 13.07.2021, sipas certifikatës së regj të pronësisë me nr pas 172/277. Prona është blerë me fonde të bashkëshortit = 155 000 euro.*

Për vitin 2021, deklaroi: *Pasuri e paluajtshme, truall + ndërtesë, datë regj 04.08.2021, bashkëpronare, vlera 155 000 euro, nr pas 172/277, ZK 2375, vol 14 faqa 77, Durrës, sip 263.93 m2, përshkrimi: Truall + ndërtesë me sip totale 187.7 m2 truall dhe 76.23 m2 ndërtesë. Prona është blerë me fonde të bashkëshortit. Kontratë shitje nr 1091 rep nr. 392 kol datë 13.07.2021.*

Bashkëlidhur kësaj kontrate është edhe Vendimi Nr. 14 dt 10.05.2013 i Këshillit Kombëtar të Territorit, Leje Zhvillimore Komplekse për Ndërtimin e Resortit Turistik në Parcelën 9 dhe 9D, me sipërfaqe 6.08 Ha Komuna Ishëm, Qarku Durrës, Nënshkruar nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit-Sali Berisha. Si edhe Leje Zhvillimore Komplekse me Nr prot 4260, dt 24.09.2014, bazuar në vendimin e KKT nr. 14 dt 10.05.2013 jepet leja zhvillimore e mësipërme, nënshkruar nga ministri Eglantina Gjermeni.

Me kontratën me nr. 1091 rep nr. 392 kol datë 13.07.2021 para noterës Rozeta Kuka, shoqëria Lura, në cilësinë e shitësit dhe Jamarbër Malltezi në cilësinë e blerësit, nënshkruajnë kontratën e shitjes së pasurisë pasurisë së paluajtshme, një truall dhe vilë (*apartment dublex*) i vendosur mbi këtë truall me nr pasurie 172/277 ZK 2375 vol 14 faqa 77 me sip truall 187.7 m2, me sip ndërtimi 76.23 m2 e ndarë në a) kati përdhe me sip 76.23 m2 kati i parë më sip 76.22 m2 si dhe verandë me sip 22.73 m2. Palët bien dakort që çmimi i shitblerjes është 155 000 euro, shumë e cila është likuaduar sipas kontratës së sipërmarrjes ne. 339 rep nr. 96 kol datë 27.04.2015.

Me aneks kontratën nr. 1109 rep nr. 401 kol datë 14.07.2021 (Deklaratë noteriale) për disa ndryshime të kontratës nr. 1091 rep nr. 392/3 kol datë 13.07.2021, të lidhur ndërmjet shoqërisë Lura sh.p.k. dhe Jamarbër Malltezi, është rënë dakort që, në lidhje me kontratën nr. 1091 rep nr. 392/3 kol datë 13.07.2021 të bëhen ndryshime e konkretisht: Në nenin 2 *Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës* të shtohet pika 2.2 si vijon: 2.2. **Palët bien dakord që çmimi i shitblerjes së pasurisë që përbën objektin e kësaj kontrate është i ndarë në: Shuma prej 6783 euro i përkon me vlerën e truallit dhe shuma prej 148 262 euro i përkon vlerës së ndërtesës.**

Në dokumentat bashkëlidhur kontratës, pagesë tjetër e dokumentuar me Union Bank ku Jamarbër Malltezi më datë 08.07.2021 derdh shumën prej 55 000 euro.

Nga verifikimi i të dhënave nga bankat e nivelit të dytë, në bankën Union me numër llogarie 113398964650127 euro, ka pagesë shume monetare më datë 08.07.2021 shuma 55,000 euro me përshkrim Jamarbër Malltezi për Lura sh.p.k., paguar kësti i fundit sipas kontratës sip. Nr. Rep. 339 nr. Kol. 6 dt. 27.04.2015.

Siç mund të konstatohet, kjo shumë është paguar vetëm pas nisjes së hetimeve dhe pa ndonjë logjikë të pagesës së saj 6 vite më vonë. Në kontratën e shitjes për më tepër, kanë cituar se shumta ishte likuajuar sipas kontratës së sipërmarrjes.

E pyetur më datë 31.07.2024 shtetësja Esmeralda Doçi ka deklaruar se, *kjo vilë ndodhet në kompleksin Lura 3 dhe është e organizuar në dy kate. Në dijeninë e saj, kjo vilë është sekuestruar nga Prokuroria e Posaçme. Në lidhje me transaksionet bankare, kujton se janë kryer tre pagesa, në vlerë nga 50 000 euro, dy herë dhe një pagesë 55 000 euro. Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, për rreth dy – tre vite ka përfunduar objekti. Në dijeninë e saj, pas përfundimit të objektit, Jamarbëri nuk ka jetuar asnjëherë në këtë objekt por e ka dhënë me qera. Nuk di të thotë përse pagesa e fundit është bërë kaq vonë.*

Gjithashtu nga kqyrja e realizuar pranë shoqërisë Lura sh.p.k. është gjetur një dokument, për klientin Jamarbër Malltezi me datë **06.07.2017, vila B2 individuale, ku paraqiten punime shtesë për t'u kryer në vilë në vlerën 16 070 euro, nga shoqëria Lura sh.p.k.** Duke qenë se sipas këtij dokumenti, një pjesë e punimeve janë kryer nga vetë klienti, në vlerën totale prej 15 709 euro, rezulton se klienti Jamarbër Malltezi duhet t'i paguante 316 euro shoqërisë Lura sh.p.k.

Shtetësja Esmeralda Doçi e pyetur për këtë moment, ka deklaruar se, *në vilën B2, shtetasi Jamarbër i ka kërkuar për të bërë disa punime shtesë me qëllim për ta bërë më të mirë për veten e tij. Kanë bërë një preventiv për kryerje punimesh të cilat do të konkludonin në prishje muresh, ngritje më pas në lartësi të mureve të reja rreth 50 cm, ndërtim rrugice përpara shtëpisë, shkallë dalje në tarrace, shtrime me pllaka, veshje me pllakë, hidraulike elektrike, dyer të brendshme e të jashtme, grila, dritare etj. Nga ana e Jamarbërit është kërkuar që shoqëria Lura sh.p.k. të bënte një pjesë të punimeve, të cilat përshtrohen në preventiv dhe janë në vlerë 10 070 euro. Pjesën tjetër të punimeve që ishin shtrime me plaka, veshje me pllakë, hidraulike elektrike, drier të rendshme e të jashtme, grila, dritare etj ka kërkuar t'i bënte vetë. Këto punime janë bërë nga ana e një kompanie që ai ka gjetur vetë por janë ndjekur nga ai dhe Agim Ramaj. Është bërë rezultati i punimeve në vlerë dhe ka pasur për të paguar 316 euro të cilat Esmeralda i ka thënë mos i paguajë. Kjo shumë nuk është arkëtuar. Pra nga vlera totale 155 000 uro, ai ka kërkuar punime shtesë që kapnin vlerën 16 070 euro. Duke qenë se pjesën hidraulike, elektrike dhe pllaka etj kërkoj t'i bënte vetë që shkonin në vlerën 15 709 euro, kjo shumë i është zbritur punimeve shtesë.*

419. Me kontratën e shitjes me rezervë nr. 143 prot datë **26.05.2005**, të lidhur ndërmjet shoqërisë Edil Al-IT sh.p.k. përfaqësuar nga Genc Dulaku dhe shtetasit Jamarbër Malltezi, rezulton se shoqëria është investitore e objektit, në vendin **Rruga Bajram Curri, pranë piramidës Tiranë.** Objekt i kontratës është, premtimi i shitjes së **ap tip 5 me sip ndërtimi 120.5 m2 që përbëhet nga 111 m2 sip ap plus 9.5 m2 sip** në pjesën e përbashkët të shkallës, që ndodhet në katin e 13 nga toka, në godinën **European Trade Center.** Kohëzgjatja e kontratës do të jetë deri në momentin e nënshkrimit të proces verbalit të marrjes në dorëzim të ap, parashikuar brenda 31.08.2005. Çmimi është **150 625 euro.** Blerësi do të paguajë këstin e parë të blerjes prej 90 000 euro brenda datës 01.07.2005; shumën 53 095 euro brenda datës 03.08.2005 dhe shumën 7 530 euro me marrjen në dorëzim të hipotekës së apartamentit. Kjo kontratë është noterizuar me nr. 4100 rep nr. 648 kol datë 26.05.2005 para noteres Ruko Sako.

Nga analiza e bankave të nivelit të dytë, në bankën ABI _000063808 EURO, në datën **27.07.2005 është marrë kredi 150,000 euro,** dhe më pas janë paguar dy këste për

apartamentin në vlerën 143,095 euro, nga shtetasi Jamarber Malltezi tek Edil Al It, në datat 27.07.2005 dhe 02.08.2005.

Shtetësja *Argita Malltezi* ka deklaruar për vitin 2005: *Apartament European Trade Center 120 m2. Pa regjistruar. Blerë në 2005 me kredi, 150,000 euro. Pjesë takuese 1/2.*

Pagesa e kështit të fundit për blerjen e apartamentit tek ETC është 7,500 euro në llogarinë Intesa 40201835102 euro në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi në datën 17.11.2014.

Në deklaratën për vitin 2014, (datë 01.04.2015) shtetësja Argita Malltezi, nuk deklaron pagesën prej 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) euro.

Në deklaratën për vitin 2009 shtetasi *Jamarbër Malltezi* deklaron "*Bashkëpronësi apt 110 m2 – ETC*" – nuk deklaron vlerë.

420. Gjithashtu, rezulton se për objekte të ndodhura godinën e ndërtuar nga shoqëria Kontakt sh.p.k. në rrugën Dëshmorët e 4 shkurtit, është lidhur një kontratë sipërmarrje me nr. 257 rep nr. 53 kol datë 07.11.2005 para noterës Laura Pustina, sipas të cilës shoq Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga Fatmir Bektashi dhe Jamarbër Malltezi, lidhin kontratën, ku pala investitore, Kontakt sh.p.k. i shtet Jamarbërit një apartament të ndodhur në Tiranë, rr. 4 Shkurti (pranë Gardës) me sip 205.43 m2 sip të brendshme dhe 14.30 m2 pjesë takuese në shkallë, gjithsej 219.73 m2. Ap ndodhet në katin e 7 të godinës dhe përbëhet nga 4 dhoma, një kuzhinë dhe 2 tualete. Porositësi do ta blejë apartamentin e mësipërm kundrejt çmimit 400 euro/m2 dhe për një çmim total 87 892 euro si dhe do të blejë garazhin kundrejt çmimit 12 000 euro. Pra vlera në total është 99 892 euro dhe i është paguar sipërmarrësit nga porositësi totalisht me një kësht të vetëm, **paraprakisht, jashtë kësaj zyre noteriale.**

Shtetësja Argita Malltezi ka deklaruar për vitin 2005: *Apartament te rr Dëshmorët e 4 shkurtit, 200 m2, blerë në 2005, ende në themel, pjesë takuese 1/2, vlera 100,000 euro...*;

Me nr. 923 rep nr 358/1 kol datë 26.06.2012 lidhet kontrata e shitjes ndërmjet shoq Kontakt sh.p.k. dhe shtetasit Aleksandër Josifi në cilësinë e shitësit dhe shtetasit Jamarbër Malltezi në rolin e blerësit. Konkretisht shitet: ap me sip totale 208.02 m2, me nr pas 4/90+1-23 ZK 8270, vol 68 faqa 227 dhe Garazh me sip totale 16.95 m2, nr pas 4/90-G6 ZK 8270 vol 68 faqa 131. Sipas nenit 2, palët kanë rënë dakord që çmimi I shitjes së pas apartament është 93 898 euro dhe garazhi 6 102 euro pra në total 100 000 euro. Palët deklarojnë se ky çmim është paguar tërësisht përpara lidhjes së kontratës.

Sipas nenit 4 do të paguajë tarifat për veprimet lidhur me regjistrimin e kontratës së shitjes pranë ZRPP-së.

Nga aktet rezultojne se dy aplikime pranë ZVRPP janë bërë nga shtetasi Jamarbër Malltezi më datë 28.06.2012 për lëshim kopje karte, shitje, lëshim çertifikate pronësie në total detyrimi për t'u paguar 31 875 lekë dhe lëshim çertifikatë pronësie, shitje, koje karte në vlerën totale 214 650 lekë, por pagesat janë kryer nga shoqëria Kontakt sh.p.k. po më datë 28.06.2012.

Nga dokumentat e sekuestruara, pranë studio Pustina më dt 28.04.2023, janë gjetur disa tabela dhe disa shkresa në të cilat përshkruhen rakordimet e kryera, dhe pagesat e kryera për shtetasit Jamarbër Malltezi. Konkretisht konstatohet se në tabelën me emërtimin "*Jamarbër Malltezi, Total pagesa për Divident 2011 – 2022*" është regjistruar veprimi si vijon: **Nr. 5, datë**

26.06.2012, shuma 1,786.41 euro, koment "Paguar Hipoteka e 4 shkurti", viti 2012, kursi 138, vlera në lekë 246,525 lekë.

Nga akti i ekspertimit të pajisjeve kompjuterike, në dosierin "D:\3-Laptop HP EliteBook 860 G9\Te Dhenat me EnCase_Bruto\Users\User\Desktop\Homeplan\Home Plan\Homeplan 2012\Bilanc 2012\ " ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin rtf, me emërtimin Arka leke 2012.rtf ", modifikuar për herë të fundit më 28.03.2013. Ky dokument paraqet lëvizjet e arkës në Lekë, të shoqërisë Homeplan shpk për vitin 2012, ku konstatohet se janë regjistruar veprimet e arkës si më poshtë: MA 244 datë 29.06.2012, me përshkrim Kontakt kthim shume, shuma 246,825 lekë dhe MP 104 datë 29.06.2012, me përshkrim pagesë hipoteke për rap dhe garazhin e J. Malltezit te, shuma 246,825 lekë.

Në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Backup Documents Odi_Laptop HP Old\Homeplan\Homeplan 2022\Bilanc 2022\ ", ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin Excel, me emërtimin "Sistemime_2022.xlsx, me autor: Heëlett-Packard Company, i krijuar më datë 02.08.2022, i ruajtur për herë të fundit më datë 02.08.2022. Ky dokument përmban 8 (tetë) nëndarje (sheet) të emërtuara si vijon: Details 21; Priv. Div.FB; FB_467; Div.Abi ; Div.Xhimi; Rak.Kontakt+HP; Per sistemim te faturave. Në nëndarjen e pestë të emërtuar "Div.Abi", paraqiten në forme tabelore me shënime përkatëse të gjitha pagesat e kryera kundrejt Abi (*dysuar Jamarbër Malltezi*), nga shoqëria Homeplan shpk. Konkretisht në këtë tabelë evidentohet se për shtetasin Jamarbër Malltezi janë bërë këto shënime **për vitin 2012 janë marrë CASH nga shtetasi Jamarbër Malltezi 1,786.41 euro ose 246,525 lekë.**

Në aktin e ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se në folderin Homeplan, Homeplan 2, Homeplan, Homeplan 2012, Bilanc 2012, në dokumentin "Arka lekë 2012" evidentohet shënimi: *MP 103 datë 29.06.2012, Fatmir Bektashi, pagesë hipoteke për ap dhe garazhin e J.Malltezit 246 825 lekë;*

Pasuria Apartament është regjistruar më datë 29.06.2012 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi me nr pas 4/90+1-23 vol 68 faqa 227 ZK 8270 me sip totale 208.20 m2. Në kartelën e pasurisë është shënuar si vlerë **93 898 euro.**

Pasuria Garazh është regjistruar më datë 29.06.2012 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi me nr pas 4/90-G6 vol 68 faqa 131 ZK 8270 me sip totale 16.95 m2. Në kartelën e pasurisë është shënuar si vlerë **6 102 euro.**

421. Në deklaratën për vitin 2009, shtetasi Jamarbër Malltezi (si person i lidhur me shtetasin Luan Malltezi) deklaron: *Apartament 196 m2 + garazh blerë nga komp. Mane TCI ... Tek të dhënat konfidenciale deklaron: Sqarim lidhur me ap e blera dhe deklaruar në faqen 10. Ap 196 m2 (bashkim dy pjesësh përkatësisht 110 dhe 86 m2) dhe garazh blerë nga kompania Mane TCI nr. 2955 rep 585 kol – 204 000 euro...*

Në fakt, nga aktet konstatohet se kontrata e sipërmarrjes është lidhur me nr 2955 rep nr 585 kol datë **30.03.2010** ndërmjet shoqërisë Mane TCI dhe shtetasit Jamarbër Malltezi ku ky i fundit në cilësinë e porositësit. Sipërmarrësi, sipas kësaj kontrate, merr përsipër të ndërtojë për porositësin kundrejt pagesës **apartamentin** e ndodhur në katin e 5 të banimit me nr 27 dhe 28 me sip banimi 196.3 m2 dhe përbërje 4+1 në kuotën + 16.85 m2 sipas planimetrisë dhe garazhin e ndodhur në katin – 1 nëntokë me nr 18 dhe që ka një sip prej 15 m2. Sipas nenit 2 është përcaktuar se çmimi është për apartamentin 1 150 euro/m2 dhe për **garazhin 805 euro/m2 që në total përbëjnë shumën 237 820 euro.** Çmimi do të paguhet: 65 % e vlerës ose 154 583 euro me nënshkrimin e kontratës; 78 237 euro me dorëzimin e çelësave të apartamentit dhe 5

000 euro nga dorëzimin e hipotekës. Pagesat do të kryhen në llogarinë bankare në euro pranë Intesa San Paolo ose pranë Raiffeisen.

Në deklaratën për vitin 2012 shtetasi Jamarbër Malltezi deklaroi: *Pagesë finale e detyrimeve për apt tek Ambasador 2 - 12 040 euro.* Në vitin 2012, shtetasi Jamarbër Malltezi ka kryer pagesë për punime ndërtimi dhe sipërfaqe të përbashkëta të apartamentit blerë tek Ambasador 2, Mane TCI shpk 12,040 euro (1,682,228.8 lekë), pagesa në datën 30.11.2012 në llogarinë IntesaSanpaolo 40201835102 euro.

Me kontratën e shitjes nr. 644 rep nr. 370 kol datë 08.09.2014, para noteres Sonila Bejtja, shoqëria Mane TCI sh.p.k. në cilësinë e shitësit dhe shtetasi Jamarbër Malltezi në cilësinë e blerësit, lidhin një kontratë shitblerje. Sipas kësaj kontrate shitësi, pronar i pasurisë së llojit apartament me nr. 6/408+1-22 vol 40 faqa 104 ZK 8160, me sip të shfrytëzueshme 201.88 m² me adresë rruga Dervish Hima, i pajisur me çertifikatë për vërtetim pronësie me nr. 774211 datë lëshimi 18.07.2013 i shet blerësit pronën e sapocituar në vlerën 225,745 euro. Çmimi i shitjes është likujduar tërësisht nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. 2955 rep nr. 585 kol datë 30.03.2010 dhe pagesave vijuese gjë që vërtetohet nga mandat pagesat.

Në vitin 2014, evidentohet pagesa e fundit për apartamentin e blerë në 2010 tek Ambasador 2 për marrjen e hipotekës 5,000 euro, (700,700 lekë), në llogarinë IntesaSanpaolo 40201835102 euro për Mane TCI shpk më datë 15.04.2014.

Në vitin 2014 nuk konstatohet që shtetësja Argita Malltezi të ketë bërë deklaratë për këtë pasuri.

Me kontratën e shitjes nr. 645 rep nr. 371 kol datë 08.09.2014, para noteres Sonila Bejtja, shoqëria Mane TCI i shet shtetasit Jamarbër Malltezi pasurinë e llojit garazh me nr 6/408-G52, vol 40, faqa 60, ZK 8160 me sip 14.06 m² me adresë rruga Dervish Hima, i pajisur me çertifikatë pronësie me nr. 774010 me datë lëshimi 18.07.2013 në shumën prej 12 075 euro. Çmimi i shitjes është likujduar jashtë kësaj zyre.

Në vitin 2014 nuk konstatohet që shtetësja Argita Malltezi të ketë bërë deklaratë për këtë pasuri.

421.1. Në deklaratën e datës 07.10.2021 shtetësja Argita Malltezi deklaroi: *Në deklaratimet e kaluara kam deklaruar pasuri të cilat janë blerë me fonde vetjake të bashkëshortit ose me fonde të përbashkëta, por që janë regjistruar në emrin e bashkëshortit si psh ap në Bulevardin Bajram Curri (ndërtesa ETC), rruga Dervish Hima dhe Rruga Dëshmorët e 4 shkurtit. ...Në këtë deklaram nuk i kam përfshirë pasi e kam vlerësuar me të drejtë t'u përmbahem strikt kërkesave të ligjit*

422. Shtetasi Sali Berisha, në vitin 2007, siç u theksua edhe më sipër, spostohet në apartamentin e blerë nga familja Malltezi në rrugën Mustafa Matohiti.

423. Është pikërisht viti 2007 kur shtetasi Jamarbër Malltezi nis edhe blerjen e disa tokave, ku të gjitha kontratat lidhen para noteres Merita Isufaj. Në muajin korrik – gusht 2007, ai arrin të bëhet pronar i një sipërfaqe toke arë prej 3 885 m², të blerë kundrejt një shume totale prej 18 981 600 lekë, të cilën në vijim, ia shet brenda muajit shtator 2007, shoqërisë tregtare “Alpha” sh.p.k. me NIPT K72110020T me ortak të vetëm dhe administrator, shtetasin serb Damir

Fazllic, kundrejt një çmimi shumë herë më të lartë, konkretisht në shumën **396 234 euro**. Shoqëria Alpha sh.p.k. rezulton të krijohet në muajin maj 2007, ku ekspert kontabël caktohet shtetësja Shpresa Breçani. Për regjistrimin e kësaj shoqërie ngarkohet shtetësja Joana Qeleshi, e cila është e njëjta shtetase që ngarkohet edhe për të kryer veprime me shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Në fakt, marrëdhënia kontraktore si më sipër, ka nxjerrë në pah lidhjet që shtetësja Argita Malltezi ka pasur me shtetasin Damir Fazllic. Sipas deklaramit të dhënë më datë 18.12.2008 në kuadrin e procedimit penal nr 3258 të vitit 2008, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Tiranë, nga shtetësja Flutura Kolaj (Tafaj), kjo e fundit ka deklaruar se me shtetasin Damir Fazllic është njohur në periudhën tetor – nëntor 2006 në zyrën e saj, pasi ia ka prezantuar kolegja e saj shtetësja Argita Malltezi.

Referuar deklaramit të dhënë nga kjo shtetase por edhe ateve të administruara rezulton se me VKM nr 703 datë 23.04.2008 të nënshkruar nga Ministri i METE shtetasi Genc Ruli dhe Kryeministri i asaj kohe shtetasi Sali Berisha, është miratuar studimi *“Zhvillimi i integruar (në sinergji) i zonës energjitike dhe industriale të Porto Romanos, Durrës, Infrastruktura dhe konturet e saj”*.

Nisur nga të dhënat që dispononin shtetasit Kola (Flutura dhe bashkëshorti i saj Florenc) si dhe shtetasit Malltezi (shtetasit Jamarbër dhe bashkëshortja e tij Argita) mbi zhvillimin që do të pësonin pronat e ndodhura në vendin e quajtur Fshati Rinia, kanë vendosur të blejnë toka nga pronarët që i posedonin ato dhe t’ia shisnin më pas shtetasit Damir Fazllic. Personi i ngarkuar nga shtetasi Damir Fazllic për marrëdhënie të ndryshme në Shqipëri ka qenë pikërisht shtetësja Flutura Kola. Ajo që evidentohet nga këto transaksione, pra blerjet dhe më pas shitjet e kryera, është për t’u theksuar fakti se në akte përshkruhet se pagesat bëhen dorazi.

Shtetësja Argita Malltezi, evidentohet se nënshkruan kontratat e shitjes në drejtim të blerësit Damir Fazllic bashkë me bashkëshortin e saj, megjithëse nuk i deklaroi në ILDKPKI këto transaksione.

423.1. Konkretisht rezulton se me nr 1493 rep nr 306 kol datë **02.07.2007**, në Durrës, shtetasi Ylber Lleshaj, i shet shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/44, ZK 3184, vol 9 faqa 107, një sip prej 1200 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **1 440 000 lekë**, **duke u cituar në këtë kontratë se kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Shitësi ka arritur të pajiset me çertifikatë pronësie në lidhje me këtë pasuri, vetëm më datë 26.02.2007. Me nr 2333 rep nr 568 kol datë **11.09.2007**, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë “Alpha” sh.p.k., pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **21 600 euro**, **duke u cituar në këtë kontratë se kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazllic.

423.2. Me nr 1494 rep nr 307 kol datë **02.07.2007**, në Durrës, shtetasi Servet Balla, i shet shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/36, ZK 3184, vol 3 faqa 175, një sip prej 8695 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **3 000 000 lekë**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Shitësi ka arritur të pajiset me çertifikatë pronësie në lidhje me këtë pasuri, vetëm më datë 12.06.2007. Me nr 2334 rep nr 569 kol datë **11.09.2007**, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë “Alpha” sh.p.k., pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **156 510 euro**, duke u cituar në këtë kontratë

se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazlic.

423.3. Me nr 1670 rep nr 362 kol datë **23.07.2007**, në Durrës, shtetasit Agim Matmuja etj, i shesin shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/24, ZK 3184, vol 3 faqa 207, një sip prej 6512 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **7 814 400 lekë**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Me nr 2330 rep nr 565 kol datë **11.09.2007**, në Durrës, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë "Alpha" sh.p.k., pas pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **117 216 euro**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazlic.

423.4. Me nr 1671 rep nr 363 kol datë **23.07.2007**, në Durrës, shtetasit Halil Peposhi etj, i shesin shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/32, ZK 3184, vol 3 faqa 213, një sip prej 1221 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **1 465 200 lekë**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Me nr 2329 rep nr 564 kol datë **11.09.2007**, në Durrës, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë "Alpha" sh.p.k., pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **21 978 euro**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazlic.

423.5. Me nr 2162 rep nr 527 kol datë **31.08.2007**, në Durrës, shtetasit Xhemil Rusta etj, i shesin shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/27, ZK 3184, vol 4 faqa 1, një sip prej 500 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **600 000 lekë**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Me nr 2331 rep nr 566 kol datë **11.09.2007**, në Durrës, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë "Alpha" sh.p.k., pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **9 000 euro**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazlic.

423.6. Me nr 2161 rep nr 526 kol datë **31.08.2007**, në Durrës, shtetasit Zaim Basha etj, i shesin shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 18/16, ZK 3184, vol 3 faqa 127, një sip prej 3885 m2 tokë arë, ndodhur në vendin e quajtur Rinia Durrës, kundrejt vlerës prej **4 662 000 lekë**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Shitësi ka arritur të pajiset me certifikatë pronësie në lidhje me këtë pasuri, vetëm më datë 12.05.2007. Me nr 2332 rep nr 567 kol datë **11.09.2007**, në Durrës, shtetasi Jamarbër Malltezi, i shet shoqërisë "Alpha" sh.p.k., pasurinë e mësipërme, kundrejt vlerës prej **69 930 euro**, duke u cituar në këtë kontratë se **kjo pagesë jepet dorazi, jashtë zyrës noteriale**. Kontrata e shitjes është nënshkruar nga Jamarbër Malltezi (shitësi), **Argita Malltezi (Berisha)**, bashkëshortja e shitësit dhe shoqëria Alpha shpk përfaqësuar nga ortaku i vetëm dhe administratori Damir Fazlic.

423.7. Gjithashtu rezultojnë edhe dy kontrata shitje toke arë me nr 2336 rep nr 571 kol datë 11.09.2007 ku shtetasi Florenc Kola i shet shoqërisë Alpha sh.p.k. pasurinë me nr 18/28 vol 4 faqa 41 ZK 3184, tokë arë me sip 1498 m2 në shumën 26 964 euro dhe me nr 2335 rep nr 570

kol datë 11.09.2007 ku shtetasi Florenc Kola i shet shoqërisë Alpha sh.p.k. pasurinë me nr 18/29 vol 4 faqa 44 ZK 3184, tokë arë me sip 1406 m2 në shumën 25 308 euro.

Nga aktet rezulton se sipas të dhënave të ekstraktuara pas ekspertimit të hardrive-it të jashtëm të sekuestruar pranë studio Pustina, rezultojnë të evidentohen libra të mbajtur në lidhje me shoqërinë Alpha sh.p.k. Konkretisht sipas dokumentit, Alpha-Libri i Madh pasqyrohen të dhëna në lidhje me shitjet e mësipërme të shtetasit Jamarbër Malltezi, ku përveç 6 kontratave që i referohen shitësit Jamarbër Malltezi janë përfshirë edhe dy kontratat me shitës shtetasin Florenc Kola, po në rubrikën "**401001 J.Malltezi**". Në total me mandat pagesë nr 1 datë 11.09.2007 pasqyrohet se shtetasi Jamarbër Malltezi është likujduar për vlerën **448 506 euro ose 56 063 250 lekë**.

Shtetësja Flutura Kola, siç theksuam edhe më sipër, rezulton të jetë një bashkëpunëtoare e ngushtë e shtetases Argita Malltezi.

424. Me kontratën e shitjes së pasurive të paluajtshme nr 4682 rep nr 674 kol dt **26.08.2014**, para noteres Gentiana Shkodra, rezulton që shtetasit *Azis, Sadete, Kudret Lameta* i kanë shitur shtetasit Jamarbër Malltezi, pasurinë me nr 11/2 vol 1 faqa 50, ZK 1654, e llojit arë, e ndodhur në Alltatete (Komuna Baldushk), me sip totale 13 000 m², kundrejt çmimit prej 600 lekë/m² ose gjithsej 7 800 000 lekë. Në nenin 5 të kontratës është përcaktuar se çmimi është paguar nga ana e blerësit në llogaritë bankare të shitësit, para se palët të paraqiten në zyrën noteriale dhe shitësi deklaron se e ka marrë çmimin kontraktor në dorëzim të plotë dhe pa diferenca. Konstatohet se regjistruesi në këtë kohë i ZVRPP është shtetasi Andrea Miço Rezulton se mandatin bankar të Raiffeisen Bank, rezulton se më datë 26.08.2014 shtetasi Jamarbër Malltezi ka bërë pagesën prej 7 800 000 lekë.

Në muajin mars 2020, shtetësja **Elvira Lame** me porosi të shtetasit Jamarbër Malltezi ka përgatitur raport vlerësimi për këtë tokë. Sipas këtij raport vlerësimi, vlera e tregut të lirë të kësaj prone, është në shumën 39 000 000 lekë.

Sipas mandatit bankar të Credins Bank datë 11.05.2020 rezulton se shtetësja Romina Hasanaj, ka paguar për llogari të shtetasit Jamarbër Malltezi, shumën prej 936 000 lekë pranë ASHK-së.

425. **Blerjet në tokat ku shtrihen territoret e klubeve Sportive.** Pergjate viteve shtetasi Jamarber Malltezi konstatohet se ble edhe toke truall ne territoret ku jane shtrire dy Klubet Sportive Partizani.

Nga hetimi jane evidentuar keto kontrata:

Në vitin **2010**, me kontratat nr 272/117 rep/kol datë **27.01.2010** dhe nr 2659/149 rep/kol datë 05.08.2010, shtetasi Jamarbër Malltezi ble **175.7 m2 tokë**, nga shtetaset *Nerime Piro* dhe *Sejidje Kurti* në vlerën në total **4 711 029 lekë**.

Në deklaratën e dorëzuar në ILDKPKI, më datë 21.03.2010, shtetasi Jamarbër Malltezi, ka deklaruar: *Blerje dy herë nga 88 m2 (2X87.85=175.7 m2) sip ideale nga bashkëpronarët e tokës që jemi trashëgimtarë sipas kontratave nr. 272 rep nr. 117 kol dhe nr 2659 rep nr. 749 kol – 4 711 029 lekë*

Në vitin **2012**, me kontratat nr 692/425 rep/kol datë 05.04.2012; nr. 732/440 rep/kol, nr 733/441 rep/kol, nr 734/442 rep/kol, 735/443 rep/kol të datës 06.04.2012, nr 1984/1106 rep/kol dhe 1985/rep/kol datë 30.08.2012 nga shtetaset *Graciela Begeja, Vera Grabowski, Margaret Irwin* dhe 1946/931 rep/kol datë 14.09.2012 nga shtetësja *Nerime Piro*, rezulton të ketë blerë **611.53 m2** truall kundrejt vlerës **71 755.2 USD** dhe **407 100 lekë**.

Në deklaratën e pasurisë për vitin 2012 në rubrikën e të dhënave konfidenciale, shtetasi Jamarbër Malltezi, ka deklaruar: *Shpenzime për blerje toke në bashkëpronësi – 57 814 euro (nga llogaritë bankare referohet se janë transferuar tek Maksim Begeja).*

Në vitin 2016, shtetasi Jamarbër Malltezi sipas kontratës nr 2951/1145 rep/kol datë 24.10.2016, ble **366 m²** nga shtetasi Adnan Llagami, në vlerën **109 800 euro**.

Në vitin 2017, shtetasi Jamarbër Malltezi, sipas kontratës nr 3463/1158 rep/kol datë 08.12.2017 ble nga shtetësja Tire Deda (Luzi), **114 m²** në shumën **74 762 euro**.

Në vitin 2018 shtetasi Jamarbër Malltezi me kontratën nr 395/188 rep/kol datë 01.03.2018 ble ga disa prej shtetasve Llagami, **506.67 m²** truall në ZK 8220 në shumën **120 000 euro**.

Në vitin 2018 shtetasi Jamarbër Malltezi me kontratën 2800/934 rep/kol datë 30.10.2018 ble nga familja Alimehmeti **114 m²** në pas me nr 3/158 ZK 8220 në vlerën **80 000 euro**.

Në vitin 2018 shtetasi Jamarbër Malltezi me kontratën nr 3209/1083 kol datë 05.12.2018, ble nga shtetësja Rajmonda Bektashi, në pas 3/154 ble **0.84 m²** në shumën **203 euro** dhe 3/155 ZK 8220 ble **20.62 m²** në shumën **4 797 euro**.

Në vitin 2021, me kontratën nr 469/141 rep/kol datë 11.02.2021 shtetasi Jamarbër Malltezi i përfaqësuar nga shtetasi Florenc Kola, së bashku me shtetasen Nervit Hoxha blen nga shtetësja Nustret Kaçurri, pasuri tokë truall në pasurinë e ndodhur në ZK 8370 (33 m²+1341 m² por nuk jam e sigurtë) në vlerën **33 768 euro**.

Në vitin 2021, me kontratën nr 470/142 rep/kol datë 11.02.2021 shtetasi Jamarbër Malltezi i përfaqësuar nga shtetasi Florenc Kola, së bashku me shtetasen Nervit Hoxha blen nga shtetësja Nustret Kaçurri, pasuri tokë truall në ZK 8370 në vlerën **26 232 euro**.

426. Shpenzime te tjera evidentohen te jene bere edhe jashte shtetit per te cilat nuk gjenden gjurme ne deklaratat e pasurive.

426.1. Konkretisht nga analizimi dhënave të llogarisë personale të shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank sh.a., me numër llogarie ...650127 në monedhën euro, janë kryer disa transferta dalëse të cilat nga përshkrimi i transaksioneve referojne ne pagesa për një pasuri të paluajtshme:

Viti 2018. Transferta e parë: Dt 21.12.2018 në shumën **15, 530 euro** me përshkrim "*Int Outg MT nga llogaria First Payment For The Pre Sale And Purchase Contract Dt 20.12.2018 Adria Immobiliare Kft H.Doza Gjorgy Ut 86.B Budapest*". Pra pagesa e parë për kontratën e parashitjes dhe blerjes.

Në dokumentacionin justifikues të administruar për këtë transfertë dalëse pranë Union Bank sh.a është vendosur në dispozicion sëift-i. Transfertat është drejt Budapest-it, Hungari, në llogarinë bankare të Adria Immobiliare kft h. Doza gjorgy ut 86. B Budapest, Hungary në Magnet Bank ZRT, Budapest, Hu, me numër llogarie HU59162002231001036100000000.

Transferta e dytë: Dt 21.12.2018 në shumën **15,530 euro** me përshkrim "*int outg mt nga llogaria Doën Payment For Pre Sale And Purchase Contract Dt 20.12.2018 Red Pro Kft 1061 Andrassy 456 Budapest*". Pra Paradhënie për kontratën e shitblerjes dt. 20.12.2018.

Në dokumentacionin justifikues të administruar për këtë transfertë dalëse pranë Union Bank sh.a është vendosur në dispozicion sëift-i. Transfertat është drejt Budapest-it, Hungari, në

llogarinë bankare të Red Pro Kft, 1061 Andrassy, 456, Budapest, Hungary në OTP Bank plc. Budapest Hu, me numër llogarie HU74117630621898988900000000.

Viti 2019. Transferta e tretë: Dt 20.02.2019 në shumën **124,240 euro** me përshkrim "*Int Outg MT nga llogaria payment of the remaining portion for the purchase contract dt 20.12.2018 Adria Immobiliare Kft H. Dozsa Gyorgy Yt 86.b*". Pra pagesa pjesës së mbetur për kontratën e blerjes dt. 20.12.2018, Adria Immobiliare Kft H. Dozsa Gyorgy Yt 86.B.

Në dokumentacionin justifikues të administruar për këtë transfertë dalëse pranë Union Bank sh.a. është vendosur në dispozicion sëft-i. Transfertat është drejt Budapest-it, Hungari, në llogarinë bankare të Adria Immobiliare Kft H. Dozsa Gyorgy Yt 86. B Budapest, Hungary në Magnet Bank ZRT, Budapest, Hu, me numër llogarie HU59162002231001036100000000. Gjatë vitit 2019 ka pagesa faturash ndër të tjera në Andrassy Ut 55 Budapest (7,885 euro).

426.2. Nga analizimi i të dhënave bankare, nga llogaria bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank sh.a., me numër 113398964650127 në monedhën euro, janë kryer transferta dalëse në total **137,000 euro** drejt llogarisë së shtetasit Jamarbër Malltezi (me adresë Schelling Str 24, 80799 Munchen, DE) në bankën Deutsche Bank Ag, Postbank Branch (Formely Deutsche Postbank Ag) (Frankfurt Branch) Bonn De, me IBAN DE90100100100416685130. Gjithsej rezultojne per vitin 2021 te jene 16 transferta, nga te cilat 4 me vlere nga 4 000 euro, 4 me vlere nga 4500 euro, 2 me vlere nga 5 000 euro, 2 me vlere nga 8 000 euro, 2 me vlere nga 15 000, 2 me vlere nga 15 000 euro, nje me vlere 22 000 euro dhe nje me vlere 25 000 euro.

462.3. Më dt 09.07.2021 para notere Laura Pustina, shtetesja Argita Malltezi, ka emeruar shtetasin Jamarber Malltezi, qe ta perfaqesoje ne nënshkrimin e Kontratës së Kredise Bankare dhe çdo dokumenti tjetër të kërkuar nga banka, për miratimin dhe marrjen e kredisë në "Union Bank" në të cilën ajo do të jete Kredimarrëse në vlerën **450.000 Euro** ...për qëllimin e kreditimit: "*blerje shtepie banimi te llojit "Apartament" ndodhur ne Bruksel, Belgjike*". Njëkohësisht i sipërpërmenduri autorizohet t'a përfaqësojë në nënshkrimin e Marrëveshjes Siguruese që do të lidhet me Union Bank Sh.A. duke vendosur barrë siguruese mbi shumën prej Euro 475.000 (katerqind e shtatedhjetë e pese mijë) të gjendur në llogarinë bankare nr. 113398964650127 pranë Union Bank për të garantuar kthimin e kredisë së sipërpërmendur.

Nga analizimi i të dhënave bankare në vitin 2021, në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank sh.a., me numër llogarie 113398964650127 në monedhën euro, janë kryer katër transaksione/ transferta dalëse në total **460,000 euro** si vijon:

Pagesa e parë: Datë 12.08.2021 në shumën 150,000 euro me përshkrim "*Int outg mt nga llogaria payment for first installment loan for apartment purchase Jamarber Malltezi Schelling Str 24 Mynih*". Pagesa e parë për blerjen e një apartamenti.

Pagesa e dytë: Datë 16.08.2021 në shumën 150,000 euro me përshkrim "*Int outg mt nga llogaria second installment of bank loan for purchase an apartment Jamarber Malltezi Schelling st. 24 Mynich*". Pagesa e dytë për blerjen e një apartamenti.

Pagesa e tretë: Datë 02.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim "*Int Outg MT nga llogaria Buying apartment- 3rd installment Jamarber Malltezi Schellingstr. 24*". Pagesa e kështit të tretë për blerjen e një apartamenti.

Pagesa e katërt: Datë 07.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim "*Int Outg MT nga llogaria Purchase apartment 4th installment Jamarber Malltezi Schellingstr. 24*". Pagesa e kështit të katërt për blerjen e një apartamenti.

Është administruar dokumentacion justifikues për këto transfertat dalëse pranë Union Bank sh.a. dhe janë vendosur në dispozicion sëift-et përkatëse dhe një kontratë.

Transfertat dalëse janë drejt Gjermanisë në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi (me adresë Schelling Str 24, Mynih, Deutschland) në Deutsche Bank Ag, Postbank Branch (Formely Deutsche Postbank Ag) (Frankfurt Branch) Bonn De me numër llogarie **DE90100100100416685130**.

Në dokumentacionin e administruar rezultojnë Kontrata "Për përcaktimin e palëve" me shoqëritë:

1. "AG INSURANCE" Limited me seli në Bruksel (1000 Bruksel), bulevardi Emile, rrethi gjyqësor i Brukselit, referuar si "Trefonciers".
2. "Urban Project" me seli në Bruksel (1000 Bruksel), avenue des Arts 58, rrethi gjyqësor i Brukselit, referuar si "Promovuesi".
"Trefonciers" dhe "Promovuesi" do të referohen bashkërisht si shitësi përfaqësuar nga Vanessa Issi, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Uccle (1180 Bruksel), Avenue Montjole 135A përfaqësuar nga administratorja Vanessa Issi.
3. Jamarbër Malltezi, i datëlindjes 09.11.1972, Tiranë "Blerësi".

Përshkrimi i pronës: Qyteti i Brukselit, në bllokun e ndërtesës 8:

1. Apartamenti ndodhet në katin e parë i quajtur loti 8.1.3 i përbërë një sallë hyrje, një dhomë ndenje-ngrënie me kuzhinë, një sallë nate, një tualet më vete, një dhomë lavanderi, dy dhoma gjumi, një banjo dhe tualet, një dhomë dush, një tarracë në bashkëpronësi dhe bashkëpronësi të detyruar 81/10,000 (ose 9.925) e sipërfaqeve të përbashkëta, në numrin e parcelës së rezervuar B 1667 E P0062.
2. Bodrumi i vendosur në bodrumin e dytë të quajtur loti C2.76, që përfshin: vetë bodrumin në bashkëpronësi dhe bashkëpronësi të detyruar 1/ 10,000 (ose 9,925) e sipërfaqeve të përbashkëta, në numrin e parcelës së rezervuar B 1667 E P0230.
3. Parkingu ndodhet në bodrumin e parë të quajtur P1.58 duke përfshirë vendndodhja e shënuar me bojë nr. 58 në bashkëpronësi dhe bashkëpronësi të detyruar 3/10,000 (ose 9,925) të sipërfaqeve të përbashkëta me numrin e parcelës së rezervuar B1667 E P0352. Çmimi i shitjes së pronës është 395,000 euro (duke përfshirë tarifat e regjistrimit, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tarifat e tjera tatimore).

Transfertat dalëse janë drejt llogarisë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi në Deutsche Bank Ag, Postbank Branch (Formely Deutsche Postbank Ag) (Frankfurt Branch) Bonn De me numër llogarie **DE90100100100416685130**.

426.4. Nga analizimi i të dhënave bankare në vitin 2021, në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank sh.a., me numër llogarie 113398964650127 në monedhën euro, janë kryer katër transaksione/ transfertat dalëse në total **320,000** si vijon:

Pagesa parë: Dt 08.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim "Kalim vajzës për blerje apt-Ist".

Pagesa e dytë: Dt 09.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim Int Outg MT nga llogaria Vajzës për blerje apt - kësti 2 Dasara Malltezi Rotterdam".

Pagesa e tretë: Dt 10.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim " Int Outg MT nga llogaria Vajzës për blerje apt - kësti 3 Dasara Malltezi Rotterdam".

Pagesa e katërt: Datë 14.09.2021 në shumën 80,000 euro me përshkrim " Int Outg MT nga llogaria Vajzës për blerje apt - kësti 4 Dasara Malltezi Rotterdam".

Është administruar dokumentacion justifikues për këto transfertat dalëse pranë Union Bank sh.a. dhe janë vendosur në dispozicion sëift-et përkatëse dhe një kontratë.

Transfertat dalëse janë drejt Hollandës në llogarinë bankare të shtetasës Dasara Malltezi në ING BANK N.V. AMSTERDAM NL me numër llogarie NL80INGB0658415859.

Në dokumentacionin e administruar rezulton Kontrata për shitjen e të drejtës së banesës e datës 07.09.2021 me shitës shtetasen Maria Moraitis, me banim në Van Oldenbarneveltplaats 360, 3012 AM Rotterdam, Hollandë, lindur në Athinë, Greqi më 28.07.1969 dhe blerës Dasara Malltezi, banuese në Eijnbrugstraat 139, 3011 XË Rotterdam, Hollandë, lindur në Tiranë më 12.12.1996. Çmimi i shitjes së pronës është 360,000 euro.

427. Vlen për t'u theksuar se, shtetësja Argita Malltezi e cila është e vetmja nga familja Malltezi që bën deklarinimin e pasurisë në respektim të ligjit nr 9049/2003 (*bashkeshorti i saj ka deklaruar vetem me periudha te caktuara si persn i lidhur me te atin e vet*), nuk deklaroi të ardhurat, shpenzimet apo pasuritë e bashkëshortit dhe as pjesëmarrjen e tij si ortak në shoqërinë Homeplan sh.p.k., të cilat sipas K.Familjes, i kanë në bashkëpronësi. Kjo bën që të humbasin gjurmët e të ardhurave të vërteta të familjes Malltezi apo shpenzimet e tyre reale, qoftë për pasuritë (blerje, mobilim, rikonstruksione) ashtu edhe për fëmijët e tyre.

Referuar n. 73 të Kodit të Familjes, "*Bashkësia ligjore*" është sanksionuar, se **Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.**

Nga aktet e hetimit, deri në këtë moment, nuk rezultoi të jetë evidentuar ndonjë kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.

Në n. 74 të Kodit të Familjes "*Përbërja e bashkësisë*", sanksionohet se: *Bashkësia përbëhet nga:*

- a) *pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;*
- b) *të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;*
- c) *frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;*
- ç) *veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.*

Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit.

427.1. Për shembull, në aparatet kompjuterike të sekuestruara pranë studio Pustina, është gjendur dokumenti "*Përgjigje për Abin*" në gjuhën angleze i krijuar më datë 09.12.2021 dhe "*Përgjigje për Abin_VS2*" në gjuhën angleze datë krijimi 15.12.2021. Në këtë dokument parashtrihen disa kërkesa që i janë bërë vajzës së shtetasve Malltezi, nga autoritete të huaja në lidhje me justifikimin e përfitimeve të shtetasit Jamarbër Malltezi.

Paraqitet sa më poshte nje version i letres se pergatitur, per kthimin e pergjigjeve:

"...Familja e babait tim, nga gjyshja e tij nga nena, familja Begeja, ishte nje nga familjet me te pasura ne Shqiperi dhe pronarja e trete me e madhe e tokave ne Tirane deri pas Luftes se Dyte Boterore, kur qeveria komuniste i konfiskoi pronat e tyre (shihni bashkelidhur emrat e vellaite, babait dhe kusherinjve te gjyshes se babait tim jane te gjitha familja Begeja, te perfshire ne listen e pare fare te konfiskimeve qe komunistet e leshuan ne mars te vitit 1945 ne nje kohe kur lufta vazhdonte ende diku tjeter). Me renien e regjimit komunist ne vitin 1990, motra e gjyshes se babait tim (Jalldiz Begeja-Sefa) perfaqesoi pretendimet e familjes per kthimin e pronave te tyre. Ajo pati sukses ne njohjen e shume prej titujve te pronesise dhe kthimin e disa

prej tyre. Pas vdekjes se saj (perafersisht viti 2003), perfaqesimi i familjes me prokure iu kalua dajes se babait tim dhe njerit prej kusherinjve te tij (gjithashtu bashke-investitor ne projekt), dhe me vone, anetaret e familjes ia kaluan autorizimin e perfaqesimit babait tim. Prona ne te cilen eshte duke u zhvilluar ndertimi eshte njohur dhe kthyer ne nje proces qe zgjati 12 vjet dhe ne te cilin familja perfaqesohej nga paraardhesit e babait tim (Jalldiz Begeja-Sefa, motra e gjyshes se tij, dhe Bashkim Bektashi, daja i tij, te dy te ndare nga jeta shume vite me pare). Gjate regjimit komunist, kjo toke dhe toka ngjitur e kater familjeve te tjera (titulli i pronesise i te cilave u njihej edhe nga shteti) ishte perdorur si klub sportiv ushtarak dhe kishte pak ndertesa, dhe kryesisht fusha futbollit ose bosh. **Klubi u prish pas vitit 1990, ku vetem klubi i futbollit drejtohej privatisht, nga njerez qe e pervetesuan emrin pa asnje transaksion ligjor.** Per kete arsye, privatizimi i klubit "Partizani" filloi ne vitin 2005 nga ministrat e partise socialiste pak muaj para se Partia Demokratike te fitonte zgjedhjet dhe te formonte qeverine. Sipas ligjit per njohjen dhe kthimin e tokave te vitit 2004, tokat e marra nga ushtaraket gjate regjimit komunist, por qe nuk ishin me pjese e kazermave, duhej t'u ktheheshin pronareve te ligjshem, dhe per me teper, qe nga koha e kthimit te prones, qeveria eshte e detyruar te privatizojë, shpronesojë ose t'u paguaje qira pronareve. Pra, pronaret e ligjshem qe u njohen nga komisioni qe ne vitin 1994, me ne fund arriten ta regjistronin token e tyre, ndersa shteti kerkoi privatizimin e objekteve te ndertuara (jo emrin e klubit). Ne perputhje me ligjin, pronareve te tokave jo vetem qe iu ishte vjedhur toka nga shteti, por edhe duhej te paguanin pothuajse 800,000 dollare amerikane per privatizimin e ndertesave te vjetra te kalbura dhe kryesisht te uzurpuara. Pronaret e tokave zgjodhen nje shoqeri ndertimi e cila vendosi, pas marreveshjes me pronaret, ta zhvillonte zonen ne dy faza. Faza e pare, ndertimi ne nje pjese toke qe ishte prone vetem e familjes Begeja. Faza e dyte, zhvillimi i tokes qe ishte prone e pese familjeve pronare, nje nder te cilat eshte edhe Begeja. **Babai im kerkoi te merrte pjese ne investim qe ne fillim.** Ne fazen e pare, ky opsion u vu ne dispozicion te nje numri te kufizuar bashkepronarësh te tjere, por vetem njeri prej tyre pranoi. Ne fazen e dyte, ky opsion iu vu ne dispozicion te gjithe pronareve te tjere, por ata nuk pranuan. **Pra, investitore ne kete projekt jane ndertuesi Fatmir Bektashi me pjesemarrje 40%, babai im 35% dhe kusheriri i tij 25% (gjithashtu nje bashkepronar).** Aksionet e shoqerise Homeplan jane blere ne baze te nje marreveshjeje investimi ndermjet ketyre tre paleve investuese. **Kjo marreveshje mban Nr. Rep. 3000 dhe Nr. Koi. 1783, date 02.10.2008.** Bazuar ne raportin e aksioneve te parashikuara me kete marreveshje, babai im ka disbursuar shumen fillestare prej 60,000 eurosh (Koment A1: Ne programin e kontabilitetit eshte regjistruar vlera 45.128,92 euro e depozituar prane Procredit Bank me date 24.12.2012 (gjashtedhjetë mijë euro). Marreveshja parashikonte se kapitali investues do te plotesohej sipas nevojës. Si pjese e kapitalit fillestar, shoqeria ndertuese mori nje kredi bankare ne shumen (Koment A2: Investimi fillestar u be nga Kontakt (312.603 euro) dhe F. Bektashi (255.450 euro)), ndersa pronaret i dhane tokat si hipoteke. Kredia u mor nga Union Bank of Albania. Keto shuma u perdoren, nder te tjera, per pagesen e tarifave per marrjen e lejes se ndertimit. Zakonisht ne Shqiperi, sic ndodhi edhe me kete projekt, qe ne momentin e marrjes se lejes se ndertimit, njesite e ndertimit fillojne te shiten dhe çdo shpenzim buron nga shitjet. Ata ofruan ulje te çmimit deri ne 10% ne menyre qe te krijohej fluks i mjaftueshem parash ne vitet e para deri sa projekti te ishte i qendrueshem.

Investimi total i projektit eshte perafersisht 61,5 milione euro (Koment A3: Kostoja totale e projektit 61.5 milione euro, te ardhurat nga projekti 79.8 milione euro) dhe te gjitha fitimet nga zhvillimi i projektit jane deklaruar ne organet tatimore. Shoqeria i eshte nenshtruar kontrollit nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, me date 09.05.2016, me Nr. Prot. 1477/1, dhe Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave, me date 13.09.2019, te cilat te dyja kane konstatuar se shoqeria ishte ne perputhje te plote me ligjin.

Babai im nuk ka shmangur asnje deklarim ligjor te detyrueshem ndaj subjekteve publike apo shteterore. Ai ka marre masat e nevojshme ligjore per ta mbrojtur projektin nga cenimi politik. Ne momentin kur shoqeria ka paguar pjesen me te madhe te detyrimeve ndaj kontraktuesve te trete dhe ka qene e gatshme te shpemdaje dividendin, ai e ka bere publike pjesemanjen ashtu sic e kerkon ligji.

Burimi i pasurive te babait

- Do te donim te merrnim nje shpjegim gjithepershires dhe te plote, duke perfshire provat themelore qe tregojne se si babai juaj ishte ne gjendje ta ndertonte kapitalin perpara se te behej aksionar ne Homeplan dhe te ishte ne gjendje te merrte pjese ne nje projekt me vlere mbi 20 milione euro.

Ketu duhen sqaruar kostot e projektit sipas deklarimeve ne tatime.

Babai im nuk ka mbajtur asnje post publik, as nuk ka perfituar dhe as ka aplikuar per tendera publike. Te ardhurat e tij profesionale jane grumbulluar nga puna e tij me Programin e Kombeve te Bashkuara per Zhvillim (1998-2001), Misionin e Kombeve te Bashkuara ne Kosove (2001 - 2006), si konsulent per disa organizata nderkombetare, si dhe konsulenca si ekspert mjedisor. Pervec kesaj, prej vitit 1991, ai kishte ne pronesi nje apartament (te privatizuar ne ate kohe per te gjitha popullsine) dhe perfitoi prona trashegimore si nga gjyshi nga nena (familja Bektashi, Shkoder) dhe nga gjyshja nga nena (familja Begeja, Tirane). Se bashku me nenen time, ata investuan per vite me radhe ne pasuri te paluajtshme, kryesisht duke blere apartamente ne Tirane, nga te cilat siguronin te ardhura nga qirate.

Njerezit qe shpifin dhe pyesin se ku i gjeten parate per te investuar jane te njejtet qe ne vitin 2006 shkruanin se ata kishin perfituar 1 milion dollare nga puna e tyre me Kombet e Bashkuara (shihni gazeten zyrtare te partise socialiste te vitit 2006).

Pas kthimit nga karriera e tyre ne UNMIK ne vitin 2006, nena ime beri nje deklarate vullnetare te te ardhurave dhe pasurise prane autoritetit publik perkates (ILDKPKI), ne momentin kur babai i saj u be kryeminister i Shqiperise. Qe atehere, ajo ka bere deklarata vjetore, per shkak te posteve te mbajtura nga babai i saj, ne ILDKPKI dhe gjithashtu ne organet tatimore kur u vendos kerkesa ligjore per deklarimin vjetor tatimor. Nese eshte e nevojshme, mund t'ju siguroj kopjet e ketyre deklaratave dhe te gjitha kontratave te referuara ne to, vetem se ju njoftoj se jane mjaft te gjata dhe ne gjuhen shqipe.

Duke qene se babai im ishte nje nga familjet kryesore qe zoteronte token ku shoqeria Homeplan kishte licencen per fillimin e projektit te ndertimit, ne daten 02.10.2008 u nenshkrua nje marreveshje investimi me Nr. Rep. 3000 dhe Nr. Koi. 1783 per projektin me perqindje pjesemarrjeje 40% nga Fatmir Bektashi (administratori i shoqerise Homeplan), 35% nga babai im dhe 25% nga kusheriri i tij Xhimi Begeja (gjithashtu nje nga familjet bashkepronare te tokes). Ne baze te kesaj marreveshjeje investimi te vitit 2008, u specifikua vite me vone vendimi i aksionarit per shitjen e aksioneve, i dates 23.01.2014, ku babai im ka marre 35% te aksioneve (kapitali aksionar i shoqerise eshte 100.000 leke, afersisht 815 euro). Punimet e ndertimit filluan ne prill te vitit 2010 dhe investimi fillestar u be nga aksionari/administratori kryesor Fatmir Bektashi per shumen prej 255.000 eurosh. Ai eshte gjithashtu administrator i shoqerise nenkontraktuese qe kryente punimet, qe mbuloi punimet fillestare duke transferuar 312.000 euro per pagesen e tarifes se marrjes se lejes se ndertimit dhe pagesen e taksave bashkiake. Sic ndodh zakonisht ne projekte te tilla ndertimi ne Shqiperi, ne momentin kur merret leja e ndertimit, shoqeria fillon shitjen e njesive te ndertimit dhe klientet paguajne pjeserisht per njesite e blera, keshtu qe kostot mbulohen nga shitjet e kontratave me parate qe kane paguar klientet. Nga ana tjeter, shoqeria offoi nje politike prej 10% ulje ne fillim te projektit ne menyre qe te krijonte fluks te mjaftueshem parash ne vitet e para derisa projekti te ishte i qendrueshem.

Ne tetor te vitit 2013, shoqeria Homeplan mori edhe nje kredi bankare prej 1.000.000 eurosh, dhe ne vitin 2014, nenkontraktuesi dha nje kredi prej 300.000 eurosh.

Pasi shoqeria ishte e qendrueshme dhe kishte likuiditet monetar te mjaftueshem per te mbuluar punimet ne proces e siper, ajo vendosi ta shpemdaje dividendin tek aksionaret sipas perqindjeve te tyre te percaktuara ne marreveshjen fillestare te investimit te vitit 2008.

- **Do te donim te merrnim me shume prova qe dhurata qe keni marre eshte qartesisht nga pjesemarrja qe babai juaj ka ne shoqeri te ndryshme si Homeplan ne Shqiperi.**

Shpjego qe hape llogarine te Union Bank kur/pse dhe aty te shkojne vetem te ardhurat e lidhura me biznesin. Duhet t'ua bashkelidhesh bilancet dhe transfertat nga homeplan tek banka

Per vitet financiare 2015-2020, shoqeria Homeplan shpemdau dividend per shumen bruto prej 8.425.453 eurosh me shumen korresponduese neto prej 7.488.087 eurosh. Vlera qe i duhet paguar babait tim sipas perqindjes 35% eshte 2.620.830 euro.

Viti	Data	Dividenti bruto i shperndare (Euro)	Dividenti neto i shperndare (Euro)	Jamarber Malltezi (35%) ne euro
2015	30.06.2016	600,000	510,000	178,500
2016	27.06.2017	1,481,481	1,259,259	440,741
2017	30.06.2018	1,652,855	1,403,000	491,050
2018	30.06.2019	2,583,685	2,376,990	831,947
2019	30.06.2020	831,934	765,379	267,883
2020	30.06.2021	1,275,498	1,173,458	410,710
Totali		8,425,453	7,488,087	2,620,830

Bashkelidhur ju paraqes vendimet e shperndarjes se dividendit per vitet 2015-2020.

Sipas pasqyrave bankare, gjate vitit 2021, shoqeria Homeplan shpk i ka transferuar babait tim si pjese e mbetur e shperndarjes se dividendit per vitet e meparshme pagesat sipas vlerave te meposhtme: ... citon gjithsej 1 581 815 euro.

- **Do te donim te merrnim me shume prova qe tregojne se nga erdhen 42,000.00€ nga nje llogari gjermane e babait tuaj.**

Babai e depozitoi draft-kontraten per blerjen e apartamentit tim ne banken e tij ne Shqiperi, duke i njoftuar se i duhej te bente disa transferta ne llogarine time per ta perfunduar blerjen. Kishte nje limit ditor per transfertat e tij ne internet dhe ai nuk mund ta transferonte te gjitha shumen ne llogarine time. Kur ai kishte transferuar 320,000€ ne llogarine time, krejt papritur, banka vendase ne Shqiperi pati nje problem per rreth tre deri ne kater dite me sistemin e saj ne internet. Meqenese kontrata ishte me afat kohor (parate duhet t'i shkonin Noterit brenda nje afati te caktuar), per te mos deshtuar ne permbushjen e detyrimit sipas kontrates, ai vendosi qe t'i siguroje 42,000 eurot e mbetura nga llogaria e tij gjermane.

Prinderit e mi u shpergulen ne Gjermani ne maj te vitit 2020 per shkak te nje problemi shendetesor urgjent dhe serioz te nje prej vellezerve te mi. Babai im qendroi atje deri ne tetor te vitit 2021, ndersa nena dhe vellai im jane ende atje. Llogaria bankare ne Gjermani u hap per te lehtesuar pagesat e shtrenjta ne lidhje me trajtimin mjekesor te vellait tim, por edhe per t'i mundesuar babait tim qe te ndiqte disa nga veprimtarite e tij te biznesit nga distanca (per shembull ai transferoi nje pjese te nje kredie te marre nga Union Bank per qellime investimi ne Gjermani, pasi per shkak te pandemise, nuk mund te udhetonte kur duhej ne Shqiperi). Te gjitha fondet e llogarise bankare gjermane jane transferuar nepermjet bankes nga

Shqiperia, nga e njejta llogari bankare ne Union Bank. Transfertat e bashkelidhura nga Union Bank nga maji i vitit 2020 e me tej).

- Si i shpjegoni mosperputhjet ne lidhje me pjesemarrjen e babait tuaj ne shoqerine Homeplan, pasi ai supozohet te jete perfshire ne shoqeri qe nga viti 2014 dhe jo qe nga viti 2018?

Deri ne vitin 2020, kur Ligji nr. 112/2020 hyri ne fuqi, kuadri ligjor per shoqerite nuk e kushtezonte transferimin e aksioneve me kerkesen e detyrueshme te deklarimit te struktures aksionare, me perjashtim te strukturave te grupit. Siç u shpjegua me lart, babai im ka bere te gjitha deklaratat ligjore te detyrueshme ne kohën dhe menyren e kerkuar nga ligji, por ka shmangur çdo publicitet te demshem te motivuar politikisht per projektin. Shoqeria Homeplan ka bere te gjitha raportimet tatimore ne perputhje me ligjin. Shoqeria Homeplan filloi shpëmdarjen e dividendit ne vitin 2015, pasi shoqeria ishte e qendrueshme dhe kishte likuiditet monetar te mjaftueshem per te mbuluar punimet ne proces e siper, dhe per dividendin e shpëmdare ishte deklaruar dhe paguar tatimi ne burim nga Shoqeria sipas Ligjit Tatimor. Shoqeria Homeplan e shpëmdau dividendin e saj ne baze te Ligjit per Shoqerite Tregtare dhe Ligjit per Tatimin mbi te Ardhurat, dhe ne baze te ketyre ligjeve, shpëmdarja e dividendit u be sipas marreveshjes se investimit me Nr. Rep. 3000 dhe Nr. Koi. 1783, te nenshkruar me 02.10.2008, dhe vendimit te shitjes se aksioneve te nenshkruar me 23.01.2014.

427.2. Përsa i përket kontrolleve të ushtruara nga organet tatimore dhe DPPP-ja, nga aktet e administruara ka rezultuar se është mbajtur nje Raport Kontrolli nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në prani të administratorit të shoqërisë Homeplan shpk shtetasit Fatmir Bektashi, i ushtruar në zbatim të lajmërimit Nr.1477 Prot, datë 04.02.2016. Rezultatet e këtij raporti kontrolli ashtu sikurse është cituar në letren e sipercituar, veprimtaria e kompanisë është në përputhje me ligjin.

Megjithatë, sipas një table me emërtimin “Pagesa cash për Homplan” të sekuestruar pranë Studio Pustina konstatohet më datë 20.04.2016 një pagesë me përshkrimin “KP Kontroll Tat” (kontribut patriotik) në shumën 14,000 Euro.

Përfitimet e marra nga shoqëria Homeplan sh.p.k.

Jamarbër Malltezi

428. Në lidhje me përfitimet e marra nga shoqëria Homeplan sh.p.k. përgjatë periudhës 2011 – 2015, nga shtetasi Jamarbër Malltezi, evidentohet:

Në dokumentat e sekuestruara pranë studio Pustina, më datë 28.04.2023, janë gjetur disa tabela dhe disa shkresa, në të cilat përshkruhen rakordimet e kryera ndërmjet shtetasit Fatmir Bektashit dhe Studio Pustina. Këto të dhëna përmbledhen në një tabelë të emërtuar “Jamarbër Malltezi, Total pagesa për Divident 2011 – 2022” Nga analizimi i zërave të pasqyruar në këtë tabelë rezulton se për periudhën 2011 - 2015, në lidhje me shtetasin Jamarbër Malltezi janë evidentuar pagesat e mëposhtme:

Nr	Date	Shuma	Komente	Viti	Kursi	Vlera Leke
1	15/03/2011	50,000	Cash,MP nr.95 dt.15/03/2011 A01	2011	140,01	7,000,500
2	18/03/2011	10,000	Cash,MP nr.83 dt.18/03/2011 A01	2011	140,18	1,401,800
3	13/04/2011	20,000	Cash,MP nr.116 dt.13/04/2011 A01	2011	141,65	2,833,000
4	4/5/2011	10,000	Cash,MP nr.115 dt.04/05/2011 A01	2011	142,3	1,423,000

5	20/06/2012	1786,4	Paguar Hipoteka e 4 shkurti", viti 2012			
6	19/11/2015	20,000	JM Cash nga FB,MP nr 161	2015	137,67	2,753,400
7	19/11/2015	7,000	JM Cash nga FB,MP nr 161/1	2015	137,67	963,690
8	18/11/2015	20,000	JM Cash nga FB,MP nr 174	2015	138,01	3,317,230

Në total për vitin 2011 kjo shumë është **90,000** euro dhe sipas këtij dokumenti pasqyrohet si dividend që i jepet shtetasit Jamarbër Malltezi.

Në total për vitin 2012, shumë është **1,776,4** euro dhe sipas këtij dokumenti pasqyrohet si dividend që i jepet shtetasit Jamarbër Malltezi.

Në total për vitin 2015 kjo shumë është **50,000** euro dhe sipas këtij dokumenti pasqyrohet si dividend cash që i jepet shtetasit Jamarbër Malltezi Cash

Të dhënat e mësipërme janë pasqyruar edhe në dokumentat e sekuestruara me procesverbalin e datës 22.10.2023, ku ndër të tjera është gjetur shkresa e datës **21.12.2017** me titull: *RAPORT PER NDARJEN E FITIMIN*. Në përmbajtje të kësaj shkrese shkruhet: "Shumë e respektuar Znj.Pustina, Gjeni bashkelidhur raportin për pagesat e kryera për ortakët Homeplan, per fitimin e realizuar në vite, sipas pjesëve takuese ne marreveshjen e perbashket. Sqaroj se:

1. Per secilin ortak, qe jane kryer pagesa, kenë tabelat bashkelidhur. Ne pagesa jane perfshire pervec dividendit te ndare ne vitin 2016 dhe 2017, edhe te gjitha terheqjet e realizuara prej tyre, nga viti 2010 e deri ne date 10.12.2017, me cash, me fature si dhe me njesi mbi pjesen takuese, (mbi 25%), sipas kontrates se sipermarrrjes nga HP me Pronaret e truallit;
2. Shuma e mesiperme, per ortaket me 25% dhe 35%, eshte marre si baze e llogaritjes se pjeses takuese per pagese per ortakun me 40%. Pagesa e llogaritur per pagese, do te filloje te behet ne vitin 2018, pas hartimit te vendimit te ortakut per perdorimin e fitimit te vitit 2017.
3. Komentet Tuaj ju lutem per sa me larte."

Bashkëlidhur kësaj shkrese, ndër të tjera gjendet një tabelë me emërtimin "Pagesa cash dhe Bankë për Jamarbër Malltezi". Në këtë tabelë pasqyrohen sërish pagesat e kryera për shtetasin Jamarbër Malltezi sipas përshkrimeve të mëposhtme:

- Datë 15.03.2011, shuma 50,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP (JM)".
- Datë 18.03.2011, shuma 100,000 euro, komenti: cash; përshkrimi " Kontribut Patriotik Mgnet (JM)".
- Datë 13.04.2011, shuma 20,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: " Kp (JM)".
- Datë 04.05.2011, shuma 10,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: " Kp (JM)".
- Datë 26.06.2012, shuma 1,786.41 euro, komenti: cash; përshkrimi: " Paguar Hipoteka e 4 shkurti)".
- Datë 19.11.2015, shuma 20,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: " JM Cash nga FB".
- Datë 19.11.2015, shuma 7,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: " JM Cash nga FB".
- Datë 11.12.2015, shuma 7,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: " JM Cash nga FB".

Gjithashtu bashkëlidhur kësaj shkrese (21.12.2017) është gjetur tabela e emërtuar: "Sipërfaqe Ara, Pjesë takuese dif e pamarrë, pagesa Cash dhe Bankë, Jamarbër Malltezi"

Në këtë tabelë paraqiten vlerat totale të pagesave për periudhën 2011 – 2017, sipas komenteve dhe përshkrimeve përkatëse, ku për periudhën **2011 – 2015** janë shënuar totalët në lidhje me paratë që i janë dhënë shtetasit Jamarbër Malltezi. Kontretisht:

- Viti 2011, Vlera e pageses euro 90,000; Komenti: sipas tab analitike 1; Tërheqje cash

- Viti 2012, Vlera e pageses euro 1,786.41; Komenti: sipas tab analitike 1; Paguar hipoteka e 4 shkurti
- Viti 2015, Vlera e pageses euro 50,000; Komenti: sipas tab analitike 1; Cash nga Z. Bektashi

Me qëllim dokumentimin, e marrjes së shumave të mësipërme, nga shtetasi Jamarbër Malltezi janë analizuar dokumentat dhe të dhënat në pajisjet elektronike të sekuestruara në ambientet e Studio Pustina në datën 22.10.2023, në zbatim të Vendimit të Gjykatës. Konkretisht dokumentet "Homeplan – Analizë", të cilat përfaqësojnë lëvizjet e kryera në arkën e shoqërisë "Homeplan" sh.p.k, dhe të dhënat e përfutuara nga Akt i Ekspertimit me nr. Nr. 115 datë 14.06.2024, për ekspertimin teknik kompjuterik.

1. Nga analizimi i të dhënave të Akt i Ekspertimit nr. Nr. 115 dt 14.06.2024, rezulton se në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Backup Documents Odi_Laptop HP Old\Homeplan\Homeplan 2022\Bilanc 2022", ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin Excel, me emërtimin "Sistemime_2022.xlsx, me autor: Heëlett-Packard Company, i krijuar më datë 02.08.2022, i ruajtur për herë të fundit më datë 02.08.2022. Ky dokument përmban 8 (tetë) nënndarje (sheet) të emërtuara si vijon: **Details 21; Priv. Div.FB; FB_467; Div.Abi ; Div.Xhimi; Rak.Kontakt+HP; Per sistemim te faturave.**

Në nënndarjen e pestë të emërtuar "Div.Abi", paraqiten në forme tabelore me shënime përkatëse të gjitha pagesat e kryera kundrejt Abi (Jamarbër Malltezi), nga shoqëria Homeplan shpk, ku ndër të tjera për vitet 2011, 2012 dhe 2015 është shënuar "Për sistemim" dhe "Janë marre cash" dhe totalët për çdo vit.

- Për vitin 2011 është shënuar se janë marrë CASH nga shtetasi Jamarbër Malltezi 90,000 euro ose 12,658,300 lekë.
- Për vitin 2012 janë është shënuar se janë marrë CASH nga shtetasi Jamarbër Malltezi 1,786.41 euro ose 246,525 lekë.
- Për vitin 2015 është shënuar se janë marrë CASH nga shtetasi Jamarbër Malltezi 50,000 euro ose 6,891,320 lekë.

Pamje te dokumentit "Sistemime_2022.xlsx" sheet - Div.Abi:

	4.116.999	515.100.307		
Per sistemim				
	Jane marre cash Leke			
viti 2011	90,000.00	12,658,300		
2012	1,786.41	246,525		
2015	50,000.00	6,891,320		
	141.786.41	19,796,145	534,896,452	Totali ne leke
		1070614E		

Levizjet e Arkës:

Në hard diskun e sekuestruar pranë Studio Pustina është gjetur dokumenti me emërtimin "Arka Analitik 2011çIÇ", në dosierin " "D:\3-Laptop HP EliteBook 860 G9\Te Dhenat me EnCase_Bruto\Users\User\Desktop\Homeplan\Home Plan\Homeplan 2011\Rakordime per Bilanc 2011" ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin PDF, me emërtimin *Arka Analitik 2011çIÇ.pdf* modifikuar për herë të fundit më datë 01.04.2011.

Nga analizimi i lëvizjeve të Arkës, evidentohet si vijon

- MA nr. 67, datë 15.03.2011, në vlerën 50,000 euro (7,000,500 lekë), me përshkrimin "Fatmir Bektashi, tërheqje RFZ" dhe MP nr. 95, datë 15.03.2011, në vlerën 50,000 euro (7,000,500 lekë), me përshkrimin "Fatmir Bektashi, kontribut patriotik".

- MA nr. 55, datë 18.03.2011, në vlerën 10,000 euro (1,401,800 lekë), me përshkrimin "Kontakt shpk kthim shume" dhe MP nr. 83, datë 18.03.2011, në vlerën 10,000 euro (1,401,800 lekë), me përshkrimin "Kontribut Patriotik, MAGNET".
- MA nr. 89, datë 13.04.2011, në vlerën 20,000 euro (2,831,200 lekë), me përshkrimin "Fatmir Bektashi, terheqje nga Raiffeisen Bank" dhe MP nr. 116, datë 13.04.2011, në vlerën 20,000 euro (2,831,200 lekë), me përshkrimin "Fatmir Bektashi, Kontribut Patriotik".
- MA nr 88, datë 04.05.2011, në vlerën 10,000 euro (1,423,000 lekë), me përshkrimin "terheqje nga llogaria" dhe MP nr. 115, datë 04.05.2011, në vlerën 10,000 euro (1,423,000 lekë), me përshkrimin "Fatmir Bektashi, Kontribut Patriotik".

Mandat pagesat e mësipërme të vitit 2011, pasqyrohen gjithashtu edhe në dokumeta të tjerë elektronik në formatin pdf dhe excel, konkretisht në dokumentat "*Banka Analitik 2011çlÇ.pdf*", "*Llogaria shpenzimeve çlÇ.pdf*" dhe "*Libri i madh 2011.xls*". dhe përshkruhen si shpenzime për "*Kontribute patriotike*"

Nga këqyrja e llogarive bankare të shoqërisë Homeplan sh.p.k., rezulton në bankën Raiffeisen Bank në llogarinë me nr. 1235310 në euro të shoqërisë "*Homeplan*" sh.p.k, shtetasi Fatmir Bektashi ka kryer tërheqet si më poshtë:

- Në datën 15.03.2011, është kryer një tërheqje nga shtetasi Fatmir Bekatshi tërheq 50,000 euro çka përputhet me veprimet e regjistruar në dokumentat e kontabilitetit të përshkruara më sipër.
- Në datën 13.04.2011, është kryer një tërheqje nga shtetasi Fatmir Bekatshi tërheq 20,000 euro çka përputhet me veprimet e regjistruar në dokumentat e kontabilitetit të përshkruara më sipër.
- Në datën 04.05.2011, është kryer një tërheqje nga shtetasi Fatmir Bekatshi tërheq 20,000 euro çka përputhet me veprimet e regjistruar në dokumentat e kontabilitetit të përshkruara më sipër.

Sa më sipër, shumat që kanë shërbyer për pagesat e përshkruara si *kontribut patriotik*, janë tërhequr nga llogaria bankare e shoqërisë Homeplan shpk, nga shtetasi Fatmir Bektashi, janë arkëtuar në arkën e shoqërisë Homeplan shpk dhe më pas janë tërhequr nga Arka e shoqërisë për shtetasin Jamarber Malltezi me përshkrimin "*Kontribut Patriotik*" ose "KP (JM)".

Në dosierin "*D:\3-Laptop HP EliteBook 860 G9\Te Dhenat me EnCase_Bruto\Users\User\Desktop\Homeplan\Home Plan\Homeplan 2012\Bilanc 2012*" ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin rtf, me emërtimin "*Arka leke 2012.rtf*", modifikuar për herë të fundit më 28.03.2013. Nga analizimi i lëvizjeve të Arkës, evidentohet si vijon: MP nr 103, datë 29.06.2012, në vlerën 246,825 lekë, me përshkrimin "Fatmir Bektashi, pagesë hipoteke te ap dhe garazhi dhe J.Malltezit te..".

Gjithashtu, në lidhje me pagesën e mësipërme të vitit 2012, në dokumentin excel emërtimin "*Sistemime_2022.xlsx*", evidentohet se për shtetasin Jamarbër Malltezi, për vitin 2012 janë marrë CASH nga shtetasi Jamarbër Malltezi 1,786.41 euro ose 246,525 lekë. Nga aktet rezulton gjithashtu se dy aplikime pranë ZVRPP janë bërë nga shtetasi Jamarbër Malltezi më datë 28.06.2012 për lëshim kopje karte, shitje, lëshim çertifikate pronësie në total detyrimi për 'u paguar 31 875 lekë dhe lëshim çertifikatë pronësie, shitje, koje karte në vlerën totale 214 650 lekë, por pagesat janë kryer nga shoqëria Kontakt sh.p.k. po me date 28.06.2012.

Nga këqyrja e të dhënave të pajisjeve elektronike të sekuestruara, me anë të programit ekzaminues AXIOM janë gjetur gjithashtu disa emaile ku janë dërguar bashkëlidhur dokumente të cilet i perkasin vitit 2011 - 2012, konkretisht:

Më dt 31.03.2012 është dërguar email nga adresa Erovina Shallas (erovina.shallas@kontakt.al), në adresën Studio Pustina, CC Suzana Aliaj, me subject :Banka Arka Analitik, me tekst:

*Gjithe te mirat,
Dpl.Fin Erovina Shallas
Financiere
Kontakt*

Bashkëlidhur këtij emaili dërgohen 2 dokumente në formatin .pdf, me emërtimet: **Banka Analitik 2011.pdf ; Arka Analitik 2011.pdf**

Më datë 31.03.2012 është dërguar email nga adresa Erovina Shallas (erovina.shallas@kontakt.al), në adresën Studio Pustina, CC Suzana Aliaj, me subject: Te ardhura-shpenzime 2011 me tekst:

*Gjithe te mirat,
Dpl.Fin Erovina Shallas
Financiere
Kontakt*

Bashkëlidhur këtij emaili dërgohen 2 dokumente në formatin .pdf, me emërtimet: **Llogaria e shpenzimeve.pdf ; llogaria te ardhura.pdf**

Me datë 28.03.2013, ora 13:53 është dërguar emaili nga adresa Studio Pustina çMailto: mcpustina@yahoo.com, në adresen Suzana Aliaj, CC Fatmir Bektashi, me subjekt: Arka_HP, me tekst: *Pershendetje Suzana, Te lutem me dergo me email arken e Homeplan per periudhen dhe monedhat e meposhtme:*

- Euro Tetor - Dhjetor 2012;
 - ALL Tetor - Dhjetor 2012;
 - USD Janar – Maj 2012 dhe Korrik – Dhjetor 2012
- Faleminderit
Odeta*

Më datë 28.03.2013, ora 14:08 është dërguar email nga adresa: Suzana.aliaj@kontakt.al në adresën Studio Pustina, CC: Fatmir Bektashi, me subject FE: Arka_HP, me tekst: *Pershendetjke Odeta, Bashkelidhur gjeni ditarin e arkës Homeplan per te gjitha monedhat per vitin 2012.*

Bashkëlidhur këtij emaili dërgohen 3 dokumente në formatin .doc dhe .rtf, me emërtimet: Arka Euro 2012 ; Arka leke 2012; Arka dollar 2012

Për sa më sipër, evidentohet se dokumentat e dërguara me anë të këtyre e-maileve dhe më pas të gjetura nga ekspertimi kompjuterik janë pjesë e rakordimeve dhe regjistrimeve në kontabilitetin e shoqërisë Homeplan shpk

Në dokumentin e datës 19.11.2015, me përshkrimin “ HOMEPLAN 2015 – Arka -Analizë”, të sekuestruar pranë Studio Pustina, paraqiten arkëtimet dhe pagesat në monedhën euro, në arkën e shoqërisë Homeplan, për periudhën 01.01.2015 – 30.11.2015, ndër të tjera evidentohen lëvizjet e mëposhtme:

- MA 173, MP 161, datë 19.11.2015, në vlerën 20.000 euro, me përshkrimin " Kontakt shpk , Kalim fondi, PER KP, JM, mp 266, dt 19/11/2015 dhe MP 161, datë 19.11.2015, në vlerën 20.000 euro, me përshkrimin " JM, KP nga FB"

Gjithashtu, të gjitha pagesat e përmendura më sipër janë të pasqyruara, me të njëjtat vlera, data dhe përshkrime edhe në tabelat gjetur bashkëlidhur shkresës me Nr. 6372 Prot, datë 01.06.2022 që bën fjalë për rakordimet e shpenzimeve dhe shpërndarjen e "dividentit" për "ortakët", dërguar shtetases Andia Pustina dhe nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi. Konkretisht në tabelat me emërtimet : "Pagesa cash për Homeplan" , "Jamarbër Malltezi, Total pagesa për Divident 2011 – 2022" dhe "Pagesa CASH dhe Bankë Homeplan për JM"

Për sa më sipër, evidentohet se këto pagesa janë pasqyruar më shumë se një herë, në shkresat dhe tabelat rakorduese të cilat i dërgohen studios së kontabilitetit Pustina, në Arkën e shoqërisë Homeplan si dhe në dokumentat elektronik të përftuara nga ekspertimi kompjuterik, duke konfirmuar më shumë se një herë krverjen e këtyre pagesave për shtetasin Jamarbër Malltezi me përshkrimin Kontribut Patriotik.

Gjithashtu konstatohet, se këto pagesa i janë përlllogaritur shtetasit Jamarbër Malltezi si divident i marrë nga shoqëria Homeplan shpk. Theksojmë se me shkresën 26131/I Prot, datë 15.06.2023, organi tatimor na bën me dije se shtetasi Jamarbër Malltezi me ID H21109073R rezulton i regjistruar si aksioner individ i komopanisë Homeplan me NIPT K81803020E, nga data 17.12.2018 dhe se të gjitha pagesat përpara kësaj date nuk mund të jenë për llogari të Dividentit.

Nga këqyrja në sistemin informatik tatimor C@TS rezulton se shtetasi Jamarmër Malltezi, për periudhën 2011-2015, rezulton se ka deklaruar 0 lekë si të ardhura nga **dividenti**. Konkretisht:

- Në Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin 2011 (dorëzuar më datë 01.10.2012), ka deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividenti.
- Në Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2012 (dorëzuar më datë 30.04.2013), ka deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividenti.
- Në Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2013 (dorëzuar më datë 29.04.2014), ka deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividenti.
- Në Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2014 (dorëzuar më datë 30.04.2015), ka deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividenti
- Në Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2015 (dorëzuar më datë 29.04.2016), ka deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividenti.

428.1. Ne lidhje me perfitimet qe shtetasi Jamarber Malltezi, ka marre nga shoqeria Homeplan sh.p.k. pergjate vitit 2016, evidentohet se:

Në dokumentat e sekuestruara me procesverbalin e datës 22.10.2023, ndër të tjera është gjetur shkresa e datës 21.12.2017 me titull: *RAPORT PER NDARJEN E FITIMIT*. Në përmbajtje të kësaj shkrese shkruhet: *Shumë e respektuar Znj.Pustina, Gjeni bashkelidhur raportin për pagesat e kryera për ortakët Homeplan, per fitimin e realizuar në vite, sipas pjesëve takuese ne marreveshjen e perbashket.*

Sqaroj se:

1. *Per secilin ortak, qe jane kryer pagesa, keni tabelat bashkelidhur. Ne pagesa jane perfshire pervec dividentit te ndare ne vitin 2016 dhe 2017, edhe te gjitha terheqjet e realizuara prej tyre, nga viti 2010 e deri ne date 10.12.2017, me cash, me fature si dhe*

me njesi mbi pjesen takuese, (mbi 25%), sipas kontrates se siper marrjes nga HP me Pronaret e truallit;

2. Shuma e mesiperme, per ortaket me 25% dhe 35%, eshte marre si baze e llogaritjes se pjeses takuese per pagese per ortakun me 40%. Pagesa e llogaritur per pagese, do te filloje te behet ne vitin 2018, pas hartimit te vendimit te ortakut per perdorimin e fitimit te vitit 2017.
3. Komentet Tuaj ju lutem per sa me larte."

Bashkëlidhur, ndër të tjera gjendet tabela me emërtimin "Pagesa cash dhe Bankë për Jamarbër Malltezi"

Kjo tabelë përbëhet nga katër kolona të emëtuara Data; Vlera e pagesës euro; komente; përshkrimi.

Për vitin 2016 reflektohen shumat, komentet dhe përshkrimet si më poshtë:

- Datë 17.05.2016, shuma 40,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM".
- Datë 24.06.2016, shuma 19,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM, terheqje ne ub nga FB".
- Datë 27.06.2016, shuma 21,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM, terheqje ne ub nga FB".
- Datë 01.09.2016, shuma 18,855 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per JM".
- Datë 03.09.2016, shuma 500 euro, komenti: cash; përshkrimi: "JM per Bishqemi".
- Datë 05.09.2016, shuma 11,145 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per JM".
- Datë 10.09.2016, shuma 32,711 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per JM".
- Datë 30.09.2016, shuma 7,692.31 euro, komenti: cash; përshkrimi: "JM 10000 dollare".
- Datë 20.10.2016, shuma 39,914 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per JM".
- Datë 23.12.2016, shuma 62,200 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per bashkeinvestoret".
- Datë 23.12.2016, shuma 729.93 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per bashkeinvestoret".
- Datë 27.12.2016, shuma 437.93 euro, komenti: cash; përshkrimi: "FB per bashkeinvestoret".

Sa më sipër rezulton se në total për vitin 2016 shtetasit Jamarbër Malltezi i është dhënë shuma **190,817 euro**.

Gjithashtu bashkëlidhur kësaj shkresë (21.12.2017) është gjetur tabela e emërtuar: "Sipërfaqe Ara, Pjesë takuese dif e pamarrë, pagesa Cash dhe Bankë, Jamarbër Malltezi"

Në këtë tabelë paraqiten vlerat totale të pagesave sipas viteve, me komentet dhe përshkrimeve përkatëse, ku për vitin 2016 është shënuar : **Viti 2016, Vlera e pageses euro: 190,817; Komenti: sipas tab analitike 1; Përshkrimi: Cash nga Z.Bektashi**

Nga analizimi i të dhënave të ekspertuara me Akti i Ekspertimit me nr. Nr. 115 datë 14.06.2024, për ekspertimin teknik kompjuterik, rezulton se në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Backup_Pustina share\Andia Documents_15.12.22\Andia Documents\Home Plan", ndër të tjera është gjetur dokumenti në formatin Excel, me emërtimin "**Permbledhese 30.09.15 Ortaket.xlsx**", me autor: Griselda, i krijuar më datë 28.05.2015, i ruajtur për herë të fundit më datë 28.06.2016 nga "Pustina". Ky dokument përmban 4 (katër) nënndarje (sheet) të emëtuara si vijon: Sheet 1; JM; Xhimi; Permbledhje.

Në nënndarjen e dytë me emërtimin JM, paraqiten pagesat e kryera kundrejt bashkëinvestitorit JM (*dyshuar Jamarbër Malltezi*), gjatë viteve 2011-2016, më konkretisht:

•	Kontrata kleringu	442,240
•	Pag.Fat.Gimi	100,000
•	Cash nga Fatmiri 2011	80,000
•	CASH nga Fatmiri 05-2016	40,000
•	Cash nga Fatmiri 06-2016	40,000
	Totali	702,240

Për vitin 2016 konstatohet se janë bërë shënimet Cash nga Fatmiri 05-2016 - 40,000 dhe Cash nga Fatmiri 06-2016 – 40,000.

Këto vlera përputhen gjithashtu me të dhënat e tabelave të emërtuara "Pagesa cash dhe Bankë për Jamarbër Malltezi" dhe "Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM" të analizuara më sipër, ku rezulton se shtetasit Jamarbër Malltezi i janë dhënë cash 80,000 euro në muajt Maj 2016 dhe Qershor 2016, konkretisht:

Në datën 17.05.2016, shuma 40,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM".

Në datën 24.06.2016, shuma 19,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM, terheqje ne ub nga FB".

Në datën 27.06.2016, shuma 21,000 euro, komenti: cash; përshkrimi: "KP JM, terheqje ne ub nga FB".

Në lidhje me pagesat cash të datave 24.06.2016 shuma 19,000 euro dhe 27.06.2016 shuma 21,000 euro me përshkrim "KP JM terheqje ne ub nga FB" të cituara në tabelat e mësipërme, janë kryer verifikimet në llogaritë bankare të shoqërisë "Homeplan" sh.p.k. me numër 111283737020121 në monedhën euro nga ku rezulton se të vetmet tërheqje për muajin Qershor 2016 nga shtetasi Fatmir Bekrashi janë tërheqjet e mëposhtme:

- Datë 02/06/2016 shuma 10,000 euro me përshkrim "Tërheqje nga Fatmir Petrit Bektashi".
- Datë 03/06/2016 shuma 10,000 euro me përshkrim "Tërheqje nga Fatmir Petrit Bektashi".
- Datë 06/06/2016 shuma 10,000 euro me përshkrim "Tërheqje nga Fatmir Petrit Bektashi".
- Datë 08/06/2016 shuma 10,000 euro me përshkrim "Tërheqje nga Fatmir Petrit Bektashi"

Në total, gjatë muajit Qershor 2016, brenda pak ditëve, janë tërhequr 40,000 euro cash nga shtetasi Fatmir Bektashi, shumë kjo që përkon me regjistrimet e bëra në tabelat e mësipërme.

Në vijim të hetimeve ka rezultuar se në dokumentat e sekuestruara në Studio Pustina, me procesverbalin e datës 28.04.2023 është gjetur ndër të tjera shkresa me nr. 6372 Prot, datë 01.06.2022. Kjo shkresë bën fjalë për rakordimet e shpenzimeve dhe shpërndarjen e "dividentit" për "ortakër" e shoqërisë Homeplan sh.p.k., është e nënshkruar nga shtetasi Fatmir Bektashi dhe i është dërguar shtetases Andia Pustina. Në përmbajtje të kësaj shkrese konfirmohet dërgimi i disa dokumenteve (tabelave) dhe ndër të tjera citohet: "...Gjithashtu bashkelidhur do te gjeni dokumenta qe Znjsh. Suzana Aliaj ka sjell tek ju per dividentin e Z. Jamarber Malltezi. Jane terhequr divident nga Z. Fatmir Bektashi 637 k€ dhe jane paguar per Z. Malltezi: paguar cash vlera 547 k€ dhe 90 k€ fatura konculence. Keshtu qe nga detyrimi i dividentit te Z. Bektashi duhet te zbritet vlera 637 k€...."

Bashkëlidhur kësaj shkrese, ndër të tjera është dërguar sërish tabelat me emërtimin "Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM", ku për vitin 2016 janë pasqyruar të njëjtat vlera si në tabelën e dërguar me shkresën e datës 21.12.2017.

Në vijim të korrespondencës të shtetasit Fatmir Bektashi me Studion e kontabilitetit Pustina është gjetur gjithashtu shkresa e datës 25.07.2022, drejtuar Andia Pustinës nga Fatmir Bektashi,

ku kërkohet korrigjimi i tabelës "Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM" dërguar me shkresën e datës 01.06.2022. Për këto korrigjime evidentohet në shkresë se është rënë dakord dhe është sqaruar situata me shtetasin Jamarbër Malltezi. Konkretisht për vitin 2016, është shënuar si më poshtë: "1. Vlera prej 254 k€, e cila i është dhene Z. Malltezi ne vitin 2016 nga ana ime, te korrigohet dhe hiqet nga tabela, sepse nuk eshte per llogari te dividendit".
2. Vlera prej 90 k€, e cila eshte paguar ne vitin 2017 nepermjet faturave te sjella nga Z. Malltezi, duhet te qendroj ne tabele sepse eshte per llogari te dividendit te Z. Malltezi.
3. Vlera prej 120 k€, e cila i eshte dhene Z. Malltezi ne muajin Mars 2017, duhet te llogaritet si dividend per te tre ortakët sipas kuotave perkatese: J. Malltezi vlera 42 k€ (35%), F. Bektashi vlera 48 k€ (40%) dhe Xh. Begeja vlera 30 k€ (25%)
Bashkelidhur do te gjeni tabelen e excel per terheqjet e dividendit per Z. Jamarber Malltezi, ku jane realizuar korrigjimet. Pas korrigjimeve te realizuara, rezulton se jane terhequr dividend nga Z. Fatmir Bektashi 304 k€ dhe jane paguar per Z. Malltezi: paguar cash vlera 214 k€ dhe 90 k€ fatura konculence..."

Bashkelidhur kësaj shkrese (të datës 25.07.2022) është dërguar sërish tabelë me emërtimin "Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM", në të cilën është shtuar një kolonë me emërtimin "Korrigjime". Shumat e cituara në excelin e tabelës së dërguar më datë 01.06.2022 janë hequr dhe në kolonën "Korrigjime" është bërë shënimi "Duhet të hiqet nga llogaria e dividendit të z. Jamarbër Malltezi". Në fund të këtij dokumenti gjendet gjithashtu një tabelë përmbledhëse me emërtimin "Korrigjuar, zbritur nga llogaria JM" dhe për vitin 2016 ku është shënuar "Per Ana- 254,185.19, Viti 2016".

Shtetasi Jamarbër Luan Malltezi me ID H21109073R, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), për vitin 2016 (dorëzuar më 27.04.2017), 16-A, në rubrikën ç5Ç: Të ardhura bruto nga Dividenti deklaron vlerën 0 lekë

428.2. Në lidhje me të ardhurat që ka marrë shtetasi Jamarber Malltezi, pergjate periudhes 2017 – 2022 evidentohet se:

Nga analizimi i të dhënave të ekspertuara me Akti i Ekspertimit me nr. Nr. 115 dt 14.06.2024, për ekspertimin teknik kompjuterik, rezulton se: në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Backup Documents Odi_Laptop HP Old\Homeplan\Homeplan 2022\Bilanc 2022", ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin Excel, me emërtimin "Sistemime_2022.xlsx", me autor: Hewlett-Packard Company, i krijuar më datë 02.08.2022, i ruajtur për herë të fundit më datë 02.08.2022.

Ky dokument përmban 8 (tetë) nënndarje (sheet) të emërtuara si vijon: Details 21; Priv. Div.FB; FB_467; Div.Abi ; Div.Xhimi; Rak.Kontakt+HP; Per sistemim te faturave.

Pamje te dokumentit "Sistemime_2022.xlsx" sheet - Div.Abi:

	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J		
07			1 - 121.59L			19 774 400.00L						
08	KAK	15.02.2021	Pag. dividend J.Malta:	55	5124	110 000.00"		2 302 107.00				
09			1 - 121.57L			13 582 700.00L						
10	KAT	16.02.2021	Pag. dividend J.Malta:	58	5124	130 000.00"		2 132 107.00				
11			1 - 121.58L			16 062 800.00L						
12	KAG5	30.07.2021	Pag. dividend J.Malta:	58	5124	100 000.00"		2 232 107.00				
13			1 - 121.80L			12 180 000.00L						
14	KAG7	02.08.2021	Pag. dividend J.Malta:	1	5124	100 000.00"		2 332 107.00				
15			1 - 121.66L			12 166 000.00L						
16	KAG8	03.08.2021	Pag. dividend J.Malta:	2	5124	100 000.00"		2 432 107.00				
17			1 - 121.56L			12 150 000.00L						
18	KAG70	04.08.2021	Pag. dividend J.Malta:	4	5124	111 615.00"		2 543 322.00				
19			1 - 121.47L			13 582 98.00L						
20												
21						2021						
22				Eur		1396077.25						
23						1396077.25	Nat. Kontatid i Kontatidit					
24							differenca					
25												
26												
27												
28												
29				Eur		1396077.25						
30						1396077.25	Nat. Kontatid i Kontatidit					
31							differenca					
32												
33												
34												
35					Total	Leka						
36					2017	109,307	90,417,450.65		127,503,368	21,914,062.65		
37					2020	30,000	3,723,300.00					
38					2021	1581,835	194,670,268.05					
39					2022	1,206,077	167,299,367.90					
40						4,116,533	515,100,387					
41												
42					Per sistemim							
43					Jane mare cash	Leka						
44				982911	2012	90,000.00	12,658,300					
45					2015	1,786.41	248,525					
46					2015	50,000.00	6,831,320					
47						141,786.41	19,736,145	534,896,452	Total ne leke			
48							19790145					
49					Grand total	4,258,785.66	Paguar ABIT					
50												
51												
52	46715	Jamar er Malta:				Eur				0		
53	0201	24.12.2012	Lik. Det. Jamarber Mal	79	51290	45 128.94L		-45 128.94				
54			1 - 129.20L			6 201 948.45L						
55		0.30.12.2012	korrigim kursi	210		0.00L		-45 128.94				
56			1 - 129.59L			17 600.28L						
57												
58				Eur		0 45 128.94L						
59												
60					Per ti kthyer Abit	Leka						
61					Euro	45 128.94	6 201 948.00	kalm i kthyer ne 2012 nga jM ne Homeplan				
62			100.00	Euro	44 126.70	5 736 431.00	5 736 431.00	shese sipendaje takonca si bashkepronar per ti kthyer Abit				
63							12,019,429.00	12019429				
64					Euro	1,206,236.30	Mare me teper sipendaje tek ARA ti kthyeri, duhem kthyer oca shtrifur nga llogj e dividendit					
65					Leka	158,237,650.00	Kursi i pare dhe i dyte tek ti kthyeri, do vendoset si do trajtohet, si ardhur apo do zgjidhet ndryshe					
66												
67					Grand total	3,097,226.30						
68					Total i detejimit ne Homeplan ka rritur ABIT	5,426,345.82	67297502.6	Leka				
69												
					Details 21	Priv.	Div.FB	FB_467	Div.Abi	Div.Xhimi	Rak.Kontatid+HP	Per sistemim te faturave

Në nënndarjen e pestë të emërtuar **"Div.Abi"**, paraqiten në forme tabelore me shënime përkatese të gjitha pagesat e kryera kundrejt Abi (*Jamarbër Malltezi*), nga shoqëria Homeplan shpk, ku ndër të tjera për vitet **2017** është shënuar **"957,107 euro me bankë"**; **"72,000 euro cash (sistemimi i 120k në mars 2017)"** dhe **"90,000 euro nëpërmjet faturave"**

Konstatohet gjithashtu se në këtë dokument është bërë shënimi **“1,250,815.00 EURO - Marre me teper sip.takuese tek ARA 11-kateshi, duhen kthyer ose zbritur nga llog.e dividendit: Kati I pare dhe i dyte tek 11 kateshi, do vendoset si do trajtohet, si ardhur apo do zgjidhet ndryshe”**

Në nënndarjen e fundit të dokumentit excel të emërtuar **“ Per sistemim te faturave”**, paraqitet se si do të bëhet sistemimi i shumave të kaluara përmes faturave dhe vlerave cash.

Në lidhje me këto shuma, autori i këtij dokumenti ka bërë shënimet si vijon:

				F.B.	J.M	XH.B	
	2017			0.4	0.35	0.25	
ABI	90,000	fatura	do ndahet ne 3 ortake	36,000	31,500	22,500	90,000

Cash						
ABI	72,000.00	cash (sistemimi I 120k ne mars 2017)				
ABI	141,786.41					
	213,786.41					

Shuma prej 141,786.41 përbën ekzaktësisht shumatoren e pagesave **cash** kundrejt shtetasit Jamarbër Malltezi për periudhën 2011-2015.

Në lidhje me faturat e sipërpërmendura konstatohet gjithashtu se në shkresën Nr. 6372 Prot, datë 01.06.2022 dërguar Andia Pustinës dhe ndër të tjera citohet : **“...Gjithashtu do të gjeni dokumente që Znjsh. Suzana Aliaj ka sjellë tek ju për dividendin e Z. Malltezi. Janë tërhequr dividend nga Z.Fatmir Bektashi 637 mijë euro dhe janë paguar për Z.Malltezi : paguar CASH vlera 547 mijë euro dhe 90 mijë euro fatura konsulence. Kështu që nga detyrimi i dividendit të Z. Bektashi duhet të zbritet vlera 637 mijë euro.”**

Citimi i mësipërm se 90 mijë euro, i janë paguar shtetasit Jamarbër Malltezi me fatura konsulence për efekt **“dividentit”**, konfirmon faktin se këto faturime janë bërë me qëllim marrjen nga ky shtetas, të përfitimeve të shoqërisë Homeplan, pavarësisht se nuk ka qenë ligjërisht ortak i kësaj shoqërie.

Për sa më sipër, me procesverbalin e datës 23.06.2023 janë sekuestruar faturat e blerjes të shoqërisë Homeplan shpk nga ku rezulton se:

- Shtetasi Jamarbër Malltezi me ID 029309605 ka lëshuar faturën me faturën me numër serial nr 20716096, me numër fature 1199/B datë 30.12.2016 me përshkrim **“Sa faturuar shërbim për studimin e impaktit të ndikimit në mjedis”** me vlerë 22.500 euro.
- Shtetasi Jamarbër Malltezi me ID 029309605 ka lëshuar faturën me faturën me numër serial nr 20716095, me numër fature 1179/B datë 27.12.2016 me përshkrim **“Sa faturuar shërbim për studimin e impaktit të ndikimit në mjedis”** me vlerë 22.500 euro.
- Shtetasi Jamarbër Malltezi me ID 029309605 ka lëshuar faturën me faturën me numër serial nr 20716137, me numër fature 83/B datë 20.02.2017 me përshkrim **“Sa faturuar shërbim për studimin e impaktit të ndikimit në mjedis”** me vlerë 22.500 euro.
- Shtetasi Jamarbër Malltezi me ID 029309605 ka lëshuar faturën me faturën me numër serial nr 20716138, me numër fature 84/B datë 24.02.2017 me përshkrim **“Sa faturuar shërbim për studimin e impaktit të ndikimit në mjedis”** me vlerë 22.500 euro.

Nga analizmi i faturave të sekuestruara konstatohet se bashkëlidhur faturave nuk gjendet studimi për impaktin në mjedis siç përshkruhet në faturë.

Nga verifikimet i llogarive bankare të shoqërisë Homeplan shpk rezulton se faturat e mësipërme janë likuiduar. Pra janë marrë realisht nga shtetasi Jamarbër Malltezi.

Pagesa Cash

Në lidhje me shumën 72,000 euro, të përshkruar si pagesë CASH në dokumentet elektronik të mëipërm, konstatohet se bashkëlidhur shkresës me nr.6372 Prot, të datës 01.06.2022, është dërguar ndër të tjera tabela me emërtimin "*Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM*"

Në këtë tabelë fillimisht pasqyrohen pagesat si vijon:

- Në datën 03.03.2017, 30,000 euro me komentin " HP Kompani (KP)"
- Në datën 03.03.2017, 30,000 euro me komentin " FB per JM"
- Në datën 16.03.2017, 30,000 euro me komentin " HP Kompani (KP)"
- Në datën 16.03.2017, 26,000 euro me komentin " FB per JM"
- Në datën 24.03.2017, 24,000 euro me komentin " Per JM"
- Në datën 09.05.2017, 10,000 euro me komentin " Per JM"

Në vijim, konstatohet se pagesat e mësipërme fillimisht i janë llogaritur shtetasit Jamarbër Malltezi por më pas një pjesë e tyre janë korigjuar me anë të shkresës së datës 25.07.2022, drejtuar Andia Pustinës nga Fatmir Bektashi, ku kërkohet korigjimi i tabelës "*Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM*". Për këto korigjime evidentohet në shkresë se është rënë dakord dhe është sqaruar situata me shtetasin Jamarbër Malltezi. Konkretisht në pikën 3 është shënuar si më poshtë:

"1. Vlera prej 254 k€, e cila i eshte dhene Z. Malltezi ne vitin 2016 nga ana ime, te korigjohet dhe hiqet nga tabela, sepse nuk eshte per llogari te dividendit".

2. Vlera prej 90 k€, e cila eshte paguar ne vitin 2017 nepermjet faturave te sjella nga Z. Malltezi, duhet te qendroj ne tabele sepse eshte per llogari te dividendit te Z. Malltezi.

3. Vlera prej 120 k€, e cila i eshte dhene Z. Malltezi ne muajin Mars 2017, duhet te llogaritet si dividend per te tre ortakët sipas kuotave perkatese: J. Malltezi vlera 42 k€ (35%), F. Bektashi vlera 48 k€ (40%) dhe Xh. Begeja vlera 30 k€ (25%)

Bashkelidhur do te gjeni tabelen e excel per terheqjet e dividendit per Z. Jamarber Malltezi, ku jane realizuar korigjimet. Pas korigjimeve te realizuara, rezulton se jane terhequr dividend nga Z. Fatmir Bektashi 304 k€ dhe jane paguar per Z. Malltezi: paguar cash vlera 214 k€ dhe 90 k€ fatura konculence..."

*Në tabelën "*Pagesa Cash dhe Banke HOMEPLAN per JM*" tashmë të korigjuar, konstatohet se janë bërë ndryshimet dhe në kolonën korigjime është bërë shënimi: "*Vlera prej 120,000 euro duhet të hiqet nga dividend Z Malltezi dhe të korigjohet si ndarje dividendi të të tre ortakët sipas kuotave (FB ke, JM 42 ke, XH 30ke)*"*

Në këtë tabelën e korigjuar pasqyrohen pagesat si vijon:

- Në datën 03.03.2017, 30,000 euro me komentin " HP Kompani (KP)"
- Në datën 03.03.2017, 12,000 euro me komentin " FB per JM"
- Në datën 24.03.2017, 20,000 euro me komentin " Per JM"
- Në datën 09.05.2017, 10,000 euro me komentin " Per JM"

Totali i këtyre pagesave është 72,000 euro.

Gjithashtu në tabelën e korigjuar në lidhje me pagesat për fatura është bërë shënimi: "Kjo vlerë 90,000 euro e sjellë me faturë do të përfshihet në llogaritjet e dividendit të Z. Jamarbër Malltezi. Do të mbetet si është"

Në fund të këtij dokumenti gjendet gjithashtu një tabelë përmbledhëse me emërtimin "Korigjuar, zbritur nga llogaria JM" dhe për vitin 2017 ku është shënuar "Per LB (Ortaket)".

Tabela e korigjuar, mbahet parasysh në llogaritjen e përfitimeve të shtetasit Jamarbër Malltezi, pasi siç citohen në shkresën e datës 22.07.2022, kjo tabelë pasqyron pagesat pasi është rënë dakort me shtetasin Jamarbër Malltezi. Konstatohet se vlerat paguara cash për vitet 2011-2017 vijnë të jenë të pasqyruara në këtë tabelë dhe rrjedhimisht janë pranuar nga shtetasi Jamarbër Malltezi.

Në tabelën përfundimtare të emërtuar "Jamarbër Malltezi, Total pagesa për Divident 2011 – 2022", përveç pagesave të sipërcituara evidendohet se për periudhën 25.05.2017 – 07.12.2017 janë reflektuar gjithashtu kalimet në bankë në një vlerë totale prej **1,119,107 euro**.

Me qëllim provimin e vërtetësisë së kësaj tabele janë kryer rakordimet e datave dhe vlerave të shënuara në këtë tabelë me kalimet konkrete nëpërmjet llogarisë bankare të shoqërisë Homeplan shpk. Nga verifikimet ka rezultuar se :

Kalim fondi

Nga data 25.05.2017 deri më datë 04.07.2017 janë kryer gjithësej 24 transaksione të ndara në **7 000 euro / transfertë me vlerë totale 161 000 euro** dhe një transaksion në vlerën **40 000 euro** nga llogaria bankare e shoqërisë Homeplan shpk me nr 111283737020121 në bankën Union Bank në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi, me nr 113398964650127 në bankën Union Bank, me përshkrimin "**Kalim Fondi**". Në total me këtë përshkrim, në dokumentat e sekuestruara janë kaluar **201 000 euro**.

Pagesë dividenti/kalim fondi:

Nga data 05.07.2017 deri më datë 11.08.2017 janë kryer gjithësej **27 transaksione, të ndara në 7 000 euro**, që në total është shuma **196 000 euro**.

Në tabelën e sekuestruar "Jamarbër Malltezi, Total pagesa për Divident 2011 – 2022", këto kalime janë me përshkrim **UBEUR Pagesë Dividenti**, ndërsa në përshkrimet e pagesave të kryera nga llogaria bankare e shoqërisë Homeplan shpk me nr 111283737020121 në bankën Union Bank në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi me nr 113398964650127 në po ato data dhe është shënuar "**Homeplan shpk për Jamarbër Malltezi, Kalim Fondi**"

Siç vërehet, në këtë moment ndryshon përshkrimi në shënimet e dokumentave të sekuestruara në tabelat e gjetura në studion Pustina, nga "**Kalim Fondi**" në "**Pagesë dividenti**".

Pagesë dividenti:

Nga data 14.08.2017 deri më datën 07.12.2017, janë kryer gjithësej 80 transaksione, të ndara në **7 000 euro / transfertë**, me vlerë totale **560 107 euro**, të cilat si në tabelën e sekuestruar ashtu edhe në përshkrimet e pagesave të kryera nga llogaria bankare e shoqërisë Homeplan shpk me nr 111283737020121 në bankën Union Bank në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi me nr 113398964650127, mbajnë përshkrimin "**Homeplan për Jamarbër Malltezi, Kalim për pagesë Dividenti**".

Vërehet, copëzimi i transaksioneve në vlera prej 7,000 euro për të evituar vëmendjen e autoriteteve.

Theksojmë se me shkresën 26131/1 Prot, datë 15.06.2023, organi tatimor na bën me dije se shtetasi Jamarbër Malltezi me ID H21109073R **rezulton i regjistruar si aksioner individ i kompanisë Homeplan me NIPT K81803020E, nga data 17.12.2018 dhe se të gjitha kalimet përpara kësaj date nuk mund të jenë për llogari të Dividentit.**

Shtetasi Jamarbër Luan Malltezi me ID H21109073R, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), për vitin 2017 (dorëzuar më datë 30.04.2018), 17-A, në rubrikën 5: Të ardhura bruto nga Dividenti deklaron vlerën **150,000,000 lekë**

Ndërkohë që edhe shtetasi Fatmir Petrit Bektashi me ID ADENO00047E, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), për vitin 2017 (dorëzuar dt, 19.04.2018), 17-A, në rubrikën 5: Të ardhura bruto nga Dividenti deklaron vlerën **200,000,000 lekë e cila përputhet me vendimin e ortakut të datës 27.06.2017.**

Sa më sipër ka një kontradiktë midis deklarimeve individuale të dy shtetasve se kujt i ka kaluar dividendi i shoqërisë Homeplan shpk.

Nga data 04.02.2021 deri më datë 09.05.2022 janë kryer janë kryer gjithësej 27 transaksione, me vlerë totale 2,967,892 euro **në llogarinë në llogarinë bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi me nr 113398964650127, mbajnë përshkrimin "Homeplan për Jamarbër Malltezi, Kalim për pagesë Dividenti dhe Pagesë Dividenti.**

Nga verifikimi në sistemin informatik tatimor C@TS rezulton se:

Shtetasi Jamarbër Malltezi, për periudhën **2011-2015**, rezulton se ka deklaruar 0 lekë si të ardhura nga **dividenti.**

Shtetasi Jamarbër Luan Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2018 (dorëzuar më 26.04.2019). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Jamarbër Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2019 (dorëzuar më 24.06.2020). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Jamarbër Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2020 (dorëzuar më 30.04.2021). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Jamarbër Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2021 (dorëzuar më 03.05.2022). Rezulton që të ketë deklaruar 207,630,412 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Nga verikimi i llogarive bankare, rezulton se në vitin 2021, shtetasit Jamarbër Malltezi i është transferuar në llogarinë me nr. 113398964650127 EURO, në Bankën Union, vlera totale 1,581,815 euro.

Shtetasi Jamarbër Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2023 (dorëzuar më datë 29.04.2024). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Jamarbër Malltezi ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2022 (dorëzuar më 26.04.2023). Rezulton që të ketë deklaruar 181,836,291 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Nga verikimi i llogarive bankare, rezulton se në vitin 2022, shtetasit Jamarbër Malltezi i është transferuar në llogarinë me nr. 113398964650127 EURO, në Bankën Union, vlera totale 1,386,077 euro.

- 2017: 957,107
- 2021 : 1,581,815 euro.
- 2022: 1,386,077 euro.
- Fatura: 90,000 euro
- Cash 2011-2015: 141,786 euro
- Cash 2017: 72,000 cash

Gjithësej përfitime monetare 4,657,755 euro
Përfitime në natyre mbi pjesën takuese 1,250,815

Total 5,908,570

- Shtetasi Jamarbër Malltezi ka përfituar gjithsej nga shoqëria Homeplan shpk 4,657,755 euro, të cilat janë përfitime CASH, përfitime nëprmet faturave , përfitimet nga dividendi dhe 1,250,815 euro përfitim nga njësi shërbimi të marra me tepër sipërfaqet takuese tek ARA 11-kateshi. Total 5,908,570 euro

429. Në lidhje me pjesë të marra shtesë, ka rezultuar nga akti i ekspertimit i kryer nga ekspertet e caktuar nga organi procedues, se shtetasi Jamarber Malltezi, nga totali i sipërfaqes së ndertimit e certifikuar ne ASHK ne emer te shtetasit Jamarber Malltezi, nga i gjithë trualli i vendosur prej tij ne dispozicion per te gjithë lejat e ndertimit, eshte sipërfaqja: $S=560.2+309,88+399.4+5474.8= \underline{6'744,28 \text{ m}^2}$.

Diferenca e sipërfaqeve te ndertimit midis asaj qe do duhej te Perfitonte dhe sipërfaqeve te çertefikuara nga ASHK-ja ne emer te Jamarber Malltezi: $ESHTE \text{ SIPERFAQJA} = 6'744.85 - 2'051.68 = \underline{+4'693.17 \text{ m}^2}$.

430. Në fakt, nga aktet rezulton se me kontratën e shkëmbimit pasuri të paluajtshme (pronë, truall firmë ndërtimi) (Kontratë shkëmbimi pasuri e paluajtshme (Pronarë trualli, firmë ndërtimi) nr 1666 rep nr 422/1 kol datë 16.06.2020 para noteres Laura Pustina rezulton se: Është lidhur kontratë ndërmjet shoqërive Homeplan sh.p.k., Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga Homeplan sh.p.k. dhe shtetasi Jamarbër Malltezi dhe objekt i kesaj kontrate eshte shkëmbimi i truallit të palës pronare të specifikuar në nenin 2 pg 2.1 duke respektuar pjesët takuese të palës pronare në sip e përgjithshme ndërtimore të rënë dakord me kontratën e sip nr 436 rep nr 206 kol datë 08.03.2018, kontratën e sipërmarrjes nr 478 rep nr 225 kol datë 13.03.2018, kontratën e sipërmarrjes nr 1741 rep nr 857 kol datë 12.08.2013 dhe kontratën e sipërmarrjes nr 11262 rep nr 1112 kol datë 14.12.2018 dhe konkretisht të ndarë në apartamente dhe njësi shërbimi sikurse specifikohen në nenin 2 pika 2 të kësja kontrate, të cilat ndodhen në strukturën EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime dhe 1 kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e Kompleksit Magnet të ndodhur në Rr. Ndre Mjeda, Tiranë. 1.2. Struktura EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime dhe 1 kat parkim nëntokë të përbahskët është ndërtuar nga zhvilluesit sipas lejes

zhvillimore të ndërtimit nr 8427/10 datë 18.10.2013 dhe plan vendosjes së miratuar nga Bashkia Tiranë si dhe është pajisur me çertifikatën e përdorimit nr 6219/3 prot datë 31.03.2020.

...2.1. Pala pronare Jamarbër Malltezi rezulton të jetë bashkëpronar në pasuritë e paluajshme të llojit truall të përshkuara si në vijim:

1. Pasuria nr 3/215 vol 37 faqa 233 ZK 8220 me sip trualli 3294 m² i ndodhur në rr. Frosina Plaku, në bazë të çertifikatës së pronësisë nr serial 1465083 lëshuar më datë 29.08.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 416/12000 pjesë.

Për këtë pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr 436 rep nr 206 kol datë 08.03.2018 midis palës pronare dhe shoq Kontakt sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli.

2. Pasuria nr 3/188 vol 19 faqa 235 ZK 8220 me sip trualli 2880 m² i ndodhur në rr. Frosina Plaku, në bazë të çertifikatës së pronësisë lëshuar më datë 28.08.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 186/684 pjesë.

3. Pasuria nr 3/194 vol 21 faqa 236 ZK 8220 me sip trualli 760 m² i ndodhur në rr. Frosina Plaku, në bazë të çertifikatës së pronësisë nr serial 1465087 lëshuar më datë 28.08.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 12/36 pjesë.

Për këto dy pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr 478 rep nr 225 kol datë 13.03.2018 midis palës pronare dhe shoq Kontakt për zhvillimin e tyre.

4. Pasuria nr 3/155 vol 15 faqa 185 ZK 8220 me sip trualli 660 m² i ndodhur në rr. Ndre Mjeda, bashkëpronar me 7935/33600 pjesë, në bazë të çertifikatës së pronësisë me nr serial 1836308 lëshuar më datë 24.12.2018 nga ZRPP Tiranë.

Për këtë pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr 1741 rep nr 857 kol datë 12.08.2013 midis palës pronare dhe shoq Homeplan sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli si dhe Deklarata noteriale nr 3344 rep nr 1157 kol datë 24.12.2018 ku shoq Homelan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. bien dakord që zhvillimi i ndërtimit do të realizohet nga shoq Kontakt sh.p.k. në cilësinë e investitorit dhe subjektit ndërtues.

5. Pasuria nr 3/158 vol 15 faqa 172 ZK 8220 me sip trualli 180 m² i ndodhur në rr. Frosina Plaku, në bazë të çertifikatës së pronësisë nr serial 1781106 lëshuar më datë 20.11.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 24/30 pjesë. Për këtë pasuri ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr 3262 rep nr 1112 kol datë 14.12.2018 midis palës pronare dhe shoq Kontakt sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli.

6. Pasuria nr 3/154 vol 15 faqa 176 ZK 8220 me sip 27 m² i ndodhur në rr. Ndre Mjeda, në bazë të çertifikatës së pronësisë nr serial 1836313 lëshuar më datë 24.12.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 3735/33600 pjesë.

Midis palës pronare dhe zhvilluesve është nënshkruar kontrata shtesë e sip për pjesër (pronar truall – firmë ndërtimi) nr 5402 prot datë 01.12.2018 e ndryshuar me amendimin nr 2414 rep/935 kol datë 07.10.2019 dhe amendimin nr 2793 rep/1020 kol datë 18.11.2019 te notere Laura Pustina, ku sanksionohet se në këmbim të pjesëve takuese që pala pronare ka në pasuritë e përmendura më lart do të përfitojë nga zhvilluesit pasuritë e cilësuara në nenin 2, pika 2 të kësaj kontrate shkëmbimi.

2.2. Pala pronare ka rënë dakord që në shkëmbim të pjesëve të tij takuese mbi pasuritë troje të lartpërmendura të përfitojë nga zhvilluesit pasuritë e përshkuara më poshtë:

1. Apartamanet me nr pas 3/491+19-2 i ndodhur në ZK 8220 me sip 375 m² vol 62 faqa 32 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 31.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 1).

2. Apartamanet me nr pas 3/491+19-3 i ndodhur në ZK 8220 me sip 372.4 m² vol 62 faqa 37 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 3 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe

- shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të ëprbahskët 39.5 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 2).
3. Apartamanet me nr pas 3/491+19-4 i ndodhur në ZK 8220 me sip 346.1 m² vol 62 faqa 42 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 4 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 70.3 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 3).
4. Apartamanet me nr pas 3/491+19-5 i ndodhur në ZK 8220 me sip 356.3 m² vol 62 faqa 47 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 5 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 68.8 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 4).
5. Apartamanet me nr pas 3/491+19-6 i ndodhur në ZK 8220 me sip 373.6 m² vol 62 faqa 52 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 6 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të ëprbahskët 32.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 5).
6. Apartamanet me nr pas 3/491+19-7 i ndodhur në ZK 8220 me sip 373.9 m² vol 62 faqa 57 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 7 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 31.7 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 6).
7. Apartamanet me nr pas 3/491+19-1 i ndodhur në ZK 8220 me sip 272.9 m² vol 62 faqa 65 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 1 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 29.7 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 7).
8. Njësi me nr pas 3/491+18-N1 i ndodhur në ZK 8220 me sip 167.8 m² vol 62 faqa 22 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 3.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % si dhe sip verande 160.1 m²... (Pasuria 8).
9. Njësi me nr pas 3/491+18-N2 i ndodhur në ZK 8220 me sip 214 m² vol 62 faqa 223 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 3.8 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % dhe sip verande 288.9 m² ... (Pasuria 9).
10. Njësi me nr pas 3/491+19-N1 i ndodhur në ZK 8220 me sip 305.6 m² vol 62 faqa 24 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 103.5 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % dhe sip verande 434.4 m²... (Pasuria 10).
11. Njësi me nr pas 3/491+18-N3 i ndodhur në ZK 8220 me sip 495.6 m² vol 62 faqa 26 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 18, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 43.3 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 %... (Pasuria 11).
12. Njësi me nr pas 3/491+18-N2 i ndodhur në ZK 8220 me sip 376.9 m² vol 62 faqa 27 ndodhur në rrugën Ndre Mjeda, Hyrja 19, kai i parë i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të perbashkët 38.7 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 12).

...2.3. Pala pronare deklaroi se ka marrë në dorëzim pasuritë e lartpërmednura dhe ka dhënë pëlqimin për këmbimin e trullit duke mospatur pretendime ndaj zhvilluesve për pjesën e saj takuese të lartpërmednur dhe cilësinë e punimeve...

430.1. Pranë noteres Laura Pustina, kontrata me nr 1666 rep nr 422 kol datë 16.06.2020 është gjendur e perpiluar serish, por me te njejtin numer repertori, koleksioni dhe date, por qe tashme

pasurite e perfituara nga shtetasi Jamarber Malltezi, **jane vetem 8 nga 12 qe ishin me siper, dhe dukshem me sy të lirë konstatohet se ka shkëputje të pullave.** Në faqen e parë është bërë një shënim me shkrim dore *“Sip ka ndryshuar me deklaratë rep 849/kol 269 datë 24.03.2023”*.

Konkretisht, kontrata e shkëmbimit pasuri të paluajtshme (pronë, truall firmë ndërtimi) (Kontratë shkëmbimi pasuri e paluajtshme (Pronarë trualli, firmë ndërtimi) nr 1666 rep nr 422/1 kol datë **16.06.2020** para noteres Laura Pustina (gjendur në praktikën e e akt marrëveshjes nr 2225 rep nr 754 kol datë 11.08.2023 të noteres Laura Pustina) rezulton se:

Është lidhur kontratë ndërmjet shoqërive Homeplan sh.p.k., Kontakt sh.p.k. përfaqësuar nga Homeplan sh.p.k. dhe shtetasi Jamarber Malltezi. Objekt i kësaj kontrate është shkëmbimi i truallit të palës pronare të specifikuar në nenin 2 pg 2.1 duke respektuar pjesët takuese të palës pronare në sip e përgjithshme ndërtimore të rënë dakord me kontratën e sip nr 436 rep nr 206 kol datë 08.03.2018, kontratën e sipërmarrjes nr 478 rep nr 225 kol datë 13.03.2018, kontratën e sipërmarrjes nr 1741 rep nr 857 kol datë 12.08.2013 dhe kontratën e sipërmarrjes nr 3262 rep nr 1112 kol datë 14.12.2018 dhe konkretisht të ndarë në apartamente dhe njësi shërbimi sikurse specifikohen në nenin 2 pika 2 të kësaj kontrate, të cilat ndodhen në strukturën EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime dhe 1 kat parkim nëntokë të përbahskët, pjesë e Kompleksit Magnet të ndodhur në Rr. Ndre Mjeda, Tiranë. ...

Pala pronare Jamarber Malltezi rezulton të jetë bashkëpronar në pasuritë e paluajtshme të llojit truall të përshkruara si në vijim:

1. Pas nr 3/125 vol 37 faqa 233 ZK 8220 sip trualli 3294 m2 rr. Frosina Plaku, në bazë të certifikatës së pronësisë nr serial 1465083 dt 29.08.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 416/12000 pjesë. Për këtë pasuri ka lidhur kontratën e sipërmarrjes **nr 436 rep nr 206 kol datë 08.03.2018** midis palës pronare dhe shoq Kontakt sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli.

2. Pas nr 3/188 vol 19 faqa 235 ZK 8220 sip trualli 2880 m2 rr. Frosina Plaku, në bazë të certifikatës së pronësisë dt 28.08.2018 nga ZRPP Tiranë me 186/684 pjesë.

3. Pas nr 3/194 vol 21 faqa 236 ZK 8220 sip trualli 760 m2 rr. Frosina Plaku, në bazë të certifikatës së pronësisë nr serial 1465087 datë 28.08.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 12/36 pjesë.

Për këto dy pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes **nr 478 rep nr 225 kol datë 13.03.2018** midis palës pronare dhe shoq Kontakt për zhvillimin e tyre.

4. Pas nr 3/155 vol 15 faqa 185 ZK 8220 sip trualli 660 m2 rr. Ndre Mjeda, bashkëpronar me 7935/33600 pjesë, në bazë të certifikatës së pronësisë me nr serial 1836308 datë 24.12.2018 nga ZRPP Tiranë.

Për këtë pasuri është lidhur kontrata e sipërmarrjes **nr 1741 rep nr 857 kol datë 12.08.2013** midis palës pronare dhe shoq Homeplan sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli si dhe Deklarata noteriale nr **3344 rep nr 1157 kol datë 24.12.2018** ku shoq Homelan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. bien dakord që zhvillimi i ndërtimit do të realizohet nga shoq Kontakt sh.p.k. në cilësinë e investitorit dhe subjektit ndërtues.

5. Pas nr 3/158 vol 15 faqa 172 ZK 8220 sip trualli 180 m2 rr. Frosina Plaku, në bazë të certifikatës së pronësisë nr serial 1781106 datë 20.11.2018 nga ZRPP Tiranë me 24/30 pjesë. Për këtë pasuri ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr 3262 rep nr 1112 kol datë 14.12.2018 midis palës pronare dhe shoq Kontakt sh.,p.k. për zhvillimin e këtij trualli.

6. Pas nr 3/154 vol 15 faqa 176 ZK 8220 sip 27 m2 në rr. Ndre Mjeda, në bazë të certifikatës së pronësisë nr serial 1836313 lëshuar më datë 24.12.2018 nga ZRPP Tiranë bashkëpronar me 3735/33600 pjesë.

Midis palës pronare dhe zhvilluesve është nënshkruar kontrata shtesë e sip për pjesër (pronar truall – firmë ndërtimi) nr 5402 prot datë 01.12.2018 e ndryshuar me amendimin nr 2414 rep/935 kol datë 07.10.2019 dhe amendimin nr 2793 rep/1020 kol datë 18.11.2019 te notere Laura

Pustina, ku sanksionohet se në këmbim të pjesëve takuese që pala pronare ka në pasuritë e përmendura më lart do të përfitojë nga zhvilluesit pasuritë e cilësuara në nenin 2, pika 2 të kësaj kontrate shkëmbimi.

Pala pronare ka rënë dakord që në shkëmbim të pjesëve të tij takuese mbi pasuritë troje të lartpërmendura të përfitojë nga zhvilluesit pasuritë e përshkruara më poshtë:

1. Apartamanet nr pas 3/491+19-2 ZK 8220 sip 375 m² vol 62 faqa 32 rrug Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 31.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 1).

2. Apartamanet nr pas 3/491+19-3 ZK 8220 sip 372.4 m² vol 62 faqa 37 rrug Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 3 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 39.5 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 2).

3. Apartamanet nr pas 3/491+19-6 ZK 8220 sip 373.6 m² vol 62 faqa 52 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 6 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 32.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 3).

4. Apartamanet nr pas 3/491+19-7 ZK 8220 sip 373.9 m² vol 62 faqa 57 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 7 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 31.7 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % ... (Pasuria 4).

5. Apartamanet nr pas 3/491+19-1 ZK 8220 sip 272.9 m² vol 62 faqa 65 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 1 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 29.7 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % pronësi ... (Pasuria 5).

6. Njësi me nr pas 3/491+18-N1 ZK 8220 me sip 167.8 m² vol 62 faqa 22 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 3.1 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % si dhe sip verande 160.1 m² ... (Pasuria 6).

7. Njësi me nr pas 3/491+18-N2 ZK 8220 sip 214 m² vol 62 faqa 223 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 3.8 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % dhe sip verande 288.9 m² ... (Pasuria 7).

8. Njësi me nr pas 3/491+19-N1 ZK 8220 me sip 305.6 m² vol 62 faqa 24 rruga Ndre Mjeda, Hyrja 19, ap. 2 i strukturës EB-6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime me një kat parkim nëntokë të përbashkët, pjesë e kompleksit Magnet me sip të përbashkët 103.5 m² dhe kuotë pjesmarrje në bashkëpronësi 0.91 % dhe sip verande 434.4 m² ... (Pasuria 8).

...2.3. Pala pronare deklaroi se ka marrë në dorëzim pasuritë e lartpërmednura dhe ka dhënë pëlqimin për këmbimin e truallit duke mospatur pretendime ndaj zhvilluesve për pjesën e saj takuese të lartpërmednur dhe cilësinë e punimeve...

466.3. Në fakt, rezultoi se me deklaratën noteriale nr 849 rep nr 269 kol datë 24.03.2023 para noteres Laura Pustina, janë paraqitur deklaruesit Homeplan sh.p.k. Kontakt sh.p.k. e cila përfaqësohet nga Hompelan sh.p.k. dhe Jamarbër Malltezi të cilët kanë deklaruar:

"Në palët nënshkruese, deklarojmë se kemi lidhur një kontratë shkëmbimi (pronarë truall, firmë ndërtimi) me nr rep 1666 nr kol 422 datë 16.06.2020 (notere Laura Pustina) me objekt shkëmbimin e truallit të palës pronare me sip ndërtimore të ndodhur në kompleksin Magnet, Struktura EB - 6, 8, 9, 11 kat banim dhe shërbime dhe 1 kat parkim nëntokë të përbashkët e ndodhur në Rr. Ndre Mjeda Tiranë. Pasuritë që do të përfitonte pala pronare ishin përcaktuar

paraprkisht në kontratën shtesë të siip për pjesët (pronar trualli – firmë ndërtimi) nr 5402 prot datë 01.12.2018 e ndryshuar me amendimin nr rep 2414 nr 935 kol datë 07.10.2019 dhe amendimin nr rep 2793 nr kol 1020 datë 18.11.2019 (notere L.Pustina). Sipas këtyre kontratave pala pronare duhej të përfiotnte 8 pasuri të paluajtshme të ndodhura në strukturën EB.Për shkak të një gabimi material në kontratën e shkëmbimit janë përfshirë 12 pasuri të paluajtshme. Pra pala pronare ka përfituar 4 pasuri më shumë, në kundërshtim me parashikimet e kontratave paraprake. Pasi është konstatuar ky gabim, kontrata e shkëmbimit është korrigjuar nga noterja, dhe përfshin vetëm 8 pasuri të cituara në kontratën shtesë të sip për pjesët nr 5402 prot datë 01.12.2018.

Pasuritë e përfshira gabimisht në kontratën e shkëmbimit janë:

1. Apartamanet me nr pas 3/491+19-4 vol 62 faqa 42 ZK 8220 me sip 346.1 m2 dhe sip e përbahskët 70.3 m2
2. Apartamanet me nr pas 3/491+19-5 vol 62 faqa 47 ZK 8220 me sip 356.3 m2 dhe sip e përbahskët 68.8 m2
3. Njësi me nr pas 3/491+18-N3 vol 62 faqa 26 ZK 8220 me sip 459.6 m2 dhe sip e përbahskët 43.3 m2
4. Njësi me nr pas 3/491+19-N2 vol 62 faqa 27 ZK 8220 me sip 376.9 m2 dhe sip e përbahskët 38.7 m2

Ne palët nënshkruese i kërkojmë institucionit tuaj që të kthejë në bashkëpronësi të shoq Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. katër pasuritë e përfshira si rrjedhojë e një gabimi material në kontratën e shkëmbimit (pronare trualli, firmë ndërtimi) me nr rep 1666 nr kol 422 datë 16.06.2020 (notere Laura Pustina...)

430.2. Me amendim kontratë shkëmbimi nr. 2225 rep nr 754 kol datë 11.08.2023, para noteres Laura Pustina, të lidhur ndërmjet shoqërive Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k. ku kjo e fundit përfaqësohet nga Homeplan sh.p.k. si dhe shtetasit Jamarbër Malltezi i përfaqësuar ky i fundit nga Florenc Kola (i biri i Pjetër dtl. 20.09.1967), është pasqyruar se:

Neni 1.

a) Midis subjekteve është lidhur një kontratë shkëmbimi (pronar trualli – firmë ndërtimi) rep/kol 1662/422 datë 16.06.2020 (notere L.Pustina) me anë të së cilës është kaluar pronësia e pjesës takuese tek pronari i truallit;

b) Kontrata është regjistruar rregullisht në ZRPP dhe pronari i truallit është pajisur me dokumentacionin e pronësisë për asuritë e paluajtshme të përfituara sipas legjislacionit në fuqi

c) palët në rakordimin midis tyre kanë konstatuar se pronarit të truallit i janë kaluar më shume pasuri të paluajtshme se ato të rëna dakord midis palëve sipas kontratës shtesë të sipërfaqeve për pjesët (pronar – trualli – firmë ndërtimi) nr prot 5402 datë 01.12.2018.

d) me konstatimin e gabimit palët kanë lëshuar një deklaratë noteriale rep/kol 849/269 datë 24.03.2023 (notere L.Pustina) me anë të së cilës është deklaruar gabimi material dhe korrigjimi i kontratës së shkëmbimit (pronar trualli – firmë ndërtimi) rep/kol 1666/422 datë 16.06.2020 (notere L.Pustina) përkatësisht pasuritë e kaluara gabimisht tek pala pronare e truallit si në vijim:

1. Apartamanet me nr pas 3/491+19-4 vol 62 faqa 42 ZK 8220 me sip 346.1 m2 dhe sip e përbashkët 70.3 m2
2. Apartamanet me nr pas 3/491+19-5 vol 62 faqa 47 ZK 8220 me sip 356.3 m2 dhe sip e përbashkët 68.8 m2
3. Njësi me nr pas 3/491+18-N3 vol 62 faqa 26 ZK 8220 me sip 459.6 m2 dhe sip e përbashkët 43.3 m2
4. Njësi me nr pas 3/491+19-N2 vol 62 faqa 27 ZK 8220 me sip 376.9 m2 dhe sip e përbashkët 38.7 m2

Pala pronare e truallit dëshiron të mbajë pronësinë e pasurive të kaluara gabimisht në pronësi të saj me anë të kontratës së shkëmbimit duke i paguar palës së parë (pra shoqërive të sipërcituara) vlerën përkatëse të përcaktuar midis tyre si në vijim të kësaj kontrate.

Neni 2

2.1. Palët kanë rënë dakord që duke konsideruar se pronësia e këtyre pasurive ka kaluar tek Pala 1, dhe palët bashkarisht dhe me vullnetin e tyre të lirë kanë rënë dakord që kjo pronësi të mbetet tek kjo palë, pala 1, t'i paguajë palës 2 çmimin e përcaktuar midis tyre si më poshtë:

2.2. Palët bien dakord që pasurit e përcaktuara në nenin 1 të kësaj kontrate, pronësia e të cilave ka kaluar tashmë tek pala blerëse, të paguhet nga pala pronare e truallit, çmimin si në vijim:

- Çmimi i shitjes së pasurisë nr pas 3/491+19-4 vol 62 faqa 42 ZK 8220 të jetë euro 186 201.8;
- Çmimi i shitjes së pasurisë nr pas 3/491+19-5 vol 62 faqa 47 ZK 8220 të jetë euro 191 689.4;
- Çmimi i shitjes së pasurisë nr pas 3/491+18-N3 vol 62 faqa 26 ZK 8220 të jetë euro 247 264.8;
- Çmimi i shitjes së pasurisë nr pas 3/491+19-N2 vol 62 faqa 27 ZK 8220 të jetë euro 202 772.2;

Vlera totale prej euro 827 928.2 euro do të likujdohet në llogarinë bankare të deklaruar nga shitësit me koordinatat si në vijim: Banka Union, Titullare Homeplan, Nr Iban _____.

Duke qene se pronësia e pasurive të paluajtshme ka kalur tek pronari i truallit me anë të kontratës së shkëmbimit (pronar trualli – firmë ndërtimi) rep/kol 1666/422 datë 16.06.2020 (notere L.Pustina) palët bien dakord që për efekt dokumentacioni dhe deklarimi ky akt së bashku me vërtetimin e pagesës së vlerës së transferimit të pronësisë si dhe taksës së kalimit të pronësisë, të depozitohet në ASHK, brenda një afati 30 ditor nga data e nënshkrimit.

Me pagesën e vlerës totale dhe depozitim të këtij akti në ASHK palët nuk kanë më asnjë pretendim financiar/juridik apo të ndonjë natyre tjetër ndaj njëra tjetrës në lidhje me pronësinë e pasurive objekt i kësaj kontrate.

Bashkalidhur kontratës evidentohet mandat transferte e brendshme të Union Bank, ku më datë 14.08.2023 shtetasi Jamarbër Malltezi, kalon për llogari të shoq Homeplan sh.p.k. shumën prej 627 930 euro e përshkrimin "Kalim sipas akt marrëveshjes nr rep 2225 nr kol 754 datë 11.08.2023".

Gjithashtu bashkalidhur është mandat nga Raiffeisen Bank datë 22.09.2023 sipas të cilit shtetasi Jamarbër Malltezi paguan për llog të shoqërisë Homeplan sh.p.k. shumën prej 100 000 euro me përshkrimin "Pagesë pjesore sipas akt marrëveshje nr 2225 rep nr 754 kol datë 11.08.2023".

Bileta avioni

431. Në vitin 2010, rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. i ka paguar shtetasit Jamarbër Malltezi, biletë avioni në shumën 822 euro.

Më dt 30.10.2010 shtetasit **Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi**, fluturojnë me linjën e fluturimit Austrian Airlines OS 849/850 Viena për t' u kthyer më dt 04.11.2010 me të njëjtën linjë fluturimi. Biletat e avionit, në shumën 1644 euro për udhëtim TIA-VIE -JFK-VIE-TIA, janë blerë me faturën faturën nr 19 dt 18.10.2010 të lëshuar nga Premier Travel për shoqërinë Homeplan sh.p.k. me përshkrimin "Bileta avioni 1644 euro..." për shtetasin Jamarbër Malltezi dhe Fatmir Bektashi, për udhëtim, në periudhën 30 tetor – 03 nëntor, Tia-Vie-JFK-VIE-TIA, pagesë e kryer me Intesa San Paolo Bank (gjendur në hard drive fatura). Sipas dokumentit të ekstraktuar nga Hard disku i jashtëm, sekuestruar pranë studio Pustina, dokument i emërtuar si "10 Format bilanc Homeplan" në formatin excel, në faqen "details

2010" evidentohet ndër të tjera se, dokument për marketing, ka pasqyruar, debi:... Bileta avioni 1644 euro ose 233.004.12 leke.

431.1. Persa me siper, qartesisht evidentohet se te gjitha shenimet e sekuestruara dhe ato te gjendura ne pajisjet kompjuterike, permbajne te dhena dhe fakte e reale te ndodhura ne periudhat e referuara.

Xhimi Begeja

432. Nga analizimi i të dhënave të përfuara nga Akti i ekspertimit, rezulton se për shtetasin Xhimi Begeja janë përpiluar disa tabela me qëllim rakordimin në lidhje me pagesat (paratë e tërhequra nga ky shtetas nga llogaritë e shoqërisë Homeplan shpk. më konkretisht:

Në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Backup Documents Odi_Laptop HP Old\Homeplan\Homeplan 2022\Bilanc 2022\ ", ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin Excel, me emërtimin "Sistemime_2022.xlsx, me autor: Heëlett-Packard Company, i krijuar më datë 02.08.2022, i ruajtur për herë të fundit më datë 02.08.2022. Ky dokument përmban 8 (tetë) nënndarje (sheet) të emërtuara si vijon: *Details 21; Priv. Div.FB; FB_467; Div.Abi ; Div.Xhimi; Rak.Kontakt+HP; Per sistemim te faturave*. Në nënndarjen e gjashtë të emërtuar "*Div.Xhimi*", paraqiten në forme tabelore me shënime të përkatese, të gjitha pagesat e kryera kundrejt shtetasit Xhimi Begeja, nga shoqëria Homeplan shpk.

Konkretisht evidentohet se për shtetasin Xhimi Begeja, për periudhën 2011 - 2016, janë bërë këto shënime:

- *Për vitin 2011 janë marrë nga shtetasi Xhimi Begeja 10,000 euro me bankë dhe 5,000 euro Cash. Në lidhje me këtë shumë është bërë shënimi: Sistemuar si hua.*
- *Për vitin 2013 janë marrë nga shtetasi Xhimi Begeja 2,000 euro përmes faturave.*
- *Për vitin 2014 janë marrë nga shtetasi Xhimi Begeja 24,000 euro përmes faturave.*
- *Për vitin 2016 janë marrë nga shtetasi Xhimi Begeja 195,000 euro me bankë dhe 510,000 euro CASH. Në lidhje me këto shuma është bërë shënimi: "Sistemuar si hua" për shumën 195,000 euro dhe "Fatmiri - Divident per XHB / Terhequr cash nga FB - dhene Xhimit cash për shumë 510,000 euro*

Në lidhje me vlerat e sistemuar si Hua është administruar Kontrata e Huasë me nr 1806. Kol, 779 Rep, me huadhënës shoqërinë Homeplan shpk dhe Huamarrës shtetasit Xhimi Begeja, nënshkruar para Noterres Laura Pustina më datë 19.07.2016. Konkretisht në këtë kontratë janë përcaktuar kushtet e mëposhtme: ...*Shoqëria Homeplan shpk, me anë të administratorit të saj, deklaron se do ti japë hua Z. Xhimi Begeja një shumë prej 400 000 euro (katërqind mijë) , shumë nga e cila shuma prej 325 000 euro (treqind e njëzet e pesë mijë) i është transferuar Z.Begeja sipas sa në vijim:*

- *Shuma prej 270 000 euro (dyqind e shtatëdhjetë mijë) me transferta bankare sipas tabelës vijuese:*
 - ✓ *Intesa San Paolo, data 07.03.2011, shuma 10,000 euro.*
 - ✓ *UB, data 20.11.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *UB, data 27.11.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *UB, data 07.12.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *UB, data 10.12.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *BKT, data 21.12.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *BKT, data 24.12.2015, shuma 20,000 euro.*
 - ✓ *BKT, data 30.12.2015, shuma 14,000 euro.*

- ✓ NBG, data 30.12.2015, shuma 6,000 euro.
 - ✓ BKT, data 04.02.2016, shuma 20,000 euro.
 - ✓ BKT, data 11.02.2016, shuma 20,000 euro.
 - ✓ BKT, data 11.02.2016, shuma 20,000 euro.
 - ✓ BKT, data 16.02.2016, shuma 20,000 euro.
 - ✓ BKT, data 17.02.2016, shuma 20,000 euro.
 - ✓ BKT, data 08.04.2016, shuma 20,000 euro.
- *Shuma prej 55000 euro (pesëdhjetë e pesë mijë) është paguar cash ndër vite sipas mandat pagesave përkatëse të lëshuara nga huadhënësi Homeplan shpk-----*
 - *Shuma e mbetur prej 75 000 euro (shtatëdhjetë e pesë mijë) do t'i jepet z. Begeja brenda muajit në vazhdim, me dy këste të realizuara me anë të transfertave bankare, sidoqoftë jo më vonë se data 20.06.2016-----*
 - *Kjo shumë prej 400 000 euro do të shlyhet nga z. Xhimi Begeja me këste për një periudhë kohore deri më datë 31.12.2017-----*
 - *Gjithashtu të dyja palët kontraktuale bien dakort që kjo hua të jepet pa interes ose ndonjë shpërblim tjetër-----*
 - *Z. Xhimi Begeja deklaroi se ka marrë në dorëzim shumë prej 325 000 euro (treqind e njëzet e pesë) nga huadhënësi, dorëzim i cili është realizuar jashtë ambienteve të kësaj zyre noterie sipas modaliteteve të sipërpërmendura dhe që konfirmohet gojarisht para meje noteres nga të dyja palët kontraktuale. Gjithashtu Huamarrësi Z. Xhimi Begeja deklaroi se është dakort me afatin e përcaktuar në këtë kontratë për kthimin e plotë të shumës së lartpërmendur pa asnjë interes apo shpërblim tjetër, detyrim ky i cili do të ekzekutohet nga huamarrësi me këste përkatësisht deri më datë 31.12.2017-----*
 - *Me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë huaje, ajo mund të ronovohet me kërkesë verbale të Huamarrësit z.Xhimi Begeja dhe miratimin me shkrim të Huadhënësit shoqërisë Homeplan shpk me të njëta kushte të kësaj kontrate dhe për një kohëzgjatje të përcaktuar nga Huadhënësi-----*

Nga analizimi i të dhënave të përfutuara nga Akti i Ekspertimit me nr. Nr. 115 datë 14.06.2024 rezultoi se, në dosierin "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Lau Share\Homeplan\ ndër të tjera gjendet dokumenti në formatin Word, me emërtimin "Deklarate borxhi HP - Xhimi.doc", me autor Laura Pustina, i krijuar më datë 01.07.2016, i ruajtur për herë të fundit më datë 04.07.2016 nga Laura. Ky dokument paraqet një draft Deklarate Noteriale e cila mban datën __. __.2014, në të cilën shtetasi Xhimi Begeja se ka marrë nga shoqëria Homeplan shpk vlerën prej 600.000 euro për motive personale, konkretisht: ... " Une i nenshkruar, Xhimi Begeja, deklaroj se kam marrë hua, pa interes dhe pa kushte të tjera të natyrës financiare nga shoqëria Homeplan shpk, shumen prej 600.000 (gjashtë qind mijë) Euro për motive personale, shume të cilën do t'ia shlyej me keste brenda 31 dhjetorit 2017, ne të njëjten monedhe "...

Në të njëjtin dosier "D:\6-Hard disk Transcend TS2TSJ25C3N\Te dhenat bruto EnCase\Lau Share\Homeplan\ u gjend gjithashtu dokumenti në formatin Word me emërtimin " Kontrate huaje Homeplan - Xhimi.doc", me autor User, krijuar më datë 14.07.2016, i ruajtur për herë të fundit më datë 19.07.2016 nga Laura. Në këtë dokument paraqitet një draft Kontratë Huaje midis shoqërisë Homeplan shpk në cilësinë e Huadhënësit dhe shtetasit Xhimi Begeja në cilësinë e Huamarrësit e cila ka të shënuar datën __. __.2016. Konkretisht në përmbajtje të këtij dokumenti konstatohet teksti: ... "Shoqëria Homeplan shpk, me ane të administratorit të saj, deklaroi se do t'i japë hua z. Xhimi Begeja një shumë prej 325 000 Euro (treqind e njëzet e pesë mijë), shume e cila i është transferuar z. Begeja sipas sa ne vijim:

z. Xhimi Begeja deklaron se ka marre ne dorezim shumen prej 325 000 euro (treqind e njezet e pese) nga huadhenesi, dorezim i cili eshte realizuar jashte ambienteve te kesaj zyre noterie" ... sipas modaliteteve te siperpermendura dhe qe konfirmohet gojarisht para meje noteres nga te dyja palet kontraktuale. Gjithashtu Huamarresi z. Xhimi Begeja deklaron se eshte dakort me afatin e percaktuar ne kete kontrate per kthimin e plote te shumes se lartepemendur pa asnje interes apo shperblim tjeter, detyrim ky i cili do te ekzekutohet nga huamarresi me keste perkatesisht deri me date 31.12.2017. -----

Sa më sipër, vërehet se datat konkrete të veprimeve bankare (03/2011- 04/2016) janë më të hershme se datat e përpilimit të këtyre dokumentave Word. Gjithashtu vërehet ser përpiluesit e këtyre draft kontratave e kanë patur të paqartë se sa do të ishte shuma që do sistemohej si hua e marrë nga shtetasi Xhimi Begeja (600,000 euro; 325.000 euro apo 400,000 euro sic është përcaktuar në kontratën përfundimtare të huasë me nr 1806 Kol-779 Rep).

Në lidhje me shumat e cituara në kontratën e huasë me nr. 1806 Kol-779 Rep, janë kryer verifikimet në llogarinë bankare të shoqërisë Homeplan shpk, nga ku ka rezultuar se shumat në datat përkatëse, janë kaluar në llogarinë e shtetasit Xhimi Begeja me përshkrimet e mëposhtme:

- shoq Homeplan shpk në dt 20.11.2015, në llogarinë bankare me nr. ...7020121 në monedhën euro në bankën Union sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*Homeplan shpk per Xhimi Haki Begeja, shlyerje detyrimi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 27.11.2015, në llogarinë bankare me nr. ...37020121 në monedhën euro në bankën Union sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*Homeplan shpk per Xhimi Begeja, shlyerje detyrimi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 07.12.2015, në llogarinë bankare me nr....37020121 në monedhën euro në bankën Union sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*Homeplan shpk per Xhimi Begeja, pagesë për shlyerje detyrimi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 10.12.2015, në llogarinë bankare me nr. ...7020121 në monedhën euro në bankën Union sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*Homeplan shpk per Xhimi Begeja, shlyerje detyrimi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 21.12.2015, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja kthim borxhi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 24.12.2015, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja kthim borxhi*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 30.12.2015, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja kalim fondi*" në shumën **14,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 30.12.2015, në llogarinë bankare me nr. 24255710016018 euro në monedhën euro në bankën ABI sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*Transferte Xhimi Begeja, kalim fondi te Xhimi Begeja nga Homeplan*" në shumën **6,001 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 04.02.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*per Xhimi Haki Begeja shlyerje det*" në shumën **20,000 euro**.
- Shoq Homeplan shpk në dt 11.02.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja si investitor*" në shumën **20,000 euro**.

- Shoq Homeplan shpk në dt 11.02.2016, në llogarinë bankare me nr. 111283737020121 në monedhën euro në bankën Union sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*homeplan shpk per Xhimi Begeja pagese si bashkeinvestitor*" shuma 20,000 euro.
- Shoq Homeplan shpk në datën 16.02.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*per Xhimi Haki Begeja si investitor*" në shumën 20,000 euro.
- Shoq Homeplan shpk në dt 17.02.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*per Xhimi Haki Begeja si investitor*" në shumën 20,000 euro.
- Shoq Homeplan shpk në dt 08.04.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja paradhenie divid*" në shumën 20,000 euro.
- Shoq Homeplan shpk në dt 20.07.2016, në llogarinë bankare me nr. 422233578CLPRCFEURRG në monedhën euro në bankën BKT sh.a. ka kryer një pagesë përshkrimi "*per Xhimi Haki Begeja lik detyrimi kontr hua 1806 kol 779 rep I3*" në shumën 3,000 euro.
- Shoq Homeplan shpk në dt 20.07.2016, në llogarinë bankare me nr. 24255710016018 euro në monedhën euro në bankën ABI sh.a. ka kryer një pagesë me përshkrimin "*Transferte Xhimi Begeja, likujdim detyrimi sipas kontratës se huase nr 1806 kol 779 rep dt 19.07.2016nnga Homeplan shpk per Xhimi Begeja*" në shumën 72,000 euro.

Sa më sipër, duke patur parasysh edhe shënimet e bëra në dokumentin excel *Sistemime_2022.xlsx*, (sistemuar si hua), provohet se kjo kontratë është përpiluar me qëllim rregullimin e situatës financiare të shoqërisë Homeplan në lidhje me shumat e tërhequra ndër vite nga shtetasi Xhimi Begeja. Pjesa më e madhe e transfertav bankare të kryera nga shoqëria Homeplan në drejtim të shtetasit Xhimi Begeja përveçse të kryera përpara përpilimit të kësaj kontrate, janë kryer me përshkrimin : "*Shlyerje detyrimi*" (pa përcaktuar se çfarë detyrimi); "*pagesë si investitor*"; apo edhe si "*paradhënie dividendi*" (datë 08.04.2016) dhe jo si Hua apo borxh i dhënë këtij shtetasi.

Vetëm kalimet e datës 20.07.2016 i referohen Kontratës së Huasë me nr 1806 kol 779 rep dt 19.07.2016

Në vijim konstatohet se, shtetasi Xhimi Begeja ka kryer për llogari të Homeplan shpk transfertat e mëposhtme:

- Në datën 26.08.2016, ka transferuar 14,000 euro me përshkrimin "*Xhimi Begeja per Homeplan pag Per sip mbi pjesën takuese të dyqaneve 1002,2003,2005, OBJ Eagle in*"
- Në datën, 31.08.2016, ka transferuar 14,000 euro me përshkrimin "*Pagesë për dyqanet Ef sipërfaqe mbi pjesën takuese*"
- Në datën 09.09.2016, 14,000 euro me përshkrimin "*Pagesë për dyqanet EF sipërfaqe mbi pjesën takuese*"
- Në datën 16.09.2016, ka transferuar 7,000 euro "*Pag per sip mbi pjesën takues dyqanet EF*"
- Në datën 19.09.2016, ka transferuar 7,000 euro "*Pagesë për sip, mbi pjesen takuese ne dyqanet EF*"
- Në datën 23.09.2016, ka transferuar 7,000 euro "*Pag per sip mbi pjesen takuese per dyqanet EF*"
- Në datën 30.09.2016, ka transferuar 5,170 euro
- Në datën 07.11.2016, ka transferuar 5,650 euro

Total 73,848 euro

Në lidhje kalimet nëpërmjet faturave në dokumentat e sekuestruara, pranë studio Pustina, në tabelën "*Xhimi Begeja Total pagesa për Divident 2011 – 2022*", konstatohet si vijon:

Për vitin 2013 është regjistruar një faturë në vlerën 270,000 lekë. Nga verifikimet e kryera në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se shoqëria Homeplan shpk ka deklaruar në blerje faturën me nr.284, datë 29.12.2013, nga shoq "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 270,000 lekë.

Për vitin 2014 janë evidentuar 12 fatura të lëshuara nga shoqëria Begeja 1900 HTP në një vlerë totale prej 3,350,740 lekë.

Nga verifikimet e kryera në sistemin informatik tatimor C@ts, ka rezultuar se shoqëria Homeplan shpk ka deklaruar në blerje faturat e mëposhtme:

- Me numër 39, serial 11260194 datë 06.02.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,540 lekë.
- Me numër 45, serial 11260200 datë 11.02.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,760 lekë.
- Me numër 75, serial 11260230 datë 08.03.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,540 lekë.
- Me numër 105, serial 14251811 datë 04.04.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 279,640 lekë.
- Me numër 144, serial 14251811 datë 12.05.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,180 lekë.
- Me numër 176, serial 4251882 datë 11.06.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,240 lekë.
- Me numër 202, serial 14251908 datë 07.07.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,540 lekë.
- Me numër 272, serial 14251978 datë 15.09.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 279,960 lekë.
- Me numër 450, serial 17283139 datë 16.10.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 270,000 lekë.
- Me numër 336, serial 17928192 datë 17.11.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 279,700 lekë.
- Me numër 361, serial 17928117 datë 11.12.2014, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 280,340 lekë.

Pavaresisht se në tabelën "*Xhimi Begeja Total pagesa për Divident 2011 – 2022*" është shënuar shënuar shoqëria Begeja 1900 HTP, vlerat dhe datat përputhen me blerjet e deklaruara të shoqërisë Homeplan shpk nga subjekti Begeja 1900" me nipt K31421105R

Për vitin 2015 janë evidentuar 11 fatura të lëshuara nga shoqëria Begeja 1900 HTP në një vlerë totale prej 3,386,840.

Nga verifikimet e kryera verifikimet në sistemin informatik tatimor C@ts, ku kanë rezultuar se shoqëria Homeplan shpk ka deklaruar në librat e saj të blerjes faturat si më poshtë:

- Me numër 3, serial 17928143 datë 06.01.2015, nga shoqëria "Begeja 1900" me nipt K31421105R, në shumën 279,980 lekë.

- Me numër 89, serial 18458992 datë 28.02.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 126, serial 20051080 datë 28.02.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 215, serial 18458920 datë 24.04.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 252, serial 21419158 datë 05.10.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 372, serial 21418983 datë 17.06.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 464, serial 22836336 datë 15.07.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 655, serial 24094677 datë 19.08.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 705, serial 23681384 datë 14.09.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 280,000 lekë.
- Me numër 720, serial 23681399 datë 18.09.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 560,000 lekë.
- Me numër 1075, serial 27636831 datë 18.12.2015, nga shoqëria "Begeja 1900 HTP" me nipt K69215305M, në shumën 303,600 lekë.

Sa më sipër, vërtetohet kalimi i fondeve nëpërmjet faturimeve të mësipërme, ashtu siç edhe vetë shoqëria Homeplan ka bërë shënimet në dokumentat e kontabilitetit.

Më datë 30.06.2016 ortaku i vetëm Fatmir Bektashi vendos miratimin e rezultatit ekonomik për vitin 2015, me fitim 174 319 583 lekë dhe shpërndarjen në këtë mënyrë: Shuma prej 82 800 000 lekë ose ekuivalenti në euro 600 000 euro si dividend për ortakun e vetëm pas pagesës së tatimit mbi dividendin dhe kalimin e shumës prej 91 319 583 lekë në rezerva të tjera.

Sipas të dhënave të sistemit informatik tatimor rezulton se shoqëria Homeplan sh.p.k. ka shpërndarë Divident në vitin 2016 në vlerën 82,800,000 lekë dhe tatimi i llogaritur për dividendët është 12,420,000 lekë.

Situata Financiare - TMB			
Homeplan shpk - K81803020E			
Përshkrimi i rubrikës	2018	2017	2016
Të ardhurat mbi të cilat llogaritet tatim burim			
Dividentët	204,954,000	200,000,000	82,800,000
Tatimi i llogaritur për dividendët	30,743,100	30,000,000	12,420,000

Këto të dhëna përputhen me vendimin e Ortakut më datë 30.06.2016 në lidhje destinimit e fitimit të shoqërisë Homeplan të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Nga verifikimet e kryera në Bankat e Nivelit të II në Republikën e Shqipërisë konstatohet se e gjithë shuma e shpërndarë si dividend nga shoqëria "Homeplan" sh.p.k., për fitimin e vitit 2015, është marrë nga shtetasi Fatmir Bektashi, nëpërmjet transfertave bankare nga llogaria e shoqërisë "Homeplan" sh.p.k, me numër 111283737020121, në bankën Union, në monedhën euro.

Rezulton se për vitin 2016 rezulton se janë transferuar tek ortakut i vetëm i shoqërisë 510,000 euro sipas transfertave të mëposhtme:

- Në datën 05.08.2016 transferohet shuma 25,000 euro me përshkrim "Homeplan Shpk Per Fatmir Bektashi Pagine Dividenti Sipas Vend Te Ortakut".
- Në datën 05.08.2016 transferohet shuma 100,000 euro me përshkrim "Homeplan shpk per Fatmir Bektashi pagine Dividenti Sipas Vend Te Ortakut".
- Në datën 13.09.2016 transferohet shuma 100,000 euro me përshkrim "Homeplan shpk per Fatmir Bektashi pag e pjesshme Dividenti sipas Vend te ortakut per Fitimin 2015".
- Në datën 28.10.2016 transferohet shuma 285,000 euro me përshkrim "Homeplan shpk per Fatmir Petrit Bektashi, kalim i total Dividenti ne llogarine e Ortakut para mbylljes se muajit".

Shtetasi Fatmir Petrit Bektashi me ID ADENO00047E, në Deklaratën Individuale të të Ardhurave (DIVA), të vitit 2016, (dorëzuar 02.05.2017) 16-A, në rubrikën ç5Ç: Të ardhura bruto nga Dividenti deklaroi vlerën 81,600,000 lekë e cila përputhet me vendimin e datës 30.06.2016 (ekuivalenti i 600.000 eur).

Në shkresën e datës 21.12.2017 të sekuestruar pranë Studio Pustina me PV e datës 22.10.2023, me titull: "RAPORT PER NDARJEN E FITIMIN" gjithashtu janë gjetur bashkëlidhur disa tabela të nënshkruara nga shtetasi Fatmir Bektashi, në lidhje rakordimet e Homeplan me shtetasin Xhimi Begeja, konkretisht:

1. Tabela me emërtimin "*Përmbledhëse Xhimi Begeja, 2011- 15 Dhjetor 2017*".

Në këtë tabelë paraqiten përfitimet e shtetasit Xhimi Begeja deri me Dhjetor 2017 si më poshtë:

- Njësi mbi pjesën takuese të papaguara, me koment: Faqe 1 Bashkëlidhur, vlera në eruro **282,360**
- Divident 2016 (nga llog FB), me koment: Faqe 1 Bashkëlidhur, vlera në euro **510,000**.
- Tërheqje 2011-2016, me koment: Faqe 2, vlera në euro **400,000**.
- Divident 2017, me koment Faqe 3 Bashkëlidhur, vlera në euro 318,922

Shuma: 1,511,822 euro

- Në faqen 1, me anë të një tabele të emërtuar "Përmbledhëse Xhimi Begeja, Njesi dhe Vlerë, mbi pjesën takuese si Pronar" paraqiten të dhënat për persona të lidhur me shtetasin Xhimi Begeja duke përshkruar nr e Njesisë, apartament ose dyqan, emrin e klientit , vlerën në euro, vlerën e kaluar me bankë, vlerën për tu kaluar me bankë.
- Në faqen 2 , me anë të një tabele të emërtuar " Xhimi Begeja 2011-2016 (Padividentin nga llogaria e FB" paraqiten kalimet kundrejt Xhimi Begeja duke përshkruar bankën në të cilën është bërë kalimi, datën dhe vlerën në euro për periudhën 20.11.2015 – 21.07.2016, Cash+Bankë për periudhën 2011-2012 dhe kalimet me Faturë HT Pukë – Begeja 1900. Shuma totale e kalimeve është **400,000 euro**.
- Në faqen 3, me anë të një tabele të emërtuar "2017, Xhimi Begeja =Pagesë Dividenti", paraqiten kalimet kundrejt Xhimi Begeja duke përshkruar bankën në të cilën është bërë kalimi, datën dhe vlerën në përkatëse në euro. Shuma totale e kalimeve është **318,922 euro**.

Në ambientet e Studio Pustina, me procesverbalin e datës 28.04.2023 është sekuestruar shkresa me nr. 2555 Prot, datë 26.09.2019, me lëndë "Dërgohet informacion për dividendin", drejtuar shtetasës Andia Pustina, me anë të së cilës dërgohen bashkëlidhur informacion për Dividend Homeplan në Vite dhe Raport për Ortakun Xhimi Begeja.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, janë gjetur disa tabela në të cilat paraqiten rakordimet midis shoqërisë "Homeplan" sh.p.k. dhe shtetasit Xhimi Begeja, konkretisht:

1. Tabela me emërtimin "*HP Dividend në vite, (deri në vitin 2018 paguar në 2019)*", në të cilën paraqitet Dividendi i shpërndarë i shoqërisë Homeplan për periudhën 2015 -2018 dhe shuma Neto për secilin ortak të identifikuar me iniciale FB, JM dhe XHB.
2. Tabela me emërtimin "*Permbledhese Xhimi Begeja, 2011- 25.09.2019*" në të cilën janë të përshkruara "*përfitimet*" e shtetasit Xhimi Begeja nga shoqëria "Homeplan" sh.p.k. në një vlerë totale prej 2,749,447.87 euro për periudhën 2015 – 2019. Konkretisht:
 - Njësi mbi pjesën takuese të papaguara, shuma 135,000 euro, me koment "*Njesi per njerez te vetet (M. Shehu)*".
 - Divident 2015, (nga llog FB), ndare 2016, shuma 510,000 euro, me koment "*Ne 2016, pjeserisht paguar njesite mbi pjesen takuese*".
 - Terheqje, shuma 400,000 euro me koment "*Terheqje prej fillimit te HP deri 31.12.2016*".
 - Divident 2016, ndare 2017, shuma 318,922 euro, me koment "*Pagesa te vitit 2017, pjeserisht paguar njesi mbi pjesen takuese*".
 - Divident 2017, ndare ne 2018, shuma 395,500 euro me koment "*Pagesa te vitit 2018*".
 - Pagesa te Vitit 2019, shuma 865,115.3 euro me koment "*Perfshire dividend 2018, fatura, pagesa oshee, Garazh ne HP, (pjeserisht paguar njesi)*".
 - Vlera e Gjyqit Rizvanolli (detyrim XHB), shuma 124,910.57 euro me koment "*Vlera eshte vendosur sipas pohimit ne email. Kjo vlere eshte nga vendimi shk1*".

Në total shuma e përfituar është 2,749,447.87 euro,

Sa reflektuar në këtë tabelë, rezulton se për vitin 2016, përfitimet e shtetasit Xhimi Begeja janë: 135,000 euro; 510,000 euro dhe 400,000 euro

3. Tabela me emërtimin "*Permbledhese e Xhimi Begeja, Njesi dhe Vlere, mbi Pjesen Takuese si Pronar 2016 - 2019*", në të cilën paraqiten të dhëna për njësinë nr 156 ne objektin Eridanus në vlerën 135,000 euro me koment "*Kontratë Gentian Shehi dhe Marsida Shehi*".

4. Tabela me emërtimin "*Permbledhese e Xhimi Begeja, Njesi dhe Vlere, mbi Pjesen Takuese si Pronar*" në të cilën paraqiten vlerat e kaluara në bankë për njësitë që lidhen me shtetasin Xhimi Begeja. Në fund të kësaj tabele sqarohet se nga Vlera e Dividentit të kaluar në Llog FB prej **510,000 euro** , është zbritur vlera e kaluar në bankë për njësite prej **348,727 euro** dhe vlera e tërhequr Cash nga Xhimi Begeja **161,272 euro**. Mbeten për tu kaluar 0.36 euro. Gjithashtu paraqitet detyrimi i shtuar i XHimi Begeja per Ap.156 Eridianus në vlerën 135,000 euro.

5. Tabela me emërtimin "*Viti 2016 - 2017, pagesa për Xhimi Begeja, dividend i paguar nëpërmjet llogarisë së Fatmir Bektashi*"

Në këtë tabelë paraqiten të gjitha shpenzimet e kryera nga shtetasi Fatmir Bektashi, për llogari të shtetasit Xhimi Begeja në një vlerë totale prej **510,000 euro**, vlerë e cila përkon edhe me dividendin e tërhequr nga Fatmir Bektashi në vitin 2016.

Shpenzimet ose pagesat në këtë sipas kësaj tabele i korrespondojnë periudhës **15.08.2016 – 03.04.2017**. Më konkretisht:

- Xhimi Begeja tërheqje, datë 15.08.2016, shuma (7,000), përshkrim XHB
- Homeplan Llog Noteri, datë 15.08.2016, shuma (14,000), përshkrim Garazhi nr 4147 dhe nr 5138.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 24.08.2016, shuma 14,000), përshkrim XHB.
- Homeplan Llog Noteri, datë 25.08.2016, shuma (8,350), përshkrim Garazhi nr 5138.
- Homeplan Llog Noteri, datë 25.08.2016, shuma (5,650), përshkrim XHB, nepermjet llog se LP.
- Homeplan, datë 26.08.2016, shuma (14,000), përshkrim HP, EF.
- Homeplan, datë 31.08.2016, shuma (14,000), përshkrim HP, EF.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 06.09.2016, shuma (7,000), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 09.09.2016, shuma (14,000), përshkrim HP, EF.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 14.09.2016, shuma (7,000), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 16.09.2016, shuma (7,000), përshkrim HP, EF.
- Homeplan, datë 19.09.2016, shuma (7,000), përshkrim HP, EF.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 20.09.2016, shuma (3,500), përshkrim XHB.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 22.09.2016, shuma (7,000), përshkrim XHB.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 23.09.2016, shuma (3,500), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 23.09.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Begeja Ap 1036 Auriga.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 28.09.2016, shuma (6,000), përshkrim XHB/LP.
- Homeplan, datë 29.09.2016, shuma (1,830), përshkrim Per Ber Begeja Ap 1036 Auriga.
- Homeplan, datë 30.09.2016, shuma (5,170), përshkrim HP, EF.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 03.10.2016, shuma (2,752), përshkrim XHB/LP.
- Homeplan, datë 03.09.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Begeja Ap 1036 Auriga.
- Homeplan, datë 11.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Begeja Ap 1036 Auriga.
- Homeplan, datë 13.10.2016, shuma (3,399), përshkrim Per Ber Begeja Ap 1036 Auriga.
- Homeplan, datë 13.10.2016, shuma (3,601), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 13.10.2016, shuma (4,280), përshkrim XHB.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 14.10.2016, shuma (2,720), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 14.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 14.10.2016, shuma (8,000), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 17.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 20.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 24.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 26.10.2016, shuma (5,000), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 26.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 27.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 28.10.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.

- Xhimi Begeja tërheqje, datë 29.10.2016, shuma (2,000), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 01.11.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 02.11.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Homeplan, datë 03.11.2016, shuma (7,000), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 03.11.2016, shuma (3,000), përshkrim XHB/ Elsa, MP. Nr 1035, datë 03.11.2016
- Homeplan, datë 04.11.2016, shuma (5,364), përshkrim Per Ber Donald Telhallari 1057 Volans.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 04.11.2016, shuma (22,350), përshkrim XHB per vleren e PP, XJ llog. L. Pustina.
- Homeplan, datë 07.11.2016, shuma (5,650), përshkrim Dyqan ne EF, sip mbi pjesen takuese.
- Homeplan, datë 07.11.2016, shuma (1,350), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 16.11.2016, shuma (4,520), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 16.11.2016, shuma (6,960), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 17.11.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 17.11.2016, shuma (2,470), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 30.11.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 01.12.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 02.12.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 05.12.2016, shuma (5,900), përshkrim XHB/ Elsa.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 08.12.2016, shuma (4,400), përshkrim XHB/ Elsa.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 09.12.2016, shuma (10,000), përshkrim XHB/ Elsa.
- Xhimi Begeja BKT, datë 21.12.2016, shuma (8,310), përshkrim Ne BKT per fat begeja 1900, rregullim kalimi mars.
- Homeplan, datë 10.01.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 11.01.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 12.01.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 12.01.2017, shuma (2,500), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 13.01.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 17.01.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 25.01.2017, shuma (4,289), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 29.12.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 27.12.2016, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.

- Homeplan, datë 30.12.2016, shuma (14,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 08.02.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 13.02.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 16.02.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 16.02.2017, shuma (1,845), përshkrim XHB/ Elsa.
- Homeplan, datë 21.02.2017, shuma (7,000), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 22.02.2017, shuma (3,935), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Xhimi Begeja tërheqje, datë 13.03.2017, shuma (6,286), përshkrim XHB.
- Homeplan, datë 24.03.2017, shuma (3,630), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 28.03.2017, shuma (3,536), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 28.03.2017, shuma (5,382), përshkrim Ap 221, Orion depoz XHB per Smaci.
- Homeplan, datë 31.03.2017, shuma (5,895), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.
- Homeplan, datë 03.04.2017, shuma (4,675), përshkrim Ap 2055, Perseus depoz XHB per Ger Koca.

Në lidhje me datat dhe vlerat e mësipërme u krye verifikimi në llogarine bankare personale, të shtetasit Fatmir Bektashi, me nr. 113100429060121, në bankën Union Bank. Rezulton se në pjesën më të madhe janë kryer tërheqje nga shtetasi Fatmir Bektashi ekzaktësisht në datat e përshkruara më sipër, çka vërtetohet se pagesat e paraqitura në tabelën me emërtimin "*Viti 2016-2017, pagesa për Xhimi Begeja, dividend i paguar nëpërmjet llogarisë së Fatmir Bektashi*" janë kryer realisht nga shtetasi Fatmir Bektashi për llogari të shtetasit Xhimi Begeja.

Në lidhje me pagesat e mësipërme është pyetur shtetasi Gentian Shehi i cili deklaroi si vijon:
"...Dua të sqaroj se Xhimi Begeja është daja e bashkëshortes time e cila quhet Marsida Shehi dhe gjyshi i saj, Haki Begeja, para se të ndronte jetë kishte lënë amanet që një apartamente jepej mbesës së tij Marsida. Ne kemi kryer një pagesë në bankë për këtë apartament, paratë të cilat na i ka dhënë Xhimi Begeja. Apartamentin ka rreth 2 vjet që e kemi shitur. Blerës ka qenë një shtetas emri i të cilit nuk me kujtohet mire. Më duket se ka qenë nga zona e Fierit ose Patosit. Çmimi i shitjes ka qenë 135.000 euro. Une me bashkëshorten nuk kemi jetuar ndonjëhere tek ky apartament sepse jetojmë me prindërit e mi dhe nuk donim t'i linim vetëm"

Gjithashtu është pyetur edhe shtetasja Andia Telhallari e cila deklaroi si vijon:
"...Dua të sqaroj se Xhimi Begeja është daja im dhe këtë apartament na e ka dhuruar ai. Ne fillimisht kemi patur një apartament tek zona e gjimnazit Petro Nini Luarasi të cilin e shitëm dhe bleme një apartament tek Rruga Mine Peza. Me pas kaluam tek apartamenti në fjalë pra tek Klubi Partizani. Apartamentin ka rreth 3 vjet që e kemi shitur. Blerës ka qenë një çift i ri por nuk më kujtohet çmimi shitjes pasi është marrë bashkëshorti. Kemi jemi jetuar në këtë apartament për rreth 5-6 vjetësh që prej vitit 2016 deri në fund të vitit 2021. Më duket se kemi bërë një pagesë për këtë apartament por nuk më kujtohet mirë se për çfarë."

Në tabelën me emërtimin "Pagesa per Xhimi Begeja 2011- 2016, (Pa dividendin nga llogaria e FB)": paraqiten të gjitha përfitimet e shtetasit Xhimi Begeja (400,000 euro), pa llogaritur vlerën e përfutur nga dividenti i tërhequr nga Fatmir Bektashi në vitin 2016 (510,000 euro)

* Të dhënat e mësipërme konfirmohen gjithashtu nga korrespondenca midis Studio Pustina dhe shtetasit Fatmir Bektashi, konkretisht me anë të shkresës me Nr. 6372 Prot, datë 01.06.2022, e cila është sekuestruar në ambientet e Studio Pustina me procesverbalin e datës 28.04.2023. Në në përmbajtje të kësaj shkrese ndër të tjera citohet: "Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni dokumenta që Znsh. Suzana Aliaj ka sjellë tek ju, për dividendin e Z. Xhimi Begeja, që në muajin Korrik 2017. Në këtë shkresë duket qartë se Z. Fatmir Bektashi ka tërhequr vlerën 510k € dhe ja ka kaluar këto Z. Xhimi Begeja: në bankë për njësitë e personave të lidhur me te vlera 349k€ dhe pagesa cash vlera 161k €. Kështu që nga detyrimi i dividendit të Z.Bektashi duhet të zbritet vlera 510 k €"

* Bashkëlidhur shkresës me Nr. 6372 Prot, datë 01.06.2022, është gjetur gjithashtu një tabelë përmbledhëse për të gjitha pagesat e kryera për shtetasin Xhimi Begeja me emërtimin "Xhimi Begeja, Total pagesa për dividend, 2011-2022" Në këtë tabelë për vitin 2016 janë evidentuar 12 pagesa për shtetasin Xhimi Begeja, ku reflektohen sërish pagesat e marra cash, pagesat të cilat janë sistemuar si hua si dhe dividendin e tërhequr nga Fatmir Bektashi dhënë Xhimi Begeja, konkretisht:

Nr	Date	Shuma	Komente	Menyra	Viti	Kursi	Vlera Leke
1	2011	5,000.00	Cash	Cash	2011	135	675,000.00
34	02/04/2016	20,000.00	BKT		2016	138.46	2,769,200.00
35	02/11/2016	20,000.00	BKT		2016	138.82	2,776,400.00
36	02/11/2016	20,000.00	UB		2016	138.82	2,776,400.00
37	02/16/2016	20,000.00	BKT		2016	138.43	2,768,600.00
38	02/17/2016	20,000.00	BKT		2016	138.43	2,768,600.00
39	04/08/2016	20,000.00	BKT		2016	138.81	2,776,200.00
40	7/20/2016	3,000.00	BKT		2016	136.28	408,840.00
41	7/21/2016	72,000.00	NBG		2016	136.28	9,812,160.00
42	05/08/2016	100,000.00	UB, Dividend Fatmir Bektashi per llogari te XHB	Cash	2016	136.06	13,606,000.00
43	05/08/2016	25,000.00	UB, Dividend Fatmir Bektashi per llogari te XHB	Cash	2016	136.06	3,401,500.00
44	13/09/2016	100,000.00	UB, Dividend Fatmir Bektashi per llogari te XHB	Cash	2016	137.54	13,754,000.00
45	28/10/2016	285,000.00	UB, Dividend Fatmir Bektashi per llogari te XHB	Cash	2016	136.48	38,896,800.00

Sa më sipër, konfirmohet gjithashtu nga këqyrja e të dhënave të përfutura nga ekspertimi i pajisjes neëork attached Storage QNAP, HDD me nr serial S/N:Q1553B00405, të sekuestruar në ambientet e Studio Pustina eksperte kontabël e autorizuar, shtetases Andia Pustina. (Akti – Ekspertimit kompiuterik nr 06, datë 15.01.2024, ku ndër të tjera është gjetur një dokument në formatin excel me emërtimin "Dividend HP ne vite, 2015-2018_Suzana", i krijuar më datë 30.07.2019 ora 04:10 dhe i modifikuar për herë të fundit më datë 01.08.2019 ora 09.45 me autor Suzana Aliaj. Ky dokument përmban të dhëna në lidhje me shpërndarjen e Dividendit të shoqërisë Homeplan shpk për periudhën 2015 – 2018. Në këtë dokument evidentohet komenti i bërë nga Suzana Aliaj në qelizën e shumës së dividendit të ndarë në vitin 2016 FB", konkretisht : "Suzana Aliaj: kursi 138, euro 510,000 kaluar ne llogarine e FB, por per XHB dhe JM"

* Nga verifikimi në sistemin informatik të tatimeve TIK, rezulton se shtetasi Xhimi Haki Begeja me ID G50401203S, nuk ka bërë deklaratë (DIVA) për vitin 2016.

Te ardhurat e shtetasit Xhimi Begeja per periudhen 2017 - 2022

432.1. Për vitin 2017, në dokumentin "Sistemime_2022.xlsx" evidentohet se për për shtetasin Xhimi Begeja referuar këtij dokumenti, rezulton se në këtë vit këtij shtetasi i janë paguar me

anë të bankës 318,922 euro dhe cash 30,000 euro me shënimin: "shtesa takuese e 120k mars 2017 (tabela e rakordimit Kontakt)"

Pagesa në vlerën 30,000 me përshkrimin "JM 120 ke sipas kuotave te ortakeve", reflektohet edhe në tabelën me emërtimin "Xhimi Begeja , Total pagesa për Divident, 2011-2022". Sa më sipër përforcon faktin se shuma 120,000 euro i është dhënë shtetasit Jamarbër Malltezi por më pas është llogaritur si detyrim i të tre "ortakëve" siç edhe kërkohet të korigjohen llogaritë nëpërmjet shkresës së datës 25.07.2022 dërguar shtetases Andia Pustina.

Në tabelën përfundimtare të emërtuar "Xhimi Begeja , Total pagesa për Divident, 2011-2022", përveç pagesës të sipërcituar evidendohet se për periudhën 10.08.2017 – 15.06.2022 janë reflektuar gjithashtu kalimet në bankë në një vlerë totale 2,414,140 euro. Nga verifikimet në llogaritë bankare të shtetasit Xhimi Begeja rezulton se pagesat e reflektuara në tabelën e mësipërme, sipas shumave dhe datave të përshruara në këtë tabelë.

Për sa më sipër, evidentoher se këto pagesa janë pasqyruar më shumë se një herë, në shkresat dhe tabelat rakorduese të cilat i dërgohen studios së kontabilitetit Pustina, në Arkën e shoqërisë Homeplan si dhe në dokumentat elektronik të përfutuara nga ekspertimi kompjuterik, duke konfirmuar më shumë se një herë kryerjen e këtyre pagesave për shtetasin Xhimi Begeja.

Theksojmë se shtetasi Xhimi Begeja rezulton i regjistruar si aksioner individ i komopanisë Homeplan me NIPT K81803020E, nga data 17.12.2018 dhe se të gjitha pagesat përpara kësaj date nuk mund të jenë për llogari të Dividentit.

Pagesat per subjektin Aber

432.2. Referuar dokumentit elektronik "Sistemime_2022.xlsx" evidentoher se për vitin 2018, shtetasit Xhimi Begeja është paguar me anë të faturave në shumën 50.000 euro me shënimin "FF\30001, 13.11.2018, Aber"

Kjo pagesë pasqyrohet gjithashtu në tabelën e sekuestruar pranë studio Pustina me emërtimin "Xhimi Begeja, Tptal pagesa per Dividend 2011-2022", ku është regjistruar pagesa prej 50,000 euro në datën 13.11.2018 me komentin "UB, me faturë Aber".

Në lidhje me faturën e sipërcitar, u kryen verifikimet në sistemin tatimor C@TS ku rezulton se subjekti Homeplan shpk ka deklaruar në Librat e blerjes faturën tatimore të shitjes me nr. Serial 70793201, datë 13.11.2018, me subjekt blerës *Aber Engineering* shpk me NIPT L82030025U, në vlerën 6,228,500 lekë. Theksojmë se shoqëria *Aber Engineering* është në pronësi të shtetasit *Xhimi Begeja*.

Nga verifikimet e kryera në llogaritë bankare të shoqërisë Homeplan, në Union Bank, rezulton se datën 14.11.2018, nga shoqëria Homeplan është transferuar shuma prej 50,000 euro për shoqërinë *Aber Engineering* me përshkrimin "Likujdim fature me nr 70793201".

Gjithashtu referuar dokumentit elektronik "Sistemime_2022.xlsx" evidentoher se për vitin 2019, shtetasit Xhimi Begeja është paguar anë të faturave në shumën 100,000 euro me shënimin "FF\40005, 09.04.2019, Aber"

Në lidhje me faturën e sipërcitar, u kryen verifikimet në sistemin tatimor C@TS ku rezulton se subjekti Homeplan shpk ka deklaruar në Librat e blerjes faturën tatimore të shitjes me nr. Serial

70793213, datë 09.04.2019, me subjekt blerës Aber Engineering me NIPT L82030025U, në vlerën 12,496,000 lekë.

Këto të dhëna pasqyrohen gjithashtu në tabelën e sekuestruar pranë studio Pustina me emërtimin "Xhimi Begeja, Total pagesa per Dividend 2011-2022" ku janë të pasqyruara kalimet nga llogaria e shoqërisë "Homeplan" sh.p.l në union bank sipas datave përkatëse dhe pagesa prej 100,000 euro në datën 09.04.2019 me komentin "UB, me faturë Aber".

Nga verifikimet e kryera në llogaritë bankare të shoqërisë Homeplan, në Union Bank rezulton se nga shoqëria Homeplan janë kryer 15 transferta në shumën 7,000 euro me përshkrimin "Pagesë pjesëre fature nr.5 dt 09.04.2019".

Nga verifikimi në sistemin informatik tatimor C@TS rezulton se Shtetasi Xhimi Begeja nuk rezulton të ketë dorëzuar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave deri në vitin 2020

Shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2020 (dorëzuar më datë 19.04.2021). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi

Shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2021 (dorëzuar më datë 27.04.2022). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2022 (dorëzuar më datë 26.04.2023). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Xhimi Begeja ka deklaruar Deklaratën Individuale Vjetore të të ardhurave për vitin 2023 (dorëzuar më datë 16.04.2024). Rezulton që të ketë deklaruar 0 lekë të ardhura bruto nga dividendi.

Shtetasi Xhimi Begeja ka përfituar gjithsej nga shoqëria Homeplan shpk 3,354,140 euro, të cilat janë përfitime CASH, përfitime nëprmet faturave dhe pagesa dividendi.

Gjithashtu, shtetasi Xhimi Begeja ka përfituar edhe shumën prej 500,000 euro, nga shjitja e kuotave në shoqërinë Homeplan shpk, sipas kontratës së Shitjes së Kuotave me nr. 1387 rep nr 455/2 kol dt 19/05/2023. Nga verifikimet rezulton se shtetasit Xhimi Begeja kjo shumë i është kaluar në llogarinë bankare me nr 111101252650126 në Union Bank, në datën 15.06.2023.

433. E pyetur pergjate ketij hetimi, ne lidhje me plotesimin e deklaratave te pasurive per shtetasit Sali Berisha, Liri Berisha, Shkelzen Berisha, Jamarber Malltezi, Argita Malltezi, shtetesja Odeta Fisha ka deklaruar: *...jam në dijeni që deklaratat e ILDKPK-së për të pestë personat që më cituat më lart, mund t'i ketë plotësuar zonja Andia Pustina.*

E pyetur ne lidhje me dokumentin "Homeplan 2010-2013, Pagesat e kryera me arkë 2010-2013 (Aneks nr. 1)", sekuestruar pranë Studio Pustina, kjo shtetase ka deklaruar: *...Këtë dokument e ka sjellë Homeplani dhe unë e kam marrë në dorëzim për studion Pustina. Ia kam dhënë shifes sime të quajtur Andia Pustina dhe më pas e kam futur në dosjen e subjektit Homeplan. Këtë dokument e ka sjellë dorazi shoqëria Homeplan por nuk e mbaj mend se cili person konkretisht, pasi këta punonjës të Homeplan, vinin dhe sillnin dokumenta si fatura, statement banke, kontrata me klientët. Në lidhje me vendime ortakësh, ne si studio kontabile nuk merreshim dhe ndoshta i bënte zyra ligjore e Homeplan ose notere Laura Pustina.*

...Unë konkretisht jam marrë me deklaratimet e faturave të blerjes dhe të shitjes në tatime, deklaratimet e listë pagesave, regjistrimin edokumentavekontabël në programin e kontabilitetit Financa 4, rakordimin e klientëve me zyrën e financës dhe juridike të subjektit Homeplan dhe Kontakt, regjistrimin e statement bankar.

...Shoqëria Homeplan fillimisht ka pasur arkë. Regjistrimet e arkës, në kontabilitet nuk janë kryer nga ne por na është vënë në dispozicion një ditar arke, i gjeneruar nga programi i kontabilitetit Financa 5 i cili nuk është mbajtur nga ne. Ky ditar arke, është sjellë në studion Pustina, dhe meqënëse nuk është i dokumentuar me dokumenta të rregullta kontabël nuk është marrë parasysh në kontabilitetin e mbajtur pranë studio Pustina. Veprimet e arkës që janë të përfshira në pasqyrat financiare përbëhen kryesisht nga pagesa cash të faturave UKK, OSHE ose taksa të institucioneve shtetërore, të cilat ne si studio Pustina i kemi regjistruar referuar mandateve të pagesës që na sjellë nga shoqëria Homeplan.

E pyetur nese shoqëria Homeplan sh.p.k. ka kryer ndonje aktivitet tjeter vec atij per ndertimet ne territoret e Klubeve Sportive Partizani, eshte pergjigjur:Në dijeninë time, jo, vetëm tek këto territore që cituat.

E njohur me dokumenta të gjendura në HDD të sekuestruar në Studion Pustina, Hard Disk Transcend TS2TSJ25C3N, konkretisht dokumenti me emërtimin "Sistemime 2022.xlsx", në të cilin pasqyrohet në formatin excel disa faqe, ku ndërmjet të tjerave në faqen e fundit me emërtimin "Për sistemim të faturave" janë bërë shënime "Abi 90 000 euro..." dhe një ndarje mes ortakëve, kjo shtetase deklaron: Po unë e njoh dokumentin dhe e kam punuar unë. Unë i kam bërë shënimet në faqen e excelit dhe shënimet i kam bërë unë pas rakordimit me Eraldën që është ekonomiste e shoqërisë Kontakt sh.p.k. Kur ortakët kishin pretendime për dividendin, Homeplan bëri një rakordim me studion Pustina. Studio Pustina nxorri nga kontabiliteti i saj të gjithë marrëdhëniet e pasqyruara me ortakët. Ky rakordim ka ndodhur në vitin 2022 dhe gjatë rakordimit, nga subjekti Homeplan na u vu në dispozicion një tabelë me pretendime nga shoqëria për pagesa të kryera nga zoti Bektashi. Këto pretendime i ka sjellë Fatmir Bektashi nëpërmjet Eraldës. Unë bashkë me Eraldën kemi kryer rakordime pranë ambjenteve të studios Pustina. Duke iu referuar faqeve të këtij dokumenti ju sqaroj se në faqen me emërtimin "Details 21" janë të dhënat të balancave të llogarive të gjeneruara nga kontabiliteti i mbajtur nga studio Pustina, sipas të cilit janë mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2021. Faqa e emërtuar "Priv" janë kartelat 467 që lidhen me llogaritë e privatizimit të klubit Partizani, pagesa të kryera nga Kontakti dhe që aktualisht vijojnë të jenë të hapura si kartela në kontabilitetin e subjektit Homeplan, ku Kontakti pra rezulton të jetë kreditor i Homeplan në lidhje me këto pagesa. Në faqen "Div.FB" pasqyrohen të dhëna në lidhje me dividendin e z. Fatmir Bektashi. Pjesa e parë e dokumentit janë informacione nga kartelat kontabile të nxjerra nga studio Pustina kurse pjesa poshtë në formë tabele, është përgatitur pas rakordimit të kryer ndërmjet studio Pustina dhe Eraldës duke marrë parasysh informacionin e sjellë nga subjekti Homeplan. Në faqen e emërtuar "FB_467" është një përmbledhje e llogarive të z. Fatmir Bektashi, në llogarinë 467, debitorë dhe kreditorë të tjerë. Shënimi i bërë "Kontribute patriotike për konfirmim" në vlerën 1 014 829,39 euro, kurse në leke 141 868 321 lekë, është bërë pas informacionit të marrë nga tabela për pretendime e sjellë nga Homeplan dhe është vendosur për konfirmim, pasi nuk kishim informacion se për çfarë ishte. Faqa tjetër është "Dib.Abi" ku janë shënuar informacionin për pozicionin e z. Jamarbër Malltezi, për dividendin e marrë sipas kontabilitetit të studios Pustina, pjesa lart që janë kartelat. Kurse pjesa poshtë ku janë tabelat përmbledhëse ndër vite, janë përgatitur pasi informacionit të marrë nga tabela e sjellë nga subjekti Homeplan për pretendimet e shoqërisë për pagesa të kryera nga z. Bektashi. Në lidhje me shënimin "me të kuqe, për vlerën 1 250 815 euro "Marrë më tepër sipërfaqe takuese tek Ara 11 – katëshi, duhen kthyer ose zbritur nga llogaria e dividendit" dhe 150 097 800 lekë, me shënimin "Kati

i parë dhe i dytë tek 11 katëshi do vendoset si do trajtohet si e ardhur apo do zgjidhet ndryshe” janë informacione që na janë vënë në dispozicion nga shoqëria Homeplan. Gjithashtu edhe në lidhje me shënimet për sistemin “Janë marrë cash në vitin 2011 shuma 90 000 euro ose 12 658 300 lekë; 2012 shuma 1 786,41 euro ose 246 525 lekë dhe 2015 shuma 50 000 euro ose 6 891 320 lekë” janë pretendime të shoqërisë Homeplan. Të gjitha këto janë pretendime të Fatmir Bektahsit por ne nuk i kemi pasur të përfshira në kontabilitet, pasi nuk i kemi pasur të dokumentuara me dokumenta të rregullta kontabël. Konkretisht Fatmir Bektashi na ka thënë t’i përfshinim në llogaritjen e dividendit dhe t’ia dërgonim më pas atij këtë llogaritje. Vendimmarrja i takonte ortakëve. Në faqen me emërtimin “Div.Xhimi” sërish pjesa e parë e tabelës janë të dhënat që kishim nga kartelat kurse pjesa poshtë, ku janë pasqyruar sistemimet, janë bërë nga unë dhe Eralda si pasojë e pretendimeve të shoqërisë Homeplan. Xhimi pagesat e para i ka marrë si hua dhe më pas si dividend. Faqa e fundit me emërtimin “Për sistemim të faturave” janë pasqyruar sërish pretendimet e Homeplan-it, referuar tabelave që na janë përcjellë me shkresën 25.07.2022 nga shoqëria Homeplan dhe lidhen me pjesën e tabelës, me emërtimin “Pagesa Cash dhe Bankë Homeplan për JM” ku pasqyrohet për periudhën 03.03.2017 deri më 24.03.2017 rreshtat 30 – 34, me komentin “Vlera prej 120 000 euro duhet të hiqet nga dividend z. Malltezi dhe të korigjohet si ndarje dividend tek të tre ortakët sipas kuotave (FB 48 ke, JM 42 Ke, XHB 30 ke)”. Ky është koment i bërë nga shoqëria Homeplan. Unë kam marrë dijeni diku nga viti 2015 në mos gabohem, se shoqëria Homeplan kishte tre ortakë, kur kanë filluar pagesa me përshkrimin “pagesë dividendi”.

E pyetur ne lidhje me të dhënat e ekstraktuara nga hard drive-i i jashtëm sekuestruar pranë studio Pustina, një dokument në excel “Fitim_dividend_2018_final” i ruajtur për herë të fundit nga ju më datë 08.10.2019, ku ndër të tjera, në faqen “Definitive Andia” është shënuar ndër të tjera një koment “Odet: 150 000 E = 18 724 500 lekë janë nëpërmjet Faturave Aber” që i referohet një pagese për vitin 2018 për shtetasin Xhimi Begeja, kjo shtetase deklaron: *Pasi njihem me këtë dokument, ju sqaroj se shënimi është vendosur për të evidentuar një marrëdhënie tjetër me këtë ortak, pra Xhimi Begeja, nëpërmjet shoqërisë Aber. Nuk më kujtohet se çfarë shërbimesh ka ofruar shoqëria Aber Engineering për shoqërinë Homeplan por jam në dijeni për faturat që ka lëshuar ky subjekt për shoqërinë Homeplan.*

E pyetur ne lidhje me aktet e ekstraktuara nga ekspertimi i hard drive-it të sekuestruar pranë studio Pustina, konkretisht një dokument i emërtuar “Përgjigje për Abin’ në gjuhën angleze, kjo shtetase deklaron: *Në dijeninë time me këtë përgjigje është marrë Andia Pustina dhe ka marrë nga kontabiliteti, nga bilanci ose financa të dhëna që lidheshin me shoqërinë Homeplan, kryesisht me arkëtimet e saj nga klientët. ...*

Perfitime te familjes Berisha

434. Përgjatë viteve, konstatohet se edhe familja Berisha ka aksesuar dhe perfutuar nga te ardhurat e familjes Malltezi, duke kryer shpenzime te ndryshme, qe nuk mund te mbulohen vetem me te ardhurat e vajzes se tyre Argita Malltezi.

Viti 2014: Gjithsej **24 000 euro** (shuma **6,000 euro** shpenzimet shëndetësore për shtetasen Liri Berisha deklaruar në ILDKPKI nga vetë shtetasi Sali Berisha se këto para janë dhënë nga dhëndrri i tij shtetasi Jamarbër Malltezi dhe **18 000 euro** deklaruar nga shtetasi Shkëlzen Berisha se i janë dhënë hua, pa interes, nga shtetasi Jamarbër Malltezi, shumë e cila deri më sot nuk dokumentohet të jetë shlyer).

Në llogarinë dyemërore në bankën Intesa Sanpaolo, me nr: 44024135101 monedha euro, në datën 06.05.2014 shtetasja Liri Berisha ka depozituar cash në llogari shumën 6,000 euro. Transaksioni përkon me deklarinë në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të

Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për shumën 6,000 euro, në bankën Intesa Sanpaolo derdhur nga dhëndri Jamarbër Malltezi në lidhje me shpenzime shëndetësore për Liri Berishën.

Shtetasi Shkëlzen Berisha ka depozituar në ILDKPKI me inventarin e datës 14.02.2019 ndër të tjera: - Një kontratë huaje datë 03.01.2014 të lidhur ndërmjet huadhënësit Jamarbër Malltezi dhe huamarrësit Shkëlzen Berisha sipas të cilës Jamarbër Malltezi i jep hua 18,000 euro për shpenzime personale e cila do të paguhet me një këst, në momendhën euro dhe do të shlyhet brenda një afati të pacaktuar, me këste, sa herë që kjo të jetë e kërkueshme nga ana e huadhënësit, por jo para se të kalojnë tre vjet nga nënshkrimi i kontratës.

Shtetasi Shkëlzen Berisha ka dorëzuar bashkëlidhur inventarit të datës 14.02.2019 edhe një dokument me shpjegimet e tij, ndër të tjera ka cituar: Pika 11: *Shuma e marrë hua nga Jamarbër Malltezi është përdorur për shpenzime personale. Bashkëngjitur kontrata e huamarrjes. Nga analiza e bankave të nivelit të dytë, nuk rezulton të ketë transaksion bankar për këtë kontratë huaje.*

Ne fakt, nga akti i ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se *kjo kontratë gjendet e krijuar me datë 20.11.2018.*

Viti 2017: 27 439.98 USD dhe 7,403.75 euro (shuma 7 403.75 euro shpenzimet mjekësore për shtetasin Sali Berisha, vetëdeklarim i shtetases Argita Malltezi në ILDKPKI dhe 27 439.98 USD paguar avokatit i shtetasit Shkëlzen Berisha, av. Jason Zolads, në USA, shumë kjo e pretenduar e dhënë pa interes, sipas vetëdeklarimit të këtij të fundit).

Në llogarinë bankare të shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank 201182-EUR-1806000000-01-001, 8800201182, monedha euro, më datë 30.11.2017 ka një pagesë 7,403.72 euro me përshkrimin "MC Klinikum Rechts der Is". (pagesa është kryer nga shtetasja Argita Malltezi në Klinikum Rechts der Is).

Shtetasi Shkëlzen Berisha në Deklaratën e Interesave Private periodike/ vjetore, 2017 rezulton të ketë deklaruar në seksionin e Shpenzimeve të deklarueshme/ të dhënave konfidenciale: - "Vazhdon borxhi ndaj Jamarbër Malltezit, në shumën 18 000 euro". - "Paguar Av. im në SHBA nga z. Jamarbër Malltezi në rrugë bankare në shumën 27,439.98 USD mbi bazën e një marrëveshje për kthim detyrimi"

Nga aktet e dorëzuara në ILDKPKI nga shtetasi Shkëlzen Berisha rezulton një kontratë huaje datë 15.06.2017 sipas të cilës huadhënësi Jamarbër Malltezi i jep huamarrësit Shkëlzen Berisha një shumë prej 27,439 USD e cila do të paguhet me një këst, drejtëpërdrejtë nëpërmjet transferit nga llog e huadhënësit në llog e indikuar nga studio ligjore e avokatit Jason Zolads. Shuma e huasë do të shlyhet me këste dhe pa interes. Pra shuma 27,439 usd do të shërbejë për likuidim të pagesave të konsulencës juridike dhe avokatore të avokatit amerikan me studio në SHBA, Neë York, z. Jason Zolads, sipas kontratës përkatëse që z. Shkëlzen Berisha ka lidhur me të.

Ne fakt, nga akti i ekspertimit të hard diskut të sekuestruar pranë studio Pustina, rezulton se *kjo kontratë gjendet e krijuar me datë 15.11.2018.*

Nga kqyrja e llogarive bankare të shtetasit Jamarbër Malltezi, Intesa 40201835101 USD, më datë 20.06.2017 është paguar shuma 27,439.98 usd për avokatin Jason M. Zolads me përshkrim "outëard transfer overseas txn check, Jamarber Malltezi legal fee" lekë.

Shtetasi Shkëlzen Berisha ka dorëzuar bashkëlidhur inventaritet të datës 14.02.2019 edhe një dokument me shpjegimet e tij, ndër të tjera ka cituar: Pika 13: *Ju bëj me dije se Studio Ligjore në USA është likuajuar për një proces të hapur nga ana ime në USA. Shuma prej 27,349 usd, është likuajuar nga z. Jamarbër Malltezi kundrejt një kontrate huaje pa interes të cilën do ta gjeni bashkëngjitur.*

Viti 2018: 3,000 euro (pushime të paguara nga Jamarbër Malltezi për shtetasit Sali dhe Liri Berisha, sipas vetëdeklarimit të tyre në ILDKPKI).

Viti 2021: Gjithsej 19 933.35 euro (13,288.9 euro pasqyruar si detyrim ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi për shpenzimet e konsulencës, avokatisë për zyrën ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken për shtetasit Sali dhe Liri Berisha sipas vetëdeklarimit të tyre në ILDKPKI dhe 6 644.45 euro, pasqyruar si detyrim ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi për të njëjtin qëllim nga shtetasi Shkëlzen Berisha sipas vetëdeklarimit në ILDKPKI).

- Në deklaratat e Interesave Private Periodike Vjetore në Farmat Elektronik për subjekte në funksion, shtetasi **Sali Berisha** për vitin 2021, dorëzuar më datë 24.11.2022, me funksion Deputet, Kuvendi i Shqipërisë, në Seksionin Detyrime Financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, ka deklaruar:
 1. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime konsulence në SHBA nga 07.10.2021. Shuma totale 3,794.45 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, 1/4 pjesë takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve të konsulencës në masën 15,177.80 euro në SHBA.
 2. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 25.06.2021. Shuma totale 2,325 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 9,300 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
 3. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 27.10.2021. Shuma totale 525 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 2,100 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
- Në seksionin Detyrimet Financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, shtetasja **Liri Berisha** ka deklaruar:
 1. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime konsulence në SHBA nga 07.10.2021. Shuma totale 3,794.45 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, 1/4 pjesë takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve të konsulencës në masën 15,177.80 euro në SHBA.
 2. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 25.06.2021. Shuma totale 2,325 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 9,300 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
 3. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 27.10.2021. Shuma totale 525 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 2,100 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
- Në deklaratat e Interesave Private Periodike Vjetore në Farmat Elektronik për subjekte në funksion shtetasi Sali Berisha për vitin 2021, dorëzuar më datë 24.11.2022, me

funksion Deputet, Kuvendi i Shqipërisë, bashkëlidhur është deklarimi i shtetasës **Argita Malltezi** e bija si person i lidhur. Në seksionin Detyrimet Financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, shtetasja Argita Malltezi ka deklaruar:

1. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime konsulence në SHBA nga 07.10.2021. Shuma totale 3,794.45 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, 1/4 pjesë takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve të konsulencës në masën 15,177.80 euro në SHBA.
 2. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 25.06.2021. Shuma totale 2,325 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 9,300 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
 3. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 27.10.2021. Shuma totale 525 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 2,100 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
- Në deklaratat e Interesave Private Periodike Vjetore në Farmat Elektronik për subjekte në funksion shtetasi Sali Berisha për vitin 2021, dorëzuar më datë 24.11.2022, me funksion Deputet, Kuvendi i Shqipërisë, bashkëlidhur është deklarimi i shtetasit **Shkëlzen Berisha**. Në seksionin Detyrimet Financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, shtetasi Shkëlzen Berisha ka deklaruar:
1. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime konsulence në SHBA nga 07.10.2021. Shuma totale 3,794.45 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, 1/4 pjesë takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve të konsulencës në masën 15,177.80 euro në SHBA.
 2. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 25.06.2021. Shuma totale 2,325 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 9,300 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
 3. Detyrim ndaj të tretëve Jamarbër Malltezi, me qëllim shpenzime avokatie nga 27.10.2021. Shuma totale 525 euro. Shënime: Sa i detyrohem Jamarbër Malltezi, për pjesën takuese të likuidimit nga ana e tij të shpenzimeve avokatore në masën 2,100 euro, pranë zyrës ligjore në Francë për çështjen Antony Blinken.
 4. Në vitin 2021 shtetasi Shkëlzen Berisha ka deklaruar detyrimin ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi në shumën 27,439.98 usd (gjendje e detyrimt pa u shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit). Deklaruar edhe në DVIP 2017.
 5. Gjithashtu ka deklaruar detyrimin ndaj shtetasit Jamarbër Malltezi në shumën 18,000 euro (gjendje e detyrimt pa u shlyer deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit). Deklaruar edhe në DVIP 2014.

Viti 2022: 72,004.87 dollarë (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga vajza Argita Malltezi, sipas vetëdeklarimit të shtetasit Sali Berisha në ILDKPKI. Paguesa është kryer nga shtetasja Argita Malltezi sipas konfirmimeve bankare për ZAIËALLA And Co Limited).

Në deklaratën e Interesave Private Periodike vjetore shtetasi Sali Berisha për vitin 2022, data e dorëzimit të deklaratës 31.03.2023, me funksion Deputet, Kuvendi i Shqipërisë, ka deklaruar:

- Në seksionin personat fizikë/ juridikë dhe persona të besuar, shtetasi Sali Berisha ka deklaruar pagesë avokatie të bëra nga vajza në shumën 72,004.87 dollarë.

- Gjithashtu në deklarin e saj shtetasja Argita Malltezi në vitin 2022, në seksionin personat fizikë/ juridikë dhe persona të besuar deklaroi: Sa likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore, në shumën 72,004.87 dollarë.

Nga të dhënat bankare pagesat janë bërë nga llogaria me nr. 201182-USD-3839000000-01-001, monedha dollarë e shtetases Argita Malltezi si vijon:

- Datë 11.08.2022, shuma 49,093.34 dollarë, përfitues ZAIWALLA AND CO LIMITED CLIENT, përshkrimi "P220811AFNSOP08 18478577 REF KM/ZF/BERISHA CONTRACT, PAYMENT DT 10 08 2022".
 - Datë 19.09.2022, shuma 22,911.53 dollarë, përfitues ZAIWALLA AND CO LIMITED CLIENT, përshkrimi "P220919AJN6OP08 18765782 REF KM/ZF/BERISHA CONTRACT PAYMENT DT 10 08 2022".
- Total 72,004.87 dollarë.

(Pagesa është kryer nga shtetasja Argita Malltezi për ZAIWALLA And Co Limited).

Viti 2023: 201,675.6 euro dhe 54,382.76 usd (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga shtetasja Argita Malltezi për babain Sali Berisha. Ka gjithashtu disa pagesa nga Jamarbër Malltezi por ato i kreditohen në llogari këtij shtetasi nga Argita Malltezi).

Viti 2023: Përgjatë vitit 2023 shtetasja Argita Malltezi ka vijuar të kryejë pagesat për studion e avokatisë ZAIËALLA and co Limited në shumën totale 201,675.6 euro dhe 54,382.76 usd detajuar si vijon:

- Pagesa datë 29.06.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001, 8000201182, monedha euro, shuma 69,828.4 euro, me përshkrim "P230629AGLYOP08 21227084 REFERENCE BER0031, INV NO KM230623 DT23 06 2023 AND INV NO11200 DT22 06 2023 LEGAL FEES 33,815GBP AND ADVANCE PAYMENT26 185GBP KM/ZF/BER0031", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 31.10.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001, 8000201182, monedha euro, shuma 28,745.84 euro, me përshkrim "P231031AHM8OP08 22424280 MONIES ON ACCOUNT OF PRO-FORMA INVOICE NO 1610231 REF KM/ZF/BER0031 DT 16OCTOBER2023 SALI BERISHA", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 31.10.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001, 8000201182, monedha euro, shuma 32,298.14 euro, me përshkrim P231031AHMHOP08 22423470 PAYMENT FOR INVOICE NO KM0011269 REF KM/ZF/BER0031 DATE AND TAX POINT 16 OCTOBER 2023 DR SALI BERISHA", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 06.09.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-USD-3839000000-01-001, 60201182, monedha dollarë, shuma 54,382.76 USD, me përshkrim "P230906ALM7OP08 21915523 ADVANCE PAYMENT PRO - FORMA INVOICENO BER2108 DT21 08 2023 AND INVOICENO KM0011232 21 AUGUST 2023 REF KM/ZF/BER0031 SALI BERISHA", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 04.01.2023 nga llogaria e shtetasi Jamarbër Malltezi në Union Bank me numër 13398964650127, monedha euro, shuma 47,348.25 euro, me përshkrim "Int Outg MT nga llogaria PMT OF INVOICE NO. ZF0011134 DT. 14.12.2022 ZAIËALLA AND CO LTD.CLIENT ACCOUNT FLEET STREET ËC 1 VBPL", përfitues ZAIËALLA& co.

Më datë 27.01.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në ABI Bank me numër 000055027, monedha euro, është transferuar shuma 47,348 euro, me përshkrim "rimbursim fondi për faturën / Payment details ZF0011134 dt 14.12.2022 në favour të ZAIWALLA & co", me përfitues Jamarbër Malltezi, shumë e cila kreditohet në llogarinë e shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank me numër 13398964650127, monedha euro më datë 30.01.2023

- Pagesa datë 03.03.2023 nga llogaria e shtetasit Jamarbër Malltezi në Union Bank me numër 13398964650127, monedha euro, shuma 23,455.22 euro, me përshkrim "Int Outg MT nga llogaria PMT OF INVOICE NO. 010323 DT. 01.03.2023 ZAIWALLA AND CO LTD CLIENT ACCOUNT HALBORN TOËER 137-144 HALBORN", përfitues ZAIWALLA & co.

Më datë 16.05.2023 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001, 8000201182, monedha euro, është transferuar shuma 23,527 euro, me përshkrim "rimbursim i pageses se avokatit fatures atatch", me përfitues Jamarbër Malltezi.

2024: 213,590.27 euro (Likujduar faturat e studios ligjore në UK në lidhje me praktikën ligjore nga shtetasja Argita Malltezi për babain Sali Berisha).

Viti 2024: Përgjatë vitit 2024 shtetasja Argita Malltezi ka vijuar të kryejë pagesat për studion e avokatisë ZAIWALLA and co Limited dhe një pagesë për Fergus M H Randoloh Qc lidhur me faturë shpenzimesh për Sali Berisha (3,664.67 euro), në total pagesat në shumën totale **213,590.27 euro**.

- Pagesa datë 31.01.2024 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001,8000201182, monedha euro, shuma 41,988.15 euro, me përshkrim "P240131AIPFOP08 23255913 PAYMENT FOR INVOICE NO KM0011300 REF KM/ZF/BER0031 DATE AND TAX POINT 9 JANUARY 2024 DR SALI BERISHA", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 05.02.2024 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001,8000201182, monedha euro, shuma 144,052.44 euro, me përshkrim "P240205AJHOP0823303177PAYMENT FOR INV NO 310124 DT JAN31,24MONSIEER AND ACCOUNT COUNSEL FEE AND INV 3101241 DT31JAN24 FEE JAN/FEB24 REFERENCE KM/ZF/BER0031", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 18.06.2024 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001,8000201182, monedha euro, shuma 11,935.41 euro, me përshkrim "P240618AR6VOP08 24648173 PAYMENT FOR OUR REF KM/ZF/BER0031 INV NO 170624 DATE 17 JUNE 2024 DR SALI BERISHA FOR OUR TIME INCURRED FROM 1 APRIL 2024 TO 17 JUNE 2024", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 26.06.2024 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001,8000201182, monedha euro, shuma 11,949.56 euro, me përshkrim "P240626AIG2OP08 24727198 PAYMENT FOR OUR REF KM/ZF/BER0031 INV NO 240624 DATE 25 06 2024 COSTS OF APPEAL", me përfitues ZAIWALLA AND CO LTD.

- Pagesa datë 31.01.2024 nga llogaria e shtetases Argita Malltezi në Raiffeisen Bank me numër 201182-EUR-3824000000-01-001, 8000201182, monedha euro, shuma 3,664.67 euro, me

përshkrim "P240131AITÉOP08 23257651 PAYMENT OF INVOICE NO INVFR744 CASE REF NO 107108 DATE 08 12 2023", me përfitues FERGUS M H RANDOLPH QC.

Pagesa te shoqerise Homeplan sh.p.k. për këngëtarin Ricardo Cocciante

435. Përgjatë vitit 2013, në kohën e fushatës zgjedhore, rezulton se mbështetur në kërkesën dhe kujdesin e veçantë shtetasit Kryeministrit Sali Berisha, Ministri i Kulturës, ka ftuar këngëtarin Riccardo Cocciantë, të vijë në Shqipëri. Ky i fundit ka ardhur i shoqëruar me bashkëshorten e tij, këngëtarene Elhaida Dani dhe një gazetar italian. Në vetë dokumentat e Ministrisë së Kulturës paraqitet si mbështetës shtetasi Fatmir Bektashi, por nga aktet ka rezultuar se pagesat për akomodim dhe udhëtim të këtyre shtetasve janë kryer nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në një vlerë në total prej **676 250 lekësh**.

Akomodimi në Hotel Sheraton nga data 07.06.2013 deri më datë 09.06.2013 janë kryer nga shoqëria Homeplan sh.p.k. në vlerën 800 euro. Nga sistemi tatimor rezulton se shoqëria Mak Albania ka deklaruar shitje në shumën 120 822 lekë për shoqërinë Homeplan sh.p.k.

Me Faturën tatimore të shitjes nr. 312 datë 11.06.2013, e lëshuar nga Albania experience për shoqërinë Homeplan sh.p.k. dokumentohet gjithashtu të jenë paguar biletat e udhëtimit "*Bileta udhëtimi sipas faturës bashkangjitur*" në vlerën **3171.72 euro** dhe automjet me qera sipas faturës bashkangjitur në vlerën 770 euro, gjithsej 3941.72 euro ose në shumën totale **446 927 lekë**. Bashkalidhur janë të dhënat e faturës nr 312 datë 11.06 lëshuar nga Albania Experience për Homeplan sh.p.k. në një vlerë të përgjithshme prej **446 927 lekë, për shtetasit: Elhaida Dani, Riccardo Cocciantë, C. Cocciantë, G.Papi, Nausika Spahia** për pagim biletash udhëtimi. Nga kqyrjet e zhvilluara pranë subjektit Landeays International sh.p.k. rezulton se kjo shoqëri konfirmon faturat si më sipër dhe në kartelën e klientit, të kësaj shoqërie parashtrohet në lidhje me faturën e mësipërme, datë 11.06.2013 të dhëna në lidhje me blerje dhe automjete, në vlerën **555 428 lekë**.

436. Konstatohet se më datë 07.06.2013 është bërë një publik në gazetën Panorama online, ku është pasqyruar se kantautori Riccardo Cocciantë, do të vijë në Tiranë përmes një njoftimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportive, me ftesë të TKRS-së Visar Zhiti nën kujdesin e kryeministrit Sali Berisha.

Me shkresën nr. 4729/1 prot datë 16.04.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, na është vendosur në dispozicion praktika në lidhje me vizitën zyrtare të këngëtarit italian Riccardo Cocciantë. Konkretisht nga aktet rezulton se:

Me shkresën nr. 3130 prot datë 03.06.2013 Minsitria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri Visar Zhiti i është drejtuar shtetases Nausika Spahia, Konsulle e përgjithshme e RSH në Milano/Itali, duke i kërkuar mbështetjen dhe ndërhyrjen për t'i komunikuar këngëtarit të famshëm italian Riccardo Cocciantë dhe këngëtares së re nga Shkodra, Elhaida Dani, ...për të ardhur në Tiranë në një datë sa më të shpejtë në përputhje me axhendën e konsullës për të marrë pjesën e një ceremoni të veçantë nderimi nën kujdesin e veçantë të kryeministrit të Vendit **Sh.T. Z. Sali Berisha**.

Bashkalidhur është edhe ftesa për këngëtarin Riccardo Cocciantë me nr 3136/1 prot datë 03.06.2013 e nënshkruar po nga ministri Visar Zhiti.

Sa më sipër është dërguar edhe me email më datë 03.06.2013 nga shtetësja Shpresa Sulo, punonjëse e Minsitrisë. Me emailin e datës 04.06.2013 shtetësja Nausika Saphia i kthen përgjigje shtetësës Shpresa Sulo, pranë Ministrisë së Kulturës duke i bërë me dije se z. Cocciente ka pranuar me kënaqësi ftesën dhe jep edhe itinerarin e udhëtimit.

Me urdhërin nr 160 datë 05.06.2013 të Ministrit të Kulturës Visar Zhiti "Për mbulimin e shpenzimeve të pritjes së këngëtarit të mirënjohur italian Riccardo Cocciente i cili do të vijë për ceremoninë e dekorimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë" më datë 07 – 09 qershor 2013, për ceremoninë e dekorimit më datë 08.06.2013, është urdhëruar mbulimi i shpenzimeve për pritjen zyrtare të këngëtarit italian Riccardo Cocciente dhe këngëtares shqiptare Elhaida Dani ...të cilët do të vijnë në Tiranë për ceremoninë e dekorimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe pritja nga z. Kryeministër sipas programit bashkalidhur në shumën prej **98 500 lekë** (sipas preventivit bashkalidhur). Riccardo Cocciente do të vijë në Tiranë më datë 07.06.2013 dhe do të largohet më datë 09.06.2013 i shoqëruar nga bashkëshortja K.Cocciente, konsullja Nausika Spahiu, këngëtarja Elhaida Dani, gazetari italian i "La Repubblica" G.Pappi...Përkthyesë do të jetë Anila Ismailaj...Ngarkohet Fatos Korbi shef i sektorit të shërbimeve mbështetëse për lidhjen e kontratave të shërbimit me entet dhe personat që do ofrojnë shërbimin përkatës.

Preventivi përkatës në shumën 98 500 lekë ka shpenzime për dhurata dhe buqeta me lule dhe marrje me qera e luleve për skenën. Gjithashtu nga aktet evidentohet se Minsitria e Turizmit ka bërë edhe një pagesë për një shumë prej 6 000 lekësh për dy pllaka bakri,

Programi është:

Ora 11.40: Mbërritja e këngëtarit Riccardo Cocciente dhe bashkëshortes së tij në aeroportin Nënë Tereza (Alitalia)....Më datë 07.06.2013...Makina në dispozicion nga kompania Avis...

Ora 12.30: Mbërritja në Hotel Sheraton dhe akomodimi

Ora 13.00: Drekë në Hotel Sheraton

Ora 16.00: ...Mbërritja e këngëtares Elhaida Dani dhe Konsulles së përgjithshme të RSH në Milano Nausika Spahia në aeroportin Nënë Tereza dhe gazetarit të gazetës "La Repubblica" (nga Milano)....Makina në dispozicion nga Kompania Avis...

Ora 17: Mbërritja në Hotel Sheraton dhe akomodimi i pjesës tjetër të delegacionit...

Datë 08.06.2013:

Ora 08.30: Mëngjesi në Hotel

Ora 09.50: Nisja për në Presidencë

Ora 10.00 Takim me presidentin e Republikës së Shqipërisë Sh.T. Z. Bujar Nishani dhe ceremonia e dekorimit nga Presidenti i R.Shqipërisë

Ora 10.55 Nisja nga Kryeministri

Ora 11.00 Takim me kryeministrin R.Shqipërisë Sh.T.Z. Sali Berisha

Ora 12.00 Nisja për në Shkodër – vizitë në Shkodër

Ora 13.30: Drekë në Shkodër (restoranti ptk)

Ora 17.30 Kthimi për në Tiranë (Hotel Sheraton)

Ora 20.00 i ftuar në emision TV (ptk)

Datë 09.06.2013

Ora 08.30 Mëngjes në Hotel

Ora 11.00 Nisja për në aeroportin "Nënë Tereza" e këngëtarit Riccardo Cocciente dhe bashkëshortes së tij (largimi me litalia) salla Vip...

Sipas listës së personaliteteve të ftuar në ceremoninë e dekorimit të Ricardo Cocciantë, nga Presidenti, rezulton se, ndër të tjera i ftuar është edhe Fatmir Bektashi si mbështetës i vizitës së Ricardo Cocciantë si dhe shtetasi Luan Malltezi si drejtor i Muzeut Historik Komëbëtar.

Gjithashtu është realizuar kqyrje nga burime të hapura në lidhje me vizitën e këngëtarit si më sipër cituar ku nga kjo kqyrje rezultoi se:

Në artikullin me titullin Cocciantë dhe Elhaida mbërrijnë në Tiranë! (panorama.com.al) publikuar më datë Jun 7, 2013 | 15:01 ndër të tjera shkruhet se: *"Elhaida Dani e Riccardo Cocciantë mbërrijnë sot në Tiranë. Vajza që ka bërë të ndihen krenarë miliona shqiptarë dhe ka bërë për vete shumë italianë, fituesja e edicionit të parë të "The Voice of Italy", do të vijë e shoqëruar nga trajneri i saj, kantautori Riccardo Cocciantë. Përmes një njoftimi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, mësojmë se ata vijnë në Tiranë me ftesë të ministrit të TKRS-së, Visar Zhiti, nën kujdesin e Kryeministrit Sali Berisha. "Kjo vizitë organizohet në vlerësim dhe falënderim të kantautorit, i cili e udhëhoqi dhe e ndoqi me përkushtim dhe ndjeshmëri të pazakontë, performancën e saj në rritje", thuhet në njoftimin për shtyp. Riccardo Cocciantë dhe Elhaida Dani do të mbërrijnë sot në orën 11:45, në aeroportin "Nënë Tereza" në Rinas, ku do të priten nga përfaqësues të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Në orën 18:00 parashikohet një takim me ministrin Zhiti në ambientet e MYKRS dhe menjëherë pas tij do të zhvillohet edhe një konferencë për shtyp. Ndërsa nesër në orën 10:00 do të zhvillohet një takim me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, që do të pasohet nga një ceremoni dekorimi. Kalendari i vizitës së Elhaida Danit dhe Riccardo Cocciantës parashikon edhe një takim me Kryeministrin Sali Berisha"*

Në artikullin me titull Cocciantë dhe Elhaida në Tiranë - Top Channel (top-channel.tv) të publikuar më datë 07.06.2013 ndër të tjera shkruhet se: *"Pas ftesës zyrtare të MTKRS dhe kujdesit të kryeministrit Berisha, kantautori Riccardo Cocciantë dhe fituesja e "The Voice of Italy", Elhaida Dani, mbërritën në Tiranë ditën e premte. Ata u pritën nga ministri Zhiti, pranë ambienteve të Ministrisë dhe nga admirues. Cocciantë tha se ndihej i prekur nga vlerësimi i shqiptarëve, duke kthyer vëmendjen te suksesi i Elhaidës."*

Në artikullin e publikuar me titull Cocciantë vjen sot në Tiranë, dekorohet nesër nga Nishani - Vendi (orangees.tv) më datë 07.06.2013 ora 09:24 ndër të tjera është publikuar dhe axhenda si vijon: *"Riccardo Cocciantë dhe Elhaida Dani do të mbërrijnë sot në Tiranë, në aeroportin "Nënë Tereza", ku do të priten nga autoritetet e Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Mësohet se kantautori italian do të pritet në ambiente të MTKRS nga ministri Zhiti, dhe pasdite në orën 18:05, Cocciantë së bashku me këngëtarën Elhaida Dani do të dalin në një konferencë për mediat.*

Ndërkohë sipas njoftimit, zyrtar Cocciantë do të ketë nesër një takim me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, dhe do të dekorohet në një ceremoni nderimi në orën 10:00 dhe më pas në orën 11:00 do të ketë një tjetër takim me kryeministrin Sali Berisha.

AXHENDA

Sot

Ora 11:45 Mbërritja e këngëtarit Riçardo Cocciantë në aeroportin "Nënë Tereza"

Ora 16:00 Mbërritja e këngëtares Elhaida Dani në aeroportin "Nënë Tereza"

Ora 18.00 Takim me Ministrin e TKRS-së Z.Visar Zhiti në mjediset e MTKRS
Ora 18.15 Konferencë për shtyp në mjediset e MTKRS- Salla " Tefta Tashko

Nesër

Ora 10:00 Takim me Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Z.Bujar Nishani, dhe Ceremonia e dekorimit dhe nderimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë
Ora 11:00 Takim me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Z.Sali Berisha"

Pagesa per te trete

437. Shoqëria Homeplan sh.p.k. i ka paguar shtetasit Flamur Kuçi, në kohën që ky i fundit ka qenë këshilltar për Çështjet e territorit pranë Kryeministrit Sali Berisha në vitin 2012 paratë e biletës, në shumën **911 euro**.

Pagesa për Fondacionin nga shtetasit Malltezi

438. Gjithashtu konstatohet se një pjese parash nga te ardhurat e familjes Malltezi kane shkuar ne drejtim te Fondacionit Domenic Scaglione me president shettasen Liri Berisha. Konkretisht në periudhën 2010 – 2022 shtetasit Argita Malltezi dhe Jamarbër Malltezi, kanë sponsorizuar Fondacionin Fëmijët Shqiptarë, Domenick Scaglione, me president shtetasen Liri Berisha, në një shumë prej 8 599 647.6 leke, 24 171 euro euro, 8 225.89 USD

Referuar pagesave nga bankat e nivelit të dytë për OJF "FOND.I FEMJEVE SHQIP.DOMENICK SCAGLIONE" me nipt J91531002Ë

Viti 2010:

Llogaria bankare në bankën Intesa Sanpaolo Bank me nr. 1000231807 lek:

- Në llogarinë në monedhën lek të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar / Fluturo për Jetën / Domenick Scaglione, Erida Muka për llogari të Argita Malltezi ka transferuar më datë 10.09.2010 shumën 1,078,700 lekë.

Viti 2011:

- Llogaria bankare në bankën Intesa Sanpaolo Bank me nr. 1000231807 lek:
- Në llogarinë në monedhën lek të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar / Fluturo për Jetën / Domenick Scaglione, Erida Muka për llogari të Argita Malltezi ka transferuar më datë 15.04.2011 shumën 69,410 lekë.
- Në llogarinë në monedhën lek të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar / Fluturo për Jetën / Domenick Scaglione, Argita Malltezi (Ariela Shigjini) ka transferuar më datë 25.08.2011 shumat 360,000 lekë dhe 180,000 lekë.
- Në llogarinë në monedhën lek të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar / Fluturo për Jetën / Domenick Scaglione, Argita Malltezi (Ariela Shigjini) ka transferuar më datë 26.08.2011 shumën 25,300 lekë.
- Në llogarinë në monedhën lek të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar / Fluturo për Jetën / Domenick Scaglione, Argita Malltezi ka transferuar më datë 29.08.2011 shumat 360,000 leke dhe 46,000 lekë.

Viti 2012:

Llogaria bankare në bankën Intesa Sanpaolo Bank me nr. 1000231804 monedha euro

- Në llogarinë në monedhën euro të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, Argita Malltezi ka transferuar më datë 07.09.2012 shumën 7350 euro.

Viti 2013:

Llogaria bankare në bankën Intesa Sanpaolo Bank me nr. 1000231801 usd

- Në llogarinë në monedhën dollar të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione Argita Malltezi, ka transferuar më datë 17.07.2013 shumat: 3000 usd; 3600 usd; 1625.89 usd.

Viti 2014:

- Argita Malltezi nga llogaria Procredit bank 128486700001 monedha lek, ka transferuar drejt Fondacionit Fëmijët shqiptarë më datë 06.10.2014 shuma 1,080,000 lekë.

Viti 2015:

- Argita Malltezi nga llogaria Procredit bank 128486700001 monedha lek, ka transferuar drejt Fondacionit Fëmijët Shqiptarë më datë 13.07.2015 Domenick Scaglione shuma 1,080,000 lekë.

Viti 2016

- Nga llogaria Raiffeisen Bank 815451-ALL-3824000000-01-001 në emër të Jamarbër Malltezi, Pagesë për Fondacioni Fëmijët Shqiptarë, më datë 29.06.2016, pagesë për Zekat 1,080,237.6 lekë. Kjo shumë është pasqyruar në llogarinë e Fondacionit nr. 1000231800 në monedhën lekë.

Viti 2017:

- Nga llogaria në bankën Intesa Sanpaolo nr. 40201835102 euro, në emër të Jamarbër Malltezi, më datë 20.06.2017, Sponsorizim për 3 fëmijë për 1 vit për Fondacioni i Fëmijëve shqiptar 8,181 euro. Kjo shumë është pasqyruar në llogarinë e Fondacionit nr. 1000231800 në monedhën lekë, dt. 20.06.2017 në shumën 1,080,000 lekë me përshkrim "sponsorizim për 3 fëmijë për 1 vit".

Viti 2018:

- Nga llogaria në bankën Intesa Sanpaolo nr. 40201835102 euro, në emër të Jamarbër Malltezi, më datë 31.05.2018, Sponsorizim per 3 femije me autizem, Fondacioni i Femijeve shqiptare, doren tuku, kejsi nunaj olkid balidemaj 8,640 euro. Kjo shumë është pasqyruar në llogarinë e Fondacionit nr. 1000231800 në monedhën lekë, dt. 31.05.2018 në shumën 1,080,000 lekë me përshkrim "sponsorizim për 3 fëmijë me autizëm Doren Tuku, Kejsi Nunaj, Oklid Balidemaj".

Viti 2019:

- Nga llogaria në bankën Union nr. 113398964010114 lek, në emër të Jamarbër Malltezi, më datë 28.05.2019, me përshkrim "transf nat out -llogar Jamarber Malletzi për fondacioni fëmijet shqiptare kalim për sponsorizim", 1,080,000 lekë. Kjo shumë është pasqyruar në llogarinë e Fondacionit nr. 1000231800 në monedhën lekë, dt. 28.05.2019 në shumën 1,080,000 lekë me përshkrim "kalim për sponsorizim sipas kontratës dt. 27.05.2019".

Viti 2021:

- Në llogarinë në monedhën Euro me nr. 1000231804 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, Jamarbër Malltezi ka transferuar më datë 14.09.2020 shumën 8,700 euro.

- Në llogarinë në monedhën Lek me nr. 1000231800 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, Jamarbër Malltezi ka transferuar më datë 03.08.2021 shumën 1,080,000 lekë me përshkrimin “pagesë sipas kontratës së sponsorizimit”.

Viti 2022:

- Në llogarinë në monedhën Lek me nr. 1000231800 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, Jamarbër Malltezi ka transferuar më datë 19.09.2022 shumën 1,080,000 lekë me përshkrimin “pagesë sipas kontratës së sponsorizimit datë 02.09.2022”.

Pagesa për Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione nga shoqëritë Homeplan sh.p.k. dhe Kontakt sh.p.k.

Viti 2016

- Në llogarinë në monedhën Euro me nr. 1000231804 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, shoqëria “Homeplan” sh.p.k ka transferuar më datë 21.12.2016 shumën 11,855 euro.
- Në llogarinë në monedhën Euro me nr. 1000231804 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, shoqëria “Homeplan” sh.p.k ka transferuar më datë 29.12.2016 shumën 6,679.62 euro.

Viti 2021:

- Në llogarinë në monedhën Euro me nr. 1000231804 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, shoqëria “Homeplan” sh.p.k ka transferuar më datë 30.12.2021 shumën 1,970 euro.

Viti 2022:

- Në llogarinë në monedhën Euro me nr. 1000231804 të Fondacionit të Fëmijëve Shqiptar Domenick Scaglione, shoqëria “Kontakt” sh.p.k ka transferuar më datë 27.12.2022 shumën 30,000 euro me përshkrimin “*Likujdim fatura 4/2022*”. “*Sponsorizim per Vitin e Ri*”

Konkluzion

439. Përsa më sipër, vlerësohet se rezulton plotësisht e provuar se shtetasi Sali Berisha, ka konsumuar vepren penale të korrupsionit, e për këtë arsye, duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale të “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunim me shtetasin Jamarbër Malltezi, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

Sa më lart provohet me:

- Aktet e administruara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Keshilli i Ministrave, Kuvendi i R.Shqiperise,
- Akte të administruara nga Universiteti Politeknik i Tiranës,
- Aktet e administruara nga ASHK, Agjensia e Kthimit të Pronave,
- Akte të administruara nga organet tatimore dhe ato të kqyrura nga sistemet e tyre;

- Të dhëna të administruara nga sistemi TIMS;
- Deklarimet e shtetasve si Odeta Fishta, Andia Pustina, Fatmir Bektashi, Marin Biçoku, Besnik Dervishi, Suzana Aliaj, etj.
- Aktet e ekspertimit grafik, teknik, kompjuterike, telefonike, ne fushen e ndertimit, kontabel, etj.
- Akte te administruara nga bankat e nivelit te dyte;
- Akte të sekuestruara pranë studio Pustina, pranë shoqërisë Homeplan,
- Akte te administruara ne QKB;
- Akte te administruara nga gjykatat dhe prokurorite;
- Akte te administruara nga Bashkia Tirane, etj.

Si dhe gjithë aktet e tjera të përfshira në fashikullin e procedimit penal.

Persa me sipër, bazuar ne nenin 34 te K.Pr.Penale,

VENDOSËM:

1. Te marrim si te pandehur shtetasin:

- **Sali Berisha**, i biri i Ram dhe i Shiqere, datëlindja 15.10.1944, lindur në Tropojë, me nr. personal E40701031R, me masë sigurimi personal "arrest në shtëpi" parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale,

duke e akuzuar se ka kryer veprën penale të "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë", kryer në bashkëpunim me shtetasin Jamarbër Malltezi, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.

2. Te njoftoj me kete vendim te pandehurin dhe/ose mbrojtësin e tij.

PROKURORË

ARBEN KRAJA

ENKELEDA MILLONAI

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij morën dijeni për aktin e njoftimit të akuzës në orën _____, të datës _____.

I pandehuri

Mbrojtësi